

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË

SHQIPJA DHE GJUHËT E BALLKANIT

ALBANIAN AND BALKAN LANGUAGES

Konferencë shkencore e mbajtur më 10-11 nëntor 2011 në Prishtinë
Scientific Conference held on 10-11 November 2011 in Prishtina



PRISHTINË
2012

KOSOVA ACADEMY OF SCIENCES AND ARTS

ACADEMY OF SCIENCES OF ALBANIA

ALBANIAN AND BALKAN LANGUAGES

Scientific Conference held on 10-11 November 2011 in Prishtina

Editor
Academician Rexhep Ismajli



PRISHTINA
2012

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË

SHQIPJA DHE GJUHËT E BALLKANIT

Konferencë shkencore e mbajtur më 10-11 nëntor 2011 në Prishtinë

Redaktor
Akademik Rexhep Ismajli



PRISHTINË
2012

**Programi i punës i Konferencës shkencore “Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit”,
Prishtinë 10-11 nëntor 2011**

E enjte, 10 nëntor 2011

Ora 9:00

Seancën e drejtojnë: Besim **BOKSHI**, Irena **SAWICKA**, Kolec **TOPALLI**

1. Rexhep **ISMAJLI**, Prishtinë:

Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit – fjala e hapjes

2. Idriz **AJETI**, Prishtinë:

Shqipja dhe gjuhët fqinje

3. Besim **BOKSHI**, Prishtinë:

Format e futurit të shqipes në raport me gjuhët e Ballkanit

4. Bardhyl **DEMIRAJ**, Muenchen:

Velle futurum si dukuri dialektore dhe ballkanike në gjuhën shqipe

5. Seit **MANSAKU**, Tiranë:

Tipologji romane dhe ballkanike në strukturën gramatikore të shqipes

6. Francesco **ALTIMARI**, Cosenza:

Disa ndikime të greqishtes në fjalëformimin foljor të arbërishtes së Italisë

Ora 11:30

Seancën e drejtojnë: Bahri **BECI**, Heiner **EICHNER**, Francesco **ALTIMARI**

1. Heiner **EICHNER**, WIEN:

Protoshqipja në mesin e gjuhëve të lashta të Ballkanit

2. Wilfried **FIEDLER**, Meissen:

Disa veçori të urdhërores në gjuhët ballkanike

3. Victor **FRIEDMAN**, Chicago:

Problemi i urdhërores treguese në gjuhën shqipe dhe në gjuhët e tjera të Ballkanit

4. Shaban **DEMIRAJ**, Tiranë:

Ç’ dëshmon mënjanimi i paskajores në gjuhët ballkanike?

5. Irena **SAWICKA**, Warszawa:

Lidhjet fonetike të shqipes në kontekst ballkanik

6. Bahri **BECI**, Paris:

Konsiderata të përgjithshme për rolin e shqipes në formimin e bashkësisë gjuhësore ballkanike

7. Ethem **LIKA**, Tiranë:

Karakteristika tipologjike të shqipes

Ora 15:30

Seancën e drejtojnë: Victor **FRIEDMAN**, Shefki **SEJDIU**, Bardhyl **DEMIRAJ**

1. Bardh **RUGOVA**, Prishtinë:

Pozita dhe statusi i shqipes kundruall gjuhëve të tjera të Ballkanit

2. Kolec **TOPALLI**, Tiranë:

Shtresimi i huazimeve nga gjuhët ballkanike në një fjalor etimologjik

3. Rexhep **ISMAJLI**, Prishtinë:

Shqipja dhe rumanishtja

4. Marcus **GABINSCHI**, Chişinău:
Saktësime rreth fondit leksikor të quajtur „rumuno-shqiptar”
5. Shefki **SEJDIU**, Prishtinë:
Gjurmë interferimesh emërtimi helen(iko)-greke, ilir(iko)-albane dhe ital(iko)-romane në fushë të etnonimisë
6. Teuta **ABRASHI**, Prishtinë:
Nyja e prapavendosur në gjuhët e Ballkanit – ngjashmëri dhe dallime morfosintaksore
7. Aristotel **SPIRO**, Tiranë:
Përsëritja e nyjës para elementeve të sintagmës në shqipe dhe greqishte dhe problemi i nyjës shquese në shqipe

Ora 17:30

Seancën e drejtojnë: Rexhep **ISMAJLI**, Leonardo **SAVOIA**, Seit **MANSAKU**

1. Matteo **MANDALÀ**, Palermo:
Mbi turqizmat në të folmet arbëreshe
2. Gjorgji **BUFLI**, Trieste:
Kontaktet ndërgjuhësore ballkanike në rastin e turqizlave
3. Lindita **LATIFI**, Tiranë:
Për një fjalor ballkanik të turqizlave
4. Skender **GASHI**, Wien:
Gjurmë të latinitetit e të romanitetit ballkanik në mikrotoponiminë e Kosovës
5. Evalda **PACI**, Tiranë:
Elemente latine në shqipen dhe rumanishten, veshtrim semantik dhe tipologjik
6. Qemal **MURATI**, Prishtinë:
Shqipja dhe maqedoarumanishtja nga aspekti i kontakteve midis tyre
7. Artur **KARASIŃSKI**, Torunj:
Një projekt për fjalëformimin ballkanik

E premtë, 11 nëntor 2011**Ora 9:00**

Seancën e drejtojnë: Murat **BLAKU**, Matteo **MANDALÀ**, Ethem **LIKA**

1. Remzi **PËRNASKA**, Paris:
Bashkësia e “trajtave të shkurtra të përemrit vetor” dhe zgjedhimi subjektor-objektor sui generis në gjuhën shqipe dhe në gjuhët ballkanike
2. Rita **MANZINI** & Leonardo **SAVOIA**, Firenze:
Case as Nominal Property: the Interaction of DOM and Discourse-linking in Shkodër Pronouns
3. Giovanni **BELLUSCIO**, Cosenza:
Si shqiptohet shqipja në Ballkan?
4. Blertë **ISMAJLI**, Prishtinë:
Sa ballkanike janë mënyrat e foljeve të shqipes? Kushtorja dhe habitorja
5. Julie **KOLGJINI**, Prishtinë:
Një strukturë alternative foljore në gjuhën shqipe: ndikimi prej një gjuhe të arealit ballkanik

6. Dieter **NEHRING**, Berlin:

Shqipja dhe gjuhët ballkanike në arsimin shkollor tek shqiptarët dhe fqinjët e tyre

Ora 11:30

Seancën e drejtojnë: Imri **BADALLAJ**, Anila **OMARI**, Skender **GASHI**

1. Murat **BLAKU**, Prishtinë:

Interferenca të shqipes në gjuhët sllave të jugut

2. Xhelal **YLLI**, Heidelberg:

Rreth vlerësimit të huazimeve sllave në gjuhën shqipe

3. Marjan **MARKOVIĆ**, Shkup:

Balkan-Slavic lexical parallels

4. Imri **BADALLAJ**, Prishtinë:

Infinitivi në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe

5. Anila **OMARI**, Tiranë:

Shtresëzimit kronologjik dhe shtrirja dialektore e huazimeve sllave të shqipes së shek. XVII

6. Shkumbin **MUNISHI**, Prishtinë:

Probleme të zbatimit të dygjuhësisë shqip/serbisht në Kosovë

7. Haxhi **SHABANI**, Ulqin:

Ndikimi i gjuhës malazeze në emrat dhe mbiemrat e njerëzve

Ora 15:00

Seancën e drejtojnë: Bardh **RUGOVA**, Maria **MOROZOVA**, Remzi **PËRNASKA**

1. Martin **SUROVČÁK**, Brno:

Mallkimi si çështje e frazeologjisë ballkanike

2. Monica **GENESIN** & Domenico **MARTUCCI**, Bari:

Perceptimi i gjuhës dhe i kulturës shqipe nëpërmjet vëllimeve: “Le terre albanesi redenti: Cossovo” (1942) dhe “Le terre albanesi redenti: Ciamuria” (i pabotuar)

3. Dhori **QIRJAZI**, Selanik:

“Mjaltë” nga hojet dhe trojet e shqipes: Fjalori dorëshkrim shqip-greqisht i Th. Mitkos dhe suaza e tij ballkanike

4. Besim **KABASHI**, Erlangen:

Korpuse gjuhësore për shqipen

5. Timofej **ARKHANGELSKIJ** (Moskva), Mikhail **DANIEL** (Moskva), Maria **MOROZOVA** (S.-Peterburg), Aleksandër **RUSAKOV** (S.-Peterburg):

Korpusi i gjuhës shqipe: drejtimet kryesore të punës

6. Nebi **CAKA**, Ali **CAKA**, Prishtinë:

Korpusi i gjuhës shqipe – rezultatet e para, problemet dhe detyrat

Ora 17:00

Mbyllja e Konferencës – Kolec **TOPALLI**

Ora 17:30

Vizitë në Muzeun e Kosovës

shtunë, 12 nëntor 2011 Ora 8:30

Nisja për Gjakovë, Prizren para Grand Hotel Prishtina

SHQIPJA DHE GJUHËT E BALLKANIT
ALBANIAN AND BALKAN LANGUAGES
Konferencë shkencore - Scientific Conference

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
KOSOVA ACADEMY OF SCIENCES AND ARTS

AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË
THE ACADEMY OF SCIENCES OF ALBANIA

Prishtinë, 10-11 nëntor/ November 2011

Këshilli organizues i Konferencës
Organizing Board of the Conference

Akademik Rexhep Ismajli
Akademik Besim Bokshi
Akademik Idriz Ajeti
Akademik Kolec Topalli
Prof. dr. Seit Mansaku

Rexhep ISMAJLI, Prishtinë

SHQIPJA DHE GJUHËT E BALLKANIT

Kolege dhe kolegë, pjesëmarrës të nderuar,

Dy akademitë tona e kanë parë të arsyeshme të sillnin në fokus të interesimit tuaj temën “Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit” për shumë arsye. Së pari, shqipja si degë më vete e grupit indoeuropian krahasohet me gjuhët e tjera të tij për qëllime rindërtimi të fazave më të hershme dhe të raporteve midis tyre. Këto interesime shtyhen në kohë qysh në shekullin XIX.

Studimet për shqipen si degë më vete të grupit të gjuhëve indoeuropiane, natyrisht pas ngjitjes në kohë më të hershme të saj vetëm tërthorazi përmes kontakteve pjesërisht të dokumentuara, kanë interes sa krahasimi me gjuhët IE të pranishme në Ballkan, konkretisht me greqishten, me latinishten dhe romanitetin ballkanik dhe me kompleksin e gjuhëve sllave. Krahasimet e tilla më së shpeshti janë të natyrës gjenetike dhe ndërlidhen me sfondin më të gjerë IE. Në këtë sfond hyjnë dhe krahasimet me gjuhët e lashta joklasike të Ballkanit – kompleksi ilir përfshirë mesapishten, kompleksi trako-dako-mez, frigishtja, makedonishtja, etj. Gjithsesi afrinë gjenetike të shqipes me gjuhët e tjera IE janë më të largëta në kohë, prandaj shpesh më vështirë të identifikueshme për shkak të shkrimit të saj të vonë. Dokumentimi më i hershëm i gjuhëve të tjera IE potencialisht të afra me shqipen, si gjuhët sllave, greqishtja, latinishtja, armenishtja, gjuhët gjermanike, gjuhët keltike dhe krahasimi me gjuhët baltike, të dëshmuara po ashtu vonë, por mbase me afri me shqipen në një fazë shumë të hershme, kanë bërë të mundur emetimin e një numri hipotezash për lidhjet e saj të lashta me ato gjuhë dhe për vendin e saj në kuadër të gjuhëve IE. Në atë kontekst janë diskutuar edhe çështje të raporteve të saj me gjuhët joklasike të Ballkanit të lashtë, dokumentimi i të cilave është krejtësisht i pamjaftueshëm. Sado që mbi bazë evidencash të reduktuara, diskutimet lidhur me këto aspekte të krahasimit kanë qenë pasionante. Kanë mbisunduar çështje leksikore, gjithsesi jo gjithnjë shumë diskriminue-

se për aspektet gjenetike të studimit. Hipotezat e emetuara për lidhjet e supozuara të shqipes me ndonjërin prej atyre gjuhëve shpesh janë mbështetur në argumentime të natyrës historiko-kulturore, gjeografike, sepse cilësia, sasia dhe autenticiteti i elementeve të krahasueshme lënë për të dëshiruar. Ilirishtja dokumentohet: me pak glosa, me më shumë material onomastik (emra njerëzish, emra vendesh, fisesh e popujsh) në Ballkan; mesapishtja me pak mbishkrime të fragmentuara dhe ende jo krejt të interpretuara në Itali të Jugut, për të cilën mendohet të ketë qenë e afërt me ilirishten (Hamp 1957, Katičić 1976, Çabej 1976, Cimochoowski 2004, Matzinger 2005). Trakishtja, për të cilën ka pasur shumë shqyrtime në këtë gjysmë shekulli, është dokumentuar po ashtu me pak glosa, më shumë materiale onomastike (emra njerëzish, vendesh, perëndish, fisesh e popujsh), emra bimësh dhe, çka është shumë e rëndësishme, me disa mbishkrime vërtet jo shumë të gjata, por që ende presin interpretimin e pranueshëm. Studimet trakologjike kanë përjetuar një gjallëri të shënueshme në Bullgari dhe Rumani (Detschew 1957, Duridanov 1976, Georgiev 1977, Neroznak 1978, Poghirc 1983, Vraciu 1980, Brixhe-Panayotou 1994). Dakishtja, dakomezishtja, getishtja, dako-geto-mezishtja me emërtime të ndryshme dhe të ndryshueshme ka qenë objekt diskutimesh të shumta pas publikimit të idesë së Georgiev-it për konceptinin e saj si gjuhë më vete; diskutimet janë shtuar shumë në Rumani. Frigishtja është dokumentuar dhe interpretuar më mirë për fazën e saj anatolike. Ka pasur diskutime jo të pakta për makedonishten, e cila tash njihet edhe nga ndonjë mbishkrim dhe më shpesh shihet më afër me greqishten (Katičić), ndërsa nuk ka mbetur pa u diskutuar edhe për dardanishten (nga hapësira dardane njohim materiale onomastike, emra njerëzish), për peonishten. Diskutime të vazhdueshme ka pasur dhe vazhdon të ketë edhe për gjuhën që Georgiev e disa të tjerë e quajnë parahellenishte, ndërsa V. Vindekens pellazgishte, për të cilën dimë po ashtu shumë pak.

Do thënë qysh në fillim se kjo gjendje dhe këto raporte kanë implikuar një lloj tjetër krahasimi për shqipen dhe tërë këtë 'monadë' ballkanike, atë që njihet si studim areal i gjuhëve me tërë nënkuptimet e kontakteve, të huazimeve e të ndërndikimeve, të lidhjeve e shprahbundeve gjuhësore, të situatave sociolinguistike të kryqëzimit, e të proceseve të ndryshme të identifikuar nga studimet areale e sociolinguistike të kohës sonë, por për periudha e faza më të hershme. Jo një herë është fo-

lur për mundësinë e vështrimeve të pozitës së para-shqipes në suaza areale në periudha të lashtësisë, qoftë në Ballkan me gjuhët që u përmendën, qoftë dhe në faza më të hershme si ajo që ka supozuar komparatisti Eric Hamp me NWEIE në një përbashkësi me grupet e paragjuhëve balto-sllave, gjermanike, tokare e keltike.¹

Vështrimet e shqipes në suaza të teorive për prejardhjen e saj nga ilirishtja apo nga kompleksi lashtoballkanik ndonjëherë i quajtur ilirotrak, janë shoqëruar me shqyrtime serioze të raporteve të kontaktit të shqipes së hershme me gjuhët klasike – greqisht e latinsht dhe me më të vonat pastaj – sllave, romane e turke.² Në aspektin ballkanistik, sado që për nga orientimi i studimit ballkanistik përqendrimi bie mbi vështrimet tipologjike detyrimisht sinkronike, nevojat për shpjegime të ngjashmërive midis shqipes e rumanishtes, në mungesë evidencash dokumentare për faza të caktuara zhvillimesh historike, kanë kredituar hipoteza të substratit lashtoballkanik për rumanishten, ndërsa shpjegimet për sa u përket raporteve të saj me shqipen më tej kanë prodhuar hipoteza për lidhjet e afrisë së para-shqipes me atë substrat të supozuar. Kështu janë forcuar argumentet për filiacionin e shqipes me kompleksin trako-dakas, paqëndrueshmërinë e të cilit Hamp provonte ta tejkalonte përmes hipotezës për fashën e gjerë të gjuhëve proto-albanoide, ku do të përfshihej edhe substrati i supozuar i rumanishtes. Në fakt, Hamp mendonte se shqipja nuk do të ketë lidhje bijërie me trakishten (shih raportet *zjarm/ ghermi, Basiso/ besë*, etj.), por në suazat e fashës së dialekteve IE protoalbanoide, prej së cilës ka mbijetuar shqipja dhe një pjesë e elementeve të përbashkëta të saj me rumanishten, ai e shihte dhe dakishten (dako-mezishten) të ndryshme nga trakishtja. Sipas tij, leksiku i përbashkët i shqipes dhe rumanishtes do parë jo si *Lehnwörter*, po si *Restwörter*. Në këtë sfond fjalët e jetës baritore si *shtrungë, vatër* apo *urdhë*, që dëshmohen në një areal të gjerë deri në Karpate, duhet të jenë më të vjetra, ndërsa fjalë si *mosh* mund të jenë huazime nga shqipja ose e kundërta më vonë gjatë mesjetes. Dhe ndër argumentimet këtu përfshihet mundësia e interpretimit të një emri si *Drobeta* si sintagmë nominale me emrin *dru*, të huazuar në rumanishten jugore si *druți*, pra **dru-të*, me një shquese të prapavendosur qysh në periudhën

¹ Hamp 1990, 1998.

² Thumb 1909, Jokl 1923, 1926, 1927, 1934, Mihăescu 1966, Çabej 1971-73, 1976, Boretzky 1975-76, Ölberg 1977, Svane 1992, Ylli 1997.

dhën para Krishtit, çka vështirë se mund të përfillet nga perspektiva e rindërtimeve të brendshme të shqipes (sidomos Hamp).

Dua të theksoj faktin se kur shtrohet çështja e shqipes në kuadër të studimeve ballkanistike gjithsesi tipologjikisht të orientuara, pra me vështrime sinkronike, duhet të krijohet një hapësirë e domosdoshme për vështrime diakronike, brenda së cilës ndriçohen procese që kanë lënë pasojë në Sprachbundin e diskutuar kaq shumë sot. Të tilla hapësira kombinimi midis vështrimeve metodikisht të ndryshme, sinkronike – diakronike, ka provuar të shohë dhe I. Hajnal (2003). Diskutimi i tij, si përpjekje teorike për pajtimin e dy vështrimeve të ndryshme dhe për kapërcimin e hendekut midis disiplinës gjenetike dhe disiplinës areale-tipologjike ka rezultuar dhe me një hipotezë me interes për situatën gjuhësore ballkanike në lashtësi të vështruar si të Sprachbundit midis grupimeve IE greke, frigase, armene, por edhe makedone, trakase, ilire apo të kompleksit të ‘gjuhëve adriatike’, si mesapishtja e venetishtja. Diskutimet e tij për izoglosat lashtoballkanike IE në fushën e laringaleve, të varieteteve **-si/*-su* të lokativit që vazhdon të *-sh* e rrjedhës së shqipes, po të kombinohen edhe me të dhënat leksikostatistike që parashqipen e vendosin më në perëndim të asaj ‘monade’ lashtoballkanike, mbase mund të kenë vlerë edhe për argumentimet e vendit të hershëm të shqipes në Ballkan dhe për filiacionin e saj. Kështu, kërkimet drejt transgresionit metodik të ballkanistikës tipologjike drejt gjuhësisë gjenetike IE vijnë e bëhen me fuqi ndriçuese për faza më të hershme të njërit prej strumbullarëve më të lashtë të unionit gjithsesi më të vonë.

Siç e pat thënë E. P. Hamp (1977:27), “metoda krahasuese dhe gjuhësia areale janë disiplina historike – faqe binjake të gjuhësisë diakronike”, të dyja janë të domosdoshme nëse duam të japim përgjigje për çfarë mund të ketë ndodhur, gjë që shtrohet vazhdimisht nga gjuhësia historike. Nëse synimi ynë është shpjegimi se çfarë ka ndodhur, pavarësisht se si do të arrijmë ta shpjegojmë, me mjete të gjuhësisë gjenetike, të përhapjes apo me kombinimin e tyre (Campbell). Nga ana tjetër, tashmë është e qartë se rrethana si ato që na kanë bërë që për kohë më të vona të flasim për Sprachbund kanë qenë dhe janë të mundshme edhe në kohë e hapësira të tjera.

Kështu fare natyrshëm po vijmë të mundësia dhe nevoja e krahasimit të natyrës gjeografike me synim që të vendoset shqipja brenda

kontekstit të fqinjve të saj. Shqipja bashkë me greqishten flitet më së gjati në Ballkan dhe si e tillë ajo në mënyra të ndryshme ka qenë pjesë e zhvillimeve në tërë këtë kohë, duke u bërë njëherësh një nga miset dendësisht të pranishme në atë që N. S. Tubeckoi e pati quajtur *Balkan Sprachbund*. Studimet e këtij lloji të saj mund të ndihmojnë për të ndriçuar raportet brenda arealit gjuhësor ballkanik dhe zhvillimet e ngjashmërive të shumta strukturore me bazë areale midis këtyre gjuhëve, të krijuara në saje të kontakteve të gjata dhe të drejtpërdrejta. Qysh J. Thunmann, pastaj J. Kopitar, A. Schleicher, F. Miklosich, në shekullin 19 kishin hetuar se gjuhët e Ballkanit, bashkë me to shumë manifestime të jetës së shoqërive përkatëse, shfaqnin ngjashmëri midis tyre, Kopitar madje i kishte parë si gjuhë me leksik të ndryshëm por me gramatikë të njëjtë.³ Në vijën e Thunmann-it ishte menduar se këto ngjashmëri midis shqipes në mes dhe latinitetit ballkanik nga përndimi e sllavishtes bullgare nga lindja i detyroheshin bazës ilire, apo iliro-trakase. Schleicher, ndërkaq, këto zhvillime i shpjegonte në kuadër të ideologjisë për korruptimin e gjuhëve popullore në raport me klasiket burimore. Në pjesën e parë të shekullit 20 doli dhe botimi i rëndësishëm i studiuesit danez K. Sandfeld me titull “Linguistique balkanique”, studimet e G. Weigand-it, etj. Si të rëndësishme për njohjen e realiteteve të Europës Juglindore u theksuan studimet gjuhësore, por paralelisht me to edhe gjurmimet e folklorit, të etnologjisë, të kulturave dhe të çdo gjëje që mund të bënte pjesë në “botëkuptimin ballkanik”. U teoretizua koncepti i *Lidhjes gjuhësore*, që theksonte arsyeshmërinë e studimit të afrive areale dhe jo vetëm gjenetike midis gjuhëve. U bënë studime konkrete dhe botime me vlerë, u ndërmorën nisma për botime të përkohshmesh, etj.

Ideja shoqërohej me supozimin se ngjashmëritë midis gjuhëve, po edhe të kulturave ballkanike i detyroheshin trashëgimisë nga lashtësia dhe jetës së përbashkët në rrethana të ngjashme dhe në fqinjësi shekullore të gjuhëve dhe të popujve të Ballkanit. U theksua sidomos çështja e substratit lashtoballkanik (trako-ilir), ndërsa më vonë u vunë në pah aportet me peshë në këto hapësira të trashëgimisë romane dhe bizantine. Roli ndriçues i të dhënave të saktësuara të shqipes në këtë lloj tematizimesh ka qenë gjithnjë i dorës së parë.

³ cf. Friedman, 2004, etj.

Në pjesën e dytë të sh. 20 këto studime morën hov të ri. Paralelisht me zhvillimet teorike në fushën e kontakteve të gjuhëve, u thellua dimensionimi i zhvillimeve të ngjashme në gjuhët e kësaj hapësire për pasojë të jetës së përbashkët dhe të kontakteve midis gjuhëve. U diskutuan aspekte themelore të ngjashmërive midis këtyre gjuhëve, që përbëjnë veçanti në raport me hapësirat e tjera, u përdegezuan diskutimet për implikimet teorike të gjetjeve eventuale të këtyre studimeve dhe u intensifikuan hulumtimet në terren. Kështu ballkanologjia në kuptimin e gjerë dhe ballkanistika në një kuptim më të ngushtë të fjalës vijuan debatin e tyre multidisiplinor. Diskutimet u zhvilluan deri në shkallën që të flitej edhe për një koncept ballkanik mbi botën. Në konceptin e Sprachbundit, pra, të unionit gjuhësor ballkanik, u bë një dallim i qartë midis gjuhëve ballkanike me tipare të këtij Sprachbundi dhe gjuhëve të Ballkanit me tërë kontradiktën, për kapërcimin e së cilës implikohen shpesh argumentime jashtëgjuhësore: në krahasimet me konvergjenca masive strukturore përfshihen shqipja, bullgarishtja, maqedonishtja, torlakishtja, disa segmente dialektore të hapësirës së Malit të Zi e të Serbisë jugore, i tërë romaniteti ballkanik pa dalmatishten e judezmon, ndërsa brenda Ballkanit janë edhe këto të fundit, tërë kompleksi tjetër serbisht, kroatisht, bosnisht, malazezisht, turqishtja, romishtja, hungarishtja, çerkezishtja, gjermanishtja. Jashtë Ballkanit mbeten rumanishtja veridanubiane, gjuhë sllave. Ngushtësisht ballkanike në të dy kuptimet mbesin shqipja, greqishtja, maqedonishtja, bullgarishtja, arumanishtja, meglenorumanishtja, rumanishtja jugdanubiane, torllakishtja, turqishtja europiane.

Në këto lloje studimesh areale çështjet e kontakteve të shqipes me gjuhë të veçanta të Ballkanit nuk mund të mos e kenë peshën e tyre edhe për ndriçimin e konvergjencave më të gjera.

Në të gjitha vështrimet e deritashme ballkanistike/ ballkanologjike është vënë në pah shumë qartë se gjuha shqipe dhe “bota shqiptare” përbëjnë një nga segmentet më të rëndësishme të këtyre studimeve. Duajeni i studimeve krahasimtare, por edhe ballkanike, Eric. P. Hamp, në një intervistë për gazetën *Rilindja* të Prishtinës më 1978 pati thënë: “*gjuha shqipe është thelbi i studimeve ballkanistike*”. Studiues të mëhershëm, themelues të ballkanistikës, si G. Weigand, e vendosnin shqipen po ashtu në zemër të ballkanistikës. Dhe vërtet, vetëm një vështrim sipërfaqësor i gjendjes në dy shekujt e fundit do të tregonte qartë se shqipja, të folme të ndryshme të saj, ndodhen në kontakte intensive me gjuhë e dialekte të ndry-

shme ballkanike – sllave jugore ijekave, ekave, torllake, maqedonase, greke brenda arealit kryesor të shqipes dhe brenda hapësirës greke, arumune në situata të ndryshme – shqip arumanisht, por edhe shqip-arumanisht-maqedonisht/ greqisht, turke, rome, etj. Studimet si ai i Juoko Lindstedt-it (2000) e kanë treguar shqipen praktikisht pjesëmarrëse në një mënyrë a në një tjetër në të gjitha tiparet karakteristike për Sprachbundin ballkanik: nyja e prapavendosur, dyfishimi i objektit, përdorimi i parafjalëve në vend të rasave, shkrija dativ/ gjenitiv, shkrija qëllim/ lokacion, relativum generale, pastaj folje ndihmëse + folje e mbaruar, futuri volo, futuri i shkuar si kushtore, perfekt i habere, evidencialët, krahasimi analitik, etj. Sipas këtyre tipareve, indeksimi i gjuhëve të Ballkanit jepte këtë pasqyrë: printe sllavishtja ballkanike me indeksin 11.5 (brenda saj maqedonishtja me 12.0), shqipja me 10.5, rumanishtja e Ballkanit dhe greqishtja me 9.5, romishtja me 7.5, çka vetëm pjesërisht pajtohet me përndarjet më fine që në qendër shohin shqipen, bullgarishten-maqedonishten, arumanishten, torllakishten, ndërsa në një radhë të dytë greqishten e rumanishten dhe të tjerat pastaj.

Por shqipja ka një pozitë të veçantë ndaj ballkanizmave, qoftë të konceptuar si të trashëguar, apo si contact induced. Nëse marrim strukturën fonetike, shqipja në gjendjen aktuale, ndryshe nga gjuhët ballkanike, ka zanore hundore në njërin prej kryedialekteve të saj, ka gjatësi zanoresh me vlerë funksionale po në atë dialekt (këtë e ka pasur më herët në tërësi), e ka në përdorim paskajoren, pos futurit me *do* ka edhe futur me *kam*, e ka të zhvilluar sistemin e habitores. Ka gjithandej ndërlihdje areale me gjuhët e tjera ballkanike, por edhe diferencime brenda saj, një situatë vërtet dinamike të përfshirjes në apo të daljes nga Sprachbundi gjithë duke qenë në qendrën e tij gjeografike.

Në tërë këtë gamë interesimesh, disiplina e ballkanistikës, për arsytet e përmendura metodike dhe për arsye të pamjaftueshmërisë së shpjegimit të fenomeneve, ka lëvizur kohët e vona ndjeshëm në konceptimet e saj, qoftë drejt kontestimeve rezolute, si mohimi i mundësisë së ekzistencës së një disipline të veçantë gjuhësore mbi këto baza qysh nga fillimi i sh. 20, qoftë si rezultat i kontestimit të një Sprachbundi për shkak të shtrirjes më tej drejt hapësirave eurolinguistike, apo edhe për shkak të vështirimeve të reja në fushën e kontakteve të gjuhëve në rrafshin e gjuhëve të folura, me ç'rast përvoja e studimeve të kreolëve dhe të kontakteve të gjuhëve në tërësi kanë sjellë ndriçime të reja.

Në pjesën e dytë të shekullit XX u themeluan revista të ndryshme për studimet ballkanike, gjuhësore, kulturore, historike, etnologjike *Zeitschrift für Balkanologie*, *Linguistique balkanique*, *Süd-ost Forschungen*, *Revue des études sud-est-européennes*, etj.), u zhvilluan qendra hulumtimi dhe bërthama studimi në vende të ndryshme, si p.sh. në München, në Berlin, në Vjenë, në Napoli, në Amsterdam, në Chicago, në Varshavë, në Poznanj, në Sankt Peterburg, në Bukuresht, në Sofie, në Beograd, në Selanik, etj. U themelua Asociacioni i Studimeve të Europës Juglindore, që u bë bartës i organizimit të kongreseve ndërkombëtare përkrye 4 vjetësh duke filluar nga viti 1966, u ndërmorën projekte të ndryshme gjithandej.

Studimet ballkanistike ndër ne janë zhvilluar në kuadër të/ dhe paralelisht me studimet historike për shqipen, ku shpesh më të rëndësishëm kanë qenë aspektet e rindërtimit të brendshëm dhe krahasues-historik, por qysh herët janë hetuar dhe aspekte areale dhe të mirëfillta ballkanike. Qysh nga A. Xhuvani, e sidomos te E. Çabej, M. Domi, I. Ajeti, S. Floqi, Sh. Demiraj, B. Bokshi, në brezat që tashmë kanë krijuar një rumbullakim të dijes së tyre, studiuesit tanë kanë problematizuar aspekte me rëndësi ballkanistike në vështrimet e çështjeve albanistike, shpesh edhe për vetë pozitën e shqipes në atë kuadër. Studimet për nyjat, për futurin, për zanoren ë apo për paskajoren, për dyfishimin e objektit apo për raportet gjinore/ dhano-re të shqipes i kanë vendosur ata automatikisht në qendër të interesimeve ballkanistike.

Qysh herët Eqrem Çabej kishte shprehur një opinion mjaft relativ lidhur me tiparet e përbashkëta ballkanike: *“janë disa zhvillime të përbashkëta në sistemin fonetik, por, si jo të përgjithësuara, ato nuk mund të trajtohen këtu; të tillat mund të hetohen më parë midis dy-tri gjuhëve, si midis shqipes e rumanishtes apo midis rumanishtes, greqishtes moderne e shqipes”*. Dhe tiparet e përbashkëta ballkanike për Çabejnë ishin: *prapavendosja e nyjës, zhdukja e infinitivit, e ardhmja e tipit me do, jo me kam, parataksa dhe frazeologjia e përbashkët*. Në këtë të fundit ai ngulte këmbë posaçërisht. Sh. Demiraj e kishte zgjeruar inventarin e ballkanizimeve, kryesisht në suaza të ballkanistikës tradicionale duke përfshirë *zanoren ë, prapavendosjen e nyjës, formimin e së ardhmes me do, dyfishimin e kundrinës përmes trajtës së shkurtë të përemrit vetor, eliminimin e pjesërishtëm të paskajores*, ndërsa B. Beci këtë inventar e zgjeronte më tej në suaza të elementeve paradigmatiche duke përfshirë *ë-në e theksuar, 6 seritë e bashkëtingëlloreve, çiftin fishkëlluese/ shushuritëse, kundërvënien qiell-*

zore/ velare, prapavendosjen e nyjës, të ardhmen me do, zëvendësimin e paskajores, raportet gjinore/ dhanore, dyfishimin e objektit, përemrat e theksuar/ të patheksuar, numërimin 11-19 dhe krahasimin analitik. Është e qartë që këto konceptime të zgjeruara apo të ngushtuara janë në ndërlidhje dhe me konceptime të tjera për shqipen, historike e krahasimtare, në një anë, dialektore/ areale, në anën tjetër. Kështu studimet ballkanistike shqiptare po hyjnë tani më pa nxitim drejt problematizimeve më të gjera të kohës sonë, modeleve shpjeguese sociolinguistike, të kontaktit të gjuhëve, të pragmatikës, etj.

Po ta shohim më hollë shqipen në raport me gjuhët ballkanike dhe të Sprachbundit mund të nxjerrim vija me interes për historinë e zhvillimit të saj: disa ballkanizma nuk shtrihen në tërë shqipen, në disa aspekte ajo manifeston ndryshime në raport me gjuhët e Ballkanit, ndonjëherë zona të saj të veçanta përfshihen në areale të ndryshme, pikërisht ashtu siç kishte sugjeruar Hamp me idenë e tij për Ballkanin si “udhëkryq të Sprachbundeve”, të nuancuar më tej nga I. Sawicka me hapësirat mesdhetare, qendrore ballkanike dhe lindore ballkanike.

Në një studim të tij të viteve të vona '70 të shekullit të kaluar, studiuesi i shqipes dhe njohësi i shquar edhe i rrjedhave në studimet ballkanike, i njohur për të gjithë ne, por sikur nga pak i lënë në harresë, Mahir Domi ankohej për faktin se shpesh nëpër vepra e studime të kësaj fushe për shqipen gjykohej edhe mbi materiale të pa-verifikuara deri në fund, të pjesërishtme, apo të gabuara.⁴ Një përshtypje e tillë të krijohet edhe sot kur në botime monografike me qarkullim ndërkombëtar sheh formulime si këta më poshtë: “*Shqipja toske flitet si gjuhë amtare nga shumica e popullatës së Shqipërisë (2,900.000 folës, sipas SIL), ashtu si në Greqi... dhe Turqi... Flitet po ashtu si gjuhë e dytë (as a second language) nga folësit nativë të shqi-*

⁴ “... Bien des faits de l'albanais ont été assez souvent présentés d'une manière insuffisante, sommaire, parfois même schématique, sans toutes les données nécessaires. On n'en a pas donné toujours une juste appréciation et interprétation. On a confondu plus d'une fois, en les mettant sur le même plan, sans aucun discernement, des phénomènes de la langue commune et des particularités d'un parler isolé ou d'un genre folklorique”; “... plus d'une fois il est nécessaire de rectifier des affirmations inexactes ou erronées qui, faute d'information, continuent de circuler parfois même de nos jours, malgré les observations faites à leur sujet ces derniers temps”, Domi (1968), f. 83. 84.

pes gege në Shqipërinë veriore dhe në krahinën Serbe të Kosovës e Metohisë, ashtu si nga folësit nativë të greqishtes, të maqedonishtes, të serbo-kroatishtes, të arumanishtes dhe të romëve që jetojnë në Shqipëri".⁵ Më tej autorja e vëllimeve 7-8 qindfaqëshe, O. Mišeska-Tomić nga një vend fqinj vijon me margaritarë si ky: "*Shqipja gege është në mënyrë inherente e pakuptueshme për folësit e shqipes toske*".⁶ Në paraqitjen e saj të core vocabulary për shqipen jepen fjalët për gegërishten e për toskërishten me forma edhe si këto: geg. *gjë* - tosk. *kafshë*, geg. *dora* - tosk. *krah*, geg. *heij* - tosk. *hi*, geg. *goditje* - tosk. *fryn* (për blow), geg. *marr frymë* - tosk. *merr frymë* (për breathe), geg. *kafshan* - tosk. *kafshon*, geg. *luin* - tosk. *kërcen* (për dance), geg. *papastër* - tosk. *ndyrë*, geg. *drejt* - tosk. *pluhur* (për dust), geg. *tlynë* - tosk. *majmë*, e kështu me radhë në vetëm një faqe.⁷ Me mosnjohje të këtilla të materialeve të shqipes nuk është e mundur të nxirren përfundime të mbështetura për çfarëdo krahasimi ballkanik apo tjetër. Prania më substanciale e ballkanologëve albanistë në studimet dhe në

⁵ Shfletimi i cilitdo manual elementar për gjuhën shqipe na mëson se dialekti i jugut apo toskërishtja shtrihet brenda Shqipërisë vetëm në jug të lumit Shkumbin, pra, afërsisht në gjysmën e territorit të Republikës. Është më shumë se mosnjohje ballkanistike të konsiderosh se shqipen standarde, që për bazë të saj e ka sistemin e variantit letrar të toskërishtes, shqiptarët e Kosovës (jo të Kosovës e Metohisë!) apo të tjerë e flitkan si gjuhë të dytë, madje njësoj si folësit nativë të greqishtes, të maqedonishtes apo të serbishtes!

⁶ Kjo nuk është dëgjuar ndonjëherë: shqipja, gege apo toske, nuk kuptohet në mënyrë inherente nga folësit e hungarishtes, të frëngjishtes, të kinezishtes, të maqedonishtes, e të serbishtes, por si mund të thuhet kjo për një shqipe nga shqipja tjetër?!

⁷ Geg. *gjâ* i përgjigjet gjithandaj tosk. *gjë*, ndërsa *kafshë* del në të dy dialektet; *dorë* dhe *krah* janë të të dy dialekteve, por me kuptimet: "hand" dhe "arm"; geg. *heij*, mbase *hei*, del vetëm në të folmet ku zan. *i* diftongohet, ndërsa geg. tjetër ka *hî/hî*; *goditje* është më tepër e shqipes letrare; *fryn* është e gjuhës standarde, por edhe e geg. e tosk., ashtu siç del në geg. edhe *fryn*, *froin*, tosk. *frin*, ndërsa shprehja *marr frymë* është shprehje foljore e pranishme njësoj në të gjithë shqipen me të njëjtin kuptim; forma *kafshan* mund të dëgjohet disi vetëm në të folmet e Ulqinit e të Shkodrës, ku zanorja *o* e patheksuar delabializohet, çka nuk ngjet në geg. tjetër; *luej* dhe *kërcej* (*luen*, *kërcen*, *kcen*) janë pjesërisht sinonime, por në tërë shqipen, ndërsa *luin* mund të ndeshet në ndonjë varietet krejt lokal; geg. thuhet edhe *ndytë* për t. *ndyrë*, ndërsa *papastër* është e tërë shqipes, por më parë letrare; ku e gjeti geg. *drejt* për *pluhur*, që geg. mund të jetë vetëm *pluhun*? Geg. *tlyn*, *tlyn* mund t'i përgjigjet vetëm t. *tlirë*, *tëlier*, por i *majmë* është i të gjithë shqipes me kuptim krejt tjetër.

tribunat ballkanistike, por edhe kujdesi i botuesve, ashtu si kritika profesionale, mund të ndihmonin për të evituar pasaktësi të tilla jo të sh. 18, po të vitit 2006.⁸

Justifikime për mangësi të tilla nuk mund të ketë as për faktin se gjithandej në qendrat e studimeve ballkanistike nëpër botë bëhen përpjekje shumë serioze për studimet e shqipes. Në hapësirat studimore shqiptare deri tani ballkanistika si disiplinë e veçantë ka zënë vetëm një vend dytësor, kryesisht në ndërlidhje me/ dhe në kuadër të studimeve albanistike. Vështrimi ballkanistik nga brenda shqipes ka nevojë të plotësohet me vështrimin edhe nga jashtë saj, nga perspektivat e përgjithshme dhe të veçanta ballkanike.

Sot këtu jemi të kënaqur që kemi arritur të mbledhim bashkë për të diskutuar raportet e shqipes me gjuhët e Ballkanit sot e në të kaluarën studiues të shquar albanologë e ballkanistë si I. Ajeti, Sh. Demiraj, B. Bokshi, K. Topalli, B. Beci, S. Mansaku, F. Altimari, etj. brenda hapësirës shqiptare, por edhe kampionë të ballkanistikës në një kuptim më të gjerë, si W. Fiedler, V. Friedman, I. Sawicka, M. Gabinschi, apo mjeshtrë të gjuhësisë së krahasuar si H. Eichner, etj.

Me trashëgiminë e njohjes së një pjese të mirë të rrethanave ballkanike (duke qenë në qendër), të mundësive për studime serioze për shqipen dhe gjuhët sllave të jugut, për turqishten, për greqishten e arumanishten, hapësira shqiptare është shumë e përshtatshme për zhvillimin e këtyre studimeve në tërësinë e tyre dhe me thellësinë e nevojshme. Përfitimet nga hulumtimet e tilla mund të jenë të rëndësishme jo vetëm për shkencën ballkanologjike, po edhe për vetë shoqërinë tonë.

Me bindjen se kjo konferencë me pjesëmarrës kështu të cilësuar të brezave të ndryshëm të studimeve gjuhësore nga bota shqiptare dhe nga vendet e tjera ku ka interes për këtë lloj studimi do të sjellë rezultate që do të nxisin më tej veprimtarinë në këtë fushë dhe integritet e një niveli dhe cilësie më të lartë në rrjedhat e përgjithshme të studimeve gjuhësore ballkanike, ju uroj të gjithëve punë të mbarë dhe diskutime të gjalla.

⁸ Olga Mišeska-Tomić: **Balkan Sprachbund Morpho-syntactic Features**, Studies in Natural Language & Linguistic Theory, Springer 2006, pp. 749.

Bibliografi

- Ajeti (1986), Idriz: *Rapports de l'Albanais avec les langues balkaniques*, **Zeitschrift für Balkanologie**. BAnd XXII/2, ff. 147-157.
- Aronson (2007), Howard, I.: **The Balkan Linguistic League, "Orientalism", and Linguistic Typology**, Ann Arbor, New York.
- Assenova (2002), Petya: **Balkansko ezikoзнание. Balkanisms**, Търново.
- Banfi (1985), Emanuele: **Linguistica balcanica**, Bologna.
- Bariq (1955), Henrik: **HËmje në historin e gjuhës shqipe**, Prishtinë;
- Beci (2002), Bahri: **Probleme të lidhjeve të shqipes me gjuhët e tjera ballkanike**, Dukagjini, Pejë.
- Bokshi (1984), B.: **Prapavendosja e nyjave në gjuhët e Ballkanit**, Prishtinë.
- Bonnet (1998), Guillaume: **Les mots latins de l'albanais**, Paris, 1998;
- Boretzky (1975-1976), Norbert: **Der türkische Einfluss auf das Albanische, I, II**, Wiesbaden;
- Brâncuș (1978), Grigore: *Balkan Studies*, në Rosetti. A. & Golopenția Eretescu, S.: (ed.): **Current Trends in Romanian Linguistics**, București, ff. 367-379.
- Brixhe (1994), Claude/ Panayotou, Anna: *Le thrace*, në Bader, Françoise (Ed.): **Langues indo-européennes**, Paris, ff. 179-203;
- Çabej (1971-73), E.: *Albanische Beitrage zur Kenntniss des lateinischen Wortschatzes*, **Bolletino del'Atlante linguistico mediterraneo** 13-15, f. 365-377;
- Çabej (1975), E.: *Karakteristikat e huazimeve latine të shqipes*, **Studime filologjike** 1.
- Çabej (1976), E.: *Hyrje në historinë e gjuhës. Fonetika historike*, **Studime gjuhësore** III, Rilindja, Prishtinë, (më herët, Prishtinë, 1970), 7-146.
- Campbell, Lyle: *Areal Linguistics, a closer Scrutiny*, në http://www.hum.utah.edu.Linguistics/Faculty/oldFacultyPage/campbel/Areal_linguistics_short.do
- Cimochowski (2004), Waclaw: **Studime për shqipen**, Prishtinë;
- Civjan (1990), Tatjana: **Lingvističeskie osnovy balkanskoj modeli mira**, Moskva.
- Demiraj (1989), Sh.: **Gjuha shqipe dhe historia e saj**, Prishtinë;
- Demiraj (1994), Shaban: **Gjuhësi ballkanike**, Shkup;
- Desnickaja (1987), A. V.: *K probleme obrazovanija albanskogo jazyka i albanski narodnosti. O latinskih elementah albanskoi leksiki*, **Albanskaja literatura i albanskij jazyk**;
- Detschew (1957), Dimitar.: **Die thrakischen Sprachreste**, Wien;
- Domi (1968), Mahir: *Concordances et analogies syntaxiques albano-roumaines*, **Actes du premier Congrès International des études sud-est européennes VI**, Sofia, ff. 681-695.
- Domi (1975), Mahir: *Considérations sur les traits communs ou paralleles de l'albanais avec les autres langues balkaniques et sur leur étude*, **Studia albanica, XII, 1**, Tirana, 81-91.
- Duridanov (1976), Ivan: **Ezikät na trakite**, Sofia.
- Feuillet (1986), Jack: **La linguistique balkanique Cahiers balkaniques 10**, Paris.
- Fiedler, Wilfried: **Einführung in die Balkanphilologie**, Rehder, P. (Hg.): **Einführung in die slavischen Sprachen**, Darmstadt, f. 347-364.
- Friedman (2004), Victor: **Studies on Albanian and other Balkan Languages**, Pejë.

- Georgiev (1968), V.: *Le problème de l'Union linguistique balkanique*, **Actes du premier Congrès international des Etudes Balkaniques et sud-est europeennes, IV, Linguistique**, Sofia.
- Haarman (1972), Harald: **Der lateinische Lehnwortschatz im Albanischen**, Hamburg.
- Hajnal (2003), Ivo: *Methodische Vorbemerkungen zu einer Paleolinguistik des Balkanraums*, Bammesberger, A. & Vennemann, Th.: **Languages in prehistoric Europe**, ff. 117-145.
- Hamp (1966), Eric P.: *The position of Albanian*, **Ancient Indo-European Dialects**, Berkeley, 97-122, shqip te **Studime për shqipen** ASHAK, Prishtinë 2007;
- Hamp (1976), E. P.: *On the distribution and origin of Vatra*, **Opuscula slavica et linguistica**, Klagenfurt, 201-210;
- Hamp (1978), Eric P.: *Strunga*, **Balkansko ezikoznanie** 20, 115-119;
- Hamp (1981), E. P.: *On the distribution and Origin of (h)urda*, **Linguistique balkanique XXIV**, 3, 47-50.
- Hamp (1989): *Yougoslavia - a Crossroads of Sprachbuende*, **Zeitschrift für Balkanologie**, 25/ 1, ff. 44-47.
- Hamp (1990), E. P.: *The Pre-Indoeuropean Language of Northern (central) Europe*, Markey et Greppin (dir.): **When Worlds collide. Indo-Europeans and Pre-Indo-Europeans**, Karoma Publisher.
- Hamp (2007), E. P.: **Studime krahasuese për shqipen**, ASHAK, Prishtinë.
- Hamp, E.: *Biso*, **Actes du XIe Congrès international des Sciences Onomastiques**, t. 1, Sofia, 367-369;
- Hamp, Eric, P.: *Thracian, Dacian, and Albanian-Romanian Correspondences*, **Actes du Iie Congrès international de thracologie**, t. III, Ed. Academiei Republici Socialiste Româna, București, ff. 57-60.
- Hinrichs (1999), Uve (Hg.): **Handbuch der Südosteuropa-Linguistik**, Wiesbaden.
- Holm (2009), H. J.: *Albanische Basiswortlisten und die Stellung des Albanischen in den Indogermanischen Sprachen*, **Zeitschrift für Balkanologie** 45, f. 171-205.
- Huld (1984), Martin: **Basic Albanian Etymologies**, Ohio.
- Ismajli (1987), R.: *Prejardhja e gjuhës shqipe*, **Artikuj për gjuhën shqipe**, Prishtinë, 9-41;
- Ismajli (1997), R.: *Ballkanistika dhe prejardhja e shqipes*, **Studime** 3, 1996, Prishtinë, 255-274.
- Jokl (1923), N.: **Linguistisch-Kulturhistorische Untersuchungen aus dem Bereiche des Albanischen**, Berlin und Leipzig;
- Jokl (1926), N.: *Griechisch-albanische Studien*, **Festschrift für Paul Kretschmer**, Wien-Leipzig-New York, 78-95.
- Jokl (1927), N., *Altmakedonisch-Griechisch-Albanisch*, **Indogermanische Forschungen** 44, 13-70.
- Jokl (1934), Norbert: *Slaven und Albaner*, **Slavia** 13, f. 281-325 dhe 609-645.
- Jokl (1984), N.: **Sprachliche Beiträge zur Paläo-Ethnologie der Balkanhalbinsel**, (Zur Frage der ältesten griechisch-albanischen Beziehungen), Aus dem Nachlass herausgegeben von O. PFEIFFER, Wien;
- Joseph (2001), Brian: *Is Balkan comparative Syntax Possible*, Rivero, M. L. and Rally, A. (eds.): **Comparative Syntax of Balkan Languages**, Oxford, 17-43.
- Katičić (1976), Radoslav: **Ancient Languages of the Balkans I, II**, Hague.
- Klingenschmit, G.: *Albanisch und Urindogermanisch*, **MSS** 40, 93-131;

- Klingenschmitt (1994), G.: *Das albanische als Glied der indogermanischen Sprachfamilie*, Rasmussen, J. E. (Hg.) **In honorem Holger Pedersen**, Wiesbaden, 221-233;
- Klingenschmitt (1994a), G.: *Die verwandtschaftsverhältnisse der indogermanischen Sprachen*, Rasmussen (Hg): **In honorem Holger Pedersen**, Wiesbaden, 235-251,
- Lindsted (2000), Juoko: *Linguistic Balkanization Contact-induced change by Mutual Reinforcement*, D. Gilberts, J. Nerbonne and J. Shaeken: **Languages in Contact**, Amsterdam, 231-246.
- Matzinger (2005), J.: *Messapisch und Albanisch*, në **International Journal of Diachronic Linguistics and Linguistic Reconstruction** 2, 29-54.
- Matzinger (2009), J.: *Die Albaner als Nachkommen der Illyrier aus der Sicht der historischen Sprachwissenschaft*, O. J. Schmitt & E. A. Frantz (Herausg.): **Albanische Geschichte. Stand und Perspektiven der Forschung**, München, 13-36.
- Meyer-Lübke (1904-6), W.: *Die lateinischen Elemente im Albanesischen*, G. Gröber (Hg.): **Grundriß der romanischen Philologie** 1, Strassburg, f. 1038-1057;
- Mihăescu (1966), Haralambie: *Les éléments latins de la langue albanaise*, **Revue des études sud-est européennes**, tome IV, nr. 1-2, 3-4.
- Mihăescu (1981), H.: *Locul elementelor lexicale latine din albaneză în cadrul romanității sud-est europene*, Coteanu, I. & Wald, L. (1981): **Semantică și semitică**, București, ff. 216-235.
- Mihăescu (1993), H.: **La romanité dans le sud-est de l'Europe**, București, botim i plotësuar nga 1978.
- Mišeska-Tomić (2006): **Balkan Sprachbund Morpho-syntactic Features**, Studies in Natural Language & Linguistic Theory, Springer, pp. 749.
- Neroznak (1978), V. P.: **Paleobalkanskije jazyki**, Moskva, 1978.
- Ölberg (1972), H.: *Griechisch-albanische Sprachbeziehungen*, R. Muth (Hrsg.): **Serta philologica Aeniponana II**, Innsbruck, 1972, f. 33-64;
- Paliga (2006), Sorin: **Influente rumane si preromane in limbile slave de sud**, București.
- Pellegrini (1998), G. B.: **Avviamento alla linguistica albanese**, Universita degli studi della Calabria, Rende.
- Poghirc (1983), Cicerone: **Philologica et linguistica**, Bochum.
- Reiter (1994), Norbert: **Grundzüge der balkanologie**, Berlin, 1-95, 691-898.
- Riza (2004), S.: *Mbi një bashkëpërkim gramatikor të posaçëm të gjuhës shqipe me greqishten*, **Vepra** 4, ASHAK, Prishtinë, 91-114;
- Sandfeld (1930), Kr.: **Linguistique balkanique. Problèmes et résultats**, Paris.
- Sawicka (1997), Irena: **The Balkan Sprachbund in the Light of Phonetic Features**, Torunj.
- Schaller (1975), Helmuth: **Die Balkansprachen. Eine Einführung**, Heidelberg.
- Schumacher (2009), Stefan: *Lehnbeziehungen zwischen Protoalbanisch und balkanischem Latein zv. Romanisch*, O. Schmitt & E. Frantz (Hrsg.): **Albanische Geschichte. Stand und Perspektiven der Forschung**, Muenchen, ff. 37-60.
- Solta (1980), Georg, R.: **Einführung in die Balkanlinguistik mit besonderer Berücksichtigung des Substrats und des Balkanlateinischen**, Darmstadt.
- Steinke, Klaus si Vraciu, Ariton (1999): **Introducere în lingvistica balcanică**, București-Iași.
- Svane (1992), Gunnar: **Slavische Lehnwörter im Albanischen**, Aarhus.
- Ylli (1997), Xhelal: **Das slavische Lehnwort im Albanischen I**, München.
- Ylli (2000), Xhelal: **Das slavische Lehnwort im Albanischen II**, München.

Idriz AJETI, Prishtinë

SHQIPJA DHE GJUHËT FQINJE

Abstrakt

1. Popull i vjetër, por në anë tjetër përmendoret e tij paraqiten shumë vonë.

Historia e gjuhës së tij askund nuk është e lidhur aq ngushtësisht me historinë kombëtare.

Meqenëse fati i popullit shqiptar vështirë mund të ndahet nga gjuha e tij, edhe në këtë vështrim të shkurtër do t'i drejtohem gjuhës sepse ajo besnikërisht e këmba këmbës e veçmas e përcjell atë kur të tjerët e injorojnë.

2. Vatra – në jetën patriarkale zjarr që luan një rol të rëndësishëm dhe njehet simbol i familjes e cila kujdeset mos të mungojë ajo kurrë në vatër të shtëpisë.

Vatra

Fjalë shqipe me vështrim simbolik, e cila në hapin e parë të shtegtimit të vet emrin nacional i fali gjuhës së fqinjët të afërm rumun, e ai, pas shumë kohësh e përhap duke e dhënë ndër sllavë ballkanikë e evropianë.

3. Historia e burimit *Ombla*

Çabej: “Hyn aty errësimi i *ā*-së në *o* në pozicion nazal; të krahasohet më një anë emri i gurrës me ujë të ëmbël *Ombla* – afër Raguzës ku përmbahet trajta *ombël* në vend të *âmbël*, fem. *âmbla*”.

Po u ndoq historiati i këtij “errësimi” mbyllja e *â*-së nazale në gegërishten në përgjithësi dhe në gegërishten veriperëndimore në veçanti, nuk mund t'i iket rrugës së atij procesi të një “mbylljeje të paqenë” në dialektet veriperëndimore, sidomos në gjysmën e dytë të shekullit X (dhjetë).

Atë risim e njohin në Kosovë disa vende (a qytete) të shtetit të ri të Kosovës, por jo mbarë Kosova; në komunën e Medvegjës s’e përdorin fare atë, as monoftongimin.

Në studimin e historisë së popullit shqiptar dhe të gjuhës shqipe ka një paradoks. Në të vërtetë, nga njëra anë populli shqiptar është njëri nga popujt më të vjetër të Ballkanit, e nga ana tjetër përmendoret e para gjuhësore të tij paraqiten shumë vonë në shekullin XIV, përkatësisht XV, kurse libri i parë i shtypur në shekullin XVI (“Meshari” i Gjon Buzukut – 1555).

Historia e gjuhës askund nuk është e lidhur aq ngushtësisht me historinë kombëtare sikurse ndodh me historinë e popullit shqiptar. E kur jemi te historia në përgjithësi vlen të thuhet se ajo ndaj popullit

shqiptar, njërit nga etnosët e rrallë paleoballkanikë që ka mbijetuar dhe ka përballur shumë përplasje, ka pasur qëndrim njerke. Shkurt, historia ndaj tij ka qenë kryesisht e pamëshirshme dhe e pamposhtme. Prandaj, me të drejtë mund të thuhet se gjatë shumë periudhave, nuk e ka marrë me të mirë sikurse ka vepruar me të tjerët.

Meqenëse fati i popullit shqiptar vështirë mund të ndahet nga gjuha e tij, edhe në këtë vështrim të shkurtër do t'i drejtohem gjuhës sepse ajo e përcjell besnikërisht këmba-këmbës veçmas në periudha kur të gjithë të tjerët e injorojnë. Nuk është thënë rastësisht se historia e gjuhës është njëkohësisht historia e popullit i cili e ka përdorur atë gjatë shekujve dhe e përdor edhe sot e kësaj dite. Megjithëse e rralluar me depërtimin e elementeve të huaja, gjuha shqipe është dëshmitari i gjallë më i besueshmi i shumë ngjarjeve të lidhura me popullin, për të cilat historia nuk e thotë asnjë fjalë.

Gjuha, në rastin tonë gjuha shqipe, për mungesë dhe mospasje të fakteve dhe të dokumenteve historike i vë përpara një mori të dhënash të sakta mbi vendin e formimit të vet mbi përhapjen e etnosit shqiptar në periudhën e Ballkanit të Lashtë, mbi huazimet e gjuhës shqipe nga greqishtja e vjetër dhe latinishtja, të hyra në gjuhën shqipe para erës sonë.

Shtrohet çështja cilat janë ato mundësi që ka gjuha dhe me të cilat është në gjendje t'i zbërthejë fenomenet historike dhe gjuhësore? Natyrisht, fjala është për rregulla të caktuara fonetike të gjuhës përkatëse që nuk janë statike por dinamike – në zhvillim të vazhdueshëm, por janë të kufizuara për nga koha.

Rregullat e tilla na mundësojnë të përcaktojmë kohën e depërtimit të elementeve të shumta gjuhësore, të hyra së jashtmi në gjuhën tonë. Në të vërtetë, në gjuhë ka disa huazime me prejardhje latine që kanë hyrë në gjuhën shqipe para erës sonë, për shembull *Diana*, shqip *zana*, ndërkaq fjala *djall* nga lat. *diabolus* në shqip ka ardhur në erën tonë.

Është vështirë të postulohet një dukuri fonetike e një të folmeje mbi bazën e një shembulli, sikurse është rasti me m'*doket* për më *duket*, për ligjërimet e shqiptarëve të Kosovës; sa për mendimin që forma e postuluar *Shkoup*, *Shkop* (për Shkup), që paska hyrë në sllavishten jugore për të përfutur trajtën e toponimit Skopje – neve nuk na duket i mundshëm për disa arsye.

b) Sa për trajtat e fjalëve që te Buzuku dalin me – o në vend me u: klomështë për *klumështë*, kon: kundi; mondonjë për *mundonjë* - përgjigjen për një pjesë të mirë të tyre e ka dhënë vetë Çabej duke i gjetur gabim shtypi dhe gabime leximi që radhitesit kanë ngatërruar një karakter të dorëshkrimit me një tjetër (Çabej, Meshari i Gjon Buzukut, f. 15-68).

Si shihet përcaktimi i ligjësave fonetike dhe kronologjia e tyre na mundësojnë që të përcaktojmë edhe krijimin e toponimeve të lashta të vendqëndrimeve, të vendbanimeve, të oronimeve dhe të emrave të lokaliteteve, të qyteteve të lashta dhe të lumenjve: *Scupi, Scardon, Scardos, Astibos, Scodra, Mathis, Drinus, Lissus, Issamnus, Dyrrachium, Barbanna*. Është me rëndësi të madhe të shpjegohen dhe të përcaktohen në çfarë mënyre ka qenë i mundshëm transformimi i toponimeve të përmendura të lashta, i hidronimeve dhe i emrave të tjerë të vendeve dhe të personave në forma të tashme: *Shkupi, Shtipi, Sharri, Shkodra, Drivastum-Drisht, Mati, Drini, Leshi (Lezha) Ishmi, Buena, Buna, Durrësi, Qafa e Prushit*.

Voter > Vater = Vatra

o > a vo < va

merret mendimi i prof. Çabejt: “Këtu sipër, thotë Profesori, kemi ndërrimin e *o*-së në *-a* por edhe duke shtegtuar ndërrimin e *vo*-së në *va* që përfshiu edhe gjuhët ballkanike dhe serbokroatishten bashkë me Evropën Lindore dhe Perëndimore, duke paraqitur një vlerë për fonetikën historike të shqipes”, Çabej, në anë tjetër, tregon që ndërrimi i *o*-së në *a*, në grupin *vo* te ky dialekt u krye mjaft heret; “në këtë grup hyjnë huazimet e vjetra nga latinishtja *oleum = vol – val, voj – vaj*, një fonemë që ka dalë prej një *o*-je të moçme në ballë të fjalës, në fjalë vendi e ndër huazime të vjetra”.

Përderisa forma e fjalës *vatra* ndaj trajtës *votër*: *vatër* del sekundare dhe nga pikëpamja e fonetikës historike të gjuhëve sllave nuk gjen shpjegim të kënaqshëm, ajo do të lidhet, pa dyshim me truallin e shqipes, me formën *vatër* të toskërishtes që shkon me çiftet e njohura të kësaj gjuhe: *varr, vorr, vaj:voj (oleum), i farfër, i vorfën (orphanus)*. Për këto çifte fjalësh dihet me siguri se kanë dalë nga forma më e moçme që niste me *o* që në shqipen u zhvillua në *vo, va*; forma e dytë e toskërishtes, sikundër e ka trajtuar Jokli, në mënyrë të shtje-

llueshme (Wiener Zeitschrift für Kunde des Morgenlandes 34) pasqyron, bashkë me të sllavishtes (serbokroatishtes) trajtën sekundare.

Në fjalorin etimologjik të gjuhës shqipe, linguisti shqiptar Eqrem Çabej e trajton shprehjen *kërcu*-ni, tosk. *kërcu*-ri dhe shpreh mendimin se ajo me kohë u shtri në rumanishten që pastaj e shpuri në rusishten dhe në gjuhë të tjera sllave me vështrim “Kërshëndella, Krishtlindje”; gjykimi i tij mbështetet kryesisht në faktin që terminin *krishtlindje*, *kërshëndella* shumica e gjuhëve të Ballkanit e kanë nga *kërcuri*, it. *ceppo* (Çabej, Studi si cercetări linguistice XII/1961; Zeitschrift für Balkanologie II/1964, f. 8; Revue roumaine de linguistique Z/1965; Studime filologjike 1/1964, Studia slavica in memoriam Alois Schmaus München 1971: Zur slavischen und albanischen Wortgeschichte f. 95-98).

Historia e burimit *ombla*

Me të rënë të sllavëve në bashkëtakim me popullsinë romane të Dalmacisë masa e madhe sllave zuri shumë shpejt të ndikojë në të folmen romane dhe ndër të parat huazime sllave të dalmatëve romanë qe emri i hidronimit *ombla*, që, krejt në pajtim me fonetikën historike, rridhte nga trajta e fjalës së sllavishtes së vjetër, përkatësisht nga zanorja *o* në pozicionin hundor të hidronimit *oblъ* me shqiptim *ombla* dhe vështrim “gurrë, burim”.

Kohë më pas zanoret hundore *o*, *e* të sllavishtës morën rrugën e çundurëzimit në *u*, *e*, pra u përftuan nga *om*, *en* në *u*, *e*, *ubli*, pastaj në *ubao*; nga *soditi* shqip *sundoj* me *sundue*, *rëd*, shqip *rënd*, serbokroatisht *red*.

Zanoret hundore të dialekteve serbe e kroate ishin në përdorim e sipër deri nga gjysma e dytë e shekullit X (dhjetë) thoshte prof. Radosav Bošković tek *Osnovi gramatike slovenskih jezika*, Beograd 1968, f. 63.

Te hidronimi *obla* për sllavishten Rijeka që është një gji i detit të Adriatikut te Dubrovniku nuk kemi të bëjmë me ndonjë adjektiv shqiptar, siç mendonte Eqrem Çabej, (Ältere Stufen des albanesischen im Lichte der Nachbarsprachen, te Zeitschrift für Balkanologie II (1964), Betrachtungen über die rumänisch-albanischen Sprachbeziehungen, Revue roumaine de Linguistique X (1965) Studi si Cercetări lingvistice X 1959), i cili hidronimin e sotëm italisht *ombla* që për herë të parë del më 1160, e bie te ar-

dhur nga adjektivi i shqipes *âmbël, ëmbël* me buzorëzimin e *â*-së hundore në *o ombël, ombla* e që duhej të shënonte një burim shqiptar të këtij hidronimi. Kur jemi në truall të shqipes dalin disa vështirësi jo të lehta për t'u kapërcyer prandaj vërtetësia e saj, sipas mendimit tonë vihet në dyshim, sepse atë risim e njohin në Kosovë vetëm disa vende të shtetit të ri të Kosovës, por jo mbarë Kosova...

As historiani i njohur i popujve të Ballkanit K. Jireçek hidronimin *ombla* te Gruzha e Dubrovnikut (Raguzës) nuk e quan të gurrës së huaj, veçse ai atë e çon tek emrat e toponimeve aq të shpeshta, nga Kraja e Malit të Zi, te Kuçi e deri në Dalmaci.

Uble – te Podgorica

Ubli - në Kuç të Podgoricës

Ubli - Nikshiq

Ubli – në Hercegovinë.

Për punë të nazalitetit të këtyre dy gjuhëve tona të pajisura atëherë me zanore, si gegërishtja e shqipes edhe serbokroatishtja, për çështjen e hidronimit *ombla* nuk dimë si do të jetë çështja drejt e mirë kur sllavët qysh nga shekulli VII-VIII duken në Bregdetin kroat te Raguzë a Dubrovniku, shqiptarët në lëvizjen e udhëtimit nga atdheu i tyre ende s'kishin arritur në viset bregdetare të Raguzës dhe në rrethinat e saj.

Paksa intelektualë të dalë nga Shkodra e Durrësi, të shkolluar në Raguzë (Dubrovnik) na kanë zbardhur fytyrën: dy intelektualë të shquar, njëri nga Shkodra (Marin Barleti) e tjetri nga Durrësi (Andrea Aleshi), i pari historian i shquar, i dyti arkitekt, gjithashtu, i shquar.

Edhe diçka do të shtojmë: metateza a vendkëmbimi është njëra ndër veçoritë më të rrahura në fushën e sllavistikës.

Në gjysmën e dytë të shekullit X (dhjetë) emrin e përshtatur (kombëtar) e kishin marrë edhe këto qytete në Dalmaci dhe gjetkë: *Melita – Mleti, Sirmium – Srem, Martinus – Mrata, Spalaton – Split, Arba – Rab; Skardona – Skradin, Albona – Labin.*

Kjo rregull quhet metateza (vendkëmbimi) – është njëra ndër veçoritë më të rrahura në fushën e fonetikës historike të serbokroatishtes dhe të gjuhëve sllave.

Besim BOKSHI, Prishtinë

FORMAT E FUTURIT TË SHQIPES NË RAPORT ME ATO TË GJUHËVE BALLKANIKE

Abstrakt

Trajtimi i formave të futurit të gjuhës shqipe: kam + infinitiv (kam me mbjellë), kam + infinitiv i ri (kam për të mbjellë), do + lidhore e tashme (do të mbjell) autorin e ka sjellë në përfundim se janë përfutur pa ndikim nga latinishtja, përkatësisht nga greqishtja. Forma kam + lidhore e tashme (kam të mbjell), me përdorim tepër të kufizuar dialektor në toskërishte, vlerësohet e përfutur nën ndikimin e të folmeve përkatëse greke. Në fillim të kumtesës autori shpreh mendimin se protoshqipja kishte një futur sintetik me prapashtesë **-syo* që para kontaktit me greqishten.

Për një futur të lashtë sintetik

Futuri sintetik me **-syō*, që nuk ishte i gjuhës së lashtë ie., por që e kishin krijuar disa gjuhë, si gjuhët indo-irane dhe baltike e që e ka edhe greqishtja e vjetër në formën *-sō*, (Në fusotë: Greqishtja kishte dy forma të futurit, njërin me *-mai* nga një lidhore e vjetër, tjetrin me *-sō* nga deziderativi i vjetër,¹ dëshmohet se ishte edhe i protoshqipes në formën e pjesores pësore të futurit me *-shëm* < nga **-syō* + **-mō*: [i thyeshëm, i dukshëm, i pishëm etj.]. Prapashtesën **-mō* ~ **-mā*, siç jemi shprehur në veprën *Rruga e formimit të fleksionit të sotëm nominal të shqipes*,² e zbulojnë si formant të paricipit mediopasiv të njëkohësisë emrat si bimë = që bin, mjelm = që millet, pështymë = që pështyhet, frymë, shkelm etj., që dalin të nominalizuar në të dy gjinitë. Eric Hamp-i në vitin 1973 e kishte barazuar prapashtesën *-m* të shqipes me atë të baltosllavishtes e të luvianishtes, ku ajo e kishte vlerën e shënuesit të paricipit pasiv të prezentit ashtu si dhe në gjuhën shqipe, duke u shprehur se kjo “e rrit listën e lidhjeve baltosllave dhe shqipe”.³ Edhe në greqishten e vjetër mbi futurin me *-sō* është shtuar pra-

¹ Pierre Monteil, *Éléments de phonétique et de morphologie du latin*, Paris, 1986, f. 329

² Prishtinë, 1980, f. 76

³ Në *Baltistica*, IX(I), 1973, f. 47.

pashtesa *-meno-* e mediopasivit të njëkohësisë për të krijuar participin medial të futurit (lusómenos), të futurit ekzakt (lelusómenos) dhe të futurit të dobët (ludhesómenos). Trajtimi i prapashtesës *-shëm* si formant i dikurshëm i participit pasiv të futurit mbështetet edhe në kuptimin që e zbulojnë mbiemrat deverbativë të tipit i thyeshëm = që mund të thehet, a më parë: që do të thehet, i pishëm = që mund të pihet a që do të pihet, i përdorshëm = që mund të përdoret a që do të përdoret etj.

Kuptohet se prapashtesa *-mō ~ -mā* nuk mund të bëhej prapashtesë e participit të futurit kur shënonte participin pasiv të prezentit, por kur ende nuk e shënonte kohën, d.m.th. kur ishte formant i mediopasivit të njëkohësisë. E. Hamp-i, në kundërshtim me N. Joklin, është kategorik se *-m* nuk është zvogëlim i prapashtesës *-meno-* (apo *-mno*), por është vetëm refleksi i prapashtesës **-mō*. Nga sa u shënuar del se edhe përftimi i participit pasiv të futurit është i kohës së afrisë baltosllave të protoshqipes ashtu si dhe forma e futurit me **-syo* dhe e participit pasiv të prezentit me prapashtesën *-mō ~ -mā*., që do të thotë se janë shumë më të hershëm se kontakti i protoshqipes me greqishten.⁴

. Mendimi i Joklit,⁵ pranuar nga Sandfeldi, Riza, Hampi e ndonjë tjetër se habitörja p.sh. *qenkam* është përftuar nga përngjitja e formës së futurit që paska qenë sipas tij *qenë kam* me pjesën *qenë* në vlerë të paskajores *me qenë*, d.m.th. me kuptimin *me qenë kam = kam me qenë*, është i pasaktë, ashtu siç janë të pasakta edhe mendimet e disa gjuhëtarëve që i shohin format e pjesores pësore të së kryerës si forma origjinalisht të paskajores së lashtë në shprehjet *duhet / do mbjellë* dhe *tue / duke mbjellë*, d.m.th. edhe në *me mbjellë, pa mbjellë* etj.⁶ Kjo është në përputhje me mendimet e shumë studiuesve se protoshqipja nuk kishte krijuar ndonjë formë sintetike të infinitivit.

Forma e futurit *kam + infinitiv*

Paskajorja e tipit *me + forma e pjesores pësore e së kryerës* (me

⁴ Për futurin me *-syo* në protoshqipen kemi folur në veprën **Rruga e formimit të fleksionit të sotëm nominal të shqipes**, Prishtinë, 1980, f. 77.

⁵ Në **Leteris, IV**, 3, f. 207-8. Shih edhe Sh. Demiraj, **Gramatikë historike e gjuhës shqipe**, Prishtinë, 1988, f. 1010.

⁶ Në fusnotë: Shih vrejtejet për paqëndrueshmërisë së këtyre vlerësimeve në veprën **Pjesorja e shqipes – vështrim diakronik**, Prishtinë, 1997.

dalë, me mbjellë etj.) është përftuar para krijimit të mbiemrit të nyjshëm, domethënë brenda huazimeve latine para shek. VI të erës sonë, kështu që ishte e tërë shqipes, ashtu si dhe privativi *pa dalë*, *pa mbjellë* etj. Nyja e përparme e mbiemrit është përftuar shpejt pas këtyre huazimeve latine deri nga shek. VIII.⁷

Edhe perifraza *kam + infinitiv* (kam me dalë, kam me mbjellë etj.) imponohet të shikohet e përftuar shpejt pas krijimit të kësaj paskajoreje. Po kur kjo perifrazë do të ketë kaluar në futur?

Futurin *kam + infinitiv* në gjuhën shqipe Sandfeldi⁸ e disa të tjerë e shohin të përftuar nën ndikimin e latinishtes, ashtu siç është, sipas tij, në rumanishten, në bullgarishten e greqishten bizantine.

E. Benvenistei ka shënuar se perifraza *habeo + infinitiv* për një kohë shumë të gjatë nuk ka pasur mundësi të kalonte në futur e ta zëvendësonte futurin e lashtë me *-bo* (cantabo etj.) për shkak se kishte një vlerë semantike “krejtësisht të ndryshme nga vlera e synimit që e shoqëron nocionin e futurit”. Kjo perifrazë ka pësuar ekstension duke kaluar në fjali të lirë nga fjalia e varur dhe me infinitiv nga të gjitha foljet e se “ky ekstension është përftuar shumë vonë (shek. VI –VII)... Në të njëjtën kohë është realizuar progresivisht fiksimi i renditjes *infinitiv + habeo* dhe fuzioni i dy pjesëve përbërëse. Është ky transformim i sintagmës në një formë unike që e ka bërë të aftë të marrë në paradigëmë vendin e futurit të vjetër”.⁹

Në jemi shprehur se në gjuhën shqipe forma perifrastike *kam + infinitiv* (kam me mbjellë etj.) burimisht nuk ka mundur të shprehte kuptimin e futurit, sepse infinitivi pas foljes *kam* do të ishte në funksion kundrinor.¹⁰ Nga kjo lidhje me foljen *kam* nuk mund të dilte kuptimi i veprimit që synohet, që do të kryhet, kuptimi i kohës së ardhme.

Neve na ka rezultuar se kjo paskajore, e përftuar nga sintagma parafjalore me kuptim instrumental të parafjalës *me*, që ka kaluar në pjesëz, nuk mund të dilte në funksion të fjalisë qëllimore.¹¹ Funksio-

⁷ **Periodizimi i ndryshimeve morfologjike të shqipes**, Prishtinë, 2010, 62 e Sh. Demiraj, **Gjuha shqipe - Probleme dhe disa figura të shquara të saj**, Tiranë, 2003, 33.

⁸ Në **Linguistique balkanique**, 1930.

⁹ Në **Problèmes de linguistique générale**, 2, Paris, 1974, f. 132-33.

¹⁰ **Periodizimi i ndryshimeve morfologjike të shqipes**, Prishtinë, 2010, f. 64.

¹¹ **Shih Pjesorja e shqipes – vështrim diakronik**, Prishtinë, 1998, f. 136 e vijim.

nin e fjalisë qëllimore paskajores ia sjell parafjala *për*. Kështu më parë ishte krijuar shprehja *kam për me mbjellë* = kam për qëllim me mbjellë, e cila që në krijim e kishte krejt të afërt kalimin në funksion të futurit si formë e parë e kësaj kohe. Më vonë me elipsimin e parafjalës *për* në këtë kontekst u përftua forma e së ardhmes [kam me mbjellë etj.], ku *me mbjellë* erdhi tani si fjali e varur qëllimore me prani të nënkuptuar të parafjalës *për*. Përftimi i funksionit të fjalisë qëllimore të paskajores në bashkëvajtje me parafjalën *për* (për me mbjellë etj.) është i njëkohshëm me përftrimin e funksioneve të fjalive të tjera të varura të paskajores, d.m.th. se është krejt i afërt me kohën e krijimit të kësaj paskajoreje.¹² Mund të përfundohet, prandaj, se futuri *kam + për + infinitiv* është përftuar brenda kohës së shënuar të huazimeve latine, para kontaktit me gjuhët sllave.

Kalimi i perifrazës së shënuar në futur në gjuhën latine, siç u pa, ka përfunduar pas ndryshimit të renditjes në *infinitiv + habeo* me elementet e përngjitura. Ky zhvillim i kësaj perifraxe është kryer në gjuhët neolatine perëndimore përmes latinishtes tardive. Nga kjo do të nënkuptohej se latinishtja perifrazën *kam për me mbjellë* në gjuhën shqipe e kishte lënë pa ndikim të mëtejme për të kaluar në futur. Ndikimi i vjetër nga latinishtja do të ishte i pandërprerë drejt kalimit në renditje të përmbysur të elementeve përbërëse edhe në gjuhën shqipe. Kështu kalimi i kësaj perifraxe të shqipes në futur, duke e ruajtur renditjen *kam + për + infinitiv* tregon se nuk u krijua nën ndikimin e latinishtes. Rënditja e tillë e segmenteve përbërëse (*habeo + infinitiv*) nuk u bë formë e futurit në gjuhët romane. Ajo, siç është çmuar, “është etapë e ndërmjetme midis futurit latin dhe futurit roman”.¹³ Nga sa u tha mund të përfundohet se kuptimin e futurit perifraza *kam + për + infinitiv* e kishte marrë në një proces më të shpejtë se perifraza e latinishtes që u desh të kalonte nëpër një transformim të gjatë kuptimor e formal deri në kuptim të futurit.

Në latinishten ballkanike kontinentale a danubiane perifraza *habeo + infinitiv* u krijua më vonë e nuk u zhvillua si në latinishten vulgare perëndimore, kështu që nuk u përftua e njëjta formë e re sintetike e kohës së ardhme. Në pjesën e latinishtes ballkanike që kaloi në dalmatishte nuk u

¹² Shih vep. e cit., f. 160 e vijim.

¹³ E. Benveniste, vp. e cit., f. 131.

zhvillua as perifraza *infinitiv + habeo* as perifraza *habeo + infinitiv*, kështu që në këtë gjuhë futuri *kantura (do të këndo)* është vijim i formë së futurit II cantavero (*do të kem kënduar*).

Për perifrazën *habeo + ad + infinitiv* në gjuhën rumune është thënë se është më e vonshme se rumanishtja e përbashkët,¹⁴ ashtu si dhe kalimi i saj në futur të kufizuar dialektor dhe se del edhe në greqishten e mesme a bizantine. Në greqishten e mesme kjo perifrazë qëndroi deri kur infinitivi doli nga përdorimi, d.m.th. deri në përfundim të kësaj periudhe dhe vetëm disa të folme e zëvendësuan infinitivin me lidhore dhe shprehja *kam + lidhore* e përftoi vlerën e së ardhmes, ndërsa në rumanishten perifraza e tipit *kam + lidhore*, e krijuar pas rumnishtes së përbashkët, që d.m.th. se ishte dialektore, ka mbetur shprehje modale me kuptim të detyrimit, pa arritur ta përftojë vlerën e futurit, ashtu siç nuk ka kaluar në futur as perifraza *kam + lidhore* në bullgarishte, maqedonishte e serbishte.

Perifraza *habeo + ad + infinitiv*, që del më e vonshme se krijimi i futurit *infinitiv + habeo* dhe më e vonshme se rumanishtja e përbashkët, ashtu si dhe në greqishten bizantine, d.m.th. githsesi pas shekulli XI, e përjashton mundësinë e lidhjes së saj me futurin e shqipes *kam për me mbjellë* etj. Krijimi i vonshëm i kësaj perifraze në rumanishte e në greqishten e mesme mbase përkon me krijimin recent të së njëjtës perifrazë (*habeo + infinitiv*) në disa dialekte të italishtes, spanjishtes e të Sardishtes.

*

Shqipja e fazës së dokumentuar si forma të futurit ka edhe format *do + lidhore e tashme [do të mbjell etj.]* dhe *kam + paskajore e dytë [kam për të mbjellë etj.]*. Toskërishtja e ka edhe formën e futurit [*kam të shkoj etj.*] në përdorim tepër të kufizuar dialektor, në të folmet italo-arbëreshe, në çamërishte e në nja dy fshatra të Bregdetit të Poshtëm në përdorim të rrallë. Kjo formë del edhe në elementin italo-grek e në ndonjë të folme të greqishtes.¹⁵

Futuri [*kam për të mbjellë*], që është më i ri se futuri [*kam për me mbjellë a kam me mbjellë*], është përfutur pasi ishte krijuar mbiemri i nyjshëm. SP-ja [*për të mbjellë etj.*] në funksion të plotësit të

¹⁴ *Istori limbii române, II*, grup autorësh, București, 1969, f. 268.

¹⁵ Me trajtim të veçantë duhet të shikohen rastet e rralla, të reja të përdorimit të këtij futuri në të folmen e Dibrës e të Matit.

qëllimit me foljet jokalimtare të lëvizjes ka kaluar në infinitiv me funksion të kufizuar të fjalisë qëllimore. Kështu, format e futurit [*kam për me mbjellë etj.*] dhe [*kam për të mbjellë etj.*] kanë arritur të jenë variante të lira për mjaft kohë në tërë shqipen. Ato vijuan të jenë të tilla në gegërishte deri në ditët e sotme.

Në toskërishte, kur doli nga përdorimi paskajorja *me mbjellë etj.* nga preferenca e shprehjes me lidhore, ajo nuk qëndoi as në përbërje të futurit *kam me mbjellë*, edhe pse aty nuk ishte e zëvendësueshme nga lidhorja. Këtu mbeti në përdorim futuri sinonimik *kam për të mbjellë*, që vijonte të përdorej edhe në gegërishte.

Mbasi paskajorja brenda futurit *kam me mbjellë* në toskërishte nuk u zëvendësua nga lidhorja *të mbjellë etj.* (*kam të mbjell etj.*), futuri *kam të mbjell etj.* nuk del të ketë qenë i tërë toskërishtes e se përdorimi i tij tepër i kufizuar do të jetë krijim mjaft më i ri se dalja nga përdorimi i paskajores *me mbjellë etj.* në këtë dialekt. Ngurosja e foljes *kam*: *ka të vemi etj.* në të folmen e San Marcanos, të Castroregios e në ndonjë të folme tjetër të arbërishtes, nuk ndeshet në të folmet e shënuara të toskërishtes, që do të thotë se kjo ngurosje është bërë pas kalimit të arbëreshëve në Itali. Kështu edhe mos ngurosja në pjesët e tjera tregon se kjo formë e së ardhmes është relativisht e re, përfutuar nën ndikimin e të folmeve greke që, siç u tha, e kishin krijuar këtë të ardhme pas heqjes nga përdorimi të infinitivit, d.m.th. pas shek. XII.

Forma e futurit dua + lidhore

Është konstatuar se mënyrën lidhore shqipja e ka të trashëguar nga gjuha e lashtë ie., “por gjatë zhvillimit historik të kësaj gjuhe, siç shënon Shaban Demiraj, ajo ka pësuar ndryshime largëvajtëse si nga ana kuptimore-funksionale ashtu edhe nga ana formale”.¹⁶

Në kohën kur protoshqipja nuk kishte paskajore, lidhorja nuk do të mund të mbetej pa u begatuar me funksione të fjalive të varura. Paskajorja, që u krijua më vonë, i mori të gjitha funksionet e fjalive të varura që i kishte marrë më parë lidhorja dhe doli sinonimike me të. Ato, me përjashtim të ndonjë rasti të rrallë, ku nuk ishin të zëvendë-

¹⁶ Në veprën **Gramatikë historike e gjuhës shqipe**, Prishtinë, 1988, f. 865.

sueshme me njëra-tjetrën, qëndruan variante stilistike, variante të lira dhe funksionojnë të tilla edhe sot në gegërishte.¹⁷

Nuk mund të mendohet po ashtu që lidhorja të mos ketë krijuar që atëherë edhe shprehje modale të tipit *dua të shkoj, mund të shkoj, lypset të shkojmë, duhem të shkoj* etj. e që paskajorja të mos i ketë gjetur këto shprehje të krijuara para saj. Ajo edhe këtu hyri në përdorim sinonimik me lidhoren: *dua/duë me mbjellë, mund (mu) me mbjellë, lypset me mbjellë, duhet me mbjellë* etj. Në *dua të mbjell* etj. ishte i hapur procesi i krijimit të futurit *do të mbjellë* etj., pa e humbur përdorimin si shprehje modale paralele me shprehjen *due/dua me mbjellë*.

Paskajorja e shënuar e shqipes nuk merr pjesë në evoluimin e shprehjes *dua me mbjellë* në futur, d.m.th. se ajo vijoi të mbetej shprehje modale *dua me mbjellë, duam me mbjellë* etj. Meqë kjo perifrazë nuk kaloi në futur, siç kaloi në nonjë të folme të greqishtes së vjetër, në rumanishten e përbashkët e në gjuhët përkatëse sllave të Ballkanit në shek. XIV, nuk mund të ketë gjenezë të përbashkët me perifrazën *dua + infinitiv* të këtyre gjuhëve.

Nga kjo shihet se procesi i formimit të futurit volitiv në gjuhën shqipe e greqishte është i ndryshëm. Ndërsa shqipja para se ta krijonte perifrazën *dua + infinitiv* e kishte krijuar shprehjen *dua + lidhore e tashme* (*due/ dua të shkoj*), nga e cila u krijua e ardhmja, në greqishte në përgjithësi (me përjashtim të pak të folmeve) *thélō + infinitiv* (*thélō gráfein - dua + infinitiv*), e krijuar që në shekujt e parë të e. re, nuk kaloi në futur. U desh që infinitivi të zëvendësohej nga lidhorja, kur në tërësi doli nga përdorimi dhe vetëm atëherë perifraza e krijuar *thélō na grafō* mori rrugën e gramatikalizimit në formë të futurit thà grafo. Përjashtimi i paskajores ka përfunduar në greqishten e mesme aty nga shek. XII, që do të thotë se perifrazës *thélō na grafō* i është dashur edhe një kohë për të kaluar në futur. Edhe në gjuhën bullgare e maqedone brenda futurit infinitivi u zëvendësua nga lidhorja dhe u përfutua forma e ngurosur e foljes *dua* dhe shprehja kaloi në futur në shekujt XVII - XVIII. Kështu, duke qenë se *dua të shkruaj* del formim më i lashtë se *thélō na grafō*, rezulton se edhe gramatikalizimi i këtyre shprehjeve në futur volitiv është më i hershëm në gjuhën shqipe.

¹⁷ Shih *Funksionet paralele të lidhores e të paskajores te W. Fiedler, Zhvillimi i infinitivit gegë nga aspekti i ballkanologjisë, Gjurmime albanologjike, V, 1975.*

Meqë paskajorja e shënuar ka dalë nga përdorimi vetëm në toskërishte nga preferenca e shprehjes me lidhore, ne kemi pranuar se kjo është zhvilluar nën ndikimin e greqishtes së mesme në një kohë kur në gjuhën shqipe ishin dobësuar shumë lidhjet veri-jug. Por prania e futurit *do të shkoj*, për të cilin Sandfeldi ka menduar se është vetëm i toskërishtes, bashkë me futurin *kam me shkue* në gegërishten është një fakt tjetër që e përjashton mundësinë që futuri i parë të jetë përfutur nën ndikimin e greqishtes, sepse nuk do të ishte edhe i gegërishtes.

Nga sa u shënuar del se i pari futur i protoshqipes ishte futuri sintetik me prapashtes *-syō. Nga format e futurit të përfutur nga perifraza i pari është futuri *do + lidhore* (do të shkoj etj.). Futuri i dytë, i afërt në lashtësi me të parin, është futuri *kam + paskajore* (kam me mbjellë) etj.), ndërsa futuri *kam + paskajorja e dytë* (kam për të mbjellë) është i kohës pas krijimit të nyjës së përparme, d.m.th. pas shek. VI e deri para huazimeve sllave. Futuri *kam + lidhore* (*kam të vete* etj.) është krijim edhe më i ri: pas largimit të infinitivit nga toskërishtja, d.m.th. pas shek. XII-XIII.

Bardhyl DEMIRAJ, LMU München/BRD

E ARDHMJA E TIPIT DO + LIDHORE SI DUKURI
MBARËGJUHËSORE, DIALEKTORE DHE BALLKANIKE NË
SHQIPE

Abstrakt

Objekti i kumtesës sime është i mirënjohur dhe i mirëtrajtuar, por që vijon të hulumtohet në mënyrë po aq intensive edhe në kohën tonë, sidomos në albanologji, ku është rihapur ndërkohë sipari i qerthullit problematik që ngërthen në vetvete shqyrtimi përqasës dhe diakronik i kësaj dukurie në shqipe, si gjuhë e mëvetësishme që flitet në Ballkan dhe si gjuhë ballkanike. Do të përqendrohemi në debatin lidhur me përfitim dhe shtrirjen në zanafillë të kësaj dukurie, që vjen me thënë me çështjet, nëse: a) kjo dukuri ka pasur e ka karakter të gjithmbarshëm apo thjesht dhe vetëm dialektor, e në bashkëlidhje me këtë edhe me çështjen b) rreth dinamikës dhe kronologjisë së zgjerimit të radiusit të saj në mbarë hapësirën kompakte shqipfolëse në Ballkan; e së fundi, në varësi me c) vlerësimin e faktorit brendagjuhësor është kushtëzuar dhe kushtëzohet edhe d) roli i faktorit të jashtëm, shi ai i kontaktit ndër-gjuhësor brenda së ashtuquajturës Lidhje Gjuhësore Ballkanike, ku në radhë të parë vjen në diskutim një ndikim i mundshëm i greqishtes së mesme (pas shek. XIII), parë ky edhe si një faktor domino që nxiti përfitim të këtij izomorfii dhe përhapjen e tij në formë valësh në mbarë arealin shqipfolës. Këto janë katër çështjet kryesore, në të cilat jemi fokusuar në studim, sigurisht pa synuar të kërkojmë e të gjejmë në çdo rast ndonjë zgjidhje të re, aq më tepër që qarkullon ndërkohë një mori syresh, të cilat i dallon nga njëra-tjetra sipas rastit nata me ditën, por jo rrallë vetëm cipa e qepës. Në pikëpamje të metodikës në punë i mbetemi besnikë hetimit diakronik dhe rindërtimit gjuhësor që pason mbledhjen, krehjen dhe përqasjen e të dhënave dialektore dhe atyre të dokumentacionit shkrimor, të cilin në kohën tonë arrijmë ta hetojmë dhe përpunojmë teknikisht shumë më lehtë e më mirë se dikur. Lidhur me rolin e faktorit të jashtëm, shi me statusin e kësaj dukurie si ballkanizëm i mirëfilltë i shqipes, jemi mjaftuar në përfundim vetëm me ndonjë vërejtje të skajshme të karakterit metodik, sa i përket konceptimit dhe hetimit të interferencës përkatësisht konvergencës gjuhësore në kuadrin e Lidhjes Gjuhësore Ballkanike. Këtë e kushtëzon deri diku edhe fokusimi ynë në studim kryesisht në arealin gjuhësor e kulturor gegë.

1. Objekti i studimit, qerthulli problematik dhe diskutimi përkatës

Objekti i këtij punimi është i mirënjohur për shumëkënd, i mirëtrajtuar nga shumëkush e që vijon të hulumtohet në mënyrë po aq intensive edhe në kohën tonë. Mjafton të përmend këtu vetëm disa emra studiuesish që i janë përkushtuar kësaj dukurie me punime ballore në dhjetëvjeçarim e fundit, siç janë Sh. Demiraj (2002), Fiedler (2004a/b) e Altimari (2005) për të vijuar me syresh që kanë botuar studimet e tyre deri para pak kohësh, si p.sh. Maynard (2009), Mansaku (2010), Badallaj (2010), Matzinger (2010 a/b), Topalli (2010, 2011) e duke e përmbyllur listën me një punim të I. Arapit, i cili nuk ka parë ende dritën e botimit. Sigurisht që një vështrim perspektiv i historikut të hulumtimit diakronik të kësaj dukurie në shqipe do të përcillte në debat edhe më shumë emra albanologësh, ndër të cilët – përpos disave të përmendur më lart, lejohem të veçoj atë të albanologes peterburgase Zhugra (A. B. Žugra 1976). Emra të tjerë studiuesish që lidhen me këtë objekt studimi, si p.sh. Kopitar (1829), Miklosich (1861), Weigand (1926), Sandfeld (1930), Ajeti (1954, 1978), Domi (1961), Çabej (1975), Likaj (1978), Solta (1980), krahas Sh. Demiraj (1986, 1994), Fiedler (1989) etj.¹ dëshmojnë, ndër të tjera, edhe perspektivat e ndryshme të studimit që parakupton hulumtimi ballor i tipit të së ardhmes DO + LIDHORE, që rezulton ndërkohë:

a) në vështrim sinkronik:

- të ketë hedhur rrënjë të forta në gramatikën përshkruese dhe normative të shqipes standarde (GGJSSH I 316vv);
- të jetë i pranishëm në kohën tonë thuasje gjithkund në hapësirën kompakte shqipfolëse (ADGJSH I, 376, Karta nr. 126), edhe pse jo kudo me të njëjtën gamë dhe denduri përdorimi;²

b) në vështrim diakronik:

- të ketë zanafillën e vet në një periudhë para fillimeve të lëvrimit të shkrimit shqip (Sh. Demiraj 1986 816vv, 850);

¹ Një bibliografi shteruese lidhur me studimin e kësaj dukurie, sidomos nga perspektiva e gjuhësisë ballkanike, do t'i kapërcente kufijtë e një artikulli studimor.

² Lidhur me dendurinë e përdorimit të këtij tipi në hapësirën kompakte shqipfolëse citohet edhe në kohën tonë konstatimi i Çabejt (1975 64), sipas të cilit: "Në pikë-pamje dialektgjeografike ... e ardhmja e ndërtuar me *kam* + *paskajore* mbizotëron në gegërishten, sidomos të pjesës veriore, e ardhmja me *do* në toskërishten e në gegërishten jugore." Hollësisht për këtë Sh. Demiraj 1986 824vv.

- të jetë rezultat i gramatikalizimit largvajtës të një fraze foljore me dy gjymtyrë në marrëdhënie sintaksore (pas gjase) asindetike e me përdorim prospektiv-voluntativ ose/edhe necesitativ, një gramatikalizim ky që mori formë të përfunduar me përgjithësimin dhe ngurosjen e fjalëformës (2/3 nj. tash. dëf. akt.) {do} si pjesëz gramatikore, e cila i paraprin foljes kryesore në trajtën paradigmatiche përkatëse të mënyrës lidhore, khs. *do të shkruaj, do të shkruaja, do të kem shkruar, do të kisha shkruar* (Sh. Demiraj 1986 816vv).³ Ishin së fundi këto rrethana që mundësuan më tej:

- të mëtohej për këtë dukuri njëherësh dhe qysh herët një dëshmi e kontaktit ndër-gjuhësor, duke e vështruar atë si ballkanizëm të mirëfilltë, bash si produkt i së ashtuquajturës interferencë gjuhësore (= transfer gjuhësor) ndër-mjet gjuhëve në kontakt (lidhja gjuhësore ballkanike), të cilat në shumicë e ndoshta jo rastësisht kanë sot në përdorim të gjithmbarshëm ose dialektor tipa strukturorë të kësaj natyre, khs.: rum. o să scriu, arum. va (s-)scriu, bullg. šte (da) piša (ще (да) пиша), maq. ke (da) pišuvam (ке (да) пишувам), 4 gr. ὄχι γράφω (< ὄχι γὰρ γράφω) “do të shkruaj” (Sandfeld 1930 180vv).

Kjo paraqitje sado e thukët e objektit të studimit sigurisht që vetëm na nxit të hapim siparin e qerthullit problematik që ndërthet në vetvete shqyrtimi për qasës dhe diakronik i kësaj dukurie në gjuhën shqipe. Përpos gjurmimit të ndër-lidhnisë së mundshme ndër-mjet faktorëve gjuhësorë të brendshëm (evolucioni i mëvetësishëm i shqipes si gjuhë bashkëkohore) me ata të jashtëm (prirja e këtij evolucioni në bashkëvajtje me konvergencën ndër-gjuhësore ballkanike), edhe në këndvështrimin se cili syresh ka luajtur rol kryesor në përfitim dhe ngjizjen e kësaj dukurie në shqipe, kohët e fundit të bie në sy (ri)hapja e debatit për çështje, rreth të cilave sigurisht që është debatuar edhe më parë, por që pozicionimi ka qenë më se

³ Në ligjërimin bisedor, por edhe në shqipen e shkruar, nuk janë të rralla format e tkurrura të kësaj strukture që dëshmojnë bjerrje të shënjesit gramatikor {të} të mënyrës lidhore, khs.: *do shkruaj, do shkruaja, do kem shkruar, do kisha shkruar* (shih GGJSSH I 290v). Në të folme të ndryshme toske, duke përfshirë këtu edhe të folmet e diasporës ndeshim dukuri kontaminimi largvajtës me pjesëzën gramatikore {do} si shënjesit i kategorisë së kohës, khs. *dot, ot, o, da* etj. (hollësisht Fiedler 1989 92).

⁴ Në bullgarishte kemi edhe format e plota me *da*, khs. *šte da piša*, ndërsa në maqedonishte ndërtime të tilla si: *ke da pišuvam*, bartin edhe kuptimin modal të presuntivitetit. Shih ndër të tjerë Solta 1980 217v dhe sidomos Fiedler 1989 88vv (me aparat bibliografik përkatës).

i qartë ndërmjet dhe jo edhe përbrenda perspektivave të studimit. Bëjmë fjalë këtu fillimisht për debatin lidhur me përfitim dhe shtrirjen në zanafillë të kësaj dukurie, që vjen me thënë me çështjen, nëse: a) kjo dukuri ka pasur e ka karakter të gjithmbarshëm apo thjesht dhe vetëm dialektor, e në bashkëlidhje me këtë edhe me çështjen b) rreth dinamikës dhe kronologjisë së zgjerimit të radiusit të saj në mbarë hapësirën kompakte shqipfolëse në Ballkan; së fundi, në varësi me c) vlerësimin e faktorit brendagjuhësor është kushtëzuar dhe kushtëzohet edhe d) roli i faktorit të jashtëm, shi ai i kontaktit ndërgjuhësor brenda së ashtuquajturës Lidhje Gjuhësore Ballkanike, ku në radhë të parë vjen në diskutim një ndikim i mundshëm i greqishtes (pas shek. XIII), parë ky më fort si një faktor domino që nxiti përfitim dhe këtij izomorfi dhe përhapjen e tij në formë valësh në mbarë arealin shqipfolës.

Këto janë katër çështjet kryesore, në të cilat jam përqendruar në studimin tim, sigurisht pa synuar të kërkoj e të gjej për çdo rast ndonjë zgjidhje të re, aq më tepër që qarkullon ndërkohë një mori syresh, të cilat i dallon nga njëra-tjetra sipas rastit nata me ditën, por jo rrallë vetëm një cipë qepe. Në pikëpamje të metodikës së punës i mbetem besnik hetimit diakronik dhe rindërtimit gjuhësor që pason mbledhjen, krehjen dhe përqsajen e të dhënave dialektore dhe atyre të dokumentacionit shkrimor, të cilin në kohën tonë arrijmë ta hetojmë dhe përpunojmë teknikisht shumë më lehtë e më mirë se dikur. Lidhur me rolin e faktorit të jashtëm, shi me statusin e kësaj dukurie si ballkanizëm i mirëfilltë i shqipes, jam mjaftuar në përfundim vetëm me ndonjë vërejtje të skajshme me karakter metodik, sa i përket konceptimit dhe hetimit të interferencës (= transferit) përkatësisht konvergencës gjuhësore në kuadrin e Lidhjes Gjuhësore Ballkanike. Këtë e kushtëzon deri diku edhe fokusimi im në studim kryesisht në arealin gjuhësor e kulturor gegë.

2. Dukuri dialektore apo e gjithmbarshme në hapësirën shqipfolëse

Lidhur me çështjen e parë, debati mund të konsiderohet sot i ezauaruar për shqipen e folur bashkëkohore.⁵ E për këtë mjafton me shfletuar

⁵ Edhe pse jo i njohur e i pranuar sa e si duhet, sidomos në rrethe shkencore të interesuara drejtpërsëdrejti për rezultatet në albanologji. Më hollësisht Fiedler (1989 90; 2004 531), i cili ngre zërin ndaj mendimit të gabuar në ato rrethe, ku mëtohet prania e një dallimi dialektor në ndërtimin e kohës së ardhme midis toskërishtes dhe gegnishtes (: t. {do_{pi}})

tash Atlasin Dialektologjik të Gjuhës Shqipe (I 376), i cili na kumton se ky tip ndërtimi i së ardhmes mbulon gjithë hapësirën kompakte shqipfolëse, sikurse edhe enklavat e diasporës historike shqiptare. Hetimi i korpusit letrar dhe ai i dokumentacionit shkrimor në shek. XIX dhe XX, duke përfshirë këtu edhe fondin e regjistruar të letërsisë gojore shqipe të shpie natyrshëm në të njëjtin përfundim.⁶ Për më tepër, rezultatet e këtij hetimi mbështesin bindshëm mendimin se në dialektin gegë – sidomos në gegnishten qendrore dhe veriore – ky tip strukturor konkurrohet denjësisht prej ndërtimeve paralele të tipit KAM + PASKAJORE: a) *kam me shkru(e)* dhe më rrallë b) *kam për të shkru(e)*, pra me anë të foljes ndihmëse {kam_{find}} dhe ndërtimeve paskajore përkatëse: {me_{pj} + V_{pjes} PASKAJORE} dhe {për_{pj} + të_{pj} + V_{pjes} PASKAJORE}, duke ngushtuar deri diku, krahas dendurisë, edhe spektrin e përdorimit të tij kryesisht në bashkëlidhje me nuancimet modale të doemosdoshmërisë (= futurum necessitatis) përkatësisht të dëshirës, apo vullnetit (= futurum voluntatis)⁷ ose/edhe në ndërtimet privative përkatëse.⁸ Përkundrazi, në dialektin toskë – siç pritet dhe dihet – ky tip strukturor sundon thuajse i vetëm në ligjërimin bisedor.⁹

Këto rrethana bëjnë që çështjen në shqyrtim ta zhvendosim në dia-kroni, d.m.th. të gjurmojmë përfundimin dhe përhapjen e kësaj dukurie në shqipe, shi nëse kemi të bëjmë me një dukuri në zanafillë me karakter dialektor apo me shtrirje të gjithmbarshme në hapësirën shqipfolëse. Pa hyrë që në fillim në detaj, mund të themi paraprakisht se të dyja opsionet mbe-ten sot e gjithë ditën të hapura, edhe pse në studimet e fundit vërejmë t'i mëshohet më fort të parit, i cili mëton një risi gramatikore të mirëfilltë që shtrihej para dokumentimit shkrimor të shqipes vetëm në arealin toskë, por

+ {të_{pj} V_{lidh} LIDHORE} ~ g. {kam_{find}} + {me_{pj} V_{pjes} PASKAJORE}), i cili, sipas tij, edhe në rast se ekziston, ka të bëjë vetëm me variantet letrare të këtyre dialekteve.

⁶ Në këtë rast vjen në vështrim sidomos areali kulturor-gjuhësor i Veriut. Ndër autorët e hetuar në këtë areal dallojmë: (shek. XIX) G. Guagliata 1856²; E. Radoja 1862, 1872; Jung, G. 1862 etj.; (shek. XX) Fishta, Gj.: Lahuta e Malcis, 1937 (ribot. Shkodër 2006: Botime Françeskane); nga letërsia gojore mbledhur në shek. XX, khs. ndër të tjerë: Gjeçov 1933; Shuteriqi 1990; Jankaj, P. Z.: 2007 etj.

⁷ Sh. Demiraj 1986 826v.; K. Topalli 2010 235vv.

⁸ Ndërtime të tilla i ndeshim p.sh. në të folmet e gegnishtes verilindore (Kosovë), khs.: *kam me shkue, po s'do t' shkoj*. (kumtim me gojë prej R. Ismajlit)

⁹ Për ndërtimet me nuacime të fuqishme modale të tipit *kam për të shkruar*, shih së fundi GGJSSH I 291v.; për tipin italo-arbëresh *kam të shkruaj*, që është regjistruar në ndonjë të folme toske jugore shih ADGJSH I 376.

që erdhi e u përhap pas shek. XVI edhe në gegnishte (Mansaku 2010). Argumentet gjuhësore që sillen në vështrim janë të karakterit negativ-falsifikues e që:

a) kanë të bëjnë kryesisht me vlerësimin dhe interpretimin e fakteve gjuhësore në dokumentimin shkrimor: Letërsia e vjetër geqe e shek. XV/XVI – XVIII dëshmon vetëm tek-tuk ndonjë ndërtim të tipit të së ardhmes DO + LIDHORE (Demiraj 1986 824, Fiedler 2004 531v), madje edhe për këto pak raste nuk mungon tashmë përdorimi i bodecit, sa i përket forcës së argumentit (Matzinger 2010a 52vv.; 2010b 458vv.). Është fjala këtu si për dëshminë e mëhershme të këtij tipi që e ndeshim në fjalësin e kalorësit gjerman Arnold von Harff (1497), ashtu edhe për dy dëshmi më të vona në “Mesharin” e Gjon Buzukut (1555), khs:

(1) Von Harff: <do duple / ich wil dat gelden> = [?]|do da ple| [?][= do ta blej] ¹⁰

(2) Buzuku: fol. 68 70 (Gjoni 18 11):

<Anuche doh teh pij chelkine kimeh orzënoih atih> |A nukë do të p¹ kelqinë qi më ordhënoi ati?|

¹⁰ Interpretimi i dikurshëm (1 nj dëf ardh akt) {do_{pj} t_{pj}(-a) ble_{1 nj lidh tash akt}} (ndër të tjerë Demiraj 1986 825vv), vihet ndërkohë në diskutim nga disa studiues që mëtojnë – pas gjase me të drejtë – një tog foljor dy gjymtyrësh në marrëdhënie asindetike *{du(e/o)_{1 nj dëf tash akt}} + {t_{pj}(-a) blej_{1 lidh tash akt}} (Hetzer 1981 237v; së pari Meyer 1884 260; shih edhe Fiedler 2004 532; Matzinger 2010a 52v; 58vv). Analiza e grafisë së tekstit të Von Harff-it lejon të interpretohet patëmetë vlera fonetike çu| për (alo)grafet <o>, <oi>, <oy>, khs. <poylle> = [‘pu.lə], <boice> = [‘bu.kə], <oi> [‘u.jə], <sto> = [ʃtu] “ashtu”; hollësisht për këtë çështje Maynard (2009 237vv). Gjithsesi përsiatjet ndaj një fjalëforme të rregullt çduo| që i përshtatet së ashtuquajturës shqipe e kohës së Buzukut janë hipotetike. Kështu së fundi Maynard (*ibid.*), e cila rreket të rindërtojë një të tillë: **|duo ta blej|, edhe pse jo vetëm për zanoren fundore të gjymtyrës së parë <do>: [?]|duo| (khs. <sto> = |shtu|) nuk gjen shpjegim, por edhe për atë të gjymtyrës së dytë: <-ple> rindërton pa forcë argumenti një fjalëformë me mbaresën {-j}, e cila pa dyshim do të duhej të gjëllinte në atëbotë si *{-nj}. Për mendimin tonë, do të ishim më të saktë, sikur të pranionim paraprakisht një formë alegro të ligjërimit të thjeshtë me thjeshtim të togut zanor: |du da ple| në vend të një forme hiperkorrekte **|duo ta ble(nj)|.

¹¹ Interpretimi i mëparshëm (1 nj dëf ardh akt) **{do_{pj} + të_{pj} + p¹_{1 nj lidh tash akt}} (Demiraj 1986, 825) ka për bazë – sipas Matzinger-it (2010a 53vv; 2010b 456vv) –, pas gjase versionin klementin të Vulgatës (lat.) |calicem quem dedit mihi Pater non bibam illum|. Përndryshe ai kërkon dhe gjen gjegjësin latinisht, duke iu referuar versionit të Mesharit Romak paratridentin: *Calicem quem dedit michi pater. non uis ut bibam illum*, i cili mundëson një interpretim të ri, përkatësisht praninë e dy predikateve në lidhje asindetike nënrenditëse me dy kryefjalë të ndryshme: {do_{2 nj dëf tash akt}} + {të + p¹_{1 nj lidh tash akt}}

(3) Buzuku: fol. 95^v, 44

<Pers eh chɤ *doh tete dergogn* tih teh veste> |Përse ku *do të të dërgonj*, ti të veshte|¹²

(lat)(non dicere pure sum) quoniam ad omnia quae mittam te ibis|

b) ose këto dyshime janë të karakterit strukturor-tipologjik: gegnishtja, ndryshe nga toskërishtja, gëzonte atëbotë, sikurse gëzon edhe sot e gjithë ditën një formë të pashtjelluar (analitike) të paskajores: {me_{pj} + V_{pjes} PASKAJORE}, përkatësisht dy tipa strukturash morfosintaksore të kohës së ardhme që ndërtohe(shi)n mbi këtë bazë, të prirë a) nga folja ndihmëse {kam}, khs.: *kam me shkue*,¹³ si edhe jo rrallë b) në bashkë-vajtje edhe foljen modale {dua}, e cila pas gjase i injekton(te) gjithë togut predikativ një funksion prospektiv-volitiv, khs.: *du(e) me shkue* (Mansaku 2010 337), si p.sh.:

(4) Buzuku: fol. 20^v, 5-6; 46

<Ai doh meh |ǰafune | chancha / e εognefeh ...> |qi do me thashunë | kanka e zonjësë|
<... ban por doh mee |ǰeǰune> |ban por do më gjegjunë|¹⁴

Gjithë këto përsiatje kundër përfimit të njëkohshëm e mbarëdialektor të tipit *do + lidhore* i ndeshim në plotësinë e vet e në një përfundim disi më të moderuar në studimin e fundit të Mansakut (2010 354v) rreth tipologjisë dhe kronologjisë së tipave të së ardhmes në gjuhën shqipe, ku ai vjen në përfundimin, se:

“Trajta e së ardhmes me *do + lidhore* duhet të ketë lindur e të jetë përgjithësuar së pari në një areal gjuhësor ku ka munguar paskajorja, siç është dialekti jugor i shqipes dhe prej andej është shtrirë në të gjithë shqipen, edhe në dialektin verior të pajisur me paskajore. Kjo shtrirje ka qenë krejt e mundshme, sepse edhe në këtë dialekt kanë ekzistuar parakushtet për një formim të pavarur të saj: lidhorja

[= do (ti, që unë) të pi ?] Vështirësitë objektive të dokumentimit na shtyjnë që këtë dëshmi ta lemë përkohësisht jashtë diskutimit.

¹² Fiedler (2004 422vv) mëton këtu një dëshmi më se të sigurt të tipit strukturor në fjalë: {ku_{ndf}} + {do_{pj} + të_{pj} + ... + dërgonj₁ nj dëf ardh akt DÉFTORE} [= (atje) ku (unë ty) do të të dërgoj]; ndërkohë që Matzinger (2010a 54) parapëlqen edhe në këtë rast një ndërtim sintaksor me nënrenditje me një fjalëformë lidhore, së cilës i paraprin një (ish) lokucion lidhëzor-ndajfoljor, khs.: ... {kudo_{ndf}} + {të_{pj} + dërgonj₁ nj lidh tash akt LIDHORE} [= ... kudo (ku/që unë ty) të dërgoj]. Shih më hollësisht § 2.1 / vërejtje (1), (2).

¹³ Hollësisht Demiraj, Sh. 1986 835vv.; Fiedler 1989 96vv., Mansaku 2010 338vv.

¹⁴ Filipaj (1994) në përkthimin e tij i mbetet besnik origjinalit latinisht duke dhënë të tashmen prospektive: <... por *po shkoj* ta zgjoj ... >.

përdorej gjerësisht dhe paralelisht me paskajoren, madje, siç e vumë në dukje më sipër, ndërtimet e lira sintaksore me foljen *dua* + mënyrën lidhore për të shprehur një veprim të dëshiruar në të ardhmen takohen shpesh edhe në “Mesharin” e Gjon Buzukut. Megjithatë fakti që në këtë tekst prej rreth 200 faqesh trajta me *do* + lidhore si trajtë e mirëfilltë gramatikore e së ardhmes takohet vetëm një herë dëshmon se kjo trajtë në shekullin XVI në dialektin verior, të paktën në të folmen e Buzukut nuk ishte përgjithësuar. Shtrirjen e saj besoj e ka ngadalësuar përdorimi i dy trajtave të tjera: përdorimi i mënyrës lidhore me vlerën e së ardhmes dhe ai me *kam* + paskajore. Në këto rrethana trajta e së ardhmes me *do* + lidhore në gegërishte duhet të jetë përgjithësuar në periudhën pas shekullit XVI si rezultat i bashkëmarrëdhënies të natyrshme midis dy dialekteve. Përhapja e kësaj trajte edhe në gegërishte ishte krejt e mundur sepse të dy elementet përbërëse të saj ishin pjesë përbërëse e strukturës gramatikore të gegërishtes.”

Pa hyrë që në fillim në detaj, mund të shtojmë paraprakisht se në rast se këtë tezë do të mund ta vërtetonim katërcipërisht, atëherë do të kishim të bënim me një dukuri të parë morfologjike(-sintaksore) që dëshmon një “rezultat të bashkëmarrëdhënies të natyrshme midis dy dialekteve” kryesore e, për më tepër, do të ishim në gjendje ta gjurmonim atë hap pas hapi në kulturën e shkrimit shqip. Do të kishim të bënim pra me përhapjen dinamike të një izomorfi, domethënë të një dukurie gramatikore me karakter në zanafillë dialektor, e cila në më pak se dy-tri shekuj arrin të përhapet natyrshëm përgjatë aksit Jug > Veri në të gjithë arealin shqipfolës.

Ishin pikërisht këto rrethana që na nxitën të thelloheshim më tej në shqyrtimin diakronik të kësaj dukurie, duke dashur të provojmë së pari bazën dokumentare të përhapjes së saj në kohë dhe hapësirë.

2.1. Gjurmë të së ardhmes së tipit DO + LIDHORE në gegnishten letrare të shek. XVII/XVIII

Lidhur me kronologjinë e përfimit dhe të përhapjes së këtij tipi strukturor – siç cekëm më lart¹⁵ – do sjellë në debat në radhë të parë situata në gegnishte, meqenëse në dokumentimin e saj shkrimor, që në përjasje me toskërishten është shumë më i plotë dhe në vijimësi edhe për shek. XVII-XVIII, nuk arrijmë ta izolojmë qartë, d.m.th. ose mungon fare,¹⁶ ose

¹⁵ Jashtë trajtimit të mëtejshëm kemi lënë shembujt nr. (1) dhe (2). Shih shën. 10 dhe 11.

¹⁶ Kontrolli i kryer në tekste të shkurtra, siç është rasti në “Letrën e pleqve të Gashit” (1689: shih Bartl – Camaj 1967, 22vv.), në “Mallkimet e së Enjtes së Madhe” (1744 sic!^o - 1704]: shih Kamsi 1956 210v.); në doracakun e Gjon P. Nikollë Kazazit “Dotrina

ato dëshmi gjuhësore që vijnë në analizë, lënë shteg për diskutim.

Të tillë janë p.sh. një buri shembujsh që kemi mundur të gjurmojmë në veprat e Pjetër Budit (1618, 1621a/b),¹⁷ të cilat bartin thujtje të njëjtën problematikë, sikurse në tekstin e Buzukut (shemb. nr. (3)). Këto raste Svane (1985, 1986) i ka zgjidhur në botimet e tija kritike duke përsiatuar trajta të lidhore në bashkëlidhje me një formacion, sipas rastit, përemëror, ndajfoljor apo lidhëzor me përngjitje, ku feks shënjesi {-do} si morfemë fjalëformuese përmbyllëse, khs.:

(5) Budi: RR 19 12-14

<tadie giççe cufc, afctuchi *cuurdote goditeey*, afctu ndoogne nevoye, te mos vdaarey ndoogne paa pageuom, ptepaamfuom, etepaadijytune:>

|t a die gjithëkush, ashtu qi, *kūr do të goditēj* ashtu ndōnjë nevojë, të mos vdārēj ndōnjë pā pagëzuom p[ër] të pāmsuom e të pādī(j)tunë.¹⁸

E njëjta situatë na paraqitet edhe në veprën e Frang Bardhit (1635), khs.:

(6) Bardhi: 210 12

<Cus ue nde Mullij *do emos do permiellette*> |Kush ve ndë mullī, *doemos do përmielletē*¹⁹ <(it.) Chi vā al mulino è forza che si infarini.>

Digitalizimi dhe botimi kritik i plotë i veprës së Pjetër Bogdanit “Cuneus Prophetarum ...” (Padua 1685) nga A. Omari (2005) mundëson ndërkohë edhe kërkimin dhe verifikimin e shpejtë në këtë veper madhore të letërsisë së vjetër shqipe. Hapin e parë dhe vendimtar në këtë drejtim e ka

christiana” (Romæ 1743 – bot. kritik prej B. Demiraj 2006); në “Letrën e fretënve të Pultit” (1761: shih Bartl – Demiraj 2009 63vv.); në “Pun t’nevoishime” (1766: shih B. Demiraj 2011, 79vv.) nuk dha asnjë rezultat pozitiv.

¹⁷ Kontrolli i kryer në konkordancat leksikore te Svane-s 1985, 1986 për veprat e Pjetër Budit “Dottrina Christiana” (1618), “Rituale Romanum” dhe “Speculum Confessionis” (1621).

¹⁸ Svane (*ibid*): |kuurdo|. E njëjta zgjidhje leksiko-sintaksore dhe grafike, në rasat e bashkëlidhjeve me funksion – sipas rastit – ndajfoljor, përemëror e lidhëzor: |ndo|, |sido|, |sado|, |kudo|, |kushdo|, |kedo|, |e cejeddo| ç= e cilado|, |posido|, khs. Budi RR 8 30; 10 21; 19 12; 25 3; 28 20; 68 4; 93 25; 107 25; 349 14; SC 16; 5 17 etj.

¹⁹ Diktuar dhe sjellë për diskutim së pari nga Sh. Demiraj (1986 825), i cili anon më fort në njohjen e një lokucioni ndajfolor / fjale ndërmjetëse, khs.: |Kush ve ndë mullī, doemosdo përmielletē| Ndryshe shkruesi i këtyre radhëve në botimin kritik të fjalorit të Bardhit (B. Demiraj 2008 517), ku ka parapëlqyer segmentimin me lokucion ndajfoljor të përngjitur në bashkëvajtje me një tog predikativ (= kohë e ardhme), që parakupton bjerje të natyrshme në ligjërimin e thjeshtë të pjesës {të} të mënyrës lidhore në kohën e tashme joaktive: |doemos do [të] përmielletē|.

ndërmarrë Arapi, e cila diktoi dhe përcolli në debatin albanologjik fillimisht dy dëshmi (2007 113v), duke i plotësuar ato më pas me një të tretë në punimin e saj në dorëshkrim (2010 – drsh.). Këto dëshmi përcjellin të njëjtat rrethana që përshekruam më sipër (shembujt nr. 3, 5, 6), khs.:

(7) Bogdani: Pj I: Scal. I. Lig. VII, 43 11-19 § 12:

<Beda për mbij | keto fjalë ڤڤotë ... Të keqijtë as gia kanë mbë Chiełt; e jù as gia mbë ketë jetë. Pò me fperelë t'atynë t' miravë kahë ini ndërëchiunë, chifc dò tù goditëtë mb' uçë duhetë mee gheuem.>

|Beda për mbī | keto fjalë thotë ... Të këqijtë asgja kanë mbë Qiellt; e ju asgja mbë ketë jetë. Po me shpëresë t'atyne t' mirave kahë ini ndërëqunë, qish do t' u goditëtë mb' udhë duhetë me e gëzueu.|

(it./lat.) <Beda sopra questa parola dice; ... Mali nihil habent in Cëlo; Vos nihil in Mundo; sed spe illius boni, ad quod tenditis, quidquid in via contingat gaudere debetis>

(8) Bogdani: Pj I: Scal. II Lig. I, 58 4-6 § 11 (Gjoni 4 13v)

<Cusc dò të pie kefsi vji perferij ka me i arçunë het>

|Kush do të pie kësi uji, përsërī ka me i ardhunë het|

(lat.) <Omnis, qui biberit ex hac | Aqua, sitiet iterum.>

(9) Bogdani: Pj II: Scal. II, Lig. II, 72 23-25 §3 [sic.4] – Mateus, 16 18):

<Tyg kam më të çanë Dryenatë Regenijlë Chiełet: chifc do të liçifc per mbij çheet, ka më kjanë liçunë endë mbë Ciełt:>

|Tÿ kam më të dhanë dryenat̃ e regjënīsë qiellët; qish do të lidhish përmbī dhët, ka më kjanë lidhunë ende mbë qiellt.|

<Tibi dabo claves Regni Caelorum; quodcunque ligaueris super Terram, erit & in Cëlis>

Siç u përmend edhe më lart, të gjitha këto struktura sintaksore (të nënvizuara prej nesh) – kryesisht në fjali me nënrenditje –, ku pjesëmerr rregullisht shënjuesi (i gramatikalizuar) {do}, kërkojnë hetim të detajuar për çdo rast në veçanti, sepse në çdo rast ky shënjues shfaqet me specifikën e vet, përkatësisht me një status të veçantë në kufijtë e fjalë- dhe të formë-formimit. Këtë specifike rreket dhe saktëson qartas Arapi (2007 113v),²⁰

²⁰ Sipas Arapit: “Hier ergibt sich das gleiche Problem wie bei Fiedler’s Beispiel von Buzuku. D. h. es ist fraglich, ob man es nicht mit den unbestimmten Pronomen *qishdo* und *kushdo* zu tun hat, die sich aus den Pronomen *qish* “was” und *kush* “wer” sowie der Partikel *do* zusammensetzen und die Bedeutungen “jede Sache, alles” bzw. “jeder-mann” haben.”

kur përqas shembujt nr. (8) dhe (9) me gjegjësit përkatës në “Mesharin” e Buzukut, i cili përdor aty rregullisht fjalëformat e kohës së tashme të lidhore apo të dëftores për të kumtuar një veprim që do të kryhet në të ardhmen, khs.:

(10) Buzuku: fol. 53^f 77-78:

|Gjithëkush *pi* n kësi ui, përhapë t i vinjë et|

(11) Buzuku: fol. 52^f 8-11:

|E u për të vërtetë juve thom se *qishdo* kafshë ju të *nlihdhëni* përmbi dhet, ato të jenë *nlihdhunë* e mbë qiellt|

Raste të kësaj natyre dëshmohen me shumicë në veprën e Bogdanit, e për to jo gjithmonë na vjen në ndihmë përkthimi përkatës italisht apo teksti origjinal latinisht që i vihen përballë tekstit shqip. Po sjellim këtu sa për ilustrim një shembull, ku përkthimi italisht pasqyron funksionin e disafishtë (fjalë- dhe formëformues) të shënjesit {do} në shqipen e kohës, khs.:

(12) Bogdani: Pj. II, Scal. II, Lig. II, 83 2-3 § 37:

<E *cuj do të lanë* begatijtë vet, kicf per ti çanë gni chind per gnia:...>

|E *kuj do të lanë* begatit̃ e vet, kish për t i dhanë njiqind për nja.|

(it.) <e che à *qualfiuoglia*, che *lasciarà* le sue ricchezze, li dara cento per vno>

Vërejtje (1): Përkthimi italisht i tekstit tingëllon në këtë rast fjalë për fjalë: [= e *kujtdo*, që *do t(i) lërë* pasuritë e veta, *do t'i japë njëqind për një.*] Pra, përdorimin e shënjesit {do} në tekstin origjinal shqip ne mund ta interpretojmë në vetëdijen e sotme gjuhësore, ndër të tjera: a) si pjesë përbërëse e një përemri të pacaktuar, në rastin tonë <*kujdo*> [= *kujtdo*] = it. <*qualsivoglia*>; b) si pjesë përbërëse e një fjalëforme foljore në kohën ardhme, në rastin tonë (3 nj dëf akt) <*do të lanë*> [= *do të lërë*] = it. <*lasciarà*> [= *lasciera*]; por edhe c) si fjalëformë më vete e foljes {dua}, përkatësisht si një gjymtyrë e mëvetësishme e një togu dyfoljor në bashkëlidhje sintaksore asindetike e me të njëjtën kryefjalë: <*do [qi] të lanë*> [= *do (ai që) të lërë*]. Gjithsesi, përdorimi në fjalinë kryesore i një forme të së ardhmes (së mënyrës dëftore / përkatësisht të mënyrës kushtore) të tipit {*kam_{find}*} + {*me_{pj} V_{pjes} PASKAJORE*}: <*kicf per ti çanë*> na lejon në këtë rast – sikurse në shembujt nr. (8), (9) – të mos hezitojmë e të pranojmë në gjuhën e Bogdanit si të mirëqenë ndërtimin e një forme të ardhme jo patjetër me nuancë modaliteti të ashtuquajtur prospektiv-volitiv ase necesitativ të tipit DO + LIDHORE.

Këtë përsiatje e tumir shterueshëm shembulli që vijon, të cilin e kemi qëmtnuar po në veprën e Bogdanit, e ku nuk gjejmë asnjë motivacion për të supozuar një formim të mundshëm ndajfoljor me përngjitje më {-do}, apo të një togu foljor me lidhje asindetike, khs.:

(13) Bogdani: Pj. II, Scal I, Lig. VI, 28 13 (§ 5)

<Herodi me te maç kujdes, e eεελ tinece ξξίρι ndaj vetehee te tre Regenijtë, e mballi muer bucurë fiale, tue ù porofitune atyne fa ma fort, chi të kçejine atypari, tue i καλεουεμ *kù do te kifcinë gietunë*, ate Reg terij, afctu chi endë aj te Vej meju fale.>

|Herodi me të madh kujdes e zëll tinëzë thirri ndaj vetëhë të tre regjënitë, e mbasi muer bukurë fjalë, tue u porositunë atyne sa ma fort, qi të kthejinë atypari, tue i kallëzuem, *ku do të kishinë gjetunë* atë regj të rī, ashtu qi ende aj të vej me ju falë.|

(it) <L'Herode con gran cura, & applicazione nascostamente chiamò à feli tre Rè, e fando da loro pienamente informato, raccomandandofi loro grandemente, che douessero per quella via ritornare con renderlo partecipe, *ouunque haueffero trouato* quel nuovo Rè, acciò ancor egli douessè andare ad'adorarlo.>

Vërejtje (2): Shembulli i përzgjedhur është një dëshmi më se e qartë, në kuptimin që nuk lejon asnjë lloj konfuzioni edhe në vetëdijën e sotme gjuhësore, lidhur me funksionin e shënjesit {do} në sekuencën |tue i kallëzuem, *ku do të kishinë gjetunë*|, ku ai shfaqet thjesht dhe vetëm si pjesëz gramatikore për të ndërtuar një formë analitike tejet të avancuar të njëres prej “kohëve të përbëra” të së ardhmes, siç është (3 sh dëf ardh përp shkuar akt): *do të kishinë gjetunë*.²¹

Një situatë të ngjashme gjuhësore me tekstin e Bogdanit, ndeshim edhe në tekstin e mëvonshëm dhe të vëllimshëm të Kuvendit të Arbënit (1706), ku arrijmë gjithashtu të diktojmë dëshmi më se të qarta përdorimi të së ardhmes së tipit DO + LIDHORE,²² por që sipas rastit mund të bash-

²¹ Qëllimi i kumtimit në tekst nuk na lejon aspak që në sekuencën |ku (do të kishinë gjetunë)| [= pikërisht aty ku (do të kishin gjetur)] të supozojmë praninë e ndajfoljes së përngjitur *kudo* „gjithkund“.

²² Pa ndonjë rezultat pozitiv u mbyll gjurmimi i kësaj strukture në gramatikën e parë të botuar të shqipes (gegnisht) prej murgut françeskan Francesco Maria da Lecce (1716), i cili regjistron kryesisht fjalëformat tipike geqe me foljen ndihmëse {kam}, khs. (indicativo – futuro) <une kam me kenduem>. I vështirë mbetet qëmtimi etimologjik i gjymtyrës së parë në tipin strukturor SHEI + LIDHORE, të cilin Da Lecce e regjistron rregullisht si <futuro> [= e ardhme] brenda nënsistemit të të ashtuquajturit <optativo> [= dëshirore]: khs. <scèi te kendògn , Dio voglia, che io canti> = |shei të kendonj| “da-

këmbartin edhe ndonjë nuacim modal volitiv përkatësisht necesitativ khs.:

(14)KA 1706 59 11-13

<e per trī | here nde trii ditt te Feftefe te leecitet Populit cù *dò te* *ççohet* mefcia e Parrocchie>

|e per tri here nde trī dit te festese te lëçitet popullit, ku *do te thohet* mesha e parrokiese|

(15)KA 1706 62 20-23 ~ CA (lat) 1706 50 3-5:

<Practù | te Prinde bijene endè veti nde fcommunike me te | biite, nde mos i daagnene, *do te bagnene* me vum | cunorene.>

|Prashtu te prinde bijene ende veti nde skomunike me te bīte, nde mos i dānjene, *do te banjene* me vum kunorene.|

<..., ideo Parentes etiam nefandi auctores proftribuli, jifdem anathematis cenfuris, à fuâ, filiorumque iniquitate removeantur:>

(16)KA 1706 96 27-29 ~ CA (lat) 1706 81 7-9:

<Giççe gaa te Kifcefe, chi del prej fe mbelieçun|nit, ndo prej ake, ndo prej fruitescit fe bafcti|navet, ndo *kadò te dall* dobija mbe Parochie, ççohet gjaja e Crifctit.>

|Gjithe gjā te Kishese qi del prei se mbliedhunit, ndo prei ake, ndo prei fruiteshit se bashtinavet, ndo *ka do te dal* dobija mbe paroqe, thohet gjaja e Krishtit.| KA 1706 97 32 ~ CA (lat) 1706 82 5-6:

(17)KA 1706 97 32 ~ CA (lat) 1706 82 5-6

<E te castigognene Parochit, ndo chi *dò te jene* faitore.>

|E te kastigonjene paroqit, ndo | qi *do te jene* faitore|

<... & Parochi, cujulcumque alterius culpam, pœnis vindicent severioribus.>

Kësaj tubëze shembujsh të përzgjedhur mund t'i shtohen tashmë edhe syresh të diktuar në tekstin e mëvonshëm gegnisht (jugor) të Anonimit të Elbasanit (1761[?])²³

(18)Anonimi i Elbasanit: 7 2-5:

|o mama ime, të dhimtunit qi ke për të marë për mort eme është ajo shpatë qi *do të shkonjë* ndë zemër të shpirtit yt.|

shtë Zoti, që unë të këndoj” (f. 51), <scèi te scèrbègn , Dio voglia, che io serva> = |shei te shërbenj| “dashtë Zoti që unë të shërbej”. Sipas Anila Omarit (kumtim me shkrim) na paraqitet një rast interesant te Bogdani, i cili do studiuar në veçanti, khs.: [Turitë i besojnë, e shej të bante i lumi Zot qi të mos kishinë dashunë ende me i ndjekunë malësorëtë tanë.| (I 44 17).

²³ Botim kritik i Elsie 1995.

(19) Anonimi i Elbasanit: 12 1-5:

|... shtiu duartë ndë qafë e e pu- thi ndë qafë e i tha: o krye i shenjtënuashim mbushun me urtësit të perëndisë qielsë, si *do të durojsh* kunorë ...|

Shumë domethënese në këtë pikë janë edhe regjistrimet e bëra (në fakt) gjysmën e parë të shek. XIX për të folmen gege të disporës shqiptare të Istrias, e cila pas gjithë gjasash duhet të jetë themeluar në (fillimet e) shek. XVIII.24 Këtu dëshmohen qartë forma me tkurrje të së ardhmes me *do* + lidhore, khs.:

(20) Shqipja e Istrias: Historia e Djalit Plangprishës (Luka 15 18)

|*Do ngrihem e vete* me karko tëtam tem, e *do tham* ati: tata, un kam vojt në kat me qiel e kontra tatës tem|

(lat.) |surgam et ibo ad patrem meum et dicam illi pater peccavi in caelum et coram te|

Vërejtje (3): Në këtë fjali ndeshim tri fjalëforma të së ardhmes në ligjërimin e thjeshtë dhe/ose të shpejtë, ku pjesëza e gramatikalizuar {të} e mënyrës lidhore është rrëgjuar e bjerrë përfundimisht, duke dëshmuar në të njëjtën kohë një moshë aspak të re të këtij ndërtimi/tipi strukturor në këtë të folme të diasporës gege. Të bie në sy në këtë rast edhe bivalenca e fjalëformave të latinishtes: (1 nj dëf ardh akt / 1 nj lidh tash akt) *surgam*, *ibo*, *dicam*.²⁵

2.2. Konkurrencë dhe variacion tipologjik në tekstet toskërisht të shek. XVI dhe XVIII

Transponimi i çështjes rreth pranisë dhe përdorimit të së ardhmes së tipit DO + LIDHORE në dialektin toskë për periudhën ndërmjet shek. XVI-XVIII duket në pamje të parë fiktiv, meqë askush nuk e hamendëson sot rrallësinë, e aq më pak mungesën e plotë të saj atëbotë në këtë dialekt. Gjithsesi të gjithë jemi po aq të vetëdijsëm e të ndërgjegjshëm që argumenti bazë që mbështet këtë përfundim nuk ka të bëjë aspak me rrethanat gjuhësore që ofrojnë përmendoret e lashta të shkrimit shqip në këtë dialekt, sesa me dendurinë e përdorimit të saj sot në ligjërimin e thjeshtë, i cili

²⁴ Bartoli 1932 359v (faksimile e tekstit origjinal); Ajeti 1971, 19982/3 (botim filologjik).

Hollësisht për fjalëformat dhe dukurinë në shqyrtim te Sh. Demiraj 1986 me literaturë.

²⁵ E kjo rrethanë na kujton dëshminë e fituar së pari në “Mesharin” e Gjon Buzukut (shemb. nr. 2), ku togut foljor, në mos njëfjalëformës foljore |do të pī| i përgjigjet fjalëforma latine |bibam|, të cilën Sh. Demiraj në kontekstin përkatës e interpreton (e pse jo!) si shënjes të mirëfilltë i kohës së ardhme. (shih § 2a)

rrjedh thujse pa kurrfarë konkurrence në jug të hapësirës kompakte shqip-folëse, d.m.th. në dialektin toskë,²⁶ por që konkurrohet më se denjësisht ndër arbëreshët e Italisë,²⁷ të cilët parapëlqejnë gjithkund ndërtimet e tipit {kam_{ind}} / {ka(t)/ ket_{pj}} + {të_{pj} + V_{lidhore} LIDHORE}. Dhe është fakt që në të vetmin tekst toskërisht/ italo-arbëresh sadopak të vëllimshëm që trashëgojmë prej shek. XVI, këtë tip strukturor të së ardhmes e hasim vetëm një herë, thënë më qartë kemi fatin të kemi hasur një të tillë, e kjo falë tekstit origjinal italisht që disponojmë në drsh. A të katekizmit të Matrëngës (1592), khs.:

(21)Matranga: drsh. A, fol. 28v 11-14, fol. 29r 1-5:

<D: pche piu presto dobbiamo, morire che offen|derlo -

I m.: psè, máæ gnìjse duàmæ, tæ vdè|sæmæ sé ti ftèsnæmæ.

M: Come *amerette* il profsimo come voistefso?

Si *do*, tæ duàx, miræ, fchìgnænæ, àxtú | sì uettæhènæ>

| D: p(er)che piu presto dobbiamo morire che offen|derlo -

I m.: pse më nǐze duamë të vde|sëmë se t' i ftesnjëmë

M.: Come *amerete* il prossimo come voistesso?

Si *do të duash* mirë fqinjënë ashtu si vetëhenë (?)|

Vërejtje (4): Siç përmendëm më lart, sekuencën |do të duash| = (origj. shq.) <do, tõe duàx> e vlerësojmë sot – sigurisht me të drejtë (!) – si fjalëformë e kohës së ardhme (pas gjase me nuancim modal necesitativ – Zhugra 1976 237; Fiedler 1989 96) falë fjalëformës it. <amerette> në variantin origjinal, i cili i paraprin gjegjëses shqipe. Përndryshe askush sot për sot nuk do të mund të kundërshtonte bindshëm dyshimin se mos ndoshta edhe në këtë rast do të kishim të bënim me një tog foljor dygjymtyrësh me të njëjtën kryefjalë, khs. **|Si *do* (ti që) të *duash*|, sikurse rezulton dy rreshta më lart, khs.: |dobbiamo morire = duamë (ne që) të vdesëmë|.

Një rast akoma më çorientues ndeshim në këtë vepër disa folie më pas, khs.:

(22)Matranga: drsh. A, fol. 37v 10-14:

²⁶ Dëshmitë e para shkrimore nga ky dialekt datohen gjithsesi jo më parë se shek. XVIII.

Në to hasim rregullisht fjalëformat e së ardhmes së ardhmes të tipit *do të shkruaj* e më rrallë atë të tipit *kam për të shkruar*, khs.: (Kostë Berati) |po ku është i Shën Pjetri që të tha: / *do të vdes* me ty bashkë|; (Nezim Berati) |ô shpirt, *do të këndonetë* / gjer më kiamet| pranë |Të *ka për të ardhurë* keq, të / thuash i-mjeri seç heq punënë| etj.

²⁷ Për fjalëformat gjegjëse në arvanitishte shih Haebler 1965 161 § 364; Sasse 1991 *passim*.

|M.: Come si *ha da preparar* colui che *si vole/confesare* -
si *kā të dërtonetë* ai që |*do të ksemolloisetë*|²⁸

Rrethana edhe më të pasigurta shoqërojnë tekstet e vjetra po-arbëreshe në gjysmën e parë të shek. XVIII,²⁹ khs.:

(23)Figlia: I Krishteu i Arbëresh 1737(?), shq. f. 49 ~ it. f. 150:

|M. Kūr *kā të zërë* fill t' agronjë?

D. *Do t'ket bërë* njëzet vjet.

M. Çë *do t'thëtë* ksomollia?

D. *Do t'thët* kūr na biemë më këmbët shejtit zot ...|

(it.) |M. Quando *dovrà iniziare* a digiunare?

F. *Dovrà avere compiuto* venti anni.

M. Che *vuol dire* Confessione ?

F. *Vuol dire* quando noi ci prostriamo ai piedi del santo signore ...|

Vërejtje (5): Në variantin shqip të këtij pasazhi ndeshim krahas ndërtimit tipik arbëresh të së ardhmes modale necesitative kam + lidhore (rreshti nr. 1), edhe (të paktën) një ndërtim të tipit necesitativ (?) do + lidhore (= e ardhme e përparme, rreshti nr. 2), që pasohet (në mos prej një forme të ardhme të arbërishtes) prej lokucionit me funksion ndajfoljor |do t'thët(ë)| (rreshtat 3, 4). Të katra dëshmitë që vijnë në varg njëra pas tjetrës në tekst, kanë një tipar të përbashkët: janë përkthime të togjeve foljore me funksion modal necesitativ: it. *dovrà iniziare*, *dovrà avere*, ose volitiv (?): it. *vuol dire*. Nga ana tjetër mund të shtojmë se pa e njohur këtë rrethanë – pikërisht tekstin origjinal italisht – ne në ndërgjegjen e sotme gjuhësore edhe në këtë rast do ta kishim më se të vështirë të bënim një dallim të qartë në statusin morfologjik-sintaksor të sekuencave |do t' ket berë| dhe |do t' thët(ë)|.

Duke përfunduar këtu këtë çështje të parë, mund të mëtojmë me pak a shumë siguri se mbledhja dhe klasifikimi i të dhënave që ofrojnë për-

²⁸ Altimari (2005 4, shën. 5) dallon këtu një ndërtim prospektiv-volitiv (= futuro “volontativo”) që është tipik për të folmet arbëreshe, të cilat me sa duket nuk kanë në përdorim një ndërtim të së ardhmes si kategori e mirëfilltë kohore, pasi sipas tij edhe ndërtimi tipik arbëresh me anë të foljes ndihmëse *kam* (edhe në formë të ngurosur *ka(t)/ket*) që i paraprin foljes kryesore në lidhore është: “tale forma verbale perifrastica, che si configura tipologicamente come futuro modale e non come futuro temporale deittico, non copre le funzioni temporali del futuro propriamente detto, continuando a mantenere dei tratti aspettuali, associabili all’idea della necessità nel presente (e nel futuro), mancando sia nell’albanese d’Italia che nel greco d’Italia un tempo futuro vero e proprio.” (f. 3)

²⁹ Për shek. XVII nuk kemi në dispozicion asnjë dëshmi të këtij tipi.

mendoret e shkrimit shqip, sidomos trashëgimia shkrimore në arealin kulturor të Veriut, por edhe ajo ndër arbëreshët e Italisë na lejon paraprakisht të përcjellim përfundime të përafërta, domethënë jo krejt të padiskutueshme, qoftë për praninë ashtu edhe për dendurinë e tipit të së ardhmes DO + LIDHORE në këto treva gjuhësore në dhe para fillimeve të lëvrimin të shkrimit shqip. Përndryshe, për praninë dhe dendurinë e saj në këtë periudhë në trevat jugore (toske) të hapësirës kompakte shqipfolëse – për mungesë dokumentacioni – thjesht mund të deduktojmë pa mundur dot ta faktojmë një situatë të tillë, të paktën për ato zona (në Jugperëndim si edhe ndër arvanitët e Greqisë) që u prekën më fort prej shpërnguljeve masive drejt Italisë së Jugut dhe Sicilisë, ku janë ende në përdorim dy tipa strukturorë të së ardhmes e që dallohen në përdorim nga njëri-tjetri kryesisht prej nuanceve modale që përcjellin në komunikim. (Altimari 2005 3vv)

3. Shkallët e gramatikalizimit të ish-togut foljor $\ast\{dua_{fm}\} + \{të_{pj} + V_{lidh}\}$ LIDHORE}

Janë pikërisht këto rrethana gjuhësore që parashtrua më lart, të cilat na nxisin t'i rikthehemi si çështje e dytë në studimin tonë diakronik kronologjisë dhe dinamikës së përhapjes së të ashtuquajturit gramatikalizim largvajtës të ish-togut foljor $\ast\{dua_{fm}\} + \{të_{pj} + V_{lidh}\}$ LIDHORE, i cili – siç pranohet sot nga shumëkush – erdhi e mori formë të përfunduar me përgjithësimin dhe ngurosjen e fjalëformës (2/3 nj. tash. dëf. akt.) {do} si pjesëz ase shënjes gramatikor, duke fituar kështu i gjithë togu kuptimin kohor-kategorial të së ardhmes, khs. *do të shkruaj, do të shkruaja, do të kem shkruar, do të kisha shkruar* (Sh. Demiraj 1986 825vv).³⁰

E gjithë çështja duket sikur përmblihet tash në një pyetje të vetme: A ishte përfutur ky proces gramatikalizimi në mbarë hapësirën shqipfolëse në shek. XVI? Po të lëmë mënjanë përkohësisht dialektin toskë si për mungesë dokumentacioni, ashtu edhe për korpusin e tij aspak të vëllimshëm ndër arbëreshët e Italisë (Matranga 1592), nuk mund të hezitojmë për të vënë në dukje se rrallësia (më se e diskutueshme) e fjalëformave të tipit DO + LIDHORE në tekstin prej thujse 200 faqesh të Buzukut lë hije të forta dyshimi jo vetëm për shkallën e përgjithësimin të saj por edhe për vetë praninë e saj në gegnishten (veriore) të asaj periudhe (Fiedler 2004 532) ose të paktën në të folmen e Buzukut (Mansaku 2010 354). Ky dyshim përfor-

³⁰ Shih shën. nr. 3.

cohet edhe më shumë, kur ndjekim nga afër këtë dukuri në gjithë letërsinë e vjetër të Veriut në shek. XVII-XVIII, e cila dëshmon të njëjtat simptoma: a) rrallësi të tejskajshme në përjasje me tipin strukturor KAM + PASKAJORE (Budi 1618, 1621; Bardhi 1635, Bogdani 1685, Kuvendi i Arbënit 1706) ose b) mungesë të plotë të saj (Fr. Maria da Lecce 1702, 1716; Kazazi 1743 etj.) Vetëm pas një periudhe heshtjeje më se njëshekullore, bash në gjysmën e dytë të shek. XIX përjetojmë një situatë krejt tjetër në letërsinë (edhe atë fetare) të Veriut, ku nuk mungon ndonjë autor – atëbotë shumë i njohur – si Át Engjëll Radoja, i cili përdor më me shumicë fjalëforma të tipit DO + LIDHORE kundrejt asosh me KAM + PASKAJORE.³¹ Megjithatë mund të themi me pak a shumë siguri se në botimet e autorëve gegë të shek. XIX-XX këto fjalëforma kohore (edhe me nuancimet përkatëse të modalitetit të dëshirës/vullnetit apo të domosdoshmërisë) njohin përgjithësisht po atë shkallë dendurie, siç i përjetojmë sot e gjithë ditën në ligjërimin e thjeshtë gegnisht, ku parapëlqehet përgjatë aksit Jug > Veri ku më pak e ku më shumë – sidomos në gegnishten veriore dhe qendrore – tipi i së ardhmes me KAM + PASKAJORE.³²

Për zgjidhjen e pyetjes së parashtruar më lart, na ofrohen tashmë në pamje të parë (vetëm) dy opsione: a) “Trajta e së ardhmes me DO + LIDHORE në gegnishte duhet të jetë përgjithësuar në periudhën pas shek. XVI si rezultat i bashkëmarrëdhënieve të natyrshme midis dy dialekteve” (Mansaku 354); ose b) kjo trajtë – pavarësisht shkallës së dendurisë së saj – njihet dhe funksiononte ndërkohë gjithkund (Sh. Demiraj 1986 846vv.) në gjuhën e folur, por që për një arsye a një tjetër nuk parapëlqehet në përdorim nga autorët e vjetër gegë. Këtë opsion të fundit, sado i guximshëm që mund të duket në pamje të parë, e hedh në debat Arapi (2010 – drsh.), duke përsiatuar “përdorimin e rrallë të këtij ndërtimi [tek autorët e vjetër gegë – B.D.] me statusin e tij të veçantë stilistik si shprehje e një regjistri të lartë gjuhësor (Hochsprache) ose si një dukuri dialektore, e cila nuk ndihej ende e përshtatshme për gjuhën e shkruar.”³³

³¹ Tek Engjëll Radoja këto forma nuk mungojnë as në titull të botimeve të tij, khs.: *Jeau Criscti n’ eemer t’ mesctaarit. Kuitime t’ scpirtit ci do t’ keet mesctari per gicëzëzilen dit t’ mōit. Këzëye sc-ciyp’ prei D. Èignl Radojet prift’ i Dieces’ Sckodrs, Rom 1862.*

³² Shih shën. 2. Sipas Topallit “Në gegërishten veriperëndimore, si e ardhme e mirëfilltë përdoret forma *kam + paskajore* (*kam me bā*), kurse e ardhmja e tipit *do + lidhore* përdoret si *futurum necessitatis*” (2010 249).

³³ “... die seltene Verwendung dieser Konstruktion durch ihren besonderen stilistischen

Siç vumë në dukje edhe më lart (§ 2.b) opsionin e parë tash për tash lejohemi ta hamendësojmë si rrjedhim kausal – më se i njohur dhe i pranueshëm në argumentimin shkencor –, por që në rastin konkret nuk mundemi as ta vërtetojmë e as ta hedhim poshtë patjetër, ndër të tjera edhe për mungesë dokumentimi të toskërishtes mëmë (të shkruar) në periudhën në fjalë. Përndryshe, tejet joshës dhe po aq risues në debatin albanologjik është opsioni i dytë (edhe pse i dyzuar), pasi ndërkaq në shqyrtimin diakronik edhe rrafshin pragmatik të gjuhës. Duke dashur të gjallërojmë pikërisht këtë linjë të dytë në debat, anojmë gjithsesi ta moderojmë këtë opsion si tumirës i një dukurie që gjëllinte atëbotë në ligjërimin e thjeshtë, por që për një arsye a një tjetër – e cila do kërkuar – nuk ndihej (ende) e përshtatshme për t’u fiksuar si e tillë edhe në kulturën e shkrimit shqip (në arealin e Veriut). Ky opsion, që parakupton një vijimësi brez pas brezi të traditës së shkrimit shqip për periudhën në fjalë (: koineja letrare geqe), do të zgjidhte si reaksion zinxhir edhe shfaqjen “krejt të papritur” dhe në masë të fjalëformave të tipit DO + LIDHORE në gegnishten letrare të shek. XIX-XX, e cila na rezulton këtë kohë që të ketë bërë ndryshime të dukshme në paradigmen e vet, duke u shkëputur ashtu nga tradita historike e lëvrimin të shkrimit shqip,³⁴ shi duke u orientuar (edhe) drejt lexuesit të thjeshtë shqipfolës, që vjen me thënë duke e zgjeruar regjistrin e saj me elementë të ligjërimin të thjeshtë të kohës.³⁵

3.1 Situata gjuhësore në “Mesharin” e Buzukut

Le t’i përmbahemi kësaj perspektive studimi duke u fokusuar fillimisht në gjuhën e Buzukut, e cila është hetuar relativisht shumë më mirë se

Status als Ausdruck der Hochsprache oder aber als dialektale Erscheinung, die als nicht gut genug für die Schriftsprache empfunden wurde.” (Arapi – drsh. 2010: Resumé)

³⁴ Shih më hollësisht Ismajli 1985 37vv.

³⁵ Ndryshimi i paradigmes gjen shprehjen e tij të plotë në ripërkthimin e Akteve të Kuvendit të Arbënit (Mërqinjë, Janar 1703) nga ana lëvruerit të madh, por ende të panjohur të letrave shkoderanisht, Át Engjëll Radojës (1872, shih edhe shën. 6). Në hyrjen e thukët „Knuesit, mikut, t’dashunit“, Radoja kumton edhe orientimin e tij ndaj lexuesit të thjeshtë, sa vijon: [Nuk t’thom se n’ket libr, shkruie mieshtisht prei Vinçenc Zmajevikut, arçipeshkvit t’Tivarit, knohen fial t’rea, t’moçme e t’zgedhuna. Besa une, si flasim shqypen n’Shkodr, ashtu me t’paken forc temen jam munue me shkruie, tui çalltis, nderi ku kam muit, m’u shporr fialvet t’gjuhvet t’huejavet, e tui bā gairet edhe çl fialt, çl knohen ktu, t’jën marrun vesht prei Shqyptarit soçm.] (f. V)

ajo e autorëve të mëvonshëm të letërsisë së vjetër të Veriut. Prashtu, njihet tashmë që Buzuku përdor në veprën e tij disa mënyra për të shprehur gjuhësisht kohën e ardhme, duke parapëlqyer sipas rastit: a) tipin {kam_{fm}} + {me_{pj} + V_{pjes} PASKAJORE}, e po ashtu b) fjalëformat e (së tashmes etj. së) lidhores: {të_{pj} V_{lidh} LIDHORE} (shpesh edhe pa pjesëzën të), më rrallë c) vetë të tashmen e mënyrës dëftore {V_{tash} DËFTORE} me kuptimin kohor-kategorial të kohës së ardhme (Demiraj 1986 817), e në raste krejt sporadike e më se të diskutueshme edhe d) tipin që kemi në shqyrtim (shemb nr. (2)³⁶ – Demiraj 1986 825; dhe nr. (3) – Fiedler 2004 532v). Hollësisht për këtë së fundi edhe Mansaku (2010 337), i cili e tendos ende më shumë paletën e tipave strukturorë, duke i shtuar gjuhës së Buzukut – me të drejtë – edhe e) gjedhe sintaksore dygjymtyrëshe me të njëjtën kryefjalë³⁶ në lidhje asindetike ku si gjymtyrë të parë kemi foljen (gjysmë)modale {dua_{fm} dëf DËFTORE} + {me_{pj} + V_{pjes} PASKAJORE}, togje këto që padyshim i shoqëron në mjedisin përkatës edhe një dozë e fuqishme modaliteti i dëshirës apo vullnetit. (shemb. nr. (4)).

Ngërthimi edhe i këtij tipi të fundit në qerthullin tonë problematik le-
joi që të hetonim më nga afër një korrelacion të mundshëm morfologjik
ndërmjet togjeve dygjymtyrëshe {dua_{fm} tash dëf DËFTORE} + {me_{pj} + V_{pjes} PA-
SKAJORE} me ato të tipit {dua_{fm} tash dëf DËFTORE} + {të_{pj} + V_{lidho} LIDHORE},
të cilët në pamje të parë duket sikur nuk konkurrojnë aspak, përkundrazi
vetëm plotësojnë njëri-tjetrin në marrëdhënie shpërndarëse (= distribucio-
nale) brendapërbrenda së njëjtës paradigme, sipas rregullsisë që vijon:

a) tipi {dua_{fm} tash dëf DËFTORE} + {të_{pj} + V_{lidho} LIDHORE} përdoret rregullisht
dhe vetëm në vetën e parë njëjës, khs.:

(24) Buzuku: fol. 58^v, 19-21 (veta 1 nj):

< ... Mah | γ duo teh vete p[feh] atah en Λ ognê Λ u|mitt ... >

| ... Ma u duo të vete p[ër]se ata enqonj en gjumit ... |

(lat.) | sed vado ut a somno exsuscitem eum ... |³⁷

³⁶ Kemi lënë jashtë vështrimit rastet me dy kryefjalë të ndryshme, që gjëlljnë jo rrallë në tekst, sidomos me ndërkalje të njëres apo tjetres kryefjalë ndërmjet gjymtyrëve, khs.: <e Λ is mos doh | tuu teh iete baam>: (fol 23r 63-64), <e duo i γ teh dini uelaæene> (fol 49v 17), < γ doeh i γ teh mos chifgni|te> (fol 88r 59-60), < γ dii feh Λ is doh | hiirr tih teh lupgnes> (fol 89r 68-69), < γ doeh i γ teh mos chifgnite> (fol 88r 59); <A donih t γ lefogn> (fol 58v 66); < Λ is doh γ tuu tete h bagn?> (fol 41r 25)

³⁷ Lista pak a shumë e plotë në të gjithë tekstin: < γ duo teh iees delirune> (fol 38^v 24), < γ

b) ndërsa tipi {dua_{fm} tash dëf DËFTORE} + {me_{pi} + V_{pjes} PASKAJORE} shfaqet rregullisht në vetat e tjera, khs.:

(25) Buzuku: fol. 58^v 12-13 (veta 2 nj):

<... e tih *doh meh vote* atieh: eɣ per |ʔeʔ Jeeɣ: ...>

|e ti *do me votë* atie. E u për|gjegj Jezu: ...|

(26) Buzuku: fol. 21^r, 57-59 (veta 3 nj):

<e p̄emene teh tii grefitete poɣ lete gre-fitete hi dreʔit: feh maa doh meh clene p̄reih dreʔit>

|e pr emënë të t̄i greshitetë, por le të gre-shitetë i dreqit, se mā do me klenë p̄rei dreqit|

(27) Buzuku: fol. 47^v, 83-84 (veta 3 sh):

<anemiʔteh tane: duone me nah faruom emee ʔitune enfare ereditatneh tand:>

|anëmiqtë tanë duonë me na faruom e me e qitune en fare ereditatnë tand| etj.

Po të vazhdojmë të lëmë mënjanë dëshminë gjuhësore, pas gjase të diskutueshme: sh. nr. (2): (veta 1 nj) |do të p̄i| (shën. 11), vërejmë se ndonjë shmangie nga kjo shpërndarje më se e rregullt e strukturave dygjymtyrëshe foljore e ndeshim vetëm në grupimin e dytë (b), madje edhe këtu më se të qarta janë vetëm dy raste në vetën e dytë njëjës, të cilat shfaqen në fjali pyetëse, khs.:

(28) Buzuku: fol. 45^v, 83-84 (veta 2 nj):

<hi ʔah *adoh teh banes*| fendos: > |i tha: a *do të banesh* | shëndosh?|

(29) Buzuku: fol. 25^v, 51-52 (veta 2 nj): < ʔis lupen. Bagmine *adoh teh pa* |ʔeones Duoh.> |qish lypën. Bagminë. A *do të pa* |gëzonest? Duo. |

Përndryshe raste të tjera (jo të rralla) që i ndeshim në tekst e që duket në pamje të parë se i shmangen po ashtu grupimit të dytë (b), i përkasin bash atij qerthulli problematik që përcollëm më lart për autorë të mëvonshëm të letërsisë së vjetër të Veriut – shembujt (5), (6), (7), (8), (9), (12), (13), (14), (16)³⁸ – e që bashkëlidhen në një mënyrë a një tjetër me shembullin nr. (3), të diktuar nga Fiedler (2004 423v), khs.: (Buzuku fol. 95^v 44):

duo teh | flas> (fol 49^f 9-10), <ɣ duo tah ʔefign> (fol 49^v 35), <duo teteɣ percass> (fol 49^v 60), <ɣ duo tap cheti (fol 49^v 66), <ɣ duo teh vete> (fol 58^v 20), <ɣduo | t̄ɣ bagn> (fol 63^r/63^v 1 90/1), <ɣ duo teh | ieem> (fol 55^f 67-68), <ɣ duo te p farogn> (fol 60^f 62), <ɣ duo teh fiell> (fol 60^f 72), <ɣ duo teh higne> (fol 62^f 83), <ɣ duo teh | vete> (fol 65^f 63-64), <ɣ maa duo teh en barogn> (fol 90^v 56). Në tekst nuk kemi ndeshur asnjë rast, ku folja gjysmëmodale në vetën e parë <duo> të pasohet nga një folje në paskajore.

³⁸ Shih më lart *Vërejtje* nr. 1 dhe 2.

<Pers eh *ch* *doh* *tete* *dergogn* tih teh veste> = lat. |(non dicere pure sum) quoniam ad omnia quae mittam te ibis|. Është fjala këtu për disa struktura sintaksore në fjali me nënrenditje, që ngërthejnë dy- ase shumëkuptimësi në sjelljen gramatikore-kategoriale të elementit {do}, të cilat po i risjellim në diskutim në mënyrë selektive te ky autor me shembullin që vijon:

(30) Buzuku fol 64^r 3-7 (Matheu 26 13)

<E *ɣ* per teh verteteh iuue *ɰ*om: *ch* *doh* *teh* *iete* *pr̥edicuom* chuu vn *ƛ*iill: nder *p*ƛi^ɰɰe f̥eculit teh *ɰ*uheteh Higne aioh e banih per teh p̥mendunit teh f̥aih.>

|E u për të vërtetë juve thom: *Ku do të jetë predikuom* k̄y ungjill, endërpër gjithë shekullit të thuhetë: Hinje ajo e bani për të p[ër]mendunit të saj|

(lat) |amen dico vobis *ubicumque praedicatum fuerit* hoc evangelium in toto mundo dicitur et quod haec fecit in memoriam eius|

Vërejtje (6): Te kjo dëshmi përjetojmë shënjesin <doh> = |do| në një situatë pak a shumë të ngjashme me atë që morëm në analizë më sipër (*Vërejtje* 1: shemb. nr. (12)). Prashtu, përdorimin e këtij shënjesi në tekstin shqip ne mund ta interpretojmë në vetëdijen e sotme gjuhësore dhe në varësi me theksin logjik që i vendosim frazës, sipas rastit: a) si element fjalëformues (në përngjitje) në ndajfolje përemërore me theks fundor, në rastin tonë <*ch* *doh*> = |kudo| [ku.'do] = lat <*ubicumque*> (pasklas.) “kudo, gjithkund”;³⁹ b) si pjesëz gramatikore, përbërëse e një fjalëforme foljore në kohën e ardhme (të përparme), në rastin tonë (3 nj joakt) |([atje] ku) do të jetë predikuom| [= (atje ku) do të jetë predikuar] = |*praedicatum fuerit*|; por edhe c) si fjalëformë më vete e foljes {dua}, përkatësisht një gjymtyrë e mëvetësishme e një togu dyfoljor në bashkëlidhje sintaksore asindetike e me të njëjtën kryefjalë: *|[atje] ku do [ai qi] të jetë predikuom|; e së fundi d) rezultat i një rrudhjeje haplogjike e strukturave rrokjesore në kufi të fjalës: **|*kudo* [qi ai] do të jetë predikuom|. Edhe në këtë rast, sikurse në shemb. nr (12) që qëmтуam në veprën e Bogdanit, fjalëforma e foljes gje-gjëse latine rezulton të jetë bivalente: <*praedicatum fuerit*>.⁴¹

³⁹ Për shq. |të jetë predikuom| përkon në këtë rast përdorimi në lidhore i gje-gjëses latine <*praedicatum fuerit*>, shih edhe shën. e mëposhtëm nr. 40.

⁴⁰ Një konstrukt të ngjashëm parapëlqen Filipaj (1994): <Kudo që do të predikohet – në botën mbarë – Ungjilli, do të thuhet në përkujtimin e saj edhe kjo që bëri>.

⁴¹ E njëjta rrethanë edhe në fjalinë kryesore me fjalëformë foljore bivalente, khs. lat. <*dicitur*> (3 nj lidh tash pasive / 3 dëf ardh pasive), të cilën te Buzuku e përcjellim, siç pritët, me një fjalëformë gje-gjëse në mënyrën lidhore: |të thuhet|. Të njëjtat proporcione

3.2 Situata gjuhësore në letërsinë e vjetër shqipe. Përfundime paraprake

Qerthullin problematik që vërejtëm në paragrafin e mësipërm mund ta zgjerojmë tash më tej, duke ngërthyer në të edhe traditën shkrimore më të hershme e sado modeste të arbëreshëve të Italisë, e cila na shfaq të njëjtat simptoma, khs.:

(31)Matranga: drsh. A, fol. 14^v, 6-11 (veta 2 sh):

M.: <sono trij dei M.: jànae, tre, tənæçòtæra

D.: segnorno percioche quantunque siano tre persone, non dimeno, e un solo dio

I. m.: io, çot se *sàa dó, tæ ièenæ*, trij fâchie, gnæ iuètæmæ, inæçot>

M.: |sono trij dei M.: janë tre tənëzotëra

D.: segnorno percioche *quantunque siano* tre persone non dimeno e un solo dio.

I m.: jo zot se *sà do të jënë* trī faqe, një i vetëmë inëzot.|

A kemi të bëjmë edhe në këtë rast të fundit me një fjalëformë të së ardhmes me DO + LIDHORE? Është kjo e njëjta pyetje që shoqëron shumicën dërrmuese të dëshmimeve gjuhësore të regjistruara më lart, e që kërkojnë secila në veçanti një hetim më vete. Gjithsesi të gjitha këto dëshmi na përcjellin një strukturë të përbashkët, e cila bashkon në vetvete në unison tërë traditën e hershme të shkrimit shqip, sikurse edhe vetë shqipen e folur sot në gjithë hapësirën e saj kompakte në perëndim të Ballkanit, madje edhe në diasporën historike shqiptare. Bëjmë fjalë këtu bash për gjedhen morfologjike-sintaksore të sinkronizuar pas gjase shumë më herët në shqipe: {do_{pj} gram PJESËZ} + {të_{pj} + V_{lidh} LIDHORE}, në të cilën elementi i parë mund të ndërndërrohej në gjuhë me elemente të tjera, me zanafillë foljore, po ashtu të gramatikalizuara, e në varësi kjo me qëllimin e kumtimit.⁴²

Problemet me të cilat përballemi në interpretim, janë pra të karakterit sa objektiv aq edhe subjektiv. Prashtu vështirësitë objektive në rastin tonë kanë të bëjnë kryesisht me statusin morfologjik-sintaksor polivalent të shë-

i ndeshim edhe në sh. nr. (3) të diktuar nga Fiedler-i, ndërmjet foljeve në fjalinë e nënrenditur, khs: lat. |mittam| (1 nj ardh dëf akt / 1 nj tash lidh akt) me atë në fjalinë kryesore, khs. lat. |ibis| (2 nj. ardh dëf akt). Në këtë hulli hyn edhe dëshmia nr. (2) – tashmë e diskutueshme – që shtroi për herë të parë në debatin shkencor Sh. Demiraj: lat. |bibam| (1. nj ardh dëf akt / 1 nj tash lidh akt).

⁴² E tillë është p.sh. gjedhja e të ashtuquajturit jusiv (Jussiv) në shqipe: {le_{pj} gram PJESËZ} + {të_{pj} + V_{lidh} LIDHORE}, khs. Buzuku (fol. 25^f 7): <Lete diis hi malecuom dreĤ: > |Le të dīsh, i mallëkuom dreq:| = lat. |Ergo maledicte Diabole recognose...|. Hollësisht Fiedler 2004 532v.

njuesit gramatikor {do}, i cili dallohej gjithkund në shqipen e vjetër⁴³ (si-kurse edhe në shqipen e sotme), ndër të tjera: a) si element me prirje të fuqishme fjalëformuese (në përngjitje) për formacione përemërore, ndajfoljore apo lidhëzore nga më të ndryshmet, khs.: {ç+do}, {kush+do}, {i silli+do}, {i silli+dot-a}⁴⁴, {n+do+një}, {ku+do}, {(n+)ka+do}, {sā+do}, {kur+do}, {qish+do}, {si+do}, {do+e+mos+do}, {(n+)do (... (n+)do)}, {do+t} etj.; deri në b) zhvillimin e tij largvajtës (në gegnisht) si përemër i mirëfilltë (Buzuku, Budi, Bardhi, Bogdani etj.) {do} “disa”⁴⁵; përdorime që nuk arrihen dot të konkurrojnë ose të mënjanojnë sadopak nga përdorimi sjelljen e tij si c) fjalëformë (edhe kjo) bivalente e foljes dua: {do_{2/3} tash dëf akt}, së cilës i shtohet si përdorim i tretë shtesë edhe d) funksioni pavetor necesitativ, që shfaqet qartas në gjedhe sintaksore të tipit {do_{pj}} + {V_{pjes} pjesore}.⁴⁶ Këtë përdorim të fundit që Fiedler-i (1989 96)⁴⁷ e fikson në mënyrë bindëse si paraformë e gramatikalizimit të këtij elementi si e) pjesëz që bart kuptimin kategorial-gramatikor të kohës së ardhme, ne lejohe mi tash ta mëtojmë edhe si vatër e përfuturit të të gjitha funksioneve që përjetoi ky shënjes i shqipes në kohë, dhe që i përkasin në tërësinë e tyre e për periudhën në shqyrtim thuajse gjithë hapësirës shqipfolëse bashkë me diasporën historike shqiptare.⁴⁸

⁴³ Në tekstet e vjetra shqip ky element dallohet tek të gjithë autorët e në shumicën dërmuese të rasteve grafikisht si njësi e veçantë (?) leksikore-gramatikore, khs. (Buzuku) <ch̥ doh>, (Matranga) <sāa dō> etj. Që ndihet si tillë edhe në ndërgjegjen (e sotme) gjuhësore, këtë lejohe mi ta deduktojmë së qarti prej sjelljes gramatikore të përemrave të pacaktuar të përbërë {kush+do}, {cili+do}, që shfaqin pas gjase jo rastësisht eptim të brendshëm në rasat e tjera, khs. kall. {kë+do}, gj./dh./rr. {(i) kujt+do}; e me ndërtimet mocionale përkatëse: {cila+do}, {cilën+do} ~ {cilën+do} etj.

⁴⁴ Te ky variant i zgjeruar i përemrit të pacaktuar e me eptim të brendshëm, ne shohim të bashkangjitur pjesëzën e gramatikalizuar {dot-a} (nga ku {dot} < *{do} + {të}), që na shfaqet rregullisht në dialektin toskë në fjali pyetëse e mohuese të tipit: *A e bën dot? S’e bëj dot.* etj.

⁴⁵ Për përhapjen dialektore të këtij përdorimi shih së fundi Çabej SE III 270: *do* II.

⁴⁶ Demiraj 1986 951v.; khs. Bogdani (shkall II, ligj I 22): |po ende për shpirt do marrë vesht| etj.

⁴⁷ Shih edhe më parë Solta 1980 217 / shën. 187 (me aparatën bibliografik përkatës).

⁴⁸ Formime paralele me shqipen i ndeshim edhe në rumanishte, ku kemi si gjymtyrë të dytë shënjesuesin e gramatikalizuar të vetës së tretë në ndërtimet e së ardhmes {va} ç= (3 nj) do], khs.: *cine+va* “dikush”, *unde+va* “diku”, *cînd+va* “dikur” etj. Të njëjtat rrethana që përshkruam në shën. 43 i ndeshim edhe në rumanishte, khs. em/kall {(pe) cine+va}, rasa e zhdrejtë {cui+va}.

4. Zanafilla e tipit $\{do_{pj}\} + \{të_{pj} + V_{lidh} LIDHORE\}$ në kohë dhe hapësirë

Kur dhe ku e kanë zanafillën e tyre këto procese gramatikalizimi? Kësaj pyetjeje e kemi sot për sot të vështirë t'i japim një përgjigje të prerë, sa i përket përhapjes fillestare dialekt-geografike, por edhe caktimit të një kronologjie relative.⁴⁹ Gjithsesi lejohemi të pranojmë me pak a shumë siguri se kemi të bëjmë këtu me gjedhe morfologjike-sintaksore që jeshnin si të tilla, d.m.th. gjëllinin të gatshme në gjuhë pas gjase shumë më herët se vetë fillimet e lëvrimin të shkrimit shqip dhe që ishin të përhapura në të gjithë hapësirën kompakte shqipfolëse.

A ishte përfutur gramatikalizimi i gjedhes (së gatshme) $\{do_{pj} \text{ gram PJE-SËZ}\} + \{të_{pj} + V_{lidh} LIDHORE\}$ për të shprehur një kohë të ardhme (të dëftores)⁵⁰ në gegnishten e kohës kur shkruan Buzuku, Budi, Bardhi e Bogdani? Edhe sikur të vijojmë të lëmë mënjanë ase të heqim dorë përfundimisht nga dëshmitë e para shkrimore që shtroi dikur për diskutim Sh. Demiraj (1986 825): shemb. nr. (1) <do duple> [?]|du(o) ta ble|, apo shemb. nr. (2) <doh teh pij> [?]|do [ti që unë] të pī|, dhe më pas Fiedleri (2004 531): shemb. nr. (3) <chχ doh tete dergogn> [?]|ku do të të dërgonj|, ne nuk kemi tash kurrfarë motivi që të tumirim një përfundim kausal (Maynard 2007 231; Matzinger 2010a 53vv; 2010b 457vv) e të mëtojmë që kjo gjedhe mungonte atëbotë në gegnishten (veriore).

Një përgjigje të plotësuar – dhe pas gjase pohuese – do të mund të jepnim pasi të jemi përballur edhe me anën tjetër të monedhës: me vështirësi të karakterit subjektiv, që vijnë e bëhen më se të prekshme, në rast se

⁴⁹ Ky proces është pas gjasë më i vonë se gramatikalizimi i pjesëzës të si shënjes morfolojk i mënyrës lidhore $\{të_{pj} + v_{lidh} \text{ lidhore}\}$, zanafilla e të cilit kërkohet me të drejtë të një përemër lidhor $\{to/-\}$ në një rasë të caktuar e që mundëson në përdorim përfutimin e marrëdhënieve sintaksore nënrenditëse (Sh. Demiraj 1986 876: me aparat bibliografik përkatës).

⁵⁰ Qëndrimi negativ ndaj nuancimit modal është për mendimin tonë fiktiv, meqë atë e parakupton vetë shprehja gjuhësore e një veprimi që pritet, mund apo duhet të kryhet në të ardhmen, d.m.th. pas çastit të ligjërit. E në këtë rast nuk ka të bëjë thjesht dhe vetëm mosha (gjithsesi relativisht e re) e përfutimit të konstruktit analitik në shqipe, përkatësisht kuptimi burimor i atyre elementëve përbërës gramatikorë që bartin atë funksion, khs. p.sh. në çfarëdo lloj gramatike të gjuhës angleze ndërtimet, funksionet dhe përdorimin e kësaj me anë të foljeve ndihmëse shall dhe will. Për kronologjinë e përfutimit dhe funksionet modale shtesë të kohës së ardhme në gjermanishte (me ndihmën e foljes ndihmëse werden) shih ndër të tjerë Besch 1989 42vv.

fokusoheми në vijim në rrafshin pragmatik të shqipes së kultivuar në shek. XVI-XVIII, duke mbajtur parasysh këtu synimin dhe prirjen e (natyrshme të) autorëve tanë të Veriut për qartësi sa më të madhe në komunikim me lexuesin shqipfolës ase atë të huaj. Pas gjase këta autorë janë ballafaquar nga njëra anë me polivalencën në përdorim të shënjesit {do} e nga ana tjetër kanë pasur gjithashtu mundësi me përzgjedhur në paletën e larmishme të gjedheve dhe të fjalëformave ekzistuese (që kumtonin një veprim që do të kryhej apo do të mund/duhej të kryhej në të ardhmen), jo vetëm ato struktura foljore që ishin më të përhapura në gjuhë por edhe syresh që mundësonin si të tilla më shumë qartësi në komunikimin me lexuesin. Është pikërisht statusi i brishtë e i mëshumësenjëkuptimshëm i gjedhes në shqyrtim që mendojmë të ketë ndikuar në mënjanimin e vetëdijshëm dhe konsekuent nga përdorimi (edhe sot) relativisht i rrallë i së ardhmes së tipit DO + LIDHORE në letërsinë e vjetër të arealit të Veriut.

4. E ardhmja e tipit DO + LIDHORE – një dukuri ballkanike e shqipes

Pa dyshim që do të ishim të paplotë, sikur këtë qerthull problematik që përçon hetimi për qasës diakronik i tipit të së ardhmes DO + LIDHORE në shqipe, të mos e fokusojmë edhe nga një perspektivë e dytë studimi, pikërisht në kuadrin e pozicionit të shqipes në Lidhjen Gjuhësore Ballkanike si gjuhë ballkanike e shkallës së parë (Schaller 1975 103). Siç cekëm edhe në hyrje të studimit, bashkëpërkimi me gjuhë të tjera ballkanike (të këtij niveli) si rumanishtja me arumanishten, bullgarishtja e maqedonishtja e deri tek greqishtja e re është vërtet marramendës, khs. rum. *o să scriu*, arum. *va (s-)scriu*, bullg. *šte (da) piša* (ще пиша), maq. *ke (da) pišuvam* (ке пишувам),⁵¹ gr. *ὄν γράφω* (< *ὄν* *ὄν γράφω*), shq. *do (të) shkruaj* (Sandfeld 1930 180vv) Të gjitha këto gjuhë i bashkon në unison një gjedhe e përbashkët e tipit {DO_{pi} PJESËZ} + {(TË_{pi} PJESËZ +) V_{tash lidh/dëf} FOLJE}, në të cilën elementi i parë {DO_{pi} PJESËZ} = shq. *do*, rum. *o*, arum. *va*, bullg. *šte*, maq. *ke*, gr. *ὄν*, është rezultat i një procesi të brendshëm gramatikalizimi largvajtës të një fjalëforme të foljes DUA (3 nj tash. dëftore), pas gjase, në

⁵¹ Në bullgarishte kemi edhe format e plota me da, khs. *šte da piša*, ndërsa në maqedonishte ndërtime të tilla si: *ke da pišuvam*, bartin edhe kuptimin modal të presuntivitetit. Shih ndër të tjerë Solta 1980 217v dhe sidomos Fiedler 1989 88vv (me aparatit bibliografik përkatës).

përdorim fillestar pavetor.⁵² Hollësi për këtë proces na kumton Fiedler-i (1989 89), i cili vëren “në përfitim e pjesëzës DO [= lat. *vult*] të së ardhmes në radhë të parë shprehjen e një prirjeje të përgjithshme për krijimin e një tipi të ri shënjesish në fushë të zgjedhimit”, e për më tepër “zhvillimi pjesëzave të tilla shfaqet më së qarti në shqipe, dhe fakti që ajo [prirje – B.D.] p.sh. në maqedonishte është zhvilluar shumë më fuqishëm se sa, fjala vjen, në bullgarishten lindore, kjo gjë flet për një përqendrim [të kësaj dukurie – B.D.] në pjesën perëndimore të arealit ballkanik.”⁵³

Numri i studiuësve që e kanë përcjellë dhe e përcjellin këtë dukuri të shqipes nga ky prizëm është sigurisht shumë më i madh se ajo dorëz emrash që rreshtuam në hyrje të punimit. Prashtu, po të lëmë mënjanë ata studiuës që nuk duan ta njohin fare këtë dukuri si ballkanizëm i mirëfilltë,⁵⁴ e të përpiqemi të rreshtojmë vetëm mendimet e atyre që gjatë trajtimit të këtij ballkanizmi janë marrë konkretisht edhe me shfaqjen e tij në shqipe, do të arrijmë të izolojmë shpejt disa grupime studiuësish, ndër të cilët të parët dhe më të hershmit i kundërvihen njëri-tjetrit në të gjitha konstelacionet

⁵² Shih ndër të tjerë Solta (1980 221), i cili ngërthen këtë ballkanizëm me të drejtë në grupin e të ashtuquajturave “ballkanizma sintaksore”. Po të vijojmë thellimin tonë në diakroni, do të arrinim pa vështirësi të fiksonim (si bashkëpërkim marramendës) një gjedhe sintaksore burimore me nënrenditje ku feks si element i dikurshëm lidhës pjesëza TË, khs.: shq. *të* (< lidh.) **që, i cili” < ie. */to-/), rum. *să* (< lidh.) **që” < lat. *si* ; gr. *và* (edhe sot në përdorim si lidhëz nënrenditëse). Hollësisht Reichenkron 1962 106vv.

⁵³ (Citati origjinal) “Wir möchten in der Entstehung der 'velle'-Futur-Partikel in erster Linie den Ausdruck einer allgemeinbalkanischen Tendenz zur Schaffung eines neuen Markertyps im Bereich der Konjugation sehen. / Die Entwicklung solcher Partikeln ist am deutlichsten im Albanischen ausgeprägt (vgl. FIEDLER 1987c), und die Tatsache, dass sie z. B. im Makedonischen stärker entwickelt ist als etwa im Ostbulgarischen, spricht für eine Konzentration im westlichen Balkanareal.” Pa hyrë më shumë në hollësi, Fiedleri mjaftohet më tej të sjellë si dëshmi konkrete të kësaj prirjeje përdorimin e formave të shkurtra të përemrave vetorë: përfitim e formave përkatëse të lidhës ballkanike, të jusivit, të formave të mohimit etj. Sipas tij, vërehet këtu prirja për përfitim “e një shënjesi [gramatikor – B.D.] për një funksion”. Më tej ai vazhdon: “Bei dieser Umgestaltung des Markertyps ist deutlich ein Bestreben zu dem Prinzip “ein Zeichen für eine Funktion” zu bemerken. Diese Zeichen tendieren also zur Univerbierung, wenn man bei diesen morphologischen Partikeln überhaupt noch von besonderen Wörtern sprechen will, und zum Monosyllabismus; meist weisen sie dabei die Struktur KV (Konsonant + Vokal) auf.” (po aty)

⁵⁴ I tillë është ndër të parët Philippide 1927, 606.

tashmë të njohura të trinomit substrat ~ adstrat ~ superstrat, ku mëtohet sipas rastit: a) vijimësia e veprimit të substratit (Weigand 1926, X: trako-shqip); ose b) mundësia e ndikimit në sajë të kontaktit historik ndërghjuhësor, e në këtë rast vjen në analizë kryesisht ndikimi kulturor-gjuhësor i greqishtes së shek. XIII-XIV (Sandfeld 1930 180vv.; Jokl Litteris IV, 3 209; Georgiev 1977 11v. etj.); ose edhe i latinishtes mesjetare (Reichenkron 1952 109⁵⁵).⁵⁶

Le të ndalemi më mirë për arsye studimi thjesht dhe vetëm në qëndrimet e fundit që mbahen në albanologji ndaj këtij ballkanizmi, ku vërejmë ndërkohë se po përvijohet një prirje që nuk e konsideron më si të pamundur veprimin e adstratit, të kontaktit kulturor-historik ndërghjuhësor, parë ky më fort si një ndikim më se i besueshëm nga ana e greqishtes. Ndër të parët albanologë shqiptarë që debutoi me këtë qëndrim është Domi (1961 70), për të cilin më pas ky ndikim “do të jetë ndër jo [aq – B.D.] në formimin e kësaj të ardhmeje, në origjinë, por më vonë mbi dialektin jugor në zgjedhjen midis formave ekzistuese, duke shkaktuar mbizotërimin absolut të formës me ndihmësen dua, pastaj mënjanimin e formës tjetër me ndihmësen kam në këtë dialekt.” (Domi 1977, 672). Me një mendim deri diku të ngjashëm shprehet më vonë Fiedler-i (1989 108), që anon po ashtu të pranojë rolin e greqishtes së re, e cila pas gjase ka emetuar impulsin e nevojshëm për përdorimin e rregullt dhe përgjithësimin e gjedheve tashmë ekzistuese në ato gjuhë.⁵⁷ Të dyja këto mendime nuk kundërshtojnë aspak, përkundrazi mund të themi se i vijnë shumë përshtat tezës së Mansakut (shih § 2), i cili i mbetet besnik hetimit hap pas hapi të kësaj dukurie në rrafsh dialektor, duke mëtuar një përhapje të saj në formë valësh përgjatë

⁵⁵ Reichenkron-i përqendrohet më fort në përdorimin pavetor të tipit latin *habet, valet*, për fjalëformat e vetës së tretë, khs.: shq. *do*, rum. *o*, gr. *ἔ*, bullg. *šte*, të cilat morën rugën e gramatikalizimit në strukturat e tipit të së ardhmes në shqyrtim.

⁵⁶ Domethënës në këtë drejtim është qëndrimi delfian që mban ndaj këtij qerthulli problematik ballkanologu dhe indoevropianisti i njohur austriak, G. R. Solta, i cili në mbyllje të kreut përkatës “Syntaktische Balkanismen” në veprën e tij (1980 223) shton: “Abschließend läßt sich sagen, daß bei den syntaktischen Balkanismen im Gegensatz zu den morphologischen und lautlichen die Frage eines altbalk. Substrats in den Hintergrund tritt, der soziolinguistische Gesichtspunkt (die Volksschichten mit geringer Bildung bevorzugen eine einfachere Syntax⁵⁶) aber in den Vordergrund. Letztlich besteht indes zwischen beiden Voraussetzungen kein innerer Gegenstand.”

⁵⁷ “Das könnte dafür sprechen, dass vom Ngr. aus immer wieder Anstöße an ein schon vorbereitetes Muster weitergegeben wurden”. (1989 108)

aksit Jug > Veri si rezultat i bashkëmarrëdhënieve të natyrshme midis dy dialekteve. Një mendim të ngjashëm por jo të njëjtë me dy të parët e hasim edhe në monografinë “Gjuhësi ballkanike” të Sh. Demirajt (1994), i cili e moderon edhe më shumë qëndrimin e tij të dikurshëm (1986 842vv.), duke njohur tashmë si të mundur edhe një ndikim të jashtëm nga ana e greqishtes, gjithsesi si faktor dytësor në përfitim të kësaj dukurie në shqipe. Kështu, sipas tij:

„... duhet pranuar që të dy tipat e së ardhmes në shqyrtim [= me *kam* dhe *do* – B. D.] kanë qenë një zhvillim i brendshëm i gjuhës shqipe. Por pas mënjanimit të shkallëshkallshëm të ngjyimeve modale të tyre ishte plotësisht e mundshme që njëri tip të mbizotëronte në njërin dialekt dhe tjetri tip në dialektin tjetër. ...arsyet, që i kanë dhënë shkas një shpërndarjeje të tillë dialektore, mbeten për t’u hulumtuar. Sidoqoftë, në këtë rast nuk duhet përjashtuar mundësia e një ndikimi grek në mbizotërimin e tipit të së ardhmes me „do” në dialektin jugor, por natyrisht ky do të ketë qenë një faktor dytësor.” (1994 123)

Pa dashur dhe pa pasur mundësi të hyjmë dot në hollësi për secilin qëndrim, mund të gjykojmë paraprakisht se edhe në këtë perspektivë studimi ne përjetojmë një situatë pak a shumë të ngjashme me atë që parashtruam më sipër (shih § 3.2; 4), ku u përballëm me vështirësi të forta argumentimi të karakterit objektiv dhe subjektiv. Të parat kanë të bëjnë rrishtas me mungesat e theksuara në dokumentimin shkrimor të toskërishtes, një situatë të cilën mendojmë se nuk e lehtëson aspak si fakt gjuhësor denduria në rrudhje e përdorimit të së ardhmes së tipit DO + LIDHORE në ligjërimin e thjeshtë përgjatë aksit Jug > Veri të hapësirës kompakte shqipfolëse, një rrudhje kjo që sot përkon në proporcion të drejtë me përhapjen e së ardhmes së tipit KAM + PASKAJORE përgjatë aksit Veri > Jug në dialektin gegë.

Kemi të bëjmë pra me mungesë dëshmish gjuhësore në toskërishte, ndërkohë që në një gjuhë me prestigj më se të njohur kulturor, siç është greqishtja, ato i përjetojmë të fiksuara me shkrim dhe në vazhdimësi në të gjitha fazat e zhvillimit të saj në kohë e hapësirë, duke fituar si e tillë edhe konturet e një ballkanizmi të mirëfilltë morfo-sintaksor, khs.: *ἔλει ίνα γράφω* (pas shek. X e. j.) > *ἔὲ νά γράφω* (fundit shek. XIV / fillimi shek. XV) > *ἔὰ νὰ γράφω* (shek. XVI) > *ἔάν γράφω* > *ἔά γράφω* (Georgiev 1977 11v.).

Dhe janë pikërisht këto rrethana që të krijojnë një përshtypje të parë, sikur tashmë nuk ndeshim më asnjë pengesë metodike në argumentimin e

mësipërm – që mund ta quajmë ndryshe rrjedhim/deduksion logjik –, meqë merr pikënisje në kontaktin e mirënjohur historik-ndërgjuhësor në Ballkan dhe bazohet në dokumentimin shkrimor të patëmetë që ofron një gjuhë kulture, edhe pse e kufizon ndikimin e mundshëm gjuhësor thjesht në emetimin e një impulsi fillestar të gjuhës dhënëse (në rastin tonë të greqishtes së re), i cili, qoftë edhe si faktor dytësor, erdhi e u përthith, menjëherë në toskërishte duke u shtrirë në kohë dhe hapësirë nëpër gjithë arealin gjuhësor shqipfolës – sikurse edhe në mjedisin përkatës gjuhësor ballkanik –, por që për një arsye a një tjetër nuk arriti të konkurrojë në Veri formimet e tjera paralele të kohës së ardhme.

Sigurisht që nuk mendojmë se bëjmë ndonjë gabim metodik, në rast se edhe këtë ballkanizëm të shqipes e vështrojmë jo patjetër si një dukuri gjuhësore, të përftuar në gjuhë nëpërmjet ndikimit të njëanshëm gjuhësor (qoftë ky i reduktuar në dhënien e një impulsi nga jashtë), sesa një produkt i konvergencës gjuhësore, të përftuar në një mjedis të përbashkët kulturor-historik, ku është ligjërimi i thjeshtë ndërgjuhësor dhe jo patjetër një gjuhë prestigji kulturor, faktori që emeton impulset e para dhe së fundi dikton ngjizjen e “nur eine Sprachform ... mit dreierlei Materie” (Kopitar 1829).⁵⁸

Po qe se e pranojmë tash këtë opsion si të mirëqenë dhe vijojmë të ecim në këtë hulli argumentimi, mendojmë se nuk do ta kishim aspak të vështirë t’i jepnim përgjigje bindëse edhe pyetjes së fundit që mbetet për t’u shtruar: përse e ardhmja e tipit do + lidhore nuk ka mundur të konkurrojë dot në gegnishten veriore dhe qendrore tipat e tjerë morfo-sintaksorë që shpreh(n)in kuptimin kategorial të së ardhmes (Sh. Demiraj 1994 123). Në këtë rast na duhet thjesht dhe vetëm të pranojmë se – përpos tipave të tjerë konkurrues në ligjërim, khs.: a) kam + paskajore, apo b) fjalëformave të thjeshta të së tashmes së mënyrës lidhore dhe dëftore – një rol jo të parëndësishëm mund dhe duhet të ketë luajtur mjedisi historik-ndërgjuhësor, bash kontakti intensiv me gjuhët fqinjë, të cilat mund të favorizonin vetëm një gjedhe të përbashkët (por) dyfunktionale, atë të tipit c) dua + paskajore (§ 2.b): khs. serb. ću (ćeš, će) pisati [= du(e) (do, do) me shkruet], dalm. blaĭ dormér [= du(e) me fjetë] (Bartoli 1906 II § 534). Mendojmë se është pikërisht ky mjedis ndërgjuhësor, krejt i ndryshëm nga Jugu i arealit shqipfolës, që nuk i mundësoi tipit të së ardhmes do + lidhore ku-

⁵⁸ Për rrethana paralele në përfitim e numërorëve shtesore 11 – 19 në shqipe dhe çështje të karakterit metodik në studimin e tyre shih B. Demiraj 1993 66.

shtet e nevojshme për të ngadhënjyer konkurrencën me tipat e tjerë strukturore homonimikë që gjëllinin ndërkohë edhe në gegnishten veriore dhe qendrore.

5. Përfundim

Mbyllim këtu punimin tonë, duke shpresuar t'u kemi dhënë përgjigje çështjeve kryesore që sinjalizuar që në titull të tij: e ardhmja e tipit DO + LIDHORE si një dukuri sa mbarëgjuhësore, aq edhe dialektore e po aq ballkanike në shqipe, një dukuri kjo e përftuar pas gjase në truall të shqipes qysh para fillimeve të shkrimit shqip, e që vijon ende sot të gjëllijë gjithkund si e tillë por me një denduri që u kushtëzua në kohë e hapësirë qoftë nga zhvillimi jo i njëtrajtshëm që përjetoi konkurrenca e homonimisë strukturore brenda në gjuhë, ashtu edhe nga mjedisi ndërgjuhësor ballkanik, i cili e orientoi konvergencën gjuhësore në mënyrë të njëanshme, duke mos arritur kështu të ngërthejë gjithë hapësirën shqipfolëse.

Bibliografi - Burimet

- Ajeti, I. 1971 (1998²³): "Djali plëngprishës" në të folët shqip të Istrisë, në: Gjurmime albanologjike SSHF, 1 [1971] 7-16 (rib. në I. Ajeti. Vepra II, Prishtinë ASHAK 131-141).
- Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe (botues J. Gjinari et al.), bl. I 2007, II 2009. Napoli: Università degli Studi di Napoli. Dipartimento di Studi dell'Europa Orientale.
- Bartl, P. – Camaj, M. 1967: Ein Brief in albanischer Sprache aus Gashi vom Jahre 1689, në: Zeitschrift für Balkanologie, (5) 22-33.
- Bartl, P. – Demiraj, B. 2009: La lettera dei frati di Pulati (1761), lo sfondo storico e il suo rapporto con la storia della scrittura albanese, në: Nordalbanien – L'Albania del Nord. Linguistisch-kulturhistorische Erkundungen in einem unbekanntem Teil Europas, Hamburg: Kovač.
- Demiraj, B. 2006: Gjon Nikollë Kazazi dhe doktrina e tij, Prishtinë: ASHAK.
- Demiraj, B. (bot.) 2008: Ditionarium Latino-Epiroticum (Romæ 1635) per R. D. Franciscum Blanchum, Shkodër: Botime françeskane.
- Elsie, R. 1995: The Elbasan Gospel Manuscript ("Anonimi i Elbasanit"), 1761, and the Struggle for an Original Albanian Alphabet, në: Südost-Forschungen (54) 105-159.
- Filipaj, D. S. 1994: Bibla – Shkrimi Shenjt. Besëlidhja e Vjetër dhe Besëlidhja e Re. Përktheu dhe shtjelloi Dom Simon Filipaj, Ferizaj: Drita.
- Omari, A. (bot.) 2005: Pjetër Bogdani, Cuneus Prophetarum (Çeta e profetëve). Botim kritik, përgatitur nga Anila Omari, Tiranë: ASHSH.
- Da Lecce, Francesco 1716: Osservazioni Grammaticali Nella Lingua Albanese, Roma: Sag. Cong. di Prop. Fede.
- Fishta, Gjergj 1937: Lahuta e Malcis, Shkodër (ribot. Shkodër 2006: Botime Françeskane).
- Guagliata, G. 1856²: Dottrina e kerscten Cardinàlit Bellarmino t' Sciochniet Jesus, Csiëlun n' schyp prei P. Zefit Guagliata t' Sciochniet evèt, n' Rom: te stampùemin t' Scëitit Cuvên de Propaganda Fide.
- Gjeçovi, A. Sh. 1933: Kanuni i Lekë Dukagjinit (vepër postume) Përmbledhë e kodifikue prej A. Shtjefën Gjeçov O.F.M., Shkoder: Shtypshkroja Françeskane.
- Jankaj, P. Z. 2007: Krijimtari gojore (Kraje - Malesi), Malësi.
- Jungg, G. (SJ) 1862: Uça e sceites cryc e tiera pun' t' divocme. Scruem prei gni frat t' sceitit Isc' Françesckut, (Roma)
- Kamsi, K. 1956: Një dokument gjuhësor shqip dhe disa vjersha e materiale gjuhësore të kolonive arbneshe të Kalabrisë e të Basilikatëtës, BUSHT SSHSH (1) 210vv., Tiranë.
- Këngë kreshnike, bl. II, Prishtinë 1990: Instituti Albanologjik i Prishtinës.
- Nga kënga e popullit, në serinë: Mbledhës të folklorit, bl. 9, Tiranë 1990: ASHSH.
- Radoja, D. E. 1862: Jëu Criscti n' æemer t' mesctaarit. Kuitime t' scpiritit ci do t' keet mesctari per gi[çç]zilen dit t' mōit. Këççye sc-ciyp' prei D. Èignl Radojet prift' i Dieces' Skodrs, N' Rom me sctamp t' Cuenit S. t' Propagands.
- Radoja, D. E. 1872 : Concilli i Xëut Scciypniis, baamun n'viet 1703 n' coh t' Paps Scciyp-tarit Clementit t'Gnimçettit. I kaa citt scciyp Don Egnell Radoja, prift i Diocesit Skodrs, N' Rom me sctamp t' Cuenit S. t' Propagands.
- Sasse, H. J. 1991: Arvanitika. Die albanischen Sprachreste in Griechenland. Teil 1, Otto Harrassowitz-Verlag, Wiesbaden.
- Svane, G. (ed.) 1985: Peter Budi, Dottrina Christiana (1618). With a transcription into modern orthography and a concordance, prepared by Gunnar Svane, Århus: Institut for Lingvistik, Aarhus Universitet.

Svane, G. (ed.) 1986: Peter Budi, *Rituale Romanun* (1621). With a transcription into modern orthography and a concordance, prepared by Gunnar Svane, Århus: Institut for Lingvistik, Aarhus Universitet.

Svane, G. (ed.) 1986: Peter Budi, *Speculum Confessionis* (1621). With a transcription into modern orthography and a concordance, prepared by Gunnar Svane, Århus: Institut for Lingvistik, Aarhus Universitet.

Literaturë shkencore

Ajeti, I. 1954: Një shqyrtimi shkurtë mbi zhvillimin e futurit në shqipe”, në: Jeta e Re (2) (ribot. në: Kërkime gjuhësore Prishtinë 1978 18-25).

Altimari, Fr. 2005: Il “futuro necessitativo” dell’albanese d’Italia: Influenza italo-romanza o arcaismo balcanico?, në: Walter Breu, botues: L’influsso dell’italiano sulla grammatica delle lingue minoritarie. Problemi di morfologia e sintassi. Atti del Convegno Internazionale – Costanza, 8-11 ottobre 2003, Rende: Università della Calabria, 1 – 13.

Arap, I. 2007: Über die syntaktische Verwendung des Konjunktivs und des unabhängigen Infinitivs im Altalbanischen, në: (B. Demiraj – botues) Nach 450 Jahren. Buzukus “Missale” und seine Rezeption in unserer Zeit, Wiesbaden: Harrassowitz, 105-139.

Arap, I. (dsh.): Der Gebrauch des *velle*-Futurs in der altalbanischen Literatur (11 f.).

Badallaj, I. 2010: Vështrim mbi tipat e formave foljore me vlerën e së ardhmes, në: Çështje të studimeve diakronike të shqipes. Materialet e Konferencës Shkencore, 6 korrik 2009, në Prishtinë, Prishtinë: ASHAK, 33-41.

Bartoli, M. 1906: Das Dalmatische, bl. I-II, në: Schriften der Balkankommission, Linguistische Abteilung V, Wien (Kraus Reprint Nendeln / Lichtenstein 1975).

Besch, F. 1989: Geschichte der deutschen Sprache, Bd. II, Berlin: Erich Schmidt Verlag.

Çabej, E. 1975: Histori gjuhësore dhe strukturore dialektore e arbërishtes së Italisë, në: Studime Filologjike (2), Tiranë.

Demiraj, B. 1993: Die hypotaktische Juxtaposition im Zahlwortsystem des Albanischen, në: Zeitschrift für Balkanologie (29) 63-67.

Demiraj, B. 2011: Norma gjuhësore dhe substandardi në një tekst shqip të shek. XVIII në arealin kulturor të Veriut, në Hylli i Dritës nr. 1, 79 – 96, Shkodër.

Demiraj, Sh. 1986: Gramatikë historike e gjuhës shqipe, Tiranë: Shtëpia botuese 8 Nëntori.

Demiraj, Sh. 1994: Gjuhësi ballkanike, Shkup: LogosA.

Demiraj, Sh. 2002: Gramatikë historike e gjuhës shqipe, Tiranë: ASHSH.

Domi, M. 1961: Morfologjia historike e shqipes, Universiteti i Tiranës, Tiranë.

Çabej, E. 1987: Studime etimologjike në fushë të shqipes, bl. III, Tiranë: ASHSH.

Fiedler, W. 1989: Zur Arealtypologie der Futurbildung in den Balkansprachen, Studien zur Morphologie und Syntax der Balkansprachen II. Beiträge zur Balkanlinguistik VI (= Linguistische Studien A 192). Berlin. Akademie der Wissenschaften der DDR, 70-109.

Fiedler, W. 2004a: Das albanische Verbalsystem in der Sprache des Gjon Buzuku (1555). Prishtinë: ASHAK.

Fiedler, W. 2004b: Der südosteuropäische Typus des grammatischen Analytismus – die “balkanische Partikelkonstruktion” im Verbalsystem, në (Uwe Hinrichs & Uwe Büttner – botues) Die europäischen Sprachen auf dem Weg zum analytischen Sprachtyp. Wiesbaden: Harrassowitz, 363-398.

Gramatika e Gjuhës Shqipe, bl. I (botues Sh. Demiraj), Tiranë 1995¹: ASHSH

Haebler, C. 1965: Grammatik der albanischen Mundart von Salamis, Wiesbaden: Harrassowitz.

Hetzer, A. 1981: Wie ist Arnold von Harffs Wörterverzeichnis (1496) zu lesen? Ein Beispiel für das Ineinandergreifen von albanischer und deutscher Sprachgeschichtsforschung., në: Balkan-Archiv N.F. 6 [1981] 229–262.

- Ismajli, R. 1985: Gjuha shqipe e Kuvendit të Arbënit (1706), Prishtinë: Rilindja.
- Kopitar, B. 1929: Albanische, walachische und bulgarische Sprache, në: Jahrbücher der Literatur, bl. 49, 59-106, Wien.
- Likaj, E. 1978: Mbi format analitike në gjuhën shqipe, në: Studime filologjike (3): Tiranë.
- Mansaku, S. 2007: Historia e kohës së ardhme në gjuhën shqipe në dritën e mesharit të Gjon Buzukut, në: (B. Demiraj – botues) Nach 450 Jahren. Buzukus “Missale” und seine Rezeption in unserer Zeit, Wiesbaden: Harrassowitz, 79 – 88.
- Mansaku, S. 2010: Sur la typologie et la chronologie des forms du futur en albanais, në: B. Demiraj (bot.) Wir sind die Deinen. Studien zur albanischen Sprache, Literatur und Kulturgeschichte, dem Gedenken an Martin Camaj gewidmet, Wiesbaden: Harrassowitz, 330-356.
- Matzinger, J. 2010a: Die albanische Sprache im Zeitalter Skanderbegs, Teil 1: Ein Überblick zur vorliterarischen Dokumentation, në: The Living Skanderbeg, The Albanian Hero between Myth and History (M. Genesin, J. Matzinger & G. Vallone – eds.), Hamburg: Kovač.
- Matzinger, J. 2010b: Die albanische Sprache im Zeitalter Skanderbegs, Teil 2 – Verschriftung des Albnischen mit Schwerpunkt auf Paulus Angelus und Gjon Buzuku, në: (B. Demiraj – botues) Wir sind die Deinen. Studien zur albanischen Sprache, Literatur und Kulturgeschichte, dem Gedenken an Martin Camaj gewidmet, Wiesbaden: Harrassowitz, 421-487.
- Maynard, K. L. 2009: “I want to buy it” in the Albanian Glossary of Arnold von Harff, në: “Transaction of the Philological Society” 107 [2009] 2, 231-252.
- Meyer, G. 1884.: Albanesische Studien II. Die albanesischen Zahlwörter’, në: Sitzungsberichte der Kais. Akademie der Wissenschaften in Wien (Philosophisch-Historische Classe), bl. 107, 259–338.
- Miklosich, Fr. 1861: Die slawischen Elemente im Rumunischen, Wien: Kaiserlich-Königliche Hof- und Staatsdruckerei.
- Philippide, Al. 1927: Originea romînilor, I-II Iași.
- Popović, I. 1960: Geschichte der serbokroatischen Sprache, Wiesbaden: Harrassowitz.
- Reichenkron, G. 1962: Zum Typus der Balkansprachen, në: Zeitschrift für Balkanologie, nr. 1, f. 91-122, Wiesbaden: Otto Harrassowitz.
- Sandfeld, Chr. 1930: Linguistique balkanique. Problèmes et resultats, (= la Société de Linguistique de Paris 31).
- Schaller, H. W. 1975: Die Balkansprachen. Eine Einführung in die Balkanphilologie, Heidelberg: Carl Winter – Universitätsverlag.
- Solta, G. R. 1980: Einführung in die Balkanlinguistik mit besonderer Berücksichtigung des Substrats und des Balkanlateinischen, Darmstadt: Wissenschaftliche Buchgesellschaft
- Topalli, K. 2010: Sistemi foljor i gjuhës shqipe, Tiranë: Plejad.
- Topalli, K. 2011: Gramatikë historike e gjuhës shqipe, Tiranë: Botimet albanologjike.
- Weigand, G. 1913: Albanesische Grammatik im südgegischen Dialekt, Leipzig.
- Weigand, G. 1926: Balkan-Archiv I, Leipzig I-X.
- Zhugra, A. V. (Жугра, А. В.) 1976: О происхждении албанского футурума тоского типа (15 Грамматический сторой), 225 – 254.

Seit MANSAKU, Tiranë

TIPOLOGJI ROMANE DHE BALLKANIKE NË STRUKTURËN GRAMATIKORE TË SHQIPES

Tiparet e përbashkëta të gjuhëve të Ballkanit ose ballkanizmat gjuhësore ka kohë që janë bërë objekt i studimeve tipologjike. Madje në studimet e kësaj fushe është shtruar pyetja a ekziston një tipologji gjuhësore ballkkanike. Një nga rezultatet teorike të këtyre studimeve është se analiza gjuhësore tipologjike e mbështetur në fakte gjuhësore konkrete dhe jo në abstraksione ka nxjerrë përfundimin teorik se asnjë system gjuhësor nuk është kurrë rezultat i një tipi të vetëm e unik gjuhësor. Çdo gjuhë historike natyrale, si rezultat i prejardhjes së saj dhe sidomos si rezultat i zhvillimit historik të saj në kontakt edhe me gjuhë e kultura të tjera është në vetvete politipologjike,¹ ngërthen në sistemin e saj struktura me tipologji të ndryshme. Kjo vlen për të gjitha gjuhët aq më shumë për gjuhën shqipe, e cila ka lindur si gjuhë e veçantë, si vazhdim i njerës prej gjuhëve të lashta të Ballkanit dhe është zhvilluar në një mjedis politik, historik e kulturor shumë të ndërlikuar, me kontakte të shumanshme gjuhësh dhe kulturash të perandorive të mëdha me prestigj të lartë gjuhësor e kulturor, me mbështetje politike të fuqishme që kanë vënë në rrezik vetë ekzistencën e gjuhës shqipe, mëvetësinë dhe identitetin e saj të veçantë. Evolucionin e vazhdueshëm nga indoeuropianishtja, nëpër ilirishte e arbërishte për të arritur në gjendjen e shqipes së sotme, kanë sjellë si pasojë që ajo sot të paraqitet me një larmi trajtash e modelesh si në këndvështrimin tipologjik ashtu edhe në atë gjenealogjik. Në strukturën e saj gramatikore bashkëjetojnë dhe funksionojnë trajta e ndërtime me tipologji të ndryshme, me gjenealogji të ndryshme dhe me kronologji të ndryshme. Por gjithsesi shqipja ka mundur të ruajë dhe të zhvillojë identitetin e vet si gjuhë e veçantë dhe prurjet që i kanë ardhur nga kontaktet me gjuhë të tjera, janë përvetësuar dhe janë bërë sot pjesë e pandarë e identitetit të saj. Nuk ka dyshim se karakterizimi që iu bë shqipes në gjysmën e

¹ Shih për këtë Paulo Ramat, **Linguistic Typology**, Berlin 1987.

dytë të shekullit XIX “si gjuhë e përzier gysëm romane” është provuar tashmë se nuk i ka qëndruar së vërtetës shkencore. Por kjo nuk do të thotë se midis shqipes dhe gjuhëve romane nuk ka tipare tipologjike të përbashkëta edhe në strukturën gramatikore.

Kur flitet për tipologji romane a ballkanike kemi parasysh disa tipare strukturore që mbizotërojnë, që përbëjnë karakteristika themelore të një grupi të caktuar gjuhësh e që nuk gjenden, ose më saktë, nuk janë relevante për një grup tjetër gjuhësh. Është një gjë e njohur në shkencën gjuhësore që dy a më shumë gjuhë kanë tipare të përbashkëta a të ngjashme në mes tyre për shkak të origjinës së përbashkët, ose bëhen të ngjashme për shkak të kontakteve historike. Rasti i parë lidhet me gjuhët romane në mes tyre, rasti dytë me gjuhët ballkanike. Por edhe kjo ndarje nuk është absolute, sepse edhe gjuhët romane kanë tipare strukturore të përbashkëta dhe të ngjashme jo vetëm për shkak të origjinës së tyre latine, por edhe për shkak të kontakteve, edhe gjuhët ballkanike, të ndryshme nga origjina, kanë fituar tipare të përbashkëta për shkak të kontakteve historike, por edhe mund të kenë trashëguar tipare të përbashkëta nga substrate të hershme. Megjithatë, kur vihen përballë njera tjetrës tipologji romane dhe tipologji ballkanike është e domosdoshme të kihet parasysh një dallim i rendësishëm i karakterit teorik: veçoritë gjuhësore që përfshihen në atë tërësi tiparësh që formojnë tipologjinë romane në pjesën më të madhe të tyre vijnë nga prejardhja e përbashkët e gjuhëve romane, nga latinishtja, më saktë nga latinishtja vulgare, ndërsa tiparet e përbashkëta të gjuhëve të Ballkanit që janë objekt i gjuhësisë ballkanike, gjenden në gjuhë me prejardhje krejt të ndryshme. Por kjo nuk e përjashton mundësinë që edhe tiparet e përbashkëta të gjuhëve të Ballkanit, të paktën disa prej këtyre tipareve, të burojnë nga latinishtja vulgare ballkanike. Nga ana tjetër, është për t’u pasur parasysh se në evolucionin gjuhësor veprojnë edhe prirje universale që ndikojnë në shumë gjuhë, siç është p. sh. prirja për thjeshtimin e sistemit të lakimit e të zgjedhimit, por sigurisht kjo prirje ndjehet më shumë në ato gjuhë që kanë ruajtur deri në kohët tona një system të pasur lakimi e zgjedhimi, siç janë edhe gjuhët ballkanike. Po kështu edhe prirja e evoluimit të gjuhëve nga sintetizmi në analitizëm etj., prirje që ka qenë më largvajtëse në gjuhët romane dhe më e kufizuar në gjuhët ballkanike. Si rezultat i këtij zhvillimi të brendshëm të shqipes, por edhe i prirjeve të përgjithshme të zhvillimit

të gjuhëve indoeuropiane dhe i zhvillimeve të nxitura edhe nga kontaktet gjuhësore latino-romane, greko-bizantine e ballkanike, shqipja sot paraqitet si një gjuhë sintetiko-analitike ku sintetizmi shfaqet më shumë në tiparet e ruajtura të saj, ndërsa analitizmi në tiparet zhvillimore inovuese. Shqipja bashkohet me gjuhët e ballkanit më shumë në tiparet analitike inovuese.

Prandaj tiparet e përbashkëta të gjuhëve të Ballkanit mund të studiohen e të shpjegohen me sukses duke kombinuar tipologjinë gjuhësore me gjenealogjinë gjuhësore. Me fjalë të tjera, studimi tipologjik i ballkanizmave, i kombinuar me studimin diakronik gjenetik të tyre mund të çojë në rezultate të reja e më të sigurta lidhur me shpjegimin e tipareve të përbashkëta të gjuhëve të Ballkanit dhe të origjinës së tyre dhe të vendit që zë secila prej gjuhëve të këtij rajoni në lidhjen gjuhësore ballkanike. Fakti që shumë ballkanizma janë të pranishme edhe në sisteme të tjera gjuhësore bën të mundur trajtimin e arealit gjuhësor ballkanik brenda një kuadri më të gjerë europian.² Madje ballknologu francez Jack Feuillet është shprehur se gjuhësia ballkanike ka kohë që po kalon një krizë dhe se ajo po përsërit vetveten dhe se rrezikon të sklerotizohet, prandaj ai mendon se gjuhësia ballkanike për të dalë nga kjo gjendje dhe për të marrë një impuls të ri zhvillimi ndoshta duhet të integrohet në një njësi më të gjerë që mund të ishte eurolinguistika. Por nga ana tjetër, po ai dijetar e ndjen se shtrirja e parimeve dhe metodave të gjuhësisë ballkanike në një hapsirë të gjerë europiane mund të çojë në humbjen e veçantisë, të mëvetësisë së kësaj discipline.³

Një çështje e rëndësishme parimore për studimin e ballkanizmave është përcaktimi i saktë i rrafshit a nivelit të vështrimit të tyre: identifikimi, karakterizimi dhe vlerësimi i ballkanizmave duhet të bëhet duke pasur parasysh jo vetëm gjuhët standarde të Ballkanit por gjuhët standarde dhe dialektet e të folmet e këtyre gjuhëve në përgjithësi. Nga ky dallim metodologjik, varen edhe përfundimet që nxirren për vendin që zë secila gjuhë në lidhjen gjuhësore ballkanike.

² Shih edhe Emanuele Banfi, *Storia linguistica del Sud-Est Europeo*, me literaturë, Milano 1991, f. 158.

³ J. Feuillet, *La place des langues balkaniques dans l'ensemble européen*, **Balkanlinguistik, Synchrony and Diachrony**, Thessaloniki, 2000, p.89.

Është vërejtur se gjuhët e ballkanit në kuadrin e lidhjes gjuhësore ballkanike kur vështrohen jo vetëm në nivele të standardeve, por edhe në nivele të substandardeve të sistemeve të veçanta, nuk përfaqësojnë një model të njësisshëm nga pikëpamja tipologjike. Ato më tepër rezultojnë të jenë, siç ka vënë në dukje edhe Vladimir Skalićka, kombinim i tipash të ndryshëm.⁴

Nga pikëpamja tipologjike, në fushën morfosintaksore një nga tiparet që i ndan gjuhët romane perëndimore nga gjuhët ballkanike, duke përfshirë edhe rumanishten është prania e paskajores dhe e lidhores në të parat, pra bashkëjetesa e tyre dhe mungesa ose humbja e paskajores në të dytat. Në këtë ndarje shqipja zë një pozitë të ndërmjetme. Një vend të ndërmjetëm zë shqipja edhe për tipat e trajtës së kohës së ardhshme. Zhdukja e paskajores në gjuhën rumune është treguesi më i qartë i formimit të një tipi ballkanik të gjuhëve të këtij rajoni. Origjina latine e rumanishtes nuk ka mundur të pengonte zhdukjen e paskajores në këtë gjuhë romane ballkanike. Me sa duket prirja që përfshiu gjuhët e Ballkanit për ta zëvendësuar trajtën e paskajores me trajtën e lidhores ka qenë më e fuqishme sesa tradita gjuhësore romane ku bashkëjetojnë paskajorja me lidhoren. Ose, e thenë ndryshe, në këtë pikë një gjuhë romane në arealin gjuhësor ballkanik ka ndjekur zhvillimet gjuhësore të rajonit jo lidhjet historike gjenetike të traditës.

Për praninë ose mungesën e paskajores gjuhët ndahen tipologjikisht në dy grupe: në gjuhë që përdorin edhe paskajoren edhe lidhoren, siç janë gjuhët romane dhe në gjuhë që përdorin vetëm ose kryesisht lidhoren, siç janë gjuhët ballkanike, ku paskajorja është zhdukur dhe ruhen vetëm disa mbetje të një gjendje të hershme kur paskajorja ishte ende një trajtë e gjallë. Nuk njoh gjuhë indoeuropiane që përdorin vetëm paskajoren, ose e thenë ndryshe të kenë zhdukur lidhoren dhe të kenë ruajtur a krijuar paskajoren. Areali gjuhësor i shqipes është i ndarë në dy pjesë: në arealin gjuhësor gegë ku bashkëjetojnë paskajorja dhe lidhorja, ashtu si në gjuhët romane dhe në arealin gjuhësor toskë ku përdoret lidhorja dhe një trajtë paskajorje e re ashtu si në gjuhët e tjera ballkanike. Pra gegërishtja nga kjo pikëpamje është më pranë tipit gjuhësor roman, ndërsa toskërishtja është më afër tipit gju-

⁴ Vladimir Skalićka, *Über die typologische Eingliederung der Balkansprachen*, *Les études balkaniques tchecoslavaques*, 1977.

hësor ballkanik, madje gegërishtja është më afër tipit gjuhësor roman edhe se vetë rumanishtja që është gjuhë romane. Këtu është vendi për të bërë një vërejtje të karakterit metodologjik.

Shumë herë kur flitet për tiparet ballkanike të shqipes dhe vendin që zë shqipja në lidhjen gjuhësore ballkanike kihet parasysh vetëm varianti i standardit dhe jo variantet substandarde e ndonjëherë përfundimet mbështeten jo mbi gjendjen e dëshmuar të dukurive gjuhësore, por mbi hipoteza të pavërtetuara plotësisht, siç është rasti kur flitet për humbje të paskajores. Me terma realë vështirë se mund të flitet me siguri për humbje të paskajores dhe zëvendësimin e saj me lidhoren si tipar ballkanik i shqipes. Përse? Sepse, nëse kemi parasysh një paskajore të vjetër sintetike në gjuhën shqipe, nuk mund të flitet për humbje të saj për sa kohë që ajo ende nuk është vërtetuar e dëshmuar. Nëse do të pranohet mendimin e Selman Rizës që në ndërtimin *do thenë*, i barazvlerëshëm me lat. *dicendum est* dhe në trajtën mohore pa punuar shihte një paskajore të vjetër të mbarë shqipes, përsëri nuk mund të flasim për humbje të paskajores, sepse trajtat që sapo përmendëm, janë në përdorim edhe sot në të gjithë shqipen. Po ashtu nuk mund të flitet për humbje të paskajores mesjetare të tipit *me punue* në shqipe, për sa kohë që ajo përdoret gjërësisht sot në në arealin gjuhësor gegë dhe sporadikisht në arealin jugor. Gjithashtu nuk mund të flitet për humbje të kësaj paskajoreje në toskërisht për sa kohë që ekzistenca e saj në këtë dialekt ende nuk është provuar në mënyrë të pakundërshtueshme. Unë nuk besoj që të ketë ndikuar greqishtja në zhdukjen e një paskajoreje me *me*. Më e shumta afërsia gjeografike me arealin e greqishtes mund të ketë ndikuar në pengimin e shtrirjes së një paskajoreje të tillë në dialektin jugor të shqipes dhe jo në zhdukjen e saj.⁵ Selman Riza, që është marrë gjerësisht me sistemin foljor të shqipes ka pohuar se paskajorja e tipit *me punue* është inovacion ekskluziv i gegërishte.⁶ Pra po ta vështrojmë shqipen nga kjo pikepamje, ajo nuk merr pjesë në tiparin ballkanik të humbjes së paskajores dhe të zëvendësimit të saj me lidhoren. Në tërësinë e saj me këtë tipar ajo është më afër tipologjisë së gjuhëve romane që përdorin edhe paskajoren edhe lidhoren,

⁵ Shih edhe E. Çabej, *Kontributi i shqipes në formimin e lidhjes gjuhësore ballkanike*, **Studime gjuhësore**, IV, Prishtinë 1977, f. 340.

⁶ Selman Riza, **Vepra 2**, Prishtinë 1997, f. 207.

sesa me gjuhët ballkanike ku paskajoja është zëvendësuar me lidhoren. Kjo vlen edhe po të marrin si pikë referimi gjuhën standarde shqipe që ka në sistemin e saj foljor një paskajore të tipit *për të punuar*, e cila dëshkohet që nga shekulli XVII në veprën e P. Bogdanit dhe që në studimet tona gramatikore quhet paskajore e dytë, ose paskajore inovuese e mbarë shqipes së sotme letrare (S. Riza). Kjo paskajore nuk është e barasvlershme as me një paskajore sintetike të supozuar, as me paskajoren gege të tipit *me punue*, por jo krejt e pangjashme me të; ajo i ka veçoritë e një paskajoreje josintetike me funksione ende të kufizuara, por gjithnjë e më shumë përvijohet prirja për t'i zgjeruar funksionet e saj dhe për t' u përdorur ajo në disa funksione që janë karakteristike për këtë të fundit ose për lidhoren, siç është p. sh. funksioni kundrinor ose kryefjalor. Në shqipen e sotme dëgjohen dhe shkruhen jo rallë ndërtime të tilla: *vendosa për të shkuar* në vend të *vendosa të shkoj* ose *vendosa me shkue*; *kam dëshirë për të studiuar* në vend të *kam dëshirë të studioj* ose *kam dëshirë me studiuë*, *është e vështirë për të vendosur* në vend të *është e vështirë të vendoset* ose *është e vështirë me vendosë*. Parafjala *për* si element përbërës i kasaj trajte të paskajores ka filluar ta zbeh kuptimin fillestar të qëllimit dhe po shndërrohet në një pjesëz trajtëformuese ashtu si me në trajtën e paskajores gege *me punue*. Këto ndërtime sigurisht që kanë dallime në nivelin e ligjëritimit, por ato nuk vijnë në vështirim, kur është fjala për shqyrtime tipologjike, ose për prirje të zhvillimit të gjuhës.

Unë pajtohem plotësisht me tezën që nuk pranon monogjenezën në krijimin e tipareve të përbashkëta të gjuhëve të Ballkanit, por i shikon ato si rezultat i veprimt të shumë faktorëve historikë, gjuhësorë e kulturorë. Dhe një nga faktorët që ka ndikuar në krijimin e përhapjen e ballkanizmave ka qenë romaniteti ballkanik. Në këtë mënyrë ato paraqiten si tipologji romane dhe ballkanike njëkohësisht. Nga pikëpamja e origjinës janë romane, nga ana tipologjike janë romane dhe ballkanike. Kështu p. sh. trajta e së kryerës së gjuhës shqipe, e formuar nga folja ndihmëse *kam* dhe pjesorja e foljes kryesore: *kam shkruar*, *kam kënduar* etj., duket se është krijuar sipas modelit latin *habeo scriptum*, *habeo cantatum* etj. Këtë e kanë pranuar edhe ata studiues të shqipes, midis të cilëve edhe E. Çabej, i cili është bashkuar me përfundimin e H Pedersenit për çështjen e ndikimit latin në strukturën gramatikore të shqipes, por në këtë pike, pra në formimin e së

kryerës, në pajtim me B. Havranekun, sheh në të një kalk gramatikor nga romanishtja ballkanike.⁷ Këtë model të së kryerës e ka edhe rumanishtja, që është gjuhë romane lindore: *am văzut* “kam parë”, e ka edhe greqishtja: *έχω δεμένο* “kam lidhur,” e kanë edhe shumë gjuhë të tjera indoeuropiane, sa që është e vështirë ta karakterizosh si veçori strukturore romane. Ndoshta dëshmimi i hershëm në latinishten vulgare i togut *habeo scriptum* dhe prestigji i lartë i saj, shtrirja në të gjitha gjuhët romane na japin të drejtën ta quajmë pjesë të modelit latino-roman. Kjo nuk do të thotë domosdo se kjo trajtë në të gjitha gjuhët e tjera që kanë atë sipas këtij modeli, është huazim latino-roman. Premisat për t’u krijuar në mënyrë të pavarur nga një tog i lirë sintaksor kanë ekzistuar në shumë gjuhë. Do të jepja vetëm dy shembuj nga shqipja e sotme të marrë nga shtypi për të dëshmuar se sa e mundshme është të kalohet nga një tog i lirë sintaksor në një trajtë gramatikore të së kryerës: Thonë se dikush *ka të filmuar* ca dëshmi të tjera (Shekulli, 06. 04. 2011, f. 4); Policia *ka të filmuar* vjedhësin, por... (Shekulli, 07. 10, 2011, f.1). Në planin tipologjik krahasues është me vlerë për gjuhësinë ballkanike të ndiqet mënyra e formimit të së kryerës së foljeve që tregojnë lëvizje e foljen *kam* apo me foljen *jam*. Shqipja ka modelin me foljen *kam*: *kam shkuar, kam ardhur, ka qenë, ka vdekur* etj., sikurse dhe gjuhë të tjera ballkanike si greqishtja, rumanishrja, ndryshe nga gjuhë romane si italishtja e frëngjishtja: *sono andato, sono venuto, je suis allé, je suis venu, e morto, est mort* etj.

Le të ndalemi tani në trajtat e së ardhmes në shqipe në krahasim me gjuhët romane dhe gjuhët ballkanike. Edhe për trajtat e së ardhmes gjuha shqipe zë një vend të ndërmjetëm midis gjuhëve ballkanike dhe gjuhëve romane, sepse në strukturën gramatikore të saj ka trajtën e së ardhmes me *do* + lidhoren, që i përket modelit ballkanik, trajtat me foljen ndimëse *kam* + paskajoren gege me *me*, ose paskajoren e mbarë shqipes me *për të*, të cilat i përkasin modelit roman dhe trajtën me foljen ndihmëse *kam* + lidhoren që, siç jam shprehur edhe më parë, përbën një model të përzier, hybrid romano-ballkanik, roman për nga elementi i parë, folja ndihmëse *kam*, ballkanik për nga elementi dytë, mënyra lidhore.

1. Tipi ballkanik i së ardhmes: *do të punoj* përfshin trajta të for-

⁷ E. Çabej, *Vep. cit.* f.340

muara me foljen **dua** të ngurosur në vetën e dytë ose të tretë njejës të kohës së tashme të mënyrës dëftore **do**, ndjekur nga trajta të mënyrës lidhore: *do të punoj, do të kem punuar, do të punoja, do të kisha punuar*, të cilat janë trajta të përgjithshme të shqipes së sotme standarde dhe të përhapura në të dy dialektet dhe të folmet e tyre. Këto trajta, edhe pse gjenden edhe në gjuhë të tjera jobalkanike si në anglishte, gjermanishte etj. mund të thuhet se i përkasin *tipit ballkanik të së ardhmes*, sepse tipologjia e formimit të tyre është e përhapur në të gjitha gjuhët e Ballkanit dhe përbën një nga tiparet themelore morfosintaksore të lidhjes gjuhësore ballkanike: greqisht *θα γράφω* “do të shkruaj” nga *θέλω* *vá* *γράφω*, rumanisht *voi să scriu*, bullgarisht *šte da piša*, maqedonisht *ke pišam*; është formuar në një areal gjuhësor ku ka munguar ose është zhdukur trajta foljore e paskajores, gjë që i përgjigjet arealit gjuhësor të këtij rajoni. Përgjithësisht një model i tillë nuk është formuar e përhapur në gjuhët romane, italishtja, frëngjishtja etj. Në gjuhën shqipe sot u përket të dy dialekteve, por është tipi mbizotërues në dialektin e Jugut ku mungon paskajorja e tipit *me shkrue*; paskajorja e tipit *për të shkruar* është formuar dhe përhapur vonë në të gjithë shqipen, pas shekullit XVII. Nga pikëpamja semantike modale ky tip i së ardhmes është mbajtur si e ardhme volitive që shpreh një veprim që dëshirohet të kryhet në të ardhmem, kuptim të cilin ja jep morfema *do*, trajtë e ngurosur e foljes *dua*. Për sa i përket origjinës së këtij tipi të së ardhmes, që nga Sandfeldi, mbizotëron mendimi se burimi i saj është greqishtja. Origjina greke e kësaj forme mbështetet në faktin se kjo trajtë dëshmohet më herët se në gjuhët e tjera të Ballkanit. Është një gjë e njohur që në greqishte që nga periudha e koinesë perifrazat që kanë shërbyer për të shprehur kuptimin kohor të së ardhmes, kanë pësuar ndryshime që dëshmohen mirë me tekste të shkruara. Ky evoluim trajtash është i lidhur me zhdukjen e paskajores në greqishte dhe me zëvendësimin e saj me lidhoren. Kështu nga perifraza *θέλω γράφειν*, ose *θέλω έλθειν* u kalua me kohë në perifrazat *θέλω* *vá* *γράφω*, *θα γράφω*. Një zhvillim i përafërt po vërehet edhe në shqipen e sotme, gjithmonë e më shpesh po përdoret trajta pa pjesëzën *të* të lidhores: *do shkruaj, do shkoj, do fitoj* etj., nëdonëse nuk bëjnë pjesë në gjuhën standarde. Madje Selman Riza një gjysëm shekulli më parë (1967)

shkruante për tipin *do harroj* se për gjymtime të tilla nuk duhet të ketë vend në shqipen e shkruar.⁸ Por dokumentimi i hershëm në greqishte i kësaj trajte, siç ka vënë në dukje Sh. Demiraj, nuk është domosdo provë e përhapjes së saj në gjuhët e tjera të Ballkanit nëpërmjet greqishtes. Është krejt e mundur që trajta e së ardhmes e tipit *do* + lidhore të zhvillohet në mënyrë të pavarur nga togfjashat e lirë sintaksorë në gjuhët a dialektet që nuk e kanë trajtën e paskajores.

Kjo trajtë sot është e mbarë shqipes, e shqipes standarde dhe e të dy dialekteve të saj. Ajo, siç dihet, del në shqipen e shkruar që te Fjalorthi i Arnold von Harfit i vitit 1497, një here të vetme *do ta ble* dhe një here të vetme në librin e parë shqip, në "Mesharin" e Gjon Buzukut . ë në një frazë me fjali pyetëse: *A nuk do të pi kelqinë qi më ordhënoi Ati?* (Meshari II, f. 221, a). Lat. "calicem, quem dedit mihi Pater non **bibam** illum"(GjoniXIV, 18). Për të njëjtën folje, pothuajse në të njëjtin kontekst autori përdor trajtën e së ardhmes *kam* + paskajore: *A mundë pini ju kelqinë qi u kam me pitë?*. (Meshari, f. 141, a); *A mund të pini atë kelq qi u kam me pīm?* *E i thanë i atī: Mundnjëmë. E u tha atyne: Kelqinë qi u kam me pīm ju ta pini...*(Meshari, f.337, a). Lat. "Potestis bibere calicem quem ego **bibiturus** sum? Dicunt ei: Possumus. Ait illis: Calicem quidem meum **bibetis**,..". Autori përdor edhe në një vend tjetër trajtën e lidhores së tashme të kësaj foljeje me vlerën e kohës së ardhme: *Ju për të vërtetë të pini* (= do të pini. S. M.) *kelqinë tem.* (Meshari, f. 141, a).

Studimet dialektore kanë vërtetuar se trajta e së ardhmes me *do* nuk është vetëm e toskërishtes, por edhe e gëgërishtes. Argumentet për të vërtetuar se e ardhmja me *do* + lidhore ka qenë e mbarë shqipes janë sjellë kryesisht për të kundërshtuar tezën e atyre studiuesve që mendojnë se ky tip i së ardhmes në gjuhën shqipe është krijuar nën ndikimin e greqishtes, prandaj ai është i përhapur kryesisht në Jug të vendit. (Kristian Sandfeld, *Linguistique balkanique, problèmes et résultats*, Paris 1930, p.).

Pavarësisht nga ky kontekst diskutimi, fakti që e ardhmja me *do* + lidhore takohet një herë të vetme në "Mesharin" e Gjon Buzukut, një tekst i gjerë prej rreth 220 faqesh dhe nuk gjendet as në tekstet e tjera të vjetra të autorëve veriorë të shekullit XVII, dëshmon së paku

⁸ Selman Riza, *Vep cit.*, f. 208

që kjo trajtë në gegërishten e shekujve XVI-XVII nuk ishte përgjithësuar. Në këto rrethana, kjo gjendje e së ardhmes me *do* në tekstet e vjetra mund të shpjegohet në dy mënyra: ose e ardhmja me *do* ka qenë në përdorim edhe në gegërishten para fillimit të shkrimit të shqipes dhe ka ardhur duke u reduktuar pas formimit të së ardhmes së tipit *kam* + paskajore, gjerësisht e përdorur në tekstet e vjetra të autorëve veriorë dhe në gegërishten në përgjithësi dhe kështu trajta e vetme të *Fjalorthi i Arnold von Harfit* dhe të “Meshari” i Gjon Buzukut mund të shihen si relike të një gjendjeje më të vjetër të gegërishtes ose, nga ana tjetër, këto dy raste tregojnë se trajta e së ardhmes me *do* + lidhore sapo kishte filluar të shtrihej në gegërishten e shekujve XV-XVI, si krijim i pavarur i krijuar nga gramatikalizimi i një togu të lirë sintaksor me foljen *dua* të ndjekur nga trajta të mënyrës lidhore brenda gegërishtes, ose si rezultat i shtrirjes nga nga dialekti i Jugut. Ne mendojmë se kjo teza e dytë është më e mundshme. Nuk ka asnjë arsye për të besuar se gegërishtja para trajtës *kam me punue* të ketë pasur në përdorim trajtën *do të punoj*. Këtë e mbështesim në këtë arsyetim: Në “Mesharin” e Gjon Buzukut krahas trajtës së ardhmes së tipit *kam* + paskajoren geqe, përdoret mjaft dendur me vlerën kohore e së ardhmes trajta e lidhores, e cila besojmë se do të ketë qenë përdorur në shqipen mesjetare edhe para lindjes së trajtave të specializuara për të dhënë kuptimin gramatikor të së ardhmes. Më pas në gegërishte është formuar trajta *kam* + paskajoren e tipit *me shkrue*, e cila, pas të gjitha gjasave, duhet të jetë trajta më e vjetër e së ardhmes në gegërishte pas përdorimit të lidhores me këtë vlerë kohore. Në këto rrethana ka pak të ngjarë që në një të folme ku funksiononin dy trajta foljore me vlerën e kohës së ardhme të krijohej dhe të përgjithësohej edhe një trajtë tjetër e tipit *do të shkruaj*. Një hipotezë të re për të shpjeguar rastin e vetëm të së ardhmes me *do* në “Mesharin” e Gjon Buzukut ka hedhur studiuesi J. Matzinger, i cili, duke krahasuar tekstin e Buzukut ku gjendet ky rast i së ardhmes, me tekste përkatëse të mesharëve romanë para Koncilit të Trentit dhe me mesharët kroatë të periudhës së autorit tonë ka hedhur idenë se fraza e Buzukut: *A nuk do të pī kelqinë që më ordhënoi Ati*, mund të interpretohet si frazë retorike: *A nuk do ti që unë të pi kupën*. Këtë interpretim autori e mbështet në një përkthim në kroatisht të kësaj fraze nga Bernardini nga Spliti *Čašu ovu mi je dal otac naš li da ju popiju* “këtë kupë që më dha Ati, a nuk do që ta pi?”

Por vetë autori vëren se tekste kroate në përkthimin e kësaj fraze nuk përkojnë me versionin kanonik të sllavishtes së vjetër.

Një e ardhme me *do* + paskajoren gege *me shkruë* me kuptimin e dëshirës, ashtu si e ardhmja *do* + lidhore, nuk arriti të formësohej e të përgjithësohej në gegërishte, megjithëse nuk ka munguar dhe nuk mungon ndërtimi i lirë sintaksor me foljen *dua* të ndjekur nga paskajorja. Një ndërtim i tillë takohet shpesh edhe te “Meshari” i Gjon Buzikut, madje në disa raste në kufijtë e një trajte perifrastike me kuptimin e së ardhmes. Edhe sot në gjuhën e folur në dialektin gegë dëgjohehen ndërtime të tilla si: *Do me u prishë koha = Duket se do të prishet koha; Do me ra shi nesër = Duket se do të bjerë shi nesër*, madje edhe me foljen *dua* në trajtën e habitores *doka me ra shi sonte, dashka me ardhë nesër në Tiranë etj.* Janë ndërtime me modalitet supozimi a dyshimi. Një e ardhme e këtij tipi edhe pse jo krejt e panjohur, nuk u përgjithësua në gegërishte për shkak të konkurrencës së dy trajtave të tjera: *kam me shkruë* dhe *do të shkruaj*. Në mënyrë të veçantë shtrirja e trajtës *do të shkruaj* me kuptim të dëshirës edhe në gegërishte ka penguar përhapjen e përgjithësimin e një trajte tjetër *do* + paskajore me të njëjtin kuptim kohor e modal. Një konstrukt me foljen *dua* + infinitiv me vlerën e së ardhmes ka ekzistuar edhe në ndonjë gjuhë tjetër ballkanike si në rumanishte para se të zhdukej paskajorja e të zëvendësohej nga lidhorja: *voi jura, vei jura etj.*, edhe në greqishten bizantine: *θέλω γράφειν*. Ekziston sot edhe në serbisht : *Ja ću ćuti, ti ćeš ćuti etj.* Madje edhe në latinishte togu me foljen *volo* i ndjekur nga paskajorja me kuptimin e së ardhmes nuk ka qenë i panjohur.

2. Tipi roman i së ardhmes: *kam me shkruë, kam për të shkruar*

Tipi i së ardhmes *kam* + paskajore mund të konsiderohet si tipi roman, sepse nga ana tipologjike është i krahasueshëm me trajtat e gjuhëve romane të ndërtuara mbi bazën e gjedhës së latinishtes vulgare infinitiv + foljen ndihmëse *habeo: cantare habeo*. Nga ky ndërtim i latinishtes vulgare e kanë prejardhjen, siç dihet, futuri i italishtes *cantero* nga *cantare ho* dhe ai i frëngjishtes *chanterai* nga *chanter + ai*, veta e parë e foljes ndihmëse *avoir* në të tashmen e dëftores. Ky model roman është i përhapur edhe në gjuhë të tjera europiane. Kjo nuk do të thotë domosdo se e ardhmja e tipit *kam* + paskajore në shqi-

pe dhe në gjuhë të tjera është krijuar nën ndikimin e drejtpërdrejtë të latinishtes vulgare ose të latinishtes ballkanike, siç është pohuar nga disa studiues. Kristian Sandfeld⁹ shkruan se “përdorimi i *kam* për të shënuar të ardhmen është një fakt roman që bie shumë në sy.” Shaban Demiraj, i cili është marrë gjerësisht me trajtimin historik të trajtave të së ardhmes në gjuhën shqipe, 8, ka shprehur mendimin se “ka pak të ngjarë që e ardhmja e tipit *kam* + paskajore të jetë formuar nën ndikimin e latinishtes vulgare. Mjafton,- pohon autori,- të mbahet parasysh renditja e gjymtyrëve të formës analitike të këtij tipi të së ardhmes ku ndihmësja *kam* është e fiksuar para paskajores me pjesëzën *me*. Kurse tipi roman e ka burimin te një togfjalësh, ku folja *kam* ishte e vendosur pas paskajores sintetike.”¹⁰

Ky argument nuk është i mjaftueshëm, sepse ka të dhëna se në latinishten vulgare dhe në latinishten kishtare krahas togfjalëshit *cantare habeo* nga e kanë prejardhjen trajtat e së ardhmes në gjuhët romane perëndimore, ka ekzistuar edhe togfjalëshi *habeo cantare, habeo dicere* dhe *habeo ad cantare* nga mund të burojnë togjet sintaksore e pastaj trajtat e shqipes *kam me këndue* dhe *kam për të kënduar*. Te “Meshari” i Gjon Buzukut gjenden raste kur togu sintaksor *kam me thashunë* paraqitet ende i paformësuar plotësisht si trajtë gramatikore e së ardhmes, i cili i përgjigjet togut latin *habeo dicere*. Kështu që ndikimi i latinishtes mund të supozohet që në fazën e lindjes dhe të përdorimit të togut të lirë sintaksor. P.sh. *E ndaj këto kafshë u kam shumë kafshë me u thashunë*. (Meshari, f. 257, 1). Lat. “Adhuc multa habeo vobis dicere” (Gjoni XVI, 12); *U kam shumë kafshë me thanë e me gjykuom në jush* (Meshari, f.137, b). Lat. “ Multa habeo de vobis loqui et judicare” (Gjoni 8, 26). Edhe në latinishte togu *cantare habeo*, ose *habeo cantare* në fillimet e përdorimit të tij nuk ishte formëzuar si trajtë foljore e së ardhmes: folja *habeo* në origjinë kishte ende kuptimin e një folje të mëvetësishme me kuptimin “duhet”. Me këtë kuptim haset në këtë fjali pyetëse te Seneka: *Quid habui facere?*. Më vonë gjatë përdorimit folja *habeo* në këtë tog e humbi mëvetësinë kuptimore dhe bashkë me paskajoren u formëzuan si trajtë e re e së ardhmes me kuptimin e detyrimit. Për latinishten mendohet se ky evoluim

⁹ K. Sandfeld, *Linguistique balkanique, problèmes et résultats*, Paris, 1930, p. 183.

¹⁰ Shaban Demiraj, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Tiranë 1986, f. 848.

ishte realizuar në shekullin IV, kur dëshmohet me shembuj të sigurtë si: *quae nunc fiunt...qui nasci habent scire non poterunt* (Shën Jeronimi në Ecces.1)¹¹. Këtu është rasti për të theksuar se tipi i së ardhmes *me kam* + paskajore në gjuhët romane perëndimore është formuar mbi bazën e togut latin *cantare habeo*, ndërsa ai i shqipes dhe i rumanishtes së vjetër mbi bazën e togut latin me rend të përkundërt *habeo cantare* Mbi bazën e këtij lokucioni është krijuar futuri i vjetër rumun *am a cânta*, që u zëvendësua më vonë me trajtën e së ardhmes *am sâ cînt*.¹² Modelin e ndërtimit *kam* + infinitive e ka njohur edhe greqishtja byzantine *έχω γράφειν krahas θέλω γράφειν*¹³, që në një periudhë më të vonë u zëvendësua nga tipi *θέλω να γράφω, θά γράφω* “do të shkruaj”.

Përveç kësaj në gjuhët romane perëndimore kjo trajtë e së ardhmes, pavarësisht nga prejardhja, sot paraqitet si trajtë sintetike e thjeshtë, ndërsa në rumanishte dhe në shqipe është një formë perifrastike. Kjo mund të lidhet si me kronologjinë e formimit të tyre ashtu edhe me faktin që folja ndihmëse *kam* në pozicion enklitik të prapavendosur mund t'i bashkohej më lehtë trajtës kryesore të foljes në paskajore. Sigurisht ka luajtur rol edhe mënyra e theksimit. Edhe në gjuhën shqipe në trajtën e habitores, që është krijuar mbi bazën e së kryerës së përmbysur, folja ndihmëse *kam* i është prapangjitur pjesores së foljes kryesore; nga një anë kemi *kam punuar* nga ana tjetër kemi *punakam*

Trajta *kam për të punuar* i përgjigjet tipit roman, fr. *j'ai á écrire*, it *ho da scrivere*. Kjo trajtë e së ardhmes është e gjithë shqipes, sepse edhe paskajorja që merr pjesë në formimin e saj shtrihet në të dy dialektet, por besoj se përdorim më të gjerë ka në të folmet e Shqipërisë së Mesme ku trajta e gegërishtes veriore *kam me shkue* përdoret më pak. Ndërsa në dialektin e Jugut, siç u përmend më lart, përdoret më shumë e ardhmja e tipit me *do* + lidhore. Nga ana kuptimore e ardhmja *kam për të punuar* shpreh një detyrim që synohet të kryhet në të ardhmen. Kuptimin e detyrimit formës perifrastike ja jep folja ndihmëse *kam*.

¹¹ O. Densusianu, **Histoire de la langue roumaine**, t. I, Bucarest 1929. p. 180-181)

¹² Ovid Densusianu, Vep. cit. , p.181.

¹³ Vit Bubenik, *On the Nature of Innovations in the Aspectual Systems of Medieval Greek and South Slavic Languages*, **Balkanlinguistik, Synchrony and Diachrony**, Thessaloniki, 2000, p. 42

3. Tipi i së ardhmes me foljen ndihmëse *kam* e ndjekur nga trajta e lidhore: *kam të vete*, *kam të shkoj* etj. Ky tip i së ardhmes, përdoret kryesisht në të folmet arbëreshe të Italisë dhe si relikto në ndonjë të folme jugore të Shqipërisë. Tipologjikisht nga elementi i parë, folja ndihmëse *kam*, mund të përfshihet në modelin roman, por për nga folja kryesore në mënyrën lidhore dhe për nga shtrirja, mund të përfshihet në modelin ballkanik, prandaj ne do ta quanim model i përzier, romano-ballkanik.

Për sa i përket burimit të kësaj trajte, çështja shtrohet: arbërishtja e Italisë e ka trashëguar nga dheu mëmë apo e ka përfutur në atdheun e ri, në Itali të Jugut. Me fjalë të tjera, pyetja mund të formulohet kështu: a kemi të bëjmë me një trajtë të formuar brenda shqipes, apo me një ndikim roman nga dialektet e Italisë së Jugut?

Një ndikim i dertpërdrejtë i supozuar nga ndërtimi i italishtes i tipit *ho da scrivere*, që i përgjigjet ndërtimit latin *habeo ad scribere* nuk ka të ngjarë. Një supozim i tillë kundërshtohet me tre argumente historiko-gjuhësore. Së pari, trajta perifrastike *kam* + lidhore me vlerën modale e kohore të një *futurum necessitatis* gjendet që në librin e parë të shkruar në arbërishten e Italisë, në veprën e Lekë Matrëngës të vitit 1592. Në atë kohë vështirë të thuhet se kishte ndodhur një ndikim i tillë gramatikor në arbërishte të Italisë. Në veprën e tij gjejmë: *Lumtë ata çë janë gëzuar zemre, pse ata kanë të shohënë tenëzonë*. It. Beati quelli che sono godi di cuore, perche essi vedrano il Dio (L. Matrënga, E mbësuaame... f. 42); *Lumtë ata çë janë të butë se kanë të trashëgonjë*. It. "Beati mansueti, perche possederano la terra" (Po ai, po aty). Së dyti, e ardhmja e tipit *kam* + lidhore takohet edhe sot në ndonjë të folme skajore të dialektit të Jugut, në të folmen e Çamërisë dhe të Bregdetit të Poshtëm: *Kam të dërgoj një letër në Vlorë*.¹⁴ Së treti, trajta perifrastike *kam të shkruaj* e arbërishtes, siç e ka vënë në dukje studiuesi Francesco Altimari¹⁵, *Studi linguistici arbëreshe*, Quaderni di Zjarri, 1968, ndryshojnë nga ndërtimet romane të tipit lat. *habeo ad cantare*, it. *ho da scrivere* nga pikëpamja strukturore, sepse trajta e

¹⁴ Shih për këtë Qemal Haxhihasanin, *Vështrim mbi të folmen e Çamërisë*, **Dialektologjia shqiptare, I**, Tiranë 1971, f. 183 dhe Menella Totonin, *E folmja e Bregdetit të Poshtëm*, **Studime filologjike**, 2, 1973, f. 63..

¹⁵ Francesco Altimari, **Studi linguistici arbëreshe**, Quaderni di Zjarri 1968.

arbërishtes si element të dytë ka një folje kryesore në mënyrën lidhore, e cila bashkohet me foljen ndihmëse *kam* në mënyrë të drejtpërdrejtë pa parafjalë, ndërtimet romane si element të dytë kanë një folje në paskajore që bashkohet me foljet ndihmëse përkatëse *habeo*, *ho* me parafjalët përkatëse *ad*, *da*.

Në këto rrethana ka të ngjarë që në kohën e shpërnguljeve të arbëreshëve nga dheu mëmë, trajta *kam* + lidhore të ketë qenë me përdorim më të gjerë në të folmet e jugut dhe të ketë lindur si trajtë përgjegjëse e së ardhmes së gegërishtes *kam* + paskajore: *kam me shkruar* në një truall gjuhësor ku mungonte trajta e paskajores, domethënë në toskërishte. Pyetjes që mund të bëhet me të drejtë, pse kjo trajtë në folmet jugore të sotme pothuajse është zhdukur, ndërsa ruhet mirë në të folmet arbëreshë, besoj se mund t'i përgjigjemi me arsyetimin se trajtën *kam të shkruaj* në të folmet jugore e kanë konkuruar dy trajta të tjera të së ardhmes: *do të shkruaj* dhe *kam për të shkruar*, të cilat janë mbizotëruese në këto të folme. Kështu që me kohë, pas intensifikimit të përdorimit të trajtës më të përgjithshme *do të shkruaj* dhe pas formimit dhe shtrirjes së trajtës më të re *kam për të shkruar*, që ka kuptimin e domosdoshmërisë, përdorimi i trajtës *kam të shkruaj* me po atë kuptim, erdhi duke u rrudhur dhe u ruajt në arbërishten e Italisë dhe në ndonjë të folme të skajit jugor të shqipes.

Përveç shqipes trajta perifrastike *kam* + lidhore me vlerën kohore të së ardhmes dëshmohet edhe në greqishte, në rumanishte dhe në maqedonishte. Greqishtja krahas trajtës ballkanke *θα γράφω nga θέλω να γράφω* dhe trajtës me foljen *μέλλω (μέλλω πάσχειν)*, në koinenë e periudhës së vonë ka njohur edhe perifrazën me foljen *kam* + lidhoren: *έχω να γράφω, έχω να τραγουδώ*. G. Rohlfs¹⁶ ka vërejtur se në dialektin e Salentos takohet ndërtimi perifrastik *enna grapso* në të cilin *enna* vjen nga *έχω να*, ndërtim i cili shpreh një situatë domosdoshmërie. Sipas G. Rohlfs *enna grapso* do të thotë “devo scrivere”, shqip “duhet të shkruaj”; *enna pame* “dobbiamo andare”, *pu e' nna pame?* “dove andremo”? Kjo mënyrë të shprehuri në këtë të folme përdoret kur është fjala jo për një të ardhme me kuptim

¹⁶ Gerhard Rohlfs, *Grammatica storica dei dialetti italo-greci di Calabria*, München 1977, p. 194, mbështetur në të dhënat e G. Morosi, *Studi dei dialetti greci della terra d'Otranto*. Lecce 1870., p.145.

kohor, por për një të ardhme me kuptim modal dhe vështrohet nga studiuesit që janë marrë me të si një ndërtim arkaik.

Ndërtimet e tipit perifrastik të tipit *kam* + lidhore për të shprehur domosdoshmërinë e kryerjes së një veprimi në të ardhmen, nuk janë të panjohura edhe për rumanishten. Në dialektin dakorumun takohet perifraza *am să cînta* “kam të këndoj”. Alf Lombard¹⁷ jep për rumanishten perifrazën *am să jur*, me kuptimin e detyrimit në të ardhmen “do të betohem, duhet të betohem.” Ky ndërtim perifrastik përdoret edhe si ardhme e së shkuarës me foljen ndihmëse në të pakryerën: *aveam să jur* “do të betohesha, duhej të betohesha”. Nga gjuhët sllave të Jugut bullgarishtja përdor perifrazën *imam da četa* “kam të lexoj”, krahas ndërtimit me foljen *dua šte četa* “do të lexoj”. Një trajtë foljore e tillë perifrastike me kuptimin e domosdoshmërisë në të ardhmen gjendet edhe në serbokroatishten *imam da radim* “kam të punoj, kam për të punuar”.

Prandaj, në qoftë se humbja e paskajores dhe zëvendësimi i saj me lidhoren mbahet si një nga ballkanizmat tipike në fushën morfositaksore, trajta perifrastike *kam* +lidhore si pasojë e kësaj gjendjeje, mund të përfshihej në radhën e tipareve ballkanike, pavarësisht se sot ka një përdorim të kufizuar.

Nyja si tipar gjuhëve të Ballkanit paraqet një varg problemesh që janë studiuar nga balkanologë dhe albanologë të shquar, siç janë po të përmendnim vetëm disa emra nga studiuesit shqiptarë: Eqrem Çabej, Selman Riza, Besim Bokshi, Shaban Demiraj, Koleç Topalli presin ende për t’u sqaruar përfundimisht: lindja e dy palë nyjash, të prapme dhe të përparme, kronologjia e shfaqjes së tyre në gjuhët që kanë nyje, çeshtja e prapavendosjes së tyre në shqipen, në rumanishten dhe në bullgarishten e maqedonisht, prejardhja e nyjave në secilën prej këtyre gjuhëve etj.

Lindja e nyjave nuk është një dukuri e veçantë në gjuhët e Ballkanit, por një dukuri e shumë gjuhëve indoeuropiane. Nyja shquese ka lindur në një fazë të caktuar të zhvillimit të gjuhëve për të rritur saktësinë dhe përkryerjen e informacionit, për të shënuar shquarësinë, për të bërë dallimin i caktuar i pacaktuar jo si rezultat i ndërhyrjes së ndonjë procesi planifikimi gjuhësor, por si rezultat i zhvillimit të vetvetishëm të tyre. Nga kjo pikëpamje shfaqja e nyjes nuk është as dukuri romane as dukuri

¹⁷ Alf Lombard, *La langue roumaine, une présentation*, Paris 1974, p. 274.

ballkanike, por edhe romane edhe ballkanike. Ballkanizëm është prapavendosja e nyjës shquese që është e pranishme në shqipe, në rumanishte në bullgarishte dhe në maqedonishte. Greqishtja e vjetër ishte e pajisur me nyje shquese që në fazën e hershme të dokumentimit të saj. Ajo vijon edhe sot e kësaj dite në greqishten e re, por në prepozicion. Latinishtja nuk kishte nyje shquese, por nga gjuhët që rrjedhin prej saj, gjuhët romane të perëndimit dhe të lindjes janë të pajisura me nyje. Në të gjitha gjuhët romane të Perëndimit nyjet shquese janë të paravendosura, të vendosura para emrit dhe të shkëputura prej tij, ndërsa në të vetmen gjuhë romane të lindjes, në rumanishten dhe në shqipen nyja shquese është e prapavendosur dhe e ngjitur pas emrit. Pra dukuri ballkanike nuk është prania e nyjes në gjuhët e Ballkanit, por prapavendosja e tyre në shqip, në rumanisht, në bullgarisht dhe në maqedonisht. Kjo meriton të shqyrtohet me vëmendjen e duhur si dukuri ballkanike. Cila është origjina e prapavendosjes së nyjes? Origjina greke përjashtohet apriori, sepse në greqishte, që kur kjo gjuhë njihet me dëshmi të shkruara, nyja është e vendosur para emrit që i përket. Prandaj origjina e prapavendosjes së nyjes, në mos qoftë zhvillim i mëvetësishëm në gjuhët e Ballkanit, duhet kërkuar, ose nga latinishtja ballkanike, ose në njerin nga substratet e lashta ballkanike, në substratin ilir ose trak.. Por para se të merret në vështrim teza e substratit, ndoshta jo vetëm për çështjen e nyjeve, por edhe për dukuri të tjera që janë konsideruar tipare ballkanike, është e domosdoshme të shqyrtohen në mënyrë shterruese dëshmitë që na jep latinishtja ballkanike. Gjendja e gjuhëve të sotme romane perëndimore me nyje të paravendosur tregon se burim i prapavendosjes së nyjës nuk mund të kërkohet as në latinishten klasike, as në latinishten vulgare të Gadishullit italik, as në atë të Gadishullit iberik, as në latinishten e folur në Gali, sepse në këto variante të latinishtes, siç tregon rezultati, nuk kanë ekzistuar premiset, ose më saktë kushtet sintaksore për prapavendosje të nyjës. Këtë e dëshmon më së miri rezultati i paravendosjes së nyjes shquese në gjuhët romane perëndimore. Në të vetmen gjuhë romane lindore ballkanike në rumanishte nyja është e prapavendosur. Kjo të shtyn të mendosh e të kërkosh nëse në latinishten ballkanike kanë ekzistuar ose jo struktura sintaksore që çojnë në prapavendosje të nyjës. Rruga e formimit të nyjës në rumanishte, prapavendosja e saj në rumanishte, nëse ka origjinë latine ose është i trashëguar nga substrati trak, mund të ndiqet më me lehtësi se sa në shqipe. Prandaj problemi i prapavendosjes së nyjes shquese në shqipe nuk duhet parë i shkëputur nga i njëjti problem në rumanishte

dhe në bullgarishte e maqedonishte. Nga pikëpamja e metodologjisë së studimit të kësaj dukurie, do të doja të theksoj se, përderisa të gjithë studiuesit e gjejnë burimin e nyjeve të dëftorëve anaforikë, atëherë prapavendosja e nyjes shquese duhet kërkuar në ato gjuhë që kanë njohur prapavendosjen e këtyre dëftorëve. Prandaj nëse mund të flitet për ndikim të ndonjë gjuhe të vetme në krijimin e kësaj ballkanizme, ndikimin duhet ta kërkojmë në shtrirjen e modelit me dëftorë anaforikë të prapavendosur, sepse zhvillimi nga dëftorë të nyja shquese është, do të thoja, një proces i brendshëm i secilës gjuhë. Me fjalë të tjera, një strukturë me dëftorë anaforikë të prapavendosur mund të jetë rezultat i ndonjë ndikimi në formë kalku i latinishtes ballkanike ose i ndonjë substrati.

Nga fusha e përemrave, si dukuri me karakter ballkanik është vështruar përdorimi njëkohësisht i përemrave vetorë të theksuar dhe të patheksuar në funksion të objektit të drejtë dhe të zhdrejtë, ose e shprehur me terma sintaksorë, rimarrja e objektit të drejtë dhe të zhdrejtë nëpërmjet trajtave të patheksuara të përemrave vetorë. Një dukuri e tillë haset në shqipe, në rumanishte, në bullgarishte dhe në maqedonishte. Por një tipologji të tillë e njohin edhe gjuhët romane, prandaj vështirë se mund të vështrohet si një ballkanizëm tipike. Është një dukuri gjuhësore që shfaqet në shumë gjuhë si zhvillim që lidhet me atë që në gjuhësinë funksionale, është quajtur perspektiva funksionale e frazës, ose me konceptin e remës e të temës.

Në sistemin e numrimit, nga mënyra e formimit të numërorëve të përbërë nga 1deri më 19 *njëmbëdhjetë, dymbëdhjetë* etj, të formuar nga një *mbë (mbi) dhjetë*, qëndron larg tipit roman dhe bashkohet me të gjitha gjuhët e tjera ballkanike përveç greqishtes. Në ruajtjen e ndonjë elementi të sistemit vigezimal (njëzet, dyzet), shqipja bashkohet me frëngjishten (*quatre vingt*).

Si përfundim, do të thoja që shqipja, e marrë në tërësinë e saj, merr pjesë në lidhjen gjuhësore ballkanike me disa tipare kryesore të sistemit të saj gramatikor dhe në disa prirje zhvillimi, por në disa tipare ajo afrohet edhe me struktura të gjuhëve romane, duke zënë kështu një vend të ndërmjetëm midis gjuhëve ballkanike dhe gjuhëve romane. Siç ka vërejtur E. Çabej, zgjerimi i fushës së krahasimit edhe me gjuhë të tjera jashtë Ballkanit mund të ndihmojë në sqarimin më të plotë e

më të sigurt të vetë ballkanizmave, të prejardhjes së tyre në gjuhë të ndryshme dhe të kohës së formimit të tyre.

Francesco ALTIMARI, Universiteti i Kalabrisë:

DISA NDIKIME TË GREQISHTES NË FJALËFORMIMIN FOLJOR TË ARBËRISHTES SË ITALISË

Abstrakt

Në këtë kumtesë autori, duke u bazuar mbi tekstet e vjetra arbëreshe dhe mbi kërkimet në terren, ndalet në fjalëformimin folJOR të arbërishtes së Kalabrisë ku dëshmohet një numër i konsiderueshëm formash hibride romano-greke çka duket se ka qenë një prirje e kahershme që gjallon ende në strukturën e thellë leksikore të kësaj dege të vjetër dhe deri diku më arkaike të shqipes. Kjo prirje shfaqet sidomos në disa neologjizma foljore prejëmërorë ku përdoren thujse rregullisht morfema nga greqishtja mesjetare dhe ajo e re, si *-as (+ënj)*, *-aks (+ënj)* dhe *-is (ënj)*, të ndjekura nga mbaresat e vjetra arbëreshe.

• Bazë leksikore romane (+ ndajshtesë greke) + eptim arbëresh

Në të folmet arbëreshe të Italisë dëshmohet një numër i konsiderueshëm greqizmesh që sot gjejmë sidomos në të folmet simotra të shqipes së Çamërisë dhe në toskërishten jugore, në përgjithësi, dhe natyrisht në të folmet arvanite të Greqisë, për të cilat disponojmë sot pas monografisë së Sasse-s, të monografive të plota dhe sistematike të përgatitura në dhjetëvjetëshin e fundit nga albanologu i mirënjohur Titos Jochalas – përmend këtu vetëm studimin e tij të fundit dhe të rëndësishëm *I arvanitjã sto Moriã, chronikã porias*, në dy vëllime, që doli sivjet në Athinë.

Kërkimet e reja të Jochalasit - kujtoj këtu vëllimet e tij *Άνδρος. Αρβανίτες και Αρβανίτικα* (Αθήνα 2000), *Ευβοία. Τα Αρβανίτικα* (Αθήνα 2002), *Υδρα. Αησμονημένη γλώσσα*, gjithashtu në dy vëllime (Αθήνα 2006), me të dhënat e reja gjuhësore që na sollën, na detyrojnë ta rikonsiderojmë pak historinë e shqipes duke na ofruar një dokumentacion të pasur dhe të ri për arvanitishten, që na paraqet një spektër më të gjerë diatopik dhe diakronik për ta rishikuar këtë variant jugor të gjuhës dhe vendin e tij në kontekstin e varianteve të shqipes, sidomos

për sa i përket raportit të tij me një variant tjetër të toskërishtes së vjetër siç është arbërishtja e Italisë.

Dhe këtu do të hap një parentezë të shkurtër për të theksuar nevojën që kemi në komunitetin tonë shkencor – dhe ky tubim ynë i sotëm albanologjik kështu i rëndësishëm për studimet tona gjuhësore ndoshta mund të na japë rastin e mirë për ta diskutuar këtë çështje seriozisht – të fusim në përdorim një term që na mungon për gjuhën e përbashkët panshqipe nën çatinë e së cilës duhet të përfshihen qoftë komunitetet e folësve të varianteve të gjuhës së diasporës arbërore që u shkëputën nga trugu para shekullit XV domethënë arbëreshët e Greqisë dhe të Italisë, qoftë komunitetet e shqipfolësve të Ballkanit. Të vazhdojmë ta quajmë atë ‘shqipe’ si u bë deri sot ka rrezik të vazhdojmë ta mbulojmë shtratin e madh gjuhësor me një batanije të shkurtër, gjysmake nga ana diakronike dhe diatopike, që nuk mund ta mbulojë atë sepse nuk e ka masen e kohës dhe të hapësirës të shtratit që duhet ta përfshijë. Por duke e quajtur atë ‘shqipe’ edhe për periudhën në të cilën nuk ishte ‘shqipe’, por ‘arbërishte’, rrezikojmë të dërgojmë tipologjikisht në mërgim jashtë shtratit të përbashkët jo vetëm ‘arbëreshët’ me eksodin e tyre historik, më parë në Greqi dhe pastaj në Itali, por edhe ‘arbërishtet’ që gjuha ‘shqipe’ nuk mund të përfshijë historikisht duke përcaktuar një fazë diakronike të gjuhës më të vonshme se ajo e diasporave arbërore. Tani, duke mos qenë Arbërishtja – ajo e Greqisë dhe ajo e Italisë – dhe shqipja dy gjuhë paralele, si vazhdojnë të trumbetojnë disa diletantë katundi - por me të gjitha veçoritë e veta variante gjuhësore brenda shtratit të një gjuhe të përbashkët, neve na duhet domosdo ta kemi këtë term identifikues të brendshëm që nuk kemi për ta identifikuar këtë gjuhë të përbashkët, domethënë se duhet ta kemi edhe në këtë term asnjans që mjerisht deri sot na mungon, por nuk u mungon gjuhëve të huaja ku gjejmë terma si “albanese” (italisht), “Albanian” (anglisht), “Albanische” (gjermanisht), “albanais” (frëngjisht) etj.

Për këtë term që na mungon në shqipe dhe në terminologjinë tonë shkencore për *gjuhën e përbashkët panshqipe*, duke shkaktuar anakronizma dhe anatopizma [me “arbëreshët” që sipas shqiptarëve flasin shqip dhe me shqiptarët që sipas arbëreshëve flasin arbërisht!], para do kohe kam avancuar idenë që këtë gjuhë të përbashkët pan-

shqipe mund ta emërtojmë për shembull *albanishte*, ose *albanishtja e re*, ku mund të përfshihen të gjitha variantet e saj pas protoshqipes, ose *albanishtja e vjetër*: e kam fjalën këtu për të gjitha variantet qoftë diakronike qoftë diatopike - shqipja, arbërishtja e Greqisë, arbërishtja e Italisë - që regjistrohen përkatësisht në trevat shqipfolëse, në trevat arvanitishtfolëse dhe në trevat arbërishtfolëse.

Por ta lëmë tani diskutimin për albanishten dhe të kthehemi në temën qendrore të kësaj kumtese time për ndikimet e greqishtes në fjalëformimin foljor të arbërishtes. Do të ndalem posaçërisht në efektin e dendurisë së lartë të greqizmeve, sidomos të atyre foljore, që ka ushtruar në sistemin foljor të vetë arbërishtes, duke prekur edhe fjalëformimin e saj në një hark kohor shumëshekullor. Dhe kjo ndodhi edhe pas shumë shekujsh nga shkëputja e arbërishtes nga trangu i Ballkanit dhe nga ndërprerja e kontaktit të ngushtë që ajo kishte me greqishten, por edhe për efekt të hegjemonisë fetare dhe kulturore të greqishtes bizantine në kishën lindore arbëreshe, që zgjati për një pjesë të komuniteteve arbëreshe deri në ditët tona dhe që solli si pasojë asimilimi brenda arbërishtes të një numri të lartë leksemash, sidomos emra por edhe folje, që e pasuruan fondin e arbërishtes, duke e karakterizuar edhe atë në krahasim me variantet e tjera të gjuhës.

Dihet se ka rëndësi se si verifikohet në këtë rast, në kontekste me kontakt gjuhësor, ndërhyrja, dmth interferenca gjuhësore, që mund të ndodhë përmes rrugës gojore apo shkrimore, brenda një konteksti komunikativ prestigji siç është ai fetar, që, megjithëse sektorial, e ushtron peshën e vet me fuqinë e institucionit bartës të gjuhës liturgjike – kisha – edhe në një komunitet si ishte ai arbërishtfolës në të kaluarën që karakterizohej për një prani të madhe greqizmesh në shumë fusha të gjuhës së folur. Kjo peshë ka qenë e madhe nëse ky ndikim përmes oralitetit, i tejkaloi kufijtë e leksikut, siç do të shikojmë më tej, dhe iu adaptua morfologjisë së gjuhës që mori hua për efekt të induksionit edhe prapashtesat nga gjuha marrëse.

Në arbërishten, sikurse edhe në gjuhët e tjera ballkanike, greqizmat foljorë kanë hyrë nga koha e aoristit, dhe jo nga e tashmja, duke paraqitur këto ndajshitesa që rrjedhin përkatësisht nga tema e kohës së kryer të thjeshtë të greqishtes: **-as** [nga morfema e aoristit $\alpha\sigma(\alpha)$], **-es** [nga morfema e aoristit $-\varepsilon\sigma(\alpha)$], **-is** [nga morfema e aoristit $-\iota\sigma(\alpha)$], -

os [nga morfema e aoristit -όσ(α)], **-aks** [nga morfema e aoristit -αξ(α)], **-eks** [nga morfema e aoristit -εξ(α)], **-aps** [nga morfema e aoristit -αψ(α)], **-eps** [nga morfema e aoristit -εψ(α)], **-ips-** [nga morfema e aoristit -ιψ(α)]. Këto huazime foljore greke përfshihen në zgjedhimin e dytë të foljeve me bashkëtingëllore në temë, por ashtu siç ndodh në arvanitishten, këto huazime foljore marrin edhe prapashitesën e vjetër të shqipes **-nj** që sot, në trajtën standarde **-j**, e gjejmë vetëm në zgjedhimin e foljeve me temë në zanore:

Sjellim këtu disa shembuj nga greqizmat foljorë që kemi nxjerrë nga vjelja e leksikut të veprës *Gjella e Shën Mëris Virgjër* (1762) të Jul Varibobës:

- Folje me temë në **-as-inj** < nga foljet greke me temë në të tashmen *άζω* dhe në të kryerën e thjeshtë *ασ(α)*:

dhjvasinj (shqip “lexoj”) < διαβάζω: 1503 çë dhjvasën urtëria;

- Folje me temë në **-es-inj** <nga foljet greke me temë në të tashmen *-αίω* dhe *-έω* dhe në të kryerën e thjeshtë *-εσ(α)*:

ftesënj (shqip “kam faj”) 1775: Të ftesa, oj Zoti Krisht, nga greqishtja *πταίω*;

ngalesënj (shqip “padis”) 965: Mos vaça t’e ngalesënj, Prefazione: e të dal dhimoni të më ngalesënj nga greqishtja *εγκαλέω*;

parkalesënj (shqip “lut”) Prefazione: Andaj të parkalesënj, Zonja e Shën Mëri, 236: parëkalesënje tën Zon nga greqishtja *παρακαλέω*.

- Folje me temë në **-is-inj** < nga foljet greke me temë në të tashmen *-ίζω* dhe në të kryerën e thjeshtë *-ισ(α)*:

dhrosisënj (shqip “ushqej” dhe jo “lag, lagështoj, freskoj”) si është në greqishten e sotme *δρoσίζω* dhe për shqipen e vjetër (shih Leotti (1937:152) “rinfrescare”: 3425 Ea më lipis, ea më dhrosis, 2602 e si bīr të dhrosisi, 2144 ndë ktë tries të dhrosisesh;

rrukullisënj (shqip “rrëkëllej”) sot jo në standardin, por e dëshmuar deri në fjalorin 1954 dhe në Leotti (1937: 1245): 151: i rrukullisi e i gramisi, 3069: mbjatu i gramisi e i rrukullisi;

qeverrisi 634: qeverrisi, via, zonjat e mia (por këtë huazim e gjejmë edhe në shqipen **qeveris** dhe në rumanishten **chivernisi** (italisht “governare”) nga aoristi κυβέρνησα i foljes greke κυβερνω.

Ndryshe nga foljet e mësipërme, që e kanë prejardhjen direkt nga greqishtja, folja **sporrisinj** (shqip “hedh farën, mbjell”) më duket se u krijua brenda arbërishtes, por duke u nisur nga fjala greke σπορέα “mbjellje”. Nuk dimë nëse folja prejëmërore **sporris** u krijua për analogji të brendshme apo ekzistonte në greqishten mesjetare dhe pra u humb, e zëvendësuar nga forma moderne σποριάζω “semenzire, tallire” sot.

- Folje me temë në -os-inj < nga foljet greke me temë në të tashmen –όνω, -όω dhe në të kryerën e thjeshtë -όσ(α):

dhullosënj (shqip “hidhëroj”) nga greqishtja δουλόω (italisht “soggiogare, asservire”).

3729: Oj mëm shëjte e dhullosur (“Madre addolorata”), 4159: gjakùn e pruar dhullosur (“nessuno fu deluso”). Altra ipotesi: nga italishtja e vjetër **dolare**, piallare;

farmakosënj (si në shqipen: “helmoj, hidhëroj”) 2458: Ka Kri-shti farmëkosur nga greqishtja φαρμακόνω ~ φαρμακώω;

serposënj (shqip “përfundoj, perëndoj”) 1865: Së dighet dit për mua, sembre serposet.

- Folje me temë në -aks-inj < nga foljet greke me temë në të tashmen –άσσω, -άζω dhe në të kryerën e thjeshtë- αζ(α):

pataksënj (shqip “çudit”, “zë në befasi”, qëlloj”) 285: Si e tha bëri, e u pataks nga greqishtja πατάσσω;

taksënj (shqip “premtoj”): 169 Atë çë taksi tat Adhamit nga greqishtja τάσσω;

gharaks (shqip “gdhin, agon”) 286: porsa u gharaks, vate e gjet nga greqishtja χαράζω (imp. albeggia, fa giorno”).

- Folje me temë në -eks-inj < nga foljet greke me temë në të tashmen -άιω, -εχω, dhe në të kryerën e thjeshtë εζ(α):

steksënj (shqip: “ulem”, “vendosem”) 4042: Ku vate e ka steksi (“Dove essa si posò”) nga greqishtja **σταίνω** (italisht “porre, collocare”);

porseksënj (shqip “dallop”, “vë re”) 743: çë ajo porseksi se llogha vin, 4040: Ma kur Romën porseksi;

streksinj (shqip “kthehem, drejtohem”) 4105: Streksi e Shën Mëria nga greqishtja στρέχω;

- Folje me temë në -iks-inj < nga foljet greke me temë në të tashmen -ηγω, dhe në të kryerën e thjeshtë $i\zeta(\alpha)$:

piksënj (shqip “ngjiz, zë”) 4037u piks porsa e pā (“ e si addensò al vederla”);

rrëfiksënj (shqip “fishket, venitet”);

- Folje me temë në -aps-inj < nga foljet greke me temë në të tashmen -άνω dhe në të kryerën e thjeshtë -αψ(α):

papsënj (shqip “fashit, qetësoj, paqësoj.

- Folje me temë në -eps-inj < nga foljet greke me temë në të tashmen -έσω dhe në të kryerën e thjeshtë -εψ(α):

jatrepsënj (shqip “mjekoj, shëroj”). 1985: ea jatreps theritat tona nga greqishtja ιατρέω.

1. Folje me temë në -ips-inj <nga foljet greke me temë në të tashmen -είπω dhe në të kryerën e thjeshtë -ιψ(α):

lipset (shqip “duhet, nevojitet”) 3401: Ju nguqet çera, se lipset vera. Nga greqishtja λείπω.

Përveç huazimeve foljore nga greqishtja mesjetare/ bizantine dhe nga greqishtja e re, ka në arbërishten e Italisë një sërë foljesh që janë formuar nëpër shekuj duke shfrytëzuar disa elemente të greqishtes, si fjala vjen morfemat që vijnë nga aoristi i gjuhës fqinje, duke i kombinuar ato me një bazë leksikore romane (e prejardhur nga italishtja ose nga dialektet italo-jugore me të cilat arbërishtja ka qenë historikisht në kontakt) dhe me mbaresat e vjetra shqipe që arbërishtja e Italisë dhe arbërishtja e Greqisë vazhdojnë të përdorin edhe sot në gjuhën e folur edhe për foljet të zgjedhimit të dytë.

Në variantet gjuhësore arbëreshe gjejmë në fjalëformimin foljor një seri formash hibride romano-greke çka duket se ka qenë kjo një prirje e kahershme që gjallon ende në strukturën e thellë leksikore e që shfaqet në disa neologjizma prejemorë ku përdoren thujse rregullisht morfema nga greqishtja mesjetare dhe ajo e re, si *-as (+ënj)*, *-aks (+ënj)*, *-aps (+ënj)* dhe *-is (ënj)*, të ndjekura nga mbaresat e vjetra arbëreshe

Në disa formime të tjera bazës leksikore romane i bashkohet një ndajshesë fjalëformuese me prejardhje greke, që ndiqet nga ndajshesat trajtëformuese arbëreshe. Një rast i tillë është p.sh. huazimi foljor *ngolisënj* ‘ngjis’ nga it. ‘incollare’ < (*n*+tema *kolë*) *ngolë+is+ënj*, që në ndonjë të folme është zëvendësuar nga huazimi më i ri *ngolarënj* që haset aty-këtu krahas fjalës shqipe *ngjitënj*.

Folja *kolis* “ngjis” që sot nuk figuron në fjalorin e shqipes standarde të Akademisë së Shkencave (edicionet: 1980 dhe 2002), figuronte në fjalorin e shqipes të vitit 1954 dhe në të mëparshmit, si në *Dizionario albanese-italiano* te Angelo Leotti, Roma 1937, f. 472: “**kolis** – v.-is, aor. -isa, attaccare, appicciare, appiappare”. Ajo ka sot një përhapje më dialektore dhe figuron në fjalorin e Çamërisë të Qemal Haxhihasanit. Nuk jemi të sigurt nëse këtu kemi të bëjmë me foljen e fondit leksikor dialektor tradicional *kolis* ose me një neologjizëm prejemor *ngolis* (nga parashtesa përforcuese **n** + **kolë** (nga italishtja ‘colla’).

Në disa formime të tjera bazës leksikore romane i bashkohet një ndajshesë fjalëformuese me prejardhje greke, që ndiqet nga ndajshesat trajtëformuese arbëreshe. Një rast i tillë është p.sh. huazimi foljor *ngolisënj* ‘ngjis’ nga it. ‘incollare’ < (*n*+tema *kolë*) *ngolë + is + ënj*, që në ndonjë të folme është zëvendësuar nga huazimi më i ri *ngolarënj* që haset aty-këtu krahas fjalës shqipe *ngjitënj*.

Giordano (1963) sjell një listë me huazime të tilla foljore me një bazë leksikore romane e ndërthurje eptimore greko-arbëreshe që hasen sot e gjithë ditën në të folmen e Frasnitës: *çotjasënj* ‘trullos’, *cingarjasënj* ~ *cingarjarënj* ‘mashtroj’, *cinxulljasënj* ‘keqtrajtoj’, *fallopjasënj* ~ *fallopjarënj* ‘ha, përtyp (barin – për kafshët)’, *fjandasënj* e *fjandaksënj* ‘imagjinoj’, *mubjasënj* ‘narkotizoj’, *mulhasënj* ‘kalb, prish’,

shkerdhjasënj ‘cifloj’ dhe *zgarrixjasënj* ‘gërvisht’. Kësaj liste ne do t’i shtonim edhe dy huazime të tjera “hibride”, me bazë leksikore romane dhe formant grek *-as*: *vakandasënj* ‘zbraz’; *kutufasënj* ~ *kutufosënj* ‘rrah’ (me një bazë romane me etimologji të pasigurt *cutuf-* nga *cutuffari* a *accutuffari* që çuditërisht nuk gjendet në Kalabri, por në Sicili).

2. Bazë arbëreshe + ndajshtesë greke/ bazë italiane + ndajshtesë greke

Gharepsënj: 89: Me tij gharepsem, o e Shën Mëri, 113: Mund gharepsesh, o e Shën Mëri, 1430 Gharepsem kur kultonj se mbi dhe.

Një tjetër huazim “hibrid”, formuar nga një bazë leksikore italiane dhe një ndajshtesë nga greqishja e re, është folja *stirandaksënj* ~ *stirandasënj* ‘ndej teshat, e i përgatit për t’u hekurosur’. Me gjasë përbëhet prej një rrënje italiane *stir-* < *stirare* dhe greqizmit foljor *adhjas(ënj)* ‘rendit, përgatit’ me mbaresat e vjetra shqipe *-ënj*, *-ën*, *-ën* etj., që në të folmet arbëreshe të Kalabrisë u shtohen foljeve me temë në bashkëtingëllore. Përdorimi i kufizuar i kësaj foljeje në kushtet e sotme mund të ketë përcaktuar perceptimin dhe interpretimin e gabuar në *stirandaksënj* ~ *stirandasënj* me gjasë nga *stiradhjas*. Një dukuri e ngjashme dëshmohet në disa të folme arbëreshe të Kalabrisë edhe në foljen *tarandaksënj* ‘shkund, tund’ me variantin *trandaksënj*.

Së fundi, në këtë kategori huazimesh me bazë italo-romane dhe ndajshtesa greke hyn edhe folja *manganisënj* ‘rrah lirin a kërpën me mëngër’, që kemi regjistruar në ngulimin arbëresh San Nicola dell’Alto, por që gjendet edhe në *Fjalorin arbërisht* nga Giordano (1963: 253). Mirëpo në këtë rast, edhe pse fjala *mangën* / *mëngër* është ndër huazimet më të vjetra greke të shqipes, në këtë të folme arbëreshe mund të ketë hyrë prej kalabrishtes *mangano*.

Në përfundim, mund të konstatojmë se huazimet, siç vëren me të drejtë gjuhëtari italian Massimo Fanfani, “*janë dëshmi të shtrenjta të historisë dhe të marrëdhënieve reciproke midis popujve, studimi i të cilave na lejon ta rindërtojmë dhe të përshkojmë përsëri shtigjet e shumta të shkëmbimeve kulturore, duke gjetur të dhëna mbi gjuhët e interesuara, mbi historinë e leksikut të tyre, mbi aspekte të fonetikës*

historike dhe mbi ngjarje morfologjike që do t'ishte e vështirë apo e pamundur të nxjerrim gjetkë”.

Bibliografi:

- GIORDANO, Emanuele (1963): *Dizionario degli Albanesi d'Italia*. Bari: Edizioni Paoline.
- HAXHIHASANI, Qemal (1974): “Vështrim i përgjithshëm mbi të folmen e banorëve të Çamërisë” (ff.3-113) në *Dialektologjia Shqiptare*, II, Tiranë.
- JOCHALAS, titos P. (1994): “Considerazioni sull’elemento greco nell’arbëresh” (pp.141-160), në I dialetti italo-albanesi. Studi linguistici e storico-culturali sulle comunità arbëreshe, a cura di F.Altimari e L.M.Savoia, presentazione di Tullio De Mauro, Bulzoni, Roma.
- JOCHALAS, Titos P. (2000): *Άνδρος. Αρβανίτες και Αρβανίτικα*. Αθίνα: Εκδοσεις Πατακη.
- JOCHALAS, Titos P. (2002): *Ενβοια. Τα Αρβανίτικα*. Αθίνα: Εκδοσεις Πατακη.
- JOCHALAS, Titos P. (2006): *Ύδρα. Λησμονημένη γλώσσα, Α΄, Β΄*. Αθίνα: Εκδοσεις Πατακη.
- JOCHALAS, Titos P. (2011): *Η Αρβανίτικα στο Μοριά, χρονικά πορείας, τόμο Α΄-Β΄*. *Il Vocabolario Treccani. Enciclopedia dell’italiano*, Istituto dell’Enciclopedia Italiana, Roma 2011.
- PICCITTO, Giorgio (a cura di) (1977): *Vocabolario siciliano. I*. Catania-Palermo: Centro di Studi Filologici e Linguistici Siciliani.
- VARIBOBA, Giulio (2005): *Vita della Beata Vergine Maria (1762) – Gjella e Shën Mëris s’Virgjër (1762)*. Edizione critica e traduzione italiana a cura di Vincenzo BELMONTE. Con cd-rom allegato. Soveria Mannelli: Rubbettino editore.
- VARVARO, Alberto (1986): *Vocabolario etimologico siciliano. Volume I (A-L)*. Con la collaborazione di Rosanna SORNICOLA. Palermo: Centro Studi Filologici e Linguistici Siciliani.

Wilfried FIEDLER, Jena/ Meißen

DISA VEÇORI TIPOLOGJIKE TË URDHËRORES NË GJUHËT BALLKANIKE

Abstrakt

Kumtesa fillon me karakterizimin e morfologjisë së urdhërores në të gjitha gjuhët ballkanike si dhe të zhvillimit të saj. Ajo trajton lidhjet e kësaj kategorie foljore me pjesët e tjera të ligjëratës, sidomos me pasthrrmat dhe, brenda sistemit emëror, me thirroren dhe me disa shprehje të veçanta të shqipes si me tipin MOTRANI, SHOQENI.

1. Ndryshe nga ballkanologjia tradicionale, e cila merret kryesisht me të ashtuquajturit "ballkanizma", d.m.th. me tipare që, si pasojë të interferencës, hetohen të paktën në tri gjuhë ballkanike, mua më duket se për të njohur natyrën e interferencës midis sistemeve gramatikore të gjuhëve në Evropën Juglindore këto duhet të shqyrtohen në tërësi, pra, të theksohen edhe dallimet midis tyre. Mendoj se këtu mund të na sjellë rezultate të reja vetëm një përshkrim tipologjik. Tipologjia e konstrukteve gramatikore që duhet të përshkruhen sistematikisht, mund të përfshijë:

1. Trajtat sintetike;
2. Trajtat analitike me folje ndihmëse, me dy nëntipe:
 - a) dy folje të zgjedhuara,
 - b) një folje e zgjedhuar dhe një trajtë infinite;
3. Trajtat analitike me pjesëza trajtëformuese.

Konstruktet e fundit, që unë i quaj "zinxhirë ballkanikë" përbëhen prej pjesëzave "trajtëformuese", të cilat - si dukuri të morfosintaksës - gjenden në stadi të ndryshme të gramatikalizimit. Tipologjia areale duhet të merret në mënyrë të posaçme me procesin e këtij gramatikalizimi deri në morfologjizim.

Pasi jemi marrë në mënyrë konsekuente me krahasimin e trajtave të indikativit, na doli si rezultat se këto formojnë, në arealin tonë, një trini me një kompaktësi mbresëlënëse, çka na tregon se jo vetëm novacionet, risitë

e përbashkëta, por edhe ngulmimi i përbashkët në një gjendje më të lashtë mund të karakterizojë arealin e konvergencës.¹

Pas trajtave të indikativit radha i erdhi urdhërores. Mendoja se në këte fushë nuk do të kishte shumë gjëra me interes ballkanologjik për të thënë, dhe më dukej se kjo kategori është shumë e përhapur dhe tipologjikisht e ngjashme nëpër gjuhët e tërë Evropës dhe të gjithë botës, edhe përmbajtja e saj thelbësore është gjithkund pothuajse e njëjta.²

2. Vërtet, morfologjia e imperativit në gjuhët ballkanike tregon përputhje, por edhe ndryshime tipologjike. Për të gjitha gjuhët moderne në arealin qëndror të konvergencës vlen, që ekzistojnë vetëm vetat e dyta në njëjës dhe në shumës. Formimi i njëjësit është mjaft i ndërlikuar, nuk mund të jepen rregulla të thjeshta as për formimin e tyre në një gjuhë konkrete, aq më pak për tërësinë e gjuhëve ballkanike, prandaj këtë çështje nuk do ta prekim këtu. Edhe disa probleme të tjera nuk do të mund të trajtohen këtu. P.sh. do të lëmë mënjanë problemet e temës së urdhërores. Mjafton të themi se duke hartuar librin "Albanische Grammatik" Oda Buchholz dhe unë në këtë kapitull e kishim më së vështiri për të bërë rregulla të përgjithshme.

Ndryshe paraqitet situata përsa i përket trajtës së shumësit: Në të dyja gjuhët standarde ballkanosllave kemi rregullisht trajta të veçanta për indikativin dhe për imperativin, p.sh.: *пешавате: пешавајте /peuume: peueme* (në këtë rast ndryshime midis bullgarishtes dhe maqedonishtes ka vetëm në theks). Kurse në shqipe, në dakorumanishte dhe në greqishte (te trajtat me temë prezenti) gjejmë pothuajse gjithnjë identitet të trajtave indikative dhe imperative, p.sh. *këndoni: këndonë*,³ *cîntați: cîntați*.⁴ Më me rëndësi është se në të gjitha gjuhët përkatëse mbaresa e mirëfilltë e vetës së dytë sh. është gjithmonë e

¹ Një pjesë e rezultateve të kësaj pune është botuar në artikullin tim Fiedler (1992).

² Disa veçori të saj në fushën e *funksionit* i ka trajtuar Petja Asenova në artikullin e saj "Fonctions non-impératives de l'impératif dans les langues balkaniques" (në LB XXXVIII, 103-110).

³ Por nuk duhet harruar se në gegërishte kemi ndryshime në gjatësinë e zanoreve; le të japim disa shembuj nga përkthimi i Dhjatës së re i Kristoforidhit: se nuk bni (J 12 19): bāni gati (Mt 3 3); Vēni orē..? (J 12 19): Vēni orē! (Mt 6 26); posa t hÿni (Mc 11 2): Hÿni! (Mt 7 13).

⁴ Ka pak përjashtime si bullg. *ядете: яжте*, gr. *τρέχετε: τρεχάτε, φεύγετε: φευγάτε*, për rastet *vini: ejani, дојдете: елате* do të flasim më poshtë.

njëjta: *-ni, -t, -me, -te*. Sigurisht: ndryshueshmëria e mbaresave indikativ: imperativ e trajtave të njëjësit dhe identiteti të paktën i mbaresave në shumës është një veti që tejkalon Gadishullin Ballkanik, por në arealin tonë ka pasur pasoja të posaçme, siç do të shohim më poshtë.

3. Një tipar i përbashkët i të gjitha gjuhëve moderne në Evropën Juglindore është, me shikim të parë, paradigma "e cunuar"- gjejmë vetëm vetën e dytë njëjës dhe shumës si trajta të veçanta sintetike. Për gjuhët ballkanosllave, për shqipen si edhe për greqishten e re kjo përmendet në të gjitha përshkrimet. Edhe gramatikat e dakorumanishtes citojnë vetëm dy trajta, por gjejmë edhe shembuj me konjunktiv pa pjesëz në disa raste, khs. Beyrer & al. (1987: 186): "nur in der 3. Pers. (Sing.) in festen Verwendungen wie *trăiască* "er/sie/es lebe", *ducă se* "gehe er/sie/es", *facă* "mache er/sie)". Raste të tilla ka edhe në shqipe dhe në greqishten e re, p.sh.: Kjo është serioze! Duhet t'i mbajmë pa tjetër. *Shkojmë e shohim* (Gjata, Këneta 338). - *Shkojmë!* - u përgjigj i vendosur Stavri... (po aty, 14). Khs. edhe për greq. e re: te Moser-Philtsou (1966: 118): Nur *πάμε* (=gehen wir) steht gewöhnlich ohne *ας*: *πάμε λοιπόν!* "gehen wir also!"

Po të ishte i mundur përdorimi pa pjesëz të të gjitha foljet, do të nxirrnim përfundimin se kemi të bëjmë me sinkretizma konjunktivi = imperativi.

Sidoqoftë, situata e sotme nuk është trashëgim nga gjuhët e lashta. Gramatikat e greqishtes së vjetër, të latinishtes dhe të bullgarishtes së vjetër na japin një pasqyrë jo krejtësisht, por pothuajse të plotë të të gjithë personave⁵ Tabela 1

Një trajtë e veçantë për v. e 1 sh. mungon në greq. e vjetër dhe në latinishte. Në këto gjuhë zëvendësohej me trajtën përkatëse të konjunktivit.⁶

Ne gjuhët fqinje, por jashtë arealit qendror të konvergencës, vetëm

⁵ Dualin në greqishten e vjetër dhe në bullgarishten e vjetër këtu nuk do ta shënojmë.

⁶ Në shembullin që vjen: *παιδεύομεν* resp. *judicemus*. Po të pranonim sinkretizëm [imperativi = konjunktivi] do të kishim një paradigëmë të plotë. Khs. Rom 14 13: *Μηκέτι οὖν ἀλλήλοις κρίνωμεν, ἀλλὰ τοῦτο κρίνατε μᾶλλον, τὸ μὴ τιθέναι πρόσκομμα τῷ ἀδελφῷ ἢ σκάνδαλον* = Non ergo amplius invicem *judicemus*, sed hoc *judicate* magis, ne ponatis offendiculum fratri vel scandalum.

serbokroatishnja ka ruajtur trajta për vetën e parë shumë⁷, kurse brenda ballkanosllavishtes hasen tashmë vetëm në Maqedoninë Jugperëndimore trajta të "pasthirmës së zgjedhuar" (sh. më poshtë!) si hajdme "(të) shkojmë".⁸ Kufizimi i kategorisë së vetës vlen bile edhe për të folme serbe në kufinë gjuhësore me shqipen, khs. Barjaktarević (1979:219) "1. лице множине императива не чује се у метохијској говорној зони, него се место њега узима речца ајд-е, ајдемо, ајмо, ајмоте, ајдете, ајдемоте + да + презент: јде да с днѐмо (Кл), јдѐмо, љди да кр нѐмо (Гор), Ајд те да се догов римо (Бд), Ајдем те да т ур дѐмо (Ист)". Të gjitha këto të dhëna nga gjuhët sllave të Jugut na tregojnë se kemi të bëjmë me interferencë.

Tabela 1

greq. e vjetër	greq. e re	bullg. e vjetër	bullg. e re	latinishtja	dakorumanishtja
παῖδευε	παῖδευε	неси	нос (нес)	canta(-to)	cîntă
παῖδευέτω []	[] []	неси несѣмъ	[] []	cantato []	[] []
παῖδεύετε ⁹ παῖδεύόντων	παῖδεύετε []	несѣте []	носѣте(несѣте) []	cantate (-tote) cantanto	cîntați []

⁷ *pletémo: plétimo; peçémo: peçimo; pišémo: pišimo; nösimo: nösimo; dámo: dájmo*

⁸ Khs. Mirčev (1963: 204 v. dhe 206). Koneski shkruan në lidhje me këtë (1967: 196): "Заповедниот начин на нашиот јазик има форми само за 2 л. едн. и мн. Формите за 3 л. едн. и 1 л. мн., што ги имал нашиот стар јазик, излегле од употреба и се замениле со описни конструкции....Остаток од 3 л. едн. Имаме во изразите: *помозибог...спасибог...*" Khs edhe për bullg. standarde te Stojanov & al. (1983:366 ff.). Shembuj të tjerë sh. më poshtë!

⁹ Siç e përmenda, trajtat e vetës së dytë shumë u përgjigjen trajtave të indikativit, kuptohet që vetëm atje ku ka indikativ, d.m.th. ku indikativi nuk përjashtohet për shkak të aspektualitetit. Kështu, prezenti i indikativit qysh në gjuhën e vjetër me temë aoristi nuk ekziston, kemi *παῖδεύετε: παιδεύετε* dhe *τίθετε: τίθετε* si imperativ = indikativ, kurse *παῖδεύσατε* ose *θέτε* ekzistojnë vetëm si trajta imperativi, jo si prezent. Siç duket, i vetmi përjashtim është folja "esse": prezenti *έστε*, por imperativi *έστε*, ku aoristi dhe si pasojë edhe imperativi i aoristit nuk ekziston fare. Ne greqishten moderne trajta sintetike kemi vetëm te trajtat e vetës së dytë nj. dhe sh.. Trajtat e vetës së 3 nuk hasen më, kurse opozicioni i temës së prezentit dhe të aoristit është ruajtur, kështu që gjejmë në gramatikat katër trajta sintetike, p.sh. te Thumb (1964:154): *δένε, δένετε; δέσε, δέσετε*, vetat e para dhe të treta jepen vetëm si trajta analitike, me pjesëzat *ας* resp. *θα*. Për foljen "esse" Thumb (1964:159) na jep: *νὰ είσαι (..νὰ 'σαι).. είσου; ἄς εἶναι; ἄς εἶμαστε, (να) είστε, ἄς εἶναι...*

Edhe përsa i përket zhvillimit në gjuhën shqipe kemi dëshmi për ekzistencën e trajtave të tjera të imperativit: Problemet e radhitjes së pjesëzave sipas konceptit tonë tipologjik mund të trajtohen vetëm duke marrë në shqyrtim trajtat e shkurtëra të pronorëve në tërësi. Megjithatë mund të themi këtu që me anën e rregullave që duhen dhënë atje, mund të nxirret përfundimi se në shqipen e Buzukut ka ekzistuar të paktën trajta e v. së 1 shumës dhe e v. së 3 njëjës.

Për vetën e 1 sh. kemi dy shembuj, të dy me të njëjtën folje:

Higne mieftri hi anderauet vien: *enurafmaeh*: e *hëfsmeh* endeh gneh en chefis pufass e omi seh cun caphse / e chehe / e angreh / e teh fohme his ndera caneh me ih cleneh: (136 26, 1 Mo 37 20) "Ecce somniator venit; venite, occidamus eum, et mittamus in cisternam veterem, dicimusque: Fera pessima devoravit eum; et tunc apparebit quid illi prosint somnia sua." Chuu anste aih hi chaa meh redituō: *enurafmaeh*: e mos iete cus te nah lupgneh: piesseneh (136 61, Mt 21 38) "Hic est heres, venite, occidamus eum, et habebimus hereditatem ejus." (Khs. Fiedler 2004/ 1: 198 ff.).

Te Buzuku gjejmë edhe një shembull të këtij lloji për vetën e 3 nj.:

... neh meh ferben cus: *diecheme*: e tuch teh iem: e eh ferbetorih em teh iete (192 11, Jh 12 26) "Si quis mihi ministrat, me sequatur et ubi sum ego, illic et minister meus erit". Veç kësaj kemi trajtën *aja!* jo vetëm për v. e 2 por edhe për v. e 3 nj.: nafte cus hi chaa &: *eiah* teh e teh piieh "Si quis sitit, veniat ad me et bibat" (180 68, Jh 7 37) Khs. Fiedler (2004/1:184 v.).

Rastet e tjera nuk na japin informata të sigurta, se janë trajta të konjunktivit pa ndonjë veti që do të fliste saktësisht për ekzistencën e urdhërores.

4. Në citatin që kemi përmendur nga gramatika e greq. së re (lidhur me *πᾶμε*) gjejmë edhe një njoftim për rrugën e mëvonshme që ka marrë shprehja e imperativitetit për vetat që kanë humbur trajtat e imperativit: Zëvendësoheshin me anën:

1. e konjunktivit në të gjitha gjuhët përkatëse;

2. e jusivit, d.m.th. me anën e konstruktit me *le*, *lă(s)*, *neka*, *aç*, në të gjitha gjuhët përkatëse, me përjashtim të dakorumanishtes: Kësh-tu kemi në meglenitshite: La persoana 3 sg. și pl. imperativul este exprimat prin prezentul conjunctivului, precedat de lă (<lasă: lă-s ásă! (<lasă si/ (<să iasă!)” Atanasov (2002:252): Ky citat tregon se dakoru-

manishtja nuk e përkthen fjalë me fjalë. E njëjta gjë si për meglenishten vlen edhe për aromuishten.¹⁰

Këtu nuk mund të ndjekim problematikën e këtyre pjesëzave, se bëjnë pjesë në tipin e tretë të trajtave foljore dhe duhen trajtuar aty.¹¹

5. Problemi i trajtave mohuese të imperativit është jashtëzakonisht i shumëllojshëm dhe nuk mund të trajtohet këtu, se ka të bëjë gjithashtu me "zinxhirin ballkanik". Dua të përmend vetëm paralelitetin e përdorimit të një pjesëze të veçantë (*mos, μη*) në greq. dhe në shq., Edhe këtu gjejmë diferenca areale midis idiomave rumune: kombinimin e pjesëzës (*nu*) kryesisht me infinitivin në dakorumanishte, por me imperativin në idiomat jugore ose "vllahe", siç thotë kolegu Friedman.

6. Trajtat e shkurtëra të përemrave janë edhe këto pjesë të "zinxhirit ballkanik"... kështu që nuk do t'i trajtojmë këtu. Megjithatë duhet të përmendim se vetëm shqipja ka konstrukte si:

Arrestojeni menjëherë dhe dorëzójani gjyqit! ... Lereni muhabetin ... Lerini fjalët! (F. Gjata)

Ky fenomen, infigimi i trajtës së shkurtër të përemrit, na tregon mundësinë e kalimit prej tipit **3** në tipin **1**. Nuk më duket e rastit që është pikërisht shqipja që ka bërë këtë hap drejt morfologjizimit, një rikrijim ky i sintetizimit.

7. Përdorimi i mbaresës së imperativit në folje supletive dhe në kategori jofoljore.

Pra, shqipja ka mundësi mbaresën *-ni* që ta ndajë nga trajta foljore. Ndarja e këtij elementi të përbashkët të indikativit dhe të imperativit pikënisjen e ka sigurisht nga tema e imperativit. Pranimi i kësaj teze lehtëson interpretimin e kësaj mbarrese si marker të përgjithshëm shumësi. Kjo dukuri, njëfarë "crossover", një kalim nga sistemi foljor në kategori të tjera gramatikore, nuk i përket vetëm shqipes, edhe pse, siç do të shohim, shqipja këtë tipar e ka zhvilluar në mënyrë më konsekuente. Kjo dukuri del të paktën në këto pesë kategori:

a) *mos- mosni* ...

Pjesëza mohuese *mos*, e cila në "zinxhirin ballkanik" lidhet p. sh.

¹⁰ Khs. Papahagi (1963:616): *lás*, invar., *lasă*, nu-i nimic; hai: *lás si nă turnă'm* (hai să ne întorcem), ...

¹¹ Me disa aspekte të kësaj problematike jam marrë në Fiedler (1971).

me imperativin, me konjunktivin dhe me optativin, mund të përdoret, ndër të tjera, edhe si zëvendësues i një fjalie prohibitive, dhe në këtë funksion ka edhe shumësin me *-ni*: - *Mos*, bir, se ma këpute shpirtin! (Gjata, Këneta 35); - *Mos*, more! - ia bëri Abdiu dhe u bë dyllë... (Gjata, Këneta 120) *Mosni!* (Fjalor 2002, 807). K. Topalli (2011: 818) trajtën *mosni!* e klasifikon si "pseudourdhërore".

Një dukuri të ngjashme, por për nga origjina krejt të ndryshme gjejmë edhe në slavishen e Jugut: Ballkanosllavishtja preferon *немо(у)*, *немојте* nga bullg. e vj. *НЕ МОЖИ, НЕ МОЖЬТЕ* (folja *МОЖИ* "me mujtë"), (BER 3: 619 v.), po ka edhe *недей, недейте* nga folja *ДЕЛАТИ* "me bâ" e bullg. së vj. (BER 3: 597; 1: 351) të dyja me disa variante dialektore, të cilat ekzistojnë edhe në serbokroatishte. (sh. disa shembuj nga të folmet e Metohisë më lart!).

b) *eja-ejani* ...

Në fjalorët dhe gramatikat e gjuhës shqipe si trajta e imperativit të foljes *vjen* jepet *eja: ejani*, së fundmi Dhrimo-Memushaj (2011: 877). Shembuj si: *Ejani* me mua! (Gjata, Kën. 231) tregojnë se kemi të bëjmë me një trajtë brenda një foljeje supletive. Një dukuri shumë të ngjashme gjejmë edhe në gjuhët e tjera ballkanike. Në shqipen e sotme ekziston një skemë si në rastet e tjera që po trajtojmë: trajta e shumësit përbëhet prej trajtës së njëjësit + mbaresa *-ni*.

Përshkrimet e greq. së re japin si urdhërore të foljes *έρχομαι: έλα - έλατε* (Triantaphylidēs 1938:371); ato të ballkanosllavishtes (khs. BER (1: 488)) përmendin disa trajta të ndryshme: *el'a: el'ame* (lindje), 'ela:'elate, 'яла:'ялате [nga *я ела, я елате*] (perëndim), *el, 'elay: 'елте, 'елайте* (në Бесвина, Леринско). Sipas Mirčev-it trajta njihet që në vitin 1432 te Bullgarët e Transilvanisë.¹² Nga idiomat rumune e kanë aromunishtja dhe meglenishtja, por përsëri jo dakorumanishtja, pra: "*éla*, imperativ sg. [dakorum.] *vino*, "viens", pl. *ilať* [dakoum.] *veniți*, "venez" (Papahagi (1963: 440)). Paralelisht edhe në meglenishte: "*éla... ino ... la-ts* pri minti (vino-ți în minți)... [și *éla...Māmu, el* sã vez tsišta fitșoril'... *éla, āla... el*, plur. *elati, ilati* [për shkak të *-t-së* në vend të *-ț-së* sigurisht huazim brenda paradigme] - Din bg. *ela*, (gr. *έλα* imper. de la *έρχομαι*)" (Capidan (1935: 123)).

¹² Sipas fjalorit etimologjik të bullgarishtes (BER 1: 488) trajtat bullgare si edhe trajtat e të gjitha gjuhëve të tjera ardhkan prej greqishtes: "От нгр. *έλα, έλατε...* заето в срѣб диал. *эла*, алб. *eja, ejani*, арум. *éla*. мн. ч. *ilať*."

Me shikim të parë duket se të gjitha këto trajta vijnë prej trajtave të greqishtes, të cilat sipas Andriotis (1971:94) janë të lashta: "*άρχ. ἔλα, προστ. τοῦ ἐλάωνω* ["shtyj"]. *Ἡ σημερινὴ σημ. μεσθ.*" Kështu duket sikur të kishim një areal të madh në Jug të dakorumanishtes.

Mirëpo Çabej (1996:70 v.) ka treguar se pikërisht shqipja nuk mund të krahasohet drejtërsëdrejti me greqishten dhe me gjuhët sllave të Jugut dhe idiomat "vllahë". Vërtet trajta *eja-ni* mund të shikohet si njëfare qasjeje të mëvonshme drejt gjuhëve fqinje - me mbaresën *-ni* që kishte në dispozicion. Se kjo trajtë nuk është e vjetër; në shqipen e përbashkët trajtat ishin *eja: enni*. Kështu Buzuku ka si nj. *ejã* dhe si sh. *enni* (18:19 dëshmi, khs. Fiedler (2004/ 1: 788)), dhe në arvanitish-te përdoret gjithashtu *éa* (më rrallë edhe *éja*): *éni* (Sasse (1991: 210)). Në këtë vend Çabej hedh poshtë edhe një teori tjetër të disa albanologëve prominentë, sikur kjo trajtë të paskish rrjedhur prej pasthirmës *ala* të turqishtes.¹³ Kështu mbetet si i vetmi shpjegim "krijimi elementar" i një pasthirmë *ei, eia* (khs. në gjuhë të tjera: lat. edhe ital. *eia*, gr. e vj. *εἶα*). Sidoqoftë: çifti gjithshqiptar *e(j)a: enni* tregon se karakteri i veçantë i mbaresës *-ni* si shenjë e vetës së dytë sh. është i lashtë - i kohës paraturke. Kjo mund të jetë me interes për sqarimin e etimologjisë së kësaj mbarese (edhe jashtë imperativit!).

c) *hajde-hajdeni* (*na, aman, bujrum...*) ...

Ndryshe qendron puna në lidhje me konstruktin shq. *hajde-hajde-ni*, i cili rrjedh pa tjetër prej turqishtes *haydi* me një trajtë shumësi *haydi(yi)n* që tipologjikisht u ngjan konstrakteve të gjuhëve indoevropiane ballkanike. Khs. Çabej (1996:345 f.): *hajde* "eja" *haj* "hajde", *hájdeni* "ejani", me mbaresën e vetës së dytë shm. të foljes. Prej turq. *hayde*, që ka shkuar dhe në të tjerat gjuhë të Ballkanit..." Në gjuhën turke hasen edhe trajtat *hayda, háydi*, khs. Baskakov & al. (1977: 395), gjithashtu me trajtën e shumësit *haydi(yi)n*: ~ *çocuklar, gidelim artık! ну ребята, идёмте*¹⁴ *же!* (po aty).

¹³ Mua më duket se ky krahasim bie poshtë jo vetëm për shkak të kohës së mundshme të të huazuarit, të paralelitetit Buzuku:arvanitish-tja, por edhe për hir të semantikës: "**ala** ~ ~ (hey)! *долой! довольно!, хватит!* (при массовом негодовании); ~ ~ **ya kalkmak** *поднять улюлюканье*" (Baskakov & al.(1977: 41)). Për gjuhët e tjera ballkanike shpjegimi prej greqishtes mbetet më i bindshëm, sidomos po të kemi parasysh shënimin "*άρχ...*" te Andriotis (sh. më lart!).

¹⁴ Kjo trajtë e rusishtes është gjithashtu interesante në lidhje me temën tonë, por këtu nuk duam të hyjmë në këtë çështje.

Pa tjetër kemi të bëjmë me një fjalë të turqishtes, se haset edhe në gjuhë të tjera turke larg Ballkanit, p.sh. në gjuhën çuvashe: *хайт* "возглас для понуждения к какому-л. действию" (Sirotkin & al. (1961:478)) ose në vollgatatarishte: *давай[те]... айде, айдегез..* (Ganieva (1984: 121)). Tipari i ekzistencës së një trajte të shumësit në gjuhët indoevropiane të Ballkanit mund të jetë marrë prej turqishtes, por në këtë rast si përkthim, jo si huazim i drejtpërdrejtë si në rastin *baba-baballarë*.

Hajde mund të ketë karakter foljor, të paktën pjesërisht, sidomos kur është pajisur me mbaresën *-ni*. Kështu mund të krahasohet disi me *eja*, që, siç thamë, rregullisht konsiderohet si trajtë supletive foljore: - Më mirë *mos hajde* sot në Maliq. Shko fli, çlodhu dhe *hajde nesër*. (Gjata, Kën. 284). Por ka edhe raste të tjera, thjesht "pasthirmore": *hajde dynja hajde!* (Gjata, Kën. 240); *hajde kokë hajde!* Të rroftë qeleshja që ma ke vënë mbi sy! (Gjata, Kën. 241).

Kjo pasthirmë "gjysmëfoljore" me trajtë shumësie, e huazuar prej një gjuhë turke gjendet edhe në greq. e re: *άντε* (Πλ. *άντεστε, άντέστε*)... *ну!, ну-ка!, давай!* ... ~ *vá páμε давай nouðëm!*; gjithashtu: *άντε, άντέστε* (Chorikov/Malev (1980: 91 dhe 32)). Paralelisht edhe dakorumanishtja ka krijuar trajta shumësi: *háide, haida* ("imprumutënd desinençe verbale de pers. 1 și 2 pl.") *Haidați*, camarazilor ... *haidați ... haidem* [d.m.th. përdoret edhe për v. e 1 sh., e cila sipas gramatikave nuk ka fare trajta imperativi!] *în țară*" dhe shembuj të tjerë në Dictionarul II, 434. Për aromanishten dhe meglenitishten nuk mund të gjej trajta të zgjedhuara të këtyre pasthirmave, që përndryshe ekzistojnë edhe në këto idioma - p.sh arom. *ha ! ha de* "allons" (Papahagi 1963, 540); *há s'iardzimu pânã în Pole "a să mergem pânã la Constantinopole"* (Mihăileanu 1901:227). Për dakorumanishten gjejmë shumë material në fjalorin e Tiktinit (1903:713 v.): *ha de, ~m!, ~t !... ha da, a da, ha t()*. Shembujt e tij tregojnë se trajtat e vetës së 1 dhe të 2 sh. nuk përdoren gjithmonë në mënyre "korrekte", përsa i përket kategorisë së vetës: *Haid, duçeți-mă înapoi* "so kommt und führt mich zurück!"... *Ha deț amîndo* "gehen wir beide"; ... *Haideț să ne logodim!* "wir wollen uns verloben"; *Ia ha deaț de mi-l arată și mie* "So komm und zeig' mir's doch!". Gjithashtu kemi *na ~t, -vă* (*Na-vă* "nehmt!"). Për serbokroatishten khs. Leskien (1914: 552): "Zuweilen werden die Personalendungen des Plurals *-mo, -te* an Adverbia oder Partikeln auffordernden oder anrufenden Sinnes gefügt, wenn der Aufruf an mehrere Personen ergeht, z.B. allgmein *hàjde, h jde* ("auf, vorwärts!") *hajdémo, h jdemo* gehen wir! *hàjdete,*

h jдете geht ihr!; so auch *n (n)* da (hast du!) *n te (n te)* da (habt ihr!); *òvamo* hierher! *òvamo-te* hierher ihr! u.a.d.A." Gjithashtu gjejmë edhe në shqipe: *Hajde të shkoj-më* "Los, lasst uns gehen!", përsëri me shenja të v. së 2 sh. *Hajdeni të këndojmë* "Los, lasst uns singen!, por mbaresa vetore vetëm në v. e 2 sh.: *hajdeni!* "Los, kommt!" - të gjithë shembujt nga Fjalori 1980, f. 641.

Si në gjuhët fqinje edhe në shqipe mund të lidhen disa pasthirmra të tjera me mbaresën *-ni*, p.sh.shqip, me karakter gjysmëfoljeje *na: nani* (informata nga K. Topalli); pasthirmë e vërtetë: *aman: amani: - Amani ore, më thërrisni! Të vi [!] të shoh Tiranën, se vdiqa këtu në Maliq (Gjata, Kën. 212);- Amani, o burra! Amani, o trima! Amani, o kapedanë! Amani, amani* (Mitrushi, Si u takua Ndoni me zallorët, f. 137).

Maqedonishtja, e cila njësoj si toskërishtja gjendet në bërthamën e arealit të konvergencës, ka gjithashtu disa konstrukte të këtij tipi. Te Koneski (1967:416) lexojmë: Оваа наставка во народниот јазик може да се сретне придадена и кај некои други зборови што се употребуваат во обраќање: *Аманте, луѓе! Ајде, збогумте! Ајдете! Бујрумте!* Исто и во овој збор за повикување, заемка од грчкиот јазик: *ела- елате*.

d) *shokëni, motrani ...*

Por ka edhe raste, të cilat, si duket, i përkasin vetëm shqipes.

Në gramatikën tonë (Buchholz/Fiedler (1987: 215)) ne shkruajmë se disa emra në shumës (p.sh. *motrani, shokëni, shoqeni, burrani* (sipas Ardian Klosit edhe *djemani...*) mund të lidhen me formativin foljor *-ni*, dhe përmendim një shembull nga Хоха: - Bre kjo vera ç'më përtërit, *o shokëni*

Shembujt më të hershëm të këtij lloji mund të gjenden te Mitrush Kuteli:

- *o burrani* t'i përvëlojmë me vaj të valë (Hapu, malore! Mbyllu, malore! - Xinxifua, f. 160).

- *Motrani, moj motrani*, ç'më bëtë kështu? (Të tri motrat, f. 173).

- *Mos bijani, mos ...* dhe pak më tutje: Unë jam plak, *bijani*, e vij të bëj qymyr (Babalja, f. 134).

- *O burrani*, t'ua mbushim mendjen të dy palëve që i biri i Nure Gjatolliut të marrë të bijën e Sefedin Gjonomadhit (Gjonomadhë e Gjatollinj, f. 209).

Pastaj kam gjetur mjaft shembuj në romanin Këneta të F. Gjatës: (f.

91): ... po kamionçina nuk u ndez. - Kështu e ka kjo, me naze! Shtyjeni, *o burrani!* - u thirri shoferi. Prapa maqinës u mbështetën duart e Mihalit, të Filloretës [!], të Gjergjit e të Poliksenit [!]. E shtynë me forcë duke rënkuar e duke i dhënë zemër njëri tjetrit. - Jepi! *O burra!*; (f. 290 vv.): -Si shqer-këz kam fjetur! *Shoqeni*, ngreuni! Po na thërresin. ...- Tashi, *shoqeni*, vihuni në radhë! Do të fillojmë, siç e dini, gjmnastikën e mëngjezit... Gati-tu!... Po vihuni në radhë de! *Juve shoqeni*, atje në fund, mos u mbani për dore, se s'ini fëmijë! Lereni muhabetin de! Mbyllni gojën dhe merrni frymë me hundë! Nxirrni kraharorin përpara! Hajde fillojmë!...- Lerini fjalët, *shoqeni!* Duart lart...- *Shoqeni*, dëgjoni! Sot do të vijë një e deleguar... Prandaj hani shpejt mëngjes dhe, *o burrani* [! kemi të bëjmë vetëm me gra!], t'i përvishemi punës... (f. 297): - Ju shkoni në misrit. *Halladitëni*- [??] i tha Hasani duke qeshur me lot; (f. 293): -Forca *shoqeni!* T'ia marrim flamurin rinisë!

Më në fund le të përmend edhe tre shembuj nga Petro Markoja: (Luan Pengili, të cilin e falënderoj bashkë me Ardian Klosin si "ndërmjetës", ka gjetur vetëm këta të tre):

Ultimatumi: ... Saliu ... dëgjoi më lart: "Bjeruni qenve! *O burrani* përmbi ta! ..."

Qyteti i fundit: "Ha-ha-ha! Keni parë ju, *moj motrani!* Atë që ne bëjmë në nevojtoe, kjo e ka mbështjellë në një shami..." Hasta la vista: Një spanjoll thirri: "Ai ka ardhur gjer këtu dhe po vdes për Spanjën tonë, kurse ne po bëjmë sehir nga llogoret! *O burrani*, në sulm!"

e) *mirëmëngjesni!* ...

Trajtën *mirëmëngjesni!* "Guten Morgen allerseits!" si edhe *mire-mbrëmani!* përmend A. Dhrimoja (2005:750). Siç shihet, në toskërishte edhe disa formula përshëndetjeje mund të lidhen me mbaresën *-ni*.

10. Tani, më në fund, kalojmë në një dukuri, të cilën hëpërhë mund ta trajtojmë vetëm për greqishten dhe për ballkanosllavishten, se për meglenitishten, ku mund të priteshin paralele, na mungon materiali i duhur. Në këtë rast nuk ishte imperativi që u ndryshua, por imperativi, siç më duket, dha shkas për sistemimim tipologjik të një grupi të tërë trajtash jashtë sferës preteritale. Pozita karakteristike e imperativit në greqishte dhe në sllavishten e Ballkanit mund të tregohet vetëm, nëse merret në shqyrtim gjithë sistemi i prezentit, i konjunktivit, i futurit dhe i imperativit, d.m.th. sistemi i trajtave jashtë kohëve të së kaluarës. Kemi të bëjmë me mjetet

foljore për të shprehur kategorinë funksionalo-semantike të aspektualitetit - një tipar që nuk u përket të gjitha gjuhëve ballkanike: ekziston një areal me dy "dimensione" të ndryshme të trajtave të imperativit. Ky areal përfshin greqishten, ballkanosllavishten dhe, siç duket, meglendorumanishten. Urdhërorja në të gjitha këto gjuhë sillet si konjunktivi dhe futuri, d.m.th. haset me dy paradigma paralele. Nuk i përgjigjet prezentit të indikativit, në të cilin tendenca shkon drejt përdorimit ekskluziv të trajtës me temë të prezentit resp. të aspektit imperfektiv. Në greqishten e re dhe në bullgarishten standarde ka pak përjashtime (khs. Tzartanos (1944: 300 v.)), Maslov (1981:246 vv.),¹⁵ në disa të folme, p.sh. edhe në gjuhën standarde maqedonase,¹⁶ prezenti i foljeve perfekte përdoret vetëm i kombinuar me pjesëza trajtëformuese, të cilat mund të radhiten në fenomenin më karakteristik brenda grupit foljor në gjuhët e Evropës Jugperëndimore: në "zinxhirin ballkanik" të pjesëzave trajtëformuese.

Sistemi i greqishtes së vjetër për të shprehur kategori semantike 1. të së tashmes, 2. të aspektualitetit perfektiv, 3. të volitivitetit (një dëshirë të lehtë), 4. të së ardhmes dhe 5. të imperativitetit (shprehjen e dëshirës së fortë, të optativitetit, e lëmë mënjane) kishte këto trajta:

¹⁵ Tzartanos (1944:300 f.): *Η ύποτακτική (κανονικά τοῦ ἀορίστου) χρησιμοποιεῖται ἀπλῶ, (ἢτοι χωρὶς τὸ ἄς ἢ τὸ νὰ μπροστά της) με σημασία μελλοντικῆ: 1) κατόπιν ἀπ' τὸ ἐπίρρημα ἴσως .. Ἴσως δὲν ἔρθω αὐριο..... 2) σὲ ζεύγη προτάσεων με ἀντίθετη σημασία, ὅπου ἐκφράζεται ἀδιαφορία γὰρ τὸ τί θὰ γίνη... Ἐρθῆ δὲν ἔρθῆ ὁ Πέτρος, ἐμεῖς θὰ πάμε... çkhs. edhe bullg. Дойдеш, не дойдеш...; për këtë shembull i jam mirënjohës K. Kostovit] ...Χάσω κερδίσω, τὸ ἴδιο εἶναι...*

Khs. gjithashtu, me karakterizimin e mundësive të kombinimit me pjesëza trajtëformuese, te Triantaphyllidēs (1966: 146).

Maslov (1981:246 ff.): "Оно не может употребляться в значении конкретного настоящего, почти не встречается в функции нарративного настоящего при обозначении однократных, разовых действий, не употребляется (за пределами придаточных предложений определенного типа) для обозначения действий, предстоящих в будущем...употребляется..:

1. Как собственно настоящее - в значении повторительного и потенциального настоящего...: *излжеш ли веднж, не т врват втри пт ... Электричество! Натиснеш само едно бутонче и готво!...*

2. Как нарративное настоящее, обычно в значении многократного действия ...:

А ор'елът вс'е се в'иеше. П'лющне дв'аж-тр'иж крил'е, па п'ак ги простр'е неподв'ижни и ч'ерни във в'здуха...

¹⁶ Vgl. Lunt (1952:82); Koneski (1967:412).

1. e tashmja që mund të jetë vetëm joperfektive: prezenti indikativ;
2. funksioni volitiv dhe deliberativ (dëshirë): që shprehet me dy trajta- me konjunktivin e prezentit dhe të ashtuquajturin aorist-konjunktiv; gjithsej kemi gjashtë seri me nga 9 resp. 6 trajta (njëjës, shumës dhe dual);
3. e ardhmja: me një seri të veçantë që nuk është diferencuar për nga aspektualiteti;^{17 18}
4. Imperativitet që shprehet me dy seri: joperfektive dhe perfektive. Atje ku ka opozicion kemi trajta me dy tema të ndryshme, me temën e prezentit dhe atë të aoristit.

Sistemi i bullgarishtes së vjetër për të njëjtat kërkesa funksionale ofronte këto të dhëna: kishte dy radhë foljesh paralele - njëra përbëhej prej foljesh imperfektive, radha tjetër prej foljesh perfektive. Me qenë se çdo folje kishte vetëm nga dy trajta sintetike, paradigma tërësore përfshinte katër seri: për të tashmen kishte prezentin e foljes imperfektive, për të ardhmen prezentin e foljes perfektive. Për funksionin volitiv dhe deliberativ nuk ekzistonin mjete morfologjike ose morfo-sintaksore. Kurse opozicionin perfektiv: joperfektiv bullgarishtja e

¹⁷ Trajta e futurit përdorej me vlerë perfektive dhe imperfektive. Ketë gjë mund ta provojmë p.sh. me krahasime të teksteve greke me përkthime në greqishten e re, por edhe në gjuhën ruse, ku futuri imperfektiv shprehet me foljen ndihmëse буду, будешй...:

J 4 14:

ὁς δ' ἂν πῖη ἐκ τοῦ ὕδατος ὃ δώσω αὐτῷ, οὐ μὴ διψῶσιν εἰς τὸν αἰῶνα, ἀλλὰ τὸ ὕδωρ, ὃ δώσω αὐτῷ, γενῶσται ἐν αὐτῷ πηγὴ ὕδατος ἀλλομένου εἰς ζωὴν αἰώνιον.

-ὅποιος ὁμῶς πίνει ἀπὸ το νερό που θὰ του δώσω ἐγὼ δε θὰ διψάσει ποτέ, ἀλλὰ το νερό που θὲς του δώσω θὰ γίνεи μέσα του μια πηγὴ που θ' ἀναβλύζει νερό ζῶναις αἰώνιας.

-А кто будет пить воду, которую Я дам ему, тот не будет жаждать вовек; но вода, которую Я дам ему, сделается в нем источником воды, текущей в жизнь вечную.

J 4, 21:

Γύναι, πιστευσόν μοι, ὅτι ἔρχεται ὥρα ὅτε οὐτε ἐν τῷ ὄρει τούτῳ οὐτε ἐν Ἱεροσολύμοις προσκυνῶσετε τῷ πατρί.

- πιστεψέ με, γυναίκα, τῆς λέει τότε ὁ Ἰησοῦς, εἶναι κοντά ὁ καιρός που δε θὰ λατρεύετε τον Πατέρα οὔτε σ' αὐτὸ το βουνό οὔτε στα Ἱεροσόλυμα.

- Поверь Мне, что наступает время, когда и не на горе сей, и не в Иерусалиме будете поклоняться Отцу."

¹⁸ Ne bullg. e vjetër e ardhmja joperfektive mund të shprehej vetëm në mënyre leksikore, me folje ndihmëse që pjesërisht vërtet ishin në rrugën e morfologjizimit si *χοῦβτι/χῆβῆτι, имѣти* dhe të tjera (khs. Asenova 2002:204 vv.)

vjetër mund ta shprehte me mjete sintaksore-leksikore pikërisht me imperativin e foljes imperfektiv: perfektiv.

Kështu që në dy gjuhët e vjetra në sferën tërësore të trajtave për të tashmen dhe për të ardhmen imperativi paraqitet më i ngjashëm. Prapëseprapë: Nëse në greqishten e vjetër veta e parë nuk kishte trajta të veçanta - në vend të kësaj përdorej konjunktivi - bullgarishtja e vjetër përkundrazi kishte trajta për vetën e tretë nj., kurse mungonin të tilla për vetën e parë nj. dhe për vetën e tretë sh. (dhe duali): Këtë skemë na ofrojnë gramatikat e Kieckersit, e Triandaphyllidhisit, e Leskienit dhe e Maslovit (pjesërisht si shembuj përdorim folje të tjera, me qëllim që të mund t'i krahasojmë më mirë):

Nga tabela 2 del qartë se në dy gjuhët e lashta paraleliteti i shprehjes së aspektualitetit ekzistonte vetëm në imperativ, ndërsa paraleliteti tipologjik i kësaj shprehjeje në konjunktiv dhe në futur është krijuar më vonë. Duket se pikënisjen e këtij zhvillimi e kemi tamam te imperativi.

Këtë fenomen po e trajtoj këtu për të treguar se koncepti im tipologjik nuk kufizohet me ato tipare që hasen në më shumë se dy gjuhë. Vërtet - faktet e meglenitishtes nuk i njohim sa duhet – teorikisht mund edhe të kemi një "ballkanizëm". Por, a do të na ndihmonte kjo në njohjen e mekanizmit të interferencës? Dukuria e përshkruar këtu paraqet një nga dëshmitë e interferencës në arealin qëndror ballkanik që çfaqen kryesisht midis dy kontinuumëve të gjuhëve ballkanike si edhe sistemi i nyjave atributive (shqip-rumanisht), sistemi admirativ-re-narrativ (shqip-ballkanosllavisht) dhe sistemi i mohimit (shqip-greqisht).

kategori/gjuhë	greq. e vj.	greq. e re	bullg. e vj.	bullg. e re
1.Ind.Prs.	Παιδεύεις παιδεύει παιδεύομεν παιδεύετε	παιδεύεις = -is παιδεύει = -i παιδεύο(υ)με = -ome/ume παιδεύετε = -ete	несеш несеть несемъ несете	носиш (несш) ¹⁹ носи (нес) носим (несм) носите (несме)
2.Konj. ipf.	παιδεύης παιδεύη παιδεύομεν παιδεύητε	να παιδεύης = -is να παιδεύη = -i να παιδεύομε, -ουμε = -ome/-ume να παιδεύετε = -ete		да носиш (да несш) да носи (да нес) да носим (да несм) да носите (да несте)
3.Konj. pf.	παιδεύσης παιδεύση παιδεύσομεν παιδεύσητε	να παιδέψης = -is να παιδέψη = -i να παιδέψομε, -ουμε = -ome/-ume να παιδέψετε = -ete		да нанесш ²⁰ да нанес да нанес да нанесете
4.Fut. ipf.	παιδεύσεις παιδεύσει παιδεύσομεν παιδεύσετε	θα παιδεύης = -is θα παιδεύη = -i θα παιδεύομε, -ουμε = -ome/-ume θα παιδεύετε = -ete		ще носиш (ще несш) ще носи (ще нес) ще носим (ще несм) ще носите (ще несте)
5.Fut. pf.	= Fut. ipf.	θα παιδέψης = -is θα παιδέψη = -i θα παιδέψομε, -ουμε = -ome/-ume θα παιδέψετε = -ete	нанесеши нанесеть нанесемъ нанесете	ще нанесш ще нанес ще нанес ще нанесете
6.Ipv. ipf.	παίδευε παιδεύετω [] παιδεύετε	παίδευε [] [] παιδεύετε	неси неси несѣмъ несѣте	нос (нес) [] [] носте (несте)
7.Ipv. pf.	παίδευσον παιδευσάτω [] παιδέυσατε	παίδεψε [] [] παιδέψτε	нанеси нанеси нанесѣмъ нанесѣте	нанес [] [] нанесте

¹⁹ Trajtat në kllapa, morfologjikisht u përgjigjen trajtave të bullgarishtes së vjetër, janë krahinore.

²⁰ Trajtat e konjunktivit perfektiv në të dy gjuhët mund të ekzistojnë pa pjesëza vetëm në pak raste të veçanta (khs. sh. 15). Tendenca shkon drejt përdorimit ekskluziv me pjesëza që radhiten me konsekuencë të ndryshme në "zinxhirin ballkanik". Kjo nuk mund të trajtohet këtu. Me rëndësi është fakti se disa të folme të sllavishtës ballkanike, duke përfshirë edhe maqedonishten standarde, nuk e njohin fare.

Bibliografi

- Andriotis, N.P. (²1967) = Ανδριώτης, Ν.Π. 'Ετυμολογικό Λεξικό τῆς κοινῆς νεοελληνικῆς θεσσαλονίκης.
- Asenova = Асенова, Петя. (¹1989); (²2002). *Балканско езикознание. Основни проблеми на балканския езиков съюз*. ¹Sofija; ²V. Tarnovo.
- Asenova, P. (1997). Fonctions non-impératives de l'impératif dans les langues balkaniques. In. *LB XXXVIII*, 2. S. 103-110.
- Atanasov, P. (2002). *Meglenoromâna astăzi*. București.
- Barjaktarević, D. (1979). = Барјактаревић, Д.П. *Говор Срба у Метохији*. Приштина.
- Baskakov, A. N. & al. (1977) = А. Н. Баскаков & al. *Турецко-русский словарь*. Москва.
- BER (1962-) = *Български етимологичен речник*. София.
- Beyrer, A. & al. (1987). *Grammatik der rumänischen Sprache der Gegenwart*. Leipzig.
- Buchholz, O./Fiedler, W. (1987). *Albanische Grammatik*. Leipzig.
- Çabej, E. *Studime etimologjike në fushë të shqipes*, Tiranë, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë. Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, vol. I (1982), vol. II (1978), vol. III (1987), vol. IV (1996), vol. VI (2002), vol. VII (2006).
- Capidan, Th. (1925-1935). *Meglenoromânii. III. Dicționar meglenoromân*. București.
- Chorikov/Malev (1980) = И.П. Хориков/ М.Г. Малев. *Новогреческо-русский словарь*. Москва.
- Dhrimo, A. (2005). *Fjalor Shqip-Gjermanisht. Albanisch-deutsches Wörterbuch*. Tiranë.
- Dhrimo, A. & R. Memushaj (2011). *Fjalor drejtshkrimor i gjuhës shqipe*. Tiranë.
- Dicționarul (1955-1957) = Academia Republicii Populare Romine. *Dicționarul limbii romine literare contemporare. Vol. I-IV*. București.
- Fiedler, W. (1971). Zur Verbreitung eines grammatischen Morphemtyps. Südslawisch *neka, nek* und typolo-gisch Ver-wandtes. In: *ZfSl* 16, S. 58-67.
- Fiedler, W. (1992). Ist das Albanische, "dem Typus nach", die entscheidende Sprache des ganzen balkani-schen Gebietes? In: *Albanica* 3-4. Winter 1992. Washington, DC, S. 78-95.
- Fiedler, W. (2004/1). *Das albanische Verbalsystem in der Sprache des Gjon Buzuku (1555)*. Prishtina.
- Fiedler, W. (2004/2). Der südosteuropäische Typus des grammatischen Analytismus - die "balkanische Partikelkonstruktion" im Verbalsystem. In: *Die europäischen Sprachen auf dem Wege zum analytischen Sprachtyp*. Hrsg. v. Uwe Hinrichs unter Mitarbeit von Uwe Büttner = Eurolinguistische Arbeiten. Hrsg. Uwe Hinrichs. Bd.1. Wiesbaden. S. 363-398.
- Fjalor (1980) = *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*. Tiranë.
- Fjalor (2002) = *Fjalor i shqipes së sotme*. Tiranë.
- Ganieva, F.A. (1984) = Ф. А. Ганиева. *Русско-татарский словарь*. Москва.
- Kieckers, E. (1926). *Historische griechische Grammatik. II. Formenlehre*. Berlin/Leipzig.
- Koneski, B. (1967) = Б. Конески. *Граматика на македонскиот литературен јазик. Дел I и II*. Скопје.
- Leskien, A. (1914). *Grammatik der serbo-kroatischen Sprache*. Heidelberg.
- Lunt, H. (1952). *A Grammar of the Macedonian Literary Language*. Скопје.
- Maslov (1981) = Ю.С.Маслов: *Граматика болгарского языка*. Москва.
- Mihăileanu, S. (1901). *Dicționar macedo-român*. Bucuresci.
- Mirčev (²1963). = К. Мирчев, *Историческа граматика на българския език*. Sofija.
- Moser-Philtsou, M. ⁴1966. *Lehrbuch der neugriechischen Volkssprache*. Leipzig.

- Papahagi, T. (1963). *Dictionarul dialectului aromân. General și etimologic*. București.
- Sasse, H. J. (1991). *Arvanitika. Die albanischen Sprachreste in Griechenland. I*. Wiesbaden.
- Sirotkin, M. Ja. & al. (1961) = Сироткин, М. Я. (ред.) Чувашско-русский словарь. Москва.
- Stojanov u.a. (1983) = Ст. Стоянов (гл. ред.): *Граматика на съвременния български книжовен език. Том II. Морфология*. София.
- Thumb, A. (1964). *A Handbook of the Modern Greek Language*. Chicago.
- Triantaphyllidēs, M. (1938) = Τριανταφυλλίδης, Μ.Α. *Νεοελληνικὴ γραμματικὴ. Πρῶτος τόμος. Ἱστορικὴ εἰσαγωγὴ*. Ἀθῆναι.
- Tzartanos, A. (1963) = Α.Τζάρτζανος, *Νεοελληνικὴ σύνταξις (τῆς κοινῆς δημοτικῆς)*. Β' Ἀθῆναι.

Victor A. FRIEDMAN, Universiteti i Chicagos

URDHËRORJA TREGUESE NË GJUHËT BALLKANIKE

Abstrakt

Përdorimi i mënyrës urdhërore në tregim është karakteristik për gjuhën shqipe si edhe për gjuhët sllave. Megjithatë, përdorimi shqip dhe sllavo-ballkanik shkon së bashku dhe përdorimi në gjuhët sllave joballkanike është tjetër. Këtë përdorim e kanë edhe gjuhë të tjera në Ballkan, por jo të gjitha. Në fund, mund të themi se udhërorja treguese është një ballkanizëm që deri tani nuk është vështruar.

Në veprën e saj *Gjuhësi ballkanike*, Petja Asenova (2002:191-195) diskuton një përdorim të mënyrës lidhore në kohën e tashme (d.m.th. *da, të, së/si/s', na* + formën e përshtatshme të së tashmes) për tregime të shkurtra në kohën e shkuar, që ajo e përshkruan si “konstrukt dëshirore-urdhërore me vlerë të së shkuarës” (193). Dy shembuj shqip me përkthimin bullgar mjaftojnë si sqarim:

(1) *Të kthehet në mes të natës i pirë, të ngrëjë më këmbë shtëpinë dhe të na bëjë turp për botën!*

Da se vërne posred nosht pijan, da vdigne kështata na krak i da ni napravi na smjah na horata! (Asenova 2002:193)

(2) *Të rrish një orë në rradhe dhe të mos marrësh bukë! Da sedish edin ças na opashka i da ne vzemesh hljab!* (Asenova 2002:193)

Shembujt në greqishte dhe rumanishte janë të njëjtë. Asenova shkruan se ky përdorim është bisedor apo folklorik (d.m.th. dialektor) dhe në gjuhën letrare ka një kuptim emocional. Dzardanos (1939: 188) shkruan se një përdorim i tillë në greqishte vërehet nga shekulli XIV e më tej dhe kërkon shpjegimin në të ashtuquajturën paskajore historike të latinishtes. Një përdorim i tillë i paskajores shihet në frëngjishte dhe gjermanishte. Asenova bën një krahasim me përdorimin e tillë të urdhërores sintetike (dmth. urdhërorja *sensu stricto*) për tregimet në gjuhët sllave në përgjithësi, por shkruan se ky përdorim nuk ekziston në gjuhët e tjera ballkanike. Mirëpo, megjithëse urdhërorja

treguese nuk ekziston as në greqishte as në të folmen vllahe në Greqi, ndeshet jo vetëm në të folmen vllahe në Maqedoni, por edhe në rumanishte, turqishte, romishte (në Ballkan) dhe shqipe. Përveç kësaj, përhapja në ballkanosllavishte dhe ish-serbo-kroatishte sugjeron që kemi të bëjmë me një ballkanizëm të painedentifikuar deri tani. Në këtë kumtesë do të sjell argumente për këtë pikëpamje.

Në maqedonishte, urdhërorja treguese perfektive mund të përdoret në qoftë se ngjarja është e mbaruar dhe përsëritëse, siç shihet në shembujt (3) dhe (4)

(3) *Tetin Nomče beše orač. Eden vol kupi, drug pçovisaj. Cel život toa raboteše.* (Hacking 1997: 215)

Dajë Nomçe ishte lëvrues. Një dem blej, tjetri ngordh. Tërë jetën punonte kështu.

(4) *Se vračavme pijani: toj padni, jas stani, jas padni, toj stani* (krah. Koneski 1967: 418)

U kthym të pirë: ai bjer, unë çohu, unë bjer, ai çohu.

Edhe urdhërorja imperfektive mund të përdoret në maqedonishte në qoftë se ngjarjet janë përsëritur dhe të përfunduara, apo ka një vlerë të përgjithshme si në shembujt (5) e (6):

(5) *Teraj, teraj, napinaj, napinaj - ne biduva, ne biduva - ostana kolata v kal* (Koneski 1967: 418)

Grah, grah, tërheq, tërheq - s'ndodhet, s'nodhet - u mbet qerrja në baltë.

(6) *Starite naveduj se, mladite rasti, taka vrvi vekov.* (Koneski 1967: 418)

Të pleqtë përkulu, të rinjtë rritu, ashtu kalon kjo dynja.

Për bulgarishten, kemi shembuj të ngjashëm me ata që kemi në maqedonishte në gramatikën e Teodorov-Balanit të vitit (1940: 195), mirëpo, nuk kemi shembuj të tillë në asnjë gramatikë normative bullgare pas Luftës II Botërore. Në studimin e Nicollovës (Nicolova 1974), të gjithë shembujt janë nga studimet dialektore. Sot folësit bullgarë të shkolluar me të cilët e kam diskutuar këtë dukuri më kanë thënë se për ta ky përdorim është i stilizuar, dialektor dhe arkaik. Përveç kësaj, bile në literaturën e shekullit XIX dhe të fillimit të XX përdorimi i urdhërores treguese kishte për qëllim të krijonte një efekt të të folurit fshatar. Domethënë se duket që një përdorim i tillë nuk është miratuar nga intelektualët nga Bullgaria lindore, dialekti i të cilëve ishte

themeli i bullgarishtes letrare.

7Për ish-serbo-kroatishen Stevanović (1986: 708-709), i cili përshkroi variantin lindor, citon shumë shembuj nga shkrimtarët e shekullit XIX prej gjithë truallit të serbo-kroatishes, nga Njegoš në Malin e Zi jugor deri te Kovačić nga Oplaznik të Kroacisë në kufi me Slloveninë, mirëpo edhe thekson se përdorimi është veçanërisht karakteristik në Malin e Zi. Maretić (1963: 625), duke shkruar për variantin perëndimor, thekson se s'ka asnjë shembull në përkthimet e Biblës as të Vukut as të Daničićit, dhe se shembujt e tillë janë shumë të rrallë në shkrimet e Vukut. Pastaj, Maretić (1963: 626) shkruan se përdorimi është “shumë i shpeshtë në të folmet e jugut, por është dialektizëm.” Shembujt janë edhe perfektivë edhe imperfektivë. Prej kësaj është e qartë se, madje para shpërbërjes së ish-serbo-kroatishes, urdhërorja treguese ishte identifikuar si më tepër “serbishte” sesa “kroatishte” dhe se përdorimi u pa si tipik mu për dialektet më të afërta me ballkano-sllavishten.

Në sllavishten lindore, urdhërorja perfektive përdoret për ngjarjet e papitura në të shkuarën (Vinogradov 1972: 434–437). Përdorimi në sllavishten lindore ndryshon nga përdorimi në sllavishten jugore nga dy anë të rëndësishme: përdorimi i sllavishtes lindore është semelfaktiv dhe jo iterativ dhe është i kufizuar në aspektin perfektiv.

Në sllavishten perëndimore, ndërtimi ndeshet vetëm në disa shprehje në gjuhën çeke, ndërsa në gjuhën sllovaqe shihet si një sllavizëm lindor jashtë shprehjesh të tilla. Në polonishte pothuajse nuk ekziston (Nicolova 1974). Vinogradov bën vërejtje për sugjerimin që përdorimi rusisht vjen nga një interpretim i ri i së kryerës së thjeshtë (veta e 2/3), që në disa zgjedhime është njëlloj me urdhëroren njëjës. Mirëpo, ky interpretim nuk është i mudshëm për sllavishten jugore, sepse e kryera e thjeshtë është e gjallë atje. Dhe, për më tepër, e kryera e thjeshtë është më e gjallë pikërisht në jug në truallin e sllavishtes jugore ku edhe urdhërorja treguese është më e përdorur. Përveç kësaj, që të dyja përkasin vetëm në një klasë shumë të kufizuar dhe joproductive. Koneski (1967: 420) sugjeron që urdhërorja treguese në maqedonishte vjen nga e tashmja perfektive (veta e tretë), që shpesh herë nuk ndryshon nga e kryera e thjeshtë (veta 2/3) dhe që nuk ndeshet vetëm në maqedonishte. Mirëpo, duke pasur parasysh se urdhërorja treguese del edhe në ish-serbo-kroatishte dhe në bullgarishte, ku nde-

shet edhe perfektivi i pavarur i së tashmes, ky shpjegim duket i dyshimtë.

Ndoshta për shkakun se ndërtimi është i gjuhës së folur dhe nuk del në greqishte, nuk është dëshmuar në sllavishten e vjetër. Megjithëse ndryshimi aspektual midis përdorimeve të sllavishtes lindore dhe të sllavishtes jugore mund ta arsyetojë shpjegimin që thotë se janë zhvillime të pavarura, është po ashtu e mundshme që urdhërorja treguese të ketë qenë një dukuri gojore e sllavishtes së përbashkët dhe të jetë zhvilluar ndryshe në sllavishten lindore dhe në sllavishten jugore. Do të kthehem në këtë pikë pastaj.

Për gjuhën shqipe, Buchholz dhe Fiedler (1987: 150) japin disa shembuj:

(7) *Po vajta, se s' kisha ç' të bëja, vajta këmbadoras, aty ngeu, aty rrëxohu* (H. Petrela).

Në turqishte kemi të njëjtën urdhërore treguese si në maqedonishte ose shqipe. Shembujt (8) dhe (9) janë përkthime të shembujve (3) e (4) në turqishten letraren dhe në të folmen e Gostivarit:

(8) a. *Nomçe enişte çifçiydi: bir öküz al, diğeri geber.*

b. *Nomçe inişte idi çifçi: al bir ukuz, übürisi geber*

(9) a. *Sarhoş dönüyorduk: o düş, ben kalk, ben düş, o kalk.*

b. *Sarvoş dinerdik: o düş, ben kolk, ben düş, o kolk.*

Shembulli (10) e përkthen shembulli (2), por me dy variante, i pari (10a) është me urdhërore treguese derisa i dyti është me paskajore, që ka një lidhje kuptimore me përdorimin e lidhores derisa lidhorja është e lidhur me paskajoren (shih Asenova 2002: 194):

(10) a. *Bir saat kuyruk bekle, ekmek alma! =*

b. *Bir saat kuyruk bekleye, ekmek almamak, olur mu?!*

Në turqishten letrare, në shembullin (8), është parapëlqyer një ndërtim përcjellor *-düşe kalka -*, por megjithatë edhe ligjërata me urdhërore mund të përdoret.

Edhe në romishte ka mundësi për përdorimin e urdhërores treguese. Shembulli (11) e përkthen shembullin (4) në të folmen arli të Shkupit:

(11) *Irinaja sine amen mate: ov per, me ušti, me per, ov ušti*

Është me interes të thuhet se s'kemi përdorime të tilla në dialektet rome jashtë Ballkanit, as në Greqi, por i kemi në Turqi, në Kosovë, dhe në Serbi (Matras 1994, Cech & Heinschink 1999: 195).

Në rumanishte, urdhërorja treguese është karakteristike për Vllahi dhe Moldavi dhe ka një ndjenjë dialektore apo arkaike. Shembulli (12), në Graur (1966: 223), është nga shkrimtari B. Delavrancea nga shekulli XIX në Vllahi

(12) *Cartea e deschise la foia 80; și eu trage-i tare și delușit...*

Libri u hap në faqen 80; dhe unë lexo[ja] me zë të lartë e qartë

Edhe shembujt në Dumitru (1976: 126) janë nga shekulli XIX nga Vllahia dhe Moldavia. Sa për vllahishten (arumanishten), dialektet e Maqedonisë, dmth. ato që janë më tepër në kontakt me maqedonishten, e kanë urdhëroren treguese, ndërsa dialektet e Greqisë, që janë shumë të ndikuara nga greqishtja, nuk e kanë këtë përdorim. Shembulli (13) bazohet në (4) dhe shembulli (14) në megleno-rumanishte:

(13) *Nă turnăm beac, kaz-skoala-ti*

(14) *Toata ziuă manka, manka, nu si dumanka* 'Tërë ditën ha, ha, nuk ngopet.'

Duke pasur parasysh të gjitha këto të dhëna, mund të themi se urdhërorja treguese paraqitet si një ballkanizëm deri tani i paidentifikuar. Por duhet të pyesim, a kemi të bëjmë me një dukuri të shkaktuar nga kontakti apo jo? Megjithëse s'kemi mjaft të dhëna tekstore historike, përhapja në gjuhët romane, sllave dhe dialektet rome së bashku me përdorimet shqip dhe turqisht sugjeron se duhet të kemi të bëjmë me një dukuri areale që tani është më e gjallë pikërisht në qendër të zhvillimeve gjuhësore ballkanike.

Bibliografi

- Asenova, P. 2002. *Balkansko ezikoznanie*. Sofia: Faber.
- Buchholz, Oda and Wilfried Fiedler. 1987. *Albanische grammatik*. Leipzig: Encyclopädie Verlag.
- Cech, P. & Heinschink, M. 1999. *Sepečides–Romani. Grammatik, Texte und Glossar eines türkischen Romani–Dialekts*. Weisbaden: Harrassowitz.
- Graur, A. et al. 1966. *Gramatica limbii române I*. Bucharest: Academia Republicii socialiste România.
- Hacking, Jane 1997. Reconciling the exhortative and non-exhortative uses in the Macedonian imperative. *Balkanistica* 10.212-20.
- Koneski, B. 1967. *Gramatika na Makedonskiot literaturnen jazik*. Skopje: Kultura.
- Irimia, Dumitru. 1976. *Structura gramaticală a limbii române: Verbul*. Iași: Junimea.
- Maretić, T. 1963. *Gramatika hrvatskoga ili srpskoga jezika*. Zagreb: Matica Hrvatska.
- Nicolova, Ruselina. 1974. Kām vāprosa na imperativa v bālgarski i drugite slavjanski ezici. *Bālgarski ezik* 6.514-22.
- Stevanović, M. 1986. *Savremeni srpskohrvatski jezik I*. Beograd: Naučna Kniga.
- Teodorov–Balan, A. 1940. *Nova bālgarska gramatika*. Sofia: Čipev.
- Tzartanos, A. A. 1939. Mia idiorythmē khrysis tēs ypotaktikēs. *Arthra kai meletēmata: Prologos, sēmeiōseis, epimeleia Násou A. Tzartzánou*. Athēna: Kakoulide.
- Vinogradov, V. V. 1972. *Russkij jazyk*. Moskva: Vysšaja škola.

Shaban DEMIRAJ, Tiranë

Ç`DËSHMON MËNJANIMI I PASKAJORES NË GJUHËT BALLKANIKE?

Abstrakt

Pas një diskutimi të hollësishëm nga shumë aspekte, autori i kumtesës arrin këtë përfundim më të përgjithshëm: “Nga sa u shtjellua këtu më sipër, del pak a shumë e qartë se çështja e zhdukjes së paskajores në gjuhët e Ballkanit mbetet e hapur. Ka shumë të ngjarë që kjo dukuri të ketë një burim të përbashkët, por s’është e domosdoshme që ky burim për të gjitha gjuhët, ku ajo është shfaqur, të kërkohet patjetër te ndikimi i supozuar i greqishtes apo i ndonjë gjuhe tjetër. Në të tilla rrethana, më duket më e arsyeshme të pranohet që këtu kemi të bëjmë, në thelb, me një nga pasojat më të dukshme të një prirjeje të vjetër të gjuhëve të Ballkanit për një qartësim sa më të madh të kumtimit gojor, duke shfrytëzuar për këtë qëllim edhe përdorimin ridondant të mjeteve gjuhësore. Përdorimi i formave vetore të lidhores në vend të formës së pashtjelluar të paskajores, që nuk e dallon vetën e atij që kryen (apo të atyre që kryejnë) veprimin e shprehur nga kjo formë foljore do të ketë qenë një nga pasojat e kësaj prirjeje. Natyrisht, këtu është fjala për faktorin zanafillës, që ka bërë të mundur shfaqjen dhe përhapjen e kësaj dukurie në gjuhët e Ballkanit. Por, nga ana tjetër, nuk ka si të përjashtohet mundësia e një ndikimi të ndërsjellë apo e ndikimit të kësaj ose të asaj gjuhe në përhapjen e mëtejshme të kësaj dukurie në Ballkanet. Veçse ky ndikim duhet të jetë shfaqur nëpërmjet të folmeve popullore në fqinjësi midis tyre e sidomos të trevave kufitare, ku njerëzit, krahas gjuhës amtare, kishin mundësi të mësonin e të flisnin edhe një gjuhë të dytë gjatë kontakteve me popullsinë aloglote. Në përhapjen e kësaj dukurie nga një gjuhë në një tjetër një rol të rëndësishëm duhet të kenë luajtur edhe rastet, kur një popullsi e caktuar, në gjuhën e së cilës mbizotëronin ndërtimet me paskajoren, për një arsye a për një tjetër, është ndikuar nga një gjuhë tjetër, ku mbizotëronin ndërtimet me lidhoren. Pra, siç u vu në dukje edhe pak më sipër, në ndonjë rast nuk duhet përjashtuar edhe ndikimi i jashtëm, kur rrethanat gjeografike-historike i kanë dhënë mundësi një ndikimi të tillë. Pas gjithë gjasash, një ndikim i tillë mund të supozohet sidomos për maqedonishten perëndimore, ku janë shfaqur edhe dukuri të tjera, që e dallojnë atë nga gjuhët e tjera sllave, duke përfshirë edhe bullgarishten. Mjafton të përmendim; sa për shembull, faktin që në maqedonishten standarde; ndryshe nga gjuhët sllave në përgjithësi (shih për këto Andersen: 1994, 476v.), fjalia (a më saktë fraza) mund të fillojë edhe me një fjalëz të patheksuar: E në këtë rast ndikimi i jashtëm nuk mund të mohohet. Pra, maqedonishtja perëndimore (dhe si rrjedhim edhe maqedonishtja standarde) në këtë rast (dhe jo vetëm në këtë rast) është larguar

nga tipi i gjuhëve sllave, në të cilat, me sa duket, është ruajtur një tipar i hershëm i gjuhëve indo-europiane për të mos e filluar frazën me një fjalëz të patheksuar (ligji i Wackernagel-it):

Në mbyllje të kësaj kumtese më duhet të pohoj se çështja e mënjanimit të paskajores nëpërmjet formave vetore të lidhores në gjuhët ballkanike kërkon hulumtime të mëtejshme më të plota.”

Siç dihet, një varg gjuhëtarësh, sidomos pas botimit të veprës së mirënjohur të Sandfeldit të vitit 1930, i kanë kushtuar një vëmendje të posaçme kësaj dukurie, që është shfaqur, ku më herët e ku më vonë, në të gjitha gjuhët e Ballkanit, duke përfshirë edhe serbishten jugore. Pra, nga shtrirja e saj gjeografike mënjanimi i paskajores është shfaqur në më shumë gjuhë të Ballkanit se prapavendosja e nyjës shquese, e cila në greqishte del e paravendosur. Këtu nuk do të merrem me mendimet e gjuhëtarëve të ndryshëm mbi burimin apo mbi mënyrën e përhapjes së kësaj dukurie në gjuhët ballkanike, që i kam parashtruar në punime të mëparshme, aq më tepër sepse tema e kësaj kumtese synon të hedhë sadopak dritë për pyetjen: Ç`dëshmon mënjanimi i paskajores në gjuhët ballkanike? Natyrisht, sqarimi i kësaj pyetjeje kërkon që të thuhet paraprakisht nja dy fjalë mbi vetë kategorinë e paskajores në gjuhët indoeuropiane. Gjatë shtjellimit të kumtesës nuk mund të lihet pa prekur edhe çështja e paskajores në gjuhën shqipe.

Në përgjithësi, ata që janë marrë me indoeuropianistikë, kanë vënë në dukje se paskajorja në gjuhët indoeuropiane është zhvilluar paralelisht në këto gjuhë qysh në periudha të hershme nëpërmjet verbalizimit të një emri foljor. Pra, nuk kemi të bëjmë me një kategori të trashëguar, siç është rasti i pjesores së shkuar. Mjafton të kihet parasysh se kjo e fundit në gjuhë të ndryshme i.e. shfaqet me formante të ngjashme të një burimi të përbashkët, kurse paskajorja në degë të ndryshme të gjuhëve i.e. shfaqet me formante të ndryshme. Mjafton të përmendim, sa për shembull, formantet e ndërtimit të paskajores në greqishte të vjetër, në latinishte, në gjuhët sllave dhe në gjuhët gjermanike. Gjithsesi, paskajorja pas integritetit të saj në sistemin foljor ka marrë disa kategori gramatikore karakteristike të foljes, siç janë kundërvëniet diatezore, aspekte dhe kohore. Por si një formë e pashtjelluar foljore ajo, në përgjithësi, nuk ka zhvilluar kategoritë gramatikore të vetës dhe të numrit.

Në gjuhët ballkanike paskajorja si kategori foljore sintetike (me forma të ndryshme nga pjesorja e shkuar), siç dihet, dëshmohet në greqishte të vjetër, në rumanishte dhe në gjuhët sllave, Vlen të shënohet se paskajorja, në raport me foljen drejtuese mund të përdoret në të gjitha funksionet sintaksore; duke përfshirë edhe ato të kryefjalës e të kundrinës. Vlen të theksohet gjithashtu se përdorimi i paskajores ndeshet sidomos pas foljeve modale, kur kryefjala e saj e shprehur ose e nënkuptuar është e njëjtë me atë të foljes modale. Do pasur parasysh gjithashtu se në të gjitha gjuhët e tjera ballkanike, paskajorja e dëshmuar del formalisht ndryshe nga pjesorja si për nga formantet përbërëse ashtu edhe për nga kuptimi, si kur përdoret me vlerë foljore, ashtu edhe kur emërzohet. Kurse në gjuhën shqipe pjesorja e emërzuar me nyjën e përparme të gjinisë asnjënjëse (ose edhe të gjinisë femërore) del me kuptim vepror, ndërsa pjesorja e mbiemërzuar me nyjën e përparme të gjinisë mashkullore ose femërore del me kuptim pësor. P.sh. të krahasohen: *të ngrënë-t* tepër dëmton shëndetin ~ *buka* e ngrënë etj.

Do pasur parasysh gjithashtu se mënjanimi i paskajores në gjuhët ballkanike është kryer nëpërmjet së njëjtës rrugë dhe pikërisht nëpërmjet zëvendësimit të saj me forma vetore të mënyrës lidhore (përkatësisht dëftore në gjuhët sllave) të prira nga një pjesëz. E një zëvendësim i tillë, siç dihet, nuk është kryer në të njëjtën kohë në të gjitha gjuhët ballkanike. Një dukuri e tillë për greqishten dëshmohet qysh në shekullin e dytë të erës së re (Shih Sandfeld: 1930, 177), kurse në bullgarishte ajo është shfaqur pas shekullit IX, sepse në shkrimet e Qirilit e të Metodit nuk shfaqet. Edhe në rumanishte (kryesisht në të folmet jugore të saj) kjo dukuri është shfaqur pas pajisjes së lidhores me pjesëzën *să* (me origjinë lidhëzore), d.m.th. pas shekullit X të erës sonë (shih Ivănescu: 1980, 343, 416). Në përgjithësi, është pohuar që mënjanimi i paskajores ka qenë më i madh në dialektet dhe të folmet rumune më jugore, sidomos në aromunishte, meglenishte dhe në dakorumanishten jugore. Kurse në istro-rumanishte paskajorja është ruajtur Edhe në të folmet veriore dhe perëndimore të dakorumanishtes paskajorja nuk është mënjanuar fort nga përdorimi. Vlen të shënohet se në dakorumanishte paskajorja është ruajtur ende në disa tipa ndërtime, si p.sh. pas foljeve modale *a putea* “mund”, *a vrea* “dua” (shih Sandfeld: 1930, 184, Ivănescu: 1980, 414).

Për sa i takon gjuhës shqipe, këtu çështja në shqyrtim paraqitet

shumë e vështirë për t'ua ndriçuar. Përveç faktit që në këtë gjuhë nuk dëshmohet gjëkund një paskajore sintetike me formante të ndryshme nga pjesorja, qysh para Buzukut në dialektin verior është përdorur forma perifrastike e tipit *me punue(m)* me vlerë paskajoreje. Mendimi i disa gjuhëtarëve që kjo formë perifrastike ka qenë e mbarë shqipes, d.m.th. ka ekzistuar edhe në dialektin jugor, nuk është argumentuar bindshëm. Gjithashtu mbetet e paqartë edhe rruga e formimit të saj. Gjithsesi, pavarësisht nga vështirësitë e pakapëryera mbi rrugën e formimit të paskajores së tipit *me punue(m)*, prania e saj e hershme, qoftë edhe vetëm në dialektin verior, dëshmon qartë se përdorimi i paskajores nuk ka qenë i pazakonshëm ndër stërgjyshërit e shqiptarëve edhe në një kohë, kur në gjuhët e tjera ballkanike kishte nisur procesi i zëvendësimit të kësaj forme të pashtjelluar nga format vetore të lidhore. Për më tepër, në periudhën pas shekullit të Buzukut në mbarë shqipen ka ardhur duke u përdorur me vlerë paskajoreje (por me funksione sintaksore më të kufizuara) forma e tipit *për të punuar /për të punue*; e ndërtuar nga emri prejfoljor i gjinisë asnjane, i prirë nga parafjala *për*. Megjithatë, edhe në gjuhën shqipe bie në sy përdorimi gjithnjë e më i dendur i formave të mënyrës lidhore edhe në ato raste, kur zakonisht pritej përdorimi i paskajores. Një dukuri e tillë është më e përhapur në të folmet jugore, por është shfaqur edhe në dialektin verior e për këtë na dëshmojnë, ndër të tjera, jo vetëm e e ardhmja e tipit *do ta ble*, që regjistroi Arnold von Harff-i në Durrës më 1497, por edhe përdorimi i saj në veprat e autorëve të vjetër veriorë. Sipas Mansakut (1973, 149v.), Buzuku në veprën e tij “në rreth 43 ndërtime me foljen modale *duhet* ka përdorur 32 herë paskajoren, 11 herë lidhoren dhe vetëm një herë pjesoren”. Edhe pas foljes modale *mund*, sipas Mansakut (1973, 141) kjo folje modale të Buzuku është përdorur rreth 226 herë, e ndjekur 188 herë nga lidhorja dhe 38 herë nga paskajorja. Por unë këtu do të ndalem vetëm në nja dy raste përdorimi të lidhore pas foljeve modale *duhet* dhe *mund* në Fjalorin e Frang Bardhit prej Zadrimë. Në faqen 209 të atij Fjalori gjejmë shprehjen: *Gjithëkush duhetë të mbae pajë mjeshtrij-së vet*, që i përgjigjet shprehjes latine Quilibet *de sua, & non de aliorum professione loqui debet*. Te Bardhi kjo dukuri shfaqet edhe pas foljes modale *mund*. Kështu në parathënien e Fjalorit të tij gjejmë: *e s dijnë gjuhënë latine, paa të sijet askush s munë shërbenjë ...* Kjo dukuri del edhe në faqen 161 të atij Fjalori, atje ku ai shpjegon fjalën latine *stypticus*, të cilën në mungesë të një fjale të shqipes e shpjegon: *Ai qi s'unë dalë për vetëhe*. Siç shihet, në të dy

rastet te rrokja fundore *-në* e foljes modale është “shkrirë” edhe pjesëza e lidhore *të*. Madje, trajta *s’ unë* del edhe pa tingullin nistor *m-* e një dukuri e tillë, që ndeshet edhe sot në ndërtime të këtij tipi gjatë të folurit të shpejtë ndër folësit veriorë, me sa duket është relativisht e vjetër. E për këtë dëshmojnë edhe trajtat *s und* e Jul Varibobës dhe *s-ëndë* e De Radës etj. (shih Demiraj: 1986, 871). Gjithsesi, te Bardhi pas foljes modale *munë* apo *un-ë* (= *mund të*) është përdorur lidhorja me të njëjtën kryefjalë si folja modale. E po të kemi parasysh se në këtë rast Bardhi ka pasqyruar me siguri një përdorim të së folmes popullore të kohës së tij, atëherë nuk është vështirë të nxirret përfundimi që përdorimi i lidhore pas foljes modale *mund* nuk ishte i pazakonshëm në të folmet veriore, sidomos kur të dyja foljet i referoheshin së njëjtës kryefjalë. Por do pasur parasysh se në f. 147 të atij Fjalori (sipas botimit të Mario Roques të vitit 1932) pas kësaj foljeje modale në vetën e parë njëjës Bardhi ka përdorur paskajoren: *Maa s’po mundinjt me duruam* (latinisht *sedenim durare nequeo*).

Shembujt e mësipërm dëshmojnë qartë se edhe në të folmet veriore është shfaqur prej kohësh dukuria e zëvendësimit të paskajores nga forma të lidhore, që shënjonin edhe vetën edhe numrin e vepruesit. E një përdorim gjithnjë e më i dendur i formave vetore të lidhore do t’i ketë dhënë shkas mënjanimit gradual të formës së pashtjelluar të paskajores në të folmet jugore, në rast se edhe ato e kanë pasur dikur paskajoren e dokumentuar të gegërishtes. Ka shumë të ngjarë që një zëvendësim i tillë i paskajores nga format vetore të lidhore në krye të herës të jetë vërtetuar në ato raste kur paskajorja i referohej një kryefjale të ndryshme nga ajo e foljes drejtuese, por me kalimin e kohës mënjanimi i paskajores nëpërmjet përdorimit të formave vetore të lidhore do të ketë ardhur duke u përgjithësuar. Pas gjithë gjasash, këtë rrugë ka ndjekur mënjanimi i paskajores nga format vetore të lidhore edhe në gjuhët e tjera ballkanike në përgjithësi. Mirëpo a ka ndodhur kjo dukuri në të gjitha gjuhët ballkanike në mënyrë të pavarur, apo në ndonjë a në disa nga gjuhët e Ballkanit kjo dukuri është shfaqur nën ndikimin e një gjuhe tjetër, kjo mbetet ende për t’u hulumtuar

Për këtë arsye studiues te ndryshëm janë përpjekur të shpjegojnë burimin e kësaj dukurie ballkanike dhe mënyrën e përhapjes së saj në gjuhët e ndryshme të këtij Gadishulli. Dhe, siç dihet, mendimi më i përhapur është ai i mbrojtur sidomos nga Sandfeldi, i cili e shihte burimin e shfaqjes së kësaj dukurie te greqishtja, ku ajo është shfaqur më

herët, duke pasur parasysh edhe faktin që greqishtja si gjuhë kulture dhe si gjuha zyrtare e Perandorisë Bizantine dhe e Kishës Ortodokse ka ndikuar mjaft mbi gjuhët e tjera ballkanike. Por ata që kanë mbrojtur këtë mendim, nuk kanë arritur të sqarojnë përse vetë greqishtja, që dikur e kishte shumë të zhvilluar kategorinë e paskajores me kundërvëniet diatezore, aspektore dhe “kohore” (shih Schwyzer: 1959, 804vv, Rix: 1976, 237v) dhe që si gjuhë kulture nuk kishte më pak nevojë se gjuhët e tjera ballkanike për kategorinë e paskajores, e mënjanoi këtë më heret se gjuhët e tjera të Ballkanit. Për më tepër, ndikimi i një gjuhe mbi strukturën gramatikore të një gjuhe tjetër a të disa gjuhëve të tjera, është një proces i jashtëzakonshëm. Gjithsesi, një ndikim i tillë nuk mund të ndodhte, në rast se gjuha a gjuhët e ndikuara nuk do të ishin “të paragatitura për ta përvetësuar” një ndikim të tillë. Me fjalë të tjera, mënjanimi i paskajores nëpërmjet zëvendësimit të saj nga format e zgjedhueshme të mënyrës lidhore nën ndikimin e një gjuhe tjetër mund të përftohej vetëm atëherë kur gjuha e ndikuar të kishte zhvilluar përdorimin e dendur të lidhores si sinonime të paskajores në sa më shumë funksione sintaksore të përbashkëta. E kjo parakupton njëkohësisht që folësit e gjuhës së ndikuar të kenë pësuar një ndryshim të madh në mënyrën e të shprehurit të mendimeve të tyre. Pa një paragatitje të tillë *gjuhësore dhe mendore* të folësve të gjuhës së ndikuar vështirë se ata mund të përgjithësonin në përdorim një mënyrë të shprehuri të ndryshëm nën ndikimin e një gjuhe tjetër. E një paragatitje e tillë *gjuhësore dhe mendore* në këtë rast nënkuptohet edhe për folësit e gjuhës ndikuese, cila do të ketë qenë ajo. P. sh. le të marrim rastin e greqishtes, që sipas disa gjuhëtarëve ka ndikuar mbi gjuhët fqinje në mënjanimin e paskajores dhe në zëvendësimin e saj nga format vetore të lidhores. Por, megjithëse greqishtja e vjetër, siç u vu në dukje pak më sipër, e kishte mjaft të zhvilluar kategorinë e paskajores si për nga larmia e formave me kundërvënie diatezore, aspektore dhe “kohore” ashtu edhe për nga përdorimi, aty nga shekulli II (shih Sandfeld: 1930 177) në atë gjuhë dëshmohet zëvendësimi i saj nga format e lidhores. Natyrisht, një zëvendësim i tillë nuk është kryer brenda një kohe të shkurtër, por duhet të jetë kryer pas një kohe relativisht të gjatë “konkurrence” midis lidhores dhe paskajores, duke përfunduar me mënjanimin e shkallë-shkallshëm të formave të paskajores.

Një gjë e ngjashme duhet të ketë ndodhur edhe në gjuhët e tjera

ballkanike. Le të marrim për shembull rastin e rumanishtes, e cila, ndryshe nga gjuhët e tjera romane, duke përfshirë edhe dalmatishten “e vdekur”, ka ardhur duke e mënjeluar paskajoren e duke e zëvendësuar atë me forma të lidhore të prira nga pjesëza me burim lidhëzor *să*. Pra, rumanishtja në këtë rast (dhe jo vetëm në këtë rast) gjatë evolucionit të saj historik në truallin ballkanik ka ndjekur një rrugë të ndryshme nga gjuhët romane perëndimore. Ndërsa në këto të fundit në ndonjë rast paskajorja ka pasur edhe një farë gjallërimi të mëtejshëm përdorimi në krahasim me latinishten, (p.sh. të krahasohen latinisht *venio rogatum* (supin) dhe italisht *vengo a domandare*), në rumanishte, në përgjithësi, përdorimi i saj ka ardhur duke u kufizuar gjithnjë e më shumë deri në mënjanimin e saj pothuaj të plotë në disa dialekte dhe të folme, nëpërmjet zëvendësimit të saj me forma vetore të lidhore.

Mënjanimi i paskajores nëpërmjet zëvendësimit të saj me anë të formave vetore të mënyrës lidhore ka nisur qysh në periudhën paralet-rare të rumanishtes, d.m.th. para shekullit XVI. Në tekstet e vjetra rumune kjo dukuri ndeshet, por nuk është e përgjithësuar. Siç u vu në dukje pak më sipër, zëvendësimi i paskajores me anë të mënyrës lidhore duhet të jetë përfutur, pasi kjo e fundit ishte pajisur me pjesëzën me origjinë lidhëzore *să*. Ndërkaq, në rumanishte, ashtu si në shqipe, është përfutur edhe një dukuri e përkundërt. Është fjala për përdorimin e pjesores së shkuar pësore¹ të prirë nga parafjala *de, pentru* etj. me vlerën e një paskajoreje me funksione sintaksore të kufizuara.² Kuptohet vetiu që ndërtimet e këtij tipi kanë bërë të mundur mënjanimin e pjesshëm të formave të lidhore. P.sh. të krahasohen: *era de spălat* “ishte për t’u shplarë”, *îl chemase pentru scuturat* “e kishte thirrur për ta shkundur”. Pra, në rumanishte, ashtu si në shqipe gjatë shekujve të fundit, krahas prirjes për zëvendësimin e paskajores nga forma të lidhore, është shfaqur edhe prirja e kundërt me krijimin e disa formave

¹ Është fjala për format e tipit *făcut, scris* etj., që në GLR I, 268, në këtë përdorim trajtohen si *supin*.

² Është fjala për ndërtime të tipit *pentru scris* “për të shkruar”, *am de citit* “kam për të lexuar”, *greu de spus* “difficile dictu” etj. Për togjet e tipit *de făcut, pentru scris* etj. disa gjuhëtarë si Sandfeldi: 1930, 130 etj. mendojnë se kryejnë funksionin e paskajores (në më të shumtën e rasteve me kuptim qëllimor), kurse GLR I, 268 ndërtime të tilla i trajton si *supin*. Të kihet parasysh se një formë e tillë përdoret edhe pas foljes pavetore *trebuie*, si p.sh. *trebuie făcut* “duhet bërë”.

perifrastike me vlerë foljore, që në njëfarë mase e kufizojnë përdorimin e lidhores. Megjithatë, është një gjë e ditur se lidhorja në rumanishte si edhe në shqipe (sidomos në dialektin jugor të kësaj) kanë një përdorim të dendur edhe në ato raste kur në gjuhët e pajisura me paskajore përdoret kjo e fundit.

Por, ndërkaq mbetet e paqartë përse në gjuhë të tjera i.e., si p.sh. në gjuhët romane perëndimore, ku janë në përdorim si paskajorja ashtu edhe lidhorja, nuk ka ndodhur një dukuri e tillë. Megjithatë, edhe në ndonjë gjuhë romane perëndimore është shfaqur një dukuri e ngjashme, por jo e njëjtë. Fjala është për portugalishten, ku krahas formës së zakonshme të paskajores (*infinitivi impersonal*) është shfaqur edhe paskajorja vetore (*infinitivi personal*). Ky i fundit si në formën e thjeshtë ashtu edhe në atë të së shkuarës, kur i referohet një kryefjale të vetës së dytë njëjës ose një kryefjale në njërën nga tri vetat e numrit shumës, pajiset me mbaresat vetore *-es* (për vetën II njëjës: p. sh. *falar-es*), përkatësisht *-mos*, *-des*, *-em* (p.sh. *falar-mos*, *falar-des*, *falar-em*). E një dukuri e tillë shfaqet jo vetëm në paskajoren e thjeshtë, por edhe në atë të së shkuarës, ku mbaresat vetore i prapangjiten paskajores së foljes ndihmëse *ter* të ndjekur nga pjesorja e shkuar e foljes themelore. Paskajorja vetore (*infinitivi pessoal*) përdoret kryesisht kur i referohet një kryefjale të ndryshme nga kryefjala e foljes drejtuese (shih Maria Helena Mira Mateus: 1983. 240vv, Maria-Martins: 1998, 197, Evsio-kov: 1972, 247vv.). Pra, edhe në portugalishte ka ndodhur diçka e pazakontë për paskajoren e gjuhëve të tjera romane. Megjithatë, një dukuri e tillë, sipas literaturës, që kam lexuar, është shfaqur edhe në të folmen e krahinës së Galicies (në Spanjën veri-perëndimore) dhe në disa të folme të Italisë qendrore-jugore. Veçse në këtë rast nuk kemi të bëjmë me mënjanimin e paskajores, por me krijimin e një *paskajoreje vetore* krahas *paskajores pavetore*, kurse për gjuhët ballkanike bëhet fjalë për mënjanimin e paskajores nëpërmjet formave vetore të lidhores, (përkatësisht të dëftores të prirë nga pjesëza *da* në bullgarishte-maqedonishte). Por pyetja se *kur* dhe *si* ka ndodhur një dukuri e tillë në portugalishte dhe në disa të folme të tjera (të Spanjës dhe të Italisë), i kapërcen synimet e kumtesës sime dhe njohuritë e mia të sotme për evolucionin historik të atyre gjuhëve. Për më tepër, në disa të folme të portugalishtes dhe gjetkë mbaresat vetore merr edhe përcjellorja (gjerundi) Prandaj le t'i kthehemi çështjes sonë mbi mënjanimin e pa-

skajores nëpërmjet formave vetore të lidhore në gjuhët ballkanike. Sqarimi i kësaj çështjeje në të vërtetë është shumë e vështirë të bëhet vetëm nëpërmjet gjuhësisë, sepse i kapërcen mundësitë e kësaj shken-ce. Por unë, duke shkelur porosinë e fjalës së urtë të cituar nga Bardhi *Gjithëkush duhet të mbae pajë mjeshtrij-së vet*, që i përgjigjet shprehjes latine *Quilibet de sua, & non de aliorum professione loqui debet*, po lejojhem të shpreh një mendim, më fort për të nxitur më tej diskutimin e kësaj çështjeje

Nga sa u shtjellua këtu më sipër, del pak a shumë e qartë se çështja e zhdukjes së paskajores në gjuhët e Ballkanit mbetet e hapur. Ka shumë të ngjarë që kjo dukuri të ketë një burim të përbashkët, por s'është e domosdoshme që ky burim për të gjitha gjuhët, ku ajo është shfaqur, të kërkohet patjetër te ndikimi i supozuar i greqishtes apo i ndonjë gjuhe tjetër. Në të tilla rrethana, më duket më e arsyeshme të pranohet që këtu kemi të bëjmë, në thelb, me një nga pasojat më të dukshme të një prirjeje të vjetër të gjuhëve të Ballkanit për një qartësim sa më të madh të kumtimit gojor, duke shfrytëzuar për këtë qëllim edhe përdorimin redundant të mjeteve gjuhësore. Përdorimi i formave vetore të lidhore në vend të formës së pashtjelluar të paskajores, që nuk e dallon vetën e atij që kryen (apo të atyre që kryejnë) veprimin e shprehur nga kjo formë foljore do të ketë qenë një nga pasojat e kësaj prirjeje. Natyrisht, këtu është fjala për faktorin zanafillës, që ka bërë të mundur shfaqjen dhe përhapjen e kësaj dukurie në gjuhët e Ballkanit. Por, nga ana tjetër, nuk ka si të përjashtohet mundësia e një ndikimi të ndërsjellë apo e ndikimit të kësaj ose të asaj gjuhe në përhapjen e mëtejshme të kësaj dukurie në Ballkanet. Veçse ky ndikim duhet të jetë shfaqur nëpërmjet të folmeve popullore në fqinjësi midis tyre e sidomos të trevave kufitare, ku njerëzit, krahas gjuhës amtare, kishin mundësi të mësonin e të flisnin edhe një gjuhë të dytë gjatë kontakteve me popullsinë aloglote. Në përhapjen e kësaj dukurie nga një gjuhë në një tjetër një rol të rëndësishëm duhet të kenë luajtur edhe rastet, kur një popullsi e caktuar, në gjuhën e së cilës mbizotëronin ndërtimet me paskajoren, për një arsye a për një tjetër, është ndikuar nga një gjuhë tjetër, ku mbizotëronin ndërtimet me lidhoren. Pra, siç u vu në dukje edhe pak më sipër, në ndonjë rast nuk duhet përjashtuar edhe ndikimi i jashtëm, kur rrethanat gjeografike-historike i kanë dhënë mundësi një ndikimi të tillë. Pas gjithë gjasash, një ndikim i tillë mund të supozo-

het sidomos për maqedonishten perëndimore, ku janë shfaqur edhe dukuri të tjera, që e dallojnë atë nga gjuhët e tjera sllave, duke përfshirë edhe bullgarishten. Mjafton të përmendim; sa për shembull, faktin që në maqedonishten standarde; ndryshe nga gjuhët sllave në përgjithësi (shih për këto Andersen: 1994, 476v.), fjalia (a më saktë fraza) mund të fillojë edhe me një fjalëz të patheksuar: E në këtë rast ndikimi i jashtëm nuk mund të mohohet. Pra, maqedonishtja perëndimore (dhe si rrjedhim edhe maqedonishtja standarde) në këtë rast (dhe jo vetëm në këtë rast) është larguar nga tipi i gjuhëve sllave, në të cilat, me sa duket, është ruajtur një tipar i hershëm i gjuhëve indo-europiane për të mos e filluar frazën me një fjalëz të patheksuar (ligji i Wackernagel-it).

Në mbyllje të kësaj kumtese më duhet të pohoj se çështja e mënjanimi të paskajores nëpërmjet formave vetore të lidhores në gjuhët ballkanike kërkon hulumtime të mëtejshme më të plota.

Literatura

- Ajeti : 1972 Ajeti, Idriz. Për historinë e marrëdhënieve të hershme gjuhësore shqiptare – sllave. **Studime filologjike** 1972.
- Andersen: 1994 Andersen, Henning. *Le lingue slave*, në: Ramat: 1994.
- Bokshi: 1984 Bokshi, Besim. **Prapavendosja e nyjës shqese në gjuhët ballkanike**. Prishtinë.
- Demiraj: 1986 Demiraj, Shaban. **Gramatikë historike e gjuhës shqipe**: Tiranë.
- Demiraj: 1994 Demiraj, Shaban. **Gjuhësi ballkanike**. Shkup.
- Demiraj: 2003 Demiraj, Shaban. **Some distinctive features of the standard Macedonian** (kumtesë e dërguar për një simpozium të Akademisë së Shkencave të Maqedonisë).
- Evciokov: 1971 Evciokov, P. N. **Samouçitel portugalskogo jazyka**. Moskva.
- Fiedler: 1975 Fiedler, W. Zhvillimi i infinitivit gegë nga aspekti i ballkanologjisë **Gj. Alb. SSHF** 1975.
- Fiedler: 1987 Fiedler, W. Zur Typologie der grammatischen Interferenz zwischen den Balkansprachen im Bereich der Konnektive. **Linguistische Studien - Reihe A**. Berlin 1987.
- Fiedler: 1987/a Fiedler, W. Zur Arealtypologie des Konjunktivs in den Balkansprachen. **Linguistische Studien -Reihe A**. Berlin 1987
- Friedman: 1977 Friedman, V. A. **The grammatical categories of the Macedonian indicative**. Columbus. Ohio
- GLR I: 1963 **Gramatica limbii române, I** (ed. a două). București.
- Hundertmark-Martins: 1998 Maria Teresa Hundertmark-Santos Martins, **Portugiesische Grammatik**. Tübingen
- Ivănescu: 1980 Ivănescu, G. **Istoria limbii române**. Jași.
- Mansaku: 1979 Mansaku, Seit. Ndërtimet me foljet modale *mund* dhe *duhet*. **SF** 1979/3.
- Katičić: 1976 Katičić, Radoslav. **Ancient languages of the Balkans**: Paris.
- Maria Helena Mira Mateus: 1983. **Gramatica da lingua portuguesa: elementos para a descrição da estrutura, funcionamento e uso do português actual**. Lisboa.
- Mihăescu: 1966 Mihăescu, H: **Influența grecească asupra limbii române**, București
- Miklosich: 1889 Miklosich, Fr. **Über die Einwirkung des Türkischen auf die Grammatik der südeuropäischen Sprachen**. Wien.
- Ramat: 1994 **Le lingue indoeuropee**; a cura di Anna Giacalone Ramat e Paolo Ramat. Bologna
- Rix: 1976 Rix, Helmut. **Historische Grammatik des Griechischen**. Darmstadt.
- Sandfeld: 1930 Sandfeld, Kristian. **Linguistique balkanique. problèmes et résultats**. Paris.
- Schwyzler: 1959 Schwyzler, E. **Griechische Grammatik. Auf der Grundlage von Karl Brugmanns Griechischer Grammatik** (dritte Auflage) I, II. München.
- Solta: 1980 Solta, Georg Renuat. **Einführung in die Balkanlinguistik mit besonderer Berücksichtigung des Substrats und des Balkanlateinischen**. Darmstadt.
- Svane: 1992 Svane, Gunnar. **Slavische Lehnwörter im Albanischen**. Aarhus.
- Wackernagel: 1892 Wackernagel, J. Über ein Gesetz der indogermanischen Wortstellung. **IF** (1892).

Irena SAWICKA, Warszawa, Poloni

LIDHJET FONETIKE TË SHQIPES NË KONTEKST BALLKANIK

Abstrakt

Albanian phonetics belongs to the western Balkan phonetic type which, in fact, does not differ essentially from the Western-European phonetics. However, in some micro-regions of more intensive convergence certain very specific phonetic phenomena emerged.

Among the phonetic links, shortly presented in the paper, phenomena regarding the whole Albanian area as well as those appearing in certain micro-regions will be discussed.

Para se të filloj numërimin e paraleleve fonetike ballkanike të gjuhës shqipe, duhen bërë vërejtjet e mëposhtme. Fonetika zhvillohet pak më ndryshe se konvergjenca morfo-sintaktike. Zhvillimi fonetik është më i shpejtë, sepse objekt i konvergjencës këtu është vetëm kumbimi. Efektet e konvergjencës rrallë kanë mbështetje në funksion. Konvergjenca kryesisht është e kufizuar në unifikimin e plotë të tingujve të ngjashëm. Nëse ndodhin konvergjenca më të thella, ato zakonisht janë vetëm tendenca, d.m.th. unifikimi i relacioneve sistematike nuk është i plotë. Si rezultat dalin opsione dhe lëkundje të shumta. Se dyti, si efekt i mungesës së mbështetjes në funksion, konvergjenca fonetike është më e thjeshtë dhe më e shpejtë. Si rrjedhojë, rezultatet e saj nuk duhet të jenë të përhershme. Kështu që, rezultatet e konvergjencës fonetike mund të ruhen në disa rajone, ndërsa faktet, që e kanë shkaktuar këtë konvergjencë në dialektin e dhënësit nuk ekzistojnë më. Pra, territori i shfaqjes së ndonjë tipari nuk duhet të jetë kompakt – një tipar i tillë mund të ruhet në rajone të largëta. Dhe në përfundim, gjë që është e lidhur me atë çfarë u tha më lart, një vëmendje e veçantë duhet të përqendrohet në rajonet e vogla me një konvergjencë shumë të fortë. Këto janë fshatra, ose grupe fshatrash, së paku dygjuhësorë, të cilat për shkaqe të ndryshme, janë të imunuara ndaj presionit të gjuhëve standarde (për shembull fshatrat maqedonase në Greqi).

Në lidhje me atë që thashë më lart, tabloja fonetike ballkanike ndryshon shumë nga tabloja e ligës fonetike ballkanike morfo-sintak-

tike. Kjo tablo përbëhet nga fakte gjenetike dhe tipologjike të rastësishme, të cilat u nënshtrohen proceseve të konvergjencës.

Ballkani ndahet në pjesën lindore dhe perëndimore, pjesë këto që kanë fonetikë diametrikisht të ndryshme. Pjesa lindore, që përfshin territore bullgare dhe rumune, karakterizohet me pjesëmarrje më të madhe të palatalizimit në sistemin fonetik, veçanërisht palatalizim asimilativ, si dhe me reduktim të zanoreve të patheksuara. Kjo është një lloj fonetike akomodative dhe për arsye të specifikës kundrejt Evropës, ky terren u propozua si qendër e ligës fonetike ballkanike (Ivić 1968). Ky tip fonetik tani po tërhiqet nga Evropa, por akoma ai përfshin një territor të madh në Evropë ku futen shumica e gjuhëve sllave në veri të maleve Karpat. Këto gjuhë kanë sistem konsonantik më të zhvilluar, kryesisht falë fonemave palatale. Gjithashtu karakteristike këtu është edhe prania e zanores së centralizuar dhe artikulimi dhëmbor i bashkëtingëllores së fortë laterale. Këto dy tipare shfaqen edhe në Toskërisht – në Gegërisht kemi vetëm një tipar. Por, vlen të theksohet që zanorja e centralizuar *ë* nuk është shumë e centralizuar, ngjyrimi i saj na kujton i [e]-në polake, e cila nuk konsiderohet zanore e centralizuar. Disa nga këto tipare kanë rreze veprimi pak më të madh. Në disa dialekte veriore greke gjithashtu shfaqet palatalizimi kombinatorik. Në të gjitha dialektet e Greqisë veriore Kemi, si në bullgarishten, një reduktim të fortë të zanoreve të patheksuara, të cilat shpesh ndikojnë në shqiptimin e dialekteve maqedonase, sidomos në Maqedonine Egjeane. Pjesa lindore e Ballkanit hyn në territorin e propozuar dikur nga Roman Jakobson dhe e quajtur nga ai liga gjuhësore euroaziatike. Tiparet karakteristike të kësaj lige janë korrelacioni i pasur i palatalizimit dhe mungesa e politonisë. Midis pjesës lindore dhe perëndimore kufiri i fonetikës ballkanike nuk është i qartë. Gjithë Bullgaria Perëndimore, një pjesë e Maqedonise Lindore dhe dialektet lindore serbe janë një territor tranzitor. Ballkani Jugperëndimor është një territor që kundërvihet, për sa i përket fonetikës ka lidhje me Evropën Perëndimore. Sistemet vokalike janë më të pasura (në varësi të dialektit këtu mund të kemi zanore të gjata, zanore hundore, si dhe dy nivele të zanoreve të mesme, ose dy fonema vokalike të ulëta). Fonetikat konsonantike palatale janë maksimumi pesë – dy obstruentë dhe tre sonantë. Theksi ka tendencë për stabilizim në rrokjen e dytë ose të tretë nga fundi i fjalës. Bashkëtingëlloret nuk u nënshtrohen palata-

lizimive kontekstuale, ndoshta me përjashtim të bashkëtingëlloreve velare. Asimilime të tjera gjithashtu janë të rralla. Midis të tjerash, në qendër të këtij territori sandhi është i kufizuar dhe i parregullt. Qendra e këtij territori është vendi i takimit maqedono-shqiptaro-grek. Këtu shfaqet gjithashtu një varg dukurish, të cilat lidhen me funksionimin specifik të togjeve konsonantike të tipit “sonanti hundor plus okluzivi me vend të njëjtë artikulimi” (ND). Dhe një tipar i tillë mjafton për të nxjerrë terrenin e ligës fonetike. Përveç kësaj kemi këtu shumë lenicion (ndikime greke) dhe si rezultat krijohen shumë togje zanoresh. Mungesa ose kufizimi i pranisë së bashkëtingëllores [x], si dhe dukuri që çojnë në kufizimin e mëtejshem të butësisë - para së gjithash forcimi i afrikateve palatale ([ts], [dʒ]/[c], [ʃ]). Përveç kësaj, lloji i fonotaktikës ka lidhje me Evropën Perëndimore, ndoshta përveç strukturës së rrokjes. Një pjesë e dukurive të lidhura me grupet ND shfaqet gjithashtu edhe në dialektet jugore italiane. Pra, siç shihet, gjuha shqipe, e sidomos gegërishtja, ndodhet mu në qendër të ligës fonetike ballkanike. Tani do i hedh një sy tipareve fonetike të konsideruara ballkanizma. Për arsye të kufizimit kohor do të jetë një tablo shumë e përgjithshme. Tiparet ballkanike si: zhdukja e [x]-së, forcimi i afrikateve, kufizimi i sandhit janë banale. E lidhin shqipen me dialektet serbe dhe maqedonase. Tendencat e theksimit e lidhin shqipen me greqishten dhe maqedonishten. Prania e bashkëtingëlloreve interdentalë e lidh shqipen me greqishten. Siç shihet sistemi fonologjik i zanoreve, i cili konsiderohet nganjëherë si ballkanizëm (Minissi 1982) ose sistemi konsonantik (Simeonov 1975) nuk mund të konsiderohen të tilla. Shumë i fortë është ndikimi grek mbi dukuri të lidhura me funksionimin e grupeve të zanoreve të maqedonishtes, ndërsa për shqipen nuk jam në gjendje të jap mendim. Një rol kyç kanë dy tipare, të cilat janë aq specifike sa vetë mund të bëjnë dallimin e një territori të caktuar. Për të dy këto tipare kam folur më parë në disa konferenca në Prishtinë (Sawicka 2001, 2010), prandaj do i rikujtoj shkurt. I pari tashmë është një tipar joaktual, historik - shfaqja e shva-së hundore. Në kundërshtim me shumë përshkrime nuk mendoj se shfaqja e shva-së jo-hundore ka qenë tipar ballkanik. Argumentimi është dhënë më herët. Ndërsa në periudhën e mesjetës së hershme shva-ja hundore është shfaqur në të gjitha gjuhët klasike ballkanike (në shqip, rumanisht, bullgarisht dhe maqedonisht - ndoshta për arsye se ky është një territor i shfaqjes së sub-

stratit ballkanik). Secila nga këto gjuhë dispononte kushte për zhvillimin e pavarur të këtij tingulli, por faktin, që një fonemë kaq e rrallë u zhvillua në një territor të mbyllur, mund t'ia atribuojmë konvergjencës. Disponojmë data kohore vetëm për gjuhët sllave. Dihet se kjo ka ndodhur pas vokalizimit të jerëve të fortë dhe humbjes së jerëve të dobët. E vërteton këtë jo vetëm rikonstrukcioni i brendshëm, por edhe shkrimet, që përmbajnë përzierje të jereve dhe zanoreve hundore të shekullit të X/XI, që nuk do të thotë se kjo dukuri nuk mund të jetë shfaqur edhe më herët, por edhe nuk do të thotë që në gjuhët e tjera u shfaq në të njëjtën kohë. Zhvillimi sllav mund të jetë kushtëzuar nga situata e gjetur në Ballkan. Tipari i dytë është frekuenca e lartë e grupeve të sonanteve hundore me obstruent homorganik si dhe një seri opsionesh të lidhura me realizimin e këtyre grupeve e që janë rrjedhë e tendencës për ekuivalencë funksionale të grupeve ND dhe okluziveve të zëshme. Shqipja i ka para së gjithash këto grupe në fillim të fjalëve si e vetmja gjuhë letrare në Evropë. Por përveç formës letrare, këto grupe në fillim të fjalëve shfaqen edhe në dialektet italiane, ku gjithashtu janë rezultat i reduktimit të zanoreve të shkurtra të pafthësuar. Reduktimi analogjik në arumanisht nuk qe i plotë. Këto grupe në fillimin e fjalëve shfaqen edhe në tregimet greke plot emociione, ku si rrjedhë e kuptimit të njëjtë fonologjik, zëvendësojnë okluzivet e zëshme në fillim të fjalëve. Në dialektet e gegërishtes u shfaq zëshmimi i okluziveve të pazëshme pas sonanteve hundore. Ky tipar shfaqet edhe në greqisht dhe dialektet e italishtes jugore. Në dialektet veriore greke aktualisht shfaqen grupe analogjike me okluzivin e pazëshëm. Këto janë grupe dytësore të krijuara si pasojë e reduktimit të zanoreve të larta. Dytësore janë edhe grupet me okluzivin e zëshëm, sepse në dialektet veriore greke grupet e dikurshme ND u thjeshtësuan. Thjeshtësimet e grupeve ND në dialektet e gegërishtes të kujtojnë geminacioni i tyre në dialektet e italishtes jugore, sepse këtu mbizotëron thjeshtësimi deri në sonantin hundor (p. sh. *mret* < *mbret*, it. *munnu* < *mondo*). Kurse krejt në jug, në dialektet e Çamërisë dhe Labërisë mbizotëron thjeshtësimi në okluziv (*dhëbi* < *dhëmbi*), tipar ky që është shfaqur edhe në dialektet veriore greke.

Dukuria e radhës: një okluziv shtesë që ndan grupin e përbërë nga frikativi dhe sonanti ose nga dy sonante dhe që shfaqet kryesisht në dialektet veriore greke, ka një lloj paraleleje në grupet e shqipes

mr, ml, të cilat në dialekte japin *mbr, mbl* p. sh. *zëmbra, numbri* (kësh-tu është edhe në dialektet e maqedonishtes nga territori i Shqipërisë, p. sh. *mbleko*). Ekuivalenca funksionale greke e grupeve ND dhe e okluziveve të zëshme pasqyrohet në dialektet e shqipes në prenazalizim të pamotivuar të okluziveve (*vampor*) ose në shtimin e okluziveve pas sonantit hundor (*aspirind*) ose në të kundërt, në thjeshtësimin e grupeve etimologjike ND. Kryesisht opozita ruhet në shqip (*mbesë - besë*). Në shumicën e dialekteve të shqipes në Greqi prenazalizimi është i rregullt (*runga, vongël*). Në një farë shkalle ekuivalenca funksionale ka ndikuar edhe në ruajtjen e hundorësisë nga zanoret hundore në disa dialekte jugore maqedonase. Kjo është një dukuri shumë komplekse. Shumë herë kam shkruar për këtë dhe këtu s'ka kohë ta paraqes me detaje. Në përgjithësi kjo përmbledhje e dukurive heterogjenike konvergjon njëri me tjetrin mbi bazën e afërsisë së tingëllimit dhe formon tiparin fonetik ballkanik më karakteristik.

Në mbyllje desha të them diçka për strukturën e rrokjes në gjuhët ballkanike. Ky problem nuk shfaqet në punimet ballkanologjike, sepse në Ballkan shfaqen modele të ndryshme rrokjesh. Shumica e gjuhëve evropiane dhe botërore ka të ashtuquajturin modelin e rrokjes me një kulm, pra radha e segmenteve në rrokje respekton shkallën e sonoritetit. Përrjashtime gjejmë pikërisht në Evropën juglindore, sidomos në gjuhët veriore sllave, ku ashtu si fillimi dhe/ose mbarimi i fjalisë kanë strukturë rrokjeje me dy kulme sonoriteti (intensiteti). Ndërsa në jug të Evropës ruhet modeli i rrokjes me një kulm, por josi-metrik. Në gjuhët "mediterane" fundi i rrokjes është i hapur ose pjesërisht i hapur (pra i mbyllur vetëm me një sonant, më rrallë me obstruent, repertori i të cilëve është i kufizuar). Kështu është në gjuhën letrare greke dhe në dialektet jugore, në italishten letrare dhe në shumicën e dialekteve jugore, në spanjisht dhe portugalisht (për më tepër këtë rajon e lidh lenicioni i okluziveve të zëshme). Në gjuhët sllave në Ballkan shfaqet rregullisht modeli i rrokjes simetrike me një kulm, ndërsa në shqipen letrare, në fillim të fjalëve gjithashtu shfaqet struktura me dy kulme. Në standardin shqiptar kjo i takon vetëm shfaqjes së grupeve fillestare të tipit sonant hundor plus obstruent. Në dialekte në fillim të fjalëve shfaqen edhe grupet të përbëra nga bashkëtingëlloret e lëngëta dhe obstruenti. Fundi i rrokjes është rregullisht me një kulm. Ndryshe është në disa të folme arbëreshe, ku janë të mundshme

forma me dy kulme, të tilla si [katr], [lopn]. Forma të një lloji të tillë shfaqen edhe në dialektet italiane, psh. në dialektin e Barit, ku kemi forma si [tʃipr], [sepwolkr], madje edhe me sonant të pazëshëm në fund të rrokjes. Por këto situata janë të rralla. Në mënyrë absolute dominon modeli i rrokjes me një kulm, ndërsa në italisht modeli me një kulm dhe të hapur, pra jo-simetrik.

Punimet e cituara

- Ivić P., 1968, *Liens phonologiques entre les langues balkaniques*, [në:] *Actes du premier congrès international des études balkaniques et sud-est européennes*, Sofia, 133-143.
- Jakobson R., 1962, *К характеристике евроазиатского языкового союза*, [në:] *Selected writings I*, Mouton & 's-Gravenhage, 144-202.
- Minissi N., Kitanoski N., Cinque U., 1982, *The phonetics of Macedonian*, Napoli.
- Sawicka I., 1991, *The problem of the prenasalization of stops in Southern Slavic*, [në:] *Studies in the phonetic typology of the Slavic languages*, Warszawa, 113-125.
- Sawicka I., 2001, *Lidhje midis hundoresisë dhe reduktimit në gjuhëve ballkanike*, [në:] *Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare XIX*, Prishtinë 2001, 283-286.
- Sawicka I., 2002, И. Савицкая, *Функционирование групп согласных типа НД в балканских языках*, [në:] *Материалы конференции посвященной 90-летию со дня рождения Агнии Васильевны Десницкой*, Санкт-Петербург., 195 -198.
- Sawicka I., 2010, *Probleme me periodizimin e fakteve fonetike të gjuhëve ballkanike*, Prishtinë.
- Simeonov B., 1975, Б. Симеонов, *К вопросу о модели консонантизма балканских языков*, Балканско езикознание XVIII.

Bahri BECI, Paris

KONSIDERATA TË PËRGJITHSHME PËR ROLIN E SHQIPES NË FORMIMIN E BASHKËSISË GJUHËSORE BALLKANIKE

Abstrakt

Lidhur me rolin e shqipes a të parashqipes në formimin e bashkësisë gjuhësore ballkanike janë vënë re dy qendrite a teori kontradiktore, një teori e parë dhe më i vjetër, që e pranon ndikimin e shqipes a të parashqipes në formimin e bashkësisë gjuhësore ballkanike dhe një teori e dytë e mëvonshme, që e mohon mundësinë e ndikimit të shqipes a të parashqipes në formimin e bashkësisë gjuhësore ballkanike.

Gjatë shqyrtimit të dukurive të përbashkëta gjuhësore ballkanike, përfshirë këtu edhe historinë e formimit të tyre, na është krijuar bindja se studiuuesit e derisotëm nuk kanë pasur gjithmonë sa dhe si duhet parasysh shtrirjen gjeografike dhe vjetërsinë e këtyre dukurive në shqipe.

Dukuritë e përbashkëta të gjuhëve ballkanike në shqipe grupohen : në dukuri gjuhësore ballkanike që shtrihen në mbarë shqipen dhe në dukuri gjuhësore ballkanike që shtrihen vetëm në dialektin e jugut ose toskërishte.

Vështrimi i tyre më për së afërmi na duket se flet për një vjetërsi dhe shtrirje më të madhe të tyre në shqipe, çka na shtyn të mendojmë për valë që kanë ardhur nga vise perëndimore ose nga një zonë që e ka pasur qendrën diku në territoret shqiptare e maqedone perëndimore dhe greke veriore.

Kjo gjën mbështetje edhe në kushtet historike, në situatën etnike dhe në rolin e elementit etnik shqiptar në këto territore.

Teoritë kryesore për rolin e shqipes në formimin e bashkësisë gjuhësore ballkanike

Lidhur me rolin e shqipes a të parashqipes në formimin e bashkësisë gjuhësore ballkanike janë vënë re dy qendrite a teori kontradiktore, një qendrim a teori e parë dhe më e vjetër, që e pranon ndikimin e shqipes a të parashqipes në formimin e bashkësisë gjuhësore ballkanike dhe një qendrim a teori e dytë e mëvonshme, që e mohon mundësinë e ndikimit të shqipes a të parashqipes në formimin e bashkësisë gjuhësore ballkanike.

Sipas teorisë së parë tiparet e përbashkëta gjuhësore ballkanike janë rezultat i ndikimit të një substrati ilir ose trak që identifikohet me gjuhën shqipe. Kështu për shembull, Fr. Miklosich e kërkonte burimin e shu-

micës ose, të paktën, të pjesës më të madhe të dukurive të përbashkëta gjuhësore ballkanike “tek elementi i lashtë autokton” për të cilin shkruante se besonte “të ketë qenë i afërt me shqipen e ditëve tona” që ai e konsideronte si “vazhduesen e ilirishtes”¹.

Edhe G. Weigand e kërkonte burimin e dukurive gjuhësore të përbashkëta ballkanike tek veprimi i substratit të përbashkët trako-shqiptar, duke e konsideruar shqipen, në ndryshim nga Fr. Miklosich, si vazhduesen e trakishtes². Sipas teorisë së dytë ndikimit i shqipes mbi gjuhët e tjera ballkanike është i pamundur.

Kështu për shembull, sipas Kr. Sandfeldit “është paimagjinueshme që një gjuhë kulture si greqishtja të ketë mundur të pësojë ... ndikimin e një gjuhe barbare që nuk mbështetet në asnjë autoritet politik...”³.

Edhe J. Feuillet, kur flet për origjinën e zhdukjes së paskajores në gjuhët ballkanike shkruan se “përsa i përket shqipes, që ka ndikuar shumë pak në gjuhët e tjera ballkanike, është krejt e pamundur të jetë në origjinën e këtij fenomeni”⁴.

Lidhur me mundësinë e ndikimit të shqipes mbi gjuhët e tjera ballkanike R. G. Zolta ka shkruar se “ideja e Sandfeldit që greqishtja ka mbartur peshën kryesore për burimin e ballkanizmave nuk mund të pranohet. Përkundrazi qysh nga fundi i antikitetit greqishtja ka ardhur duke u ballkanizuar gjithnjë e më shumë. Gjuhë vendimtare e ballkanëve duhet të jetë pikërisht shqipja, pranë së cilës mund të vendosen rumanishtja dhe bullgarishtja”⁵.

Edhe H. Schaller i ka klasifikuar gjuhët ballkanike në gjuhë ballkanike të shkallës së parë (*shqipja, bullgarishtja, maqedonishtja dhe rumanishtja*), të shkallës së dytë (*greqishtja, serbo-kroatishtja*) dhe të shkallës së tretë (*turqishtja, sllovenishtja dhe hungarishtja*). Origjina e

¹ Fr. Miklosich, *Die slavischen Elemente im Rumänischen*, **Denkschriften der Kaiserlichen Akademie der Wissenschaften**, Philos.- histor. Classe, XII, Wien, 1861, f. 8.

² G. Weigand, *Ethnographie von Makedonien*, Leipzig 1924, f. 58-67 ; *Sind die Albaner die Nachkommen der Illyrier oder der Thraker?*, **Balkan-Archiv**, III, 1927, f. XI.

³ Kr. Sandfeld, *Linguistique balkanique, Problèmes et résultats*, Paris, 1930, f. 177-178.

⁴ J. Feuillet, *La linguistique balkanique*, **Cahiers Balkaniques**, n° 10, Paris, 1986, f. 112.

⁵ G. R. Zolta, *Einführung in die Balkanlinguistik mit besonderer Berücksichtigung des Substrats und des Balkanlateinischen*, Darmstadt, 1980, f. 233.

ballkanizmave, sipas tij, duhet kërkuar në gjuhët e shkallës së parë. Gjuhët e shkallës së dytë “përsa i përket ballkanizmave të tyre, nuk janë gjë tjetër veçse rezultat i rrezatimeve të dukurive gjuhësore që vinë nga gjuhët ballkanike të shkallës parë⁶.

Ballkanizmat që shtrihen në mbarë shqipen

Gjatë shqyrtimit të dukurive të përbashkëta gjuhësore ballkanike, përfshirë këtu edhe historinë e formimit të tyre, na është krijuar përshtypja a bindja që shtrirja gjeografike dhe vjetërsia e dukurive ballkanike në shqipe është me rëndësi për të shpjeguar historinë e formimit ballkanizmave në përgjithësi.

Sipas shtrirjes gjeografike në shqipen, dukuritë e përbashkëta të gjuhëve ballkanike mund të grupohen :

- a) në dukuri gjuhësore ballkanike që shtrihen në mbarë shqipen;
- b) në dukuri gjuhësore ballkanike që shtrihen vetëm në dialektin e jugut ose në toskërishte.

Ballkanizmat më të rëndësishme që shtrihen në mbarë shqipen janë :

- 1) prapavendosja e nyjës shquese;
- 2) bashkëpërkimi i rasave gjinore dhe dhanore;
- 3) rimarrja e kundrinave;
- 4) Formimi i së ardhmes me ndihmën e foljes “dua”;
- 5) formimi i numërorëve 11 deri në 19 me ndihmën e një parafjale.

Nga pesë dukuritë gjuhësore ballkanike të shtrira në mbarë shqipen, vetëm dy dukuri, bashkëpërkimi i gjinores me dhanoren⁷ dhe formimi i së ardhmes me ndihmën e foljes “dua”⁸, shtrihen në mbarë gju-

⁶ H. W. Schaller, *Die Balkansprachen. Eine Einführung in die Balkanphilologie*, Heidelberg, 1975, f. 77.

⁷ Për *shqipen* shih: Sh. Demiraj, *Gramatika historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1986, f. 255-285; *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, Tiranë, 1988, f. 60-61; *Gjuhësi ballkanike*, Shkup, 1994, f. 85-99. Për *greqishten* shih: Kr. Sandfeld, *Linguistique balkanique. Problèmes et résultats*, Paris, Klincksiek, 1930, f. 185-187. Për *maqedonishten* dhe *bullgarishten* shih: K. Mirčev, *Istoriya na bëlgarskija ezik*, Sofija, 1950, f. 125, 132, 133, 139; B. Koneski, *Istoriya na makedonskiot jezik*, 1967, f. 159v, 166. Për *rumanishten* shih: *Istoria limbii române, vol. II*, București, 1969, f. 219-220v; I. Coteanu, *Morfologia numelui în protoramână*, București, 1969, f. 58; *Gramatica limbii române, I*, București, 1963, f. 105.

⁸ Për *shqipen* shih: Sh. Demiraj, *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, Tiranë, 1988, f. 61-62;

hët ballkanike, pra në shqipe, greqishte, rumanishte, bullgarishte e maqedonishte, të tjerat kanë një shtrirje më të kufizuar.

Kështu p.sh. prapavendosja e nyjës shquese, karakteristike për shqipen, rumanishten, bullgarishten dhe maqedonishten⁹, po edhe formimi i numërorëve 11-19 me ndihmën e një parafjale karakteristik për gjuhën shqipe, rumanishten, bullgarishten, maqedonishten dhe serbo-kroatishten¹⁰, po edhe format e mënyrës habitore karakteristike për

Gjuhësi ballkanike, Shkup, 1994, f. 121. Për *greqishten* shih: A. Thumb, **Handbuch der neogriechischen Volkssprache**, Strasburg, Trübner, 1910, f. 153 v. Kr. Sandfeld, **Linguistique balkanique. Problèmes et résultats**, Paris, Klincksiek, 1930, f. 182, 184; Për *bullgarishten e maqedonishten* shih: B. Koneski, **Istorija na makedonskiot jazik**, Skopje, 1967, f. 204; **Gramatika na makedonskiot knižoven jazik**, Skopje, 1967, 487; K. Mirčev, **Istorija na bëlgarskija ezik**, Sofija, 1950, f. 159, 204-6. Për *rumanishten* shih: **Istoria limbii române, vol. II**, București, 1969, f. 268; **Gramatica limbii române, I**, București, 1963, f. 220, 241, 243; A. Lombard, **La langue roumaine**, Paris, 1974, f. 34-35, 275. Për këtë tipar të gjuhëve ballkanike shih edhe B. J. Kopitar, **Albanische, walachische und bulgarische Sprache**, Wien, 1829, f. 272; Fr. Miklosich, **Die slavischen Elemente im Rumänischen**, Denkschriften der Kaiserlichen Akademie der Wissenschaften, Phil.-histor. Classe, XII, Wien, 1861, f. 6; Kr. Sandfeld, **Linguistique balkanique, problèmes et résultats**, Paris, 1930, f. 181-184; Sh. Demiraj, **Gjuhësi ballkanike**, Shkup, 1994, f. 112v.

⁹ Fr. Miklosich, **Die slavischen Elemente im Rumänischen**, Denkschriften der Kaiserlichen Akademie der Wissenschaften, Phil.-histor. Classe, XII, Wien, 1861, f. 7; Kr. Sandfeld, **Linguistique balkanique, problèmes et résultats**, Paris, 1930, f. 165-173; H. Pedersen, *Bidrag til den albanesiske sproghistorie*, **Festschrift Vilhelm Thomsen**, Köbenhavn, 1894, f. 48v; E. Çabej, *Rreth disa çështjeve të historisë së gjuhës shqipe*, **BUSHT, SSHSH**, 1963, 3, f. 78v; S. Riza, *Nyjat e shqipes*, **BUSHT, SSHSH**, Tiranë, 1958, 4, f. 11v; 27; *Probleme të nyjave të shqipes*, **SF**, Tiranë, 1982, 1, f. 123; A. Graur, *Questions latino-roumaines:... 2. A propos de l'article postposé*, **Romania**, T.L.V. Paris, 1929, f. 476 v; *De nouveau sur l'article postposé en roumain*, **RRL**, 1967, 1, f. 16; La Piana, **Sudi linguistici albanesi, I**, Palermo, 1939, f. 129; Sh. Demiraj, **Gramatika historike e gjuhës shqipe**, Tiranë, 1986, f. 328; P. Asenova, *Aperçu historique des études dans le domaine de la linguistique balkanique*, **Linguistique balkanique**, Sofija, 1979, XXII, 1, f. 21-25.

¹⁰ Kr. Sandfeld, **Linguistique balkanique, Problèmes et résultats**, Paris, 1930, f. 148v; H. W. Schaller, **Die Balkansprachen. Eine Einführung in die Balkanphilologie**, Heidelberg, 1975, f. 151; J. Feuillet, *La linguistique balkanique*, **Cahiers balkanique**, nr.10, 1986, f. 78; I. Coteanu, *Morfologia numelui în protoramână*, București, 1969, f.155; Sh. Demiraj, **Gjuhësi ballkanike**, Shkup 1994, f. 165-166.

shqipen, bullgarishten dhe maqedonishten¹¹ mungojnë në greqishte. Haborja mungon edhe në rumanishte¹², kurse rimarrja e kundrinave nuk është përgjithësuar në rumanishte¹³, ajo ndeshet më së shumti në shqipen, në të folmet maqedone dhe më rrallë në bullgarishten lindore, kurse në greqishte vetëm në dialektet e saj veriore¹⁴.

¹¹ G. Weigand, *The Slavonic Review*, 2, f. 567-568; *Das Albanesische in Attika*, *Balkan-Archiv*, I, Leipzig, 1925, f. 150-152; A. Teodor Balan, L. Andreičin, *Voprosy grammatiki bolgarskogo literaturnago jazyka*, 1959, f. 315 v.; S. Stojanov, *Grammatika na bëlgarskija knižoven ezik*, Sofija, 1977, f. 393 v.; R. Debraekeleer, *Une catégorie verbale complexe et originale du bulgare moderne: le mode de la "narration indirecte"*, *Annuaire de l'Institut de Philologie et d'Histoire orientales et Slave*, T. XVII, (1963-1965), Bruxelles, 1966, f. 265 v.; E. I. Demina, *Pereskazyvatelnye formy v sovremennom bolgarskom jazyke*, *Voprosy grammatiki bolgarskogo literaturnago jazyka*, 1959, f. 322, 325-328; B. Koneski, *Istorija na makedonskiot jazik*, Skopje, 1967, f. 175 v.; *Gramatika na makedonskiot jazik*, Skopje, 1967, f. 477-481; Sh. Demiraj, *Gramatika historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1986, f. 930, *Gjuhësi ballkanike*, Shkup, 1994, f. 169-170; W. Fiedler, *Zu einigen Problemen des Admirativs in den Balkansprachen*, *Actes du premier Congrès International des Etudes Balkaniques et Sud-est Européennes*, VI, Sofia, 1968, f. 369.

¹² Sh. Demiraj, *Gjuhësi ballkanike*, Shkup, 1994, f. 169-171.

¹³ *Gramatica limbii romîne*, I, București, 1963, f. 145v; F. Asan, *Reluarea complementului în limba romînă*, *Studii de gramatica*, III, București, 1961, f. 93-105; N. Saramandu, *Reluarea și anticiparea complementului indirect exprimat prin substantiv în limba romînă din secolul al XVIII-lea*, *Studi și cercetări lingvistice*, București, 1966, 4, f. 424v; Sh. Demiraj, *Gjuhësi ballkanike*, Shkup, 1994, f. 133-134,

¹⁴ Për shqipen shih: Sh. Demiraj, *Gramatika historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1986, f. 584v.; *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, Tiranë, 1988, f. 64-66; *Gjuhësi ballkanike*, Shkup, 1994, 127-146 etj. Për rumanishten shih: *Gramatica limbii romîne*, I, București, 1963, f. 145v; F. Asan, *Reluarea complementului în limba romînă*, *Studii de gramatica*, III, București, 1961, f. 93-105; N. Saramandu, *Reluarea și anticiparea complementului indirect exprimat prin substantiv în limba romînă din secolul al XVIII-lea*, *Studi și cercetări lingvistice*, București, 1966, 4, 424v. Për bullgarishten e maqedonishten shih: A. Seliščev, *Traits linguistiques communs aux langues balkaniques: un balkanisme ancien bulgare*, *Revue des études slaves*, V, Paris, 1925, pp. 45; Kr. Sandfeld, *Linguistique balkanique. Problèmes et résultats*, Paris, Klincksiek, 1930, pp. 262; B. Koneski, *Gramatika na makedonskiot jazik*, Skopje, 1967, f. 262; Ju. Lopašov, *Mestoimennye povtory dopolnenija v balkanskijah jazykah*, Leningrad, 1978, 28-32, 44-50; J. Rusek, *Po vaprosa za xronologijata na udvojavane na dopalnenijata v savremennija balgarski ezik*, *Bälgrski ezik*, XIII, 1963, 2, f. 142; K. Mirčev, *Za xronologijata na osnovnite balkanizmi v bälgarskija ezik*, *Bälgrski ezik*, V, XVI, 1966, 4, f. 284. Për greqishten shih: E. Blass-A. Dobrunner, *A greek Grammar of the*

Siç shihet, këto dukuri dobësohen ose zhduken sa më në lindje dhe jug të gjuhëve ballkanike të shkojmë; më të përgjithësuar paraqiten në viset perëndimore të Ballkanit, pra, në Shqipëri dhe Maqedoninë. Mendoj se ky është një tregues që ndoshta nuk duhet nënvleftësuar ose harruar.

Edhe nga pikëpamja e vjetërsisë vihen re disa prirje. Tri nga dukuritë e ballkanike, bashkëpërkimi i rasave gjinore-dhanore, prapavendosja e nyjës shquese dhe rimarrja e kundrinave janë të vjetra ose relativisht të vjetra në shqipe¹⁵; në rumanishte dy të parat, bashkëpërkimi i rasave gjinore-dhanore dhe prapavendosja e nyjës shquese janë të hershme, kurse e treta, rimarrja e kundrinave, as e përgjithësuar, as e hershme¹⁶; në bullgarishte e maqedonishte e para, bashkëpërkimi i rasave gjinore-dhanore, i përket periudhës pas shekullit XV¹⁷, e dyta,

New Testament and other early Christian Literature, Cambridge, 1961, f. 32; G. Ljungvik, *Beiträge zur Syntax der spätgriech, Volkssprache*, Uppsala, 1932, f. 6-8; Debrunner, A. **Geschichte der griechischen Sprache, II**, Berlin, 1954, f. 96; P. Ilievski, *Kon interpretaciata na modelot na udovoeni ot objekt vo makedonskiot jazik, "Godishen"* i universitetit të Shkupit, 1973, f. 21.

¹⁵ Për rasat gjinore-dhanore në shqipe shih: Sh. Demiraj, **Gramatika historike e gjuhës shqipe**, Tiranë, 1986, f. 275; **Gjuhësi ballkanike**, Shkup, 1994, f. 87. Për nyjen e prapme në shqipe shih: Kr. Sandfeld, **Balkanfilologien. En oversigt over dans resultater og problemer**, Köbenhavn, 1926, f. 98. N. Jokl, *Zur Geschichte des alb. Diphthongs -ua/-ue*, **IF**, 1932, 50, 45v. E Çabej, **Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Seria Shkencat Shoqërore**, Tiranë, 1963, 3, f. 78-80. Sh. Demiraj, **Gramatika historike e gjuhës shqipe**, Tiranë, 1986, f. 33-40, 44-48, 329. Për rimarrjen e kundrinave në shqipe shih: Sh. Demiraj, **Gjuha shqipe dhe historia e saj**, Tiranë, 1988, f. 64-66; **Gjuhësi ballkanike**, Shkup, 1994, f. 130. B. Bokshi, **Rruga e formimit të fleksionit të sotëm nominal të shqipes**, Prishtinë, 1980, f. 247; **Prapavendosja e nyjeve në gjuhët ballkanike**, Prishtinë, 1984, f. 195.

¹⁶ Për bashkëpërkimin e rasave gjinore-dhanore në rumanisht shih: **Istoria limbii române**, vol. II, București, 1969, f. 220; I. Coteanu, **Morfologia numelui în protoramână**, București, 1969, f. 58 v. Sh. Demiraj, **Gjuhësi ballkanike**, 92. Për nyjen e prapme në rumanishte shih: Kr. Sandfeld, **Linguistique balkanique**, f. 170; **Istoria limbii române, II**, f. 232. Sh. Demiraj, **Gramatika historike e gjuhës shqipe**, f. 329. Për rimarrjen e kundrinave në rumanishte shih: **Gramatica limbii române, I**, București, 1963, f. 145v; F. Asan, *Reluarea complementului în limba română*, **Studii de gramatica**, III, București, 1961, f. 93-105. N. Saramandu, *Reluarea și anticiparea complementului indirect exprimat prin substantiv în limba română din secolul al XVIII-lea*, **Studi și cercetări lingvistice**, București, 1966, 4, f. 424v.

¹⁷ K. Mirčev, **Istoriya na bëlgarskija ezik**, Sofija, 1950, f. 139; B. Koneski, **Istoriya na**

prapavendosja e njëjës shquese, sipas Kr. Sandfeld është e periudhës pas shekullit XV, kurse për të tjerë e periudhës pas shik. IX¹⁸, kurse e treta, rimarrja e kundrinave rreth shekujve XII-XIII¹⁹; në greqishte e para, bashkëpërkimi i rasave gjinore-dhanore është e hershme²⁰, e dyta, prapavendosja e njëjës shquese, nuk ekziston²¹, kurse e treta, rimarrja e kundrinave, jo shumë e vjetër dhe dialektore veriore²²

Është përsëri një situatë që flet për një vjetërsi, po edhe shtrirje më të madhe të tyre në shqipe, çka të shtyn të mendosh për valë që kanë ardhur nga vise perëndimore ose nga një zonë që e ka pasur qendrën diku në territoret shqiptare e maqedone perëndimore dhe greke veriore.

Ballkanizmat që shtrihen në dialektin e jugut të shqipes

Nga gjashtë tipare dalluese dialektore të toskërishtes ose të dialektit të jugut, katër ose pesë janë vlerësuar si ballkanizma:

1. mungesa e kundërvënies sipas gjatësisë dhe hundorësisë;
2. prania e zanores qendrore /ë/;
3. rotacizmi i /n/ në /r/;
4. zëvendësimi i paskajores me lidhoren.

Janë të përbashkëta për shqipen e jugut (toskërishten) dhe rumanishten ose dialekte të saj mungesa e kundërvënies sipas hundorësisë dhe sipas gjatësisë, prania e fonemës zanore të theksuar /ë /, rotacizmi, kalimi i *vo*-së në *va*- (në rumanishte në *oa*), me të cilin në shqipen e

makedonskiot jazik, 1967, f. 159, 166. Sh. Demiraj, **Gjuhësi ballkanike**, Shkup, 1994, f. 92. J. Feuillet, *La linguistique balkanique*, Cahiers balkanique, nr.10, 1986, f. 82.

¹⁸ Kr. Sandfeld, *Linguistique balkanique, problème et résultats*, Paris, 1930, 170. B. Koneski, **Istorijska na makedonskiot jazik**, Skopje, 1967, 153; Sh. Demiraj, **Gramatika historike e gjuhës shqipe**, Tiranë, 1986, f. 328.

¹⁹ P. Ilievski, *Kon interpretaciata na modelot na udovoeniotobjekt vo makedonskiot jazik*, "Godishen" i universitetit të Shkupit, 1973, f. 218; Sh. Demiraj, **Gramatika historike e gjuhës shqipe**, Tiranë, 1986, f. 606; **Gjuhësi ballkanike**, Shkup 1994, f. 136.

²⁰ Kr. Sandfeld, **Linguistique balkanique**, f.186.

²¹ Kr. Sandfeld, **Linguistique balkanique**. f. 165 v.; J. Feuillet, *La linguistique balkanique*, Cahiers balkanique, nr.10, 1986, f. 72

²² P. Ilievski, *Kon interpretaciata na modelot na udovoeniot objekt vo makedonskiot jazik*, "Godishen" i universitetit të Shkupit, 1973, f. 216; Sh. Demiraj, **Gjuhësi ballkanike**, Shkup, 1994, f. 137.

Jugut (toskërishten) shkon paralel edhe kalimi i *-uo-* në *-ua-*²³, si edhe zëvendësimi i paskajores me lidhoren.

Nga këto dukuri të përbashkëta për shqipen e jugut (toskërishten) dhe rumanishten, në bullgarishte dhe maqedonishte vërtetohen mungesa e kundërvënies sipas hundorësisë dhe sipas gjatësisë, mungesa e rotacizmit dhe e kalimit të grupit tingullor *vo-* në *va-*; kurse janë të pranishme fonema zanore e theksuar /*ë*/ dhe zëvendësimi i paskajores me lidhoren; në serbo-kroatishte gjenden mungesa e kundërvënies sipas hundorësisë dhe sipas gjatësisë, fonema zanore e theksuar /*ë*/ (vetëm në disa të folme) dhe zëvendësimi i pjesshëm i paskajores me lidhoren (vetëm në disa dialekte serbe), kurse në greqishte vërtetohet mungesa e kundërvënies sipas hundorësisë e gjatësisë, e *ë-së* së theksuar, e rotacizmit, e kalimit të *vo-së* në *va* si edhe prania e lidhores në vend të paskajores²⁴.

²³ Lidhur me këtë dukuri E. Çabej ka shkruar: “Nga ndryshimet që janë zbatuar në sistemin vokalik të shqipes N. Jokli hapjen e *vo-së* nistore në *va-* në toskërishten në të tilla fjale si *voj, vaj* prej lat. *oleum* e vuri në një vijë me zhvillimin e *uo-së* në *ua* po në atë dialekt. Për këtë grupim të shqipes mund të na rezultojë mbase një lidhje edhe më e hapët po ta vemë atë në krahasim me diftongimin e *o-së* në *oa* të rumanishtes në ballë e në trup fjale (*hospitem / oaspet, noctem / noapte*). Kjo pra do të ishte një nga ato isoglosat fonetike (ose shkurt izofonat) që ekzistojnë midis dy gjuhëve ballkanike, për të cilat, pas Kr. Sandfeldit, ka tërhequr vëmendjen sidomos V. Pisani (E. Çabej, *Disa faza më të moçme të shqipes në dritën e gjuhëve fqinje, Revistë shkencore e Institutit Pedagogjik Dyvjeçar të Shkodrës*, Shkodër, 1964, 1, f. 7).

²⁴ Për të gjitha këto dukuri shih: N. Jokl, *Linguistisch-kulturhistorische Untersuchungen aus dem Bereiche des Albanischen*. Berlin und Leipzig 1923; P. Skok, *A propos du nasalisme et du rhotacisme roumaino-albanais, Arhiv za arbanasku starinu, jazyk i etnologiju*, Beograd, 1921, f. 334; Kr. Sandfeld, *Linguistique balkanique*, f. 1930, f. 6, 114; A. Rosetti, *Melanges de linguistique et de philologie*, București, 1947, f. 157; *Sur les voyelle roumaines ä /ë/ et / î /* në *Melanges linguistiques*, București, 1977, f. 141; “Rhotacisme” et “pseudo-rhotacisme” en roumain, *Revue roumaine de linguistique*, București, vll. XIX, 1974/4, f. 399-400; A. Vaillant, *Manuel de vieux slave*, vll. 1, *Grammaire*, Paris, 1948, f.16, 26; G. Rohlfs, *La perdita dell’infinitonelle lingue balcaniche e nell’ Italia meridionale, Omagiu lui Iorgu Iordan*, București: 1958, f. 733-744; E. Çabej, *Disa faza më të moçme të shqipes në dritën e gjuhëve fqinje, Revistë shkencore e Institutit Pedagogjik Dyvjeçar të Shkodrës*, Shkodër, 1964, 1, f. 7; Vl. Georgiev, *Vokalnata sistema v razvoja na slavjanskite ezici*, Sofija, 1964, f. 63; K. Mirčev, *Bëlgarskijat ezik prez vekovete*, Sofia, 1964, f. 43; B. Koneski,

Pra, nuk ndeshen në greqishte fonema zanore e theksuar /ë /, dukuria e rotacizmit të *n*-së ndërzanore, kalimi i *vo*-së në *va* me të cilin në shqipen e jugut (toskërishten) shkon paralel edhe kalimi i *uo* në *ua*, çka përjashton edhe mundësinë e ndikimit të greqishtes në këto zhvillime të toskërishtes.

Së dyti, këto dukuri në tërësinë e tyre nuk gjenden as në maqedonishte, as në bullgarishte. Por, edhe kur ekziston ndonjëra prej tyre siç është për shembull prania e zanores *ë* të theksuar në maqedonishte dhe bullgarishte, ajo është zhvilluar në këto gjuhë në periudhën ndër-mjet shek. XII-XIII²⁵, pra, është shumë më e re në kohë se *ë*-ja e theksuar e toskërishtes²⁶. Madje B. Koneski ka pranuar mundësinë e ndikimit të shqipes ose të arumanishtes në kalimin e *ô* > *b* (*ë*) në maqedonishte (përjashtuar të folmet veriore të saj)²⁷.

Po kështu edhe humbja e hundorësisë në maqedonishte e bullgarishte është një dukuri relativisht e re; hundorësia ka filluar të zhduket në maqedonishte në shek. XII, kurse në bullgarishte në shek. XIII²⁸.

Kështu që përjashtohet edhe mundësia e ndikimit të bullgarishtes e maqedonishtes në këto zhvillime të shqipes dialektore.

Istorija na makedonskijot jazik, Skopje, 1967, f. 26-28, 40-45; Vl. Georgiev, *Le problème de l'union linguistique balkanique*, **Actes du Premier Congrès International des Études Balkaniques et Sud-Est Européennes, VI, Linguistique**, Sofia, 1968, f. 10; M. Iliescu, *Encore sur la perte de l'infinifit en roumain*, **Actes du Premier Congrès International des Études Balkaniques et Sud-Est Européennes, VI, Linguistique**, Sofia, 1968, f. 115; L. Vuković, **Istorija srpskohrvatskog jezika, I, Fonetika**, Beograd, 1974, f. 94; M. Sala, **Contribution à la phonétique historique du roumain**, Paris, 1976, f. 189, 223.

²⁵ K. Mirčev, **Bëlgarskijat ezik prez vekovete**, Sofia, 1964, f. 60; B. Koneski, **Istorija na makedonskijot jazik**, f. 26-28.

²⁶ W. Meyer-Lübke, *Rumänisch, romanich, albanesisch*, në **Mitteilungen des Romanischen Instituts an der Universität Wien, I** Heidelberg, 1914, f. 41; B. Beci, **Probleme të lidhjeve të shqipes me gjuhët ballkanike**, Pejë, 2002, f.63-64; (shih edhe **Studime filologjike** 1982, 3). Sh. Demiraj, **Gjuha shqipe dhe historia e saj**, f. 234-235; **Gjuhësi ballkanike**, f. 81; **Fonologjia historike e gjuhës shqipe**, 1996, f. 69.

²⁷ B. Koneski, **Istorija na makedonskijot jazik**, f. 26-29.

²⁸ K. Mirčev, **Bëlgarskijat ezik prez vekovete**, f. 60; B. Koneski, **Istorija na makedonskijot jazik**, f., 26-29.

Lidhjet me rumanishten

Lidhjet me rumanishten nuk mund të përjashtohen apriori, aq më tepër kur dihet që këto dukuri në shqipe²⁹ dhe rumanishte³⁰ janë të hershme.

Siç thamë janë të përbashkëta për shqipen e jugut ose toskërishten dhe rumanishten mungesa e kundërvënies sipas hundorësisë dhe sipas gjatësisë, prania e fonemës *ë* të theksuar, rotacizmi, kalimi i *vo-së* në *va-* (në rumanishte i *o-së* në *oa*), paralelisht me kalimin e *ou-së* në *ua* në toskërishte, si edhe zëvendësimi i paskajores me lidhoren.

P. Skok, H. Bariç dhe A. I. Balota kanë parë mundësinë e ndikimit të shqipes në rotacizmin dakorumun³¹. P. Skok, duke kundërshtuar Rosetin dhe Prokopeviçin që hedhin poshtë çdo raport të hundorësisë dhe të rotacizmit rumun me hundorësinë gege dhe rotacizmin toskë, ka shkruar: “unë jam i bindur se në këtë çështje, si në shumë të tjera, janë pikërisht faktet e shqipes që na ndihmojnë për të gjetur zgjidhjen sadopak të kënaqshme”, “ka prova, vazhdon ai, nga të cilat del që rotacizmi istrorumun duhet të ketë ndodhur në jug të Danubit, diku në Ballkan. Unë nuk dua të them tani për tani, për shkak të mungesës së provave bindëse, që kjo mund të ketë ndodhur në fqinjësi me toskërishten”³².

A. B. Balota ka pranuar që trajtimi i njëjtë i *n-së* ndërzanore në pozicion hundor në rumanishten veriore dhe në shqipen toske na shtyn të pranojmë origjinën shqiptare të rotacizmit³³.

Përpjekja e V. Polakut për ta shpjeguar këtë dukuri të toskërishtes me një lloj imitimi të *n-së* kakuminale të shqipes nga bullga-

²⁹ B. Beci, **Probleme të lidhjeve të shqipes me gjuhët e tjera ballkanike**, Pejë, 2002, f. 163-164.

³⁰ M. Sala, **Contribuții la fonetica istorică a limbii române**, f. 57. **Contributions à la phonétique historique du roumain**, f. 223.

³¹ P. Skok, *A propos du nasalisme et du rhotacisme roumaino-albanais*, **Arhiv za arbanasku starinu, jazik i etnologiju**, Beograd, 1921, f. 334; H. Bariç, **HËmje në historin e gjuhës shqipe**, Prishtinë, 1955, f. 68; A. Balotă, **La nasalisation et le rhotacisme dans les langues: roumaine et albanais**, București, 1926, f. 150-161, 174.

³² P. Skok, *A propos du nasalisme et du rhotacisme roumaino-albanais*, **Arhiv za arbanasku starinu, jezik i etnologiju**, Beograd, 1921, f. 334.

³³ A. Balotă, **La nasalisation et le rhotacisme dans les langues: roumaine et albanaise**, Bucarest, 1926., f. 150-161, 171.

rosllavët është hedhur poshtë³⁴.

Majer-Lybkeja ka mbrojtur pikëpamjen që hundorësia e bashkë me të edhe rotacizmi i toskërishtes janë procese të zhvilluara para marrëdhënieve të shqipes me sllavishten³⁵ Sipas Çabejt, “Nazalizmi i shqipes ka një lidhje historike me atë të rumanishtes”, “në të dyja këto gjuhë edhe rotacizmi lidhet me nazalizimin”³⁶. Një mendim të ngjashëm me Çabejn ka shprehur edhe O. Densusianu, kurse Avrami bën një varg vërejtjesh kundër një mendimi të tillë³⁷.

Demiraj shton që “dukuria e hundorësisë në këto dy gjuhë është shoqëruar edhe me shfaqjen e zanores /ë/ në mbarë rumanishten dhe në dialektin jugor të shqipes, si edhe me rotacizmin në dialektin jugor të shqipes, si edhe në disa dialekte të rumanishtes” dhe se “hundorëzimi i zanoreve në këto dy gjuhë është një dukuri kryesisht parasllave, pra relativisht e vjetër”.

Konkluzioni në të cilin arrin Demiraj është se “kemi të bëjmë me një dukuri të zhvilluar paralelisht (në mënyrë të pavarur) në dy gjuhë simotra, që kanë pasur një sistem gjuhësor të ngjashëm, i cili i është nënshtruar një evolucioni të ngjashëm”³⁸.

Në dallim nga Demiraj, të tjerë, duke folur për hundorësinë e zanoreve në shqipe e rumanishte kanë insistuar se “një lidhje e dukurive të shqipes me rumanishten në këtë pikë ka mbështetje në faktorin kronologjik, meqenëse zhvillimin e saj të plotë në gjuhën shqipe kjo dukuri e ka pasur në Mesjetën e hershme, para ardhjes së sllavëve në Ballkan. Kjo është arsyeja që gjuhëtarët e ndryshëm, sidomos ballkanistët, i kanë dhënë përgjigje pozitive çështjes që shtron Majer-Lybkeja për lidhjen me rumanishten në këtë pikë”³⁹.

Ndër të tjera edhe G. Brënkush ka pranuar se terminologjia baritore (në shqipe) është shumë më e pasur se sa në rumanishte ... çka

³⁴ R. Ismajli, **Artikuj mbi gjuhën shqipe**, Prishtinë, 1987, f. 176-171.

³⁵ W. Meyer-Lübke, *Rumänisch, romanisch, albanesisch*, në **Mitteilungen des Romanischen Instituts an der Universität Wien**, I Heidelberg, 1914. f. 41-42.

³⁶ E. Çabej, *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe.*, Tiranë, 1960, f. 115.

³⁷ Sh. Demiraj, **Fonologjia historike e gjuhës shqipe**, Tiranë, 1996, f. 79-80.

³⁸ Sh. Demiraj, **Fonologjia historike e gjuhës shqipe**, f. 79-80.

³⁹ Sh. Demiraj, **Fonologjia historike e gjuhës shqipe**, f. 79-80; K. Topalli, **Për historinë e hundorësisë së zanoreve në gjuhën shqipe**, Tiranë, 1996, f. 53.

regon, sipas tij, se ky tip qytetërimi material që kanë zhvilluar shqiptarët në kohët e lashta mund të jetë marrë si model nga secilido popull ballkanik, duke përfshirë edhe rumunët. Prandaj termat teknikë baritorë ka mjaft mundësi, vazhdon ai, që të interpretohen në rumanishte si të huajtura nga shqipja⁴⁰.

Kr. Sandfeld, duke folur për lidhjet gjuhësore ndërmjet shqipes dhe rumanishtes ka nënvizuar se “të gjitha këto lidhje midis shqipes dhe rumanishtes nuk mund të jenë rezultat i rastësisë”, “shumica e gjuhëtarëve të huaj, vazhdon ai, kanë shikuar në raportet e ngushta të shqipes e rumanishtes miratimin e faktit që ... kombësia rumune është zhvilluar në shekujt e parë të erës sonë, në Jug të Danubit, në kontakt intim me shqiptarët dhe shtrirja e sotme e rumunëve i dedikohet një imigracioni të mëvonshëm. Kjo hipotezë, që mund të mbrohet edhe me argumente të tjera, përputhet me faktin që një popullsi rumune, arumunët, janë të përhapur sot edhe në jug të Danubit...”⁴¹.

Të gjitha këto na shtyjnë të mendojmë për një rol më të rëndësishëm se ç’është menduar deri tani të shqipes a të parashqipes në zhvillimin e elementeve të përbashkëta gjuhësore ballkanike.

Probleme të etnicitetit të popujve të lashtë të Ballkanit

Në këto rrethana është me rëndësi t’i vështrijmë kushtet historike, situatën etnike dhe rolin e elementit etnik shqiptar a parashqiptar në këtë territor.

J. Thunman duke folur për origjinën e popullit shqiptar ka shkruar: “Populli i parë që njeh historia në këtë vend (ka parasysht territoret perëndimore të Ballkanit) janë ilirët, një popull i madh, i shumë në numër dhe i fuqishëm, që, sipas Strabonit dhe Apianit, banonte në detin Adriatik, nga lumi Po deri në Gjirin e Ambrakisë e në veri deri në Danub... . Apiani thotë shprehimisht se panonët ilirë, istrianët, japodët, dalmatët, liburnët, dardanët, ardianët, autariatët e, me një fjalë, të gjithë popujt deri në malet Keraune, përgjithësisht njiheshin si ilirë. Por ata gjendeshin kudo në Maqedoni, në Epir e në Thesali...”

⁴⁰ G. Brîncus, *Probleme ale reconstrucției elementelor lexicale autochtone în română comună*, **Studi și cercetări lingvistice**, București, 1966, 2, f. 209 (botuar edhe në **Studime filologjike**, Tiranë, 1966, 1).

⁴¹ Kr. Sandfeld, *Linguistique balkanique*, f. 141-142.

Edhe në Epir banonin vetëm popuj jogrekë, të cilët, siç u vu re më parë, flisnin gjuhën maqedone ose, çka është e njëjtë, gjuhën ilire⁴². J. G. Hahn insistonte që *epirotët, maqedonët dhe ilirët ishin fise të afërta me njëri-tjetrin, ose me prejardhje të përbashkët*.⁴³ Sipas R. Katičićit, për autorët e vjetër grekë, jo vetëm trakasit dhe ilirët, po edhe maqedonasit dhe epirotët ishin “barbarë”⁴⁴ term me të cilin grekërit, siç dihet, emërtonin popujt e tjerë, jo grekë⁴⁵.

Kurse për sa i përket gjuhës së maqedonasve ai ka shkruar se “është fare i paarsyeshëm fakti që disa dijetarë provojnë të dëshmojnë se çdo shkencëtar që dyshon nëse maqedonasit kanë qenë me origjinë greke është ose i painformuar ose pa vullnet të mirë”⁴⁶.

Pra, mundësia që maqedonasit të mos kenë qenë grekë, po ilirë ose të afërt me ilirët nuk mund të përjashtohet apriori.

Sipas E. Çabej teza e afërsisë së Epirotëve, Ilirëve dhe Maqedonasve është sot një mendim i pranuar pothuajse gjithkund, sepse edhe ato pak dëshmi që kanë ngelur nga gjuhët e këtyre popujve, flasin qartë për një afërsi të tillë⁴⁷.

Madje ka studiues që insistojnë që “rënjtë etnike të maqedonasve të lashtë kanë qenë, sipas të gjitha gjasave, ilire, ndonëse shtresa e lartë në atë kohë kishte rënë nën ndikimin e kulturës greke”⁴⁸.

Burimet më të vjetra historike tregojnë që edhe popullsia e vjetër e Epirit i përkiste shtresës etnike ilire⁴⁹.

⁴² J. Thunman, *Gjurmë rreth historisë së popujve të Evropës lindore*, Leipzig, 1774. Shih J. Kastrati, **Historia e albanologjisë**, Tiranë, 2000, f. 394.

⁴³ J. G. Hahn, *Albanesische Studien*, 1854, f. 211-217.

⁴⁴ R. Katičić, **Ancient languages of the Balkans**, The Hague-Paris, 1976, f. 100-107. Sh. Demiraj, **Prejardhja e shqiptarëve nën dritën e dëshmimeve të gjuhës shqipe**, Tiranë, 1999, f. 50.

⁴⁵ R. Katičić, **Ancient languages of Balkans**, f. 104. Sipas Katičićit Demosteni *Filipin e Maqedonisë* e konsideronte *barbar*. Sipas historianit romak Justin populli i Maqedonisë së vjetër quhej pellazg (Shih **Ilirët dhe Iliria tek autorët antikë**, Tiranë, 2002, f. 151).

⁴⁶ Shih R. Ismajlit, **Artikuj mbi gjuhën shqipe**, Prishtinë, 1987, f. 231.

⁴⁷ E. Çabej, **Studime gjuhësore**, Prishtinë, 1997, III, f. 43 -44.

⁴⁸ B. Jelavich, **Historia e Ballkanit, V I**, Tiranë 1999, f. 20.

⁴⁹ J. Thunman, **Untersuchungen über die Geschichte der östlichen europäischen Völker**, Leipzig, 1774, f. 245; J. G. Hahn, **Albanesische Studien**, Wien, 1854, f.

Me emrin Epir në antikitetet njihej rajoni që shtrihej nga malet Akrokeraune (Himara) në veri, dhe deri tek gjiu i Ambrakisë në jug dhe nga brigjet e detit Jon në perëndim deri në vargmalet Pindit në lindje⁵⁰.

Tukididi historian i shekullit të V p.e. re, Straboni, gjeograf në ka-përçyell të erës së re dhe Stefan Bizantini i shekullit VI-të të erës sonë i kanë përcaktuar banorët e Epirit si “barbarë”⁵¹. Ephore, bashkohës i Tukididit, në përshkrimin e tij të Greqisë e lë jashtë Epirin⁵². Pseud-Scylax-i, gjeograf grek i shekullit të IV, ka shkruar se “Pas Molosisë është Ambracia, qytet grek... Këtu fillon Greqia, pa ndërprerje deri tek lumi Penenes...”⁵³. J. G. von Hahn ka shkruar se “Shkumbini i ndan sot gegët dhe toskët sikundër që ka ndarë që moti stërgjyshërit e tyre ilirët dhe epirotët që kishin afrim gjaku...”. Sipas tij “zona në jug të Shkumbinit deri në gjirin e Ambrakisë ka qenë e banuar nga fise epirote, nga pikëpamja etnike të të njëjtës shtresë si edhe ilirët...”⁵⁴.

Për këtë flasin edhe zhvillimet fonetike të emrave të vendeve të dëshmuara në këto territore nga koha antike ose Mesjeta e hershme si: *Aulona* > *Vlona* / *Vlora*, *Tamarus* > *Tomor*, *Aoos* > *Vjosë*, *Arachthos* > *Artë*, *Germinium* > *Dhërmi*, *Xııaıpa* > *Himarë*, *Thyamıs* > *Çam* etj. të cilët dëshmojnë se kanë qenë pandërprerje në gojën e shqiptarëve dhe se vetëm gjuha shqipe ka mundur t'u japë trajtën që kanë sot⁵⁵.

211-217; P. Kretschmer, *Einleitung in die Geschichte der griechischen Sprache*, Göttingen, 1896, f 254; M. P. Nilson, *Studien zur Geschichte des alten Epeiros*, Lund Ohlson, 1909, f. 7.

⁵⁰S. Islami, *L'Épire ancienne, Réflexions sur le problème ethnique*, *Studia albanica*, Tiranë, 1992, 1-2, f. 93.

⁵¹R. Katičić, *Ancient languages of the Balkans*, 1976, f. 120. Sh. Demiraj, *Epiri, pellazgët, etruskët dhe shqiptarët*, Tiranë, 2008, f. 60.

⁵²*Histoire de l'Albanie des origines à nos jours*, Paris, 1974, p. 17-18. S. Islami, *L'Épire ancienne, Réflexions sur le Sproblème ethnique*, *Studia albanica*, Tiranë, 1992, 1-2, f 93.

⁵³S. Islami, *L'Épire ancienne*, *Studia albanica*, Tiranë, 1992, 1-2, f. 93.

⁵⁴J. G. von Hahn, *Albanesische Studien*, Jena, 1854, I, f 218-219. F. Miklosich gjithashtu u është referuar pohimeve të Hahnit në *Albanische Forschungen*, Wien, 1871, f. 3.

⁵⁵E. Çabej, *Problemi i autoktonisë së shqiptarëve në dritën e emrave të vendeve*, **BUSHT, SSHSH**, Tirana, 1958, 2, f. 54; *Vendbanimi i hershëm i shqiptarëve në Gadishullin Ballkanik në dritën e gjuhës e të emrave të vendeve*, **BUSHT, SSHSH**; Tirana, 1962, f 222-223; W. Cimochoowski, *Des recherches sur la toponomastique de l'Albanie*, **Lingua Posnaniensis**, VIII, 1960, f 133; S. Mansaku, *Autoktonia e shqiptarëve në dritën e të dhënave të toponimisë së lashtë*, **Studime filologjike**, Tirana, 1983, 3, f. 111;

Edhe N. G. L. Hammond ka pohuar se "Dëshmitë arkeologjike tregojnë se kultura greke, siç shfaqet në poçeri dhe objekte të tjera, nuk depërtoi në Epirin e brendshëm, me përjashtim të Dodonës dhe atje vetëm në një masë të kufizuar, deri në shekullin VI. Dëshmitë historike në përgjithësi dhe përshkrimi i tribuve të Epirit të brendshëm si barbarë nga Tukididi, Straboni dhe Stefan Bizantini janë në harmoni me dëshmitë arkeologjike. Prandaj nuk mund të merret seriozisht ideja që gjuha greke u përhap prej qyteteve greke në bregdet dhe zëvendësoi një gjuhë jogreke gjatë shekullit të pestë ose të gjashtë. Iliria qendrore ishte gjeografikisht shumë më e hapur për depërtim nëpërmjet Epidamnit, Apolonisë dhe Bylisit, por gjuha greke nuk e zëvendësoi gjuhën ilire atje në shekullin IV ose më vonë"⁵⁶.

Sipas historianëve që kur fillojnë të dalin dokumentet e para me karakter etnik (shekujt XII-XIII) shqiptarët paraqiten si banorë autoktonë të Epirit. "Gjatë gjithë Mesjetës dhe deri në Kohët e reja, shkruan historianit P. Xhufi, Epiri ka qenë një territor kryesisht shqiptar. Nga pikëpamja etnike, Epiri ishte një territor shqiptar që i është nënshtuar një procesi të vazhdueshëm helenizimi dhe për pasojë dezalbanizimi"⁵⁷.

Ata kanë pohuar gjithashtu që gjatë Mesjetës territoret përgjatë vijës Nish-Shkup-Manastir- Kostur-Janine-Artë kanë qenë të banuara kryesisht nga shqiptarë dhe kjo vijë përbën kufirin lindor të etnisë shqiptare. Në një dokument të shekullit XIV (1390) përmenden si pjesë përbërëse të Arbërisë Kosturi, Konica. Sipas Gjon Muzakës (1510) kufiri lindor i Arbërisë ishte Bullgaria dhe malet e Peristerit (Pindi)⁵⁸.

Në shekullin XIV shqiptarët përbënin një element demografik shumë të pranishëm edhe në Thesali. Defterët e Turqisë të shekullit XIV i paraqesin ata si popullsinë e dytë përsa i përket numrit, duke i renditur menjëherë pas grekëve. Dokumentet e shekullit XIV brenda konceptit "shqiptar" përfshinin edhe rrethet e Pogonit, Konicës dhe Kosturit. Edhe

R. Ismajli, *Prejardhja e gjuhës shqipe*, Prishtina, 1987, f.12; Sh. Demiraj, *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, Tiranë, 1988, p 154-181;

⁵⁶ N. G. L. Hammond, *Epirus*, Oxford, 1967, f. 423. Shih edhe Sh. Demiraj, *Epiri, pellazgët, etruskët dhe shqiptarët*, 2008, f. 68.

⁵⁷ P. Xhufi, *Migrimet shqiptare në Greqi në shekullin XIV*, *Studime historike*, Tiranë, 1991, 3-4, f. 7.

⁵⁸ K. Biçoku, *Viset etnike shqiptare në Mesjetë dhe përhapja e emrit kombëtar Arbër, (Arbëri, Albani)*, *Studime historike*, Tiranë, 1992, 1-4, f. 28.

gjatë pushtimit serb të Thesalisë (1348-1384) shqiptarët përmenden si një element themelor i Thesalisë perëndimore dhe veriperëndimore. Ka, pra, arsye ta konsiderojmë Thesalinë perëndimore si vendbanim të vjetër të shqiptarëve. Nuk ka asnjë të dhënë që të vërtetojë një kolonizim shqiptar të Thesalisë para, gjatë ose pas shekullit XIV⁵⁹.

Pra, siç ka theksuar E Çabej “territori i sotëm i shqiptarëve nuk është rezultat ekspansioni, po rezultat i një ngushtimi të paprerë gjatë historisë shqiptare”⁶⁰.

Këtu është me rëndësi të shënojmë që P. Asenova ka theksuar që nyjën e proceseve konvergjente në Ballkan e formojnë dialektet jugore të shqipes, dialektet serbe të Prizren-Timokut, dialektet bullgare jugperëndimore, dialektet greke veriore (Epir, Maqedoni) dhe arumanishtja.

Sipas saj “rolin e një qendre ballkanike e ka luajtur pjesa jugperëndimore e gadishullit ndërmjet luginave të lumenjve Vjosa e Vardar, domethënë jugu i Shqipërisë, Epiri dhe Maqedonia perëndimore. Për M. Pavlović, vazhdon ajo, kjo zonë ballkanike qendrore është Epiri grek dhe shqiptar”⁶¹.

Edhe O. J. Nasteva ka ngulur këmbë që qytetet Ohër, Elbasan, Voskopojë, Korçë, Janinë, Kostur, Lerin, dhe Sollyn paraqesin rajonin ekonomik e politik nga janë nisur gjatë shekujve shumë ballkanizma në dialektet dhe zonat gjuhësore fqinje⁶².

Si përfundim mund të thuhet se të dhënat e gjuhës shqipe flasin në të mirë të një roli më të madh se ç’është menduar deri tani të gjuhës shqipe, ose parashqipes, në zhvillimin e tipareve të përbashkëta gjuhësore të gjuhëve ballkanike⁶³. Edhe G. R. Solta ka mbrojtur të njëjtën pikëpamje⁶⁴.

⁵⁹ P. Xhufi, *Migrimet shqiptare...*, **Studime historike**, Tiranë, 1991, 3-4, f. 8.

⁶⁰ E. Çabej, *Problemi i vendit të formimit të gjuhës shqipe*, **Studime gjuhësore**, V, Prishtinë, 1975, f. 29.

⁶¹ P. Asenova, *Aperçu historique des études dans le domaine de la linguistique balkanique*, **Linguistique balkanique**, Sofija, 1979, XXII, 1, f. 12.

⁶² O. J. Nasteva, *Prilog kon proučevanieto na leksičkite balkanizmi vo makedonskiot jazik*, **Makedonski jazik**, 1974, p. 223.

⁶³ Shih E. Çabej, *Kontributi i shqipes në formimin e lidhjes gjuhësore ballkanike*, **Studime filologjike**, Tiranë, 1970, 4, f. 3-21 botuar gjermanisht edhe në librin **Les problèmes fondamentaux de la linguistique balkanique**, Sofie, 1966, f. 47-65.

⁶⁴ G. R. Solta, *Einführung in die Balkanlinguistik mit besonderer Berücksichtigung des Substrats und des Balkanlateinischen*, Darmstadt, 1980, f. 233, 121.

Ajo që deshëm të bënim përmes kësaj kumtese ishte të tërhiqim vëmendjen në një aspekt që na duket se nuk është vënë në dukje sa duhet dhe pikërisht në rolin e shqipes a parashqipes në formimin e bashkëpërkimeve gjuhësore ballkanike.

Sigurisht do të duhen kërkime të tjera për t'i bërë të pranueshme këto pikëpamje, po gjithsesi mendojmë se kërkimet duhet të vazhdojnë edhe në këtë drejtim.

Bardh RUGOVA, Prishtinë

POZITA DHE STATUSI I SHQIPES KUNDRUALL GJUHËVE TË TJERA TË BALLKANIT

Abstrakt

Gjuha shqipe që nga standardizimi i saj më 1972 ka kaluar në tri faza të ndryshme shoqëro-politike me ndikim për zhvillimin e saj. Faza e parë është ajo nga viti 1972 deri në fillim të viteve nëntëdhjetë, kur bëhet kalimi nga shoqëria totalitare në shoqëri demokratike në Shqipëri dhe në ish-Jugosllavi, dy vendet ku shtrihej pjesa më e madhe e folësve të shqipes. Faza e dytë, përfshin vitet nëntëdhjetë, deri në përfundimin e Luftës së Kosovës – shpërbërjen e ish-Jugosllavisë dhe pluralizmin në Shqipëri. Faza e tretë është ajo e pas luftërave në Kosovë, në Luginë të Preshevës dhe në Maqedoni.

Në asnjërën nga këto faza, shqipja standarde e folur, si çdo gjuhë standarde, nuk është identike dhe unike në të gjitha hapësirat ku flitet (Ismajli 2002:161). Ajo, thuajse në të gjithë arealin e saj është në kontakt me gjuhë të tjera, ndonëse raporti me ato gjuhë ndryshon varësisht nga vendi.

Një vështrim i statusit dhe i pozitës së shqipes kundruall gjuhëve të tjera të Ballkanit e dëshmon këtë.

Pozita e shqipes në kuadër të gjuhëve të Ballkanit është trajtuar në studime të mëhershme (Beci 2002, Ismajli 2002), siç është trajtuar edhe statusi (Ismajli 2002, Munishi 2009, Kramer 2010). Një vështrim i punimeve të deritashme kundruall gjendjes në terren mëton të tregojë rrjedhat dhe transformimet e pozitës dhe të statusit të shqipes në kontakt me gjuhët e tjera të Ballkanit në vitet e fundit.

Fjalët kryesore: Gjuhë standarde, status i gjuhës, gjuhë të Ballkanit, gjuhë e prestigjit, gjuhë në kontakt

Shekulli i shkuar ka qenë i kapluar nga ndryshime të mëdha politike në Ballkan, të përshkuara me themelime të shteteve nga shpërbërja e perandorive dhe shteteve shumëgjuhësore (Perandoria Osmane dhe ish-Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë), krijime të kufijve të rinj dhe ndryshim i tyre, zhvendosje popullate, duke nxitur me to, shpeshherë, edhe ndryshim të pozitës dhe të statusit të gjuhëve nga ato minoritare në gjuhë të shumicës dhe anasjelltas. Shqipja këtu nuk përbën përjashtim.

Gjuha shqipe që nga standardizimi i saj më 1972 ka kaluar në tri faza të ndryshme shoqëro-politike me ndikim për zhvillimin e saj. Faza e parë është ajo nga viti 1972 deri në fillim të viteve nëntëdhjetë, kur bëhet kalimi nga shoqëria totalitare në shoqëri demokratike në Shqipëri dhe në ish-Jugosllavi, dy vendet ku shtrihej pjesa më e madhe e folësve të shqipes. Në këtë fazë, shqipja në ish-Jugosllavi është gjuhë e rendit të dytë, ndërsa gjuhë zyrtare, e prestigjitetit dhe e funksioneve të tjera shtetërore është serbo-kroatishtja, ndonëse i kushtohet mjaft vëmendje, në Kosovë sidomos, kultivimit të gjuhës shqipe.

Faza e dytë, përfshin vitet nëntëdhjetë, deri në përfundimin e Luftës së Kosovës – shpërbërjen e ish-Jugosllavisë dhe pluralizmin në Shqipëri. Gjatë kësaj kohe, aparati që kujdesej për shqipen standarde dhe kontrollin e saj në Shqipëri zbehet, ndërsa mbyllja e televizioneve në gjuhën shqipe dhe degradimi i sistemit shkollor i japin një status edhe më të errësuar shqipes në Kosovë. Ndikimi i televizioneve shton numrin e ndikimeve të serbishtes. Mirëpo, si pasojë e sistemit “të nëntokës” të arsimit, serbishtja nuk është më gjuhë e shkollës. Numri i fëmijëve që e mësojnë shqipen bie. Sa për ilustrim hulumtimi për numrin e studentëve që e flasin serbishten në vitin 2000 dhe 2001 është 4 për qind, duke pasur një defekt në hulumtim, pasi që nuk është marrë parasysh fare sfondi etnik i studentit. Kjo nënkupton që kjo përqindje do të mund të jetë edhe më e vogël. Në këtë periudhë, kufiri Shqipëri – Kosovë mbetet i mbyllur, por hapet mundësia e kontaktit të shqiptarëve të Maqedonisë me Shqipërinë.

Faza e tretë është ajo e pas luftërave në Kosovë, në Luginë të Preshevës dhe në Maqedoni. Krijohet kontakt më i lirë mes shqiptarëve në anë të ndryshme të kufirit dhe ndryshon pozita juridike e shqiptarëve në Kosovë, në Luginë të Preshevës, në Maqedoni dhe në Mal të Zi. Në asnjërën nga këto faza, shqipja standarde e folur, si çdo gjuhë standarde, nuk është identike dhe unike në të gjitha hapësirat ku flitet (Ismajli 2003:161). Ajo, thuajse në të gjithë arealin e saj është në kontakt me gjuhë të tjera, ndonëse raporti me ato gjuhë ndryshon varësisht nga vendi. Një vështrim i statusit dhe i pozitës së shqipes kundruall gjuhëve të tjera të Ballkanit e dëshmon këtë. Pozita e shqipes në kuadër të gjuhëve të Ballkanit është trajtuar në studime të mëhershme (Beci 2002, Ismajli 2003), siç është trajtuar edhe statusi (Ismajli 2003, Munishi 2009, Kramer 2010). Një vështrim i punimeve të deritashme

kundruall gjendjes në terren mëton të tregojë rrjedhat dhe transformimet e pozitës dhe të statusit të shqipes në kontakt me gjuhët e tjera të Ballkanit në vitet e fundit.

Megjithatë, një pjesë e shënimeve zyrtare që përdoren edhe nga lingvistë të ndryshëm kanë nevojë për rishikim. Sa për ilustrim, SIL, burimi, ndoshta primar i studiuesve për të dhëna teknike për gjuhët, ofron të dhëna se arbnesët e Zarës janë toskë (sic), se në Maqedoni të gjithë shqiptarët janë gegë (sic). Natyrisht, pohime që është e tepërt edhe të komentohen. Shqiptarët sot formojnë areale gjuhësore në pjesën jugperëndimore të Ballkanit, ndërsa diaspora e saj shtrihet edhe në jug të Italisë, në bregdetin e Kroacisë, në Bullgari, në Ukrainë. Pjesa më e madhe gjëllon në trevat e Ballkanit – numri i përafërt, sipas shënimeve të Islamit (1994), është rreth 6,5 milionë shqiptarë (të dhënat e viteve të fundit janë të diskutueshme, për shkak të defekteve serioze të regjistrimit të popullsisë në Kosovë, në Serbi dhe në Maqedoni). Pjesa më e madhe jeton në Republikën e Shqipërisë, hulumtimi i vitit 2010 jep shifrën prej 3,19 milionë banorë që është për më shumë se 100.000 banorë më pak se njëzet vjet më parë, më 1990.

Të dhënat më të besueshme për Kosovën janë ato të Entit të Statistikave e vitit 2005 dhe shënimet e CIA-s World Factbook, që sjellin popullatën e Kosovës mes 1,9 milionë dhe 2,2 milionë banorë, nga të cilët shqiptarë janë 88 – 92 për qind – rreth 1,7 milionë sa ka qenë edhe numri i banorëve të Kosovës në censusin e fundit të plotë në ish-Jugosllavi më 1981 – 1,73 milionë banorë, nga të cilët mbi 1,2 milionë shqiptarë. Shënimet e censusit të fundit nuk po i diskutojmë, ngase edhe më pare i kemi konsideruar jobindëse, për shkak të defekteve serioze metodologjike dhe praktike.

Në ish-Republikën Federative të Maqedonisë, shqiptarët, sipas të dhënave të censusit të vitit 2002, përbëjnë pak mbi gjysmë milioni banorë, 25,17 për qind e popullatës së përgjithshme. Afër katër për qind e popullatës janë regjistruar si turq.

Në Malin e Zi, po ashtu, ka raport të diskutueshëm. Të dhënat e vitit 2003 tregonin për 620 mijë banorë, nga të cilët 48.184 shqiptarë, apo afër 8 për qind. Censusi i vitit 2011, jep po atë numër të përgjithshëm të banorëve, por vetëm 30.000 shqiptarë të regjistruar – 4,91 për qind. Në Serbi, në rajonin, i cili pas luftës së fillimit të viteve dymijë u bë i njohur si Lugina e

Preshevës, jetojnë mbi 55 shqiptarë – sipas të dhënave të vitit 2002, në Preshevë mbi 31.000, në Bujanovc mbi 23.000 dhe në Medvegjë më pak se 2000. Në Greqi jetojnë dy grupe të popullsisë shqiptare: çamët dhe arvanitët. Beci (2002:15) pohon për 100.000 shqiptarë në Çamëri. Sipas të dhënave të SIL http://www.ethnologue.com/show_language.asp?code=aat në Greqi janë rreth 150.000 arvanitë, por vetëm 50.000 që e dinë gjuhën. I njëjti burim flet për 15.000 folës të arbnishtes në Zarë, Kroaci. Kovaçec (1992) pohon për disa qindra folës. Itali – 80.000 folës, popullata etnike mbi 250.000 (SIL) Në Ukrainë 5000 folës (SIL) - ky burim i njeh si gjuhë të rrezikuara të gjitha këto, ndonëse të rrezikuara rëndë arbnishten dhe arvanitishten. Thashë më parë shënimet e SIL-it janë në shumë raste fare të gabueshme. Në secilin nga këto vende shqipja ka kontakte të ndryshme dhe status të ndryshëm nga vendet e tjera. Munishi (2009) në punimin e tij për politikën gjuhësore të BE-së dhe barazinë e gjuhëve në Kosovë konstaton se në gjuhë reflektohen vetëdija, mentaliteti, botëkuptimet dhe vlerat e asaj bashkësie gjuhësore, por në të njëjtën kohë edhe sfidat, problemet dhe vështirësitë, me të cilat përballlet ajo bashkësi. Të shumtën e rasteve një bashkësi gjuhësore e caktuar jeton dhe vepron në një territor të përbashkët me një a më shumë bashkësi të tjera gjuhësore, të cilat flasin gjuhë të ndryshme dhe në raportet dhe qëndrimet reciproke midis këtyre bashkësive reflektohen edhe raportet e gjuhëve që përdorin ato bashkësi. Gjuha shndërrohet në parametrin kryesor matës të lirisë së individit a të grupit shoqëror. Rasti i shqipes i ilustron më së miri këto pohime.

Në parantezë, një studim për qëndrimet e bashkësive të ndryshme etnike në Ballkan është bërë edhe nga këndi kulturor, i etnomuzikës. Svanibor Pettan (2007:365) flet për kalimin e kufijve në Ballkan, nëpërmjet pop-kulturës dhe folklorit të trashëguar osman.

Munishi (2008) vëren se në fillim të mijëvjeçarit të ri, shtetet e Ballkanit Perëndimor kanë hyrë në rrjedha zhvillimore që kanë për synim anëtarësimin në BE dhe në NATO. Kjo ka bërë që vendet e Ballkanit Perëndimor të angazhohen për t'i pranuar dhe për t'i zbatuar standardet politike, ekonomike dhe institucionale të Bashkimit Evropian dhe, rrjedhimisht, edhe ndikimin ideologjik. Ky proces ka ndikuar edhe në politikat kulturore e gjuhësore të këtyre shteteve, megjithëse edhe në këtë kuadër ka një boshllëk midis statusit të gjuhëve dhe shtrirjes së funksioneve dhe domeneve të përdorimit të gjuhëve (Mu-

nishi, 2009). Edhe brenda vetë shteteve të BE-së ka probleme të natyrës politike që bëjnë që politikat gjuhësore të BE-së të mos zbatohen, siç është rasti mosnjohjen ligjore të ekzistimit të pakicave etnike në Greqi. (Në zonën e Maqedonisë së Egjeut, nuk njihet pakica maqedonase dhe për pasojë nuk njihen as dialektet sllave). Në po të njëjtën situatë janë edhe arvanitasit dhe varietetet e tyre, të cilat Cramer (2010: 24) i quan pak më të favorizuara kundruall të parave. Kjo lidhet me zhvillimin e një programi të financuar nga BE-ja që ka të bëjë me ruajtjen e arvanitikas. Sidoqoftë, qëndrimi i BE-së ndaj gjuhëve ka ndikim edhe në politikat gjuhësore të vendeve të tjera evropiane, të cilat synojnë integrimin në BE.

Të shohim si është gjendja me shqipen. Për gjendjen në Shqipëri kanë folur Beci (2002) dhe Cramer (2010). Beci (2002:21) vëren pakicën greke, si më të madhen, pastaj maqedonasit, malazeztë, vllehtë dhe romët. Po ashtu, ka edhe goranë. Në regjistrimet e fundit, më pak se 2 për qind e popullatës së përgjithshme janë joshqiptarë (më 1989, censusi i fundit me të dhënat etnografike). Një vërejtje që lidhet me censusin e fundit ka të bëjë me nenin 20 të Ligjit për Censusin, në të cilin thuhet se do të jetë një gjobë me para për cilindo shtetas që shënon një tjetër kombësi nga ajo që e ka të shënuar në certifikatën e lindjes. Si pakica të pranuar janë grekët dhe maqedonasit. Për shkollimin e tyre në Shqipëri më gjerësisht flet Cramer (2010): fëmijët maqedonas kanë shkollat në rajonin e Prespës dhe të Korçës; ata grekë në Gjirrokastër, Delvinë, Sarandë dhe Përmet. Cramer (2010:35) thotë se kjo gjendje nuk përmbush pritjet e pakicave për shkollën e arsimit në gjuhë amtare. Shqipja është gjuhë e administratës, gjuhë që u huazon pakicave, por u nënshtrohet huazimeve kulturore sipas termave të Bloomfieldit nga italishtja dhe greqishtja. Kjo si rezultat i mbylljes gjatë fazës së parë, për të cilën folëm në fillim të kumtesës dhe nëpërmjet kësaj mbylljeje i krijimit të mungesës së koncepteve.

Kosova – Një studim lidhur me statusit dhe pozitën ofrojnë Ismajli (2003) dhe Munishi (2009). Pas përfundimit të luftës në Kosovë çështja e statusit të gjuhëve që përdoren në Kosovë u saktësua me dokumente ligjore (rregulloret e UNMIK-ut dhe Ligji për përdorimin e gjuhëve në Kosovë, Kushtetuta e Kosovës) dhe në nivelin qendror, si gjuhë zyrtare u sanksionuan shqipja, serbishtja dhe anglishtja me status ekstraterritorial. Në nivelin komunal, u garantua përdorimi i

gjuhëve të bashkësive etnike. Sa i përket rregullimit të statusit të gjuhëve edhe në nivelin qendror, edhe në nivelin komunal është marrë parasysh edhe Karta Evropiane për Gjuhët Regjionale ose të Minoriteteve. Në komunat, në të cilat banojnë bashkësitë e ndryshme etnike që përbëjnë, së paku, 5 për qind të popullsisë së asaj komune, gjuha e asaj bashkësie ka statusin e gjuhës zyrtare në atë komunë dhe në veçanti në komunën e Prizrenit, gjuha turke e ka statusin zyrtar. Po ashtu, në komunat ku jeton një bashkësi, gjuha amtare e së cilës përfaqëson më shumë se 3% të popullatës së përgjithshme të komunës, gjuha e asaj bashkësie do të ketë statusin e gjuhës në përdorim zyrtar në atë komunë. Munishi (2009) flet edhe për përdorimin e arabishtes së Kurranit që ka lënë gjurmë në rrjedhën historike. Ismajli (2003) ofron të dhëna për çerkezët, të cilët deri pas lufte kanë pasur një ngulim të vogël në Kosovë. Shqipja ka statusin e gjuhës zyrtare dhe të prestigjit, ndërsa vazhdon kontaktet me gjuhët e tjera. Kontaktet janë kryesisht me dy nëndialekte serbe: Kosovsko-reshavski dialekt që përfshin Pejën, Mitrovicën dhe Prizrensko-Juzhnomoravski: Prizrenin, Prishtinën dhe Luginën e Preshevës deri te Nishi e përtej te Aleksinci në Serbi. Kjo Prizrensko-Juzhnomoravski njihet si novoshtokavski dialekt. Kosovsko-resavski dialekt ka nëndialektin kosovsko-metohijski (Okuka 2007: 211). Okuka (ibid.) thotë se në këto të folme vërehet ndikim i shqipes dhe i turqishtes. Studime të tjera (Blaku (2010) i vërejnë këto ndikime, duke vërejtur elemente substrati, më shumë se adstrati.

Okuka (2007: 242-243) ndan Prizrenski-Juzhnomoravski dialekat në nëndialektin prizrensko-gjakovacki dhe gnjilansko-vranjski. Ai flet për ndikim në sistemin vokalik nga shqipja, turqishtja dhe maqedonishtja. Okuka i fut të tëra në të ashtuquajturat shtokave të mesme, të njohura ndryshe si dialekti prizrensko-timoçki. Dialektet juglindore, Pavle Iviq dhe Olga Tomiq, i quajnë Torlak dhe vlerësojnë për shumë tipare që i dallojnë nga të folmet e tjera shtokave, përfshirë serbishten standarde (Tomiq 2006: 698). Shqipja ka kontakt edhe me gjuhën gorane. Mladenoviq (fq. 49) në punimin për gjuhën gorane, apo si e quajnë ata nashinski apo nashenski bën ndarje në tri të folme (f. 51): e folmja e Brodit, e Restelicës dhe më dominuesja Doloistanski, siç e quajnë ata vetë. Situatën sociolinguistike e ka përshkruar Munishi (2009): Përdorimi dhe barazia e gjuhëve të bashkësive etnike në Kosovë i ka problemet e veta, kryesisht të natyrës praktike. Disa prej këtyre problemeve janë paraqitur në “Raportin për përdorimin e

gjuhëve minoritare në komunat e Kosovës”, të hartuar nga misioni i OSBE-së në Kosovë. Në raport thuhet se ndonëse qeveria e ka themeluar komisionin për gjuhët, megjithatë ende ka probleme në zbatimin e këtij ligji. Në raport thuhet që krahas problemeve që kanë bashkësitë minoritare në përdorimin e gjuhëve të tyre, edhe përdorimi i gjuhës shqipe has në probleme të caktuara brenda Kosovës. Në komunat veriore të Kosovës me shumicë serbe procesverbalet e organeve përfaqësuese dhe ekzekutive nuk publikohen në gjuhën shqipe, ndërsa në komunat me shumicë shqiptare procesverbalet në gjuhën serbe publikohen fare rrallë. Çështja e barazisë së gjuhëve në Kosovë është e lidhur ngushtë me rrethanat historike-politike, nëpër të cilat ka kaluar Kosova në këto 20 vitet e fundit. Gjatë periudhës kur Kosova ishte pjesë e ish-Jugosllavisë, serbishtja kishte më shumë prestigj dhe epërsi ndaj shqipes në shumicën e funksioneve dhe të domeneve formale. Si rrjedhojë, folësit e serbishtes ishin më të privilegjuar. Por, pas përfundimit të luftës në Kosovë faktori demografik ka bërë që shqipja të jetë gjuha kryesore në Kosovë. Problemet e bilinguizmit shqip-serbisht janë të lidhura me mungesën e kontakteve midis shqiptarëve dhe serbëve, si pasojë e problemeve politike dhe mosnjohjes së gjuhëve reciproke nga brezat e rinj. Sa i përket turqishtes, statusi i saj juridik është degraduar në krahasim me statusin që e kishte në kohën, kur Kosova ishte krahinë autonome në kuadër të ish-RSFJ-së, kur turqishtja përcaktohej si gjuhë zyrtare. Në dokumentet kushtetuese të tashme, turqishtja nuk e ka më statusin e plotë zyrtar, sikurse shqipja dhe serbishtja. Munishi pohon se politika gjuhësore që po ndiqet në Kosovë ndaj gjuhëve të bashkësive minoritare, është në përputhje me trendet e politikës dhe ideologjisë gjuhësore të BE-së.

Sot, ndonëse flitet nga 5-7% e popullsisë së përgjithshme të Kosovës, serbishtja ka status më të favorshëm juridik, sesa p.sh. shqipja në Maqedoni, e cila flitet nga më shumë se 25% e popullsisë së Maqedonisë, vlerëson Munishi.

Në Maqedoni, krahas gjuhës shumicë, maqedonishtes, një numër i konsiderueshëm folësish janë të shqipes, të romishtes, të turqishtes, të serbishtes/bosnishtes, të arumunishtes. Problemi i statusit të gjuhëve të tjera në Maqedoni ka qenë i vështirë në periudhën e pas Luftës së Dytë Botërore deri në konfliktin e vitit 2001.

Marrëveshja e Ohrit e vitit 2001, e trajton me tetë pika në nenin e gjashtë çështjen e arsimit dhe të gjuhës. Kjo marrëveshje garanton

mësim në gjuhën amtare për të gjitha pakicat, arsimim universitar në gjuhët, të cilën e flasin mbi 20 për qind të popullatës (ku bën pjesë shqipja), ofrohet diskriminim pozitiv në universitete shtetërore për pakicat, ndërsa në gjyq personi ka të drejtën që ta dëgjojë palën në gjuhën e tij amtare – të përkthyer nga gjuha zyrtare. Mirëpo, pika 4 thotë: “Në tërë Republikën e Maqedonisë dhe në marrëdhëniet ndërkombëtare gjuhë zyrtare është gjuha maqedonase”.

Pika 6 thotë: “Lidhur me pushtetin vendor në komunat, ku bashkësia e caktuar përbën të paktën 20 për qind e popullatës së komunës, gjuha e asaj bashkësie do të përdoret si gjuhë zyrtare, në mënyrë plotësuese maqedonishtja”.

Kjo i lë shqiptarët në situatë të detyruar bilinguale. Me këtë zgjidhje, ndonëse shqipja merr statusin e gjuhës pothuajse zyrtare në Maqedoni, funksionet dhe domenet e përdorimit të plotë të saj si gjuhë zyrtare mbeten të kufizuara.

Çështja e shqipes dhe e luftës për statusin e saj në Maqedoni trajtohet më gjerësisht në një libër në botim të Veton Surroit (2011). Sa për ilustrim, Seminari V i Albanologjisë (me theks të veçantë te i Albanologjisë) në Tetovë dhe Shkup u hap nga rektori në gjuhën shqipe dhe pastaj u përkthye në maqedonisht fjalimi i tij. Për më tepër, aparati shtetëror shfrytëzon mjete të tjera represive. Një hulumtim i kryer muajin e shkuar në qytetin e Shkupit ka trajtuar mbishkrimet e dyqaneve. Këtu do të pohojmë se Shkupi është i ndarë në dhjetë komuna, plus qendra dhe prej tyre Çairi dhe Saraji janë komuna me shumicë shqiptare. Mirëpo, edhe në disa nga komuna të tjera popullata shqiptare e arrin 20-përqindëshin që parashihet në pikën 6 të nenit të gjashtë të Marrëveshjes së Ohrit. Megjithatë, hulumtimi tregon se 19 për qind të mbishkrimeve në Bitpazar janë në cirilikë, përfshirë disa raste, kur fjala është në gjuhën shqipe. Në anketë, 21 për qind të pronarëve të anketuar kanë përmendur frikën nga masat e inspektorëve si arsye të shënimit të firmës së tyre në cirilikë; 19 për qind kanë pohuar se mbishkrimi ka mbetur nga kohë të tjera; 39 për qind nuk kanë dhënë përgjigje fare, ndërsa në përgjigjet e tjera përfshihen arsyet ekonomike, joshja e blerësve maqedonas e të tjera. Sa për krahasim, në qendër të Shkupit, në qendrat tregtare Vero dhe Ram Store, dominojnë mbishkrimet e huaja, me alfabet latin; 24 për qind janë në cirilikë, pothuajse sa në anën shqiptare.

Rasti tjetër lidhet me komunën e Strugës, një tjetër komunë me shumicë shqiptare në Maqedoni. Në këtë komunë, në restorante lëshohen fatura fiskale në cirilikë, ndonëse emërtimi i produktit mund të jetë në gjuhën shqipe. Pronarët kanë pohuar për bazën shtetërore, e cila i prodhon dhe i vendos aparatet. Pra, edhe një tjetër mekanizëm shtetëror për represion gjuhësor ndaj gjuhëve të tjera brenda shtetit.

Mali i Zi – Një studim i gjerë është realizuar nga Shabani (2007). Edhe në Kushtetutën e Malit të Zi të pavarur u përcaktua që në komunat, në të cilat jeton një numër substancial i bashkësive etnike, gjuha e tyre do të jetë në përdorim zyrtar. Kontakti kryesor është me dialektin zetsko-rashki. Okuka (2007:170) këtë dialekt e shtrin në jugperëndim deri në Ulqin, pastaj deri te Perasti në Grykën e Kotorit, Bijelo Polje dhe pjesën veriore të Kosovës, deri te Mitrovica në lindje. Më tutje, (Okuka 2007:55) bëhet ndarja e dialekteve neoshtokave që shtrihen në zonën e mesme, atë jugore dhe veriore të diasistemit shtokav në Mal të Zi, Serbi, Bosnjë, Kroaci. Këta janë: ijekavski, ekavski dhe ikavski. Serbët janë folës të dialektit ijekav dhe ekav, malazezët ijekav. Pra, shqiptarët e Malit të Zi janë në kontakt me ijekavishten. Shabani (2007:123, 124) konstaton se në Mal të Zi shqipja ka një stabilitet të konsiderueshëm; deri në një masë ka realitete gjuhësore, por sa më shumë zyrtarizohet komunikimi, vendin e shqipes nis dhe e zë gjuha malazeze, duke u përdorur nga vetë shqiptarët dhe në komunikimin zyrtar të shkruar, shqipja del si gjuhë e përkthyer. Po ashtu, folësit shqiptarë gjatë komunikimit më njëri-tjetrit për tema që kanë të bëjnë me politikën, ekonominë, sportin bëjnë ndërrimin e kodit, duke kaluar nga shqipja në malazezishte.

Në Luginë të Preshevës - Neni 10 i Kushtetutës së Serbisë e sanksionon serbishten gjuhë zyrtare sikur edhe shkrimin cirilik. Ndërkaq, me ligjin për Gjuhët dhe shkrimin, të vitit 2010, mundësohet që në komunat me shumicë të pakicave, të përdoret si gjuhë zyrtare, krahas serbishtes, edhe gjuha e pakicave. Sipas këtij ligji, pakicat që arrijnë 2 për qind të popullatës, kanë të drejtë t'u drejtohen organeve republikane në gjuhën e tyre amtare dhe të marrin përgjigje po në atë gjuhë. Shqiptarët, sipas censusit të parafundit, arrijnë nën 1 për qind të numrit të përgjithshëm të popullatës në Serbi. Kontakti i shqiptarëve të Luginës është në dy rrafshje: kontakti i drejtpërdrejtë përmes fqinjësisë dhe administratës dhe kontakti nëpërmjet medimeve, jo në shkallë të

lartë. Rrafshi i parë duket më ndikues. Karakteristikat e serbishtes ndër folësit e shqipes nga kjo anë shquhen me tipare gjuhësore të dialektit prizrensko-juzhnomoravski dhe të folmen e gnjilansko-vranjaçki. Përfshirë përdorimin e përemrave enklitikë *gu, gi, vu*; enklitikët foljorë *çu dodjem, çe dodjem*, formimi jotipik i shumësit, *igrali se deca*.

Nga studentë të gjuhës shqipe në UP nga Lugina e Preshevës, në provime pranuese, numri i huazimeve të serbishtes është për 12 për qind më i lartë se i studentëve të tjerë – nga rezultatet e testit, ndërsa njohja e serbishtes pohohet nga 72 për qind të kandidatëve. Të dhënat janë të diskutueshme, po i përmendim vetëm sa për të treguar situatën bilinguale.

Në Greqi – mund të kundrohet statusi i shqiptarëve emigrantë. Sipas shënimeve të censusit të vitit 2001, mbi 400.000 shtetas shqiptarë jetojnë dhe punojnë në Greqi, duke krijuar kështu grupin më të madh etnik atje pas grekëve. Numri i emigrantëve shqiptarë në Greqi përbën afër 70 për qind të numrit të përgjithshëm të emigrantëve në shtetin e Greqisë – të dhën atë publikuar në Wikipedia. Ky grup shfaqet me nevojën e detyrueshme të bilinguizmit, si nevojë e punës.

Statusi i shqipes në Kosovë, në Mal të Zi, në Maqedoni dhe në Luginë të Preshevës ka pësuar ndryshime në dhjetëvjetëshin e fundit. Për reflektimet e këtij statusi kundruall shqipes standarde dhe funksionet e konceptit gjuhë standarde kanë shkruar mes tjerësh Rrustemi (1979), Ismajli (2003) dhe Rugova (2009) – sidomos funksioni i prestigjit, bashkues dhe ndarës. Mirëpo, ndryshimi i statusit të shqipes përgjithësisht mbetet për t'u kundruar më tutje edhe në rrafshin e statusit të të folmeve brenda vetë shqipes.

Bibliografia

- Beci (2002) Bahri, *Probleme të lidhjeve të shqipes me gjuhët e tjera ballkanike*, Dukagjini, Pejë
- Blaku (2010) Murat, *Ndikimi i shqipes mbi të folmet serbe të Kosovës (sipas materialeve gjuhësore të botuara)*, Instituti Albanologjik, Prishtinë
- Friedman (2005) Victor A., From Orientalism to Democracy and Back Again – Turkish in the Balkans and in the Balkan Languages, te *Developing cultural identity in the Balkans: convergence vs divergence (Detrez – Plas red.)*, P.I.E. Peter King, Brussels
- Islami (1994) Hivzi, *Rrjedha demografike shqiptare*, Dukagjini, Pejë
- Ismajli (2003) Rexhep, *Standarde dhe indentitete*, Dukagjini, Pejë
- Kramer (2010) Christina E., *Minority Language Rights: A Century of Change*, The Keneth E. Naylor Memorial Lecture Series number 5, Beeh Stave Press, New York
- Malcolm (1998), *Kosova – histori e shkurtër*, KOHA, Prishtinë
- Munishi (2009) Shkumbin, *Barazia e gjuhëve në Kosovë dhe perspektiva evropiane*, 1 Balkanlarda Tarih ve Kultur Kongresi (Kongresi I Ndërkombëtar Ballkanik), Sakarya Universitetesi, Sakarya
- Okuka (2007) Nenad, *Srpski dijalekti*, PKD Prosvjeta, Zagreb,
- Pettan (2007) Svanibor (red), *Balkan Boundaris and How to Cross Them: A Postlude*, te *Balkan Popular Culture and the ottoman Ecumene: Music, Image, and Regional Politicak Discourse (Europea: Ethomusicologies and Modernities)* Donna A. Buchanan (red.), Scarecrow Press Inc.
- Rugova (2009) Bardh, *Gjuha e gazetave*, KOHA, Prishtinë
- Rrustemi (1979) Ferit, *What's the Significance of Standard Language Theory for the Study of Language Planning*, Suny at Buffalo
- SIL – <http://ethnologue.com/>
- Surroi (2011), *Libri i fluturave*, KOHA, Prishtinë
- Shabani (2007) Haxhi, *Rrezikimi i gjuhës shqipe (për dygjuhësinë te shqiptarët e Ulqinit)*, Toena, Tiranë
- Tomić (2006) Olga M., *Balkan Sprachbund Morpho-Syntactic Features (Studies in Natural Language and Linguistics Theory)*, Springer,
- Wikipedia - http://en.wikipedia.org/wiki/Albanian_diaspora#Greece

Kolec TOPALLI, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë

SHTRESIMI I HUAZIMEVE NGA GJUHËT BALLKANIKE NË NJË FJALOR ETIMOLOGJIK

Abstrakt

Në hartimin e një fjalori etimologjik (një punë që e kemi nisur këtë vit), një vend të veçantë zënë huazimet nga gjuhët ballkanike, që kanë hyrë në kohë të ndryshme nga gjuhët me të cilat shqipja ka pasur kontakte gjatë historisë së saj. Fjalorë të tillë bëjnë të mundur të dallohen shtresat e ndryshme të huazimeve historike, si edhe të ndiqen rrugët e hyrjes së tyre.

Me një vështrim të përgjithshëm të situatës gjuhësore në Gadishullin Ballkanik, shqipja në periudhën historike të 2000 vjetëve të shkuara ka pasur marrëdhënie gjuhësore me lindjen dhe perëndimin, me gjuhë më të lashta e me gjuhë më të reja në këtë Gadishull, me kontakte që rrjedhin nga fqinjësia gjeografike mijërvjeçare dhe me gjuhë të ardhacakëve, që erdhën si pushtues. Problemet kryesore që dalin në një fjalor etimologjik lidhur me huazimet e periudhës historike janë: përcaktimi i burimit të tyre, shtrirja gjeografike e dialektore dhe shkalla e rrënjës së tyre në gjuhë.

Në mbështetje të analizave burimore të huazimeve, procesin e marrëdhënieve të shqipes me gjuhët me të cilat ka pasur kontakte, mund ta ndajmë në tri faza: faza e parë përfshin marrëdhëniet me gjuhët e vjetra klasike, greqishten e latinishten. Kjo është periudha antike e shqipes, që lidhet me nënën a shqipen e vjetër. Periudha e dytë përfshin marrëdhëniet me gjuhë më të reja, që janë të gjalla edhe sot dhe përfshin marrëdhëniet me italishten, gjuhët sllave dhe greqishten e mesme e të re. Periudha e tretë, më e reja përfshin marrëdhëniet gjuhësore në mesjetën e vonë, duke filluar me shekullin XVI deri në shekullin XX, që është e lidhur kryesisht me ndikimin e turqishtes, duke vijuar ndikimi i gjuhëve sllave dhe i greqishtes së re në krahinat kufitare, të banuara nga shqiptarë, si edhe ndikimi i gjuhëve perëndimore kryesisht nëpërmjet librash.

Sipas një projekti të miratuar në Këshillin Shkencor të Institutit të Gjuhësisë, kemi nisur punën për hartimin e një fjalori etimologjik të gjuhës shqipe. Fjalorë të tillë janë pasqyrë e historisë së gjuhës, dhe në një kuptim më të gjerë, janë pasqyrë e historisë së vetë popullit që e flet atë. Për gjuhën shqipe ata dëshmojnë trashëgiminë e hershme mijërvjeçare të ruajtur brez pas brezi që nga periudhat më të hershme të njerëzimit, si edhe rrugën e vështirë të historisë së shqiptarëve për-

gjatë shekujve, me kontakte të shumta e të vazhdueshme me popuj të ndryshëm, që kanë lënë gjurmët e tyre në histori dhe në gjuhë, në tradita e zakone, në doke e fe, në mendësi dhe në mënyrën e jetesës.

Duke ndjekur udhën e gjatë të historisë së kombit që e flet, shqipja ka marrë e ka dhënë me gjuhë të tjera. Në historinë e këtyre marrëdhënieve bëjnë pjesë edhe lidhjet me gjuhët e Gadishullit Ballkanik, të cilat rrjedhin nga fqinjësia gjeografike ose nga kontakti me gjuhët e popujve që erdhën si pushtues në trevat e banuara nga shqiptarë. Fjalorë të tillë bëjnë të mundur të dallohen shtresat e ndryshme të huazimeve historike, si edhe të ndiqen rrugët e hyrjes së tyre. Dukuritë fonetike e gramatikore që kanë vepruar në huazime të periudhave të ndryshme, bëjnë të mundur gjithashtu përcaktimin e kronologjisë së vetë dukurive, kur dihet se kontaktet me disa popuj të trevës ballkanike mund të datohen historikisht.

Me një vështrim të përgjithshëm të situatës gjuhësore në Gadishullin Ballkanik, shqipja në periudhën historike të 2000 vjetëve të shkuara ka pasur marrëdhënie gjuhësore me lindjen dhe perëndimin, me gjuhë më të lashta e me gjuhë më të reja në këtë Gadishull, me kontakte që rrjedhin nga fqinjësia gjeografike mijëravjeçare dhe me gjuhë të ardhacakëve, që erdhën si pushtues.

Problemet kryesore që dalin në një fjalor etimologjik lidhur me huazimet e periudhës historike janë: përcaktimi i burimit të tyre, shtrirja gjeografike e dialektore dhe shkalla e rrënjosjes së tyre në gjuhë.

Në mbështetje të analizave burimore të huazimeve, procesin e marrëdhënieve të shqipes me gjuhët me të cilat ka pasur kontakte, mund ta ndajmë në tri faza: faza e parë përfshin marrëdhëniet me gjuhët e vjetra klasike, greqishten e latinishten. Kjo është periudha antike e shqipes, që lidhet me nënën a shqipen e vjetër. Periudha e dytë përfshin marrëdhëniet me gjuhë më të reja, që janë të gjalla edhe sot dhe përfshin marrëdhëniet me italishten, gjuhët sllave dhe greqishten e mesme e të re. Periudha e tretë, më e reja përfshin marrëdhëniet gjuhësore në mesjetën e vonë, duke filluar me shekullin XVI deri në shekullin XX, që është e lidhur kryesisht me ndikimin e turqishtes, duke vijuar ndikimi i gjuhëve sllave dhe i greqishtes së re në krahinat kufitare, të banuara nga shqiptarë, si edhe ndikimi i gjuhëve perëndimore kryesisht nëpërmjet librash.

Për periudhën e parë, greko-latine, analiza etimologjike e huazimeve dëshmon se fjalët e marra nga këto dy gjuhë, u janë nënshtruar dukurive të njëjta. Kjo do të thotë se huazimet e këtyre gjuhëve kanë hyrë në shqipe afërsisht në të njëjtën kohë. Në këtë rast, huazimet e greqishtes së vjetër, më të pakta në numër, krahasohen me shtresën më të lashtë të huazimeve latine. Ndër këto dukuri vëmë në dukje:

1) theksi në fjalët e huazuara nga këto dy gjuhë, ose është ruajtur në pozicionin e tij në fjalë me ritëm daktilik, ose është zhvendosur në rrokjen e ballit të fjalës, për arsye se shqipja në atë periudhë të lashtë të zhvillimit të saj ka pasur theks nistor. Kësisoj, *drapënë* nga gr. vj. *δράπανον*, *kandërrë* nga gr. vj. *κάνθαρος* dhe *femën* nga lat. *fēmina*, *balshëm* nga lat. *balsamum*, e kanë ruajtur njëllëj pozicionin e theksit; kurse *mokënë* nga gr. vj. *μᾶχανά* dhe *voshtër* nga lat. *oleaster* e *kumtër* nga lat. *compāter*, e kanë zhvendosur atë në rrokjen nistore.

2) Gjatësia e zanoreve, që shfaqet me të njëjtat ndryshime në huazimet e marra nga këto gjuhë, është i njëllëjtë me evolucionin e gjatësive të trashëguara. I tillë është ndërrimi /ā/ > /o/, në fjalë të trashëguara: *motër* nga ie. *māter*; në huazimet greke: *mollë* nga gr. *μᾶλον*, *shkop* nga gr. *σκᾶπος*; në huazimet latine: *rruaj* nga lat. *rādere*, *truaj* nga lat. *trādere*.

3) Zantorja /ē/ (e gjatë) në huazimet e këtyre dy gjuhëve ka dhënë /e/; në huazimet greke: *shpellë* nga gr. *σπήλαιον*, *pellëg* nga gr. vj. *πήλαγος* dhe *eshkë* nga lat. *ēasca*, *vëner* nga lat. *venēnum*. Meqenëse në elementin e trashëguar /e/-ja ka dhënë /o/, kjo do të thotë se huazimet e këtyre gjuhëve kanë hyrë pasi kishte mbaruar evolucionin i /ē/-së në /o/; por në një kohë kur shqipja i ruante ende gjatësitë e zanoreve të trashëguara; sepse me këtë shpjegohet përse /ē/-ja nuk është diftonguar në /je/ në këto huazime, dukuri që ka prekur /e/-në e shkurtër të fjalëve të trashëguara dhe të huazimeve nga greqishtja e vjetër e latinishtja.

4) /o/-ja (e shkurtër) paraqitet me dy evolucione të ndryshme në të dyja këto gjuhë, nga njëra anë, me zanoren /u/, si në *mushk* nga gr. vj. *μόσχος* dhe *nun* nga lat. *nonnus* e *murg* nga lat. *monachus*; nga ana tjetër me grupin *vo-* / *va-*, si në *vodhë* / *vadhë* nga gr. vj. *οἴη*, *voj* / *vaj* nga lat. *oleum*, *i vorfën* / *i varfër* nga lat. *orphanus*. Të dy këto evolucione gjenden edhe në fjalë të trashëguara; për shndërrimin /o/ > /u/

vëmë në dukje: *punë*: ie. *pondā*, *hudhër*: ie. *sšor-* me të njëjtin kuptim; për evolucionin *vo-* / *va-* kemi: *votër* / *vatër*: ie. *āt-* “zjarr”, *vorr* / *varr*: ie. *ēr-* “dhe, tokë”.

5) Zanoret paratheksore të huazimeve nga të dyja këto gjuhë, kanë ndjekur rrugë të njëjtë evolucioni. Ato janë rrëgjuar në fjalë me një zanore paratheksore, si në *pëllambë* nga gr. vj. *παλάμη* dhe në *fëmijë* nga lat. *familia*; por në fjalë me dy rrokje të patheksuara është rrëgjuar vetëm zanorja më afër theksit të fjalës, kurse zanorja e ballit që ndodhej më larg theksit, është ruajtur; p.sh. *qersh* nga gr. vj. *κεράσια*, *mallëkoj* nga lat. *maledicere*, *kallënduer* nga lat. *calendarium*.

6) Zanoret pastheksore të huazimeve nga të dyja këto gjuhë janë rrëgjuar gjithandej në zanoren -ë-; p.sh. *shpargën* nga gr. *σπάργανον*, *mangën* nga gr. vj. *μάγγανον*, *frashën* nga lat. *fraxinus*, *qiqër* nga lat. *cicer*.

7) Në aspektin gramatikor, huazimet e të dyja gjuhëve që dalin me sonanten hundore -n ose me një lëngëzore, marrin mbaresën -ë në shqipe, që është mbaresa e kallëzores së trashëguar, e cila në emrat mashkullorë me këtë përbërje është shtrirë edhe në emërore me ristrukturimin e sistemit rator. Vëmë në dukje, nga huazimet e greqishtes së vjetër: *pjepënë* nga gr. vj. *πέπων*, *kandërë* “enë vaji” nga gr. vj. *κάνθαρος* dhe *lepurë* nga lat. *leporem*, *shekullë* nga lat. *seculum*.

8) Një aspekt tjetër gramatikor është veprimi i metafonisë në huazimet e të dyja këtyre gjuhëve, si: *presh* nga gr. vj. *πράσον*, *bretëk* nga gr. vj. *βρόταχος* dhe *rreze* nga lat. *radia*, *rremb* nga lat. *rāmus*, *qerre* nga lat. *carrus*.

Të gjitha këto evolucione të përbashkëta që kanë ndjekur huazimet nga të dyja këto gjuhë, të çojnë në përfundimin se marrëdhëniet e shqipes me greqishten e vjetër dhe latinishten, megjithëse me intensitet dhe kohëzgjatje të ndryshme, janë zhvilluar afërsisht në të njëjtën kohë, dhe duke u mbështetur edhe në tregues të tjerë, e kanë filluesën e tyre në kapërcyell të fillimit të mijëvjeçarit të parë të erës së re.

Për huazimet e periudhës së dytë, analiza e tyre etimologjike të çon në përfundime të tjera. Huazimet e mesjetës së hershme lidhen me ndikimin e gjuhëve sllave, të greqishtes së mesme e të re dhe të italishtes. Përcaktimi i kufijve kronologjikë të ndikimeve të këtyre gjuhëve-

ve mund të bëhet duke marrë parasysh faktorët historikë dhe gjuhësorë. Sipas faktorit historik mund të përcaktohet kufiri i fillimit të ndikimit të sllavishtes, meqenëse sllavët kanë ardhur në Ballkan në një periudhë të caktuar, që datohet nga historia. Kurse kufiri i fillimit të ndikimit të greqishtes së mesme e të re dhe i italishtes mund të bëhet sipas faktorit gjuhësor, meqenëse këto gjuhë janë vijuese të gjuhëve të vjetra, si rrjedhim, ndikimi mbi shqipen është në vazhdimësi gjuhësore.

Për të përcaktuar burimin dhe moshën e këtyre huazimeve, është e nevojshme të mbahen parasysh disa dukuri fonetike që janë zhvilluar në kohën e hyrjes së këtyre huazimeve ose në periudhën para hyrjes së tyre. Dukuri të tilla janë rregullimi mekanik i theksit, hundorësia e zanoreve e rotacizmi, rrëgjimi i zanoreve të patheksuara etj. Disa prej tyre, siç është rregullimi mekanik, është dukuri mbarëgjuhësore; por dukuri të tjera, siç është hundorësia, kanë nisur si të tilla në fazat e tyre të para, por më vonë janë zhvilluar si dukuri dialektore duke dhënë edhe përfundime të ndryshme. Më së fundi, ka pasur edhe dukuri, siç është rotacizmi, që ka pasur karakter dialektor që në fillimet e tij.

Rregullimi mekanik i theksit mund të ndiqet me huazime që janë marrë nga gjuhët e ndryshme. Kësaj dukurie nuk i janë nënshtruar huazimet e periudhës së parë, domethënë ato që janë marrë nga greqishtja e vjetër e latinishtja, por u janë nënshtruar huazimet e periudhës së dytë, huazimet nga sllavishtja, greqishtja e mesme a e re e italishtja; si p.sh., nga sllavishtja: *zakón* nga sll. *zákon*, *lëndinë* nga sll. *lędina*, *kastrevéc* nga sll. *krástavec*; nga italishtja: *makínë* nga it. *máccina*, *rrezík* nga it. *rísico*, *balsám* nga it. *bálsamo*; nga greqishtja e mesme dhe e re: *faqéll* nga gr. *φάκελος*, *trëndafil* nga gr. *τριανδάφυλος*, *Patós* nga gr. *πάτος*. Kjo dukuri është e lidhur me rrëgjimin e zanoreve pastheksores, të cilat kur janë ruajtur të parrëguara, e kanë tërhequr theksin e fjalës mbi vete duke krijuar përgjithësisht fjalë parafundore me mbaresat e sistemit emëror.

Ndryshe është zhvilluar hundorësia e zanoreve, që ka nisur si dukuri mbarëgjuhësore, por më vonë ka marrë tipare dialektore duke marrë rrugë të ndryshme zhvillimi në dy dialektet e shqipes. Ndërsa në gegërishte hundorësia është ndalur me krijimin e zanoreve hundore, që janë ruajtur të tilla deri në ditët tona, toskërishtja, përkundrazi, ka

vijuar evolucionin e tyre, me rotacizimin e sonantes hundore, e cila nga ana e saj është bërë shkak për zhdukjen e karakterit hundor të zanoreve. Fakti që huazimet e periudhës së dytë, përgjithësisht, nuk u janë nënshtruar hundorësisë dhe rotacizmit, i vendos këto dy dukuri në periudhën para se të fillonin kontaktet me këto gjuhë, ose diçka më vonë, në periudhën e kontakteve të hershme, duke marrë parasysh se një shtresë më e mëtejshme e këtyre huazimeve u është nënshtruar këtyre dukurive. Të tilla janë huazimet me rotacizëm: *tërsirë*, *shtëpreshtë* nga sllavishtja; *spërk*, *korë* nga greqishtja e re; *kudhër*, *këmborë* nga italishtja. Meqenëse huazimet nga këto gjuhë mund të datohen afërsisht rreth shekullit VII-VIII, përfshirja e një pjese të vogël të huazimeve nga këto gjuhë dëshmon se vetë dukuritë ishin në shuarje e sipër në kontaktet e para me këto gjuhë, duke bërë të mundur vendosjen e kufirit kronologjik të shuarjes së tyre në shekujt e fundit të mijëvjeçarit të parë.

Të gjitha këto dukuri duhen vlerësuar në një fjalor etimologjik kur është puna për kronologjinë e hyrjes së huazimeve, që nganjëherë përcaktohet nga format e fjalëve, siç ndodh me huazimet e dyfishta: *këmborë* e *kambanë*, *Mërtiri* e *Martini*, *gjiri* e *gjini*, *djemër* e *demon*, *korë* e *ikonë*, *Frar* e *fanar*, *spërk* e *spanua* etj. Ndërkaq, duhet marrë parasysh se disa dukuri, kur morfologjizohen, vijnë të veprojnë me rrugë analogjike edhe kur janë shuar fonetkisht. E tillë është p.sh. hundorësia e zanoreve në gegërishte, që shfaqet në disa elemente formuese të marra nga turqishtja, siç është prapashtesa *-dan*, te emrat *flakadâ* e *lavërdâ*; shndërrimi i zanores /a/ në /ë/ në pozicion hundor në disa huazime turke, si *tamëm*, *bakëm*; si edhe qiellzorëzimi i grykoreve në huazime të reja që kanë hyrë me rrugë librore, siç janë disa forma shumësi, si: *çeqe* nga ang. *check*, *stoqe* nga ang. *stock* etj.

Periudha e tretë e depërtimit të huazimeve nga gjuhët ballkanike është më e vona dhe lidhet me kontaktet me turqishten në mesjetën e vonë, prej së cilës shqipja ka marrë fjalë që lidhen me mënyrën e jetesës orientale, me jetën luftarake etj. Shumica e huazimeve nga kjo gjuhë po zhvendoset gjithnjë e më shumë në periferi të shqipes me prirje për të dalë nga gjuha. Me ndryshimet e mëdha që pësoi organizimi i mënyrës së jetesës në shekullin e fundit është pakësuar ndjeshëm pesha e këtyre huazimeve, prandaj edhe paraqitja e tyre në një fjalor etimologjik do të ketë parasysh shkallën e rrënjës së tyre në

gjuhën e sotme. Për këtë arsye në fjalor do të trajtohen huazimet me përhapje të përgjithshme, si: *xhep, baba, mashë, xham, pambuk, sheqer* etj.; por do të lihen jashtë huazimet me përhapje krahinore a lokale, si: *alldysy, allçak, masllahat, hudud, zahmet* etj., që s'kanë gjasë të hyjnë në përdorim të përgjithshëm. Ndonjë prej këtyre huazimeve, megjithëse ka dalë nga shqipja, ka lënë gjurmë në toponimi, në emra familjesh a personash, siç është p.sh. emri *bazhdar* "nëpunës që peshonte mallrat", i cili si apelativ ka dalë jashtë përdorimi, por ruhet si emër familjesh.

I njëjti qëndrim do të mbahet ndaj huazimeve librore a fjalëve diturake, që kanë hyrë nëpërmjet librash dhe kohët e fundit po vërshojnë me fuqi të jashtëzakonshme duke errësuar shpesh forcën krijuese të shqipes. Edhe prej këtyre huazimeve do të trajtohen etimologjikisht vetëm ata që kanë fituar qytetarinë në fjalorin e shqipes, që janë të nevojshëm dhe kanë krijuar edhe rrjedhoja të tjera me mjetet fjalëformuese të shqipes. Sipas këtij kriteri do të përfshihen në fjalor emrat: *akt, dokument, normë, kolektiv*; mbiemrat: *absolut, abstrakt* etj., duke lënë jashtë termat shkencore e teknike të degëve të ndryshme të shkencave, si: *neurozë, agregat, termostat, anestezi* etj., që kanë përdorim të kufizuar dhe njihen vetëm nga specialistët e fushave të veçanta. Këto terma shkencore e teknike, që janë prej burimi të huaj, mund të trajtohen në fjalorët terminologjikë sipas degëve të shkencës.

Duke kaluar tashti në shqyrtimin e aspektit sasior, në fjalësin e tij, në një fjalor etimologjik të vëllimit të mesëm do të përfshihen huazimet që kanë hedhur rrënjë në gjuhë, që janë të domosdoshëm dhe kanë krijuar përgjithësisht rrjedhoja me ndajshitesa. Të tilla janë fjalët: *adhuroj, i lirë, bankë, bujk, kumbull, drejt* etj. Por do të lihen jashtë huazimet që kanë qenë lidhur me mënyra jetese të së kaluarës, si rrjedhim, edhe fjalët me të cilat janë shprehur kanë dalë jashtë përdorimit. Jashtë fjalorit do të mbeten edhe disa huazime që kanë autorët e vjetër, por nuk janë integruar në gjuhë, si: *dullye, baçil, furrëqí, axímatë* etj.

Së fundi, për të gjitha huazimet që shpjegohen, ashtu si edhe për fjalët e trashëguara, do të shënohet në mënyrë të përmbledhur bibliografia, duke shfrytëzuar literaturën e qëmtuar prej vitesh, për mbledhjen e së cilës kanë kontribuar shumë gjuhëtarë, nga radhët e të cilëve po lejohej të përmend, të pranishëm në sallë: akademikët Besim

Bokshi, Rexhep Ismajli, Wilfried Fiedler, Francesco Altimari; profesorët Matteo Mandalà, Besim Kabashi, Bardhyl Demiraj, Irena Sawicka, Monica Genesin; ndërsa të papranishmëm, gjuhëtarët: Eqrem Çabej, Kolë Ashta, Eric Hamp, Antonio Filippin, Michiel de Vaan, Elton Prifti, Marcu Gabinski, Andrei Avram, Paolo Di Giovine etj. Të gjithëve u jam mirënjohës për kontributin e dhënë.

Literatura

- Bokshi, Besim: **Rruga e formimit të fleksionit të sotëm nominal të shqipes**. Prishtinë, 1980.
- Çabej, Eqrem: **Studime etimologjike në fushë të shqipes**. Tiranë, I 1982, II 1976, III 1987, IV 1996, VI 2002, VII 2006.
- Dizdari, Tahir: **Fjalor i orientalizmave në gjuhën shqipe**. Tiranë, 2005.
- Huld, Martin E.: *Basic Albanian Etymologies*. California State University. Los Angeles, 1984.
- Janson, Bernd: **Etymologische und chronologische Untersuchungen zu den Bedingungen des Rhotazismus im Albanischen unter Berücksichtigung der griech. und lat. Lehnwörter**. Frankfurt am Main - Bern - New-York, 1986.
- Jokl, Norbert: **Linguistisch - kulturhistorische Untersuchungen aus dem Bereiche des Albanischen**. Berlin und Leipzig, 1923.
- Meyer, Gustav: **Etymologisches Wörterbuch der albanesischen Sprache**. Strassburg, 1891.
- Thumb, Albert: *Altgriechische Elemente des Albanischen*. **IF** 26, 1910.
- Topalli, Kolec: **Fonetika historike e gjuhës shqipe**. Tiranë, 2007.

Rexhep ISMAJLI, Prishtinë:

SHQIPJA DHE RUMANISHTJA

Abstrakt

Raportet midis shqipes dhe rumanishtes janë bërë objekt studimi prej kohësh. Një aspekt të veçantë të këtyre studimeve paraqesin elementet e përbashkëta joromane, josllave, joturke, jogjermanike midis shqipes e rumanishtes, për të cilat rumanistët rumunë kërkojnë shpjegim kryesisht te substrati trako-dakas i rumanishtes, gjë që implikon përfundime të caktuara për raportet e shqipes me gjuhët e lashta të Ballkanit dhe për vendin e saj në lashtësi, për çka ka pasur po ashtu hipoteza të ndryshme. Para më se dy dekadash ishte konstatuar se “aspekti autokton i gjuhës rumune mbetet enigmë” (Brâncuș), ndërsa sot vazhdojnë diskutimet kryesisht në aspektin ballkanistik lidhur me këto gjuhë, por ka dhe një rikthim të interesit për vështrimet me implikime më të lashta. Këto dhe çështje që lidhen me kërkesën për substratin si shpjegim, me vendin e shqipes në lashtësi, me trashëgiminë e përbashkët midis dy gjuhëve dhe me përfundimet që mund të nxjerrim prej andej janë objekt i diskutimit të kësaj kumtese.

Historia e raporteve midis shqipes dhe rumanishtes është e gjatë. Dy gjuhët paraqesin afërsi të shumta midis tyre. Qysh herët është vërejtur se disa syresh janë të hershme në kohë, gjithsesi para ardhjes së sllavëve në Ballkan, ka të tjera më të vona; disa karakterizojnë vetëm këto dy gjuhë, të tjera tipare ngërthehen në një rrjet më të gjerë Ballkanik. Një aspekt të veçantë të këtyre studimeve paraqesin elementet e përbashkëta strukturore, si p.sh. *zanorja ë, nyja e prapavendosur, përsëritja e kundrinës, numërimi 11-19, krahasimi analitik, apo elementet leksikore pararomane*, për të cilat rumanistët rumunë kërkojnë shpjegim kryesisht te substrati trako-dakas i rumanishtes, duke implikuar me këtë edhe përfundime të caktuara për raportet e shqipes me gjuhët e lashta të Ballkanit dhe për vendin e saj në lashtësi. Në këtë mënyrë implikohen vështrime të natyrës diakronike, tipologjike, areale dhe të kontaktit të gjuhëve bashkë me qëndrimet përkatëse në fushë të metodës, ndonjëherë në kundërshtim me njëri-tjetrin.

Në shqyrtimin që mëtonte paraqitjen e përmbledhur të rezultateve të studimeve ballkanike në Rumani më 1978, rumanisti që me dekada u mor me raportet midis shqipes e rumanishtes, me vështrim të veçantë lidhjet e

tyre të mundshme me gjuhët e lashta të Ballkanit dhe sidomos me atë që quhet substrat i rumanishtes, Grigore Brâncuș kishte mundur të emetonte pohimin vijues: “Në përfundim mund të thuhet se megjithë përpjekjet e mëdha të bëra nga linguistët rumunë në dekadat e fundit për të sqaruar problemin e trashëgimit nga substrati i rumanishtes, *hulumtimi nuk ka shënuar përparim të madh*”. Dhe më tej: “Aspekti autokton i gjuhës rumune mbetet një enigmë”.¹

Prej atëherë nuk ka pasur raporte për zhvillime që do të na bënin të ndryshonim rrënjësisht vlerësimet. Ka pasur interpretime më pak a më shumë të përkrahura për aspekte të ndryshme të implikuara në këto studime. Përfundimin e përmendur Brâncuș-i e kishte arritur pasi kishte paraqitur pikëpamjet e studiuesve rumunë lidhur me këto raporte, duke filluar nga B. P. Hasdeu në sh. 19, për të vazhduar me O. Densusianu në fillim të sh. 20 me vështrimet kritike, me I. A. Candrea-n, pastaj P. Papahagi-un, T. Capi-dan-in, S. Pușcariu-n, Alexandru Philipoide-n, etj.

Sipas Russu-it (1981: 103), nga e tërë kjo paraqitje Philippide nxirrte një përfundim me interes: nëse ngjashmëritë e ndryshme na bëjnë të vendosim një afri gjenetike midis rumunëve dhe shqiptarëve, “dallimet shumë më të mëdha na obligojnë t’i ndajmë këta dy popuj”, çka, pas tij, del dhe nga “struktura e tyre shpirtërore e veçantë”.² Russu shkante më tej dhe fliste për mungesën e mbështetjes për teorinë e “lidhjeve” të ngushta gjuhësore dhe etnike-shoqërore dhe të varësisë së gjuhës rumune si debitorë ndaj shqipes: “gjuha rumune ka të përbashkëta me shqipen një radhë tiparesh fonetike, morfologjike dhe sintaksore, të cilat (të shqyrtuara me kujdes) janë pak konkludente, duke qenë plotësisht të shpjegueshme në kuadër të zhvillimit specifik të romanitetit lindor (ballkanik, karpato-danubian), të tjerat përmes një substrati identik apo ngushtësisht të afërt, unitar në linja të përgjithshme, duke pasur pastaj gjatë epokës mesjetare, shumë elemente të përbashkëta kulturore-historike dhe politike”.³

Në shqyrtimin e elementeve të përbashkëta romane midis shqipes e rumanishtes, Russu-i raportonte shkurt idetë e shfaqura në studimin e H. Mihăescu-t për huazimet latine të shqipes. Katër grupet e fjalëve: 1. fjalë latine të dëshmuara edhe në shqipen, gjuhët romane e rumanishten; 2. fjalë

¹ Brâncuș (1978), ff. 367-379, këtu f. 374.

² Russu (1981), 103.

³ Russu (1981), 103-105.

lat. që ekzistojnë në gjuhët romane perëndimore dhe në shqipen, por jo në rumanishten; 3. fjalë lat. të ruajtura vetëm në shqipen e rumanishten; 4. fjalë latine të ruajtura vetëm në shqipen, që konvergojnë me botën perëndimore, lejojnë të pohohet se “elementet latine të shqipes dhe të rumanishtes që vijnë nga një burim i përbashkët, i quajtur nga disa eruditë ‘latinishte ballkanike’, mungojnë”. Kështu e kemi të shpënë në skaj mendimin e kundërt me më të shpeshtin, që thoshte se latiniteti ballkanik ka qenë relativisht unik, apo, tek e shumta, në një anë kemi pasur latinitetet bregdetar-dalmatin, në anën tjetër të brendisë, ballkanik, pra rumun.

Sintezën e studimeve të tilla në Rumani e bëri A. Rosetti, i cili tërë çështjen e ndërveprimit të gjuhëve ballkanike e kishte vendosur në suazat e rrethanave më të gjera politike, ekonomike e shoqërore. Studimet e tij në këtë fushë kanë zgjatur me dekada, prandaj edhe idetë kanë evoluar. Rosetti sillte në vëmendjen e opinionit shkencor vrojtimit e tij për zanoren *ă* të rumanishtes në kontekst ballkanik, për çështjen e rotacizmit në shqipen e në rumanishten, për zhvillimet e grupeve latine *ct*, *cs*, për prapavendosjen e nyjës, për zhdukjen e paskajores, për dallimet midis fjalive qëllimore dhe objektore, për derivacionet me *-ește*, *-ză*, dhe për 85 fjalët e përbashkëta midis shqipes e rumanishtes.⁴ Më duket se Brâncuș-i kishte të drejtë kur këtë vepër e cilësonte sintezën më të mirë të çështjes në Rumani. Mbështetës i teorisë së unionit gjuhësor ballkanik, Rosetti theksonte se gjenezën e paralelizmave në zhvillimet e gjuhëve ballkanike mund ta shpjegonin faktorë si bilinguizmi substracial dhe ndikimi i kulturës bizantine, se në këtë aspekt një rol e kishin luajtur latinishtja lindore dhe rumanishtja. Duke dashur të provonte karakterin njësor të qytetërimit të lashtë të popujve rumun e shqiptar, ai kishte ndërmarrë grupimin e termave autoktonë e latinë në shqipen e në rumanishten. Më 1978 Rosetti, pasi kishte kritikuar teorinë e V. Georgiev-it për veçimin e dako-mezishtes nga trakishtja, kishte theksuar afrinë midis dy gjuhëve tona në bazë të substratit të njëjtë, trakas apo dako-mez. Ai e gjente të nevojshme të theksonte po ashtu faktin se afria e shqipes me ilirishten mbështetet në korrespondenca fonetike që nuk mund të mohohen dhe saktësonte: “prej këndeje duhet të nxjerrim përfundimin se shqipja, vazhduese e ilirishtes, ka qenë në kontakt në një moment të caktuar të historisë së saj në Siujdhesën Ballkanike me trakishten apo dako-mezishten dhe ka qenë ndikuar nga kjo gjuhë, e cila i ka dhënë elemente të një

⁴ Rosetti (1968); ka një botim të ri 1986.

serie termash e tiparesh gramatikorë karakteristike, të cilët i gjejmë në rumanishten”.⁵ Ndryshe nga Georgiev-i dhe përkrahësit e teorisë së tij për dallimin e dakishtes nga trakishtja, studiues të shumtë rumunë ngulin këmbë te përbashkësia e tyre, sepse në atë mënyrë duan të vendojnë një bazë të përbashkët për rumanishten, bullgarishten e shqipen. Anash mungesën e njohjeve për kontaktin e atij lloji me trakishten apo dako-mezishten, të ndryshme/ të njëjta, që vazhduesës së ilirishtes i paska dhënë tërë atë seri termash e tiparesh karakteristike gramatikorë, anash mungesën e vendosjes kronologjike në raport me zhvillimet brenda shqipes, duket pak e vështirë të shpjegohet si u ndodh pasardhësja e ilirishtes në Traki apo në Daki. Në fusnotë Rosetti referonte Georgiev-in,⁶ duke pohuar se huazimet latine në shqipen vijnë nga lindja e Siujdhesës Ballkanike, si në proto-rumanishten, se habitati i shqiptarëve në epokën e vjetër paskësh qenë Mezia e Epër (Dardania, Dakia Mediterranea) dhe perëndimi i Dakisë, se rumanishtja dhe shqipja qenkan formuar në rajonin dako-mezian. Meqë rumanishtja nuk është formuar para sh. VI, madje edhe më vonë, neve na duket e vështirë të supozojmë që djepi i shqiptarëve të ketë qenë hapësira e përmendur në atë kohë. Nga ana tjetër, studimet e shumta kanë treguar ngjashmëri dhe ndryshime midis elementit latin të shqipes dhe rumanishtes, sa i përket moshës, apo fushave.

Vitet '60-'70 të sh. XX në Rumani sollën intensifikim të studimeve të kësaj problematike. U shquan sidomos autorët I. I. Russu, C. Poghiric, A. Vraciu, G. Brâncuș, etj. Në studimet e tyre janë shqyrtuar tiparet ballkanike të rumanishtes në strukturën fonetike e gramatikore, në fushën e etimologjisë së fondit që njihet si “i substratit”, i raporteve rumuno-shqiptare dhe i rindërtimeve trako-dakase. Një shtysë të fuqishme kësaj vale studimesh u kanë dhënë rezultatet e studiuesve bullgarë në fushë të trakologjisë, D. Deçev,⁷ V. Georgiev,⁸ I. Duridanov,⁹ etj., por janë marrë parasysh edhe studimet etimologjike të E. Çabejtë dhe vështirimet e tij për raportet midis dy gjuhëve.¹⁰ Në hulumtimet e atyre dekadave mbisundonte koncepti pas të cilit elementet autoktone

⁵ Rosetti (1978), ff. 79-80.

⁶ Georgiev (1972), f. 50 e v.

⁷ Detschew (1957), 1957.

⁸ Georgiev (1968); Georgiev (1960), 1-19; Georgiev (1977), ff. 348.

⁹ Duridanov (1976).

¹⁰ Çabej (1976), 7-146. Çabej (1959), f. 531. Çabej (1971-73), f. 365-377; Çabej (1975);

rumune të përbashkëta me shqipen janë trashëguar drejtpërsëdrejti nga substrati nga secila gjuhë në mënyrë të pavarur. Kundërshtojë ideja e mëhershme për ekzistencën e një simbioze rumuno-shqiptare në një periudhë parasllave e ndoshta pjesërisht edhe më vonë. Ngulej këmbë në dëshmimin me çdo kusht të teorisë për formimin e rumanishtes e të rumunëve në Daki, në radhë të parë në veri të Danubit, por për disa edhe në jug. Në rumanishten ato kanë ndjekur të njëjtin zhvillim si elementet latine: “Teza për të ashtuquajturën ‘simbiozë’ albano-rumune, e huazimit nga shqipja nuk mbështetet më sot nga asnjë linguist rumun. Prandaj, etimologjia e sotme ngul këmbë në rindërtimin e trako-dakishtes (Russu), me referencë të korrespondencat e ndryshme indoeuropiane. Krahasimi me gjuhën shqipe implikon nevojën e rindërtimit të formave paralele në rumanishten komune dhe në shqipen e përbashkët respektivisht”.¹¹

Më vonë Brâncuș-i ka botuar dhe dy libra me vlerë për këtë çështje, ku nuk fshihet këmbëngulja tek argumentet që ishin shprehur më parë nga ai vetë në studime të shumta pikërisht për shpjegimet e përbashkësive midis rumanishtes e shqipes përmes substratit të quajtur nga ai “trako-dak”, nga të tjerë “dako-get”, apo edhe “trako-dako-geto-mez”.¹²

Në librin e dytë, ku rimerren studimet e tij të mëhershme për çështje të strukturës fonetike e gramatikore të dy gjuhëve, Brâncuș-i nxirrte këtë përfundim (citoj sipas Rezymesë gjermanisht): “Studimi i substratit të rumanishtes kërkon patjetër të shtrihet vështrimi tek shqipja. Midis këtyre dy gjuhëve ka jo vetëm përkime leksikore, por edhe tingullore, gramatikore dhe frazeologjike. Elementet e përbashkëta të të dy gjuhëve më në fund tregojnë ndikimin trako-dak mbi latinishten vulgare të hapësirës karpato-danubiane, por jo ndikimin e mëvonë të shqipes mbi rumanishten.¹³ Në vështrimin tonë nuk kanë aq shumë rëndësi dallimet midis dy gjuhëve, që te gjuhët me prejardhje të ndryshme janë të pritshme, po ngjashmëritë”.¹⁴

Me pak përjashtime, thoshte ai, fjalët e rumanishtes të trashëguara nga substrati ndeshen nëpër tërë hapësirën gjuhësore dakorumune, por “në rumanishten e lashtë këto fjalë ndesheshin dhe në jug të Danubit”. Zhduk-

¹¹ Brâncuș (1978), f. 370.

¹² Brâncuș (1983), ff. 197.

¹³ Ndikimin e shqipes nga shtresa folësisht të ardhur në hapësirat rumune nga jugu shqiptar e kishin vënë në pah dijetarë si G. Weigand për hapësira të caktuara të transilvanisë.

¹⁴ Brâncuș (1995), f. 111.

jen e mëvonë të disa prej këtyre fjalëve në dialektet jugdanubiane ai e shpjegonte me zëvendësimin nga gjuhët përreth që ndikuan mbi to. Sipas tij “është shumë e besueshme që *ǎ* rumune dhe *ě* shqipe duhet t’i atribuohen një ndikimi të substratit trako-ilir, në çdo rast një tendence të substratit”.¹⁵ Këtë ai e mendonte sipas idesë së C. Poghirc që në trakishten kishte lëkundje në shkrime të emrave e të materialit tjetër të paktë midis *a* dhe *e*, çka do të fliste për ekzistencën e një zanoreje [*a*] në gjuhët e lashta të Ballkanit. Por kur është fjala për zhvillimin e zanores së tillë në shqipen, rindërtimi i brendshëm jep edhe kronologji relative, që mund të flasin ndryshe.¹⁶

Brâncuş-i më tej si ndikime të substratit shihte ekzistencën e bashkëtingëllores *h-* në fillim të fjalës, kryesisht në bazë të fjalës së përbashkët me shqipen *hameş*: *hamës*; në të vërtetë, në shqipen popullore nga folja *ha* kemi ndërtimin [*hās*], jo *hamës*. Rotacizmin e shihte dëshmi të ndikimit të substratit trako-dak: “...rotacizmi është reliket nga gjuha e ‘dakasve të lirë’, që mbijetuan deri në shekullin 6 jashtë Dakisë, në veri dhe në jug të provincës së romanizuar. Duhet të mendohet që paraardhësit e toskëve (shqiptarëve të jugut), më vonë dhe të istrorumunëve, shtegtuan drejt jugut përka-tësisht perëndimit nga hapësira e ‘dakasve të lirë’ e nga zonat përreth”.¹⁷

Sa i përket rotacizmit, qysh në vitet ’70 kishim sugjeruar një shpjegim, që supozonte zhvillime të mundshme brenda raporteve të caktuara sintagmatike, të mundshme në zhvillimet edhe brenda gjuhëve romane të hundores *n* në pozitë ndërzanore, pra, që mund të paraqitet si vijon¹⁸: $VnV \rightarrow VrV$ *bā*: [*bā.nē*] – *bërë*; *rā*:*n(ē)* – *rërë arēna anmīk* – *armik inimicus*; *nn* > *n*: *gunna* > *gunë*, **hana* > *hanë*, **puṇa* > *punë*, **thanV* > *thanë*; në gjuhët romane: 1. *n* > *r*; *nn* > *n*; 2. *n* > 0; *nn* > *n*; 3. *n* = *n* *nn* > *η*. Për këtë ndryshim ka pasur dhe shpjegime të tjera, por asnjëherë nuk është abstraguuar konteksti nazal dhe denazalizimi. Është pranuar përgjithësisht se në shqipen ky ndryshim do të ketë përfunduar rreth sh. VIII. Kronologjia në rumanishten mund të jetë e ndryshme.

Më tej në këtë libër Brâncuş-i vijonte me diskutimet që kishte zhvilluar dhe më herët për numërorët 11-19 në shqipen e rumanishten, tipar i

¹⁵ Brâncuş (1995), f. 114.

¹⁶ Shih dhe Ismajli (1987).

¹⁷ Brâncuş (1995), f. 116. Supozimin lidhur me dakasit e lirë dhe eventualisht lidhjen e tyre të prejardhjes së shqiptarëve të mëvonë nga ta e shohim të mjegulluar.

¹⁸ Shih Ismajli (1971-2), rimarrë te Ismajli (1987), ff. 184-192.

përbashkët me sllavishten dhe me gjurmë në baltishtet, pra i rrafshit IE, për çka qysh nga Jokl-i është numëruar si pa ndonjë lidhje ndikimi nga sllavishtja, ashtu si momente të tjera lidhur me përdorimin e numërorëve, pa treguar pse rumanishtja huazoi leksemën sllave (*sutā*) për numrin 100, ndërsa shqipja e ka marrë leksemën latine (*qind*). Si elemente të padyshimta të ndikimit të substratit Brâncuş-i numëronte prapavendosjen e nyjës shquese në të dy gjuhët dhe disa çështje të renditjes së përcaktorëve, ashtu si mungesën e nyjës tek emrat që parashikohen nga një parafjalë (*trece pe drum - kalon në rrugë*), përveç në rastin e parafjalëve rumune *cu*, *shq. nga e te*, që kërkojnë nyjë, çka do të bëhet më vonë objekt diskutimesh të veçanta të Joseph Brian pikërisht lidhur me substratin. Në përgjithësi duket se në përkimet në fushën sintaksore Brâncuş-i gjente një rrugë shpjegimi përmes thënies vijuese: “Rumanishtja dhe shqipja tregojnë një prirje të posaçme për prapavendosjen e pjesëzave të patheksuara (trajtat e shkurta të përemrave dhe të foljeve ndihmëse), të cilat i shtohen fjalës paraprijëse”,¹⁹ çështje që mund të gjenden të komentuar nga Shaban Demiraj në veprat *Histori e shqipes* dhe *Gjuhësi ballkanike*. Në përgjithësi, ky brez i studiuesve rumunë ngul këmbë te mohimi i ndonjë ndikimi të shqipes në rumanishten sa u përket elementeve të përbashkëta të dy gjuhëve.

Në studimet shqiptare me raportet midis shqipes e rumanishtes janë marrë E. Çabej, M. Domi, S. Floqi, E. Lafe, Sh. Demiraj, B. Bokshi, autori i këtyre radhëve, etj. Çabej kishte theksuar: “Shqipja dhe rumanishtja kanë lidhje të ngushta në fushën e fonetikës, të morfologjisë, të leksikut, të formimit të tingujve, të sintaksës dhe frazeologjisë, të mënyrave të të thënit dhe të lokucioneve proverbiale, saqë – pa i harruar veçantitë – krijohet përshtypja se fjala është për një frymë të vetme të gjuhës të manifestuar në dy forma... Besoj se këto raporte mund të vlerësohen drejt vetëm kur të vështrohen në kuadër më të gjerë të relacioneve kulturore midis këtyre dy popujve” [kursivi r.i.].²⁰ Reminishencat e frymës kopitariane e më vonë të sh. XIX me ‘frymën e vetme’, por me dy forma, nuk duan koment.

Duke kundërshtuar në mënyrë të vendosur implikimet e teorive të përmendura të gjuhëtarëve rumunë për vendin e hershëm të shqipes, duke saktësuar se sa i përket shqipes nuk mund të behet fjalë për substrat, sepse

¹⁹ Brâncuş (1995), f. 118.

²⁰ Çabej (1959), f. 531.

këtu nuk kemi të bëjmë me ndryshim gjuhe, duke theksuar se mungesa e dëshmimeve të gjuhëve të lashta të Ballkanit nxjerr vështirësi për atribuimin e fjalëve të mëvona për cilëndo prej tyre, duke vënë në pah se ndër elementet e përbashkëta midis këtyre dy gjuhëve do të bëjë një shtresëzim kohor, Çabej avanconte idenë vijuese: “degët e skajit më verilindor të etnosit shqiptar... në mesjetën e hershme, pas gjase një kohë ende para dyndjes sllave, kanë qenë në një fqinjësi të pandërmjetme, fqinjësi kontakti, me degët e skajit më jugperëndimor të etnosit rumun, dhe kjo lidhje u ushqye më tej edhe me anën e transhumancës të barinjve shtegtarë. Duke gjykuar nga dëshmitë gjuhësore, ky kontakt duhet të ketë qenë mjaft intim, dhe vise-vise ka shkuar mbase gjer në simbiozë”. Dhe ideja e simbiozës ka qenë e pranishme edhe tek autorë të tjerë joshqiptarë, qysh nga shkulli XIX e sidomos në gjysmën e parë të sh. XX.

Ne më 1983,²¹ në vijën e Çabejtë, lidhur me ato studime kishim bërë disa vërejtje: emërtimi i substratit është herë dakishte, herë trako-dakishte, herë trako-dako-getishte, herë trako-dako-geto-mezishte, çka krijon paqartësi; nuk dihet se cilës prej gjuhëve paleoballkanike i takonin fjalët që merren si të substratit; romanizimi në Ballkan kishte përfshirë të gjithë, nuk bënte seleksion etnik, nëse në rumanishten u ruajtën vetëm elemente të caktuara nga substrati, ndërsa në rastin e shqipës kemi vazhdimin e njasaj gjuhe që u bë substrat, si mund të ngremë pretendimin që vendi i formimit të shqipës ishte pikërisht vendi ku mbisundoi një gjuhë romane?; sa u përket raporteve leksikore, me rëndësi është fakti nëse ato hyjnë në vorbull etimologjik, të fjalëformimit e të prodhimitarisë kuptimore; disa prej atyre fjalëve mund të jenë të huazuara nga shqipja, disa nga rumanishtja, disa nga ndonjë gjuhë tjetër, pra do të bëjë diferencim kronologjik, diferencim për sa i përket burimit, etj.; ka dhe huazime krejt të vona nga shqipja, ose nga rumanishtja, etj.

Sa u përket elementeve të strukturës, ishte bërë vërejtja se shpesh ato i visheshin substratit pa argumentim, sepse nuk kishte shpjegim tjetër; lidhur me sistemin fonetik ishin vënë në pah dallimet jo të vogla të të dy sistemeve: shqipja ka *y*, ka vetëm një *ë*, ka gjatësi zanoresh, më herët ka pasur edhe në jug, ka hundorësi në veri; rum. nuk ka gjatësi zanoresh, nuk ka *y*, ka dy *ë*, nuk ka hundorësi, por ka diftongje të mesme, ka palatalizim; shqipja ka ndërthembore, ka *h*, ka *l/L*, *r/rr*; ishte bërë

²¹ Ismajli (1983), rimarrë në Ismajli (1987), ff. 57-71.

shpjegimi për rotacizmin si fenomen i ruajtjes së dallimit midis dy majoreve hundore me funksion fonematik, që ngjet edhe gjetiu në botën romane, por me rezultate të ndryshme, etj. Të gjitha këto flasin ndryshe nga ç'sugjeron 'fryma e njëjtë'. Ishte vënë në dyshim shpjegimi përmes substratit, sakohë që kemi shpjegime të arsyeshme gjuhësore brenda zhvillimeve normale. Njësoj ishin vënë në dyshim 'tendencat' e trashëguara nga substrati, të vëna madje në kontekste fare të pamundshme me dialekte sllave jo të afërta, pra duke përdorur të dhëna të pasakta. Sa i përket prapavendosjes së nyjës ishte parapëlqyer shpjegimi i B. Bokshit në kuadër të zhvillimeve të sintagmës nominale dhe të grupit nominal në raport me renditjen në një kohë kur lëvizja ishte e mundshme në shqipen, e kur në romanitetin ballkanik që po bëhej rumanishte kishte lëvizje.

S. Riza e kishte kritikuar E. Çabejnë se po i theksonte më shumë se ç'duhej raportet e afërsisë të shqipes me rumanishten, ndërsa ato, përkundrazi, pas Rizës, duheshin trajtuar si të mesjetës. Për lashtësinë, sipas tij, duheshin marrë në konsideratë më parë raportet me gjuhët indoeuropiane, konkretisht me greqishten.²² Çabej kishte qenë kundër mendimit të Dh. Kamardës, i cili kishte parë ngjashmëri midis shqipes e greqishtes sa u përket nyjave dhe shumë më tepër.²³ Çabej kishte parë një paralelizëm të përsosur midis sistemit nyjor të shqipes e të rumanishtes. Nevojën për t'i vështruar më parë raportet e shqipes me gjuhët lashtoballkanike e IE, duke parë aty diçka që ka të bëjë "me fondin e pahuazuar të leksikut dhe strukturën origjinale të gramatikës sonë", Riza e kishte konkretizuar me shpjegimet për ngjashmëritë për krijimin e nyjës shquese të shqipes e të greqishtes mjaft më herët: "sistemet nyjorë të gjuhës shqipe dhe greqishtes duhet të jenë vërsnikë të një vërsnikie nga më të hershmet. Në këto dy gjuhë vetëm kështu mund të shpjegohen kënaqshëm në një anë idiomatizmi unikal i nyjësimit të përgjithësuar të emrave të përveçëm, e n'anë tjetër mundësia gjithashtu unike e primjes së emrave të nyjësuar nga dëftorët përkatës".²⁴

Në këtë punë ai nuk ishte mjaftuar me kritikën e vet, po i ishte

²² Riza (2004), f. 93.

²³ Shih Camarda (1864), ff. 188-189.

²⁴ Riza (2004), f. 113.

drejtuar tashmë një tradite albanistike për ato lidhje me greqishten, të shembëlluar më vonë me Marko La Pianën: "... tiparet e përbashkët midis greqishtes e shqipes janë aq të shumtë e të tejpashëm në çdo fushë, në leksik, në morfologji, në sintaksë e deri në mënyrën e të menduarit e të shprehurit të mendimit, sa është absurde të duash t'i shpjegosh veçmas me ndikime të mundshëm të njëjës gjuhë mbi tjetrën" ...²⁵

Shaban Demiraj, pas paraqitjes së argumentimeve të Çabejtë, kishte parapëlqyer po ashtu trajtimin e zërthyer të fjalëve të përbashkëta shqipe-rumune në grupe të ndryshme fjalësh, kishte shprehur rezervë për çështje të substratit, sidomos për implikimet e tij lidhur me vendin e formimit të shqipes, por kishte lënë të hapura çështjet e etimologjive konkrete. Mahir Domi e Spiro Floqi kishin ngulur këmbë më shumë në aspekte që mund të jenë më qartësisht objekt i trajtimit ballkanistik të raporteve midis shqipes e rumanishtes - të strukturës sintaksore.

Besim Bokshi në librin e tij *Prapavendosja e nyjave në gjuhët e Ballkanit*, duke u nisur nga studimi shterues i zhvillimeve brenda shqipes, ishte marrë edhe me proceset e prapavendosjes së nyjave në gjuhët rumune e bullgare dhe kishte arritur në përfundimin se ka mundësi që shqipja të kishte ndikuar në romanitetin ballkanik të periudhës së sh. VII-VIII, kur po formohej rumanishtja, e kur kontaktet ishin ende të pandërprera nga sllavishtet.

Të gjitha këto, përveç studimeve të Çabejtë dhe fare pak të Domit, nuk janë parë të konsultuara ndonjëherë në romanistikë.

Sorin Paliga, në kohët e vona me një sërë botimesh i ka rimarrë raportet e shqipes me rumanishten duke i parë jo vetëm në kontekst të koncepteve për substratin trakas, po edhe më gjerë në një synim për të vendosur trakishten në tërë botën e lashtë IE. Në bazë të analizave komparative-etimologjike e toponimeve parasllave të Siujdhesës ballkanike dhe të ujdhesave adriatike ai nxirrte vlerësime të përgjithshme: e tërë hidronimia e lumenjve të mëdhenj është jo vetëm parasllave, po edhe pararomane, trake dhe/apo ilire; disa prej këtyre emrave shpjegohen përmes vokabularit komun IE, të tjerat lejojnë shpjegime përmes të ashtuquajturit fond 'mesdhetar', para-indoeuropian; emrat e

²⁵ La Piana (1939), f. 139-140, përkthimi i S. Rizës.

ujdhesave janë parasllavë, ilirë ose romanë, ose të origjinës italiane (veneciane); janë parasllave dhe pararomane (trake dhe/ose ilire) disa hidronime që u referohen rrjedhave ujore për t'u bashkuar me rrjedhat kryesore; të tilla janë dhe disa toponime dhe oronime; në arealin kontinental emrat e origjinës latine janë më të rrallë, më të shpeshtë janë në bregdet dhe ujdhesa; në arealin kontinental, në Bullgari dhe Serbi, më të shpeshtë janë toponimet me prejardhje rumune, ndërsa në Adriatik - dalmatine dhe italiane. Pastaj Paliga diskutonte toponime parasllave e latine popullore të periudhës deri në sh. V-VII, para ardhjes sllave. Pjesa II e sh. VI, sipas tij, është faza më e vjetër e kalimit nga lat. e vonë në dalmatishten dhe rumanishten, çka nuk pajtohet me shumë historianë të rumanishtes. Në intervalin midis sh. VI-X ka ndodhur procesi i etnogjenezës së popujve të Europës Juglindore dhe në përgjithësi të Europës; bënte dallim midis trakëve dhe ilirëve të romanizuar dhe rumanishtes e dalmatishtes, por flet për element trako-ilir në zonat kalimtare – Maqedoni e Bosnje, Baseni i Drinës, ndërsa kelte në Slloveni. Në ff. 37-42 fliste për etnogjenezën e shqiptarëve. Pranonte se në territorin shqiptar ka pasur vazhdimësi banimi, por ai shihte aty dhe probleme. Në fakt ai nisej nga idetë e I. I. Rusu, të shprehura në konferencë në Akademinë Rumune më 1981. Reperët e teorisë së tij janë: nuk mund të flitet për diskontinuitet habitati në territorin shqiptar; është dëshmuar qartë romanizimi i ilirëve, nëpër një proces të shpejtë dhe të thellë, sa që ilirët nuk përmenden më si grup etnik i veçantë nga sh. II pas Krishtit. Është pak e besueshme që një popull në fqinjësi me grekët të mos përmendej nga autorët antikë. Këtë e shpjegon vetëm romanizimi i tyre i plotë dhe i thellë. Meqenëse shqipja është idiomë me strukturë të veçantë të tipit neoilir apo neotrak, duhet ta identifikojmë arealin ku do të jetë ruajtur në shekujt e parë të erës sonë si një grup etnik trak apo ilir jo shumë i prekur nga romanizimi. Përmes eliminimit Russu ka përfunduar se në jug të Danubit i vetmi popull i paromanizuar kanë qenë grekët, kështu që duket pak e besueshme që këtu të ketë mbijetuar një ishull i paromanizuar. Po të kishte mbijetuar, do të përmendej në dokumente.²⁶ Më tej ai thoshte se edhe në Veri të Danubit romanizimi ka qenë i fuqishëm dhe i thellë. Por ka ekzistuar hapësira e Moldovës dhe Maramureshit ku arkeologët kanë

²⁶ Paliga mendon se ky pohim është tepër i guximshëm.

treguar se dakët e lirë kanë vazhduar për një kohë mënyrën tradicionale të jetesës. Vetëm grupe relativisht kompakte të dakëve të lirë, sidomos të karpëve e kostoboçëve, nën trysninë e shtrirjes sllave, u shpërngulën drejt jugut deri në jug të Danubit. Këtu, në përzierje me popullsinë lokale ilire të romanizuar bënë të lindte një popull i ri: shqiptarët. Gjuha shqipe ka disa komponente: autoktone ilire, latine popullore (si rezultat i romanizimit), trake-veriore (karpike, sepse grupi karp ishte grupi më tenac trak i paromanizuar deri vonë, i përmendur në dokumente deri në sh. V, mendonte ai) dhe protorumune. “Vetëm një stratifikim i këtillë etnolinguistik mund të shpjegojë, nga njëra anë, ngjashmëritë midis rumanishtes dhe shqipes (edhe për çka ka të bëjë me lashtësinë autoktone, ashtu si për elementet romane), por edhe veçantitë”.

Në horizontet e sh. IV-VI e më vonë, kanë ekzistuar dy areale ku mund të ruheshin grupe kompakte trake: areali karpik-kostobok (Moldavia e sotme) dhe një areal në jug të Bullgarisë moderne, thoshte ai.

Pas Paliga-s, hipoteza e Russu-it dhe e shkollës bullgare kërkojnë të pajtojnë teori të papajtueshme, sepse, në një anë, i konsiderojnë shqiptarët ekskluzivisht ilirë të romanizuar (shkolla shqiptare), por, nga ana tjetër, me origjinë trake. Ka argumente historike e arkeologjike që e mbështesin njërën prej hipotezave: shqipja reflekton pa dyshim një ndikim trak, qoftë verior (të tipit karpik), qoftë trak në kuptimin e mirëfilltë (trak jugor).²⁷ Pas tij ka ekzistuar një grup etnik i paromanizuar apo vetëm pjesërisht i romanizuar që do të ketë luajtur rol me rëndësi në etnogjenezën e shqiptarëve. Ky ka qenë vetëm trakas. Pyetja shtrohet vetëm sa është e mundshme që një grup karpik të ketë pasur mundësi të tillë më shumë se një grup jugor, më afër shqiptarëve. Paliga nuk merrte qëndrim. Nuk e përjashtonte që në etnogjenezën e shqiptarëve të kenë marrë pjesë dhe grupe të tjera veri-trake (karpike) dhe jug-trake. “Veçoritë dialektore midis gegërishtes dhe toskërishtes mund ta reflektonin pikërisht këtë gjë”. “Especial na duket fakti se shqipja nuk mund të konsiderohet një idiomë neoilire, po një përzierje elementesh ilire, romane (apo ilire të romanizuara) me të cilat bashkohen më vonë elemente trakase dhe elemente protorumune, në shkallën që romanizimi avanconte”.

Argumente linguistike për këso formulimesh kërkonte tek Landi

²⁷ Paliga, 40.

(1986),²⁸ pas së cilës *mbret* në shqipen nuk rrjedh nga *imperatorem*, sepse kjo do të kishte dhënë **mbërdur*, **mbërtuor*, **mbërtuer*, po nga e ndërmjetmja romane *împărat*). Por, në të vërtetë, në shqipen pas rënies së *i-* nistore forma për huazim do të ketë qenë **mpirat* (> *mbrat* > *mbret*), pasi kishte rënë dhe prapashtesa *-or*. Pavarësisht nga kjo Paliga kërkonte dhe përjashtime të tjera: *kryq(ë)*, *kjel*, *kreshmë*, *rërë*, *mik*, *pëlqenj*, *qytet*, *qind*, *fruer*, *fshat*, *këndoj* (referonte dhe Vătăşescu 1997).

Aporti i fondit ilir: argument për këtë është fakti se hidronimia dhe toponimia antike është ruajtur në shqipen sipas zhvillimit fonetik specifik: *Scupi* – *Shkup*, *Naissus* – *Nish*, *Scodra* – *Shkodër*, *Lissus* – *Lesh*, *Ulcinium* – *Ulqin*, *Dyrrachium* – *Durrës*, *Aulona* – *Vlorë*. Shkonte edhe më larg dhe citonte Brâncuş-in me idenë se shqipja paska elemente të tipit satem dhe centum, për të nxjerrë përfundimin e tij vërtet specifik: “*Shkurt, mund të pohohet se shqipja është gjuhë sintezë multilinguistike, stratifikim etno-kulturor, dukshëm derutant, por që – në analizën e kujdesshme – e ka logjikën e vet të brendshme*”, duke pohuar në rrugën e thjeshtësimeve, madje, kështu qenka pronocuar dhe Huld 1984, 1-14, çka, natyrisht, është pak si ndryshe dhe më komplekse.

Në librin për etimologjitë trakase në rumanishten S. Paliga përpiquej t’i vendoste këto realitete duke hamendësuar formulime që mund të kërkonin argumentime plotësuese, madje të forta. Pas tij, romanizimi në bregun e Adriatikut qe i shpejtë, ndërsa ilirishtja dhe folësit e saj u zhdukën nga dokumentet duke filluar nga sh. 2 pas Krishtit, pastaj Iliria kishte vetëm kuptim thjesht gjeografik. Përkundrazi, trakishtja vijoi të ekzistonte me shekuj, megjithë trysninë e fuqishme të romanizimit. Shkolla bullgare e studimeve trakase mbron me këmbëngulje mbijetesën e trakishtes deri tek arritja e sllavëve në sh. VI, ndërsa arkeologët rumunë argumentojnë se folës të shpërndarë trakas kishin qëndruar në hapësirat e paromanizuara të Moldavisë (Karpët) dhe të Transilvanisë. Sipas Paliga-s trakishtja është folur deri në sh. VI-VII pas Krishtit, mbase edhe më vonë në hapësira të izoluara: “Nëse pranojmë idenë se shqipja në themel është idiomë neotrakase dhe jo neoilire, siç ishte menduar më herët, mund të vendosim hipotezën se trakishtja ende jeton - në mënyrë të çuditshme - me emërtimin shqipe. Nëse një vizion i tillë nuk konsiderohet tepër audicioz, formula mund të ishte: trakishtja është ende idiomë e gjallë me emrin shqipe dhe

²⁸ Landi 1986.

përmes elementeve të numrëta indigjene të rumanishtes, disa prej të cilëve janë ruajtur apo huazuar nga gjuhët fqinje (bullgarisht, serbisht, ukrainisht, hungarisht)²⁹. Në fusnotë ai shtonte: “Sido që të jetë, karakteri i sugjeruar neo-ilir i shqipes nuk mund të invokohet më me argumente shkencore”. Megjithatë, Paliga e ndjente të nevojshme të shtonte gjithashtu se, sipas Russu-it, trakishtja dhe ilirishtja “duhet të kenë qenë gjuhë ngushtësisht të afra midis tyre, mbase reciprokisht të kuptueshme, së paku përgjatë kufirit të tyre gjuhësor”(1)³⁰

Supozim pas supozimi, në një përzjerje të këtyre, të gjitha këto përfundojnë të marra si të vërteta, “meqë inventari i ilirishtes është ende më pak i numërt se i trakishtes, do të përqendrohemi në rindërtimin e arsyeshëm të fonetikës së trakishtes. Meqë ilirishtja ishte gjuhë e shuar në sh. II pas Krishtit, i kemi të gjitha arsyet të pranojmë që elementet e mundshme ilire, kryesisht në shqipen, disa në kroatishten dhe sllovenishten, duhet të jenë ruajtur përmes proto-dalmatishtes, më pak përmes proto-romanishtes perëndimore”. f. 239.

Për shembull, në fushën e vokalizmit Paliga theksonte se Reichenkron (1966), Russu, shkolla bullgare (Georgiev, Duridanov) dhe Poghiric kanë ndjekur rrugë të papajtueshme të rindërtimit fonetik. Megjithatë, Poghiric e Brâncuș i kanë përshtatur përfundimet e studiuesve bullgarë. Të rindërtosh vokalizmin e trakishtes, sipas tij, do të thotë të bësh analizë të emrave trakas të ruajtur nga shkrintarët grekë e latinë; të bësh analizë të formave të mundshme moderne të ruajtura në rumanishten, shqipen dhe bullgarishten. Kështu është shumë e besueshme që trakishtja të ketë pasur një zanore neutër, siç provohet nga rumanishtja *ă*, shqipja *ë*, bullgarishtja *ъ*, siç kishte sugjeruar Poghiric.

Indoeuropeisti dhe ballkanologu Eric P. Hamp, duke u nisur nga shqyrtimi i raporteve të shqipes me rumanishten, kishte avancuar hipotezën e tij për ekzistencën në lashtësi të një fashe dialektesh IE që ai i quante proto-albanoide, e që shtrihet nga vija Jireček e deri në Karpate, ndërsa shqipja ishte vetëm një mbetje e atij grupi dialektesh, ashtu si dhe elementet e përbashkëta të rumanishtes e mbase edhe elemente të tjera leksikore karpato-ballkanike. Në vështrimin e tij “historikisht rumanishtja është latinishte e folur me një sistem theksor shqip”, çka do të thotë se në latinishten e vonë

²⁹ Paliga, ff. 236-237.

³⁰ Paliga, f. 239.

danubiane të Dakisë kishte pasur një ndikim të gramatikës së një grupi të proto-shqipes, apo, si thoshte ai, të proto-albanoidishtes. Këtë ai kishte provuar ta përtregonte përmes zhvillimeve fonetike në fushën e lateraleve në sllavishtet jugore në raport me shqipen, me implikime për zhvillimet *-l- > -r-* në rumanishten. Fjalët e rumanishtes të njohura si të substratit, Hamp i kishte parë si *Restwörter* dhe jo si *Lehnwörter*, duke veçuar midis tyre: a) një shtresë më të hershme karpato-ballkanike të fushës baritore, b) një shtresë nga kontaktet e mëvona midis shqipes e rumanishtes dhe c) një shtresë tjetër më të re. Sa i përket shtresës së parë, të ekzemplifikuar përmes *vatër*, *shtrungë*, *hurdhë*, Hamp mendonte se reflektonin një tufë të tillë gjuhës/dialektesh proto-albanoide që shtriheshin nga vija Jireček e deri në Karpate dhe Ukrainë. Këtë vijë të menduari ai e ndiqte edhe me analizën e emërvendit *Drobeta* si *dru+të*, duke parë aty sintagmën më të vjetër shqipe (sh. I para K.), çka na ishte dukur e paqëndrueshme për arsye të zhvillimit të nyjave (Ismajli, 2003). Përgjithësisht Hamp po ashtu kishte vërejtur se toskërishtja në një kohë do të jetë kaluar nga veriu (zonat Leskovac-Nish) anash Sharrit drejt jugut, çka po ashtu nuk duket plauzibile për shkak të dispozicionit shumë të hershëm të ndarjes dialektore të shqipes ashtu si është sot. As Hamp-i as Brâncuș-i e të tjerë që mund të kenë menduar se dallimi gegërisht/ toskërisht mund të kishte prejardhje të mëhershme të ndryshme gjeografike, pra edhe gjuhësore, dmth. shtrirje dy shtresash gjuhësore, nuk kanë sjellë argument tjetër, pos afisë së supozuar më të madhe të toskërishtes me rumanishten, çka mendoj se mund të shpjegohet me arsye të tjera të zhvillimit gjuhësor. Për më tepër, edhe teoria për shtyrjen e arumanishtes në jug nga veriu diku pas sh. X gjithnjë e më pak po ka mbështetje.

Joseph Brian (1999, 2001), duke u mbështetur në idetë e Hamp për teorinë e substratit përmes proto-albanoidishtes, ka provuar të gjepte elemente të tjera mbështetëse në fushën e strukturës gjuhësore. Infinitivi, për të cilin ai është specialist i kulmit, për arsye kronologjike nuk i delte i pranueshëm sa i përket substratit, koncept të cilin ai e pranonte dhe i bënte jehonë sërish. Por ai gjepte elemente të tjera strukturore, në fushën e fonetikës me vendin e theksit në raport me mbaresat, ndryshe nga prapashtesat, me lateralet, apo të sintaksës me parafjalët *cu – me* në sintagma emërore. Idetë e tij janë ende në zhvillim dhe duhet të presim argumentet që do të sjellë.

S. Schumacher (2009) i është kthyer me shumë mprehtësi studimit të

huazimeve protoshqipe në latinishten/romanishten, duke synuar kështu ridiskutimin e njërit nga elementet thelbësorë të argumentimeve substratiste. Duke e cilësuar si “një paragjykim etnocentrik me formulim polemik” (ein polemisch formuliertes ethnozentrisches Vorurteil), pa të dhëna empirike pyetjen e A. Graurit “në cilën epokë mund të besohet se shqiptarët kanë qenë aq superiorë ndaj rumunëve, në mënyrë që këta të fundit të kenë huazuar nga të parët terma qytetërimi si ‘vatra’, ‘mosha’, etj?”³¹ ai, në mbështetje të krahasimeve me raportet e aborijenëve australianë me anglishtfolësit, ku ka huazime nga ato gjuhë, e cilësonte absurd pohimin e tillë dhe shpjegonte se huazime nga proto-shqipja në latinishten mund të ketë pasur qoftë në rastet kur latinishtfolësit të kenë huazuar ndonjë fjalë prej shqipfolësve, qoftë dhe në rastet kur shqipfolësit e romanizuar të kenë përdorur ndonjë fjalë të proto-shqipes në latinishten e tyre, duke krijuar kështu huazime.

Schumacher-i bënte edhe vlerësimin e studimeve rumune të raporteve të shqipes me rumanishten përmes dy personazheve: G. Brâncuș dhe I. I Russu. Të parin e cilësonte të interesuar për t’iu afruar së vërtetës, ndërsa punën e të dytit e shihte si njëformëshe dhe me metodë të vjetruar, çka, sipas tij, shpjegohej me detyrimin që kanë këto botime ndaj ideologjisë shtetërore rumune për të treguar se “rumaniteti është zhvilluar në truall të Dakisë - dhe vetëm aty”. Schumacher-i analizonte gjerësisht huazimet në rumanishten ballkanike nga proto-shqipja: *harc*, *țarcu* – *thark*, që në një studim të detajuar etimologjik e bie të lidhur me shqipen *thur*; *vatră* – *vatrë*, *votrë*, në proto-shqipen **ātrā*, prej nga u bë *votrë* > *vatrë* brenda shqipes, ndërsa forma më e hershme u huazua në romanishten ballkanike. Kështu evitohej dhe nevoja për supozimin se fjala do të ketë hyrë nga toskërishtja. Më tej ai merrte në shqyrtim *pîrîu*: *përria*, *viezure* – *vjedullë*, dhe *curpen* – *kurpën*. Merrte qëndrimet ndaj ideve të Russu-it, Brâncuș-it, Çabejtë. Të parin e kritikonte për arsye metode e për ngurtësi ideologjike, të dytin e lavdëronte për përpjekjet për t’iu afruar së vërtetës, edhe pse më vonë, mbase nën trysni të rrethanave, ishte kthyer prapa. Për Çabejnë theksonte ndryshimet ndaj Russu-it e Brâncuș-it sa i përket vendit të formimit të shqipes. Shprehte keqardhjen që në disa raste Çabej, sipas tij, nuk ishte i saktë në çështje të historisë fonologjike.

³¹ Graur (1936), f. 63.

Në fushë të përkimeve strukturore ai merrej sidomos me çështjen e nyjës, ku shqyrtonte sërish çështjen e aglutinimit të emrit me nyjën, që mendonte se do të ketë ndodhur para se të binin në proto-shqipen bashkëtingëlloret hundore fundore në fjalët shumëërrokëshe, çka, në krahasim me zhvillimet e tilla në latinishten e në greqishten, i dukej të vendosëj para sh. I para Kishtit. “... ka porse një argument thelbësor kronologjik, që në diskutimin për nyjën e prapavendosur deri tash nuk është marrë parasysh: në shqipen përngjitja e emrit dhe nyjës shquese vijuese ka një lashtësi të madhe – kjo shihet sidomos nga fakti se kallëzorja e emrave mashkullorë e femërorë me nyjën shquese në shqipen e lashtë kishte formën /-në/, se kjo /-në/ lidhet me *-om+*-tom, përkatësisht *-ām+*-tām”. “... përngjitja midis emrit dhe nyjës shquese duhet të ketë ndodhur para se në shqipen bashkëtingëllorja hundore fundore në fjalët shumëërrokëshe të jetë bjerrë”, f. 56

Sipas tij, nuk ka të dhëna direkte kur u borën bashkëtingëlloret hundore, por ka mundësi krahasimi me latinishten, ku mund të çohet deri në shekullin III para K., e me greqishten, ku do të jetë zhdukur në shekullin II para Krishtit. Prandaj, nëse proto-shqipja lidhur me këtë çështje fonetike do të jetë sjellë afërsisht si latinishtja e greqishtja e asaj kohe, bashkëtingëlloret përkatëse hundore të proto-shqipes do të jenë zhdukur tërësisht më së voni në sh. I para K. Meqenëse përngjitja e emrit me nyjën shquese duhet të ketë ndodhur para rënies së bashkëtingëllores hundore, kjo do të thotë se protoshqipja qysh para sh. I para K. kishte një shquese të përngjitur (f. 57). Është e besueshme që krijimi i nyjës shquese në gjuhën shqipe të ketë ndodhur nën ndikimin e greqishtes. Krijimi i nyjës mund të konsiderohet fenomen areal. Por, meqë nyja shquese e gjuhëve romane është krijuar vetëm pasi të jenë mëvetësuar ato, kjo do të thotë se në rastin e krijimit të nyjës në shqipen nuk kemi të bëjmë me ndonjë ndikim nga latinishtja, po përkundrazi, shqipja e lashtë mund të kishte ndikuar në çështjen e prapavendosjes së nyjës shquese në rumanishten, që është e vetmja gjuhë romane me një të prapavendosur e që në fqinjësi kishte shqipen, e cila do ta ketë prapavendosur nyjën shekuj më herët. Në romanistikë një ide e tillë është kundërshtuar.

Schumacher-i nuk i kishte shënuar si të njohura idetë e S. Rizës për krijimin mbi dy mijë vjet më herët të nyjës shquese (të paravendosur, e që u prapavendos më vonë) në shqipen, as për ngjashmërinë

me greqishten e vjetër lidhur me krijimin e një shquese,³² as idetë e Bokshit për mundësitë e ndikimit të shqipes në rumanishten sa i përket prapavendosjes së një dhe për diskutimin lidhur me prejardhjen e *-n* të kallëzores.³³ Përfundimi i Schumacher-it më duket me interes: në Ballkan latinishtja e folur, përkatësisht rumanishtja, ka qenë në kontakt me proto-shqipen, prej së cilës ka pësuar ndikime leksikore dhe strukturore. Ku do të jetë zhvilluar ky kontakt, sipas tij, nuk dihet, por mund të thuhet se një pjesë e proto-albanëve u romanizua dhe ajo pjesë solli pastaj tipare leksikore e strukturore të gjuhës së saj në latinishten. Sa i përket konceptit të substratit ai mendonte se kemi të bëjmë me një mistifikim. Përdoret kryesisht nga ata që duan të mohojnë se proto-shqipja mund të ketë ndikuar në latinishten e folur/ rumanishten në Ballkan. Substrati i paemër ballkanik, sipas tij, ka një prapavijë politike: “shërben para së gjithash për të mbështetur tezën e autoktonisë që në Rumani praktikisht është ngritur në rrafsh doktrine shtetërore”, 59.

Në krahasimet midis rumanishtes dhe shqipes na dalin elemente të ndryshme: të vjetra, strukturore, sintaksore, leksikore të shtresave të ndryshme. Në konceptimet e Sprachbundit ballkanik ato që janë vetëm të shqipes dhe të rumanishtes sikur dalin periferike, dhe aty hyjnë më të vjetrat, gjithësi përbashkësitë vetëm të këtyre gjuhëve para periudhës sllave. Pastaj vijnë përbashkësitë nga fondi latin dhe më tej ato me burim sllav, për të mos u ngjitur më tej në kohë kur kontaktet midis dy gjuhëve duket të kenë qenë jo të drejtpërdrejta dhe intensive. Prandaj, për të folur në mënyrë më të saktë për vendin e shqipes në lashtësi del e nevojshme të shohim raportet e këtyre gjuhëve në fushën e latinitetit. Haralambie Mihăescu dhe të tjerët kishin konstatuar se shqipja, duke u folur në fqinjësi dhe në hapësira ku dominonte latinishtja, ka një shtresë të gjerë fjalësh latine në të gjitha fushat, rreth 600 fjalë bazë. Latinizmat e shqipes për një pjesë janë më të hershëm se të rumanishtes, kanë karakter edhe urban, më pak rural se të rumanishtes, për një pjesë afrohen më shumë me dalmatishten e romanitetin perëndimor; është vërejtur një shtresë që veçon latinizmat e shqipes dhe të greqishtes nga latinizmat e tjerë ballkanikë.³⁴ Qysh

³² Riza (1958), Riza (1966).

³³ Bokshi (1980), Bokshi (1984).

³⁴ Mihăescu (1966); Mihăescu (1981). Shih shtojcën.

Meyer-Lübke kishte parë se latinizmat e shqipes ishin më të vjetra, se janë kryesisht nga forma të thjeshta, ndërsa të gjuhëve romane derivate, më popullore.

Kjo do të thotë se në raport me rumanishten shqipja ishte folur më në perëndim të Gadishullit Ballkanik. Fakti se në shqipen kemi huazime të vjetra greke, shumë më tepër se në rumanishten, flet po ashtu në të mirë të këtij konstatimi.

Me interes kanë qenë pikërisht në këtë drejtim vrojtimit e Jürgen Kristophson (1988: 51-93) për romanizmat e shqipes. Sipas tij, kontaktet e shqipes me latinishten/ gjuhë romane kanë qenë dinamike, në kohë dhe hapësirë. Në parim, duke lënë anash latinishten e periudhës klasike standarde, gjuhë e shkruar, ai veçonte më tej latinishten e periudhës pasklasike, gjuhë e shkruar, gjuhën popullore latine, të periudhës klasike, gjuhën popullore latine të periudhës pasklasike, variantet rajonale në kohë të ndryshme, gjuhët joromane në pika të ndryshme kohore, duke vendosur kështu kontakte dinamike dhe jo njëdrejtimëshe midis idiomës vendore jolatine dhe idiomave romane (latinishte popullore) në kohë të ndryshme. Ndër periudhat që vërehen nga skica e tij, f. 53, del se kontakte mund të parashikohen midis latinishtes në kuptimin e gjuhës popullore të periudhës klasike, por edhe të latinishtes klasike standarde, pastaj midis latinishtes popullore të periudhës pasklasike, ku relacionet midis lat. klasike dhe romanishtes së periudhës së kohës së tashme e romanishtes së kohës klasike janë të tipit të kontinuitetit, por janë të mundshme aty ndikime lat. klasike pasklasike në të dhe në shqipen përkatëse njëherësh; derisa në periudhat e mëparme kemi ndikime në shqipen nga latinishtja dhe romanishtja apo latinishtja popullore e kohës klasike e pasklasike, në një periudhë kohore të caktuar kemi ndikime nga romanishtja në variacionet rajonale të tipit rumanishte, të tipit rajonal dalmatishte dhe të tipit rajonal italishte, të gjitha në një periudhë të shqipes së hershme (Frühalbanisch). Në këtë lak kohor mendohet të ketë pasur një fazë bilinguizmi midis shqipes përkatëse dhe para-rumanishtes; në periudhën kohore vijuese, ndërkaq, shënohen më tej kontakte dhe ndikime midis romanishtes së tipit dalmat e italian, por jo më rumun në shqipen. Në kohën t3, pra, kemi një kontakt të tipit të bilinguizmit të përhapur midis parashkallës së rumanishtes së sotme, para-rumanishtes dhe rumanishtes së hershme dhe para-shqipes apo shqipes së hershme (Vor-, Früh-albanisch):

këtu mendohet të ketë pasur ndikime nga drejtimi i romanishtes së tipit para-rumun apo rumanishte e hershe në para-shqipen apo shqipen e hershme, por edhe e kundërta: kjo merret si një situatë e bilinguizmit të përhapur, apo edhe si e rrethanave të substratit të disa grupeve të folësve të shqipes së asaj shkalle, por jo të gjithëve për përkatësen romane. Këtë hipotezë e mbështeste, pas tij, më tej fakti se elementi autokton i rumanishtes shfaq paralele të pjesshme me shqipen, sakohë që me gjuhë të tjera nuk dalin korrespondenca bindëse.³⁵ Pavarësisht se ka raste shpjegimesh kronologjike-etimologjike të errëta, diskutimi i tij në bazë të kriterëve nga fusha e zhvillimeve fonetike e semantike ka vlerë. Prej këtyre analizave të risimeve del se disa prej elementeve romane të shqipes lidhen me rumanishten, konkretisht me para-rumanishten apo rumanishten e hershme. Si ilustrim jep rastin: lat. *scala*, rom. *scala*, formë e veçantë gjuhësore *scarǎ* (forcim i *l* ndërzanore, dobësim i fundjes), rom. e re: *scala* it., *scară* rum. (*ʃ*: *r*), *échelle* fr., *escala* sp. Huazimi në shqipen e hershme *shkallë* (*ʃ* = *ll*, në fund ka *ë*, në fillim *sh*). Shqipja dhe rumanishtja këtu ndahen nga gjuhët e tjera romane me ndryshimin e *-l-*, f. 56. Pak më i vështirë shihet rasti i emrave popullorë të muajve (f. 56-7):

lat. letr.	romane rajonale	rajonale romane	rumune/ shqipe
	(forma teorik. të rind.) realizime të mundshme fonet.		
<i>ianuarius</i>	<i>kalendarius</i>	<i>kałendariu</i>	<i>cārindar/ kallënduar</i>
<i>februarius</i>	<i>feurariu</i>		<i>făruar/ fruar</i>
<i>martius</i>	<i>marču</i>		<i>marʃ/ mars</i>
<i>aprilis</i>	<i>prihtu</i>		<i>prier/ prill</i>
<i>iumius</i>	<i>ceresiarius</i>	<i>k'erešariu</i>	<i>cirešar/ qershor</i>
<i>iulius</i>	?
<i>augustus</i>	<i>agustu</i>		<i>agust/ gusht</i>
<i>septembris</i>	?
<i>octobris</i>	?
<i>novembris</i>	<i>brumarius</i>	<i>brumariu</i>	<i>brumar/ brymor</i>
<i>decembris</i>	<i>Sanctus Andreas</i>	<i>san andrea</i>	<i>îndrea/ shënëndre</i>

shën e shqipes duhet t'i përgjigjet formës së vjetër rumune *sîn*, si te it. *san*. Forma e plotë, apo e gjatë, në rumanishten është sllave – *sfint*, apo greke – arum. *ajiu*, shqip *shenjt*, *i*, *e*, prandaj duhet të jetë nga një tjetër idiomë romane, ku *-nct* u bë *-nj*. Do të vërejmë se në rastet si *gusht*, mund të kemi të bëjmë me fazë më të hershme, sepse rënia e zanores në fillim përputhet

³⁵ Kristophson 1988, f. 53-54.

me të tjerat: *Ndue, Ndre, mik, rrgjan*, etj.; te *qershor, brymor* mund të kemi të bëjmë me huazim të përmes *qershi, brymë* dhe pastaj ndërtime brenda rrjedhave të shqipes; te *shën, shenjtë*, kemi të bëjmë me kronologji tjetër të huazimit të terminologjisë së krishterë, prandaj edhe shtresë tjetër gjuhësore, nuk e di sa e afërt me dalmatishten.

Midis lat. rum. e shq. ai vendos ndërpërgjegjësi tingullore si vijon:

latinisht	rumanisht	shqip
<i>a në pozitë të theksuar</i>	<i>ă, î</i>	<i>ë</i>
<i>i në pozitë të theksuar</i>	<i>ă, î</i>	<i>ë</i>
<i>ce-/ci-</i>	<i>ce-/ci-</i>	<i>q-</i>
<i>ge-/gi-</i>	<i>ge-/gi</i>	<i>gj-</i>
<i>s</i>	<i>s</i>	<i>sh</i>
<i>ti-, ci- para zanores</i>	<i>ci-, ț</i>	<i>s</i>
<i>l ndërzanore</i>	<i>r</i>	<i>ll</i>
<i>cl-, gl-</i>	<i>kl'-, gl', e vjetër ; zhvillimi i mëtejshëm i ndryshëm</i>	
<i>-ct-</i>	<i>pt</i>	<i>ft. Por shqip jt, t, qt, f. 57</i>

Korrespondenca të tilla tingullore flasin për kohë më të vjetër, aq më tepër që ato mund të vërehen edhe tek elementi autokton i rum.: *viezure/ vjedhull*. Edhe kjo flet për kontakte të lashta midis romanëve rajonalë dhe joromanëve vendorë, f. 57

Kur në fjalët shqipe me prejardhje romane kemi reflekse të tjera, kjo do të thotë se duhet të shohim lidhjet me ndonjë gjuhë tjetër romane, si gjuhë e dytë e kontaktit – këtu dalmatishtja; nëse as kjo nuk jep shpjegim duhet të shohim një gjuhë të panjohur romane, latinishte ende e panyjetuar, apo të shohim një zhvillim brenda shqipes, f. 58.³⁶

Proceset e derivimit nxjerrin vështirësi: *tjegull - tegula, tjegullar - tegularius; ashpër, shkurt - ashpërim, shkurtim - asprime, scurtime*. Por ne do të vërejmë se *ashpërim* nuk është popullore, *ashpërsim* letrare brenda shqipes. Paqartësi sjell fenomeni i *multiple etymologies*³⁷ – rastet kur një fjalë shqipe mund të dalë nga burime të ndryshme romane: *kungë* me *kungoj*, apo me *cong*, f. 59.

Studimet e mëparme theksojnë lidhjen e fortë të këtyre elementeve romane të shqipes me rumanishten³⁸ ose marrin dy rryma kryesore huazimesh – nga rumanishtja dhe nga dalmatishtja³⁹ me kufizime,

³⁶ Për bazë ka Mihăescu 1966, Haarmann 1972, Çabej 1976, Pușcariu 1905, Meyer-Lübke.

³⁷ Muljačić 1979.

³⁸ Weigand 1927, Skok 1940.

³⁹ Barić 1956 I, Çabej 1962.

shih një pozitë të ndërmjeme midis dalmatishtes e rumanishtes), ose lidhjet me rumanishten i interpretojnë veçan.⁴⁰

Nga ana tjetër, sllavizmat e shqipes dhe të rumanishtes shfaqin po ashtu ngjashmëri dhe dallime. Dallimi i parë qëndron në sasi: rumanishtja ka shumë më tepër sllavizma se shqipja. Madje edhe fjalë kështu të zakonshme si *iubi, drag, prieten, obraz, slujbă (meshë)* në rumanishten janë nga sllavishtja. Më i rëndësishëm është fakti se nga sllavishtja në rumanishten kanë hyrë kryesisht bullgarizma, ndërsa në shqipen edhe serbizma. Duket se vala e hershme sllave drejt jugut të Ballkanit nëpër Bullgari e nëpër luginën Morava-Vardar ka shkuar më parë drejt Greqisë deri në Pelepones, ku ka lënë gjurmë sllavizmesh para metatezës së likuideve sllave, që ka përfunduar në sh. 9. Duket se disa gjurmë sllavizmesh të hershëm ruhen në shqipen e jugut pikërisht nga ato kohë, ndërsa aspekti bullgar i ndikimit sllav andej u theksua pas shekullit X.⁴¹

Edhe ky dispozicion i sllavizmave të shqipes e të rumanishtes flet për ndodhjen e këtyre gjuhëve kryesisht në dy anë të Gadishullit - lindje/ perëndim. Kur kësaj i shtojmë edhe vlerësimet në rrafshin IE për shqipen si më perëndimore në raport me trakishten, frigishten, armenishten,⁴² apo edhe analizat leksikostatistike që thonë po këtë gjë,⁴³ nuk mund të mos flasim për vendosjen e proto-shqipes në hapësirat më perëndimore të Ballkanit. Kështu mund të ndihmojmë dhe për vendosjen më të saktë të kontinuumit gradual dhe me ndryshime të romanitetit ballkanik nga perëndimi në lindje, po edhe nga shek. II para K. e më vonë.

Diskutimet e paraqitura kështu përmbledhtazi sikur na udhëzojnë në të provojmë të nxjerrim përfundimet vijuese:

- shqipja dhe rumanishtja kanë ngjashmëri midis tyre në rrafshet të ndryshme. Në rrafshin strukturor ngjashmëritë nuk shkojnë më herët se sh. VII-VIII, kur u formua rumanishtja, sepse në latinishten popullore nuk dokumentohen. Tiparet si burimi dhe prapavendosja e njëjës shquese në shqipen janë të lashta, ndërsa në rumanishten mbase pas sh. VIII. Prapavendosja dhe përngjitja e njëjës shquese duket të ke-

⁴⁰ Mihăescu 1966.

⁴¹ Rosetti (1968); Mihăilă (1960); Pătruț (1974, 1974a); Ylli (1996); Svane (1992), etj.

⁴² Heinal, I. 2003.

⁴³ Holm, 2009.

të marrë fund në sh. VI-VII, prandaj bëhet e mundshme hipoteza për ndikimin eventual të shqipes mbi rumanishten. Rotacizmi do të jetë zhvillim i pavarur;

- ngjashmëritë midis dakorumanishtes dhe toskërishtes, që theksoheshin ndonjëherë pa të drejtë në raport me ndonjë shpërngulje të supozuar të folësve të toskërishtes nga hapësirat veriore, duan parë më tepër të kohëve të zhvillimeve ballkanike, pra pas vendosjes së sllavëve;

- në leksik ka shtresa të ndryshme;

- leksiku latin i të dy gjuhëve, edhe kur mendohet nga një latinishte ballkanike (sa njësores?), në rastin e shqipes shfaq veçori më përbërëse, më urbane, më të hershme se në rumanishten;

- zhvillimet fonetike në fushën e latinizmave të dy gjuhëve shfaqin ngjashmëri, por edhe ndryshime;

- sa i përket leksikut të përbashkët paralatin, për një pjesë kemi të bëjmë gjithsesi me elemente të lashta, por as në ato raste nuk mund ta dimë se nga cila gjuhë na vijnë; shtegtimi i leksikut është i njohur; për një pjesë kemi të bëjmë me zhvillime më të vona, sepse kërtë e thonë proceset fjalëformuese të identifikueshme brenda shqipes.

Shtojcë I: Fjalë të përbashkëta të shqipes e të rumanishtes

G. Brâncuș: Vocabularul autohton allimbii române , București, 1983.		sipas A. du Nay, The Early History of Rumanian , Chicago, 1977		Istoria limbii române, volumul II , București 1969, C. Poghiric	
abure	avull	abes dial.	besë	abeş	besë
arëa	Rrgäll e Madhe, ragäl,	abure	avull	abur(e)	avull
baci	baç, bac,, baçicë	arëa	ragall	amurg	murg
bajcã	bashkë	as	as	arëa	ragal
baltur	bollë, bullar	baci	baç	aş(i) 'ba, nu'	as
balegã	bagël, bajgë	bãl, bãlaş	balosh	baci	baç, bac
baltã	baltë	balã, balaur	bollë	balaur, balã	bollë
barz(ã)	bardh	balegã	bagël, bajgë	balegã	bajgë
bîlc	pellg	baltã	baltë	baltã	baltë
bîr	berr	barã	bërrakë	barã	bërrakë
brad	bredh	barzã	bardhë	bardzu	bardh
brîu	brez	başcã	bashkë,	bascã	bashkë
brusture	brushtull	bîlc	pellg	bãl, bãlan, bãlaş	balash
buc	byk	bîr	berr	bîlc	pellk, pellgu,
bucura	bukur	boreasã	bareshë	bîr interj.	berr
bunget	bung	brad	bredh	boreasã	bareshë
buzã	buzë	brîu	brez	brad	bredh
cãciulã	kësulë	brustur(e)	brushtull	brîu cingãtoare'	brez
cãlbeazã	këlbazë	buc	byk	brusture	brushtull
cãpuşã	këpushë	bucura	bukur, zbukuroj	buc 'pleavã'	byk
cãtun	katund	bunget	bung	bucura	bukuronj
ceafã	qafë	burtã	burdhë	bunget	bung
cioarã	sorrë	buzã	buzë	burduf	burdhë
cioc	çok	cãciulã	kësulë	buzã	buzë
ciucã	çukë	cãpuşã	këpushë	cãciulã	kësuljë
ciuf	xhufkë	cãtun	katund	cãlbeazã, gãlbeazã	këlbazë
ciump	thumb	ceafã	qafë	cãpuşã	këpushë
cipi	çupis	cioarã	sorrë	cãtun	katund
ciut	shut	cioc	çok	ceafã 'cerbice'	qafë
coacãzã	kokëzë	ciuca	çukë	cioarã	sorrë
copac	kopaç	ciuf, ciof	cufkë, xhufkë	cioc 'ciocan'	çok
copil	kopil	ciump	thumb	ciucã	çukë
curpen	kulpër	ciupi	cupis	ciuf	cufkë, xhufkë
curşã	kurthë	ciut, şut	shut	ciump, ciomp	thump,
droaie	drojë, droe	coacãzã	koqe	ciupi	çupis
druete,	dрутë	codru	kodër	ciut, şut	shut
fãrimã	thërimë	colibã	kolibe	coacãzã	koqë, koqëzë
fluiet	floiere	copac	kopac	codru 'pãdure'	kodër
gard	gardh	copil	kopil	colibã kolubë (!)	kolibë
gata	gati	curpen, curpãn	kulpër, kërpnajë	copac	kopaç
ghimpe	gjemb	curşã	kurthë	copil 'bastard'	kopil
ghionoaie	gjon	daş	dash	cerpen, curpãn	kulpër
ghiuj	gjysh	droaie	droje	curşã	kurthë
grapã	grep	dru	dru	daş	dash
gresie	gërresë	drum	dhrom, drum	droaie	droe, droje
groapã	gropë	fãrimã	thërimë	druete 'lemn'	dru
gurmaz	gurmaz	fluiet	flojere	fãrimã	thërimë
gruno	krunde	gãlbeazã	gëlbazë, këlbazë	fluiet	flojere
gujã	gushë	gard	gardh	gãlbeazã	gëlbazë
hamej	hamës	gata	gati	gard, gardinã	gardh
jumãtate	gjymësë	ghimp	gjemb, glemb	gata gat,	gatuaj
lete	letë	ghionoaie	gjon	ghimpe	gjëmp
leurda	hudër	ghiuj peior.	gjysh	ghionoaie, ghion	gjon
mãgar	magar	gogã	gogë	ghiuj	gjysh
magurã	magulë	grapã	grep	gogã	gogë
mal	mal	gresie	gërresë	grapã	grep
mãrar	mërajë	groapã	gropë	gresie	gërresë

mare	madh	grunz	krunde	groapă	gropë
mazëre	modhull	gurmaz	gurmas	grumaz	gurmas
mînz	mâz	guşă	gushë	grunz	grundë, krundë
moş	moshë	hameş	hamës	guşă	gushë
mugure	mugull	hututui, e	hutoj	hameş	hamës
murg	murg	late	lesh	hututui	hutoj
muşcoi	mushk	lehăi	leh	jumătate	gjymësë
năpîrca	nepërkë	lete	lehtë	lehăi	leh
noian	ujanë	leurdă	hudër	lete	leh(ë)të
pîrîu	përrua	măgar	magar	leurdă	hudhërë, hurdhë
pupăză	pupëzë	măgură	magulë	mal	mal
raţă	rosë	mal	mal	mare	madh
rînză	rëndës	mărar	mërajë	mazăre	modhullë
sărbad	tharbët	mazăre	modhullë	măgar	magar
scapară	shkrep	mînz	maz	măgură	magulë
scrum	shkrum	mînz	maz	mărar	maraj, mërajë
sîmbure	sumbull	mire	mirë	mire	mirë
şopîrla	zhapi	moş	moshë	mînz	mës, mëzi
spînz	shpendër	mugur(e)	mugull	moş	moshë
ştira	shtjerra, shqerra	murg	murg	mugur	mugull
ştrepede	shtërpi	muşcoi	mushk	muşcoi	mushk
strugure	shtrydh, shtrij?	năpîrcă	nepërkë	năpîrcă	nepërkë
strunga	shtrungë	noian	ujanë, ujë	noian	ujanë
ţap	cap	pîrîu	përrua	pîrîu	përrua
harc	thark	pupăză	pupë	pupăză	pupë, pupëzë
ţeapa	thep	raţă	rosë	raţă	rosë
urdă	urdhë	rîndză	rranxa, rransa	rîndză	rënd, rrâ
vatră	vatër, votër	sarbăd	tharbët	sarbăd, arbed	tharbët
viezure	vjedull, vjedhull	scăpăra	shkrep	scăpăra	shkrep
zară	dhallë	scrum	shkrum	scrum	shkrum
zgardă	shkardhë	sîmbure	sumbull	sîmbur(e)	umbull, thumbull
hë		sopîrlă	zhapi, jo shapi	spînz,pînt	shpendër
		spînz	shpendër	spîrc 'spîn,	spërk
		spîrc	spërk	spuză	shpuzë
		spuză	shpuzë	ştrepede	shtrep
		ştiră	shtjerrë	strungă	shtrungë
		ştrepede	shtrep	şopîrlă	shapi
		strungă	shtrungë	ştiră	shtjerrë
		ţap	cap	şut	shut
		ţarc	cark, thark	ţap	cap
		ţeapa	thep	ţarc	thark
		urdă	urdhë	ţ(e)apă	thep, gëthap
		vatră	vatër/votër	urdă	urdhë
		viezure	vjedullë	vatră	vatër
		zară	dhallë	(v)iezure,	vjedhullë
		zgardă	shkardë	zară	dhallë
				zgardă	shkardhë

Shtojcë 2: latinizmat e shqipes dhe të rumanishtes, krahasimi leksikor sipas Mihăescu (1981):

Qysh W. Meyer-Lübke e kishte theksuar karakterin më arkaik të latinizmave të shqipes në raport me të rumanishtes. Mund të pajtohemi po ashtu me këtë vijë diskutimesh, të theksuar sidomos më vonë nga H. Mihăescu, se paralelizmat fonetikë midis latinizmave të shqipes dhe të rumanishtes janë më të vogla seç besohej. është vërejtur po ashtu se në gjuhën shqipe elementet latine më shpesh vijnë nga format e thjeshta, ndërsa në rumanishten, po edhe në gjuhët romane, nga derivatet. Kjo është lidhur edhe me faktin se rumanishtja shpesh paraqet dhe aspekte më tepër rurale. Duke u nisur nga sistematizimit e H. Mihăescu-t le të japim këtu një pasqyrë të vogël krahasimesh të tilla:

lat. cēpa: shq. qepë, r. ceapă, gjuhët romane nga *cepulla: it. cipolla;
 lat. os: shq. vesh; lat. auriculla: fr. oreille, r. ureche;
 lat. par: shq. par; lat. paucicula: r. päreche;

lat. ramus:	shq. rrem;	lat. ramulus, ramuli: rum. ramuri
lat. rete:	shq. rjet;	lat. retella: r. rețea;
lat. spina:	shq. shpinë;	lat. spinalis: r. spinare
lat. truncus:	shq. trung;	lat. *trunculus: r. trunchi;
lat. vetus, veteris:	shq. i vjetër;	lat. veteranus: r. bătrîn

Fjalë që konsiderohen më të hershme:

colare:	kulloj,	rum. strecura: extracolare;
quietu:	i qetë,	rum. încet
ruinare:	rrënojt,	rum. strica: extricare;
sanare:	shëroj,	rum. sănătos, însănătoși
fides:	fe,	rum. credință;
liber:	lirë,	rum. iertat
veritate:	vërtetë,	rum. adevăr, ad de verum;
voluntatem:	vullnet,	rum. voință
Shqip –	terma paganë,	rum. terma popullore të krishterë – bizantinë:
këllanë:	calandae –	sll. colindă;
javë:	hebdomas –	r. septimană
perëndi:	imperante –	dumnezeu: domine Zeus;
rshaje:	rosaliae –	r. sll. rusalii
e shtunë:	saturni dies –	r. sîmbăta: Sabbat;
kishë (klishtë):	ecclesia -	r. biserică: basilica
kërshtëndella:	Christi natalia –	r. crăciun;
shëndërtat:	snactam trinitatem –	r. sfînta troiță
bekoj:	benedicere –	r. blagoslavi;
qelq:	calicem –	r. potir
ipeshkv:	episkopus –	r. vladică;
ungjill:	evangelium –	r. evanghelie
ferr:	infernum –	r. iad;
mallkuj:	maledicere –	r. cleveti
meshë:	missa –	r. slujbă;
mung:	monachus –	r. călugăr
parriz (parajs):	paradisus –	r. rai;
shëkroj:	sacrare –	r. sfînti
shekull:	saeculum –	r. veak;
shpërej:	sperare –	r. nădăjdui, etj.

Në vijën e shembujve të sistemuar nga Mihăescu veçohen katër kategori që dalin më shpesh në shqipen e jo në rumanishtë:

1. elemente me origjinë kulte
2. terma flore e faune mesdhetare në shqipen, jo në rumanishten
3. terma kishtarë katolikë
4. terma të tregtisë detare dhe të terminologjisë detare

shqip	latinizma	rum. huazim sllav a tj.	mesdhetare:
mik:	amicus	priten	mendull - amygdala,
anmik:	inimicus	dușman	ngjalë - anguilla,
i aftë:	aptus	potrivit	bush – buxus
këlqere:	calcaria	var	mlysh – lucius
kafshë:	causa	pricină	myll – mûlus
qind:	centum	sută	voshtër – oleaster
qimkë:	cimica	plașniță	voj – oleum
kullos:	colere	hrăni	ulli – oliva
këshill:	consilium	sfat	pjeshkë – pessica
dragua:	draconem	zmeu	shermend – samentum
fëjëj:	fallere	greși	
lirë:	liber	slobod	

Rumanisht mungojnë edhe : kënatë, gunë, limë, lluqerë, kastile, por janë: këngë – cîntec – canticum, kaptinë – căpătină – capitina, mbret – împărat – imperator.

Bibliografi:

- André du Nay, **The Early History of Rumanian**, Chicago, 1977, 62 -
- Banfi, Emmanuele 1987 : *Cristianizzazione nei Balcani e formazione della lega linguistica balcanica*, **Zeitschrift fuer Balkanologie**, 23, 4-18.
- Bariq (1955), Henrik: **HËmje në historinë e gjuhës shqipe**, Prishtinë, 1955.
- Beci, Bahri: **Probleme të lidhjeve të shqipes me gjuhët e tjera ballkanike**, Pejë, 2002.
- Bokshi, Besim: **Prapavendosja e nyjave në gjuhët ballkanike**, Prishtinë, 1984.
- Bonnet (1998), Guillaume: **Les mots latins de l'albanais**, Paris.
- Brâncuș (1978), Grigore: *Balkan Studies*, në A. Rosetti & S. Golopenția Eretescu (Eds.): **Current Trends in Romanian Linguistics**, Revue roumaine de linguistique t. XXIII, no. 1-4 dhe Cahiers de linguistique théorique et appliquée, t. XV, no. 1-2, Editura Academiei Republicii Socialiste România, București, 1978, ff. 367-379
- Brâncuș (1995), Grigore: **Cercetări asupra fondului traco-dac al limbii române**, Bibliotheca Thracologica VIII, București, 1995, f. 111.
- Brâncuș (1983), Grigore: **Vocabularul autokton al limbii române**, București, 1983, 197.
- Brixhe, Claude/ Panayotou, Anna (1994): *Le thrace*, në Bader, Françoise (Ed.): **Langues indo-européennes**, Paris, 1994, ff. 179-203;
- Çabej (1959), E.: *Unele probleme ale istoriei limbii albaneze*, në **Studii și cercetări lingvistice**, 4, X, București, 1959, f. 531 e tutje.
- Çabej (1962), Eqrem 1962 : *Zur Charakteristik der lateinischen Lehnwoerter im Albanischen*, **Revue de linguistique** 7, 161-199. shqip: Çabej (1975), E.: *Karakteristikat e huazimeve latine të shqipes*, në **Studime filologjike** 1, 1975;
- Çabej (1963), E.: *Rreth disa çështjeve të historisë së gjuhës shqipe*, **Buletin i USHT, SSSH**, 3, 1963, f. 73,
- Çabej (1967), Eqrem 1967: *Das Albanische und seine Nachbarsprachen*, **Die Sprache** 13, 39-51.
- Çabej (1970), Eqrem: **Hyrje në historinë e gjuhës me fonetikë historike**, Prishtinë, 1970.
- Çabej (1971-73), Eqrem: *Albanische Beiträge zur Kenntniss des lateinischen Wortschatzes*, **Bolletino dell'Atlante linguistico mediterraneo** 13-15, 365-377.
- Çabej (1975a), Eqrem: *Disa mendime mbi marrëdhëniet gjuhësore rumune-shqiptare*, **Studime filologjike** 1, 1975.
- Çabej (1976), Eqrem: **Studime gjuhësore III**, Rilindja, Prishtinë, 1976.
- Çabej (1976b), Eqrem: *Rumänisch-albanische Wortparallelen*, në **Revue roumaine de linguistique**, t. XXI, 1976, ff. 55-57.
- Camarda, Demetrio: **Saggio di gramatologia comparata sulla lingua Albanese**, Livorno, 1864, 188-189.
- Demiraj (1989), Sh.: **Gjuha shqipe dhe historia e saj**, Prishtinë, 1989, 222-223.
- Demiraj (1994), Shaban: **Gjuhësi ballkanike**, Shkup, 1994.
- Densusianu (1901), Ovid: **Histoire de la langue roumaine**, Paris, 1901.
- Detschew (1957), Dimitar: **Die thrakischen Sprachreste**, Wien, 1957.
- Domi (1968), Mahir: *Concordances et analoges suntaxiques albano-roumaines*, në **Actes du premier Congrès international des études balkaniques et sud-est européennes, VI**, Sofia, 1968, ff. 681-695.
- Domi (1975), Mahir: *Considérations sur les traits communs ou paraleles de l'albanais avec les autres langues balkaniques et sur leur étude*, në **Studia albanica**, Tirana, 1, 1975, ff. 81-91.
- Domosileckaja (1988), Maria Valentinova: **Leksičeskie svjazi albanskogo s vostorromanskimi jazykami (na materiale terminov skotovodčeskogo hozjaistva)**, Avto-

- referat disertatii kandidata filologičeskikh nauk, Leningrad, 1988, ff. 3-22.
- Dumitrescu, F, Pamfil, V. Barboricǎ, E., Cvasnǐi, M., Theodorescu, M., Cǎlǎrașu, C., Marta, M., Toma, E., Roxǎndoiu, L. (1978): **Istoria limbii române**, București, 1978
- Georgiev (1960), VI.: *Albanisch, dakisch-mysisch und rumänisch*. Die Herkunft der Albaner, **Balkansko ezikoznanie/ Linguistique balkanique, II**, 1960, Sofia, 1-19.
- Georgiev (1963), V.: *Thrace et illyrien*, **Balkansko ezikoznanie, 6**, 1963, Sofija.
- Haarman (1972), H.: **Der lateinische Lehnwortschatz im Albanischen**, Hamburg, 1972.
- Hajnal (2003), Ivo: *Methodische Vorbemerkungen zu einer Paleolinguistik des Balkanraums*, në Bammesberger, A. & Vennemann, Th.: **Languages in prehistoric Europe**, 2003, ff. 117-145.
- Hamp (1957), E. P.: *Albanian and Messapic*, në PULGRAM, E. (Ed.): **Studies Presented to Joshua Watmaugh on his sixties birthday**, 'S-Grevenhage, 1957, 73-89, shqip te **Studime krahasuese për shqipen**, përgatiti R. Ismajli, Prishtinë, 2007, 147-170;
- Hamp (1966), Eric P.: *The position of Albanian*, **Ancient Indo-European Dialects**, Berkeley, 97-122, shqip te **Studime për shqipen** ASHAK, Prishtinë 2007;
- Hamp (1976), E. P.: *On the distribution and origin of Vatra*, në **Opuscula slavica et linguistica**, Klagenfurt, 1976, 201-210;
- Hamp (1978), Eric P.: *Strunga*, **Balkansko ezikoznanie 20**, 1978, 115-119;
- Hamp (1980), E. P.: *Thracian, Dacian and Albanian-Romanian correspondences*, **Actes du IIe congrès international de thracologie**, 1980, f. 575-60;
- Hamp (1981), E. P.: *On the distribution and Origin of (h)urda*, **Linguistique balkanique XXIV**, 3, 1981, 47-50.
- Hamp (1981a), E.P.: *Autochthonous vatra*, **Revue roumaine de linguistique 24**, 1981, 315.
- Hamp (1989): *Yugoslavia - a Crossroads of Sprachbuende*, në **Zeitschrift fuer Balkanologie**, 25/ 1, 1989, ff. 44-47.
- Hamp (1990), E. P.: *The Pre-Indoeuropean Language of Northern (central) Europe*, in Markey et Greppin (dir.): **When Worlds collide. Indo-Europeans and Pre-Indo-Europeans**, Karoma Publisher, 1990.
- Hamp (1998), Eric, P.: *Whose were Tocharians? Linguistic Subgrouping and Diachronic Idiosyncrasy*, në V. H. Mair (Ed.): **The Bronze Age and Early Iron Age Peoples of Eastern Central Asia**, Institute for the Study of Man and University of Pennsylvania, 1998, ff. 307-346.
- Hamp (2007), E. P.: **Studime krahasuese për shqipen**, ASHAK, Prishtinë, 2007.
- Hamp, Eric, P.: *Thracian, Dacian, and Albanian-Romanian Correspondences*, në **Actes du IIe Congrès international de thracologie**, t. III, Ed. Academiei Republici Socialiste Româna, București, ff. 57-60.
- Hasdeu (1901), Petriceicu, Bogdan: *Cine sunt albanesi?*, **Analele Academiei Române**, tom XXIII, Memoriile, Secț. Literare, ff. 103-113.
- Holm (2009), H. J.: *Albanische Basiswortlisten und die Stellung des Albanischen in den Indogermanischen Sprachen*, in **Zeitschrift fuer Balkanologie 45**, 2009, f. 171-205.
- Huld (1984), Martin: **Basic Albanian Etymologies**, Ohio, 1984.
- Ismajli (1971-2), Rexhep: *Edhe diçka rreth rotacizmit në gjuhën shqipe*, në **Ditura 2/3**, 1971-72, Prishtinë, rimarrë te **Artikuj për gjuhën shqipe**, Prishtinë, 1987, ff. 184-192.
- Ismajli (1987), R.: **Artikuj për gjuhën shqipe**, Prishtinë, 1987, ff. 57-71.
- Ismajli (1996), R.: *Ballkanistika dhe prejardhja e shqipes*, **Studime 3**, 1996, Prishtinë, 1997, 255-274.
- Ismajli (1983), R.: *Marrëdhëniet e shqipes me rumanishten*, **Rilindja**, Prishtinë, 15. 1. dhe 29. 1. 1983,

- Ismajli (1987), R.: *Ndryshime fonetike të vona të shqipes dhe rumanishtes*, **Artikuj për gjuhën shqipe**, Prishtinë, 1987, f. 83.
- Istoria limbii române, volumul II**, Ed. Academiei Republicii socialiste România, București 1969, në pjesën e punuar nga C. Poghirc, f. 335-55.
- Jokl (1963), N.: *Die Verwandtschaftsverhältnisse des Albanischen zu den übrigen indogermanischen Sprachen*, **Die Sprache** 9, 1963, 113-156.
- Jokl (1984), N.: **Sprachliche Beiträge zur Paläo-Ethnologie der Balkanhalbinsel**, (Zur Frage der ältesten griechisch-albanischen Beziehungen), Aus dem Nachlass herausgegeben von O. Pfeiffer, Österreichische Akademie der Wissenschaften, Philologisch-Historische Klasse, Linguistische Abteilung XXIX, Wien 1984;
- Jokl (1928), Norbert 1928: *Balkanlateinische Studien*, **Balkan-Archiv**, 4, 195-217.
- Jokl (1936), Norbert 1936: *Zu den lateinischen Elementen des albanischen Wortschatzes*, **Glotta** 25, 1211-134.
- Joseph (?), Brian D.: *A note on Slavic Loans in Romanian: (I) revisited*, **Limba română, limbă romanică**, Academia Română, Institutul de lingvistică "Iorgu Ioedan - Al. Rosetti", estras, București, ff. 231-234.
- Joseph (1999), Brian: *Romanian and the Balkans: Some Comparative Perspectives*, në Embleton, S. & Joseph, J. & Niedereh H.J. (eds., 1999): **The Emergence of Modern Language Sciences. Studies on the Transition from Historical-Comparative to Structural Linguistics in Honour of E. F. K. Koerner**, v. 2, Amsterdam, ff. 218-235.
- Joseph (2001), Brian D.: *Is Balkan comparative Syntax Possible*, në Rivero, M. L. and Rally, A. (eds.): **Comparative Syntax of Balkan Languages**, Oxford, 2001, 17-43.
- Katičić (1976), Radoslav: **Ancient Languages of the Balkans I, II**, Hague, 1976.
- Klemenčič (2007), Simona: *K metodologiji dialektologije jezikovnih družin: sklepanje o obstoju narečenega areala*, in **Slovenski jezik/ Slovene linguistic studies**, 6, 2007, pp. 133-150.
- Klingenschmitt (1994), Gert: *Das Albanische als Glied der indogermanischen Sprachfamilie*, J. E. Rasmussen (Hrsg.), **In Honorem Holger Pedersen**, Wiesbaden, 1994, ff. 221-233;
- Kristophson, Jürgen 1988: *Romanische Elemente im Albanischen*, *Zeitschrift für Balkanologie* 24, 51-93.
- La Piana, Marco: **Studi linguistici albanesi, vol. I, Prolegomeni allo studio della linguistica albanese**, Palermo, 11939, f. 139-140, përkthimi i S. Rizës.
- Landi (1986), Adolorata: *Considerazioni sulla nota di A. Rosetti*, në **Studia albanica** 23, 2, ff. 139-144.
- Landi, Addolorata 1989: **Gli elementi latini nella lingua albanese**, Napoli.
- Lindsted, Juoko: *Linguistic Balkanization Contact-induced chang by Mutual Reinforcement*, në D. Gilberts, J. Nerbonne and J. Shaeken: **Languages in Contact**, Amsterdam, 2000, 231-246.
- Matzinger (2006), J.: **Der Altalbansiche Text Mbsuame e Krështerë (Dottrina cristiana) des Lekë Matrënga von 1592**, Dettelbach, 2006.
- Matzinger, J.: *Messapisch und Albanisch*, në **International Journal of Diachronic Linguistics and Linguistic Reconstruction** 2, 2005, 29-54.
- Meyer-Lübke, Wilhelm 1914: *Rumänisch, Romanisch, Albanesisch*, **Mitteilungen des Rumänischen Instituts an der Universität Wien** 1, Heidelberg, 1-42.
- Meyer-Lübke, Wilhelm 1904: *Die lateinischen Elemente im Albanesischen*, Gustav Gröber, **Grundriss der romanischen Philologie** 1, Bd. Strassbourg, 1038-1057.

- Mihăescu (1966), Haralambie: *Les éléments latins de la langue albanaise*, në **Revue des études sud-est européennes**, tome IV-1966, nr. 1-2, 3-4.
- Mihăescu (1981), Haralambie: *Locul elementelor lexicale latine din albaneză în cadrul romanității sud-est europene*, në Coteanu, I. & Wald, L. (1981): **Semantică și semitică**, București, 1981, ff. 216-235.
- Mihăescu (1993), Haralambie: **La romanité fans le sud-est de l'Europe**, București, 1993, botim i plotësuar nga 1978.
- Mihăilă, G.: **Imprumuturi vechi sud-slave în limba română**, București, 1960.
- Neroznak (1978), V. P.: **Paleobalkanskije jazyki**, Moskva, 1978.
- Paliga (2006), Sorin : **Influențe rumane și preromane în limbile slave de sud**, Fundația Evenimentul, București, 2006.
- Pătruț (1974), I.: *Locul elementului sllav în structura limbii române*, në **Studii de limba română și slavistică**, Editura Dacia, Cluj, 1974, ff. 91-100.
- Pătruț (1974a), I.: *Vechimea relațiilor lingvistice slavo-române*, në **Studii de limba română și slavistică**, Editura Dacia, Cluj, 1974, ff. 101-123.
- Pellegrini (1998), G. B.: **Avviamento alla linguistica albanese**, Università degli studi della Calabria, Rende, 1998
- Philippide (1894), A.: **Istoria limbii române I. Principii de istoria limbii**, Iași, 1894;
- Philippide (1927), Alexandru: **Originea românilor II. Ce spun limbile română și albaneză**, Iași, 1927;
- Poghirc (1968), C.: *Reflexions sur les problemes du daco-moesien, L'Ethogenese des peuples balkaniques*, Symposium International sur l'Ethogenese des peuples balkaniques, Plovdiv 1969, Sofia 1971.
- Poghirc (1983), Cicerone: **Philologica et linguistica**, Ausgewählte Aufsätze (1953-1983), Bochum, 1983.
- Poghirc, Cicerone: **Le roumain fans le contexte de la linguistique indo-européenne/ Limba română în limina lingvisticii indeuropene**, București
- Riza (2009), Selman: *Mbi një bashkëpërkim gramatikor të posaçëm të gjuhës shqipe me greqishten*, **Vepra 5**, ASHAK, Prishtinë, 2009, ff. 564-569, botuar për herë të parë nga dorëshkrimi i vitit 1966 te **Studime 10**, 2004.
- Riza (1966), Selman: **Sur une concordance grammaticale spécifique de l'albanais avec le grec**, ishte botuar si broshurë për Kongresin e Ballkanologëve në Sofje të vitit 1966 nga Comité National Albanais des Études Balkaniques, Tirana 1966, ff. 1-54
- Riza, Selman: **Sur une concordance grammaticale spécifique de l'albanais avec le grec**, **Studime 10/ 2003**, ASHAK, Prishtinë, 2004.
- Rosetti (1967), Alexandru: *Sur la reconstruction du dace*, në **Revue roumaine de linguistique**, t. XII, no. 2, 1967, ff. 163-164.
- Rosetti (1968), Alexandru: **Istoria limbii române de la origjine pînă în secolul al XVII-lea**, București, 1968, ka një botim të ri 1986.
- Rosetti (1972), Alexandru: *Le Vocabulaire du sud-est européens de quelques institutions*, në **Proceedings of the Eleventh International Congress of Linguists**, Bologna-Florence, 1972, ed. by Luigi Heilmann II, il Mulino, ff. 759-763.
- Rosetti (1972-73), Alexandru: *Le Vocabulaire du sud-est européens de quelques institutions*, në **Analele Societății de limba română**, 3-4, Ed. Libertatea, Panciova și Societatea de limba română, Zrenjanin, 1972-73, ff. 479-482.
- Rosetti (1972b), Alexandru: *État actuel des études de linguistique balkanique en Roumanie*, në **Actes du IIe Congrès International des études du sud-est européens**, **Tom I**, Athènes, 1972, ff. 450-455.

- Rosetti (1977), Alexandru: *Thrace, daco-mésien, illyrien, roumain et albanais. Quelques précisions*, në **Linguistique balkanique XX, 1-2**, Sofia, 1977, ff. 79-82.
- Rosetti (1977b), Alexandru: *Slavo-romanica. Considérations sur les rapports linguistique slavo-roumains à l'époque la plus ancienne*, në **Analele Universității București, Limbi și literaturi străine II**, anul XXVI, 1977, ff. 27-30.
- Rosetti (1978), Alexandru: *Sur la parenté du roumain et de l'albanais*, në **Revue roumaine de linguistique**, tome XXIII, 1978, Supplément, București, ff. 79-80.
- Russu, I. I.: **Die Sprache der Thrako-Daker**, București, 1969.
- Russu, I. I.: **Illirii. Istoria, limba și onomastika, romanizarea**, București 1969.
- Russu, Ion I.: **Etnogeneza românilor. Fondul autokton traco-dacic și componenta latino-romanică**, Editura științifică și enciclopedică, București, 1981, ff. 466.
- Sala (1999), Marius: **Du latin au roumain**, traduction de Claude Dignoire, L'Harmattan Paris – Univers encyclopedic Bucarest, ff. 187.
- Sandfeld, Kr.: **Linguistique balkanique. Problèmes et résultats**, Paris, 1930.
- Schramm (1994), G.: **Anfänge des Albanischen Christentums. Die frühe Bekehrung der Bessen und ihre langen Folgen**, Freiburg/ Brisgau, 1994.
- Schumacher, Stefan: *Lehnbeziehungen zwischen Protoalbanisch und balkanischem Latein zv. Romanisch*, në O. Schmitt & E Frantz (Hrsg.): **Albanische Geschichte. Stand und Perspektiven der Forschung**, München, 2009, ff. 37-60.
- Solta, Georg, R.: **Einführung in die Balkanlinguistik mit besonderer Berücksichtigung des Substrats und des Balkanlateinischen**, Darmstadt, 1980.
- Svane, Gunnar: **Slavische Lehnwoerter im Albanischen**, Aarhus, 1992.
- Tagliavini, Carlo 1968: **La stratificazione dell lessico albanese**, Bologna.
- Vătășescu, Cătălina: **Vocabularul de origine latină din limba albaneză în comparație cu româna**, București, 1997, ff. 543.
- Vraciu, A.: **Limba daco-geților**, editura Facla, Timișoara, 1980, ff. 218.
- Ylli, Xhelal: **Das slavische Lehngut im Albanischen I**, München, 1997, II 2000.
- Дуриданов (1976), Иван: **Езикът та Траките**, София, 1976.

Marcus A. GABINSCHI, Chişinău:
SAKTËSIMI RRETH FONDIT LEKSIKOR TË QUAJTUR
“RUMUNO-SHQIPTAR”

Abstrakt

Në këtë vështrim bëhen disa plotësime rreth një pale fjalësh të identifikuar ka shumë kohë si “rumuno-shqiptare”, një palë nga shumë të paktat që dëshmohen qysh në toponimet e Ilirishtes dhe të Dakishtes, d.m.th. shq. *mal* dhe rum. *mal*. Prejardhja e tyre e përbashkët nuk ngjall dyshime as nga ana fonetike, as nga ana kuptimore, sepse në përgjithësi kuptimet ‘mal’ dhe ‘breg, buzë’ janë mjaft të afërta. Në disa raste ato janë kuptime të fjalëve gjuhësh të ndryshme, por që e kanë të njëjtën prejardhje, si p.sh., gjerm. *Berg* dhe fjalë të gjuhëve të ndryshme sllave, siç është rusishtja *беpez*, etj. Khs. edhe shq. *breg* në kuptimin më të rrallë ‘kodër e vogël, kodrinë’.

Megjithatë, në diskutim mund të sillen fakte që e paraqesin bashkësinë kuptimore të të dy fjalëve çështje edhe më të madhe, pra edhe zhvillimin e tyre semantik edhe më të përbashkët sesa pranohet në përgjithësi.

Në pjesën e dytë të kumtesës bëhet fjalë për një palë leksikore që, me sa dimë, nuk ka figuruar akoma në krahasimet albano-rumune. Ky fakt është i kuptueshëm, sepse kemi të bëjmë me një fjalë ngushtësisht dialektore, që nuk e ka dëgjuar shumica dërmuese e folësve të rumanishtes. *a înzita* është një fjalë që i përket së folmes së fshatit Rozalua të Maramureshit e do të thotë “a nderma” dmth. “shtyj, nxis, zgjoj” etj. Diskutohen dhe fjalë të tjera.

Në këtë ndarje bëjmë vetëm disa plotësime rreth një pale fjalësh të identifikuar ka shumë kohë si “rumuno-shqiptare”, një palë nga shumë të paktat që dëshmohen qysh në toponimet e Ilirishtes dhe të Dakishtes, d.m.th. shq. *mal* dhe rum. *mal*. Prejardhja e tyre e përbashkët nuk ngjall dyshime as nga ana fonetike, as nga ana kuptimore, sepse në përgjithësi kuptimet ‘mal’ dhe ‘breg, buzë’ janë mjaft të afërta. Në disa raste ato janë kuptime të fjalëve gjuhësh të ndryshme, por që e kanë të njëjtën prejardhje, si p.sh., gjerm. *Berg* dhe fjalë të gjuhëve të ndryshme sllave, siç është rusishtja *беpez*, etj. Khs. edhe shq. *breg* në kuptimin më të rrallë ‘kodër e vogël, kodrinë’.

Megjithatë, mund të sjellim disa fakte që e paraqesin bashkësinë kuptimore të të dy fjalëve çështje edhe më të madhe, pra edhe zhvillimin e

tyre semantik edhe më të përbashkët sesa është në përgjithësi e pranuar.

Fjalorët e rumanishtes japin për fjalën mal pothuajse gjithmonë kuptimin “breg, bregdet, buzë”, ç’është e drejta, me disa përjashtime të rralla, duke i përmendur edhe kuptimet metaforike, siç është p.sh. fjalori i madh i gjuhës rumune, i cili e jep frazeologjizmin *un mal de om sau de femeie*, tekstualisht “një mal njeriu ose gruaje”; dmth. “një njeri (ose grua) shumë i madh (e madhe)”, si dhe *cît un mal* “sa një mal” (i madh),¹ metafora këto që nënkuptojnë si bazë atë kuptimin e *malit* që e ka në shqipen (khs. Maqedonisht *kapna od човек*, tekstualisht “shkëmb njeriu” me po atë kuptim.

Ne kemi dëgjuar në rumanishten e folur të Moldavisë (siç e kemi fiksuar në disa artikuj) shprehje si *curechiul să maluri* “lakra rri grumbuj grumbuj”, kuptim që e ka edhe ay në bazë zhvillimin semantik nga *mal* si “sasi e madhe (e diçkaje)”, zhvillim që del sporadikisht në ligjëratën e përditshme nëpër gjuhë të ndryshme. Shembuj të ngjashëm kishim cituar në artikuj edhe nga I. Creangă dhe nga folklori rumun.

Por në *mal*-in e rumanishtes kemi takuar edhe metaforën kohore që deri tani e kemi njohur vetëm në fjalën e afërt të shqipes: khs. *mal dite*. Kështu, nga përrallat popullore të përpunuara nga folkloristi i çmuar moldavian G. Botezatu njohim shprehjen (që ai e përdor disa herë) *maluri de vreme*, tekstualisht “Qysh atëherë kanë kaluar maluri de vreme”, dmth. “shumë vjet”.

Pra, shembuj të tillë dëshmojnë për një bashkësi kuptimore më të thellë midis rumanishtes *mal* dhe shqipes *mal*, sesa dukej deri tani, fakt që duhet paraqitur në krahasimet leksikore dhe frazeologjike shqiptaro-rumune, si dhe në fjalorët e tyre dygjuhësh.

II

Kësaj radhe bëhet fjalë për një palë leksikore që, me sa dimë, nuk ka figuruar akoma në krahasimet albano-rumune. Fakti është i kuptueshëm, sepse kemi të bëjmë me një fjalë ngushtësisht dialektore, që nuk e ka dëgjuar shumica dërmuese e folësve të rumanishtes. Është një fjalë që i përket së folmes së fshatit Rozalua të Maramureshit, ku do të thotë, sipas glosarit të librit “Antologie de lirică populară

¹ Sh. Dictionar explicativ al limbii române (DEX), București, 1975, f. 518.

românească (București, 1980, f. 598) “a îndemna” dmth. “shtyj, nxis, zgjoj” etj., siç është regjistruar në këto radhë thirrjeje ndaj një bime:

<i>Ce stai, bade, așa blîndut?</i>	Pse rri, mor djalë, kaq i trishtuar?
<i>Ori te-a-nzzitat oarecine</i>	Mos të ka shtyrë dikush
<i>Ca să nu grăiești cu mine.</i>	Që të mos flasësh me mua.
<i>De-te-au nzzitat fetele,</i>	Në qoftë se të kanë shtyrë vajzat,
<i>N-aibă noroc bretele.</i>	Mos paçin lumturi të gjorat,
<i>De cununa cea verzie</i>	Mos njofshin kurorën e gjelbër
<i>Și de sfânta cununie</i>	As kurorëzimin e shenjtë.
<i>De te-au-nzzitat feciorii</i>	Në qoftë se të kanë shtyrë djemtë
<i>N-aibă noroc săracii,</i>	Mos paçin lumturinë të mjerët,
<i>De struțul cel mohorît,</i>	Mos njofshin tufën me lule të kuqe,
<i>Și de stântul jurământ.</i>	As të shenjtin betim.

Atje, f. 205.

Siç shohim, fjala duke qenë ngushtësisht dialektore, ka shumë pak gjasë t'i përkasë atij fondi të vjetër tradicional “rumuno-shqiptar” që njihet tashmë qysh nga J. Thunmanni (1774), të përshkruar në hollësi nga shumë gjuhëtarë. Në këtë rast do të kemi një huazim më të vonë, të lënë nga ndonjë grup i vogël shqiptarësh të asimiluar në ambientin rumun. Disa prej fjalëve të tilla i ka sjellë G. Weigandi nga disa vende të Transilvanisë, p.sh. *dandar* “njeri i huaj” (< shq. dhëndër), *fară* (= shqip farë), *ghintură* (= shqip gjymtyrë), etj.² Edhe ne kemi sjellë ka pak kohë në disa artikuj dialektizma nga Republika e Moldavisë në lidhje të mundshme etimologjike me fjalë të ngjashme të mbarë shqipes: *barc* “gropë me ujë; vend i thellë në kënetë” etj. (khs. shqip *bark*, sidomos *barku i furrës*), *chimtuț* “njeri i paktë nga trupi” (khs. shqip *qimkë*), *tartabel*, po ajo (khs. shqipen *tartabiqe*), *țurane* “shkëmb i rrëpirët” (khs. shqip *curr*). Edhe këto fjalë duket të kenë mbetur nga “arnautët” e Moldavisë (si edhe të Rumanisë) së vjetër, që ishin mjaft të numërt këtu në kohët e feudalizmit si roje të princërve të çifligarëve, etj. Edhe tani llagapi *Arnăut(u)* është mjaft i përhapur në Moldavi, si edhe (në variante të ndryshme) në Rumani.

Struktura e foljes *a înzita* na sjell ndërmend fofflje të shumta rumune të formuara me rrethshesën (konfiksin) *a în... a* (si edhe *a în...*

² Sh. A. Rosetti, *Istoria limbii române*, II,⁴ București, 1964, f. 122.

i) nga emra, psh. *a încleșta* “kap me mashë” < *clește* “mashë”, *a închega* “mbledh, formoj” < *cheag* “droçkë”, *a îngropa* “varros” < *groapă* “varr” etj., po kështu nga mbiemra, numërorë, etj. Mirëpo, për *a înzita* nuk gjejmë në rumanishten një temë derivatore *-*zit-*, fakt ky që flet në të mirë të huazimit të një fjale të tërë me një temë të ngjashme me atë të fjalës *a înzita* vetë. Dhe këtu natyrisht na kujtohet fjala shqipe *nxit* (apo *nxit*) me kuptimin e saj mjaft të afërt me atë të rum. *a înzita*. Aspekti fonetik nuk paraqet as ai vështirësi; në shqipet çdo temë që fillon me *z-* duke marrë një *-n-* prapa bëhet me *nx-*, psh. *zë*>*nxë*, *i zi*>*nxij*, ndërsa në rumanishten ato tema dialektore që fillojnë me *dz-*, duke marrë një *-în* përpara, bëhen me *înz-*, psh. dial. *Dzî* “ditë” > *a înzili* “i ngjat jetën (dikujt)”, ose dial. *dzășe* “dhjetë” > *a înzeci* “dhjetëfishoj”. Kjo përputhje fonetike midis fjalëve *a înzita* dhe *nxit(oj)* është e qartë edhe pa argumentuar me variantet e vjetra dhe dialektore si *nzis*, *nzitem*, *nxitin*.³ Dhe si një paralele e tërë në rastin tonë mund ta sjellim çiftin, tashmë të identifikuar si të tillë, shq. *Vajtoj* – rum. *a vǎ(i)eta*.

Pra, fjalët *nxit(oj)* – *a înzita* (kjo e fundit me qarkullim të ngushtë në rumanishten) mund të paraqesin edhe një çift leksikor “rumuno-shqiptar”, edhe pse me rëndësi relativisht të vogël.

³ Shih S. Mann, *An historical Albanian-English Dictionary*, London-New York-Toronto, 1948, f. 329.

Shefki SEJDIU, Universiteti i Prishtinës:

GJURMË INTERFERIMESH EMËRTIMI HELEN(IK)O-GREKE,
ILIR(IK)O-ALBANE DHE ITAL(IK)O-ROMANE

Abstrakt

Nga tema bosht që është propozuar për këtë sesion shkencor ndërkademi, vërehen sugjerime për të trajtuar çështje që do t'i përkisnin edhe paleoballkanistikës. Sugjerimi ishte i drejtë kur dihet se Gadishulli, për shkak të pozitës gjeografike ka qenë udhë dhe urë kalimesh, lëvizjesh e qarkullimi popujsh, kulturash, civilizimesh, gjuhësh duke ndikuar në dhe mbi njëri tjetrin e duke krijuar (mbi)shtresim llojesh e natyrash të ndryshme gjatë mileniumeve.

Zhvillimi, sidomos, i shkencave konverguese siç janë historia, arkeologjia, etnologjia, antropologjia, etnosikologjia, linguistika, semantika, teoria e emërtimit si dhe paradigmatica si sistem dhe metodologji ka hapur rrugë për hulumtimin e shumë çështjeve komplekse siç janë interferencat dhe interferimet edhe në fushë të emërtimit.

Në këtë trajtesë, pra, vëmendja hetuese e hulumtuese është përqendruar tek motivimet, konceptualizimet dhe bazat emërtuese si dhe tek origjina e etnonimeve ilir, gegë, alban (arbën, arbër), grek dhe italik.

Zhvillimi, sidomos, i dijeve konverguese, siç janë historia, arkeologjia, etnologjia, etno-psikologjia (dhe mitologjia), linguistika, semantika, teoria e emërtimit dhe paradigmatica si sistem e metodologji, ka hapur rrugë të reja për hulumtimin e shumë çështjeve komplekse, siç janë *interferencat* dhe *interferimet* edhe në fushë të emërtimit, përkatësisht në fushë të etimologjisë. (Il. dhe Il; MILAJ; DHIMA; GIMPERA; KORKUTI; DUMEZIL; DEL; ÇABEJ; VINJA, etj.).

Në këtë trajtesë vëmendja hetuese e hulumtuese është përqendruar tek motivimet dhe motivet, konceptualizimet dhe konceptet, bazat dhe toposet emërtuese si dhe origjina e etnonimeve *helen, grek, ilir, gegë, alban, shqiptar dhe italik*.

Në këtë seri etnonimesh edhe *subjekte, edhe objekte emërtimi janë heleno-grekët, iliro-albanët dhe italo-romanët*. Në këta terma-kompozita vërehen gjurmë hapësire, kohe, por edhe gjurmë etnike, etno-kulturore, mitologjike, gjuhësore, etj.

Mesdheu në përgjithësi, e pjesa qendrore-veriore në veçanti, ka qenë *urë* dhe *udhë* kalimesh, lëvizjesh e qarkullimi popujsh, kulturash, besimesh, civilizimesh e gjuhësh, duke ndikuar *në* dhe *mbi* njëri-tjetrin a *mbi* njëra-tjetrën, duke formuar (mbi)shtresime llojesh e natyrash të ndryshme gjatë mileniumeve. (MARTINET; KORKUTI; PATSCH, etj.).

Të dhënat që sjellin arkeologjia, antropologjia, semantika, listoria, gjuhësia dhe shkencat tjera diakronike, tregojnë se kjo pjesë e Mesdheut ka qenë lashtësisht e banuar, por edhe e hulumtuar shumanshëm. (ATROP-SHQ, 24; CEKA, 215; HAMMOND, 124, etj.).

Në këtë kuadër kanë qenë të përfshira hapësira e Pellgut të Egjeut, ajo e Ilirikut dhe e Apenineve, të cilat, që nga parahistoria kanë qenë të banuara prej mediteranësh paraindoeuropeanë, pastaj edhe nga indoevropianët që kishin depërtuar që nga mileniumi i dytë para epokës së re. Edhe pse paraindoeuropeanët e kësaj hapësire u asimiluan nga të ardhurit indoevropianë, megjithatë, mbetën gjurmë të tyre gjuhësore, ritesh e mitesh, gojëdhënash e legjendash, por edhe gjurmë natyre materiale, mendore e morale.

Duhet shënuar me këtë rast se rëndësi të veçantë ka *koha* dhe *rrugët*, kur fiset indoevropiane filluan të lëviznin nga trualli (i supozuar indoevropian (Kaspiku lindor, Kaukazi verior, Pontusi dhe Karpatet lindore). Ka rëndësi të dihen edhe drejtimet që këto fise morën me rastin e dyndjeve të tyre. Prehelenët, me gjasë, të ambientuar me detin (Pontus), u përqendruan rreth Pellgut të Egjeut. Fiset preilire (sipas CEKA, 24) preitalike dhe prekelte, siç na informojnë antropologët, u shpërngulën ndër të parët nga atdheu i hershëm indoevropian për t'u vendosur për shumë shekuj në hapësirën ndërmjet Karpateve perëndimore dhe Alpeve lindore (PITTARD, 32; PATSCH, 5; GIMPERA, F. 47; KORKUTI, 24 v).

Fiset e periudhës kohore 6000-2600 Ceka i quan *preilire* (CEKA 29). Këto fise (preilire, preitalike, prekelte) aty kishin jetuar në fqinjësi një kohë të gjatë dhe në bazë të të dhënave kronologjike ata kishin qenë dolikocefalë (PITTARD, 32; MILAJ, 74 vv). Këto fise edhe nga ajo hapësirë kishin lëvizur: *prekeltët* drejt perëndimit, *preitalikët* drejt Apenineve e *preilirët* drejt Dravës, Savës, Danubit, Adriatikut e përgjatë gadishullit, që më vonë do të quhej nga romakët *Paeninsula illyrica* apo *Illyricum*. Këtë emër do ta mbajë gadishulli deri në fillim të

shekullit XIX, kur zëvendësohet nga emri *Ballkan* me origjinë turko-orientale. Emrin Ballkan për herë të parë e ka përdorur gjeografi gjerman A. Zeune në vitin 1909 (LJLZ, 76v).

Protoilirët (ilirët e periudhës 2600-1200, Ceka do t'i quajë *protoilirë*), sipas N. Cekës, në Gadishull arritën ndër të parët (CEKA, 33) ku i nënshtruan e i asimiluan autoktonët paraindoeuropeanë. Në këto hapësira ilirët edhe tipologjikisht kishin filluar të evoluojnë. Procesi i dedolikocefalizimit, që kishte filluar edhe më përpara tek ilirët edhe në gadishull vazhdon për të kaluar në brakicefali në masë të madhe, ku edhe u krijua tipi antroposomatik që antropologët do ta quajnë *ilirid* apo *dinarid* (MILAJ, 49; GIMPERA, 37; KORKUTI, 15). Këto i theksuam se brakicefalia predominon në hapësirat iliro-albane e edhe në ato pjesë perëndimore të vargmaleve të Pindit, ku kishin qëndruar edhe *dorët* të përzierë me fiset epirotike *kaonët*, *molosët* dhe *thesprotët* (MILAJ, 128; PITTARD, 32). Këto afri dhe të tjerat që u përmendën më sipër, janë dëshmi e kontakteve dhe interferimeve kulturore dhe gjuhësore e që kanë shërbyer edhe si baza motivuese e emërtuese etnonimike.

U tha se *protohelenët* u përqendruan në Pellgun e Egjeut dhe aty morën shumëçka nga ambienti, nga kulturat dhe civilizimet e Mesdheut Verilindor të popujve indoevropianë, siç ishin hititët, por morën edhe nga joindoevropianët fenikas e të tjerë, andaj tek protohelenët krijohet një shpirt që edhe sot e quajnë *heleno-* apo *greko-levantin* që i karakterizon imagjinata e zhvilluar, të menduarit mitologjik, shkaktësia, cinizmi, mefiansa, por edhe afiniteti për të krijuar rrëfime e histori, mite e legjenda, vepra arti e letrash, si edhe prirja për t'u vënë të tjerëve attribute pejorative (JACQUES, 154).

(Proto)ilirët dhe *italikët* nuk ishin aq imagjativë dhe spekulativë si *helenët* dhe nuk mbështeteshin aq as në mite, mitologji hyjnore e diellore. *Ilirët* dhe *italo-romanët* ishin më “tokësorë” andaj edhe karakteret etnike të tyre, për aq sa shtriheshin drejt perëndimit dallonin nga imagjativët heleno-grekë lindorë. Autorë të ndryshëm kishin vërejtur tek ilirët dinamikë lëvizjesh, guxim, agresivitet, violencë, krekosje, krenari, por edhe spontanitet, inkonsistencë, mosorganizim (THALOCZY, 52; WILLKES, 213, 231; PATSCH, 38; CEKA, 131). Për *italo-romanët* studiuesi i njohur Georges Dumézil thot se ata mendonin “historiquement, nationalement, pratiquement, empiriquement, politi-

quement, relativement”, cilësi që më pak i karakterizonin *ilirët* dhe *heleno-grekët* (DUMÉZIL, 38V; JACQUES, 157).

T’i kthehemi prap temës së trajtesës që përmban shenja formale dhe semantike ku figuron viza ndarëse a bashkuese, kllapa, presja e pika dhe, krejt në ballë të saj qëndron fjala *gjurmë*; e, të gjitha këto shprehin kompleksitet(in) që haset në fushë të hulumtimit dhe sqarimit të motiveve, motivimeve dhe konceptualizimeve emërtuese. Aty është termi intencional *interferim*, që në raport me fjalën *gjurmë* na dukej më adekuat se sa termi *interferencë* që, sipas rasteve, paraqitet gjatë analizave; termi *interferim* mbartë edhe tiparë semikë virtual, metonimikë dhe ironizues.

Andaj, siç dihet, që nga Platoni (dhe Kratili i tij), Varroni, skolastikët dhe Ménage-i e Turgot-i deri te gramatikanët e rinj dhe fjalësendistët e modernët e Shkollës së W.V.Wartburg – ut, çështjet e etimologjisë dalin shumë komplekse. Më në fund, me paraqitjen e semantikës dhe kognitivistikës, në qendër të vëmendjes vëhet *referenti*, pra *objekti* pa njohjen e të cilit nuk mund të bëhen analiza valide të natyrës onomasiologjike, as semamasiologjike që do të mundësonin njohjen e etimonit primar (VINJA, 32vv).


Mirëpo *objekti* dhe njohja e tij paraqet shpeshherë vështirësi të pazgjidhshme, sidomos nëse ai (*objekt*) është ndërtuar në rrethana jo lehtësisht të përceptueshme, andaj çdo hulumtuesi do t’i imponoheshin një sërë pyetjesh që tingëllojnë tepër retorike, por ato janë edhe epistemologjike e udhërrëfyese kur synohet të hetohen struktura natyrash e nivelesh të ndryshme të sheshuara apo të fshehura a të mbetura si *gjurmë*, origjina dhe kuptimi (etimoni) i të cilave do të duhej eksploruar. Për temën që po e trajtojmë imponohen pyetje si:

Kush? Cili? Çka? Kë? Cilin? Ku? Kur? Përse? Si? Në ç`mënyrë? Sipas çkafit? Sipas cilit model? Sipas cilit impuls emërtues? Mbi çfarë baze motivuese? Në çfarë rrethanash socio-kulturore e historike është përceptuar dhe konceptualizuar *objekti*? Sipas cilit kodit gjuhësor është formësuar dhe shenjuar *koncepti*? Cili është objekti që pëceptohet? Kush është ai që pëcepton, konceptualizon dhe kodimikon? Kush është pra *onomaturgu*? A ka *kompatibilitet* midis formës dhe përmbajtjes së shenjës gjuhësore? Mbi çfarë referencash mbështetet hulumtuesi? A ka paragjykime *onomaturgu*? Etj.

Përgjigja arsyetuese *sepse* do të pritej të kishte probabilitet të lartë vërtetësie, andaj gjurmuesit etimologë do të duhej t`u shmangeshin zgjidhjeve, respektivisht konkludimeve simpliste e gratuite.

Konformë këtyre që u thanë, ndërtuam një KORPUS – SKEMË me rrafshë, baza emërtimi dhe forma etnonimike sipas një kriteri toposesh hierarkike ku paraqiten edhe relatorë shkalle hiponimie dhe kohiponimie të përfshirë hiperonimisht nga etnonimet.

HELEN(Ë) - ILIR(Ë) - ITALIK(Ë) SKEMA



Megjithatë, duhet thënë diçka edhe për origjinën e disa formave që i konsiderojmë me interes për të kuptuar më mirë relevanten e

këtyre toposeve etnonimike e bivalente popujsh e hapësirash që shtrihen në kohë deri në parahistori e që *grosso modo* prekin tri periudha kohore, që arkeologu N. Ceka do t'i quante *preilire*, *prehelene*, *pritalike* (6000 – 2600 para epokës së re), përkatësisht *protoilire*, *protohelene*, *protoitalike* (edhe pse këto dy terma për helenët dhe italikët nuk i përdorë). Periudha që Ceka e shënon me *proto-*, sipas tij përfshin 2600 – 1200 vjet para epokës së re (Shih CEKA, 29v, 31v). Mendojmë, pra, që etnonimi ilir duhet t'i kishte takuar mileniumit të parë para epokës së re, por shumë kohë përpara se të jenë përmendur nga Herodoti, (andaj) edhe fiset që nga Histria deri në Kaoni janë fise *ilire* e jo *protoilire* dhe emërtimet e tyre, me gjasë janë formësuar në hapësirat e gadishullit që më pastaj, do të quhet *Ilirik*.

1. HELLEN – HELLAS (GRAECUS – GRAECIA)

Që të tria toposet bivalente (popull-vend): Hellen–Hellas, Ilir–Iliri, Italik–Itali kanë bazë emërtuese mitologjike, por helenët emërtuan popullin dhe vendin e tyre me rrugë dhe mjete gjuhësore të veta, diçka që nuk kishte ndodhur tek ilirët.

Protohelenët edhe pse, siç mendohet, janë shpërngulur herët nga trualli indoevropian, ata si duket edhe atje kishin ndërtuar një afinitet për detin dhe bregdetin, andaj (edhe) nuk u larguan shumë nga Pontusi (RENFREW, 76). Këta ranë në kontakt edhe me fiset indoevropiane, sidomos me hititë që kishin krijuar madje edhe perandori. Protohelenët aty i mësuan shumë gjëra dhe iu përshtatën edhe rrethanave gjeo-klimatike dhe socio-kulturore, sidomos, kur ranë në kontakt edhe me jo-indoevropianët fenikas, asirë, egjiptianë, etj.. Në atë hapësirë mediterane u njohën edhe me kulturat, besimet dhe mitologjitë e tyre (MIREHE, 110v, 195, 279). Ata aty krijuan një shpirt kurreshtar, inventiv, kreativ, por edhe mefiant, cinik e egocentrik (cf. supra); vetveten e emërtuan mbi bazë të besimit se rrjedhin nga Helleni, i biri i *Deukalionit*, sipas tyre, themelues i njerëzimit. Pra, helenët, emrin e tyre e kishin motivuar, besuar dhe bazuar tek drita e Dielli – perëndi (MIREHE, 195, 279).

Heleno-grekët me imagjinatën e tyre, shpeshherë, të motivuar intencionalisht, emërtojnë fiset dhe popujt fqinjë me emra fyes, duke i quajtur barbarë, të egër, bisha, gjarpërinj, njala, kërmij, rrëqebuj, etj.

Kështu mbi format e përmbajtjes kanë ndërtuar etnoparadigma mbi baza zoonimike me hiperonimin **Illyrioi**:

Illyrioi – “gjarpinj”
 Enheleis – “njala”
 Helidones – “kërmij”
 Lynkestes – “rrëqebuj”

1.1. GRAECUS – GRAECIA. Edhe këta emra, si duket, kanë bazë indoevropiane, por të conceptualizuarë dhe të emërtuarë nga të tjerët, jo nga grekët.. Me të arrirë në Epir, romakët, kishin dëgjuar nga epirotët fjalë, për ta të pakuptueshme, e që u referoheshin fqinjëve helenë. Fjala *graec(us)* romakëve u tingëllonte si formë onomatopeike pa e ditur se ishte e motivuar mbi bazë antipatie. Kjo formë që përmban tinguj ekspresivë konsonantikë në grup si *gr* – përcjellë nga *aec* ua tërheqë vëmendjen etimologëve dhe autorëve të njohur të *Fjalorit etimologjik të gjuhës latine* A. Ernout dhe A. Meillet, të cilët, duke u përqendruar tek zëri *Graecus* vërejnë se forma *grāi* i përkiste gjuhës epike dhe poetike, andaj edhe konkludojnë: “Il s’agit sans doutë d’une forme populaire empruntée par la voie orale et qui peut-être ne provient pas de Grèce, mais d’Illyrie”. (DEL, 280).. Format, pra, *Grāi*, *Graecus* mund të afrohen me fjalën *grācula* “zë, krrokatje: Ky afrim *graecus* dhe *Grāi* me *gracula* shton gjasat se helenët janë quajtur *graek* që metonimikisht i kanë perceptuar si “breshkarë”.

Në shumë gjuhë kjo formë etnonimike (e supozuar me origjinë ilire) shërben për të shënjuar etnosin grek dhe vendin e tyre Greqinë; nga vetë grekët kjo trajtë nuk përdoret. Etnonimi *helen* dhe toponimi *Hellas* vazhdojnë të jenë emra nacionalë dhe shteti grek.

2. ILIRO - ALBANO - SHQIPTARËT

2.1. ILIRËT

Nga mileniumi i gjashtë para epokës së re kishin filluar lëvizjet e fiseve *preilire*, *preitalike*, *prekelte* në drejtim të perëndimit dhe shumë shekuj kishin qëndruar në hapësirën *Karpate lindore – Panoni - Alpe lindore* (PATSCHE, 5; GIMPERA, 47; CEKA, 23). Nga ajo kohë dhe hapësirë rrjedhin disa cilësi të përbashkëta që edhe në kohërat e më-

vonshme janë vërejtur tek *ilirët*, *italikët* dhe *keltët*. Te këto fise, sipas hulumtimeve të antropologëve, kishte filluar një transformim fizik – cefalik, sidomos ai i dedolikocefalizimit (MILAJ, 98; RENFEREW, 76). Në depërtimet e tyre protoilirët arrijnë deri në jugun e Gadishullit; emri *Ballkan* që tani mban gadishulli ynë është i vonë. Ky emër origjine turko-orientale për herë të parë del tek gjeografi gjerman A. Zeune në vitin 1909 (Ijlz, 76; cf. edhe supra).

Etnonimi ilir përmendet tek autorët antikë që nga Herodoti, Tukididi deri te Apiani e Herodiani kurse disa fise ilire përmenden edhe në Iliadën e Homerit, por edhe te Hesiodi (Il. dhe Il, passim). Emri ilir është formësim helen i ndërtuar mbi rrënjën *illy* – që haset edhe te emri hitit *Illyjunksash*, emër i një gjarpri shumë të rrezikshëm mitik (MiReHe, 9v; STIPÇEVIQ, 326).

Helenët përdornin forma fyese për të emërtuar edhe të tjera fise të fqinjëve ilirë si tek emrat *enkelej* “njala”, lloj gjarpërinjsh uji e bërrakash, por motive të ngjashme vërehen edhe tek emri i fisit tjetër ilir helidonët “kërmill”, për helenët elidonët përceptohen dhe quhen *kërmij* (WILLKES, 257v).

Edhe miti mbi *Kadmin* dhe *Harmoninë*, të larguar dhunshëm nga Orienti, mitologjia greke i vendos në Epirin ilirik, dhe në afërsi të enkelejve, ku jetojnë në formë gjarpërinjsh dhe e lindin djalin *Ilirin* në formë gjarpri (DURANTE, 403; STIPÇEVIQ, 349v). Në këtë mënyrë paraqiten dy baza mitologjike me emrin *Ilir*: *Iliri Dardan*, themelues i Ilionit, Trojës së famshme të Homerit dhe *Iliri i Epirit* Ilirik (DURANTE, 399; DHAMA, 121).

Si arsyetim etnonimet *ilir* dhe *enkelej* janë produkt i motivimit, konceptualizimit dhe emërtimit të fqinjëve helenë me formën e përmbajtjes “gjarpër” që paradigmatisht mund të vërtetohet me të dhënat që dalin nga shënimet që sjellin autorët antikë se ilirët perceptoheshin nga helenët si njerëz fizikisht të fuqishëm, të ashpër, të rrezikshëm sa që vetë helenët me shumë kujdes dhe frikë i qaseshin Adriatikut (WILLKES, 238). Ndoshta edhe emrat *gegë* dhe *Gegëri*, për shkak të formës dhe substancës së përmbajtjes së shenjës (gjuhësore) *gigas*, në kuptimin “i madh, i fuqishëm, i rrezikshëm”, mund të kenë qenë emërtime grekësh. Andaj kjo *gigas* si dhe emri i fisit epirot *kaon(es)* “zjarrvënës” e ndoshta edhe etnonimi *pirust* “i zjarrtë, i vetëtimshëm; i vrullshëm”, emër gjithashtu i një fisi të guximshëm ilir, do

të mund të integroheshin në paradigmen intencionale e interferuese etnonimike me autorësi heleno-greke (WILLKES, 156v; DHAMA 100).

2. 2. ILIRO - ALBANËT

Kjo periudhë historiko-shoqërore e kombëtare i përket kohës kur fiset ilire si organizime shoqërore nuk funksionojnë si në kohën kur ato ishin *fise – mbretëri*. Në antikitetin e vonë dhe në mesjetën e hershme këto si organizime degradojnë deri në shkallë të *familjeve e dyerve* të “mëdha”, për t’u ngritur vetëm deri në shkallë *dinastësh e dinastishë* e, më vonë, në *principata*. (Shih. SHUFFLAY, 29). Edhe emrat gjithëpërfshirës *Ilir* dhe *Iliri* “zbehen” për të mos u përdorur si të tillë që nga fillimi i shekullit VII. Në këtë periudhë kalimtare nga emrat e organizimit fisnor ilir mbetën vetëm ata të *albanëve* dhe të *dardanëve*, sidomos emri i *albanëve*, mbahet dhe shtrihet (mbi bazë të *albanoi-ve* e të *Albanon-it* të Ptolemeut, përmes latino-romanëve që del në vitin 1188 te vepra Florimont i Aimon de Varennes në trajtën *Albanie*, emër për hapësirën e *albanoive*. Kjo *Albanie* si formë dhe përmbajtje duhet të ketë qenë e bazuar në ndonjë evidencë latine që do të çonte te trajta latine *Albania*, andaj në krye të paradigmes të periudhës së dytë këtë emër vendi e kemi shënuar me asterisk - *Albania.

Pra, fazës së dytë të etnonimeve të hapësirës *iliro–albane* do t’i takonin ndërtimet etnonimike që mbështeten mbi bazën *alb-* zgjeruar nga format afiksale latino – romane *-anos, -anoi, anon*. Nga baza formale *alb-*, më vonë, me alternim paradigmatic të likuideve *l>r*, ku edhe mund të ketë pasur ndikim greko-bizantinishtja, krijohet një formë më dinamike *arb-*, nga e cila dalin format etnonimike gjithëpërfshirëse *Arben, Arbër* për të gjithë arbërisht apo arbënisht folësit dhe për atdheun e tyre *Arbëni, Arbëri*. Turqit, mbi format e greqizuara *arvanitas* e prodhojnë edhe një formë *arna(v)ut*, për shqiptarin dhe *Arnautlluk* për atdheun e tij Arbëninë a Arbërinë, përkatësisht Shqip(ë)ninë a Shqipërinë. (ÇABEJ, 85 vv DEMIRI, 53; LUKA, 104vv; DUCELLIER, 235; SHUFFLAY, 109; SHKURTAJ, 103v).

Vlen të theksohet se kjo bazë *alb-*, nuk përmban elemente semike as mitologjike, as legjendare, por është e mbështetur në faktorë gjeofizikë, në shkëmbinjtë, lartësinë, borën e bardhësinë e Alpeve Albane.

2.3. ALBANO - SHQIPTARËT

Edhe kjo periudhë etnohistorike e etnosit *iliro-albano-shqiptar*, kohësisht nuk është e përcaktuar. Ka shumë gjasa të kenë filluar me paraqitjen e fiseve terciare siç i quan Shufflay (SHUFFLAY, 60), kur bëhej një përpjekje e *tretë* për rikonsolidimin etnik në kulmin e sundimit otoman. Sidomos pas luftërave të Gjergj Kastriotit – Skënderbeut dhe disa rrethanave që krijohen në Europë (ri)ngjallet ndjenja që në tërë hapësirën arbërore ku jetonin njerëz të një gjaku e gjuhe të defino-heshin gjuhësisht, territorialisht dhe etnikisht. Në *Kuvendin e Arbërit* (1703) doli një formë e re adverbiale *me folë shqip* në vend të asaj që do të ishte më e pritshme me *folë arbërisht* (Shih ISMAJLI, 224v). Për përdorimin e kësaj forme të re janë ende të paqarta impulset e (ri)motivimit për ta krijuar këtë formë të re. Por, meqë del nga një tubim aq me rëndësi, siç ishte ai i *Kuvendit të Arbërit*, rrënjët do të duhej kërkuar te një fazë dhe bazë më e hershme, siç do të ishin paraqitja dhe shtrirja e ideve reformatore si dhe nevoja që predikimet (fetare) të bëhen në gjuhën që e kupton populli dhe, ndoshta, edhe verbi *excipio*, *excipëre* “kuptoj, me kuptue” nga rrodhi edhe fjala shqip “kuptua-shëm”, siç e kishte interpretuar edhe Gustav Meyeri (MEYER, 480).

Kjo formë ndajfoljore *shqip* (< lat. excipio “kuptoj”) mund të ketë shërbyer si *nukleus* për krijimin e paradigmes *shqip* (flas) – (gjuhë) *shqipe* – (popull)-*shqiptar* – (vendi) *Shqip(ë)ni*, *Shqipëri*. Mirëpo, ky interpretim nuk duhet marrë aq thjeshtë. Për t’u ndërtuar një paradigmë aq e bukur, aq ekspresive, e qartë, e pranueshme dhe gjithëpërfshirëse, rrënjët duhet kërkuar më thellë: në traditë e histori, në rrethana që sillnin epoka reformatore dhe e Renesansës që kishin filluar në Itali me Danten, me idetë kalviniste në Zvicër dhe ato luteriane në Gjermani e më gjerë, me ato paskaliane e më vonë edhe iluministe në Francë.

Në traditën gojore shqiptare përcilleshin, mbahe(shi)n mend e (ri)kujtohe(shi)n figurat e njohura të periudhave të ndryshme të historisë *iliro-albano-shqiptare*. Kujtesë e bukur e motivuese ishte për arbërorët thënia se Pirroja për ushtarët e vet ishte *shqiponjë*, kurse për Pirron ushtarët ishin *krihët* e saj. Këto dalin si reminishenca edhe tek Skënderbeu kur vëren entuziazmin dhe gëzimin e popullit për lirinë që po ua sillte. *Ai* u përgjigjet se lirinë nuk ua kishte sjellë, po e kishte gjetur midis tyre. (FRANKE, 332).

Të tilla (ri)kujtime, ndoshta, e (ri)sjellin *shkabën, shqiponjën* në sistem të kujtesës së popullit se *shqiponja* si koncept dhe totem me shekuj kishite qëndruar në vertikalen *gjarpër – shqipe (shqiponjë) – diell (qiell)* paradigmë mitike e përbashkët për shumë popuj të Mesdheut e më gjerë. Në këtë sistem të menduari, *shqiponja* funksionallizohet edhe si stimulues, edhe si motiv(im), edhe si bazë konceptualizimi e kodifikimi për të marrë pjesë në krijimin përmes kryqëzimeve asociative, të një ekuacioni: *excipio + shqip(e) + shkabë (+shqiponjë)* për të arritur deri te paradigma (që u përmend edhe më sipër) me pak ndryshime: *shqip(e)-shqip(e)tar-Shqip(e)ni-Shqipëri* apo edhe më qartë: (flas) *shqip*-(gjuhë) *shqipe* – (popull) *shqiptar* – (vendi) *Shqipëri*.

Sado që këto afrime duken të justifikueshme, mbetet t'i konsiderojmë vetëm një sprovë rreth një çështjeje gjuhësore që do hulumtime të mëtejme për zgjidhje të arsyeshme etimologjike.

3. ITALO - ROMANËT

Edhe në krye të SKEMËS vërehet se preitalikët indoevropianë kishin lëvizur nga trualli i hershëm indoevropian dhe kishin qëndruar shumë shekuj në afërsi me *preilirët* dhe *prekeltët*. Këta *preitalikë* kishin kërkuar dhe zënë hapësira të reja (që e pranojnë edhe historia, antropologjia dhe gjuhësia) dhe zbresin në Gadishullin e Apenineve, ku i gjejnë *ligurët* dhe *etruskët* joindoevropianë. Por, në atë gadishull,

përveç autoktonëve paraindoevropianë *protoitalikët*, atje gjetën edhe fise ilire që kishin kaluar Adriatikun, siç ishin *mesapët, japiçët, kalabrët*, etj. Fiset italice, *oskët, umbrët* dhe *latinët*, që ishin përqendruar rreth brigjeve të lumit Tiber në Apeninet qendrore, u shkrinë mes veti. Aty, në shekullin VIII para epokës së re, sipas legjendës, pasardhësit e Eneut trojan, të bijtë e perëndisë *Mars* dhe të *Rhea Silvia-s, Romuli* e *Remi*, themeluan Romën mitike që më vonë u bë *Roma Aeterna* dhe për shumë shekuj kryeqendër e Perandorisë Romake.

Edhe para themelimit të Romës në gadishulli rreth shekullit X para epokës së re kishin depërtuar fise ilire si nga bregdeti Liburn ashtu edhe nga ai jugor i Adriatikut, fise këto që njiheshin për mobilitetin dhe shkathtësinë e tyre që ndikuan edhe në jetën e vendorëve *italikë*. Edhe vetë emri *Itali* lidhet me prezencën e këtyre fiseve ilire në gadishullin e Apeni-

neve. Supozohet që edhe etniku *ital*(ik), pastaj edhe emrat *Itali* dhe *italian*, janë të ndërtuar mbi bazë të *Italos-it* që mitikisht lidhen me *Italos-in mëzat* (*viç*) i perëndisë *Mars*. Etimologjinë e fjalës *Itali* studiuesit e njohur fren-gë A. Ernout dhe A. Meillet në *Dictionnaire étymologique de la langue latine, tek zëri Italus dhe Italia shënojnë*: “... *Italien, Italie. Osq. Viteliu, Vitelliu “Italia”; et Vitulāria uia. Sans étimologie. Le rapprochement de vitulus qui fait d’ Italia “la terre des veaux”... n’est qu’un calembourg. Sans doute mot indigène (illyrien?)*. (DEL, 323).

Si mund të vërehet gjatë trajtimit të këtyre çështjeve aq komplekse etno-onomasiologjike, ka dominuar paradigma si qasje dhe formë sqarimi e argumentimi, si në planin motivues, konceptual e referencial dhe formal, sidomos tek klasa Iliro-Albano-Shqiptar, e cila, për shumë arsye historike-shoqërore (jo edhe aq të sqaruara si dhe sa duhet) është “shkëputur” në tri etnofaza:

- I. ILIRE – shek. VI para erës së re – shek. VII mbas erës së re
- II. ALBANO-ARBËROREE – shek. VII-XVII
- III. ALBANO-SHQIPTARE – shek. XVII-XXI

Dhe, për të përfunduar, vlen të thuhet se këta tre popuj, ndonëse jetuan me mijëra vite në fqinjësi dhe janë me origjinë indoevropiane, janë dalluar (dhe dallohen) në të menduar dhe vepruar:

tek *heleno-grekët* ka mbisunduar mitologjia dhe egocentrizmi,
 tek *iliro-albano-shqiptarët* spontaniteti dhe individualizmi,
 tek *italo-romanët* racionalja, institucionalja dhe rendi.

Bibliografia me referenca dhe shkurtesa

- ANTR-SHQ Antropologjia e Shqiptarëve , Konferenca e Parë, Tiranë, 24-26 tetor 1997
- BENAC A. Benac” Mbi proceset etimologjike dhe përcaktimin e kufijve tokësore të fiseve ilire. Studime ilire I, Rilindja, Prishtinë, 1978.
- BORGEAU W. Borgeau, Les Illyriens en Grèce et en Italie. Genève, 1943.
- CEKA N. Ceka, Ilirët, Tiranë, 2001
- ÇABEJ E. Çabej, Studime gjuhësore III. Rilindja, Prishtinë, 1976.
- DEL A. Ernout-A. Meillet, Dictionnaire étymologique de la langue latine.. Histoire des mot. IV ed, Paris, 1967
- DEMIRAJ Sh. Demiraj, Epiri, pellazgët dhe shqiptarët. Tiranë, 2008.
- DEWVOTO G. Devoto, Il linguaggio d’ Italia. Milano, 1974.
- DUCELLIER A. Ducellier, Përpyjekje e re rreth shfaqjes së popullit shqiptar në burimet historike bizantine. Studime ilire II. Rilindja, Prishtinë, 1978.
- DUMÉZIL G. Dumézil, Mythes et dieux des indoeuropéens. Flammarion, Paris 1992.
- DURANTE M. Durante, *Ylles, Encheleis, Yllyrioi* Antiquitates Indogermanicae, studien zur Indogermanischen Altumdiskunde und kur Sprachung kultur geschichte. Innsbruck, 1974.
- DHAMA T. Dhama, fjalor i Mitologjisë. Rilindja, Prishtinë, 1988.
- DHIMA A. Dhima, Gjurmime antropologjike për shqiptarët. Tiranë, 1985
- FRANKE P. R. Franke, Disa probleme dhe detyra të numizmatikës ilire. Studime ilire I. Rilindja, Prishtinë, 1978.
- GATTI E. Gatti, Ilirët. Tiranë, 2005.
- GIMPERA B. P. Gimpera, Çfarë thotë arkeologjia për popujt indoevropianë. Tiranë, 1985
- HAMMOND N. G. L. Hammond, varrime me tuma në Shqipëri dhe problemet e etnogjenezës. Studime ilire I. Rilindja, Prishtinë, 1978
- IL. DHE IL. Ilirët dhe Iliria te autorët antikë. Tiranë, 1965.
- ISMAJLI R. Ismajli, Gjuha e Kuvendit të Arbërit (1706). Rilindja, Prishtinë, 1985.
- JACQUES E. Jacques, Shqiptarët. Historia e popullit shqiptar nga lashtësia deri në ditët e sotme. Tiranë, 1995.
- KONDA S. Konda, Shqiptarët dhe problemi pellazgjik. Tiranë, 1966.
- KORKUTI M. Korkuti “Mbi fillimet e shoqërisë njerëzore në territorin e Shqipërisë”. Antropologjia shqiptare. Konferenca I, 24 – 26 tetor 1997. Tiranë,
- LJLZ Leksikon Jugoslavenskog Leksikografskog Zavoda. Zagreb, 1974.
- LUKA D. Luka, Studime gjuhësore I. Shkodër, 1999
- MARTINET A. Martinet, Lingvističke srodnosti u Sredozemlju. Suvremena lingvistika 4. Zagreb, 1967
- MEYER G. Meyer, Fjalor etimologjik i gjuhës shqipe. Tiranë, 2007.
- MILAJ J. Milaj, Raca shqiptare. Studim antropologjik dhe historik. Tiranë, 1944.
- MIREHE Mitologjia i religjia hetita. Beograd, 1989.
- NA-JUL N. Julien, Le dictionnaire des mythes. Mirabout, Belgique, 1992.
- OREL V. Orel, Albanian Etymological Dictionary. London-Boston-Köln, 1998.
- PATSCH K. Patsch, Ilirët. Eugen. Tiranë, 2004.
- PITTARD E. Pittard, L’indice céphalique chez les Albanais. Revue anthropologique. Paris, 1920.
- RENFREW C. Renfrew, L’Origine indoeuropéenne. Archéologie et langage. Paris, 1990.

- SEJDIU Sh. Sejdiu, Gjurmë lashtësie antropologjike dhe gjuhësore të shqiptarët. Vjetari XXXV-XXXVI. Arkivi i Kosovës, Prishtinë, 2006.
- SEJDIU Sh. Sejdiu, Paradigma, formë sistimore (argumentimi apo edhe përgënjeshtrimi) në trajtime shkencore. Instituti Alb-shkenca, Prishtinë-Shkup, 2010.
- STIPÇEVIQ A. Stipçeviq, Ilirët, Rilindja, Prishtinë, 1967.
- SHKURTAJ Gj. Shkurtaj, Onomastikë dhe etnolinguistikë. SHBLU, Tiranë, 2001
- SHUFFLAY M. Shufflay, Serbët dhe shqiptarët. Rilindja, Prishtinë, 1968.
- THALOCZY L. V. Thaloczy, Vëzhgime iliro-shqiptare. Shkodër, 2004.
- TIMOFJEVA N. K. Timofjeva, Mitologjia i religjia Etruraca. Beograd, 1989
- VINJA V. Vinja, Jadranska fauna. Etimologjia i struktura naziva. Logos, Split, 1986.
- WALBANK W. Walbank, Ilirët e jugut në shek. III-II. Studime ilire I. Rilindja, Prishtinë, 1978.
- WILEKS J. Wilkes, Ilirët. Bachus, Tiranë, 2005.
- WINDEKENS A. J. V. Windekens, Etudes pélasgiques. Louvain, 1960
- ZAMAROVSKY V. Zamarovski, heronjtë e miteve antike. Rilindja, Prishtinë, 1985.

Teuta ABRASHI, Universiteti i Prishtinës
NYJA E PRAPAVENDOSUR NË GJUHËT BALLKANIKE-
NGJASHMËRITË DHE DALLIMET MORFO-SINTAKSORE

Abstrakt

Një ndër veçoritë e përbashkëta të ashtuquajturave gjuhëve të Balkan-sprachbund (shqipja, rumanishtja, bullgarishtja dhe maqedonishtja) është edhe nyja definite. Janë dy arsye që e karakterizojnë këtë veçori: (i) pozicioni dhe (ii) prania e saj te gjuhët sllave (maqedonishtja dhe bullgarishtja). Ndonëse e hasim në shumë studime si sinkronike ashtu edhe diakronike, jo rrallë vetitë morfo-sintaksore dhe shkalla e gramatikalizimit të saj te këto gjuhë “përshtaten” për të vërtetuar ndonjë hipotezë, teori apo model gramatikor. Kështu, ato herë dalin afiks e herë klitik, kurse shkalla e gramatikalizimit herë rezulton si e avancuar e herë e stagnuar. Në këtë punim duke u bazuar në kriteret e Zwicky-Pullum nga njëra anë dhe Himmelmann nga ana tjetër do të provohet të përcaktohet statusi i tyre morfo-sintaksor: klitik apo afiks gjegjësisht statusi kategorial: nyjë apo formant –tregues i tipareve morfo-sintaksore. Kurse, për të përcaktuar shkallën e gramatikalizimit për bazë do të merren statet gramatikalizuese të dala nga analiza tipologjike e Greenberg-ut. Analiza do të tregojë se nyja e shqipes dhe rumanishtes janë afiks, kurse nyja e bullgarishtes dhe maqedonishtes klitik. Këto dhe rezultatet e ngjashme të dala nga analiza, përveç që do të konsiderohen si objektive, ato do të mundësojnë një paraqitje më të saktë të strukturës së frazës nominale në këto gjuhë si në rrafshin sinkronik ashtu edhe në rrafshin diakronik.

Nëse ndonjë gjuhë ka nyja, atëherë analizimi i cilësdo dukuri brenda domenit nominal pashmangshëm çon drejt analizimit të këtyre nyjave. Një analizë e tillë është sidomos e rëndësishme nëse kihen parasysh modelet e ndryshme gramatikore të cilat janë në dispozicion për të paraqitur strukturën e frazës nominale. Në gjuhët ballkanike, të cilat formojnë të ashtuquajturin *Sprachbund* (shqipja, rumanishtja, bullgarishtja dhe maqedonishtja) nyja e shquar është një morfemë e cila nuk mund të qëndron vetëm, por i prapavendoset një gjymtyre tjetër. Veçoritë kryesore të saj janë: (i) prapavendosja, e cila paraqitet edhe te gjuhë të tjera si p. sh. gjuhët skandinave dhe (ii) prania e saj te gjuhët sllave (bullgarishtja dhe maqedonishtja). Jo rrallë, nyjat e gjuhëve ballkanike e skandinave nga njëra anë dhe nyjat e gjuhëve të cilat e prapavendosin atë para emrit nga ana tjetër (anglishtja, gjermanishtja etj.), klasifikohen si dy grupe dhe analizohen an-bllok. Situa-

të e ngjashme është edhe gjatë analizës së nyjave të cilat i takojnë grupit skandinav apo grupit ballkanik, prandaj ato hasen shpesh si nyja skandinave dhe nyja ballkanike. Börjas (1994, 1998) konstaton se të parat janë afiksë, kurse të dytat klitikë. Harrison (1998) në punimin e tij rreth nyjës shqipe, konkludon se nyja ballkanike është klitik. Nga ana tjetër Ortmann dhe Popesku (2000) konstatojnë se, përveç nyjës së maqedonishtes, të gjitha nyjat e tjera të gjuhëve ballkanike janë afikse. Kurse Himmelmann (1997), pa hyrë në ndonjë analizë të thellë, kritikon analizën e Börjas sidomos lidhur me nyjën shqipe, për të cilën thotë se as që është bërë ndonjëherë fjalë se ajo është klitik. Por, edhe ai konstaton se përveç rumanishtes e shqipes, nyja e bullgarishtes dhe e maqedonishtes janë (më shumë) klitikë se sa afiksë. Në këtë punim, përveç argumenteve pro dhe kontra të autorëve të mësipërm, do të shohim se ka dallime të tjera brenda domenit nominal te gjuhët ballkanike. Përcaktimi i statusit morfosintaksor të nyjës: klitik apo afiks, dhe përcaktimi i statusit të saj në rrafshin pragmatik dhe rrafshin semantik jo vetëm që janë çështje esenciale për të pasqyruar sintaksën e frazës nominale, por ato janë esenciale edhe për studime diakronike, sidomos për të përcaktuar shkallën e gramatikalizimit të dëftorit apo ndonjë pjesëze deiktike¹ të dikurshme nga i cili (apo e cila) u zhvillua nyja e shquar.

Përcaktimi i statusit morfosintaksor do të bëhet në bazë të kriterëve të Zwicky dhe Pullum (1981)², të cilat aktualisht konsiderohen si më të besueshme për të bërë dallimin midis klitikut dhe afiksit.³ Do të vazhdohet me kriteret e dala nga Himmelmann (1997)⁴ dhe Himmelmann (2001)⁵ për përcaktimin e statusit në rrafshin pragmatik dhe semantik. Shkalla e gramatikalizimit të pjesës zës deiktike apo dëftorit do të përcaktohet duke iu referuar stadeve të gramatikalizimit të Greenberg (1978)⁶.

¹ Sipas Himmelmann (1997: 21) fillimisht të gjithë elementët deiktikë në gjuhët IE ishin pjesëza.

² Zwicky, A. & G. Pullum (1983): *Clitization vs. Inflection: English n't*. Language 59: 502-513

³ Shih autorët e përmendur dhe Birgit Gerlach and Janet Grijzenhout (eds.) (2000): *Clitics in Phonology, Morphology and Syntax*, John Benjamins, Amsterdam/ Philadelphia me literaturë.

⁴ Himmelmann, N. (1997): *Deiktion, Artikel, Nominalphrase. Zur Emergenz syntaktischer Struktur*. Tübingen: Niemeyer


⁵ Himmelmann, N. (2001): Articles. Në Haspelmath, M, König, E, Oesterreicher, W (eds.): *Language Typology and Language universals*, 831-841, Berlin: Mouton de Gruyter

⁶ Greenberg, Joseph (1978): How does a language acquire gender markers?. Në J. Greenberg et. al. (eds.): *Universals of Human Languages, vol 3. Word Structure*, 47-82. Stanford University Press.

1. Klitik apo afiks?⁷

Në gjuhët ballkanike, nyja është një morfemë e lidhur me një gjymtyrë të pavarur e cila quhet bartëse (angl. *host*⁸). Në morfologji dallohen format e lira dhe format e lidhura, të parat janë fonetikiisht të pavarura dhe mund të qëndrojnë vetëm, kurse të dytat janë fonetikiisht të varura dhe nuk mund të qëndrojnë vetëm, por lidhen me bartësin e tyre. Sikurse afiksët, klitikët janë forma të lidhura. Dallimi midis tyre qëndron në mënyrën se si kombinohen me bartësin që skematikiisht mund të paraqitet si në (1):

(1)



⁷ Shembujt që në këtë punim janë përdorur për të verifikuar kriterin e zbatuar a për të ilustruar ndonjë dukuri në gjuhët ballkanike, janë huazuar nga gjuhëtarë kompetentë: Himmelmann (1997): *Deiktion, Artikel, Nominalphrase-zur Emergenz syntaktischer Struktur*, Max Niemeyer Verlag, Tübingen; Börjas, Kersti (1998): *Feature Distribution in Swedish Noun Phrase*, Blackwell, Oxford; Tomic, Olga Miseska (2006): *Balkan Sprachbund Morpho-Syntactic Features*, Springer, Dodrecht; Harrison, David (1998): The Morphology of Special Clitics: The Definite Article in Albanian, In: Kaiser, Lizanne ed.: *Yale A-Morphous linguistics Essays-Studies in the Morpho-syntax of Clitics*, Yale University, Yale, 45-74; Ortmann, Albert and Popescu, Alexandra (2000): Romanian definite articles are not clitics, In: Gerlach, Birgit and Grijzenhout, Janet ed.: *Clitics in Phonology, Morphology and Syntax*, John Benjamins publishing, Amsterdam; Halpern, A. (1995): *On the placement and morphology of clitics*. Stanford, CA:CSLI publications; Dimitrova-Vulchanova, M & G. Giusti (1998): Fragments of Balkan Nominal Structure, Në A. Alexiadou & C. Wilder (eds.): *Possessors, Predicates and Movement in the Determiner Phrase*, 333-360. Amsterdam: John Benjamins

⁸ Në fakt *host* në anglishte ka kuptimin e mikpritësit.

Në (1a) kombinimi ndërmjet nyjës *-i* dhe bartësit të saj, emrit-rrënjë *Libr-*, bëhet ashtu që fraza nominale del nga leksikoni mental si një gjymtyrë apo një fjalë: [Libr-**i**]_{NP}, e cila përbëhet nga emri (rrënjja) dhe nyja. Emri *Libr-* ka tiparin [-CL] (që do të thotë: nuk është klitik), kurse nyja ka tiparin [+def] që do të thotë i caktuar dhe [-CL] që do të thotë se nuk është klitik. Meqë ato janë të kombinuara para se të dalin nga leksikoni, atëherë thuhet se kombinimi i tyre është bërë në domenin morfologjik⁹. Në shembullin (1b) emri *Libr-* dhe nyja *-i* dalin nga leksikoni mental dhe kombinohen në domenin sintaksor duke dhënë një frazë nominale: [[Libr-]_{NP}[-**i**]_{DET}]_{NP}. Tiparet e emrit janë: [-CL] [-def], kurse ato të nyjës [+CL] [+def].

Ngjashëm mund të thuhet edhe për gjuhët e tjera ballkanike:

- (1) a) [Kniga-**ta**]_{NP} ose a') [[Kniga-]_{NP}[-**ta**]_{DET}]_{NP} bullgarisht
 b) [Carte-**a**]_{NP} ose b') [[Carte-]_{NP}[-**a**]_{DET}]_{NP} rumanisht
 c) [Kniga-**ta**]_{NP} ose c') [[Kniga-]_{NP}[-**ta**]_{DET}]_{NP} maqedonisht

Më konkretisht, afiks apo klitik nënkupton se a duhet nyja të trajtohet në nivel të fjalës (afiks) apo në nivel të frazës (klitik). Për dallim nga afiksët, klitikët konsideron si forma të ndërmjetme, ato janë as fjalë e as forma të lidhura ose mund të thuhet se janë edhe fjalë e edhe forma të lidhura. Për këtë arsye, kombinimi i një klitiku me bartësin është më kompleks: ai bëhet në domenin morfologjik, sintaksor por edhe fonetik. Thënë ndryshe, ata dallojnë nga afiksët në sintaksë, formë dhe veti fonologjike.

Për të ilustruar një gjë të tillë po marrim një shembull të huazuar nga Fromkin (2000:71)¹⁰ për gjenitivin saksonik ‘s dhe mbaresën *-s* e shumësit në gjuhën angleze. Ata kanë forma të njëjta morfologjike, por i pari është klitik kurse i dyti afiks:

- a) The girl I saw’s flowers.
 b) The girl I saw yesterday’s flowers.
 c) The girl who helped me’s flowers.
 d) The girl who was helpful’s flowers.

Në (3), kur përdoret një fjali lidhore, gjenitivi saksonik ‘s mund

⁹ Teoritë e fundit transformacionaliste, siç është Programi Minimalist i Çomskit, mbështeten në një “jo-leksikalizëm” radikal. Sipas këtij programi, nëse elementi flektiv nuk është pjesë e kompozitës, atëherë ai është pjesë e sintaksës.. Thënë ndryshe, sipas kësaj teorie, edhe po të ishte nyja afiksi ajo i bashkëngjitet bartësit në domenin sintaksor e jo morfologjik. Shiko më gjerësisht Börjas (1998: 41-42) dhe referimet në autorë të tjerë aty.

¹⁰ Fromkin, V. et al. (2000): *Linguistics-An Introduction to Linguistic Theory*, Blackwell, Oxford

të jetë pas foljes (3a), ndajfoljes (3b), përemrit (3c) apo mbiemrit (3d). Mbaresa e shumësit – s në gjuhën angleze përdoret më ndryshe se ‘s i gjenitivit. Mbarsa -s e shumësit nuk vendoset në fund të frazës nominale, sepse shumësi i *King of England* (*mbreti i Anglisë*) nuk është **King of England-s*, por thuhet *King-s of England* dhe shumësi në fjalinë lidhore *girl I saw* (*vajzën që e pashë*), *girl we were talking about* (*vajzën për të cilën bisedonim*) apo *girl who helped me* (*vajzën e cila më ndihmoi*) është: *girl-s I saw*, *girl-s we were talking about* dhe *girl-s who helped me*. Thënë ndryshe, shumësi bëhet duke i shtuar mbaresën apo afiksin –s gjithnjë kryefjalës së fjalisë lidhore:

- (2) a) girl’s I saw
 b) girl’s we were talking about
 c) girl’s who helped me

Pra, afiksi i ngjitet gjithnjë të njëjtës kategori leksikore (p.sh. emrit në shembullin 4), kurse gjenitivi saksonik ‘s apo klitiku mund ti bashkëngjitet kategorive të ndryshme leksikore: emrit, foljes, ndajfoljes, përemrit, mbiemrit etj.

Shpesh dallimi ndërmjet klitikëve dhe afiksive nuk është i qartë si në shembullin e mësipërm. Në ato raste zakonisht merret për bazë definicioni i klitikut dhe definicioni i afiksit. Por, modelet dhe teoritë e ndryshme gramatikore, përveç tjerave, dallohen edhe për nga definicioni i këtyre formave. Në këtë punim nuk do të merremi me definimin e këtyre formave, por ideja është të aplikojmë kriteret neutrale të cilat japin rezultate objektive. Në literaturë kriteret e shtruara nga Zwicky dhe Pullum (1983) konsiderohen si kriteret më kredibile dhe më neutrale për përcaktimin e dallimit ndërmjet klitikëve dhe afiksive. E meta (eventuale) e tyre është se autorët synojnë ti klasifikojnë format e lidhura në dy grupe: klitik ose afiks. Qasja e tillë mund të nxjerrë vështërisi, ngase, siç ndodh edhe me dukuritë e tjera në gjuhësi, kënaqja e secilit kusht apo kriter është i pamundshëm sepse sjellja e elementëve nuk është gjithnjë e qëndrueshme. Prandaj, nuk duhet të presim që rezultatet të sigurojnë një mbyllje të prerë dhe përfundimtare, por analiza gjithsesi do të sigurojë një evidencë më të besueshme lidhur me çështjen a është nyja klitik apo afiks dhe një pasqyrim më të saktë të tipareve morfo-sintaksore.

Zwicky dhe Pullum, në punimin e tyre lidhur me përcaktimin e statusit (klitik apo afiks) të mbaresës mohuese ‘nt në gjuhën angleze, propozojnë këto kriteret:

- (3) (i) Klitikët kanë liri më të madhe në përzgjedhjen e bartësve se sa afiksats
(ii) Mospërputhjet arbitrare janë më shumë karakteristikë e afiksave se sa klitikëve
(iii) Veçoritë morfo-fonologjike janë më shumë karakteristikë e afiksëve se e klitikëve.
(iv) Veçoritë semantike janë më shumë karakteristikë e afiksëve se sa klitikëve
(v) Rregullat sintaksore mund të afektojnë afiksët, por jo klitikët
(vi) Klitikët mund ti ngjiten ndonjë materiali i cili ka klitikë, kurse afiksi nuk mund ta bënë një veprim të tillë.

1.1 Kriteri i parë: klitikët kanë liri më të madhe në përzgjedhjen e bartësve se sa afiksët

Afiksët zakonisht kombinohen vetëm me një kategori leksikore, kurse klitikët mund të kombinohen me kategori të ndryshme leksikore. Të shohim tani se si kombinohen nyjat në gjuhët ballkanike:

A. Gjuha Shqipe:

- (4) a) djal-**i** i mirë emër
b) i mir-**i** djalë mbiemër
c) cil-**in** djalë përemër pyetës
d) të par-**in** djalë rreshtor
e) i im-**i** djalë pronor

Në këtë punim të gjitha kombinimet e nyjës me një (lloj) përemri do ta kategorizojmë si kombinim me përemër. Nyja në gjuhën shqipe, përveç pronorit dhe përemrit pyetës, kombinohet edhe me përemrat e pacaktuar (*asnjër-i*), lidhor (*cil-i*) reflektiv (*vetvet-en*) etj. Në shembullin (6) vërejmë se nyja kombinohet me elemente të ndryshme leksikore të domenit nominal: emër, mbiemër, përemër, dhe rreshtor. Ajo gjithnjë është e vendosur në gjymtyrën e parë të frazës nominale dhe nëse supozojmë se nyja i ngjitet kësaj gjymtyre në sintaksë, atëherë mund të themi se ajo është gjithnjë në pozicionin e dytë të frazës nominale. Klitikët e pozicionit të dytë në literaturë janë të njohur si klitikë të Wackernagel (sipas gjuhëtarit Jacob Wackernagel). Ky fakt lë të konkludohet se liria e zhvendosjes së klitikut është e kufizuar. Meqë nyja kombinohet me jo vetëm një lloj kategori leksikore dhe nëse ky kriter merret si kriter kyç apo i vetëm, atëherë mund të thuhet se nyja e shqipës është klitik.

Lidhur me këtë sjellje të nyjës janë shprehur edhe disa gjuhëtarë të shqipes, kështu Cipo pohon: “nyjat kanë këtë të veçantë që mund ta sub-

stantivojnë çfarëdo pjese të ligjëratës përveç foljes” (Sintaksa, f. 68), kurse për Newmark kjo dukuri paraqet një ndërrim të kategorisë gramatikore brenda frazës nominale (*grammatical category switching*), sepse kur mbiemri del në pozitë të parë bëhet emër, ndërkaq emri shndërrohet në mbiemër. Rrjedhimisht, mbiemri ishte dashur të shënon individin (ose sendin), kurse emri të shënon një tipar të atij individi. Këtu po bëjmë një digresion. Edhe sipas Gramatikës së Akademisë prania e nyjës shënon emrin. Prandaj në shembullin:

(5) Puna e bënë [[njeri-**un**] [njeri].

Gjymtyra e parë në frazën nominale të kundrinës *njeri-un* është emër, kurse gjymtyra e dytë *njeri* është mbiemër. Nëse është kështu atëherë del se shembulli (8):

(6) a) Agimi bleu veturë. b) *Agimi e bleu veturë.

nuk ka kundrinë, sepse *veturë* nuk është një emër i vërtetë¹¹ sepse nuk pasqyron një send, por një tipar (apo bashkësi tiparesh) i cili e karakterizon konceptin veturë. Për këtë arsye edhe rimarrja e kundrinës në shembullin (8b) është e pamundshme, sepse antecedenti (-e) nuk ka në këtë të referohet, sepse *veturë* nuk është send, por është tipar. Mirëpo, kështu nuk mendojnë edhe autorët e kësaj gramatike, sipas tyre në gjuhën shqipe kundrina e drejtë mund të del edhe në këtë formë, pra pa nyje. Sipas Kallullit¹² (1999), në këtë rast, frazës nominale i mungon komplet një shtresë sintaksore e cila është refleksi i tiparit morfo-sintaksor të shquarsisë apo nyja e cila kohët e fundit konsiderohet si kokë e frazës nominale. Pohimet e Cipos¹³ dhe Newmark¹⁴ i shkojnë për

¹¹ Dilema rreth kësaj çështje nuk është e re, Bühler, citon gjuhëtarin Walter Porzig (1924) sipas të cilit emri pa nyjë nuk është emër i mirëfilltë. (f. 345). Mirëpo, kjo dilemë, nuk e ka humb as aktualitetin. Kështu p.sh. Baker në monografinë e vet rreth përkufizimit të kategorive leksikore konstaton: “ X është emër, nëse X është kategori leksikore dhe X siguron indeksin e referencës” (f. 9). Për dallim nga emri, i cili duhet të siguron identitetin dhe referencën e atij identiteti, mbiemri nuk ka nevojë për asnjërin nga këta dy kushte. Bühler, Karl (2011): *Theory of Language- The representational function of language*, John Benjamins, Amsterdam
Baker, Mark (2003): *Lexical Categories*, Oxford University Press, Oxford

¹² Kallulli, Dalina (1999): *The Comparative Syntax of Albanian: on the Contribution of syntactic Types to Propositional Interpretation*, Durham University, <http://theses.dur.ac.uk/>

¹³ Cipo, K (1952): *Sintaksa*, Tiranë. Pohimi i Cipos është në frymën e Wackernagel, i cili forcën substantivuese të nyjës nuk e parashih vetëm për njëjën shqipe apo vetëm për nyjat e prapavendosura, por për nyjat në përgjithësi. (Bühler, po aty, f. 346)

¹⁴ Newmark, L. (1982): *Modern Albanian: A Reference Grammar for Students*. Stanford, CA.

shtati kësaj teze. Të rikujtojmë, nyja është edhe lokus i të gjitha tipareve morfo-sintaksore të frazës nominale.

Le ti kthehemi tani temës kryesore. Ka raste kur nyja nuk shfaqet gjithnjë në pozicion e dytë të frazës nominale. Këtë pozicionim e bllokon ndajfolja, por edhe gjymtyrë të tjera:

- (7) a) shumë i mir-**i** djalë
 b) dy më të mir-**ët** djem
 c) gjithë të mir-**ët** djem
 d) ky i mir-**i** djalë
 e) ai i mir-**i** djalë etj.

Prandaj, për gjuhën shqipe lidhur me këtë kriter mund të përmbillet si vijon:

- (8) Në gjuhën shqipe nyja e shquar kombinohet me këto elemente leksikore të domenit nominal: emër, mbiemër, përemër dhe rreshtor. Ajo shpesh mund të gjendet në pozicionin e dytë të frazës nominale.

B. Gjuha rumune:

Ngjashëm si nyja e shqipes, nyja e shquar (**ul**, mask. Sing dhe **le**, fem, PL) e rumanishtes, gjithashtu shfaqet në pozicionin e dytë:

- (9) a) om-**ul** bun burr-**i** i mirë emër
 b) bun-**ul** om i mir-**i** burrë mbiemër

Në gjuhën rumune bartës i nyjës rregullisht mund të jenë emri dhe mbiemri. Këtë e bëjnë edhe rreshtori i parë: intii-**ul**) dhe rreshtori i fundit: ultim-**ul**:

- (10) a) intii-**ul** etaj i par-**i** kat. (kati i parë) rreshtori i parë
 b) ultim-**ul** i fund-**it** kat (kati i dytë). rreshtori i fundit

Nyja e rumanishtes nuk mund të kombinohet me përemra të pakufishëm, ndajfolje, numërorë etj.

- (11) a) *tot-**ul** oraş *tërë-DEF qytet
 b) tot oraş-**ul** i tërë qytet-**i**
 c) *fort-**ul** sârac oraş shumë-DEF i varfër qytet
 d) foarte sârac-**ul** oraş shumë i varfër-**i** qytet
 e) doi copii-**i** dy fëmijë-**t**

Në (11-12) gjithashtu vërejmë se nyja e shquar merr gjithnjë pozicionin e dytë brenda frazës nominale. Prandaj, për gjuhën rumune mund të thuhet:

- (12) Në gjuhën rumune nyja e shquar mund të kombinohet me emër, mbiemër, rreshtorin e parë dhe rreshtorin e fundit. Ajo shpesh merr pozicionin e dytë në frazën nominale.

C. Gjuha bullgare:

Gjuha bullgare nuk ka morfologji të rasave. Prania e nyjës nuk e mundëson ndërrimin e renditjes së gjymtyrëve, ajo mbetet e ngulitur: mbiemri gjithnjë qëndron para emrit dhe nuk del pas tij (cf. Vulchanova and Giusti)¹⁵.

- (13) a) momče-**to** djal-i emër
 b) goljamo-**to** momče i madh-i djalë mbiemër
 c) prvi-**te** dve bukvi të parat dy letra rreshtor
 d) dve-**te** prvi bukvi dy-DEF të parat letra num
 e) tvoja-**ta** prva xubava roklja i yt-i i pari bukur fustan pron
 f) vsički-**te** studenti të gjithë-DEF studentët pakuf.

Në gjuhën bullgare nyja e shquar kombinohet me emër, mbiemër, përemër, rreshtor, dhe numëror. Ajo shfaqet edhe më shpesh në pozicionin e dytë se sa në gjuhën rumune e gjuhën shqipe. Mirëpo, edhe në këtë gjuhë pozicioni i dytë mund të bllokohet nëpërmjet ndajfoljes apo ndonjë gjymtyre tjetër:

- (14)a) mnogo vernik-**at** na žena si maž shumë besnik ndaj gruas burrë
 b) mnogo-**to** sella shumë-DEF fshatra
 c) poveče-**to** sela shumica-DEF e fshatra
 d) Onja moj-**at** maž mi izjede glava-ta. Ky im-DEF burrë më hëngri kokë-DEF

Në shembujt (16b) dhe (16c) *mnogo* dhe *poveče* sipas Ortmann dhe Popescu (2000) janë mbiemra e jo ndajfolje.

D. Gjuha maqedone:

Edhe gjuha maqedone nuk ka morfologji të rasave (Friedman 1993: 260) dhe prania e nyjës nuk e ndërron renditjen e gjymtyrëve të frazës nominale (Friedman 1993: 286): mbiemri gjithnjë del para emrit.¹⁶

- (15) a) čovek-**ot** njeri-DEF emër
 b) dobr-**iot** čovek i mirë-DEF njeri mbiemër
 c) * dober čovek-**ot** i mirë njeri-DEF

¹⁵ Vulchanova and Giusti (1998: 144): Fragments of Balkan Nominal Structure, *University of Venice Working Papers in Linguistics*, Venice, vol. 8, nr.1, 141-172

¹⁶ Friedman, Victor (1993): Macedonian, Në: Comrie, Bernard and Corville, Corbet: *The Slavonic Languages*, Routledge, New York, 249-305

- d) *moj-ot* časovnik i im-DEF orë pronor
- e) *prva-ta* rabotna nedela e para punues javë rreshtor
- f) *dve-te* prvi rabotni nedeli dy-DEF të parë punuese javë numëror
- g) *si-te* ovie studenti të gjithë këta studentë pakuf

Në gjuhën maqedone nyja e shquar merr shumë më shpesh pozicionin e dytë se sa në gjuhë të tjera. Madje, nyja mund të kombinohet me fjalën e parë edhe kur kjo fjalë nuk është përcaktor i emrit¹⁷:

- (16) *çetiri-te* stotini lug'e katër-DEF qind njerëz numëror
Një dukuri e tillë nuk shfaqet në gjuhën bullgare:
- (17) a) *çetiri-stotin-te* çoveka.
b) **çetiri-te* stotin çoveka
Edhe në maqedonishte ndajfolja e bllokton pozicionin e dytë:
- (18) a) **mnogo-to* golem čovek
b) *mnogo* golem-*ot* čovek

E. Përmbyllje e kriterit të parë

Siç pamë në të gjitha gjuhët ballkanike nyja e shquar kombinohet me së paku dy lloje të njëjësive leksikore dhe shpesh merr pozicionin e dytë brenda frazës nominale. Për gjuhëtarët si Börjas dhe Harrison, ky kriter tregon qartë se nyja shquese në gjuhët ballkanike është më shumë klitik se sa afiks.

Konkluzat e Börjas dhe Harrison bëhen më domethënëse kur kihet parasysh se nyja suedeze i bashkëngjitet vetëm emrit:

- (19)a) [Gris-**en**] NP grymtade. (derr-i hungëroi)
- b) [Den här gamla smutsiga gris-**en**] NP grymtade. (ky derr i vjetër hungëroi)
- c) [Gris-**en** med läng shans] grymtade (derr-i me bisht të gjatë hungëroi)

Në (20) nyja e gjuhës suedeze -**n** vazhdimisht i ngjitet emrit pa varësisht se a gjendet ai në ballë (20a dhe 20c) apo në fund (20b) të frazës nominale. Pra, pozicioni i njëjës sipas pozicionit të emrit. Meqë ajo kombinohet vetëm me emër, nyja suedeze i ngjan mbaresës së shumësit në gjuhën angleze si në shembullin (4), kurse nyjat në gjuhët ballkanike më shumë i ngjajnë gjenitivit sakson, por kryekëput në domenin nominal. Nyja gjenitiv sakson është aktive edhe në domenin verbal.

Gjithashtu, nëse kihet parasysh se gjymtyrët e frazës nominale

¹⁷ Shih edhe Friedman, Victor (2001:32):

Macedonian, <http://www.seelrc.org:8080/grammar/mainframe.jsp?nLanguageID=3>

shpesh marrin funksione të njëjta, ani pse forma e tyre mund të tregojnë një lloj tjetër të elementit leksikor (rreshtor, pronor, etj.), ata në fakt të gjithë ushtrojnë funksionin e përcaktorit të emrit. Kështu që mund të themi se nyja e shqipes, rumanishtes¹⁸ dhe bullgarishtes kombinohet me dy lloj gjymtyrësh të frazës nominale: emër dhe përcaktor. Prandaj, **sipas këtij kriteri**, nyjat e këtyre gjuhëve (kushtimisht¹⁹) mund të konsiderohen se janë afiks e jo klitik. Për nyjën e maqedonishtes nuk mjafton vetëm kaq. Në shembullin (18), ajo mund të kombinohet edhe me një fjalë brenda frazës nominale e cila nuk është përcaktor i emrit.

1.2 Kriteri i dytë: Mospërputhjet arbitrare janë më shumë karakteristike e afikseve se sa e klitikëve

Sipas Ortmann dhe Popescu (2000:303) ekzistojnë disa mbiemra dhe emra në gjuhën rumune të cilët nuk kanë eptim dhe si pasojë nuk mund të kombinohen me nyjën shquese:

- (20) șic (i mençur)
 incurâ-lume (ngatërrestar)

Kurse Halpern (1994 :168) pohon se disa mbiemra në gjuhën bullgare dhe maqedone, të cilët kanë origjinë të huaj, nuk mund të kombinohen me nyjën:

- (21) * serbez-**ta** žena (grindavece-DEF grua)

Në gjuhën shqipe ekzistojnë gjithashtu mbiemra të cilët nuk mund të kombinohen me nyjën shquese:

- (22) detyr-**ën** (çështj-**en**) kyç(e) syrin blu
 *kyç-**ën** detyrë (çështje) *blu-DEF sy

apo mbiemrat të cilët nuk mund të dalin para emrit:

- (23) flamur-**i** rus
 *rus-**i** flamur

Për shkak se mospërputhjet morfologjike nuk janë edhe aq të shpeshta në gjuhët ballkanike, sipas Lyons (1999: 71) këto nyja nuk kanë status të qartë morfologjik, prandaj nuk është e pabazë të supozohet se ato

¹⁸ Sipas Lyons (1999:74), nyjat bullgare dhe rumune janë klitik. Madje, ai pohon se nyja rumune është klitik i përpiktë Wackernagel, kundrejt nyjës bullgare, pozicionin e dytë të së cilës e bllokun ndaj-folja! Për Lyons është interesant se nyja e rumanishtes është goxha e integruar me bartësin e saj, kështu që morfema e nyjës nuk mund të ndahet dhe është bartëse e tipareve kryesore të frazës nominale.

¹⁹ Shiko digresionin e përmendur më herët.

nuk janë afikse të fjalës, por janë afikse të frazës me një status të caktuar sintaksor. Në këtë kuptim Lyons pohon se nyja e shqipes sillet si nyja e paravendosur e gjuhës standarde arabe **-al**, format e së cilës saktësisht mund të parashihen me rregulla të përgjithshme²⁰.

1.3 Kriteri i tretë: veçoritë morfo-fonologjike janë më shumë karakteristike e afikseve se sa klitikëve

Sipas Zwicky e Pullum kjo nuk është një e papritur nëse kihet parasysh se kur dy gjymtyrë kombinohen në sintaksë ato nuk kanë informata (fonologjike) paraprake për njëra tjetrën, prandaj nuk pritet të ketë ndërrime morfo-fonologjike të papritura, ndërrimet eventuale janë më shumë pasojë e rregullave të përgjithshme fonologjike të gjuhës përkatëse. Ndryshe qëndron puna nëse kombinimi bëhet në rrafshin morfologjik. Në at rast, të dy njësitë leksikore paraprakisht posedojnë informatat fonologjike për njëra tjetrën, prandaj ato dalin si një fjalë e vetme nga leksikoni vetëm atëherë kur “pajtohen” me njëra – tjetrën. Por, këto “pajtime” nganjëherë janë arbitrare dhe nuk janë në përputhje me rregullat e përgjithshme fonologjike të gjuhës përkatëse. Sipas Zwicky e Pullum pikërisht këto veçori arbitrare janë evidencë bindëse dhe e mjaftueshme për të pohuar se një element i caktuar është afiks. Mirëpo, duhet theksuar se nëse në ndonjë gjuhë nuk haset në ndonjë arbitraritet të tillë, kjo evidencë nuk dëshmon se elementi i trajtuar është klitik, por vetëm tregon se kjo evidencë nuk ka dhënë dëshmi se elementi ka status të afiksit²¹.

Për të ilustruar se ç’po nënkuptohet me rregulla fonologjike po ndihmohemi me disa të dhëna nga Bevington²².

- (24) a) djal-**i** mik-**u** emër
b) dol-**i** ik-**u** folje

Sipas Bevington (1970: 121), nyja e shquar e emërores të gjinisë mashkullore në njëjës **-i** paraqitet pas të gjitha bashkëtingëlloreve me tipare fonologjike [-prapa], kurse nyja **-u** shfaqet pas segmenteve [+prapa]: **-k**, **-g**, **-h** dhe zanoreve **-a**, **-i** dhe **-e** (25a). Ky distribucion është identik me dis-

²⁰ Ky pohim i Lyons nuk i jep *a priori* njëjës shqipe apo arabe statusin e klitikut, por vetëm lë të kuptohet se përcaktimi jo arbitrar i formave të njëjës shqipe (dhe arabe) nuk është dëshmi për statusin e afiksit.

²¹ Shiko Kersti Börjars & Pauline Harries (2008: 14): The clitic-affix distinction, historical change, and Scandinavian bound definiteness marking. *Journal of Germanic Linguistics* 20(4): 289—350

²² Bevington, Gary Loyd (1970): *Albanian Phonology*, Dissertation, University of Massachusetts,

tribucionin e shënuesit të vetës së tretë njëjës të aoristit (25b).

Kurse, në shembullin (26), në shikim të parë, shtimi i bashkëtingëllores **-r** në fund të rrokjes te emrat duket se është pasojë e pranisë së nyjës së shquar **-i** e cila ka shkaktuar ndryshime morfo-fonologjike në bartësin e saj.

- (25) sy : sy-**ri** gji : gji-**ri**
 bri : bri-**ri** gju : gju-**ri**
 ulli : ulli-**ri** dru : dru-**ri**
 mulli : mulli-**ri** zë : zë-**ri**

Mirëpo, ndërrimet e rrokjes nga zero në **-r** si në (26) haset edhe në domenin verbal²³. Sipas Bevington dukuria e tillë shfaqet te foljet, të cilat ai fonologjikisht i klasifikon si *folje [+R]*, siç është folja *bëj*. Paraqitja e **-r** te kjo folje, në fund të rrokjes, bëhet vetëm në aoristin njëjës: *bë-ra*, *bë-re* dhe *bë-ri*. Fakti se përveç alternimit (zero → r) edhe distribucioni sipërfaqësor në domenin nominal dhe verbal i kësaj mbarese përputhet, është dëshmi e fortë se alternimi në fund të rrokjes së emrit dhe foljes i nënshtrohen procesit të njëjtë²⁴.

Një tjetër shembull është edhe rasti i emrave, forma e pashquar e të cilëve, përfundon me një çift të zanoreve **-ua** apo **-ye**²⁵:

- (26) ftua fto-**i** patkua patko-**i**
 kua ko-**i** krua kro-**i**
 langua lango-**i** përrua përro-**i**

Ndryshimet nga **-ua** në **-o** janë identike me ato të disa foljeve të cilat kalojnë nga diateza pësore e vetës së tretë të aoristit në diatezën veprorë : *u punua*: *punoj*.

Mirëpo, jo gjithnjë njohja e formës fonologjike të bartësit të nyjës është e mjaftueshme për të parashikuar formën e nyjës, e cila varet nga tiparet themelore të frazës nominale:

²³ Bevington (po aty, f. 122)

²⁴ Është interesant se Bevington (po aty, f. 124) propozon edhe një alternativë tjetër lidhur me emrat dhe foljet të cilat marrin **-r** në mbarim të rrokjes. Rregulla alternative (e përgjithshme) fonologjike në at rast do të ishte: **-r** shfaqet para afiksit- zanore. Meqë edhe nyja e shquar mashkullore në emërore të njëjësit është zanore (**-i** dhe **-u**) i bie që paraqitja e **-r** në shembullin (26) është evidencë që nyja është afiks. Bevington e mbështetë këtë rregull me faktin se paraqitja e **-r** nuk bëhet vetëm për shkak të pranisë së nyjës. Ai merr si shembull ndërtimin e shumës të disa emra siç është p. Sh. emri *zë*, i cili e ndërton shumësin e pashquar (pra, pa nyje të shquar) duke i shtuar zanoren **-a**: *zër-a*. Forma e shquar është *zër-a-t*.

²⁵ Bevington (po aty, f.127-128)

- (27) grua: grua-**ja** pjepër : pjepr-**i** pe : per-**i**
 krua : kro:i kodër : kodr-**a** dhe : dhe-**u**

Por, në gjuhën shqipe ka kombinimi të emrit me nyjën e cila shkakton ndërrime morfo-fonologjike në bartësin e nyjës, të cilat nuk janë në përputhje me rregullat fonologjike:

- (28) a) dele del=ja apokopën e rrokjes së fundit²⁶
 b) baba baba=i ç'vendosje të theksit etj.

Integrimi i nyjës me bartësin e vet bëhet edhe në gjuhët e tjera ballkanike:

maqedonisht:

- (29) a) gráb shpinë
 b) gráb+ot gárb-**at** shpin-a metatezë
 c) teatar+ot teatr-**ot** teatr-i

bullgarisht:

- (30) a) grèk grek
 b) gèrk-**ot** metatezë

rumanisht:

- (31) a) familii + i famil-iei

Sipas këtij kriteri del se nyjat në të gjitha gjuhët shkaktojnë veçori morfo-fonologjike të bartësit, që nuk është veçori e klitikëve.

1.4 Kriteri i katërt: veçoritë semantike janë më shumë karakteristike e afikësve se sa klitikëve

Te ky kriter nëse kombinimi i nyjës me bartësin e vet bëhet në rrafshin sintaksor atëherë ishte dashur që kuptimi i frazës të nxirret nga parimi i kompozicionalitetit (parimi i Freges), i cili thotë se kuptimi i frazës është ekuivalent me kombinimin e kuptimeve të secilës gjymtyrë të frazës veç e veç plus sintaksa. Nëse kombinimi bëhet në rrafshin morfologjik, kuptimi i fjalës nuk është gjithnjë identik me kombinimin e kuptimive të pjesëve të saj²⁷.

Në gjuhën shqipe emrat pa përjashtim kombinohen me nyjën, pra edhe me emrat e përveçëm. Prania apo mosprania e saj te këta emra është e kushtëzuar me kushte gramatikore e jo semantike. Në gjuhën rumune, përveç në rrethana emfatike, nyja nuk është e prani-

²⁶ Shiko Harrison (1998)

²⁷ Shiko Zwicky & Pullum (1983: 505)

shme te emrat e përveçëm, përveç emrave gjeografikë. Te gjuha bullgare e maqedone, emrat e përveçëm dhe gjeografikë paraqiten vetëm në rrethana emfatike.

Në gjuhën shqipe dhe rumune, kur emrat kombinohen me emra pas disa parafjalëve (p.sh. **-në** në shqip dhe **-pe** në rumanisht), ata nuk mund të kombinohen me nyja (33a, b):

- (32) a) në karrige (*n) a') në karrige-**n** e verdhë
b) pe scaun (*ul) b') pe scaun-**ul** galben

Mirëpo, kur ata kombinohen edhe me ndonjë përcaktor tjetër, vendosja e nyjës është e detyrueshme (33 a', b').

1.5 Kriteri i pestë: rregullat sintaksore mund të afektojnë afiksët, por jo klitikët

Në shembullin (34) vërejmë se forma e nyjës **-u** bëhet **-i** nëse mbiemri zë vendin e emrit:

- (33) a) mik-**u** i mirë
b) i mir-**i** mik

Mirëpo, ky ndërrim nuk është i kushtëzuar nga kushtet morfo-sintaksore, por, siç u pa në kriterin e tretë, për shkak të rregullave të përgjithshme fonologjike të gjuhës shqipe. Ndërrimi i formës mund të jetë i kushtëzuar edhe për shkaqe leksikore:

- (34) a) daj-**a** i mirë
b) i mir-**i** dajë

Emrat: daja, hoxha etj. janë emra të huazuar, të cilët kanë si veçori marrjen e nyjës së gjinisë femërore.

Dukuri të ngjashme paraqiten edhe në rumanishte (shiko Ortmann (2002²⁸) dhe Popescu (2003)²⁹):

- (35) a) pap-**a** polonez pap-a polonez
b) polonez-**ul** papa polonez-i papë
(36) a) profesor-**ul** mare profesor-i i madh
b) mare-**le** profesor i madh-**i** profesor

Në (36) ndërrimi i formës së nyjës është i kushtëzuar nga kushtet leksikore, kurse në (37) për kushte fonologjike.

²⁸ Ortmann, Albert (2002: 18): *Kategorien des Nomens-Schnittstellen und Ökonomie*, Max Niemeyer Verlag, Tübingen

²⁹ Popescu, Alexandra (2003: 41): *Morphophonologische Phänomene des Rumänischen*, Dissertation, Heinrich-Heine-Universität, Düsseldorf

1.5.1 Bashkërendimi i emrave dhe mbiemrave

Njëri ndër indikacionet bindëse lidhur me statusin sintaksor është edhe mos-përsëritja e nyjës te strukturat bashkërenditëse. Kur nyja është më e pavarur dhe përdorimi i saj është jo aq i ngulitur, folësit mund ta shënojnë atë vetëm një herë, sepse fusha e veprimit apo skopusi i saj nuk kufizohet vetëm në gjymtyrën e parë. Mirëpo, nëse nyja është e integruar me emrin (apo mbiemrin), fusha e veprimit të saj është e kufizuar dhe nuk mund të përfshinë edhe gjymtyrën e dytë, prandaj edhe nevoja që ajo t'i prapavendoset secilit emër dhe mbiemër. Sipas Mladenova³⁰ (2007: 44), kur dy emra bashkërenditen norma aktuale e bullgarishtes kërkon që nyja të jetë e pranishme në secilin emër. Mirëpo një rregulle të tillë nuk i nënshtrohen edhe mbiemrat: nëse ata aplikojnë për referentin e njëjtë, si në shembullin (38c), nyja duhet t'i prapavendoset vetëm mbiemrit të parë. Për këtë arsye, si evidencë po sjellim vetëm shembujt me mbiemra:

(37)a) E gjor-**a** dhe e mjer-**a** vajzë shq.

b) bun-**ul** și inteligjent-**ul** linguist i mirë-DEF dhe inteligjent-DEF gjuhëtar rum.

c) xubavi-**te** i novi(-**te**) çanti. të bukur-DEF dhe të re çantë bullg

d) ubavi-**te** i novi(-**te**) automobili të bukur-DEF dhe të ri-DEF maq.

Në gjuhën shqipe dhe rumanishte prania e nyjës është e obligueshme në të dy mbiemrat (38a,b), kurse në maqedonishte, ngjashëm si në bullgarishte, mjafton që nyja t'i prapavendoset vetëm njërit mbiemër (38d)³¹.

1.5.2 Bashkërendimi me dëftorin

Sipas disa gjuhëtarëve, nëse nyja ka status sintaksor atëherë ajo zë pozicion të njëjtë strukturor sikurse dëftori, prandaj nëse prania e nyjës e përjashton praninë e dëftorit ose prania e dëftorit e përjashton praninë e nyjës, atëherë një shfaqje e konsiderojnë të jetë evidencë se nyja ka status sintaksor. Pohimi i tillë, i cili daton qysh nga Bloomfield-i (1933:203)³², është përvetsuar nga shumë gjuhëtarë dhe është bërë pjesë standarde e shumë gramatikave³³ dhe librave të gjuhësisë³⁴.

³⁰ Mladenova, Olga M (2007: 44): *Definiteness in Bulgarian-Modelling the Processes of Language Change*, Mouton de Gruyter, Berlin-New York,

³¹ Shiko Ortmann dhe Popescu (2001)

³² Bloomfield, Leonard (1933): *Language*, London, George Allen & UNWIN Ltd. Përveç, dëftorit, Bloomfield merr edhe pronorin, të cilin do ta trajtojmë në paragrafin e ardhshëm.

³³ Heidolph et. al. (1981: 306): *Grundzüge einer deutschen Grammatik*, Berlin: Akademie Verlag

Në gjuhët, siç janë anglishtja dhe gjermanishtja, nyjat e të cilave janë klitkë dhe kanë status sintaksor, është e logjikshme të konkludohet se dëftori dhe nyja janë në raporte konkurruese për të njëjtin pozicion strukturor.

- (38) * the this book (ky libr-i) anglisht
 (39) * das dieses Buch (ky libr-i) gjermanisht

Në gjuhën shqipe nyja dhe dëftori nuk e përjashtojnë njëra-tjetrën:

- (40) Ky djal-i i mirë
 Në rumanishte kemi një situatë pak më ndryshe:
 (41) a) acest om ky burrë
 b) *acest om-**ul** ky burr-**i**
 c) om-**ul** acesta burr-**i** ky

Në (41) vetëm pasi dëftori pozicionohet pas emrit struktura gramatikisht është e pranueshme. Disa gjuhëtarë, si Börjas (1998: 81) mendojnë se në këtë pozicion dëftori është në funksion të mbiemrit, sepse, sipas saj këtë e konfirmon edhe prania e mbaresës **-a** në (41c).

Bullgarishtja dhe maqedonishtja e përjashtojnë praninë e dëftorit:

- (42) a) тази книга ky libër bullgarisht
 b) *тази-та книга ky-DEF libër
 c) *тази книга-та ky libër-ky
 (43) a) тој човек/ * човек-от ky njeri/njeri-DEF
 b) овој човек/* човек-от ky njeri/njeri-DEF

1.5.3 Bashkëndimi me pronorin

Përveç dëftorit, Bloomfield konstatonte se edhe pronori është në marrëdhënie konkurruese me nyjën:

- (43) * the my book (libr-i im) anglisht
 (44) * das meine Buch (libr-i im) gjermanisht

Në gjuhët ballkanike, përveç maqedonishtes, te të gjitha gjuhët e tjera nyja dhe pronori, përveç emrave të fafesisë, nuk e përjashtojnë njëra tjetrën:

- (44) a) libr-i im shqip
 b) carte-**a** meu (libr-i im) rumanisht
 c) книга-**та** (libr-**i** im) bullgarisht
 d) *книга-**та** mi³⁵ (libr-**i** im) maqedonisht

Në rastin e pronorit konkludojmë se vetëm nyja e maqedonishtes ka status sintaksor, kurse nyjat e shqipes, rumanishtes dhe bullga-

³⁴ Fromkin et. al. (2000)

³⁵ Tomić (2006: 75)

rishtes kanë status morfologjik.

Mirëpo, nëse nga njëra anë, nyja e dëftori, kurse nga ana tjetër, nyja dhe pronori janë në marrëdhënie konkurruese për të njëjtë pozicion strukturor, atëherë ishte dashur që edhe dëftori e pronori të jenë në marrëdhënie konkurruese. Mirëpo, një gjë e tillë nuk ndodh, madje as në gjuhët, të cilat nuk munden ta bashkërendisin njëën as me dëftorin e as me pronorin, si p.sh. gjermanishtja, tek e cila kombinimi ndërmjet dëftorit e pronorit është i mundshëm:

- (45) a) diese meine Bücher (këto libr-**at** e mia)
 b) * die diese Bücher (këto libr-**at**)
 c) * die meine Bücher (libr-**at** e mia)

Në përgjithësi, ekziston një laramani të bashkërenditjes së njëjës me pronorin e dëftorin: disa gjuhë nuk e përjashtojnë, kurse disa e përjashtojnë këtë bashkërenditje, pavarësisht a është fjala për gjuhë me nyje të prapavendosura apo të paravendosura:

- (46) **Il** mio fratello (vëlla-**u** im) italisht
η μανα μου (nën-**a** ime) greqisht

Nëse kushtet sintaksore nuk e kufizojnë bashkërenditjen, atëherë duhet të ekziston një arsye tjetër përse në disa gjuhë kombinimi është i mundshëm e në disa jo. Në pikëpamje semantike, prania e një përcaktori individualizues, siç është pronori, është i mjaftueshëm për individualizimin kuptimor të emrit, prandaj prania e njëjës, siç konstaton edhe Demiraj (1985: 559)³⁶, është ridondante. Se është kështu, e vërteton edhe fakti se nyja shquese përjashtohet në rastin kur pronori bashkërenditet me emrat e farefnisës edhe në gjuhët, si italishtja, të cilat normalisht e lejojnë një gjë të tillë:

- (47) * la mia madre³⁷ nën-**a** ime

Arsyeja e një sjellje të tillë është se emrat e farefnisës kanë statusin e emrave personal, pra unik, sepse nëna është vetëm një. Prandaj, përdorimi i njëjës semantikisht është i tepërt.

Përveç shqipes edhe gjuhët e tjera ballkanike e ndjekin italishten:

- (48) a) nën-**a** ime shqip
 b) *mica-**e** mea³⁸ (nën-**a** ime) rumanisht

³⁶ Demiraj, Shaban (1985): *Gramatikë Historike e Gjuhës Shqipe*, 8 Nëntori, Tiranë.

³⁷ Haspelmath (1999: 236)

³⁸ Tomić (2006:144, fn. 209)

c) *majka-**ta** mi³⁹ (nën-**a** ime) bullgarisht

d) *majka-**ta** mi⁴⁰ (nën-**a** ime) maqedonisht

Meqë gjuha shqipe përdor rregullisht njën me emrat e përveçëm, pra edhe me ata personal, do të thotë se folësit e kësaj gjuhe janë të mësuar të përdorin njën edhe në rastin kur ajo semantikisht është jo e domosdoshme. Prandaj, njëri nga shpjegimet do të ishte se përdorimi i njëjës në rastin e emrave të farefisnisë është për shkak të parimit të analogjisë.

Mirëpo, nëse emri shpreh marrëdhënie farefisnie, sintaksa e gjuhës shqipe lejon që pronori të del edhe para emrit,

(49) ime nënë

Në (50) vërejmë se nyja nuk është e pranishme, pra kemi një situatë identike si te gjuha italiane dhe gjuhët e tjera ballkanike. Sipas Haspelmath⁴¹ përjashtimi i njëjës kur pronori është para emrit (jo vetëm të farefisnisë) paraqitet te shumë gjuhë:

(50) a) * mitt hus-**id** hus-**id** mitt (shtëpi-**a** ime) islandisht

b) * min vän-**nen** ven-**nen** min (mik-**u** im) suedisht

Një ndër shpjegimet e mundshme do të ishte edhe kështu⁴²: nëse pronori i paraprinë emrit, atëherë kur dëgjuesi e dëgjon emrin ai tashmë e ka informatën nga pronori se fjala është për një shprehje nëpërmjet së cilës individualizimi është i mundshëm, prandaj përdorimi i njëjës është i panevojshëm. Në rastin e kundërt: nëse emri është para pronorit, në momentin kur dëgjuesi e dëgjon emrin ai ende nuk e ka informatën për praninë e pronorit dhe meqë ankorimi i referencës është i domosdoshëm për të bërë individualizimin e shprehjes, folësi përdor njën. Rrjedhimisht, është vonë të bëhet përjashtimi i kësaj të fundit pasi të dëgjohet pronori. Një shpjegim i tillë është në përputhje me parimin e ekonomizimit të gjuhës. Mirëpo, nëse qenka kështu, shtrohet pyetja: a është maqedonishtja, e cila e përjashton përdorimin e njëjës me pronorin (45d), gjuhë “më ekonomike” se sa gjuhët e tjera ballkanike? Meqë, procesi i ekonomizimit është një proces relativisht i gjatë, atëherë kjo imponon që shpjegimi të kërkohet në rrafshin diakronik.

³⁹ Po aty (f. 101)

⁴⁰ Po aty (f. 74)

⁴¹ Haspelmath (1999: 234)

⁴² Haspelmath (1999: 235)

Sipas Haspelmath⁴³, logjikisht janë dy skenarë të mundshëm lidhur me përjashtimin e nyjës kur përdoret pronori:

- (i) **Supozimi i parë:** gjatë një periudhe të caktuar kohore gjuha toleron përdorimin e nyjës me pronorin, prandaj fraza nominale individualizuese **jo posesive** është [Nyja+Emri], kurse fraza nominale **posesive** individualizuese është [Nyja+POS+Emri]. Më vonë ndodh një ndërrim strukturor, ashtu që nyja, për shkaqe të ekonomizimit të gjuhës, përjashtohet nga përdorimi me pronorin. Prandaj, forma e frazave nominale individualizuese modifikohet në: [Nyja+Emër] dhe [POS +Emër].
- (ii) **Supozimi i dytë:** fillimisht gjuha nuk ka nyje shquese, prandaj fraza nominale jopositive ka formën [Emër], kurse ajo posesive [POS+Emër]. Më vonë ndodh një ndërrim strukturor dhe si pasojë e këtij ndërrimi shfaqet nyja e shquar. Për shkak të ekonomizimit të gjuhës, nyja nuk arrin të bëhet pjesë e frazave posesive, meqë në këto rrethana përdorimi i saj është ridondant. Forma e frazave nominale individualizuese do të jetë: [Nyja+Emër] dhe [POS +Emër].

Forma e frazave nominale individualizuese të dy supozimet është e njëjtë: [Nyja+Emër] dhe [POS +Emër], por vetvetiu shtrohet pyetja: cili supozim është më i afërt me realitetin. Sipas Haspelmath⁴⁴, në bazë të dhënave diakronike gjegjësisht procesit të gramatikalizimit, supozimi i parë është i pamundshëm. Të rikujtojmë, nyja u zhvillua nga dëftori, i cili në fazën e parë të gramatikalizimit përdorej shpesh, por nuk ishte i detyrueshëm. Ai përdorej vetëm aty ku nuk kishte mënyra të tjera për të bërë individualizimin e frazës nominale⁴⁵. Me kalimin e kohës, konstruktet gramatikore me nyjën bëhen më të ngulitura dhe përdorimi i saj gradualisht shndërrohet në një përdorim me rregulla të detyruara. Edhe nëse ka ndodh ndonjë ndërrim strukturor, folësi nuk mund të përjashton përdorimin e nyjës, sepse për të ekonomizuar gjuhën ai mund të bënë vetëm reduktime fonologjike e jo morfo-sintaksore⁴⁶. Do të thotë: supozimi i parë nuk mund

⁴³ Po aty (f. 236)

⁴⁴ Po aty (f. 237)

⁴⁵ Shiko Leiss, Elisabeth (2007): Covert patterns of definiteness/ indefiniteness and aspectuality in Old Icelandic, Gothic, and Old High German. Në: Stark, Elisabeth, Elisabeth Leiss and Werner Abraham (eds.): *Nominal Determination-Typology, context constraints and historical emergence*, John Benjamins Publishing, Amsterdam/Philadelphia.

⁴⁶ Haspelmath (1999:238)

të ketë ndodhur, prandaj mbetet supozimi i dytë, i cili është ndërtuar gjatë procesit të gramatikalizimit të nyjës.

Nga ky shtjellim mund të nxjerrim këto konkluzione: së pari, nyjat e gjuhëve të cilat e përjashtojnë përdorimin e saj me pronorin duhet ta kenë nyjën relativisht të re, pra më të re se konstruktet posesive. Kjo i bie se konstruktet me pronor në gjuhën shqipe *ime nënë/ nën-a ime*, kanë moshë të ndryshme: i pari është ndërtuar para shfaqjes, kurse i dyti pas shfaqjes së nyjës shquese. Së dyti, shqipja, rumanishtja dhe bullgarishtja nuk e përjashtojnë përdorimin e nyjës, prandaj, për t'ju përgjigjur pyetjes së shtruar, maqedonishtja nuk është gjuhë me ekonomizim më të lart, por nyja e saj është më e re. Së treti: përdorimi i nyjave me njësi leksikore të cilat kanë veti të brendshme individualizuese si p.sh. emrat e përveçëm nënkupton shkallë më të lartë të gramatikalizimit. Në këtë aspekt, duket se gjuha shqipe ka shkallë më të lartë të gramatikalizimit, ajo në gjuhën shqipe përdoret rregullisht me këta emra, kurse në gjuhët e tjera ballkanike vetëm në raste të caktuara⁴⁷.

1.6 Kriteri gjashtë: klitikët mund ti ngjiten ndonjë materiali i cili ka klitikë, kurse afiksi nuk mund ta bënë një veprim të tillë

Këtë kriter nuk do ta provojmë sepse nyjat në gjuhët e Ballkanit nuk i ngjiten ndonjë klitiku. Gjithashtu, nyjat në gjuhën shqipe dhe rumune nuk janë morfema të thjeshta, por të ashtuquajtura morfema *portmanteau*, pra morfema që ndërthejnë në veti disa tipare gramatikore me morfemat e tyre gjegjëse: morfemën e gjinisë, numrit, rasës dhe shquarsisë, prandaj çdo tentim për të bërë segmentimin e tyre do të shpiente në konkluzione spekulative.

1.7 Rezyme e kritereve klitik apo afiks.

Nyjat e të gjitha gjuhëve ballkanike kanë përzgjedhje të bartësit më të lirshëm se sa suedishtja, e cila ka bartës vetëm emrin. Më përzgjedhësja në këtë aspekt është nyja e rumanishtes me dy (emri dhe mbiemri) apo eventualisht me tre (rreshtori i parë dhe i fundit) bartës. Pason nyja e shqipes me katër (emri, mbiemri, rreshtori, përemri), pastaj e bullgarishtes dhe maqedonishtes me nga pesë (emri, mbiemri, rreshtori, përemri, numërori) bartës. Por, vërejtëm se nyja e maqedonishtes mund të kombinohet

⁴⁷ Shiko për rumanishten Lyons (1999: 123, fn. 9)

fjalën e cila nuk është përcaktor i emrit (çetiri-**te** stotini lug'e), prandaj, me pozicionin aq të shpeshtë të saj të dytë brenda frazës nominale, ajo kualifikohet në kategorinë e klitikëve special⁴⁸.

Te të gjitha gjuhët hasen mospërputhje arbitrare morfologjike, andaj të gjithat e plotësojnë kriterin e dytë. Kjo vlen edhe për kriterin e tretë, të gjitha gjuhët dëshmojnë veçori morfo-fonologjike.

Te kriteri semantik, dallohet gjuha shqipe me përdorimin e saj edhe me emrat e përveçëm, jo përdorimin e nyjës te parafjalët etj. Vetinë e fundit e ka edhe rumanishtja, por jo edhe bullgarishtja e maqedonishtja. Kriteri i pestë është kriteri kyç, sepse nëpërmjet tij mund të dallojmë më qartë se cila nyjë është klitik. Në gjuhën shqipe e rumune, kur dy emra bashkërenditen secili prej tyre duhet të përdoret me nyja. Kështu ndodh edhe me bashkërenditjen e mbiemrave të cilët aplikojnë për referent të njëjtë. Te gjuha bullgare e maqedone, mjafton që vetëm mbiemri i parë të ketë nyje. Kjo qartë dëshmon për karakterin klitik të nyjave të këtyre gjuhëve. Gjithashtu u tregua se përjashtimi i përdorimit të nyjës në bashkërenditje me dëftorin dhe pronorin nuk dëshmon, siç pohojnë disa gjuhëtarë si p.sh. Börjas⁴⁹, për statusin sintaksor të nyjës, por është një indikacion për moshën e nyjës në një gjuhë të caktuar. Analiza tregoi se maqedonishtja ka një nyjë më të re krahasuar me gjuhët e tjera ballkanike. Si përfundim mund të nxjerrim: nyja e shqipes dhe rumanishtes janë afiks, kurse nyjat e bullgarishtes dhe maqedonishtes janë klitik, por kjo e fundit mban edhe epitelin special.

2. Referencialiteti dhe shquarësia - statusi pragmatik dhe semantik i nyjës

Nyja është bartëse e kategorisë gramatikore të shquarsisë dhe kodifikuese e funksioneve të ndryshme të diskursit të shprehura nëpërmjet referencialitetit, e cila është kategori e domenit semantiko-pragmatik. Raporti ndërmjet këtyre dy kategorive nuk është një me një. Shpesh herë prania e nyjës bëhet për shkaqe gramatikore p. sh. ajo është e pranishtme te shprehjet gjeneralizuese⁵⁰ te të gjitha gjuhët ballkanike (shiko

⁴⁸ Sipa Zwicky e Pullum, klitikët special karakterizohen me sintaksën e tyre të ngulitur. Gjithashtu, meqë nyja e maqedonishtes zë në shumicën e rasteve pozicionin e dytë, ajo shpesh quhet klitik Wackemagel (sipas gjuhëtarit Jacob Wackemagel), Shiko për këtë Tomić (2006)

⁴⁹ Börjas, Kerstin (1998: 75-82)

⁵⁰ Nyja konsiderohet e mirëfilltë vetëm nëse ka depertuar në domenin gjeneralizues. Shih: Kramsky,

Tomić⁵¹), përdorimi i saj te lokucionet verbale apo, siç i quan Buchholz⁵² në gjermanisht: *Verbale Wendungen*, si p.sh.

- (51) a) mbush mendje-**n**/* mbush një mendje
 b) heq dorë/ * heq dorë-**n**/ * heq një dorë
 c) qan halli-**n**/ * qan një hall etj

Në frazat (52a, b, c) vërejmë se nyja është e fiksuar, kështu që opozicioni shquar/ jo shquar dhe zëvendësimi i nyjës shquese me nyjën jo shquese është i pamundshëm. Përveç kësaj, këto konstrukte karakterizohen me aktante valentore dhe rekcion specifik të vetin. Pra, ka tiparet e një njësie të pavarur leksikore. Siç duket arsyeja e ekzistimit të këtyre strukturave është për nevoja idiomatike. Mirëpo, në gjuhën gjermane ka struktura të ngjashme verbale të quajtura struktura funksionale verbale (*Funktionsverbgefüge-FVG*), të cilat paraqiten për shkak të paaftësisë të disa foljeve për tu shfaqur në mënyrë të pavarur, prandaj ato zgjedhin emrat apo parafjalët si “ndihmëse” të tyre. Kur emrat hynë në një strukturë të përbashkët me foljen ata marrin me veti ose nyjën e shquar ose jo të shquar, e cila nuk mund të zëvendësohet me tjetrën. Edhe FVG-të karakterizohen me valencë dhe rekcion specifik të vetin. Në gjuhën gjermane kjo dukuri është mjaft e përhapur dhe sipas Leiss⁵³ këto struktura janë dëshmi e fillimit të demontimit të funksioneve pragmatiko-semantike të nyjës në gjuhën gjermane. Pohimin e vet ajo e përforcon edhe me faktin se arsyeja e demontimit të tërësishëm të këtyre funksioneve të nyjës në persishte ishin strukturat e ngjashme verbale.

Përdorimi i nyjës me emrat e përveçëm si në gjuhën shqipe, jo prania e saj te frazat prepozicionale në gjuhën shqipe dhe rumanishte,⁵⁴ bashkërenditja dëftor e pronor etj. të gjitha janë indikatorë të përdorimit të

Jiri (1972:33): *The Article and the Concept of Definiteness in Languages*, Mouton, Hague.

⁵¹ Tomić (2006)

⁵² Buchholz, Oda und Wilfried Fiedler (1987: 216): *Albanische Grammatik*, VEB Verlag Enzyk⁵² Börjas, Kerstin (1998: 75-82)

⁵³ Nyja konsiderohet e mirëfilltë vetëm nëse ka departuar në domenin gjeneralizues. Shiko për këtë çështje: Kramsky, Jiri (1972) *lopedie*, Leipzig

⁵³ Leiss, Elisabeth (2010): Koverter Abbau des Artikles im Gegenwartsdeutschen, Në: Bittner, Dagmar and Livio Gaeta (Eds.): *Kodierungstechniken im Wande I- Das Zusammenspiel von Analytik und Synthese im Gegenwartsdeutschen*, De Guyter, Berlin/ New York., 137-157

⁵⁴ Boretzky, Norbert (1968): Der bestimmte Artikel nach Präpositionen im Albanischen, *Zeitschrift für vergleichende Sprachforschung*, Heft 1, Göttingen, 129-152

nyjës për nevoja gramatikore dhe për nivel të theksuar të gramtikalizimit të saj.

Nga ana tjetër, nyja përdoret edhe për të bërë individualizimin e sendeve apo individëve:

(52) Srešu nas s viska skorost se dvižeše ogromen kamion. Mislehme, će še katastrofirame, no kamion-**ot** uspe da svie vdesno⁵⁵.

(Drejt nesh, me një shpejtësi të madhe ishte duke ardhur një kamion i madh. Kujtuam, do të ndeshemi, por kamion-**i** arriti të kthehet djathtas.)

gjatë përdorimit anaforik si në shembullin në bullgarisht (53) apo shqip (përkthimi në 53). Përderisa gjuha shqipe futjen e referentit në diskurs apo antecedentin (*një kamion*) e realizon nëpërmjet nyjës së pashquar **një**, gjuha bullgare e realizon at me anë të emrit (*kamion*) pa u ndihmuar nga ndonjë përcaktor. Kurse, identifikimi i referentit bëhet nëpërmjet nyjave shquese **-ot** dhe **-i**.

Në gjuhën rumune kemi një përdorim të ngjashëm si në gjuhën shqipe:

(53) La petrecerea de aseara, Andrei a cunoscut **un** politician si an cântăret de renume. Astăzi a întâlnt politician-**ul** in piață.⁵⁶

(Në natën e mbrëmshme, Andrei takoi një politikan dhe një këngëtar të njohur. Sot ai e takoi politikan-**in** në treg.)

Te përdorimi anaforik, të dy gjuhët e fusin referentin në diskurs nëpërmjet nyjës jo shquese **-un** (*un mār*) dhe **një** (*një mollë*), kurse identifikimi i referentit nëpërmjet nyjave shquese **-e** dhe **-a**.

Në maqedonishte situata është e ndërlikuar, sepse morfologjia e nyjës në këtë gjuhë ende e ka një paradigme me tri forma, të cilat reflektojnë me tipare të trefishta deiktike-anaforike në rrafshin semantiko-pragmatik. Po themi ende sepse, është dokumentuar se bullgarishtja⁵⁷ dhe armenishtja⁵⁸ e vjetër kanë pas sistem të trefishtë të nyjës së shquar me një komponentë të

⁵⁵ Bontcheva, Katina (2010:74): *Elementary Bulgarian Grammar*, WEB version

⁵⁶ Chiriacescu, Sofiana & Klaus von Heusinger (2001:4): The Discourse Structuring Potential of Noun Phrases in Natural Discourse
http://www.ilg.uni-stuttgart.de/vonHeusinger/projekte/C4/publications/DAARC_Chiriacescu_vHeusinger_SFB2.pdf

⁵⁷ Mila Dimitrova-Vulchanova, Olga Miseska Tomic (2009: 5): Mila Dimitrova-Vulchanova, Olga Miseska Tomic (2009: 5): *Investigations in the Bulgarian and Macedonian Nominal Expression*, Tapic Academic Press, Trondheim

⁵⁸ Müh, Angelika (2011): Categories of Definites in Classical Armenian, Në: Eirik Welø (ed.): *Indo-European syntax and pragmatics: contrastive approaches*, Oslo Studies in Language 3(3), 2011, 11-25

theksuar deiktike sikurse e ka maqedonishtja e sotme⁵⁹: Paradigmë identike ka edhe dëftori⁶⁰

(54)

	1 2 3 4	tiparet deiktike
t	-ot -ta -to -te	Proksimal: veta e dytë dhe neutral
v	-ov -va -vo -ve	Proksimal: veta e parë
n	-on -na -no -ne	Distal

Për këtë arsye, jo secila formë e njëjës mund të shfaqet gjatë përdorimit anaforik:

(55) **Toj** beše svesen deka mu pripag'a na mnogoplodniot makedonski narod, kako što sami-**ot** go narecuva.

(Ai ishte i vetëdijshëm se i takonte popullit shumë pjellor maqedon si vet ai i quante.)

Në shembullin (56)⁶¹ vërejmë se në pozicion anaforik është shfaqur forma **-t** (**-ot**), e cila mund të jetë proksimale për vetën e dytë dhe neutrale.

- (56) a) Voz-**ov** odi kon jug. maqedonisht
 b) **This** train is southbound. anglisht⁶²
 c) **Ky** tren shkon kah jugu. shqip

Në (57) nyja **-ov**, ka funksion deiktik (dëftues) e jo ekzoforik (apo anamnestik) siç është e zakonshme në gjuhët e tjera. Sipas Himmelmann⁶³ (f.62) ky lloj i njëjës tripalëshe mund të quhet edhe një deiktike për shkak të komponentës dukshëm të theksuar deiktike, e cila për nga intensiteti (si në shembullin e mësipërm) barazohet me dëftorin. Prandaj, shtrohet pyetja, cili është dallimi ndërmjet dëftorit dhe njëjës, duke mos harruar se kjo e fundit është zhvilluar nga dëftori. Lidhur me këtë të rikujtojmë pohimin e Jakobsonit (1972:131)⁶⁴. Sipas

⁵⁹ Tomić (2006: 56)

⁶⁰ Shiko Friedman (1993: 261) dhe Tomić (2006: 61, fn. 29)

⁶¹ I huazuar nga Topolinska, Suzanna (2009: 39): On Pronominal Markers of Noun Phrase Extension in Macedonian and Bulgarian, Në: Mila Dimitrova-Vulchanova, Olga Misesda Tomic (Eds.): *Investigations in the Bulgarian and Macedonian Nominal Expression*, Tapic Academic Press, Trondheim, 24-50

⁶² Shembulli (57a) dhe përkthimi anglisht i tij (57b) janë marr nga Mirkulovska, Milica (2009: 177): Definiteness in Macedonian with some Parallels in Bulgarian. Në: Mila Dimitrova-Vulchanova, Olga Misesda Tomic (Eds.):

⁶³ Himmelmann, Nikolaus (2001:62): Articles, Në: Haspelmath, Martin: *Language Topology and Language Universals*, De Gruyter, Berlin, 831-841

⁶⁴ Jakobson, Roman (1972): Shifters, Verbal Categories, and Russian Verbs; In: *Selected Writings II-*

tij dëftori, i cili e ka të theksuar komponentën deiktike, i takon të ashtuquajturve ‘*zhvendosëve të thjeshtë*’ (simple shifters angl.), kurse nyja është një ‘*zhvendosës i përbërë*’ (complex shifters). Nocioni *zhvendosës* është i lidhur ngushtë me faktin se demonstrativi ‘*ky*’, i cili nuk identifikon gjithnjë të njëjtin entitet, ai ndërron prej rastit në rast. Në një situatë p.sh. ai tregon personin X, kurse në një situatë tjetër personin Y. Pra, ai është ngushtë i lidhur apo më mirë të themi i ankoruar në pikën e vrojtimit të folësit⁶⁵, prandaj potencia për të caktuar referencën varet kryekëput nga pikëvrojtimi i folësit⁶⁶. Këtij grupi të *zhvendosëve* i takojnë edhe ndajfoljet p.sh. *këtu, dje* etj. Nyja dhe përemrat vetorë bëjnë pjesë në grupin e *zhvendosëve të përbërë* dhe gjatë procesit të nxanjës së gjuhës këta *zhvendosës* mësohen më vonë se sa dëftori, kurse tek *afazia* ata zhdukën që në fillim të paraqitjes të kësaj sëmurje. Te *zhvendosësit e thjeshtë*, vetëm folësi e ka të njohur referencën, dëgjuesi njoftohet me atë duke përcjellë gjestet dëftuese të folësit-gishtin. Këta *zhvendosës* hyjnë në grupin e mjeteve themelore të komunikimit. Madje, ata përdoren edhe gjatë komunikimit të njerëzve me disa primat siç është p.sh. qeni. Te *zhvendosësit e përbërë*, folësi dhe dëgjuesi duhet të kenë (apo të ndajnë siç thotë Hawkins⁶⁷) njohuri të përbashkëta.

Prandaj, për shkak të komponentës së theksuar deiktike, del se nyja e maqedonishtes ende nuk e ka arritur nivelin e gramatikalizimit si te gjuhët e tjera ballkanike. Mirëpo, në këtë gjuhë janë të mundshme edhe përdorimet që janë tipike për *zhvendos të përbërë*:

- (57) Eden od vojnicite beše bolen. Lekar-**ot** mu se doblži na bolniot⁶⁸.
Një nga ushtarët ishte i sëmurë. Mjek-**u** iu afrua të sëmurit.

Në (58) paraqitja e *nyjës-ot* bëhet për shkaqe të njohurive të përgjithshme që kanë folësi dhe dëgjuesi. Vërejmë gjithashtu se edhe

Word and Language, Mouton, The Hague

⁶⁵ Leiss, Elisabeth (2007: 94): Covert patterns of definiteness/indefiniteness and aspectuality in Old Icelandic, Gothic and Old High German; In : Stark, Elisabeth; Abraham Werner, Leiss, Elisabeth Ed.: *Nominal Determination: Typology, Context Constraints, and Historical Emergence*, John Benjamins Company

⁶⁶ Demonstrativi e luan rolin e treguesit (indeksit), zëvendëson gishtin tregues.

⁶⁷ Hawkins, John (1978): *Definiteness and Indefiniteness*, London: Croom Helm

⁶⁸ Shembull i marr nag Topolinska (2009: 181): Definiteness (Synchrony), Në: Wiegand, Herbert: *Slawische Sprachen, Handbüchern zur Sprach-und Kommunikationswissenschaft*, De Gruyter, Berlin, VOL 1, 176-188

në këtë shembull është përdor forma **-ot**, e cila ka tipar neutral deiktik dhe ajo nuk mund të zëvendësohet me dëftorin.

Për bullgarishten, Mladenova⁶⁹ jep disa shembuj në të cilët nyja e shquar nuk bënë individualizimin dhe më shumë e merr rolin e nyjës jo shquese, e cila përdoret për të futur referentin në diskursin e shqiptimit:

- (58) Zaštoto te smetnali će fajton-**ut** e na edin pijanica ...
(Sepse ata llogarisnin se karroc-**a** i takonte një pijaneci...)

Në këtë rast nyja shquese mund të kualifikohet si nyjë specifike⁷⁰, Përveç kësaj, ajo gjithashtu pohon se mund të dëshmohej përdorime ekzoforike të nyjës në ‘damaskin’ (tekste të bullgarishtes moderne, e cila u shfaq jo më herët se në fillim të shek. XVII), të cilat shfaqen edhe në gjuhën e sotme bullgare:

- (59)...Nov upravitel se naznači na mjestoto na starija xandžija ...Za da uveri klienti-**te**, ...
U caktua drejtori i ri në vend të hanxhiut të vjetër...Për të bindur klientë-**t** ...

Të gjitha këto fakte flasin se në gjuhët ballkanike nyja përdoret për nevoja pragmatike (lidhja me diskursin), semantike (gjeneralizimi, njohurive të përgjithshme të folësit dhe dëgjuesit etj.) dhe gramatikore (lokucionet verbale, parafjalët etj.).

3. Ndikimi në strukturë

Më lart u pa se nyjat e gjuhëve ballkanike nuk kanë status të njëjtë morfo-sintaksor. Nëse është kështu, atëherë shtrohet pyetja: si duket struktura e frazës nominale kur nyja është afiks e si duket kur është klitik. Për të dhënë përgjigje në këtë pyetje duhet të ndihmohemi me diagramin në (1). Kur nyja është afiks, kombinimi bëhet në rrafshin morfologjik, kurse kur nyja është klitik kombinimi bëhet në sintaksë. Si emri ashtu edhe nyja janë elemente leksikore me tiparet e veta gramatikore dhe semantike. Tiparet e emrit janë: gjinia, veta (morfologjikisht reflektohet në folje) dhe numri (*pluralia tantum* dhe *singularia tantum*). Kurse, tipari i nyjës është determinativiteti apo individualizimi, të cilin po e shënojmë me [+DEF]. Nëse emri dhe nyja bashkohen në rrafshin morfologjik, ata hynë si një njësi e vetme leksikore në sintaksë. Prandaj, kjo do të nënkuptonte se secili emër

⁶⁹ Mladenova, Olga (2007): *Definiteness in Bulgarian: modelling the process of language*, De Gruyter, Berlin /New York

⁷⁰ De Mulder, Walter & Anne Carlier (2010): *Definite articles*, *Cambridge Handbook of Grammaticalization*, Cambridge University Press, Cambridge

që hyn në sintaksë dhe është i bashkuar me nyjën, ai posedon tiparin [+DEF]. Thënë ndryshe, secili emër i pajisur me një, kuptimisht është ekuivalent me emrat e përveçëm dhe përemrat. Bashkimi në sintaksë nuk nënkupton një gjë të tillë, sepse bashkimi i emrit me nyjën dhe pajisja e tij me tiparin [+DEF] bëhet kur ka nevojë për tiparin [+DEF]. Mirëpo, më sipër, vërejtëm se në bullgarishte nyja përdoret edhe për shkaqe gramatikore ani pse ajo ka më shumë statusin e klitikut. Arsyeja e një rrethane jo të qartë është sepse ndërmjet kuptimit dhe formës së frazës nominale nuk ekziston një raport një me një. Rrjedhimisht, çdo tentim për të pasqyruar strukturën e frazës nominale bëhet i pamundur nëse përdoret vetëm njëri nga rrafshet gjuhësore (morfologjik apo sintaksor). Prandaj, ishte dashur të gjendet një mënyrë alternative e cila do të përfshinte raportin jo simetrik ndërmjet formës dhe kuptimit.

Löbner⁷¹ dallon dy lloje të shprehjeve individualizuese të cilat përdoren nyja: *shprehjet pragmatike* dhe *shprehjet semantike*. Te *shprehjet semantike* referenca përcaktohet në mënyrë të pavarur nga situata dhe konteksti i shqiptimit, kurse te *shprehjet pragmatike* referenca është tërësisht e varur nga konteksti dhe situata. Baza empirike për një klasifikim të tillë mund të gjendet, në mes të tjerave, edhe te disa dialekte gjermane⁷², të cilat kanë zhvilluar dy lloje të nyjave shquese: *nyjën-A* dhe *nyjën-D*. E para përdoret në shprehjet gjeneralizuese:

(60) A kateter kleri. (Mac-**et** gërvishtin)

apo në shembujt kur referenti është unik:

(61) A san skiinj. (Diell-i ndriçon)

Nyja-A përdoret kur kushtet brenda-gjuhësore dominojnë dhe roli pragmatik i nyjës në kuptimin e shprehjes nuk është aq i theksuar. Kurse, e dyta përdoret kur referenti përcaktohet nëpërmjet kontekstit

(62) Smatst' mi ans **det** pokluad aure? (Do ma hedh lapsi-**n** këtej?)

Ose nëpërmjet përdorimit anaforik:

(63) Peetje hee mister **an** kü slaachtet. Jo saai **det** kü wiar äi sünj.
(Peetje preu **një** ka dje. Thuhet se ka-**u** nuk ishte i shëndoshë.)

Nyja-D përdoret në rastet kur kushtet jashtë-gjuhësore përcaktojnë

⁷¹ Löbner, Sebastian (1985): Definites, *Journal of Semantics* 4, 279-326

⁷² Ebert, Karen H. 1970. *Referenz, Sprechsituation und die bestimmten Artikel in einem nordfriesischen Dialekt*. Bräist/Bredstedt: Nordfriisk Instituut.

referencën e shprehjes, duke përfshirë edhe përdorimin anaforik e kataforik. Thënë ndryshe, të gjitha përdorimet kur nëpërmjet nyjës arrihet lidhja me diskursin gjuhësor. Kjo nënkupton edhe rastin e rimarrjes së kundrinës:

- (64) a) Agimi (e) lexoi libr-**in**. shqip
b) Agimi (*e) lexoi libër.
- (65) [L]- am invitat [pe student-**ul** ei]. rumanisht
E thirra student-**in** e saj.
- (66) Izprati li go pismo-**to**/*pismo ? bullgarisht
A e dërgove letr-**ën**/*letër?
Jana go zaboravi pismo-**to**. maqedonisht
Jana e harroi letr-**ën**/*letër.

Përdorimi anaforik i nyjës te rimarrja e kundrinës bëhet për të “licencuar” formën e shkurtër të përemrit, i cili është referent i këtij mini-diskursi. Rreth arsyes së ekzistimit të rimarrjes së kundrinës ende nuk ka një mendim të prerë, por disa gjuhëtarë supozojnë se ajo është një instrument për të zhvendosur kundrinën nga pjesa e Rhemës (informatës së re apo ende të panjohur) në pjesën e Themës (informata së njohur), ashtu që dëgjuesi të “paralajmërohet” lidhur me objektin e bisedës⁷³.


Sipas Alexiadou⁷⁴ (duke u mbështetë në të dhëna empirike) struktura e frazës nominale është e konceptuar ngjashëm si struktura e fjalisë. Ky koncept tenton të integron njëkohësisht strukturën informative të gjuhës (Thema/ Rhema informatë e njohur/ informatë e re) dhe ti-paret morfo-sintaksore. Ajo ka dy domene strukturore. Domeni i sipërm kodifikon funksionet pragmatike dhe lidhjet me diskursin, kurse domeni i poshtëm kodifikon funksionet semantike dhe gramatikore. Pra, kemi një situatë identike sikurse në rastet e dialekteve gjermane të cilat përdorin dy lloje të nyjave. Në pjesën e sipërme të strukturës, për shkak të lidhjes me diskursin gjuhësor, janë të pozicionuara funksionet e *nyjës-D*, kurse në pjesën e poshtme janë funksionet e *nyjës-A*. Maqedonishtja ka një sistem tri-palësh të nyjave, format **-n** dhe **-v** të maqedonishtes mund të merren si ekuivalente me *nyjën-D*, kurse format -

⁷³ Shiko më gjërësisht kapitullin hyrës të Kallulli, Dalina dhe Liliane Tasmowski (2008): *Clitic Doubling in Balkan Languages*, John Benjamins Publishing Company, Amsterdam

⁷⁴ Alexiadou, Artemis, Haegemman Liliane and Melita Stavrou (2007: 51): *Noun Phrase in Generative Perspective*, De Gruyter, Berlin /New York

t janë ekuivalente me *nyjën -A*.

(67)



Mirëpo, gjuhët e tjera ballkanike kanë vetëm nga një nyjë, e cila ka funksione pragmatike (*të nyjës-D*) dhe funksione semantike (*të nyjës-A*). Në fakt, gjatë procesit të gramatikalizimit, këto nyja kanë zhvilluar dy lloj tiparësh: (i) morfo-sintaksor (shquar/ jo shquar) dhe (ii) pragmatik (individualizimin); i pari i jepet emrit në rrafshin morfologjik, kurse i dyti në rrafshin sintaksor⁷⁵. Prandaj, meqë emri tiparin [+DEF] e përfiton nga struktura, ai (në rastin e gjuhëve shqipe dhe rumune) nuk del nga leksikoni me status ekuivalent (pragmatiko-semantik) të emrave të përveçëm ose përemrave.

4. Shkalla e gramatikalizimit të nyjës

Himmelman⁷⁶, në qasjen e tij tipologjike, jep kriteret e identifikimit të nyjave:

- (i) shfaqen vetëm te shprehjet nominale
- (ii) kanë pozicion të fiksuar brenda shprehjeve nominale
- (iii) përdoren në kontekste semantike e pragmatike në të cilat nuk mund të përdoret dëftori
- (iv) përdorime te *shprehjet semantike*
- (v) përdorimet te *shprehjet pragmatike*
- (vi) përdorimet te *shprehjet gramatikore*


⁷⁵ Një konstatim i tillë është edhe me rrjedhat aktuale gjenerativiste në domenin nominal. Shiko lidhur me këtë: Pesetsky, David & Esther Torrego (2004): The Syntax of Valuation and the Interpretability of Features, MIT, UMass/ Boston; si dhe Lyons (1999: 305).

⁷⁶ Himmelman (2001: 832-834)

Nyjat ballkanike i plotësojnë të gjitha kriteret: ato shfaqen vetëm te shprehjet nominale, gjithnjë u prapavendosen bartësve të tyre dhe kanë funksion të *zhvendosësve të përbërë*. Funksioni i fundit ka aplikim të kufizuar te maqedonishtja, e cila ka ende sistem të trefishtë të nyjave; vetëm njëra mbulon funksionin e *zhvendosësit të përbërë*, dy të tjerat kanë funksion deiktik. Te të të gjitha gjuhët ballkanike nyja përdoret në *shprehjet pragmatike, shprehjet semantike dhe shprehjet gramatikore*.

Caktimi i shkallës së gramatikalizimit të nyjës është një problematikë e vështirë dhe shumë komplekse. Qëllimi i këtij punimi nuk është të jep një propozim të prerë lidhur me shkallën e gramatikalizimit të nyjave ballkanike, por, të pasqyron korrelacionin ndërmjet shkallës së gramatikalizimit, tipareve dhe statusit morfo-sintaksor të nyjave.

(68)



Në bazë të Greenberg⁷⁷ janë katër stadi nëpër të cilat është dashur të kalojnë gramatikalizimi i nyjës: (i) dëftori, (ii) nyja e shquar, (iii) nyja specifike dhe (iv) shënues i emrit⁷⁸. Prandaj, fillimisht përdorimi i saj është kryekëput pragmatik dhe përdoret vetëm për të bërë individualizimin, më vonë përdorimi i saj bëhet edhe për shkaqe semantike dhe gramatikore, kurse në stadin e fundit ajo përdoret kryekëput për funksione gramatikore.

⁷⁷ Greenberg, J. (1978): How does a language acquire gender marking? Në: J. Greenberg et al. (eds.): *Universals of Human Language*, vol 3.: *Word Structures*, Stanford University Press, 47-82

⁷⁸ Shënues i emrit nënkupton se nyja nuk ka më aftësi individualizuese, ajo shënon kategorinë gramatikore të emrit. Nyja e mbiemrit në gjuhën shqipe ka një funksion të tillë,

Në diagramin e dhënë në (70)⁷⁹ vërejmë gjithashtu se klitikët kanë më shumë funksione pragmatike sesa semantiko-gramatikore, çka përputhet me të dhënat e paraqitura në këtë punim.

⁷⁹ Diagrami (70) i prezantuar më lart është bërë duke u bazuar në këta autorë: Hopper, P. & E. Traugott (2003: 7): *Grammaticalization*, Cambridge University Press, Cambridge; Lehmann, Christian: *Thoughts on Grammaticalization*, Second edition, Arbeitspapiere des Seminars für Sprachwissenschaft der Universität Erfurt.

Aristotel SPIRO, Universiteti i Tiranës

PËRSËRITJA E NYJËS PARA ELEMENTEVE TË SINTAGMËS EMËRORE NË GREQISHTE DHE SHQIPE DHE PROBLEMI I NYJAVE NË SHQIPE

Abstrakt

Në gjuhën greke përsëritja fakultative e nyjës shquese para gjymtyrëve të sintagmës emër+mbiemër është një përdorim i zakonshëm (o καλός ο άνθρωπος) i ligjëritimit bisedor. Një dukuri e ngjashme vërehet edhe në gjuhën shqipe në ndërtimin analog (njeriu i mirë apo tek ndërtimi i supozuar *i njeri i mirë). Ky është një krahasim i vendosur edhe nga studiues të nyjës e në përgjithësi të përcaktorëve të gjuhën shqipe (La Piana 1939; Riza 1953, 1979; Demiraj 1973, 1985; Androutsopoulou 2001; Topalli 2009). Por a qëndron në thelb ky krahasim? Në pamje të parë duket se qëndron. Por ekzistojnë disa ndryshime strukturore thelbësore, si p.sh. rendi i gjymtyrëve, spektri i shtrirjes së këtij ndërtimi, veçoritë gramatikore të elementëve të sintagmës që i diferencojnë të dy gjuhët, gjë që vërehet edhe në pasojat historike gramatikore të tyre. Këto ndryshime strukturore, të krahasuara edhe me gjuhë të tjera ballkanike si bullgarishtja, maqedonishtja sllave, rumanishtja, ndihmojnë për të argumentuar nëse shqipja ose nëna e saj ka pasur nyje shquese të paravendosur ose jo.

Në gjuhën greke përsëritja fakultative e nyjës shquese para gjymtyrëve të sintagmës *emër + mbiemër* (o άνθρωπος ο αγαθός) është një përdorim i zakonshëm i ligjëritimit bisedor. Në greqishten e re përdoret gjithashtu edhe ndërtimi *o αγαθός ο άνθρωπος*, ku rendi i gjymtyrëve paraqitet i alternuar. Çka na intereson këtu - dhe vërehet në të dy shembujt - është përsëritja pleonastike e nyjës para njërës prej gjymtyrëve të sintagmës.

Një përdorim i ngjashëm (por jo e njëjtë) vërehet edhe në gjuhën shqipe në ndërtimin gjegjës *njeriu i mirë* apo tek ndërtimi i supozuar **i njeri i mirë*. Është ky një krahasim i vendosur ose i përmendur edhe nga studiues të nyjës e në përgjithësi të përcaktorëve të gjuhën shqipe (La Piana 1939; Riza 1979, 1982; Demiraj 1973, 1985; Androutsopoulou 2001; Topalli 2009), por edhe i vënë në dyshim (khs., p.sh.

Çabej 1963). Ndërtimi i lartpërmendur i greqishtes¹, sidomos ai *nyjë + emër + nyjë + mbiemër* përmendet shpesh në tekstet që i referohen lindjes së *nyjës* shquese në shqipe. Por a qëndron në thelb ky krahasim, i cili në pamje të parë duket i njëmendtë? Disa dallime të rëndësishme midis ndërtimit të greqishtes dhe atij të shqipes e lëkundin fort përligjjen e tij. Do të shqyrtojmë vijimisht disa aspekte, si p.sh. rendi i gjymtyrëve, spektri i shtrirjes së këtij ndërtimi, veçoritë gramatikore të elementëve të sintagmës, ku do të konstatohen ndryshime strukturore thelbësore midis dy gjuhëve, të cilat pranojnë interpretime të ndryshme dhe konfirmohen nga pasojat historike gramatikore të këtyre ndërtimeve.

1. *Rendi i gjymtyrëve*. Në greqisht kemi rendin *nyjë + emër + nyjë + mbiemër*, ndërsa në shqip *emër-nyjë + nyjë + mbiemër*. Përsëritja në greqishte është e dukshme, e qartë, sinkronike; vendosja e mbiemrit pas emrit është shënjuese e një stili joneutral, ku mbiemri del si një gjymtyrë e fokusuar, ndërsa *nyja* shquese është një tregues gramatikor plotësues por i domosdoshëm i këtij fokusimi. Ndërtimi *nyjë + emër + mbiemër* do të interpretohej si kundërgramatikor (**ο άνθρωπος αγαθός*). *Nyja* shquese është po aq e detyrueshme përpara sintagmës greke, sa ç'është i detyrueshëm në shqip përdorimi i *nyjës* së "përparme" përpara mbiemrit. Kjo gjendje gramatikore ka favorizuar në shqipe një ndjenjë gjuhësore që e interpreton *nyjën* si pjesë të strukturës së mbiemrit, gjë që në greqishte nuk vërehet. Në sintagmën shqipe *emër-nyjë + nyjë + mbiemër* përsëritja është konvencionale, e nënkuptuar, diakronike. Treguesi gramatikor i shquarsisë vetëm funksionalisht mund të quhet *nyjë*, pasi tashmë është trupëzuar tek emri si pjesë e temës së tij të shquar, si një morfemë e varur. Prandaj grafikisht e paraqesim të bashkuar me emrin dhe të dallueshëm me anë të një vije ndarëse. Vetëm e ashtuquajtura *nyjë* e "përparme" është morfemë e lirë. Në të vërtetë, përsëritja këtu duhet kuptuar në një plan historik, si një rishfaqje e elementit strukturor në zinxhirin sintagmatik, pas krijimit të zbrazëtisë ndërtimore të shkaktuar nga përngjitja e *nyjës* tek emri.

¹ Përveç këtij rasti, në greqishte vërejmë gjithashtu përsëritjen e *nyjës* shquese edhe përpara ndajshtimit, kur ky shprehet me një emër që shënon profesion a veçori dalluese të personit, p.sh. *η Μαρία η μαθηματικός* (Clairis-Babiniotis et al. 2005: 203) ose përpara llagapit të bashkëpërdorur me emrin e parë, për të shënuar një person, të cilin folësi e paraqet si shumë të njohur e të afërt (ibidem, 201).

2. *Marrëdhëniet sintaksore.* Në greqishte përsëritja e nyjës shquese është pleonastike, fakultative, pasi ajo nuk ndryshon marrëdhëniet ekzistuese sintaksore midis gjymtyrëve. Në shqipe, edhe në vështrim diakronik, përsëritja e nyjës në sintagmën emërore çon në ndryshimin e marrëdhënieve sintaksore, ndërsa përdorimi i saj ndër-mjet emrit dhe mbiemrit është i detyruar.

Në greqishte përsëritja e nyjës është gjendje gramatikore lehtësisht e lokalizueshme e prekshme, ndërsa në shqipe e hamendësuar dhe e paprovuar. Në greqishte paravendosja e nyjës shquese është një fakt real, i dokumentuar historikisht e diakronikisht. Ajo shfaqet që nga *Iliada* (shek. VIII p.e.s.) dhe e ka prejardhjen nga dëftori i vjetër, i cili u specializua për të shënuar shquarsinë (Papanastasiou-Petrounias 2001:423). Në shqipe, përkundrazi, ajo nuk dokumentohet dhe, pavarësisht nga hamendësimet e një ekzistence të mundshme zanafillëse, asnjë gjurmë në sistemin e saj gramatikor nuk jep shkas për të aluduar rreth një pranie të dikurshme.

3. *Vërejtje tipologjike.* Në vështrim tipologjik, nga një krahasim i thjeshtë, vërehet lehtë që elementet e analizimit në greqishte janë më të përhapura sesa në shqipe. Pavarësisht se nyja shquese është e vendosur para mbiemrit, në të vërtetë përcakton emrin. Topika e saj ndikon në emërzimin e mbiemrit (përmes elipsës), por lidhja e saj sintaksore me mbiemrin, ashtu si edhe me emrin, është shumë e çlirët. Mbiemri në greqishte zotëron një mjaftueshmëri ndërtimore dhe kuptimore, që nuk e ka mbiemri i shqipes. Emërzimi i tij është i natyrshëm. Nëse i paraprin nyja shquese, sillet si emër. Kjo ndodh sepse në sintagmën *emër + emër* të greqishtes nyja e përsëritur para gjymtyrës mbiemërore shfaq të njëjtat marrëdhënie sintaksore sikurse nyja kryesore e sintagmës që i paraprin emrit (*ο άνθρωπος ο αγαθός*). Përsëritja e nyjës, pra, vendosja e saj midis emrit dhe mbiemrit është e detyruar, sepse është shënjuese e gramatikueshmërisë së një sintagme të përmbysur, meqenëse rendi i zakonshëm në greqishte është (*nyjë + mbiemër + emër*). Në sintagmën *ο αγαθός άνθρωπος* përsëritja e nyjës shquese para gjymtyrës emërore është fakultative. Arsyeja është se nyja shquese e vendosur para mbiemrit lidhet gramatikisht me emrin, ose më saktë përcakton krejt frazën emërore (mbiemër + emër). Me ndër-futjen e nyjës shquese midis mbiemrit dhe emrit (*ο αγαθός ο άνθρωπος*) përcaktueshmëria formale në sintagmë rishpërndahet: secila nyjë

përcakton gjymtyrën vijuese më të afërt, ndërsa marrëdhëniet gramatikore midis dy frazave tashmë njore (nyjë + mbiemër, nyjë + emër) shpërfaqen nga pranëvënia e tyre. Në këtë sintagmë komplekse përkatësia e nyjës ndaj mbiemrit shkaktohet nga topika e saj dhe “legjtimohet” d.m.th. i takon edhe formalisht, kur pranë emrit përdoret një nyjë e përsëritur dytësore pleonastike. Në këtë mënyrë krijohen të gjitha premiset gramatikore për një përmbysje të sintagmës, e cila merr këtë formë: *ο άνθρωπος ο αγαθός*.

Në këtë ndërtim vendosja e nyjës para mbiemrit është e detyrueshme (khs. sintagmën përkatëse shqipe *njeriu i mirë, pusi i thellë*), ndërsa mospërdorimi para emrit e kthen ndërtimin në kundërgramatikor (khs. *ο άνθρωπος ο αγαθός* dhe **ο άνθρωπος αγαθός*). Çka na intereson të theksojmë në këtë pikë është se përdorimi i nyjës shquese të greqishtes nuk lind nga ndonjë nevojë shqimi por nga nevoja e lidhjes gramatikore midis mbiemrit dhe emrit. Pa praninë e nyjës sintagma cilësohet kundërgramatikore. Prania e nyjës shquese para emrit imponon përdorimin e saj para mbiemrit dhe këtu nyja e përsëritur luan rol lidhës, ndërsa pasvendosja e mbiemrit inkadrohet në një “strategji” ligjërimore të fokusimit të cilësisë. Aq e vërtetë duket kjo, sa që edhe në rast se lihet pa u përdorur nyja e parë (e emrit), nyja para mbiemrit mund të qëndrojë (khs. *άνθρωπος ο αγαθός, Πέτρος ο Μέγας, Ιβάν ο Τρομερός, Ηλιος ο Πρώτος*). Prania e nyjës shërben këtu për të treguar një tipar themelor që karakterizon sendin e shënuar nga gjymtyra bosht, e cila luan edhe rolin e kokës së sintagmës. Gjymtyra bosht pa nyjën shquese ka kuptimin përgjithësues të sendit të shënuar. Ky ndërtim nuk ka korrespondues formal në shqipe (një ndërtim i përafërt do të ishte sintagma e “sforcuar” *njeriu i miri*).

Mjaftueshmëria relative ndërtimore e mbiemrit në greqishte e nxjerr në pah më qartë karakterin e lirë të nyjës shquese. Këtu nuk mund të bëhet fjalë, pra, për mbiemra të nyjshëm, si në rastin e shqipës. Mund të flitet, megjithatë, në një kuptim për paranyjëzim të mbiemrave në greqishte, ashtu siç mund të flitet për paranyjëzim të emrave, por vetëm nëse i japim përmbajtje topike këtij termi.

4. *Argumentimi i nyjës shquese të paravendosur në (proto)shqipe*. Sintagma greke me dyfishim të nyjës shquese do të përbënte një argument ndihmës për të mbështetur ekzistencën e mundshme të një sintagme shqipe

(a parashqipe) *nyjë + emër + nyjë + mbiemër* (* *i njeri i mirë*, **i pus i thellë*). Por meqenëse rendi i zakonshëm i përcaktorëve mendohet se ka qenë paravendosja (Çabej 1963:84, Riza 1959:9, Bokshi 1980:53) sintagma e supozuar duhet shndërruar në *nyjë + mbiemër (+ nyjë) + emër* (**i mirë (i) njeri*, **i thellë (i) pus*) (Riza 1958, 1982: 123, Bokshi 2008 (1984): 92, 157, Topalli 2009: 64), ku nyja e paravendosur do të kishte funksion shques dhe do të përcaktonte togfjalëshin *mbiemër + emër* (*mirë njeri, thellë pus*), me gjymtyrë bosht emrin, i cili do të përcaktohej nga nyja *i* (**i pus*). Midis kësaj sintagme hamendësohet ndërkalja e një mbiemri (*thellë*). Mandej, në sintagmën **i pus i thellë* i-ja para emrit do të justifikohet e përdorur për të lehtësuar emfazën (fokusim mbi gjymtyrën mbiemërore), bash si në përdorimin e sotëm grek (*ο άνθρωπος ο αγαθός*). Afërmendsh, mund të bëhet fjalë vijimisht dhe për një sintagmë me rend të përmbysur (**i thellë i pus*), ose ndryshe rendi normal me përsëritje të nyjës shquese para të dy elementeve të sintagmës.

Le t'i konsiderojmë të gjitha rindërtimet e mësipërme si të mundshme. Ka ardhur një moment kur këto ndërtime për një arsye të caktuar (p.sh. pamjaftueshmëria shprehëse) nuk u përdorën më dhe u kalua në prapavendosjen e përcaktorëve (Demiraj 1986:539), siç është p.sh. sintagma e njohur *pus i thellë*, ku nyja e shquar kaloi nga prokliza në enklizë (Riza 1982:136, Bokshi 2008 (1984):174-176, Topalli 2009: 65). Një kalim i tillë duhet hamendësuar detyrimisht, meqenëse imponohet nga gjendja e sotme e gjërave.

5. *Rishtrimi i problemit të nyjave*. Por këtu lindin natyrshëm disa pyetje, të cilat kërkojnë përgjigje të arsyetuara e bindëse:

Cila ishte nevoja që nyja shquese e paravendosur të ndryshonte pozicionin e të vendosej pas emrit, përderisa këtë funksion mund ta kryente mjaft mirë edhe në pozicionin që kishte? Pse nuk u prapavendosën të gjithë përcaktorët e shqipes? P.sh. pse nuk u prapavendosën për emrin dëftor *i* (Topalli 2009:54)? Pse nyja nuk u prapavendos tek mbiemri, por mbeti para tij? Pse nyja para mbiemrit nuk ka funksion shques, individualizues, emërzues (Topalli 2009:50)? Pse mbeti para mbiemrit, megjithëse nuk ka funksion shques? Nëse ka pasur ndonjëherë funksion shques, si dhe pse e humbi? Pse nuk mbeti ndonjë gjurmë përdorimi e nyjës shquese të paravendosur në sistemin e gjuhës?

Përgjigjet ndaj këtyre pyetjeve janë të vështira, në mos të pamundura. Këmbëngulja për të hamendësuar medoemos një fazë ku emrat në shqipe kanë pasur nyja shquese proklitike paraqitet si një deduksion i pambështetur. Në kushtet ku nuk ka asnjë provë bindëse për një mjedis gramatikor proklize të shquar, jemi të detyruar të heqim dorë nga një hamendësim i tillë dhe të marrim si pikënisje një sistem emëror pa nyjë shquese.

6. *Sintagma emër+dëftor anaforik+emër në gjinore si pikënisje.* Për shkak të simetrisë strukturore dhe paradigmës së njëjtë e shohim paralelisht problemin e nyjës së prapme e të përparme (Newmark et al. 1982:179, Androutsopoulou 2001:164), ndërsa studimin e nyjave të përparme e fillojmë jo nga mbiemri, por nga emri në rasën gjinore (Spiro 2000-2001:46, 2009:165). Në “sintagmën gjentivale” e sheh pikënisjen e formimit të nyjës edhe Topalli (2009:66).

Krahasimi me sintagmën greke hyn në argumentet analogjike, pasi tipologjikisht të dyja gjuhët ndahen në këtë vështirim. Prapëseprapë ky krahasim na ndihmon për të shtruar më saktë problemin e lindjes së nyjave shqipe. Sintagma greke *o άνθρωπος ο αγαθός* vetëm së jashtmi mund të krahasohet me sintagmën shqipe *pusi i thellë*, pasi analiza e tyre e hollësishme nxjerr në pah dallime shumë të rëndësishme. Frazja *o άνθρωπος* është funksionalisht e njëjtë me frazën *pusi*, por në greqisht nyja është një morfemë e lirë proklitike, së cilës i përgjigjet në shqip një morfemë e varur, përfutur pas gramatikalizimit të një enklize.

Nëse krahasojmë pjesën e dytë të sintagmës komplekse (*ο αγαθός* dhe *i thellë*), vërejmë disa dallime shumë të qenësishme. Mbiemri në greqishte, për shkak të pranisë së një morfeme të lirë (nyjës shquese) është emërzuar. Pa këtë nyjë mund të përdoret po aq natyrshëm me funksionet e mbiemrit. Në frazën shqipe *nyjë + mbiemër (i thellë)* prania e nyjës së përparme nuk përbën shkak emërzimi. Nyja shfaqet këtu si një morfemë me liri të kufizuar, përdorimi i së cilës kushtëzohet nga mjedisi sintaksor. Dallimi kryesor midis shqipes dhe greqishtes në këtë pikë është se, ndërsa nyja e përsëritur e greqishtes e ruan plotësisht funksionin e saj shques, nyja e paravendosur / e përparme shqipe nuk ka aspak një funksion të tillë. Po si është e mundur që kjo nyjë, historia e së cilës lidhet me shquarsinë, të mos ketë funksion shques (Topalli 2009:50)? Cila është ajo rrethanë sintaksore,

që e mundëson këtë? Përgjigjja duhet kërkuar në një mjedis të tillë sintaksor, ku përdoret si nyja e prapme, ashtu edhe ajo e përparme, por kuptimi i shquarsisë kalon në plan dytësor, zbehet ose zhduket krejt. Ky mjedis sintaksor identifikohet në rasat e zhdrejta dhe konkretisht në rasën gjinore. Dhe, vërtet, nëse sintagmën greke e “modifikojmë” në rasën gjinore (*του ανθρώπου του αγαθού*), do të vërejmë se marrëdhëniet e shquarsisë kalojnë në plan të dytë, ndërsa në plan të parë dalin marrëdhëniet përcaktore midis gjymtyrës së varur dhe gjymtyrës bosht. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për sintagmën greke të përbërë nga dy emra (*το τσάι του βουνού* “çaji i malit”, *ο ήλιος του καλοκαιριού* “dielli i verës”, *το περίπτερο της γειτονιάς* “kioska e mëhallës”). Nyja e paravendosur funksionon si një fjalë gramatikore, shprehëse e një marrëdhënieje të përgjithshme nënrenditëse. Me këtë shpjegohet edhe njësimi i formave të nyjave të përparme brenda paradigmes (Likaj 1977:32), por edhe shkuptimësimi i shquarsisë së formave të shquara (Gramatika 1995:108), si dhe njësimi i disa trajtave të lakimit të shquar dhe të pashquar, që çon në riorganizimin e paradigmes së lakimit në shqipe. Zbehja e kuptimit të shquarsisë së nyjës në rasat e zhdrejta mund të vërehet edhe në raste analoge gjuhësh të tjera, p.sh. në italishte ose frëngjishte. Kjo vlen sidomos kur emri në gjinore është i përgjithshëm dhe luan rol klasifikues ndaj gjymtyrës drejtuese.

7. *Disa përfundime.* Nga gjithë sa u tha më lart mund të udhëhiqemi në përfundimet vijuese:

1) Nyja e përparme ka lindur në sintagmën emërore pas përngjitjes së dëftorit anaforik tek tema e emrit paraprijës dhe krijimit të zbrazëtisë ndërtimore (Spiro 2000-2001:47, 2009:166).

2) Në një fazë tjetër u krye pajisja me nyjë e mbiemrave në pozicion emërzimi (Spiro 2000-2001:48, 2009:167). Me kalimin e kohës ky u bë pozicioni themelor dhe i natyrshëm i mbiemrave.

Në greqishte përsëritet nyja shquese për shkak të një nevoje rikonfirmimi të përcaktueshmërisë, d.m.th. se nyja i takon jo mbiemrit, por emrit, diçka që në përgjithësi nuk është marrë parasysh nga disa gramatika greke në të kaluarën, të cilat kanë ofruar tabela lakimi mbiemrash të “nyjshëm” (Triantafillidis 1941:261-268). Një gjë e tillë vërehet edhe tek disa gramatika shqipe të traditës, si p.sh. tek “*Saggio di grammatologia comparata della lingua albanese*” të Dh. Kamardës (Camarda 1864:196), “*Grammatica della lingua albanese*” e G. de

Radës (1870:43), “*Gramatika e gjuhës shqipe*” e K. Kristoforidhit (Christophoridou 1882:24-25), “*Shkronjëto e gjuhës shqip*” të S. Frashërit (1886:126-127) etj.

Në shqipe përsëritja ndodh në të njëjtën “hallkë” të sintagmës, dhe kjo përsëritje sjell pasoja për krejt sintagmën. Të dy nyjat (e “prapme” dhe e “përparme”) ndjekin rrugë të ndryshme. Elementi i parë i prapangjitet emrit, që shërben si koka e sintagmës emërore, ndërsa elementi i dytë ruan një pavarësi relative duke u shndërruar në mjet lidhës.

Në shqipe, pra, përsëritja e nyjës ka kuptim të shihet vetëm në një vështrim diakronik, për të përshkruar një proces me pasoja tipologjike krejt të ndryshme nga ato të gjuhës greke (të lashtë e të re): për shkak të përdorimit të vazhdueshëm prapa emrave u përngjit me ta, por modeli sintaksor i përdorimit vijoi të ekzistonte (Pedersen 1894: 248-249, Likaj 1977:31, Riza 1982:123), kështu që ky dëftor vijoi të përdorej për të mbushur “zbrazëtinë ndërtimore” që la përngjitja pas emrit, por tashmë roli i këtij dëftori u reduktua në atë të një “rregullatori” gramatikor.

Gjithë argumentimi krahasues gjuhësor duhet të përfshijë, sikundër është vepruar deri më sot, gjuhët ballkanike që kanë të njëjtën topikë të formantit të shquarsisë: rumanishten, bullgarishten dhe maqedonishten sllave. Pas një krahasimi të përgjithshëm, si të nyjave të prapme (shquese), ashtu edhe të përparme vërejmë që në shqipe ato paraqesin një shtrirje të gjerë, në atë masë sa të flasim për lakim paralel (të pashquar dhe të shquar) si dhe për një të përparme në përcaktorët emërorë dhe mbiemërorë. Veç kësaj, konstatohet edhe një simetri (ngjashmëri fonetike) që nuk vërehet në gjuhët e tjera ballkanike. Ky krahasim do të ndihmonte për të vërtetuar se cila nga këto gjuhë ka ndikuar në shtrirjen e enklizës shquese dhe shndërrimin e saj në një dukuri gramatikore ballkanike. Por kjo çështje e kapërcen tematikën e premtuar të kësaj kumtese dhe i përket një diskutimi tjetër.

Referime bibliografike

- Androutsopoulou, A. 2001. Adjectival Determiners in Albanian and Greek, në Rivero M.L. & Ralli A. (eds.) *Comparative Syntax of Balkan Languages*, OUP, 161-299.
- Bokshi, B. 1980. *Rruga e formimit të fleksionit të sotëm nominal të shqipes*. Prishtinë.
- Bokshi, B. 1984. *Prapavendosja e njëjës shqese në gjuhët ballkanike*. Prishtinë.
- Camarda, D. 1864. *Saggio di grammatologia comparata della lingua albanese*. Livorno: Successore di Egisto Vignozzi e C^o.
- Christophoridou, K. 1882. *Grammatiki tis Albanikis Glossis kata tin Toskikin Dialekton*. En Konstantinoupolei: Boyadjian.
- Clairis, Ch.-Babiniotis, G. Et al. 2005. *Grammatiki tis Neas Ellinikis Domoliturigiki – Epikinoniaki*. Athinë: Ellinika Grammata.
- Çabej, E. 1963. Rreth disa problemeve të historisë së gjuhës shqipe, *Buletini i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Seria Shkencat Shoqërore*. 3:78-92.
- Demiraj, Sh. 1973. *Morfologjia historike e gjuhës shqipe*. I. Tiranë.
- Demiraj, Sh. 1975. *Sistemi i lakimit në gjuhën shqipe*, Tiranë.
- Demiraj, Sh. 1985. *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*. Tiranë.
- De Rada, G. 1870. *Grammatica della lingua albanese*. Firenze: Tipografia dell' Associazione.
- Frashëri, S. 1886. Shkronjëto e gjuhësë shqip. *Vepra*, II. Tiranë: Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Historisë. 1988, 95-221.
- Gramatika e gjuhës shqipe*. 1995. Tiranë: ASH e RSH, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë.
- La Piana, M. 1939. Studi linguistici albanesi. I. *Prolegomeni allo studio della linguistica albanese*. Palermo.
- Likaj, E. 1977. Disa çështje të zhvillimit historik të nyjave në gjuhën shqipe. *Studime filologjike*. 4:29-35.
- Newmark, L., P. Hubbard dhe P. Prifti. 1982: *Standard Albanian: A Reference Grammar for Students*. Stanford: Stanford University Press.
- Papanastasiou, Georgios K.-Petrounias, E. 2001. I morfologia tis Klasikis Ellinikis, në Christidis, A.-F. (ed.) *Istoria tis Ellinikis Glossas*. Thessaloniki: Kentro Ellinikis Glossas & Instituto Neoellinikon Spoudon [Idryma Manoli Triantafillidi], 421-434.
- Pedersen, H. 1894. Bidrag til den albanesiscke sproghistorie. *Festskrift til Wilhelm Thomsen*. København, 248-257 (bot. shqip: Kontribut për historinë e gjuhës shqipe. *Buletini i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Seria Shkencat Shoqërore*. 3 (1959):227-233, përkthyer nga S. Riza).
- Pedersen, H. 1900. Die Gutturale im Albanesischen. *Zeitschrift für vergleichende Sprachforschung auf dem Gebiete der indogermanischen Sprachen, begründet von A. Kuhn*. Berlin und Gütersloh. 36:309-315 (bot. shqip: Guturale në shqipen, në H. Pedersen. 2003. *Studime për gjuhën shqipe*. Prishtinë: ASHAK. 55-114, përkthyer nga A. Dhrimo).
- Riza, S. 1958. Nyjat e shqipes. *Buletini i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Seria Shkencat Shoqërore*. 4:3-59.
- Riza, S. 1982. Probleme të nyjave të shqipes. *Studime filologjike*. 1:121-138.

Spiro, A. 2000-2001. The Parallel Evolution of Postpositive and Prepositive Articles in Albanian. *Albanohellenica*, 2:45-50.

Spiro, A. 2009. Evolucioni paralel i nyjave të përparme e të prapme në gjuhën shqipe. *Studime filologjike*, 3-4: 163-172.

Topalli, K. 2009. *Nyjat e shqipes*. Tiranë: Qendra e Studimeve Albanologjike.

Triantafyllidis, M. 1941. *Neoelliniki Grammatiki tis Dimotikis*. Thessaloniki.

Matteo MANDALÀ, Palermo

MBI TURQIZMAT NË TË FOLMET ARBËRESHE

Abstrakt

Në këto radhë, përmes të dhënash të reja e të panjohura më parë, rrekemi të japim një ndihmesë në studimin diakronik të shtresimit të leksikut të shqipes, duke u ndalur veçanërisht te turqizmat, rolit dhe peshës së të cilave në shqipe, me gjithë kontributet e derisotme, nuk u është kushtuar vëmendja e duhur, e njëherazi synojmë të mbështesim tërthorazi disa teza metodologjike e etimologjike të Eqrem Çabejt.

Gjurmët që turqishtja ka lënë në gjuhët e tjera të Ballkanit janë të shumta nga pikëpamja sasiore dhe të rëndësishme nga pikëpamja cilësore. Jo më kot ato përbëjnë një nga tiparet mbi të cilat ngrihet *lidhja gjuhësore ballkanike*. Krahas përbashkësive morfologjike si nyjat e përparme, sistemi rasor, përdorimi i lidhore në vend të paskajores etj., edhe bashkëpërkimet leksikore, ndër të cilat turqizmat, janë bërë me të drejtë pjesë e objektit të studimit të ballkanologjisë.

Për sa i përket shqipes, përveç disa kontributeve me karakter përgjithësues, studimet e derisotme nuk kanë bërë të mundur përcaktimin e qartë dhe të sigurt të modaliteteve dhe sidomos të fazave historike që ka njohur kjo dukuri, gjë që mund të realizohet vetëm përmes datimit të depërtimit të turqizmave rast për rast. Përpjekja e vetme dhe e lavdërueshme e Çabejt për një shtresim të turqizmave në shqipe mbetet në këtë kuptim e panjaftueshme.

Të folmet arbëreshe, si një dëshmi e gjallë e një faze të vjetër e të padokumentuar të shqipes, janë vendimtare, sepse përmbajnë gjurmë të qarta të kontakteve të hershme me turqishten. Mirëpo, ndryshe nga gjuhët ballkanike dhe nga vetë shqipja, prania e turqizmave në të folmet arbëreshe nuk u detyrohet vetëm kontakteve të drejtpërdrejta që këto dy gjuhë patën para shpërnguljes së arbëreshëve në Itali, por edhe kanaleve të tjera të tërthorta që u krijuan në kushtet e reja gjeografike, historike e kulturore pas shpërnguljes. Përmes një analize të vëmendshme fonetiko-morfologjike rast për rast, gërshtuar me hulumtime, përjasje dhe ballafaqime leksikore ndër-gjuhësore, mund të veçojmë me njëfarë sigurie turqizmat që kanë hyrë në të folmet arbëreshe përmes të folmeve romane të Italisë Jugore, sidomos sicilianishtes dhe kalabrishtes, nga ato që kanë hyrë përmes greqishtes, apo nga ato të mëvonshme, që janë thjesht ndikime kryesisht letrare nga shqipja ballkanike.

§ 1.- Në fund të studimit të tij “Mbi leksikon arbëresh dhe turqizmat” (*Sul lessico dell’arbëresh ed i turchismi*), G. B. Pellegrini (i cili shpesh i ka kushtuar vëmendje çështjeve të albanologjisë qoftë të para në vetvete, qoftë edhe në një kuadër ballkanologjik), ftonte “ata që duan të njohin shqipen e vërtetë, të mos harrojnë rolin dhe peshën e shtresës leksikore turke” dhe “të pranojnë se turqizmat kanë depërtuar thellë në gjuhë, e madje shpesh janë bërë pjesë e saj”¹.

Duke e pranuar ftesën e gjuhëtarit të shquar italian, në këto radhë, përmes të dhënash të reja e të panjohura më parë, rrekemi të japim një ndihmesë në studimin diakronik të shtresimit të leksikut të shqipes, përfshirë turqizmat, e njëherazi mbështesim tërthorazi disa teza metodologjike e etimologjike të Eqrem Çabejt. Mes këtyre përmendim atë që i binte ndesh hapur prirjes që sundonte asokohe në Shqipëri e që synonte zëvendësimin dhe pastrimin “nga lart” të turqizmeve të shumtë të shqipes². Çabej paralajmëronte me largpamësi se ai program, duke ndjekur synime “puriste” jo gjithmonë të përligjura në rrafshin e historisë së gjuhës, duke shtënë në shqipe huazime e barbarizma të tjerë (sidomos nga italishtja)³, jo vetëm që nuk do t’i kishte çrrënjësuar turqizmat nga përdorimi i përditshëm, por do të pengonte studimet leksikore dhe dialektologjike duke dëmtuar kështu jo vetëm albanologjinë, por edhe kërkimet ballkanologjike e turkologjike⁴. Madje vetë Çabej ka vënë në dukje mungesën e një studimi

¹ G. B. PELLEGRINI, *Il lessico dell’arbëresh e i turchismi*, në *Le minoranze etniche linguistiche*, Atti del II Congresso Internazionale, Piana degli Albanesi Palermo, 1989, f. 356, tani në, *Ricerche linguistiche balcanico-danubiane*, Roma, 1992, f. 161-200.

² Shih A. KRAJNI, *Hymnja e turqizmeve në shqipen dhe përpjekjet për zëvendësimin e tyre*, në *Studime Filologjike*, nr. 1, 1965, Tiranë, 1965, f. 144-151, tani në *Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe*, II, Tiranë, 1972, f. 279-287. Për të përligjur këtë ndërhyrje puriste shpesh është thënë se intelektualët e Rilindjes u përpoqën të shmangnin turqizmat që gjatë shek. XIX ishin vërtet të shumta. Ky ishte një nga mjetet romantike që u përdorën në funksion të zgjimit të ndërgjegjes kombëtare të shqiptarëve si edhe për t’i vënë fre trysnisë së kulturës islamike. Mirëpo pas Luftës së Dytë Botërore zëvendësimi nga lart i mijëra turqizmeve që tashmë ishin pjesë e gjuhës shqipe, dilte vërtet i papërligjshëm.

³ Shih E. ÇABEJ, *Introducere în istoria limbi albaneza*, cit. nga G. B. PELLEGRINI, *Il lessico*, cit., f. 356.

⁴ Të vihet re se përveç punimit të lartpërmendur të Krajnit, të pakta kanë qenë

shterues mbi ndikimin e turqishtes në shqipe, duke zënë ngoje vetëm kontributin e vitit 1884 të Miklosich-it mbi elementin turk në gjuhët e Europës jug-lindore, të cilin e konsideronte tashmë të tejkaluar qoftë për lëndën e mbledhur qoftë për metodën e zbatuar, por sidomos sepse i mungonte inkuadrimi historik i fakteve gjuhësore⁵.

§ 2.- Gjurmët që turqishtja ka lënë në gjuhët e tjera të Ballkanit janë të shumta nga pikëpamja sasiore dhe të rëndësishme nga pikëpamja cilësore. Jo më kot ato përbëjnë një nga tiparet mbi të cilat ngrihet *lidhja gjuhësore ballkanike*: jo vetëm tipare gjuhësore si prapashitesat, parafjalët, ndajfoljet, lidhëzat, frazeologjizmat hyjnë në bashkëpërkime mes bullgarishtes, rumanishtes, shqipes, greqishtes dhe turqishtes, por sidomos leksiku “montre lui aussi à bien des égards une conformité remarquable, due surtout aux très nombreux mots de provenance grecque et turque répandus par toute la péninsule, et qui rappelle en quelque sorte l’empreunte d’unité donné aux langues de

studimet e kryera në Shqipëri mbi elementin turko-oriental në shqipe. Përveç studimeve “klasike” të E. ÇABEJ, *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe. Kapitulli V. Huazimet turke*, në *Studime gjuhësore*, vëll. III, Prishtinë, 1987, f. 64-69 dhe *Për një shtresim kronologjik të huazimeve turke të shqipes*, në *Studime gjuhësore*, vëll. V, Prishtinë, 1988, f. 274-279, të pakta kanë qenë kontributet e vlefshme. Mes këtyre përmendim studimin e T. DIDZARIT, *Disa vëzhgime mbi turqizmat në shqipe* kumtesë mbajtur në *Konferencën e Parëtë studimeve Albanologjike* 15-21 nëntor 1962, Tiranë, 1965, f. 407-408 si edhe sidomos *Huazime orientalizmesh në shqipet*, në *Buletini i Universitetit Shtetëror të Tiranës*, Tiranë, 1960, nr. 3, f. 239-263; 1961, nr. 4, f. 181-200 dhe nr. 5 f. 160-177; 1962, nr. 1, f. 161-180; në *Studime Filologjike*, Tiranë, 1964, nr. 2 f. 95-199; nr. 3, f. 75-89; 1965, nr. 1, f. 47-77; nr. 3, f. 85-100; 1966, nr. 1, f. 121-137. Ky punim i rëndësishëm, me vdekjen e papritur të autorit, mbeti i papërfunduar, bashkë me monografinë e tij mbi orientalizmat mbetur në dorëshkrim që ruhet pranë arkivit të Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë të Akademisë së Shkencave. Në vitin 2005 doli në qarkullim, nën kujdesin e Artan Gogës, vepra e T. DIDZARIT, *Fjalor i orientalizmave në gjuhën shqipe. Rreth 4500 fjalë me prejardhje nga gjuhët turke, arabe dhe perse*, AIITC, Tiranë. Tjetër prirje ndjek artikulli i A. KOSTALLARIT, *Rreth depërtimit të turqizimeve në gjuhën shqipe gjatë shekujve XVII-XVIII*, në *Gjurmime albanologjike, Seria e Shkencave filologjike*, VII, Prishtinë, 1977, f. 39-51, si edhe faqet e pakta që mund të lexohen aty-këtu (sidomos në revistën *Studime Filologjike*) mbi huazimet turke në sferat e ndryshme të shqipes.

⁵ Shih E. ÇABEJ, *Huazimet turke*, cit., f. 66.

l'Europe occidentale par les emprunts faits au latin"⁶. Për të dëshmuar sesa e saktë është vërejtja e Sandfeldit do të mjaftonin studimet e mëpasme, sidomos ato të gjysmës së dytë të shek. XX, ku janë vënë në pah bashkëpërkimet leksikore mes gjuhëve ballkanike që i detyrohen ndikimit të turqishtes, sidomos numri i konsiderueshëm i turqizmeve dhe orientalizmeve që kanë hyrë përmes turqishtes.

Sa i përket shqipes, Gustav Meyer llogariste rreth 1.180 fjalë me prejardhje turke⁷. Më pas, falë vjeljes së lartpërmendur të Dizdarit, numri i turqizmeve të dokumentuara u rrit shumë dhe kapi shifrën rreth 4.000 fjalë. Në vitin 1977 Androkli Kostallari, duke ndjekur nga afër punën për përpilimin e fjalorit shpjegues të shqipes që u botua në vitin 1980⁸, njoftonte se nga qëmtimi leksikor rezultoi rreth 3.700 orientalizma, të ndara në 1.700 turqizma të mirëfilltë, 1500 arabizma dhe 500 fjalë nga persishtja⁹.

Gjithmonë sipas Kostallarit, këto huazime mund të klasifikohen sipas sferave leksikore dhe sipas shpërndarjes¹⁰:

<i>Administrata, gjykatat, ushtria</i>	rreth	800
<i>Feja islame</i>	"	170
<i>Ushqimi, mjetet e gatimit e të ngrënies</i>	"	360
<i>Veshmbathja e stolitë</i>	"	420
<i>Zejtaria, ndërtimi e arkitektura</i>	"	380
<i>Shëndetësia, mjekësia</i>	"	250
<i>Ekonomia, tregëtia, marrëdhëniet pronësore ekonomiko-shoqërore</i>	"	320
<i>Arsimi</i>	"	90
<i>Lojnat e zbavitjet</i>	"	100
<i>Etika, estetika</i>	"	50
<i>Masat e kohës, të vëllimit, të peshës dhe monedhat</i>	"	120
<i>Ngjyrat</i>	"	30
<i>Muzika</i>	"	100
<i>Lundrimi e mjetet e tij</i>	"	70
<i>Bujqësia e blegtoria (duke përfshirë florën e faunën)</i>	"	430
<i>Dukuritë gjeografiko-natyrore</i>	"	80
<i>Sfera të tjera</i>	"	200

Mbi bazën e kësaj ndarjeje në fusha leksikore dhe duke rimarrë disa

⁶ K. SANDFELD, *Linguistique balkanique. Problèmes et résultats*, Paris, 1930, f. 11.

⁷ G. MEYER, *Etymologisches Wörterbuch des albanesischen Sprache*, Strassburg, 1891, f. IX.

⁸ Shih *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë, 1980.

⁹ Shih A. KOSTALLARI, *Rreth depërtimit*, cit., f. 43.

¹⁰ *Po aty*, p. 44.

përfundime të Çabejt, Kostallari vlerësonte se turqizmat që kishin hyrë në shqipe ishin përhapur nga qendra (sidomos qytetet) drejt periferisë (fshatrave dhe zonave të thella), e me gjithë numrin e lartë të tyre, autori vinte në dukje se në *Fjalorin e Bashkimit*¹¹, hartuar në fillim të shek. XX, huazimet turke mbanin një raport 1 me 8, ndërsa në *Fjalorin e vitit 1954*¹², ku ishin përfshirë edhe turqizma jo më të gjalla në fondin aktiv të shqipes, ky raport ishte reduktuar në 1 me 17¹³. Kjo e dhënë dëshmonte një tkurrje progresive të fondit leksikor turko-oriental, tkurrje që i detyrohej pjesërisht arsyeve të jashtme (si politikat puriste të lartpërmendura) dhe pjesërisht depërtimit të huazimeve nga gjuhë perëndimore.

Në fakt një studim më i thelluar, jo vetëm etimologjik, por edhe dialektologjik, mund të dëshmonte se kjo e dhënë tendencioze nuk u përgjigjet përmasave reale të shtresës aktuale të turqizmeve në shqipe, e nuk mban parasysh as veprimin e neologjizmave të shumtë, të cilët, sidomos pas luftës së dytë botërore, duke hyrë me plot të drejtë në fondin aktiv të shqipes, kanë ndikuar në uljen e ndjeshme të huazimeve.

Përtej të dhënave sasiore-statistikore, sidomos atyre që bazohen në vlerësime që jo gjithmonë pasqyrojnë përhapjen reale gjeografike të fjalëve (siç është rasti p.sh. i leksikut “zyrtar” që dëshmohet në *Fjalorin e vitit 1980*), duhet mbajtur parasysh gjendja reale, që mund të nxirret përmes dokumentimit nga veprat letrare ose përmes vjeljeve të reja dialektologjike.

Në vitet 1975-76 Norbert Boretzky botoi një studim të rëndësishëm mbi turqizmat në shqipe¹⁴. Në vëllimin e parë autori shqyrton me vëmendje aspektet fonologjike dhe morfologjike të elementit turk në shqipe, ndërsa në vëllimin e dytë sjell një listë pak a shumë ta plotë të turqizmeve, vjelë nga vepra të ndryshme e plotësuar nga burime dialektologjike të gegërishtes (*Drenica, Presheva, Zadrime, Dibra*) dhe të toskërishtes (*Çamëria*). Kjo vepër dëshmon se, së pari, shpërndarja e

¹¹ Shih *Fialuer i rii i shcypés*, Perbâam préie Shocniit t’ Bashkimit, 1908.

¹² Shih *Fjalor i gjuhës shqipe*, botim i Institutit të shkencave - Seksioni i gjuhës e i letërsisë, Tiranë, 1954.

¹³ Shih A. KOSTALLARI, *Rreth depërtimit*, cit., f. 43.

¹⁴ Shih N. BORETZKY, *Der türkische Einfluss auf das Albanische*, Albanische forschungen 11, Otto Harrassowitz, Wiesbaden, 1975-76: *Teil I. Phonologie und Morphologie der albanischen Turzismen; Teil II. Wörterbuch der albanischen Turzismen*.

turqizmeve në shqipe është homogjene për sa u përket dialekteve dhe, së dyti, se kjo dukuri nuk ka qenë e izoluar dhe nuk ka hasur asnjë pengesë në viset e banuara kryesisht nga katolikë në Veri dhe ortodoksë në Jug. Mirëpo me gjithë këto rezultate, problemi i vërtetë mbetet ai i një klasifikimi diakronik a shtresimi kohor të huazimeve turke, pra përcaktimi i periudhës kur ata kanë hyrë në shqipe.

§ 3.- Nëse periodizimi i prurjeve leksikore turke në kuadrin ballkanik është i vështirë, ende më i vështirë është ky për sa i përket shqipës¹⁵, kryesisht për shkak të natyrës dhe të pamjaftueshmërisë së burimeve të shkruara, jo vetëm për periudhën që paraprin vendosjen e arbëreshëve në Itali, por, siç do ta shohim më poshtë, edhe për atë që nis nga gjysma e dytë e shek. XVI.

Ndër të parët që përcaktuan disa kritere të përgjithshme për një analizë diakronike të huazimeve turke në shqipe ishte Eqrem Çabej¹⁶, që propozoi një periodizim në tri faza: faza e parë, para shek. XV që dëshmohet vetëm me anë të fondit leksikor arbëresh; e dyta, nga shek. XVI deri në gjysmën e dytë të shek. XVIII, që përkon me periudhën më intensive të pushtimit osman të Shqipërisë e që dokumentohet përmes veprave të Buzukut (1555), Budit (1618 e 1621), Bardhit (1635), Bogdanit (1685), *Kuvendit të Arbënit* (1706), *Fjalorit* (1702) dhe *Gramatikës* (1716) së Da Lecce-s, si edhe të veprave të tjera të mbetura në dorëshkrim; së fundi, faza që mbulon gjithë shekullin XIX deri në pavarësinë e Shqipërisë (1912) e që nga pikëpamja e dëshmimit me shkrim është pa dyshim më e pasura. Këtij shtresimi kronologjik i referohen edhe studiues të tjerë, sidomos Krajni e Kostallari, të cilët edhe pse i kanë bërë ndonjë modifikim të lehtë, e kanë pranuar si të vlefshëm. Në fakt, po të kemi parasysh se burimet që përdor Çabej për arbërishten nuk janë gjithmonë të sigurta, mendojmë se është e nevojshme të bëjmë ndonjë saktësim të karakterit të përgjithshëm mbi turqizmat në të folmet arbëreshe të Italisë.

¹⁵ Përveç ÇABEJ, shih I. NÉMETH, *Traces of the Turkish Language in Albania*, in *Acta Orientalia*, Academiae Scientiarum Hungaricae, Suppl., XIII, 1961, f. 9-29; S. STACHOWSSKI, *Beiträge zur chronologie der albanischen Turzismen*, in *Folia Orientalia*, X, 1968, f. 52-58.

¹⁶ Shih E. ÇABEJ, *Për një shtresim*, cit., f. 275-278.

§ 4.- Në më se një rast Çabej ka vlerësuar lart ndihmesën që i japin historisë së leksikut të shqipes të folmet arbëreshe të Italisë, duke i konsideruar ato si dëshmi të gjalla të një faze të vjetër e të padokumentuar të shqipes. Në lidhje me studimin e shtresimit të elementit turk, të folmet arbëreshe janë vendimtare sepse përmbajnë gjurmë të qarta të kontaktit me turqishten. Është fjala për turqizma (si p.sh. *fitil* < turk. *fitil*, *sakat sahat* < turk. *saat*, *sënduq sunduq sduq* etj. < turk. *sandîk sanduk*, *gajtan* < turk. *gaytan kaytan* etj.) që u përkasin kryesisht fushave leksikore të ekonomisë shtëpiake dhe të teknologjisë ushtarake, që meqenëse gjenden te të folmet arbëreshe, i përkasin fazës së parë të depërtimit të elementit turk në shqipë.

Për Çabejn¹⁷ këto janë gjurmë të lëna nga kontaktet me ushtarët turq të cilët nga gjysma e dytë e shek. XIV deri në gjysmën e parë të shek. rrihnin trojet e Gadishullin Ballkanik. Vetëm më pas, falë ndihmës që i dhanë perandorit Andronik III Paleologut, trupat mercenare turke u shndërruan në pushtues, duke shtënë në dorë disa vise jugore të Shqipërisë. Gjatë grindjeve mes Gjergj Balshës dhe Karl Topisë, osmanlinjtë që ndërhyjnë ushtarakisht në ndihmë të Topisë, përfituan nga rasti për të pushtuar disa qytete të Shqipërisë (Durrësin dhe Shkodrën në vitin 1386, Krujën në vitin 1415, Vlorën në vitin 1417). Ky ishte preludi i pushtimit të mirëfilltë që u krye pas vdekjes së Skënderbeut (1468) me pushtimin sërish të Krujës (1478), Shkodrës (1479), Durrësit (1501). Pikërisht gjatë kësaj periudhe nisën valët e njëpasnjëshme të mërgimit të arbëreshëve drejt Italisë së Jugut, që vazhduan deri në gjysmën e parë të shek. XVIII.

Nuk ka dyshim se qysh në periudhën mes gjysmës së parë të shek. XIV dhe gjysmës së dytë të shek. XV pati kontakte mes shqiptarëve dhe turqve. Çabej pasi kujton p.sh. se në një letër të Skënderbeut drejtuar Alfonsit të Aragonës lexojmë fjalën turke *haraç*¹⁸, duke analizuar leksikun e të folmeve arbëreshe, qëmton turqizma që dëshmojnë një fazë të parë shtresimi e që u përkasin sferave leksikore të ndryshme (terminologji ushtarake, veshje, ekonomia shtëpiake, mjedisi shoqëror etj.), duke theksuar se ndryshe nga të folmet arbëreshe të Greqisë, ato të Italisë gjenden në një kontekst gjuhësor roman, që nuk

¹⁷ Shih E. ÇABEJ, *Huazimet turke*, cit., f. 64-65

¹⁸ *Po aty*, f. 68.

pati kontakte të drejtpërdrejta me turqishten, kështu që në të shumëshumë mund të kishte depërtuar “ndonjë element i veçuar turk (ose përgjithësisht oriental, sidomos arab)”¹⁹. Mbetet për t’u saktësuar jo aq vërtetësia e këtij depërtimi, për të cilin jemi të sigurt, sesa përmasat reale të tij. Në fakt, po të mbajmë parasysh nivelin e objektivitetit të burimeve për turqizmat e përgjithësisht orientalizmat që gjenden në të folmet arbëreshe, duket të jemi shumë të kujdesshëm sepse ato që mbahen si burime kryesore, siç është p.sh. *Fjalori* i Giordano-s²⁰, nuk janë aq të besueshëm sa ç’është menduar deri sot. Nuk duhet marrë pa rezerva as pohimi i Çabejt sipas të cilit, të folmet arbëreshe, duke u gjendur në një kontekst roman, e kanë ruajtur të pastër leksikun e tyre origjinal, sepse elementet orientale, sidomos arabe, në sicilishte e në kalabrishte nuk janë aq të pakta e të papërfillshme. E meqenëse orientalizmat në arbërishte kanë hyrë nga burime të ndryshme, ato duhen shqyrtuar rast për rast pa përgjithësime të tepruara, duke mbajtur parasysh faktin se këto huazime kanë kaluar përmes katër kanaleve:

a) *permes kontakteve me dialektet jugore të Italisë*, sidomos me sicilishten dhe kalabrishten, që kanë ndikuar më tepër në të folmet arbëreshe. Për të përmendur vetëm një shembull, fjala arb. *kofë -a, kufë -a* ‘kofin’ (GIOR. 194 e 207), me prejardhje arabe nga *quffa* ‘shportë thuprash dhe kashtë’, ka hyrë në të folmet arbëreshe përmes sicilishtes *coffi* ‘shportë e vogël’ dhe kalabrishtes *coffa* ‘shportë thuprash’²¹. Në të folmet arbëreshe të Sicilisë ka shumë fjalë me prejardhje arabe që kanë hyrë përmes sicilishtes, si *barrakan -i* (PELL. Arab. 337, shumë e përhapur në Liguria, por e pranishme edhe në të folmen arbëreshe të Horës ‘leckë, paçavure, sukull’), *kafis -a* (khs. sic. *cafisu*, PELL. Arab. 145; AMB. Strat. 45), *damus -i* (PELL. Arab. 155; AMB. Strat. 45), *trabut -i tabut -i tavut -i* (GIOR. 492; PELL. Arab. 169), *zimbill -i zymbyll -i* (PELL. Arab. 171-172) etj.;

b) *përmes veprave të autorëve shqiptarë*, të studiuara nga intelektualët arbëreshë, - sidomos gjatë shek. XIX -, prej nga janë nxjerrë disa fjalë me prejardhje turke që mblodhi Giordano, por që nuk për-

¹⁹ Shih E. ÇABEJ, *Për një shtresim*, cit., f. 275.

²⁰ E. GIORDANO, *Fjalori i Arbëreshvet t’Italisë*, Bari, 1963.

²¹ Shih G. B. PELLEGRINI, *Gli arabismi nelle lingue neolatine con speciale riguardo all’Italia*, I, Brescia, 1972, f. 164.

doren vërtet nga arbëreshët: i tillë është rasti p.sh. i fjalës *kazan kazane* (GIOR. 186), që nuk është një turqizëm i trashëguar e që nuk haset në gjuhën e folur, por që është regjistruar për herë të parë në një poezi të Nilo Catalanos, i cili siç dihet, i njihte mirë të folmet gege e u ndikua në veprat e tij edhe nga veprat e autorëve të vjetër gegë. Këtij lloji huazimi “libror” u përkasin turqizmat *yar -i, adet -i, bori -a, isap -i hesap, hambar -i, majdan -e, penxher -i*, etj., të gjitha të dëshmuara në veprat letrare të autorëve arbëreshë të shek. XIX (De Rada, Santori, Dara dhe Schirò). Madje veprat e Zef Skiroit sidomos ato që u shkruan pas vitit 1900, përmbajnë një numër të konsiderueshëm turqizmesh që ai i mori qoftë nga burime të shkruara shqiptare, qoftë edhe nga njohja e drejtpërdrejtë e shqipes së folur gjatë periudhës që poeti kaloi në Shqipëri.

c) *përmes greqishtes*. Për mendimin tonë do të ishte me vend shqyrtimi i rolit që, për arsye historiko-kulturore dhe gjeografike, ka luajtur greqishtja, në formimin e leksikut të të folmeve arbëreshe. Disa turqizma që dëshmohen në këngët popullore arbëreshe, si p.sh.. *cohë -a* dhe *janicar -i* ‘jeniçer’, kanë hyrë përmes greqishtes. Shpjegimi i Çabejt për këto raste është i mbështetur, sepse kalimi $\zeta /tʃ/ > c /ts/$, haset rregullisht në huazimet turke të greqishtes (khs. *cohë* < gr. τσόχα < turk. çohë, arb. *Janicer -i* < gr. λενιτσόρος < turk. yeniçer)²². Në *Fjalorin* e Da Lecces dëshmohet *cohë*, ndërsa në shqipe është ruajtur afrikatja *jeniçer*. Në këtë grup fjalësh që kanë kaluar në arbërishte përmes greqishtes hyjnë edhe *sundug* e *manusaqe* ku kemi palatalizimin e velares *k* të ndjekur nga zanorja *i* tipike për greqishten σεντοῦκι μανουσακι. Përmes greqishtes mund të kenë hyrë edhe të tjera turqizma në shqipe sidomos në ato të folme toske prej nga, sikurse dihet, vjen pjesa më e madhe e ngulimeve arbëreshe të Italisë. Të tilla duket të jenë *fital* gr. φιτίλι, *daul* ‘tamburo’ gr. νταούλι, *gajtan* ngr. γαϊτάνι, *dufek*, gr. τουφέκι. Nga ana tjetër disa greqizma si *qeramidhe* në arbërishte kanë hyrë drejtpërdrejt nga greqishtja, ndërsa në Shqipëri, sidomos në viset gege, ka hyrë përmes turqishtes, siç dëshmohet nga forma *hijeremī* që del te *Fjalori* i Da Lecces.

d) *përmes turqishtes para shpërnguljes së arbëreshëve*. Është fjala për turqizma që nuk mund shpjegohen ndryshe. Arb. *narënxë* ‘portokall, nerënxë’ vjen drejtpërdrejt nga turqishtja pa kaluar përmes

²² Shih E. ÇABEJ, *Për një shtresim*, cit., f. 276.

sicilishtes (sicilishtja e shek. XV kishte *araniu*, që Ambrosini propozon me të drejtë të lexohet /aran ġiu/ nga arabishte-persishtja *nā-ranġ*²³). Fjalë si *sahat* ose *çarap* – e para e dëshmuar, sipas *Fjalorit* të Giordano-s, vetëm në të folmen e Horës së Arbëreshëve dhe e marrë nga Schirò – mbijetojnë në disa shprehje të ngurtësuar: *isht'e jep sakat* ~ *sahat* ‘po jep shpirt’ dhe *çarapudhjar*, -e përbërë nga *çarap* (këtu me kuptimin ‘këpucë’) + *udhjar*, ‘që është në udhëtim, që udhëton gjithmonë’ (nga *udhë*), por me kuptimin ‘ngatërrestar’ (ai që i bën gjërat çorap)²⁴; *tumacë* ‘lloj makaronash shtëpie’ (GIOR. 507 ‘pasta di casa, maccheroni’) nga turk. *tutmaġi* (që haset edhe sot në çamërishte, *tumaca*, -t²⁵); *arap* (dëshmuar në Kodikun e Kieutit), *hajat*, që haset në të folmen e Shën Mitrit në formën *ghalt*, janë ndër turqizmat më të vjetër në shqipe. E pasigurt duket prejardhja turke e fjalës l’arb. *barrë* ‘njësi peshe’, ende e gjallë në Horën e Arbëreshëve, me të njëjtin kuptim që ka turqishtja *bâr*. Duke pasur parasysh vitalitetin e këtyre huazimeve dhe pa përrjashtuar një ndërmjetësim nga gjuhë të tjera ballkanike (si sllavishtja, greqishtja e sidomos rumanishtja), ka gjasa që këto të kenë hyrë në shqipe para shpërnguljes së arbëreshëve. Në këtë grup huazimesh studiuesit kanë përfshirë edhe turqizmat që mbloodhi Lambertz-i në Villa Badessa, por në fakt këto të fundit duhen dalluar nga ato që gjenden në të folmet e tjera arbëreshe, sepse ky ngulim arbëresh është relativisht i vonë. Banorët e tij u shpërngulën nga fshati Piqeras (Bregdeti i Poshtëm) në vitin 1744, pas një kontakti të gjatë me pushtuesit turq. Nëse e folmja e Villa Badessa-s është e dobishme për shtresimin e turqizmave në shqipe,

²³ Shih R. AMBROSINI, *Stratigrafia lessicale di testi siciliani dei secoli XIV e XV*, Biblioteca del Centro di Studi Filologici e Linguistici siciliani, I, Palermo, 1977, f. 48: “poiché ç...] le prime documentazioni di *narancia*, ovviamente voce non toscana né settentrionale, sono del XVI secolo, sembra credibile che l’assordimento di /n ġ / in /nć / si sia compiuto tra il XVIV secolo e il XVI secolo. Certamente esso è successivo all’introduzione dei prestiti arabi, pur con tutte le riserve che si possono fare circa la realizzazione fonetica dell’arabo *ġim*”. Shih edhe PELL. *Arab.* 186-187.

²⁴ Të vihet re edhe *ghajdhuri* i *Çarapanit* ku *çarap* është bërë emër vetjak, ndoshta nga një nofkë (të vihet re prapashtesa përbuzëse -an me të cilën në të folmen e Horës formohen emra përgjithësisht nga emra konkretë). Nofka *çarap* përdoret ende në Horë, por në gjendjen e sotme kuptimi i kësaj fjale është i errët.

²⁵ Shih Q. HAXHIHASANI, *Vështrim i përgjithshëm mbi të folmen e banorëve të Çamërisë*, in *Dialektologjia shqiptare*, II, Tiranë, 1974, f. 104.

ky nuk duket konsideruar si një kontribut i të folmeve arbëreshe *tout court*, të cilat dëshmojnë jo vetëm fazën më të vjetër të leksikut të shqipes, por edhe atë më pak të prekur nga ndikimi i turqishtes.

Për fat të keq ende nuk ka një inventar të plotë të turqizmave e të orientalizmave në arbërishte, por siç thoshte Çabej, ka të ngjarë që “me romanizimin progresiv të këtyre ngulimeve, me mënyrën e re të jetesës që nisën me kohë në mjedisin e ri e krejt të ndryshëm nga i pari, e me ndryshimin kulturor që erdhi nevojishtë në këto kushte, bashkë me disa elemente të leksikut shqiptar që sollën me vete, mund të jetë bjerrë dhe një pjesë e huazimeve turke”²⁶. Për mendimin tonë numri i turqizmave në arbërishte nuk do të ketë qenë shumë i lartë, sikurse edhe dëshmohet nga tradita shkrimore arbëreshe e shek. XVI. Kështu në veprën e Matrangës *E mbsuame e krështerë* e vitit 1592 nuk ka asnjë turqizëm, ndërsa te *Meshari* i Buzukut (1555) dëshmohen disa të tilla, që edhe pse të pakta në numër, përbëjnë një dëshmi domethënëse të depërtimit të turqizmave në shqipe pikërisht gjatë asaj periudhe. Kjo e dhënë, sado e rëndësishme, mbetet gjithsesi e pamjatueshme për të dalë në përfundime të sigurta rreth fillimeve të kësaj dukurie në shqipe. Në këtë kuptim, është ende aktuale nevoja që shtronte Çabej qysh në vitin 1975 për një shqyrtim më të thelluar e shterues të leksikut të të folmeve arbëreshe, që doemos mund të hedhë dritë të re në studimin e shqipes së shek. XVI e njëherazi mund të kontribuojë edhe në studimin e gjuhëve të tjera ballkanike.

²⁶ E. ÇABEJ, *Për një shtresim*, cit., f. 277.

Gjorgji BUFLI, Università degli Studi di Trieste

KONTAKTET NDËRGJUHËSORE BALLKANIKE NË RASTIN E TURQIZMAVE

Abstrakt

Në kuadrin e studimeve të ballkanistikës nuk mund të lëmë mënjanë turkologjinë, në veçanti për sa i përket interferencës gjuhësore të turqishtes me gjuhët e tjera të Ballkanit. Ky artikull i përket një hulumtimi timin mbi turqizmat e gjuhës shqipe, të ballafaquara me gjuhë të tjera ballkanike, që nuk do të paraqitet thjesht si një përditësim i veprave themelore të Tahir Dizdarit e të Norbert Boretzky-t, por edhe si një pjesë plotësuese e rëndësishme në kuadrin e projektit të *ardhshëm të një Thesaurus-i të ri (siç shprehet Matthias Kappler në artikullin e tij "Drejt një enciklopedie të re të turqizmeve ballkanikë", përmbajtur në Procese të konvergencës dhe të diferencimit në gjuhët mesjetare dhe moderne të Europës), pra të një azhurnimi dhe pasurimi të veprës madhore enciklopedike të Franz Miklosich-it Elementet turke në gjuhët e Europës Juglindore dhe Lindore*. Kumtesa përfshin pikat që vijojnë:

Induksion i morfemës:

Mbaresa "-çe", e pranishme në turqizma të mirëfilltë të shqipes dhe në ndajfolje ose mbiemra që kanë në rrënjë fjalë jo turke (fshatarçe, vendçe, alla shkodranchë, tironçe, kosovare,.

Fjalë të përbëra hibride,

Fjalë të përbëra që paraqesin vetëm pjesërisht material gjuhësor turk (gazepmadh, qametmadh, adetkeq).

Kalke shprehjesh turke:

"Alamet(e) kiametit" dhe shprehja turke "kıyamet alameti".

"Me marrë ibret" dhe shprehja turke "ibret almak".

Turqizma që simbas gjasës kanë hyrë mbas rënies së Perandorisë Osmane:

"Rrobdishamë, rrobdëshamë" dhe turqishtja "robdöşambr".

"Sytyen/ë, sutjen" dhe turqishtja "sütyen, sutyen".

Etimologji popullore:

"Mushmollë" dhe turqishtja "muşmula".

"Hagrep, agrep" dhe turqishtja "akrep".

Ndërhyrje turqizmesh mes gjuhësh ballkanike:

"Agëllek", "agallëk" dhe problemi i lidhur me serbokroatishten "agaluk".

"Rasë", "rast" dhe problemi i lidhur me turqishten "rast".

Raste të paqarta dhe përpjekjet për t'i shpjeguar:

*"Abolla", greqishtja epirote *μολάκι* dhe turqishtja "bolaki".*

"Ajna" dhe fjalët turke "ayna" dhe "ayni".

“Aklashit” dhe foljet turke ”aklamak, aklaşmak dhe haklaşmak”.

Në kuadrin e studimeve të ballkanistikës nuk mund të lëmë mënjane turkologjinë, në veçanti për sa i përket interferencës gjuhësore të turqishtes me gjuhët e tjera të Ballkanit. Kjo kumtesë mbështetet mbi materialin e mbledhur për një hulumtim në proces mbi turqizmat e gjuhës shqipe, të qasura me turqizma nga gjuhë të tjera ballkanike, si dhe mbi interreferencat ndërgjuhësore mes shqipes, turqishtes dhe gjuhëve të tjera. Ky hulumtim nuk do të paraqitet thjesht si një përditësim i veprave themelore të Tahir Dizdarit e të Norbert Boretzky-t, por edhe si një pjesë plotësuese e rëndësishme në kuadrin e projektit të ardhshëm të një *Thesaurus*-i të ri (siç shprehet Matthias Kappler në artikullin e tij “Drejt një enciklopedie të re të turqizmeve ballkanikë”, përmbajtur në *Procese të konvergencës dhe të diferencimit në gjuhët mesjetare dhe moderne të Europës*), pra të një azhurnimi dhe pasurimi të veprës madhore enciklopedike të Franz Miklosich-it *Elementet turke në gjuhët e Europës Juglindore dhe Lindore*.

Edhe nëse një pjesë e fjalëve që trajtohen janë të vjetëruara, të gjitha shërbejnë për të hedhur dritë mbi ndikimin historik të turqishtes në shqipe dhe në gjuhët e tjera të Ballkanit.

I. Induksioni i morfemës

“Huazimi” i morfemave nuk është thjesht një proces imitues, por është një proces që kërkon një qëndrim aktiv të folësit, i cili interpreton dhe shfrytëzon mjetet e vëna në dispozicion nga huazimet leksikore për të ripërtërirë mundësitë e tija shprehëse.

Gjuhëtari italian i mirënjohur Roberto Gusmani në veprën e tij *Studime mbi interferencën gjuhësore* nuk e konsideron induksionin e morfemës si një rast të mirëfilltë interference gjuhësore, megjithëse lind nga një kontakt ndërgjuhësor, por si një fazë të mëtejshme në të cilën folësi ripërpunon ose rishikon në mënyrë të pavarur materialin gjuhësor që disponon, pavarësisht nga origjina që ai mund të ketë.

Në shqipe kemi huazime nga turqishtja si p.sh. *adetçe* “simbas zakonit”, që ka të njëjtin kuptim edhe në turqishte. Mirëpo kemi edhe ndajfolje (që kalojnë edhe në klasën e mbiemrave) si p.sh. *fshatarçe*, *vendçe*, *tironçe*, *kosovarçe* që përfaqësojnë raste tipike induksioni të

morfemës, ku folësi shqiptar e ka përfshirë mbrapashtesën *-çe*, ndonëse me prejardhje turke, në bagazhin e tij gjuhësor dhe e përdor edhe me fjalë jo turke.

Një rast i ngjashëm është ndajfolja *alla shkodrançe*, ku “*alla*” na kujton italishten. Por këtu mund të kemi ndërmjetësimin e turqizimave *allaturka* e *allafranga* (< tur. *alaturka* “simbas mënyrës turke” dhe tur. *alafranga* “simbas mënyrës europiane”, me origjinë nga italishtja *alla turca* dhe *alla franca*).

II. Fjalë të përbëra hibride

Bëhet fjalë për kompozita të shqipes që paraqesin vetëm pjesërisht material gjuhësor turk:

Gazepmadh, *-i* (em.m./mb.) – njeri që ankohet për gjënë më të vogël.

< tur. *gazep*, *gazap* – zemërim, mëri, nevrkosje (+ shq. *madh*).

• arum. *găzepi*; gr. γαζέπι; srbkr. *gazap*, *gazab*, *gazep* – edhe me kuptimet: mot i keq, katastrofë natyrore; hakmarrës; i mallkuar; fatkeq, derëzi (Nosić, fq. 261); bullg. газеп, казеп (dial.) – me shumë piper; i egër, i keq (DTB, f. 46); maq. газеп.

Qametmadh, *-i* (em.m./mb.) – njeri që hidhërohet shumë, që bind dheun kur hidhërohet.

< tur. *kıyamet* – 1. dita e fundit të botës (kur të vdekurit ringjallen); 2. katastrofë; 3. rrëmujë, zhurmë, trazirë (+ shq. *madh*).

• gr. κιαμέτι; srbkr. *kijamet* – edhe me kuptimet: grumbull njerëzish që bëjnë zhurmë; mot i keq; ngut (Nosić, f. 385); bullg. каемет (dial.); maq. кијамет.

Adetkeq, *-i* (em.m./mb.) – njeri me vese.

< tur. *adet* – zakon, traditë (+ shq. *keq*).

• rum. *adet* – detyrim, taksë (Cioranescu, fq. 7); *adetiū* – edhe me kuptimin “taksë” (Șăineanu, fq. 7); (Mold.) *adetiū*; meglen. *adet*; arum. *adete*; gr. αντέτι; srbkr. *adet*, *hadet* – edhe me kuptimet: Ligj Islamik (që ndjek Kuranin); traditat e myslimanëve (Nosić, f. 10); bullg. адет, адет (dial.) – edhe me kuptimin “karakter” (DTB, f. 2); maq. адет.

► Fjalët *gazep*, *qamet*, *adet* janë të pranishme në mënyrë të pavarur në leksikon e shqipes, ashtu si dhe në gjuhët e tjera ballkanike. Modeli i fjalëformimit të kompozitave *gazepmadh*, *qametmadh* dhe

adetkeq respekton atë të shqipes, ashtu si në raste të tjera ku nuk kemi të bëjmë me turqizma, si p.sh.: *kryemadh* apo *shpirkeq*.

III. *Kalke shprehjesh turke*

III.1. *Shqipja “alamete kijametit” dhe turqishtja “kıyamet alametleri”*

Alamete kijametit (lok.) – shenjat e fundit të botës.

< tur. *kıyamet alametleri* (me të njëjtin kuptim).

► Lokucionet kanë rend të ndryshëm fjalësh sepse shqipja është gjuhë progresive (pjesa kuptim-mbajtëse e sintagmës emërore vjen përpara), ndërsa turqishtja është regresive.

Ky fenomen mund të konsiderohet si “huazim i maskuar”, siç e quan Gusmani. Megjithatë vetë ai, në rastin e lokucioneve, duke e konsideruar shprehjen në tërësinë e saj, nuk e mohon mundësinë që ta konsiderojmë si një kalk nga shprehja bashkëpërgjegjëse turke.

Alamet – 1. (përdorim mb.) thekson lavdërueshmërinë e emrit që i vjen pas (dhe ky është kuptimi kryesor sot); 2. (em.m.) shenjë, ogur; 3. gjëmë, e keqe e madhe që i bëhet dikujt; 4. fjalë e rëndë, e pahijshme.

< tur. *alamet* – 1. shenjë (paralajmëruese), simbol; 2. i përbindshëm, i stërmadh.

• srbkr. *alamet* – shenjë, simptomë (Škaljić, f. 85); shenjë (paralajmëruese), ogur; ngjarje; rast i përshtatshëm; stuhi, mot i keq; mallkim (Nosić, f. 27); bullg. (dial.) *аламет* – vështirësi, telash; ngjarje, rast; (dial.) *алимет, њлимет* – stuhi (DTB, f. 7).

Shqipja *kijamet*, *qamet*, *kiamet*, *kjahmet* ka si kuptime: 1. (em. m.) fundi i botës, dita kur ngjallen të vdekurit në Gjyqin e fundmë; 2. fatkeqësi e madhe, katastrofë, përmytje; 3. plym; 4. (ndajf.) tejet, jashtëzakonisht, hatashëm.

► Dizdari përmend edhe një variant të dyfishuar *qameti qameti* “në maksimum, shumë shumë, në rastin më të keq”.

Për sa i përket përdorimit mbiemëror të *alamet* dhe *kiamet* (si dhe *goxha/koxha* < tur. *koca*), pozicioni përpara emrit nuk përfaqëson një rast tipik të shqipes (janë të rralla përdorimet si “i madhi Çabej”, “e dashur Enkelejda”), ndërkohë që në turqishte këta mbiemra paraprijnë rregullisht emrin.

III.2. “*Me marrë ibret*” dhe turqishtja “*ibret almak*”

Me marrë ibret (lok.) – zë mend, mësoj nga një gabim.

< tur. *ibret almak* – edhe me kuptimet: marr (diçka) si paralajmërim; marr shembull.

► Këtu kemi një përkthim të pjesshëm: *ibret* është marrë nga turqishtja, i favorizuar nga fakti që ekziston në shqipe si element i parvarur. Ndërsa folja turke *almak* është përkthyer. Është e qartë interferenca e turqishtes *ibret almak* (në veçanti për sa i përket kuptimit “me marrë shembull”) me gjuhë të tjera si it. *prendere esempio*, angl. *to take example* etj. Megjithatë, shq. *me marrë ibret* ka njëfarë distance nga shq. *me marrë shembull* për faktin që e para lidhet me shembullin apo mësimin nga një gabim, nga një e keqe, që është edhe kuptimi kryesor i turqishtes.

Ibret (em.m.) – 1. pamje e shëmtuar; 2. neveri; 3. njeri i shëmtuar; 4. lemeri; 5. (ndajf.) si mos më keq, në mënyrë të shëmtuar.

< tur. *ibret* – 1. mësim (nga një fatkeqësi); 2. fatkeqësi që shërben si parandalim; 3. paralajmërim; 4. (goj.) i çuditshëm, i shëmtuar.

• arum. *ibrete* – shembull (lemerie); lemeri (Papahagi, f. 570); gr. *μπρέτι* – shembull (Koukkidis, fq. 37); srbkr. *ibret* – mësim; shembull; çudi (Škaljić, f. 338); paralajmërim; masë njerëzish, kallaballëk; tallje; njeri që meriton të tallet (Nosić, f. 312); bullg. *ибрет* (dial.) – shembull; përbindësh, gogol (DTB, f. 99).

IV. *Turqizma të mundshëm që simbas gjasës kanë hyrë mbas rënies së Perandorisë Osmane*

Rrobdisham/ë, -a, rrobdëshamë, rrobdyshamë, robdisham, robdëshambër (em.f.) – rrobë shtëpie; rrobë banje (peshqir i madh).

< tur. *robdöşambr*.

► Në origjinë kemi të bëjmë me një galicizëm (nga fr. *robe de chambre*), ku mund të jetë bërë ndërmjetëse turqishtja *robdöşambr*.

Një tog bashkëtingëlloresh *-mbr* është i pazakontë në turqishte. Në këto raste nevojiten elemente zanore mes bashkëtingëlloreve. Fakti që kjo formë galicizmi turk nuk ka pësuar ndryshime të mëtejshme dëshmon hyrjen e saj relativisht të vonë në gjuhën turke. Në fakt, kjo fjalë nuk është e dokumentuar në turqishte para viteve '30.

Sytjen, -i, sutjen (em.m.), *sutjen/ë, -a* (em.f.) – gjoksmbajtëse, gjimmbajtëse, rrexhipet.

< tur. *sütyen, sutyen*.

► Në rastin e galicizmit tjetër *sytjen, sutjen* (< tur. *sütyen, sutyen* < fr. *soutien-gorge*), fakti i ndërmjetësimit të turqishtes qartësohet nëpërmjet një dëshmie fonetike: zanores *y*. Varianti turk *sütyen* është i dokumentuar mirë dhe mbizotërues. Ai ndjek ligjet e harmonisë vokalike turke, në bazë të së cilave zanorja *e* në rrokjen e dytë shkakton anteriorizimin (ose përparësimin) e zanores së rrokjes së parë: pra, në kalimin nga frëngjishtja në turqishte, për shkak të *e*-së, *u*-ja bëhet *ü*. Kështu, turqishtja *sütyen* lidhet drejtpërdrejt me shqipen *sytjen* (*y = ü*).

Edhe nëse pranohet mundësia që këto galicizma të jenë përdorur në gjuhën e folur shumë kohë para se të dokumentoheshin me shkrim, gjithsesi mund të konfirmohet njëfarë vazhdimësie e ndikimit të turqishtes në shqipe edhe mbas rënies së Perandorisë Osmane.

V. Etimologji popullore

V.1. Turqishtja “*muşmula*” dhe varianti i shqipes “*mushmollë*”

Mushmoll/ë, -a, mushmull/ë (em.f.) – *Mespilus germanica*.

< tur. *muşmula*.

• rum. *moşmol, moşmon* (pema); *moşmoală, moşmoană, moşmulă, muşmulă* (fryti) (Cioranescu, fq. 540); arum. *muşmoală, muşmulă* (fryti); *muşmuleŭ* (pema) (Papahagi, fq. 720); gr. *μούσμουλο*; srbkr. *mušmula, mušmulja*; bullg. *мушмула, мушмала* (dial.), *мушмул, мошмул*; maq. *мушмула*.

► Nuk ka ndonjë lidhje të qartë mes formave greke (gr. e vjetër *μέσπιλον*, gr. mesjetare *μούσπουλον*, gr. e re *μούσμουλο*) dhe atyre turke. Si rregull, tur. *muşmula* konsiderohet e prejardhur nga gr. *μούσμουλο*. Por ka gjuhëtarë si p.sh. Meyer (1893, fq. 33) të cilët e konsiderojnë gr. moderne *μούσμουλο* si një ri-huazim nga turqishtja. Në këtë mënyrë fjala turke identifikohet si e prejardhur nga format më të lashta të greqishtes. Po të pranohet këtë hipotezë, do të na duhej të pranohet edhe hipotezën tjetër sipas së cilës asimilimi *p > m* është zhvilluar në turqishte e jo në greqishte.

Disa interpretime të mundshme në lidhje me formimin dhe kuptimin në gjuhën shqipe:

a) Etimologji popullore (paretimologji) “e pjesshme”: në fjalën *mushmollë* mund të dallojmë lehtë fjalën *mollë*.

b) “Mollë e mbushur, e mbufatur” (etimologji popullore): *mush* mund të jetë identifikuar me foljen *mbush*, ku *b*-ja nuk është shqiptuar, siç ndodh në disa raste me gegnishten: *mbrapa-mrapa*; *mbrëmje-mramje*, *këmborë-kumonë*, *këmbë-kamë* etj.

Në fjalorin e Cordignano-s (1938) gjejmë sinonimin *mollë-muç/e,-ja*, i pranishëm edhe në FGJSSH (1980). Por fjala *muçe* mungon. Atë e gjejmë tek fjalori i Elezit (2006) me kuptimin “gomar”. Është vështirë të mendohet që *mollëmuçja* të ketë lidhje me veshët e gomarit për shkak të formës së gjetheve të saj. Elezi jep edhe kuptimin “grumbull bari që i qitet lopës”, ku shton edhe variantin *muç*. Vështirë të ketë lidhje me foljen *muçit* “bëj mu”, ngaqë kjo e fundit është tingullimituese. Por *muç/muçe* mund ta ketë prejardhjen nga venecianishtja *mucio* “grumbull”.

Ekziston një folje vetvetore *muçitem* “ënjtem, fryhem, mbufatem” (FGJSSH 1980, fq. 1178), e cila mund ta vërtetojë tezën e *mollës* së mbufatur, por duke patur parasysh gjithnjë mundësinë e një ndikimi kuptimor reciprok mes foljes *muçitem* dhe lopës që ngopet duke ngrënë në *muçen* (ose *muçin*) e barit.

Pra, me sa duket tur. *muşmula* është reinterpretuar në shqipe si *mushmollë* (ndërsa varianti *mushmullë* është një turqizëm i mirëfilltë), duke i dhënë këtij turqizmi një kuptim të mundshëm që nuk gjendet në gjuhën turke: *mollë* e fryrë, e mbushur.

Përveç kësaj, Leotti (1937) jep variantin *muçmollë*, që nga njëra anë mund ta vërtetojë kuptimin “*mollë* e fryrë, e mbushur” por nga ana tjetër mund të jetë rezultati i një fenomeni fonetik *sh > ç* (fërkimore postalveolare e shurdhët > afrikate postalveolare e shurdhët) si p.sh. në variantet e fjalës së urtë “Sa të rrosh do të mësosh”/”Sa të rroç do (të) mësoç”, fenomen që mund të jetë i pranishëm ndoshta edhe në foljen *muçitem*, nëse kjo mund të vinte nga një variant hipotetik **m(b)ushitem*.

c) “Mollë e mbuluar me push” (etimologji popullore): fjalori i Gazullit (1941) jep fjalën *mush* me kuptimin “push” (Guri i Zi, Shko-

dër). Kjo çon në një tjetër reinteretim të mundshëm të mushmollës si “mollë e mbuluar me push”.

V.2. Turqishtja “akrep” dhe variantet “agrep” dhe “hagrep” në shqipe

Hagrep, -i, *agrep* (em.m.) – shkrap, sfurk, cfurkth.

< tur. *akrep*.

• srbkr. *akrep*, *jakrep*; bullg. ѝќрап (dial.) – insekt helmues (DTB, f. 111); maq. акреп – edhe me kuptimin e figurshëm “njeri i shëmtuar, dordolec” (RMJ, f. 8).

► Në këto variante me *g*, për shkak të një paretimologjie, është i mundshëm ndikimi i fjalës *grep*, ndoshta në lidhje me thumbin e akrepit. Në fakt Dizdari jep edhe variantin *grep* me kuptimin “akrep”.

Për sa i përket variantit *hagrep*, Gazulli në fjalorin e tij e interpreton si *ha-grep* “që han grepin”, ndoshta në lidhje me legendën sipas së cilës ky araknid thumbon vetveten kur është i rrethuar nga flakët.

VI. Interferenca turqizmesh mes gjuhëve ballkanike

VI.1. Fjalët shqipe “agallëk”, “agëllek” dhe serbokroatishtja “agaluk”

Agallëk, -u, *agallek* (m.n.) – 1. gjendja e të qenit apo e të jetuarit si një aga; 2. (keq.) sjellje prej agai.

< tur. *ağalık* – 1. të qenit aga; 2. bujari; 3. fisnikëri.

• srbkr. *agaluk* – si në shqipe; edhe me kuptimet: pasuria, prona e agait (Škaljić, f. 73); pjesa e të ardhurave që shërbëtorët duhet t’i japin agait; autokraci, përdorim i dhunës në ushtrimin e pushtetit të agait (Nosić, fq. 14); bullg. агалѣк – bollëk; bujari; të gjithë turqit në një vend apo situatë të caktuar, të konsideruar si një trup i vetëm; алѣк (dial.) – krenari (DTB, f. 2, 8); maq. агалак – fisnikëri; arrogancë; pasuri, pronë (RMJ, fq. 5).

► Kuptimet e turqishtes “bujari” dhe “fisnikëri” i ka përkatësisht edhe bullgarishtja dhe maqedonishtja.

Agëllek, -u, *agllik*, *agllok* (m.n.) – para që i jepen nuses si pajë nga dhëndri.

< tur. *ağırılık* – 1. barrë, bagazh; 2. (tur. krahinore) para që i jepen nuses si pajë nga dhëndri; bizhuteri.

• rum. *agarlık, argalık, aǧarlık, angarlık* – bagazh (Cioranescu, f. 12); srbkr. *agrluk, agaluk*; bullg. агърлък, агарлък, аглък.

► Turqishtja krahinore, serbokroatishtja dhe bullgarishtja kanë të njëjtin kuptim me shqipen.

Shqipes *agallëk* i përgjigjet serbokroatishtja *agaluk* (me të njëjtin kuptim të shqipes, por edhe me kuptimet “pasuria, prona e agait”, që i ka edhe maqedonishtja). Ndërsa në rastin e shqipes *agëllek*, serbokroatishtja jep *agrluk* dhe prapë formën *agaluk*, por në këtë rast me një kuptim tjetër. Mund të themi që sikurse *agallëk*, ashtu edhe *agëllek* kanë të bëjnë kryesisht me aspekte të lidhura me mireqenien ekonomike. Kjo ngjashmëri semantike mes dy turqizmeve mund të ketë kushtëzuar përkimin formal në srbkr. *agaluk*. Duhet konsideruar edhe fakti që shq. *agëllek* mund të identifikohet lehtë me shq. *agallëk* për shkak të një etimologjie *agë* (një variant i *aga* gjithnjë në trajtën e pashquar) + *-llek*, që në disa raste (si p.sh. në gegnishte) zëvendëson sufiksin *-llëk* (< tur. *lık*).

Rënia e *r-së* në shq. *agëllek* dhe srbkr. *agaluk* tregon që njëra prej këtyre gjuhëve mund të jetë ndërmjetëse për tjetrën, në lidhje me turqishten *aǧırlık*.

Në rastin e rumanishtes *argalık* dhe *angarlık* mund të identifikohen interferencat përkatësisht me turqishten *argat, ırgat* “punëtor në bujqësi; punëtor në ndërtim” (shq. *argat* “punëtor krahu në bujqësi, që punon me mëditje; bujk që vinte të ndihmonte një bujk tjetër pa shpërblim”) dhe tur. *angarya* “punë e detyruar pa shpërblim; hamallëk” (shq. *angari* edhe me kuptimin “barrë, punë që bëhet pa dëshirë, që nuk sjell kënaqësi apo dobi”), të dyja koncepte që lidhen me punë të rënda.

VI.2. Fjalët shqipe “rasë”, “rast” dhe turqishtja “rast”

Ras/ë, -a (em.f.) – 1. rasë gramatikore; 2. rast; 3. rrethanë.

Rast, -i (em.m.) – 1. rrethanë; 2. mundësi; shans; 3. shkak, arsye.

< tur. *rast* – shkak; rrethanë; rast.

< tur. *rast gelmek* – me takue rastësisht dikë.

• arum. *araste* – rast, moment i përshtatshëm (Papahagi, f. 128); gr. *ράστι, ράστ'* – rastësi, shans; rrethanë; rast; ngjarje, takim rastësisht (Koukkidis, fq. 79).

► Sot, *rasë* përdoret kryesisht me kuptimin “*rasë gramatikore*”, ndërsa me kuptimin “*rast, shans*” mbijeton në ndonjë përdorim të rrallë në gjuhën e folur. Ajo me siguri ka patur një përdorim më të gjerë në gegnishte. E gjejmë në formën arkaike të tekstit të lutjes katolike “*Puna e Pendimit*”, në veprën letrare të Haki Stërmillit “*Sikur t’isha djalë*” e kështu me radhë.

Në studimet e Çabejt (2002) fjala *rasë* konsiderohet njësoj me tur. *rast*, por në variantin pa *-t*. Për këtë ai jep si shembull variantet me *-t* dhe pa *-t* të ndajfoljeve turke *rasgele, rastgele* “*rastësisht, kuturu*”. Sipas tij, ajo shfaqet për herë të parë në Fjalorin Shqip-Latinisht të Atë Jungg-ut (1895) në formën *ras-a* “*mundësi, shans*”. Sipas Çabejt, *rasë* me kuptimin “*rasë gramatikore*” dhe *casus* (si p.sh. te *tri rasa tifoje; në çdo rasë*) ka mundësi ta ketë prejardhjen kuptimore prej it. *caso*, fr. *cas*, it./lat. *cadere*, gjerm. *Fall*. Ashtu si p.sh. it. *caso* lidhet me paskajoren *cadere*, kështu kleri i Shkodrës në periudhën pas Meyer-it dhe Jungg-ut mund ta ketë lidhur fjalën *rasë* me paskajoren e gegnishtes *me ra*. Prandaj Fjalori i Ri i Gjuhës Shqipe i Shoqërisë Bashkimi (1908) është i pari që jep kuptimin “*rasë gramatikore*”.

Por diku tjetër Çabej (1976, 1987) jep një seri fjalësh shqipe në variantet me *-t* dhe pa *-t*: *ças/çast, bas/bast, mes/mest* (ndajf.), *kosa/kosra/kostra* “*kosë; e korrë; gërshet flokësh*” dhe *(i, e) djathtë < (i, e) djathët/ë < (i, e) djathë*. Ai e shpjegon praninë e shkronjës *t* si një karakteristikë fonetike të shqipes ose si një mbetje të *rasës* së vjetër lokative. Duke përjashtuar variantet *ras/ë* dhe *rast* nga lista e këtyre fjalëve, ai përjashton mundësinë që *t*-ja në variantin *rast* të mund të jetë perceptuar si një epitezë e shqipes. Duhet marrë parasysh edhe fakti që në Fjalorin Shqip-Anglisht të Stuart Mann-it (1948) kemi variantin tjetër *rasje* “*rast, shans*”.

Mbetet për të shqyrtuar si mund t’i krahasojmë variantet *rasë, rasje* dhe *rast* me njëra-tjetrën, duke patur parasysh edhe turqizmat *bas/bast*. Gjithashtu, mbetet për të shqyrtuar si mund t’i përjasim variantet e mësipërme me fjalë ku zakonisht variantet pa *t* vijnë nga gjuhë të ndryshme: *ças/çast* (sllavizëm), *mes/mest* (greqizëm), *kosa / kosra* (sllavizëm) dhe *i djathtë/i djathë* (me trashëgimi indo-europiane).

VII. Ndonjë rast tjetër i paqartë dhe përpjekjet për ta shpjeguar

VII.1. Shqipja “*abolla*”, greqishtja epirote *μολάκι* dhe turqishtja “*bolaki*”

Abolla (lidh.) – kështu që; ashtu që.

► Bëhet fjalë për një lidhëz krahinore të vjetëruar të gegnishtes.

Simbas Meyer-it (1891, fq. 1), pjesa *-olla* përmban mënyrën dëshirore të vetës së tretë njëjës të foljes turke *olmak* “me u bâ, me qenë”, ku hyn edhe tur. *olaki* “që të”, ndërsa pjesa *ab-* mbetet e errët.

Simbas Çabejt (1976), *a*-ja nistore mund të jetë pjesëza pyetëse *a*, në ndonjë fjali pyetëse të përdorur si qëllimore (si p.sh.: *do të përpiqem a mund të...*). Simbas tij, pjesa *-bolla* nuk mund të ndahet nga gr. e re e Epirit *μολάκι* “n’ dashtë Zoti; mbase”, e cila në *-ki*-në fundore duhet të përmbajë turqishten *ki* “që”. Në këtë mënyrë, shpjegimi i fjalës së shqipes e të greqishtes dialektore nga tur. *olmak* dhe *olaki* paraqitet mjaft bindës, vetëm se *b*-ja nistore mbetet e paqartë për Çabejn.

Në të vërtetë, edhe *b*-ja nistore është krejt e qartë. Variantet *bolaki*, *bolayki* dhe në veçanti *bola ki* “nëse do Zoti; sa do të doja” janë të dokumentuara mirë në osmanishte, ashtu si dhe në turqishten dialektore të sotme. Rrjedhimisht gr. *μολάκι* e ka origjinën tek turqishtja dhe etimologjinë e shqipes *abolla* mund ta formulojmë si vijon: *a-* + *bola (ki)* domethënë pa *ki* në fund.

VII.2. Shqipja “*ajna*” dhe turqishtja “*aynı*”, “*ayna*”

Ajna (ndajf.) – në mënyrë të përkryer, shkëlqyeshëm.

< tur. *ayna* – 1. pasqyrë; 2. i lëmuar dhe i shkëlqyeshëm si pasqyrë, pa asnjë njollë; 3. (dial.) i shkëlqyeshëm, i përkryer, i përsosur.

• srbkr. *ajna* – pasqyrë (Škaljić, fq. 77).

► Simbas Dizdarit, është përdorur në Shkodër në shprehjen *me e ba ajna (diçka)* “me mësue me e ba diçka shkëlqyeshëm falë ushtrimit, përvojës etj.”. Ai përmend gjithashtu një variant me metatezë *ajan*, me kuptimin “qartë”.

Dizdari sugjeron si krahasim tur. *aynı* “i/e njëjtë, njësoj”, por origjina duhet kërkuar në tur. *ayna*, që ka kuptimet: pasqyrë; i lëmuar dhe i shkëlqyeshëm si pasqyrë, pa asnjë njollë. Megjithatë, turqishtja

dialektore *ayna* ka kuptimin “i shkëlqyeshëm, i përkryer, i përsosur”, duke u lidhur kështu drejtpërdrejt me shqipen.

VII.3. Shqipja “*akllashit*”, “*akllashname*”, bullgarishtja *аклъшмак* dhe turqishtja “*aklamak*”, “*aklaşmak*”, “*haklaşmak*”

Akllashit (fol.) (Veri-Lindje e Kosovës) – sqaroj, zgjidh (në bazë të derivateve që jep Dizdari).

► Dizdari jep dy mundësi prejardhjeje për këtë folje:

< tur. *aklamak* – 1. me zbardhue; 2. me pikëluë me të bardhë; 3. me pastrue; me shlye (ku vërejmë komponentin turk *ak* “ngjyra e bardhë; i pastër”).

< tur. *haklaşmak* – me i dhanë hak njani-tjetrit; me qërue hesapet.

Nëse origjina e shqipes është turqishtja *haklaşmak*, atëherë në shqipe kemi një rënie të spirantes nistore *h*. Rënien e *h*-së e kemi edhe në bullgarishten *аклъшмак* “rregullim, ndreqje” (DTB, fq. 5), e cila mund të jetë ndërmjetësja për shqipen. Ndërsa kjo e fundit ndërron mbaresën *-mak* të turqishtes me shq. *-it*, duke dhënë *akllashit*.

Derivate:

(*i, e*) *pakllashitun* (mb.) – i paqartë.

akllashnam/e, -ja (em.f.) – 1. konfirmim; 2. siguri; 3. bindje.

► Vërejmë sufiksin tur. *name* (< pers.) që dikur në gjuhën turke kishte kuptimin “letër; çertifikatë, dokument”, por sot përdoret vetëm për të formuar fjalë të përbëra. Simbas Dizdarit, trajta pësore *aklaşmak* “zbardhem, zbardhohem”, nuk figuron në fjalorë në mënyrë që të jepte temën *aklaş* me sufiksin *-name*.

Duhet thënë që jo të gjitha trajtat e foljeve apo kompozitat me një sufiks të caktuar gjenden në fjalorë. Edhe po nuk u gjenden, nuk do të thotë gjithmonë që nuk ekzistojnë. Në fakt, trajta pësore *aklaşmak* sot është e dokumentueshme. Për ta sqaruar më mire këtë pikë, le të marrim shembujt e kompozitave *ispatname* dhe *zabitname* që jep Dizdari. Për faktin që ai nuk i ka gjetur as këto në fjalorët që ka konsultuar, supozon që ato të jenë sajime të brendshme të shqipes. Por *ispatname* është e dokumentuar me kuptimin “dëshmi” (si në shqipe) në gjuhën ujqure, gjuhë turkike që, pavarësisht nga largësia gjeografike, ka qenë historikisht e ndikuar nga leksiku i turqishtes. Ndërsa *za-*

bitname ekziston në turqishte me kuptimet: proces-verbal i një mble-dhjeje; process-verbal i gjykatës; dosje policie. Për shqipen, Dizdari jep kuptimet që vijojnë: kompetencë qeverimi; mandat ekzekutimi që i jepej një të parit në mbarështim të vendit, ose një oficerit komandues në një ekspeditë në një krahinë të caktueme; trupi gjykues dhe ekzekutues në ngatërresa të mëdha e ndër gjaqe.

Bibliografia

- Alderson A.D., İz F. (1984). *The Oxford Turkish-English dictionary*. New York: Oxford University Press.
- A.SH.R.P.S.SH. (1980). *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*. Tiranë: Akademia e Shkencave e R.P.S. të Shqipërisë. Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë.
- Bonelli L. (1939). *Lessico turco-italiano*. Roma: Istituto per l'Oriente.
- Boretzky N. (1975-1976). *Der türkische Einfluß auf das Albanische*. I-II, Wiesbaden: Harrassowitz.
- Cioranescu A. (1958). *Diccionario etimológico rumano*. Tenerife: Universidad de La Laguna.
- Cordignano F. (1938). *Dizionario italiano-albanese*. Scutari: Tipografia dell'Immacolata.
- Çabej E. (1976, 1987, 1996, 2002, 2006). *Studime etimologjike në fushë të shqipes II, III, IV, VI, VII*. Tiranë: Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë. Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë.
- Demiraj Sh. (2004). Rreth huazimeve turke në gjuhën shqipe. Në *Studime filologjike* 3-4. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 19-28.
- Devellioğlu F. (1962). *Osmanlica-Türkçe ansiklopedik lûgat*. Ankara: Doğuş Ltd. Şti. Matbaası.
- Dizdari T.N. (2005). *Fjalor i orientalizmeve në gjuhën shqipe*. Tiranë: AIITC.
- Elezi M. (2006). *Fjalor i gjuhës shqipe*. Tiranë: Enti Botues "Gjergj Fishta".
- Gazulli N. (1941). *Fjalorth i rí. Fjalë të rralla të përdoruna në Veri të Shqipërisë*. Tiranë: Çabej.
- Grannes A., Rå Hauge K., Süleymanoğlu H. (2002). *A dictionary of Turkisms in Bulgarian*. Oslo: Novus Forlag. The Institute for Comparative Research in Human Culture.
- Gusmani R. (1981, 1983). *Saggi sull'interferenza linguistica I, II*. Firenze: Casa Editrice "Le Lettere".
- Јашар-Настева О. (2001). *Турските лексички елементи во македонскиот јазик*. Скопје: Институт за Македонски Јазик "Крсте Мисирков".
- Karpler M. (2000). Verso un nuovo Thesaurus dei turchismi balcanici. Në *Processi di convergenza e differenziazione nelle lingue dell'Europa medievale e moderna*. Udine: Forum Edizioni, 157-194.
- Κουκκίδης Κ. (1960). *Λεξιλόγιον ελληνικών λέξεων παραγομένων εκ της τουρκικής*. Αθήνα: Εταιρείας Θρακικών Μελετών.
- Leotti A. (1937). *Dizionario albanese-italiano*. Roma: Istituto per l'Europa Orientale.
- Mann S. (1948). *A historical Albanian-English dictionary*. London: William Clowes and Sons.
- Meninski F.M. (1680). *Thesaurus linguarum orientalium turcicae, arabicae, persicae, 3 voll.* Wien: "Shtypshkronja e Meninski-t".

- Metaj I. (2009). *Orientalizmat. Shtrirja leksiko-semantike në gjuhën shqipe*. Prishtinë: Drenusha.
- Meyer G. (2007). *Fjalor etimologjik i gjuhës shqipe*. Tiranë: Çabej.
- Meyer G. (1893). *Türkische Studien. I. Die griechischen und romanischen Bestandtheile im Wortschatze des Osmanisch-Türkischen*. Wien: Sitzungsberichte der Kais. Akademie der Wissenschaften.
- Miklosich F. (1884-1890). *Die türkischen Elemente in den südost- und osteuropäischen Sprachen I-IV*. Wien: Denkschriften der Kaiserlichen Akademie der Wissenschaften.
- Ndreca M. (2007). *Fjalor fjalësh të huaja në gjuhën shqipe*. Tiranë: Toena.
- Newmark L. (1999). *Albanian-English dictionary*. New York: Oxford University Press.
- Nosić M. (2005). *Rječnik posuđenica iz turskoga jezika*. Rijeka: Maveda.
- Papahagi T. (1963). *Dicționarul dialectului aromân. General și etimologic*. București: Editura Academiei Republicii Populare Romîne.
- Rocchi L. (2009). *Il lessico turco nell'opera di Bernardino Pianzola*. Trieste: Edizioni Università di Trieste.
- Șăineanu L. (1885). *Elemente turcești în limba română*. București: Tipografia Academiei Române (Laboratorii Români).
- Škaljić A. (1985). *Turcizmi u srpskohrvatskom-hrvatskosrpskom jeziku*. Sarajevo: Svjetlost.
- Redhouse J.W. (1890). *A Turkish and English lexicon*. Constantinople: A.H. Boyajian.

Lindita XHANARI (LATIFI), Tiranë

PËR NJË FJALOR TË TURQIZMAVE BALLKANIKE

Abstrakt

Historikisht gjuhët e Ballkanit kanë dhënë e kanë marrë me njëra-tjetrën. Ndikimet gjuhësore ndërmjet tyre kanë qenë thjesht të karakterit lokal e të kufizuara në dialektet kufitare. Në dallim nga këto ndikime, huazimet turko-orientale janë të përhapura në mënyrë aq uniforme në të gjitha gjuhët e Ballkanit, sa që një numër i konsiderueshëm i tyre mund të përcaktohet si ‘Turqizma ballkanike’, për shkak të ekzistencës së tyre në pothuajse të gjitha gjuhët e Ballkanit. Për këtë arsye do të ishte me vlerë që në kuadrin e Gjuhësisë Ballkanike të bëhej evidentimi i huazimeve të përbashkëta turko-orientale nëpërmjet një Fjalori të Turqizmeve Ballkanike. Një fjalor i tillë do të ndihmonte në përcaktimin e saktë të frazeologjive të përbashkëta ballkanike, pasi një pjesë e mirë e tyre kanë në përbërje huazime turko-orientale. Çështja e turqizmeve dhe orientalizmeve ka paraqitur gjithmonë interes për gjuhëtarët shqiptarë e të huaj. Në punimet e tyre është hedhur dritë për çështje që kanë të bëjnë me historikun e depërtimit të turqizmeve dhe orientalizmeve në gjuhë të ndryshme të Ballkanit, për faktorët që kanë luajtur rol në depërtimin e tyre, për klasifikimin semantik dhe për ndikime të karakterit gramatikor në gjuhët e Ballkanit. Turqishtja ka qenë një nga burimet më të rëndësishme të pasurimit të fjalorit të këtyre gjuhëve përgjatë 5 shekujsh. Pjesa më e madhe e leksemave turko-orientale jo vetëm u është përshtatur gjuhëve të Ballkanit, por edhe është kthyer në një përbërës natyral të gjuhëve të veçanta dhe asaj rajonale. Huazimet turko-orientale gjetën vendin e tyre brenda leksikonit të secilës gjuhë ballkanike dhe më pas vazhduan të jetonin në këtë sistem të ri gjuhësor, duke iu përshtatur veçorive të gjuhëve përkatëse. Risitë që u futën nga kultura turko-orientale sollën koncepte të reja. Kalimi në një mënyrë të re jetese, u shoqërua edhe me huazimin e fjalëve që e kishin ekuivalentin e tyre në gjuhën përkatëse. Edhe pse jo rrallë ekzistojnë ndryshime semantike e sidomos fonetike, fjalët që kanë hyrë në gjuhët e Ballkanit shekuj më parë, u huazuan në ato forma e kuptime që asokohe ishin më të përhapura. Fjalët e huazuara, pasi u pranuan, filluan jo vetëm të përvetësohen në masë nga ballkanasit, por edhe të përdoren dendur në jetën e përditshme shoqërore e administrative, e më pas filluan të përpunohen e t’u përshtaten këtyre gjuhëve. Ky është një reaksion zinxhir, që ka vazhduar për një kohë relativisht të gjatë. Një pjesë e mirë e korpusit të përbashkët ballkanik gjendet në fondin aktiv të gjuhëve të Ballkanit. Hartimi i Fjalorit do të përcaktonte jo vetëm korpusin e përbashkët ballkanik, por do të bënte edhe përjasjen kuptimore të huazimeve në gjuhë të ndryshme. Studimi i këtyre huazimeve, megjithëse jo në një terren të ri, mbetet ende joshtrues.

Organizimi i kësaj Konference shkencore përkoi me punën përgatitore që po bënim për hartimin e një projekti për një Fjalor të Turqizmeve Ballkanike. Për këtë arsye parapëlqeva të paraqitem me këtë kumtesë, pasi diktoj se megjithëse për huazimet nga turqishtja është folur shumë, përsëri kjo fushë studimi mbetet ende joshteruese.

Turqishtja ka qenë një nga burimet më të rëndësishme të pasurimit të fjalorit të gjuhëve të Ballkanit, gjatë 5-shekujve të dyndjes osmane. Të gjitha gjuhët e Ballkanit, ku më shumë e ku më pak, kanë dhënë e kanë marrë nga njëra-tjetra. Ndikimet në këto gjuhë kanë qenë thjesht të karakterit lokal dhe të kufizuara vetëm në dialektet kufitare. Në dallim nga këto ndikime, huazimet turke janë të përhapura në mënyrë aq uniforme në gjuhët e Ballkanit, saqë një numër i konsiderueshëm i tyre mund të përcaktohen si “*turqizma ballkanike*”.

Shembujt sporadikë të përdorimit të fjalëve të ardhura nga turqishtja në tekste të gjuhëve të ndryshme të Ballkanit (shqip, bullgarisht, serbisht, kroatisht, maqedonisht, greqisht, rumanisht) mund të gjurmohen që në fillimet e shekullit XV. Procesi i huazimeve nga turqishtja në këto gjuhë arriti kulmin në shekullin e XIX. Për ballkanasit turqishtja ishte gjuha e komunikimit brenda Perandorisë Osmane. Pjesa më e madhe e leksmeve turke jo vetëm u është përshtatur gjuhëve të Ballkanit, por edhe është kthyer në një përbërës natyral të gjuhës së përgjithshme dhe asaj rajonale. Fjalët e huazuara jo vetëm u pranuan në gjuhët e folura të Ballkanit, por edhe iu bashkëngjitën letërsisë, gjuhës së mësuar fetare, shkresave administrative dhe teksteve të tjera të shkruara. Rezultati natyral i kontaktit mes kombeve të ndryshme gjatë historisë është bashkëveprimi mes kulturave dhe gjuhëve të tyre. Me ardhjen e osmanëve në Ballkan, u vendos një sistem i ri shtetëror, një kulturë e re, një besim i ri fetar. Këto risi rezultuan të sillnin një ndryshim të madh në fushën sociale, ekonomike, edukative dhe kulturore në gjithë Ballkanin. Kjo kulturë e re mbizotëroi për shekuj me radhë. Feja dhe tradita të sjella nga turqit, me fjalë të tjera, stili i jetës që u fut prej tyre, u pranuan nga shumica e popujve të Ballkanit. Edhe pse turqishtja u pranua masivisht, dihet që ajo asnjëherë nuk u arkivua me statusin *lingua fatica*, pasi gjithë popujt e Ballkanit vazhduan të përdornin gjuhët amtare në jetën e përditshme. Statusi i turqishtes ishte krejtësisht i ndryshëm nga statusi i gjuhëve të tjera orientale, pasi arabishtja e persishtja ishin të kufizuara në disa fusha të jetës,

si: besimi, shkenca dhe edukimi (shkollimi), kurse turqishtja zuri vend në rutinën e përditshme si gjuhë që përdorej në institucionet qeveritare, në tregti dhe jetën shoqërore. Tregues i këtij ndikimi është numri i madh i fjalëve turke që u futën në gjuhët e popujve të Ballkanit. Risitë që u futën nga kultura turke, gjithashtu sollën koncepte të reja që deri aso kohe ishin të panjohura në ato zona. Deri atëherë nuk kishte fjalë në gjuhët amtare për këto koncepte të reja ose deri sa nuk u përfutuan fjalë, fjalët dhe terminologjia turke u transferuan në pothuajse të gjitha gjuhët e Ballkanit. Veç kësaj, kalimi në një mënyrë të re jete, u shoqërua edhe me huazimin e fjalëve turke, që tashmë ekzistonin në këto gjuhë. Me fjalë të tjera, u huazuan fjalë që e kishin ekuivalentin e tyre në gjuhët përkatëse. Kjo situatë përforcon faktin se procesi i huazimeve ishte i bazuar jo vetëm në arsye linguistike, por edhe në ato ekstralinguistike.

Megjithatë, elementet e huazuara turke, termat si dhe një numër i kufizuar prapashtesash, pavarësisht përdorimit të dendur në të gjitha gjuhët e Ballkanit, nuk kanë paraqitur asnjëherë ndonjë kërcënim për dështimin e esencës së tyre. Huazimet gjetën vendin e tyre brenda leksikonit të secilës gjuhë në të cilën u futën, dhe me pas vazhduan të jetonin në atë sistem të ri, duke iu përshtatur veçorive të gjuhëve përkatëse. Procesi i hyrjes së huazimeve turko-orientale, që ka zgjatur për afro pesë shekuj, paraqitet si një tablo shumëgjyreshë, që ngërthen në vetvete çështje: historike, kulturore, etnografike, letrare e gjuhësore. Këtu nuk bëhet fjalë thjesht për huazim fjalësh dhe kuptimesh që bartin ato në gjuhën nga hyjnë. Fillimisht gjuhët e Ballkanit, për shkak të rrethanave historike të ditura tashmë, kanë huazuar fjalë që shprehnin kuptime e nocione të panjohura më parë për to. Më pas, këto fjalë janë pranuar dhe kanë filluar të përvetësohen në masë, pasi përdorshin dendur në jetën e përditshme shoqërore e administrative. Pasi u pranuan, u përdorën e u përvetësuan, huazimet turko-orientale filluan të përpunohen e të pasurohen në gjuhët ballkanike. Ky është një reaksion zinxhir, që ka vazhduar për një kohë mjaft të gjatë. Po, në ç' masë u pranuan, u përvetësuan dhe u përpunuan këto huazime? Cili qe raporti i këtyre huazimeve nga njëra gjuhë në tjetrën dhe a i rezistuan shekujve në të njëjtën mënyrë, në të gjitha gjuhët ballkanike. Këto janë pyetje që mund të marrin përgjigje vetëm me hartimin e një Fjalori të Turqizmeve Ballkanike, i cili jo vetëm do të evidentonte korpusin ballkanik të huazimeve nga turqishtja, por do të saktësonte edhe problem-

min e mjaft fjalëve për të cilat gjuhë të ndryshme kanë pretendime të ndryshme. Turqizmat sot zënë një vend të rëndësishëm në leksikun e gjithë gjuhëve ballkanike. Edhe pse jo rrallë ekzistojnë disa ndryshime semantike e sidomos fonetike, këto fjalë që kanë hyrë në gjuhët e Ballkanit shekuj më parë, u huazuan në ato forma e kuptime që asokohe ishin më të përhapura. Në të vërtetë fjalët që u huazuan fillimisht përmes gjuhës së folur, në fakt u huazuan nga dialektet turke që flite-shin në rajonin e Ballkanit. Ajo nuk ishte një turqishte e pastër dhe kishte dallime të ndjeshme nga turqishtja e Stambollit, mbi të cilën u ngrit gjuha letrare turke. Huazimet që ishin në harmoni me sistemin e gjuhës në të cilën u futën, i ruajtën format e tyre origjinale, kurse ato që nuk ishin në harmoni pësuan ndryshime fonetike dhe morfologjike. Përveç kësaj, me kalimin e kohës turqishtja ka pësuar shumë ndryshime specifike dhe zhvillim të spektrit kuptimor të fjalëve të ndryshme. Prandaj, ndryshimet mes fjalëve turke që ekzistojnë ende në këto gjuhë dhe përdorimi i tyre në turqishten e sotme, është rezultat natyral i zhvillimeve të gjuhës. Kështu, gati të gjitha gjuhët e Ballkanit kanë huazuar fjalën *araba*, e me të edhe kuptimin e vjetër të saj: *karrocë*. Ndërsa sot, kjo fjalë në turqisht, përdoret në kuptimin: makinë.

Bazuar në studimin e fjalorëve të sotëm të gjuhëve të Ballkanit, rezulton se numri i huazimeve nga turqishtja është relativisht i madh dhe i ndryshëm për gjuhë të ndryshme. Pavarësisht se ndikimi i pushtetit otoman ishte pothuajse i njëjtë në të gjithë këto vende, ndikimi gjuhësor nuk ishte i njëjtë dhe kjo jo vetëm për shkak të veçorive gjuhësore të gjuhëve përkatëse, por mbi të gjitha për arsye që kanë të bëjnë me çështjen se në ç' masë u pranua islamizmi nga popuj të ndryshëm të Ballkanit, si edhe në cilat vende pati dyndje të nomadëve turq, të cilët edhe sot e kësaj dite, ekzistojnë në formën e pakicave kombëtare në pjesë të ndryshme të Ballkanit. Deri më sot studiues të ndryshëm të gjuhëve të Ballkanit, ballkanas dhe të tjerë, janë marrë me evidentimin e huazimeve nga turqishtja për çdo gjuhë ballkanike me vete, janë përpjekur të analizojnë kronologjinë e hyrjes së këtyre huazimeve, kanë bërë klasifikimin semantik të huazimeve, duke nxjerrë në pah fushat leksikore që janë prekur më shumë nga këto huazime, si dhe kanë studiuar ndikimet e karakterit gramatikor, sidomos në fushë të fjalëformimit. Nga studimet e deritanishme rezulton se:

Shqipja ka huazuar rreth 4406 fjalë, nga të cilat rreth 1400 janë në Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe. Me studimin e tyre janë marrë shumë gjuhëtarë shqiptarë dhe të huaj, e këtu mund të përmendim: E. Çabej, A. Kostallari, A. Krajni, M. Samara, G. Meyer, F. Miklosich, N. Boretzky etj. Megjithatë merita më e madhe i takon T. Dizdarit, i cili la në dorëshkrim veprën e mrekullueshme: *Fjalorin e orientaliz-mave*, që sot për sot përbën punimin më të saktë e më shkencor në fushë të huazimeve turke. Fjalori përmban 4406 huazime, që autori i quan huazime të drejtpërdrejta nga gjuha turke. Dizdari dallon cilësisht nga të gjithë studiuesit ballkanas, pasi jo vetëm përcakton saktë fjalët e huazuara nga turqishtja, por jep edhe të dhëna me rëndësi për studime të mëtejshme në lidhje me kuptimet leksikore që përmbajnë fjalët e huazuara, në lidhje me ndryshimet fonetike që kanë pësuar këto fjalë duke iu përshtatur shqipes, si dhe në lidhje me përhapjen e tyre në dialektet e shqipes dhe në gjuhët e tjera të Ballkanit.

Bashkë me fjalën në gjuhën shqipe kanë hyrë edhe prapashtesa fjalëformuese turke. Prapashtesat e huazuara nga turqishtja, dhe që deri në njëfarë mase janë bërë prodhimtare në gjuhën shqipe, janë:

-xhi (-ci;-ci;-cu;-cu); -çi (-çi;-çi;-çu;-çu)

-llëk (-lik;-lik;-luk;-luk)

-qar (-kâr)

-çe (-çe;-ça)

-li/-lli (-li;-li;-lu;-lu)

-sız/-söz; -dan

Të gjitha këto prapashtesa, pavarësisht ekzistencës së tyre në formën e varianteve fonetike në përshtatje me harmoninë vokale të gjuhës turke, në gjuhët shqipe kanë depërtuar duke iu përshtatur sistemit fonetik dhe strukturës gramatikore të saj.

Serbo-kroatishtja ka huazuar rreth 8742 fjalë, nga të cilat 6500 janë të përdorshme edhe sot. Të gjitha huazimet turke në këtë gjuhë, është përpjekur t'i mbledhë në punimin e tij: *Turkish Words in Serbian-Croatian Languages*, Abdullah Škaljić. Autori ka përcaktuar në këtë punim 8742 fjalë të burimit turk. Më pas, me studimin e tyre është marrë Milan Adamović, i cili këtë çështje e ka trajtuar gjerësisht në punimin e tij "Tanitma". Ai përcakton si fjalë të përdorimit të përditshëm rreth 6500 huazime turke Stachowski thekson se prapashtesat

-džija/ -lija/ -luk në serbo-kroatishte nuk janë aspak produktive në gjuhën e sotme, ndërsa për Pavle Ivić prapashtesa *-džija* është ende produktive, por me konotacion ironik. Ndërsa, A. Xhuvani dhe E. Çabej në punimin e tyre “Prapashtesat e gjuhës shqipe”, theksojnë se edhe në serbishte ndeshen prapashtesat: *-lik* (*-lik/-luk/-lük*), *-li* (*-li/ -lu/ -lü*) dhe *-ci* (*-ci/-cu/-cü/-çi/-çü/-çü/-çü*). Ata numërojnë shembujt: *bojali, demirli, dertli, obrazlija, pasalija, Bosnalija, pasaluk, ciganluk, Arnautluk, bojadzija, kaigdzija, tobdzija* etj.

Në gjuhën boshnjake studuesja Kerima Filan përcakton rreth 10 000 fjalë turke. Fjalët që përmend ajo janë mbledhur përgjithësisht nga letërsia gojore (sidomos nga letërsia e bejtexhinjve) dhe nga gjuha e folur.

Greqishtja, sipas studuesve të ndryshëm: Miklošič, Gustav Meyer, Rouzevalle Krumbacher, Kostantinos Kukkidis, Pavlos Georgidas, Evangelia Ahladi mendohet se ka huazuar rreth 300 fjalë. Triantaphyllidës : në vëzhgimet e tij thekson se prapashtesa *-ci* edhe në greqisht ndeshet në funksion pexhorativ. Ky autor bën të njëjtin vlerësim edhe për prapashtesën *-lik*, që gjithashtu përdoret në kuptim pexhorativ, me përjashtim të rasteve kur përdoret për të shënuar emra që u referohen funksioneve ose posteve zyrtare të ndryshme, por që gjithnjë e më tepër po merr kuptim ironik e tallës. Ndërsa për prapashtesën *-li* ai thekson se është joproduktiv në gjuhën standarde greke.

Në gjuhën e sotme maqedonase ekzistojnë rreth 4500-5000 huazime turke. Huazimet turke në këtë gjuhë përgjithësisht vlerësohet të jenë deri diku të njëjta me ato të serbo-kroatishtes e të bullgarishtes. Me studimin e tyre janë marrë shumë autorë si: Olivera Nasteva, Zbigniev Gołąb, etj. Maqedonishtja, ashtu si edhe gjuhët e tjera të Ballkanit ka huazuar edhe një mori prapashtesash turke, të cilat janë prodhimtare edhe sot. Këtu mund të përmendim:

- *-xhi* (*-ci; -ci; -cu; -cu*); *-çi* (*-çi; -çi; -çü; -çü*)
- *-llëk* (*-lik; -lik; -luk; -luk*)
- *-qar* (*-kâr*)
- *-çe* (*-çe; -ça*)
- *-li/-lli* (*-li; -li; -lu; -lu*)
- *-sız/-söz; -dan*

Rumanishtja ka huazuar rreth 3900 fjalë, nga të cilat rreth 1700 janë të përdorimit të përditshëm. Studimet për huazimet turke në ru-

manisht janë të shumta në numër. Mund të përmendim: Miklosich, Lazar Saineanu, Theophil Lobel, Karl Lokotsch, Heine F. Wendt, M. Guboğlu, Muammer Nurlu dhe Kerim Altay i cili në katër fjalorët e rumanishtes, të hartuar prej tij, vëren se fondi i huazimeve turke që i përket përdorimit të përditshëm mund të shkojë deri në 2000 fjalë. Edhe rumanishtja, ashtu si gjuhët e tjera ka huazuar disa prapashtesa turke. Werner Bahner në punimin e tij thekson se prapashtesa *-giu (-ci)* vazhdon të jetë produktive në rumanishten kontemporane si sufiks pexhorativ. Ai jep shembuj si: *laptagiu, cazangiu, cafegiu, odagiu, hangiu, borangiu* etj. A. Xhuvani dhe E. Çabej në punimin e tyre “Prapashtesat e gjuhës shqipe”, theksojnë se në rumanishte ndeshet edhe prapashtesa *lik (lik/luk/lük)*. Ata numërojnë shembujt: *çiflic, geamlic, babalic, caraghioslic*.

Bullgarishtja ka huazuar rreth 3500 fjalë. Ato i përkasin kryesisht sferës ekonomike, politike dhe jetës së përditshme. Me studimin e tyre janë marrë: Alf Grannes, M. Türker Acaroğlu etj. Nga studimet rezulton se në bullgarishte kanë hyrë edhe rreth 5000 emërtime vendesh turqisht. Megjithatë, në botimin e tretë të Fjalorit të fjalëve të huaja, rezultojnë gjithsej 3548 fjalë të burimit turk, arab e pers, që kanë hyrë nëpërmjet turqishtes. Mircevthekson se, sa u takon deriva-teve me prapashtesat *-ci* dhe *-lik/ -dzija, lak*, në bullgarisht ato kanë përfundimisht një konotacion ironik, tallës dhe pexhorativ, megjithëse në raste të veçanta ato shërbejnë për të formuar nomina agentis, duke iu referuar zanateve tradicionale si: *bojadzija, xalvadzija, kafedzija* etj. Megjithatë ka formime bullgare me këtë prapashtesë që nuk kanë absolutisht kuptim ironik. Këtu mund të përmendim fjalëve që kanë hyrë së fundmi: *kompjuterdzija (kompjuterist)* dhe *balkandzija (ballkanolog)* etj. A.Xhuvani dhe E.Çabej në punimin e tyre “Prapashtesat e gjuhës shqipe”, theksojnë se edhe në bullgarishte ndeshet prapashtesa *lik (/luk/lük)*. Ata numërojnë shembujt: *Arnautlluk, babaluk*.

Mbështetur në sa parashtruam më sipër, natyrshëm lindin pyetjet: A ekziston një fond i përbashkët ballkanik i huazimeve nga turqishtja? Cili është statusi i sotëm i tij në gjuhët e Ballkanit? Ç’ veçori paraqet ky fond? Ç’ fusha leksikore ka përfshirë fondi i përbashkët ballkanik? Si i janë përshtatur prapashtesat fjalëformuese turke, mënyrave dhe tipave fjalëformuese të gjuhëve të Ballkanit, etj?

Sado të përpiqesh të japësh vetëm thelbin, kompleksiteti i kësaj çështjeje është e pamundur të trajtohet në një kumtesë të vetme. Më duhet të theksoj se kur fillova të merrem me studimin e korpusit të përbashkët ballkanik, mendoja se për këtë çështje në radhë të parë duhej të ishte e interesuar vete turkologjia turke. Me keqardhje diktova se turkologjia turke, e këtu fus turkologët e sotëm turq, në pjesën më të keqe të rasteve kanë idenë e gabuar se ballkanasit flasin vetëm turqisht, e në një pjesë tjetër nuk janë aspak të vetëdijshëm për pasurinë e madhe leksikore, që kanë lënë në gjuhët e Ballkanit. Kjo vjen për shkak se e meta më e madhe e tyre lidhet me mungesën e theksuar të njohurive që kanë ata për gjuhët e Ballkanit në përgjithësi, e sidomos me mosmësimin e gjuhëve ballkanike në veçanti. Për këtë arsye, studiues ballkanas e të tjerë të huaj, që njohin turqishten dhe osmanishten, e në veçanti studiuesit shqiptarë, që (për shkak të rrethanave historike të ditura nga të gjithë) kanë fatin të jenë njohës të disa gjuhëve të Ballkanit njëkohësisht, do të ishin më frytdhënës në këtë fushë. I them të gjitha këto sepse, pavarësisht se studiuesit e çdo gjuhe ballkanike kanë bërë evidentimin e saktë të fjalëve të ardhura nga turqishtja në gjuhët e tyre, është bërë shumë pak për sqarimin e statusit aktual të këtyre fjalëve në gjuhët përkatëse, për përjasjen kuptimore me gjuhën nga vijnë, për zhvillimet leksiko-gramatikore të huazimeve në gjuhët e Ballkanit, për sqarimin e rolit që kanë luajtur këto huazime në pasurimin e strukturës leksikore të këtyre gjuhëve etj. Mendojmë se nëse do të hartohet një Fjalor i Turqizmave Ballkanike, duke u mbështetur vetëm në studimet e deritanishme, që kanë evidentuar thjesht huazimet nga turqishtja për gjuhë të ndryshme ballkanike, puna do të ishte thjesht mekanike dhe pa rezultatet shkencore që mëtojmë të sjellim. Besojmë se do të ishte me interes shkencor kombinimi i këtyre studimeve të vyera me vëzhgime në terren (që mund të realizohen me anën e ekspeditave gjuhësore) për të diktuar statusin aktual të këtyre huazimeve në gjuhët e Ballkanit. Një studim i tillë do të na çonte në përfundime interesante, dhe me aq sa kemi mundur të vëzhgojmë deri tani, deri diku edhe befasuese, në lidhje me disa çështje që kanë të bëjnë me:

- *Korpusin e huazimeve të plota*, pra të atij grupi fjalësh që ruan po të njëjtat kuptime që kanë pasur në turqisht në kohën kur janë huazuar. Këto fjalë edhe sot e kësaj dite përdoren në të gjitha gju-

hët e Ballkanit, me të njëjtat kuptime dhe në të njëjtat kontekste, që kanë pasur shumë vite më parë.

- *Korpusin e huazimeve të pjesshme*, pra të atij grupi fjalësh, që ka marrë nga turqishtja vetëm njërin kuptim, kuptimin themelor ose kuptimin dytësor. Me aq sa kemi mundur të vëzhgojmë, duket që gjuhët e Ballkanit e kanë ndjerë të nevojshme të huazojnë fjalën vetëm në kuptimin që i ka interesuar, e jo me kuptimet e dyta apo të treta, që mund të ketë pasur ajo në turqisht. P sh. Në gjuhë të ndryshme të Ballkanit (shqip, bullgarisht, rumanisht, serbisht) fjalla: aheng (nuk ka marrë kuptimin: harmoni), alamet (nuk ka marrë kuptimin: shenjë), allah (nuk ka marrë kuptimin:usta), allaxha (nuk ka marrë emërtimin e frutave, që çelin për herë të parë), allçak (nuk ka marrë kuptimin: i shkurtër nga trupi), anaç (nuk ka marrë kuptimin:kurnac), arallëk (nuk ka marrë emërtimin e muajit, hapësirën ndërmjet rreshtave etj), asqer (nuk ka marrë kuptimin: person i disiplinuar), astar (nuk ka marrë kuptimin: suvaja e mureve), ashk (nuk ka marrë kuptimin: optimist), axhami (nuk ka marrë kuptimin:nëpunës me moshë të re në Perandorinë Osmane), bahçe (nuk ka marrë kuptimin:ara të mëdha të mbjella me zarzavate), bajram (nuk ka marrë kuptimin: emërtim i festave kombëtare) etj.
- *Korpusin e huazimeve me kuptim të ndryshuar në gjuhë të ndryshme*, pra të atij grupi fjalësh, kuptimi i të cilave nuk përputhet me kuptimin e fjalës përkatëse në turqisht. Nga vëzhgimet e deri tani na rezulton që ky grup të përfshijë një numër të kufizuar fjalësh dhe duhet thënë se, megjithëse ndihen diferenca të rëndësishme semantike, përsëri, edhe tek këto fjalë, është e pranishme lidhja e tërthortë kuptimore, me kuptimet që bartin ato në gjuhën turke. P sh. *allti, arazi, avaz, bajrak, bash, bataqçi, bojalli, burani, çilek, çini, çivi, çomlek, damlla, divan, fiqir, gazele, gazep, gjerdan, gjoja, gjon, gjysleme, hajn, hallk, havale, japrak, jaran, kaçak, kade, kamare, kanun, kara, kasaba, kaull, kaurma, kiamet, kumbarë, llonxhë, mazgallë, mejtep, mereqep, mevlud, myhib, myshteri, pajandër, peshtaf, pizeveng, qelepir, qesim, qilarxhi, qoshk, reshper, saraf, saraj, sefte, selamet, serbes, silah, sixhade, shair, sharki, shebek, tajë, taksë, tebdil, telendis, tepelek, tymak, xhanëm, xhephane*.

- Korpusin i huazimeve me kuptim dytësor të zhvilluar nga gjuhë të ndryshme*, pra të atij grupi fjalësh që, veç kuptimit të huazuar, kanë zhvilluar në gjuhët e Ballkanit (shqip, bullgarisht, rumanisht, serbisht, greqisht) edhe kuptime të tjera, të cilat nuk gjenden sot në turqisht: *alamet* (përdoret edhe në kuptimin: gjëmë), *arrakat* (përdoret edhe në kuptimin: përndaj andej-këtej pa rregull), *bori* (përdoret edhe në kuptimin: qyng sobe), *çakër* (përdoret edhe në kuptimin: dikush ka diçka të parregullt në sjellje a në veprime), *çardak* (përdoret edhe në kuptimin: pjesë e hapur, e rrethuar zakonisht me parmakë, që shërben për të pritur miq), *çark* (përdoret edhe në kuptimin: kornizë druri, varg eshtrash të turpit të njeriut), *daulle* (përdoret edhe në kuptimin: pjesë e një makine apo e një mekanizmi në trajtën e një cilindri të zbrazët), *dynja* (përdoret edhe në kuptimin: sasi e madhe, shumicë), *dyst* (përdoret edhe në kuptimin: diçka që është në rregull), *efendi* (përdoret edhe në kuptim ironizues), *fajde* (përdoret për të emërtuar edhe dobinë) *farashë* (përdoret për të emërtuar edhe kutinë, që shërben për të mbajtur kripën etj), *farfuri* (përdoret edhe në kuptimin: qeramikë me shkëlqim, porcelan), *filiz* (përdoret edhe në kuptimin: trashëgimtar i një familjeje), *fishek* (përdoret edhe si ndajfolje në kuptimin: menjëherë).
- Korpusin e huazimeve që kanë pësuar zhvillime figurative e stilistikore të veçanta*, pra të atij grupi fjalësh që gjatë përdorimit kanë zhvilluar me kalimin e kohës edhe kuptime figurative e stilistikore të veçanta. Këto kuptime janë kryesisht me konotacion mospërfillës, me ngjyrim tallës dhe ironik, si dhe me ngjyrim përbuzës a keqësues. Një pjesë e mirë e tyre, megjithëse kanë sinonimin përgjegjës në gjuhët e Ballkanit, vazhdojnë të jenë të përdorshme, sidomos në ligjërimin bisedor. Për këtë arsye, duket se janë bërë pjesë e pandarë e këtyre gjuhëve. Këto fjalë kanë ruajtur kuptimin e parë me të cilin kanë hyrë në gjuhët e Ballkanit, si kuptim të vjetruar apo historik, duke zhvilluar kuptime të prejardhura me ngjyime të reja stilistikore. Pikërisht këto ngjyime të reja u kanë dhënë mundësinë këtyre fjalëve të gjallërohet dhe të kenë jetëgjatësi në këto gjuhë, pasi me nuancat që shprehin pasurojnë semantikën e tyre. P sh. *çorape*, *akraba*, *allish-verish*, *anadollak*, *asqer*, *at*, *avaz*, *badihava*, *bajame*, *bajraktar*, *bakall*, *bakllava*, *bardhak*, *barut*, *bashibozuk*, *batall*, *behar*, *bejllëk*, *bina*, *bi-*

zele, bojë, bozë, bunar, burgji, burnot, çadër, çakëll, çakër, çanak, çap, çapraz, çarçaf, çare, çark, çekiç, çelik, çengi, çervish, çezmë, çibukçi, çiflig, çikrik, çirak, çivit, çizme, çorap, çorbë, çull, dajë, dallgë, damlla, dava, defter, din, dizgjin, dua, duzine, dyfek, dylbi, dynja, dyzen, ezh-dërha, fener, ferman, feste, filiz, filxhan, fishek, fitil, fuçi, furçë, gajtan, gjemi, gjol, gjym, hafif, hallall, hallkë, hallvë, han, hanxhar, haram, hardall, hatull, havale, havan, hazine, hejbe, hendek, hesap, hordhi, ibrik, ilet, ilik, jastëk,

- *Korpusin i huazimeve që kanë si fjalë sinonimike përsëri një fjalë të huazuar nga turqishtja.* ahengxhi-sazexhi, allçak-budalla, allish-verish-dallavere, bataqçi-kallpaza- xhambaz, bela-hall –telash-zavall, budalla-teveqel- teleshman- hardall- allçak, hall-siklet-zordert- qeder-zavall- telash- kusur.

Më pas do të duhej të analizonim lëvizjet morfologjike që kanë pësuar këto huazime, pasi vërejmë mjaft të tilla:

- *Në disa gjuhë të Ballkanit një pjesë e huazimeve paraqitet si emër dhe si mbiemër.* Në këtë rast, me të njëjtën fjalë, emërtohet si personi që është bartës i një cilësie të caktuar, ashtu edhe vetë cilësia. Këtu hyjnë fjalët: beqar, dallaveraxhi, dangall, delenxhi, dori, fakir, gjevrek, gjytyrym, hasetçi, horr, jabanxhi, kadife, kapadai, kodosh, llafazan, maskara, matuf, nursëz, pis, portokall, qorr, qylaxhi, qymyr, ryshfetçi, sakat, sarhosh, shakaxhi, tamahqar, xhahil, xhanan, xhuxh, zavall etj.
- *Një pjesë e huazimeve megjithëse në turqisht janë mbiemra, në gjuhët e Ballkanit paraqiten jo vetëm si mbiemra, por edhe si emra.* Lëvizjet kuptimore kanë sjellë kalimin nga emërtimi i cilësisë së individit në turqisht, në emërtimin e vetë individit, nëpërmjet cilësisë së tij në këto gjuhë. Këtu hyjnë fjalët: allçak, balllek, bajraktar, bataqçi, borxhli, çakër, çapkën, çerek, farfuri, fukara, hajn, hileqar, kara, kopuk, marifetçi, myteber, qose, vesveseli, zengjin, zevzek.
- *Një pjesë e huazimeve, veç përdorimit emëror njëlloj si në turqisht, duke u pasuruar me kuptime figurative, përdoren në gjuhët e Ballkanit edhe si mbiemra.* Këtu hyjnë fjalët: bizele, burnot, çelik, futë, hazine, jetim, pastërma, pelin, pestil, pizeveng, turli, xhambaz, xhelat etj.

- *Një pjesë e huazimeve, që në turqisht janë mbiemra, në gjuhët e Ballkanit përdoren edhe si ndajfolje. Këtu hyjnë: batall, çapraz, dyst, eksiq, hazërxevap, qelepir, safi, serbes, ters etj*
- *Një pjesë e huazimeve, për shkak të zgjerimit a ngushtimit kuptimor, bën kalime nga njëra pjesë e ligjëratës në tjetrën, si p sh:*
 - Nga emër në turqisht, në pasthirmë në gjuhët ballkanike: aferim.
 - Nga numëror themelor në turqisht, në emër në gjuhët ballkanike: allti, yç.
 - Nga emër në turqisht, në ndajfolje në gjuhët ballkanike: arazi.
 - Nga ndajfolje në turqisht, në emër në gjuhët ballkanike: axhele.
 - Nga numëror themelor në turqisht, në ndajfolje dhe mbiemër në gjuhët ballkanike: birinxhi.
 - Nga folje në turqisht, në pjesëz në gjuhët ballkanike: demek.
 - Nga ndajfolje në turqisht, në pjesëz në gjuhët ballkanike: gjoja, zatan.
 - Nga pjesëz në turqisht, në emër në gjuhët ballkanike: hair.
 - Nga pasthirmë në turqisht, në ndajfolje në gjuhët ballkanike: meazallah
 - Nga emër në turqisht, në ndajfolje në gjuhët ballkanike: qesim.
 - Nga ndajfolje në turqisht, në pjesëz në gjuhët ballkanike: tamam.
 - *Interes të veçantë paraqet çështja e statusit aktual të prapashtesave turke. Në të gjitha gjuhët e Ballkanit një pjesë e prapashtesave turke, të cilat u futën së bashku me fjalët turke, u izoluan nga fjalët e huazuara dhe filluan të bëhen produktive me rrënjë jo turke. Ato sot ekzistojnë edhe në formën e prapashtesave sinonimike të prapashtesave të shqipes, serbishtes, maqedonishtes, rumanishtes, greqishtes etj.*

Për të gjitha këto, do të ishte me vlerë, që në kuadrin e gjuhësisë ballkanike, të bëhej evidentimi i huazimeve të përbashkëta turke në këto gjuhë, pra të gjendej korpusi i përbashkët ballkanik i huazimeve turke. Veç kësaj do të ishte me interes të studioheshin ndryshimet fonetike që kanë pësuar këto huazime në gjuhët e Ballkanit, përshtatja me format gramatikore të këtyre gjuhëve, si dhe lëvizjet kuptimore e nuancat stilistikore që mund të kenë pësuar apo fituar huazime të ndryshme në vite. Një studim i tillë do të çonte edhe në përcaktimin e saktë të frazeologjive të përbashkëta ballkanike, pasi dihet që një pjesë

e mirë e tyre kanë në përbërje huazime turke. Hartimi i Fjalorit të Turqizmeve Ballkanike do të ishte një ndihmesë jo e vogël për vetë Ballkanistikën. Ai do të theksonte edhe më shumë lidhjen gjuhësore ballkanike, pasi me të drejtë mendohet që “korpori i përbashkët i huazuar nga turqishtja megjithëse nuk përbën lidhjen gjuhësore ballkanike, sidoqoftë e përforcon atë”.

Bibliografi

- Akay, M., *Makedonca'daki türkçe kelimeler ve dil unsurları*, Birinci uluslararası balkanlarda türk varlığı sempozyumu, Izmir, 2002.
- Altın Türkçe Sözlük, Ankara, 1991.
- Banguoğlu, T., *Türkçenin grameri*, Ankara, 1990.
- Boretzky, N., *Der Türkische Einfluss auf das Albanische*, teil 1, 1975.
- Boretzky, N., *Sur la substitution des noms de profession d'origine turque en albanais*, Canier Balkanique, 1981, 2.
- Çabej, E., *Për një shtresim kronologjik të huazimeve turke të shqipes*, SF, 1975, 1.
- Demiraj, Sh., *Gjuhësi Ballkanike*, Tiranë, 2004.
- Dizdari, T., *Fjalor i orientalizmeve*, Tiranë 2005.
- Fjalor i gjuhës së sotme shqipe, Tiranë, 1980.
- Fjalor i gjuhës së sotme shqipe, Tiranë, 1954.
- Fjalori sinonimik i gjuhës shqipe, Tiranë, 2005.
- Guboğuz, M., *Rumanya Turkolojisi ve Rumen dilinde Türk sözleri hakkında bazı araştırmalar*, Ankara, 1968.
- Hasan, H., *Makedonya ve Kosova Türklerince kullanılan Atasözleri ve Deyimler*, Ankara, 1994.
- Ismajli, R., *Tekste të vjetra*, Pejë, 2000.
- Kakuk, Z., *Macar dilinde Osmanlı-Türk unsurları*, Ankara, 1972.
- Kakuk, Z., *Recherches sur l'histoire de la langue Osmanlie des XVI et XVII siècles, les éléments Osmanlis de la langue Hongroise*
- Karaagaç, G., *Türkçe verintiler Sozlüğü*, Ankara, 2008
- Kazazis, K., *The status of Turkisms in the Present-day Balkan Languages*, Aspects of the Balkans. Continuity and Change, International Balkan Conference, october, 1969.
- Kerim, A., *Türkçeden Romenceye giren sözcükler-Romencedeki Türkçe kelimeler*, Ankara, 1996.
- Kostallari, A., *Rreth depërtimit të turqizmeve në gjuhën shqipe gjatë shekujve XVII-XVIII*, Gjurmime albanologjike, SSHF, Prishtinë 1978.
- Krajni, A., *Hymja e turqizmeve në shqipen dhe përprekjet për zëvendësimin e tyre*, SF, 1965, 1.
- Latifi, L., *Huazimet turke në gjuhën shqipe krahasuar me gjuhët e tjera të Ballkanit*, Tiranë 2006.
- Louis K.Katona, *Le Dialecte Turc da la Macedoine de l'Ouest*, Türk Dili Araştırmaları Yıllığı, Belleten, Ankara, 1969.
- Mandalà, M., *Il Dittionario (1702) di F. M. Da Lecce e i turchismi nell'albanese (secili XVII-XVIII)*, *Albanica* 10
- Meyer, G., *Etymologisches Wörterbuch der albanischen Sprache*, Strassburg, 1891.

- Miklosich, F., *Die Türkischen Elemente in den südost-und osteuropaischen Sprachen* (V.I-II), Wien, 1884-1890.
- M. Türker Acaroğlu, *Bulgaristanda Türkçe Yer Adlari Kilavuzu*, Ankara, 1988.
- Ndreca, M., *Fjalor fjalësh e shprehjesh të huaja*, Prishtinë 1986, 2000.
- Reinkowski, M., *Zum Status der Turzismen in den Sprachen südosteuropa*, 2002
- Samara, M., *Zhvillime leksiko-semantike të turqizmeve në gjuhën shqipe*, SF,1995, 1-4.
- Schütz, I., *Gjurmë gjuhësh turke mesjetare në shqipen e sotme*, Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare, Prishtinë, 1986.
- Skaljiç, A., *Srp-Hrvat Dilinde Türkçe Kelimeler*, Ankara, 1957.
- Vajzović, H., *Orijentalizmi u književnim djelu - Lingvistička analiza*, Sarajavo, 1999.
- Xhuvani, A., Çabej, E., *Prapashtesat e gjuhës shqipe*, Tiranë,1962.
- Yaşar, Y., *Bulgarcaya Türkçeden ve Türklerden geçen sözcükler*”, Ankara, 1991.

Skënder GASHI, Vjenë

GJURMË TË LATINITETIT DHE TË ROMANITETIT BALLKANIK NË TOPONIMINË E KOSOVËS

Abstrakt

Nga studime të kësaj natyre kam veneruar se ka arësye të besohet që në mikrotoponiminë historike dhe aktuale të Kosovës ka dy shtresa të latinitetit, përkatësisht të romanitetit ballkanik. Në këtë hapësirë ka:

1. Mikrotoponime me prejardhje nga latinishtja ballkanike, të vazhduara nga popullata shqipfolëse [si psh. emrat Këlkerja, Ledina e Këlkerave, Guri Kilikerës në katundet Junik; Voksh, Planejë dhe Blaç në rrethina të Deçanit, Gjakovës e të Prizrenit, që rrjedhin nga të lat. vulgare. *calcaria/calcaria* „gëlqere; gropë e gëlqeres; vend me gur gëlqerje”; Shtatuli nga lat. *statio* „stacion vendroje ushtarake”; Rrîpa, shkëmb në katundin Muzheçk të krahinës së Triepshit, Ripa në katundin Botushë të Gjakovës e ndoshta edhe emri i zhdukur Ripanje i një katundi që në vitin 1455 ishte evidentuar për në rrethina të Podievës së sotme, që ndoshta rrjedhin nga ripam „buzë lumi, kodër, shkëmb”e latinishtes; dromonimi Udha pukë në katundin Rrenc të krahinës së Opojës, që mund të jetë vazhdim shqiptar i sintagmës toponimike **Via publica* të latinitetit ballkanik] dhe sosh të ruajtura në trajta të „shtanguara” të tyre latine-ballkanike [si Cibrina, bjeshkë e lartë, kullotë e madhe midis katundeve Kovaçicë e Bajgorë të malësisë së Mitrovicës; mikrohidronimi Cibrin, përkatësisht Cibren në kompleksin Starasellë sipri katundit Mojstir të rrethinave të Istogut; Picel bjeshkë në krahinën e Shalës së Bajgorës e afërt përkah prejardhja me nocionin retoroman Pitz në kuptimin „majë e mprehtë mali”, i zgjeruar me prapashtesën -el që dëshmohet edhe në toponime të tjera me prejardhje latine të hapësirës së Ballkanit; Kurvalla, përkatësisht Maja e Kurvall's, bjeshkë/kullotë e male në veri të Gjerovicës, në kompleksin e Bjeshkëve të Nemuna, nga adjektivi latin *cürvus* „i dredhët, i lakuar, bërryl” dhe nga apelativi *vallis* „luginë” dhe

2. Mikrotoponime të sajuara nga emri etnik vllah [khs. emrat e katundeve Vllahinje në krahinën e Shalës së Bajgorës dhe të regjionit të Hasit, të përmendur në vitet 1313-1318 dhe 1330; Vllasë të regjionit të Gallapit dhe shumë mikrotoponime të dëshmuara në burime kishëtare serbe që e mbajnë artibutin *vlaški/vlaška* „i e vllahëve” nëpër gjithë hapësirën e Kosovës, nga antroponime vllahe e sllave dhe sosh të zgjeruara edhe me prapashtesën karakteristike vllahe/ aromune të zvogëlisë -šor [Khs. Bunkov Vinograd „Vneshta e Bunk-ut” i përmendur në v. 1330, afër katundit Bërnjakë të rrethinës së Rahovecit; Dabšor - vend ku ishte një vreshhtë, i përmendur në v. 1198-1199; Milšor, shkorret në rrethina të katundit

Radesh të regjionit të Gorës, i përmendur në v. 1348; Papulova Rupa “Gropa e Papulit” midis katundeve Pagarushë e Dobërdolan të Suharekës, i përmendur në vitin 1327; Selištor, emër i zhdukur i një vendbanimi, i dëshmuar në vitet 1566-1574 në regjionin e Gjilanit; Skokšor ujëvare/theqafë në Bjeshkët e Nemuna në rrethina të Istogut, i dëshmuar në fund të shek. 13; Tudorç Dol i dëshmuar në v. 1348 për në rrethina të katundit të sotëm Kërstec të krahinës së Gorës dhe mikrotoponimet e sotme Babshori në katundin Kralan të krahinës së Dushkajë të Gjakovës, Banishori - vend në katundin Kerninë të Istogut etj.] dhe nga brumi leksikor i romanishtes ballkanike, përkatësisht i vllahishtes/arumanishtes [Khs. mtp. Carina; Carinat ara e fusha në katundet Hoçë e Madhe, Zoqisht e Opterushë në rrethina të Rahovecit nga rum. țarină „arë, ugar, 2. tokë e katundit’] e shumë emra të tjerë.

Këta (emra) janë gjurmë onomastike të popullatës baritore me prejardhje trakase/dakase fillimisht të romanizuar e më vonë të bullgarizuar në hapësirën gjuhësore të bullgarishtes/ maqedonishtes, që nga perandoria bullgare u soll në Kosovë gjatë shekujve 10-12. Më vonë, gjatë shekujve 13-14, kjo popullatë u bë „pronë” e qendrave kishëtare serbe si Banjska, Graçanica, Deçani e Patrikana e Pejës. Në pjesë të tjera të Kosovës, kah nuk kishte qendra kishëtare serbe (si psh. krahinat e Llapit, Gallapit, Moravës), kishte vllahë të pavarur nga kisha serbe. Midis këtyre vllahëve kishte edhe sish të ardhur nga hapësira gjuhësore e greqishtes. Përkundër tezës sipas së cilës vllahët e hapësirës së sotme të Kosovës bashkë me sish të pjesës jugore të Ballkanit qenkan shpërngulur në shek. 15 në Dalmaci e deri në Istri, unë kujtoj se këtu kemi të bëjmë më parë me procesin e përfunduar në shek. 15 të deromanizimit të vllahëve, përkatësisht që pjesa e popullatës ardhëse romane e vendosur në e rrënzë Bjeshkëve të Nemuna, Sharit, Pashtrikut dhe pjesës shqiptare të Kopaonikut u shqiptarizua, ndërsa pjesa e vendosur në vise rrafshinore, përkatësisht rreth Rahovecit, në Rrafsh të Kosovës dhe pjesërisht në rrethina të Novoberdës e të Gjilanit u serbizua.

Dija shqiptare e gjuhësisë është marrë krejt pak, për të mos thënë fare, me çështjen e mbetjeve onomastike të latinitetit e të romanitetit ballkanik në hapësirën etno-linguistike të shqiptarëve, jashtë kufijve të shtetit të sotëm shqiptar. Duket se kështu ndodhi për shkak se edhe ata pak romanistë që i ka Kosova u përqendruan kryesisht në mësimdhënie të latinishtes e të frëngjishtes, në përkthime veprash letrare etj. nga gjuhë neolatine, jo porse edhe në studime në rrafshin diakronik të raporteve të shqipes me latinitetin ballkanik.

Vetëm kështu, kujtoj unë, mund të kuptohet përse në pjesën kosovare të filologjisë romane nuk u trajtua çështja e përmasave të latinizimit të popullatës vendëse të Dardanisë së lashtë e as çështja e pranisë, e bashkëjetesës dhe përmasat e shqiptarizimit të popullatës roma-

ne-ballkanike, të njohur me emrin e përgjithshëm vllah (arumun; kucovllah, karagun, gogë, cincar) dhe me emra të tjerë.

Para se t'i parashtroj venerimet e mia përkitazi me këtë temë, e njoftoj lexuesin e nderuar se unë nuk kam kompetenca në fushën e romanistikës. Të gjitha të dhënat e sjella në këtë trajtesë timen mbështeten mbi rezultate të studiuesve romanistë, sllavistë e indoeuropeistë të huajë, të cilët porse nuk i kishin pasur për temë trajtimi elementet latine-ballkanike e ato vllahe në makro- e mikrotoponiminë e hapësirës së sotme të Kosovës.

Nga studime të kësaj natyre kam veneruar se ka arësye të pranohet që në mikrotoponiminë aktuale të Kosovës ka dy shtresa të latinitetit, përkatësisht të romanitetit ballkanik. Në këtë hapësirë ka:

1. Mikrotoponime me prejardhje nga latinishtja ballkanike dhe

2 Mikrotoponime me prejardhje nga brumi leksikor i romanishtes ballkanike, përkatësisht i vllahishtes.

I. Shtresës së parë i përkasin kryesisht emrat që shenjojnë male/ bjeshkë si bf. *Cibrina*, bjeshkë e lartë, kullotë e madhe midis katundeve Kovaçicë e Bajgorë të malësisë së Mitrovicës. Emri i kësaj bjeshke është i së njëjtës prejardhje si edhe emrat *Cibar* e *Cibrica* të lumenjve në hapësira të Bullgarisë, të cilët (emra) dijetari bullgar V. Georgiev i sheh të sajuar nga varianti *cibār* i mbiemrit të formuar nga apelativi *cibrina* që dëshmohej edhe në trajtën *cibrec*, me kuptimin “(qiell) i kthjellët; i qartë”. Përafërsisht këtë kuptim, përkatësisht “mot i mirë; qiell pa vranësira”,

http://du102w.dub102.mail.live.com/mail/-1345c8f6ae48653b__ftn1¹
fjala *cibrina* e ka edhe në të folmen e regjionit të Ohrit, ndërsa në të folmen e Kërçovës fjala dhe mbiemri në trajtat *cibrak-u* e *cibrak* e ka kuptimin „i ftohtë i madh, acar, ngricë”: „Përrjashta asht cibraku i madh”, që ndonjë studiues e merr gabimisht për sllavizëm të kësaj të folmeje të shqipes. http://du102w.dub102.mail.live.com/mail/-1345c8f6ae48653b__ftn2²

Apelativi *cibrina* dhe mbiemri *cibār* bashkë me foljen pavetore *cibree* se „pastrohet; kthjellët” paskan hyrë në bullgarishten, sipas dijetarit VI. Georgiev, nga latinishtja vulgare *cēbrus* „i qartë, i pastër; i

¹ Sipas Zamfira Mihaila, *Arumunische Elemente im Bulgarischen*, *Revue des études sud-est européennes*, 18 (1970), f. 400.

² khs. Qemal Murati, *Fjalor i sllavizmave në të folmet e shqiptarëve të Maqedonisë*, Albas, Prishtinë (pa vit të botimit), f. 21.

kthjellët”, me ndërmjetësimin e popullatës autoktone të romanizuar thrakase ose dako-mize që në shek. 2 para erës sonë e cila (popullatë) këtë fjalë e përdorte në trajtën cibār. Edhe kalimi i ē në i, përkatësisht i kíabrov në kéabrov sqaron VI. Georgiev, qenka veçori e thrakishtes, përkatësisht e dako-mizishtes.³

Në dritën e një zhvillimi të këtillë, Georgiev shton më tej se edhe kalimi i ke- në tse (= ce) si dhe në c është veçori e dialektit të arumanishtes, prandaj fjalën cibār ky e sheh për si huazim aromun në leksikon bullgar e në emra vendesh të hapësirës së bullgarishtes, aqë më parë pse kjo fjalë del në të folme perëndimore të bullgarishtes prej nga i rezulton se ky element i huaj paska hyrë në bullgarishten „nga arumunët dmth. nga popullata e romanizuar e këtij territori”.⁴ Në të mirë të kësaj teze flet edhe rrethana që në territorin e Rumanisë ekziston emri Cibru i vendit, i cili mund të jetë refleks i një trajte latine Cebro (castellum), prej nga e heq prejardhjen edhe emri Cibrica i lumit në Bullgari. Unë po e shtoj në këtë mes vetëm rrethanën që emrin e cituar më lart Cebro (castellum) të kështjellës, historiografi Flavius Vegetius Renatus e përmend, në veprën e vet *Institutorum rei Militaris*, për si kështjellë në Daki në trajtën Cebri.⁵ Sipas M. Oroş,⁶ ky mbiemër përmbahet edhe në emrin Cebru të një mali në kompleksin e Karpateve* dhe, sipas E. Petrovici,⁷ jo rrallë edhe si emër personal, antroponim i rumunëve.

Përkitazi me prejardhjen substratike të fjalës cibar të toponimeve që rrjedhin nga kjo, mendim të vetin ka shfaqur edhe dijetari bullgar B. Simeonov⁸ Ky e vë në spikamë rrethanën se emrat me origjinë latine, që në bullgarishten kanë hyrë përmes trakishtes, dalin kryesisht në format me c (khs. Vacicel, Cerecel, Cikura nga Cicura,

³ sipas Zamfira Mihaila, poaty.

⁴ Poajo, poaty,

⁵ **Ilirët dhe Iliria te autorët antikë**, Tiranë, 2002, f. 386.

⁶ sh. *Din Toponimia văii Bistrei (Judetul Bihor)*, in **Studii și materiale de onomastică**, Editura Academiei Republicii Socialiste România, 1968, f. 192.

* khs. shpjegimin në punimin e saj të cituar më lart, *Arumunische ...: pădure de foioase „În această pădure sînt multe căprioare și cebri“*.

⁷ khs. *Omonime formate din antroponime în Carpații românești*, në **Studii și materiale de onomastică**, Editura Academiei Republicii Socialiste România, 1968, f. 192.

⁸ sh. *O karaktere mestnih nazanii romanskoga proishozdenia v Bolgarii*, **Actes de XI Congres international des sciences onomastiques 2**, Sofia 1973, f. 282-283.

Kornicel nga Cornicel dhe së fundi Cibar e Cibrica nga Cēbrus). Sipas persiatjeve të Simeonov-it, hapësira në të cilën adjektivi cēbrus është ruajtur në trajtën e tij të papalalizuar, puçet me një trevë gjuhësore „latine-shqiptare”, në të cilën ndeshet rregullisht edhe tërrnimi karakteristik (SG. për shqipen) i s në sh (khs. Šarašur nga lat. saristura rus. рѣзѣок gjerm. Sprung „kërcim; kapërcim 2. gabim në radhitje”; Šuglja nga lat. Sugela; Šugarnik nga Sgarnik nga lat. sugare „shtoj”; Šurdil nga Surd/Surda rus. „vend i madh; hapësirë; gjerësi” etj.).⁹

Mendim të vetin përkitazi me këtë emër ka shfaqur edhe gjuhëtari serb I. Popović. Në një punim të tijin ky thoshte që Cibrica mund të sqarohet si emër i latinitetit vulgar (ballkanik) Ci(a)brus përkatësisht Ki(a)brus, në të cilin (kalim) roli ndërmjetësues po u dashka t’i atribohet sllavishtes, me ç’rast këtu paskemi të bëjmë me tërrnimitin e k > c në vend të atij k > ć. Këtë tezë të veten I. Popović e mbështet edhe tek fenomeni i palatalizimit të ki-/ke- i cili „në sllavishten jep gjithashtu ci/ce dhe jo či/če”.¹⁰ Në një punim tjetër të tijin, autori I. Popović¹¹ shton se tek emri Cibrica i lumit në Bullgari paskemi të bëjmë me një vazhdimësi sllave të një trajte parasllave Κέβροç ashtu si edhe tek emri Ogosta i Bullgarisë që rrjedh nga një A(u)gusta e latinishtes.

Duke qenë se emri Cibrina i Kosovës shenjon një bjeshkë/ kullotë të gjerë mbi të cilën fort rrallë apo kurrnjëherë nuk ka re e vranësira lejohet paravendimi që (edhe) kjo mund ta ketë marrë emrin nga një fjalë e cila e ka kuptimin „i (e) qartë, i (e) kthjellët”. Ky paravendim gjen mbështetje edhe tek rrethana që për adjektivin e përmbajtur në emrin Cibrina të kësaj bjeshke në të folmen lokale shqipe nuk ka ndonjë adjektiv apo apelativ korrespondent me kuptimin që e ka emri i bjeshkës dhe që emri latin nuk është përkthyer, siç ka ndodhur psh. me emrin Bistreț (nga slav. bistro „i kthjellët”) të një liqeni që ndodhet jo larg nga vendi i quajtur Cibar i Bullgarisë,¹² që s’është tjetër veçse përkthim sllav i një emir latin i sajuar nga lat. cebrus „i kthjellët”.

⁹ Poai, poaty, f. 283.

¹⁰ sh. *Vlacho-serbica, Influence de la langue roumaine sur le serbokroate et sa geographie*, **Godišnjak II**, Sarajevo, 1961, f. 118.

¹¹ sh. *Die Einwanderung der Slaven in das Oströmische Reich im Lichte der Sprachforschung*, **Zeitschrift für Slawistik**, **Bd. III**, 1958, f. 706.

¹² sh. Aurelian Constantinescu, *Sur quelques survivances romanes dans la toponymie*

Në këtë grup emrash unë e shtoj edhe mikrotoponimin Cibrin,¹³ përkatësisht Cibren¹⁴ që shenjon një krua në kompleksin Starasellë sipri katundit Mujstir/Mojstir të periferisë së qytetit të Istogut.

Në dritën e rrethanës që ky emër vendi gjendet pikërisht në atë pjesë të hapësirës së sotme të Kosovës, popullsia dardane e së cilës e kishte përpara dhe në shekujt e parë të sundimit romak municipiumin (komunën) e vet të njohur si Municipium DD, përkatësisht Municipium Dardanorum ose Municipium Damastium Dardanorum dhe që, siç e ka dëshmuar dijetarja F. Papazoglu,¹⁵ popullata e këtushme dardane kishte pothuaj se përgjithësisht antroponimi ilire, i hapet udhë pohimit se këtu kemi të bëjmë me një emër me prejardhje nga latiniteti ballkanik, i cili është vazhduar vetëm nga popullata e romanizuar dardane dhe jo me ndërmjetësimin e ndonjë popullate tjetër, përkatësisht asaj sllave apo aromune. Kjo sepse, sikundër vërente P. Skok,¹⁶ në meglenorumanishten një c e latinishtes do të reflektohej në ç khs. çur < çiu nga lat. cibrum si edhe çirešaš e činuša. Ky emër nuk është vazhduar as nga sllavët ardhës sepse edhe ato krejt pak fjalë latine në gjuhët sllave të Jugut, sidomos ato latinizma të paravenduara për në hapësirën e dialektit të çakavishtes (khs. racione < račun dhe rogatione < rugātšuni) janë mbase reflekse të vona të togut lat.-ti. Emri latin i kësaj bjeshke nuk i është nënshtruar as veçorive fonetike të shqipes. Kjo sidomos pse një c (c, k) nistore e latinishtes, khs. lat. cicer - shq. qiqërr; lat. cepa - shq. kepa/qepa; lat. cerasia - shq. qershi,-a etj. është reflektuar në shqipen si palatal (q) dhe, së këndejmi, do të pritej një variant shqip *Qibrina ose *Çibrina.

Për të mos qenë i anëshëm në trajtimin e prejardhjes së këtyre emrave, duhet përmendur që bjeshka Cibrina e Kosovës ndodhet në atë hark gjeografik në të cilin është edhe bjeshka e quajtur Barel. Kur po e shkok-

roumaine, **Ballkansko ezikoznanie (Linguistique Balkanique)** 21/1978, f. 32.

¹³ Siç e ka shënuar në terren Svetozar Stijović, *Onomastika zapadnog dela Metohijskog (Pečkog) Podgora*, **Onomatološki prilozi, III**, SANU, Beograd, 1982, f. 321.

¹⁴ Siç e ka shënuar në terren Dr. Jusuf Osmani, **Vendbanimet e Kosovës 12**, *Burimi* (Istogu), Prishtinë, 2004, f. 130.

¹⁵ sh. punimin e saj *Dardanska Onomastika*, **Zbornik Filozofskog Fakulteta, VIII**, Spomenica Mihaila Dinića, 1, Beogradski Univerzitet, Beograd, 1964.

¹⁶ khs. *Iz Rumunske Literature o Balkanskim Vlasima*, në **Glasnik Skopskog Naučnog Društva, Vëllimi II**, *Fashikulli 1-2*, Shkup, 1927, f. 300-301.

lonte punën e prejardhjes së emrit Barelić të katundit të rrethinave të Vranjës (Serbi), autori O. Franck,¹⁷ e lejonte mundësinë që ky oikonim do të mund të sqarohej me fjalën veneciane që po e hiqka prejardhjen nga fjala romane barela (toskan. barile) „fuçi vëne” duke e mbështetur këtë sqarim të vetin tek rrethana që në qytetin e Novobërdës kishte gjatë mesjetës së vonë romanë raguzas e venedikas, përkatësisht që fjala romane barela ka hyrë në të gjitha gjuhët e Ballkanit. Këtij interpretimi të O. Franck-ut unë ia shtoj faktin që raguzanë e venedikas kishte gjatë mesjetës edhe jo larg bjeshkës së Barelit, përkatësisht në koloninë raguzase-sase të Trepçes dhe se, ç’është me rëndësi themeltare, bjeshka Barel dëshmohej që në çerekun e parë të shek. 14, përkatësisht në krisobulën e pandehur për të viteve 1313-1318 të sundimitarit serb St. Milutin, shprehimisht për si vendbanim i vlllehëve, përkatësisht si Vlasi Bareljevi’ski¹⁸ „Vlllehët e Barelit”.* Nga ky burim kishtar serb nuk mund të mësohet nëse edhe në këtë rast kemi të bëjmë me popullatë vendëse të romanizuar, që administrata dhe kisha serbe ishte mësuar ta quante „vlahъ, shm. vlasi” apo me vllleh të ardhur nga vise jugore të Ballkanit, në kohën e pushtimeve bullgare, gjithsesi përpara pushtimit të Kosovës nga principata serbe e Rashës së Nemanjidasve. Në të mirë të tezës së mësipërme do të fliste rrethana që po në këtë kohë, po në këtë burim dhe po në këtë hapësirë dëshmohej edhe katounъ блъгаръски¹⁹ „katuni i bullgarëve”, sot shq. Bugariq, serb. Srbobran.

Me prejardhje nga latinishtja vulgare dhe vazhdimësi të padiskutueshme shqiptare është, sipas mendimit tim, edhe emri Këlkerja - një mal gurinor, kullotë në territorin e katundit Junik; Ledina e Këlkerave në katundin Voksh midis Deçanit e Gjakovës; Këlkerja, një kodër në katundin Planejë të Prizrenit si dhe Kilikerja e Guri i Kilikerës në katundin Blaç të të krahinës së Opojës. Në të gjitha këto mikrotoponime përmbahet trajta latine-vulgare calcaria/calcaria „gëlqere; gropë e gëlqeres; vend me gur gëlqerje”, nga e cila rrjedh edhe fjala e sotme e shqipes gëlqere/këlqere dhe trajtat e saj më të vjetra këlqere, kërqele kërquelë, kalkerre, kercele që i sjell Fr. Miklosich.²⁰ Me interes për t'u

¹⁷ sh. *Studien zur serbokroatischen Ortsnamenkunde*, Leipzig, 1932, f. 48.

¹⁸ sh. Lj. Kovačević, *Svetostefanska hrisovulja*, *Spomenik SKA 4* (1890), f. 8.

* Trajta e dëshmuar në vitin 1455 *Bariljevo* dhe e sotmja *Barilevë*, është deformim i trajtës së kryeherëshme *Barel-*.

¹⁹ sh. Poai, Poaty, f. 8.

²⁰ khs. trajtesën e tij *Albanische Forschungen II*, *Die romanische Elemente im Albane-*

squaruar në këtë mes mbetet çështja përse popullata shqiptare vendëse i ruajti deri në ditë tonat mikrotoponimet e sajua nga trajta latine-ballkanike *calcaria* e fjalës, ndërsa vetë këtë apelativ e tjetërsoi në këlqere-gëlqere, përkatësisht përse edhe kjo fjalë e latinitetit ballkanik nuk e përsoi në shqipen fenomenin e palatalizimit të c (k) nistore të latinishtes siç ndodhi psh. me fjalët qershi (nga lat. *cerasia*) e qiqërr (nga lat. *cicer*). Sqarimi nga romanistë kompetentë i kësaj çështjeje do të tregonte nëse në këtë zonë bjeshkësh kishte ende ilirë të latinizuar folës të latinishtes ballkanike apo vetëm ilirishtfolës vazhdues të një gjendjeje të para kalimit të ilirishtes në arbërishten/shqipen.

Me prejardhje nga latinishtja popullore e Ballkanit do të jetë, sipas mendimit tim, edhe emri Kurvalla, përkatësisht Maja e Kurvall's, (e lartë 2303 m.) i një bjeshke/kullote dhe maleve në veri të Gjericës, në kompleksin e Bjeshkëve të Nemuna midis katundeve Botushë e Junik të Malësisë së Gjakovës. Ka mundësi që emri i kësaj bjeshke të jetë sajuar nga adjektivi latin *cūrvus* „i dredhët, i lakuar, kërryl” dhe nga apelativi *vallis* „luginë”. Si i këtillë, emri shqip i kësaj lugine në Bjeshkët e Nemuna do të jetë i të njëjtit formant si edhe emri Curvalle, mbase bjeshkë, në Francë.²¹

Pokështu mund të thuhet edhe për emrin Picel të bjeshkës në regjionin e (Shalës së) Bajgorës. Ka mundësi që ky emër të jetë i së njëjtës prejardhje, përkatësisht latine, si edhe emri Pitztal „Lugina, Gryka e Pic-it” në krahinën e Tirolit për të cilin mendohet se rrjedh nga nocioni retoroman Pitz në kuptimin „majë e mprehtë mali”. Prejardhjen latine ballkanike të emrit të kësaj bjeshke do ta dëshmonte edhe prapashtesa -el e cila dëshmohet edhe në toponime të tjera me prejardhje latine të hapësirës së Ballkanit. Kjo prapashtesë përmbahet psh. edhe në emrat e vendeve Vacicel, Cerecel, Kornicel që i shkollonte dijetari bullgar B. Simeonov.²²

Ndër mikrotoponime latine që me ndërmjetësimin e popullatës vendëse së pakut gjysmë të romanizuar u përcoll deri në ditë tonat do

sischen, Wien, 1871, f. 8.

²¹ khs. A. Dauzat et Ch. Rostaing, *Dictionnaire des noms de lieux de France*, bot. Librairie Larousse, Paris, 1963, f. 236.

²² sh. *O karaktere mestnih nazanii romanskoga proishozdenia v Bolgarii*, **Actes de XI Congrès international des sciences onomastiques 2**, Sofia 1973, 282-283.

të jetë edhe pjesa e dytë e dromonimit Udha pukë që unë vetë e kam shënuar para më shumë se 30 vitesh në katundin Rrenc të krahinës së Opojës. Ka mundësi që emri i kësaj udhe të jetë refleksi i shqipfolësve vendës i sintagmës toponimike *Via publica të latinitetit ballkanik, ashtu sikundër ndodhi, sipas prof. E. Çabej, edhe me emrin Puka të qytetit të sotëm të Veriut të Shqipërisë.

Tufës së emrave të vendeve me prejardhje nga latinishtja ballkanike në hapësirën gjuhësore të shqipes (khs. psh. Postripa (nga para-fjala latine post „prapa, mbas” dhe apellativi rīpa „breg, ngriturinë” në rrethina të Shkodrës; Ripa (afër katundit Domni të Kavajës);²³ Rrīpa, një shkëmb, emrin e të cilin e kam shënuar vetë, në katundin Muzheçk të krahinës së Triepshit midis Shkodrës e Podgoricës e ndonjë tjetër, bën t’i shtohet edhe emri Ripa i një vendi në katundin Botushë të Gjakovës e ndoshta edhe emri Ripa i lokalitetit kodrinor të periferisë së Gjakovës buzë lumit të Erenikut në të cilin qenkan gjetur gypa të një ujësjellësi dhe një shtatore mashkulli të periudhës romake.²⁴ Ky mikrooronim është sajuar nga fjala latine rīpa, ae „breg, ngriturinë”. Këtu bie ndoshta edhe emri Ripanje i zhdukur i një katundi që ndodhej në një timar me kompleksin Ugrijat midis katundeve Grashticë e Mramuer të krahinës së Gallapit.²⁵

Mbetje onomastike nga latiniteti ballkanik do të jetë edhe emri Shtatuli i një kullote të gjerë pas vendit shkëmbor të quajtur Kisha në katundin Blaç të krahinës së Opojës. Edhe ky mikrotoponim do të jetë me prejardhje latine. Në të mirë të pararendimit se këtu kemi të bëjmë me një emër të shtresës latine-ballkanike do të shkonte edhe rrethana që në bazë të gërmimeve arkeologjike është dëshmuar se në këtë vend kishte në kohën e sundimit romak një statio²⁶ „stacion”. Vetë funksioni dhe pozita e vendit Shtatuli e lejojnë pararendimin se këtu kemi të bëjmë me një zgjerim dhe toponimizim përmes prapashtesës latine-romane -ul të zvogëlisë të një statio të paemër *Statul që vetëm me

²³ sh. Emil Lafe, *Toponime latine-romane në truallin e shqipes*, **Studime Ilire II**, Prishtinë, 1978, f. 133.

²⁴ Sipas Exhlale Dobruna, *Të Dhënat Arkeologjiko-Toponimike për Trevën e Gjakovës, Toponimia e Gjakovës me Rrethinë, Gjakovë*, 2002, f. 59.

²⁵ sh. Hamid Hadžibegić, Adem Handžić, Ešref Kovačević, **Oblast Brankovića, Opširni katastarski popis iz 1455. godine**, Orijentalni Institut u Sarajevu, Sarajevo, 1972, f. 303.

²⁶ N. Vulić, *Antički spomenici naše zemlje, Spomenik, SKA LXXI*, f. 91.

ndërmjetësimin e shqipfolësve do të ketë kaluar në trajtën Shtatul. Këtu kemi të bëjmë me kalimin e rregullt të togut konsonantik st- të latinishtes në sht- në shqipen si psh. striga → shtrigë, stratum → shtrat e shumë të tjera. Në të mirë të korrektësisë së pararendimit tonë do të fliste rrethana që një kalim i togut st- të latinishtes në sht- (siç do ta tregonte trajta Staçulina e emrit të një vendi afër Trogirit në brigje të Adriatikut, të cilin (emër) P. Skok e nxirrte poashtu nga lat. statio „station”.²⁷ nuk ndeshet as në sllavishten e as në rumanishten. Në këtë të fundit statio e latinishtes nuk jep një *ştatul, por një statul, përkatësisht statulet „qytet i vogël”.

Me prejardhje nga latiniteti ballkanik do të jetë edhe emri Gusha i një përrocke të katundit Koshare të Malësisë së Gjakovës e cila duke kaluar nëpër një grykë derdhet në Erenik. Ky hidronim është sajuar nga fjala latine që konsiderohet për latinizëm i pothuaj të gjitha gjuhëve të Ballkanit (khs. shq. gushë, rum. guşă, bullg. guša, serb. guša, greq. e re. γκούσα) me kuptimin primar „fyt” dhe me atë të dytin „grykë” në kuptimin e terminologjisë gjeografike-onomastike. Kjo fjalë ndeshet e përmbajtur dendur ndër mikrotoponime sidomos në Rumani, porse edhe në Bullgari, përkatësisht në Maqedoni. Përkitazi me prejardhjen e vetë kësaj fjale, mendimet janë të ndara: dijetarët rumunë e bullgarë e konsiderojnë këtë për fjalë të fondit autokton të rumanishtes, ndërsa gjuhëtari Henrik Barić kujtonte se kjo latinizëm ka hyrë në rumanishten me ndërmjetësimin e shqipes.

II.

Më të shumëta përkah numri dhe me përhapje më të gjerë janë mikrotoponimet e shtresës romane-ballkanike, përkatësisht të asaj që tradicionalisht i mbajnë për gjurmë të popullatës baritore (transhuman-te e nomade), përkatësisht të asaj „vllahë”.

Para se të sjell vetëm disa shembuj mikrotoponimesh të dëshmuara nëpër burime dhe syresh aktuale me prejardhje „vllahë”, po shënoj që të dhënat më të vjetra e njëkohësisht edhe të vetmet nga të cilat mund të mësohet diçka përkitazi me shtrirjen e vllahëve dhe sidomos përkitazi me vendbanimet blegtorale/baritore (në tekstin e mëposhtëm të quajtura katun,-e) në hapësirën e sotme të Kosovës gjatë shek. 13-14 mbeten disa

²⁷ khs. *Prilozi k ispitivanju hrvatskih imena mjesta, III*, Nastavni Vjesnik XI, f. 348.

krisobula, kartëdhurata, urdhëresa e dokumente të tjera të lëshuara nga kisha serbe dhe nga sundimtarë lokalë serbë të asaj kohe. Në këtë mes duhet pasur parasysh rrethanën që i gjithë dokumentacioni kishëtar serb ka të bëjë vetëm me një pjesë krejt të vogël të hapësirës mesjetare të Dardanisë (Kosovës) përkatësisht vetëm me vendbanime/vëllazëri vllahe që ishin bërë prona të qendrave kishëtare të Banjskës, Graçanicës, Deçanit e të Prizrenit e jo pra me gjithë hapësirën e Kosovës. Kjo edhe është arsyeja bazë përse duhet që kjo e vërtetë historike-gjuhësore domosdo të gjurmohet më tej sepse „vllhë” do të ketë pasur edhe në ato zona të Kosovës në të cilat (e kjo është pjesa më e madhe absolute e saj), në kohën e lindjes së këtij dokumentacioni, përkatësisht në kohën e ekspansionit në shek. 12 të principatës pushtuese të Rashës/ Rashkës dhe të kishës së saj, nuk kishte qendra kishëtare serbe. Këtë të vërtetë e dëshmon, fundja, sidomos prania e emrave vllhë të katundeve dhe të shumë mikrotoponimeve e edhe e disa emrave me prejardhje vllahe të vëllazërive gjithandej Kosovës së sotme.

II. 1. Mikrotoponime të dëshmuara në burime të shekujve 14-15, të sajuara nga emri etnik vllah [khs. emrat e katundeve Vllahinje në krahinën e Shalës së Bajgorës dhe emrin Vllahinje të regjionit të Hasit, të përmendur në vitet 1313-1318 dhe 1330 dhe sidomos emrin e mikroregjionit vlaška zemlja „Tokë, vend i vllhëve”,²⁸ banorët e të cilit quhen mbase edhe vlasi svetovrac’ski „vllhët e Shën Vraçit” i cili (mikroregjion) ka të bëjë pas gjithë gjasësh me banorët mesjetarë të hapësirës që sot e zënë katundet Kievë, Llashkadrenoc (nga një *Vlaški Drenovac „Drenovci i vllhëve”), Lubizhdë (i shënuar ndonjëherë edhe si vlaška Ljubizda), Gllarevë, Rixhevë dhe Plloçicë të komunës së Klinës; vlaška kućišta,²⁹ „shtëpitë e vllhëve” në rrethina të Prishtinës; Vllasë të regjionit të Gallapit dhe shumë mikrotoponime të dëshmuara në burime kishëtare serbe që e mbajnë artibutin vlaški/vlaška “i, e vllhve” nëpër gjithë hapësirën e Kosovës.

Nëpër burime kishtarë serbe janë dëshmuar edhe disa mikrotoponime posesive, në pjesën e dytë të të cilave përmbahet emri etnik i

²⁸ sh. Vatroslav Jagić, *Svetostefanski hrisovulj kralja Stefana Uroša II Milutina*, Wien, 1890. Banorët e këtij regjioni quheshin në vitin 1330 edhe Vlasi Svetostefanski „Vllhët e kishës/ manastirit të Shën Stefanit” të Banjskës (khs. edhe S. Milojević, *Dečanske hrisovulje*, *Glasnik Srpskog Učenog Društva* 12 (1880), f. 93.

²⁹ khs. tekstin: „megju dobroglëgje i arhidijače u kamenъ koi postaviše. kako putъ izlazi is krive vëje i përs putъ u dolъ i uz dolъ u vlaška kućišta ...”, *Dečanske hrisovulje*, f. 96.

vllhve në rasën gjinore të serbishtes vlaški, vlaška “i, e vllhve”. Të kësaj natyre janë psh. mikrotoponimet: Vlaški brod³⁰ „Vau i Vllhve” i cili është dëshmuar në dokumentin e viteve 1313-1318 dhe që ka të bëjë me vendin e quajtur edhe sot Llashki brodi në territor të katundit Dolc të Klinës; Vlaški laz³¹ „Shkorreti i Vllhve”, një vend i paidentifikuar që sajonte njërin ndër kufinj të midis katundeve Gjurgjevikë e Shtitaricë të Klinës:...” dhe Vlaška kućišta³² „Trojet; shtëpitë e Vllhve”, një vend poashtu i panjohur në kufij të katundit Arhidijača (katundi i sotëm shqiptar Harilaq/Halilaq midis Prishtinës e Gllogovcit), që përmendet në vitin 1330.

Nga mikrotoponime të këtij tipi, janë edhe ato të sotmet: Vlaška/(V)laškište, Vlaške livade e Laški potok ← *Vlaški potok [në katundin Vranisht], Vlaška, e Vlaška ravn - fushë, kullotë midis katundeve Mlikë e Vranisht, Vlaška padina; Vlaška ravn (tjetër); Laški put ← *Vlaški put, në Zli Potok, të gjitha në krahinëzën sllavishtfolëse të Gorës, të cilat i përmend madje edhe vetë pretendenti i tezës së prejar-dhjes serbe të goranëve - M. Lutovac,[33]³³ si edhe mikrotoponimi Vlahinica e ndoshta edhe ai Vlani sad (i pari në Borje e i dyti në Černolevë, si edhe patronimi Vlaša në katundin goran Pakish të rrethinave të Kukësit, [34]³⁴

Se emrat e mësipërm dhe të tjerë të kësaj kategorie janë të pandashëm me praninë fizike të elementit etnik vllah dhe të folësve të vllahishtes dëshmohet nga një numër jo krejt simbolik të mikrotoponimeve të sajuara nga antroponime vllahe [khs. Bunkov Vinograd „Vneshta e Bunk-ut” i përmendur në v. 1330, afër katundit Bërnjakë të rrethinës së Rahovecit, tek i cili ruhet antroponimi karakteristik vllh Bun; Papulova Rupa „Gropa e Papulit” midis katundeve Pagarushë e

³⁰ sh. Svetostefanska hrisoulja ..., f. 3.

³¹ khs. tekstin origj.: “A se megje štitarici s’gjorgjevikomъ ōd broda čestomъ na srъkvъ i ōd srъkve ouzъ dľbokii doľb.i ouzъ drougii doľb na vlaš’kii lazъ i ouzъ dĕľb nadъ vlahе ...” tek Dečanske hrisovulje, f. 25.

³² khs. **Dečanske hrisovulje**, f. , 27; 96: A se megja kumanovu ot radojeva č...]i arhidijače č...] u vlaš’ka kućišta. č...]i meg-ju belakjev’cъ.

³³ sipas: Sadik Idrizi Aljabak, **Aromunsko-vlaški tragovi u Gori (I-IV)**, fejton në http: // www.prizren-web.com/magazin/.

³⁴ Të cilat i ka shënuar N. Dokle sh. librin e tij **Për Gorën dhe Goranët**, (Artikuj e Studime), Prizren, 2002, f. 58.

Dobërdolan të Suharekës, i përmendur në vitin 1327; Tudorç Dol i dëshmuar në v. 1348 për në rrethina të katundit të sotëm Kërstec të krahinës së Gorës] e sllave dhe të zgjeruara edhe me prapashtesën karakteristike vllahe/aromune të zvogëlisë -šor [khs. Dabšor - vend, mbase në rrethina të Prizrenit, ku ishte një vreshtë, i përmendur në vitet 1198-1199 i së njëjtës prejardhje si edhe antroponimet Daboje, Dabko, Dabiživ të sllavëve; Skokšor ujëvare/theqafë në Bjeshkët e Nemuna në rrethina të Istogut, i dëshmuar në fund të shek. 13; Milišor, shkorret në rrethina të katundit Radesh të regjionit të Gorës, i përmendur në v. 1348 dhe mikrotoponimet e sotme Babshori në katundin Kralan të krahinës së Dushkajë të Gjakovës, Banishori - vend në katundin Kerninë të Istogut (që s'janë tjetër veçse zgjerime me prapashtesën karakteristike vllahe/rumune -šor të antroponimeve Bab- e Ban- të dëshmuara në burime të shek. 14 edhe si antroponime të shqiptarëve).

Nga grumbulli i mikrotoponimeve, të dëshmuara nëpër burime dhe sosh aktuale, të sajuara nga leksiku i folësve të vllahishtes vlen të përmenden: Kračunista - vend midis katundeve të sotme Studenčan de Reshtan të komunës së Suharekës, i dëshmuar në vitet 1327 e 1348 (emër që mbase nuk ka të bëjë me nocionin rumun crăciun, përkatësisht seara crăciunului „Kërshëndellat; përkatësisht „Nata e kërcûnit; Nata e buzmit”, porse me apelativin rumun crăciun i afërt me të shqipës kërcû „trup lisi; cung” të cilin unë e shoh të ruajtur tek mikrotoponimi Kërcûna zéz, mal me dru ahu në katundin Sedllar të krahinës së Hashanisë në kufirin e sotëm midis Kosovës e Serbisë.³⁵

Në hapësirën e Kosovës ka edhe mikrotonime aktuale, të padëshmuara nëpër burime, që janë me prejardhje vllahe. Të këtillë janë emrat Kodra e Koronës në Istog dhe Koroniqet në katundin Cercë të Istogut,³⁶ në mesin e të cilave s'do të ishte mbase gabim të inkuadrohej edhe emri Koronica i katundit të rrethinave të Gjakovës. Në drritën e rrethanës që një oronim Korona dëshmohej edhe në zonën karakteristike romane ballkanike në të cilën gjenden edhe emrat karakteristikë vllahë *Durmetor/Durmitor, Negrišor, Bukor, Visitor, Rumska, Vlašić* e ndonjë tjetër e lë të hapur shtegun të besohet që këtu kemi të bëjmë

³⁵ I shënuar në terren nga Bahtijar Kryeziu, **Onomastika e Hashanisë**, Prishtinë, 2000, f.110.

³⁶ Të shënuara në terren nga Jusuf Osmani, **Vendbanimet e Kosovës 12**, Burimi (Istogu), Prishtinë, 2004, f. 79, 88.

me emra të sajuar nga apelativi lat. corona “kunorë” khs. rum. coroañ “kurorë” si edhe në hapësirën e sotme të Maqedonisë për ku, jo larg nga vendbanimi Arbanas i shek. 15 - që ishte në rrethina të Kërçovës, dëshmohet edhe një vend i quajtur Korun.³⁷

Me prejardhje nga leksiku i variantit latin, përkatësisht nga brumi leksikor i romanishtes ballkanike (= vllahishtes/arumanishtes) do të jenë edhe emri *Kashkavalli* i një mali në katundin Cercë të Istogut, emri i të cilit lidhet me fjalën *kashkavall* të një lloji të djathit që në rumanishten njihet si *cașcaval* dhe që prej andej do të jetë përhapur edhe në gjuhë të tjera të Ballkanit dhe mtp. *Carina; Carinat* ara e fusha në katundet Hoçë e Madhe, Zoqisht e Opterushë në rrethina të Rahovecit, që rrjedhin nga rum. *țàrină* “arë, ugar, 2. tokë e katundit”]; Maqina, i dëshmuar në vitin 1348 si Maćinci,³⁸ “banorë të vendit Maqina”, afër katundit të sotëm Senik të Rahovecit. Emra vendesh të quajtura kështu ka edhe në disa katunde të rrethinave të Rahovecit dhe në Rahovecin vetë. Kështu, në Rahovec është mikrotoponimi Maqina; Maqina quhet dhe një vend në katundin Potoçan i Epërm; një hapësirë toke midis katundeve Nushpal, Potoçan i Epërm dhe Drenovc quhet poashtu Maqina.

Si emri i vendbanimit mesjetar ashtu edhe emrat e sotëm mund të shpjegohen me foljen rumune a mácina “bluaj” i zgjeruar me prapshitesën serbe *-ci* me të cilën, në rastin tonë, tregohet edhe mjeshtria me të cilën merret një vëllazëri konkrete. Vetë folja *mácin/mácina* rrjedh, sipas Sextil Puscariu,³⁹ nga lat. **machino, machinare* ose *macinare*; khs. lat. *machināri* (prej nga rrjedhin ital. *machināre*, span. *Maznar*, velot. *maknur*; arum. e meglenorum. *mařin*, istrorum. *mořiru*.)⁴⁰ Tek emrat e mësipërm kemi të bëjmë me emra vllah të moti-

³⁷ Blaže Koneski, **Makedonski Mesta i iminja**, NIO, Studentski zbor, Skopje, 1991, f. 33.

³⁸ khs. J. Šafarik, *Hrisovulja cara Stefana Dušana, kojomь osniva monastirь sv. Arhangela Mihaila i Gavrilja u Prizrenu godine 1348 ?*, **Glasnik Društva Srbske Slovesnosti**, 15, Beograd, 1862, f. 276: „Selo sěnjani. a megja mou z doubljany ot potoka ouzdolь na děľ koudě bělegě postavisьmo. a ot megje doubljanyške routemь po dělou do bělěga. i vьlou sěnjamь megjā s potočany i s maćinci ...”.

³⁹ khs. **Etymologisches Wörterbuch der rumänischen Sprache** (Lateinisches Element), Heidelberg 1905; Alejandro Cioranescu, **Dictionario etimologico rumano**, Madrid, 1966, f. 492.

⁴⁰ Fr. Miklosich, **Die Romanischen Elemente im Albanischen**, ..., f. 37 i shkruan fjalët italiane si mácina „mokën”; macinare „bluaj” dhe rum. mấtsin; mrum. matzen „bluaj”.

vuar nga puna, e bluarjes, të vëllazërive gjegjëse; Shtubeja burim në katundin Poklek të komunës së Glllogovcit nga rum./vllah. *ştiubei* “burim”, që në hapësirën gjuhësore të rumanishtes ndeshet e përmbajtur në emrat e vendeve *Dealul Ştubeilor, Ştubeiul, Ştubeiul-Oroşti* dhe në krahinën e Banatit etj. dhe që gjithandej e ka kuptimin “burim”; Flori - vend në katundin Prapashticë të Prishtinës (në hapësirën e të cilit ekzistojnë edhe mikrotoponimet Laki i Florit dhe Shkozat e Florit (që, të gjitha, e heqin prejardhjen nga fjala rumune floare “lule” (nga lat. florem) duke e përfshirë këtu edhe emrin Nekshor të vëllazërisë, të sajuar nga antroponimi Nek- (që e mbajnë edhe shqiptarët) i zgjeruar poashtu me prapashtesën karakteristike vllahe -*şor** si edhe emrin Brajšhori të një vëllazërie të këtij katundi); Kampula në katundin Marec të Prishtinës (khs. rum. *cîmpul* “fushëzë”); Paskalica, vend që sipas tekstit që përmbahet në një krisobulë të sundimtarit serb Stefan Uroš të vitit 1327,⁴¹ del se ishte pikë kufiri e katundit Shtitaricë, përkatësisht Tuçep të komunës së Klinës.⁴²

Emri i dëshmuar Paskalica i vendit në të cilin paska pasur edhe një kishë është ruajtur/vazhduar deri në ditë tonat si emër homonim i vendbanit të rreth 10 familjeve shqiptare të besimit katolik, të cilin administrata e kishte regjistruar për pjesë/lagje të katundit Videjë të komunës së Klinës. Përveç si emër vendbanimi, emri mesjetar është ruajtur edhe në mikrotoponimin Lugu i Paskalicës. Nëse mund t’u besohet sqarimeve që i sjell J. Osmani,⁴³ ka mundësi që këtu kemi të bëjmë me një vendbanim të quajtur sipas emrit të një kisha, ekzistimin e së cilës në këtë katund e dëshmon mikrotoponimi aktual Ara e Kishës i këtij katundi.

Unë i shoh për si të pranueshme dy interpretime të mundshme të emrit Paskalica. Ky emër mund të rrjedh nga emri latin pascha që shenjonte kremten e rrshajave, emër ky që nga ana tjetër, është huazim e trajtësim i pesah/pesach të një feste të vjetër ebreite, si shenj për-

* Romanisti i njohur kroat, Prof. August Kovačec më këshillonte që ta marr parasysht edhe mundësinë që ky emër mund të rrjedhë nga emri i dëshmuar dendur *Neg- për si i vllëve dhe praapashtesa -şor.

⁴¹ J. Šafarik, **Pamatky** ..., f. 96. : „[...] na desno poutemь vyše paskalice na dělь [...]”

⁴² Sipas Mitar Pešikan, *Iz istorijske toponimije Podrimlja, Onomatoloski Prilozi, II*, SANU, Beograd, 1981, f. 54.

⁴³ **Vendbanimet e Kosovës**, 3, *Klina*, Prishtinë, 2003, f. 110.

kujtimi i dyndjes së ebreitëve nga Egjypti. Në të mirë të këtij interpretimi do të fliste rrethana e ditur që emri i kësaj feste (khs. më lart) është reflektuar në shqipen si Pashkët. Interpretimi i dytë i mundshëm do të ishte që në emrin tonë të përmbahet antroponimi roman Pascal⁴⁴ i zgjeruar, përkatësisht i toponimizuar më vonë, me prapashtesën sllave -ica antroponim ky që është ruajtur e vazhduar nga shqiptarët në përputhje me reflektimin karakteristik për shqipfolësit: khs. emrin personal m. Pashk,-u, fem. Pashk/e,-ja). Prej këndeje do të rezultonte që ky emër mund të jetë vazhduar nga shqipfolësit, pa iu pas dhënë reflektimi karakteristik shqiptar; Mosha: Kështu quhet një mal, kodër në katundin Bllacë të komunës së Suharekës. Ky emër është me prejardhje vllahe, jo vetëm pse ndodhet në hapësirën e katundit të cilësuar në vitin 1348 si vllhë të Bllacës, përkatësisht vlasi blat'čani, por pse edhe është sajuar nga një mbiemër apo antroponim me prejardhje vllahe, rumune. Të së njëjtës prejardhje (khs. më poshtë) si emri Mosha i malit të Bllacës janë mbase edhe emri Mosheli - një mal në katundin Temal të Shqipërisë së Veriut⁴⁵ dhe Kroni Mosheqit - një burim uji në katundin Gropa në rrethina të Pukës,⁴⁶ poashtu në Veri të Shqipërisë. Të së njëjtës prejardhje si emri kosovar dhe emrat në Shqipëri të Veriut janë edhe emrat e vendeve Mošulj, një mal në regjionin Toplica të Serbisë së Jugut; Mošino, emri i një katundi në jugperëndim të Sofjes (Bullgari), Mošinci, katund afër Deževo-s në Serbi, si edhe vendet Mošonaiele, Mošoaiiele Mari e Mošoaiiele Mici në Rumani. Kur po e shkollonte çështjen e timologjisë së emrave që u sollën më lart (pa toponimet shqiptare) G. Weigand⁴⁷ mendonte se këto emërtime qenkan sajuar nga mbiemri rumun moaşa “i moçëm” (i huazuar në rumanishten nga shqipja mosh/ë,-a “moshë, vjetërsi”); Fr. Miklosich⁴⁸ shtonte se kjo fjalë e

⁴⁴ Më shumë përkitazi me prejardhjen e këtij emri khs. Christian Ionescu, **Mică enciclopedie onomastica**, Bucureşti, 1975 230-231; Në të mirë të prejardhjes vllahe të këtij emri flet rrethana që këtu mungon ndërmjetësimi i fenomenit të togut -sk- në sh të antroponimit Pascal, i cili në shqipen është reflektuar si Pashk,-u, f. Pashk/e-ja.

⁴⁵ sipas Fluvio Cordignano, **L'Albania a traverso l'opera e gli scritti di un grande missionario italiano il P. Domenico Pasi S. I.** (1847-1914), vol. III, Roma, 422.

⁴⁶ Poai, poaty

⁴⁷ sh. **Rumänen und Arumunen in Bulgarien**, Leipzig, 1907, f. 44.

⁴⁸ **Über die Wanderung der Rumänen in den dalmatinischen Alpen und in den Karpaten**, Wien, 1879., f. 59.

ka po atë kuptim “gjysh” të rumanishtes moşulū edhe ukrainishten, ku kjo ka hyrë në trajtën moşul, ndërsa E. Petrovici⁴⁹ i interpreton emrat rumunë të vendeve për si të dalaur nga një antroponim Moş, ndërsa I. Jordan⁵⁰ si edhe Al. Rosetti⁵¹ i shohin këta emra të jenë sajuar nga mbiemri rum. moş „i moçëm” e shumë emra të tjerë.

II. 2) Sipas vendeve ku jetonin në kohën para kohës së lindjes së këtyre burimeve

Nga materiali onomastik/gjuhësor dhe nga të dhëna të pakta jashtëgjuhësore mbetet e paqartë përse disa vëllazëri vllhësh, të cilat në këto burime u quajtën sipas vendeve ku u ngulitën: (khs. vllhët e quajtur *govnečije* “të Govn”-it; [në vitin 1220]; *bareljev’ski* “të Barelit” [në vitet 1313-1318]; *kostërčani* “të Kostercit” [1348]; *pagarušani* “të Pagarushës” [1348], *vardištani* [1330] “të Vardishtës”; *sušičani* “të Sushicës” [1330]; *sremljani* [1330] “të Sremit”; *goinovci/goilovci* “të Goinos” [1330]; *dobrodoljani* “të Dobërdolit” [1330] mbase pse ishin vendosur në vendet e quajtura *Govънъ*, *Barel*, *Kosterc*, *Pagarusha*, *Vardishta*, nga regjioni Srem i Panonisë, Dobërdol kohë përpara vendosjes së tyre aty.

II. 3). Sipas emrave të pararendësve

Të kësaj kategorie janë emrat e dëshmuar në burime kishëtare serbe e osmane-turke të shekujve 14-15: si: proilovci [në vitet 1313-1318], katundi i sotëm Prellovc në shpatije të bjeshkëve të Çiçavicës: (vëllazëri që për të parë e kishte një të quajturin Proil) *dragoljevci* [1348], (pjesëtarë të vëllazërisë me emrin e një pararendësi të quajtur Dragol) katundi i sotëm Draolevc/Dragulevc i komunës së Istogut; *turoričevci* [në vitin 1330 i dëshmuar shprehimisht për katun i vllhve] (katundi i sotëm Turiçevc i komunës së Skënderajt), që do të kenë qe-

⁴⁹ sh. *Oronime din antroponime in Carpații romanești*, Studii și materiale de onomastica, București, 1964, 67.

⁵⁰ sh. **Toponimia romanească**, 33. Cit. sipas, I. I. Russu, **Etnogeneza românilor. Fondul autohton traco-dacic și componenta latino-romanică**, Edit. Științifică și enciclopedică, Bucharest, 1981, f. 360; khs. edhe .M. Scărlatoiu, *Emprunt roumains dans les lexique serbocroate*, **Revue des études sud-est européennes**, 10 (1972), f.120.

⁵¹ khs. *Istoria limbii române*, București, 1968, f. 431.

në pjesëtarë të një vëllazërie që për të parë e kishte një të quajturin Tudor); *bobojevci* [1330] (katundi i sotëm Bubavec i komunës së Klinës) që do të kenë qenë pjesëtarë të një vëllazërie me pararendës një të quajtur *Bob-(oje)*; *golubovci* [1330] (katundi i sotëm Gullboc i komunës së Klinës), pjesëtarë të një vëllazërie me pararendës të quajtur Golub); *lepčinovci* [1330] (vendbanim vllahësh i rrethinave të Istogut, emri i të cilit nuk është ruajtur), me pararendës një të quajtur Lepčin); *gjuraševci* [në vitin 1330 i cilësus shprehimisht për katun i vllahëve], njëri nga katundet e sotme Gjurgjevik i Madh e Gjurgjevik i Vogël të komunës së Klinës, me pararendës një të quajtur Gjuraš); *kostadinovci* [në vitin 1330 i cilësus shprehimisht për katun i vllahëve, banorët e të cilit duhej t'i kullotnin llaçumitë e pelave të kishës]. Kjo vëllazëri (me pararendës një të quajtur Kostadin) do të ketë jetuar në rrethina të Istogut, por emri i tij nuk është ruajtur.

Me prejardhje antroponimike është edhe emri Mushtisht i katundit të komunës së Suharekës. Dëshmia më e vjetër e emrit të këtij vendbanimi rrjedh nga dokumenti i hartuar midis viteve 1313-1318, kur është shënuar në trajtën e vendores sllave “ou M’šoutišihь”,⁵² në vitin 1348 në trajtën “selo M’šoutišta”;⁵³ në vitin 1454 në trajtën “od M’šoutišь”;⁵⁴ në vitin 1465 si “selo Mušutište”.⁵⁵ etj.

Emri i këtij vendbanimi është me prejardhje antroponimike. Rrjedh nga antroponimi Mušat, ndërsa ky vetë nga mbiemri rumun, vllah mušat i zgjeruar me prapashtesën rumune *-ești* me kuptimin “i bukur, fort i bukur”, përkatësisht fr. “gentil, joli, joliet”.⁵⁶ Vetë mbiemri vllah, përkatërisht aromun *mušat* është refleks i mbiemrit latin *formosus*: (*for*)*mosatus* > *mušat* i cili ndeshet në gjithë zonën e rrjedhës së poshtme të Danubit, tek meglenorumunët e Greqisë e deri edhe tek Istrorumunët. Megjithatë, pikërisht për shkak të trajtës në të cilën reflektohet, antroponimi *Mušat*

⁵² Khs. **Svetostefanska hrisovulja** ..., f.

⁵³ Hrisovulja ..., f. 278.

⁵⁴ Solovjev, **Odabrani spomenici** ..., f. 215.

⁵⁵ Kosta N. Kostić, *Pomenik manastira Sv. Troice kod Prizrena*, **Spomenik SKA XLIX**, sipas I. Jastrebov, *Podaci za istoriju crkve u Staroj Srbiji*, **Glasnik Srpskog Učenog Društva XLII**, Beograd 1875, f. 360 - 361.

⁵⁶ Për kuptimin khs. psh. T. Papahaghi, **Dictionarul aromân general și etimologic**, București 1974, f. 841; Alejandro Cioranescu, **Dictionario etimologico rmano**, Madrid 1966, f. 548.

konsiderohet për antroponim karakteristik i vllahve dhe i arumunëve. I këtij formanti do të jetë, sipas mendimit tim të mbështetur mbi rezultate të gjurmimeve të të tjerëve, edhe emri *Nishor* i një katundi të komunës së Suharekës, i cili në vitin 1348 dëshmohej në trajtën *Vinišor*, përkatësisht *Vinišorski grab* si edhe *katunъ petrъčъ vlasi* “katuni Petërç” i vllahve” (të Petrit?/ *Pjetrit) [1330].

Midis vendbanimeve të dëshmuara në burime osmane-turke të shek. 15-16 në këtë kategori bien edhe emrat *Hërçuri* -emër i zhdukur i një katundi që mbase do të ketë qenë afër katundit të sotëm *Kolloleq* të komunës së Gjilanit, i dëshmuar gjatë viteve 1455-1487 herë si truallishte *Hrçuri* e herë si vendbanim aktiv *Hërçur* e *Hërsofc*.⁵⁷ Ky emër është trajtë e toponimizuar e emrit të një vëllazërie të quajtur *Hërçur*-i. Vetë emri i vëllazërisë e ka për prejardhje antroponimin vllah, rumun *Hrs*, i cili i heq rrënjët nga antroponimi latin *Ursus*, i reflektuar në rumanishten me prapashtesën karakteristike rumune *-ul* si *Ursul*, prapashtesë kjo e cila nuk ka gjë të përbashkët me mbaresën *-us* (*ursus*) të latinishtes dhe pjesa e parë e emrit *Bukurdoll* i dëshmuar për vendbanim më vete në vitin 1455⁵⁸ e që ka të bëjë me një pjesë të katundit të sotëm *Sallâbajë* të Podievës, duke e përfshirë këtu edhe emrin e zhdukur *Bukurenc* të një katundi të dëshmuar në burime osmane të shek. 15 e 16 që, sipas J. Osmanit,⁵⁹ paska qenë në rrethina të Kaçanikut dhe emrin Bukurovcë të katundit në Luginën e Preshevës që e kanë për rrënjë antroponimin karakteristik vllah *Bucur* me kuptimin përafërsisht apo plotësisht si antroponimet moderne Gëzim, Gazmend e Lum të shqiptarëve; emri *Sharban* i katundit të komunës së Prishtinës, i dëshmuar në defterin osman të regjistrimit të vitit 1455⁶⁰ si *Šarbanovci*, i sajuar si rezultat i toponimizimit të emrit të vëllazërisë që për pararendës do ta ketë pasur një bartës të antroponimit karakteristik *Šarban/Šerban* përkatësisht *Šerbu* fem. *Šerba* i vllahëve, i cili i heq rrënjët nga emri më i vjetër **Servus* **Serva* i latinishtes, përkatësisht nga rum. *šerb* “bujkrob”);

II. 4) Emra me prejardhje nga brumi leksikor i vllahishtes

⁵⁷ **Oblast Brankovića** ..., f. 206, 309

⁵⁸ Poaty, f. 279

⁵⁹ khs. **Vendbanimet e Kosovës 10**, *Kaçaniku*, Prishtinë 2004, f. 120, i cili mbështetet tek botimi **Turski dokumenti za istorijata na makedonskiot narod, Opširni popisni defteri od XV vek, Tom III**, Skopje, 1976, f. 157.

⁶⁰ **Oblast Brankovića** ..., f. 80.

Me prejardhje nga brumi leksikor i romanishtes ballkanike/ vllahishtes do të jetë emri Shaptej i katundit të rrethinave të Deçanit, (i dëshmuar në vitin 1330), i cili rrjedh nga numërori *şapte* “shtatë” i vllahishtes. Në dritën e bashkëjetesës, simbiozës dhe sidomos të “shqiptarizimit” të vllahëve nuk duhet të shihet për e papritur që madje edhe emri Flokocvi i katunit të arbanasëve i vitit 1348 mund të jetë me prejardhje vllahe.

Sadoqë në veprën e tij madhore⁶¹ e shprehte mendimin se emri i këtij katuni të arbanasëve do ta ketë marrë emrin për shkak se banorët e tij „dalloheshin për flokë të gjata” që i banin dhe se vetë kjo fjalë rrjedh nga varianti latin-ballkanik i lat. *floccus*, në një punim të tijin më të hershëm⁶² P. Skok e lejonte mundësinë që ky emër të rrjedh nga emri i pjesës së veshjes flokata që, sipas këtij dietari, tek toskët korrespondon me emrin aromun *şipunea* të veshjes, ndërsa fjala flokatë është sipas tij e huazuar nga vllahët. Sqarimit ndryshe të këtij emri nuk do t'i ndihmonte as lidhja e kësaj fjale me lëvizjen tradicionale të vllahëve midis kullotave të verës e të dimrit, kur këta merrnin me vete “shtroje të leshta me flokë” që gjendet tek M. G. L. Hammond⁶³. Ky katun i blegtorëve arbanasë ishte, sipas autorit kosovar Dr. J. Osmani,⁶⁴ në vendin e quajtur *Flokat* (mbase duhet *Flòkat*) në katundin e sotëm Lutogllavë midis Suharekës e Prizrenit.

Me prejardhje vllahe do të jetë edhe emri i katunit *Shpinadija* të arbanasëve *şpinadinci* të rrethinave të Prizrenit, i dëshmuar në vitin 1348⁶⁵ Emri i këtij katuni rrjedh më parë si rezultat i oikonizimit të një vëllazërie me pararendës një të quajturin *Spin, përkatësisht *Shpin- (khs. psh. dëshmitë: Gjon-i, i bir i Shpin-it, banor i katundit Baloz, sot Balc të rrethinave të Shkodrës⁶⁶) i zgjeruar me formantin sllav -ad

⁶¹ **Etimologijski rjecnik hrvatskog ili srpskog jezika, I**, Zagreb, 1971.

⁶² khs. punimin e tij: *Iz Rumunjske Literature o Balkanskim Vlasima*, në **Glasnik Skopskog Naučnog Društva, Vëllimi II, Fashikulli 1-2**, Shkup, 1927, f. 307.

⁶³ në **Epiri: I. Udhëtime në Epir dhe Shqipërinë Jugore; II Epiri dhe Pushtimi i Greqisë**, Tiranë, 2004, f. 60-61

⁶⁴ **Vendbanimet e Kosovës 18**, Prizreni, Prishtinë, 2006, f. 144.

⁶⁵ sh. *Hrisovulja cara Stefana Duşna, koiomъ osniva monastirtъ sv. Arhangela Mihaila i Gavrilja u Prizrenu godine 1348 ?*, **Glasnik Društva Srbske Slovesnosti**, 15, Beograd, 1862, f. 279.

⁶⁶ khs. Selami Pulaha, **Defteri i regjistrimit të sanxhakut të Shkodrës i vitit 1485**,

dhe prapashtesën *-inci* të shumësit sllav se sa nga romanishtja ballkanike **spinu* ose vllah.-rum. *spin* “drizë, therrë, kaçubë” sikur mendonte N. Jokl,⁶⁷ i cili e lejonte porse edhe interpretimin shumë popullor me të shqipes *shpin a din?* “a e di shtëpinë?”

Një toponim tjetër vllah i po kësaj hapësire është edhe emri Guncati, i dëshmuar në vitin 1348 shprehimisht për si katun i vllahëve), katundi i quajtur sot *Ngucat* në rrethina të Suharekës, emri i të cilit (katun) rrjedh nga ballkanizma, mbase me prejardhje vllahe, *gună*⁶⁸ „gunjë; veshje e leshtë barinjsh”. Territorialisht bukur larg nga kjo pjesë e Kosovës, me prejardhje nga bumi leksikor i vllahishtes është edhe emri *Makresh*, i dëshmuar midis viteve 1438-1440 si *Machrexa* (lexo *Makresaha*) dhe në funksion të ktetitikut *Maxresanin*⁶⁹ “që vie nga vendbanimi *Makresh*” i komunës së Gjilanit apo i lagjes së sotme *Makresh* të katundit *Marec* të komunës së Prishtinës, përkatësisht Novoberdës (nga apelativi rumun *măcriș* (bot. *Rumex acetosa*) shq. “lëpjetë, lpetër, lakna t’livadhit”; emri i zhdukur *Negrisor* (lexo *Negrishor*) i një katundi i regjionit të Gallapit, i shënuar po në vitet 1438-1440 bashkë me emrin *Stanixor*⁷⁰ - katundi i sotëm *Stanishor* në rrethina të Kamenicës e të Novoberdës (duke përfshirë këtu edhe mikrotoponimin Stanistur në katundin Busijë të rrethinave të Prishtinës); si edhe emri i zhdukur *Seliștor* i një vendbanimi, i dëshmuar në vitet 1566-1574 në regjionin e Gjilanit, bashkë me emrat e katundeve *Firiqejë*, (nga vllahishtja *ferigă* “fier” - duke përfshirë këtu edhe mikrotoponimin *Kroi i Firiqit* në katundin Blaç të krahinës shqipfolëse të Opojës); *Korbuliq*, (nga rum. përkatësisht latiniteti ballkanik *corbul* “korb” i shpendit (zool. *Corvus corax*); *Magura* midis Prishtinës e Fushkosovës (duke përfshirë këtu edhe mikrotoponimin homonim midis katundeve Dazhnicë e Kostadincë të Kamenicës) e shumë të tjerë.

III. Venerime përmbyllëse

Në dritën e pranisë së mikrotoponimeve me prejardhje nga lati-

Tiranë, 1974, f. 157.

⁶⁷ khs. punimin e tij *Katun. Zur Geschichte eines Balkan- Wortes*, **Indogermanische Forschungen** 33/1919, f. 423-424.

⁶⁸ khs. psh. Al. Rosetti, **.Istoria limbii române**, București, 1968, f. 432.

⁶⁹ khs. M. Dinić, **Iz Dubrovačkog Arhiva I**, Beograd, 1957, f. 19, 41, 51, 75, 79, 81.

⁷⁰ Poai, Poaty, f. 51, 71.

niteti ballkanik, të cilat ndeshen kryesisht në Bjeshkët e Nemuna, në Malet e Sharit e në ato të Pashtrikut dhe që u vazhduan deri në ditë tonat nga shqipfolës të këtyre hapësirave, ka arësye të shtrohet (edhe) pyetja se cila etni i kishte emërtuar këto vende. Po u pat parasysh rrethana që këto mikrotoponime dëshmohen në vise të larta malore ku nuk do të ketë pasur civilizim latin-romak, mund të mendohet me shumë të drejtë se këtu kemi të bëjmë me emërtime të vendësve. Po të jetë kështu, do të vërtetohej konstatimi largpamës i njohësit më të mirë të historisë së Ballkanit K. Jireček, i cili ishte i mendimit se ndër romanët ballkanikë, përkatësisht vlllehët, përveç kolonëve romakë kishte edhe ilirë autoktonë, përkatësisht të romanizuar kështu që “romanët në territorin në jug të Danubit ishin të ndarë nga romanët e bregdetit dalmatin nga një vis malor i cili ishte në pjesën më të madhe të tij i banuar nga ilirë që ende nuk ishin romanizuar plotësisht dhe se pasardhës të këtyre ilirëve janë shqiptarët e sotëm.” Përafërsisht kështu shprehej shumë vite më vonë edhe dijetari Windisch, i cili vërente se vlllehtë e territorit të Dardanisë duhet të shihen në parim si popullatë e Ballkanit të Jugut, përkatësisht si popullatë e romanizuar ilire e trakase e cila nga pushtues të ndryshëm u dëbua nga viset rrafshinore-bujqësore dhe që në male të larta të Dardanisë u ruajtën bukur mirë duke u marrë me blegtori transhumante .

Ndryshe qëndron puna e prejardhjes së mbetjeve onomastike të elementit roman ballkanik. Kjo sepse si antroponimia e banorëve të vendbanimeve blegtorale/ katuneve vllahe ashtu edhe një pjesë e oikonimeve dhe e mikrotoponimeve të dëshmuara nëpër burime kishtare serbe të shekujve 13-14 është sajuar nga brumi leksikor latin-ballkanik që është konform me veçoritë morfologjike e fonetike të arumanishtes. Kjo rrethanë i del krah paravendimit se këtu kemi të bëjmë me mbetje onomastike të elementit etnik e gjuhësor aromun që në hapësira të Dardanisë u vendos midis shekujve 10-12 nga hapësira e perandorisë jetërshkurtër bullgare, përkatësisht përpara pushtimit dhe etablimit të krijesës shtetërore në ekspansion të principatës së Nemanjidasve të Rashës/Rashkës në hapësira të Kosovës së sotme. Kjo popullatë erdhi në vise të Dardanisë pothuaj se e bullgarizuar si në rrafshin onomastik ashtu edhe në atë gjuhësor.

Përkundër tezës sipas së cilës vlllehët e hapësirës së sotme të Kosovës bashkë me sish të Luginës së Vardarit, siç mendon Zef Mirdita,

në shekujt 14-15 “kishin migruar drejt Veriut dhe ishin vendosur në Luginën e Timokut e të Moravës. Pjesa tjetër e atij elementi vllah shkoi po në atë kohë drejt Nish-it dhe përmes Luginës së Nishavës depërtoi deri në Srednja Gora të Bullgarisë dhe pastaj nga Sofia drejt veriperëndimit deri tek kufiri i Serbisë. Në Mal të Zi e në Hercegovinë vllehtë janë identifikuar në shek. 14.”⁷¹ e njëkohësisht edhe në Dalmaci e deri në Istri, unë kujtoj se këtu kemi të bëjmë më parë me procesin e përfunduar në shek. 15 të deromanizimit të vllahëve, përkatësisht që pjesa e popullatës ardhëse romane e vendosur në e rrënzë Bjeshkëve të Nemuna, Sharit, Pashtrikut dhe pjesës shqiptare të Kopanikut u shqiptarizua, ndërsa pjesa e vendosur në vise rrafshinore, përkatësisht rreth Rahovecit, në Rrafsh të Kosovës dhe pjesërisht në rrethina të Novoberdës e të Gjilanit u serbizua.

⁷¹ Vlasi, *polinomičan narod; Povijesni prilozi 33*, Hrvatski institut za povijest, Zagreb, 2007, sipas www.paundurlic.com/forum.vlasi.srbije

Evalda PACI, Tiranë

ELEMENTE LATINE NË SHQIPE DHE RUMANISHTE (VËSHTRIM SEMANTIK DHE TIPOLOGJIK)

Abstrakt

Elemente latine të shqipes, çështje të identifikimit dhe periodizimit të tyre në studimet albanologjike. Përcaktimi kronologjik i ndikimit nga latinishtja: emërtesa të përdorura në lidhje me latinishten në traditën e studimeve mbi historinë e shqipes.

Elemente latine në rumanishtë: çështje të ndikimit nga latinishtja ballkanike. Dallim objektiv midis ndikimeve të latinishtes në shqipë dhe në rumanishtë.

Elemente latine të përbashkëta në të dy gjuhët: fusha leksikore të dallueshme: emërtime të pjesëve të trupit, të fushës së liturgjisë, emërtime gjallesash a bimësh, perkime në fusha të caktuara (folklor), shembuj të transferimit të kuptimit të fjalës latine në të dy gjuhët.

Çështje të gjurmimit të elementeve latine të përbashkëta mes dy gjuhëve në studimet shqiptare: të dhëna dialektore nga studimet etimologjike mbi shqipën.

Shqipja dhe rumanishtja mbeten dy gjuhë të arealit ballkanik që ofrojnë qasje të rëndësishme për studiuesit e gjuhësisë ballkanike, albanologjisë si edhe të gjuhësisë romane.

Studimet ekzistuese kanë evidentuar vështirësitë që paraqet shkalla e arritjeve të ndriçimit të periudhave më të errëta të prehistorisë së secilës prej të dyja gjuhëve, rrugët e veçanta të evolucionit që në drejtim të rumanishtes shfaqen jo vetëm me një periudhë të ngjeshur të romanizimit të popullsisë banore të Mizisë, Dakisë por dhe me një diferencim progresiv dialektor që shënon njëkohësisht një prej veçantive themelore të karakterizimit tipologjik të kësaj gjuhe të Ballkanit.

Këto dy gjuhë historikrimi i të cilave fillon me anë veprash hagio-grafike apo përkthimesh tekstesh liturgjike¹, mund të qasen në pikëpamje të marrëdhënies (dhe ndikimit) me gjuhë të tjera jo vetëm indoevropiane si dhe në drejtim të elementeve leksikore të përbashkëta të fushave të ndry-

¹ Shih dhe Bourciez, É. : *Éléments de linguistique romane*, Paris, Librairie Klincksieck, 1967, f. 546-548.

shme semantike. Të dyja gjuhët kanë pasur kontakte të vërtetuara mes tyre, fakt ky që shpjegon dhe mjaft përkime të mundshme sidomos në fushë të leksikut apo dhe të folklorit.

Një moment i rëndësishëm mbetet ai i ndikimit të tyre nga latinishtja, pikërisht nga një gjuhë historia e së cilës karakterizohet nga një linjë e qenësishme: prestigji territorial i saj, gjurmët e dukshme në fusha të ndryshme të civilizimit, në drejtim të leksikut dhe të nënsistemeve të tjera gjuhësore që shkojnë paralelisht me shtrirjen politike të sundimit të përdoruesve të saj. Pikërisht dhe çështja e shtrirjes së ndikimit në nënsisteme të caktuara gjuhësore përbën një prej dallimeve kryesore kur bëhet fjalë për të trajtuar elementin latin në shqipe dhe në rumanishte.

Një problem po aq i rëndësishëm mbetet dhe mbijetesa dhe rrugëtimi i elementeve latine dhe në periudha që pasojnë përfundimin e procesit të romanizimit dhe përballjes së të dyja gjuhëve me të tjerë faktorë ndikimi, qofshin këto dhe nga gjuhë të tjera, të ndryshme nga latinishtja. Siç dihet, studiuesit mendojnë për periudha të ndryshme të ndërprerjes respektive të këtij ndikimi.²

Në pikëpamje të gjenealogjisë së saj shqipja njihet si gjuhë më vete e familjes gjuhësore indoevropiane, ndërsa rumanishtja vështrohet si një gjuhë romane e formuar në një substrat specifik të ndryshëm nga ai i gjuhëve të tjera të së njëjtës familje dhe që gjeografikisht mund të ndodhen më afër qendrës së latinitetit. Përcaktimit të rumanishtes si një gjuhë romane e formuar në një truall (substrat) ku ka vepruar i ashtuquajtur *latinitet lindor* (*gjithashtu latinitet kontinental*) i janë kushtuar studime dhe punime të ndryshme me karakter analitik dhe jo rrallë dhe komparativ, në veçanti kur bëhej fjalë për vënien në dukje të tipareve të përbashkëta me të tjera gjuhë të së njëjtës familje por që në pikëpamje gjeografike dhe të gjuhësisë areale mund të mos jenë të afërta me këtë të fundit.³ Nga këto qasje kanë

² Çabej E., *Karakteristikat e huazimeve latine në gjuhën shqipe*, **Studime gjuhësore IV**, Prishtinë, 1977, f. 261: *Ndikimi i latinishtes në Shqipëri, sikundër dihet, ka nisur tre shekuj më parë se në truall të Rumanisë. Dhe lidhjet me botën romane a me rrymat e saj kulturore kanë vazhduar në gjuhë shqipe edhe pas nguljes së sllavëve në Gadi-shullin Ballkanik, nuk morën fund si ndodhi në Rumani. Më anë tjetër ndërkaq, procesi i romanizimit ndër të parët e rumenëve të sotëm duhet të ketë qenë shumë më intensiv sesa ndër të parët e shqiptarëve, se ashtu shpjegohet formimi i një gjuhe romane në ato anë.*

³ Iordan I., *Le roumain et l'espagnol, aires latérales de la latinité*, në **Revue rou-**

dalë në pah aspekte të përkimit apo dhe veçantisë së gjuhëve romane në pikëpamje të reflektimit të elementeve përbërëse fonemore a morfemore të fjalëve latine si dhe të transmetimit të kuptimeve të tyre, kanë dalë përfundime mbi elemente të reflektuara në të gjitha gjuhët romane apo dhe vetëm në rumanishte. Një traditë e konsoliduar studimesh mbi gjuhët romane nuk mund të mos konsiderojë në mënyrë konsekuente fakte të qenësishme gjuhësore në të cilat përfshihet edhe (kjo e fundit) rumanishtja, që në pikëpamje të vendit të formimit dhe për rrethanat në të cilat është realizuar shndërrimi gradual në një gjuhë të kësaj familjeje, përbën një nga gjuhët më interesante të Ballkanit.

Në mjaft studime të kësaj natyre, në veçanti kur trajtohen elementet latine të rumanishtes, ecuria evolutive dhe prania e tyre në gjuhë të tjera romane, zhvillimi specifik kryesisht i natyrës semantike i tyre, vihen shpesh në dukje elemente të qasjes me shqipen, qoftë dhe kur bëhet fjalë për shqyrtimin e fakteve që kanë të bëjnë vetëm me gjuhët romane apo me historinë e gjuhës rumune.

Qasjet e rumanishtes me shqipen janë bërë objekt vëmendjeje nga studiues të huaj dhe shqiptarë, albanologë, ballkanologë dhe romanistë, duke çuar në përvijimin e një linje të mirëfilltë studimesh që ndriçojnë aspekte të njohjes më të thelluar të nënsistemeve të të dyja gjuhëve. Rrethana të mundshme të kontakteve mes tyre merren si argument për elemente të përbashkëta leksikore, jo vetëm me origjinë latine.⁴

Në fakt, në mjaft trajtime mbi aspekte tipologjike të rumanishtes konsiderohen elementet e përkimit me shqipen e në veçanti ato leksikore me origjinë latine. Nga ana tjetër, Eqrem Çabej flet dhe për rindërtim trajtash të *latinitetit ballkanik* me shqyrtimin e trajtave të rumanishtes, dalmatishtes por dhe të romanizmave të shqipes.⁵

Rrethanat historike të romanizimit ballkanik prekin pa dyshim dhe kontekstin territorial të viseve që sot e kësaj dite janë përkatësisht

maine de linguistique, Tome IX, n.1, 1964, f.5- 14.

⁴ Çabej E., *Rum. Crăciun "kërshëndella"*, në **Studime gjuhësore IV**, 1977, f.237-240.

⁵ Çabej E., **Studime gjuhësore IV**, 1977, f.261: *Ashtu si në fushën e gjuhëve romane perëndimore, edhe në atë të gjuhëve romane lindore, një pjesë të konsiderueshme të leksikut latin popullor e kanë nxjerrë duke e rindërtuar nga gjendja e gjuhëve që sot janë të gjalla. Aty, për latinitetin ballkanik, përveç rumanishtes dhe dalmatishtes, vijnë në vështrim, sikundër dihet, edhe romanizmat e shqipes.*

shqiptare dhe rumune e ky fakt bashkon por edhe diferencon në drejtim të shkallës së përjasjes së elementeve të caktuara në lidhje me këto dy gjuhë. Ky fakt i qenësishëm i historisë së lashtësisë të këtyre viseve dëshmohep nëpërmjet burimesh shkrimore të njohura dhe nga një numër i konsiderueshëm mbishkrimesh latine që përbëjnë korpuse të rëndësishme dokumentare mbi mënyrën e jetesës, emrat e përveçëm të personave, lidhjet mes mediatorëve të romanizimit me vendasit, emrat e vendeve apo dhe periudhat më të rëndësishme që dëshmohen nëpërmjet tyre. Me të drejtë toponimia përkatëse e dëshmuar në mbishkrime, në burime shkrimore të kohës si dhe në studime *ad hoc* të mëvona përbën një faktor të rëndësishëm për dokumentimin e këtij konteksti historik, por dhe për qasjen tipologjike të transmetimit të formanteve me origjinë latine dhe asimilimin e tyre në përbërje të emërtimeve të caktuara. Pikërisht në lidhje me shqipen, do të përbente një ndihmesë të madhe dhe përpjekja për të hartuar një gjeografi të shpërndarjes së toponimeve me origjinë latine apo latino-romane.⁶

Qasja edhe në pikëpamje të tipologjisë së mbishkrimeve latine në këtë areal ku mendohet se është ushtruar prirja për romanizim dhe ekspansion të imperium-it aq të fuqishëm të antikitetit evropian, do të ndihmonte fuqishëm në zbardhjen e mëtejshme dhe deduktimin e fakteve të rëndësishme mbi popujt dhe gjuhët e folura në këto vise.⁷ Romanizimi i tyre mbetet faktor i rëndësishëm që nuk mund të mos merret parasysh në drejtim të sqarimit të periudhave të historisë përkatëse të gjuhës dhe të popullit që e fliste atë. Në drejtim të formimit të një gjuhe me elemente të konsiderueshme latine duhen marrë parasysh gjithashtu dhe marrëdhëniet paraekzistuese me Romën e lashtë që në njëfarë mënyre i paraprinë këtij faktori.

Rrethanat e realizimit të romanizimit dhe marrëdhëniet me popujt të tjerë që shfaqen në periudha të mëvona mbeten gjithashtu një tjetër faktor i rëndësishëm që ka lënë gjurmët e veta në këtë mes.⁸ Një problem me

⁶ Mansaku S., *Autoktonia e shqiptarëve në dritën e të dhënave të toponimisë së lashtë*, në SF n.3, 1982, f. 103-113.

⁷ Anamali S., Ceka H., Deniaux É., **Corpus des inscriptions latines d'Albanie**, Collection de l'École française de Rome, 2009.

⁸ Çështja e ndikimit të latinishtes mbi gjuhët e popujve vendas mund të shtrohet edhe për vise të tjera që nuk ishin romane para se të njihnin ekspansionin romak: Gadishulli Iberik, Galia, zona të caktuara të Gadishullit Italik etj.

rëndësi të veçantë diskutimi mbetet çështja e së ashtuquajturës *latinishte ballkanike*, emërtesë e përdorur nga studiues të historisë së gjuhës latine, gjuhësisë romane dhe asaj ballkanike dhe e rimarrë gjatë shqyrtimit të përfaqjes së elementeve latine në shqipe dhe në rumanishte. Po aq me rëndësi paraqitet edhe çështja e konceptimit të unicitetit idiomatik të saj, konceptim që shfaqet i ndryshëm sipas periudhave dhe studiuesve që janë marrë me këtë argument.⁹

Duhet nënvizuar fakti që për rumanishten pikërisht nga lidhja me latinishten (një variant të *latinishtes popullore ballkanike*) arrihen të gjurmohen faza të rëndësishme evolutive në sistemin vokalik dhe konsonantik si dhe procese të mbartjes së fjalëve nga një fazë protoromane në dialektet kryesore të saj, duke u cilësuar njëkohësisht sa të ndryshme apo të përbashkëta janë këto të fundit me përgjegjëset kuptimore në gjuhë të tjera romane. Këto procese që përfshijnë nënsisteme të rëndësishme gjuhësore kanë të bëjnë njëkohësisht me gjuhësinë romane, me historinë e gjuhëve romane por dhe me historinë e vetë gjuhës rumune dhe trajtohen sistematikisht në studimet përkatëse të kësaj disipline. Me interes të veçantë paraqiten rastet e kontinuitetit të trajtave origjinare nga latinishtja vulgare, të para në vështrim përfaqës me trajta përgjegjëse (kur ekzistojnë) me gjuhë të tjera romane dhe në krahasim me shqipen jo vetëm në pikëpamje të ngjashmërisë tingullore, por dhe në pikëpamje të vjetërsisë apo dhe faktit që në këtë të fundit mund të jenë huazuar nga regjistra a variante të tjera të latinishtes.¹⁰

Në traditën e studimeve gjuhësore shqiptare romanizimi i Ballkanit merret në shqyrtim sa herë shtrohet çështja e një trajtimi tipologjik të shtresëzimit leksikor të shqipes që ka të bëjë me elementet latine në leksikon e saj.

Edhe në lidhje me këto studime duhen pasur mirë parasysh emërtesat e përdorura nga studiuesit në lidhje me latinishten që mendohet se ka

⁹ Mihăescu H., *Les éléments latins de la langue albanaise*, **Revue des études sud-est européennes**, 1966, f.: *En conséquence, les preuves qui permettraient d'affirmer que les éléments latins de l'albanais et du roumainin découlent d'une source commune, appelée par certains savants "latin balkanique", font défaut. En réalité, l'influence de Rome a agi dans le Sud-Est européen par des voies diverses, durant une période de longue durée: elle n'a pu conduire à des résultats unitaires et homogènes.*

¹⁰ Për çështjen e kontinuitetit të trajtave të caktuara latine në shqipe shih dhe trajtimin e E.Çabejt në **Studime gjuhësore IV**, 1977, f.256.

qenë faktor ndikimi në një periudhë relativisht të konsiderueshme kohore (rreth shtatëqind vjet sipas Çabejt), por dhe që pasqyrohet me anë mbi-shkrimesh të periudhave të caktuara të antikitetit roman dhe ballkanik. Po aq e rëndësishme mbetet vërejtja e E.Çabejt mbi vendin e romanizmave të shqipes mbasi vëren vazhdimësinë e trajtave të caktuara të toponimeve: ato kanë pjesë njëkohësisht dhe në latinitetin bregdetar-adriatik dhe në latinitetin ballkanik – të brendshëm e kontinental.¹¹

Për disa elemente mendohet të kenë kaluar nga latinishtja klasike dhe jo nga ajo popullore. Janë cituar shembuj (dhe me anë interpretimesh) elementesh të leksikut religjioz parakristian apo pagan.¹² Problemit në fjalë i është dhënë jo rrallë dhe një vizion i natyrës sociolinguistike.

Duke ditur tashmë se në lidhje me të dyja gjuhët duhet të ketë ekzistuar një kontekst historik që ka favorizuar në shkallë të ndryshme depërtimin e leksikut latin, në vështrimin tonë vëmendja përqendrohet pikerisht në një sprovë për një vështrim semantik dhe tipologjik të elementit latin në leksikun e dy gjuhëve të Ballkanit, shqipes dhe rumanishtes.¹³

Çdo ndërmarrje njohëse dhe analitike e natyrës diakronike në ditët e sotme mbi elementin latin të shqipes do të çonte në përfundimin se tashmë është përvijuar një traditë e mirë studimesh mbi këtë argument dhe se arritjet e deritanishme kanë ndihmuar të sqarohen e të dallohen elementet latine më të lashta nga ato më të vona, proceset kryesore fonetike që kanë shoqëruar kalimin në gjuhën shqipe, elemente gjuhësore latine të botës së krishtërimit, elemente më të vona të dëshmuara që te autorët e vjetër të letërsisë shqipe si dhe të saktësohet natyra e këtij ndikimi ndaj shqipes,

¹¹ Çabej E., *po aty*, f.256: *Kur të vështrohen romanizmat e shqipes nga këto pikëpamje, arrihet prapë në përfundimin që ato kanë pjesë njëkohësisht dhe në latinitetin bregdetar-adriatik dhe në latinitetin ballkanik – të brendshëm e kontinental.*

¹² Shih dhe Ölberg H., *Kontributi i gjuhësisë për çështjen e atdheut ballkanik të shqiptarëve*, në **SF** n.3, 1982, f.35-39.

¹³ Shprehje të qarta të përfshirjes në procesin e romanizimit të viseve ku mendohet të kenë lindur gjuhët në shqyrtim mbeten dhe citimet përkatëse në veprat e autorëve latinë të shekullit të parë para Krishtit apo dhe të periudhës së Augustit (Ovidi, me veprat e njohura *Tristia* dhe *Epistulae ex Ponto*). Illyricum-i përmendet në *Bellum civile*, një nga veprat më në zë të Jul Cezarit (100 a.Ch.n-44 a.Ch.n.), prijës ushtarak por edhe figurë politike e Romës së lashtë. Në këtë vepër gjejmë një sërë toponimesh e hidronimesh që ruhen edhe sot e kësaj dite si elemente të onomastikës së antikitetit romak dhe ilirik.

pikërisht nënsistemet në të cilat ky ndikim është pasqyruar më tepër. Në studimet e R. Ismajlit gjendet gjithashtu një sistemim konciz dhe orientues i arritjeve të dijes në lidhje me këtë argument, duke filluar gjithashtu dhe raportin e elementeve latine të shqipes ndaj atyre të rumanishtes, në kuadrin e domosdoshmërisë së një impostimi të saktësuar të elementit latin të shqipes, afëritë e tij përkatësisht me latinitetin perëndimor dhe atë lindor.¹⁴

Nga studiuesit që janë marrë me këtë çështje janë evidentuar dhe klasat e fjalëve në të cilat gjurmohen më tepër këto elemente. Trajtime të tilla në lidhje me të dyja gjuhët ndihmojnë për një vështrim të krahasuar tipologjik të këtyre elementeve, vështrim ky i pandarë nga ai i natyrës semantike.¹⁵

Këto elemente që përfaqësojnë fusha të ndryshme leksikore janë bërë pjesë e leksikut përkatës të secilës prej gjuhëve duke formësuar tipare të qëndrueshme formale në drejtim të ndryshimeve fonemore apo dhe përshtatjes me mjetet formuese të gjuhës përkatëse.

Studimet mbi elementin latin të shqipes dhe shtrirjen e tij në leksikon

¹⁴ Ismajli R., *Huazimet latine të gjuhës shqipe*, në **Rilindja**, Prishtinë, 1987, f. 88-95. Shih dhe Çabej E., **Studime gjuhësore IV**, 1977, f.260: *Po t'i sillemi tani shqyrtimit të çështjes se ç'vend zë edhe farë lidhje afërish ka elementi latin i shqipes në rrethin e gjuhëve romane, ky vend është i përcaktuar me këtë mënyrë, që ky element, sikundër dihet, së bashku me rumanishten, me dalmatishten dhe me elementet latine të serbokroatishtes e të greqishtes së re, bën pjesë në romanitetin lindor, vazhdim i latinishtes ballkanike. Ky grupim ndërkaq, ashtu si çdo afri gjuhësore, nuk përjashton kalime nga njëra fushë në tjetrën. Kështu, p.sh. shqipja, krahas me këto afrime, paraqet dhe përkime(konkordanca) të veçanta me disa gjuhë e dialekte romane perëndimore më fort periferike, sidomos të Gadishullit apenin, duke formuar ajo, në pajtim me situatën gjeografike, gjer diku një hallkë ndërlidhëse midis asaj treve gjuhësore dhe romanitetit lindor.*

¹⁵ Natyrisht që për një gjuhë të dokumentuar me shkrim relativisht më vonë se gjuhë të tjera të së njëjtës familje gjuhësore, prania e elementeve të tilla leksikore e aq më tepër prania e të njëjtave elemente në një gjuhë në kontakt mund të jenë shfrytëzuar edhe në drejtim të hipotetizimit të disa çështjeve me rëndësi si origjina e gjuhës shqipe apo trualli origjinar i kësaj gjuhe të vjetër të Ballkanit. Një fakt i tillë është trajtuar dhe marrë në konsideratë mjaft herë dhe në studime që kanë pasur si objekt studimi elementet latine të shqipes. Evidentimi përpjesëtimor i elementeve latine të përbashkëta mes shqipes dhe rumanishtes, i parë në raport me elemente po latine të përbashkëta me të tjera gjuhë romane, i jep një përgjigje dhe këtij problemi.

e saj shpesh janë shoqëruar nga marrja parasysh e elementeve paralele në gjuhën rumune, pa përfshirur këtu edhe ato raste kur të tilla elemente mund të ndeshen në të tjera gjuhë romane. Gjithashtu në studimet etimologjike mbi leksikun e shqipes vihet re një prirje për të vënë në dukje për fjalë të caktuara praninë e varianteve gjegjëse apo referenciale në gjuhë të Ballkanit, e jo rrallë dhe në rumanishte. Një prirje e tillë vihet re dhe në studimet apo botimet e kësaj natyre në lidhje me rumanishten. Problematika e këtij argumenti, elementeve latine në shqipe dhe në rumanishte përmbledh një sërë çështjesh me rëndësi, ndër të cilat mund të përmendim edhe atë të nënvizuar shpeshherë e që ka të bëjë me vjetërsinë e këtij elementi në krahasim me forma përgjegjëse të gjendura në gjuhët romane dhe veçanërisht në rumanishte. Një fakt i tillë që lidhet nga studiuesit me periudha të caktuara të zhvillimit të latinishtes dhe me përkimin e fazave të caktuara evolutive të saj me ndikimin në gjuhën tonë, vihet në dukje qoftë kur flitet për karakteristikat e elementeve latine të gjuhës shqipe, qoftë në analiza të veçuara etimologjike të fjalëve të caktuara, të cilat mund të jenë me përkatësi dialektore apo dhe të mbarë shqipes. Ai mund të interpretohet dhe nga fakti që ky romanizim nuk pati të njëjtin ndikim në areale të caktuara të Ballkanit dhe që në pikepamje kronologjike mund të ketë qenë më i hershëm në viset e banuara nga paraardhësit e shqiptarëve. Një faktor po aq i rëndësishëm për t'u paratur parasysh mbetet dhe intensiteti i ndryshëm i ushtrimit të këtij ndikimi në këto vende.

Kategorizimet përkatëse të kryera kohë më parë nga studiues dhe njohës të të dyja gjuhëve, të problematikës së gjenezës së tyre si dhe të problemit të burimit latin të mjaft elementeve leksikore të tyre u japin rëndësinë e duhur dhe atyre elementeve që gjenden edhe në shqipe, edhe në rumanishte, pavarësisht se në pikëpamje numerike mund të paraqiten më të pakta se elemente të tjera që janë të burimit latin por mund të gjenden dhe në gjuhët e tjera romane apo dhe vetëm në shqipe.¹⁶

¹⁶ Mihăescu H., *Les éléments latins de la langue albanaise*, në **Revue des études sud-est européennes**, IV, 1-2, Bucarest, 1966, f.8; *Les éléments latins de l'albanais peuvent être rangés en quatre catégories: 1. mots latins de large circulation conservés en albanais, en roumain et dans les langues romanes occidentales; 2. éléments latins communs à l'albanais et aux langues romanes occidentales; 3. Eléments latins conservés seulement en roumain et en albanais; 4. éléments latins n'ayant subsisté qu'en albanais.*

Në studimet përkatëse mbi elementin latin të shqipes (i bërë gjerësisht objekt studimi veçanërisht në shekullin e kaluar)¹⁷ gjendet shpesh dhe një panoramë e plotë e arritjeve në lidhje me argumentin në fjalë, duke pasur parasysh disa kriterë të rëndësishme: rendin kronologjik të realizimit të këtyre arritjeve, objektivin e mundshëm të synuar prej secilit prej studiuesve të përmendur, shfrytëzimin e të dhënave gjuhësore të dala nga analizimi i këtyre elementeve në funksion të deduktimit të dukurive apo fakteve të rëndësishme që kanë të bëjnë me historinë e gjuhës shqipe dhe me faza të rëndësishme të evolucionit të saj, kryesisht para dokumentimit shkrimor të saj, dhe që ndihmojnë patjetër dhe në veçimin e disa elementeve të përbashkëta mes të dyja gjuhëve të Ballkanit.

Metodologjia studimore mbetet një tjetër aspekt qasjeje në drejtim të trajtimit të elementeve latine në të dyja gjuhët, në shqipe dhe në rumanishte. Ajo ndryshon dhe sipas periudhave të caktuara a studiuesve që ndërmarrin studimin e kësaj çështjeje. Shpeshherë studiuesit ndjekin rrugën e nisur nga paraardhësit.

Në lidhje me këtë argument evidentimet e përpikta të këtyre elementeve përbëjnë premisën kryesore për të kaluar në vështrime të natyrës semantike dhe tipologjike. Vënia në dukje e pranisë së tyre në gjuhët romane dhe në shqipe, apo dhe vetëm në shqipe dhe në rumanishte, si dhe veçantia e elementeve të caktuara latine në shqipe ndihmon në sqarimin e problemeve të ndryshme, qoftë dhe të kontakteve mes popujve apo gjuhëve në shqyrtim.¹⁸

¹⁷ Për një periodizim dhe trajtim diakronik të studimeve mbi elementet latine në shqipe shih R. Ismajli, *art. i cit.*, Prishtinë, 1987.

¹⁸ Një mënyrë e konceptimit të paraqitjes së këtij elementi të rëndësishëm në leksikon e të dyja gjuhëve pasuar nga një sërë konsideratash konkluzive mbi fushat leksikore të përfshira në një kategorizim të tillë, ndeshet dhe në studimet e Mihaescut (**La romanité du sud-est de l'Europe**, Bukuresht, 1993). Ky fakt i fundit i pranishëm që në shtjellimet e para të argumentit bën dhe më interesant trajtimin e këtyre elementeve dhe plotëson kështu kuadrin e nënsistemeve në të cilat janë përfshirë të dyja gjuhët në shqyrtim. Në shënimet e këtij studiuesi gjejmë përcaktime që përgjithësojnë mbi fushën leksikore të elementeve të caktuara, por dhe që bëjnë të shtyresh më tej në disa reflektime që kanë të bëjnë me përdorimet konkrete të fjalëve të caktuara në të dyja gjuhët, duke pasur parasysh mirëfilli se ato kanë ndjekur rrugë të caktuara evolutive në secilën prej gjuhëve, jo vetëm të natyrës fonetike. Shembujt që citohen në këtë rast nga studiuesi

Në kuadrin e gjurmimit të vazhdueshëm të marrëdhënieve midis dy gjuhëve, shqipes dhe rumanishtes, një prirje pozitive dhe konstruktive del në pah në studimet e E.Çabejt, studiues i historisë së gjuhës shqipe që vlerësoi përherë elementet e leksikut, frazeologjisë, strukturës së formimit të fjalëve, historisë së fjalës qoftë për gramatikën historike të gjuhës sonë, qoftë dhe për një vlerësim përherë objektiv të këtyre marrëdhënieve ndërghjuhësore. Përveç studimeve mbi strukturën e ngjashme të pjesëve të ndryshme të ligjëratës apo çështje të realizimit të eptimit emëror me anë formantesh të krahasueshme, reksionit foljor, përdorimit të paskajores shqipe (gege) në vështrim të krahasuar me ndërtimet gjegjëse në rumanishte, Çabej ka marrë në shqyrtim një numër të konsiderueshëm elementesh leksikore nga fusha të ndryshme në të cilat dallohen pa dyshim dhe ato latine. Këto elemente nuk mungojnë dhe në fjalë me më shumë se një përbërës, që emërtojnë koncepte apo si në rastin e fjalës *cuminte*: *i urtë*, *i mençëm* me ndërtimin *me mend*, *krahas mbiemrit i mençëm*.¹⁹

Këto përkime gjithsesi nuk shtrihen dot plotësisht në drejtim të adaptimit të prefikseve apo formanteve të tjera përbërëse të fjalës, meqë në rumanishte çështja e reflektimit të tyre nga trajta origjinare latine është dukuri më vete, e dallueshme dhe midis dialekteve të saj e madje dhe nga e njëjta dukuri në gjuhë të tjera romane.²⁰ Fjalë të shqipes me origjinë latine a më saktë latino-romane që përmbajnë formante të caktuara tipike për këtë gjuhë të rëndësishme kulture kanë

rumun u përkasin fushave të ndryshme leksikore: janë emërtime zogjsh a gjallesash të tjera, emërtime emrash që shënojnë lidhje farefisnie, fjalë që mund të përdoren dhe në fushën e liturgjisë (*canticum*, shq.këngë, rum.cintec). Këto elemente mund të jenë gjithashtu emërtesa frutash, sëmundjesh, konceptesh, pjesëve të trupit të njeriut apo dhe që kontekstualisht mund të jenë terma të leksikut ushtarak. Në pikëpamje të përbërjes fonematike, nga të dy gjuhët dallohen fjalë që kanë pësuar ndryshime të dukshme tematike në krahasim me trajtën origjinare latine: *krushk*, *mbret* (*lat. imperator*).

¹⁹ Çabej E., *Disa mendime mbi marrëdhëniet gjuhësore rumune-shqiptare*, **Studime gjuhësore (IV)**, Rilindja, Prishtinë, 1977, f. 248.

²⁰ Ndërsa në shqipe konstatohen huazime fjalësh latine në faza dhe më të hershme se kur kanë ndodhur të tilla procese në rumanishte apo protorumanishte dhe të shoqëruara me të tjera procese të modifikimit fonetik të fjalëve. Për çështjen e adaptimit të mjeteve të formimit me origjinë nga latinishtja në rumanishte shih sërish Mihaescu, *vep. e cit.*, Bukuresht, 1993, f.173-176.

hyrë dhe më vonë, u përkasin fushave të dijes dhe në lidhje me to ësh-të e konsoliduar prirja për ruajtjen e pandryshuar të formantit përkatës.

Elementet latine të të dyja gjuhëve, të para në pikëpamje seman-tike janë përfshirë në mjaft fusha të rëndësishme të veprimtarisë njerë-zore dhe konceptimit të nocioneve të caktuara. Vëzhgimet e kryera japin shkas për interpretime të mëtejshme të zërave të shqyrtuar, veça-nërisht kur bëhet fjalë për diferencime kuptimore: janë zëra apo fjalë që përfaqësojnë fushën leksikore të hierarkisë së pushtetit, por që në kontekstet konkrete në të dy gjuhët kanë ruajtur apo zhvilluar ngjy-rime të caktuara të kuptimit themelor të tyre. Për fjalën *mbret*²¹ ka për t'u vënë re se në ç' tekste përdoret në të dyja gjuhët, kur shfaqet për herë të parë, ç' ka ruajtur rumanishtja nga trajta latine *imperator*, me të cilën shënohej jo vetëm perandori, por dhe prijësi ushtarak. *Impera-tor*²² në botën romake ka një sërë funksionesh të rëndësishme, është themelues dhe institucionalizues i strukturës perandorake, por merr pjesë dhe në ceremoni e rituale, element ky që duhet parë sa është për-cuar përkatësisht në gjuhët që po shqyrtojmë. Tek autorët e vjetër të letërsisë shqipe ndeshim trajta të tjera: *regj*, *perandor*.²³ Fjalën *mbret* e ndeshim kryesisht në tekste përrallash popullore, por dhe në tekstet e sotme liturgjike.

Fusha e liturgjisë ofron mundësi thellimi të shqyrtimit të fakteve të vëna në dukje nga tradita e studimeve mbi këtë argument. Për fjalë të caktuara diferencimi kuptimor është më se i qartë, qoftë dhe në drej-tim të larmisë së numrit të derivateve brenda një familjeje fjalësh në një-rën apo tjetrën gjuhë (rasti i fjalës *paganus* dhe i derivateve për-

²¹ Çabej E., *po aty*, f. 260: *Vetëm në shqipen ruhen në Ballkan më se një emër latin të djallit: diabolus, draco, dracōnem, pastaj edhe reflekset e imperator(mbret, p-erëndi) e të imperatorem (perënduar), kjo mbase si një fjalë gjysmësavante), edhe ato të regem "mbret", terme të leksikut politik e kishtar, me të cilat kjo gju-hë merr pjesë dhe në leksikun roman lindor dhe në perëndimorin.*

²² Demiraj B., **F. Blanchus, Dictionarium latino-epiroticum, Romae, 1635**, Botime fran-çeskane, 2008, 34 20, 34 25: *Imperator: perëndij; turcice sultan, transkr. perëndi...; im-peratrix: perendefca, transkr. perëndesha...; më tej, po ai, 134 28: rex: reg, transkr. regj.*

²³ Ashta K., **Leksiku historik i gjuhës shqipe III**, Shkodër, 2000, f.227: *peranduer-uori em. lat. Imperans, -antis; perëndeshë-a; em. Lat. imperans, antis, "imperatrix: pe-rëndesha", 34. Perëndi-a em.lat.imperans, antis. Perandor" imperator, sultan: perëndi" 34, "Caesar: perëndi" 9.*

katëse).²⁴ Në raste të tjera në rumanishte gjendet dhe ndonjë fjalë me origjinë sllave krahas asaj latine, si në shembullin e fjalës *altar*, të cilën studiuesit e lidhin me një formë latine **altarium*.²⁵

Ndërtimi *Domine Deus* ka marrë rrugë të ndryshme në përshtatjen apo përkthimin në gjuhët e shqyrtuara. Gjenden shembuj përshtatjeje të saj dhe variante në dialektet kryesore të rumanishtes, pa humbur lidhjen fillestare me trajtën e sipërshënuar latine.²⁶

Në letërsinë e vjetër shqipe gjejmë ndërtime që janë më tepër përshtatje nga ana e tyre: te Pjetër Bogdani, 1685 (*Shkall. I, Ligj. IV, f. 13*) ndeshim përdorimin *Zoti Hyj*. Dallohen elementet *Zot* (lat. *Dominus*) dhe *Hyj* (lat. *Deus*).²⁷ Në lidhje me këtë ndërtim të mësipërm vihet re një përshtatje e ndryshme te tekstet e *Mesharit* të Buzukut.²⁸

²⁴ Mihaescu H., *botim i cit.*, f.295. Të vihen re variantet e kësaj fjale në dialektet rumune dhe derivatet apo fjalët e së njëjtës familjeje fjalësh.

²⁵ Edhe në lidhje me këtë të fundit, paraqet interes shpjegimi në frëngjisht që gjendet te Mihaescu (sipas atij të Ernout-Meillet në *Dictionnaire étymologique de la langue latine*, Paris, 1951, f.43) pas evidentimit të variantit *ltër* të shqipes: *autel ou on brûle les offrandes...*, shpjegim ky që gjendet të paktën në dy punime të tijat mbi elementet latine të shqipes dhe që në njëfarë mënyre të kujtojnë elemente të një bote parakristiane. Për përdorimin e kësaj fjale te autorët e vjetër të shqipes shih ndër të tjera dhe shembullin nga *Cuneus prophetarum* të Pjetër Bogdanit, *Shkalla I, Ligjërata III*, Tiranë, 2005, f.11: Ditësë prende Abrāmi desh me shëkruem të birrë vet *Izāknë mbë ltër*.

²⁶ Mihaescu H., *botim i cit.*, f.296-297: *Domine deus* (*Dominus deus* "dieu (notre seigneur)": dr. Dumnezeu, Dumnezău, Dumnidzău, Dumnazău, etc., ar. Dumnidză(u) "Dieu" (it. *Dominateddio*, a. fr. *Damnedeu, Damledieu*); dans le dialecte mégléno-roumain a été attesté le dérivé *dumnizes* "divin", auquel on a attribué pour point de départ la forme **Dumnizo*.

²⁷ Bogdani P., *Cuneus prophetarum*, *botim i cit.*, *Shkall. I, Ligj. I*, f.3: ..Pra sod ke me dijtunë se *Zotynë Hyji yt* vetë ka me të prīm përpara, posi zjarmi përpis e nretës, qi ka me i çartunë e me i fshīm e me i përdam etc., përse banë vetëhesë idhullë. (lat. *Scies ergo hodie, quod Dominus Deus tuus ipse tranfubit ante te ignis devorans, atque confumens, qui conterat eos; et deleat, atque disperdat etc. quia fecerunt fibi conflatile..*)

²⁸ Për një vështrim diakronik të historisë së përdorimit të këtyre emërtesave në shqipen e vjetër dhe shfaqjen origjinale te përshtatjes së kësaj sintagme në veprën e Pjetër Bogdanit shih Rrota J., *Per historin e alfabetit shqyp dhe studime tjera*, Botime françeskane, Shkodër, 2005, f.17.

Veçanërisht në lidhje me elementet e fushës së liturgjisë qasjet mund të shtrihen dhe në përdorime paralele aktuale të të dy gjuhëve.

Studimet e deritanishme mbi këtë argument kanë ndihmuar në evidentimin e mjaft fushave leksikore në të cilat vërtetohen qasje të përgjithshme, përafrime por edhe diferencime të kushtëzuara nga rru-ga reale e *usus*-it të fjalëve të caktuara. Shqyrtimi konkret i disa termave nga fusha e liturgjisë dëshmon në njëfarë mënyre dhe diferencimin tipologjik të të dy gjuhëve. Mendojmë se këto diferencime janë të lidhura dhe me faktorë jashtëgjuhësorë, si dhe nga ndikimet konkrete të terminologjisë me origjinë nga gjuhë të tjera, ndoshta më të drejtpërdrejta në rastin e rumanishtes.²⁹ Panorama mund të plotësohet më tej nga qasja më e thelluar e burimeve epigrafike ekzistuese përsa u përket periudhave që lidhen me romanizimin e Ballkanit; e burimeve mesjetare si dhe analizimi i teksteve liturgjike që qëndrojnë në themel të inicimit të historishkrimit të secilës prej këtyre dy gjuhëve ballkanike.

²⁹ Çabej E., *po aty*, f.261: *Nga një shqyrtim historik i organizimit kishtar në Shqipëri rezulton që ky, në kohën e ardhjes së sllavëve, edhe si bashkësi (komunitet) fetare edhe në liturgjinë e tij e në gjuhën e saj, në qenësi, në esencë ishte tashmë i formuar. Vetëm me këtë rrethanë dhe me antagonizmin që zgjati gjithë mesjetën midis kishës perëndimore edhe lindores, gjen shpjegim fakti që në leksikon kishtar të shqipes të përbashkët për mbarë gjuhën nuk ka as edhe një huazim prej sllavishtes. Ky fakt, i cili është me rëndësi edhe për historinë e vendit, qëndron në kundërshtim të shënueshëm me rumanishten, ku ndikimi sllav në gjuhën kishtarë dihet se zë një vend të dorës së parë. Në gjuhën shqipe terminologjia kristiane me gurrë latine përbën shtresën më të moçme të gjuhës fetare, më e moçme se shtresa greke, dhe me përdorim edhe tek elementi ortodoks i vendit.*

Bibliografi

- Anamali S., Ceka H, Deniaux É., *Corpus des inscriptions latines d'Albanie*, collection de l'École française de Rome, 2009.
- Banfi E., *Linguistica balcanica*, Zanichelli, Bologna, 1985.
- Banfi E., Grandi N., *Lingue d'Europa*, Carocci editore, Roma, 2003.
- Banniard M., *Du latin aux langues romanes*, Armand Colin, Paris, 2010.
- Bogdani P., *Cuneus prophetarum, botim kritik përg. nga A.Omari*, Tiranë, 2005.
- Bourciez É., *Éléments de linguistique romane*, Paris, Librairie Klincksieck, 1967.
- Campanile E., De Felice E., Gusmani R., Lazzeroni R., Silvestri D., *Linguistica storica*, Carocci, Roma, 2002.
- Danesi G. G., *Guida alla lingua latina*, Carocci, Roma, 2008.
- Çabej E., *Shumësi i singularizuar në gjuhën shqipe*, Tiranë, 1967.
- Çabej E., *Studime gjuhësore IV*, botime Rilindja, Prishtinë, 1977.
- Demiraj Sh., *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, Tiranë, 1988.
- Demiraj Sh., *Gjuhësi ballkanike*, Tiranë, 2004.
- Ölberg H., *Kontributi i gjuhësisë për çështjen e atdheut ballkanik të shqiptarëve*, në SF n.3, 1982.
- Herman H., *Le latin vulgaire*, Paris, 1967.
- Ernout A., *Morphologie historique du latin*, Éditions Klincksieck, Paris, 1974.
- Georgiev V., *Le dace comme substrat de la langue roumaine*, në *Revue roumaine de linguistique*, Tome X, n.1-3, Bucarest, 1965.
- Giovine Di P., *Il gruppo ct latino in albanese*, Istituto di Glottologia, Università di Roma, 1982.
- Grandi N., *Fondamenti di tipologia linguistica*, Carocci editore, Roma, 2006.
- Hubschmid J., *Interpretimi historik i disa barazimeve shqiptaro-rumune të fjalëve dhe substrati dakomiz*, në SF n.3, 1982.
- Iliescu M., *Du latin au roumain. Sur quelques traits romans méconnus de la langue roumaine*, në *Revue roumaine de linguistique*, Tome X, n.1-3, Bucarest, 1965.
- Ismajli R., *Huazimet latine të gjuhës shqipe*, në Rilindja, Prishtinë, 1987.
- Jordan J., *Le roumain et l'espagnol, aires latérales de la latinité*, në *Revue roumaine de linguistique*, Tome IX, n.1, 1964.
- Landi A., *Gli elementi latini nella lingua albanese*, Edizioni scientifiche italiane, Napoli, 1989.
- Lee Ch., *Linguistica romanza*, Carocci editore, Roma, 2008.
- Luisi A., *Il perdono negato*, në *Quaderni di "Invigilata lucernis"*, Edipuglia, Bari, 2001.
- Luisi A., Berrino N.F., *Culpa silenda, le elegie dell'error ovidiano*, në *Quaderni di "Invigilata lucernis"*, Edipuglia, Bari, 2002.
- Mansaku S., *Autoktonia e shqiptarëve në dritën e të dhënave të toponimisë së lashtë*, në SF n.3, 1982.
- Mihăescu H., *Les éléments latins de la langue albanaise*, në *Revue des études sud-est européennes*, Bucarest, 1966.
- Mihăescu H., *Linguistika dhe etnogjeneza e shqiptarëve*, në SF n.3, 1982.
- Mihăescu H., *La romanité dans le Sud-Est de l'Europe*, București, Editura Academiei Române, 1993.
- Nocentini A., *L'Europa linguistica, profilo storico e linguistico*, Le Monnier, Firenze, 2008.

- Norberg D., *Manuale di latino medievale*, Avagliano editore, Salerno, 2002.
- Palmer L.R., *La lingua latina*, Einaudi editore, Torino, 2002.
- Pelegriani Xh.B. *Disa vëzhgime mbi elementin latin të shqipes*, në SF n.3, 1982.
- Pocetti P., Poli D., Santini C., *Una storia della lingua latina, (formazione, usi, comunicazione)*, Carocci editore, Roma, 2003.
- Ramat P., Ramat A.G., *Le lingue indoeuropee*, Il Mulino, Bologna, 1997.
- Renzi L., Andreose A., *Manuale di linguistica e filologia romanza*, Il Mulino, Bologna, 2006.
- Rrota J., *Per historin e alfabetit shqyp dhe studime tjera*, Botime françeskane, Shkodër, 2005.
- Sala M., *La place du roumain parmi les langues romanes*, në *Revue roumaine de linguistique*, Tome IX, n.6, 1964.
- Schlösser R., *Le lingue romanze*, Il Mulino, 2005.
- Stolz F., Debrunner A., Schmid W.P., *Storia della lingua latina*, Pàtron editore, Bologna, 1993.
- Väänänen V., *Introduzione al latino volgare*, Pàtron, Bologna, 2003.
- Väänänen V., *Introduction au latin vulgaire*, Librairie Klincksieck, Paris, 2006.
- Varvaro A., *Storia, problemi e metodi della linguistica romanza*, Napoli, 1968.

Qemal MURATI, Prishtinë

SHQIPJA DHE MAQEDOARUMANISHTJA NGA ASPEKTI I KONTAKTEVE MIDIS TYRE

Abstrakt

Ky punim studimor synon të japë një pamje më tërësore mbi gjendjen dhe lidhjet që ekzistojnë midis shqipes dhe arumanishtes në rajonin e Maqedonisë, vështruar në rrafshin leksikor, fonetik, morfologjik, idiomatik, onomastik etj. Punimi mbështetet në burime të ndryshme dialektologjike, leksikografike, folklorike dhe toponomastike, të cilat sjellin informacione me interes në këtë fushë studimore.

Arumunët - një popullsi e romanizuar që jeton në Gadishullin e Ballkanit, e cila flet një gjuhë që i përket grupit lindor të latinishtes, sot në Ballkan janë rreth 1 milion, të njohur edhe si *vllëh*, *ramër*, *cincar*, *crnovun*, *karagun* (*kucovllëh*), *farshëriot* (*arvanjito vllëh*), *çiçi* (Vlahović 1984, 87).

Emrin *arumun* atyre ua dha studiuesi gjerman Gustav Weigand, i cili u mor në fund të shekullit 19-të me gjuhën dhe mënyrën e jetesës së tyre, për shkak të një tipari fundamental të arumanishtes së jugut të shtesës së një *a*-je në fillim të fjalëve – si *amáre* (mare “det”), *armān* (roman), *arobā* (“rrobë, fustan”), *Avardarul* (Vardari), etj.

Për sa i përket origjinës së vjetër të arumunëve, vllëve, apo çobanëve, është e qartë se ata kanë qenë një popullsi lëvizëse (nomade) me bagëtinë, më së shumti në malet e Pindit, e që më pas janë vendosur në vende të ndryshme në Shqipëri, Maqedoni, Rumani, Greqi, e deri në Kroaci. Ka teori se janë trako-ilirë, rumunë, apo se janë polakë të ngulitur nga koha e kryqëzatave apo të tjera teza të shumta.

Ky grup etnik, që jeton në Shqipëri, Maqedoni dhe Greqi, i cili e përdor këtë gjuhë arkaike ende sot në jetën e përditshme, por e ka në përgjithësi të vështirë të ruajë identitetin e vet, ka pasur kontakte e simbiozë shekullore edhe me shqiptarët, me të cilët ka marrë e ka dhënë edhe në lëmin e gjuhës.

Në fushën e kontakteve të tyre, posaçërisht të vrullshme dhe intensive kanë qenë kontaktet gjuhësore shqiptaro-arumune, ku njerëzit

e këtyre dy etnitetëve duke jetuar së bashku, kanë mësuar dhe kanë folur gjuhët e njëri-tjetrit, e pasojisht kanë huazuar dhe elemente të shumta në gjuhët respektive dhe kanë asimiluar njëri-tjetrin.

Për sa u përket elementeve të shqipes në arumanishten, numri i tyre nuk është për t'u nënvlerësuar. Tache Papahagi në Fjalorin e tij dialektor të arumanishtes (*Dicționarul dialectului armomîn*, 1963) e çon atë në 350 leksema bazë, pothuajse aq sa është dhe numri i italizimeve në arealin lingvistik të arumanishtes. Por, në fakt, po të gjurmohet me kujdes kjo idiomë e arumanishtes, ky numër sigurisht do të dilte shumëfish më i madh.

Hulumtimet e ndërsjella midis shqipes dhe arumanishtes paraqesin interes të veçantë për gjuhët e këtyre dy popujve, sepse më shumë se me popujt e tjerë fqinjë, shqiptarët dhe arumunët kanë pasur ndërmjet veti një simbiozë më të gjatë e më të hershme si bartës të një kulture sedentare në hapësirat e tyre ballkanike.

Maqedoarumanishtja në idiomën e saj përshfaq elemente të shumta leksikore, fonetike, morfologjike, sintaksore, onomastike dhe frazeologjike të ngjashme me ato të shqipes, të cilat meritojnë të gjurmohen në mënyrë më të plotë e sistematike. Hulumtimet në këtë fushë marrin një rëndësi të dorës së parë jo vetëm për albanologjinë, por për romanistikën dhe për ballkanologjinë, sepse me ndriçimin e tyre mund të sqarohet e kaluara dhe e tashmja e këtyre dy etnive dhe jo vetëm, që kanë pasur një histori të përbashkët mijëvjeçare.

Numri i madh i tipareve të përbashkëta të shqipes me arumanishten shprehet në këtë, që etnikumi vllah (arumun) ka dalë si rezultat i romanizimit të popullsisë vendëse ballkanike (epire, trakase, makedonase, ilire), nga sundimi shumëshekullor i Perandorisë Romake në Ballkan, pra si rezultat i romanizimit dhe të elementit parashqiptar. Më pas ky element vllah u nënshtrohet proceseve të ndryshme asimiluese, në Shqipëri një rishqiptarizimi, kurse në truallin e sotëm të Maqedonisë një sllavizimi pothuajse të plotë. Në këtë hulli, numri i madh i elementeve leksikore dhe të tjera prej mbi 700, që i kishim vënë re në hulumtimet tona gjuhësore (Murati 2007), si huazime të shqipes në maqedonishten, në fakt duhen parë jo si fjalë shqipe në sllavomaqedonishten, por si korrespondenca shqiptaro-arumune

a si fjalë shqipe në maqedoarumanishten (arumanishten e sllavizuar), që në Maqedoni përkthehet si “maqedonishte”.

Bashkëpërkimet e shumta shqiptaro-rumune i ka hulumtuar dhe studiuesi Grigore Brënkush në një botim të tij me interes “*Kërkime mbi fondin trako-dak të gjuhës rumune*”, i cili shprehet: Shumë më afër së vërtetës më duket hipoteza që ngjashmëritë midis dy gjuhëve (shqipes dhe rumunishtes) shpjegohen nga një gjuhë e tretë që flitej në këtë zonë në periudhën pararomake (Brâncuş 2009, 4). Ndërkaq, historiani rumun Nikolla Jorga, në një vepër të tij “*Historia e rumunëve të Gadishullit të Ballkanit*” (Shqipëri, Maqedoni, Epir, Thesali etj., Bukuresht, 1913 (Xoxi 2001, 98), shprehet që arumunët janë me origjinë thjesht italice të ardhur në Ballkan gjatë pushtimit romak, pa u regjistruar asgjëkund, jo vetëm sepse regjistrat në atë kohë mungonin, por edhe vetë perandoria romake ishte e të gjithëve. Jorga shkruan për arumunët: “*Këta kolonë romakë, këta të emigruar nga Italia republikane janë atje prej 2000 vjetësh*”.

Areali i Maqedonisë – një xeherore me pasuri të pafundme etnolinguistike në Ballkan

1. *Në rajonin e Ballkanit, që paraqet njërin nga mozaikët e rrallë të pasur në botë në pikëpamje etnolinguistike, ku gërshetohen aq shumë gjuhë, kultura e religjione të ndryshme, jeta e asnjë populli të këtij visi nuk mund të studiohet pa u studiuar dhe ajo e popujve fqinjë – shprehet studiuesi Petar Atanasov (Polenaković 2007, 202). Kështu, dhe historia e gjuhës shqipe nuk mund të studiohet pa u studiuar edhe gjuhët e tjera ballkanike dhe, anasjelltas, nuk mund të ketë studime ballkanistike pa shqipen. Pa shqipen ballkanistika do të dukej si një përroskë (N. Jokl). Pa albanologji as nuk mund të flitet për romanistikë, edhe aq më pak për hulumtime rreth prejardhjes së rumanishtes (Bela Kopeczi). Shqipja është strumbullari rreth së cilës sillet gjithë gjuhësia ballkanike. Është themeli i sprachbundit ballkanik – thotë komparativisti dhe albanologu i shquar amerikan Eric Hamp.*

Gjatë historisë shqiptarët kanë qenë gjithmonë eklektikë, domethënë ata kanë pasur një qëndrim të hapur ndaj botës. Kanë ditur të marrin, të asimilojnë dhe të përshtatin elemente të shumta. Ky qëndrim i hapur shihet më mirë në gjuhën shqipe, e cila është një përzierje

e habitshme elementesh. *Zor të gjesh një fjalë shqipe pa ndikim të huaj* – pohon studiuesi i pasionuar i gjuhës shqipe Robert Elsi (Elsie 1996, 88). Por, nga ana tjetër, shqiptarët edhe u kanë dhënë popujve fqinjë jo pak elemente nga të gjuhës së tyre.

Duke qenë për një kohë të gjatë në kontakt e në simbiozë me popujt e Ballkanit: me grekët, romakët, sllavët e jugut, turqit, vllehtë, romët, sefardët (hebrenjtë), etj., shqiptarët kanë marrë dhe u kanë dhënë atyre mjaft elemente edhe në fushë të fjalorit e të gramatikës.

Në fushën e kontakteve ndërghjuhësore një xeherore me pasuri të pafundme përbën sidomos areali i Maqedonisë, me jo më pak se 23 gjuhë e kultura që fliten në këtë territor dhe që si i këtillë paraqet një fenomen etnolinguistik në Ballkan dhe në Evropë. Mu për këto arsye territori i Maqedonisë paraqet bërthamën e *‘Lidhjes gjuhësore ballkanike’*. Në një situatë të tillë bilinguizmi e pluralinguizmi në Ballkan dhe në Maqedoni, posaçërisht të vrullshme dhe intensive kanë qenë dhe janë kontaktet gjuhësore shqiptaro-rumune dhe ato shqiptaro-arumune, ku njerëzit e këtyre etniteteve duke jetuar së bashku, kanë mësuar dhe kanë folur gjuhët e njëri-tjetrit, e pasojisht kanë huazuar dhe elemente të shumta në gjuhët respektive. Për sa u përket lidhjeve të shumanshme shqiptaro-rumune, studiuesit kanë vënë në dukje se rreth 600 fjalë janë të njëjta ose me rrënjë të përbashkët midis shqipes dhe rumanishtes. Kjo tregon lidhjet e ngushta që kanë ekzistuar midis ilirëve dhe trakasve, të cilët kanë jetuar në Gadishullin Ballkanik shumë shekuj përpara se sllavët të shkelnin në këto treva (Papailia 2000 3). Njohësi i mirë i marrëdhënieve mes popujve të Gadishullit Ballkanik, Teodor Kapidan, shprehet kështu: *“Për dallim nga lidhjet me grekët dhe sllavët, lidhjet e rumunëve me shqiptarët, në pikëpamje ballkanike, shfaqen shumë më të ngjeshura. Ato nisin nga një numër fjalësh që nuk janë as latine, as greke, as sllave dhe as huazime të ndërsjella rumuno-shqiptare, por disa trajta që nisen nga të njëjtat fjalë themelore, të cilat duhet të kenë ekzistuar mbase në të folmet pararomake trako-ilire...”* (Albanezul 1996, 21). Për këtë arsye, ndoshta është më mirë të flitet për elemente të përbashkëta të shqipes dhe arumanishtes, se sa për ndikimin e njëres gjuhë mbi tjetrën. Albanologu i shquar gjerman Gustav Meyer këtë substrat të përbashkët e shpjegon kështu: Një radhë përputhesh në shndërrimin e elementit latin me rumanishten, e cila pas gjithë gjasave është krijuar gjithashtu në veri të Gadishullit Ballkanik, pra në afërsi të shqipes, flasin

për një substrat të përbashkët etnologjik të të dy gjuhëve, ose ngaqë rumunët pararomakë flisnin një gjuhë të afërt me ilirishten, ose pse si shqiptarët ashtu edhe rumunët para se të romanizoheshin kishin asimiluar një element të jashtë fisit, jo indogjerman...

Nocioni i termit arumun dhe shtrirja e elementit arumanishtfolës në Ballkan

2. Sipas studiuesve të kësaj problematike, nocioni *arumun* lidhet me popullsinë vendëse të romanizuar të Ballkanit (trake, ilire, shqiptare etj.). Në romanistikë sundon mendimi i përgjithshëm që arumanishtja është dialekt i gjuhës rumune (Tache Papahagi, Petar Atanasov), kurse te një lagje tjetër trajtohet si gjuhë e veçantë e latinishtes ballkanike (B. Nastev, Dina Cuvata). Te Fjalori i Dina Cuvata (Dimo N. Dimçev), autori i fjalorit të njohur *Dicționarul Dialectului Aromân*, Papahaxhi, mallkohet me këtë nëmë: *urbarea su-l batã Tachi Papahagi tsi dzãsi ca limba armãneascã-i dialectu-a limbãljei valahu-teascã = U verboftë Taqi Papahaxhi, që thotë se gjuha arumune është dialekt i vllahishtes (rumanishtes)*. Marrëdhëniet e shqipes me arumanishten ndërkaq konsiderohen si marrëdhënie midis shqipes dhe rumanishtes, pasi, *arumanishtja* trajtohet si dialekt i rumanishtes, duke i vendosur ato shpesh në marrëdhënie varësie midis tyre, duke mos i parë si dy idioma të veçanta të latinishtes ballkanike (Poçi 2009).

Elementi arumun në Ballkan ka një shtrirje të hapët gjeografike, kryesisht në brezin kufitar shqiptaro-greko-maqedonas. Më së shumti e gjen në krahinën e Pindit, në Greqi, pastaj në rajonin e Myzeqesë në Shqipëri dhe, së fundi, në Maqedoni (Nastev 1988, 149). Në truallin e Maqedonisë me një dendësi më të madhe arumunët shtrihen sidomos në Krushevë (ku janë popullsi dominante), Manastir, Resnjë, Ohër, Strugë, Shkup, Shtip, Koçan, Veles, Prilep, Ovçe Pole, e pjesërisht dhe në Kërçovë, Gostivar, Tetovë, Dibër etj., ku kanë punuar si tregtarë e zanatçinj: bojaxhinj, kujunxhinj (argjendarë), qiraxhinj, pra në ato vende ku jeton dhe një popullsi e ndjeshme shqiptare dhe ku bashkëmarrëdhëniet e këtyre dy popujve dhe gjuhëve të tyre kanë qenë të gjata dhe intensive. Sot vllehtë i gjen në Shqipërinë Qendrore dhe Jugore, kryesisht në jug të vijës Durrës - Ohër, si: në Durrës, Elbasan, Tiranë, Kavajë, Rrogozhinë, Lushnjë, Berat, Fier, Vlorë, Pogradec,

Korçë, Gramsh, Ersekë, Përmet, Gjirokastrë, Delvinë, Sarandë. Kjo popullsi, ashtu si në gjithë Ballkanin, edhe në Shqipëri ka realizuar një bashkëjetesë mijëvjeçare, duke mundur të ruajë deri në ditët tona identitetin e saj nga asimilimi prej shumicës vendase. Si rezultat ngjashmëritë janë krijuar edhe në mendësinë popullore dhe atë etno-kulturore, e cila do të pasqyrohej në krijimin e shprehjeve, frazave, mënyrave të të thënit në mënyrë paralele në këto gjuhë (Poçi 2009).

Një analizë të qëndrueshme lidhjeve gjuhësore të arumanishtes dhe shqipes u ka bërë ballkanologu eminent me origjinë arumune nga Prilepi *Teodor Kapidan* në punimin e tij *Raporturile albano-române* ("Dacoromania" II, f. 444-554; Atanasov 1997, 6). Këtu ai na jep një shtresim të elementeve të përbashkëta në të dy gjuhët, duke i ndarë ato në tri kategori: *fjalë arumune të huazuara nga shqipja, ndër të cilat dhe elemente autoktone, fjalë me origjinë të përbashkët dhe ballkanizma*. Mbi bazën e elementeve të përbashkëta shqiptaro-rumune, Kapidan arrin në konkluzionin e tij se "përveç kontakteve ndërmjet rumunëve dhe shqiptarëve në periodën romake, duket se ka ekzistuar diçka, edhe përpara këtyre marrëdhënieve, e elementit autokton", që domethënë i jep rëndësi substratit. Ndërkaq, punim me vlerë në këtë fushë ka bërë dhe romanisti Petar Atanasov: *Romansko-Albanski jazični vrski* (Atanasov 1997, 1-18), Haralambie Mihăescu (Mihăescu 1978), etj.

Për t'i thelluar më tej rezultatet në këtë fushë, një kontribut modest mund të jetë dhe ky punim yni që kemi ndërmarrë mbi raportet gjuhësore të shqipes dhe *maqedoarumanishtes*, duke e kufizuar gjeografinë gjuhësore kryesisht për rajonin e Maqedonisë, ku piqen e gërshetohen ndjeshëm këto dy gjuhë e dy kultura. Me termin *maqedoarumanishte* do të shënjojmë arumanishten që është folur e që flitet në rajonin e Maqedonisë, për ta dalluar nga idiomat e tjera të arumanishtes në Shqipëri, Greqi e Bullgari. Këtë nocion *maqedorumanishte* e ka përdorur dhe albanologu i njohur Gustav Majer në Fjalorin e tij të famshëm etimologjik të gjuhës shqipe (Majer 1891, 2007, 32). Studiuesit në Maqedoni për të shënjuar komunitetin *vllëh* përdorin termat *Vlasi* e *Aromâni*, këtë të fundit e përdorin dhe vllëhtë për të emërtuar vetveten. Sipas kategorive të ndryshme sociale, për të emërtuar vllëhtë bëhet dhe një distinkcion tjetër: *cinçar* (për urbano vllëhtë, që janë marrë me zanate të ndryshme në qytet), dhe *aromân* (për vllëhtë nomadë, çobenjtë, që kanë pasur ngulime të përkohshme baritore). Nga

hulumtimet e bëra në terren, në Maqedoni, nga Aleksandra Popvasileva (Popvasileva 1987, 109), rezulton se vllëhtë nomadë (çobenjtë) nuk i kanë përdorur instrumentet muzikore. Një dukuri të ngjashme e ndeshim dhe te popullata shqiptare e Kërçovës, ku dhe atje këngët e burrave janë kënduar gjithmonë pa instrumente muzikore.

Për hetimin e elementeve të shqipes në arumanishten e truallit të Maqedonisë kemi qëmtuar burime të ndryshme dialektologjike, leksikografike, folklorike dhe toponomastike: studimin monografik për dialektin arumun të Krushevës “*The arumanian dialect of Kruševo in Sr Macedonia SFR Yugoslavia*” të sllavistit dhe ballkanologut të njohur polak Zbigniew Gołab (Gołab 1984), një përmbledhje me përralla popullore të Krushevës “*Vlaškitë narodnik prikazni od Kruševo*” (Anovska 2002), tregimet popullore dygjuhësore dhe relacionet vllëho-maqedonase (Popvasileva 1987), *Vlaško-makedonski rečnik -Dictionar armanescu-machidunesku* të Dina Cuvata/ Dimo Dimčev (Cuvata 2006), fjalorin dialektor të arumanishtes të Taqë Papahaxhi (Papahagi 1974), “*Aromanski studii*” të Bozhidar Nastev (Nastev 1988), toponiminë e fshatrave vllahe Belicës së Epërme dhe Belicës së Poshtme “*Toponimija na vlaškitë sela Gorna Belica i Dolna Belica*” (Dunovski 1998), etj., një studimin të shkëlqyer monografik për të folmen maqedonase dhe arumune në regjionin e Ohrit dhe të Strugës “*Govorot na Aromancite Farseroti od ohridsko-struskiot region (vo balkanski kontekst)*” të Marjan Marković (Marković 2000), të cilat na japin informacione me interes në këtë fushë studimore. Hulumtimi i bashkëmarrëdhënieve gjuhësore shqiptaro-arumune është me interes studimet komparativiste linguistike.

Arumanishtja ndjente nevojë për pasurimin e fjalorit të saj nga shqipja

3. Për sa u përket elementeve të shqipes në arumanishten, sipas vëzhgimeve paraprake që janë bërë nga autorë të ndryshëm, është pohuar që numri i tyre nuk është për t'u nënvlerësuar dhe mund të sillet mbi 300 leksema bazë, që kanë hyrë me rrugë të ndryshme në këtë idiomë, pothuajse aq sa është dhe numri i italianizmave në arealin linguistik të arumanishtes (Nastev 1988, 62). Po t'i referohemi fjalorit etimologjik të T. Papahagit (*Dictionarul dialectului aromin*, 1963), në arumanisht janë huazuar rreth 355 fjalë, si: *guvë, gorricë, merimangë, pikë, rrap, shëllirë,*

shollë, mëllagë, çilimi, çakërdisem, degë, mezi, mace, vijë etj. Ky numër sigurisht është edhe më i madh nga ai që është paraqitur nga leksikologët dhe studiuesit që janë marrë me elementet shqipe në arumanishten dhe mbase mund të arrijë dyfishin e më shumë.

Nga ana tjetër, edhe shqipja ka huazuar disa fjalë nga arumanishtja, ndoshta jo të shumta, p.sh: *fjçor, kënut, milor* etj. Por, nga anketimet e bëra sot në jug të Shqipërisë vërehet se gjendja gjuhësore e arumanishtes nuk është më kjo (Poçi 2009). Si shprehje e kontakteve të ndërsjella kulturore e gjuhësore, këtyre mund t'u shtojmë për shqipen dialektore edhe fjalë të tjera të hyra nga arumanishtja: *bujer, kaptell, kërluk, konoshtejs, perdaf, partall, sugar, Kaset/ Kasa, Purellket/Purellku* – emra familjesh e mbi-emra familjarë (Sërbicë, Kërçovë), etj.

Në fjalorin e arumanishtes nga të regjionit të Krushevës dhe të qyteve të tjera të përmendura këtu sipër kanë hyrë një numër i konsiderueshëm i elementeve të shqipes. Kur është fjala për Krushevën, vlen të theksojmë se në këtë areal, përveç popullsisë arumune dhe maqedonase, kanë jetuar dhe shqiptarë të konfesionit ortodoks, të cilët kanë lënë dhe gjurmët e tyre në toponimi dhe në gjuhë. Në Krushevë është e njohur *Mëhalla “Ohtul di Arbinesh” (“Kodra e Shqiptarëve”, Arnautskiot Rid)*, formuar në fillim të shek. XIX, në pjesën perëndimore të këtij vendbanimi, në anën e majtë dhe të djathtë të lumit të Krushevës, nga shqiptarë ortodoksë të Shqipërisë Jugore, Korçës e Voskopojës, të cilët siç pohon studiuesi Aleksandar Matkovski, “*filluan të vllahizohen qysh në kohën e ardhjes së tyre*” (Matkovski 1978, 13; Anovska 2002, 9).

Arumanishtja, sikurse dhe gjuhët e tjera ballkanike, ndjente nevojë për pasurimin e fjalorit të saj (Atanasov 2000), përveç nga gjuhët e tjera, edhe nga shqipja. Direkt ose indirekt, në arumanishten kanë hyrë një numër i konsiderueshëm i elementeve nga shqipja, sipas vëzhgimeve tona, kund një 700 leksema e topoleksema.

I. Elemente shqipe në të folmen arumune të Krushevës

Për regjionin e Krushevës mund të evidentojmë një numër jo të pakët të leksemave të tilla, kund mbi 30 fjalë, të nxjerra nga studimet dialektologjike të linguitit polak Z. Gollab (1984) dhe Marjan Mar-

koviík (Markoviík 2000), që prezanton të folmen e arumunëve Farshëriotë (me prejardhje nga Frashëri i Shqipërisë).

Arbinésu m. -lu pl. *Arbineši, -li* ‘shqiptar’ (Goľab 1984, 201). Me emrin e këtij etniku lidhet dhe topoleksema *Arbinovë* – fshat tani i banuar me popullsi maqedonase në rrethinat e Ohrit.

Arbinišie ‘Shqipëria’.

ambáru pl. *ambári* ‘i mbarë, i pashëm’: *kale-mbár* (kale + ambarárə) = lamtumirë (në ndarje) (Goľab 1984, 197), “mirëmbeç”.

análtu ‘lart’ (Goľab 1984, 198). Nga shqipja dialektore e Maqedonisë *nalt*. E sjell dhe fjalori i Dina Cuvata (2006, 28).

báltə f. pl. *bálca, -le*. Kjo leksemë është huazuar nga shqipja ‘baltë’, jo nga sll. **bolto* siç shprehet linguisti polak Goľab (Goľab 1984, 207).

bənezə, pl. *bənəmu* ‘banoj, jetoj’ (Goľab 1984, 207).

búzá f. pl. *buzle* ‘buzë’ (Goľab 209). Albanizëm që ka shkuar edhe në të tjera gjuhë ballkanike. Prej këndeј rrjedh dhe mbiemri familjar arumun *Buzleski* në rrethinat e Resnjës, përdorur si ofiq me cilësimin ‘njeri me buzë të mëdha’. Khs. në Kosovë *harbuzç*. *Asht njëfar harbuzçi* (Vushtrri).

capu m. *-lu* pl. *cak`i, -li* ‘cjap’ (Goľab 209), shq. cjap, dial. cap.

Dibreánu m. *-lu* ‘erë që fryn në drejtim të perëndimit’ (nga Dibra). Nga shq. Dibër (Goľab 211).

duk`ėsku, duk`áre/ duk`íre: mi duk`ėsku ‘më duket’ (Goľab 213).

dhále/ dálə f. – shq. dhallë (Goľab 1984, 214).

flukatə “flokate, velenxë” (Goľab 1984, 214).

fitur “flutur” (Goľab 1984, 214).

furtunə -a f. ‘furtunë, stuhi’ (Goľab 1984, 216).

frikə -a f. shq. ‘frikë’.

frikósu, frikoásə, frikoáse ‘i, e frikësuar’. Kjo fjalë me format e mësipërme është marrë nga shqipja ‘frikë’, një fjalë e mbarë kësaj gjuhe, e jo nga greqishtja e re *friki* siç e shpjegon Gollab (Goľab 1984, 216).

gurmázu, -lu, pl. *gurmáze, gurmázle* – Gollab e shënon me pikëpyetje si ballkanizëm (Goľab 1984, 218). Në fakt kjo fjalë njihet si një albanizëm ballkanike (Çabej 1996).

gúvə, -a f. pl. *gúve, -ile* ‘guvë, vrimë e madhe a gropë brenda në një shkëmb ose në tokë, shpellë, zgërbonjë’ (Goľab 1984, 218).

g`élə, -a f. pl. *g`éle, -ile* ‘gjellë’ (Goľab 1984, 218).

g`izə, -a f. *g`izuri, -le* ‘gjizë’ (Goľab 1984, 219); *ghizā, ghizāreauuū* (Cuvata 2006, 266).

g`umu, pl. *g`úme, -ile* ‘gjym’ (Goľab 1984, 219).

kalu, kálu, pl. *kál`i*. Në arumanishten e Krushevës do të jetë huazuar nga shqipja ‘kalë’, porse Goľab e merr si fjalë arumune (Goľab 1984, 223).

kárpə f. ‘karpë’. Gollab e regjistron për Gopesh, por thotë që është e panjohur në arumanishten e Krushevës (Goľab 1984, 218).

kúçubə, -a f. *kuçúbe* ‘kaçubë’ (Goľab 1984, 228).

kupaçu m. *kupašlu* ‘kopaçe’ (Goľab 1984, 228).

minduésku, mindúire fol. ‘mendoj’ (Goľab 1984, 235).

nəpərtíkə/ nípərtíkə, -a f. pl. *nəpərtíci, -sle* ‘nëpërkë’ (Goľab 1984, 237).

Ohərda ‘Ohri’. Artikuluar me formën e shqipes në të pashquarën Ohër.

siguru “sigurt” (Goľab 1984, 248). Këtë fjalë Goľab e shpjegon me burim nga greqishtja, që ka hyrë nga italishtja. Kur dihet historia e formimit të këtij lokaliteti, ku ka dhe

popullatë shqiptare të aromanizuar, si dhe gjeografia e Krushevës, në fqinjësi me fshatrat shqiptare të këtij visi, kjo leksemë nuk ka si të ndahet nga shq. *sigurt*. *strambu*, -e pl. *strang* 'i shtrembër' (fizikisht ose moralisht (Goľab 1984, 250). *shutu* pl. *shucə, shute* 'shyt, pa brirë' Goľab 1984, 253). *vátrə*, -a f. pl. *vəcri, -le/vatre, -ile* 'vatër'. Gollab e jep me shënimin ballkanizëm (Goľab 1984, 258), por kjo leksemë njihet si një albanizëm ballkanike. *zvéřka*, -a f. pl. *zvéřk* 'i, -le' 'zverk' (Goľab 1984, 260).

II. Bashkëpërkime leksikore të shqipes me maqedoarumanishten

4. Një numër të konsiderueshëm elementesh leksikore të shqipes a bashkëpërkimesh (konkordancash leksikore) hasim dhe te *Fjalori arumumanisht-maqedonisht* i Dino Cuvata (Dimo N. Dimčev) "*Dictsionar armāneascu-machidunesku*" (*Vlaško-makedonski rečnik*, Skopia, 2006), i cili përfshin një lëndë leksikore prej 21.500 fjalësh nga të kësaj idiome, si dhe në të folme dhe në burime të tjera të literaturës. Nga këto burime kemi qëmtuar një material të pasur leksikor e gjuhësor me burim shqiptar që ka shkuar e rron në arumanishten ose që mund të jenë fjalë me origjinë të përbashkët dhe ballkanizma.

agalea ndajf. "ngadalë": *agalea, -agalea-agiumsirā* = ngadalë-ngadale, mbërrita (Cuvata 2006, 56, 10). Me ndërmjetësi të arumanishtes ka hyrë dhe në maqedonishten dialektore *agale* "poleka, bavno" *odi si agale, agale. Aga se moma razbudi, agale gaski isklani* (RMNP 1, 118; Angelovski 2000). Argirovski GMJ 59 e afron me greq. e re *àgál(a)*. Kjo vetë mbase rrjedhur nga shq. *ngadale*, dial. *kadale, gadale*, me formë metatetike dhe me *a*-protetike në arumanishten.

aducā "ngjashmëri, të dukë": *shi-ahitari-aducā, nun ji-aveam vidzutā = aq kanë të dukë (janë të ngjashëm), sa s'kam parë* (Cuvata 2006, 7).

agru mb. "i egër" – *tsi agru mi mātri!* = sa egër më shikoi; *agru biba* - patë e egër (Cuvata 2006, 14). Në maqedoarumanishten kjo fjalë do të jetë huazuar nga shq. *egër*, kjo vetë rrjedhur nga lat. *acris*.

alāvđari "lëvdoj, lavdëroj": *alāvđarea easti-arānji* = lavdërimi është zgjebe (Cuvata 2006, 18). Fjalë e burimit latin *laudare* "lavdi", rum. *lāuda, lāudare*. Në arumanishten me këtë formë me *vd* do të ketë hyrë përmes shqipes.

alāvđat "i lavdëruar, i lëvduar" (Cuvata 2006, 18).

alāvđālāchi "të lavdëruarit" (Cuvata 2006, 18).

alāvđā tor "lëvdues, ai që lëvdohet, që e lëvdon veten". Përdoret dhe *alāvđodicu, alāvđos* (Cuvata 2006, 18).

ambar ndajf. "mbarë, me fat": *du-ti-ambar* = të qoftë mbarë, shko mbarë; *oarā bunā sh-calea-mbar!* = mirupafshim dhe rrugë të mbarë! *Ti-ashtisi, shi-a lui ālji yinea-mbar* = për ashtu, edhe atij i vinte mbarë (Cuvata 2006, 24).

ambāreatsā pash. "mbarë"! (në punë) (Cuvata 2006, 24).

āmbar, āmbarā, pl. *āmbari* 'mbarë, mbarësi': *calea-mbar s-vā* = të keni udhë të mbarë; *lucurlu- mbar* = punë të mbarë (Cuvata 2006, 70).

analtu "nalt, lart": *analtu pi cal* = nalt mbi kalë; *multu analtu* = shumë nalt (Cuvata 2006, 28); *La noi sh'are munte analtu* = Te ne ka male të nalta (Trajanovski 1998, 191).

andralā, pl. **andralji** ‘marramendje’ = *biu dauuā shushi di yin tora lj-yini-andralā – piu dy shishe verë dhe tash ka marramendje* (Cuvata 2006, 30). Shq. bised. *andrallë* ‘kokëçarje, telash’.

Andreu, Andrelush “Shënëndre, Shndre, dhjetori” (Cuvata 2006, 30).

arām (arāmi, arāmat, arāmri) “arvoj “gërmoj, mih, rrëmih” = *purtsel-u-aestu lu- arāma oborlu tut – derrkuci e ka armuar (gërmuar) krejt oborrin* (Cuvata 2006, 41). *Arvoj* (Kërçovë).

aradā “radhë, rend” (Cuvata 2006, 39).

arasti “rast”: *lj-i-u-adasu-arastea = e gjeti rastin* (Cuvata 2006, 40).

arācāi “rrëke”: *cara dendī nā ploai mea cara vinirā – arācāili-mproasti = kur ra shi, erdhën rrëke të rrëmbyeshme* (Cuvata 2006, 41).

arāndzā f. ‘mullëz, farë djathi, rëndës, rrëndës’ (Cuvata 2006, 42). Fjalë nga terminologjia baritore. Edhe në rum *rīnzā*. *Sipas* G. Majerit (Meyer 2007) fjala pas gjase duhet bashkuar me *rëndë* ‘i rëndë’ dhe prapashtesën –ës, ku në këtë mënyrë trajtat e rumanishtes dhe të arumanishtes janë huazuar nga shqipja.

arobā “rrobë, fustan” (Cuvata 2006, 49).

arotā “rrotë” (Cuvata 2006, 49).

astup “shtupoj”: *astup-u = shtupoje, mbylle (mjaft, mos fol, mos qaj)* (Cuvata 2006, 61).

astupat mb. “i shtupuar, i mbyllur” (Cuvata 2006, 49).

ashi “ashtu”: *ashi, mica, ashi = ashtu, nënë, ashtu* (Cuvata 2006, 56, 323).

atā “lok. nënë” (Cuvata 2006, 62). Shq. dial. *tatē* “nënë” (Kërçovë). Për babanë “*dat*”.

avrapā “vrap, vrapim, galop”: *caljlji vinirā cu-avrapā-n hoarā, ca cārvānarlji lj-i-avea vātāmatā-andartsālji gārtseshtā = kuajt erdhën duke galopuar në fshat, ngase karvanxhinjtë i kishin vrapë andartët grekë* (Cuvata 2006, 91).

avrari “godas, vras” (Cuvata 2006, 67).

baci “emër me të cilin vëllai i vogël e thërret vëllanë e madh; 2. përdoret me nderim edhe përpara emrit të një njeriu më të moshuar (Cuvata 2006, 93). Përdoret në disa të folme veriore dhe verilindore të shqipes, prej nga do të ketë hyrë dhe në arumanishten.

bāligari “për kafshët, bagëlon” (Cuvata 2006, 98).

bāligat “për kafshët, bagëlon” (Cuvata 2006, 49).

baligā – ‘bajgë, balgë, bagël’ (Cuvata 2006, 94). Fjalë që ka shkuar edhe në rum. *balegā*, megl. *baligā*, maq. *baliga*, skr. *balega*, të gjitha këto të ardhura nga shqipja me trajtën primare *balgë* (Çabej 1976, 49). Në të folmet popullore të maqedonishtes përdoret dhe me kuptim të figurshëm: *Ne balegaj* “mos bagëlo” (Shtip), *Ne baleguvaj* (Maleshevë), pas gjuhëtarit D. Angelovski një arumanizëm në maqedonishten (Angelovski 2000, 31).

bārnā bot. “bimë që zvarritet, bar” (Cuvata 2006, 99).

bardzu, bardzā – ‘kalë i zi me qime të murrme ngjyrë kafeje’ (Cuvata: 2006, 95). Fjala në thelb vjen nga arum. *bardhu* ‘me varra-varra të zeza’ (për bagëti), por e cila rrjedh nga një fazë e përparme e shqipes *bardhë* (Çabej 1976, 57).

besā – shq. besë. Përdorur në shprehje të tilla: *bre, bre, besā ghigāneascā = shih, shih, besë gegu* (Cuvata 2006, 101).

besa-bes – nga shq. besë (betim). (Cuvata 2006, 101).

bironji - ‘kafsha që nuk pjell, beronjë, shtirë; gruaja që nuk lind’ (Cuvata 2006, 104) – shq. *beronjë*.

bācātar, pl. **bācātari** – ‘shqiptar farshëriot’ (Cuvata 2006, 97). Ky cilësim rrjedhur nga *bācātar* ‘ai që ruante disa dele rreth fshatit’ në rrethinat e Berit.

- bārsū** – ‘bërsi, fundërria e rushit dhe e ullinjve që mbeten pasi shtypen’ (Cuvata 2006, 100). Pas Meyer fjalë e prejardhur nga lat. *brisa*. Por në arumanishten gjithsesi është një huazim nga shqipja *bërsi* (Çabej 1976, 62).
- bāricā** pl. **bārici** “bërrakë” (Cuvata 2006, 99).
- biro** palak. ‘babaçko’ (Cuvata 2006, 104).
- birbu** “bir, djalë” (Cuvata 2006, 103).
- bobo!** pasth. *bobo! Tsi sherpi mi māshca* = bobo, çfarë gjarpri më kafshoi (Cuvata 2006, 105). *bobo* (FGJSSH).
- buljear**, pl. **buljeari** ‘bollë e madhe, lloj bolle’ (Cuvata 2006, 109). *Bullar* (FGJSSH).
- brushtulā**, pl. **brushtuli** ‘lakror me djathë e me gjalpë’ (Cuvata 2006, 107) *brushtull* (FGJSSH).
- brumā**, pl. **brumi** ‘brymë’: *bruma lji-arsi bāhceadzli* = bryma i dogji bahçet (Cuvata 2006, 107).
- brumar** – ‘nëntori’: *cad ca frānzā tu Brumar shi ca schiclu tu-Alunar* - bien si gjethet në nëntor dhe kallinjtë në korrik (Cuvata 2006, 107). – *brymēs* ‘nëntor, muaji i brymēs’ (FGJSSH).
- buburanā**, pl. **buburani** – ‘flakadan i madh, zjarr i madh’ (Cuvata 2006, 108) – shq. bubulak (për zjarrin), bubulon, bubullon, bubullin (FGJSSH), me alternimin *l-r*.
- bura** “trim, burrë”: *bura Tega nu s-aspari* = trimi (burri) Tega nuk frikësohet (Cuvata 2006, 110).
- budzā**, pl. **budzā** (buxë) “buzë”: *cu budzāli aroshi di sāndzā* = me buzë të kuqe nga gjaku; *cāt bati budzāli* = *mezi i lëviz buzët* (është i sëmure, flet ngadalë); 2. skaj (në lumë ose në det): *casa u-aveam pi budza di-arāu* = shtëpinë e kemi buzë bregut të lumit; *oili li-avem dip pi budza di-amari* = dhentë i kemi buzë detit; *apili-a Avārdarlui lji-avea vinitā isa cu budzāli* = ujërat e Vardarit i arritën deri buzë bregut; 3. skaj, qoshe (e bunarit, kazanit): *cu bārgacili-mplini pān di budzā* = me kazanat të mbushur deri në buzë, buzë më buzë; 4. *shmāshcā budzāli di cripari* = i kafshoi buzët nga vështirësitë; 5. *budzā-groasi* = me buzë të mëdha; 6. mallk. *S-nu lji-arādā budzāli* = i vari buzët (u hidhërua) (Cuvata 2006, 109) – shq. *buzë*.
- budzos**, **budzoasā**, pl. **budzoshi**, **budzoasi** – ‘buzëmadh, që është me buzë të mëdha’ (Cuvata 2006, 109).
- bucuvālā**, pl. **bucuvāli** ‘bukëvale’: *tora seara va s-avem bucuvālā* = sonte do të hamë bukëvale (Cuvata 2006, 108).
- bis**, pl **bishi** - ‘bythë’ (Cuvata 2006, 104).
- tāpoarā** “cakorre, sëpatë”: *lo tāpoara shi s-dusi ti leamni* = e mori cakorren dhe shkoi për dru.
- tāpor** dem. “cakorre, sëpatë e vogël” (Cuvata 2006, 521).
- tsap** “përç, cjaq” (Cuvata 2006, 544).
- tsāpar** “tregtar i cjepve” (Cuvata 2006, 545).
- cātse?** “pse”: *cātse nu vinishi* = ce (pse) nuk erdhe (Cuvata 2006, 131). Përemër pyetës, që reflekton trajtën dialektore të shqipes së Maqedonisë *ce* “pse”.
- çipitā** “majë (e gjuhës, drurit, kodrës, malit), cep”: *pi cipita di limbā lu-am, ma nu-nji ticneashti cum s-dzātsi* = e kam në majë të gjuhës, por nuk më teket (kujtohet) si thuhet (Cuvata 2006, 166). Me ndërrimin e rregullt fonetik *e-i* në arumanisht, khs. si te *ciresh* – *qershī*, *cirishear* – *qershōr*, *cirgar* – *cergar* etj.
- chicā**, **chicutā** “çikë, pikë”: *acātsa di-arucā cāti vārā chicutā* = filloi të bjerë nga ndonjë çikë (pikë shiu). 2. çikë, diçka e imët: *tuti-aesti tsi li spunji suntu unā chicutā tu-amari* = gjithë kjo që thua, është vetëm një pikë (çikë) në det (Cuvata 2006, 173).
- chicātūrā** “vendi ku çikon çatia (në tavan, në dysHEME)” (Cuvata 2006, 173). Shq. *çikë*.

- cilimean** (çilimean) “kalama i vogël, çilimi”: *s-agiuca doi cilimeanji* = luan me fëmijë, çilimi”. 2. djalë, çilimi: *am unā featā shi-un cilimean* = kam një vajzë dhe një çilimi (Cuvata 2006, 165). Një “formim elementar” që në arumanishten duket të ketë depërtuar nga shqipja.
- cingrimi** pl. **cingrinji** “të ftohtë i madh e i thatë, acar, ngrica e dimrit, cingërimë” (Cuvata 2006, 166). *cingërimë* (FGJSSH).
- tsopā** (copë) “copë, pjesë e madhe buke”: *tsopa di pāni* = copë buke (Cuvata 2006, 545; Polenaković 2007, 189). Studiuesi i njohur arumun Haralampie Polenaković, me origjinë nga Gostivari, këtë fjalë e bie të ardhur nga turq. *çup*, porse prejardhja e kësaj lekseme pa diskutim rrjedh nga shqipja *copë*.
- tsātsā** “cucë”: *Feata ni earam/ feta ni escu/ Tsātsā ni aveam/ tsātsā ni am* (në një përrallë popullore) = Çfarë më bëni ? Cucë isha/ cucë jam prapë (Popvasileva 1987, 102). Fjalori i arumanishtes *tsātsā* e sjell me kuptimin “cicë, sisë” (Cuvata 2006, 545).
- ceapā** (çepapë) pl. **ceapi** (Krushevë) “çap, hap” (Cuvata 2006, 163).
- ceapkān** (çepkën) “çapkën, djalë i shpejtë, i prapë, të cilit i vlon gjaku” (Cuvata 2006, 163). Fjalë me burim nga turq. *çapkën*, por në arumanishten mbase mund të ketë depërtuar përmes shqipes.
- ceapcānlāchi** (çepkënlëqi) “çapkënlëqe” (Cuvata 2006, 163).
- chicā** (çikë) “pikë e vogël uji që bie nga çatia, çikë” (Cuvata 2006, 173).
- dash** pl. **dashi** “dash” (Cuvata 2006, 180).
- deagā** (frashëriotët) “degë” (Cuvata 2006, 184).
- denghi** “ballë e madhe, paketë” (Cuvata 2006, 188).
- denghi** (dengj) “kategori, shtresë”: *nu nā hits denghi, noi him chihēadz shi voi hits picurari* = nuk jeni dengju ynë, ne jemi qehallarë (të pasur), ju jeni barinj (Cuvata 2006, 188).
- doci** pl. **doceanji** (te Frashëriotët) “kopil. Fëmijë jashtë martese, bastard, doç” (Cuvata, 207, Papahagi 497).
- dosā** pl. **dosi** “kurvë” (Cuvata 2006, 208). Kuptimi i kësaj fjale, përdorur figurshëm “kurvë” në arumanishten, pëlqen dhe me atë të shqipes “grua e pandershme”.
- drāzgā** – shkurre, kaçubë (Cuvata 2006, 209).
- erā** pl. **eri** “erë”: *s-lom niheām erā = të marrim një erë, të freskohemi* (Cuvata 2006, 222).
- etā** pl. **eti** “1. kohë, jetë. 2. përjetësi” (Cuvata 2006, 224). Në ligjërimin e Kërçovës e hasim të përdoret shprehje të tilla si *më jetë e më denjo* “në përjetësi, për jetë të jetëve”.
- āngrānji** pl. **āngrānjeri** “ngrënie me fjalë” (Cuvata 2006, 84).
- āngrāshca** “ngrënës, llupës” (Cuvata 2006, 84).
- ānglitsat** - ngrij, me altermimin e rregullt në arumanishten të r-së në l (Cuvata 2006, 84).
- āngrāshca** ndajf. “ngrykë, në krah, hopa” (Cuvata 2006, 84).
- ānprapā** “i shpejtë, agil, i gjallë” (Cuvata 2006, 86). Formuar me parashtesën *ān* dhe fjalën shqipe *prapë* “i sertë”, sikurse *ānreghistrari* “regjistrim”. Kjo fjalë (*i,e*) *prapë* përdoret kështu për një “njeri që është i egër, i rreptë, i vrazhdë, i sertë” edhe në shqipen dialektore të Maqedonisë (Kërçovë, Strugë, Dibër, Tetovë).
- ānvets** “ves, shprehi”: *nibun ānvets* = ves i keq (Cuvata 2006, 90).
- ānvescu** “vesh, vishet”: *sā-nviscu tu stranji nauuā* = u vesh me rroba të reja (Cuvata 2006, 90).
- ānvishetari** pl. **ānvishteri** “veshje” (Cuvata 2006, 91).
- āndriptati** “drejtësia”: *āndriptatea-anāchisi* = fitoi drejtësia (Cuvata 2006, 79).
- āndriptat** “i drejtë” (Cuvata 2006, 79).

- farā** pl. **fari** “1. popull. 2. familje, farë, farefis”: de, bre, de! *Tsi farā-aleaptā = de, bre, de, çfarë familje vetjake!* (Cuvata 2006, 230). Fjalë nga terminologjia e jetës familjare, e cila nuk mund të ndahet nga shq. *farë, farefis*.
- bea`min** (Krushevë), *te`min* (Ohër) – femër (Marković 2007, 30).
- festā** pl. *festi* “festë” (Cuvata 2006, 234).
- fleamā** “zjarr, ndezje” (Cuvata 2006, 237).
- fitur** pl. **fituri** zool. “flutur” (Cuvata 2006, 236).
- floc** pl. **floaci** – flokë, thekë (te jambolia) (Cuvata 2006, 237).
- fortsā** “forcë, fuqi”: *cu forsa = me forcë* (Cuvata 2006, 239).
- fuscā** pl. **fuschi** – flluska (e sapunit) (Cuvata 2006, 246).
- fuljeauuā** pl. **fuljei** “folë e shpendëve” (Cuvata 2006, 243).
- fricos** “frikës, frikshëm”: *lj-easti fricā = ka frikë, frikësohet* (Cuvata 2006, 242, 317).
- fundu** “fund”: *amarli, di-ahāndoasi tsi suntu, nu lā si shiit fundu = detrave, për shkak se janë të thellë, nuk u shihet fundi* (Cuvata 2006, 243).
- fustanelā** “lloj veshje, fustanellë” (Cuvata 2006, 246). Kjo lloj veshje, si pjesë e kostumit kombëtar shqiptar për burra, nuk mund të mos njihet si një huazim i shqipes në arumanishten, që ka hyrë atje jo vetëm si fjalë, por dhe si kostum.
- fut** “1. kryej aktin seksual, 2. fig. ia hedh dikujt me mashtrime” (Cuvata 2006, 246).
- fuchū** “forcë, fuqi” (Cuvata 2006, 243).
- gavrā** pl. **gavri** “guvë, zgavër” (Cuvata 2006, 249).
- gāl-gāl** pash. imitohet rrjedhja e verës, ujit “gëll-gëll”: *āl muta shushu shi, gāl-gāl, āl biu yinlu tut = e ngriti shishen dhe, gëll-gëll, e piu krejt verën* (Cuvata 2006, 250).
- grit** fol. “grish, thërras” (Cuvata 2006, 250).
- gritā** pl. **griti** “grishje, thirrje”: *unā gritā cx-vini = një të grishur, erdhi* (Cuvata 2006, 256).
- gumar** pl. **gumari** zool. gomar, 2. fig. njeri me tipare të ulëta, jonjeri = *mari gumar inshi Poni* – gomar i madh u tregua Poni (Cuvata 2006, 258).
- gushi** “gushë, fyt”: *lu-acātsa di gushi = e rroku për gushe* (Cuvata 2006, 259).
- guvā** pl. **guvi** “vrimë e madhe në tokë, në dru a në një shkëmb, shpellë”: *tu pishitireauu ā ari nā guvā mari = te shpella ka një guvë të madhe* (Cuvata 2006, 259). Shq. *guvë*.
- gal** – “djalë”. Fjalë nga terminologjia familjare, që e hasim në një këngë që këndohej për Shëngjergj në Dibër: *Ludaj, lulaj, Dostole! Ata řale, mja řale! Ajde řale, Petre le! Petreva e bre nevesta* (Nastev 1988, 79).
- yiūlū** (gjallë): “*Fichir, fichir, yiūlū cu mortulū, t` un loc mâcā pâni!* = Fikir, fikir, i gjalli me të vdekurin, hanë bukë në një vend! ose *Fichir, fichir, yiūlū cu mortulū, di un loc hea apā = Fikir, fikir, i gjalli me të vdekurin, pinë ujë në një vend (në baladën “Mrtviot brat”, Popvasileva 1987, 78).*
- ghelā** pl. **gheli** “gjellë, ushqim”: *ghelā di campiri = gjellë me patate* (Cuvata 2006, 263).
- ghelagi** - gjellaxhi, ai që përgatit gjellën (Cuvata 2006, 263).
- giza**, pl. **gizadz, ghiza** ‘gjizë’. (Cuvata 2006, 262, 266). Fjalë nga terminologjia e ushqimit, albanizëm me burim interballkanik (Çabej 1976).
- ghusmāpingā**, pl. **Ghusmāpinganji** – ‘gjysmopingë’, nofkë që arumunët ua jepnin shqiptarëve: *Arbineslu-i ghusmāpingā = shqiptari është gjysmopingë* (Cuvata 2006, 266).
- giuemetā** pl. **giuets** (Farsheroti) – gjysma (e diçkaje): *giuemetā di dzuuā lu-ashtiptai, sh-nu vini = gjysmë dite e prita, dhe nuk erdhi* (Cuvata 2006, 262).
- giuimitati** – gjysmë: *s-adra giuimitati di om = kishte mbetur gjysmë njeriu* (ishte dobësuar shumë, i rënë nga shëndeti) (Cuvata 2006, 262).

giuniticu – figurë e përrallave popullore arumune e maqedonase, e afërt me të shqipes. *Gjysmagjeli*, te maqedonasit si figurë përrallore ka mbetur prej arum. *Giuniticu*, ndërsa në vetë arumanishten ka dalë prej leksemës *gunitate* a *jumatate* “motie”, një fjalë që njihet si një huazim prej shqipes *gjymës*, *gjysmë*, sh. H. Mihaescu, Remarques sur rapports albano-aroumains, Gjurmime albanologjike – Seria e shkencave filologjike VII1977, Prishtinë, 1978 (Murati 1990, 61).

ghegan pl. **gheganji** – gegë, shqiptar nga Shqipëria e Veriut (Cuvata 2006, 263).

harei – gazmend, hare, dasmë (Cuvata 2006, 268).

h'er “hekur” – te arumunët farshëriotë të Strugës dhe të Ohrit (Marković 2000, 31).

shilji “pluhur, hi”, *cinushi*: *Dina easti shilji-nt-oclji la ehtsãrlji-a Armãnjlor = Dina është hi në sy te armiqtë e arumunëve; tu vatra-a ta sh-cinushea ardi = në vatrën tënde digjet edhe hiri (çdo gjë të shkon mbarë)* (Cuvata 2006, 511, 563).

dzira (xira) “hirrë”. Te arumunët ndeshet në terminologjinë baritore, në situata të tilla bise-dimi: *i kiseloto mleko osloboduva xira*, me shqiptim të *x* për *h*. Arumanizëm që ka hyrë në maqedonishten (Angelovski 2000, 31), e në vetë arumanishten huazuar nga shqipja *hirrë*.

hut, **hutã** “i trashë nga mendja, i hutuar, budalla”: *armasi ca hut = mbeti si hut* (Cuvata 2006, 282).

izoti palak. “i zoti, i aftë”: *nu-i izoti el ti-ahtari un lucrú = nuk është i zoti ai për një punë të tillë* (Cuvata 2006, 300).

cãceak “kaçak, grabitës, plaçkitës shqiptar” (Cuvata 2006, 122).

cãciubã pl. *Cãciubi* “trung i shkurtër, gëmushë, kaçubë”. 2. plak (Cuvata 2006, 123).

cãsulã “kaçule, kësulë, kapuçi i gunës, bërrucit”. Me këtë kuptim kjo fjalë njihet edhe në të folmet dialektore maqedonase të Maleshevës dhe të Prilepit si një arumanizëm (Angelovski 2000, 31). Në arumanishten huazuar nga shqipja *kaçule*, *kësulë*.

cac (*cãcai*, *cãcari*), kryej nevojën, dhjes (Cuvata 2006, 112). Në shqipen dialektore të Kërçovës, në gjuhën e fëmijëve, përdoret *kakë* “mut” dhe *kak* “dhjes”.

tsatsa “pasth. “kështu i quan nusja motrat e burrit në shenjë nderimi”. (Cuvata 2006, 544). Termi i arumanishtes *tsatsa* në thelb reflekton *kaka*, me ndërndërrimin fonetik *ts-c*, si te *tseapã – kepë, qepë*. Kjo leksemë bashkohet me *kako* të shqipes së Kërçovës, përdorur si ndajshtim me të njëjtin funksion, kjo mbase prej *kokonë*, gr. *kokona* “zonjë”.

cal pl. *calji* “kalë, at”, 2. fig. kokëfortë, budalla”: *zurlu, ca cal = budalla, si kalë*. 3. fraz. *Pi cal easti = është në kalë* (në pozitë të mirë); *cãdzu, di pi cal pi gumar = ka rënë prej kali në gomar; analtu pi cal = nalt mbi kalë* (Cuvata 2006, 113, 28).

calesh, **caleshi** mb. 1. “kalesh, zeshkan”. 2. (për dhen) *kaleshë* (Cuvata 2006, 114). Fjalë e mbarë shqipes *kalesh*, *kaleshan*, *kaleshë*.

carcalets zool. “kandërr si karkalec, bulkth” (Cuvata 2006, 113).

Cãstrãnjot “Kastriot, pjesëtar i familjes Farshërioti (Frashëri), sipas Kuvatës fis arumun, të përhapura në Epir dhe Myzeqe: *Ioryi Cãstrãnjoitu = Gjergj Kastrioti- Skënderbeu* (Cuvata 2006, 130).

catandasi “gjendje” (Cuvata 2006, 121).

cãtun pl. *cãtuni* “katun, fshat” (Cuvata 2006, 132).

checi “qeçe, lloj kësule” (Cuvata 2006, 172).

gãlbadzã “metil, këlbazë”: *gãlbadzã s-vã mãcã, de! Malklim për dhentë:Këlbaza, u faroftië, de!* (Cuvata 2006, 250).

cãmeshi pl. *cãmeshi* “këmishë” (Cuvata 2006, 125).

cãpushi zool. “rriqër, këpushë” (Cuvata 2006, 127).

caputã pl. *caputi* “shputa e këmbës, gjurmashkë, këputë” (Cuvata 2006, 118).

cārtsālinā anat. “kërcell” (Cuvata 2006, 129).

cārtsunā pl. *Cārtsuni* “kokë, krye, kërcu” (Cuvata 2006, 130).

clīni pl. “palë, kind”: *fustani cu cljini-cljini* = *fustana me kinda-kinda* (Cuvata 2006, 133).

Culac – bukë e rumbullakët, kulaç (Cuvata 2006, 152). *Culachu a nunlui* – kulaçi i kumbarës.

Culonjea, fig. rrëmujë. Përdorur në shprehje të tilla: *nā u-adra casa ca di Culonjea* = na e kanë bërë shtëpinë si prej Kolonje (rrëmujë, të çrregulluar, pa asfarë rregulli). (krahosim me qytetin e Kolonjës në Shqipëri) (Cuvata 2006, 153).

korb “gavran” - te arumunët farshëriotë të Strugës dhe të Ohrit (Marković 2000, 52).

corba! pash. *corba! corba!* – maq. lele. kutrite! – shq. grua e shkretë, grua fatqeqe! (Cuvata 2006, 144).

creastă “kreshtë (te kafshët), 2. majë mali (Cuvata 2006, 147).

cuclā pl. *cucli* “kukull” (Cuvata 2006, 150). Në maqedoarumanishten më shpesh del të përdoret leksema tjetër *pāpushi*.

culacu “pogaçe, kulaç” (Cuvata 2006, 152). Leksemë e burimit sllav *kolač*, *por me fonetikën e fjalës arumune do të njihet të ketë hyrë në këtë gjuhë prej shqipes kulaç*.

cumbar – kumbarë nun (Cuvata 2006, 154).

cushuri pl. *cushuradz* “kushëri. dial. kushuri”: *o, cushuri, yina cama-ncoa, de!* = *o kushuri, eja këho (këtu), de!* (Cuvata 2006, 159).

cusurinā “kushërirë, kushërinë”: *cusurinā vearā* = kushërirë e parë; *cusurinā andaulea* = *kushërirë e dytë* (Cuvata 2006, 159).

cuvendā “1. fjalë, 2. bisedë e shtruar, bisedim” (Cuvata 2006, 159).

lafazan – llafazan, ai që flet shumë (Cuvata 2006, 303).

ljeap “cub, kusar shqiptar” (Cuvata 2006, 316). Emërtuar sipas etnonimit *lab-* banor i krahinës së Labërisë.

Lalē pl. *lālānji* “ungj, xhaxha” 2. dajë 3. burri i tezes ose i hallës: *lali Santa* = *lala Santa*, *lali Coli-Mari* = *lala Koli Mari* (Cuvata 2006, 304). Në shqipen *lalë* ka po kështu shumë përdorime: babai në moshë të re kundrejt fëmijëve të vet; vëllai i madh kundrejt vëllezërve më të vegjël ose kundrejt motrave më të vogla; kunati ose kunati i madh kundrejt kunatave; xhaxhai kundrejt nipërve ose mbesave. 2. Përdoret përpara emrit të një njeriu shumë të afërt ose kur thërresim me nderim a me dashuri dikë, Lalë Gjoni. Hajde, or lalë. *Lalë* – emër i lashtë i banorëve të Myzeqesë, me të cilin thërrisnin me përbuzje fshatarin e varfër të kësaj krahine (FGJSSH).

lāpārdii “fjalë e ndytë, lapërdhi” (Cuvata 2006, 307).

lāpushi “lapë, pjesa e poshtme e veshit, ku vihen vathët” (Cuvata 2006, 308). Shq. *lapë*.

largu ndajf. “larg, përtej detit”: *fudz largu di mini* = ik larg prej meje; *cāt/ tsi ma largu* = *sa më larg*; *la Gretsliji, di la dzācā pān la facā easti largu* = *Te grekët, nga të thënë në të bërë, është larg* (Cuvata 2006, 304, 215).

lari “larje” (Cuvata 2006, 305).

lat, latā “i larë, e lame” (teshat) (Cuvata 2006, 305).

ljear, lejarā “larë, dele e zezë me me lesh të bardhë në disa vende” (Cuvata 2006, 316).

latin, pl. *latini* “shqiptar katolik”: *tsi-aurli ca latin* = çka piskat/ çirresh si shqiptar katolik (Cuvata 2006, 305). Me termin *llatin* në mesjetë shënjohej elementi katolik shqiptar nga popullsia arumune dhe ajo sllavomaqedonase, për ta dalluar nga elementi vetjak ortodoks. Për këtë dëshmon dhe emërtimi *Latinski Grobišta* në fshatin Llatovë të Kërçovës (Smiljanic Kičevića 476), pastaj *Latinska Crkva* në lokalitein *Arbanasi* afër Nebregovës (Prilep). Këtë kishë B. Koneski (Make-

- donski mesta i iminja, 30) me të drejtë e lidh me elementin etnik shqiptar, duke theksuar se te popullsia sllavomacedonase “*llatinë quhen shqiptarët katolikë*”.
- latinā** “shqiptare katolike” (Cuvata 2006, 305).
- lau (mi)** fol. “lau” (Cuvata 2006, 305).
- lelic** pl. *lelits* zool. “lejlek” (Cuvata 2006, 310).
- lepur** pl. *lepuri* zool. “lepur” (Cuvata 2006, 317). Grupin konsonantik *lj* e ruan dhe e folmja e Zajazit të Kërçovës.
- ljpipurar** pl. *ljpipurari* “ai që ruan lepujt” (Cuvata 2006, 317).
- ljpurici** dem. zool. “lepurush” (Cuvata 2006, 317).
- lerā** “zhul, zdral (te teshat)”: *iaca di cāmeashi lj-easti-agno lerā = jaka e këmishës është me lerë* (Cuvata 2006, 311).
- vālāndueari** “lëndim, mundim (shpirtëror), 2. i shkaktoj sëmundje shpirtërore (Cuvata 2006, 563).
- lāngoari** “sëmundje, lëngatë” (Cuvata 2006, 307).
- lipsit** fol. “lipset” (Cuvata 2006, 315).
- lisā** “emër i shpeshtë për pelën, bushtrën” (Cuvata 2006, 315).
- ljin** pl. *ljinuri* “li”: *cāmeashi di ljin = këmishë liri* (Cuvata 2006, 317).
- mangu** pl. *mangani* “burrë i madh e i fortë”: *Coli, ashi-l cjeamā mangul = Kole, ashtu e thërrasin atë mashkull* (Cuvata 2006, 324). Shq. *mang*, nga një **mank*, me sufiks diminutiv *-ko* (Çabej SGJ I 331).
- mats** psth. thirrje për macen (Cuvata 2006, 328).
- matsā** zool. “mace” (Cuvata 2006, 328).
- mari** “i madh”: *mari lucru = punë e madhe* (Cuvata 2006, 326).
- calea-mbar** = udha e mbarë (Cuvata 2006, 114).
- māduuā** “mend”, me sinkopim të *n-së* te grupi konsonantik *nd*: *tini nu-ai māduuā-n cap = ti s’ke mend në kokë* (Cuvata 2006, 330).
- mengā**, pl. *mendzā* “mendje”: *lj-trapsi menga = ia vuri mendjen, i kushtoi kujdes* (Cuvata 2006, 339).
- maramangā** zool. “merimangë” (Cuvata 2006, 325). Dial. *merimangë* (Kër.).
- njeadzā** “mes”: *njeadzā dzuuā = mesditë, mjesditë*. Në arumanishten kjo fjalë do të ketë hyrë nga shqipja, me zhvillime fonetike *mj-nj*, si te *mjegull – njegull* (Cuvata 2006, 380).
- mesi** “mesi, qendra”: *bash tu mesi = bash në qendër; tu mes` di hoarā = në mes të fshatit, 2. (anat.) mesi i trupit: mi doari mesea = më dhemb mesi, mjedisi, 3. ndajf. me prepozitivin di mesi “i mesëm”: cum birichetea ? – di mesi = si ishte bereqeti? – i mesëm, 4. mini escu-atsel/ atsea di mesi = unë jamë i mesmi (vëllai)* (Cuvata 2006, 339).
- mizi** “mezi”: *mizi u scoasim dzeana-aestā = mezi e kapërcyem këtë kodër* (Cuvata 2006, 350).
- mācat** “mëkoj, ushqej dikë” (Cuvata 2006, 329).
- māslati** pop. “bisedë, muhabet”: *pi omlu-aestu ari multi māslats = ky njeri tregon shumë mësalla* (Cuvata 2006, 335). Fjalë edhe e shqipes krahinore *mēsalle* “përrallë” (Malësia e Tetovës).
- misit** “misit, ndërmyjetës” (Cuvata 2006, 348).
- misitū** “mesitni” (Cuvata 2006, 348).
- alāsā-nj-mi, dado** = *ler-më (lësho-më), dadë; leja-mi sh-muni cu tini = merr-më edhe mua me ty* (Cuvata 2006, 341) = *më* (trajtë e shkurtër e përemrit vector *mua më*).
- māndzu** pl. *māndzā* “mëz” (Cuvata 2006, 332).

- njiic**, pl. **njiits** “mic, fëmijë i vogël” (Cuvata 2006, 381). Në arumanishten përdoret dhe *ot mic* “burrë i vogël, burrec”, sikurse bullg. мъжец (Bello 2009, 333). Shq. *mic* “fëmijë i vogël, djalë i vogël”.
- turtā di misir** “bukë misri që gatuhet për kremten fetare Ujët e bekuar te vllhtë e Strugës” (Trajanovski 1998, 71).
- mushcā** zool. “mushkë”: *dzasti mushchi di fluri* = dhjetë mushka me flori (Cuvata 2006, 359).
- murgu, murgā** “i murrëm, i murgët”: *avea dupā oi un cāni murgu = kishte me dhentë një qen të murgët* (Cuvata 2006, 358).
- Murgiu** “emër qeni, Murxho” (Cuvata 2006, 358).
- ndauiu** “ndoca, disa”: *Nijopuli ari- ndauuā casi di Sāracāceanā* = në Nizhopole ka disa shtëpi të Sarakaçanëve (Cuvata 2006, 464).
- nānā** “nënë” – kështu e quante nusja nënën e burrit, vjehrrën: *nēnē, tatē* në familjet vllahe të Strugës (Trajanovski 1998, 210). Kështu dhe në shqipen e Kërçovës.
- nāpārtic** pl. *nāpārtits* zool. “nepërkë, gjarpër”. 2. fig. grua e keqe: *taha loarā-nveastā sh-elji, bāgarā nā nāpārticā-n casā* = edhe ata kinse kanë marrë nuse, kanë shti nepërkë në shtëpi (Cuvata 2006, 366).
- ngrupa** – gropos, varros: *ši dusi sum un migdalul/ š’ li ngrupa* = i çoi nën një bajame/ dhe i groposi (Popvasileva 1987, 76).
- nipot** “nip”: *am un nipot shi-unā nipoatā di hilji-nju* = kam një nip dhe një mbesë të djalit. *Nipot di frati* = nip vëllai (Cuvata 2006, 366).
- nora** “nuse”: *Soacra rao, nora bunā/ Sh’dole va s’tritsem* = Vjehrra e keqe, nusja e mirë/ bashkë do të kalojmë (Trajanovski 1998, 191). Me rotacizmin e *s-r* në arumanisht.
- nāearcā** pl. *nāerchi* “njerjë”: *isturiea sā spusi nāearcā cu-Armānjli* = historia është treguar njerjë për arumunët (Cuvata 2006, 365).
- njiisā** “lesh i deles te qafa, bishti dhe stomaku, me kualitet të dobët, njicë” (Cuvata 2006, 382). Lesh që ka marrë emrin nga të ngjiturit, shq. njis, nji “ngjit”.
- oi-bobo! o-bobo!** psth. “obobo”! (Cuvata 2006, 386).
- ore!** psth. “ore” (Cuvata 2006, 388).
- orā** – orë (në arumanishten e Ohrit, Markoviq, 2007, 85).
- pabes** pl. **pabeshi** “i pafe” (Cuvata 2006, 392).
- pabesā** pl. **pabesi** “e pafe” (Cuvata 2006, 392).
- pagā** “pagë, rrogë” (Cuvata 2006, 393).
- pampori** (te gramostenët e Ovçe Poles) “pamor, pampur”: *Armānjli di Shtip tu pampori fudzirā ti tu Armānii* = Arumunët nga Shtëpi me pampor shkuan në Rumuni (Cuvata 2006, 394).
- pastrā** pl. **pastrī** “pastër, pastërti” (Cuvata 2006, 400).
- pātātā** “patate” (Cuvata 2006, 407).
- patā** zool. “patë” (Cuvata 2006, 400).
- pendā** “masë toke, tokë sa punon një pendë qe në një ditë” (Cuvata 2006, 410).
- peshk** zool. “peshk” - Aist *peshch* një l’ āps ‘eshti ti la jatur - shq. këta peshq më duhen për ke mjeku. Mi tor di la *peshk* – u ktheva nga peshkimi (në arumanishten e Ohërit) (Markoviq 2011, 200). Edhe *pescu*, pl. *peshtsā* (Cuvata 2006, 412).
- pitaçiu** (pitaç) – “lypës”. Këtë fjalë e ka dhe shqipja e Kërçovës *pitaç* “lypës”, e *pitaç* “lyp”, *pitaçkë* fig. sharje për gra; edhe maq. *pitaç*.
- pūrit** zool. “petrit, shpend grabitqar” (Cuvata 2006, 420).
- pūrit, pūritā** fig. “i bukur, fort i bukur, i pashëm” (Cuvata 2006, 420). Këtë kuptim e ka dhe në shqipen dialektore të Kërçovës: *osht petrejt* – është bërë i bukur, është përtërirë.

pã`rumb - te arumunët farshëriotë të Strugës dhe të Ohrit, me rotacizim të ll-së ndërzanore në r (Marković 2000, 32).

pri “për” (në betimet popullore): *pri pãni* = për bukët; *sh-pri oclji* = për sytë (Cuvata 2006, 432).

pãshpurami sing. tantum “1. pëshpëritje. 2. marrëveshje e fshehtë” (Cuvata 2006, 407).

pãshpuredz “1. pëshpërit, 2. bën marrëveshje të fshehtë” (Cuvata 2006, 407).

pisuprã “përmbi, përsipri” (Cuvata 2006, 419).

pleagã “plagë”: *pleaga-a mea nu lji-ari vindikari* = plaga ime nuk shërohet (Cuvata 2006, 422).

plãscãnescu “plas, pëlças”: *plãscãnirã dauuã tufechi* = plasën dy pushkë (Cuvata 2006, 422).

plãscu “plasja” (e pushkës) (Cuvata 2006, 422).

pleacicu “plaçka”: *shi-aduna pleacichili* = i mbloodhi plaçkat (iku, shkoi) (Cuvata 2006, 422).

placã “pllakë”: *placã ti gramafon* = pllaka e gramafonit (Cuvata 2006, 420).

plup pl. **pluchi** bot. plep. *Plup analtu* = plep i naltë (Cuvata 2006, 424). Rum. *plop*.

popul let. “popull”. Fjalë e gjuhës letrare (Cuvata 2006, 427).

popullar “i njohur, i popullarizuar” (Cuvata 2006, 427).

prash bot. “presh”: *carni cu prashi* = mish me presh (Cuvata 2006, 430).

preftu “prift”: *ca preftul cu iazmolu* = si prifti me ajazmën (ujin e bekuar); *preftu sã-nji ti ved* = *prift të pafsha* (mallkim) (Cuvata 2006, 430). Te vllëhtë e Belicës së Strugës: *prifteasea si nclinë/ Pescul tu farina* = prifti lutet/ peshku në miell (në një këngë lazore) (Trajanovski 1998, 96). Rum. *préot*; *p’reftu*, *p’refulu* (në Belicën e Poshtme, Marković, 2007, 84).

prufet “profet” (Cuvata 2006, 440).

pulj “shpend, zog, pulë squkë”: *avem nã loci cu yinghits di pulji* = kam një pulë squkë me njëzet zogj (Cuvata 2006, 443).

Pulji astar. “plejada e yjeve, Pula me zogj, Pulëzat” (Cuvata 2006, 444).

pushur, pushpurat “pëshpëritje, të folurit ngadalë” (Cuvata 2006, 446).

cheantsã (qeancë) bot. vëngjezë (Kërçovë), elegjinë, lëgjinë (Kosovë).

chelchi “qelq”: *s-frãndzi, ca di chelchi = thyhet, si qelq* (Cuvata 2006, 172).

chelesh pl. *cheleshi* e *cheleshean* “1. njeri pa flokë, qel, qelesh. 2. njeri me trup të ulët, njeri i pacipë, horr, qelesh” (Cuvata 2006, 172).

chendru, pl. **chendri** “qendra”: *tu chendrul a cãsãbalui = në qendër të qytetit* (Cuvata 2006, 172).

tseapã (ceapë) bot. “qepë” (Cuvata 2006, 546). Me ndërrimin fonetik *k-ts* (c).

cireashi (çireashi) bot. “qersh” (fruta) (Cuvata 2006, 167).

ciresh (çireshe) bot. “qersh” (trungu) (Cuvata 2006, 167).

cirishear (çirishear) “qershor”: *Andreilu-al Bagav muri tu Cirishear* (1889) = Andrej Bagav vdiq në qershor (1889) (Cuvata 2006, 167). Me alternimin fonetik *e-i*.

regulã “rregull, normë” (Cuvata 2006, 453).

rãgucari “rëshqitje, rrokullisje mbi akull” (Cuvata 2006, 450).

rod pl. **rodì** krahin. “dëborë, borë, vdorë” (Cuvata 2006, 457). Në arumanishten kjo fjalë del të përdoret si një regjionalizëm, si një shformim me metatezë nga shqipja *dëborë*.

rufëe pl. *rufei* “rrufe”. Krahas kësaj përdoret dhe *arofhi* (Cuvata 2006, 458).

slotã “skllotë, llohë, shqotë, stuhi me shi e borë” (Cuvata 2006, 483). Kjo fjalë, të cilën Vasmer e shpjegon si të burimit sllav *slota*, kurse Çabej (1976) e bie të ardhur nga

bullgarishtja, si e tillë mungon në maqedonishten. Prandaj në dialektin e maqedoarumanishtes konsiderojmë të ketë hyrë nga shqipja.

tsinë “(sonte/ sot” (Cuvata 2006, 548). Në shqipen zgjeruar me formantin *-te*. Këtu do afruar dhe *sot* – arum. *azā, astāzi*, rum. *azā astādz*, që kanë rrënjë të ngjashme. Sikurse vuri re së pari F. Bopp-i më 1884, ndajfolja *sonte* (te autorët e vjetër *sónëte*) ka dalë nga aglutinimi i dy fjalëve *so nate* nga “aso nate”, me theksim mbi përemrin *só*, e *sot* nga *so dite*. Edhe Çabej (1976, III, 110), duke përsëritur mendimin e Bopp-it, te *sot* e *sonte* sheh kompozita të moçme të shqipes të dala nga *so dite, so nate* (në thelb *këso dite, këso nate*). Të kihen parasysh këtu dhe rrjedhjat e arumanishtes për *só* “*kësi*”, *astā-noapti* “kjo natë, sonte”, *astādz* “kjo ditë sot”; khs. dhe sll. *sinoć* “sonte”, nga prasl. **sъ ovaj noć*, e *dan, danas*, prasl. **дъньсь*.

tsupatā “sopatë e madhe” (Cuvata 2006, 549).

strānipot “stërnip” (Cuvata 2006, 497). Për shkak të *i-së* nuk mund të jetë rrjedhojë e drejtpërdrejtë nga latinishtja *nepos*, por rrjedh nga shqipja *nip, stërnip*.

rāmā zool. “skrranjë” (Cuvata 2006, 450). Në shqipen me parashtesën *-sk*.

sharā “sharrë” (Cuvata 2006, 508).

shilturā “shilor, qafë mali, vendkalim i ngushtë në pyll” (Cuvata 2006, 512).

shcāmbā pl. *shcāmbi* “karpë, shkëmb” (Cuvata 2006, 508).

scamnu pl. *scamnuri* “stol, karrige e thjeshtë” = *scamnu di cheatrā* - shkëmb guri (Cuvata 2006, 466). Shq. dial. *Shkom* (Kërçovë).

scāрпи “degë të holla e të thata për të ndezur zjarrin, karthje 2. fig. e pavlerë”: *casā di scāрпи* = shtëpi me shkarpa; *om di scāрпи* = njeri i dobët si shkarpë (Cuvata 2006, 468).

shcop pl. *shcopuri* “shkop, 2. fig. goditje me shkop”: *lu-arcarā tu shcop* = e rrahën me shkop; *tsi shcop māca* = hëngër qotek me shkop (Cuvata 2006, 510).

shcodā bot. “shkozë”: *lemmul di shcodā* = dru shkoze (Cuvata 2006, 510).

shcrac zool. “shkrap, akrep” (Cuvata 2006, 510). Fjalë me burim nga lat. *scorpius*, me metatezë të sll.vj. dha *skrapij*, por me formën fonetik të *s-sh* në maqedoarumanishten do të njihet të ketë hyrë përmes shqipes.

shcret, shcretā ndajf. “shkret” (për vende, për shtëpi): *loclu tut s-pari ca shcret* = krejt vendi duket si i shkretëtë; *ma shcret di Santa nu-aflji tu-Armānami* = më të shkretët se Santa nuk mund të gjesh te arumunët (Cuvata 2006, 510).

shcretueari pl. *shcretuери* “shkretim” (Cuvata 2006, 510).

shcretuescu “shkreton” (Cuvata 2006, 510).

scrum “shkrumb, zhezhi”: *s-arsi pita, s-adra scrum* = u dogj peta, u bë shkrumb (Cuvata 2006, 470).

scrumat “i bërë shkrumb”: *nu s-mācā, amārashiti, ghela-i scrumatā* = nuk hahet, idhëton, gjella është bërë shkrumb (Cuvata 2006, 470).

shcurtu “muaji shkurt” (Cuvata 2006, 237, 510): *tu Shcurtu Armānjli nu fac canā harauuā* = Arumunët në shkurt nuk bëjnë kurrfarë gazmendi. (Cuvata 2006, 237, 510). Në maqedoarumanishten kjo fjalë ka krijuar rrjedhoja të tëra përdorimi: *shkurtat, shcurtedz, shcurticari, shcurticat, shcurtichedz, shkurtimi, shcurtu* etj.

shearpi zool. “shtëрпи, zvarranik, bollë” (Cuvata 2006, 510).

shtisā “degë druri” (Cuvata 2006, 510).

shtisā “rreze e diellit” (Cuvata 2006, 513).

shcurtabac dem. “shkurtabiq, shkurtalaq, një pëllëmbë njeri” (Cuvata 2006, 510).

shkurtacā “xhakëtë e shkurtër grash, shkurtë” (Cuvata 2006, 510).

shcurtari “shkurtim, të shkurtuarit, 2. të shkuarit rrugës më të shkurt, 3. të folurit konciz” (Cuvata 2006, 510).

- spats** “vend i pjerrët” (Cuvata 2006, 237, 486).
- spatā** “shpatë avlëmendi” (Cuvata 2006, 237, 486).
- spes** pl. **speshi** “shpesh”: *dintsālji lji-ari speshi* = dhëmbët i ka të shpeshtë (Cuvata 2006, 237, 487). Kjo fjalë me burim nga lat. *spissus*, në maqedonarumanishten me formën e saj fonetike do të ketë hyrë nga shq. *shpesh*.
- stirpar** “bari që ruan delet shterpa” (Cuvata 2006, 237, 495).
- stirgoanji** pl. **stirgonji** bot. “shtarë, qingël bjeshke” (Cuvata 2006, 499). Me ndërrimin e rregullt fonetik *a-i* në arumanisht.
- strozmā** “shtrojë, shtrosë, shtromë” (Cuvata 2006, 237, 499).
- strungā** “vend i thurur, ku përbujnë e ku mjelin bagëtinë, strungë, shtrungë” (Cuvata 2006, 499).
- shupleacā** “shuplakë”: *lj-trapsi (lji-alichi) nā shupleacā* = ia lidhi një shuplakë (Cuvata 2006, 237, 515).
- shurshur** “shushuritje” (Cuvata 2006, 515).
- shurshurari** “shushurin” (Cuvata 2006, 515).
- shut** “pa brirë (për kafshët)”: *caprā shutā* = dhi shytë (pa brirë), 2. fig. budalla: *armasi ca shut* = mbeti si shyt (Cuvata 2006, 515).
- Cārshutā** “dhi pa brirë, shutë, shytë” (Cuvata 2006, 129).
- tāshi** ndajf. *s-dusi tāshi-acasā* = *shkoi tashti në shtëpi* (Cuvata 2006, 522).
- teli** “tel”.
- telj** “zbukurim që i bëhet nuses së re me tel të artë ose të argjendtë” (Cuvata 2006, 515). Fjalë e turqishtes, e cila në maqedoarumanishten do të ketë hyrë nga shqipja.
- tāmbļā** pl. **tāmbli** anat. “tëmbël, tëmth”: *gāgoshlu-l lo pi la tāmbļā* = plumbi e goditi në tëmbël” (Cuvata 2006, 521).
- Mirā** pl. **miri** mit. “Të mirat, Fatitë”: *trei-seara mirili tsi lji-ngrāpsirā* = *natën e tretë çka i kanë caktuar të mirat* (Cuvata 2006, 346).
- tārfoļj** bot. “detelinë, tërfil, tërfonjë” (Cuvata 2006, 522). Rum. *trifoi*. Arumanishtja këtë fjalë me formën e saj *tërfoļj* do ta ketë huazuar nga shqipja e Maqedonisë *tërfoņjē* (Krëçovë).
- tārtā-pārtā** “llomotitës, mashtrues, njeri joserioz” (Cuvata 2006, 522). Në shqipen e Kërçovës përdoret si shprehje për dikë që i ndërron fjalët, që nuk është serioz: *njaft mō me tērtā-pērtā!*
- tengalā** “lodër fëmijësh, me të cilën gjuajnë gurë të vegjël, bahe” (Cuvata 2006, 524). Këtë leksemë e hasim dhe në ligjërimin shqiptar të Prilepit *tingallē* (Cërnilishtë.), *tangallē*, *thingallē* (Zhitoshe.).
- toacā** “tokë, çangë”: *ti mirindi s-avdzā toaca di la bāsearicā* = pasdite u dëgjua toka e kishës” (Cuvata 2006, 530).
- tufā** “tufë, buqetë, 2. perçe e flokëve”: *aduna unā tufā di lilici* = mblodhi një tufë me lule (Cuvata 2006, 540).
- talāndzā** zool. “thëllëzë” (Cuvata 2006, 518). Rum. *potirniče*.
- sārmā** “thërrime” (Cuvata 2006, 465). Siç e shpjegon dhe G. Meyer (2007), nga shqipja rrjedh rum *fārimā* “thyej”, e arum *sārmā*.
- sārmu** “thërrmoj”: *pānea-aestā multu s-sārmā* = kjo bukë thërrmohet shumë (Cuvata 2006, 465).
- urdā** “urdë, hurdhë, gjizë”. (Cuvata 2006, 555). *Urda* f. izvarka (RMJ III 442; MAR 638) Në dialektin e Galicnikut urda (Belić GD 123), në Dibër urda “vid jako sirenje” Iloj djathi i fortë (Vidoeski DG 82). Në proverbat popullore të Strugës: Sekoj petok urda jadam

(Kavaev: 1961). Ka një shtrirje të madhe në gjuhët ballkanike e jashtëballkanike, përhapur gjithandej prej barinjve arumunë, por si një huazim i fondit të shqipes (Murati 1990, 42; Hoxha 2001, 179).

urđin “urdhër” (Cuvata 2006, 556).

urat, uratā “i uruar, i dashur” (Cuvata 2006, 555).

urari “përgëzim, urim” (Cuvata 2006, 558).

urā pl. **uri** “urrej, urrejtje” (Cuvata 2006, 555).

ush! pash. “urdhër që i thuhet gomarit për të ecur” (Cuvata 2006, 556).

vatrā “vatër, shtëpi”: *tu vatra-a ta sh-cinushea ardi* = në vatrën tënde digjet edhe hiri (çdo gjë të shkon mbarë), 2. fig. atdheu, vendlindja: ...*Vatra-a mea iu nji-ardu anljji tsi-am bānatā* = Vatra ime (atdheu) ku më digjen vitet që i kam jetuar; *va ndizem tu vatra-a noastā* = do të shkojmë në vatrën (atdheun) tonë (Cuvata 2006, 563).

vār, vārā pakuf. “dikush, ndonjëri, ndonjëfarë” = *vār ljepur - ndonjëfarë lepuri* (Cuvata 2006, 564). Shq. dial. *far; erdhi far njeriu?* (Kërçovë).

cacavatrā “ai që tërë ditën rri në shtëpi, pranë vatrës” (Cuvata 2006, 112).

cutuvālescu “valloj (kafshët, punët), bëj që të ecin” (Cuvata 2006, 161). Shq. dial. *Valloj çetë* “grah qetë”. *Valloj pounët* grah punët (Tetovë, Kërçovë).

urbari “verbëri, verbësi, verbim, i verbër”: *urbarea-ts* – u verbofsh (mallkim) Cuvata 2006, 555).

vāltos “moçal, baltë” (Cuvata 2006, 99). Me ndërnëdërrimin fonetik *b-v*, khs. si te *vārgār* = *bullgar, vārgarā* – *bullgare, vārgareashi* – *bullgarisht* (Cuvata 2006, 564).

Vearā, Dzua di Vearā “Ditë Vere”. Urimet për Ditën e Verës te vllëhtë e Strugës: *Bunā dimneatsa shi vearā nbar* = *Mirëmëngjesi dhe Vera e mbarë*. Në përgjigje: *Si him hariosh shi cu nbāreatsā Vearā* = *Qofshim të gëzuar dhe ta kemi mbarë Ditën e Verës* (Trajanovski 1998, 81).

veti “në vete”: *bārbatlu sh-vini niheam pri veti* = burri erdhi paksa në vete (Cuvata 2006, 568).

viyā “vijë”: *Me a cu yin sh` cu rachiā/ Mea shi cu apā di la viyā* = Me verë e raki/ Por dhe me ujë nga vija (në këngë dasme kur i japin nuses ujë (Trajanovski 1998, 182).

vira ndajf. “shpesh, dendur”: *vira treatsi pi la sor-sa* = virra shkon te motra vishem” (Cuvata 2006, 570). Kjo fjalë me këtë kuptim përdoret në shqipen e Kërçovës.

vulā “vulë”: *cartea-aestā easti cu vulā* = kjo letër është me vulë (Cuvata 2006, 574).

zalā “breg lumi me zall, rërë” (Cuvata 2006, 580).

Dzānā (xanë) “zanë”: *Armānili, ca dzāni* = *Arumunët, si zana*” (Cuvata 2006, 215).

zbuldzu “bucë, bulë, top bore” (Cuvata 2006, 582).

zii “vuan, heq të zitë e ullirit”: *banā cu zii* = jetë e zezë, me halle (Cuvata 2006, 584).

shiguni pl. **shigurnji** “një lloj gune e madhe, zhgun” (Cuvata 2006, 511).

Përngjasime e diferencime leksikore semantike

Në shqipen dhe në maqedoarumanishten disa fjalë kanë zhvilluar kuptime të njëjta figurative, si p.sh. arum. *plāngu* “qahet, ankohet”: *Armānljji dit Vlāhii s-plāmsirā la Consiliulu-a Ivropāljei* – Aromunët nga Rumania janë ankuar në Këshillin e Evropës (Cuvata 2006, 421), e ngjashme dhe për shqipen. Por, në kodifibialitetin gjuhësor të këtyre idiomave, ka dhe diferencime, p.sh. arumanishtja diferencion *cireashi*

(çireashi) “qershi” (fruta), *ciresh* (çireshe) “qershi” (trungu) (Cuvata 2006, 167), kurse në shqipen nuk bëhet një përdallim i tillë.

Elementet leksikore të vështuara këtu sipër të shqipes në maqedo-arumanishten, që i kemi qëmtuar nga burime të ndryshme të literaturës, kund rreth 300 leksema, disa nga të cilat mund të jenë nga një substrat i përbashkët, konsiderojmë se paraqesin vetëm një pjesë të fjalësit të shqipes që ka hyrë në këtë idiomë, dhe se ky element duhet të hulumtohet edhe më tej në të ardhmen. Në këtë fushë të fjalorit, për të qenë dhe më të saktë, disa leksema mbase duhet të konsiderohen si mbetje leksikore (Restworter) në shqipen dhe maqedoarumanishten, nga një substrat i përbashkët, dhe jo si huazime të ndërsjella në këto dy gjuhë.

Elementet leksikore shqipe në arumanishten, sikundër shprehet studiuesi arumun Petar Atanasov (1997, 13), mund të kenë depërtuar si rezultat i ndikimit nga tri faza të ndryshme:

a) nga një periodë më e vjetër nga e cila datojnë një radhë elementesh leksikore që janë trashëguar nga një substrat autokton (për shqipen ato janë elemente leksikore që kanë kaluar nga faza më e vjetër në fazën më të re të zhvillimit të kësaj gjuhe).

b) nga një periodë më e re.

c) Nga një periodë shumë më e re në të cilën ndikimi i shqipes kufizohet vetëm në të folurit lokal frashëriot të dialektit arumun.

Ngjashmëritë në terminologjinë familjare të vllahëve të regjionit të Strugës dhe të shqiptarëve

Kah fundi i shekullit XVII, blegtorë vllahë erdhën e populluan fshatrat Belicë e Epërme dhe Belicë e Poshtme të Strugës (të cilët quheshin *armanj*), nga rajoni malor i Çermenikës dhe Zmollnikut të Shqipërisë (Радовановић 1936, 21-30). Krahas blegtorisë, ata filluan të merren dhe me bujqësi. Shumë vllahë e pranuan fenë islame dhe në vend të *armân* *crishtin* u shndërruan në *armân turq*. Një proces të tillë e përjetuan 6 familje vllahe. Në mesin e vllahëve, çdo herë është ruajtur një pjesë si krishtere dhe me mënyrë blegtorale të jetesës. Gjatë shekullit XIX, shumë familje u shpërngulën në Strugë dhe Serbi (sot në Belicën e Epërme ndodhen vetëm dy familje vllahe). Vllahët e quajnë veten *armanj*, kurse shqiptarin – *shiptar*, ndërsa shqiptari vllahun e quan *vllav* (*vlla*).

Duke e krahasuar leksikon e terminologjisë familjare të popullatës vllahe dhe asaj shqiptare në Belicën e Poshtme mund të konstatohen shumë ngjashmëri. Marrëdhëniet fqinjësore, prania kolektive në ritet dhe festat e ndryshme, nuk ka mundur të mos evidentohet te këta dy kolektivitetet etnike një nomenklaturë e ngjashme e jetës familjare.

Në rrethin e tyre familjar përdoren emërtime të njëjta për pjesëtarët e familjes te këta dy kolektivitetet:

Burri për gruan ishte – *nicuchir* (te shqiptarët *domaqin*).

Gruaja për burrin ishte – *nicuchira* (te shqiptarët *domaqinkë*).

As burri e as gruaja nuk janë quajtur me emrin e tyre, por përdornin shprehjet:

- Gruaja për burrin – *N`as* (*Ai*)

- Burri për gruan – *N`asa* (*Ajo*).

Burri gruan e vet ende e thërret *nvesta* (*nuse*), e po kështu edhe të afërmit e burrit e thërrasin *nvesta* (*nuse*).

Fqinjët dhe bashkëfshatarët nusen e thërrisin me emrin e burrit duke i shtuar përpara *Tsal Pasku* (ajo e Paskut), përkatësisht *gruaja e Paskut*, te shqiptarët e Prespës e *Paskut*, e *Axhibeut*, kurse te shqiptarët dhe maqedonasit prapashtesën –*icë* (*-ica*): *Alicë*, *Hazbicë Kadricë* (te maq. *Spasenica*, *Mitrovica*). Fëmija nënën e vet te vllëhtë e thërriste *Nana*, te shqiptarët *Nanë*.

Nipat edhe te vllëhtë edhe te shqiptarët mund të jenë:

Nipot di hilj (*nip prej djali*)

Nipot di hilja (*nip prej vajze*)

Nipot di frate (*nip prej vëllai*)

Nipot di soara (*nip prej motre*).

Vëllai i babait quhej *Lala*, një term që i referohet dhe vëllait të nënës. Këtë emërtim e përdorin dhe shqiptarët *Lalë*.

Fise (*Fisi*) konsiderohet edhe te vllëhtë edhe te shqiptarët një lidhje e më pak apo më shumë familjeve që rrjedhin nga një paraardhës i njëjtë në linjën e mashkullit (Dunovski 1998, 30).

Fonetika

Në fonetikën e idiomës së maqedoarumanishtes hasim tipin e *lj*-së sikurse në ligjërimin shqiptar të Zajazit të Kërçovës: *ljepur* (në Zajas *ljepër*), *ljeat*, *lejarā* (ljarë), *ljin* (lji-ni) etj. Pastaj fonemën e errët *ā* (shq. *ë*): *arobā* (rrobë), *aroatā* (rrotë), etj.

Morfologjia

Edhe në fushën e morfologjisë vërehen një varg tiparesh të përbashkëta të këtyre gjuhëve, nga të cilat mund të veçojmë:

1. Dyfishimi i parafjalëve në shqipen dhe në arumanishten:

Arum. Aist peshch një l' āps 'eshti *ti la jatur*.

shq. këta peshq më duhen *për ke mjeku*.

maq. Ovie ribi mi trebat *za na lekar* (në maqedonishten e Ohrit) (Marković 2011, 200).

Kān mi turai *di la pazari*, aren mult akumat.

Kur u ktheva *pi ke pazari*, isha shumë i lodhur (në shqipen e Kërçovës).

Koga se vrativ *od na pazar*, bev mnogu umoren (në maqedonishten e Ohrit) (Marković 2011, 200).

Mi tor *di la lacur*.

Kthehem *pi në punë* (në shqipen e Kërçovës).

Se vrakam *od na rabota* (në maqedonishten e Ohrit). (Marković 2011, 200).

U skosh shporetlu *di sum skār*.

E hoqa shporetin *prej ndër shkallë*.

Go istadov šporetot *od pod skali* (në maqedonishten e Ohrit) (Marković 2011, 200).

Në maqedonishten kjo dukuri ka karakter dialektor, kufizohet vetëm në idiomën e Ohrit, aty ku ndikimi i arumanishtes dhe i shqipes është më i theksuar.

2. Emrat e vendeve (qyteteve) që në maqedonishten mbarojnë me formën e shquar *-o*, në shqipen dhe arumanishten marrin mbare-sën *-a*: maq. *Tetovo*, shq. *Tetova*, arum. *Tetova*; *Kumanovo*, shq. *Kumanova*, arum. *Cumanuva* (Atanasov 1997, 13).

3. Në fushën e morfologjisë vlen të përmendim këtu *admirativin e arumanishtes*, i cili, siç e ka vënë re Victor Friedman (Friedman 1997, 139), ndeshet vetëm në Maqedoninë Jugperëndimore, tek folësit e fshatit Gorna Belica (Beala di Susi), që kanë emigruar atje rreth një shekull më parë nga Shqipëria, e që duket mjaft qartë se është një huazim morfologjik dhe gramatikor i mbështetur në shqipen: *lucra-cka* – shq. *punua-ka*.

Ā brā, tu fost-āi mari om!

Ore, ti qen-ke njeri i madh!

Ku folja *fost* është pjesore dhe *ai* është folje ndihmëse. E kryera normale megleno-rumune do të ishte *ai fost* (Friedman 1995, 195).

Kështu dhe *Abe, tini avus-ka mari kasa!* (Ore, ti *pas-ke* shtëpi të madhe!) (Fridman 2009, 236).

Kjo dukuri e veçantë e morfologjisë së foljes e shqipes, që si e tillë ka shkuar edhe në arumanishten, është një indicie që na detyron ta hulumtojmë edhe më shumë morfologjinë e arumanishtes, ku do të gjenden pa dyshim forma e paralelizma më të shumta kësodore.

Mënyrat e të thënit të arumanishtes që janë paralele me të shqipes

Në fushën e frazave, të idiomatikës (frazologjisë), hasim shumë shprehje të përbashkëta shqiptare-arumune, të një substrati ballkanik, të cilat mund ta kenë burimin te një ndikim i shqipes mbi arumanishten në trajtën e përbrendshme të atyre frazave, sidomos kur të kihet parasysh që gjuhët e tjera të Ballkanit nuk njohin shprehje të tilla.

Arucā zboarā pi vinte = shq. *flet në erë* (Cuvata 2006, 413).

Dzuuā-albā - “ditë të gëzuar”, shq. *ditë të bardhë*, maq. *bel den*.

Cāmeashea di pi trup s-nu ts-u vre, mallk. – *Hiksh pi këmishe* (Kërçovë) ‘të mos e duash këmishën në trup, ta urresh vetveten’, maq. *Da ne si ja sakaš košulata na grbot* (Cuvata 2006, 125).

Fratī ti frati, ma cashlu ti pāradz = shq. *vëlla për vëlla, gjiza me pare*. Maq. *brat za brat, sirenje za pari* (Cuvata 2006, 241).

Ma mari darā di loarea = *më e madhe dara se oka* (fitimi) (Cuvata 2006, 180).

Ficiorlji li mēcā-agromeanli shi maralji lā-amurtā dintsālji = shq. ‘fëmijët i hanë mollët e tharta, të mëdhenjve u mpihen dhëmbët (Cuvata 2006, 195).

Lai di borģe – laj borxhet.

Lai ca għiftul = shq. *i zi si xhyp* “shumë i zi” (Cuvata 2006, 65).

Luplu su-l mēcā = shq. *ujku ta hajë*, maq. *volkot d ago izede* (Cuvata 2006, 320).

Matsa s-la tu fatsā – maca lan faqet (thuhet se do të bjerë shi) (Cuvata 2006, 306).

Ma mari darā di loarea = shq. *më e madhe dara se oka* “më shumë jep se sa fiton” (Cuvata 2006, 180)

Pi chipita di limbā lu-am, ma nu-nji ticneashti cum s-dzātsi = shq. *e kam në majë të gjuhës, por nuk më teket (kujtohet) si thuhet* (Cuvata 2006, 166, 175).

Prifteasea si nclinā/ Pescul tu farina = *prifti lutet/ peshku në miell (në një këngë lazore, te vllhtë e Belicës së Strugës)* (Trajanovski 1998, 96). Rum. *préot*.

Pri pāni (në përbetimet popullore) = *me preopizitivin pri (për): për bukët*, maq. *žimi lebot; sh-pri oclji = për sytë*, maq. *žimi očite* (Cuvata 2006, 432).

S-nu lji-arādā budzāli = *i vari buzët (u hidhërua)*.

Shi-aduna pleacichili = shq. *i mbloodhi plaçkat (iku, shkoi)* (Cuvata 2006, 422).

U strāmbu cāciula = shq. *e shtremboi kësulën*, maq. *ja nakrivi kapata* (Cuvata 2006, 497).

Onomastika

Në fushën e onomastikës dalin të ruhen po kështu gjurmë të vjetra shqiptare që përshfaqen me fonetikën e arumanishtes. Këtu mund të sjellim disa emra lagjesh e topikësh që kanë lidhje të drejt-përdrejtë me ruajtjen e elementit shqiptar në arumanishten.

Albince – katund baritor te Jakupica, ku ruhet trajta vllehe *Albin* e etnonimit shqiptar *Alban* / *Arban* (Murati 1999, 40).

Arbinovë – fshat i rrethit të Ohrit, i banuar me popullsi maqedonase. Emri i këtij topiku, që dëshmohehet në Defterin e regjistrimit turk Nr. 25 për Sanxhakun e Ohrit më 1589 me format *H'rbino* e *Harbino*, me një *h* sekundare, lidhet me bazën etnike *Arbin*, formuar me ndërmjetësi të arumanishtes nga *Arban* me alternimin fonetik të kësaj gjuhe *a:i* dhe sufiksit sllav *-ovë*, siç e ka shtjelluar drejt dhe Petar Hr. Ilievski (Ilievski 1988, 482), e jo me fitonimin *vrba* 'salix', siç shprehen J. Zaimov, V. Pjanka, etj. (Murati 1999, 40).

Arbinesh – lagje në Krushevë të Maqedonisë (*Mahala dila Arbineshi*/ ose *Arbišesku Mahala* (Gočab 1984, 20), tani e vllahizuar.

Ruan trajtën rumune *Arbin* prej *Arban* me zhvillimin fonetik të rregullt *a:i* (Murati 1999, 41).

Arbina – vis në Podbregje të Tetovës (Trifunoski 1976, 44).

Arbino – lokalitet arkeologjik në fshatin Kopancë të rrethit të Tetovës, i periodës romake, në të cilin janë zbuluar fragmente të enëve të qeramikës, tjegulla dhe materiale ndërtimore (AKRM II 420; Murati 1999, 44).

Arbino – ngulim i zhdukur i antikës së vonë në fshatin Raotincë të Tetovës, ku janë gjetur themele, objekte, fragmente të enëve të qeramikës (AKRM II 424; Petruševski 1999, 11; Murati 1999, 44).

Arbun (TD VI II (1568-69), 365) – lagje në fshatin Vrapçisht të Gostivarit, që ruan emrin etnik *Arbun* nga një emër vetjak *Arban*, i shpeshtë në periodën e mesjetës, me ndërmjetësi të ligjeve fonetike të arumanishtes *a:u* (Murati 1999, 41).

Te topikët e mësipërm *Arbin* e *Arbun* shihet të ruhen trajtat fonetike të arumanishtes *-in/ -un* të emrit etnik *Arban*.

Arbišiea – vendbanim shqiptar në rrethinat e Shtipit, tanimë i zhdukur, por që del të përmendet në tregimet popullore vllehe:

Cât ea hoara š' pulitiea/ Cât ea hoara š' pulitiea/ Si cu tuta *Arbišiea*/ (U selo imalo,/ u selo imalo,/ Kolku seloto bilo ubavo, tolku bilo i lošo,/ Seloto ubavo, ne e samo selo bilo,/ *Ovaj Albansko selo, Arbašija. Albansko selo...*).

(Përrallën në formë vargësh e tregoi në gjuhën vllehe dhe maqedonase Atanas Ristov Taškov, i lindur më 1908 në fsh. Urarci, Kočevsko. Ka jetuar në Star Karaorman, Shtipsko. Me përkatësi vllah, me profesion qiraxhi; Popvasileve 1987, 128-129).

Labino – lokalitet me rrënoja arkeologjike të kohës së bronzit dhe të mesjetës së hershme, që shtrihet në jugperëndim të kështjellës së Samoilit në Ohër. Tek emri i këtij lokaliteti gjejmë të zhvilluar metatezën sllave të likuidave *al/la*: **Albino:Labino* (Murati 1999, 37).

Bukri – fshat i zhdukur në sinorin e Brodit, afër Kërçovës. Nga ep. *Bukur*. Në truallin gjuhësor maqedonas, në sistemin onomastik, me apelativin e albanizmit *bukur* del të përmendet dhe *Bukur* si emër vetjak, si mbiemër *Bukurovci* dhe si toponim *Bukurci* fshat në Shkup, të cilin e regjistron A. M. Selishçevi (Makedonskie kodiki XVI-XVII vekov, Sofija 1933, f. 26), e që sipas tij përmban emrin vetjak të ndonjë vllahu *Bukur*

(O. Jashar-Nasteva, Vtora Jugoslovenska Onomastička Konferencija, Skopje, 6-9 oktombri 1977).

Nga topikë të tjerë që ruajnë gjurmë të shqipes në arumanishten mud të veçojmë:

Floka – masiv malor te Kajmakçalan, i quajtur ndryshe dhe Nixhe (Skok 1933). Emërtim metaforik për viset kodrinoro-malore, të veshura me barishte të imëta, si “flokë”.

Codra Fura – kodër në malin Shar, në kufirin midis Maqedonisë dhe Kosovës (Cuvata 2006, 135). Edhe te maq. *Kodra Fura (Ajdučka Šuma)*, nga shq. *kodër* dhe arum. *fur* ‘hajdut’, *Kodra e Hajdutit* (jo *Kodra e Furrës*, siç përdoret gabimisht në media, khs. këtu “*Serbia dhe Kodra e Furrës prishin hesapin*”, titull, Koha, Shkup, 17. 9. 2009).

Në lokalitetet vllahe Belica e Epërme (Beala di Supra) dhe Belica e Poshtme (Beala di Ghios) të rrethinës së Strugës hasim toponimet shqipe, si :

Gropa Mare (Gropa e Madhe),

Gropa Shtregonjeljei,

Guva di Gaia, me apelativat *gropë* e *guvë*,

Cale Ngusta (Udha e Ngushtë),

Calea Mare,

Kodur, Shtë Catun (Dunovski 1998, 95, 97, 123; Trajanovski 1998, 29).

Farsherioti – komunitet arumun, që mban emrin e vendbanimit të lashtë Frashëri në rrethin e Përmetit të Shqipërisë së mesme, shpërngulur në Belicën e Epërme dhe të Poshtme dhe në fshatra të tjera Vevçan. Vishni, Podgorci e Llabunishtë të Strugës.

Surunica – vend në mal, ara dhe livadhe (Leshnica e Epërme - Tetovë).

Arum. *surin* “shullë, vend të e rrok dielli”.

Përfundime

Hulumtimet e ndërsjella ndërmjet shqipes dhe arumanishtes paraqesin interes të veçantë për gjuhët e këtyre dy popujve, sepse më shumë se me popujt e tjerë fqinjë, shqiptarët dhe arumunët kanë pasur ndërmjet veti një simbiozë më të gjatë e më të hershme si bartës të një kulture sedentare në hapësirat e tyre ballkanike.

Për sa u përket lidhjeve të shumanshme shqiptaro-rumune, studiuesit kanë vënë në dukje se rreth 600 fjalë janë të njëjta ose me rrënjë të përbashkët midis shqipes dhe rumanishtes. Kjo tregon lidhjet e ngushta që kanë ekzistuar midis ilirëve dhe trakasve, të cilët kanë jetuar në Gadishullin Ballkanik shumë shekuj përpara se sllavët të shkelnin në këto treva (Papailia 2000, 3). Njohësi i mirë i marrëdhënieve mes popujve të Gadishullit Ballkanik, Teodor Kapidan, shprehet kështu: “*Për dallim nga lidhjet me grekët dhe sllavët, lidhjet e rumunëve me shqiptarët, në pikëpamje ballkanike, shfaqen shumë më të ngjeshura. Ato nisin nga një numër fjalësh që nuk janë as latine, as greke, as sllave dhe as huazime të ndërsjella rumunoshqiptare, por disa trajta që nisen nga të njëjtat fjalë themelore, të cilat duhet të kenë ekzistuar mbase në të folmet pararomake trako-ilire...*”

(Albanezul 1996, 21). Për këtë arsye, ndoshta është më mirë të flitet për elemente të përbashkëta të shqipes dhe arumanishtes, se sa për ndikimin e njëjërës gjuhë mbi tjetrën.

Maqedoarumanishtja në idiomën e saj përshfaq elemente të shumta fonetike, morfologjike, sintaksore, leksikore, onomastike dhe frazeologjike të ngjashme me ato të shqipes, të cilat meritojnë të gjurmohen në mënyrë më të plotë e të gjithanshme. Përmes elementeve gjuhësore të arumanishtes, ne shohim dhe gjurmë të vjetra mbeturinore të shqipes dhe shtrirjen e elementit shqiptar edhe në Maqedoninë e sotme lindore, ku tanimë nuk ka shqiptarë, khs. topikët e tillë si: *Arbinovë*, *Arbişiea* – vendbanim shqiptar në rrethinat e Shtipit, etj.

Hulumtimet etnolinguistike shqiptare-maqedoarumune marrin një rëndësi të dorës së parë jo vetëm për albanologjinë dhe romanistikën, por dhe për ballkanologjinë, sepse me ndriçimin e tyre mund të sqarohet dhe e kaluara dhe e tashmja e këtyre dy etnive dhe jo vetëm, që kanë pasur një histori të përbashkët mijëvjeçare. Numri i madh i tipareve të përbashkëta të shqipes me arumanishten shprehet në këtë, që etnikumi vllëh (arumun) ka dalë si rezultat i romanizimit të popullsisë vendëse ballkanike (epire, trakase, makedonase, ilire), nga sundimi shumëshekullor i Perandorisë Romake në Ballkan, pra si rezultat i romanizimit dhe të elementit para-shqiptar. Më pas ky element vllëh u nënshtrohet proceseve të ndryshme asimiluese, në Shqipëri një rishqiptarizimi, kurse në truallin e sotëm të Maqedonisë një sllavizimi të plotë. Në këtë hulli, numri i madh i elementeve leksikore dhe të tjera prej mbi 700 huazimeve të shqipes në maqedonishten, që i kemi vënë re në hulumtimet tona gjuhësore (Murati 2007), në fakt duhet parë jo si fjalë shqipe në sllavomaqedonishten, por si konkordanca dhe albanizma në maqedoarumanishten (arumanishten e sllavizuar).

Shkurtime e literaturës

- Albanezul 1996 = *Anuar Albanezul*, 401, Uniunea Culturală a Albanezilor din România, București, 1996.
- Angelovski 2000 = Angelovski, Dušan, *Prilog kon proučavanjeto na aromanizmite vo makedonskite narodnik govori. Prvi Romanističko-Balkanistički sredbi vo čest na Božidar Nastev*. Univerzitet "Sveti Kiril i Metodij". Skopje 2000.
- Anovska 2002 = Anovska Liaku Kleanti, *Vlaškite narodnik prikazni od Kruševo*, Institut za Folklor "Marko Cepenkov", Skopje, 2002.
- Asenova 2006 = Asenova, P. *Gruaja monolinge në Ballkanin biling*, Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Prishtinë, 2006.
- Atanasov 1997 = Atanasov, Petar, *Romansko-Albanski jazični vrski*, Godišen zbornik kniga 23, Filološki fakultet, Skopje 1997.
- Atanasov 2000 = *Prvi romanističko-balkanistički sredbi*. Univerzitet "Sveti Kiril i Metodij". Skopje. 2000.
- Bello 2009 = Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, 28/1, Prishtinë, 2009.
- Dunovski 1998 = Dunovski, Vanfel, *Toponimija na vlaškite sela Gorna Belica i Dolna Belica*, Struga, 1998.
- Dunovski 1998 = Dunovski, Vanfel, *Toponimija na vlaškite sela Gorna Belica i Dolna Belica*, Struga, 1998.
- Cuvata 2006 = Dina Cuvata/Dimo N. Dimčev, *Dictionar armâneascu-machidunesku / Rečnik vlaško-makedonski*, Skopia, 2006.
- Çabej 1976 = Çabej, Eqrem, *Studime gjuhësore I*. Rilindja, Prishtinë, 1976.
- Çabej 1976 = Çabej, Eqrem, *Studime gjuhësore III*, Prishtinë, 1976.
- Çabej 1996 = Çabej, Eqrem, *Studime etimologjike në fushë të shqipes*, ASHSH, IV. Tiranë, 1996.
- Elsi 1996 = Robert Elsie, *Një vjedhje në Dubrovnik dhe dalja në skenë e gjuhës dhe e kulturës shqiptare*, Përpjekja 6, Tiranë, 1996, 88.
- Friedman 1995 = Friedman, Viktor, *Ndikimi i shqipes në të folmet arumune të Maqedonishtes Jugperëndimore: Mënyra habitore*, Studime 1/1994, ASHAK, Prishtinë, 1995.
- Friedman 1997 = Friedman, Victor, *Kontaktet dhe ndërjegjija në Lidhjen gjuhësore ballkanike*. Studime albanologjike I, Tiranë, 1997.
- Fridman 2001 = Friedman, A. Victor, *The Vlah Minority in Macedonia: Language, Identity, Dialectology, and Standardization*. Selected Papers in Slavic, Balkan, and Balkan Studies, ed. by Juhani Nuoluo, Martti Leiwo, Jussi Halla-aho, (Slavica Helsingiensia 21). Helsinki: University of Helsinki. 2001.
- Fridman 2009 = *Deloto na akademik Viktor Fridman*, Abakus komerc, Skopje, 2009.
- Golab 1984 = Zbigniew Gollab, *The arumanian dialect of Kruševo in Sr Macedonia SFR Yugoslavia*, Macedonian Academy of Sciences and Arts, Skopje, 1984).
- Ilievski 1988 = Ilievski, Petar, *Balkanološki lingvistički studii*, Skopje, 1988.
- Karadafov 1992 = Karadafov, Petrula, *Vlasi – bit i kultura*, Muzej na Makedonija. Erheološki, Etnološki, Istoriski –Skopje, Skopje, 1992.
- Marković 2000 = Marković, Marjan, *Govorot na Aromancite Farseroti od ohridsko-struskiot region (vo balkanski kontekst)*. Ph.D. dissertation, Sts. Cyril and Methodius University of Skopje.
- Marković 2007 = Marković, Marjan, *Aromanskiot i makedonskiot govor od ohridsko-struskiot region (vo balkanski kontekst)*, Makedonska Akademija na

- Naukite i Umetnostite, Skopje, 2007.
- Marković 2011 = Marković, Marjan, *Za udvojuvanjeto na predlozite vo Ohridskiot govor (vo balkanski kontekst)*, Seminar za makedonski jazik, literatura i kultura, Ohrid, 15-16 juli 2011, Univerzitet "Sv. Kiril i Metodij", Skopje, 2011.
- Matkovski 1978 = Matkovski, A. *Pojava i rastež na Kruševo. Opštествeno ureduvanje. Istrorija na Kruševo i Kruševsko*. Kruševo. 1978.
- Meyer 2007 = Meyer, Gustav. *Fjalor etimologjik i gjuhës shqipe*, Botime Çabej 2007.
- Mihăescu 1978 = Mihăescu, Haralambie, *Remarques sur les rapports lexicaux albano-aroumaines*, Gjurmime Albanologjike, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1978.
- Murati 1999 = Murati, Qemal. *Shqiptarët dhe Ballkani ilirik në dritën e emrave të vendeve dhe të familjeve*, Tetovë, 1999.
- Murati 2007 = Murati, Qemal, *Bashkëmarrëdhëniet gjuhësore shqiptare-maqedonase*, Seminari i Albanologjisë i Universitetit Shtetëror të Tetovës, 2007.
- Nasteva 1998 = Nasteva, Olivera Jashar, *Kontaktet gjuhësore në hapësirat ballkanike*, Logos-A, Shkup, 1998.
- Nastev 1988 = Nastev, Božidar, *Aromanski studii. Prilozi kon balkanistikata*. Ogledalo, Skopje, 1988.
- Papahagi 1974 = Papahagi, Tache, *Dictionarul dialectului aroman, gjeeneral si etimologic*, Bucuresti, 1974.
- Papailia 2000 = Papailia, N. Jorgji, *Dicționar român-albanez (Fjalor rumanisht-shqip, Botime Toena, Tiranë, 2000*.
- Petruševski 1999 = Petruševski, Ilija, Petruševska, Nikolina, *Zborovnik na toponimi na severoistočniet del od Dolni Polog*, Luboten, 1999.
- Poçi 2001 = Poçi, Spiridulla, *Vllehët (arumunët) e Shqipërisë dhe gjuha e tyre*, Kërkime universitare, Universiteti i Gjirokastrës "Eqrem Çabej", Gjirokastrë, 2001.
- Poçi 2009 = Poçi, Spiridhulla, *Gjuha shqipe dhe marrëdhëniet e saj me arumanishten*, Seminari II Ndërkombëtar i Albanologjisë, 2009.
- Polenaković 2007 = Polenaković Haralampie, *Turskite elementi vo aromanskiot, Makedonska Akademija na Naukite i Umetnostite*, Skopje, 2007.
- Popvasileva 1987 = Popvasileva, Aleksandra, *Dvojazičното raskažuvanja na narodni prikazni (Vlaško-makedonski i makedonski-vlaški relacii*, Institut za folklor 'Marko Cepenkov', Skopje 1987.
- Радовановић 1936 = Војислав С. Радовановић, *Горња и Доња Белица у Струшком Дримкоду, Гласник географског друштва, св. XXII*, Beograd 1936.
- Riska 2004 = Riska, Albert, *Gjurmë të arumanishtes në toponiminë e Shqipërisë*, Buletin shkencor, Universiteti "Aleksandër Xhuvani", Elbasan, 2004/2.
- Simpozium 1963 = Simpozium o srednjovekovnom katund, održan na 24 i 25 novembra 1961 g., Naučno Društvo Bosne i Hercegovine, Posebna izdanja, knjiga II, Odjeljenje istorijsko-filoloških nduka, Sarajevo. 1963.
- Skok 1933 = Skok 1933 = Skok, Petar, *Glasnik Skopskog Naučnog Društva*, Knj. XII, Skoplje, 1933.
- Trajanovski 1998 = Trajanovski, Todor, Vlasi – *Narodnute obiçai ka vlasite od Struško*, Struga, 1998.
- Xoxi 2001 = Xoxi, Koli, *Nikolla Jorga – Dijetari pa frikë e pa njollë*, Horizont, Tiranë, 2001.

Artur KARASIŃSKI, University of Nicolas Copernicus, Torun

METODAT SINTAKSORE NË FJALËFORMIMIN NË BAZË TË FJALËFORMIMIT KRAHASIMTAR TË GJUHËVE TË BALLKANIT

SYNTACTIC METHODS IN WORD FORMATION ON THE BASIS OF CONTRASTIVE WORD FORMATION OF THE BALKAN LANGUAGES

Abstract

In the project I intend to say few words about a project which is carried out in the Institute of Slavistics of the Polish Academy of Sciences. The project embraces all major Balkan languages. Most of participants of the project come from Poland and Macedonia. Its main task is to determine the most common patterns of word formation in the Balkan languages. These patterns are understood as “mirrors” or transformation of syntactic structures (predicate–argument structures).

Kam ndërmend të them disa fjalë për një projekt ndërkombëtar i cili është kryer në Institutin e Slavistikës të Akademisë së Shkencave të Polonisë. Projekti i quajtur *Fjalëformimi krahasimtar i gjuhëve të Ballkanit* përfshin të gjitha gjuhët e mëdha të Ballkanit.

Qëllimi shkëncor i projektit

Qëllimi kryesor është që të përcaktojë karakteristikat specifike të fjalëformimit Ballkanik në aspektin semantik dhe formal. Për të arritur këtë, së pari ne kemi nevojë për të përshkruar sistemave fjalëformuese të gjuhëve individuale duke përdorur një model të përbashkët. Kështu, pika e fillimit për krahasim është gjuha ndërmjetësues (lat. *tertium comparationis*), që përfshin njësitë semantike (kategoritë) dhe rregullat e lidhjeve të tyre (të marrëdhënieve midis tyre). Ballafaqimi i të dhënave gjuhësore në bazë të një gjuhë semantik ndërmjetësues (*tertium comparationis*) do të lejojë të përcaktojë një inventar të llojeve fjalëformuese, aktivitetin e tyre dhe specifikat në gjuhë të veçantë Ballkanike. Në këtë kuptim kjo do të jetë një studim krahasimtar dhe tipologjik.

Rëndësia e projektit

Lidhja gjuhësore ballkanike është sot një temë e shpeshtë të hetimeve sistematike gjuhësore. Ashtu si gjuhëve ballkanike ne kuptojmë gjuhët e Ballkanit që i përkasin Ballkan Shprachbund (një njësi i klasifikimit areal e gjuhëve) dhe jo të gjitha gjuhët që thjesht ndodhin në Ballkan. Rrjedhimisht objekt i hulumtimit tonë do të jenë: bullgarisht, maqedonisht, serbisht, shqip, greqisht, rumunisht, arumunisht dhe ndoshta gjuha rome. Ndërsa në rastin e morfosintaksës ne mund të formulojmë një sërë karakteristikash të veçanta, që fjalëformimi ballkanik nuk është studiuar më parë. Edhe korpusi i materialit nuk është përgatitur (më përjashtim të serbisht dhe bullgarisht), por këtë përshkrimet ekzistuese duhet të riformulohet sipas modelit të përbashkët. Si pasojë, përshkrimi i cili do të behet në kuadër të projektit, në rast të caktuar do të jetë i vetmi projekt fjalëformues në këtyre gjuhëve, dhe kjo mund të pritet të shkaktojë hetimin e mëvonshme të fjalëformimit të gjuhëve ballkanike të veçanta si dhe të lidhjeve ballkanike. Përveç kësaj, në sajë të metodologjisë së aplikuar në projektin, rezultatet e arritura mund të shërbejnë si një bazë për hetime të mëtejshëm kognitive që janë në lidhje me ashtu-quajtur “profilizimin”.

Pse e bëjmë këtë?

Njohuri të përbashkëta dhe të ndryshme fjalëformuese fenomene është gjithashtu shumë e rëndësishme për leksikografi dhe glotodidaktik. Rezultatet e projektit mund të jenë të dobishme në të ardhmen në përgatitjen një ose dygjuhësh fjalorë (përfshirë polish – një nga gjuha ballkanike dhe anasjelltas. Ato edhe mund të shërbejnë si materiale didaktike në mësimin e gjuhëve ballkanike. Duhet të teksohet se arritjet e gjuhësisë polake për përpunim e modeleve teoretike, si dhe praktika në përshkrimin fjalëformuese të garantojë një bazë të mirë për realizimin e projektit.

Çfarë është njohur në lidhje me temë kërkimore

Shumica e përshkrimët fjalëformuese e gjuhëve ballkanike që ekziston tani janë vetëm kapituj në gramatikat e përgjithshme të një gjuhë të caktuar. Ata janë të shkurtra dhe shumë tradicionale. Jo rrallë ka vetëm një listë e morfemave të ndryshme fjalëformuese dhe disa shembuj. Përshkrimet fjalëformuese të veçanta janë botuar vetëm për gjuhën serbe dhe bullgare – këto janë edhe tradicionale: pika e fillimit gjithmonë është forma,

kriteret përshkrimore janë intuitive dhe heterogjene. Nga puna krahasuese ka edhe disa studime shumë të detajuara. Nëse ata thonë diçka në lidhje me konvergjencën – këto janë gjithmonë vërejtje diakronike për shembull huamarrje e prapashtesave sllave, turke apo greke në gjuhën shqipe. Për arumunisht apo rome ne nuk gjejmë asgjë në lidhje me fjalëformimin. Në projektin tonë ne jemi duke u përpjekur për të ndërtuar një model në të cillin të gjitha gjuhët të krahasuara kanë një pozitë të barabartë – kjo do të lejojë që të observojë dallimet dhe dukurive të zakonshme

Teoria dhe metodologjia në një fjalë

Në hulumtimin e propozuar fjalëformimi është kuptuar si një hetim sinkronik i marrëdhënieve të brendshme në një gjuhë, si një hetim i marrëdhënieve mes morfemave që formojnë një fjalë të prejardhur. Si pasojë, fjalëformimi mund të kuptohet si një hetim sintaksor brenda një fjalë të prejardhur.

Metodologjia që është aplikuar në këtë projekt ka të bëjë me zhvillimin dhe përpunimin e modelit semantik të fjalëformimit krahasues. Baza dhe pikënisja për krahasim është gjuha ndërmjetësues (lat. *tertium comparationis*) që përfshin njësitë semantike (kategoritë) dhe rregullat e lidhjeve të tyre (të marrëdhëniëve midis tyre).

Postulat i rëndësishëm është prania e izomorfizmit struktural ndërmjet strukturës së fjalës së prejardhur dhe strukturës së fjalisë. Kjo do të thotë se rregullat e njëjta kombinatorë drejtojnë menyrën e lidhjes së fjalëve në fjali dhe mënyrën e ndërlidhjes së morfemave në fjalë të prejardhura.

Ndryshe se në fjalinë, ka një korrelacion të vazhdueshëm në mes të strukturës semantike dhe strukturës formale të derivatit: formanti shërbën gjithmonë si një eksponent i një kuptimit të përgjithshëm, ndërsa tema e tregon kuptimin e detajuar. Të vetmet përjashtime janë fjalët të përbëra dhe fjalët prapashtesor që janë përbërë nga dy nocione të detajuar.

Një tjetër postulat i cili është bazë për hulumtim, së bashku me izomorfizmin struktural, është autonomia relative e strukturave semantike dhe sintaksore të njësisive të gjuhës. Lidhur me fjalëformimin kjo do të thotë se në këtë rast derivatet semantike dhe formale duhet të dallohen në analogji me sintaksë e fjalisë, që e dallon struktura e konceptit dhe struktura formale.

Aplikimi sistematik i këtij dallimi çon në përkufizimin e fjalë-

formimit si një sintaksë morfemore (e ngjashme me sintaksë e fjalisë) ndërsa fjala të prejardhur (derivati) si një strukturë në të cilën rregullat e kombinimit të morfemave formale e të semantike janë realizuar. Kjo lejon për të gjetur rregullat e kombinimit të morfemave dmth. marrëdhëniet midis morfemave që janë të rregullta.

Vendosja e inventarit të kategorive fjalëformuese është një rezultat i ndarjes logjike bazuar në kriteret funksionalo-semantike – ndarje në dy pjesë:

Faza I: + / - kuptimi i përgjithshëm të shprehur në strukturën semantiko-morfemore nga formanti: 1. Predikati, 2. Argumenti (material)

Faza II + / - Predikati thelbësor: 1. Predikati bërthamor (që përbën strukturën e lartë), 2. Predikati i shtuar.

Faza III: përmbajtja e lidhjeve të kuptimeve përbërëse: 2.1.2.n. (llojet e pozicioneve argumentuese).

Kategoritë të specifikuar në bazë të procedurës e mësipërm përbëjnë klasa të ndara. Rrjedhimisht, kjo do të thotë që përbërësi semantik (kuptimor) i përkët një kategorie të caktuar mund të shfaqet vetëm një herë në kuadër të strukturës monopredikative.

Inventari i kategorive fjalëformuese, të cillat formojnë gjuhën ndërmjetesues, përbëhet nga dy grupe: kategoritë predikatuese (të shquar në fazën e dytë të ndarjes) dhe kategoritë argumentuese (të shquar në fazën e tretë të ndarjes).

Inventari i kategorive fjalëformuese që formojnë gjuhën ndërmjetesues (tertium comparationis) në përshkrimin fjalëformues dhe krahasues.

a. Kategoritë argumentuese	b. Kategoritë predikative
vepruesi	gjendja
pësuesi	ngjarja
rezultati	vendi
përvojes	mënyra
rregulluesi	predispozicioni
beneficienti	mohimi
objekti	shkaku
elementi	ngjashmëri
mjeti	relacionet
material	madhësia
	gjinia
	rinia
	emocioni dhe/ose vlerësimi
	sasia
	intensiteti

Funksioni i formantit varet nga pjesëmarrja i tij në karakteristikën semantike dhe formale (morfologjike dhe sintaksore) e njësisë leksikore së krijuar. Në këtë mënyrë përcaktojmë dy funksionet e mundshme – *semantik dhe sintaksor*. Kjo do të thotë se këto funksione mund të realizohen në çdo predikat. Funksioni semantik i formantit qendron në faktin se ky formant është treguesi i një nga përbërësi të strukturës morfemike dhe semantike të derivatit. Më fjalë të tjera formanti (parashtesa ose prapashtesa) ka një funksion semantik kur ai është treguesi i predikatit (bërthamor ose shtuar) ose kur ai është treguesi i argumentit. Ndërsa formanti ka një funksion sintaksor kur ai përcakton karakteristikat kategoriale (morfologjike dhe sintaksore) të derivatit, rrjedhimisht formant vendos karakteristikën distributive të derivatit.

Bazuar në një kombinim të pranisë (+) dhe mungesës (-) e këtyre dy funksione e mundshme mund të dallohet këtu katër klasa funksionale të derivateve:

Klasa	Derivatet	Funksioni i formantit:	
		Semantik	Sintaksor
1)	Mutacioni	+	+
2)	Modifikimi	+	-
3)	Transponimi/zhvendosje	-	+
4)	Tautologji	-	-

Formantët me funksion semantik janë eksponentët e kategorive fjalëformuese të cillët u dalluan si njësitë e gjuhës ndërmjetësues (lat. *tertium comparationis*) në procesin e modelimit të strukturave semantike të derivateve.

Tema (temat) e cila bashkohet me formantet të ndryshme është gjithmonë komponenti përbërës i strukturës formale të derivatit. Lloja e formantit është përdorur si bazë për ndarjen formale të strukturave derivate.

Disa shembuj të analizës semantike në gjuhën shqipe:

Relacione $Ob_x - Loc_y + P_{Quant}$

‘[x] **gjendet** në [y] + [x] **ka shumë**’

breg shkëmbor – ‘shkëmbinj gjendet në breg dhe atje ka shumë shkëmbinj’

‘rocky shore – roks are on the shore and there are a lot of roks’

kungull farës – ‘fara gjendet në kungull dhe atje ka shumë fara’

‘grainy cucurbit – grains are in the cucurbit and there are a lot of grains’

Predikati që formon një relacion i mëlartshëm është predikati *gjendet në*. Predikati i tillë nuk është shprehur explicite. Ai implikon dy pozitë argumentuese objekti dhe vendi. Tema e mbiemrit është eksponenti i kategorisë argumentuese e objektit por treguesi vendit është tema e emrit. Formantet *-or*, *-ës* kanë funksion semantik dhe janë eksponentet të kategorisë predikative – sasia. Ky është predikati i shtuar (adiunktiv).

Relacione: Ag Res – Instr

aparatur fotografik – ‘mjet që përdoret për të fotografuar’

‘*photographic device* – ‘equipment for taking photographs’

vegël ndërtimi – ‘mjet që përdoret për të ndërtuar’

‘*construction tool* – ‘a thing used to build sth.’

Predikati që formon këtë strukturë morfosemantike paraqet kategorinë fjalëformuese predikative – shkaku. Kategoria argumentuese e agensit/vepruesit është e nëvojshme kur predikati implikon kategorinë argumentuese e mjetit. Atëherë agensi është e bllokuar. Tema e mbiemrit është një eksponent e kategorisë argumentuese të rezultatit por tema e emrit është një eksponent e kategorisë argumentuese të mjetit.

Disa shembuj që i përkasin derivateve mbiemërore të prejardhur nga mbiemrat:

Mbiemra që rrjedhin nga mbiemra të tjerë janë shumë interesante. Ky është klasa modifikuese të derivateve që do të thotë së formantet që krijojnë, ndërtojnë njësitë të reja leksikore ndryshojnë kuptimin e temës prodhuese. Formantet të tillë kanë funksion semantik dhe janë eksponentet e kategorive predikative ose argumentuese të cillat u dalluan si njësitë të gjuhës ndërmjetësues (tertium comparationis) gjatë procesit të parafrazimit dhe specifikimit elementave semantike të strukturës semantike të derivatit.

p.sh.

- *kategoria predikativw – mohimi*

i parëndësishëm – ‘që nuk është i rëndësishëm’ pa-

‘*unimportant/insignificant* – which is not important’

i panevojshëm – ‘që nuk është i nevojshëm’

‘*unnecessary* – which is not necessary’

- *Kategoria predikative – relacioni hapësinor*

ndërplanetar – ‘i tillë P që behet ndër planetet / i tillë x që vëpron, punon / gjendet ndër planetet’

‘*interplanetary* – such P that happens between planets / such x that acts / takes place between planets’

Remzi PËRNASKA, Paris

BASHKËSIA E TË ASHTUQUAJTURAVE TRAJTA TË SHKURTËRA TË PËREMRAVE VETORË DHE ZGJEDHIMI NËNANOR-KUNDRANOR (SUBJEKTOR-OBJEKTOR) *SUI GENERIS* NË GJUHËN E SOTME SHQIPE

Abstrakt

Bashkësia e të ashtuquajturave trajta të shkurtra a trajta të patheksuara të përemrave vetorë në gjuhën shqipe është mbajtur nga tradita me të njëjtën gjendje gjuhësore si bashkësia e trajtave të plota a të theksuara të po këtyre përemrave, ndaj edhe është folur për përsëritje a dyfishim të kundrinave të drejta dhe të zhdrejta. Po kjo gjuhësi tradicionale fjalën e përkap si njësi njëherazi fonetike, grafike dhe semantike, midis dy heshtjesh në të shqiptuar a dy të bardhash në të shkruar. Megjithëse një përkufizim i tillë i fjalës është mjaft i papërcaktuar, gjithë duke iu përmbajtur atij, në kumtesë bëhet një përpjekje për të provuar në këto të tria nivele se të ashtuquajturat trajta të shkurtëra të përemrave vetorë nuk kanë sot të njëjtën gjendje gjuhësore me vetë trajtat e plota a të theksuara të përemrave vetorë në gjuhën shqipe, çka çon në një ndryshim tipologjik në këtë pikë. E ky ndryshim tipologjik po e kalon fazën e aglutinimit dhe po shkon drejt fazës së trajtëndryshimit, çka lë shteg për një trajtim të zgjedhimit të foljes në gjuhën shqipe, jo vetëm si subjektor, por edhe objektor sui generis.

Bashkësia e të ashtuquajturave trajta të shkurtëra të përemrave vetorë¹ e gjuhës shqipe është paraqitur qysh herët në Gramatikën e Da Leçes (1716), para gramatikave të gjuhëve të tjera të Ballkanit që i kanë ato, për më tepër duke i quajtur pjesëza (particelle)².

Miklosiçi vuri re i pari se ato gjenden edhe në gjuhë të tjera të ball-

¹ Ka gjuhëtarë që pranojnë "trajta të shkurtëra" dhe për përemrat dëftorë: O. Myderrizi, **Gramatika e Re e shqipes**, Tiranë, 1944, f. 107; K. Cipo, **Sintaksa**, Tiranë, 1952, f. 31; H. Vokshi, *Objekti i dyfishtë – për përdorimin e dyfishtë të disa rasave në shqipet, Përparimi*, Prishtinë, 1955, 4, f. 213; J. Luka, *Për një interpretim më të drejtë shkencor të përemrave vetorë të vetës së tretë 'ai, ajo, ata, ato'*, **Lëndët shoqërore në shkollë**, Tiranë, 1969, 6, f. 74, 76, 86.

² F. M. da Lecce, **Osservazioni grammaticali nella lingua albanese**, Roma, 1716.

kanit (shqipe, rumanishte, bullgarishte, maqedonishte dhe greqishte)³. Ndeshen edhe në disa të folme periferike serbe dhe kroate dhe përbëjnë ballkanizëm. Dukuria ka shkuar më përpara në maqedonishte dhe në shqipe. Ato gjenden edhe në gjuhët neolatine. Ne do të merremi vetëm me ato të shqipes, por mënyra e vështrimit dhe rezultatet mund të vlejnjë qoftë edhe pjesërisht edhe për ato gjuhë që e kanë një bashkësi të tillë.

Ka autorë që pranojnë "trajta të shkurtëra" edhe për gjinoren⁴. Të tjerë pranojnë edhe "trajta të shkurtëra" tonike⁵.

* * *

Gjuhëtarët janë të një mendjeje sot për gramatikalizimin e plotë të kundranorit të zhdrejtë, madje dhanorja vetë është e rimarrë gjithmonë nga një e ashtuquajtur trajtë e shkurtër e përemrit vetor te folja, çka ne e përdorim, ndër të tjera, si argument për të dalluar dhanoren nga gjinorja.

Gjuhëtarët janë të një mendjeje sot për gramatikalizim të plotë të kundranorit të drejtë të shprehur prej vetës së parë dhe të dytë njëjës dhe shumës.

Këtyre dy gramatikalizimeve të para u kundërvihet gramatikalizimi i vetës së tretë, që është i kushtëzuar nga ndarja aktuale e thënies ku ato bëjnë pjesë. Ky gramatikalizim është i plotë kur kundranori i drejtë është temë ose pjesë përbërëse e temës dhe jo i plotë kur theksi i ngulmimit bie mbi kundranorin vetë, pra kundranori i drejtë nuk "rimerret, nuk përsëritet, nuk dyfishohet" prej të ashtuquajturave trajta të shkurtëra të përemrave vetorë kur theksi i ngulmimit bie mbi të dhe krijon kështu kundërvënie reale ose të mundshme me një kun-

³ F. Miklosich, *Die Sprache der bulgaren in Sierbenbürgen*, Denkschriften der Wiener Akademie der Wissenschaften, Phil.-hist., kl., Bd. VII (1856); po ai, *Die slavischen Elemente im Rümänischen*, *ibid.*, Bd. XII (1862); A. M. Seliščev, *Des traits linguistiques communs aux langues balkaniques*, *Revue des Etudes Slaves*, t. V, Paris, 1936; Ю. А. Лопашов, *Об одном албанизме в северновогреческом говоре*, *Проблемы балканской филологии*, Санкт-Петербург, 2006, f. 162 vë re se inkorporimi i të ashtuquajturave trajta të shkurtëra të përemrave vetorë, karakteristik për shqipen, është futur edhe në të folmen greke të fshatit Eratira.

⁴ P. Wassa, *Grammaire albanaise*, London, 1887, f. 32-33.

⁵ I. D. Sheperi, *Gramatika dhe sindaksa e gjuhës shqipe, sidomos e toskënishtes* (Për shkollat e mesme), Vlorë, 1927, f. 56; O Myderrizi, *Gramatika e Re e shqipes*, Tiranë, 1944, f. 103,.

dranor tjetër⁶. Mungesa e të ashtuquajturave trajta të shkurtëra të përmrave vetorë është tregues i gramatikalizimit të shkallës zero.

Ky gramatikalizim i ashtuquajturave trajta të shkurtëra të përmrave vetorë mund të paraqitet me grafën e mëposhtëm:

personne	Complément d'objet indirect	Complément d'objet direct	
		pronom	nom
I			
II			
III			

Në shqipen e folur, madje edhe në atë të shkruarën, vihet re prirje për gramatikalizim të skajshëm edhe në këto raste. Kjo prirje është edhe më e theksuar në të folmet geje verilindore, sidomos në ato të Kosovës.

Vetëm gramatikalizimi do të mjaftonte që ato të mos mbaheshin më si përsëritëse, rimarrëse, dyfishuese të kundranorit të drejtë dhe të zhdrejtë.

⁶ I. D. Sheperi, **Gramatika dhe sindaksa e gjuhës shqipe, sidomos e toskënishtes** (Për shkollat e mesme), Vlorë, 1927, f. 154; P. Novak, *K zdvojevani predmetu v albanistine, Sbornik slavistických prací venoranych IV mezhnarodnimu zjezdi slavistu v Moskve*, Praha, 1958, f. 27-32; N. Barri, *Albanais : Thème, propos et pronoms atones*, **Bulletin de le Société de Linguistique de Paris**, tome 70, fasc. 1 (1975), f. 179-202; Sh. Demiraj, *Diskutim për kumtesën e O. Buholcit, Actes du 1^{er} Congrès International des Balkaniques et Sud-Est Européennes, VI, Linguistique*, Sofia, 1968, f. 726 dhe **Sistemi i lakimit në gjuhën shqipe**, Tiranë, 1975, f. 129, 134; Sh. Demiraj, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1986, f. 588v.; Totoni, etj., **Libri i gjuhës shqipe për klasën VII**, Tiranë, 1971, f. 48; M. Totoni, **Gjymtyrët e fjalisë – kryefjala, kallëzuesi, përcaktori dhe përcaktori kallëzuesor** (tezë disertacioni për shkallën I të kualifikimit), Tiranë, 1980, f. 16; Th. Rushi, *Rendi i fjalëve në fjalinë e thjeshtë dëftore në gjuhën shqipe (Disertacion për kërkimin e gradës "Kandidat i shkencave")*, Tiranë, 1983, f. 128.

* * *

Bashkësia e të ashtuquajturave trajta të shkurtëra të përemrave vetorë, në gjuhët ballkanike e romane, ku ato gjallojnë, është mbajtur si bashkësi fjalësh, si përemra, ndaj edhe flitet për trajta të shkurtëra, të patheksuara të përemrit vetor, pra si fjalë, si përemra, njësoj si trajtat e plota a të theksuara të përemrave vetorë, në fund të fundit me përdorim pleonastik, rimarrës, përsëritës, dyfishues.

Ne mendojmë se të ashtuquajturat trajta të shkurtëra të përemrave vetorë nuk kanë gjendje (status) gjuhësore gramatikore si të trajtave të plota, të theksuara.

Po të kishin të njejtën gjendje gjuhësore gramatikore, ato, si fjalë, do të mund të veçoheshin (të izolohehin, të shqiteshin) me metoda gjuhësore gramatikore transformacionale, distributive, etj. nga vargu i fjalëve të tjera në ligjërime, si fjalë më vete, dhe vetëm pastaj të cilësoheshin si përemra vetorë. Por një izolim i tillë gjuhësor gramatikor është i pamundshëm, për disa arsye, prej të cilave po renditim shkurtazi vetëm disa prej më peshuesve.

Sipas gjuhësisë tradicionale, fjala është element i kuptimshëm i përbërë prej një ose disa fonemash midis dy pushimesh, në të shkruar, midis dy të bardhash, që ruan formën e vet tërësisht ose pjesërisht (trajtëndryshim) në përdorimet e ndryshme sintagmatike, që shënon send (substantiv), veprim ose gjendje (folje), cilësi (mbiemër), marrëdhënie (parafjalë), etj.⁷

Dhe kur flitet për pjesë të ligjëratës, pra edhe për përemra, jemi e mbetemi në gjuhësi tradicionale.

Ndër vështirësitë që ndesh një konceptim i tillë i fjalës është njëjtësia që bashkëbart midis të shkruarit (të grafizmit) dhe funksionimit semantik. Kjo mungesë rreptësie shpjegon pse strukturalizmi e mënjanon kategorinë e fjalës, për rrjedhojë edhe skajin *fjalë*. Për A. Martinenë, nocioni *fjalë* duhet braktisur në të mirë të nocioneve *mone*-më dhe sintagmë. Për E. Benvenistin, në vend të skajit fjalë duhen përdorur respektivisht skajet sinapsi, leksi, njësi domethënëse. Gramatika lindëse (gjenerative), që pranon pjesërisht analizën strukturore të leksikut (shihni: analiza e përbërësve, analiza semike), u kushton megjithatë jo aq shumë

⁷ J. Dubois, M. Giacomo, etj., *Dictionnaire de linguistique*, Paris, 1973, f. 327-328.

rëndësi njësave leksikore, që dalin te performancat. Përkundrazi, gramatika lindëse interesohet për marrëdhëniet sintaksore-semantike. Edhe për gjuhësinë ligjërimore të thënies është i pranueshëm nocioni tradicional për fjalën, të cilën e sheh si njësi gjuhësore njëherazi fonetike, grafike dhe semantike, por i përmbahet mendimit se përkufizimi i fjalës është i vështirë, sepse vetëdija e ligjëruesve për ndarjen (copëzimin, pjesëtimin, izolimin, veçimin) e thënieve në njësi nuk është e njëjta në rrjedhë të kohës.⁸

* * *

Megjithatë, gjuhësia thënësore pranon se ka kritere pak a shumë të besueshëm për t'i kufizuar, shkoqur, izoluar fjalët e një gjuhe natyrore.

Së pari, sipas *kriterit shndërrues (transformacional) të zëvendësimit, të shkëmbimit të vendeve në një klasë paradigmatiske*, një fjalë e dhënë nuk mund të zëvendësohet veçse nga një fjalë që i përket po asaj klase.⁹

Me kundranor të drejtë :

Agronin e ftuan në dasmë.

Atë e ftuan në dasmë

**E* e ftuan në dasmë

Teutën e ftuan në dasmë.

Atë e ftuan në dasmë

**E* e ftuan në dasmë

Me kundranor të zhdrejtë :

Agronit i dërguan ftesë për në dasëm.

Atij i dërguan ftesë për në dasëm.

**I* i dërguan ftesë për në dasëm.

Teutës i dërguan ftesë për në dasëm.

Asaj i dërguan ftesë për në dasëm.

**I* i dërguan ftesë për në dasëm.

Si shihet, vetëm trajtat e plota a të theksuara të përemrave vetorë mund të zëvendësojnë një fjalë të klasës emërore, kurse ato të shkurtrërat a të patheksuarat nuk e kanë më një mundësi të tillë, pra nuk janë

⁸ M.-L. Groussier, C. Rivière, *Les mots de la linguistique. Lexique de la linguistique énonciative*, Paris, 1996, f. 124.

⁹ Po ata, *po aty*.

fjalë emërore, madje, sipas këtij kriteri, as edhe fjalë. T'i mbash ato sot si përemra do të thotë të mbetesh në origjinën e tyre dhe jo në evolucionin historik që kanë pësuar.

Një kriter tjetër *shndërrues (transformacional)* për të kufizuar, veçuar, shkoqur, izoluar fjalët është edhe ai i *njëjtësisë, i homogjenitetit*. E pikërisht sipas këtij kriteri dy trajta të plota, të theksuara të përemrave vetorë mund të zëvendësojnë njëra tjetrën, ose një fjalë tjetër emërore, kurse, përkundrazi, dy trajta të shkurtëra, të patheksuara të përemrave vetorë nuk mundën kurrsesi të zëvendësojnë njeri-tjetrën, ose një fjalë tjetër emërore :

Me kundranor të drejtë :

Mua dhe *ty* na thirrën në dasmë.

**Mua* dhe *të* na thirrën në dasmë.

**Më* dhe *ty* na thirrën në dasmë.

**Më* dhe *të* na thirrën në dasmë.

Ty dhe *mua* na thirrën në dasmë.

**Ty* dhe *më* na thirrën në dasmë.

**Të* dhe *mua* na thirrën në dasmë.

**Të* dhe *më* na thirrën në dasmë.

Teutën dhe *Agronin* i thirrën në dasmë.

Agronin dhe *Teutën* i thirrën në dasmë.

Teutën dhe *atë* i thirrën në dasmë.

Atë dhe *Agronin* i thirrën në dasmë.

Agronin dhe *atë* i thirrën në dasmë.

Atë dhe *Teutën* i thirrën në dasmë.

Atë dhe *atë* i thirrën në dasmë.

**E* dhe *e* i thirrën në dasmë.

Me kundranor të zhdrejtë :

Agronit dhe *Teutës* i dërguan ftesë për në dasmë.

Atij dhe *asaj* i dërguan ftesë për në dasmë.

**Atij* dhe *i* i dërguan ftesë për në dasmë.

**Atij* dhe *asaj* i dërguan ftesë për në dasmë.

**I* dhe *i* i dërguan ftesë për në dasmë.

Teutës dhe *Agronit* i dërguan ftesë për në dasmë.

Asaj dhe *atij* i dërguan ftesë për në dasmë.

**Asaj* dhe *i* i dërguan ftesë për në dasmë.

Atij dhe asaj i dërguan ftesë për në dasmë.

**I dhe i* i dërguan ftesë për në dasmë.

e kështu me radhë.

Edhe sipas këtij kriteri, të ashtuquajturat trajta të shkurtëra të përemrave vetorë nuk dalin të një fare me trajtat e plota a të theksuara të këtyre përemrave. Edhe sipas këtij kriteri, të ashtuquajturat trajta të shkurtëra të përemrave vetorë nuk mund të veçohen, të shkoqen, të izolohen si fjalë emërore, madje as edhe si fjalë.

Edhe kaq do të mjaftonte për të pohuar se të ashtuquajturat trajta të shkurtëra të përemrave vetorë nuk janë më as përemra, as edhe fjalë.

E po nuk qenë fjalë, mbetet që të jenë pjesë fjale. Ja një përfundim i parë madhor.

Së dyti, po vazhdojmë me një kriter tjetër gjuhësor, me *kriterin përndarës (distribucional)*. Edhe sipas këtij kriteri, të ashtuquajturat trajta të shkurtëra të përemrave vetorë nuk mund të dallohen, të veçohen, të izolohen si fjalë më vete. Kriteri përndarës është mjaft i pasur, por në këtë kumesë do të përdoren aspekte të tij nga më kryesoret.

Është vënë re prej gjuhëtarëve se trajtat e shkurtëra të përemrave vetorë gjenden gjithmonë ngjitur me rënjën e foljes, para ose pas saj, me të cilën formojnë një fjalë fonologjike midis të cilëve nuk mund të ndërshtihet kurrëgjë tjetër, veçse një trajtë tjetër "e shkurtër e përemrit vetor". Kjo do të thotë se të ashtuquajturat trajta të shkurtëra nuk mund të shkëputen nga folja, ndaj edhe B. Bokshi i quan ato të lidhura në rrafshin sintagmatik, ndryshe nga trajtat e plota, të cilat i quan të lira. Megjithatë, i mban ato me të njëjtën gjendje si edhe trajtat e plota në rrafshin paradigmatic, pra si përemra. O. Myderrizi porositi që "trajtat e patheksuara të përemrave vetorë të mos trajtohen veças foljes, po të trajtohen si afikse të foljes¹⁰, madje i shkruan me vizë ndarëse, kur janë pas foljes, si bënin disa rilindës edhe me pjesëzën u. Kjo ide e Myderrizit çon larg, çon te zgjedhimi nënanor-kundranor i foljes në gjuhën shqipe, për më tepër, ajo çon në rivështrimin e nocionit për marrëdhëniet predikative dhe shtënien në to, përveç nënanës, edhe të kundranës, çon pashmangshëm në konceptimin e një logjike joaristoteliane.

¹⁰ O. Myderrizi, *Gramatika e Re e shqipes*, Për shkollat e mesme, vëllimi I (Fonologji e morfologji), Tiranë, 1944, f. 21, 103.

Gjithnjë sipas kriterit përndarës, të ashtuquajturat trajta të shkurtëra të përemrave vetorë nuk mund të mbahen më si fjalë, sepse ato zënë vend të caktuar, të kushtëzuar nga natyra e thënies, si thuhet ndryshe, vihen gjithmonë vetëm para, ose pas temës së foljes. Ato vihen pas foljes, ose në trup të saj (edhe në këtë rast duhej të thuhej gjenden pas rrënjës), kur folja është në mënyrën urdhërore në fjali urdhërore pohuese: merrE dhe merrEni. Në kesi rastesh, do të detyroheshim të pranojmë se dy fjalë mund të japin një fjalë të vetme në këto kushte ligjërimore. Për më tepër, kjo rregullsi rendi merr karakter aglutinimi në rastin e parë, si ndodh edhe me të ashtuquajtuajturat prapashitesa trajtëformuese të shumësit, dhe ndërshtënieje (inkorporimi) në rastin e dytë. Kemi, pra, ndryshim tipologjik.

Po në këtë hulli, të ashtuquajturat trajta të shkurtëra të përemrave vetorë kombinohen midis veti gjithmonë me një a disa (deri në tri) dhanore që prijnë dhe vetëm një kallëzore që ndjek, dhe në këto kombinime, mund të kemi edhe shkrirje të dy trajtave në një të vetme : më+e=ma, të+e=ta, i+e=ia, etj. Nëse do të vazhdohet të mbahen të ashtuquajturat trajta të shkurtëra të përemrave vetorë si përemra, si fjalë, atëherë do të duhej të pohohej se kemi dy fjalë, dy përemra te *ma*, *ta*, *ia*, etj.? Pse vetëm të ashtuquajturat trajta të shkurtëra të përemrave vetorë e kanë këtë aftësi për t'u kombinuar, kurse të plotat jo?

Gjithashtu, është vënë re prej studiuesve se të ashtuquajturat trajta të shkurtëra të përemrave vetorë nuk mund të prihen nga para-fjalë, ndryshe nga trajtat e plota që e kanë një mundësi të tillë. Nëse të ashtuquajturat trajta të shkurtëra të përemrave vetorë do të mbahen për përemra, do të dilte se vetëm ato, nga e gjithë klasa e emërorëve, nuk e kanë një përndarje të tillë.

Nga ana tjetër, B. Bokshi vë re se trajtat e plota të përemrave vetorë "mund të përdoren të përforcuar nga përemri identifikues *vetë*, që është neutral në kuptimin e vetës, të numrit, të gjinisë", mundësi që nuk e kanë të ashtuquajturat trajta të shkurtëra të përemrave vetorë : *unë* vetë – vetë *unë*; *ti* vetë – vetë *ti*; *ai* vetë, *ajo* vetë – vetë *ai*, vetë *ajo*; etj.; **më* vetë – vetë *më*; **të* vetë – vetë *të*; **i* vetë – vetë *i*; **e* vetë – vetë *e*; etj. Edhe në kesi rastesh, do të dilte se vetëm të ashtuquajturat trajta të shkurtëra të përemrave vetorë nuk e kanë këtë mundësi në klasën e emërorëve.

B. Bokshi vë re se të ashtuquajturat trajta të shkurtëra të përemrave vetorë nuk mund "të rimarrin, të përsëritin, të dyfishojnë" kur kemi vetë të dytë njëjës me vlerë përgjithësuese, sepse trajtat e plota nuk mund t'u bashkëshoqërohen në këtë funksion". Pse vallë vetëm të ashtuquajturat trajta të shkurtëra të përemrave vetorë e kanë një mundësi të tillë?

Ai vë re gjithashtu se vetëm trajtat e plota të përemrave vetorë kanë aftësinë të shoqërohen me disa mbiemra të emëruar, të substantivuar (*i mjeri, i gjori, i ngrati, i lumi*), kurse të ashtuquajturat trajta të shkurtëra të përemrave vetorë kurrsesi : *mua* të mjerin, *mua* të mjerën, *mua* të mjerit, *mua* së mjerës, *mua* të gjorin, *mua* të gjorit, *mua* së gjorës, etj., por: *të mjerin (të gjorin, të ngratin, të lumin) *më*; të mjerën (të gjorën, të ngratën, të lumen) *më*; *më* të mjerin (të gjorin, të ngratin, të lumin), etj.

Ka edhe argumente të tjera përndarëse që vërtetojnë se të ashtuquajturat trajta të shkurtëra të përemrave vetorë nuk kanë më natyrë fjalore e që nuk mund të mbahen si përemra.

* * *

Si përfundim, trajtat e shkurtëra të përemrave vetorë, në shqipen e sotme, nuk dalin të një fare me trajtat e plota a të theksuara të këtyre përemrave, pra nuk kanë më të njëjtën gjendje midis tyre.

Dhe tani shtrohet natyrshëm problemi: meqë nuk janë më as përemra, as fjalë, si duhen trajtuar atëherë?

Po të marim parasysht që ato nuk janë më në të njëjtën gjendje gjuhësore midis tyre, si edhe po të kemi parasysht që të ashtuquajturat trajta të shkurtëra të përemrave vetorë gjenden gjithmonë ngjitur, para, ose pas, temës a rrënjës së foljes, me të cilën formojnë një fjalë fonologjike, midis të cilëve nuk mund të ndërshtihet kurrëgjë tjetër veçse një trajtë tjetër e ashtuquajtur e shkurtër e përemrit vetor, atëherë foljes kalimtare i duhet njohur një vend bosh, të cilin në ligjërim e plotësojmë me "trajtë të shkurtër", kur kundranori i drejtë nuk është remë e thënies, dhe nuk e plotësojmë, kur kundranori i drejtë është remë e thënies, kurse kur në thënie ka kundranor të zhdrejtë vendi bosh para foljes plotësohet gjithnjë. Vend të tillë bosh nuk ka për foljet moskalimtare, sepse ato nuk marrin kundranor të drejtë. Gjithë sa u tha në këtë paragraf mund të paraqitet me grafim abstrakt : Folje kalimtare me

kundranor në dhanore: -(+)Folje; Folje kalimtare me kundranor të drejtë : -(+)Folje + kundranor të drejtë temë e thënies, -(Ø)Folje+ kundranor të drejtë në vetën e tretë njëjës a shumës remë e thënies, dhe -(+)Folje+ kundranor në vetën e parë dhe të dytë njëjës e shumës.

Kjo skemë abstrakte e ndërtuar me induksion tregon se të ashtuquajturat trajta të shkurtëra të përemrave vetorë sillen ndaj foljes si elemente aglutinative të paravendosura, të pasvendosura dhe të ndërvendosura te folja dhe shenjojnë kështu njëherazi një ndryshim tipologjik: ato sillen tek folja gati si të ashtuquajturat prapashtesa trajtëformuese të shumësi i emrave, "prapashtesa" këto që tipologjikisht dalin si elemente aglutinuese. Dhe tani kuptohet edhe më mirë qëndrimi i O. Buchholzit dhe V. Fidlerit që bashkësinë e trajtave të shkurtëra të përemrave e quajnë *Objektzeichen*, *Objektmarker* "shënues i objektit"¹¹ dhe i H. Valterit që i quan ato *morfema (afikse) të foljes*¹².

S. Riza ka vërejtur me të drejtë se në sintagmatikë të ashtuquajturat trajta të shkurtëra të përemrave vetorë sillen ndaj trajtave të plota gjegjëse (kundranor), po ashtu si mbaresat e foljeve ndaj përemrave me funksion nënanori (kryefjale)¹³. Pra kemi skemën: Nënanor1 + (2)Folje(1) + Kundranor2. Vetëm kaq dhe do të mjaftonte që të ashtuquajturat trajta të shkurtëra të përemrave vetorë të mos mbaheshin si

¹¹ O. Buchholz, *Zur frage der Verdoppelten der Objekte im albanischen*, **Actes du I-er Congrès International des Etudes Balkaniques et Sud-Est Eropéennes, VI, Linguistique**, Sofia, 1968, f. 711-724; O. Buchholz, V. Fiedler, *Zur Stellung der Objektzeichen in der albanischen Litteratursprachen der Gegenwart und bei Gjon Buzuku*, **Akte des Internationalen Albanologischen Kolloquiums, Innsbruck**, 1977, f. 433; O. Buchholz, *Mbi gërshetimin e aspekteve morfologjike e sintaksore tek rasat në gjuhën shqipe*, **Gjurmime albanologjike, seria e shkencave filologjike, VII-1977**, Prishtinë, 1978, f. 147.

¹² H. Valter, *Zum problem der sog. Verdoppelten Objekte in den Balkansprachen*, **I-er Congrès International des Etudes Balkaniques et Sud-Est Eropéennes**, Sofia, 26 août-1 septembre 1966, Résumés des communications, Linguistique, Sofia, 1966, f. 225.

¹³ S. Riza, **Sistemi foljor i letrarishtes shqiptare bashkëkohore**, Tiranë, 1994, f. 159: "Pra, në gjuhën shqipe, rregullës së përgjithshme të mosshprehjes dhe rregullës së veçantë të shprehjes së përemmit vetor në funksion ndënanor – u përgjigjen pikë për pikë rregulla e përgjithshme e mospërdorjes dhe rregulla e veçantë e përdorjes së formave të theksuara të të njëjtit përemër"; shihni edhe: S. Riza, **Vepra II**, Prishtinë, 1997, f. 109.

fjalë, si përmra vetorë, por si mbaresa vetore të kundranës te folja.

* * *

Kur pohojmë se të ashtuquajturat trajta të shkurtëra të përemrave vetorë nuk kanë më natyrë përemërore, nuk janë përmra vetorë, kjo nuk do të thotë se ato nuk e kanë më aftësinë e shënimit të vetës. Dhe pikërisht se e kanë ruajtur këtë aftësi, ato shërbejnë sot për të shenjuar vetën e kundranorit dhe sillen kësisoj thuajse si mbaresat vetore të foljes. Dhe kjo bëhet më e qartë po të kihet parasysh se të ashtuquajturat trajta të shkurtëra të përemrave vetorë bashkëpërshtaten me kundranorin në po ato kategori gramatikore si edhe mbaresat foljore me nënanën (kryefjalën), pra edhe ato vihen në ekstrapozicion, si do të thoshte O. Jesperseni, i cili lidhjen sintaksore të përshtatjes e quante *enigmë*, dhe është i pari që bën dallimin përshtatje,- e plotë, në të gjitha kategoritë e përbashkëta, ose e pjesshme, vetëm në disa kategori të përbashkëta të dy elementeve me lidhje nënrenditëse,- dhe ekstrapozicion, që në e japim me skajin *bashkëpërshtatje*.

E në u pranofte se të ashtuquajturat trajta të shkurtëra të përemrave vetorë vihen në ekstrapozicion, atëherë shtrohet diktueshëm problemi i zgjedhimit subjektor-objektor.

Gjuhësia e përgjithshme njuh gjuhë vetëm me një zgjedhim nënanor (subjektor), ku është përfshirë edhe gjuha shqipe dhe gjuhë me dy zgjedhime të tjera, ku përveç zgjedhimit nënanoror, ka edhe një zgjedhim tjetër kundranor (objektor ose të shquar) ku bëjnë pjesë, gjuhët ugro-fine, si, p.sh., hungarishtja, dhe një zgjedhim nënanor-kundranor, ku janë përfshirë gjuhë familjesh të tjera. Punët janë më të ndërlikuara se kaq. Ne dhamë vetëm një përshkrim të thjeshtuar skajshëm.

Gjendja që paraqet gjuha shqipe sot, sa i takon zgjedhimit të foljes, nuk mund të futet as vetëm te zgjedhimi nënanor, si del nga sa u rrekëm të provojmë deri këtu, as vetëm te zgjedhimi kundranor, as edhe te ai nënanor-kundranor, ashtu si njihet nga gjuhësia e përgjithshme¹⁴. Zgjedhimi

¹⁴ Përveç shumë botimeve të bollshme të shkollës gjuhësore të San-Peterburgut, kemi shfrytëzuar me dobi edhe shkrimet e Zhan Perrosë (Jean Perrot), *Conjugaison subjective et conjugaison objective: un imbroglio morpho-syntaxique et historico-descriptif de la linguistique finno-ougrienne*, **Etudes finno-ougriennes**, t. 15, 1982, f. 261-271; *La double conjugaison (subjective et objective) dans les langues finno-ougriennes: aperçu des problèmes*, **Lalies**, 1984, 25-32; *La rela-*

që njih shqipja është nënanor, por nga fryma edhe kundranor, ndaj duhet folur për zgjedhim nënanor-kundranor *sui generis*.

Pse *sui generis*? Sepse të ashtuquajturat trajta të shkurtëra të përemrave vetorë kanë ose janë duke kaluar nga stadi aglutinativ i të ashtuquajturave trajta të shkurtëra të përemrave vetorë në atë fleksional, pikërisht se shenjojnë vetën e kundranorit.

Dhe ja tani si do të dilnin paradigmat e zgjedhimit të foljes në shqipen e sotme :

Pjesa nënanore e zgjedhimit nënanor-kundranor :

(unë)	puno- j
(ti)	puno- n
(ai, ajo)	puno- n
(ne)	puno- jmë
(ju)	puno- ni
(ata, ato)	puno- jnë

Pjesa kundranore e zgjedhimit nënanor-kundranor :

Më ftoi	(mua)
Të ftoi	(ty)
E ftoi	(atë)
Na ftoi	(ne)
Ju ftoi	(ju)
I ftoi	(ata, ato)
Më thotë	(mua)
Të thotë	(ty)
I thotë	(atij, asaj)
Na thotë	(neve)
Ju thotë	(juve)
U thotë	(atyre)

Zgjedhimi nënanor-kundranor¹⁵ :

(ai, ajo) më fton	(mua)
(ai, ajo) të fton	(ty)
(ai, ajo) e fton	(atë)

tion objectale et ses corrélats: quelques données des langues ouraliennes, La transitivité, Lille, 1998.

¹⁵ Pjesa subjektore u zgjedh vetëm në numrin njëjës, dhe në vetën e tretë, sepse jep më shumë mundësi kombinuere se veta e parë dhe e dytë.

(ai, ajo) na fton	(ne)
(ai, ajo) ju fton	(ju)
(ai, ajo) i fton	(ata, ato)
(ai, ajo) më shkruan	(mua)
(ai, ajo) të shkruan	(ty)
(ai, ajo) i shkruan	(atij, asaj)
(ai, ajo) na shkruan	(neve)
(ai, ajo) ju shkruan	(juve)
(ai, ajo) u shkruan	(atyre)

E kështu me radhë.

* * *

Mohimi i natyrës fjalore dhe përemërore të bashkësisë së të ashtuquajturave trajta të shkurtëra të përemrave vetorë dhe pranimi i tyre si morfema që çon diktueshëm në zgjedhim nënanor-kundranor në gjuhën e sotme shqipe është me pasoja të mëdha largvajtëse për trajtimin teorik dhe praktik të gramatikës së gjuhës së sotme shqipe, sidomos për sintaksën e saj.

Kështu, p.sh., marrëdhëniet predikative duhen parë jo si lidhje kallëzuesore e nënanës më kallëzuesin, por, së paku, si lidhje midis nënanës, kallëzuesit e kundranës njëherazi, çka tipologjia e gjuhëve e ka dhënë me formulën SVO. E në u dashtë t'i mbetemi besnikë analizës tradicionale strukturore, atëherë duhet të kalohet nga skema dyjare nënanë+kallëzues në lidhjen tjetër dyjare: nënanë + (kallëzues+kundranë), çka tipologjikisht do të jepej me skemën: S-VO, Si shihet, predikatimi i fundit është nënanë + (kallëzues+kundranë), para tij ka pasur predikatim tjetër: kallëzues+kundranë. Duket tani më qartë se logjika rrafshore e Aristotelit me nominalizimet e veta është e pamjaftueshme për të shpjeguar ndërtimin e gjuhëve; duhet logjikë tjetër, logjikë vëllimore.

Rrjedhojë e pranimit të zgjedhimit nënanor-kundranor *sui generis* për shqipen do të ishte, ndër të tjera, edhe rivështrimi i kategorisë sintaksore të gjymtyrës së fjalisë, po të vazhdojmë t'i mbahemi asaj, sidomos ndarja në gjymtyrë kryesore dhe të dyta, do të shtronte veçanërisht problemin e kundranorit si gjymtyrë të dytë, të ndryshme nga nënanori që ka tradita dhe jo si gjymtyrë kryesore si edhe nënanori si e kërkon zgjedhimi subjektor-objektor.

Ka edhe shumë e shumë rrjedhoja të tjera, që kërkojnë rivështrim sistemor tërësor të ndërtimit gramatikor të gjuhës shqipe, të çli-ruar nga imperializmi indoeuropian tradicional.

Leonardo M. SAVOIA - Maria Rita MANZINI, Università di Firenze

CASE AS DENOTATIONAL PROPERTY: THE INTERACTION
OF DOM AND DISCOURSE-LINKING IN SHKODËR
PRONOUNS

Abstract

1. Starting point. In the minimalist approach (Chomsky 1995 ff.) syntactic structures are projected from lexical specifications, corresponding to intrinsic properties of lexical items. Denotational primitives of argumental constituents as Number and person are real (ϕ -)features. However relations, such as theta-roles, are not features at all, but correspond to configurations. Therefore, it is potentially problematic to assimilate case, which is traditionally conceived of as a relational notion, to a feature. The solution formulated in Chomsky (2001, 2008) is to deny that case is a primitive of grammar. Rather, the real underlying relation between Case assigner and Case assignee is an agreement relation, involving ϕ -features; case is but a reflex of this relation on nominal constituents (cf. also Pesetsky & Torrego 2004, 2007). Pursuing Chomsky's program, we argue that the traditional label of case in reality corresponds to denotational primitives, such as nominal class, definiteness, quantification (Manzini & Savoia 2011, in press).

2. The data. As generally in Albanian varieties, in the Geg of *Shkodër*, examined here, indefinite nouns distinguish oblique from nominative-accusative; definite nouns distinguish three case forms in the singular (nominative, oblique and accusative) and two forms in the plural (nominative-accusative vs. oblique) (Manzini & Savoia 2011). This paradigm applies to 3rd person pronouns as well, as illustrated in (1). In particular, the accusative, i.e. the case of the internal argument of transitives, is distinct from the oblique, which marks both the goal/ possessor in ditransitive contexts and the argument of (some) locative prepositions. A different distribution of cases is shown by 1st /2nd pronouns. 1st/2nd singular pronouns in (2) distinguish the nominative from an objective case, covering the accusative, the dative (cf. (3i)), and a subset of prepositional contexts (e.g. *mE* 'with') as exemplified in (3ii). This latter form is separated from the ablative, associated with prepositional contexts, as in (4c). There are specialized possessive pronouns for genitive contexts.

(1) **Nom Acc Obl Abl**

3sg ai/aja atE atij atij

3pl ata ata asAj asAj

(2) **Nom Obj Abl**

1sg un mu mej-E-t

2sg ti ty tej-E-t

1pl na ne ne-S

2pl ju ju ju-S

(3) i. E / m@ / na SOfin a"tE / mu / ne

him/ to-me/ to-us they.see him / to.me / to.us

ii. j a / m a / n a japin a"tij / mu / ne

to-him it / to-me it/ to-us it they.give to.him / to.me / to.us

(4) a. **Prep – Nom** b. **Prep –Obj/ 3rdAcc** c. **Prep –Abl/3rdObl** tE un / ti / ai mE mu / ty / atE pRei/ poSt/ para mej-E-t/ nE-S / atij at I / you / he with to-me/to-you/ him from/ behind/ before me / us / him

3. DOM and discourse-linking properties. The major question raised by the examples in (1)-(4) is why 1st / 2nd person referents (speaker, hearer) are associated with a specialized array of ‘cases’ with respect to other (3rd person) referents. This is of course a manifestation of the classical 1st /2nd vs. 3rd split. Three principal types of split show up: 3rd person (nouns included) vs. 1st and 2nd person; 1st and 2nd singular vs. 1st and 2nd plural; 1st vs. 2nd. To begin with, 1st and 2nd person pronouns systematically put together all types of objects (first argument of transitives, goal/ possessor of ditransitives, argument of prepositions). In other words, there is no specialized exponent for 1st/2nd accusative and the first argument of a transitive is marked as a dative/ locative complement, recalling the phenomenon studied as Differential Object Marking (DOM) in typological literature (cf. Aissen 2003). Interestingly, the coincidence of 1st/2nd plural with the noun system is only apparent, since the oblique forms in (2ii) include the internal argument of transitives as well, thus contrasting with nouns, which select the specialized accusative in this context. The gist of DOM is that certain types of referents, of which participants in the discourse are the fundamental subset, are associated with certain roles in the event: agent, possessor (i.e. ‘dative’ or ‘oblique’), but not theme (i.e. ‘accusative’).

DOM morphosyntax can be seen as a reflection of the intrinsic denotational force of these lexical elements. As for 1st/2nd person, their denotation is fixed in virtue of their being coordinates of the universe of discourse, without necessarily making reference to the structure of the event. By contrast, the reference of 3rd person lexical elements is not directly anchored at the universe of discourse – but rather is mediated by anchoring in the event structure (cf. Manzini & Savoia 2005, 2007, 2008). The insertion of specialized 1st/2nd (case) forms in arbëresh varieties suggests that 1st/ 2nd person cannot be embedded as the internal argument of an event.

Rather, their merging in the sentence requires the oblique form associated with ‘possession’ or ‘zonal inclusion’ (Belvin & den Dikken 1997). In other words, 1st and 2nd person intrinsically are possible source of the event (‘nominative’) or ‘possessors’, ‘including’ (a part of) the event.

4. *What does case externalize?* The preceding discussion implies that there is a link between DOM phenomena and case syncretism illustrated in (2), where an unique exponent (Obj) includes accusative, dative and oblique. Following Manzini & Savoia *in press*, 2011, we can trace the further syncretism between dative and locative back to the conceptual closeness of the notions of possessor (here 'zonal' inclusion) and location (Freeze 1992, Belvin & Den Dikken 1997), which is well-known in the typological literature. In present terms this conceptual closeness corresponds fundamentally to inclusion, that we characterize as the quantificational property $Q(\acute{I})$, i.e. superset-of. This can explain the fact that the same specialized form shows up also in prepositional contexts; the preposition introduces a dyadic relation between its complement and some argument of the matrix predicate, where the former is construed as the inclusive location of the latter. This means that the nominal properties of 1st/2nd person pronouns automatically entail a superset-of/ location relation, creating the DOM distribution (cf. (3i, ii), (4)). Only 3rd person elements, as in (3i), yield a canonical transitive event structure comprising an agent and a theme. In short, therefore the treatment of case that we are sketching is that case externalizes lexical properties associated to argumental environments. As for 1st /2nd person, we can associate the specialized lexical bases, such as *mu* 'to.me', or the specialized inflections to the concept of location/ superset-of; the (1st / 2nd) nominal class as one of its defining properties assigns locative/ superset-of properties to the referents introduced in the event. Consider now prepositional phrases. The fact that prepositional phrases license all cases that sentences do, would appear to be incompatible with the idea that prepositions assign a specialized Oblique case in the sense of Chomsky (1995). The question then arises which properties govern the selection of different cases by different prepositions (cf. Pesetsky & Torrego 2004). A morphological model like Distributed Morphology could solve the incompatibility of data such as (4) with the Oblique case by assuming rules like that of Impoverishment which create a surface form distinct from a more abstract categorial stratum. Within the present approach, we can say that 3rd accusative forms lexicalize the internal argument of the prepositions whose contexts behave like those defined by transitive active verbs. In these contexts 1st/2nd persons introduce their unique objective form in the terms of the DOM distribution just examined, as in (4). The prepositional contexts requiring the so-called nominative in (4a), provide a clue that case coincides with denotational properties, concurring to the fixing of argument reference. In particular, so-called nominative inflections are of course associated with contexts where they are in the scope of the D argument of the sentence (the finite verb inflection). Prepositions like *tE* in (4a) then select inflections with the same denotational properties found in the scope of D; these are the properties relevant for fixing the reference of their internal argument. In *Shkodër* an ablative specialized morphology appears on the 1st / 2nd person singular in locative contexts. We propose therefore that what 1st and 2nd persons have in common with locatives, is precisely the connection with the universe of discourse. The existence of a differentiated case in 1st / 2nd person

pronouns takes us back to the question raised by the examples in (1)-(4) – namely why 1st / 2nd person referents (speaker, hearer) are associated with a specialized array of ‘cases’. The particular shape that the splits take has richer case specifications associated with the lexical bases denoting elements of the universe of discourse (with maximally specific denotation, i.e. ‘hearer’ and ‘speaker’). In other words, this systems are sensitive to the capability of these element to fix denotation independently of the structure of the event.

1. Some theoretical points

Recent theoretical debate concerning the notions of Faculty of Language (FL) and Universal Grammar (UG) raises questions as to the status of the grammatical categories normally assumed in linguistic analysis. If we admit that the linguistic capability of humans has a genetic basis, FL, it remains to ask what the notion of UG refers to. The content of UG and the adequacy of the traditional categorial distinctions represent two sides of the same coin, what we can think of as a sort of ‘orthodox generative synthesis’.

The crucial point is that in the traditional framework, categories correspond to real Platonic objects, entirely listed in UG. Culicover & Jackendoff (2005: 6) aptly characterize a particularly popular conception of the relation of the semantics to the syntax as ‘Interface Uniformity’. In other words, much current theorizing assumes a picture where syntax includes interpretation, whereby all relevant semantic information finds itself translated into syntactic structure.

Many authors, from different perspectives, consider this solution inadequate to allow for the extent of linguistic variation, trying to provide the notion of UG with a more defensible characterization. Evans & Levinson (2009) get to the point of asserting that linguistic diversity makes the existence of linguistic universals and, in particular, the notion of UG into a myth, devoid of explanatory power. We think that this conclusion is in many cases questionable, and frankly ideological, in turn. Rather, we agree with Culicover & Jackendoff (2006: 416) on the idea that interpretation is ‘the product of an autonomous combinatorial capacity independent of and richer than syntax’, ‘largely coextensive with thought’, which syntax simply restricts in crucial ways.

Let us briefly review some key conceptual points. According to Chomsky (2000: 119), ‘the human language faculty and the (I-) languages

that are manifestations of it qualify as natural objects'. This approach - that 'regards the language faculty as an "organ of the body"' - has been labelled the 'biolinguistic perspective' by Chomsky (2005: 1). Hauser, Chomsky & Fitch (2002: 1570) base their discussion of the key biological question of evolution on the 'biologically and individually grounded' use of the term language 'to refer to an internal component of the mind/ brain (sometimes called "internal language" or "I-language")'. They distinguish two conceptions of the faculty of language, one broader (FLB) and one narrower (FLN):

FLB includes FLN combined with at least two other organism-internal systems, which we call "sensory-motor" and "conceptual-intentional"... A key component of FLN is a computational system (narrow syntax) that generates internal representations and maps them into the sensory-motor interface by the phonological system and into the conceptual-intentional interface by the (formal) semantics system ... Most, if not all, of FLB is based on mechanisms shared with nonhuman animals ... (Hauser, Chomsky & Fitch 2002: 1571).

We can wonder in what sense the role of FLN and FLB interact in domains such as language evolution, genetics, neurology, specifically as regards the issue of language variation, starting with the idea that:

There is a reason to believe that It may be that the computational system itself is (virtually) invariant, fixed by innate biological endowment, variation among languages and language types being limited to certain options in the lexicon; quite restricted options ... (Chomsky 2000:79)

In fact, we know that there exist languages that seem to cast a shadow over the more crucial tenets of FL/UG, like recursion/ embedding (Evans & Levinson 2009, Pinker & Jackendoff 2009, Everett 2005) or fundamental categorial distinctions like noun and verb (Jelinek 1995). This suggests that the traditional notion of UG, as the container of a fixed list of categories, must be revised; we can think that UG simply refers to a conceptual (and phonetic) space which establishes the boundaries of linguistic variation. In the present study we address the issue of how the linguistically relevant conceptual space yields different languages beyond the obvious aspect of 'Saussurean arbitrariness'.

Suppose that the lexicon is the locus of linguistic variation – in the presence of an invariant repertory of interface primitives, both phonological and conceptual. Non-trivial questions arise here: how can the lexicon vary on the basis of a universal inventory of properties (or "features")? and how come that variation in the lexicon has as its con-

sequence variation in order, agreement, selection, and other syntactically relevant relations? A possible answer which is pursued by various scholars is that there is a fundamental distinction between functional and non-functional elements. Thus within the Distributed Morphology framework, Embick (2000:187) assumes a ‘distinction between the functional and lexical vocabularies of a language... functional categories merely instantiate sets of abstract syntacticosemantic features’, on which the derivational component operates. Variation is the result of the different ways of lexicalizing these abstract categorial primitives.

In Manzini & Savoia (2005, 2007, 2008, 2011) we pursue a different picture, where morphosyntactic structures are projected from lexical terminals. There is a conceptual and grammatical space to be lexicalized and variation results from the different partition of that space. There is no fixed functional lexicon which varies along the axis of overt vs. covert realization – so-called functional space is just like all other conceptual space, and all lexical entries are overt. Thus the distinction between functional, i.e. grammatical, contents and conceptual ones is an external one; as such it is at best useless, while at worst it obscures the real underlying linguistic generalizations. In short, the lexicons of the different languages are formed on this universal basis, covering slightly different extensions of it and in slightly different ways.

In this sense, linguistic variation depends on which pieces of the universal conceptual space and of an invariant repertory of interface primitives, the language-specific lexicon is able to externalize. It is the ‘externalization’ processes (Berwick & Chomsky 2011) that creates the space of the variation. In this line of thought, the comparison between two Albanian varieties presented in this work can contribute to an understanding of the mechanisms underlying and feeding the morpho-syntactic component of FL/UG.

1.1. The notion of case

Consider the notion of case in syntactic theory. In the minimalist approach of Chomsky (1995 ff.) syntactic structures are projected from lexical specifications – and the latter correspond to intrinsic properties of lexical items. Properties of number and person, that correspond to denotational primitives of argumental constituents, are taught

of as real features, namely phi-features. However relations, such as theta-roles, are not features at all, but correspond to configurations. Therefore, it is potentially problematic to assimilate case, which is traditionally conceived of as a relational notion, to a feature. The fact that case is the only feature in Chomsky (1995) which is radically uninterpretable (i.e. which does not have an interpretable counterpart) is a reflex of the deeper difficulty of reconciling its relational core with its feature status. The solution at which Chomsky (2008) arrives is effectively to deny that case has a primitive relational content. In technical terms case does not enter into any feature checking. We agree with the idea that case cannot be a primitive of grammar. However, if case is reduced to other primitives, why do we need to keep the case label at all? In other words: what is the difference between a language which has just agreement (say, Italian) and a language like Latin which has the ‘case’ reflex of agreement?

Works such as Chomsky’s, or Pesetsky and Torrego’s 2007 consider so-called ‘abstract’ case, i.e. a case property independent of morphological realization, and as such found (by hypothesis) in all languages. In turn, case inflections have been the target of morphological discussion, in particular in relation to syncretic morphology. If we maintain a syntactic level including abstract case features, the effect of syncretic forms exist is just to conceal the semantic properties that should be expressed by them.

In the standard morphological implementation of minimalist syntax, namely Distributed Morphology (Halle & Marantz 1993, 1994, Calabrese 1998), case and phi-features are functional properties, as such undergoing morphological rules. In DM the syntax operates on abstract bundles of features to which Vocabulary Insertion associates lexical terminals, i.e. ‘exponents’, only after morphological rules have applied (*Late Insertion*). One of the results of these morphological operations is the creation of syncretic surface forms. A good illustration is provided by the analysis of the two-case system (nominative vs. objective) of Old French in Calabrese 1998. The case inflection of the nouns deriving from the II nominal class of Latin present a crossed distribution, whereby the same inflection *-s* puts together nominative singular and accusative plural, e.g. *mur-s* ‘wall/walls’, as opposed to \emptyset of nominative plural and accusative singular,

e.g. *mur*∅. According to Calabrese 1998 the syntactic representation of these forms includes a complete case specification, i.e. [+subject, +direct] for nominative and [-subject,+direct] for accusative, but vocabulary insertion depends on underspecified lexical element, which register only the [+/-plural] difference.

More precisely, case exponents are introduced by the two rules in (1a, b), which apply to the result of two Morphological rules of readjustment. In particular, (1c) impoverishes the content of syntactic representation by deleting [-plural] in the context [+subject, II, III class]; (1d) changes the value of the feature [+plural] in the context [+subject, II class]. Impoverishment (1c) feeds (1b), in the sense that (1a) can no longer apply to a representation devoid of the feature [-plural] so that (1b) will introduce the default ending *-s*. Feature change (1d) creates a representation which undergoes (1a).

(1) (Calabrese 1998: 117)

- a. ∅ ↔ ∅_{ThematicVowel} [-plural]
- b. -s ↔ *Elsewhere*
- c. Impoverishment
[-plural] ↔ ∅ / [____, +subject, II, III class]
- d. Feature change
[+plural] ↔ [-plural] / [____, +subject, II class]

The result of the system in (1) is that syncretic morphology is only based on the [+/-plural] feature and the underlying case specifications are completely obscured.

What interests us here directly is that under the Distributed Morphology approach, a morpheme traditionally associated with case, e.g. nominative, turns out not to have any such property, but only a [+/- plural] denotation. In general, in case-inflected languages, the presence of morphological entries associated with several case contexts (i.e. syncretic in traditional terms) leads to the conclusion that these case morphologies have a purely denotational content, devoid of case properties, and associated only with nominal class, number, possibly definiteness, etc. As we will see, the conclusion that case properties depend on nominal denotational features is reached also in other theoretical framework, for instance in the literature on Person Case Constraints (PCC) effects (Adger & Harbour 2007).

2. The data.

As generally in Albanian varieties, in the Geg of Shkodër indefinite nouns distinguish nominative-accusative from oblique, and, in the plural nominative-accusative, oblique and ablative-locative; definite nouns have nominative, oblique and accusative in the singular (Camaj 1984, Beci 2004). This definite case system is illustrated by by 3rd person pronouns, as in (2).

(2)	<i>Nom</i>	<i>Acc</i>	<i>Obl</i>
	3sg a-i/a'j-a	a't-ε	a't-i-j / a's-a-j
	3pl a't-a	a't-a	a't-y-ne

A different distribution of cases characterises 1st / 2nd pronouns in (3), where objective case covers the accusative, exemplified in (4i), the dative, exemplified in (4ii), and a subset of prepositional contexts (e.g. *me* 'with') as exemplified in (5ii). This latter form is separated from the ablative, also associated with prepositional contexts, as exemplified in (5iii).

(3)	<i>Nom</i>	<i>Obj</i>	<i>Abl</i>
	1sg un	m-u	mej-ε-t
	2sg t-i	t-y	tej-ε-t
	1pl n-a	n-e	ne-ʃ
	2pl ju	ju	ju-ʃ

- (4) i. ε / mə / na ʃəfin a'tε / mu / ne
 him/to.me/to.us they.see him/to.me/to.us
 'They see him/ me/ us'
 ii. j / m / n a japin a'tij / mu / ne
 to.him/to.me/to.us it they.give to.him/to.me/to.us
 'They give it to him/ me/ us'

- (5) i. P – Nominative
 tε un / ti / ai
 at I/ you/ he
 ii. P – Objective/ 3rd Accusative
 mε mu / ty / atε
 with me/ you/ him
 iii. P – Ablative / 3rd Oblique
 prei/ poʃt/ para mejet/ nε-ʃ / atij
 from/ behind/ before me / us / him

In many of the Arbëresh varieties of Italy the pronominal para-

digm presents a more reduced case system. For example, in the grammar of Greci (Campania) the three-case system characterizes 3rd person pronouns in (6i), but in the 1st and 2nd person a more reduced system shows up, as in (6ii, iii). In particular, 1st singular person only distinguishes a nominative and an objective case which encompasses accusative and oblique/ablative meanings; 2nd singular has a sole synthetic form. 1st/2nd plural pronouns in (6iii) separate an accusative from an oblique form, whose distribution is however different from those in the 3rd person. In fact, Greci's accusative *ne/ ju* are restricted to some prepositional contexts, as in (8ii). Oblique *neui/ juvui* are inserted in other verbal and prepositional contexts, as in (7i, ii) and (8iii), except for nominative context, like (8i).

(6) Greci

i. Nom Acc Obl
 3sg a-i/a-jɔ at-ə at-i-a / asa-i-ta
 3pl at-a at-a at-i-rv-ui

ii. Nom Obj
 1sg u m-ua
 2sg t-i t-i

iii. Nom Acc Obl
 1pl n-a n-e ne-ui
 2pl ju ju ju-v-ui

(7) i. *ʃehan atə / mua / juvui*

he.sees him / to.me / to.you
 'He sees him/me/you'

ii. *j / m / v a jəpan atia / mua / juvui*

to.him/to.me/to.you it he.gives to.him/to.me/to.you
 'He gives it to him/me/you'

(8) i. P – Nom

ka ai / u / ju
 at he / I / you

ii. P – Acc/ 1st/2ndsgObj

ma atə / mua / ne
 with him / to.me/ us

iii. P – Obl/ 1st/2ndsgObj

para atia / mua / neui before to.him/ me / us

3. DOM and discourse-linking properties.

The major question raised by the examples in (2)-(8) is why 1st/2nd person referents (speaker, hearer) are associated with a specialized array of ‘cases’ with respect to other (3rd person) referents. We can think of this distribution as a manifestation of the classical 1st/2nd vs. 3rd split. In our data, three principal types of split show up: 3rd person (nouns included) vs. 1st and 2nd person; 1st and 2nd singular vs. 1st and 2nd plural (Greci); 1st vs. 2nd (Greci).

To begin with, 1st and 2nd person pronouns unify all types of verbal objects (first arguments of transitives and goals/ possessors of ditransitives) as well as arguments of prepositions. As hinted at by our glosses, we conclude that there is no specialized morphological exponent for 1st/2nd accusative and the first argument of a transitive is marked as a dative/ locative complement, as an instance of the phenomenon known as Differential Object Marking (DOM) in typological literature (cf. Aissen 2003). The gist of DOM is that certain types of referents, of which participants in the discourse are the fundamental subset, are associated with the agent role (i.e. ‘nominative’) or the possessor role (i.e. ‘dative’ or ‘oblique’) in the event, but not with the theme role (i.e. ‘accusative’). In Albanian varieties 1st/ 2nd person cannot be embedded as the theme of an event, but they require the oblique form associated with the possessor.

Let us clarify our conception of so-called oblique. Consider the syncretism between dative, locative and genitive attested in *Shkodër* by the *-ij* of 3rd singular pronouns inflection in (2). Manzini & Savoia (2011, 2011a), explain it by assuming that a single quantificational property, namely inclusion/superset-of $Q(\subseteq)$, is associated with the different interpretations. In particular, Manzini & Savoia (2011) argue that we can take all types of possession, hence of ‘genitive’, including inalienable and psych state possession to fall under a reasonable extension of the same relation. This proposal is close to that advanced by Belvin & den Dikken (1997:170) according to whom ‘Entities have various zones associated with them, such that an object or eventuality may be included in a zone associated with an entity without being physically contained in that entity... The type of zones which may be associated with an entity will vary with the entity’. In turn, the conceptual closeness of the notions of possessor to both ‘dative’ and

‘locative’ is well-known in the typological literature. This conceptual closeness, mirrored by the syncretic ‘oblique’, corresponds fundamentally to inclusion, in present terms to $Q(\subseteq)$.

Despite the strong split between 3rd person and 1st/2nd singular that we observe in Greci, 1st/2nd plural at least partially pattern with 3rd person. This can be derived from the fact that 1st/2nd plural, like 3rd person, involve individuals which are different from speaker and hearer. On the other hand the coincidence of 1st/2nd plural with the noun/3rd person system is only apparent, since the oblique forms in (6iii) appear as the internal argument of transitives as well, thus contrasting with nouns/ 3rd person pronouns, which select the specialized accusative in this context.

In short, the referential properties of 1st / 2nd person entail an inclusion/ location relation to other arguments/ events in the semantic space. In Romance varieties that have ‘prepositional accusatives’, like Spanish, Romanian and Southern Italian dialects, the same interpretive relation is externalized by means of a locative/ directional preposition *a* ‘to’. In general, DOM morphosyntax appears to be a reflection of the intrinsic denotational force of these lexical elements. The reference of 3rd person lexical elements is not directly anchored at the universe of discourse, but it is mediated by anchoring in the event structure (cf. Manzini & Savoia 2005, 2007, 2008). By contrast, the denotation of 1st/2nd person is fixed in virtue of their being coordinates of the universe of discourse, without necessarily making reference to the structure of the event. Their merging in the sentence requires the oblique form associated with ‘possession’ or ‘zonal inclusion’ in the sense just discussed. In other words, 1st and 2nd person intrinsically are sources/ agents of the event (‘nominative’) or ‘possessors’ ‘including’ (a part of) the event.

4. Is case a spurious notion?

DOM morphosyntax can be connected with the ‘referential/ person/ animacy hierarchy’ (Nichols 2001): 1st person > 2nd person > 3rd person animate > 3d person inanimate. Specifically, in many languages the Object cannot outrank the Subject in the hierarchy, in the sense that for example a sequence 3rd subj – 1st object is either excluded or morphologically marked. Our data, in particular the externalization of 1st/2nd person as dative/ oblique, can be connected with the

hypothesis (Nichols 2001) that dative is a last resort strategy aimed at avoiding the configuration in which a 1st/2nd person object combines with a 3rd person (or an equally ranked) subject.

A related observation is that case syncretism between accusative and dative in 1st/2nd pronouns feeds the Person Case Constraint (PCC). The constraint usually observed is restricted to clitic or inflectional elements and prevents 1st/2nd person accusative from combining with 3rd person datives (Bejar & Rezac 2003, 2009, Adger & Harbour 2007). The PCC is at work also in Albanian, as for instance in (9i)-(9ii). In the *Shkodër* variety 1st/2nd sg. clitics have an accusative/ dative syncretic form *m/t*, while 3rd person clitics distinguish singular Acc *ε/a* from Dat and Acc. pl. *i*. The co-occurrence of a 1st/2nd clitic with dative or another 1st/2nd clitic is excluded. A similar exclusion is in force in *Greci*.

- (9) i. *ai m i ka prezan¹tu: *Shkodër*
 *ai m i prəzəntuacən *Greci*
 he to.me to.him (has) introduced
 ii. *m tə ka prezan¹tu: *Shkodër*
 to.me to.you he.has introduced

In this connection, we can consider the variation between Geg data and Arbëresh data. In *Shkodër* the combination between strong 1st/2nd pronouns is only marginally possible, as in (10i). The sequence 1st/2nd pronouns - 3rd dative is excluded, as in (10ii).

- (10) *Shkodër*
 i. ai m/ t ka prezan¹tu ?mu: ty / ?? ty mu:
 he to.me/to.you has introduced me to.you/ you to.me
 ii. ai ka prezan¹tu *mu:/ ty atij /asqj
 he has introduced me/ you to.him/to.her

Normally two 1st/2nd objective arguments are admitted only if the goal argument is introduced by a locative element, as in (11i). (11ii) illustrates the combination *person pronoun - 3rd person locative*

- (11) *Shkodër*
 i. m/ t kan prezan¹tu: mu: tɛ ti / ty tɛ un
 to.me/to.you they.have introduced me at you/you at I
 ii. m/ t kan prezan¹tu: mu:/ ty tɛ ai
 to.me/to.you they.have introduced me/you at he

The insertion of a 1st/2nd is allowed of in the context of a 3rd person internal argument, as in (12), where the locative is correspondingly excluded.

(12) *Shkodër*

m/t a kan prezan¹tu: a'te mu:/ ty /*tε un/ ti
to.me/to.you him they.have introduced him to.me/you/at I/you

In (12) it is the presence of 1st/2nd clitics associated to the goal/ possessor argument that calls for the oblique form of the strong pronouns. Locative is realized if the 1st/2nd clitic is not inserted, as in (13). This is consistent with the fact that in (11) locative occurs, since the clitic cluster $I^{st}/2^{nd}/3^{rd}_{Dat} - I^{st}/2^{nd}_{Acc}$ is banned.

(13) *Shkodër*

ε kan prezan¹tu: a'te tε un/ ti
him they. have introduced him at me/ you

By contrast, in *Greci*, the combination between strong pronouns, as in (14i,ii), is normally accepted.

(14) *Greci*

i. mə prəzəntəci mua ti
me he.introduced me to.you
ii. mə / a prəzəntəci mua atirvui / atə mua
me/him he.introduced me to.them / him to.me

A fundamental point is that the literature on referential hierarchy phenomena, to which our data can be ascribed, and the constraints on the distribution of case morphology (PCC) entail referring to intrinsic denotational properties of the involved elements (pronouns, agreement morphemes). In particular, the PCC is related to an effect of competition in person feature checking. Adger & Harbour (2007) assume that in the internal argument position of a ditransitive verb, only a 3rd person can occur, because devoid of [participant] features – while 1st/2nd person pronouns are excluded. To reiterate, a significant point emerges from the works on referential hierarchy/ PCC phenomena, to which we subscribe. That is, the constraints on the distribution of case morphology (hence the PCC) entails reference to intrinsic denotational properties of the elements involved (pronouns, agreement morphemes), while the notion of case is effectively not involved.

We noted that there is a link between referential hierarchy phenomena and case inflection syncretism, as in (3). As we have seen, this corresponds to the fact that, unlike 3rd person elements, syncretic forms of 1st/2nd person pronouns exclude the canonical transitive event structure comprising an agent and a theme, creating the DOM distribution (cf. (4), (7)). Only 3rd person elements, as in (4i), yield a canonical transitive event structure comprising an agent and a theme.


5. What does case inflection externalize within a lexicalist model?

In the present approach, syntactic and semantic content is directly imputed to morphological entries. They specify a mapping between sound and meaning (cf. Jackendoff 2002), without having recourse to a morphological buffer (as in DM) between syntactic nodes and the exponents that instantiate them. Argumental lexical items (nouns) are associated just with denotational properties that characterize them independently of the position of insertion. We recognize three fundamental types of properties as theoretically relevant for case and nominal inflection, namely N(ominal class), Q(uantification), D(efiniteness). Q inflections are responsible for the so-called oblique case – effectively a dyadic operator yielding a ‘zonal inclusion’ (possession) relation between the element to which it attaches and the internal argument of the verb (dative) or the head of a noun phrase (genitive). Q inflections are further responsible for plurality, while N inflections satisfy argument-of contexts (accusative) and D characterizes EPP contexts (nominative).

In a language with no ‘case’ on nouns, like Italian, the so-called agreement inflection of the noun phrase can be analysed as a structure in which the lexical base, indicated as $\sqrt{\quad}$ (root), expressing predicative content, combines with a nominal class (gender) N inflection, associated with the internal argument of the predicative base, as in $[[\text{macchin}_{\sqrt{\quad}}]a_N]$. If the traditional labels of case in reality correspond to denotational primitives such as nominal class (gender), definiteness, quantification, we are induced to assume that case languages like Latin or Albanian/ Arbëresh are not qualitatively different systems with respect to Italian but only slightly richer systems. More precisely, the so-called case inflection is an inflection with denotational content (nominal class, quantification etc.) specialized for the satisfaction of certain syntactic junctures (agreement, but also theta-configuration, or other). Case is but the name given to lexical items which

in virtue of these properties specialize for the satisfaction of certain syntactic environments.

Consider for instance *Shkodër*, where a syncretic 3rd singular pronoun inflection *-ij* lexicalizes dative, locative and genitive, as illustrated in (2). Following the discussion in section 3, *-ij* introduces a superset-of reading corresponding to dative/ locative/ genitive in relation with certain contexts of insertion. A more detailed analysis can decompose *-ij* in the nominal class formative *-i-* which occurs in the morphology of nouns as well, and the quantificational element *-j*, as suggested in (15).



In the dative interpretation, we take the superset-of reading of *-j* to depend on the sentential scope of $Q(\subseteq)$. In the genitive reading, the $Q(\subseteq)$ specifications of *-j* take in their scope the head noun of the phrase. In the locative interpretation the scope of $Q(\subseteq)$ is the sub-event introduced by the preposition. Thus, the notion of case reduces to denotational primitives (person, nominal class, definiteness, quantification), associated with the relevant lexical entries in accordance with the general theory of the lexicon just outlined. Different denotational properties satisfy different interpretive environments. The constraints on the distribution of the morphology are effectively treated as emergent properties of the lexical elements – not the lexical elements as an emergent property of the constraints.

6. Prepositional contexts.

The fact that prepositional phrases license all cases that sentences do, appears to be incompatible with the idea that prepositions assign a specialized Oblique case in the sense of Chomsky (1995). Consider first the prepositions selecting accusative in the 3rd person. Prepositions are always two place predicates whose internal argument is their complement, while the external argument is controlled by some argument of the matrix predicate. Therefore, prepositional contexts with accusative behave like

those defined by transitive active verbs, in that the internal argument is satisfied, by the specialized N morphology of nouns (-*n*) or of 3rd person pronouns corresponding to the traditional ‘accusative’ in the terms of Manzini & Savoia (2011, 2011a). As we can expect, 1st / 2nd singular person pronouns are characterized by the DOM morphology occurring in transitive contexts: the prepositional domain is conceptualized as being ‘possessed’/ ‘included’ by 1st/ 2nd person. Note however that 2nd plurals introduce the same form occurring in EPP context, i.e. in traditional terms they present a nominative – accusative syncretism, or in other terms yet the *ju* form simply lexicalized a direct (non-oblique) case.

Prepositions requiring so-called nominative provide a crucial clue that there really are no case inflections, but only denotational properties capable of satisfying argument reference in certain syntactic contexts. So-called nominative inflections can associate with contexts where they are in the scope of the D (EPP) argument of the sentence (the finite verb inflection). However, the same denotational properties that satisfy the subject contexts, also satisfy the sub-event introduced by prepositions like *ka/ te* in (5i) and (8i), whose internal argument they satisfy. In particular, in the 1st/ 2nd person, the pronominal bare forms *u(n)*, *ti*, *ju*, *na* show up, suggesting that their deictic properties alone are able to lexicalize these contexts. 3rd person pronouns and nouns introduce specialized definite inflections.

We then come to prepositional contexts selecting ablative in *Shkodër*. In this variety the specialized singular ablative morphology appears not only on 1st/2nd person pronouns but also on a set of locative nouns, such as ‘house’, ‘room’, ‘door’, ‘chair’ etc. (Manzini and Savoia 2011, 2011a), as in (16).

- (16) *prej/ mas/ para* [pi-ε-t
 from/ behind/ before house-fs-Abl.def
 ‘from/ behind/ before the house’

We propose that 1st and 2nd person have in common with locative nouns a connection with the universe of discourse. In other words, the specialized ‘ablative’ morphology in reality is locative/ deictic. In fact, it is generally agreed that ‘speaker’ and ‘hearer’ are two necessary coordinates of the universe of discourse; a locative specification, roughly ‘here’, must also be one of the coordinates. In the

Greci variety, lacking a specialized locative/ ablative form, the oblique is inserted. We conclude that the inclusion relation associated with oblique morphology can be read as locative inclusion and is therefore able to introduce the locative interpretation.

The particular shape that the person split takes in our data has different case specifications associated with the lexical bases denoting elements of the universe of discourse (i.e. ‘hearer’ and ‘speaker’) and other lexical bases. 1st /2nd person lexicalize an uninflected form for ‘nominative’ and a Q(\subseteq) form for ‘dative’, ‘locative’ and DOM ‘accusative – or eventually two Q(\subseteq) forms, one of which specialized for prepositional contexts ‘locative’, as in *Shkodër*. Thus there is a strict correlation between the referential content of the lexical base and its specialization for so-called case, i.e. for denotational properties satisfying contexts of lexical insertion – which we take to argue in favour of our overall conception of case.


7. The referential split again.

In what precedes, we have seen that 1st /2nd singular and 3rd person have different way for lexicalizing different argumental contexts (subject vs. object vs. arguments of prepositions). We have argued that these morphological differences are not surface phonetic labels of abstractly identical categories. On the contrary, they correspond to true different types of conceptualization, within the same universal space of interface primitives.


In a nutshell, the split between 1st/2nd person pronouns and 3rd person can be related to different manner of lexicalizing the participants of the event. Our idea is that lexical bases denoting elements of the universe of discourse participate in the event in terms of their intrinsic properties of agent/ location (dative/ oblique morphology). Indeed the morpho-syntactic properties of *mu:/ mua*, *ty/ ti* show that 1st / 2nd person forms cannot be embedded as the internal argument of an event. Our hypothesis is that their embedding requires the presence of the Q(\supseteq) operator for inclusion, externalized by the the oblique morphology of 3rd persons as well, as in (2) and (6i).

In this perspective, we may also pursue an explanation for the PCC, as seen in the clitic combinations in (10) and (14). Two different

mechanisms of argument satisfaction are introduced by 1st/2nd person forms, i.e. the simple anchoring to the coordinates of discourse and Q(\subseteq) quantification. Suppose that simple anchoring underlies the argumental interpretation of 1st/2nd person pronoun, hence 1st and 2nd person clitics do not in fact include the superset-of operator. Nevertheless they make the superset-of Q(\subseteq) operator unavailable for 3rd person clitics, as suggested in (17) for *Greci* – in the absence of which the event cannot be read.




Unlike the incompatibility between 1st/2nd (acc) and 3rd dative clitics, in Arbëresh the combination of the quantificational properties of the strong 1st/2nd person pronouns and of the 3rd person dative are interpretable, as in



This possibility opposes Arbëresh to *Shkodër*, where this combination is not admitted. Naturally, we may expect that objective forms of strong 1st/ 2nd person pronouns are incompatible in their turn. This is the case of *Shkodër*, where none of the sequences *mu: ty/ ty mu:/ mu: atij/ ty atij* occur. Therefore, with strong pronouns as well, anchoring underlies the argumental interpretation of 1st/2nd person pronoun, making nevertheless unavailable the superset-of meaning lexicalized by the Q(\subseteq) operator.

Shkodër solves the incompatibility by introducing a locative which allows the 1st/2nd person referents to combine with a 3rd person

possessor/goal, as in (19).



The variation between the morphosyntactic behavior of *Greci* and *Shkodër* can be accounted for by assuming that their grammars contain different lexical entries. In particular in the lexicon of *Shkodër* strong pronouns are not treated as dative, i.e., more precisely, as elements associated with the Q(\supseteq) operator, like 1st/2nd person clitics.

8. Concluding remarks.

This article presents an account of case morphology in Albanian varieties, proposing in particular that DOM follows from deeper referential properties, namely that only nouns and 3rd person pronouns yield a canonical transitive event structure comprising an agent and a theme. Deictic referents are introduced not as themes, but as possessor ‘locatives’. This corresponds to the fact that the denotation of 1st and 2nd person is fixed in virtue of their being coordinates of the universe of discourse, without necessarily making reference to the structure of the event. In general, we have examined case phenomena from a lexicalist viewpoint, whereby each lexical entry is a function from sound to interpretation (and vice versa). The notion of case reduces to denotational primitives (person, nominal class, definiteness, quantification), associated with the relevant inflectional entries – where different denotational properties satisfy different syntactic environments. In this perspective, we can think of morphological differences as authentically different conceptualizations, within a single universal space of interface primitives. In the same framework, we also proposed an approach to the PCC, pointing out once again its strict link to the referential properties of the lexical items involved.

References

- Adger D. & D. Harbour 2007, *The Syntax and Syncretisms of the Person Case Constraint*. In *Syntax* 10: 2–37
- Aissen J. 2003, Differential object marking: iconicity vs. economy. In *Natural Language & Linguistic Theory* 21: 435-483.
- Bejar S. & M. Rezac. 2003. *Person licencing and the derivation of PCC effects*. In *Romance linguistics: Theory and acquisition*, ed. by Anna-Teresa Pérez-Leroux & Yves Roberge, 49–62. Amsterdam: John Benjamins.
- Bejar S. & M. Rezac. 2009. *Cyclic Agree*, in *Linguistic Inquiry* 40: 35–73
- Belvin, R. & M. Den Dikken 1997. *There, happens, to, be, have*, *Lingua* 101: 151-183.
- Berwick R.C. & N. Chomsky 2011, The biolinguistic program: The current state of its evolution and development, in A.M. Di Sciullo & C. Boeckx, *The Biolinguistic Enterprise*, OUP: 19-41.
- Calabrese, Andrea 1998, *Some remarks on the Latin case system and its development in Romance*, in J. Lema and E. Trevino (eds.), *Theoretical Advances on Romance Languages*, Amsterdam, John Benjamins: 71-126.
- Chomsky N. 1995, *The Minimalist Program*, Cambridge Mass., The MIT Press
- Chomsky N. 2000. *New horizons in the study of language and mind*. Cambridge, Cambridge University Press
- Chomsky, N. 2002. *On Nature and Language*. Cambridge, Cambridge University Press
- Chomsky, N. 2005. *Three factors in language design*, in *Linguistic Inquiry* 36: 1-22.
- Chomsky N. 2008, *On Phases*, in R. Freidin, C. Otero & M.-L. Zubizarreta (eds.), *Foundational Issues in Linguistic Theory. Essays in Honor of Jean-Roger Vergnaud*, Cambridge, Mass., The MIT Press.
- Culicover, P. & R. Jackendoff 2006. 'The simpler syntax hypothesis', in *Trends in Cognitive Sciences* 10: 413-418.
- Embick, D. 2000. *Features, syntax and categories in the Latin perfect*, in *Linguistic Inquiry* 31: 185-230.
- Evans N. & S. Levinson 2009, *The myth of language universals: language diversity and its importance for cognitive science*, in *Behavioral and Brain Sciences*, 32: 429-448
- Everett D.L. 2005, *Cultural Constraints on Grammar and Cognition in Pirahã*, in *Current Anthropology*, 46, 4: 621-646.
- Halle M. & A. Marantz 1993. *Distributed morphology and the pieces of inflection*. In K. Hale and S. J. Keyser (eds.) *The view from Building 20*, Cambridge, Mass.: The MIT Press: 111-176.
- Hauser M., N. Chomsky & W. T. Fitch 2002. *The faculty of language: what is it, who has it and how did it evolve?*, in *Science* 298: 1569-1579.
- Jackendoff, R. 2002. *Foundations of Language*. Oxford, Oxford University Press.
- Jelinek E. 1995, *Quantification in Straits Salish*, in E. Bach, E. Jelinek, A. Kratzer & B. Partee (eds.), *Quantification in natural languages*: 487-540, Dordecht, Kluwer
- Manzini M.R. & Savoia 2005, *I dialetti italiani e romanci. Morfosintassi generativa*. Alessandria, Edizioni dell'Orso, 3 vols.
- Manzini M.R. & L.M. Savoia 2007, *A unification of morphology and syntax. Studies in Romance and Albanian varieties*. London, Routledge
- Manzini M. R. & L.M. Savoia 2008, *Worknotes on Romance morphosyntax* –

- Appunti di morfosintassi romanza*, Alessandria, Edizioni dell'Orso
- Manzini M.R. & L.M. Savoia 2010. *Case as denotation: variation in Romance*, in *Studi Italiani di Linguistica Teorica e Applicata*, 39, 3: 409-438
- Manzini M.R. & L.M. Savoia 2011, *Grammatical Categories*. Cambridge: Cambridge University Press
- Manzini M.R. & L.M. Savoia 2011a, Reducing 'case' to 'agreement': Nominal inflections in the Geg Albanian variety of Shkodër, *Linguistic Variation Yearbook* 11, 1: 76-120.
- Nichols L. 2001, The syntactic basis of referential hierarchy phenomena: clues from languages with and without morphological case, in *Lingua* 111: 515-537
- Pesetsky D. & E. Torrego 2007. *The Syntax of Valuation and the Interpretability of Features*, In S. Karimi, V. Samiian & W. Wilkins, eds. *Phrasal and Clausal Architecture*. Amsterdam: Benjamins.
- Pinker S. & R. Jackendoff 2009, *The reality of universal language faculty*, in *Behavioral and Brain Sciences*, 32: 465-466.

Giovanni BELLUSCIO, Universiteti i Kalabrisë: SI SHQIPTOHET SHQIPJA NË BALLKAN?

Abstrakt

Përdorimi i shqipes në disa programe të radiov kombëtare në shtete të Ballkanit ka një traditë shumëvjeçare; ky përdorim paraqet një interes të veçantë sepse nga ana fonetike tregon cilët janë bazat gjuhësore të përbashkëta dhe cilët janë përjashtimet, d.m.th. ku, kur dhe pse arrihen apo nuk arrihen pikësynimet që kërkohen për një realizim të përsosur të shprehjes tingullore të shqipes. Do të analizohen pesëmbëdhjetë lajme të nxjerra nga emisione të radiove kombëtare të Shqipërisë, Malit të zi, Maqedonisë, Kosovës, Serbisë, Bullgarisë, Turqisë dhe do të jepen të dhena objektive të nxjerra me metodën e fonetikës eksperimentale, transkriptime dhe përshkrime gjuhësore përkatëse.

1. Emisionet ne gjuhën shqipe në Ballkan

Ato që ishin radiostacione kombëtare në Ballkan para vitit 1989 sot vazhdojnë të ekzistojnë, por pranë tyre janë krijuar edhe stacione të reja lidhur me gjeografinë e re politike të sotme.

ig. 1. Ballkani sipas F.W. Carter (1977). *An Historical Geography of the Balkans*. Accademic Press: London.



Fig. 2. Ballkani në 2011 (nga Interneti)










Për sa i përket përshkrimit gjeografik (dhe gjuhësor) të Ballkanit ka disa interpretime sipas të cilave shtete si Turqia, Moldova dhe Sllovenia mund të përfshihen apo jo si pjesë të Gadishullit Ballkanik. Ne

këtu jemi përqendruar në dy harta mjaft të ngjashme, sipas të cilave edhe Turqia edhe Sllovenia konsiderohen pjesë të këtij areali, këtyre shteteve u shtohet këtu edhe Moldova. Sipas situatës politike të sotme konsiderojmë që Ballkani përfshin trembëdhjetë shtete të pavarura ashtu siç tregon Fig. 2.

Edhe radiot kombëtare të Ballkanit të sotëm janë trembëdhjetë, ndër to jo të gjitha japin lajme të shkruara apo me zë në gjuhën shqipe. Tabela 1, tregon situatën që kemi gjetur:

Tabela 1. Të dhënat e radiove të analizuar dhe emisionet përkatëse në gjuhë të huaja.

Radiot dhe viti i themelimit	Lajme të shkruara	Emisione në gjuhë të huaja
 RTSH Programi shqip për bashkëatdhetarët 1938 www.rtsh.al/?fq=brenda&gj=gj1&kid=29	jo	po
 Radio Televizija Crne Gore (Radio Mali i Zi) 1949 www.rtcg.me/lajmet.html	malazezisht, shqip ¹	---
 Makedonska Radio-Televizija (Radio Shkupi) www.mtv.com.mk/al 1944	maqedonisht, shqip	---
 RTK1 Radio Televizioni i Kosovës 1999 www.rtklive.com	shqip , anglisht, serbisht, bosnisht, turqisht, romanes	shqip , serbisht, bosnisht, turqisht, romanes
 Radio Srbija 1936 www.glassrbije.org/A	serbisht, anglisht, rusisht, gjermanisht, frëngjisht, italisht, arabisht, greqisht, spanjisht, hungarisht, shqip	serbisht, anglisht, rusisht, gjermanisht, frëngjisht, italisht, arabisht, greqisht, spanjisht, hungarisht, shqip
 BNR Bulgarsko Nacionalno Radio 1930 http://bnr.bg/sites/sq/FullEmisions/Pages/11122011.aspx	anglisht, gjermanisht, rusisht, frëngjisht, spanjisht, serbisht, greqisht, shqip , turqisht, arabisht	anglisht, gjermanisht, rusisht, frëngjisht, spanjisht, serbisht, greqisht, shqip , turqisht, arabisht
 TRT Türkiye Radyo ve Televizyon Kurumu (Zëri i Turqisë) 1937	anglisht, gjermanisht, frëngjisht, rusisht, italisht, spanjisht, arabisht, turkmenisht (2)	anglisht, gjermanisht, frëngjisht, rusisht, italisht, spanjisht, arabisht, turkmenisht

¹ Emisionet e Radios së Malit të zi në gjuhën shqipe filluan në vitin 1965, redaksia perbehet sot nga shtatë veta; programi javor permban *Ditarin* (një gjysmë ore për 5 ditë në javë) dhe emisionin informativo-muzikor *Në fund të javës* (një gjysmë ore ditën e shtunë) plus çdo mëngjes jepen lajmet e shkurtra per pesë minuta, gjashtë ditë në javë (jo të dielën).

www.trt.albanian.com/trtworld/al/news.aspx	alfab.), ujugurisht (2 alfab.), azerbejxhanisht (2 alfab.), hungarisht, greqisht, maqedonisht, kirgizisht, pashtu, persisht, darisht, uzbekisht (2 alfab.), bullgarisht, armenisht, bosnisht, kroatisht, rumanisht, kazakisht, serbisht, shqip , gjeorgjisht, tatarisht, urdu kinezisht, turqisht	(2 alfab.), ujugurisht (2 alfab.), azerbejxhanisht (2 alfab.), hungarisht, greqisht, maqedonisht, kirgizisht, pashtu, persisht, darisht, uzbekisht (2 alfab.), bullgarisht, armenisht, bosnisht, kroatisht, rumanisht, kazakisht, serbisht, shqip , gjeorgjisht, tatarisht, urdu kinezisht, turqisht
--	--	---

Veç këtyre, Radio Greqia (Ελληνική Ραδιοφωνία Τηλεόραση, themeluar në 1938, www.ert.gr/filia/index.php/sq.html) jep vetëm lajme të shkruara në gjuhën shqipe dhe në njëmbëdhjetë gjuhë të tjera (arabisht, bullgarisht, rusisht, gjermanisht, spanjisht, frengjisht, polonisht, rumanisht, serbisht, turqisht, anglisht) kurse radiot e shteteve të tjera të rajonit nuk japin as lajme të shkruara, as emisione në gjuhën shqipe².

² Radio Bosnja (*Radiotelevizija Bosne i Hercegovine* www.bhrt.ba, themeluar në 1932) jep lajme të shkruara dhe me zë vetëm në gjuhën boshnjake; Radio Sllovenia (*Radiotelevizija Slovenija* www.rtv.slo.si, themeluar në 1928) transmeton emisionet në sllovenisht, gjermanisht dhe anglisht, faqja e internetit është vetëm në sllovenisht. Radio Kroacia (*Međunarodni program Hrvatskoga radija "Glas Hrvatske"* www.hrt.hr, 1926) jep emisione në anglisht, gjermanisht, italisht, hungarisht dhe spanjisht, kurse faqja web jep lajme të shkruara vetëm në gjuhën kroate; bën përjashtim Radio Rijeka, e cila ka edhe redaksinë italiane); Radio Romania (*Radio Româna Internațional* www.ri.ro, themeluar në 1927) jep lajmet e shkruara dhe me zë në anglisht, spanjisht, italisht, rusisht, kinezisht, gjermanisht, frëngjisht, serbisht, ukrainisht, arabisht dhe arumanisht); Radio Moldova (*Radio Moldova Internațional* www.trm.md/ro/radiointernational, 1992 - por emisionet radiofonike filluan qysh në 1939) jep lajme të shkruara dhe emisionet përkatëse në anglisht, frëngjisht, spanjisht, rusisht dhe rumanisht. Në botë ka edhe stacione të tjera me traditë që japin programe informative (të shkruara dhe me zë) në gjuhën shqipe, siç janë *Zëri i Amerikës* (www.voanews.com/albanian/news), *Radio Vatikani* (www.radiovaticana.org/alb/on_demand.asp), *Deutsche Welle* (www.dw-world.de/dw/0,,10433,00.html), *RAI Radiotelevizioni italian* (www.international.rai.it/radio/multilingue/presentazioni/albanese.shtml), *Radio Evropa e lirë* (www.evropaelire.org) e cila jep emisione për Kosovën nga Praga, Radio Kina (<http://albanian.cri.cn>) dhe *Zëri i Rusisë* (<http://albanian.ruvr.ru>), i cili jep sidomos lajme të shkruara dhe në pak raste edhe me zë. Deri më 28 shkurt 2011, edhe BBC-ja, transmetoi rregullisht emisione në gjuhën shqipe duke filluar prej 1945-ës, (historiku i emisioneve në gjuhën shqipe, me disa materiale zanore, mund të lexohet në faqen

2. *Materialët*³

U analizuan 933,40 sek. (d.m.th. 15,55 minuta) incizimesh radiofonike (sidomos të tipit ‘lajme’) të ndara për çdo radio sipas tabelës 2. Shumica e radiove ka programe satelitore që transmetohen edhe nëpërmjet të internetit. Për këtë arsye gjetja dhe marrja e materialeve që mjaft e lehtë; në rastin e Radios Mali i Zi dhe Radio Shkupit na u desh t’u referohemi drejt-përdrejt redaksive, të cilat na dërguan incizime të emisioneve të lajmeve⁴. Siç kuptohet vetiu, materiali i analizuar është i njëtrajtshëm si nga cilësia ashtu edhe nga stili i të folurit e nga konteksti në të cilin është prodhuar. Për sa u përket spikerëve, për disa prej tyre nuk kemi të dhëna të sakta rreth prejardhjes si edhe rreth mësimit të shqipes, u dërguam redaksive një seri pyetjesh rreth programeve dhe spikerëve, por nuk kemi marrë përgjigje. Përveç spikerëve të Radio Tiranës, të Radio Kosovës dhe të Radios Mali i Zi, të gjithë vendalinj, vetëm spikerja e Radio Shkupit ka emigruar prej Shqipërie dhe është vendosur në Maqedoni, gjë kjo që do të trajtohet më poshtë. Spikerët e Radio Serbisë, Bullgarisë dhe Turqisë, nga ndikimet e forta të fonetikës-fonologjisë së gjuhës së tyre amtare sipas shqiptimit do të jenë vendas që mësuan shqipen si gjuhë të huaj dhe kjo e shpjegon shqiptimin e tyre; por edhe nga struktura e lajmeve dhe të disa njësisë leksikore të veçanta duket që janë vendës që mësuan shqipen si gjuhë të huaj.

Në tabelën 2 paraqitet skema e materialeve, me të dhënat mbi gjininë e spikerëve, zgjatjen e incizimit, fjalët nistore të lajmit.

Tab. 2. *Pasqyra e teksteve të përdorura dhe informacione përkatëse*

RADIO	Dok.	Folësi	Zgjatja në sek.	Fillimi i lajmit
Tirana	1	m.	17,52	<i>Kryeministri Berisha dhe bashkëshortja e tij...</i>
Tirana	2	f.	110,95	<i>Kryeministri Berisha dhe bashkëshortja e tij...</i>
Tirana	3	m.	32,05	<i>Çdo ndryshim i mundshëm...</i>
Mali i Zi	4	m.	33,58	<i>Deputetët shqiptarë në parlamentin...</i>
Mali i Zi	5	m.	50,02	<i>Tuz. Me pesëmbëdhjetë dhjetor...</i>
Maqedonia	6	f.	26,17	<i>Ka rrezik real që shteteve...</i>
Maqedonia	7	f.	23,52	<i>Marrëveshja midis Maqedonisë dhe Shqipërisë...</i>

www.bbc.co.uk/albanian/news/2011/03/110317_alb_closure_chronology.shtml).

³ Lajmet e përdorura dhe të transkriptuara në § 6 mund të dëgjohen në faqen www.albanology.com e *International Network of Albanology (INA)*.

⁴ Falenderojmë zonjën Ajten Vllasaku Mehmeti, drejtoreshë e Radio Shkupit, zotin Musa Gjoka i televizionit të Malit të Zi, si edhe zotin Senad Gjilic, spiker i redaksisë shqipe të Radio Mali i Zi, për ndihmën dhe për dërgimin e materialeve.

Maqedonia	8	m.	38,16	<i>Ajo që dje është dukur e pabesueshme...</i>
Kosova	9	m.	72,96	<i>Dymijenjëmbëdhjeta nuk do të jetë farë e lehtë...</i>
Serbia	10	f.	66,74	<i>Ministri i mbrojtjes i Serbisë...</i>
Serbia	11	f.	24,76	<i>Presidenti i Serbisë Boris Tadiq...</i>
Bullgaria	12	f	62,65	<i>Tungjatjeta të nderuar dëgjues të radio Bullgarisë...</i>
Bullgaria	13	f.	49,76	<i>Grupi i "Miq të radio Bullgarisë" në fejsbuk...</i>
Turqia	14	m.	83,23	<i>Pjesa e greke e Qipros...</i>
Turqia	15	m.	42,12	<i>Kadafi i bëri thirrje popullit...</i>

3. Shqipja radiofonike

I pari studim kushtuar shqipes radiofonike u botua nga Angoni (1984)⁵. Aty autori analizon disa karakteristika të gjuhës së përdorur në radio dhe në televizion sidomos nga pikëpamja e shkeljes së normës gjuhësore por krejtësisht leksikore, sipas qëllimeve gjuhësore normative të kohës. Ky punim mbetet sot si barazi dhe na ndihmon për të kuptuar në njëfarë mënyre si ka evoluar leksiku i shqipes së folur në këto tridhjetë vitet e fundit. Po të marrim parasysh tri listat që paraqet autori për të vënë në dukje depërtimin e termave të rinj dhe të huazimeve nga gjuhë të huaja në emisionet radiotelevizive të kohës, dhe t'i krahasojmë ata me botimin e fundit të fjalorit shpjegues të shqipes së sotme (Tirana 2006) do të vërejmë se një përqindje e konsiderueshme e fjalëve, që në 1984 konsideroheshin si pa të nevojshme, bile 'të përndjekura', sot janë radhitur në faqet e fjalorit "zyrtar" të shqipes bashkëkohore⁶. Nga ana fonetike autori vë në dukje profesionalitetin e folësve dhe arritjet e tyre në përmirësimin e vazhdueshëm të shqiptimit "në stilin e plotë letrar". Megjithatë ai nënvizon edhe disa shmangie nga "norma drejtshqiptimore" si: e > ë vënd, dhëmbje, kuvënd, shëmbull etj.; ë > e njeri, i njejtë, vemendje etj.; ue > u mësus, ndër-tus, vazhdueshëm etj.; sh > ç çfrytëztoj, i çfrytëzuar etj.; ndër-futja e një ë-je të panevojshme: tregëtar, bijëve, e ardhëshme etj., si dhe u kërkon folësve të radios dhe të televizionit të bëjnë kujdes në vendosjen e theksit (tabló dhe jo táblo, Komán dhe jo Kóman, Liverpúl dhe jo Líverpul, e díel dhe jo e diél(ë), kalciúm dhe jo kálçium), në përdorimin e c-së dhe jo të ç-së

⁵ Edhe Islamaj (2003:23-24) trajton, megjithëse jo në thellësi, gjuhën e mediave dhe të radios.

⁶ Po japim këtu vetëm disa të dhëna sasiore rreth fjalëve që sot janë në *Fjalorin e Gjuhës Shqipe* e 2006-s: nga lista e parë e Angonit 50% të fjalëve, nga lista e dytë 24 mbi 28, nga lista e tretë 9 mbi 12.

(deficit, koncesion dhe jo defiçit etj.), si edhe në raste të ndryshme: Evropë dhe jo Europë, psikik dhe jo psiqik, gjen dhe jo gen, gjips dhe jo gips. Përpos këtyre ai vë në dukje edhe luhatje dhe keqpërdorime në intonacion, në ritmin e të folurit (i cili nuk konsiderohet si i natyrshëm), në pushimet që nuk respektojnë sintaksën e gjuhës. Kjo tregon se si dhe sa ndikon gjuha e mediave për zgjerimin, përditësimin dhe modernizimin e gjuhës së një vendi. Ashtu siç ndikojnë nga ana terminologjike, mediat ndikojnë edhe duke përhapur modele ortoepike për përshtatjen e anës fonetike të gjuhës. Pajtohemi me Angonin (1984), kur ai thekson “Fjala në radio dhe televizion është shtyp i folur. [...] Por gjuha e radios dhe e televizionit ka edhe veçoritë e veta. Ajo parapëlqen trajtat më të shkurtra e më të thjeshta, pra, fjali të shkurtra, kryesisht me bashkërenditje dhe me lidhëza të thjeshta.” Kjo është pikërisht edhe gjendja e sotme. Nuk kemi shqyrtuar këtu aspektin sintaksor apo leksikor të lajmeve, por nga pikëpamja e cilësisë së të folurit, në të gjithë kampionin e analizuar, lajmet e dhëna me zë kanë të gjitha origjinë të shkruar, pra tekste të prodhuara nga redaksitë dhe, në shumicën e rasteve, të publikuara në internet, siç vërtetojnë dhe shembujt e mëposhtëm (në notat 19-21). Si i tillë, të folurit e analizuar paraqet disa dukuri që e veçojnë nga të folurit spontan dhe të përditshëm. Siç është vënë në dukje në Belluscio et al. (1997), edhe të folurit e spikerëve ka veçoritë e veta. Ky i fundit, në krahasim me atë të folësve të tjerë, ka prirje të ketë më pak ndikime dialektore, të jetë më i kontrolluar dhe të ruajë më shumë strukturën e gjuhës së shkruar. E megjithatë, analiza e lajmeve të emetuara nga spikerët e Radio Tiranës nxjerr në pah që ritmi i shpejtë i leximit mund të bëhet shkak për shfaqjen e po të njëjtave dukuri, të cilat vërehen në të folurit e përditshëm të folësve të tjerë. Sidoqoftë, nuk është e mundur të bëhen përgjithësime edhe pse çdo spiker (ashtu si çdo folës) ka tiparet e veta, stilin e vet, mënyrën e tij të dhënies së lajmit etj. Kjo vërtetohet edhe nga analizat akustike të ritmit të të folurit, si dhe nga transkriptimet e teksteve.

3.1. Tiparet kryesore të të folurit radiofonik

Siç është vënë në dukje në letërsinë shkencore (Atzori 2002 me bibliografi) të folurit radiofonik përmbledh në përgjithësi të gjitha shprehjet gjuhësore dhe një sasi stilesh që mund të përdoren në emisionet në radio: lajmet, kronikat sportive, rubrikat, bisedat me dëgjuesit (p. sh. të folurit telefonik), radiodramat, etj. Sipas tipologjisë së emisioneve, të folurit mund të jetë spontan ose jo spontan, d.m.th. i mbështetur apo jo në leximin e

teksteve të shkruara. Ndryshimet kryesore midis të folurit spontan dhe leximit lidhen në veçanti me ritmin, me intonacionin, me mungesën në lexim të pauzave të plota ose pauza ngurrimi, me hezitime në fillim apo në mes të frazave (si rezultat i pasigurisë mbi atë që do të thuhet fill më pas), me prarinë kur jepen tekste të lexuara të një sintakse më të përsosur, me përzgjedhjen e fjalëve dhe të terminologjisë përkatëse. Materiali i analizuar në këtë studim, si shembull i të një të foluri të lexuar ndryshon, veç tipareve të përmendura më sipër, si për mungesën e pikëpyetjeve dhe të pikëçuditësive, ashtu edhe të pasthirmave. Kjo e fundit nuk paraqet strategji të rolit të folësit dhe ndryshimin e saj, siç ndodh rëndom p.sh. gjatë një bisede (të ashtuquajturit *Speaking turns*). Leximi i lajmeve ka një ecuri që mund të quhet ‘neutrale’ ose ‘jo i shënuar’. Spikeri lexon tekstet e shkruara nga redaksia pa emocione⁷, duke i kushtuar vëmendje shqiptimit, duke respektuar sa më shumë shenjat e pikësimit dhe pauzat (që, gjatë leximit, shfaqen normalisht në kufijtë prozodiko-sintaksorë), vështirë të bëjë lapsuse, gabime ose ndryshime në ton dhe intonacion. Në përgjithësi të folurit radiofonik është një i folur i pandërprerë, i cili, si i tillë, paraqet një variacion të lartë alofonik, ndryshimi të çrregullt të zgjatjes apo të tkurrjes të segmenteve, fshirjen/asimilimin e tingujve⁸, të rrokjeve etj. Ndërsa nga ana praktike dhe analitike ai paraqet vështirësi për segmentimin, për analizën formantike të zanoreve, për llogaritjen e numrit të rrokjeve, për transkriptimin fonetik etj. Duke qenë se emisionet e lajmeve nuk kanë një publik të caktuar dhe i drejtohen një shtrese mjaft të gjerë të popullatës dhe jo uniforme si nga ana shoqërore (për sa i përket shkollimit, kulturës, përkatësisë shoqërore, interesave), ashtu edhe nga ana gjeograffike, megjithëse lajmi jepet në gjuhën standarde, jo të gjithë dëgjuesit kanë një kompetencë gjuhësore të mjaftueshme pasive dhe aktive për ta kuptuar dhe për ta përdorur standar-

⁷ Dodi (2004) jep disa shënime rreth stilit radiofonik, të cilin e konsideron si ‘shqiptim i kujdesshëm ose shqiptim neutral’ dhe shton se ky “është stili i lajmeve të zakonshme në radio, televizion, etj.” dhe se “kur përcaktojmë përbërjen fonetike të fjalëve mbështetemi pikërisht te ky stil” (f. 217); më pas vazhdon: “stili solemn (oratorik) [...] është stili i njoftimeve të rëndësishme në radio dhe televizion [...] Me këtë stil folësi përpiket të ushtrorë dhe ndikim emocional te dëgjuesi.”

⁸ Vetëm si tregues të kësaj dukurie (në lidhje edhe me të ashtuquajturin “shqiptim standard” i cili konsiderohet si i mbështetur në shkrimin) krahasuam një paragraf të lajmit të shkruar të Radio Kosovës me të njëjtin lajm të lexuar nga spikeri, prej ku rezultoi se mbi 451 grafema (me transkriptim fonetik) spikeri nuk nyjëtoi 24 fonema, d.m.th. 5,32%.

din⁹. Lajmet duhet të jenë të kuptueshme për të gjithë si nga pikëpamja e shqiptimit dhe nga pikëpamja e përmbajtjes. Gazetari radiofonik është i vetëdijshëm që koha për emisionet është e kufizuar¹⁰ dhe që çdo lajm duhet të ketë një densitet të caktuar informacioni, nga ana tjetër, duket që lexuesi i lajmit i përshtatet gjatësisë së çdo lajmi edhe duke ndryshuar ritmin e leximit. Nuk do të merren parasysh problemet lidhur me marrjen e lajmeve nga ana e publikut, d.m.th. duke analizuar dhe vlerësuar tiparet e të folurit lidhur me ritmin e leximit, intonacionin, me cilësinë e zërit, me nivelin e kuptueshmërisë së lajmeve në përgjithësi etj. nga ana e radiodëgjuesve. Në mënyrë të kufizuar do të analizohen ndryshimet diatopike dhe diafazike brenda teksteve lidhur me folësit dhe me vendin nga ku transmetohet.

3.2. Korpuset e shqipes radiofonike

Mbledhja, transkriptimi dhe arkivimi i të folurit radiofonik të disa radiove (publike e private) të Shqipërisë, të Kosovës, të Maqedonisë e të Malit të Zi, mund t'i paraprijë krijimit të një korpusi të të folurit bashkëkohor por edhe me drejtim diakronik¹¹ (sa të jetë e mundur) për të vënë në dispozicion të studiuesve dhe të kërkuesve materiale të dorës së parë, që dëshmojnë shqipen “e gjallë”. Duke qenë se organizimi i materialeve të ndryshme (siç kemi vënë në dukje në § 3) duhet grupuar sipas tipologjisë dhe përmbajtjes, mund të flitet për korpusë të caktuara të këtij tipi të foluri. Materialet, siç u tha, do të mund t'u shërbejnë fushave të ndryshme të gjuhësisë, dhe mund të jenë me vlerë për studimin e intonacionit të shqipes bashkëkohore.

⁹ Prifti (2005, 2009) trajton në mënyrë të shkëlqyeshme situatën sociolinguistike të shqipes standarde të sotme lidhur me variacionet diamesike, diatopike dhe diafazike të saj dhe duke dalluar dy degëzime të vlefshmesipas nesht: standardin ekzogjen dhe endogjen.

¹⁰ Atzori (2002:22) shkruan “La radio deve dire molte cose in tempo ristretto e dirle chiaramente, la sua forma deve essere sobria e corretta, in quanto l'ascoltatore ha più difficoltà a comprendere di quanta ne abbiano il lettore o l'ascoltatore diretto”. Nga ana tjetër, pohimi i Atzori-t vlen sot disi më pak kur thotë se dëgjuesi nuk mund të kthehet mbrapa për të ridëgjuar atë që nuk kuptoi, sepse sot, dhjetë vjet pas pohimit të kësaj autoreje, shumica e lajmeve ruhen nëpër arkiva digjitale dhe mund të shkarkohen në *podcast*. Përveç kësaj sot ka ndryshuar edhe mënyra e dëgjimit të radios, e cila, siç nxjerr në pah edhe ky studim, dëgjohej sidomos edhe nëpërmjet internetit.

¹¹ I referohemi në këtë pikë projekteve të tillë si p. sh. Parlaritaliano (www.parlaritaliano.it/index.php/it/corpora/647-selezione-dal-qcorpus-di-parlato-telegiornalistico-anni-sessanta-vs-2005q) ku mblidhet dhe studiohet një përzgjedhje e lajmeve të radios italiane RAI të periudhës 1960-2005.

3.3.1. LSR-ja Leksiku i (frekuencës i) Shqipes Radiofonike

Krijimi i arkivit të të folurit radiofonik, sipas qëllimeve të sipërpërmendura, sjell rrjedhimisht edhe mundësinë e krijimit automatik të një leksiku sektorial të shqipes radiofonike, i cili do të japë një pasqyrim statistik të fjalëve, me të cilat ballafaqohet çdo ditë popullsia shqipfolëse. Ai do të ndihmojë edhe në vlerësimin e ndryshimit real të leksikut, si për matjet statistike edhe për përditësimin e fjalorit të gjuhës së sotme shqipe¹².

4. Analiza e materialeve

Materialet u analizuan së pari nga pikëpamja fonetike akustike (matja e 'grupeve frymëmarrës' (Breath groups), të pauzave, të disa dukurive akustike të segmenteve) dhe së dyti nga pikëpamja gjuhësore (dukuritë fonetike dhe fonologjike, llogaritja e rrokjeve).

4.1. Metoda

Për përpunimin e materialeve të zgjedhur u përdor softueri PRAAT i cili mund të shkarkohet nga interneti dhe nuk ka kufizime përdorimi. Me PRAAT-in u bë segmentimi i sinjalit, përcaktimi i rrokjeve, matja e zgjatjes së grupeve frymëmarrëse (Breath Group Duration - BGD) dhe të pauzave midis tyre (Internal Breath Pause - IBP) (Wang et al. 2010).

4.1.1. Matja e grupeve frymëmarrëse dhe të pauzave

Matjet në fushën e fonetikës elektroakustike nuk kanë vlerë absolute. Ky fakt është vënë shpeshherë në dukje në letërsinë shkencore përkatëse. Eksperimenti i paraqitur në Trumper et al. (1993) tregon qartë lëkundjet që shkaktojnë matjet e të njëjtit material nga foneticienë të ndryshëm. Prandaj duhet mbajtur parasysh, edhe në këtë kontekst, fakti që rezultatet e paraqitura këtu duhet të lexohen si tregues të një tendence, të shfaqjes së disa dukurive. Për të arritur në një vlerë më objektive do të duhet të mbështetemi në një kampion materialesh më të gjerë dhe me përsëritje të një pjese të matjeve edhe nga ana të shkencëtarëve të tjerë. Përvoja jonë pothuajse tridhjetëvjeçare dhe mbështetja në literaturën e derisotme (shih sidomos Wang 2010) bëri që të arrihej tek një metodë që ka baza të shëndosha

¹² Në fragmentet e materialeve që jepen në § 6 mund të vërehet prania e një serie termash, të cilët megjithëse përdoren në media dhe (ndoshta) nga popullsia, nuk kanë gjetur ende vend nëpër fjalorë.

shkencore. Në rastin tonë jemi bazuar në leximin e valës akustike të sinjalit dhe në shfaqjen e tingujve në sonogramet. Në kuadrin e krahasimit dhe të shqyrtimit të dy treguesve nuk qe e vështirë të përcaktoheshin pauzat e brendshme dhe matja e tyre, apo grupet frymëmarrëse. Të dhënat paraqiten në sekonda; jepet gjithashtu shuma për çdo fragment të teksteve, mesatarja, devijimi standard, vlerat që na shërbejnë, së bashku me llogaritjen e rrokjeve, për matjen e përshpejtimit të nyjëtimit (*Articulation Rate*) dhe të përshpejtimit të të folurit (*Speaking Rate*).




Fig. 3. Ndarja e sinjalit në grupe frymëmarrëse duke u mbështetur në valën akustike dhe në përshkrimin aerodinamik të rrymës së të folurit (BGD; Zgjatja e grupit frymëmarrës, IBP: Pauzë frymëmarrëse e brendshme, ID: Zgjatja e pauzës frymëmarrëse. Wang et al. 2010)

4.1.2. Ndarja në rrokje

Pozicionet e studiuesve rreth rrokjes si njësi gjuhësore janë të ndryshme: ndokush pranon rrokjen si fonetike dhe fonologjike, ndokush tjetër vetëm si fonologjike dhe të tjerë, si Chomsky-Halle, nuk e konsiderojnë fare këtë segment gjuhësor në studimet e tyre. Nuk është ky vendi për të shqyrtuar këtë problem; në Hyman (1981:258) mund të lexohen kriteret dhe shpjegimet rreth rrokjes dhe teorive kryesore, në të cilat mbështet analiza, kurse në Laver (1995) jepet një përshkrim i shkurtër dhe literatura përkatëse. Për shqipen kemi sot disa trajtime të zgjeruara rreth rrokjes nga Dodi (2004), Hamiti (2005), Hysa (2007) dhe Memushaj 2011. Për ndarjen në rrokje jemi mbështetur sidomos mbi konceptin e bërthamës rrokjesore: konsideruam pra si rrokje çdo tingull zanor që ka vlerën e bërthamës, pa marrë parasysh problemin ende të pazgjidhur të ndarjes së bashkëtingëlloreve (sidomos të grupeve bashkëtingëllore). Duke qenë se gjatë të folurit të lirë rryma e zërit pëson ndryshime mbajtëm parasysh dhe vendosëm që: a)

togzanoret të llogariten si dy rrokje: *ta-ku-ar* dhe jo *ta-kuar*, *gru-a gru-an* dhe jo *grua gruan*; ashtu si për sinalefën, zanoret që takohen në kufi të fjalëve llogariten si një zanore e vetme: ...*e këtij viti ishin...* = /ektij'vitishin/; nuk llogariten zanoret që folësit nuk shqiptojnë, d.m.th. nuk mbahet parasysh drejtshkrimi i shqipes; /u/ dhe /i/ kur shqiptohen si gjysmëzanore [w] [j] nuk llogariten si bërthama rrokjesore. Ndarja në rrokje, së bashku me kohëzgjatjen e grupeve frymëmarrëse dhe të pauzave frymëmarrëse, shërben këtu si vlerë për të matur përshpejtimin e nyjëtimit dhe të të folurit. *4.1. Përshpejtimi i nyjëtimit (Articulation Rate) dhe përshpejtimi i të folurit (Speaking Rate)*¹³

Si analizë të parë dhe të vetme në këtë kumtesë propozojmë matjen e ritmit të të folurit të spikerëve në gjashtë radiot e cituara. Shpeshherë na ndodhi të dëgjojmë nga folës të ndryshëm vlerësime subjektive rreth përshpejtimin mes kosovarishtes dhe shqipes së Shqipërisë, nga ana e kosovarëve ritmi i të folurit të shqiptarëve konsiderohej si shumë i shpejtë, kurse nga shqiptarët kosovarishtja konsiderohej si e ngadaltë dhe pak e mërzitshme. Këto janë padyshim vlerësime subjektive, por sa janë të vërteta? Le të nisemi atëherë nga uniformiteti i të folurit radiofonik, i cili në rastin tonë paraqet vetëm ndryshime diatopike, d.m.th. lidhur me vendin në të cilin jetojnë dhe nga i cili flasin spikerët. Duke qenë se folësit shprehen në të njëjtin kontekst (studio radiofonike), në të njëjtën mënyrë (lexojnë lajme) dhe përdorin të njëjtin mjet transmetimi (zërin dhe radion) të folurit e tyre nuk paraqet ndryshime diafazike dhe diamezike. Kemi të bëjmë kësh-tu me një situatë shumë homogjene. Përpos kësaj përdorim materiale dëgjimore dhe gjuhësore prapë mjaft homogjene.

Duke aplikuar metodën që paraqitëm në 4.1.1. dhe 4.1.2. matëm zgjatjen e grupeve frymëmarrëse, pauzat frymëmarrëse të brendshme dhe rrokjet brenda çdo grupi frymëmarrës. Të dhënat jepen në detaje në tabelat e mëposhtme 4-10.2 për çdo radio, për çdo folës, për çdo tekst. Në çdo


¹³ Sipas literaturës vazhdimësia e të folurit dhe përshpejtimi i nyjëtimit konsiderohen si trajta jogjuhësore, e, në një farë mënyre, edhe paragjuhësore, ashtu siç pohon Laver (1995:534): "The continuity of speech and the rate of articulation of individual utterances are best thought of as non-linguistic in nature. To the degree that continuity and rate of speech are subject to conventional interpretation, reflecting the communication of such attitudinal or emotional states as impatience, deliberation, excitement, happiness, disappointment or sadness, for instance, then they are paralinguistic in nature."

tabelë dhe për çdo shtyllë jepen matjet e veçanta: shuma, mesatarja dhe devijimi standard. Këto matje kanë si qëllim përshkrimin sasior fonetik të të folurit, përcaktimin e përshpejtimit të nyjëtimit (*Articulation Rate*) dhe të përshpejtimit të të folurit (*Speaking Rate*). Ndërsa i pari shprehet me matjen e numrit të rrokjeve lidhur me gjatësinë e thënies në sekonda pa llogaritur pauzat boshe, i dyti matet duke pjesëtuar numrin e rrokjeve me zgjatjen e plotë të thënies (duke përfshirë të gjitha pauzat). Variacioni i kampionit përshkruhet në tab. 3, ku jepet zgjatja e grupeve frymëmarrëse dhe e pazave të brendshme. Për sa i takon vlerësimin të këtyre dukurive studiuesit nuk janë të njëjtit mendim, si për sa i përket matjeve të ritmit, ashtu edhe matjes së përshpejtimit, për arsye se jo të gjitha gjuhët kanë të njëjtën strukturë fonetike, fonologjike dhe pranojnë të njëjtin sistem rrokjezimi. Siç thotë Roach (1998), një gjuhë me strukturë rrokësore të thjeshtë ka mundësi të prodhojë më shumë rrokje në një sekondë sesa një tjetër me strukturë silabike më komplekse¹⁴. Në përgjithësi përshpejtimi i të folurit matet sipas tri shkallëve: e ngadaltë, e mesme, e shpejtë, por ende nuk është gjetur një matje që të pranohet nga të gjithë për të lidhur këto shkallë me vlera numerike. Deri tani vetëm në Iwasaki et al. (2002) kemi gjetur përcaktimin e rrokjeve për çdo shkallë: 11 rrokje për sek. = e shpejtë, 9 rrokje p/s. = mesatare, 6 rrokje p/s. e ngadaltë; por si do të shohim kjo nuk na ndihmon shumë për leximin e të dhënave tona.

Në grafikun 1 tregohet ecuria e përshpejtimit të të folurit për çdo spiker sipas teksteve të lajmeve në § 6. Siç mund të vërehet spikerët e Radio Tiranës japin lajmet me një shpejtësi më të lartë, kurse nivelin më të ulët e paraqesin spikeret e Radio Bullgarisë. Për sa i përket Radio Maqedonisë na dalin tri vlera në të cilat konstatojmë që ajo më e ulëta (Maqedonia3) largohet prej të tjerave. Kjo situatë shpjegohet duke konsideruar se të dy tekstet e parë u lexuan nga një spikere me prejardhje nga Shqipëria, e emigruar në Maqedoni, kurse teksti i tretë u lexua nga një shqiptar maqedonas. Ecuria tregon edhe që i njëjti spiker nuk ruan në përgjithësi të njëjtin përshpejtim. Ky fakt është krejt normal, madje, siç ka vënë në dukje Dankovičová (1999), përshpejtimi (i nyjëtimit) faktikisht ndryshon edhe gjatë të folurit, brenda çdo fraze intonacionore.


¹⁴ Siç ndodh në shembullin që ai jep: fjalia “Smith’s strength crunched twelve strong trucks” e anglishtes e cila paraqet 6 rrokje dhe përbëhet nga 32 tinguj zgjatet më shumë sesa fjalia e japonishtes “kakashi to risu” po me 6 rrokje por me vetëm 12 tinguj. Por ky nuk është problem që na intereson, sepse ne merremi me një material gjuhësor pothuajse homogjen. Por nga ana tjetër, siç kuptohet vetiu, ndikon jo pak substrati gjuhësor amtar.

Graf. 1. Përshpejtimi i të folurit për çdo spiker (sipas leximit të teksteve të § 6)



Grafiku 2 paraqet ecurinë e përshpejtimit të të folurit dhe të nyjetimit sipas vlerave mesatare të përgjithshme për çdo emision radiofonik.


Graf. 2. Mesataret e përshpejtimit të nyjetimit dhe të të folurit



Duke barazuar rezultatet tona me ato që jepen në Pellegrino et al. (2011) për shtatë gjuhë të tjera, ku vlerësimet janë bërë duke përdorur pjesë të lexuara dhe matjet duke u mbështetur në rrokjen si njësi bazë, mund të shohim se cilin vend zënë spikerët e radiove të analizuara. Për të nënvizuar situatën specifike të Radio Maqedonisë këtu ndamë rezultatet e spikeres (Maqedonia1) nga ato të spikerit maqedonas (Maqedonia2). Doli qartë si spikerja përkon me Tiranën kurse spikeri i afrohet përshpejtimit të spikerit të Radio Mali i Zi. Vlerësimi i fundit që duhet bërë është se ngadalësia e të folurit të spikerëve të Radio Turqisë, Serbisë dhe Bullgarisë varet ndoshta edhe nga fakti që për këta spikerë shqipja është gjuhë e huaj, e mësuar në mënyrë të pilotuar dhe si e tillë është pak e përdorur (ndoshta vetëm në studiot radiofonike), kurse për spikerët e Maqedonisë, Malit të Zi dhe Kosovës, shqipja është gjuhë amtare dhe rezultatet pasqyrojnë një situatë reale, e

cila përfshin edhe trajtat e natyrshme të ritmit të të folurit të vendit.

Graf. 3 Barazimi i Përsheptimit të nyjëtimimit të spikerëve të shqipes me Përsheptimin e disa gjuhëve të tjera (sipas Pellegrino et al. 2011)



Tab. 3. Zgjatja në sekonda të Grupeve frymëmarrëse (me shifra të trashashënohen vlerat më të ulëta dhe më të larta për çdo kategori)

	Kohëzgjatja në sekonda e Grupit frymëmarrës (BGD)				
	n.	Minim.	Maksim.	Mesat.	σ
Tirana1	2	3.69	13.53	8.61	6.95
Tirana2	27	0.94	8.14	3.83	1.93
Tirana3	6	1.84	9.78	5.07	2.87
Mali i Zi1	9	1.06	6.72	3.37	2.01
Mali i Zi 2	11	1.39	8.59	4.13	1.85
Maqedonia1	7	2.83	5.54	3.14	1.09
Maqedonia2	7	1.03	4.65	3.09	1.29
Maqedonia3	13	0.89	3.81	2.60	0.94
Kosova	20	1.08	6.79	3.34	1.58
Serbia1	13	2.29	8.66	4.82	1.84
Serbia2	5	1.09	11.31	4.69	3.95
Bullgaria1	12	1.97	7.39	4.84	2.09
Bullgaria2	10	2.73	6.27	4.52	1.21
Turqia1	13	2.30	11.08	5.89	2.70
Turqia2	7	2.20	8.43	5.37	1.82

Tab. 3.1. Zgjatja në sekonda të Pauzave frymëmarrëse të brendshme (me shifra të trasha janë shënuar vlerat më të ulëta dhe më të larta për çdo kategori)

	Kohëzgjatja në sekonda e Pauzës frymëmarrëse të brendshme (IBP)				
	n.	Minim.	Maksim.	Mesat.	σ
Tirana1	1	0.33	-	-	-
Tirana2	26	0.16	0.45	0.29	0.05
Tirana3	5	0.25	0.38	0.31	0.06
Mali i Zi1	8	0.34	0.53	0.39	0.05
Mali i Zi 2	10	0.24	0.76	0.45	0.18

Maqedonia1	6	0.28	0.40	0.34	0.05
Maqedonia2	6	0.24	0.35	0.30	0.03
Maqedonia3	12	0.24	0.71	0.35	0.12
Kosova	16	0.19	1.56	0.37	0.32
Serbia1	12	0.25	0.45	0.33	0.06
Serbia2	4	0.29	0.34	0.31	0.02
Bullgaria1	11	0.32	0.52	0.41	0.07
Bullgaria2	12	0.28	0.84	0.55	0.20
Turqia1	12	0.28	0.84	0.55	0.20
Turqia2	6	0.38	0.52	0.74	0.46

Tab. 4. Radio Tirana: të dhënat mbi tre spikerët

Grupi Frym.	Spikeri 1 - § 6.1.			Spikerja 2 - § 6.2.		
	Zgjatja në sek.	Pauzë në sek.	Numri i rrokjeve	Zgjatja në sek.	Pauzë në sek.	Numri i rrokjeve
1	13,53	0,33	99	8,14	0,33	55
2	3,69		25	4,63	0,29	33
3	Spikeri 3			4,30	0,33	28
4	9,78	0,31	57	4,75	0,33	27
5	6,35	0,38	44	3,71	0,29	28
6	5,46	0,39	29	1,26	0,24	8
7	4,53	0,26	31	5,99	0,32	42
8	2,5	0,25	16	6,42	0,37	39
9	1,84		15	3,47	0,34	22
10				4,79	0,31	35
11				3,44	0,30	23
12				5,10	0,31	38
13				3,78	0,28	26
14				1,63	0,22	12
15				1,52	0,23	11
16				1,16	0,26	7
17				5,11	0,29	32
18				0,94	0,24	6
19				5,96	0,30	44
20				4,75	0,31	31
21				6,84	0,29	49
22				1,29	0,25	6
23				4,18	0,45	29
24				3,58	0,30	24
25				2,44	0,20	17
26				1,79	0,16	11
27				2,44		14
Σ	17,22	0,30	124	103,41	7,54	697

x	8,61	-	62	3,83	0,29	25,81
σ	6,95	-	56	1,93	0,05	13,66
Spikeri 3 - § 6.3.						
Σ	30,46	1,59	192			
x	5,07	0,31	32			
σ	2,87	0,06	16,27			

Tab. 4.1. Radio Tirana: të dhënat e përbashkëta

	Zgjatja në sek.	Pauzë në sek.	Numri i rrokjeve	Spikeri 1	Spikerja 2	Spikeri 3	Spikerët 1+2+3
Σ	151,09	9,46	1013				
x	4,31	0,29	28,94	Articulation Rate	7,20	6,74	6,46
σ	2,62	0,05	18,33	Speaking Rate	7,07	6,28	5,99
							6,70
							6,30

Tab. 4.2. Radio Tirana: Përshpejtimi i nyjetimit dhe i të folurit

Tab. 5.. Radio Mali i Zi: të dhënat për dy spikerët

Grupi Frym.	Spikeri 1 - § 6.4.			Spikeri 1(2) - § 6.5.		
	Zgjatja në sek.	Pauzë në sek.	Numri i rrokjeve	Zgjatja në sek.	Pauzë në sek.	Numri i rrokjeve
1	5,21	0,43	29	8,59	0,49	52
2	6,72	0,34	37	5,44	0,31	34
3	1,2	0,36	7	3,38	0,34	22
4	1,06	0,40	6	1,39	0,24	10
5	4,29	0,37	26	2,17	0,68	14
6	3,95	0,53	25	4,4	0,34	23
7	2,3	0,39	13	4,38	0,76	19
8	1,26	0,37	8	4,45	0,39	31
9	4,4		26	3,65	0,32	22
10				3,62	0,65	24
11				4,03		24
Σ	30,39	3,19	177	45,5	4,52	275
x	3,37	0,39	19,66	4,13	0,45	25
σ	2,01	0,05	11,31	1,85	0,18	11,18

Tab. 5.1. Radio Mali i Zi: të dhënat e përbashkëta

	Zgjatja në sek.	Pauzë në sek.	Numri i rrokjeve
Σ	75,89	7,71	452
x	3,79	0,42	22,6
σ	1,91	0,14	11,27

Tab. 5.2.. Radio Mali i Zi: Përshpejtimi i nyjetimit dhe i të folurit

	Spikeri 1	Spikeri 1 (2)	Spikeri 1+2
<i>Articulation Rate</i>	5,82	6,04	5,95
<i>Speaking Rate</i>	5,27	5,41	5,40

Tab. 6. Radio Maqedonia: të dhënat për spikerët 1-2

Grupi	Spikerja 1 - § 6.6.			Spikerja 1(2) - § 6.7.		
	Zgjatja në sek.	Pauzë në sek.	Numri i rrokjeve	Zgjatja në sek.	Pauzë në sek.	Numri i rrokjeve
1	5,54	0,36	37	4,65	0,29	29
2	2,84	0,28	17	2,74	0,31	18
3	3,10	0,39	22	4,52	0,35	30
4	2,83	0,31	19	2,72	0,33	21
5	3,33	0,40	24	3,75	0,32	26
6	4,21	0,30	25	2,27	0,24	16
7	2,28		14	1,03		7
Σ	24,13	2,04	158	21,68	1,84	147
x	3,14	0,34	22,57	3,09	0,30	21
σ	1,09	0,05	7,45	1,29	0,03	8,16

Tab. 6.1. Radio Maqedonia: të dhënat për Spikerin 3

Grupi Frym.	Spikeri 3 - § 6.8.		
	Zgjatja në sek.	Pauzë në sek.	Numri i rrokjeve
1	2,21	0,26	13
2	1,14	0,24	6
3	2,67	0,33	16
4	3,08	0,36	18
5	3,01	0,71	17
6	1,97	0,29	12
7	3,01	0,39	15
8	0,89	0,30	5
9	1,77	0,30	10
10	3,69	0,37	27
11	3,70	0,40	20
12	2,91	0,35	17
13	3,81		24
Σ	33,86	4,30	200
x	2,60	0,35	15,38
σ	0,94	0,12	6,35

Tab 6.2. Radio Maqedonia: të dhënat e përbashkëta

	Zgjatja në sek.	Pauzë në sek.	Numri i rrokjeve
Σ	79,67	8,18	505
x	2,95	0,34	18,70
σ	1,10	0,09	7,60

Tab. 6.3. Radio Maqedonia: Përshpejtimi i nyjetimit dhe i të folurit

	Spikerja 1	Spikerja 1(2)	Spikeri 3	Spikerët 1+2+3
Articulation Rate	6,54	6,78	5,90	6,33
Speaking Rate	6,03	6,25	5,24	5,74

Tab. 7. Radio Kosova: të dhënat e spikerit

Spikeri 1 - § 6.9.			
Grupi Frym.	Zgjatja në sek.	Pauzë në sek.	Numri i rrokjeve
1	5,46	0,19	31
2	2,31	0,34	15
3	5,82	0,30	35
4	1,10	0,32	5
5	3,90	0,30	8
6	2,82	0,32	19
7	3,13		24
8	5,44	0,18	32
9	6,79	0,24	46
10	2,41	1,56	14
11	2,04		14
12	2,63	0,33	18
13	2,07		14
14	3,87	0,35	27
15	3,51	0,36	21
16	1,86	0,27	12
17	2,86	0,26	17
18	3,39	0,34	20
19	4,48	0,33	28
20	1,08		7

Tab. 7.1. Radio Kosova: të dhenat e përbashkëta për çdo grup të të folurit

	1 Zgjatja në sek.	1 Pauzë në sek.	1 Numri i rrokjeve	2 Zgjatja në sek.	2 Pauzë në sek.	2 Numri i rrokjeve	3 Zgjatja në sek.	3 Pauzë në sek.	3 Numri i rrokjeve	4 Zgjatja në sek.	4 Pauzë në sek.	4 Numri i rrokjeve
Σ	24,54	1,77	137	16,68	1,98	106	4,70	0,33	32	21,05	1,91	132
x	3,50	0,29	19,57	4,17	0,66	26,5	2,35	-	16	3,00	0,31	18,85
σ	1,69	0,05	11,22	2,31	0,78	15,52	0,39	-	2,82	1,18	0,04	7,60

Tab. 7.2. Radio Kosova: të dhenat e përbashkëta

	Zgjatja në sek.	Pauzë në sek.	Numri i rrokjeve
Σ	66,97	5,99	407
x	3,34	0,37	20,35
σ	1,58	0,32	10,36

Tab. 7.3.. Radio Kosova: Përshpejtimi i nyjetimit dhe i të folurit

	Spikeri 1
Articulation Rate	6,07
Speaking Rate	5,57

Tab. 8. Radio Serbia: të dhenat për një spikere

Grupi Frym.	Spikerja 1 - § 6.10.			Spikerja 1(2) - § 6.11.		
	Zgjatja në sek.	Pauzë në sek.	Numri i rrokjeve	Zgjatja në sek.	Pauzë në sek.	Numri i rrokjeve
1	8,18	0,26	39	11,31	0,31	59
2	4,48	0,31	26	1,09	0,34	5
3	4,52	0,39	26	5,03	0,29	26
4	4,81	0,45	26	3,18	0,33	16
5	8,66	0,41	47	2,88		16
6	4,09	0,25	19			122
7	5,42	0,30	27			
8	2,29	0,31	13			
9	3,12	0,34	20			
10	5,42	0,32	26			
11	4,86	0,38	23			
12	3,72	0,28	17			
13	3,17		16			
Σ	62,74	4,0	325	23,49	1,27	122

x	4,82	0,33	25	4,69	0,31	24,4
σ	1,84	0,06	9,31	3,95	0,02	20,71

Tab. 8.1. Radio Serbia: të dhënat e përbashkëta

	Zgjatja në sek.	Pauzë në sek.	Numri i Rrokjeve
Σ	86,23	5,27	447
x	4,79	0,32	24,83
σ	2,46	0,05	13,74

Tab. 8.2. Radio Serbia: Përshpejtimi i nyjetimit dhe i të folurit

	Spikerja 1	Spikerja 1 (2)	Spikerja 1+2
Articulation Rate	5,18	5,19	5,18
Speaking Rate	4,86	4,92	4,88

Tab. 9.1. Radio Bullgaria: të dhënat për dy spikerët

Grupi Frym.	Spikerja 1 - § 6.12.			Spikerja 2 - § 6.13.		
	Zgjatja në sek.	Pauzë në sek.	Numri i rrokjeve	Zgjatja në sek.	Pauzë në sek.	Numri i rrokjeve
1	7,39	0,47	35	3,13	0,39	12
2	4,83	0,34	21	6,27	0,58	30
3	1,97	0,48	9	4,28	0,45	23
4	8,72	0,44	41	5,03	0,65	22
5	2,07	0,34	10	4,67	0,29	24
6	6,57	0,34	29	2,73	0,66	13
7	5,03	0,52	24	4,32	0,41	20
8	2,97	0,32	14	3,29	0,31	16
9	3,80	0,44	15	5,78	0,74	28
10	5,81	0,51	29	5,78		20
11	3,44	0,35	15			
12	5,50		24			
Σ	58,1	4,55	266	45,28	4,48	208
x	4,84	0,41	22,16	4,52	0,49	20,8
σ	2,09	0,07	1°,05	1,21	0,16	5,92

Tab. 9.2. Radio Bullgaria: të dhënat e përbashkëta.

	Zgjatja në sek.	Pauzë në sek.	Numri i Rrokjeve
Σ	103,38	9,03	474
x	4,69	0,45	21,54
σ	1,72	0,12	8,27

Tab. 9.3. Radio Bullgaria: Përshpejtimi i nyjetimit dhe i të folurit

	Spikeri 1	Spikeri 2	Spikeri 1+2
Articulation Rate	4,57	4,59	4,58
Speaking Rate	4,24	4,18	4,21

Tab. 10. Radio Turqia: të dhënat për dy spikerët

Grupi Frym.	Spikeri 1 - § 6.14.			Spikerja 2 - 6.15.		
	Zgjatja në sek.	Pauzë në sek.	Numri i rrokjeve	Zgjatja në sek.	Pauzë në sek.	Numri i rrokjeve
1	7,32	0,28	40	4,96	0,52	25
2	5,15	0,73	26	4,99	0,42	26
3	11,08	0,32	63	2,20	1,23	11
4	3,66	0,84	19	5,73	0,49	29
5	5,76	0,73	35	5,81	1,45	32
6	10,48	0,35	55	8,43	0,38	41
7	2,30	0,53	12	5,51		29
8	5,21	0,66	30			
9	6,2	0,83	33			
10	7,49	0,57	35			
11	2,38	0,45	13			
12	4,02	0,35	24			
13	5,54		32			
Σ	76,59	6,64	417	37,63	4,49	193
x	5,89	0,55	32,07	5,37	0,74	27,251
σ	2,70	0,20	14,73	1,82	0,46	9,01

Tab. 10.1. Radio Turqia: të dhënat e përbashkëta

	Zgjatja në sek.	Pauzë në sek.	Numri i rrokjeve
Σ	114,22	11,13	610
x	5,71	0,61	30,5
σ	2,39	0,31	12,95

Tab. 10.2. Radio Turqia: Përshpejtimi i nyjëtimit dhe i të folurit

	Spikeri 1	Spikeri 2	Spikeri 1+2
Articulation Rate	5,96	5,12	5,91
Speaking Rate	5,44	4,58	5,34

5. Shënime gjuhësore

Vijojnë disa prej dukurive gjuhësore kryesore duke marrë si pikë referimi dhe si model shqipen e radio Tiranës me të cilën do të krahasojmë realizimet e tjera të ndara në dy grupe. Në grupin e parë hyn të folurit e spikerëve që kanë shqipen si gjuhë amtare (emisionet e radiove të Kosovës, Malit të Zi dhe Maqedonisë); në të dytin hyjnë spikerët e tjerë, të cilët përdorin shqipen si gjuhë të huaj (emisionet e radiove të Bullgarisë, Serbisë dhe Turqisë). Ndryshimet fonetike kryesore, sipas dëgjimit, dalin krejtësisht në pah në cilësinë e fonemave zanore¹⁵, në nyjëtimitin e bashkëtingëlloreve dhe në intonacion, por në këtë paragraf do të përshkruhen vetëm dukuritë kryesore që dallojnë ose bashkojnë informatorët.

5.1. *Radio Tirana*. Dy spikerët e radio Tiranës ndryshojnë si nga pikëpamja e përshpejtimin të nyjëtimit, ashtu edhe nga mënyra e shqiptimit. Siç dëshmojnë tekstet, spikeri nyjëton në mënyrë më të qartë dhe tregon më pak rindertime fonetiko-fonologjike në të folurit e vet, dukuritë që paraqiten janë: fshirja pothuajse e rregullt e *ë*-së së patheksuar në pozicion fundor dhe në mes të fjalës [an'tarət], [təm'da], neutralizimi i kundërvënies *rr~r*, reduktimi i diftongut zbritës *-ij* në *-i* pozicion fundor; shqiptimi i *e*-së si [ə] para hundoreve: [vənd] 'vend', [ku'vənd] 'kuvend' ¹⁶; efekte të sand-

¹⁵ Por nuk është ky vendi për analizën fonetike të tingujve. Ndryshimet në sistemet zanore të shqipes dhe të kosovarishtes u vunë tashmë në dukje prej Moosmüller, Granser 2006, kurse për sa i përket VOT-it, nga Belluscio 2002.

¹⁶ Dodi (2004:222) pohon se "Norma e drejtshkrimit për fjalët me e+bashkëtingëllore hundore është vendosur për gjuhën e shkruar në gjuhën letrare. Në gjuhën e radios, të televizionit, të teatrit kësaj norme me disa lëkundje i përgjigjet edhe shqiptimi", dhe më pas: "Norma e drejtshqiptimit mbi

hit [pər, mezdisku'timit]; spikerja paraqet të njëjtat dukuri, por në nivel më të lartë, efekti i sandhit del më shpesh, ashtu si edhe fshirja e *ë*-së së patheksuar në vende të ndryshme, pra shtohet fshirja e *h*-së brenda dhe në fund të fjalës [ʃp_reu] 'shprehu', [ndər'ko] 'ndërkohë', reduktimi (jo i rregullt) i *-a*-së në togzanorin *-ua*:- ftuër, zhvilluëra, u realizuën, por: u respektua, u numërua; shurdhimi i bashkëtingëlloreve të zëshme në fund të fjalës: [ruk] 'rrugë', [inten'sif] 'intensiv'; lëkundja në shqiptimin e *c*-së si [tʃ] procesin ~ proceset; për efektin e izokronisë theksore fuqia e theksit bën që të tkurren tingujt dhe rrokjet si në [ba'fortja] 'bashkëshortja', [jati'viti] 'gjatë këtij viti', [jicytə'tarət] 'gjithë qytetarët'.

5.2. *Radio Mali i Zi*. Shqipja e përdorur nga spikeri i kësaj radioje, nga ana dëgjimore i ngjan asaj të spikerit maqedonas, për intonacionin, për cilësinë e zanoreve, për shqiptimin në përgjithësi. Megjithatë kjo paraqet disa tipare të veçanta. Togzanori *ua* ashtu si edhe në spikerë të tjerë mund të kalojë në [uə]~[u]: [e'huəj], ['rujtjes]; [r]>[r] por ruan vetinë e bashkëtingëllores njëdridhëse; /j/ para zanoreve ka prirje të mos shqiptohet: [proekt'liʃit] 'projektligjit', [pa'lee] 'pa leje', [dotə'tet] 'do të jetë', [temi] 'të jemi'; *-en-* ruhet si e tillë: kuvendin, por ndonjëherë pëson edhe kalimin në [ə] [rənd] 'rend'; /h/ nuk pëson fshirje; zanoret e patheksuara mund të qendërzohen në [ə]; nyjëtimi i /l/ paraqet qiellzorëzim të ndjeshëm [l] ~ [ɬ] [eɬav'diʃme] 'e lavdishme'; sandhi këtu nuk paraqitet, del rrallë ndonjë shembull zëshmimi [mjə'dizi] ose shurdhimi fundor të bashkëtingëlloreve [tus] 'Tuz'; efekti i sandhit nuk shfaqet; ndikimi i gegërishtes paraqitet p. sh. në kalimit /ɲ/ > [n] dhe të togut bashkëtingëllor /mb/ > /m/ [ʃum'komshe] 'shumëkombëshe' [,dymienim'ðjet] 'dymijenjëmbëdhjetë'.

5.3. *Radio Maqedonia*. Konsiderojmë këtu vetëm materialin tepër të shkurtur të spikerit me origjinë maqedonase, duke qenë se të folurit e spikerës i ngjan atij të spikerëve shqiptarë të përshkruar në 5.1. Edhe këtu vërehet fshirja pothuajse e plotë e *ë*-së së patheksuar fundore dhe, në

bazën e formave me *e* po përhapet gjithnjë e më shumë jo vetëm në shqiptimin e kujdesshëm (neutral) por edhe në atë bisedor." Pra, për sa i përket *ë*-së së patheksuar në rrokje jonistore, shkruan: "Mjetet e komunikimit masiv, radioja, televizioni, filmi si edhe shkolla, për normën e gjuhës letrare orientohen në këto raste nga norma e gjuhës së shkruar duke e ruajtur në shqiptim këtë zanore." Por, me sa duket, dhe sipas dëshmisë së materialeve tona dhe të transkriptimeve, sot situata është krejt e ndryshme.

shumë raste, të saj në pozicion të brendshme të fjalës; si edhe shqiptimi i disahershëm i /ə/ si [e]. Dridhësja /r/ neutralizohet me /r/ por kjo e fundit nuk ka prirje të shqiptohet si tingull përafrues; fërkimorja /h/ shqiptohet me ferkim të ndjeshëm, por në kontekst ndërzanor ka prirje të kalojë në zero; diftongu zbritës -ij ka prirje të shqiptohet -i në pozicion fundor. Vërehet gjithashtu ndikimi i sandhit [,sodəzɔbərəali'tet] 'sot është bërë realitet', me fshirjen e tingujve/rrokjeve si në [midiz'matfeonizðe'ʃip'ris] 'midis Maqedonisë dhe Shqipërisë'.

5.4. *Radio Kosova*. Për shqipen e Kosovës kemi pak të dhëna për të shprehur një mendim të përgjithshëm. Radion e Kosovës nuk arritëm ta dëgjoni në internet dhe lajmin e vetëm që kemi përdorur e kemi gjetur rastësisht. Ai nuk është i mjaftueshëm për të dhënë përfundime por na jep padyshim mundësi për të nënvizuar: a) fshirjen pothuajse të rregullt të *ë*-së fundore dhe, në shumë raste në pozicion të brendshëm; qendërzimin e zanorëve në drejtim të /ə/ [ɲə'tosjen] 'njollosjen', shqiptimi mjaft i rregullt i *q*-së dhe *gj*-së si [tɕ ~ tʃ] dhe [dʒ ~ dʒ], fshirja e *h*-së në pozicione të ndryshme; shqiptimi i /r/ si tingull njëdridhës dhe jo si aproksimante; përceptimi i shurdhimit të bashkëtingëlloreve të zëshme si [,nukto'tje(t)] 'nuk do të jetë', [dymije'θjetes] 'dymijë e dhjetës', ruajtja e shqiptimit të *e*-së para bashkëtingëllore hundore ['vendit] 'vendit', zëshmimi paravajtës në kontekst sonor lidhur edhe me efektin e sandhit [,pavar'sizeka(n)] 'pavarësisë e kanë', [pazven'dimi(t)] 'pas vendimit'.

5.5. *Radio Serbia*. Për radiot në të cilat shqipja përdoret nga folës që e kanë si gjuhë të huaj ndërvepron në shqiptimin e tyre edhe i ashtuquajturit substrat gjuhësor të gjuhës amtare, atëherë këto shënime duhej të pajiseshin edhe me analizë krahasuese të strukturës fonetiko-fonologjike të, bullgarishtes, serbishtes dhe turqishtes (këto dy gjuhët e fundit paraqesin pra edhe strategji kohore nga shqipja duke qenë gjuhë me izokroni silabike, d.m.th. syllabic-timed) pse, përveç ritmit dhe intonacionit ndikime do të veprojnë edhe në nivelin fonologjik dhe fonetik të cilit i mbivendoset shqipja.

Spikerja e radio Serbisë paraqet fshirjen e rregullt të /ə/ fundore, por ruajtjen pothuajse komplete të saj në pozicion të brendshëm; shqiptimin e *q*-së dhe të *gj*-së si [tɕ]~[tʃ], [dʒ]~[dʒ]. Nuk duket se vepron shumë dukuria e qendërzimit të zanoreve të patheksuara; struktura rrokjesore të fjalëve në përgjithësi ruhet mirë, ashtu edhe nyjëtimi i /h/ (e cila në prani të zanoreve të përparme ka prirje të shqiptohet si [ç]; vërehet zëshmimi i fish-

këlllores /s/ para bashkëtingëlloreve të zëshme [sər'biz 'bɔris] ‘Serbisë Boris...’, [ʼazɲə] ‘asnjë’, [aznə'mars] ‘as në mars’; tërheqja e theksit nga rrokja e fundit në rrokjen paraprirëse [ʼat] ‘ata’; thyerja vokaliqe e *o*-së në rastin e [kəɾ'kwojm] ‘kërkojmë’; shqiptimi i *l*-së si [l]~[ɮ], [teɬe'gramin], [ɮi'ri-n], shurdhim në pozicion fundore të bashkëtingëlloreve [tə'maθ], vështirësi në nyjetimin e togut *ng-* [enəguʃəɫimit] ‘e ngushëllimit’.

5.6. *Radio Bullgaria*. Materiali i analizuar nuk është ai i tipit të lajmeve të mirefillta; spikeret lexojnë tekste që u drejtohen dëgjuesve të rubrikës ‘Kutia postare’ kështuqë shpejtësia e të folurit ndoshta është disi më e ulët lidhur si me tipologjinë e ‘lajmit’ edhe me përmbajtjen e tij. Tërheq vëmendjen sidomos theksi i fortë i bullgarishtes si edhe izokronia theksore e kësaj gjuhe (Dimitrova 1997, Barry dhe Andreevna 2001). Për faktin se spikeret lexojnë shumë ngadalë, ato ruajnë në një nivel të lartë rrokjet, dhe madje shtojnë edhe disa tinguj zanorë të cilët, me sa duket, rikrijojnë strukturën tipike të bullgarishtes, e cila si gjuhë paraqet një strategji kohore që në disa aspekte ndryshon nga ajo e shqipes. Rreth përdorimit të shqipes standarde në emisionet e Radio Bullgarisë kemi në dispozicion përshkrimin e bërë nga Bejleri (2002) në të cilën shqyrtohet aspekti fonetik, morfologjik, sintaksor dhe leksikor i shqipes së përdorur në emisione. Ndonëse autorja përqendrohet mbi normën gjuhësore, përta i përket fonetikës edhe ajo vë në dukje disa dukuri, me të cilat pajtohem. Për sa na përket, këtu Spikerja 1 paraqet një shqiptim i cili nxjerrë më shumë në pah ndikimin e bullgarishtes sesa Spikerja 2. Trajtat kryesore janë: shqiptimi i bashkëtingëlloreve *q, gj* si *ç, xh* (sidomos Spikerja 1): *miçt, façen, çë, tunxhatjeta, dexhues, suxherimet*; shurdhimi i bashkëtingëlloreve të zëshme në fund të fjalës: *i math, funtë, njerës*; prirja drejt qiellzorëzimit të bashkëtingëlloreve para zanoreve të larta: *tjyre* (< *tyre*), dhe të togjeve *tj* si [c] dhe *dj, di-, dy-* si [ʃ]; fshirja e *ë*-së fundore (por me përjashtime), fshirja e *ë*-së në pozicion të brendshëm: *mir[ë]njohjen, Shqip[ë]ri*; qendërzimin e zanoreve të patheksuara (a>ë); *nderuër, emisjonëve, Bullgëri, krijuër*; kalimi i *ë*-së së patheksuar në *e*: *pershëndes, perzemërisht, te* (<të), shtesën apo ndërfitjen e një tingulli eufonik në disa raste: *sot a nderin, te programite, në funtë, shkurtë, një vendë, interesë*; përdorimi i mbiemrit pronor me një të përparme: *emisjonet e tona, materialet e tona, miçt e tanë, emisjonet të tona*; neutralizimi i opozicionit *r~ rr*: *regullisht*; ruajtja e *h*-së (si [h] ose si [x] në të gjitha kontekstet. Për sa i përket rangut të shpejtësisë së të folurit dhe të nyjetimit (matjet jepen në tabelat e mësipërme) shqipja e këtyre spikereve arrin nivelin më të ulët brenda kampionit të analizuar por, siç thamë,

kjo ndoshta është lidhur me tipologjinë e ‘lajmit’ dhe me kontekstin.

5.7. *Radio Turqia*. Turqishtja, ashtu si serbishtja, është gjuhë me izokroni silabike kështu spikerët e radio Turqisë, përveç intonacionit të substratit turk, paraqesin një nivel të lartë të ruajtjes së strukturës rrokjesore të shqipes, kjo ndoshta si rezultat e strategjisë të izokronisë silabike e cila tregon kështu prirjen për një shqiptim sa më të rregullt të të gjitha rrokjet, d.m.th. kemi këtu erozion rrokjesor shumë të vogël. Megjithatë edhe në dy materialet që kemi analizuar paraqiten dukuri që u takuan tashmë në materialet e tjera si: fshirja e *ë*-së fundore e cila ruhet mjaft mirë në pozicion të brendshëm; nyjëtimi i /r/ si [r], jemi pra në prani të të njëjtit neutralizim që kemi vënë re edhe në spikerë të tjerë por me ruajtjen e tipareve të bashkëtingëllores njëdridhëse dhe jo të përafrueses [ɾ]; shurdhimi i bashkëtingëlloreve të zëshme në fund të fjalës: [juk] ‘jug’, [funt] ‘fund’; ruajtja pothuajse e plotë e /h/ e cila paraqitet me fërkim të fortë dhe grykor [x]; reduktimi i togzanorit *ua* > [uə]; zgjatja e zanoreve në vende që nuk janë të natyrshme për shqipen: [tə'ga:zit] ‘të gazit’, [sem ' bi:plat ' format] ‘se mbi platformat’, [' pa:pilot] ‘pa pilot’; fshirja e tingujve të tjerë dhe të rrokjeve [dek ' ra:t] ‘deklaratë’, [dekrə ' atən] ‘deklaratën’, [parlemə ' rimeve] ‘paralajmëtimeve’. Me sa duket shqiptimi i *j*-së në pozicion pas zanoreve lidhet me nivelin fonologjik të turqishtes (Göksel 2005) si në rastin e sapo transkriptuar të fjalës ‘paralajmëtimeve’ dhe në disa të tjera: [' laemit], ashtu si edhe prania e një zanoreje protetike para disa togjesh bashkëtingëlloresh: [pjesaeg ' reke] ‘pjesa greke’, [radjuegreke] ‘radio greke’.

5.8. *Përfundim*

Me sa duket, ashtu siç ndodh sipas teorisë së valëve, nëse konsiderohet Shqipëria si qendër gjuhësore verifikohet pikërisht se aty veprojnë ndryshime divergjente nga rrathët periferikë ku, me sa duket ruhen trajta dhe dukuri që në qendër kanë evoluar, një risi, ose janë zhdukur, si p.sh. mosnyjëtimi i *h*-së, neutralizimi i kundërvënies *r~rr* dhe shqiptimi i *r*-së si tingull përafrues [ɾ], reduktimi i togzanorit *ua* > *uë* > *u*, shqiptimi i grupit *en* si *ën*, prirja për të shqiptuar /c/ dhe /j/ si [tɕ] [dʒ] deri në [tʃ] [dʒ], ndryshimi i ritmit në drejtimin e një rritjeje të shpejtësisë së nyjëtitimit dhe të të folurit. Kështu ndodh që shqipja e folur në Kosovë, Maqedoni dhe në Malin e Zi vazhdon të ruajë disa trajta fonetike, të cilat në shqipen e Shqipë-

risë janë duke ndryshuar. Kjo pra ka të bëjë edhe me ‘treguesit’ e standardit në shqiptim, të cilët vazhdojnë të mos merren parasysh në tekstet e cituar të fonetikës kushtuar shqipes. Nga ana tjetër duhet nënvizuar se shqiptimi i spikerëve të sotëm (por edhe në brezin e ri) është duke u larguar nga trajta e shkruar e gjuhës. Kjo prirje ka gjasa të vazhdojë edhe më tej në të ardhmen aq sa edhe për shqipen mund të ketë një shkëputje më të thellë midis të folurit dhe të shkruarit, çka do të krijojë edhe më probleme në përdorimin korrekt të gjuhës së shkruar. Sot e kësaj dite, në përdorimin e gjuhës së shkruar në rrjetet shoqërore të internetit, por edhe nga përvoja jonë reale, mund të vërehen p. sh. probleme në shkrimin e *q*-së dhe të *ç*-së (që shpeshherë ngatërrohen) të *r*-së dhe të *rr*-së, të *ë*-së dhe të *e*-së, të *h*-së etj. Pra në diskutimet (polemike) për rishikimin e standardit, për “reformatimin” e tij dhe për një riformulim të disa trajtave të standardit të sotëm nuk duhet të harrohen risitë gjuhësore që vihen re në gjuhën e folur si edhe nuk mund të mos mbahet parasysh fakti që sot shqipja dhe përdorimi i saj nuk janë kufizuar vetëm brenda kufijve të Shqipërisë dhe të Kosovës, ajo shtrihet edhe më tej, në vende të tjera shqipfolëse por edhe në “ishuj gjuhësorë” që përbëjnë rrjetin e redaksive të radiove ndërkombëtare ku shqipja përdoret prej jo-shqiptarëve, por edhe nga shqiptarë që jetojnë jashtë vendit pas mërgimit të fillimit të viteve ’90 ose edhe më parë. Në këto vende ‘virtuale’ sot shqipja e folur dhe e përdorur në shumë raste përputhet dhe pasqyron standardin madje edhe më shumë se sa respektohet në djepin e tij, atëherë, ndoshta, energjitë duhen harxhuar jo për një rishikim të bazës dialektore të standardit ose për një “standard të ri”, por tash për mosprishjen e sistemit të krijuar me mund gjatë dyzet viteve të fundit. Standardi sot bashkon jo vetëm shqiptarët në të gjitha vendet por vazhdon të jetë mjet komunikimi ndërkombëtar në nivele dhe kontekste të ndryshme, ashtu siç ka vënë mire në dukje Prifti (2005, 2009), ndër të cilat hyjnë edhe emisionet radiofonike ndërkombëtare të drejuara shqiptarëve kudo që janë¹⁷.

6. Tekstet dhe transkriptimi

Për transkriptimin e teksteve nuk u zgjodh transkriptimi fonetik, në mënyrë që materialet të jenë të kuptueshme nga një numër sa më të gjerë

¹⁷ “Shqipja standarde është pronë dhe mjet i përbashkët komunikimi i gjithë shqipfolësve, kudo që të ndodhen, duke përfshirë madje dhe ata të cilët e nxënë atë si gjuhë L2. (Prifti 2009:115).

lexuesish dhe, sidomos, për të nënvizuar se ato nuk i përkasin vetëm fushës së fonetikës por edhe fushave të tjera të gjuhësisë. Faktikisht ato mund të shfrytëzohen nga studiuesit e komunikimit, nga morfologët, sintaksologët, leksikologët, sociolinguistët, historianët e gjuhës etj. Duke qenë se ky është eksperimenti i parë i këtij lloji për gjuhën shqipe dhe duke propozuar këtu krijimin e një arkivi të të folurit radiofonik, u mor si shembull përvoja shkencore e disa projekteve si LIR (*Lessico dell'Italiano Radiofonico* = Leksiku i Italishtes Radiofonike) dhe CLIPS (*Corpora e Lessici dell' Italiano Parlato e Scritto* = Korpuset dhe Leksikët e Italishtes së Folur dhe të Shkruar)¹⁸ pikërisht për transkriptimet u mor si bazë Savy (2005) por, për qëllimet tona të pranishme nuk zgjodhëm transkriptimin drejtshkrimor siç propozon me shpjegime Savy, as kemi aplikuar të gjitha teknikat që ajo propozon dhe që u përdorën në CLIPS. Në 15 tekstet që vijojnë transkriptimet u bënë në mënyrë perceptuese (shpeshherë duke u mbështetur si në përdorimin e sonogrameve edhe në dëgjimin e ngadalësuar), duke vënë në dukje një sasi dukurish të fshehura si p.sh. fshirjen e tingujve, të rrokjeve, shurdhimin, zëshmimin, pauzat, ndërprerjen, gabime shqiptimi etj. Nuk u përdorën shenjat e pikësimit thjeshtë për të ruajtur konkretisht ndarjen e fjalive nëpërmjet frymëmarrjeve (lidhja e frymëmarrjeve me shenjat e pikësimit mund të verifikohet duke krahasuar këto transkripte me lajmet e shkruara që jepen në notat 19-21, ashtu siç janë botuar në faqet e internetit. U përdor metoda, skedimi dhe një pjesë e shenjave që përdoren në Savy (2005):

+	shënon fjalët e pambaruara: <i>ndërpr+</i> ‘ndërprerje’
-	shënon një ndërprerje të brendshme: <i>emi_sionet</i>
*	shënon gabime në shqiptim ose lapsuse duke nënvizuar që nuk janë gabime shtypi
/	shënon nisjen falso e të folurit, pauza ndërprerëse të shqiptimit
	shënon një pauzë të shkurtër por pa frymëmarrje
	shënon një pauzë të gjatë por pa frymëmarrje
<breath 0,32>	shënon vendin ku folësi merr frymë me zgjatjen në sekonda të frymëmarrjes; po me të njëjtat kllapa shënohet edhe çdo tjetër sinjal joverbal si kollitja, të qeshurit, kliket me gjuhë (nck!), pashtrimin e fytyrës etj.; çdo tingull tjetër shënohet me <vocal> (por në materialin tonë nuk paraqiten raste të tilla).
RD	Radio
is	Informacion-shërbim
KOM	Koment

¹⁸ Edhe këto projekte, siç pohon Savy (2005), u mbështetën faktikisht mbi përvojën ndërkombëtare.

6.1.

TEXT_Inf.

MATERIALI	RD
MAP:	
EMISIONI:	is
Numri i dialogut	1
Numri i emisionit	1
REGJONI:	Shqipja standarde
RADIO	TIRANA PER BASHKATDHETARET

SPEAKERS_Inf.

INFORMATORI	m.
p1	

RECORDING_Inf.

TIPOLOGJIA:	File WAV
EMR:	
VENDI:	TIRANA
DATA:	2011229
ZGJATJA:	17,52 sec
KONDITIONAT:	Studio radiofonike

TRANSCRIPTION_Inf.

DATA:	2011229
KOM:	G. Belluscio
STR: = breath groups	2

Kryeministri Berisha dhe bashk[ë]shortja e tij zonja Liri Berisha dhān[ë] sot një pritje për an[ë]tarët e kabinetit qeveritar me rastin e festës së fundvitit | duke nënvizuar se gjat[ë] kti[j] viti jan[ë] realizuar me ambicje të gjith[ë] objektivat e parashikuara | kryeministri Berisha *falënderoj an[ë]tarët e qeveris[ë] <breath 0,30> për mbështetjen *de për kushtimin e tyre në realizimin e reformave të m[ë]dhā.

6.2.

TEXT_Inf.

MATERIALI	RD
MAP:	
EMISIONI:	is
Numri i dialogut	2
Numri i emisionit	1
REGJONI:	Shqipja standarde
RADIO	TIRANA PER BASHKATDHETARET

SPEAKERS_Inf.

INFORMATORI p1	Enida Sinanaj, f.
----------------	-------------------

RECORDING_Inf.

TIPOLOGJIA:	File WAV
EMR:	
VENDI:	TIRANA
DATA:	2011229
ZGJATJA:	110,95 sek
KONDITIONAT:	Studio radiofonike

TRANSCRIPTION_Inf.

DATA:	2011229
KOM:	G. Belluscio
STR: = breath groups	27

Kryeministri Berisha dhe bashk[ësh]ortja e tij zonja Liri Berisha dhan[ë] nj[ë] pritje koktej për an[ë]tar[ë]t e qeveris[ë] me rastin e mbylljes së kti[j] viti dhe ardhjes së vitit e ri dymijedymbëdhjet[ë] <breath 0,33> kryeministri shpre[h]u mir[ë]njohje për gj[ë]t[ë] qytetarët sh[q]iptar për punën dhe sakrificat e tyre gjat[ë] [kë]t[ë] viti <breath 0,25> për punonj[ë]sit e *administratëz zyrtare | dhe bashk[ë]pun[ë]torët [e] tyre duke i *ftuër për të *vazhduër <breath 0,28> përpjekjet e përbashk[ë]ta në *zhdo fush[ë] | p[ë] r[e]alizimin e *prë[j]jektit më madh[or] | Sh[q]ip[ë]ria *vënd i zhvilluar <breath 0,31> kryeministri vler[ë]soi kontributin e të gj[ë]t[ë]ve | për *proçesin e reformave t[ë] gjith[ë]n[sh]me <breath 0,25> të ndërmar[r]a gjat[ë] kti[j] vitit <breath 0,21> k[ë]to reforma nënvizoj ai | bën[ë] të mundur që ky *vënd i vogël me *nj[ë] ekonomi jo t[ë] rënd[ë]sishme *kra[h]asuar me *vëndet e m[ë]dha të *zhvilluëra <breath 0,31> në një ko[h]ë të krizës më të thell[ë] | q[ë] *Europa ka njohur të përfomj[ë] | të funksionoj[ë] normalisht dhe të *mos njo[h]ë krizën dhe të r[e]alizoj[ë] me ambicje <breath 0,33> t[ë] gjitha objektivat e *parashikuëra në programin e saj nj[ë] vit më p[ar]ë <breath 0,29> kryeministri e *cilësoj k[ë]t[ë] vit si mjaft[ë] t[ë] rënd[ë]sishëm në aspektin e reformave të ndërmar[r]a në të gjitha fushat <breath 0,28> ai vler[ë]soi reformat struk-

turore si ndër më t[ë] rënd[ë]sishmet që *du[h]eshën ndërmār[rë] <breath 0,24> kryeministri tha se ambicjet e kti[j] viti ishin të mëdha | dhe ndër ko[hë] evidentoi dy nga procesët e mëdha të kti[j] viti <breath 0,29> *zgjidhjet lokale gja[të] të cilave u respektua kushtetuta dhe *zhdo vot[ë] e *qytëtar[ë]ve <breath 0,25> u numërua në mënyr[ë] tra[n]sparente <breath 0,21> si dhe *nji tjetër proces i rënd[ë]sishëm <breath 0,21> ishte dh[e] ai [i] censusit <breath 0,25> në objektivat madhore të k[ë]saj *qeverië | kân[ë] *qën[ë] r[r]itja e r[r]ogavë [e] *pensjoneve | dhe k[ë]to obj[ek]tiva u përmbushën plot[ë]sisht <breath 0,29> thā kryeministri <breath 0,23> në k[ë]të *përju[dhë] u *realizën prof[j]ekte të mëdha infrastrukturore që së shpejti shndër[r]oj[në] në ralitet ënd[ër]ra shekullore të qytetar[ë]ve sh[q]iptār[ë] <breath 0,29> siç ësh[të] autostrada Tiran[ë] Elbasan | dhë qindra e mij[ë]ra kilometra *r[r]uk[ë] të tjera n[ë] të katra anët e *vëndit <breath 0,31> so[t] Sh[q]ip[ë]ria renditet në telefonin[ë] mobile me kuotat më të larta n[ë] *Europ[ë] | dhe telefonia mobile e saj po shkon drejt teknologjive më t[ë] avancuara tre gë <breath 0,28> dhë shum[ë] shpejt katër gëë <breath 0,25> kryeministri *vler[ë]soj edhe ndryshimet në sistemi[n] sh[ë]ndet[ë]sor si dhe në fushat e tjera t[ë] rën[dë]sishme <breath 0,44> viti u mbyll me një deficit buxhetor | sipas parashikimit tre pik[ë] pes[ë] *përqint <breath 0,30> para kemi një vit tjetër *inte[n]sif | tha kryeministri <breath 0,19> nj[ë] vit i cili dallon nga *zhdo vit tjetër <breath 0,14> sepse *ëzhd[ë] viti i *njqin[d]vjetori[t] të pavar[ë]sis[ë].

6.3.

TEXT_Inf.

MATERIALI	RD
MAP:	
EMISIONI:	is
Numri i dialogut	3
Numri i emisionit	1
REGJONI:	Shqipja standarde
RADIO	TIRANA PER BASHKATDHETARET

SPEAKERS_Inf.

INFORMATORI p1	m.

RECORDING_Inf.

TIPOLOGJIA:	File WAV
EMR:	
VENDI:	TIRANA
DATA:	20111229
ZGJATJA:	32,05sec
KONDITIONAT:	Studio radiofonike

TRANSCRIPTION_Inf.

DATA:	20111229
KOM:	G. Belluscio
STR: = Breath Groups	5

*Xhdo ndryshim i mundshëm i sistemit zgjedhor do të vij vetëm *përmez diskutimit dhe *dakortsisë mes partive politike *nënvizoj sot kreu i prezencës së Osëbeës në Tiran[ë] Oigen Volfart <breath 0,31> duke ju përgjegjur interesi[t] *d[ë] mediave lidhur me kërkesën e partive të vogla me *njëë kor[r]ektim kombëtar të sistemit aktual zgjedhor <breath 0,36> Volfart deklaroi se është shum[ë] e rënd[ë]sishme *të mbahet një stabilitet e t[ë] mos kemi ndryshime të shpeshta <breath 0,39> po në të njëjtën koh[ë] është legjitime t[ë] *diskutohet edhe kur *bëhet në parlamen[t] në m[ë]nyrën e du[h]ur <breath 0,26> kjo mund [të] bëhet megjithatë i takon partive politike <breath 0,25> sī kũ dhe në ç' mënyr[ë] nënvizoj ambasadori Volfart.

6.4.

TEXT_Inf.

MATERIALI	RD
MAP:	
EMISIONI:	is
Numri i dialogut	4
Numri i emisionit	2

RECORDING_Inf.

TIPOLOGJIA:	File WAV
EMR:	
VENDI:	PODGORICA
DATA:	20111217
ZGJATJA:	33,58 sek.

REGJONI:	Shqipja standarde
RADIO	MALI ZI

SPEAKERS_Inf.

INFORMATORI p1	Senad GILIC, m.

KONDITIONAT:	Studio radiofonike
--------------	--------------------

TRANSCRIPTION_Inf.

DATA:	20111221
KOM:	
STR: = breath groups	9

Deputetët sh[q]iptar[ë] në parlamentin e Mal[it] t[ë] Zi Genc Inimabëgu Mehmet Bardhi dhe *Vasëj Sinishtaj <breath 0,43> kan[ë] *rëaguër ashpër kundër pro[j]jektligjit mbi *rendin dhe qet[ë]/sin[ë] publik[ë] e i cili së shpejti do të [j]et[ë] në votim në kuvendin e Malit e zi <breath 0,34> sipas këtij pro[j]jektligji <breath 0,36> mbi rendin dhe qet[ë]/sin[ë] <breath 0,40> *sanksjonohën shkeljet e rendit dhe sigurohen kushtet për funksjonimin e rendit publik <breath 0,37> ku ceket edhe përdorimi pa le[j]je i flëmurit apo *stemes së shtetit e *huëj <breath 0,53> deputetët shqiptar[ë] në kuvendin e Mal[it] t[ë] zi <breath 0,39> kan[ë] *dor[ë]/zuërë *amandamentin <breath 0,37> me qëllim të ru[a]jtjes së *drejtes së përdorimit e lir[ë] të flëmurit komb[ë]tar sh[q]iptar në Mal të zi.

6.5.

TEXT_Inf.

MATERIALI	RD
MAP:	
EMISIONI:	is
Numri i dialogut	5
Numri i emisionit	2
REGJONI:	Shqipja standarde
RADIO	MALI ZI

SPEAKERS_Inf.

INFORMATORI p1	Senad GILIC, m.

RECORDING_Inf.

TIPOLOGJIA:	File WAV
EMR:	
VENDI:	PODGORICA
DATA:	20111217
ZGJATJA:	50,02 sek.
KONDITIONAT:	Studio radiofonike

TRANSCRIPTION_Inf.

DATA:	20111221
KOM:	
STR: = breath groups	11

Tüz me pes[ë]mb[ë]dhjet[ë] dhjetor u shënua dita *ç[l]ërimit ku njëkoh[ë]sisht u mbajt edhe manifestimi me rastin e shënimit të përvjetorit të gjash[të]dhjet[ë] e shtat[ë] të *ç[l]ërimit *[t]e Tuzit <breath 0,49> kryetari i komunës urbane të Tuzit Nikoll[ë] Gegaj në fjalën e rastit *theksoj së kemi arsye t[ë] [j]emi krenar <breath 0,31> që i takojm[ë] keti[j] *mjedizi me të ar[r]iturat e *ljavdishme antifashiste <breath 0,34> të bashk[ë]jetesës së harmonishme <breath 0,24> *multienticitetit dhe multikonfesjonale <breath 0,68> siç tha Gegaj Mal[ë]sia shum[ë]kom[bë]she është[ë] mjaft e gjer[ë] për të gjith[ë] dhe nuk mun[d] të [j]et[ë] ndryshe <breath 0,34> na kan[ë] mësuar të parët të respektojm[ë] dhe të *ruëjm[ë] të *tjeret <breath 0,76> Gegaj poashtu përmendi edhe projektet e *ralizuërë dhe disa të cilat jan[ë] në realizim e sipër <breath 0,39> duke *theksuër se viti *dymi[j]enim[bë]dhjet[ë] për komunën urbane te Tuzit <breath 0,32> ka qen[ë] më i suksesshmi në dhjet[ë] vitet e kaluara për sa i takon investimeve <breath 0,65> *aj *ketu përmendi shifrën prej tre presje pes[ë] miljon euro të investuar në *ket[ë] vit.

6.6.

TEXT_Inf.

MATERIALI	RD
MAP:	
EMISIONI:	is
Numri i dialogut	6
Numri i emisionit	3

RECORDING_Inf.

TIPOLOGJIA:	File WAV
EMR:	
VENDI:	SHKUP
DATA:	20111219
ZGJATJA:	26,17 sek

REGJONI:	Shqipja standarde
RADIO	MAQEDONIA

SPEAKERS_Inf.

INFORMATORI p1	f. Mirela SAITI, f. (nga Shqipëria)

KONDITIONAT:	Studio radiofonike
--------------	--------------------

TRANSCRIPTION_Inf.

DATA:	20111221
KOM:	G. Belluscio
STR: = breath groups	6

Ka r[r]ezik real që shteteve t[ë] Ballkanit perendimor sërish t'u rivendoset rexhimi i vizave p[ë]r/r rajonin e Shëngënit <breath 0,36> nëse urgjentisht nuk e zgjidhin problemin me azilantët e r[r]em[ë] <breath 0,28> *k[ë]te ka deklaruar *Tanja Fajo[n] raportuese e parlamentit *europjan <breath 0,39> ajo *përkujtoj se në kuadër të institucionev[e] *europjane <breath 0,31> po zhvillo[h]en bisedime për mekanizmin e suspendimit të regjimit pa viza <breath 0,40> mekanizmi [i] ri mun[d] të hyj[ë] në fuqi kur ato do të kontraktohen për të gjitha holl[ë]s[ë]t[ë] <breath 0,30> dhe do të miratohen në parlament dhe këshill.

6.7.

TEXT_Inf.

MATERIALI	RD
MAP:	
EMISIONI:	is
Numri i dialogut	8
Numri i emisionit	3
REGJONI:	Shqipja standarde
RADIO	MAQEDONIA

SPEAKERS_Inf.

INFORMATORI p1	f. Mirela SAITI, f. (nga Shqipëria)

RECORDING_Inf.

TIPOLOGJIA:	File WAV
EMR:	
VENDI:	SHKUP
DATA:	20111219
ZGJATJA:	23,52 sek.
KONDITIONAT:	Studio radiofonike

TRANSCRIPTION_Inf.

DATA:	20111221
KOM:	G. Belluscio
STR: = breath groups	6

Mar[rë]veshja midis Maqedoniz[ë] dhe Sh[q]ip[ë]ris[ë] për kalim të kufijve shtet[ë]ror[ë] vetëm me letërnjoftime <breath 0,29> është përshëndetur nga sektor[i] i biznesit dhe i kulturës <breath 0,31> Menderës Kuçi dhe Ramada[n] Ramadani thon[ë] se kjo padysim do të lehtës[ë]j[ë] qarkullimin e njer[ë]zve <breath 0,35> gjë e cila do të r[r]is[ë] edhe bash[kë]punimin ekonomik dhe kulturor <breath 0,33> nd[ë]rkoh[ë] që mar[rë]veshja në fjal[ë] është[ë] përshëndetur edhe nga kreu i BëDëI-s[ë] Ali Ahmeti <breath 0,32> i cili premtion mar[rë]veshjet e njëjt[a] edhe më Kosovën <breath 0,24> raporton Bekim Laçi.

6.8.

TEXT_Inf.

MATERIALI	RD
MAP:	
EMISIONI:	is
Numri i dialogut	9
Numri i emisionit	3
REGJONI:	Shqipja standarde
RADIO	MAQEDONIA

SPEAKERS_Inf.

INFORMATORI p1	Bekim LAÇI, m.

RECORDING_Inf.

TIPOLOGJIA:	File WAV
EMR:	
VENDI:	SHKUP
DATA:	20111219
ZGJATJA:	38,16 sek.
KONDITIONAT:	Studio radiofonike

TRANSCRIPTION_Inf.

DATA:	20111221
KOM:	G. Belluscio
STR: = breath groups	12

Ajo që dje është/ë dukur e pabesueshme <breath 0,26> *sod *ëzh[të] bë[rë] realitet <breath 0,24> thot/ë lideri [i] *BëDË-s/ë Ali Ahmeti në letërën e tij/ë <breath 0,33> në të cilin përshëndet mar[rë]veshje/n midis *Maçe[d]oniz/ë dhe Sh[q]ip/ë/ris/ë <breath 0,36> për kalim *te kufiri/t/ shtet/ë/ror vetem me letërnjoftime <breath 0,71> e *njejta do t/ë nënshkru/h/et edhe me Kosovën <breath 0,29> sepse kjo është/ë politik/ë shtet/ë/rore thot/ë më tej Ahmeti <breath 0,39> bizne/s/ sektori <breath 0,30> poashtu ka përshëndetur këtë/ë vendim <breath 0,30> Menderes Kuçi kryetar i odës ekonomike të *Maçe[d]oniz/ë veriperendimore <breath 0,37> thot/ë për programin ton/ë se kjo padyshim leht/ë/son punën e sektori/t/ te tij/ë <breath 0,40> por thot/ë se ekonomia ka nevoj/ë edhe për dis/a/ *avansime <breath 0,35> në sferën e çarkullimit sa më të leht/ë e ekonomive të të dya vendeve.

6.9.

TEXT_Inf.

MATERIALI	RD
MAP:	
EMISIONI:	is
Numri i dialogut	10
Numri i emisionit	4
REGJONI:	Shqipja standarde
RADIO	KOSOVA

SPEAKERS_Inf.

INFORMATORI p1	m

RECORDING_Inf.

TIPOLOGJIA:	File WAV
EMR:	
VENDI:	PRISHTINA
DATA:	20111219
ZGJATJA:	72,96 sek.
KONDITIONAT:	Studio radiofonike

TRANSCRIPTION_Inf.

DATA:	20111221
KOM:	G. Belluscio
STR: = breath groups	10

Dymi/j/enjëmb/ë/dhjeta nuk *to t/ë je/të farë [e] le/h/t/ë për diplomacin/ë e Kosovës | të paktën jo muajt e par/ë të vitit | <breathless 0,19> përveç problemeve [të] tjera fund/i i *dymijethjetes <breath 0,34> nxori edhe raportin e Dik Martit | i vler/ë/suar gjer/ë/sish/t/ si dokument ç/ë synon *njëlloshjen e imazhit jo vetëm të Kosovës <breath 0,30> por t/ë gjj/thë sh[q]iptar/ë/ve || <breathless 0,32> vler/ë/simet bëhen nga ekspertja për diplomaci Ënhëllusha Morina <breath 0,30> drejtorë [e]gzekutive [e] I/n/stitutit Kosovar për Stabilitet || <breathless 0,32> ajo propozon një mënyr/ë të veçan/të për ta përmir/ë/suar imazhin e vendit.

...

Kosovën që nga shpallja e *pavar/ë/siz/ë e ka/në njohur shtat/ë/dhjet/ë e dy shtete vetëm tet/ë prej tyre xhat/ë vitit dymi/j/jedhjet/ë || <breathless 0,18> analistët adresojn/ë sidomos kritika për *mosshfryt/ë/zimin e situatës pas opinionit/t të çar/të dhe pozitiv/ë të xhykatës ndërkom/bë/tare të drejt/ë/sis <breath 0,24> për *lexhimitetin e shpallje/s së pavar/ë/zis/ë së Kosovës || <breathless 1,56> Ylli Hoxha nga klubi për politik/ë të jashtme...

...

Rezultati me vetëm tri njohje *paz vendimi/t të XhëNëDë-s <breath 0,33> *ehspertja Morina thot/ë se është/ë i pashpjegueshëm

...

Poashtu *Anxhellusha Morina thot/ë se politika kosovare *gjth/ë/nji ka çen/ë n/ë *defanziv <breath 0,35> dhe në pritje të ideve të reja nga disa ambasada *çë jan/ë në Kosov/ë <breath 0,36> kurse nga shtetet e mëdha që përfaq/ë/sojn/ë <breath 0,27> është/ë pritur që të *zjidhin çështjen e njohjeve për Kosovën | <breathless 0,26> xhat/ë dymijenjëmb/ë/dhjetës analistët *thojnë se du/h/et

ndryshuar çasja <breath 0,34> dhe *du[h]ët marr[ë] vendime t[ë] cilat do t[ë] pasohën me përmir[ë]/simin e imazhit të përxhithshëm të Kosovës <breath 0,33> në skenën ndërkombtare¹⁹.

6.10.

TEXT_Inf.

MATERIALI	RD
MAP:	
EMISIONI:	is
Numri i dialogut	11
Numri i emisionit	5
REGJONI:	Shqipja standarde
RADIO	SRBIJA INTERNATIONAL

SPEAKERS_Inf.

INFORMATORI p1	f.

RECORDING_Inf.

TIPOLOGJIA:	File WAV (i regjistruar me kasetë nga interneti)
EMR:	
VENDI:	BEOGRAD
DATA:	20111219
ZGJATJA:	66,74 sec (pa frym. 65,42)
KONDITIONAT:	Studio radiofonike

TRANSCRIPTION_Inf.

DATA:	20111219
KOM:	
STR: = breath groups	13

¹⁹ Emisioni i tërë i lajmit mund të dëgjohet këtu: www.youtube.com/watch?v=LAecQaqMmp8, kurse

teksti përkatës mund të lexohet në

www.rtklive.com/?cid=1&newsId=44701&mfR2xwe17013r1sDI6!U. “2011-a nuk do të jetë fare e lehtë për diplomacinë e Kosovës, të paktën jo muajt e parë të vitit. <breathless 0,19> Përveç problemeve tjera <breath 0,34> fundi i 2010-ës nxori edhe raportin e Dik Martit, i vlerësuar gjerësisht si dokument që synon njollosjen e imazhit jo vetëm të Kosovës <breath 0,30> por të gjithë shqiptarëve. Vlerësimet bëhen nga ekspertja për diplomaci, Engjëllushe Morina, <breathless 0,32> drejtoreshë ekzekutive e Institut Kosovar për Stabilitet. Ajo propozon një mënyrë të veçantë për të përmirësuar imazhin e vendit. [...]

Kosovën që nga shpallja e pavarësisë e kanë njohur 72 shtete, vetëm 8 prej tyre gjatë vitit 2010. <breathless 0,18> Analistët adresojnë sidomos kritika për mos-shfrytëzimin e situatës pas opinionit të qartë dhe pozitiv të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë <breath 0,24> për legjitimitetin e shpalljes së pavarësisë së Kosovës. <breathless 1,56> Ylli Hoxha nga Klubi për Politikë të Jashtme: [...]

Rezultati me vetëm tri njohje pas vendimit të GJND-së, <breath 0,33> ekspertja Morina thotë se është i pashpjegueshëm. [...]

Poashtu Engjëllushe Morina thotë se politika kosovare gjithnjë ka qenë në defanzivë <breath 0,35><breath 0,36> dhe në pritje të ideve të reja nga disa ambasada që janë në Kosovë, kurse nga shtetet e mëdha që përfaqësojnë <breath 0,27> është pritur që të zgjidhin çështjen e njohjeve për Kosovën. <breathless 0,26> Gjatë 2011-ës, analistët thonë se duhet ndryshuar çasja <breath 0,34> dhe duhen marr vendime të cilat do të pasohen nga përmirësimi i imazhit të përgjithshëm të Kosovës <breath 0,33> në skenën ndërkombëtare.”

Ministri²⁰ i mbrojtjes i Sërbisë [ë] Dragan Shutànovac ka deklaruar që për Kosovën dhe *Metohjin[ë] duhet gjet[ur] zgjidhja e sigurt[ë] dhe e përhershme <breath 0,26> e cila do të jet[ë] e pranueshme për të gjithë [ë] *at[a] që jetojnë [ë] në Kosovë [ë] e në *Metohjin[ë] <breath 0,31> por edhe për bashkësinë [ë] *europjane me të cilën Serbia dëshiron të integrohet <breath 0,39> duke mos marrë parasysh shtyrjen e ndarjes s[ë] stàtusit të kandidatit për anëtarësim <breath 0,45> duke folur për reformat e realizuara Shutànovac për gazetën *beogradëse Press ka thënë [ë] që është [ë] e çar[ë] që Serbia ka plotësuar të xhitha kushtet <breath 0,41> *por fatëkeqsisht Serbia ka n[ë] ngarkim që nuk e ka pasur *aznjë <breath 0,25> shtet që është [ë] integruar me bashkësinë [ë] *europjane dhe prandaj *kërkojmë [ë] zgjidhjen e qëndrueshme <breath 0,30> që do të jet[ë] e pranueshme për të gjithë <breath 0,31> edhe për Kosovën e *Metohjin[ë] edhe për bashkësinë [ë] *europjane <breath 0,34> duke komentuar mundësinë [ë] që Sërbisë [ë] nuk i [j]epet stàtusi kandidatit *az në mars <breath 0,38> ai ka shpjeguar që thelbi nuk është [ë] në datë por në modernizimin e shtetit <breath 0,32> datat nuk duhen të na dekurajojnë [ë] por n+ të na motivojnë [ë] <breath 0,28> që të punojmë [ë] edhe më shumë [ë] ka theksuar Shutànovac.

6.11.

TEXT_Inf.

MATERIALI	RD
MAP:	
EMISIONI:	is
Numri i dialogut	12
Numri i emisionit	5
REGJIONI:	Shqipja standarde
RADIO	SRBIJA INTERNATIONAL

SPEAKERS_Inf.

INFORMATORI	f.
p1	

RECORDING_Inf.

TIPOLOGJIA:	File WAV (i regjistruar me kasetë nga interneti)
EMR:	
VENDI:	BEOGRAD
DATA:	20111219
ZGJATJA:	24,76 sec
KONDITIONAT:	Studio radiofonike

TRANSCRIPTION_Inf.

DATA:	20111219
KOM:	
STR: = breath groups	5

²⁰ SHUTANOVAC: ZGJIDHJA PËR KDHEM-NË TË JETË E PRANUESHME EDHE PËR BE-NË. Ministri i Mbrojtjes i Sërbisë Dragan Shutanovac ka deklaruar që për KdheM-në duhet të gjetet zgjidhja e sigurtë dhe e përhershme, <breath 0,26> e cila do të jetë e pranueshme për të gjithë atë që jetojnë në KdheM-në, <breath 0,31> por edhe për BE-në me të cilën Serbia dëshiron të integrohet, <breath 0,39> duke mos marrë parasysh shtyrjen e ndarjes së stàtusit të kandidatit për anëtarësim. <breath 0,45> Duke folur për reformat e realizuara, Shutanovac për gazetën beogradëse "Press" ka thënë që është e qartë që Serbia ka plotësuar të gjitha kushtet. <breath 0,41> Por *fatëkeqsisht, Serbia ka ngarkim që nuk e ka pasur asnjë <breath 0,25> shtet që është integruar me BE-në dhe prandaj kërkojmë zgjidhjen e qëndrueshme <breath 0,30> që do të jetë e pranueshme për të gjithat, <breath 0,31> edhe për KdheM-në edhe për BE-në. <breath 0,34> Duke komentuar mundësinë që Sërbisë nuk i jepet stàtusi i kandidatit as në mars, <breath 0,38> ai ka shpjeguar që thelbi nuk është në data, por në modernizimin e shtetit. <breath 0,32> Datat nuk duhen të na dekurajojnë, por të na motivojnë <breath 0,28> që të punojmë edhe më shumë, ka theksuar Shutanovac.

Presidenti i *Serbiz[ë] Boris *Tadiç ua ka dërguar telegramin e ngushëllimit presidentit çek Vaclav Klausit dhe popullit çek me rastin e vdekjes s[ë] presidentit të parë të Çekisë[ë] së pavarur <breath 0,31> Vaclav Havèlit <breath 0,24> pranoni shprehjen e ngushëllimit më të sinqert[ë] me rastin e vdekjes së Vaclav Havèlit <breath 0,29> luftëtarit të math për demokracinë[ë] paqën dhe lirin[ë] <breath 0,33> ka theksuar Tadiç në teljegramin e ngushëllimit²¹.

6.12

TEXT_Inf.

MATERIALI	RD
MAP:	
EMISIONI:	is
Numri i dialogut	13
Numri i emisionit	6
REGJONI:	Shqipja standarde
RADIO	BULGARIA INTERNATIONAL

SPEAKERS_Inf.

INFORMATORI p1	Vësela Mãnçeva

RECORDING_Inf.

TIPOLOGJIA:	File WAV > nastro
EMR:	
VENDI:	SOFJA
DATA:	20110920
ZGJATJA:	62,65 sek.
KONDITIONAT:	Studio radiofonike

TRANSCRIPTION_Inf.

DATA:	20111221
KOM:	G. Belluscio
STR: = breath groups	11

*Tunxhatjeta *te *nderuer *dexhues *te *radio Bullgaris[ë] *de mir[ë] se erdhët në programin ton[ë] javor kutia postare <breath 0,47> sot *a nderin për ta drejtuar programin kushtuar letrave tuaja <breath 0,34> e kam un[ë] Vësela Mãnçeva <breath 0,48> në fillim të *programite desha *te shpreh mir[ë]njohjen tonë ndaj të *xhithë *dexhuësve t[ë] r[r]egullit[ë] t[ë] *emisjonëve tona në *xhuhën shqipe <breath 0,44> *te cilët *ne *dëxhojnë r[r]egullisht <breath 0,34> i falënderoj *xhithashtu *te *xhith[ë] *miçt[ë] t[an] [ë] të cilët i ndjekin *emisjonët *e tona në internet <breath 0,34> *de i lexojn[ë] *materjalet e tona në *façen elektronike t[ë] *radio Bullgaris[ë] <breath 0,52> *de në *funtë desha të pershëndes perzemërsisht <breath 0,32> *de të shpreh respektin ton[ë] *te *math ndaj *te *xhith[ë] *miçt[ë] *e tan[ë] <breath 0,44> të cilët *në shkruajn[ë] *çë të shprehin mendimet *de *suxherimet e *tjyre për *emisjonet *të tona <breath 0,53> *per të *xhith ata është[ë] kënga e p[ar] [ë] në programin ton[ë] <breath 0,35> ajo titullohet *është vjeshte dhe është ne interpretim të Asen Masllarskit.

6.13

TEXT_Inf.

MATERIALI	RD
MAP:	
EMISIONI:	is

RECORDING_Inf.

TIPOLOGJIA:	File WAV > shirit > WAVE
EMR:	
VENDI:	SOFJA

²¹ 18/12/2011. TADIÇ KA DËRGUAR TELEGRAMIN E NGUSHËLLIMIT ME RASTIN E VDEKJES SË HAVELIT. Presidenti i Serbisë Boris Tadiç ua ka dërguar telegramin e ngushëllimit Presidentit çek, Vaclav Klausit dhe popullit çek me rastin e vdekjes së presidentit të parë të Çekisë së pavarur, <breath 0,31> Vaclav Havelit. <breath 0,24> “Pranoni shprehjen e ngushëllimit më të sinqertë me rastin e vdekjes së Vaclav Havelit, <breath 0,29> luftëtarit të madh për demokracinë, paqën dhe lirinë” <breath 0,33> ka theksuar Tadiç në telegramin e ngushëllimit.

(http://glassrbije.org/A/index.php?option=com_content&task=view&id=10346&Itemid=26)

Numri i dialogut	14
Numri i emisionit	7
REGJONI:	Shqipja standarde
RADIO	BULGARIA INTERNATIONAL

SPEAKERS_Inf.

INFORMATORI p1	Ekaterina Tarpomànova, f

DATA:	20110930
ZGJATJA:	49,76 sek.
KONDIATAT:	Studio radiofonike

TRANSCRIPTION_Inf.

DATA:	20111221
KOM:	G. Belluscio
STR: = breath groups	

Grupi i miq të *radio Bullgaris[ë] në fejsbuk <breath 0,39> u krijua muajn[ë] *shkurtë të k[ë]/tij viti | nga *kolegjet tona Maria Peva dhe Ana Kapitànova <breath 0,58> atje publikojmë lidhje | për *materjale interesante të *radio Bullgaris[ë] <breath 0,45> kështu që *te kemi | edhe një mundësi për kontakte me ju dëgjuesit t[ë]n <breath 0,65> notojmë dhe njoftimë për shfaqje interesante të shqiptarëve në *Bullgëri <breath 0,29> dhë të bullgarëve në Shqip[ë]ri dhe në Kosov[ë] <breath 0,66> shpresojmë se *i kemi *krijuër një *vendë në hap[ë]/sirën virtuale <breath 0,41> ku mun[d] të takohen *njerës | me *interesë të përbashkët <breath 0,31> të shkëmbejnë idë dhe *te komentojnë çështje të lidhura | me popullin bullgar dhe atë shqiptar <breath 0,74> ju ftojme të vizitoni t[ë] gjith[ë] ju që përdorni r[r]jetin *social fejbuk.

6.14

TEXT_Inf.

MATERIALI	RD
MAP:	
EMISIONI:	is
Numri i dialogut	15
Numri i emisionit	8
REGJONI:	Shqipja standarde
RADIO	TURQIA TRT Zëri i Turqisë

SPEAKERS_Inf.

INFORMATORI p1	m

RECORDING_Inf.

TIPOLOGJIA:	File WAV > nastro
EMR:	
VENDI:	ANKARA
DATA:	20110920
ZGJATJA:	83,23 sek.
KONDIATAT:	Studio radiofonike

TRANSCRIPTION_Inf.

DATA:	20111221
KOM:	G. Belluscio
STR: = breath groups	12 (në të cilat dy janë pa frymëmarrje)

Pjesa e greke e Qipros i ka bër[ë] *veshët e shurdhër ndaj *par[a]/lemërimeve të Turqis[ë] dhe të republikës turke të Qipro[s] së veriut <breath 0,28> dhe | nisi | punimet për kërkimin e rezervave të gazit natyror n[ë] *mestdheun lindor <breath 0,73> sipas *laemi[t] të publikuar nga *radiu e *greku qipriote kompania amerikane Nobël Enërxi | që bën shpime për *gas natyror deklaroh[et] se mbrëm[ë] ka nisur *proces i shpimit në *parcelën e dymbëdhjet[ë] <breath 0,32> që ndodhet në *juk t'ishullit dhe që një[h]et ndryshe me emrin Afrodit <breath 0,84> *laemi u konfirmua edhe [n]ga departamenti [i] energjetikës pran[ë] ministris[ë] [së] industris[ë] dhe *trektië[së] së Qipros greke || <breath 0,73> *radjuja *greku qipriote bëri t[ë] *dhitër gjithashtu se mb̄i platformat shpimi t[ë] kompanis[ë] amerikane *fluturoin[ë] *avjon *spjunazhi p[ë] pilot [të] Izraelit dhe se n[ë] pjesën lindore të platformës <breath 0,35> j[an] [ë] p[ar] [ë] edhe anie të flotës detare <no breathing pause 0,53> nga qeveria *greku qiprjote nuk ka ardhur ende ndonjë dek[la]r[ë]t zyrtare në lidhje me k[ë]/të çështje <breath 0,66> në *dek[la]r[ë]t[ë]n e mëparshme zyrtare ishte bër[ë] e ditur se | shpimi do të fillonte kur të ishte e nevojshme <breath 0,83> ndërsa ministr[i] i mbrojtjes [së] *Gre-qis[ë] Panos Beglitis foli për mundësin[ë] e shkallëzimi[t] të *tensjonit n[ë] mesdhë ndërsa

tha <breath 0,57> ne nuk kemi frik[ɛ] nga kërcënimet e Turqīs[ɛ] || <no breathing pause 0,45> bashkimi *evropjan në lidhje me tensjonin e krijuar [n]ga punimet e njëanshme <breath 0,35> të eksplorimit *qi ka nisur pjesa *e greke e Qipros u bëri thir[r]je pal[ɛ]ve që të *ruëjn *gjahftohtës[ɛ].

6.15

TEXT_Inf.

MATERIALI	RD
MAP:	
EMISIONI:	is
Numri i dialogut	16
Numri i emisionit	8
REGJONI:	Shqipja standarde
RADIO	TURQIA TRT Zëri i Turqisë

SPEAKERS_Inf.

INFORMATORI p1	f.

RECORDING_Inf.

TIPOLOGJIA:	File WAV
EMR:	
VENDI:	ANKARA
DATA:	20110920
ZGJATJA:	42,12 sek.
KONDITIONAT:	Studio radiofonike

TRANSCRIPTION_Inf.

DATA:	20111221
KOM:	G. Belluscio
STR: = breath groups	

Kadafi²² i bëri thir[r]je popullit | lideri i r[r]ëzuar i Libīs[ɛ] Muamar Kadafi <breath 0,52> tha *së sistemi i drejtimit i ngritur në Libī | bazohej në vet[ɛ]vendosjen e popullit <breath 0,42> e se nuk do t'i jepej *funt k[ɛ]/tij rendi <breath 1,23> Kadafi në një regjistrim zanor | të transmetuar në *televizionën Araj | me qendër në Siri tha <breath 0,49> sistemi politik në Libī bazohet në forcën e popullit *de është[ɛ] e pamundur që ky system të zhduket <breath 1,45> mos i doni ata që vijn[ɛ] në pushtet me ndihmën e forcave ajrore dhe detare të dikuj tjetër dhe mos besoni se ata e kan[ɛ] *rëzuar *rexxhimin <breath 0,38> tha Kadafi dhe *shtoj gjithashtu fjalët se bombardimi ajror në Libī do të vazhdoj[ɛ] | në përjet[ɛ]si.

²² Kaddafi i bëri thirrje popullit...

Lideri i rrëzuar i Libisë Muamar Kadafi, <breath 0,52> tha se sistemi i drejtimit i ngritur në Libi, bazohej në vetëvendosjen e popullit <breath 0,42> dhe se nuk do t'i jepej fund këtij rendi. <breath 1,23>

Kadafi në një regjistrim zanor të transmetuar në televizionin Arrai me qendër në Siri tha: <breath 0,49> "Sistemi politik në Libi bazohet në forcën e popullit dhe është e pamundur që ky sistem të zhduket." <breath 1,45> *Muamar Kadafi pasi u bëri thirrje libianëve për mos ndryshimin të regjimit, i quajti ngjarjet në vend si "maskarallëk"* [kjo fjali nuk u lexua] "Mos i doni ata që vijnë në pushtet me ndihmën e forcave ajrore dhe detare të dikujt tjetër dhe mos besoni se ata e kanë rrëzuar regjimin", <breath 0,38> tha Kadafi dhe shtoi gjithashtu fjalët se bombardimi ajror në Libi do të vazhdojë në përjetësi"

(Nga: www.trt.albanian.com/trtworld/al/newsDetail.aspx?HaberKodu=371efbcb-e96b-45f4-b0cc-aa461a1f6c59).

7. Referime bibliografike

- Angoni E. (1984). Rreth gjuhës në radio dhe televizion. *Gjuha letrare kombëtare shqipe dhe epoka jonë*. Tiranë: Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, 487-493.
- Atzori E. (2002). *La parola alla radio. Il linguaggio dell'informazione radiofonica*. Firenze: Cesati Editore.
- Barry W., Andreeva B. (2001). Cross-Language Similarities and Differences in Spontaneous Speech Patterns. *Journal of the International Phonetic Association* 31.1, 51-66.
- Belluscio G., Mendicino A., Romito L. (1997). L'albanese standard: vocalismo e strategie temporali. *Quaderni del Dipartimento di linguistica dell'Università di Firenze*, Vol. 8. Firenze, pp. 105-116.
- Boersma, P. & Weenink, D. (2009). *Praat: doing phonetics by computer*. www.praat.org.
- Dankovičová J. (1999). Articulation Rate Variation within the Intonation Phrase in Czech and English. *Proceedings of the XIV International Congress of Phonetic Science*. San Francisco CA., 269-272.
- Dimitrova S. (1997). Bulgarian Speech Rhythm: Stress-Timed or Syllable-Timed? *Journal of the International Phonetic Association* 27, 27-33.
- Dodi A. (2004). *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe*. Tiranë: Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë.
- Göksel A., Kerslake C. (2005). *Turkish. A Comprehensive Grammar*. New York: Routledge.
- Grawunder S., Engert H., Kaiser H., S. Unger, I. Bose (2008). *Pitch, speech rate and rhythm as speaking style characterizing parameters in German news presentation*. (Poster i konsultueshëm në <http://email.eva.mpg.de/~grawunde/files/LondonRhWS08poster.pdf>)
- Hamiti A. (2005). Fonetika dhe fonologjia e gjuhës **standarde shqipe**. **Shkup: Interdiskont**.
- Hohn H. (1995). *A Linguistic Analysis of BBC Radio News*. Nordested: Grin Verlag.
- Hristova-Bejleri R. (2002). **Standarti [sic] gjuhësor në emisionet shqip të Radio Bullgarisë**. Konferenca "Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot". Tiranë 11-12 nëntor 2002.
- Hyman L. (1981). Fonologia. Bologna: Il Mulino.**
- Hysa M. (2007). *Struktura e rrokjes në gjuhën shqipe*. Temë për mbrojtjen e gradës Master. Tiranë: Universiteti i Tiranës. (e pabotuar).
- Islamaj Sh. (2003). Kultura gjuhësore dhe mjetet e informimit. *Kulturë e gjuhës 1*. Prishtinë: Shoqata e Gjuhës Shqipe e Kosovës, 21-26.
- Iwasaki S, Ocho S, Nagura M, Hoshino T. (2002). Contribution of speech rate to speech perception in multichannel cochlear implant users. *Annals of Otology Rhinology Laryngology* 111(8), 718-21.
- Laver J. (1995). *Principles of Phonetics*. London: Cambridge Textbooks in Linguistics.
- Leitner G. (1980). "BBC English" and "Deutsche Rundfunksprache": A Comparative and Historical Analysis of the Language on the Radio. *International Journal of the Sociology of Language* 26, 75-100.
- Lepri S. (1981). Il linguaggio del giornalismo parlato. Accornero A., *Manuale di linguaggio giornalistico*. Milano: Etas Libri, 96-105.

- Lieberman P. (1966).** Some Acoustic and Physiologic Correlates of the Breath Group. *Journal of the Acoustic Society of America* 39.6, 1218-1218.
- Maraschio N. (1987).** **Il parlato radiofonico in diretta.** *Gli italiani parlanti. Sondaggi sopra la lingua di oggi.* Firenze: Accademia della Crusca, 198-217.
- Memushaj R. (2011). *Fonetika e shqipes standarde.* Tiranë: Toena.
- Mikros G. K. (1997). Radio news and phonetic variation in Modern Greek. G. Drachman, A. Malicouti-Drachman, I. Fykias, Ch. Klidi (Eds.), *Greek Linguistics '95. Proceedings of the 2nd International Conference on Greek Linguistics, 22-24 September 1995, Salzburg, Austria* The Department of Linguistics, University of Salzburg (Vol. I), 35-44.
- Moosmüller S., Granser T. (2006). The Spread of Standard Albanian: An Illustration based on an Analysis of Vowels. *Language Variation and Change* 18. Cambridge University Press, 121-140.
- Pellegrino F., Coupé C., Marsico E. (2011). A cross-language perspective on speech information rate. *Language* 87.3, 539-558.
- Prifti E. (2005). Kontaktinguistische Bemerkungen zum Standardalbanischen und zu seinen Varietäten. Genesin M., Matzinger J., *Albanologische und Balkanologische Studien. Festschrift für Wilfried Fiedler.* Hamburg: Verlag Dr. Kovač, 131-138.
- Prifti E. (2009). Gjurmime variacionale mbi shqipen standarde një shekull pas Kongresit të Alfabetit. *Der Kongress von Monastir - Herausforderung zwischen Tradition und Neuerung in der albanischen Schriftkultur.* Hamburg: Verlag Dr. Kovač, 114-129.
- Roach P. (1998). Some Languages are Spoken More Quickly Than Others. L. Bauer and P. Trudgill, *Language Myths*. London: Penguin Books, 150-8.
- Savy R. (2005). Specifiche per la trascrizione ortografica annotata dei testi. Albano Leoni F., Giordano R., *Italiano parlato. Analisi di un dialogo.* Napoli: Liguori.
- Sawicka I. (2007). Struktura e rrokjes në shqipen kosovare. *Gjurmime albanologjike* 37, 55-62.
- Trumper J., Romito L., Maddalon M., Mendicino A., Belluscio G.M.G. (1993). Stime manuali: un esperimento. *Atti del convegno Teoria e Sperimentazione: Parametri, tratti e segmento.* Università della Calabria, 28-29 novembre 1991. Roma: Esagrafica, Vol. XIX, 61-79.
- Wang Y., Green J. R., Nip I. S. B., Kent R. D., Finley Kent J. (2010). Breath Group Analysis for Reading and Spontaneous Speech in Healthy Adults. *Folia Phoniatrica et Logopaedica* 62(6), 297-302.

Blertë ISMAJLI, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë:

SA BALLKANIKE JANË MËNYRAT E FOLJEVE TË SHQIPES? KUSHTORJA DHE HABITORJA

Abstrakt

Sprachbund-i ballkanik karakterizohet nga tipare morfosintaksore të përbashkëta të gjuhëve të Ballkanit. Por sa mund të flitet për ballkanizma në rastin e mënyrave habitore dhe kushtore të shqipes? Në të dy rastet kemi të bëjmë me kategori foljore që hasen edhe në gjuhët jashtë Ballkanit. Tipi i kushtores së krijuar me kombinim të morfemave kohore haset edhe në gjuhët gjermanike apo ato romane. Ndërsa forma të evidencialitetit, siç është rasti edhe me habitoren, shfaqen edhe në gjuhët si lituanisht, letonisht, estonisht e edhe në Kaukaz. Duket se konteksti ballkanik është i ngushtë për trajtimin e këtyre kategorive.

Shqipja bën pjesë në gjuhët me një sistem kompleks foljor. Në studimet për gramatikën e saj vërehen dallime në kategorizimin e formave foljore si mënyra. Numri i formave foljore të trajtuara si mënyra dallon nga gjashtë, sa shihen si mënyra në Gramatikën e ASHSH (Demiraj 1995), në tetë në gramikat e Oda Buchholz & Wilfried Fiedler (1987) si dhe Leonard Newmark et al. (1987), ndërsa së fundmi Walter Breu (2010) flet për dhjetë mënyra. Janë sidomos format analitike të posibilitativit, obligativit, kondicionalit dhe admirativit që kategorizohen herë si mënyra, herë si konstrukte me folje modale, habitorja si evidencialitet ndërsa kushtorja si kohë. Nga të gjitha format foljore që konsiderohen mënyra në shqipen, dëftorja, lidhorja, dëshirorja dhe urdhërorja janë të padiskutueshme si të tilla. Në fokus të kësaj kumtese janë habitorja dhe kushtorja, klasifikimi i të cilave si mënyrë foljore vihet në pikëpyetje.

Habitorja

Habitorja është një ndërtim i veçantë foljor i shqipes, i cili si i tillë nuk haset në gjuhët tjera indoevropiane. Shikuar morfologjikisht, ajo paraqet një perfekt të përmbysur, format e së cilës janë krijuar përmes përngjitjes së foljes ndihmëse *kam* pjesores së shkurtër të foljes: *kam punuar* → *punuakam*. Habitorja përshkruhet në Gramatikën

tradicionale të shqipes si mënyrë me anë të së cilës shprehet habi, dyshim, ironi. Studime të thelluara për funksionet e saj që janë bërë në gjysmën e dytë të shek. XX nxjerrin në pah edhe funksionin e saj të referativitetit – bartjen neutrale të informatës nga folësi (Fiedler 1966, Camaj 1969, Friedman 2004). Duhet përmendur këtu se Riza në *Sistemin foljor të letrarishtes shqiptare* vëren funksionin e referativitetit që më 1966, por në Gramatikën e ASHSH nuk e gjejmë të përfshirë këtë qëndrim. Buchholz&Fiedler (1987: 154) dhe Desnickaja (1987: 55ff) dallojnë dy funksione të habitores: admirativitetin (1) si kategori emocionale dhe komentativitetin (2) si kategori modale, funksion i ngjajshëm me renarrativin e bullgarishtes dhe format *miş* të turqishtes:

(1) – *Paska gjatësinë e kolonelit Z. – tha prifti.*¹

(2) *Thashethemi sipas të cilit ai paskej vdekur gjatë mungesës sime duhet të jetë një dredhi për të më prishur mendjen, për të më futur në kurth.*²

Për shkak të ngjashmërisë në funksion me renarrativin dhe me format *miş* të turqishtes, habitorja konsiderohet si ballkanizëm. Por, ndryshe nga bullgarishtja dhe turqishtja, në shqipen nuk flitet për përdorim të veçantë të formave të perfektit, por për forma që dallohen morfologjikisht e që mund të identifikohet lehtë. Në bullgarishten format e evidencialitetit janë vetëm përdorim specifik i formave foljore dhe jo kategori të pavarura gramatikore. Në kontekstin ballkanik termi “admirativ” përdoret për të përshkruar fenomene të ndryshme që kuptim kryesor e kanë shprehjen e befasisë (edhe pse befasia kontestohet si kuptim kryesor i habitores së shqipes meqë kjo formë përdoret për të shprehur mosbesim; khs. Schmaus 1966, Fiedler 1966, Camaj 1969) dhe që kanë lidhje diakronike me perfektin.

Për origjinën e habitores janë shfaqur tri teza kryesore. Përfaqësuesit e tezës së parë konsiderojnë habitoren zhvillim të brendshëm të shqipes, por ndahen në qëndrimet e tyre për burimin nga i cili janë krijuar format e habitores. Jokli mendon se koha e tashme e habitores është krijuar nga një kohë e ardhme. Këtë tezë e mbështet edhe Riza (1997: 145). Ndërsa Demiraj (2002: 388), Ajeti (1998: 113) e Topalli (2011: 832f.) e kundërshtojnë tezën e Joklit dhe mendojnë se habitorja

¹ Kadare, Ismail. 1980. *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, Prishtinë: 129

² Kongoli, Fatos. 2005. *Lëkura e qenit*, Tiranë: 5

është krijuar me përmbysjen e perfektit. Besim Bokshi (1998: 106-118) ka një tezë tjetër për krijimin e formave të habitores. Sipas tij baza për krijimin e formës së parë të habitores duhet të ketë qenë *më se e kryera* e dëftores e jo e kryera. Ai trajtën e shkurtër të pjesores brenda formave të habitores e sheh si shumë të rëndësishme për përcaktimin e kohës së krijimit të saj. Trajta e shkurtër e pjesores brenda habitores haset në tërë shqipen, prandaj edhe dëshmon lashtësinë e saj parashkrimore. Kjo trajtë e shkurtër e pjesores brenda habitores haset që te Buzuku dhe autorët e tjerë të Veriut, ndërsa jashtë habitores pjesorja është e plotë. Me kalimin e më se të kryerës së dëftores në të parkyerën e habitores, pjesorja e humbi kuptimin e saj kohor që e kishte në përbërje të kohëve analitike dhe e ruajti vetëm kuptimin leksikor. Gjatë këtij transformimi pjesorja merrte funksion të një teme së cilës i përngjitej folja *kam*, e cila kishte funksion mbarese dhe e shënonte vetëm kuptimin kohor.³ Teza e dytë është ajo e krijimit të habitores nën ndikimin e turqishtes në strukturën gramatikore të shqipes dhe sllavishtes së Ballkanit (sipas Friedman 1999: Conev 1910/11, Gołąb 1960, Koneski 1965). Kjo tezë kundërshtohet nga Fiedler (1966: 561) i cili është i mendimit se habitorja është krijuar si pasojë e ndikimit të ndër-sjellë në gjuhët e Ballkanit (shqipja në një anë dhe bullgarishtja e maqedonishtja në anën tjetër). Këtë tezë e mbështet edhe Altimari (2002: 140ff) në artikullin e tij për të kryerën e “supozimit” të arbërishtes. Habitoret nuk paraqitet në të folmet e arbëreshëve në Itali dhe në Çamëri. Por në 37 të folme arbëreshe (nga 50 sa janë gjithsej) të përhapura në Italinë jugore, me përjashtim të Sicilisë shfaqet një dukuri që mund të ndërlidhet me habitoren e shqipes. Në këto të folme, forma analitike dhe ajo sintetike e së shkuarës nuk janë në kundërvënje kohore, por modale dhe përdoren për të treguar një veprim “të sigurt” e “të pasigurt” që ka ndodhur në të shkuarën. Forma analitike, së cilës mbështetur në autorin po i referohem si “e kryera e supozimit”, mund të përdoret vetëm në vetën e tretë për të shprehur një informatë të pasigurtë (krhs. shembujt nga Altimari 2002: 130):

<i>ai shkroi</i>	=	<i>ai ka shkruar</i>
<i>ai ka shkruar</i>	=	<i>ai ndoshta ka shkruar</i>

³ Krhs. për më tepër Bokshi 1998: 106-118

Kjo formë analitike është përkufizuar nga De Rada (1870) si “e shkuar dyshimore”. Altimari e sheh këtë ndërtim morfosintaksor si formë të konservuar në të folmet arbëreshe me prejardhje ballkanike e që pasqyron një fazë të ndërmjetme në procesin e krijimit të habitores në shqipen. Duke e mbështetur tezën e Fiedler-it, Altimari shfaq idenë se kjo formë është krijuar si pasojë e ndikimit të ndërsjellë ndërmjet gjuhëve ballkanike në kalimin e përbashkët nga një e kryer e vjetër (kam+pjesore në shqipen, pjesore në -I+jam në gjuhët sllave) në një mënyrë të re. Ai kundërshton tezën e ndikimit të turqishtes sepse ngulimet osmane në gjysmën e shek. XV, kur filloi krijimi i bashkësive të para arbëreshe, ishin të paqëndrueshme e s’mund të kenë ndikuar shumë dhe sepse periudha e shkurtër kohore e sundimit osman e pamundëson ndikimin e thellë në shqipen deri në sistemin sintaksor duke pasur parasysh se turqishtja ishte në pozicionin e superstratit. Në anën tjetër, të folmet arbëreshe janë më tepër ishuj gjuhësorë të shkëputur territorialisht nga njëri-tjetri. Prandaj e kryera e supozimit nuk mund të konsiderohet zhvillim autonom nën ndikim të ndërsjellë të të folmeve në njëra-tjetrën.

Diskutimi i Altimarit na kthen te çështja e kohës së krijimit të habitores. Format e saj shfaqen që në “Mesharin” e Gjon Buzukut (1555), gjë që nga studiuesit shihet si dëshmi që procesi i krijimit të habitores ka përfunduar qysh para shek. XVI. Fiedler dhe Çabej (Demiraj 2002: 391) mendojnë se procesi i formimit ka përfunduar rreth vitit 1600, ndërsa Ajeti (Ajeti 1998: 113), Bokshi (Bokshi 1998: 114), Demiraj e Topalli (2011: 837) kanë qëndrim tjetër: se habitoretja është krijuar në periudhën parashkrimore të shqipes. Prania e habitores në tekstet e autorëve të vjetër veriorë mbështet këtë tezë. Së paku në gegërishten procesi i krijimit të habitores duhet të ketë përfunduar në një periudhë më të hershme se shek. XV. Ndoshta në të folmet toske ky proces ishte në një fazë të ndërmjetme në kohën e shpërnguljeve arbëreshe.

Klasifikimi habitores si mënyrë në sistemin foljor të shqipes është një çështje e diskutueshme. Fiedler (1966) dhe Desnickaja (1958, 1987) e shohin atë jashtë këtij sistemi, bile Fiedler e vendos atë paralelisht me dëftoren. Shkak për këtë është kombinimi i formave të habitores me markues të tjerë modalë (lidhoren) – pra markimi i dyfishtë si dhe mohimi i saj me pjesëzat mohuese të dëftores *nuk* dhe *s’*, ndryshe nga mënyrat e tjera që marrin pjesëzën mohuese *mos* (Fiedler 1966: 563).

Fiedler shfaq mendimin se në shqipen ekzistojnë dy radhë paralele: një normale-dëftore dhe një habitore-dëftore që mund të shënohen në formën e njëjtë modale. Kjo linjë argumentimi ndiqet edhe në “Albanische Grammatik” ku habitortja trajtohet jashtë sistemit të mënyrave. Në studime të mëvonshme (krhs. Friedman 2004) habitortja konsiderohet kategori e evidencialitetit, pra mjet për kodimin e burimit të informatës. Por, siç vë re Friedman, habitortja nuk është e lidhur drejtpërdrejt me burimin e informatës, por më tepër me qëndrimin e folësit ndaj burimit ose ndaj vetë informatës. Prandaj kategorizimi i habitores vetëm si evidencialitet paraqet vështirësi. Komentativiteti është vetëm njëri nga funksionet e habitores, ndërsa funksioni tjetër – shprehja e emocionalitetit vazhdon të jetë funksion i fuqishëm i habitores. Sidoqoftë, si në rastin e emocionalitetit ashtu edhe në rastin e komentativitetit shprehet qëndrimi i folësit që është tipik për mënyrët. Pra nuk mund të mohohet fakti se habitortja është mënyrë.

Kushtortja

Format e tjera të trajtuara si mënyrë në gramatikën e shqipes e që paraqesin një çështje të diskutueshme janë format e mënyrës kushtore. Kushtortja paraqet vështirësi në trajtimin e saj për shkak të formës së saj morfologjike identike me formën e së ardhmes të së shkuarës të mënyrës dëftore. Në Gramatikën e ASHSH (Demiraj 1995: 294) format e kushtores konsiderohen forma homonime me ato të së ardhmes së të shkuarës. Morfologjikisht forma e kushtores është kombinim i dy morfemave kohore: morfemë e së ardhmes+morfemë e së shkuarës. Në morfologji kriter themelor klasifikimi është forma, prandaj format që përmbajnë morfemat e njëjta duhet të klasifikohen sipas morfologjisë së tyre. Pra, në rastin e kushtores së shqipes kemi të bëjmë me forma kohore që shprehin edhe modalitet (krhs. Topalli 2011: 803). Këto forma edhe në rastin kur përdoren për të shprehur kondicionalitet nuk e humbasin tiparin primar të tyre, temporalitetin. Krhs. shembujt:

- (3) *Do të vinja po të kisha kohë.*
- (4) *Do të kisha ardhur po të kisha pasur kohë.*

Në gramatikat historike të shqipes origjina e trajtave foljore të kushtores konsiderohet e ardhmja e së shkuarës, por gjatë përdorimit të këtyre trajtave në periudha hipotetike është forcuar kuptimi modal i

mundshmërisë duke e dobësuar kështu kuptimin kohor të së ardhmes së të shkuarës. Sipas Rizës këto forma duhen vështruar gjithsesi si dy palë trajta të dy strukturave paralele (Riza 1997: 135). Ndërsa Demiraj (2002: 310-311) e sheh homofoninë e formave të së tashmes së “kushtores” me ato të së ardhmes së të shkuarës së dëftores si një vështirësi dhe në gramatikën e tij historike nuk flet për një mënyrë kushtore.

Ndërtimet e tilla me kombinim morfemash kohore janë tipike për kondicionalët dhe konsiderohen si tendencë universale gramatikore. Futurët në përgjithësi kanë tendencë të shprehjes së modalitetit meqë për veprimet ose ndodhitë në të ardhmen zakonisht nuk mund të flitet në mënyrë neutrale. Këto veprime në të ardhmen janë të dëshirueshme, të pritshme, të parashikueshme ose edhe folësi mund të ketë frikë nga to (Palmer 1986: 216ff, Schrodtd&Donhauser 2003: 2507 ff). Prandaj shfaqen veti modale të futurit gramatikor, gjë që shkakton dyshime gjatë kategorizimit të këtyre formave.

Në kontekstin ballkanik, format e kushtores së shqipes janë të ndryshme nga ato të gjuhëve sllave, të cilat nuk përmbajnë morfemë të kohës së ardhme. Do të ndalem këtu te rasti i bullgarishtes e maqedonishtes, të cilat përmbajnë dy forma për shprehjen e kondicionalitetit (Lindstedt 2010: 409-421). Format e trajtuara si mënyrë kushtore në bullgarishten dhe maqedonishten konsiderohen forma të trashëguara nga proto-sllavishtja. Në bullgarishten ato krijohen me ndihmësen e veçantë *bi-* dhe mbaresat vetore të aoristit, të kombinuara me pjesoren e së shkuarës të foljes kryesore, ndërsa në maqedonishten folja ndihmëse është shndërruar në pjesëz të paflektuar, pra nuk ka markues vete në këtë forma perifrastike foljore:

Bullgarisht:

Az bix došāl/došla

Ti bi došāl/došla

Maqedonisht:

jas bi došol/došla

ti bi došol/došla

Forma e dytë foljore për shprehjen e kondicionalitetit në bullgarishten (5) e maqedonishten (6) është e ashtuquajtura “kushtorja e tipit ballkanik” e cila formohet me kombinim të morfemave të futurit dhe imperfektit, pra ngjashëm me kushtoren e shqipes:

- (5) *Št-ja-x* *da dojd-a* *ako namer-e-x vreme.*
FUT-IMPF-SG1 të vij-PRS.SG1 po gjen-IMPF-SG1 kohë.
- (6) *K'e* *dojd-e-v* *ako najd-e-v vreme.*
FUT vij-IMPF-SG1 po gjen-IMPF-SG1 kohë


Në maqedonishten kombinohet markuesi i paflektuar i futurit *k'e* me imperfektin e foljes kryesore, ndërsa në bullgarishten flektohet vetë markuesi i futurit *šte* në imperfekt dhe folja kryesore në kohën e tashme lidhet me të përmes *da (të)*, siç ndodh pas foljeve ndihmëse. Në këtë rast maqedonishtja është e ngjashme me disa gjuhë të Ballkanit (shqipen, greqishten, arumanishten jugore) ndërsa bullgarishtja është e ngjashme vetëm me disa dialekte arumune dhe dako-romane. Sipas gramatikës së Akademisë Bullgare të Shkencave, tipi ballkanik shpreh veprime që varen vetëm nga një kusht i jashtëm, ndërsa tipi *bi* varet edhe nga vendimi i agjentit. Forma e tipit ballkanik në traditën gramatikore bullgare është klasifikuar si kohë që ka edhe përdorim modal, çka po sugjerohet edhe për format e shqipes.

Në një studim të vitit 2010, Thieroff (2010: 1-28) duke krahasuar mënyrët në gjuhët e Evropës shfaq qëndrimin e tij se ekzistojnë dy lloje kushtoresh:

a) Lloji i parë është kohë. Këtu përfshihen format e përbëra nga kombinimi i morfemave kohore. Thieroff propozon termin “kushtore perëndimore” për emërtimin e këtyre formave meqë shfaqen kryesisht në gjuhët që fliten në perëndim të kontinentit.


b) Lloji i dytë është mënyrë. Këto forma nuk përmbajnë morfemë futuri e shpesh as të së shkuarës. Ky lloj sipas Thieroff-it mund të quhet “kushtore lindore” meqë flitet kryesisht në lindje të kontinentit.

Nisur nga ky këndvështrim, kushtorja e shqipes mund të konsiderohet kohë që shpreh edhe modalitet. Kështu ajo hyn në llojin perëndimor të kushtores duke u ndërlidhur me një hapësirë më të gjerë se Ballkani, ndryshe nga kushtorja e gjuhëve sllave që është lindore (përgjashtëm bëjnë bullgarishtja dhe maqedonishtja që përmbajnë të dy llojet). Tipin lindor të kushtores e kanë edhe letonishtja, lituanishtja, finlandishtja, estonishtja dhe hungarishtja. Përhapjen e dy llojeve të kushtores Thieroff e paraqet në këtë hartë (2010: 14):



Map 3. "Western" and "Eastern" Conditionals

Format e evidencialitetit përveç shqipes, bullgarishtes e maqedonishtes janë të përhapura edhe jashtë Ballkanit në letonishten, lituanishten, estonishten. Duhet pasur parasysh edhe praninë e formave të evidencialitetit në gjuhët e Kaukazit (theksuar nga Friedman):



Map 2. Number of moods in the languages of Europe

Kjo përhapje e formave të evidencialitetit dhe të kushtores e bën të vështirë trajtimin e tyre si dukuri ballkanike. Në të dy rastet kemi të bëjmë me forma e funksione të përhapura në hapësira gjeografike jashtë Ballkanit. Në rastin e mënyrave të shqipes, problemi që shfaqet është përkatësia kategoriale e formave foljore: si në rastin e habitores ashtu edhe në atë të kushtores kontestohet qenia e tyre mënyrë foljore. Deri sa për kushtoren situata është më e qartë, në rastin e habitores nuk mund të mohohet të qenit e saj mënyrë. Sipas Aronson (2007: 14-15), dukuritë që i atribuohen një *Sprachbund*-i nuk mund të jenë universale gjuhësore. Në rastin e kushtores kemi të bëjmë me forma që reflektojnë universale tipologjike të dëshmuara edhe jashtë Ballkanit. Siç u pa në paraqitjen paraprake, si kushtorja, ashtu edhe habitorja, ndërlidhen me gjuhë që janë jashtë Ballkanit. Sipas Aronson-it, disa gjuhë të Ballkanit mund të hyjnë në *Sprachbünde* të tjera nga ai i Ballkanit. Prandaj trajtimi i tipareve morfologjike që u atribuohen gjuhëve të Ballkanit duhet vendosur në një kontekst më të gjerë, Aronson propozon vendosjen e tyre në një *Sprachbund* pan-evropian. Diçka të ngjashme ka sugjeruar edhe N. Reiter (1994) më herët. *Sprachbund*-in ballkanik e karakterizojnë tipare morfosintaksore të përbashkëta. Por tipare të ndryshme mund të paraqiten edhe në gjuhët jashtë Ballkanit. Ngjashëm shfaqet situata edhe në rastin e tipareve fonetike (Sawicka 1997: 79). Duket se nuk mund të flitet për lidhje gjuhësh, por më tepër për lidhje kategorish të ndryshme gjuhësore. Sido që të jetë, duket qartë se konteksti ballkanistik mund të mos jetë i mjaftueshëm për trajtimin e dy mënyrave të shqipes.

Bibliografia

- Aikhenwald A. Y. (2006). *Evidentiality*. Oxford: Oxford University Press.
- Ajeti I. (1998). *Historia e gjuhës shqipe*, Vepra 3. Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës.
- Altimari F. (2002). *Vëzhgime për të kryerën e "supozimit" të arbërishtes dhe për formimin e habitores të shqipes*. Në Vëzhgimime gjuhësore dhe letrare arbëreshe. Prishtinë: Shpresa&Faik Konica, 129-152.
- Aronson H. I. (2007). *The Balkan Linguistic League, "Orientalism", and Linguistic Typology*. Ann Arbor, New York: Beech Stave Press.
- Bokshi B. (1998). *Pjesorja e shqipes (vështrim diakronik)*. Prishtinë: Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës.
- Breu W. (2010). *Mood in Albanian*. Në Rothstein B., Thieroff R. (redaktorë). *Mood in the languages of Europe*. Amsterdam/ Philadelphia: John Benjamins Publishing Company, 447-472.
- Buchholz O., Fiedler W. (1987). *Albanische Grammatik*. Leipzig: VEB Verlag Enzyklopädie Leipzig.
- Camaj M. (1969). *Lehrbuch der albanischen Sprache*. Wiesbaden: Harrassowitz.
- De Haan F. (2001). *The Relation Between Modality and Evidentiality*. Në Müller & M. Reis (redaktorë). *Modalität und Modalverben im Deutschen. Linguistische Berichte, Sonderheft 9*. Hamburg: Buske.
<www.u.arizona.edu/~fdehaan/papers/lb01.pdf>
- Demiraj Sh. (2002). *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë.
- Demiraj Sh. (redaktor). 1995. *Gramatika e gjuhës shqipe 1. Morfologjia*. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë.
- Desnickaja A. V. (1987). *Kuptimi i kategorisë së admirativit në shqipen*. Në Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, 12, Prishtinë: Fakulteti i Filologjisë, 55-59.
- Fiedler W. (1966). *Zu einigen Problemen des albanischen Admirativs*. Në Zeitschrift der Karl-Marx-Universität Leipzig: Gesellschafts- und Sprachwissenschaftliche Reihe, 15/3. Leipzig: Karl-Marx-Universität Leipzig, 561-566.
- Friedman V. A. (1999). *Evidentiality in the Balkans*. Në Hinrichs U. (redaktor). *Handbuch der Südosteuropa-Linguistik*. Wiesbaden: Otto Harrassowitz, 519-544.
- Friedman V. A. (2004). *Studies on Albanian and other Balkan Languages*. Pejë: Dukagjini.
- Lindstedt J. (2010). *Mood in Bulgarian and Macedonian*. Në Rothstein B., Thieroff R. (redaktorë). *Mood in the languages of Europe*. Amsterdam/ Philadelphia: John Benjamins Publishing Company, 409-421.
- Newmark L., Hubbard Ph., Prifti P. (1982). *Standard Albanian*. Stanford: Stanford University Press.
- Palmer F.R. (1996). *Mood and Modality*. Cambridge: Cambridge University Press.
- Palmer F.R. (2001). *Mood and Modality*. Second Edition. Cambridge: Cambridge University Press.
- Reiter N. (1994). *Grundzüge der Balkanologie. Ein Schritt in die Eurolinguistik*. Berlin: Harrassowitz Verlag
- Riza S. (1997). *Sistemi foljor i letrarishtes shqiptare bashkëkohore*, Vepra 2. Prishtinë: Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës.

- Sawicka I. (1997). *The Balkan Sprachbund in the light of phonetic features*.
Varshavë: Wydawnictwo Energiea
- Thieroff R. (2010). *Moods, moods, moods*. Në Rothstein B., Thieroff R. (redaktorë).
Mood in the languages of Europe. Amsterdam/ Philadelphia: John Benjamins
Publishing Company, 1-29.
- Topalli K. (1982). *Mënyra kushtore e foljes në gjuhën shqipe*. Në Studime
filologjike 4. Tiranë: ASHSH, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, 90-107.
- Topalli K. (2011). *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*. Tiranë: Qenda e Studimeve
Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë.

Julie KOLGJINI, IT Roçester (New York) e U. Amerikan në Kosovë
 RISHFAQJA E NJE ARKAIZMI: NDIKIMI PREJ NJË GJUHE TË
 AREALIT BALLKANIK

Abstract

Është më se e qartë se që kur gjuhët janë në kontakt, elementet e njëres gjuhë mund të huazohen prej gjuhëve të rajonit (shih Joseph 1983, 1992, 2001; Friedman 1994). Kjo situatë ndodh veçanërisht kur mjedisi gjuhësor është diglosik dhe/ose bi- dhe multilingual, ku shpesh interferenca gjuhësore prej gjuhës së parë të folësit mund të rezultojë në ndryshime të vogla në gjuhën e dytë, dhe në të kundërt; d.m.th. struktura gjuhësore e gjuhës së dytë mund të rezultojë në ndryshime të strukturave në gjuhën e parë, biles nganjëherë edhe në konvergjencë gjuhësore (p.sh. mungesa e paskajores dhe zëvendësimi i saj me mënyrën lidhore, përsëritja e trajtave të shkurta të përemrave, gjithashtu edhe nyjat e shquara në fund të emrave) siç mund të vihen re në gjuhët ballkanike (shih Joseph 1983, 2001; Friedman 2008). Mandej, ndikimi gjuhësor prej gjuhës me status *superstratum* (ose të prestigjit) mund të rezultojë në ndryshime gjuhësore të gjuhës me status *substratum* siç ka ndodhur në rajonin veri-perëndimor të Maqedonisë (në Tetovë, Gostivar, periferinë perendimore të Shkupit, Kërçovë dhe Dibër), ku disa struktura (sintagma) foljore të shqipes nën ndikimin e maqedonishtes, mund të jenë në procesin e ndryshimit – dhe ndoshta në disa rajone procesi i ndryshimit tashmë ka mbaruar, p.sh. kam të shkoj (khs. kam me shkue; gjithashtu më duhet të shkoj dhe më duhet me shkue), ke/ki(e) të shko(j)sh, ka të shkoje, kemi/kimi të shkojmë, keni/kini të shko(j)ni dhe kanë të shkojnë. Autori i këtij shkrimi i sheh format e lartpërmendura (p.sh. kam të shkoj) të formuara si pasojë e mungesës së paskajores së maqedonishtes, me ç’rast në shqipen e disa zonave të Maqedonisë në vend të formës kam me shkue, paskajorja gege është zëvendësuar me strukturën foljore të eptuar që është shënuar me pjesëzën të të mënyrës lidhore (p.sh. të shkoj, khs. në maqedonisht da + koha e tashme në mënyrën dëftore, ku da është shënues i mënyrës lidhore dhe pjesëz modale e ndjekur nga folja në mënyrën dëftore, p.sh. sakam da stanam ‘I want to become’), ku ky ndryshim në strukturën e shqipes mund të interpretohet si një përafim kuazikalk me maqedonishten *треба/морам да одам (треба/морам да одам)* ‘I need to/must go.’ Duhet shënuar që ky ndryshim strukturor mund të jetë gjithashtu ndikim i shqipes standarde/variantit toskë (khs. duhet të shkoj); por duke pasur parasysh që maqedonishtja ka ndikim sociolinguistik më të madh tek shqipfolësit e Maqedonisë (në marrëdhëniet zyrtare, në sistemin arsimor e qeveritar, marrëdhëniet e përditshme jashtëfamiljare) se sa standardi i shqipes/varianti toskë në këto rrethana specifike gjuhësore.

1.0 Hyrje

Është më se e qartë, tashmë, në fushën e linguistikës që kur gjuhët janë në kontakt, elementet e njërës gjuhë mund të huazohen prej gjuhëve të tjera të rajonit (shih Joseph 1983, 1992, 2001; Friedman 1994). Kjo situatë ndodh veçanërisht kur mjedisi gjuhësor është diglosik dhe/ose bi- dhe multi-lingual, ku shpesh interferenca gjuhësore prej gjuhës së parë të folësit mund të rezultojë në ndryshime të vogla në gjuhën e dytë, dhe në të kundërt; d.m.th. struktura gjuhësore e gjuhës së dytë mund të rezultojë në ndryshime të strukturave në gjuhën e parë, biles nganjëherë edhe në konvergjencë gjuhësore duke përzgjedhur karakteristika të elementeve gjuhësore (p.sh. mungesa e paskajores dhe zëvendësimi i saj me mënyrën lidhore, rimarrja e kundrinave, gjithashtu edhe prapavendosja e nyjave shquese) siç mund të vihen re në gjuhët ballkanike (shih Joseph 1983, 2001; Friedman 2008; Beci 2002:66). Mandej, ndikimi prej gjuhës me status *superstrat* (gjuhës së prestigjtit) mund të reflektojë ndryshime në gjuhën me status *substrat* siç ka ndodhur në rajonin veriperëndimor të Maqedonisë (Tetovë, Gostivar, periferinë perëndimore të Shkupit, Kërçovë dhe Dibër), ku disa struktura (sintagma) foljore të shqipës janë ndikuar (të paktën pjesërisht) prej maqedonishtes, p.sh. *kam të shkoj* (khs. *kam me shkue*; gjithashtu *më duhet të shkoj* dhe *më duhet me shkue*), *ke/ki(e) të shko(j)sh*, *ka të shkoje*, *kemi/kimi të shkojmë*, *keni/kini të shko(j)ni* dhe *kanë të shkojnë*. Këto forma hybrido-isoglosike të këtij rajoni gjeografik, nuk janë të përfshira në botimet më të fundit në *Atlasin dialektologjik të gjuhës shqipe* (shih 2007:376, nr. 126, harta 305; gjithashtu 2007:390, nr. 130, harta 319).

Autori i këtij shkrimi i sheh format e lartpërmendura (p.sh. *kam të shkoj*) të formuara si pasojë e mungesës së paskajores së maqedonishtes, ku në shqipen e disa zonave të maqedonisë në vend të formës *kam me shkue*, paskajorja gege është zëvendësuar me strukturën foljore të eptuar që është shënuar me pjesëzën *të* të mënyrës lidhore (p.sh. *të shkoj*), ku ky ndryshim në strukturën e shqipes mund të interpretohet si një përafrim *quasi-kalk* me maqedonishten *треба/морам да одам* (*треба/морам да одам*) 'I need to/must go.' Sipas disa gjuhëtarëve, na del që *kam* + LIDHORE (p.sh. *kam të shkoj*) është një formë arkaike (dhe e zhvilluar gjatë periudhes paraletrare) që paraprin strukturën *duo/dua/do* + LIDHORE (p.sh. *duo/duo/dua/do të shkoj*), sidomos kur shohim që ajo shfaqet dendur në shkrimet e Matrëngës (1592) si dhe në të folmet e Arbereshëve të Italisë

(shih Demiraj 1988:823, 836-838). Në rastin e kësaj formë hibrido-iso-glosike *kam të shkoj* siç paraqitet në Maqedoninë veriperëndimore, shkak mund të jetë kontakti gjuhësor me maqedonishten, që na rezulton në një inovacion (lokal), ku struktura përfundimtare shfaqet si formë identike me formën arkaike. Duhet shënuar megjithatë që ky ndryshim strukturor mund të jetë gjithashtu ndikim i variantit toskë (khs. *do të shkoj* dhe *duhet të shkoj*) ose si pasojë e zhvillimeve të brendshme gjuhësore, por duke pasur parasysh që maqedonishtja ka ndikim sociolinguistik më të madhë tek shqipfolësit e Maqedonisë se sa varianti toskë në këto rrethana specifike gjuhësore, nuk është aq bindëse. Një tjetër mundësi është që para shumë shekujsh kur arkaizmi *kam* + LIDHORE (khs. *kam* + PASKAJORE) ishte në procesin e formimit brenda shqipes, struktura e saj është përforcuar prej formave të ngjashme të gjuhëve përreth, p.sh. prej maqedonishtes në rastin e objektit të këtij shkrimi. Prania e formave të ngjashme në maqedonishte mund ta këtë përforcuar mundësinë e kësaj strukturë që paraqitet në shqipe, si njëfarë fortifikimi dhe përzgjedhjeje elementash gjuhësore të formave të përbashkëta (shih Friedman 2007:211). Opsioni i dytë na bën të mendojmë që *kam* + LIDHORE të jetë rezultat i të dyjave, prej influencës së zhvillimeve të brendshme gjuhësore dhe të gjuhëve përreth në këtë rajon.

2.0 Lënda

Kur merren në konsideratë disa gjuhë dhe disa konstruksione të përbashkëta të tyre, ose konvergjenca, në Sprachbund-in ballkanik, njëri prej fenomeneve gjuhësore të përmendura është formimi i kohës së ardhme (shih Friedman 2006, 2007, 2008b; Kopitar 1829; Kramer 1995). Qysh në gjuhët paraardhëse indo-europiane të dokumentuara mungonte një kategori morfologjike e eptimit të së ardhmes, që i ka lënë gjuhët IE të ballkanit pa një formë të trashëguar mbi të cilat mund të funksiononte (Friedman 2007:209; shih edhe Demiraj 1988:819-821, 841). Në kuptimin e formimit të së ardhmes në gjuhët ballkanike, konkurenca ekzistonte kryesisht ndërmjet foljeve ndihmëse ‘kam’ dhe ‘dua/do’ (së bashku me të tjerat), ku disa gjuhë dhe dialekte ballkanike u orientuan drejt njëres përbashkë tjetres, preferencës ‘kam’ të latinishtes dhe preferencës ‘dua/do’ të greqishtes. Friedman (2006: 666) shkruan: “Kur sllavishtja hyri në ballkan (në shekullin e 6^{te}-7^{te} e.s) filloi një konkurrencë ndërmjet foljeve ndihmëse ‘kam’ dhe ‘dua (do)’ + paskajore për të shënuar të ardhmën në latinishte dhe greqishte, me

preferencën latine ‘kam’ dhe preferencën greke ‘duo’. Sllavishtja e vjetër kishtare përdorte të kryeren e foljes ‘jam’ edhe ‘dua’, ‘kam’ dhe forma të tjera të ‘filloj’ + paskajore.” Në disa gjuhë dhe dialekte ballkanike elementi i dytë që përmbante paskajoren, më vonë u zëvendësua me konstruktin e mënyrës lidhore, p.sh. në shqipe (posaçërisht në toskërishte, si dhe në disa nëndialekte apo të folme të gegërishtes), greqishte dhe maqedonishte.

Parë nga perspektiva diakronike, format e të ardhmes si ‘kam’ ashtu dhe ‘dua/do’ janë mjaft të dokumentuara për ekzistencën e tyre të hershme në gjuhën shqipe (shih Gjinari 1968:134 në Demiraj 1988: 844). Ndërsa forma ‘kam’ (e.g. kryesisht *kam me shkue*, por edhe *kam për të shkue/shkuar*) është më gjërësisht e përhapur në variantin gegë (si në gegërishten qendrore, veriperëndimore dhe verilindore në Shqipëri; në të gjithë Kosovën; ndërsa në pjesën më të madhe perëndimore të Maqedonise mbizotëron forma *kam te shkoj*; shih Demiraj 1988: 838-839, 841), forma ‘dua/do’ (p.sh. *do të shkoj*) është e lidhur me variantin toskë (p.sh. në shumicën, në mos në të gjithë rajonet toskëfolëse qendrore dhe jugore të Shqipërisë; të folmet e Arbëreshëve të Greqisë), si dhe disa të folme në zona gegëfolëse të Shqipërisë (p.sh. gegërishtja jugore, duhet shënuar së kjo formë është edhe pjesë e variantit gegë në përgjithësi anipse përdoret më rrallë në gegërishten veriore). Edhe pse mbetet akoma e diskutueshme në debatet e gjuhëtarëve (p.sh. nga Sandfeld, Ajeti dhe Gjinari) nëse *kam* (+ PASKAJORE) është forma më e vjetër (p.sh. *kam me shkue*, shih Demiraj 1988: 841, 843, 850), e cila në variantin toskë u zëvendësua nga mënyra lidhore, duke e mënjanuar formën infinitive (përveç formës *për të shkuar*), pra duke rezultuar në strukturën *kam* + LIDHORE (*kam të shkoj*, shih Demiraj 1988:816-850). Disa gjuhëtarë (shih Camarda 1864:266, Çabej 1975:63-66; Demiraj 1988: 835-850) kanë konstatuar që konstrukti *kam* + LIDHORE (*kam të shkoj*) është strukturë shumë arkaike, (dhe e zhvilluar gjatë periudhës paraletrare) që paraprin strukturën *dua/do* + LIDHORE (p.sh. *duo/ due/ dua/ do të shkoj*), sidomos kur shohim që ajo shfaqet dendur në shkrimet e Matrëngës (1592) si dhe në të folmet e Arbereshëve të Italisë (shih Demiraj 1988:823, 836-838).

Më vonë, pjesërisht prej influencës së greqishtes (shih Demiraj 1988:842-843 në lidhje me këtë argument nga Sanfeld-i dhe Jokli), si dhe mundësia e mekanizmave veprues të zhvillimit të brendshëm gju-

hësor, foljet ndihmëse ‘dua/do’ nisen të përdoren në masë të madhe në variantin toskë, kështu duke rezultuar në *dua/do* + LIDHORE (shih Demiraj 1988: 843-844, 847 në lidhje me argumentat nga La Piana, Ajeti, Domi, Gjinari dhe Demiraj kundër influencave të tilla prej greqishtes). Është vërejtur që përhapja e brendshme, si pasojë e kontaktit ndërdialektor prej toskërishtes në gegërishte (si prej ndërveprimit të brendshëm të folësve në sfera të ndryshme të jetës së përditshme, p.sh. marrëdhëniet tregtare apo ndërmartësore), kombinuar kjo me zhvillimet e brendshme në secilin dialekt, mund të jetë shkak për paraqitjen e të ardhmes ‘dua/do’ në gegërishte (shih Demiraj 1988:841).

Edhe një herë, të dyja format si ‘kam’ ashtu dhe ‘dua/do’ kanë zënë vend në gjuhën shqipe, në një rën anë, e ardhmja ‘kam’ është zhvilluar jo vetëm në sensin vullnetar (*futurum voluntatis*), si në *I will go*, por gjithashtu edhe në sensin e detyres apo domosdoshmërisë (*futurum necessitatis*), si në *I need to/must go* (disa gjuhëtarë mendojnë se ky është kuptimi themelor, por kjo nuk mbështetet domosdoshmërisht nga komunikimi i përditshëm gjuhësor); në anën tjetër, e ardhmja ‘dua/do’ ka marrë kuptimin kryesisht vetëm të së parës, d. m. th. *Futurum voluntatis*. Të dyja format me ‘kam’ dhe ‘dua/do’ janë të dokumentuara në shkrimet e autorëve të vjetër shqiptarë. Demiraj (1988: 827) shkruan që formimi i të ardhmes *do* + LIDHORE paraqitet para shpërnguljes së shqiptarëve të Greqisë dhe Italisë, dikund para shekujve XIV-XV.

Në veriperëndim të Maqedonisë (posaçërisht në Tetovë, periferinë perëndimore të Shkupit, Gostivar, Kërçovë dhe Dibër), e ardhmja e tipit *kam të shkoj* (khs. *kam me shkue*; *më duhet të shkoj* dhe *më duhet me shkue*) mbizotëron. Në këtë shkrim paraqiten dy opsione të mundëshme pse ky tip na paraqitet në këto zona: njëri është ndërmjet kontakteve ndërgjuhësore në arealin ballkanik, më konkretisht në rastin tonë, me maqedonishten, dhe i dyti kombinimi i zhvillimeve të vazhdueshme brenda shqipes me ambientin gjuhësor në arealin ballkanik, pra ku të dy opsionet mund të jenë veprues.

Sa i përket opsionit të parë, ndërmjet kontakteve ndërgjuhësore me maqedonishten, forma gege *kam me shkue* është konsideruar si zanafilla, prej së cilës është kaluar në tjetër formë, në *kam të shkoj*, ku kuptimi është kufizuar në konceptin e domosdoshmërisë (*futurum necessitatis*), si në *I need to/must go* (d.m.th. *më duhet të shkoj* dhe *më*

duhet me shkue). Në këtë rast konstruktin *kam* gjymtyra e dytë e paska-jores, i është zëvendësuar me shënuesin e mënyrës lidhore të dhe foljen e eptuar po të mënyrës lidhore të kohës së tashme, p.sh. *ke/ki(e) të shko(j)sh* dhe *ka të shkoje*. Ky inovacion mund të jetë zhvilluar (pjesërisht) në kontakt gjuhësor me maqedonishten, gjuhë në të cilën paraqiten forma të ngjashme, p.sh. треба/морам да одам (*treba/морам да одам*) 'I need to/must go,' ku *kam* + LIDHORE mund të interpretohet si një lloj *quasi*-kalku prej maqedonishtes. Duhet përmendur që ndryshe nga konstruktin i shqipes (p.sh. pjesëza e lidhore të + LIDHORE, si *të jem, të jesh, të jetë, të jemi, të jeni, të jenë; të shkosh dhe të shkojë*), në konstruktin e maqedonishtes, shënuesi i lidhore *da* ndiqet nga një folje e eptuar e mënyrës dëftore (p.sh. maq. *da одам*), që na bën të mendojmë se kontakti gjuhësor me maqedonishten, mund të jetë vetëm shkas që na jep këtë inovacion (lokal), ku struktura përfundimtare shfaqet si formë identike me formën arkaike (ndoshta si zhvillim i brendshëm gjuhësor), ashtu si na shfaqet në shkrimet e Matrëngës, në të folmet e Arbereshëve të Italisë, si dhe në të folmet e Dibrës (pjesën verilindore të Shqipërisë shih Çabej 1975:65), tek Anonimi i Elbansanit (shih shembujt e cituar nga Domi 1961:69 tek Shkurtaç 1975:80) dhe në gjuhën e folur në bregdetin e poshtëm të skajit jugor të Shqipërisë (shih Totoni 1964:154 tek Shkurtaç 1975:83); kështu na ilustron njëfarë efekti parashutë i konstruksionit hibrido-isoglosik *kam të shkoj*.

Mund të pretendohet që kjo formë alternative *kam të shkoj* e cila shpreh sensin e detyrueshmërisë (të paktën në mënyrën që përdoret prej folësve të përfshirë në këtë studim, konkretisht në veriperëndim të Maqedonisë), nuk është formuar si pasojë e kontaktit gjuhësor me superstrat gjuhësor, në këtë rast nga maqedonishtja, por në vend të kësaj është formuar vetëm si rezultat i zhvillimit të brendshëm gjuhësor. Kjo mund të jetë e vërtetë, por pak si jobindëse duke pasur parasysh pejsazhin bilingual (ose multilingual) dhe sociolinguistik të këtyre gjuhëve të cilat kanë qenë në kontakt të përditshëm gjatë shekujve. Kontakti i brendshëm gjuhësor, siç është varianti toskë ose edhe gegërishtja jugore (si ndërmartesat apo marrëdhëniet e tjera familjare ndoshta edhe tregtare e kulturore) mund të kenë kontribuar në formimin e këtij tipi të investiguar, por jo aq shumë në këtë pejsazh gjuhësor në veriperëndim të Maqedonisë sa në Dibrën e Shqipërisë

(shih Demiraj 1988:841; Çabej 1975:65). Argumenti sociolinguistic për interferencën gjuhësore në kontakt të vazhdueshëm me maqedonishten, është ndoshta më bindës.

Nuk mund të mos merret në konsideratë që forma hibrido-iso-glosike *kam* + LIDHORE në veriperëndim të Maqedonisë të jetë rezultat i të dyjave, kontaktit gjuhësor me maqedonishten dhe zhvillimit të brendshëm gjuhësor të shqipes, ku para shumë shekujsh kur arkaizmi *kam* + LIDHORE (khs. *kam* + PASKAJORE që ekzistonte) ishte në procesin e formimit brenda shqipes (ndoshta me ndikime minore prej greqishtes për formën e mënyrës lidhore), struktura e saj është përforcuar prej formave të ngjashme të gjuhëve të tjera përreth, si në maqedonishte (apo edhe si në greqishten e re siç u përmed me lart), si një lloj përforcimi dhe përzgjedhjeje elementesh të përbashkëta sintaksore brenda Sprachbund-it ballkanik (shih Friedman 2007:211). Prania e formave të ngjashme, siç është lidhorja në maqedonishte – ose, në këtë rast, mungesa e disa konstrakteve, posaçërisht paskajorja, si në rastin e maqedonishtes, ku konstrukti *da* i për afrohet infinitivit në kuptim, por jo edhe në formë – si një gjuhë që ishte në kontakt të vazhdueshëm me shqipen (p.sh. marrëdhëniet tregtare, si dhe në të tjera mjedisë shoqërore ku përhapja e formave të ndryshme gjuhësore nepërmjet komunikimit të folësve do të ketë ndodhur), mund ta ketë fortifikuar praninë e një konstruksioni të tillë në shqipen e këtij rajoni. Kahja e këtij opsioni, lejon që *kam* + LIDHORE të shihet si rezultat i të dyjave, ndikim i zhvillimeve brenda shqipes si dhe i kontaktit me gjuhët e rajonit (shih Çabej 1975:64-66 për një diskutim të ngjashëm sa i përket formës *kam* + LIDHORE në të folmët e Arbëresheve të Italisë).

3.0 Mbyllja

Duke pasur parasysh realitetin bi-dhe multilingual në Sprachbund-in ballkanik, gjithashtu dhe diglosinë (dhe një numër çështjesh sociolinguistike), që ka ekzistuar në shekuj në ketë mjedis gjuhësor në Maqedoninë veriperëndimore (konkretisht në Tetovë, periferinë perëndimore të Shkupit, Gostivarit, Kërçovës dhe Dibres), interferenca gjuhësore me maqedonishten në njëfarë niveli është e mundshme sa i takon pranisë se *kam* + LIDHORE (khs. *kam* + PASKAJORE) – nëse jo për tjetër arsye të paktën për arsyen që maqedonishtes i mungon paskajorja e cila ka funksionuar pa të, nesë jo gjithmonë të pakën për një kohë shumë të

gjatë. Nëse zanafilla ishte *kam* + PASKAJORE ose *jo*, ngelet për tu kuptuar; sidoqoftë, forma në fjalë (*kam* + LIDHORE) mund të jetë risi lokale, duke shërbyer si një lloj *quasi*-kalku i formës së maqedonishtes e cila mbart sens semantik të ngjashëm (e.g. треба/ морам да одам (*treba/moram da odam*) 'I need to/must go'), dhe gjithashtu në të njëjtën kohë është identike me strukturën arkaike, të cilën e gjejmë në shkrimet e Matrënges, si edhe në të folmët e Arbëreshëve të Italisë.

Opsioni i dytë i përmendur, që shqiptaret e maqedonisë veriperëndimore duke përzgjedhur formën arkaike *kam* + LIDHORE (përkrah alternativave të tjera), kur këto konstrukte ishin në zhvillim e sipër në gjuhën shqipe shumë shekuj më parë, është gjithashtu i mundshëm; dhe elementet e përzgjedhur ishin format pa paskajore (që në të njëjtën kohë përmbanin shënuesin e lidhores, kh. maq. *da* dhe shq. *të*) që ishte më gjase përforcim prej këtij kontakti me maqedonishten.

Referencat

- Abetare gegënishte. 1942. Firenze: Botim i Ministrisë s' Arsimit.
- Abetare për të rritun. 1950. Beligrad: Znanje Ndërmarrje Tekstesh të RPS.
- Altinari F. 2005. "Il 'futuro necessitativo' dell'albanese d'Italia: influenza italo-romanza o arcaismo balcanico?" Atti del convegno "Convegno internazionale: L'influsso dell'italiano sulla grammatica delle lingue minoritarie," Costanza, 2003, A cura di Breu W., Centro Editoriale e Librario - UNICAL: Rende. 2005. 1-12.
- Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe V. I. 2007. Akademia e Shkencave e Shqipërisë: Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë.
- Auer, Peter. 1999. From codeswitching via language mixing to fused lects: Toward a dynamic typology of bilingual speech. *International Journal of Bilingualism* 3.309-332.
- Babel, Molly. 2009. *Phonetic and social selectivity in speech accommodation*. Berkeley: University of California, Berkeley dissertation.
- Babel, Molly. 2010. *Dialect divergence and convergence in New Zealand English*. *Language in Society* 39.437-456.
- Beci, Bahri. 1987. Të folmet qendrore të gegërishtes. *Dialektologjia Shqiptare* 3-92. Tiranë: Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë Sektori i Grammatikës dhe i Dialektologjisë.
- Beci, Bahri. 2000. Probleme të politikës gjuhësore dhe të planifikimit gjuhësor në Shqipëri. Pejë: Dukagjini.
- Beci, Bahri. 2002. *Dialektet e shqipes dhe historia e formimit të tyre*. Tiranë: Dituria.
- Bokshi, Besim. 1998. *Pjesorja e shqipes (vështrim diakronik)*. Prishtinë: Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës.
- Buzuku, Gjon. 1968. "Meshari" i Gjon Buzukut (1555). Tiranë: Universiteti Shtetëror i Tiranës Instituti i Historisë e i Gjuhësisë.
- Byron, Janet. 1976. Selection among alternatives in language standardization: The case of Albanian. *The Hague: Mouton*.
- Byron, Janet. 1978. Displacement of one standard dialect by another. *Current Anthropology* 19.613-614.
- Byron, Janet. 1979. Language planning in Albania and in Albanian-speaking Yugoslavia. *Word* 30.1:2.15-44.
- Byron, Janet. 1985. An overview of language planning achievements among the Albanians of Yugoslavia. *International Journal of the Sociology of Language* 52.93-109.
- Camaj, Martin. 1984. *Albanian grammar*. Wiesbaden: Otto Harrassowitz.
- Chambers, J. K. 1992. Dialect acquisition. *Language* 68(4).673-705.
- Cimochowski, Waclaw. 2004. *Për gjuhën shqipe*. Prishtinë: Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës.
- Cipo, K. 1949. *Gramatika shqipe*. Tiranë: Instituti i Shkencave.
- Coupland, Nikolas. 2008. The delicate constitution in face-to-face accommodation: A response to Trudgill. *Language in Society* 37(2).267-270.
- Çabej, Eqrem. 1975. *Histori gjuhësore dhe strukturë dialektore e Arbërishtes së Italisë*. *Studime Filologjike* 2.51-69.
- Çabej, Eqrem. 2008. *Studime shqiptare: Vepra të zgjedhura*. Prishtinë: Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës.
- Çetta, Anton. 1990. *Prozë popullore nga Drenica* 1-2. Prishtinë: Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës.
- Defense Language Institute. 1964. *Albanian Verbs Reference Material*.

- Demiraj, Shaban. 1988. Gramatikë historike e gjuhës shqipe. Prishtinë: Rinlindja.
- Demiraj, Shaban. (red.). 2002. Gramatika e gjuhës shqipe 1. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë.
- Domi, Mahir, Jorgji Gjinari, and Gjovalin Shkurtaj (red.). 1987. Dialektologjia Shqiptare. Tiranë: Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë Sektori i Grammatikës dhe i Dialektologjisë.
- Drejtshtkrimi i gjuhës shqipe. 1973. Tiranë: Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë.
- Elezi, Mehmet. 2006. Fjalor i gjuhës shqipe. Tirana: Gjergj Fishta.
- Errington, Joseph. 2001. Colonial linguistics. *Annual Review of Anthropology* 30.19-39.
- Ferguson, Charles. 1959. Diglossia. *Word* 15.325-340.
- Fishman, Joshua A. 1964. Language maintenance and language shift as a field of inquiry. *Linguistics* 9.32-70.
- Fishman, Joshua A. 1972a. The sociology of language. Rowley, Mass.: Newbury House.
- Fishman, Joshua A. 1972b. Language maintenance and language shift as a field of inquiry: Revisited. *Language in sociocultural change* 76-134. Standford: Standford University Press.
- Fishman, Joshua A. 1974. The sociology of language: An interdisciplinary social science approach to language in society. *Current Trends in Linguistics* 12.1629-1784.
- Fishman, Joshua A. 1977. Standard versus Dialect in bilingual education: An old problem in a new context. *The Modern Language Journal* 61(7).315-325.
- Fishta, Gjergj. 2001. Lahuta e malcis. Tiranë: Alb-ass.
- Friedman, Victor. 1979. Influence vs. Convergence in Areal Phenomena. *The Southeast Conference on Linguistics Bulletin*, Vol. 3, No. 1. 1-8.
- Friedman, Victor. 1992. Dialectal Base, Variation and Codification of the Balkan Literary Languages: Albanian, Bulgarian, Macedonian and Romany. *Balkan Forum*, Vol. 1, No. 1. 147-153. (English version of 65).
- Friedman, Victor. 1994. Variation and grammaticalization in the development of Balkanisms. Paper presented at the CLS 30 Papers from the 30th Regional Meeting of the Chicago Linguistic Society, Volume 2: The Parasession on Variation in Linguistic Theory, Chicago
- Friedman, Victor. 2003. Vendi i gegnishtes në gjuhën shqipe dhe në Ballkan [Albanian: The position of Gheg in Albanian and in the Balkans]. *Phoenix* (Shkodër) Vol 7 No. 1-6. 40-56
- Friedman, Victor. 2005. Albanian in the Balkan Linguistic League: A Reconsideration of Theoretical Implications. *Studia Albanica* Vol. 28, No. 1.33-44.
- Friedman, Victor. 2006. Balkans as a linguistic area. In Keith Brown (ed.) *Encyclopedia of Language & Linguistics*, second edition, volume 1, 657-672. Oxford: Elsevier.
- Friedman, Victor. 2007. Balkanizing the Balkan Sprachbund: A Closer Look at Grammatical Permeability and Feature Distribution. *Grammars in Contact: A Cross Linguistic Typology*, ed. by A. Aikhenvald and R.F.W. Dixon. Oxford: Oxford University Press. 201-219.
- Friedman, Victor. 2008a. Balkan object reduplication in areal and dialectological perspective. *Balkan clitic doubling*, ed. by L. Tasmowski & D. Kallulli. Amsterdam: John Benjamins.

- Friedman, Victor. 2008b. Balkan Slavic Dialectology and Balkan Linguistics: Periphery as Center. *American Contributions to the Fourteenth International Congress of Slavists*. ed. by Christina Bethin. Bloomington, IN: Slavica. 131-148.
- Gal, Susan. 1987. Codeswitching and consciousness in the European periphery. *American Ethnologist* 14(4) 637-653.
- Gal, Susan. 1989. Language and political economy. *Annual Review of Anthropology* 18.345-367.
- Gashi, Shkëlzen. 2010. Gjuha e këputun e shqipes: Përmdledhje intervistash mbi mundësinë e hapjes së shqipes standarde. Prishtinë: Rrokullia.
- Gumperz, John. 1964. Linguistic and social interaction in two communities. *American Anthropologist* 66 (6:2).137-153.
- Gumperz, John. 1976. The sociolinguistic significance of code-switching. Berkeley: University of California.
- Haugen, Einer. 1966. Dialect, language, nation. *American Anthropologist* 68(4).922-935.
- Hazen, Kirk. 2002. Identity and language variation in a rural community. *Language* 78(2).240-257.
- Heath, J. G. 1984. Language contact and language change. *Annual Review of Anthropology* 13.367-384.
- Hoxha, Shefqet. 1982. Lirikë popullore nga rrethi i Kukësit. Tiranë: Instituti i Kulturës Popullore të Akademisë së Shkencave të RPSSH.
- Hoxha, Shefqet. 1983. Epikë legjendare nga rrethit i Kukësit. Tiranë: Instituti i Kulturës Popullore të Akademisë së Shkencave të RPSSH.
- Hymes, Dell. 1964. Toward ethnographies of communication. *American Anthropologist* 66(6:2):1-34.
- Ismajli, Rexhep. 1982. Gramatika e parë e gjuhës shqipe: botim kritik, me studim e transkriptim. Prishtinë: Rilindja.
- Ismajli, Rexhep. 1985. Gjuha shqipe e kuvendit të arbënit (1706). Prishtinë: Rilindja.
- Ismajli, Rexhep. 2005a. Drejtshkrimet e shqipës. Prishtinë: Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës.
- Ismajli, Rexhep. 2005b. Gjuhë standarde dhe histori identitetesh. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë.
- Joseph, Brian. 1981. The Balkan infinitive loss – some methodological problems. In *Studies in Balkan Linguistics to Honor Eric P. Hamp on His Sixtieth Birthday (Folia Slavica 4. 2-3.)*, ed. H. Aronson and B. Darden 300-308.
- Joseph, Brian. 1983a. The synchrony and diachrony of the Balkan infinitive: A study in areal, general, and historical linguistics. Cambridge: Cambridge University Press.
- Joseph, Brian. 1983b. Language use in the Balkans: The contributions
- Joseph, Brian. 1992a. Introduction: Language and Power, Language and Freedom. In B. Joseph (ed.) *Language and Power, Language and Freedom in Greek Society*. Special issue of *Journal of Modern Greek Studies* 10.1-9.
- Joseph, Brian. 1992b. Interlectal Awareness as a Reflex of Linguistic Dimensions of Power: Evidence from Greek.
- In B. Joseph (ed.) *Language and Power, Language and Freedom in Greek Society*. Special issue of *Journal of Modern Greek Studies* 10.71-85.
- Joseph, Brian. 2001a. Is Balkan comparative syntax possible? In Rivero M & Ralli A (eds.) *Comparative syntax of Balkan languages*. Oxford: Oxford University Press. 17-43.

- Joseph, Brian. 2001b. Historical Linguistics. In M. Aronoff & J. Rees-Miller (eds.) *Handbook of Linguistics*. Oxford: Blackwell Publishers. 105-129.
- Joseph, Brian. 2007. Broad vs. Localistic Dialectology, Standard vs. Dialect: The Case of the Balkans and the Drawing of Linguistic Boundaries. To appear in *Papers from ICLAVE 4 (International Conference on Language Variation in Europe)*, Lefkosia, Cyprus, June 17-19).
- Kahane, Henry. 1983. American English: From a colonial substandard to a prestige language. *The other tongue*. ed. by Braj B. Kachru, 229-36. Oxford.
- Kahane, Henry. 1986. A typology of the prestige language. *Language* 62(3).495-508.
- King, Kendall A. et al. (eds.). 2008. *Sustaining linguistic diversity: Endangered and minority languages*
- Kolgjini, Tahir. 1978. *Po vajtojmë Gjon Gjinin*. Stanbul: Gençlik Basimevi.
- Kolgjini, Tahir. 1993a. *Poezi*. Tiranë: Shtëpia Botuese e Lidhjes së Shkrimtarëve.
- Kolgjini, Tahir. 1993b. *Luma dhe luftat e saj: përshkrim historik*. Tiranë: Shtëpia Botuese e Lidhjes së Shkrimtarëve.
- Koliqi, Ernest. 1999. *Kritike dhe estetike*. Tiranë: Apollonia.
- Koliqi, Ernest. 2001. *Pasqyrat e narçizit: tregime*. Shkodër: Camaj-Pipa.
- Koliqi, Ernest. 2003. *Vepra 3*. Prishtinë: Faik Konica.
- Labov, William. 1964. Phonological correlates of social stratification. *American Anthropologist* 66 (6:2).164-176.
- Lambertz, Max. 1948. *Albanische Lesebuch mit Einführung in die albanischen Sprache (Teil I: Grammatik und albanische Texte)*. Leipzig: Otto Harrassowitz.
- Lambertz, Max. 1959. *Lehrgang des Albanischen Teil III Grammatik der Albanischen Sprache*. Halle (Saale): Veb Max Niemeyer Verlag.
- Long, Daniel. 1996. Quasi-Standard as a linguistic concept. *American Speech* 71.2.118-135.
- Ludmila Isurin, Donald Winford, and Kees de Bot (eds.). 2009. *Multidisciplinary approaches to code switching*. Amsterdam: John Benjamins.
- Mahootian, Shahrzad. 1996. A competence model of codeswitching. *In Sociolinguistic variation: Data, theory, and analysis. Selected papers from NWave 23 at Stanford University*. Stanford, CA: CSLI Publications.
- Mahootian, Shahrzad. 2005. Linguistic change and social meaning: Codeswitching in the media. *International Journal of Bilingualism* 9.361-375.
- Mann, Stuart E. 1977. *An Albanian historical grammar*. Hamburg: Helmut Buske Verlag.
- Maynard, Kelly Lynne. 2003. *A historical dialectological approach to convergence: Isoglosses of Balkan convergence area features in Albanian dialects*. U of Chicago Dissertation.
- Mufwene. 2008. Colonization, population contacts, and the emergence of new language varieties: A response to Peter Trudgill. *Language in Society* 37(2).254-258.
- Murati, Qemal. 1989. *E folmja shqipe e rrethinës së Tuhinit të Kërçovës. Studime Gjuhësore II (Dialektologji)*. 3-113. Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës
- Myers-Scotton, C. 1993. *Duelling languages: Grammatical structure in codeswitching*. Oxford: Clarendon Press.
- Nash, Rose. 1970. Spanglish: Language contact in Puerto Rico. *American Speech* 45(3).223-233.
- Newmark, L. 1996. *Spoken Albanian*. Ithaca: Spoken Language Services.
- Newmark, Leonard, Philip Hubbard, & Peter Prifti. 1982. *Standard Albanian. A reference grammar for students*. Stanford: Stanford University Press.
- Neziri, Zymer (përgatitë). 2001. *Këngë të Kreshnikëve*. Prishtinë: Libri Shkollor.

- Osmani, Tomor. 1999. *Udhë e shkronjave shqipe: Histori e alfabetit*. Shkodër: Universiteti i Shkodrës Luigj Gurakuqi Sektori i Albanologjisë.
- Pedersen, Holger. 2003. *Studime për gjuhën shqipe*. Prishtinë: Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës.
- Pipa, Arshi. 1989. *The politics of language in socialist Albania*. Boulder: East European Monographs.
- Pool, Jonathan. 1991. The official language problem. *The American Political Science Review* 85 (2), 495-514.
- Purnell, Thomas. 2009. *Convergence and contact in Milwaukee: Evidence from select African American and White vowel space features*. *Journal of Language and Social Psychology* 28, 408-427.
- Riza, Selman. 1952. *Fillimet e gjuhësisë shqiptare*. Prishtinë: Mustafa Bakija.
- Riza, Selman. 1996. *Vepra I*. Prishtinë: Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës.
- Romaine, Suzanne. 2000. *Language in society: An introduction to sociolinguistics*. Oxford: Oxford University Press.
- Rrota, Justin. 2006a. *Gjuha e shkrueme ase vërejtje gramatikore botimi I*. Shkodër: Botim Françeskane.
- Rrota, Justin. 2006b. *Letratyra shqipe për klasët e ulta të shkollave të mjesme parime letratyret botimi III*. Shkodër: Botim Françeskane.
- Rrota, Justin. 2006c. *Letratyra shqipe për Shkollën të mjesme Botim II*. Shkodër: Botim Françeskane.
- Schneider, Edgar W. 2003. The dynamics of new Englishes: From identity construction to dialect birth. *Language* 79(2), 233-281.
- Schneider, Edgar W. 2008. Accommodation versus identity?: A response to Trudgill. *Language in Society* 37, 262-267.
- Spolsky, Bernard. 2004. *Language policy*. Cambridge: Cambridge University Press.
- Shepard, Carolyn A., Howard Giles, & Beth LePoire. 2001. Communication accommodation theory. In *The New Handbook of Language and Social Psychology*, ed. W. Peter Robinson and Howard Giles, 33-56. John Wiley and Sons Ltd.
- Sheperi, Ilia Dilo. 2001. *Gramatika dhe sindaksa e gjuhës shqipe sidomos e toskënishtes (për shkollën të mesme)*. Tiranë: albin.
- Shkurtaj, Gjovalin. 1975. *Vështrim mbi trajtat të mënyrës dëftore të të folmeve Arbëreshe të krahinës së Kozencës (Itali)*. *Studime Filologjike* 2, 71-87.
- Shuteriqi, Dhimitër. 1978. *Shkrimet shqipe në vitet 1332-1850*. Prishtinë: Rilindja.
- Toma, A., Z. Karapici, & L. Radovicka. 1989. *Gjuha Letrare Shqipe*. Tiranë: Shtëpia Botuese e Librit Shkollor.
- Topalli, Kolec. 1998. *Zhvillimi historik i diftongjeve të shqipes*. Tiranë: TOENA.
- Topalli, Kolec. 2007. *Fonetika historike e gjuhës shqipe*. Tiranë: Dituria.
- Topalli, Kolec. 2011. *Bazat e gramatikës historike të gjuhës shqipe*. Universiteti i Tiranës Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë Departamenti i Gjuhësisë. Tiranë: Shtëpia Botuese e Librit Universitar.
- Trudgill, Peter. 1983. *Sociolinguistics: An introduction to language and society*. New York: Penguin.
- Trudgill, Peter. 1986. *Dialects in contact*. Oxford: Blackwell.
- Trudgill, Peter. 2008. Colonial dialect contact in the history of European languages: On the irrelevance of identity to new-dialect formation. *Language in Society* 37, 241-280.

- Urciuoli, Bonnie. 1995. Language and borders. *Annual Review of Anthropology*. 24:525-546.
- Vokshi, Hasan. 1959. Gramatika për klasën e VII e VIII të shkollave fillore. Prishtinë: Rilindja.
- Vokshi, Hasan. 1963. Gramatikë e gjuhës shqipe për klasën e VI të shkollës fillore. Beograd: Enti për Botimin e Teksteve i Republikës Socialiste të Sërbisë.
- Woolard, Kathryn A. 1985. Language variation and cultural hegemony: Toward an integration of sociolinguistic and social theory. *American Ethnologist*. 12(4).738-748.
- Woolard, Kathryn A. & Bambi B. Schieffelin 1994. Language ideology. *Annual Review of Anthropology* 23. 55-82.
- Xhuvani, Aleksander. 1941. Historija e letërsisë greke klasike (si mbas librit të G. Sett-it) për kursin e naltë të liceut klasik (libri shteti për shkolla të mesme – nr. 15). Tiranë: Botim i Ministrisë s' Arsimit.
- Xhuvani, Aleksander. 1956. Studime gjuhësore. Tiranë: Instituti i Shkencave e Instituti i Historisë e i Gjuhësisë.
- Xhuvani, Aleksander. 1980. Vepra 1: Trashëgimi kulturor i popullit shqiptar. Tiranë: Akademia e Shkencave e RPSSH.
- Yaeger-Dror, Malcah E. 1992. Communicative Accommodation: A new perspective on 'hypercorrect' speech. *Language and Communication*. 12(3).181-192.
- Zentella, Ana Celia. 1990. Lexical leveling in four New York City Spanish dialects: Linguistic and social factors. *Hispania* 73(4).1094-1105.
- Zymeri, Isa. 1991. *Colloquial Albanian*. New York: Routledge.

Gerd-Dieter NEHRING, Berlin

SHQIPJA DHE GJUHËT E BALLKANIT NË ARSIMIN SHKOLLOR TEK SHQIPTARËT DHE FQINJËT E TYRE

Abstrakt

Kumtesa e ndriçon rolin e gjuhës shqipe dhe të gjuhëve të tjera të Ballkanit nën aspektin e statusit të tyre në arsimin e sotëm shkollor-shtetëror në vendet ballkanike ku jetojnë shqiptarët si shumicë ashtu si edhe si minoritet. Një vëmendje e veçantë i kushtohet çështjes së interdisiplinaritetit mësimor-shkollor. Ai është lënë jo rrallë mënjanë, sidomos kur është fjala për gjuhët nga këndvështrimi i një disipline tjetër. Prandaj në këtë kontekst kumtesa i analizon në mënyrë shembullore gërshtetimin e lëndës mësimore të historisë me gjuhën në përgjithësi, me gjuhët ballkanike në veçanti. Me të lidhen fillimisht të dhënat e përgjithshme për situatën gjuhësore në Kosovë, Malin e Zi, në Maqedoni, Serbi si dhe në Shqipëri. Ato krijojnë krahas me politikën gjuhësore një mbështetje të rëndësishme të kurrikulave dhe të teksteve mësimore-shkollore, të cilat përdoren, pra shqyrtohen pastaj jo vetëm me anë të të dhënave që jepen për gjuhë, por edhe nga ana e aspekteve të zgjedhura cilësore-stilistike.

Analiza është pjesë e projektit të paktit të stabilitetit për Evropën Juglindore pranë „Institutit Georg Eckert” të Braunschweigut. Ajo do të dëshmojë, lidhur me paraqitjen mësimore-shkollore të gjuhëve të ndryshme ballkanike dhe situatën gjuhësore, se janë arritur rezultate të konsiderueshme. Megjithatë mbetet i hapur ende një numër jo i vogël çështjesh, të cilat kanë të bëjnë me zbatimin e statusit të gjuhëve ballkanike në procesin e arsimit të brezave të rinj. Ato lidhen edhe me përpilimin e korpusit të tyre për tekste mësimore-shkollore dhe me transmetimin e të dhënave gjuhësore, jo vetëm nën aspektin „gjuha jonë”, por sidomos nga këndvështrimi „ne dhe fqinjët tanë”. Nevojiten hulumtime të mëtejshme, duke filluar, mendojmë në radhë të parë tek analiza e gjuhës, dmth., pa marrë parasysh nivelet e larta gjuhësore të autorëve dhe të lektorëve në shumë raste, edhe tek shqipja vetë që përdoret në arsim.

Analiza e ndriçon rolin e shqipes dhe të gjuhëve të tjera të Ballkanit nën aspektin e statusit të tyre në arsimin e sotëm shkollor-shtetëror në këto vende ballkanike shqipfolëse ku jetojnë shqiptarët si shumicë ashtu edhe si minoritet me të drejtë të përdorimit të shqipes si gjuhë zyrtare. Një vëmendje e veçantë i kushtohet çështjes së interdisiplinaritetit mësimor-shkollor. Në studime të mëparshme ajo është

lënë në të shumtën e rasteve mënjanë, sidomos kur është fjala për gjuhë nga këndvështrimi i një disipline tjetër. Prandaj në këtë kontekst shqyrtimi e analizon gërshetimin e lëndës mësimore të historisë me gjuhën në përgjithësi, me gjuhët ballkanike në veçanti. Me të lidhen fillimisht të dhënat për *situatën gjuhësore* në Kosovë, Malin e Zi, në Maqedoni, Serbi Jugore si dhe në Shqipëri (1). Ato krijojnë krahas me politikën gjuhësore një mbështetje të rëndësishme të *kurrikulave*, që paraqiten (2 a, b), dhe të *teksteve mësimore-shkollore*, të cilat përdoren sot për lëndën e historisë (3). Analiza cek më tutje me shembuj të zgjedhur gërshetimin e posaçëm të lëndës së historisë me gjuhë nëpërmjet shtjellimit të çështjes, ç' mëson brezi i ri mbi gjuhë dhe historinë e saj (4) dhe ç' tipare ka gjuha e përdorur në mjete mësimore të historisë (5)?

1. Vendet shqipfolëse të Ballkanit tërësisht nuk karakterizohen pas ndryshimeve të viteve të fundit nga një situatë gjuhësore më e thjeshtë. Kjo gjendje faktike nuk ka të bëjë vetëm me gjuhët zyrtare, të cilat pranohen në shtetet përkatëse, por edhe me vetëdijen e komuniteteve kombëtarisht-etnikisht më të ngritur sot dhe me kushte të veçanta tranzicioni që lidhen me to. Khs.¹:

¹ Vlerësimet bëhen, nëse nuk shënohet ndryshe, në mungesë të statistikave zyrtare në tërësi sipas:
<http://www.auswaertiges-amt.de/DE/Aussenpolitik/Laender/Laenderinfos/01-Laender>.

<i>Pasqyra e mbartësve të gjuhëve ballkanike në vendet shqipfolëse</i>						
	Kosovë	Mali i Zi	Maqedoni	Serbi Jugore	Shqipëri	<i>shënim</i>
<u>GJUHA ZYRTARE</u>	gjuha SHQIPE, SERBE (BOSHNJAKE, ROMANI, TURKE) ²	gj.: MALAZEZE (BOSHNJAKE, KROATE, SERBE, SHQIPE) ³	gj.: MAQEDO- NASE., SHQIPE, ROMANI, SERBE, TURKE	gj.: SERBE, SHQIPE ⁴	gj.: SHQIPE	() = në nivel rajonal
<u>KOMUNITETE</u>	<i>gjuha amtare</i>					
1. AROMUNË	aromune	sh. të tjerë	0,48 %			
2. ASHKALINJ	shqipe, serbe	sh. të tjerë				serbishtja në Kosovë = gjuhë e dytë
3. BOSHNJAKË	boshnjake	sh. të tjerë	13 % bosnjakë ose myslimanë etnikë	0,8 %		

² Shënim: *Situata gjuhësore e Kosovës*: statusin e barabartë të gjuhës shqipe dhe serbe si dhe të drejtën e çdo komuniteti të ruhet dhe promovohet identiteti i tij gjuhësor e përcakton ligji për përdorimin e gjuhëve (sh. Ligj 2006). Me të lidhet një dygjuhësi e reduktuar kryesisht në funksione formale(-shtetërore). ... “me dokumente ligjore (rregulloret e UNMIK-ut dhe ligjet e Kosovës) dhe në nivelin qendror, si gjuhë zyrtare u përcaktuan shqipja, serbishtja dhe anglishtja, me *caveat*-in që, në rast të konfliktit dhe mospërputhjes, versioni dominues është ai në gjuhën angleze.” (Munishi 2010, 95).

³ *Situata gjuhësore në Malin e Zi*: Draga (2010, 108f.) udhëzon në pabarazinë praktike të gjuhës shqipe në relacionet ekzistuese politike në Mal të Zi, “ndërsa përjashtim pozitiv bën administrata shkollore e dokumentacionit pedagogjik për nxënësit në shkollat me mësim në gjuhën shqipe.” (po ai 108).

⁴ Për Serbinë Jugore (komunat e Bujanovcit, të Medvegjës dhe të Preshevës) nuk ka të dhëna të sakta. Sipas informantëve jetojnë në këto treva rreth 60.000 njerëz. Të dhënat në burime të përgjithshme shënojnë një numër më të madh. Etnikun kryesor e paraqesin shqiptëtarët (mbi 60%), pastaj serbët (23%?), romët (mbi 10%?) dhe të tjerë.

		Kosovë	Mali i Zi	Maqedoni	Serbi Jugore	Shqipëri	shënim
4. EGJIPTIANË	romani	sh. të tjerë					
5. GORANË	gorane	sh. të tjerë					
6. KROATË	kroate	sh. të tjerë	1 %				
7. MALAZEZ	malazeze	sh. të tjerë	43 %				
8. MAQEDONAS	maqedo- nase			64,2 %			
9. ROMË	rome	sh. të tjerë	~ 3 %	2,6 %	>10% (?)		
10. SERBË	serbe	4 %	32 %	1,8 %	~25% (?)		
11. SHQIPTARË	shqipe	91 %	7 %	25,2 %	> 60%	> 98 %	
12. TURQ	turke	sh. të tjerë		3,9 %			
TË TJERË		5 %		1 %			
bashkë		~ 2.000.000	620.000	2,02 Mio	> 60.000 (?)	3,659,616	
PBV (GDP në miliardë)		~ 4,2 €	~ 3 €	6,304 €	29,34 (Serbi)	~ 4,3 \$	FRANCË 1918 €
FEJË		myslimanë (shumicë), ortodoksë, katolikë	75 % ortodoksë, 3,5% katolikë, 15 % myslim.; pa të dhëna	ortodoksë ~ 70%, mysli- manë 25%, katolikë 0,5%	ortodoksë, myslimanë	70% myslim., 20% ortod., 10% katolikë	

Në vendet shqipfolëse jetojnë, siç del nga pasqyra, më shumë se 12 komunitete të ndryshme etnike. Numri i tyre në shtete të veçanta ndryshon, ndërsa shqipja është gjuhë e shumicës së popullsisë në dy vende (në Kosovë – 92% [Kosova 2011, 530] dhe në Shqipëri – 98,6% [Fjalor 2009, 2548]). Në Serbinë Jugore flitet shqipja nga më shumë se gjysma e popullatës [mbi 60%]). Dallimi kryesor mes shqipes, kur paraqet gjuhë të shumicës, përqendrohet me të në situatën gjuhësore, në Kosovë dhe në Serbinë Jugore nuk është e vetmja gjuhë zyrtare. Në dy vende shqipja është gjuha e shumicës së popullsisë, në Maqedoni dhe në Malin e Zi.

Gjuhët e tjera ballkanike të shumicës së popullsisë janë, siç dihet: maqedonishtja (në Maqedoni), gjuha malazeze (në Mal të Zi) dhe serbishtja (tërësisht në Serbi), kurse gjuhët zyrtare, që u përkasin minoriteteve në vende shqipfolëse janë: gjuha boshnjake (në Kosovë, në Mal të Zi), gjuha kroate (në Mal të Zi), serbishtja (në Kosovë, në Maqedoni, në Mal të Zi), romani (në Kosovë, në Maqedoni) dhe gjuha turke (në Kosovë, në Maqedoni). Vlen të përmendet se sistemi arsimor sidomos në Kosovë ngarkohet me një numër problemesh, që pikënisjen e tyre e kanë në politikë, kemi në fakt dy sisteme shkollore, sistemin e qeverisë së Kosovës dhe atë të Serbisë; të dyja, me sa dihet, përjashtohen reciprokisht.

Nxënësit e popullsisë së ndryshme të shumë vendeve shqipfolëse shpesh nuk komunikojnë apo komunikojnë vetëm pak njëri me tjetrin. Feja nuk përputhet me përkatësinë etnike të mbartësve gjuhësore, por nuk krijon pengesa në komunikim. Produkti bruto i vendit (GDP) arrin në të gjitha vendet një nivel shumë të vogël. Ashtu mbetet edhe fondi financiar, i cili mund të përdoret për konsolidimin e sistemit mësimor-shkollor, i kufizuar.

2. Roli i posaçëm i gjuhëve ballkanike në mësimdhënie shkollore e ka shprehjen specifike si edhe bazën e vet të kurrikulat shtetërore, të cilat kanë marrë sot fuqinë ligjore në të gjitha vendet shqipfolëse të Ballkanit. Në qendër të vëmendjes dhe në përfillje të qëllimeve të lartpërmendura të analizës qëndron pyetja: cilave gjuhë të Ballkanit u referohen dhe si janë karakteristikat kohore të tyre? Me interes janë, lidhur me të, sidomos dy perspektiva të gërshetuara vëzhgimi. Këto janë analiza e kurrikulave të historisë, nga ana e gjuhëve, në të cilat janë përpiluar, dhe aspekti i vitit të hyrjes në tyre në fuqi (a) si dhe mësimdhënia e historisë dhe, në krahasim me të, e gjuhëve ballkanike në kohëzgjatjen e tyre javore (b). Të dhënat jepen në bazë të dispozicionit të tyre publik në librari, në bibliotekë dhe në web-faqe. Kr.:

II. a) Kurrikulat për lëndën e historisë në shkollat shetërore

Shkollë	klasë	Kosovë		Mali i Zi		Maqedoni		Serbi Jugore		Shqipëri		Shënim
		gjuha	zbatim	gjuha	zbatim	gjuha	zbatim	gjuha	zbatim	gjuha	zbatim	
shkolla fillore	4									shqipe	2007	? = pa të dhëna; "ZBATIM" = hyrje në fuqi
	5	shqipe	2007	malaz.	2005	maq.	2004	serbe	2007			
shkolla e mesme e ulët		boshn.	2007			shqipe	2004					Maqedoni: sipas arsimit të ri 9-vjeçar; planet e sistemit 8-vjeçar: 2004
	6	turke	2007?	malaz.	2005	maq.	2008	serbe	2008	shqipe	2005?	
		boshn.	2003			shqipe	2004					
	7	turke	2003?	malaz.	2005	maq.	2004	serbe	2009	shqipe	2005?	
(gjimnaz)		boshn.	2004			(shqipe)	2004					
	8	turke	2004	malaz.	2005	maq.	2004	serbe	2010	shqipe	2007	
		boshn.	2005			shqipe	2004					
Gjimnaz	9	turke	2005	malaz.	2005	maq.	2005	serbe	2003	shqipe	2007?	Serbi: gjimnazi prej kl. IX; gjim. specialë gjithashtu: 1995, 1997, 2006
		boshn.	2006			shqipe	?					
arsim profesional	10	turke	2006	malaz.	2005	maq.	2005	serbe	2003	shqipe	2008?	Mali i Zi: gjimnazi i përgjith.; Serbi: gjim. specialë gjithashtu: 1995, 1997, 2006 (Serbi: 1997, 2006 = gjim. specialë) (Serbi: 1997 = gjim. specialë)
		boshn.	2003			shqipe	2000					
	11	turke	2003	malaz.	2005	maq.	2005	serbe	(1997,	shqipe	2008?	
		boshn.	2004			shqipe	2005		2006)		2009?	
	12	turke	2004	malaz.	2005	maq.	2006	serbe	(1997)	shqipe	2010?	
	boshn.	2005			shqipe	?						
arsim profesional	13	turke	2005	malaz.	2005	maq.	2006	serbe		shqipe		Mali i Zi: I për shkolla të ulta; II arsim 3, 4-vjeçar; në kllapa = shkolla speciale
		boshn.	2006			shqipe	?					
	I	turke	2006	malaz.	2009-2011	maq.	2006	serbe	1990 (1993)	shqipe	2009?	
	II			malaz.	2009-2011	maq.	2002		1990/93	shqipe	2010?	

II. b) Shqipja, gjuhët ballkanike dhe historia sipas orëve në javë⁵

klasë	Kosovë			Mali i Zi			Maqedoni				Serbia Jugore			Shqipëri		SHËNIM		
	Gjuha shqipe, (bosh./turke)	histori	hist.	gjuha amtare + letërsi	gjuha zyrtare joamtare	hist.	gjuha amtare ¹	maqed. joamtare	vllahë roma bosh. ²	histori	gjuha amtare	serbishtja joamtare	hist.	gjuha shqipe	hist.			
1	7			6	2		6						5?	2?	?	hist. = lënda e historisë ¹ = gj. maq., shqipe, serbe, turke ² sipas planit 9-vjeçar; gjuha dhe kultura e tyre ? = pa të dhëna ³ Serbi: shkollat filologjike në çdo kl.. 2 orë zgjedh. = lëndë me zgjedhje		
2	7			6	2		6						5?	2?	?			
3	7			6	2		6		1				5?	3?	?			
4	6			5	2		5	2	2				5?	3?	?		2	
5	5	2		5	2		5	2	2				5	3	1		?	
6	5	2		5	2	1,5	4	3	2	2			4	3	2		2,7	2
7	5	2		4	2	1,5	4	3	2	2			4	3	2		2,5	2
8	5	2		4	2	2	4	2	2	2			4	2	2		2,1	2
9	4	2		4	2	2	4	2	2	2			4 ³ (+letër.)		2		3,1	2
10	4(+ letërsi)	2		4	2	2	4 (+ letërsi)	2		2			4(3) (+ letërsi)		2		3 (+ letërsi)	1
11	4(+ letërsi)	2		4	2	2	4 (+ letërsi)	2		2			5 (3) (+ letërsi)		2		3 (+ letërsi)	2 (2 zgjedh.)
12	4(+ letërsi)	2		4	2	2	4 (+ letërsi)	2		2			5 (4)		2		4 (+ letërsi)	2

⁵ Shënim për tab. II. a) dhe b):

II. a) Për arsimin joformal të Kosovës²⁷ u përpiluan kurrikulat në gjuhën shqipe dhe në gjuhën boshnjake në këto vite: më 2004 (kl. 6 çshqip, boshnjakisht]; 7 çshqip]), më 2005 (kl. 7 çboshnjakisht]; kl. 8 çshqip, boshnjakisht]); të gjitha të tjerat më 2006. Për diasporën shqiptare (kosovare) jepet historia sipas kurrikulave në tri nivele: I-III, IV-VI dhe VII-IX. Kurrikulat përkatëse hyrën në fuqi më 2007.

Kurrikulat e historisë për të rriturit të Serbisë (kl. 5-8) datohen prej vitit 1991.

II. b) Arsimi joformal kosovar parasheh: për gjuhën shqipe 7 orë (kl. 1, 2, 3), 6 orë (kl. 4) resp. 5 orë (kl. 5-9), për lëndën e historisë, duke filluar nga kl. 5) nga 2 orë në javë, ndërsa mësimdhënia e diasporës kosovare për gjuhën dhe letërsinë shqiptare 46 orë në vit nga çdo nivel, për historinë 4 orë në vit (niv. I) resp. 8 orë në vit (niv. II dhe III). Planprogramet e Serbisë për të rriturit caktojnë për gjuhën amtare 7 orë (kl. 1-2), 8 orë (kl. 3-4) resp. 5 orë në javë (kl. 5-8), për serbokroatishten si gjuhë joamtare 3 orë/javë (kl. 1-4) resp. 2 orë/javë (kl. 5-8). Lënda e historisë jepet me nga 2 orë/javë prej kl. V – kl. VIII.

klasë	Kosovë		Mali i Zi			Maqedoni				Serbia Jugore			Shqipëri		SHËNIM
	Gjuha shqipe, (bosh./turke)	histori	gjuha amtare + letërsi	gjuha zyrtare joamtare	hist.	gjuha amtare ¹	maqed. joamtare	vllahë roma bosh. ²	histori	gjuha amtare	serbishtja joamtare	hist.	gjuha shqipe	hist.	
13	4(+ letërsi)	2	4	2	2	4 (+ letërsi)	2		(2) zgjedh.	(+letërsi)			letërsi)		
I prof.					2(1)	3 (+ let.)	2 (+ let.)		2	3	2 (skr)	3, 2		1 (kl. X)	
II prof.					2(1)	3 (+let.)	2 (+ let.)		2	2/3	2 (skr)	2	?	2 (1)	Shqipëri: kl. XI
III						3 (gj.+1.)	2 (gj.+1.)			2/3	2 (skr)				
IV						3 (gj.+1.)	2 (gj.+1.)			-/3	2 (skr)				

Pasqyrat II. a) dhe b) tregojnë se kurrikulat e lëndës së historisë, të cilat mund të arrihen publikisht, përpilohen në të shumtën e rasteve në gjuhën e shumicës së popullsisë. Duke marrë parasysh situatën financiare të vendeve të veçanta, proceset e tranzicionit dhe pasojat e luftës në shumë vende, meriton ky fakt respekt. Një përjashtim paraqet nga një anë, Kosova, ku ekzistojnë kurrikulat edhe në gjuhën boshnjake dhe turke.⁶ Nëse lihet mënjanë arsimiti profesional, janë bërë këtu hapa me rëndësi për realizimin e arsimit të minoriteteve në gjuhën amtare. Edhe në Maqedoni ekzistojnë kurrikulat në gjuhën e një popullsie tjetër, në gjuhën shqipe. Sidoqoftë, ato mungojnë këtu si edhe në Malin e Zi për arsimin profesional. Me interes është fakti se në disa raste (sh. kl. 6, 10) kurrikulat në gjuhën shqipe janë më të vjetra se sa në gjuhën maqedonase.

Me të dhënat e paraqitura arrihet konkluzioni se gjuhët ballkanike në sektorin shkollor në tërësi nuk i plotësojnë publikisht funksionet e duhura dhe të kërkuara sot në Evropë, sepse nuk ua garantojnë gjithë minoriteteve të drejtën e ruajtjes dhe të promovimit të identitetit gjuhësor dhe me të të pjesëmarrjes në një diskutim më të gjerë publik shkollor në bazë të gjuhës së tyre amtare. Vlen të përmendet përveç kësaj fakti se planprogramet në shumë raste nuk janë të reja. Në Serbi kemi p. sh. diferenca të mëdha mes dokumenteve të veçanta. Me të realizohen edhe në tekste mësimore-shkollore përmbajtje të vjetruara.

Të dhënat tregojnë gjithashtu se lënda e historisë në të gjitha vendet e paraqitura ballkanike vjen, siç pritej, prej nga fondi kohor pas mësimdhënies së gjuhës amtare. Por, me ç' tipare kryesore na paraqiten gjuhët ballkanike dhe lënda e historisë në planprogramet të shkollave shtetërore? Pasqyra tregon përgjithësisht korrespondenca dhe dallime mes rolit të gjuhëve ballkanike në arsim. Mësimi i lëndës së historisë fillon në trevat, ku jetojnë shqiptarët, në klasën e pestë ose të gjashtë në varësi nga sistemi shkollor. Përjashtimin e bën Shqipëria, ku fillon aktualisht mësimdhënia e historisë prej klasës së katërt (por vazhdon në klasën e gjashtë etj.). Mësimdhënia e historisë mbaron me mësim të mesëm në klasën XII gjegjësisht XIII.

Në disa vende jepet sipas kurrikulave vetëm ose kryesisht shqipja si gjuhë amtare (Shqipëri, Kosovë), në vende të tjera gjuha amtare

⁶ Ato nuk janë të mbërrishme publikisht në disa raste, prandaj as nuk dëshmojnë përdorimin real të turqishtes në Kosovë.

sipas përkatësisë etnike (malazeze, maqedonase, serbe). Për rastin e Kosovës me të përjashtohet mundësia që nxënësit shqiptarë mësojnë një gjuhë tjetër zyrtare. Por, as planprogramet e Serbisë, as ato të Maqedonisë dhe të Malit të Zi nuk e parashikojnë mësimin e shqipes ose të një gjuhe tjetër zyrtare për nxënësit e shumicës së popullsisë. Sidoqoftë, gjuha malazeze, maqedonishtja dhe serbishtja janë lëndë të obliguara si gjuhë joamtare brenda shteteve përkatëse, ku jetojnë shqiptarët si minoritet. Ky është një dallim i rëndësishëm në statusin e gjuhëve ballkanike. Pasqyra tregon gjithashtu se kurrikulat e Kosovës rezevojnë në klasat e para numrin më të madh orësh në javë për gjuhën amtare, gjë që rrjedh nga roli i standardit të saj në Kosovë. Orët për mësimin e gjuhës amtare kombinohen shpesh me letërsinë, sidomos në Malin e Zi në shkollat e mesme të larta. Mbetet me të për t'u diskutuar çështja, duke përfillur edhe situatën gjuhësore konkrete, a zbatohen në këtë mënyrë gjithmonë kërkesat e kultivimit gjuhësor apo jo? Në Maqedoni parashikon planprogrami përveç kësaj prej klasës së tretë orët e veçanta për romë, boshnjakë dhe vllahë. Këta nxënës mësojnë kulturën dhe gjuhën e komuniteteve të tyre, sepse ato nuk janë pjesë përbërëse e kurrikulave përkatëse. Ashtu ekzistojnë edhe paralele me mësimin e shqipes në diasporë (sh. më lartë).

3. “Teksti i historisë përkrah në mënyrë efektive ndërtimin dhe zhvillimin e kompetencave themelore të nxënës/eve për të qenë qytetarë të përgjegjshëm, pjesëmarrës aktivë në ngritjen e shoqërisë demokratike” thuhet në një draft të standardeve për tekste të Kosovës (MASHT 2009, 50). Por si realizohet kjo detyrë, lidhur me gjuhën e teksteve, në vendet ku jetojnë shqiptarët si shumicë ashtu edhe si minoritet? Khs.:

III. Librat e historisë në vende shqipfolëse të Ballkanit

(Përsëritja e materialeve në klasa të Maqedonisë, Serbi së dhe Shqipërisë shënon shtëpi botuese dhe/ose vite botimi të ndryshme; + = shtëpi botuese dhe vite botimi të njëjta.)

klasë	Kosovë			Mali i Zi			Maqedoni			Serbi Jugore			Shqiperi		
	materiale	gjuha	bot. i parë	materiale	gjuha	bot. i parë	materiale	gjuha	bot. i parë	materiale	gjuha	bot. i parë	materiale	gjuha	bot. i parë
4							atlas	mak	2009						
							atlas	mak.	2005						
							atlas them.	mak.	2005						
													libër	shqipe	2007
													fletore	shqipe	2007
5	libër	shqipe	- 2007				libër	mak.	2005	libër + fletore	serbe	- 2007			
	fletore	shqipe	- 2007							libër	serbe	- 2007			
	libër	turke	- 2010							libër	serbe	- 2008			
										fletore	serbe	- 2008			
										libër	serbe	- 2010			
6	libër	shqipe	- 2004	libër	malaz..	- 2001	libër	mak.	2005	libër + fletore	serbe	- 2009	libër	shqipe	2005
	fletore	shqipe	- 2004	libër	shqipe	- 2006 (01)	libër	shqipe	2005	libër	serbe	- 2010	fletore	shqipe	2007
	libër	bosh.	- 2008				fletore	mak.	2005	libër + fletore	serbe	- 2010	libër	shqipe	p. v.
	libër	turke	- 2005				fletore	shqipe	2007 (?)	libër	serbe	- 2008	libër	shqipe	2007
													libër	shqipe	2008
7	libër	shqipe	- 2004	libër	malaz..	- 2004 (01)	libër	mak.	2005	libër + fletore	serbe	- 2009	libër	shqipe	2006
	fletore	shqipe	- 2004	libër	shqipe	- 2001				fletore	serbe	- 2009	libër	shqipe	2009
	libër	bosh.	- 2008	libër						libër	serbe	- 2010	fletore	shqipe	2007
	libër	turke	- 2005							libër + fletore	serbe	- 2010	atlas	shqipe	2006
										libër	serbe	- 2009			
8	libër	shqipe	- 2005	libër	malaz..	- 2009 (07)	libër	mak.	2005	libër	serbe	- 2010	libër	shqipe	2005
	fletore	shqipe	- 2005	libër	shqipe	- 2008	libër	shqipe	2005	libër	serbe	- 2010	libër	shqipe	2007

klasë	Kosovë			Mali i Zi			Maqedoni			Serbi Jugore			Shqiperi		
	materiale	gjuha	bot. i parë	materiale	gjuha	bot. i parë	materiale	gjuha	bot. i parë	materiale	gjuha	bot. i parë	materiale	gjuha	bot. i parë
	libër	turke	- 2005				fletore	mak.	2005	libër	serbe	- 2010	libër	shqipe	2007
							fletore	shqipe	2005				fletore	shqipe	2007
9	libër	shqipe	- 2006	libër	malaz..	- 2004 (02)	libër	mak.	2002	Libër	serbe	2003	libër	shqipe	2007
	fletore	shqipe	- 2006	libër	shqipe	- 2009	libër	mak.	2006				libër	shqipe	2009
							libër	mak.	2006				libër	shqipe	2008
							libër	mak.	2006				fletore	shqipe	2008
							libër	mak.	2006				për arsimtarë	shqipe	2009
							libër	shqipe	2006				atlas	shqipe	2005
							libër	shqipe	2006				atlas	shqipe	2005
													libër	mak.	p. v.
													libër	greke	2009
													libër	alternativ	shqipe
10	libër	shqipe	- 2004	libër	malaz..	- 2002	libër	mak.	2006	libër	serbe	2002	libër	shqipe	2009
	(mat-inf, nat.)			libër	shqipe	- 2002	libër	mak.	2006	(shkolla e			libër	shqipe	2009
							libër	mak.	2002	përgj., shoq.-					
							libër	shqipe	2006	gjuhësore)					
11	libër	shqipe	- 2004	libër	malaz..	- 2002	libër	mak.	2006	libër	serbe	2007	libër	shqipe	2010
	(i përgjth.)			libër	shqipe	- 2002	libër	mak.	2003	(shkolla e			libër	shqipe	2010
							libër	shqipe	2006	përgj., shoq.-			libër	shqipe	2010
										gjuhësore)					
12	libër	shqipe	- 2005	libër	malaz..	- 2003	libër	maq.	2005	libër	serbe	2010	libër	shqipe	2010
	(i përgjth.)			libër	shqipe	- 2003				(shkolla e përgj.,			libër	shqipe	2010
										shoq.-gjuh.);			libër	shqipe	2010
										11. nat.)			libër	shqipe	2010
13	libër	shqipe	- 2007	libër	malaz..	- 2006				Libër					
	(i përgjth.)														
I prof.				libër	malaz..	- 2003				Libër	serbe	2004			
II prof.				libër	malaz..	- 2003				Libër	serbe	2006			
													alternativ	shqipe	2009

Tabela III pasqyron një larmi të madhe edhe të gjuhëve ballkanike të përdorura në sektor shtetëror edhe të mjeteve mësimore të historisë në formë librash, fletorësh dhe atlasësh. Larmia nuk u nënrenditet vetëm rrethanave të ndryshuara shoqërore-politike në treva shqipfolëse, por edhe kushteve të ekonomisë së tregut si dhe mundësive financiare të shteteve dhe të institucioneve. Prandaj Mali i Zi deri më sot vetëm ofron, siç dëshmojnë bisedat me autoritete, librat e historisë. Mjetet mësimore të historisë së tij si edhe të Kosovës dhe të gjuhës shqipe në Maqedoni shtypen nga shtëpia botuese që gëzojnë një farë monopoli brenda ndërmarrjeve publikimi të vendeve të ndryshme. Shtëpitë botuese në fjalë bashkëpunojnë me autorë të ndryshëm, por vërehet tendenca e bashkëpunimit me autorë të njëjtë, me të cilët kanë eksperiencë të provuar. Bie në sy se Shqipëria arrin numrin më të madh shtëpish botuese dhe autorësh për lëndën e historisë. Përveç kësaj dallohet një shtëpi botuese e saj, Albasi, ndër të gjitha shtëpitë botuese që prodhojnë mjete mësimore-shkollore të historisë në treva shqipfolëse, sepse distribuon me sukses mjete mësimore-shkollore jo vetëm në Shqipëri, por edhe në Maqedoni dhe në Kosovë. Ndër gjuhët e Ballkanit ka shqipja standarde prej Shqipërisë nga kjo pikëpamje statusin më të avancuar përdorimi me funksion rrezatues në vende fqinje.

Edhe librat përpilohen në të gjitha vendet, siç pritej, në gjuhën e shumicës së popullsisë. Vlen të shquhet se mjetet mësimore në gjuhën shqipe të Malit të Zi dhe të Maqedonisë janë përkthime nga maqedonishtja respektivisht nga gjuha malazeze. dhe se Kosova deri më thotë mund të siguronte vetëm për disa klasa librat në gjuhën boshnjake dhe në gjuhën turke. Por, komunitetet e kanë të drejtë të zgjedhjes së mjeteve mësimore nga vendet ame. Duhet të përmendet në këtë kontekst se në Shqipëri për nxënësit e minoriteteve maqedonase dhe greke të klasës së nëntë shitet një libër mësimi i historisë, përpiluar në gjuhën amtare nga institucionet përkatëse të Maqedonisë respektivisht të Greqisë.

Me të dhënat e paraqitura dëshmohet përmbledhtas se në vende shqipfolëse arsimit nuk mundësohet të zhvillohet në të gjitha gjuhët zyrtare të minoriteteve. Mjetet përkatëse të arsimit të tyre mungojnë plotësisht në komunat e luginës së Preshevës ose realizohen pa përfillje të shqipes në mënyrë shumë fragmentare. Materialet e historisë që përdoren aktualisht, dolën krahas me të në raste jo të rralla përpara 5 dhe më shumë viteve, gjë që vlen sidomos për gjimnazet e Maqedonisë si dhe për mjete mësimi të Malit të Zi dhe të Kosovës. Në Maqedoni hasim edhe raste, kur teksti shkollor është më i vjetër sesa

kurrikulat përkatëse (sh. p. sh. kl. 6, 10). Shqipëria shquhet prej nga materialet më të reja. Sidoqoftë, për arsimin profesional pothuaj janë lënë në tërësi pas dore.

4. Të dhënat mbi gjuhët ballkanike që jepen në tekste mësimore-shkollore mund të ndahen në bazë të shtjellimeve të deritanishme të analizës përgjithësisht sipas kriterit a i takojnë gjuhës së shumicës së popullsisë apo jo. Me interes është pastaj çështja e tejkalimit/ mostejkalimit të kufijve shtetërore të një vendi. Khs. në shembullin e librave mësimorë të historisë që përpilohen në Kosovë sot, këto të dhëna:

I. TË DHËNAT MBI GJUHËN SHQIPE

I.1. Të dhënat mbi shqipen gjithëkombëtare

Me to ndriçohen:

I.1.1 funksioni i gjuhës shqipe. Paraqiten ngjarje të rëndësishme për të nga:

I.1.1.1 RILINDJA KOMBËTARE DERI MË 1912 në trevat shqiptare si:

a) *Përprjekjet e para të Rilindjes* Shqiptare për shkollat shqipe si nga: N. VEQILHARXDHI me abetaren e parë më 1844 (u shpërnda në Korçë, Përmet, Berat, Gjirokastër etj., më 1845); K. KRISTOFORIDHI më 1867 [Historia 10, 51v.].

b) Kërkesat kryesore të *Lidhjes së Prizrenit*: njohja zyrtare e gjuhës shqipe dhe përdorimi i saj në shkollat e vendit [Historia 10, 52].

c) *Aktivitetet e diasporës*: "Me alfabetin e ri që u vendos të përdorej u botua po në Stamboll "Alfabetarja e gjuhës shqipe", e cila përmbante shkrime të Sami FRASHËRIT, të Pashko VASËS e të Jani VRETOS për gjuhën, për historinë"... [Historia 10, 2007, 62]; "më 12 tetor 1879 ... u formua ... Shoqëria e Stambollit" [Historia 10, 63]; sh. edhe aktivitetet e shoqërive të tjera [Historia 10, 63v.].

d) *Hapja e shkollave të para* më 1887vv. [Historia 10, 64v.]; *zgjerimi i botimeve* në gjuhën shqipe (sidomos në diasporë) [Historia 10, 65].

e) *Kërkesat e shqiptarëve në fund të shekullit XIX* si: bashkimi i 4 vilajeteve, përdorimi i gjuhës shqipe në administratë dhe në shkolla [Historia 10, 66].

ë) *Shtypja e përdorimit të shqipes dhe të Lidhjes së Pejës*: "Ata ndoqën e arrestuan patriotët e mësuesit shqiptarë, mbyllën shkolla e

ndaluan përhapjen e librave dhe të gazetave shqipe.” [Historia 10, 2007, 68].

f) *1908/1909: Lëvizja Kombëtare Shqiptare*: ... “hapën shkolla shqipe dhe botuan libra dhe gazeta në gjuhën shqipe. Në të gjitha trojet, nga Mitrovica e deri në Prevezë të Çamërisë, u ngritën dhjeta klube kombëtare e shkolla shqipe” [Historia 10, 69].

g) *Kongresi i Elbasanit ... vendosi*: “të hapej një shkollë e mesme pedagogjike (normale) në Elbasan”... “Normalja e Elbasanit ishte shkolla e parë e mesme në gjuhën shqipe në trojet shqiptare” Historia 10, 69].

I.1.1.2 PERIUDHA 1914 DERI MË 1945:

a) *Lufta e Parë Botërore* – në Shqipëri: “Në disa zona pushtimi, si në atë të Austro-Hungarisë dhe të Francës me angazhimin e patriotëve shqiptarë dhe tolerancës së autoriteteve të këtyre vendeve, u hapën shkolla në gjuhën shqipe, u lejua funksionimi i një administrate shqiptare” ... “Kurse në anën tjetër pushtuesit bullgarë nuk ua njihnin shqiptarëve asnjë të drejtë kombëtare e njerëzore” [Historia 10, 100v.].

b) *Vitet midis dy Luftërave Botërore*: “Gjatë viteve 20/30, rritet numri i shkollave dhe ana cilësore e tyre. U krijua një sistem i plotë i arsimit të mesëm të përgjithshëm e profesional. Liria e fjalës dhe e shtypit, që u shpall në Statutin Themeltar të shtetit shqiptar, nxiti zgjerimin e veprimtarisë botuese në Shqipëri” [Historia 10, 2007, 135v.]. Më 1918-1939 “mbi 80 për qind e popullsisë ishte e pashkolluar” [Historia 9, 2010, 74]. Jepen të dhënat kryesore për shkrimtarët më të njohur (Fan NOLI, FISHTA, ASDRENI...) si dhe për përkthimet e Nolit nga letërsia botërore [Historia 9, 74v.].

I.1.2 *Formimi i gjuhës shqipe*

I.1.2.1 RILINDJA KOMBËTARE DERI MË 1912: Në këtë periudhë përmenden:

a) përgjithësisht *studime* të ndryshme të historisë, të folklorit dhe të gjuhës – nga Jeronim de RADA [Historia 10, 51v.].

b) *Njësimi i alfabetit*, dmth.: përpjekjet nga K. KRISTOFORIDHI, P. VASA, H. TAHSINI, I. QEMALI, e me vonë nga S. FRASHERI, J. VRETOJA etj. [Historia 10, 51v.].

c) *përpyjekjet e Lidhjes së Prizrenit* “për të krijuar një alfabet të përbashkët për gjuhën shqipe” ... “deri atëherë ishin përdorur alfabetet të ndryshme (latin, grek, arab)”. “Prandaj edhe *para* Lidhjes së Prizrenit ishin bërë përpjekje për njësimin e alfabetit të gjuhës shqipe, por nuk ishte arritur në zgjidhjen e këtij problemi. Në fillim të vitit 1879 komisioni i krijuar shqyrtoi projektalfabetet e ndryshme”... “u miratuar alfabeti i propozuar nga Sami Frashëri, i cili bazohej në alfabetin latin dhe plotësohej me disa shkronja greke e disa shkronja të krijuara posaçërisht” [Historia 10, 2007, 62].

d) *Kongresi i Manastirit* (më 1908): ... “u bënë shumë diskutime për çështjen e alfabetit.. u vendos të përdoreshin dy alfabetet” [Historia 10, 70].

e) *aktivitete të xhonturqve...* “për të penguar përparimin e arsimit e të kulturës shqiptare, xhonturqit përdorën mjete e mënyra të ndryshme. Një prej tyre ishte edhe propagandimi që i bëhej përdorimit të alfabetit turko-arab për shkrimin e shqipes”... “Por, populli shqiptar, sidomos intelektualët dhe rinia shkollore, e mbrojti me vendosmëri alfabetin e gjuhës shqipe, që ishte vendosur në Kongresin e Manastirit” [Historia 10, 71].

I.1.2.2 PERIUDHA 1914 DERI MË 1944. Vihen në dukje:

a) *Alfabeti turko-arab*. “Më 17 maj 1914 në Shqipërinë e Mesme shpërtheu një kryengritje kundër qeverisjes së Princ Vidit“... “kërkohej largimi i Princ Vidit nga Shqipëria, kthimi i Shqipërisë nën Perandorinë Osmane”... “përdorimi i një alfabeti turko-arab për shkrimin e shqipes etj. Të gjitha këto kërkesa ishin antikombëtare” [Historia 10, 88].

b) *Kongreset*: “Rëndësi të madhe”... “patën tri kongreset arsimore që u mbajtën në Lushnjë dhe në Tiranë në fillim të viteve 20-ta”... “Po ashtu u mor vendimi të përdorej një gjuhë letrare e përbashkët në tekstet shkollore [Historia 13, 74].

I.1.2.3 PERIUDHA 1945 DERI MË SOT:

a) *Kongresi i Drejtshkrimit*: “Në nëntor 1972 u mbledh Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, i cili, duke mbyllur diskutimin e gjerë rreth projektit ‘Rregullat e drejtshkrimit të shqipes’, miratoi drejtshkrimin e njësuar të gjuhës letrare kombëtare. Në këtë kongres morën pjesë edhe përfaqësues të popullsisë shqiptare të Kosovës, të Maqedonisë e të Malit të Zi, si dhe të arbëreshëve në Itali, të cilët dha-

në ndihmesën e tyre në vendosjen e rregullave të drejtshkrimit të gjuhës së përbashkët amtare" [Historia 9, 184]. "Kongresi" ... "miratoi drejtshkrimin e unisuar të gjuhës letrare shqipe. Me këtë akt u bë një hap i rëndësishëm në bashkimin e shqiptarëve rreth gjuhës dhe kulturës së tyre" [Historia 13, 184].

I.2. Të dhënat mbi shqipen në Kosovë dhe në vise të tjera ish-jugosllave

Në tekste mësimore-shkollore të Kosovës ndriçohen:

I.2.1. *Funksioni i gjuhës shqipe*. Paraqiten relativisht shpesh ngjarje, kur shqipes nuk i është njohur statusi zyrtar. Khs. :

I.2.1.1 PERIUDHA 1914 DERI MË 1944. Vihen në dukje:

a) *Shqipja e mohuar dhe e penguar*: "Shqiptarëve (të Jugosllavisë) u mohohej e drejta e përdorimit të gjuhës shqipe në administratë dhe në veprimtari publike, e drejta e shkollimit në gjuhën amtare"... "Me ripushtimin e Kosovës nga ushtria e Mbretërisë SKS (1918) populli shqiptar i Kosovës mbeti pa shkolla, pa kulturë dhe pa shkencë kombëtare. Sipas Kushtetutës së Vidovdanit, të vitit 1912, minoritetet kishin të drejtë t'i kenë shkollat e tyre në gjuhën amtare. Këtë të drejtë e gëzonte pakica gjermane, rumune, italiane, rusine, kurse shqiptarëve iu mohua kjo e drejtë elementare." "Në vendbanimet e banuara me shumicë shqiptare, shkollat ishin të rralla ose nuk ekzistonin fare" [Historia 13, 76].

b) *Mësimi i shqipes*: "Në shkollat fetare kishte rast kur ndonjë hoxhë apo prift me vetëdije kombëtare, krahas mësimit fetar, ua mësonte fëmijëve edhe lexim e shkrim në gjuhën shqipe." ... Në këto shkolla fillore (mejtepe dhe medrese) "mësimin e zhvillonin kryesisht hoxhallarët e pakualifikuar, në gjuhë të huaj dhe me metoda mesjetare" [Historia 13, 2006, 76]. "Disa të rinj kalonin ilegalisht kufirin shtetëror shqiptar të nisur nga dëshira për t'u arsimuar në gjuhën shqipe" [Historia 9, 76].

c) *Përpjekje të Hasan Prishtinës*: "Gjatë viteve 1927, 1929, 1930, patriotë dhe arsime dashësi i madh, Hasan Prishtina, i dërgoi peticione Lidhjes së Kombeve, ku thuhej: 'Afro 1 milion shqiptarë që jetojnë në Kosovë e në Maqedoni nuk kanë asnjë shkollë në gjuhën amtare' " [Historia 13, 78].

d) *Biblioteka*: "Në Kosovë në periudhën midis dy luftërave botërore ekzistonin vetëm 3 biblioteka publike me gjithsej 600 libra, nga të cilat asnjë në gjuhën shqipe" [Historia 13, 78, sh. edhe 76v.].

e) *Botime*: “Në të gjitha trojet etnike shqiptare”... “nuk u zhbi-llua veprimtaria botuese në gjuhën shqipe, ndërsa individët që sillnin ilegalisht libra shqip nga Shqipëria”... “persekutoheshin dhe dënohe- shin me dënime shumë të rënda” [Historia 9, 76v.].

ë) *Pushtimi nazifashist*: “Në administratën e viseve të bash-kuara u emëruan nëpunësit shqiptarë, u hapën shkolla shqipe, u botuan libra dhe gazeta në gjuhën shqipe. Megjithatë, shqiptarët ishin të bindur se duhej luftuar kundër çdo pushtuesi” vihet në dije për Ko- sovën dhe shqiptarët gjatë viteve 1941-1942 në zonën e pushtimit ita- lian [Historia 9, 112]. Në mënyrë analoge edhe tek: [Historia 10, 154; Historia 13, 114-116]. “Për dallim nga pushtuesi gjerman dhe ai bull- gar, pushtuesit italianë përmes politikës kulturo-arsimore përpiqeshin të bënin për vete popullsinë e këtyre viseve” [Historia 13, 108]. ... “jo vetëm që kishin shpallur bashkimin e Kosovës me Shqipërinë, por ata u treguan edhe shumë ‘dashamirës’ të arsimit dhe të kulturës shqipe në Kosovë. Andaj, ata” ... “edhe inkurajuan hapjen e tyre”. Jepen she- mbuj për hapjen dhe funksionimin e shkollave fillore dhe të mesme në gjuhën shqipe në Prishtinë, Mitrovicë, Podujevë, Pazarin e Ri [Histo- ria 9, . 122].

f) *Minimalizimi i analfabetizmit gjatë viteve 1941-1945*: ... “shu- mica e popullsisë ishte analfabete.” ... “në qershor të vitit 1941 mësuesit nga Shqipëria organizuan kësi lloj kursesh në shumë qendra dhe vendbanime” ... “Numri i vijuesve të kursit ishte shumë i madh. Në këto kurse mësohej lexim-shkrim në gjuhën shqipe dhe historia e shqiptarëve.” ... “Edhe në vitet vijuese 1942, 1943 vazhdoi puna inten- sive në fushën e arsimit” [Historia 9, 121].

I.2.1.2 PERIUDHA 1945 DERI MË SOT. Vihen re:

a) *ROLI DHE STATUSI I SHQIPES PAS 1945 DERI NË VITET 1980TA NË KOSOVË*: “Në pikëpamje të zhvillimit arsimor, Kosova dhe viset e tjera shqiptare gjatë gjithë kësaj periudhe ishin rajonet më të prapa- mbetura, sepse ndaj tyre gjithmonë është ndjekur një politikë diskri- minuese, si nga Serbia ashtu edhe nga Mali i Zi e Maqedonia.”

“Pas Luftës së Dytë Botërore u hapën kurse kundër analfabetizmit” ... “nga viti 1950-1951” shkolla fillore “ishte 8-vjeçare. Një ndihmesë shumë të rëndësishme për zhvillimin e arsimit në këto troje dhanë mësuesit dhe intelektualët e ardhur nga Shqipëria.” Jepen shembuj të përhapjes së kulturës shqiptare (nëpërmjet gazetës Rilindja, radiostacionit, bibliotekës, shoqërive kulturo-artistike, themelimit të Universitetit të Prishtinës.” Pas

Plenumit të Brionëve, sidomos pas miratimit të Kushtetutës, u themelua ASHAK dhe institute të ndryshme, thuhet më tutje. [Historia 9, 2010, 185v.] ... shquhet “shtimi shkallë-shkallë i kontakteve mes Kosovës dhe Shqipërisë pas 1968 edhe në fushën e arsimit dhe të kulturës” [Historia 9, 2010, 187] – sh. në mënyrë analoge edhe: [Historia 10, 196vv.], [Historia 13, 185]. Për viteve të fundit 1960ta deri më 1980ta jepet ky informim: ... “gjuha shqipe në paralelet serbe ishte fakultative (sipas dëshirës)”. [Historia 13, 164].

b) *Analfabetizmi*: Me gjithë përpjekjet e mëdha, numri i analfabetëve në Kosovë dhe viset e tjera shqiptare mbetet i madh. Me 1981 kishte rreth 200 mijë analfabetë” ... “Kjo përqindje ishte më e madhe te shqiptarët në Maqedoni, në Mal të Zi dhe në Luginën e Preshevës” [Historia 13, 185].

c) *Shqipja në Maqedoni në vitet 80ta vv.*: “Në Maqedoni u privua e drejta e përdorimit të gjuhës shqipe në administratë, kurse nga viti shkollor 1987-1988, nxënësit shqiptarë të shkollave të mesme i detyruan të vijonin mësimet në gjuhën maqedonase. Mësuesit e profesorët shqiptarë i detyruan t'u mbanin mësim nxënësve të vet në gjuhën maqedonase” [Historia 13, 168].

II. Të dhënat mbi gjuhë të tjera në tekste mësimore të Kosovës

Të dhënat mbi gjuhë të tjera që kishin një përdorim në treva shqipfolëse përfshijnë një numër shumë të kufizuar gjuhësh. Këto janë:

II.1. GJUHA ILIRE DHE PELLAZGJE

a) *Lidhja gjenetike me gjuhën shqipe*: “Në Iliri është folur gjuha ilire, e cila është shkruar me shkronja greke dhe latine. Nga gjuha e vjetër ilire janë ruajtur mijëra fjalë si emra të njerëzve, fiseve, qyteteve, vendeve, lumenjve. Ato fjalë janë shumë të përafërta me shqipen e sotme gjë që dëshmon se gjuha shqipe është pasardhëse e drejtpërdrejtë të ilirishtes.” P.sh. Gent, Bardhyl, Teutë ... [Historia 6, 89]. Në mënyrë analoge edhe po atje 110: përmenden edhe emra hyjnisht dhe thuhet: “Edhe pse dokumentet e shkruara për kulturën ilire janë të pakta, megjithatë lidhjet e shqiptarëve të mesjetës së hershme me ilirët dhe vazhdimësia iliro-shqiptare janë të vërtetuar. Dëshmitë më të shumta për vërtetësinë e lidhjes iliro-arbërore janë vërtetuar përmes shkencave të arkeologjisë, gjuhësisë, etnografisë, antropologjisë etj.” Krahas me të paraqiten popuj të vjetër të Ballkanit, tek pelasgët shquhet në mënyrë të paqartë: “Dijetarët men-

dojnë se ilirishtja e ka prejardhjen e drejtpërdrejtë prej gjuhës pelasge.”

II.2. GJUHA ARABE

a) *Moskuptimi i gjuhës arabe mes dy luftërave botërore* në shkolla fetare: “Për popullsinë shqiptare dhe turke u hapën shkolla fetare private, mejtepe e medrese” ... “Fëmijët shqiptarë nuk e njihnin gjuhën arabe, prandaj ata mësonin përmendësh, pa e kuptuar fare përmbajtjen e asaj që mësonin” [Historia 13, 77].

II.3. GJUHA SERBE (SERBOKROATE)

a) *Shkollimi në gjuhën serbe krijon vështirësi të mëdha mes dy luftërave botërore*: “Kishte rast kur ndonjë hoxhë apo prift” ... “mësonite fëmijëve edhe lexim e shkrim në gjuhën shqipe. Kjo e frikësonte Mbretërinë SKS. Në këto kushte, qeveria serbe propozoi të hapet medreseja në Shkup.” ... “Ajo u hap” ... “më 1924 dhe veproi deri më 1941” ... “ligjëronin mësues të ardhur nga Bosnja e Hercegovina.” ... “Ligjëratat mbaheshin në gjuhën serbe dhe kjo paraqiste vështirësi të madhe.”// “Shqiptarëve (të Jugosllavisë)” ... “u bëheshin pengesa të llojllojshme” ... “Shkolla fillore në gjuhën serbe ishte katërklasëshe. Fëmijët shqiptarë duhej të vazhdonin mësimin 5 vjet, sepse në vitin e parë mësohej gjuha serbe” ... “Për shkak të pamundësisë së përvetësimit të gjuhës serbe, vitin e parë e kryenin vetëm 30% të numrit të nxënësve të regjistruar.” [Historia 13, 76-78]. // Libri i klasës së nëntë përmend se “shkollimi ishte në gjuhën serbokroate” ... [Historia 9, 121].

b) *Biblioteka*: “Në të gjitha trojet etnike shqiptare ekzistonin vetëm disa biblioteka me një numër shumë të kufizuar librash dhe të gjitha në gjuhën serbe” [Historia 9, 76v.].

c) *Mësimi i gjuhës serbe prej viteve 1960ta deri më 1980ta*: jepet ky informim: “mësimi i gjuhës serbe në paralelet me mësim në gjuhën shqipe ishte i detyrueshëm, ndërsa gjuha shqipe në paralelet serbe ishte fakultative (sipas dëshirës)” [sh. më lartë; Historia 13, 164].

d) *Botimet serbokroate në disa raste*: “Akademia i botoi edhe revistat e veta shkencore shqip dhe serbokroatisht” [Historia 9, 185v.].

Prej shembujve të paraqitur mund të nxirren këto konkluzione kryesore:

Njohuritë mbi gjuhën e shumicës së popullsisë lidhen ngushtë me paraqitjen e ngjarjeve të historisë politike. Me interes është sidomos statusi publik i gjuhës si objekt dhe mjet politik-kulturor i përpjekjeve, të cilat specifikohen në shekullin XX kryesisht për njësi të mëdha administrative-shtetërore⁷. Funkzioni politik-kulturor i shqyrtimit të gjuhës në tekste mësimore caktohet, siç dëshmojnë faktet, me koncepte të caktuara historike.

1. Për shqipen si gjuhë të shumicës së popullsisë vërehet një tendencë e madhe gjithëkombëtare, reflektimi i përsosjes së shkrimit dhe të njësimin të gjuhës në tekste mësimor-shkollore të historisë ka karakter unik dhe bëhet pjesë e politikës gjuhësore.

2. Nuk përmenden aspekte problematike, as mundësia e interpretimit të të dhënave nga aspekti i multiperspektivititetit. Mungojnë zhvillime të rëndësishme të gjuhës ose përmenden me skajshmëri, p. sh. të viteve 1950ta dhe 1960ta, të kohës sonë etj. Pa diskutuar pasaktësi të paraqitjes së gjuhës në tekste mësimore-shkollore, jepen me të informata të paqarta dhe të paplota, tërësisht josistematike pothuaj për të gjitha klasat dhe nivelet.⁸

3. Me të dhënat nga tekstet mësimore-shkollore mbi gjuhët ballkanike nxënësit (e Kosovës) nuk aftësohen si duhet për problematikën e zhvillimit të gjuhës, as për një mendim kritik ndaj tij.

4. Interdisiplinariteti i lëndëve të ndryshme, sidomos i historisë dhe i gjuhësisë, duket të jetë pa interes me gjithë paraqitjen e fakteve gjuhësore.

5. Me të lidhet një dukuri tjetër me rëndësi, vetë gjuha, e cila përdoret në tekste mësimore-shkollore. Për përshkrimin dhe vlerësimin e përdorimit të saj adekuat nevojiten tërësisht analizat nga dy këndvështrime, nga pikëpamja e gjuhësore-stilistike (5.1.) dhe nga ana e shkencave translatojgjike (5.2.). Për fat të keq, ato mungojnë në mënyrë më të hollësishme. Khs.:

5.1. Disa karakteristika të gjuhës, e cila përdoret në mjete mësimore-shkollore të historisë, janë këto: “Përdoret një gjuhë, e cila i bën

⁷ Dmth. të Shqipërisë dhe të Kosovës. Viset e tjera të Jugosllavisë përmenden në mënyrë të përgjithshme kryesisht në klasa më të larta.

⁸ Shih p. sh. lidhur me ilirishten: “Shtirirja e ilirëve dhe e I. në periudhën antike është një problem ende i diskutueshëm. Nga I. e Ballkanit nuk kemi as tekste të shkruara, as mbishkrime.” (Fjalor II, 980). “... përkatësia etnike e Pellazgëve dhe përkatësia gjuhësore e Pellazgjishtes nuk janë zgjidhur përfundimisht.” (Fjalor III, 1979).

thirrje shpesh dhe me vetëdije ndjenjës në vend të arsyes, pra, ajo e vështirëson shumë shpesh marrëveshjen mes pjesëmarrësve të dikurshëm në luftë” (Dragidella 2010, 20). “Ashtu si serbët edhe shqiptarët e Kosovës e kanë prirjen të pretendojnë që të luajnë një rol permanent viktimash. Nga ky këndvështrim ishin rrethuar gjithmonë prej armiqve, të cilët e kërconin lirinë e popullit shqiptar” (po ky, f. 11). Kemi një fond fjalësh tipike kur përshkruhen padrejtësitë kundër shqiptarëve. Ata janë: *dëshmorë, luftëtarë për liri, trima, heronjtë, patriotë*. Kundër tyre bëhet *terror, vrasje, një genocid nga agresorët, push-tuesit, sundimtarët* etj.

Dijenitë pasqyrojnë shpesh tendencat, të cilat motivohen nga politika, gjë që vlen edhe për mënyrën e të shprehurit, për materiale të ngarkuara nga ana emocionale. Ashtu përdoren, kur përshkruhen krimet kundër serbëve: *çekiq* (čekić), *sëpatë* (sekira), *kangjella* prej *hekuri* (gvozdena rešetka), *kremator* (Stojanovic 2009, 146). Nocioni i *shtetit* përdoret në librat e historisë për ngjarjet e së kaluarës, megjithatë një njësi e këtillë territoriale nuk ekzistonte. Përveç kësaj hasim shumë pasaktësi nga pakujdesi dhe/ose nga mungesa e kohës së përgatitjes së materialeve përkatëse (?).⁹ Interpunksioni nuk është në nivel etj.

Sidoqoftë, problemi më i madh është çështja, si duhet të jetë gjuha për fëmijë që të kuptojnë lëndën mësimore të historisë sa më mirë? Edhe për të nevojiten analiza të mëtejshme.¹⁰ Një propozim i mirë është bërë në

⁹ Khs. p. sh.:

- Për popullsinë shqiptare dhe turke u hapën shkolla fetare private, mejtepe e medrese... u ngritën *dhjeta* klube kombëtare e shkolla shqipe (Historia 10, 69).
- Fëmijët shqiptarë nuk e njihnin gjuhën arabe, prandaj ata mësonin përmendësh (sh. Histori 13, 77).
- patriotë dhe arsimdashësi i madh, Hasan Prishtina, i dërgoi peticione Lidhjes së Kombeve (Historia 13. 2006, 78).
- vetëm 3 biblioteka publike me gjithsej 600 libra, nga të cilat asnjë në gjuhën shqipe (Historia 13, 78).
- dashamirës" të arsimit dhe të kulturës shqipe në Kosovë. (Historia 9. 122].
- dobili se odobrenje da propovedaju na slovenskom jeziku (Historija 6, 81].

¹⁰ Khs. p. sh.: Borries, B. von: Das Geschichts-Schulbuch in Schüler- und Lehrersicht. Einige empirische Befunde, in: Internationale Schulbuchforschung 17, 1995, f. 45-60.; Beerenwinkel, A.: Fostering conceptual change in chemistry classes using expository texts. Diss. phil. Wuppertal 2006, 233f.; Hannig, Jürgen: Normen der Sprachverwendung in Schulgeschichtsbüchern. Zum Problem der Sprache im Geschichtsunterricht. In: Geschichtsdidaktik 11, 1986, f. 182-192; Staraschik, E.: Der Einfluss von Textkohäsion und gegenständlichen externen piktoralen Repräsentationen auf die

Shqipëri me librin e klasës së katërt (sh. Historia 4).

5.2. Tekstet e historisë në gjuhën shqipe që përdoren në Maqedonisë dhe në Malin e Zi paraqesin, siç u përmend më sipër, përkthime të drejtpërdrejta prej gjuhës maqedonase respektivisht nga gjuha malazeze në gjuhën shqipe. Nga bisedat me arsimtarë dhe njerëz të tjerë kompetentë mësojmë se këto përkthime shpesh nuk plotësojnë kërkesat e shkollave, kanë gabime dhe kuptohen vetëm me vështirësi nga nxënësit. Si shkak përmendet fakti se nxënësit nuk zotërojnë si duhet gjuhën standarde (Mali i Zi) ose se përkthime janë thjesht të këqija (Maqedoni). Por, kurrë nuk është bërë asnjë analizë.

Përkthimet joadekuate ndër tekstet aktuale mësimore-shkollore dëshmojnë një marrëdhënie të shtrembëruar mes shqipes dhe gjuhëve të tjera të Ballkanit. Për ilustrimin e një përkthimi joadekuat nga gjuha maqedonase në gjuhën shqipe jepem këta shembuj:

- [Историја 6, 1]: ... со учебниот за шесто одделение ве воведваме во миналото, во средниот век на европската, балканската и македонската национална историја → ... me librin e klasës së gjashtë Ju fusim në të kaluarën e mesjetës të historisë evropiane, ballkanike dhe nacionale të Maqedonisë [Historia 6, 1]; Në po atë faqe lexojmë: паѓањето под османлиска власт се содржани во шеста тема → рënia e dominimit osman përblidhen në temën e gjashtë; Албанија како држава во која словенскиот елемент постепено бил истиснат... → Shqipëria si shtet, në të cilin elementi sllav ka qenë shtypur në mënyrë permanente...; Содавањето на словенската писменост → Krijimi i shkrimit sllav; балканските земји → shtetet ballkanike.

- [Историја 6, 72]: На тој начин албанските феудали ја задржале локалната самоуправа → Kjo nënkuptonte respektimin e normave tradicionale të qeverisjes vendore [Historia 6, 72].

- [Историја 6, 107]: Успеси на востанисите по создавањето на Лешанската лига (si titull) ... vojskata na Skender-beg ... → Fitoret e para të shqiptarëve të bashkuar ... → Ushtria e Besëlidhjes [Historia 6, 107].

- [Историја III, 200]: ... развојот и крижета на социјализмот → zhvillimi i krizës së socializmit; po atje 98: Била проучавана кни-

гата на Крсте Мисирков → u mësua libri i Kërste Misirkov [Historia III, 200, 98].

Ka edhe gabime faktike.¹¹

Përkthimet shqipe të librave të historisë në Malin e Zi nuk kanë mbetur të patrajtuara në literaturë gjuhësore. U konstatua: “Janë të përkthyer edhe tekstet mësimore, të cilat nuk do të guxohej të përktheheshin. Fjala është, për shembull, për librin e artit muzikor, për librat e historisë etj. Besoj se një gjë e tillë është shumë e dëmshme, por kjo dukuri është për t’u shqyrtuar në një tubim të karakterit tjetër. Ajo që shqetëson në tekstet e përkthyer, është fakti se janë bërë disa gabime, do të thosha jo rastësisht” (Camaj 2010, 52).

Edhe materialet plotësuese shqipe të mësimdhënies së historisë moderne të Evropës Juglindore nga qendra CDRSEE¹² kanë kritika, lidhur me gjuhën. Baza e përkthimit është anglishtja. Pastaj është e rëndësishme se përkthimit të teksteve mësimore-shkollore të historisë duhet t’i përkushtohet një vëmendje më e madhe.

Kjo vlen dhe do të vlejë tërësisht edhe për çështjet e shumëllojshme të marrëdhënieve të shqipes me gjuhët e Ballkanit në të kaluarën dhe sot.

¹¹ Ka edhe gabime faktike, si p. sh.: Abdyl Frashëri e botoi librin “Shqipëria ç’ ka qenë, ç’ është dhe ç’ do të jetë” [çИстория II, 2009, 122], Jeronim de Rada vjen nga Shkodra çpo atje f. 134] etj.

¹² Center for Democracy and Reconciliation in Southern Europe. Khs. p. sh.: Erdelja 2007.

Literaturë

- Camaj 2010 = Camaj, F.: Sfidat e shqipes standarde në Malin e Zi. Pozita 2010, f. 45-59.
- Draga 2010 = Draga, N.: Çështje të pabarazisë praktike të gjuhës shqipe në Malin e Zi. Në: Pozita 2010, f. 105.112.
- Dragidella 2010 = Dragidella, L.: Neue Entwicklungen des Geschichtsunterrichts und der Geschichtsbücher des Kosovo. In: Eckert. Beiträge 2010/12.
http://www.edumeres.net/publikationen/beitraege/beitrag_243/p/neue-entwicklungen-des-geschichtsunterrichts-und-der-geschichtsschulbuecher-des-kosovo.html, f. 1-22.
- Erdelja 2007 = Erdelja, K.; Demiri, H. (red.): Mësimdhënia e historisë moderne të Evropës Juglindore. Materiale mësimore plotësues. Libri i punës 4. Lufta e Dytë Botërore. Shkup 2007.
- Fjalor II resp. III = Fjalor enciklopedik shqiptar II, III. Tiranë 2008-2009.
- Historia 4 = Boçi, S.: Historia. Për klasën e 4-të të shkollës 9-vjeçare. Tiranë-Tetovë-Prishtinë 2008 (2007).
- Historija 6 = Boshkoski, M. et al.: Historia për klasën VI (Botimi III). Shkup 2008 (2005).
- Historija II = Ristovski, B. et al.: Istorija za vtora godina gimnazijsko obrazovanie. Albi. Skopje 2009.
- Historia 10 = Bajraktari, J. et al.: Historia 10. Gjumnazi matematikë dhe informatikë. Gjumnazi i shkencave natyrore. Botim i pestë. Prishtinë⁵2009 (2004).
- Historia 13 = Bajraktari, J.; Demaj, F.: Historia 13. Gjumnazi i përgjithshëm. Prishtinë 2006.
- Historia 6 = Rexhepi, F.; Demaj, F.: Historia 6. Botim i pestë. Prishtinë.⁵2009 (2004).
- Historia 9 = Rexhepi, F.: Historia 9. Botim i katërt. Prishtinë.⁴2010 (2006).
- Historija 7 Goloč, H.; Rama, R.: Historija 7. Udžbenik za VII razred niže srednje škole. Prishtinë 2008.
- Historija III = Veljanovski, N. et al.: Historia për vitin III të arsimit gjumnazor. Prosvetno delo. Shkup 2009.
- Istorija 6 = Bubalo, Đ.; Bečanović, B.: Istorija 6: Udžbenik za šesti razred osnovne škole. Beograd 2010.
- Istorija III = Veljanovski, N. et al.: Istorija za III godina na gimnazijsko obrazovanie. Prosvetno delo. Skopje 2009.
- Istorija VI = Bošković, M. et al.: Istorija za VI oddelenie. VI izdanie. Skopje 2010 (2005).
- Kosovë 2011 = Kosovë 2011
- Kurrikulat e veçanta gjinden në faqet e internetit të ministrive të arsimit të vendeve shqipfolëse, në shumë raste mund të arrihen vetëm me një kontakt të ministrive përkatëse.
- MASHT 2009 = Standarde për tekste të Republikës së Kosovës. draf/bazë diskutimi. Versioni parapërfundimtar. Mars 2009. Për përdorim të brendshëm. Prishtinë.
- Munishi 2010 = Munishi, Sh.: Planifikimi i statusit të gjuhëve në Kosovë. Në: Pozita 2010, f. 86-104.
- Ligj 2006 = Sh.: Ligj për përdorimin e gjuhëve 2006/02-L37, i miratuar më 27.7.2006 (<http://www.kuvendikosoves.org/?cid=1,193&date=2006-10-06.12.2011>).
- Pozita 2010 = Pozita e sotme e gjuhës shqipe në Malin e Zi në krahasim me atë në përgjithësi (Materialet e sesionit shkencor, organizuar në Ulqin më 19. 12. 2009). Red. H. Shabani. Ulqin 2010.
- Stojanović 2009 = STOJANOVIĆ, D.: Slow Burning: History Textbooks in Serbia 1993-2008. In: "Transition" and the Politics of History Education in Southeast Europe, ed. A. Dimou. Göttingen, f. 141-158.

Murat BLAKU, Prishtinë
 INTERFERENCA TË SHQIPES NË GJUHË SLLAVE TË JUGUT

Abstrakt

Autori i kumtesës gjurmon ndikime të shqipes mbi të folmet malazeze të lindjes e të jugut, që kanë qenë dhe janë në kontakte me shqipen. Kërkimet e tij ai i mbështet mbi rezultatet e studimeve të shquara a të veprave të veçanta të autorëve malazezë (M. Stevanović: Istočnocrnogorski dijalekat; L. Vujović: Mrkovički dijalekat etj.). Më shumë se mbi leksikun, ai përqendrohet në rrafshin e fonetikës, të morfologjisë e sidomos të sintaksës së këtyre ligjërimeve në dritën e interferencave të shqipes aty. Një numër të caktuar të albanizmave të konstatuar nga këta autorë (më shumë nga i dyti sesa i pari) ai u shton edhe mjaft të tjerë që ose vihen në dyshim, ose nuk sqarohet burimi i tyre, më së shpeshti si pasojë e mosnjohjes së shqipes. Prania e dukshme e elementeve të kësaj të fundit në këto nënsisteme flet ndërkaq vetvetiu për përmasat dhe cilësinë e interferimit. Për segmente të caktuara të interpretimit të dukurive problemore, autori natyrisht shpreh pikëpamjet e veta që i konsideron të qëndrueshme.

Prurjet e kërkimeve në fushën e studimit të raporteve të shqipes me gjuhët sllave të jugut, jo vetëm në këto dy-tri dekadat e fundit, hedhin një dritë të re mbi rolin dhe statusin e kësaj të parës kundrejt të dytave. Botimi në veçanti i studimeve me karakter përgjithësues, si ai i A. Omarit¹ dhe të studiuesve të tjerë² i prishin stereotipet e opinionit shkencor mbi inferioritetin apriori të shqipes në këto marrëdhënie. Madje, siç rezulton nga këto gjurmime, po edhe teorikisht në përgjithësi, epërsia e kuantitetit të interferimit, relativizohet përballë peshës së kualitetit të tij në këso relacionesh, qoftë edhe vetëm në përmasa dialektore. Për më tepër dihen konceptet e teriocienëve kryesorë të fushës së kontakteve gjuhësore për cilësinë e ndërndikimeve (leksik: struktura gramatikore). Brenda harkut kohor në fjalë, vazhdojnë të shohin

¹ A. Omari: *Ndikime të gjuhës shqipe në të folmet jugore të serbishtes*, **Studime filologjike**, 1/1989, 43-59.

² Murat Blaku: **Ndikimi i shqipes mbi të folmet serbe të Kosovës**, Prishtinë, 2010 (disertacion i mbrojtur më 1989); Qemal Murati: **Elementet e shqipes në gjuhët slave jugore**, Prishtinë, 1990 etj.

dritën e botimit ndërkaq edhe vepra që nuk dalin nga shtrati i ngurtësuar i një tradite me të meta serioze metodologjike, që më së paku mund të quhen shumë të diskutueshme³.

Nga problematika e vënë në titull, këtë herë gjurmohen **albanizma gramatikorë** ndër të folme malazeze të lindjes. Brumin kërkimor e përbëjnë rezultatet dhe të dhënat e studimeve a të veprave të veçanta të dialektologëve të shquar malazezë të këtyre ligjërimeve, ndërsa interesimi përqëndrohet kryesisht në ato pika ku konsiderohet se prania ose ndikimi i shqipes ose nuk vihet re, ose injorohet nga shkaku i mosditjes së saj, ose merret me rezervë. Mundësitë që të tria janë reale, por objektivisht është për t'u besuar se kjo e dyta duhet të jetë arsyeja kryesore. Dy janë veprat themelore që së bashku përbëjnë korpusin studimor brenda të cilit qëmtohen faktet të cilat hedhin dritë mbi synimin e parashtruar: "Istočnocrnogorski dijalekat" e M. Stevanoviçit⁴ dhe "Mrkovički dijalekat" e Ll. Vujoviçit⁵.

Karakteristikë e përgjithshme dialektore e këtyre të folmeve janë tiparet arkaike të tyre. Veç kësaj, dhe kjo është kryesorja, ndeshen në to zhvillime që shmangen nga evoluime normale në shtokavishte të tjera. Këto procese janë konsideruar me të drejtë ndikime nga jashtë, më shpesh si "romanski uticaj" (ndikim roman), po edhe ndikim i shqipes. Këtu më poshtë natyrisht që nuk do të merren në shqyrtim çështje që janë rrahur nga gjuhëtarë të tjerë. Trajtohen në nënsistemet përkatëse dukuri e segmente që reflektojnë drejtpërdrejt ose tërthorazi ndikime të shqipes që, s'janë, vënë në dukje deri sot.

a) Fonetikë

Te "Mrkovički dijalekat" Ll. Vujoviç njih interferime nga shqipja në punë të zëvendësimit të vokaleve. Ai konstaton se **a**-ja e shqipes pas **l**-së mund të zëvendësohet edhe me **e^a** (një **e** që ruan edhe timbrin e **a**-së): *lakurić*, po edhe *le^akurić* (nga shq. *lakuriq*); *Le^aktiza* (emër prone) nga shq. *i lagët*. Gjysmëzanorja **ë** e shqipes atje ka tri zëvendësime p.sh. në fjalën *frashën*: *e^a Fraš^anj*; *e*: *Frašenj*; *i* *Frašinj*

³ Vanja Stanišić: **Srpsko-albanski jezički odnosi**, Beograd, 1995.

⁴ Mihailo Stevanović: *Istočnocrnogorski dijalekat*, **Južnoslovenski filolog**, knjiga XIII, Beograd, 1933-34.

⁵ Luka Vujović: *Mrkovički dijalekat*, **Srpski dijalektološki zbornik**, XVIII, 1969.

(140) dhe këto janë pohime të tijat.

Për asimilimin e disimilimin jep shembuj e>a: *merak>marak, maraklija*. Turqizmat si ky shqiptohen gjithandej në të folmet e shqipes pikërisht me këto trajta. Po ai nuk i ndërlihd me shqipen. Edhe për asimilimin a>o: *Crnogora, Dobrovoda*, ku ndërmjetësimi i shqipes mbase nuk mund të mohohet, nuk thotë gjë. Përpjekjet që këto forma të shpjegohen me trajta të njëjësit *Crnogorac, Dobrovođanin* nuk janë bindëse.

Për ndërrime tingujsh nga përzierja e fjalëve si u>o: *kokoros* (për *kukuruz*) njih ndikimin e shqipes nga *kolomboć* (141). Ndërkaq për dukurinë e ndryshimit të tingujve në fjalë të huaja, si k>c e g>d̂ (153), si *asćer, pešćir, ćibrit, ćera* e *verđija, Đerman, đermanski* etj. ai me siguri për shkak të mosditjes së shqipes te këta shembuj nuk njih ndikime të kësaj të fundit. Për kalimin c>k (154) po: *bukelica* (shq. bucelë).

Për çështjen e nazalizimit që e vë në dukje M. Stevanović, tipet e l-së ky e Vujovići, nuk do të ndalemi, sepse atyre u janë sjellë gjuhëtarë të tjerë. Do theksuar vetëm kjo që ky i fundit njih sidomos një ndikim të fortë të shqipes në punë të transformimeve të tingujve l, lj (197). Një të tillë ndikim bashkë me turqishten ky i njih shqipes edhe për palatalizimin e tingujve š>ž dhe č>đ (204-205).

b) Morfologji

Te disa trajta emrash dhe gjinia e tyre nuk mund të mohohet ndikimi i drejtpërdrejtë ose ndërmjetës i shqipes, edhe kur autori i studimit nuk e thotë. *ćoban, Latin, Cigan* etj. (211) që dalin pa formantin – **in**, më shumë se rezultat i haplologjisë (212) duhet të jenë reflektim i trajtave të shqipes, sikurse edhe te *Đerman, verđija* etj. *Krv* (214) ndërkaq e ndonjë emër tjetër, që në serbishten standarde janë të gjinisë femërore, këtu dalin mashkullorë. Fenomeni njih shtrirje të gjerë edhe ndër ligjërime të tjera të serbishtes dhe ishte konstatuar qysh nga Belići, Stevanović etj., në vendet përkatëse⁶, por gjen shprehje më të theksuar ndër të folmet serbe e malazeze që janë në kontakt me shqipen. Kjo, natyrisht, nuk do të thotë që shqipja ishte faktori kryesor i shtytjes së dukurisë, po mjaft shembuj me këtë emër kanë ndërtim sintaksor të kësaj të fundit. Autori sjell edhe ndonjë shembull të interfe-

⁶A. Belić: *Dijalekti južne Istočne Srbije*, 305; M. Stevanović: *Dakovački govor*, 108.

rencave të drejtpërdrejta të shqipes dhe këtë e pohon shprehimisht, si p.sh. *livat* (m) (shq. *livadh*) (215).

Për morfologjinë e vetorëve në këtë të folme e në mjaft ligjërime të tjera malazeze, sikurse edhe në serbishtet jugore në kontakte me shqipen në përgjithësi, do vënë në pah dukuria që trajtat e vetës së parë dhe të dytë njëjës të tyre, si dhe forma e vetvetorit dalin pothuaj rregullisht në trajtën e tyre të akuzativit: *mene, tebe, sebe* e jo të dativit e lokativit *meni, tebi, sebi*: “*Mene su mi ga dali*” (për *meni*); “*Ko ti reče tebe*”; (për *tebi*); “*Ko što čini, sebe čini*” (për *sebi*); “*Rekoh sam sebe*” (për *sebi*).

Fenomeni ishte vënë re nga studiues si Belić⁷, M. Pavlović⁸, M. Stevanović⁹, D. Barjaktarević¹⁰; për të folmet malazeze lindore M. Stevanović¹¹, Ll. Vujović¹², ndërsa për dialektin e Zetë-Sjenicës P. Ivić¹³. Ndesht pothuaj rregullisht edhe në ligjërimet serbe të Kosovës. Historikisht nuk është shumë i vjetër ngase në sllavishten e përbashkët (“opšteslovenski”) trajtat e këtyre përemrave në dhanore e vendore dalloheshin qartë¹⁴. Për prejardhjen e tij më gjerësisht është bërë fjalë edhe në një vend tjetër¹⁵, por mbase e vlen të theksohet edhe njëherë se kësaj çështjeje nuk i është dhënë një zgjidhje e qëndrueshme. Belići mjaftohet me konstatimin se shfaqet së pari në të folmet ku gjejnë përdorim trajtat e akuzativit në vend të lokativit (e ka për të folmet malazeze), por më tutje s’thotë gjë. Për shtokavishtet e tipit ekavik, me përjashtim të jugoreve, dukuria do të mund të shpjegohej me reflektimin e “jatit”, që në këtë ligjërime përfundoi në *e*. Këtë pikëpamje e mbrojnë D. Barjaktarević¹⁶ dhe M. Gërkoviç¹⁷, por “jati” pak më i shkurtër dha *je*, ndërsa diçka më i gjati *ije* (në ligjërimet ma-

⁷A. Belić: *Istorija srpskohrvatskog jezika*, II, 104.

⁸M. Pavlović: *Govor sretečke Župe*, 171; *Govor Janjeva*, 80.

⁹M. Stevanović: *Đakovački govor*, 109.

¹⁰D. Barjaktarević: *Dijalektološka istraživanja*, 106-107.

¹¹M. Stevanović: *Istočnocrnogorski dijalekat*, 115.

¹²L. Vujović: *Mrkovički dijalekat*, 235.

¹³M. Blaku: *Ndikimi i shqipes...*, 184.

¹⁴A. Belić: *Istorija...*, II, 102.

¹⁵M. Blaku: *Ndikimi i shqipes...*, 184-186.

¹⁶D. Barjaktarević: *Govor Srba u Metohiji*, 186.

¹⁷Shih rev. *Prilozi proučavanja jezika*, 1968, 132.

lazeze lindore)¹⁸. Prandaj, dukuria s'është aq e thjeshtë dhe M. Stevanović thotë me të drejtë se kjo nuk mund të shpjegohet me rrugë e procese zhvillimesh fonetike¹⁹. Nuk del bindëse as teza e Vajanit²⁰ (rrafshimi njëherë i formave të akuzativit, të gjenitivit e të lokativit në shumës dhe pastaj kalimi i po këtyre formave në njëjës, kështu që sipas tij procesi u shtri edhe në dativin e njëjësit. Stevanoviçi u kthehet mjeteve sintaksore dhe në këto të folme ai sheh një mbipërdorim të trajtave akuzativore shoqëruar me parafjalët *na* dhe *u*. Ky mbizotërim përdorimi i këtyre parafjalëve, sipas tij, u shtri duke u përgjithësuar dhe ua zuri vendin edhe parafjalëve me të cilat ndërtohej lokativi. Prej kësaj rase pastaj, mbi bazën e analogjisë sipas tij, procesi u zgjerua edhe mbi dativin²¹. Veçse ky autor, në vend të konstatimit të pasojave, do të duhej ta gjente shkakun – shtytësin e vërtetë të fenomenit, por nuk del jashtë suazave të serbishtes – të folmeve malazeze. Vetë grumbullimi nga ana tjetër i parafjalëve pranë kategorive gramatikore nominale ka funksion kompensimin e humbjes së dinstksionit të formave rasore, si rezultat i sinkretizmit të këtyre të fundit. Në rastin konkret është rrëgjimi, madje edhe zhdukja e funksioneve të lokativit, të cilat me parafjalë i merr akuzativi. Prandaj, me gjasë, më parë se kalimi i procesit me analogji nga lokativi edhe në dativ, do të jetë marrja nga akuzativi drejtpërdrejt i funksioneve të dhanores. Një dukuri e tillë, e shkaktuar nga kontakte me gjuhë josllave, është e zakonshme në ligjërimet serbe juglindore e malazeze lindore. Për mundësi ndikimi në këtë çështje, nga gjuhët josllave rumanishtja përjashtohet, ngase këto trajta i dallon mirë: *mie*, *mine*²²; fenomenin e njohin gjuhët romane²³ dhe greqishtja e re²⁴. Për gjuhët romane duhet pasur rezervë për shkak të gjeografisë gjuhësore dhe kufizimit të fenomenit vetëm në arealet e kontakteve me shqipen, ndërsa greqishten dallimi i tyre në epoka më të hershme të saj.

¹⁸ M. Stevanović: *Istočnocrnogorski dijalekat*, 21, 74, 115.

¹⁹ Ai, aty, 74.

²⁰ A. Vaillant: *La langue de Dominiko Zlatarić*, II, 173-174 (Pas L. Vujović: *Mrkovički dijalekat*, 235).

²¹ M. Stevanović: *Istočnocrnogorski dijalekat*, 115.

²² *Gramatica limbii române I*, 137.

²³ P. Skok: *Osnovi romanske lingvistike*, III, 62-65; Demiraj, *Gramatika historike e gjuhës shqipe*, 450.

²⁴ M. Triandafillidhi: *Neoelleniqi gramatiqi*, 131.

Është shqipja ndikimin e të cilës e favorizojnë faktorë *thjesht linguistikë*: dukuria e rrafshimit në këtë gjuhë është e vjetër, ka karakter të përgjithshëm dhe është e normës së standardit; faktorë *linguistikë-gjeografikë* ngase fenomeni në vështrim shtrihet përgjatë zonave të kontakteve intensive të dialekteve serbo-malazeze me shqipen, që nga juglindja e Malit të Zi, vazhdon me dialektin e Zetë-Sjenicës²⁵ e del te tipat dialektorë kosovarë-resavas e të Prizren-Timokut. Këto kontakte në zona të caktuara shquhen shpesh edhe për fenomenin e bilinguizmit. Mbështetur mbi këto rrethana, janë të gjitha gjasat që njësimi i formave të vetës së parë dhe të dytë njëjës të këtyre vetorëve në këto ligjërime, si dhe në të folmet serbe të Kosovës: *mene*, *tebe* edhe për *meni*, *tebi* do konsideruar **interferim gramatikor** i shqipes²⁶.

c) Sintaksë

Për ndërtimin e një tipi të **rrethanorit të sasisë**, që përbëhet nga një togfjalësh, shprehës i një shume të caktuar frymorësh a sendesh, apo i ndonjë çmimi a vlere, në këto të folme për lidhjen e gjymtyrëve të tij që shënojnë shuma të mëdha (mbi njëqind) me të voglat, përdoret zakonisht lidhëza **i**: “Sto *i* dvadeset *i* pet”; “Sto iljada *i* sedamstotina *i* dvadeset *i* tri” etj. (M. Stevanović, Istočnocrnogorski dijalekat, 81-82). Autori mjaftohet me këtë konstatim dhe nuk e komenton. Ndërtime të këtilla ndeshen edhe në të folmet serbe të Kosovës²⁷, por jo edhe në shtokavishte të tjera dhe është modeli i shqipes: “Njëqind *e* njëzet *e* tre”; “Njëqindmijë *e* shtatëqind *e* njëzet *e* tre”, ku lidhëza *e* është e detyrueshme dhe e standardit.

Ka në ligjërimet në shqyrtim ndërtime sintaksore, sidomos të gjymtyrëve të dyta të fjalisë, ku reflektohet drejtpërdrejt modeli i shqipes (sikurse edhe në të folmet serbe të Kosovës). Kështu për një tip **rrethanori të kohës** që zakonisht shprehet me një togfjalësh emëror, në vend të *gjenitivit temporal*, si e kanë të folmet e tjera dhe standardi, përdoret *akuzativi temporal* (si në shqip): “Poše^a e treći de^an da se vidi...” (jo *trećeg dana*); “Trefilo se *istu godinu* da rodi...” (për: *iste godine*); “...rađaju masline *svaku godinu*” (për: *svake godine*); “*Cijelu zi-*

²⁵ P. Ivić: **Dijalektologija srpskohrvatskog jezika**, 162.

²⁶ Shih edhe M. Blaku: **Ndikimi...**, 189.

²⁷ Ai, aty, 168.

mu seđau ovce... (për: *cele zime*). Khs. për të gjithë këta shembuj në shqip: *ditën e tretë, vitin e njëjtë ose të njëjtin vit, çdo vit, gjithë (tërë) dimrin* etj.

Edhe një lloj **rrethanori i vendit** (dinamik) për nga mjetet sintaksore të ndërtimit reflekton modelin e shqipes. Shembujt si: “Ja ću tebe stremat *za u Ske^ade^ar*”; “Vodu su im prekinuli koja je išla *za u grad*” (“Mrkovićki dijalekat”, 299) etj., janë imitim i sintaksës së parafjalës për në shqipen, ku kjo, kur përdoret për të treguar drejtimin e një lëvizjeje shoqërohet nga parafjala *në*, si p.sh. “Në mbrëmje baresha mblodhi patat dhe u nis *për në shtëpi*”²⁸. Vujović thotë se ky konstrukt vjen nga ndikimi i gjuhëve romane (300), veçse të folmet në shqyrtim nuk kanë raporte kontaktesh specifike me këto gjuhë kundrejt ligjërimeve të arealeve të tjera të serbishtes, ku fenomeni nuk është aq i pranishëm.

Ndërtime interesante shfaqen me rasë të veçanta.

Me **gjenitivin** parafjala **od** (prej) veç të tjerash, hyn në ndërtime shprehjesh si: “*Na glavu od – godine (=poslije godine dana)* došli ćmo ge kuća”; “*Na glavu 2-3 dana; na glavu selam dana*” etj. Shembulli i parë përbën kalkim të mirëfilltë nga shqipja: “*Në krye të vitit* erdhëm te shtëpia”. Gjymtyra *ge kuća* po ashtu, sepse trajta e nominativit i bie ndesh pikëpamjes së Ivićit se *ge* vjen nga *kēde > gde > ge* me kuptimin “*kod*” (shq. *te*) + akuzativ (*kude nas* dialektore)²⁹. Shembujt të tjerë me *ge* në nominativ që reflektojnë konstrukte të shqipes: Neaćeas *ge-ja*; sutraveçe *ge-ti*, Sulo e bio *ge-mi* (209). Edhe shembujt e tjerë këtu janë kryekreje kalke të shqipes: “*Krye dy-tri ditësh; krye shtatë ditësh*”, etj.

Për këtë rasë është karakteristike edhe kjo që pranë instrumentalit të emrit personal, patronimi ndonjëherë përdoret në *gjenitiv* dhe ka karakter posesiv. Kështu “*Devet mjeseće^ak sedio Antom Brankovića*”; “*Sudili se Nikolom Ućinića*”; s Bojom *Vukanovića*” (296) etj., reflektojnë këtu trajta patronimikash të shqipes së stilit bisedor të tipit “*Me Skenderin e Berishëve; me Shpendin e Aliajve*”, me *Dritën e Metajve*, e nuk janë zhvillime siç supozon Ll. Vujović (296). Edhe ndërtimet e tipit “*Ćinimo drve^ak* da se grijemo; ja idem da ućinim

²⁸ Gramatika e gjuhes shqipe, I, Tirane, 1995, 392.

²⁹ P. Ivić: *O dijalekatskom obliku ge “gde”*, *Zbornik za jezik i književnost*, Titograd, 1972, 32-37; Stanišić, 1995, 58.

jenoga tovara drve^ak”, më parë se ndikim roman (Vujović, 296) do të jenë kalke të shqipes: *běj dru* për t’u ngrohur; *běj një barrë* dru etj.

Për **instrumentalin** pa parafjalë autori sjell edhe ndonjë shembull, si: “Ostala jena Cinganka *bremenom*” (jo: *noseća, u drugom stanju*) ardhur nga shqipja: “Kishte mbetur një jevge *me barrë*”, sikurse edhe: “Nije osta jeden *svetlim obrazom*” (shq. me faqe të ndritur, me faqe të bardhë); “Na konja *sedlom*” (shq. në kalë me shalë) e jo: *svetla obraza*, na *osedlanom* konju etj.

Lidhur me **akuzativin** e **lokativin** dhe konstruktet që pasqyrojnë raporte të çrregulluara ndërmjet tyre si pasojë e humbjes së reksionit të foljeve në këto ligjërime, s’mbetet ndonjë gjë e re për t’u thënë, veçse do theksuar se është pikërisht Ll. Vujović³⁰ ai që njeh një ndikim të fortë të shqipes në këtë punë.

Në të folmen e Mërkotit (Mrković) ndeshen edhe disa kalkime emrash kalendarikë nga shqipja, që i kishte shënuar së pari Julius Pisko (Kurzgefastes Handbuch..., Wien, 1896, 17) dhe i përmend edhe Ll. Vujović dhe, sado që nuk bashkëshkrihen me natyrën e problemmeve të rrahura këtu, e vlen të theksohen: “*prvi jeseni* (septembar), *drugi jeseni* (oktobar), *treći jeseni* (novembar) sipas shqipes *vjeshtë e parë, vjeshtë e dytë, vjeshtë e tretë*. Duhet të jetë shënuar gabimisht aty që *mjesec kreateak* është dhjetori; me siguri është ngatërruar me *shkurtin*.

Mund të konkludohet në fund se një prani e këtyllë e albanizmave gramatikore në këto të folme, flet më shumë se vetëm për raporte kontaktesh gjuhësore të zakonshme. Në pjesën më të madhe të tyre ato janë relikte të strukturës gramatikore të substratit gjuhësor të hershëm.

³⁰ Shih L. Vujović: *Istorijski presjek gubljenja rekvije u crnogorskim govorima*, **Južnoslovenski filolog**, XX, 87-126 (102).

Xhelal YLLI, Tiranë/Heidelberg

RRETH PËRGATITJEVE PËR NJË VLERËSIM OBJEKTIV TË HUAZIMEVE LEKSIKORE SLLAVE TË GJUHËS SHQIPE

Marrëdhëniet mes shqiptarëve dhe sllavëve të jugut vijojnë prej afro pesëmbëdhjetë shekujsh. Ato sigurisht nuk kanë pasur një zhbi-llim linear, apo me të njëjtin intensitet në kohë dhe hapsirë dhe kanë lënë gjurmët e tyre në gjuhët përkatëse. Në kushtet, kur për këto marrëdhënie burimet historike na sjellin pak të dhëna, jemi të detyruar, në njërin krah, t'i drejtohem analizës së materialit gjuhësor e në kra-hun tjetër, t'i vështrojmë këto marrëdhënie në një kuadër më të gjerë kohor e hapsinor. Dhe si çdo marrëdhënie tjetër, edhe ajo mes shqip-tarëve dhe sllavëve të jugut, ka dy anë, atë të marrjes dhe atë të dhë-nies, ndonëse, në rastin konkret, sipas dijes së derisotme, këto dy anë paraqesin rezultate asimetrike: ndikimi sllavojugor në shqipe gjen shprehje në huazimet relativisht të gjera sllave në leksik, në një rrjet të dendur gjurmësh sllave në toponimi si dhe në disa ndikime në fonetikë a strukturën morfologjike, ndikime këto të kufizuara gjeografikisht e pa ndonjë peshë të rëndësishme, qoftë edhe për strukturat nëndia-lektore të shqipes. Ndërsa ndikimi i shqipes gjen shprehje në ndihme-sën, që ajo ka dhënë në procesin e ballkanizimit të gjuhëve sllavoju-gore, në huazimet, në një masë të vogël, në leksik dhe në ndryshime të tjera fonetike e morfosintaksore në të folmet fqinje sllave, të cilat ash-tu si motrat e tyre në shqipe kanë një përhapje të ngushtë gjeografike dhe një peshë relativisht të vogël.

Ne në këtë parashtrësë të shkurtër do të ndalemi në njërin prej segmenteve të ndikimit të gjuhëve sllavojugore në gjuhën shqipe, pikërisht në huazimet leksikore duke synuar të tregojmë se evidentimi i sllavizmave leksikorë dhe analiza shumëplanëshe e tyre duhet të bë-het në funksion të krijimit të kushteve për një vlerësim objektiv të tyre. Afro një shekull e gjysëm më parë Miklosich-i me punimin e tij *Die slawischen Elemente im Albanischen* (1870) vendosi gurin e the-melit të korpusit të huazimeve sllave të shqipes, i cili vijoi të plotë-sohet e saktësohet më tej nga një varg dijetarësh [si G. Meyer (1891),

M. Vasmer (1921), Skok (1925), S. Mladenov (1927), etj.] për të arritur një nivel të ri me punimin e Seliščev-it *Slavjanskoe naselenie v Albanii* (1931), i cili paraqiti jo vetëm inventarin më të plotë të mundshëm për kohën, por ndërmoi edhe klasifikimin e parë të tij duke i dalluar huazimet leksikore sipas fushave të ndryshme të veprimtarisë njerëzore, duke i dalluar topobazat e modelet toponimformuese të gjurmëve sllavojugore në toponimi, si dhe duke ja nënshtruar të gjithë materialin një analize të gjerë fonetike dhe klasifikimit kronologjik. Më tej, siç thekson Jokli, „përmes një kombinimi të goditur të vështrimeve mbi gjeografinë e ngulimeve, mbi emërdhënësit e tyre dhe mbi aspekte social-historike”¹, përpiqet t’i interpretojë gjurmët sllave të shqipes në formën e kundërvënieve binare: nga këndvështrimi i gjeografisë së ngulimeve, shqiptarët ishin banorë të maleve dhe të zonave malore në përgjithësi, kurse sllavët e jugut banorë të fushave dhe luginave të lumenjve; nga këndvështrimi sozial-historik sllavët e jugut ishin bujqit e varur, ndërsa shqiptarët popullsia sunduese blegtorale, ndërsa lidhur me emërvënien ajo ishte realizuar nga sllavët e jugut. Në reçensionin e tij të gjerë për veprën e Seliščevit, Jokli vazhdon: „Ajo që i ka interesuar më tepër autorit duket hapur, se nuk ka qënë gjetja e elementeve të reja gjuhësore (dhe të tjera), ndonëse të tilla nuk mungojnë. Qëllimi i përpjekjeve të tij lidhet shumë më tepër, me evidentimin e gjithanshëm të popullsisë sllave, tashmë të zhdukur, në Shqipëri.”² Dhe shton: „kështu, tabloja e huazimeve sllave të shqipes paraqitet në elementët e veçantë të saj shumë më ndryshe nga ç’e ka paraqitur atë autori.”³ Ndërsa në përgjigje të pyetjes, se ç’mbetet për t’u bërë pas punimit të Seliščevit, ai thekson nevojën e „përcaktimit të përhapjes gjeografike të huazimeve sllave në dialektet e shqipes dhe dallimin e elementeve të kufizuara në një zonë pak a shumë të ngushtë nga ato me përhapje të gjerë... Vetëm pas kësaj do të

¹ Jokl (1935:284): ...eine geschickte Kombination siedlungsgeographischer, namenkundlicher und sozialge-schichtlicher Betrachtungsweise...

² Jokl (1935: 282): Worauf es dem Verfasser ankam, das ist offenbar nicht so sehr die Ermittlung neuer sprachlicher (und anderer) Einzelheiten, wiewohl es an solchen nicht fehlt. Ziel seiner Bemühungen ist vielmehr die allseitige Erfassung des gegenwärtig untergegangenen slawischen Bevölkerungselementes in Albanien

³ Jokl (1936:614): So stellt sich das Bild der slawischen Entlehnungen des Albanischen in seinen Einzelheiten vielfach anders als es der Verfasser gezeichnet hat, dar.

mundnim të skiconim një tablo të plotë historike të marrdhënieve shqiptaro-sllave, të ndikimit sllav në gjuhën shqipe, një tablo, e cila krahas ndikimit do të lejonte të shihej edhe vëllimi e intensiteti i tij.⁴ Veç ndihmesave për inventarin e sllavizmave Jokli thekson edhe korrektura thelbësore të tezave të Seliščevit, siç është pohimi, se paraardhësit e shqipëtarëve janë vendosur, që në kohët pararomake në gadishullin ballkanik, në zonat e kulturës greko-romake.⁵

Veçanërisht periudha e pasluftës solli njohuri të reja e të thella jo vetëm për shqipen e dialektet e saj, por edhe për huazimet sllave të saj. Bibliografia e studimit të marrë-dhënieve shqiptaro-sllavojugore të kësaj periudhe është mjaft e gjerë, ndaj këtu po përmendim vetëm disa prej nikoqirëve të kësaj konference, si Ajetin (1997), Ismajlin (1979, 2005), Blakun (2010) apo Gashin (1979). Inventari i huazimeve leksikore sllave vijoi të pasurohej në një sërë punimesh, prej të cilave po përmendim atë të Desnickajas (1963), Gjinarit (1966), Omarit (1994), Muratit (2004, 2007) dhe veçanërisht atë të Svanes (1992), në të cilat vihet re përpjekja për t'i kapërcyer mangësitë e vëna re prej Joklit duke shënuar edhe përhapjen gjeografike të huazimit apo klasifikimin e tij në fushën përkatëse. Më tej korpusi i sllavizmave leksikorë të shqipes u plotësua pas një pune shumëvjeçare për mbledhjen dhe verifikimin e tyre në terren nga kolegia Omari dhe Ylli dhe u botua në vitin 1997. Megjithatë, edhe korpusi i sjellë nga ky punim është i mangët, pasi, për shkak të kufizimeve të atëhershme, gjurmimi i sllavizmave leksikorë nuk mund të shtrihej në mënyrë sistematike edhe në trojet e shqipes jashtë Republikës së Shqipërisë dhe është mjaftuar me materialet e vjela të Kartotekës së Leksikut të Gjuhës Shqipe (KLSH) pranë Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, apo me ndonjë të dhënë gjithashtu josistematike të punimeve dialektore. Po

⁴ Jokl (1935:645): die geographische Verbreitung der slawischen Lehnwörter innerhalb der albanischen Mundarten festzustellen und die auf ein mehr oder weniger enges Gebiet beschränkten Elemente von den allgemein verbreiteten zu scheiden... Erst dann wird ein historisch abgerundetes Bild der slawisch-albanischen Beziehungen, des slawischen Einflusses auf die albanische Sprache, ein Bild, das neben der Tatsache der Beeinflussung ihren Umfang und ihre Intensität erkennen lässt, gezeichnet werden können

⁵ Jokl (1935: 287): (dass) die Vorfahren der Albaner schon seit vorrömischer Zeit auf der Balkanhalbinsel im Bereiche der griechisch-römische Kultur siedelten.

ashtu, për ato pak huazime të pasqyruara aty këtu, mungon edhe kartografimi. Në frymën e reçensionit të Joklit, në këtë punim u paraqit jo vetëm inventari dhe u kartografua përhapja gjeografike e çdo huazimi, por u bë edhe klasifikimi i huazimeve sipas fushave të veprimtarisë njerëzore dhe u kartografuan edhe inventari i tyre sipas përhapjes gjeografike.

Në këtë mënyrë në shtrirjen gjeografike të sipërpërmendur, është arritur të evidentohet inventari i përgjithshëm, apo siç e kemi quajtur ndryshe, absolut, i cili mund të pasurohet më tej përmes njohjes së mëtejme të të folmeve të shqipes dhe që përfshin mbi 800 huazime leksikore sllave. Në anën tjetër është paraqitur edhe ai që e kemi quajtur inventari relativ, pra inventari i sllavizmave leksikore në një krahinë të caktuar, psh. në Korçë, Shkodër, Tropojë ky inventar arrin përkatësisht në 430, 402 dhe 347 njësi, ndërsa në Durrës, Mat e Krujë përkatësisht 180, 185, 202 njësi (shih Harta 1).

Dallimi i këtyre dy lloj inventarëve është ndjekur edhe për huazimet sllave të fushave të caktuara. Kështu psh. për *Fushën e Blegtorisë* është fiksuar një inventar absolut, pra i përgjithshëm prej 62 huazimesh, prej të cilëve në Shkodër, Tropojë e Kukës, ku ndikimi paraqitet më i madh, ndeshen respektivisht 26, 27, 25 njësi, ndërsa në Durrës, Mat, Mirditë, Lezhë, ku ndikimi është më i vogël, përkatësisht 10, 10, 12, 12 huazime (shih Harta 2). *Fusha e Bujqësisë* ka një inventar absolut prej 106 huazimesh sllave, ndërsa inventari relativ përfshin në Korçë 61 huazime, në Skrapar 42, në Shkodër 41, në Tropojë e Kolonjë 36 ~ në Durrës 15, Krujë 17, Mat dhe Lezhë 22, Mirditë 26, Peshkopi 27, Pukë 28. *Emërtimet që lidhen me shtëpinë* arrijnë një inventar absolut prej 160 huazimesh, të shpërndarë në inventaret pasues relativë: Tropojë dhe Shkodër 66, Korçë 59, Pukë 58, Kukës 55, Skrapar 54 ~ 31, Tepelenë, Gjirokastër, Sarandë 35. *Fusha e Bimësisë* ka një inventar absolut prej 104 huazimesh dhe një inventar relativ si më poshtë: Korçë 42, Shkodër 31, Pogradec 25, Skrapar 23 ~ Durrës 7, Tiranë dhe Mat 8, Librazhd 9. Inventari absolut i fushës *Emërtime Kafshësh* përfshin 102 huazime, ndërsa inventari relativ në Pogradec 44, Korçë 41, Shkodër 35 ~ Mat 8, Durrës 9, Mirditë dhe Sarandë 10, Tiranë 11. *Emërtimet e terrenit, ujërave dhe dukurive natyrore* përmbajnë 87 sllavizma të shpërndara në inventarët relativë pasues: Shkodër 39, Tropojë 35, Korçë 32 ~ Gjirokastër 10, Durrës 11, Sa-

randë 12, Krujë 13. *Emërtimet që lidhen me njeriun* nga një inventar absolut prej 39 sllavizmash shfaqen me inventarët relativë përkatës: në Shkodër, Korçë dhe Vlorë 19, Kolonjë 18, Tropojë 16 ~ Mat 8, Tiranë 9, Durrës dhe Sarandë 10, Berat, Krujë, Mirditë dhe Pukë 11.⁶

Vlerësimi i mbështetur në dy llojet e inventarëve të sipërpërmendur lejon përfitimin e një tabloje më plastike e më reale lidhur me intensitetin e marrëdhënieve shqiptaro-sllavo jugore në zona të ndryshme të vendit, ku bie në sy një ndikim më i fortë në zonat veriore dhe ato juglindore. Ndërsa ndikimi më i dobët përfshin herë herë zonën e Matit, Durrësit, Tiranës, Lezhës, Mirditës, por në raste të tjera, si psh. në fushën e huazimeve nga fusha e blegtorisë, edhe në këto zona ndikimi duket, të paktën në pikpamje sasiore, i njëjtë me atë të zonave të brendshme apo periferike në jug të vendit. Inventari dhe gjeografia e sllavizmave leksikore në vetvete, por edhe gjurmët sllave në toponimi, e aq më pak një inventar dhe shpërndarje e tillë gjeografike, si kjo e sipërpërshkruar, nuk ka se si të mbështesë tezën e Seliščevit, të rimarrë edhe nga ndonje studiues i kohëve të sotme⁷, i cili shihte si vendbanime të hershme të shqiptarëve, para lëvizjes së tyre drejt jugut e veriut, zonën e Matit dhe të Ishmit. Diferencat mes zonave veriore e juglindore me zonat e tjera të brendshme sigurisht që ekzistojnë dhe kërkojnë shpjegimet përkatëse, por kalimi nga një grup zonash në tjetrin është gradual dhe shpesh i larmishëm, ç'ka flet dhe mund të flasë vetëm për raporte, intensitet e kohëzgjatje të ndryshme të marrëdhënieve shqiptaro-sllavojugore.

Thellimit të vlerësimit objektiv të huazimeve sllave të shqipes, i shërben nga ana tjetër, edhe njohja e peshës së tyre specifike brenda një fushe të caktuar. Duke i vështruar huazimet e çdo fushe të veprimtarisë njerëzore etj. në kuadrin e tërësisë së termave të saj krijohet mundësia jo vetëm për të përcaktuar vëllimin sasior në atë fushë, ndonëse ky është shpesh subjektiv e varet nga natyra e pyetësorit, por ajo që është më e rëndësishmja, përmes një mënyre të tillë vështrimi mund të dallohet qartë nëse është prekur ajo, që do të mund të quhej bërthama leksikore e fushës. Po ashtu mund të hulumtohen brenda së njëjtës fushe edhe raportet fjalë vendi, huazime latine, sllave, turke etj.

⁶ Ylli (1997: 300-315).

⁷ Sobolev (2010a: 41).

Një verifikim i tillë, i posaçëm, në terren na mungon dhe do të mund të përbente objektin e një projekti të ri lidhur me sllavizmat, por një ndihmesë të parë në këtë drejtim gjejmë në tre punime të botuar kohët e fundit, Bëhet fjalë për dy monografite e botuara nga Ylli-Sobolev, përkatësisht për të folmen e fshatit Leshnjë të krahinës së Skraparit (2002) dhe të fshatit Muhur të krahinës së Dibrës (2003), të realizuara në kuadrin e mbledhjes së materialeve për një atlas të gjuhëve ballkanike.⁸ Në bazë të një pyetësi të hollësishëm të hartuar nga kolegët rusë (Domosileckaja & Žugra 1997) për njëmbëdhjetë fusha të ndryshme, është mbledhur material në njëmbëdhjetë pika (7 sllave, 2 shqiptare, 2 greke dhe 1 aromune), që mbulojnë gjithë Ballkanin.⁹ Materiali i tyre ka filluar të kartografohet në vëllime të veçanta¹⁰ dhe këtu ne do të ndalemi për ilustrim në disa prej të dhënave që sjell vëllimi kartografues kushtuar blegtorisë, përgatitur nga kolegu Sobolev (2009). Pyetësi ka 573 pyetje lidhur me këtë fushë. Në përgjigjet e kartografuara gjenden rreth 22 huazime sllave¹¹, të ndara rreth 17 për Leshnjën dhe 12 për Muhurrin. Të përbashkëta për të dy pikat janë *grazhd*, *koc/kockë*, *kolibe*, *koritë*, *rudë*, *skopit*, *stan* dhe “sllavizmi” i dyshimtë *shelek*. Vetëm për Leshnjën jepen 6 huazime: *bravare*, *çelunik*, *ogiç*, *përçak*, *piçkë*, *vërsnik*; kurse vetëm për Muhurrin 4 huazime: *gjob*, *pojat*, *shark*, *stërvaj*. Këtyre duhet t’u shtohet edhe ndonjë sllavizëm i pa kartografuar si *dele rrogushë*, që del në Muhurr. Tabloja e përfutur mund të plotësohet edhe me të dhëna të tjera të pasqyruara në Ylli 2007: *ogiç* del edhe në gjithë veriun. Për Dibrën është fiksuar prej nesh në Staravec, nga Beci për Reç dhe nga KLSH për Kovashicë e Sllavë. *vërsnik* e kemi gjetur në Staravec të Peshkopisë, Omari e sjell për Valbonë, KLSH për Bicaj të Kukësit etj. *sharkë* / *sharë* del në gegërishten veriore, qendrore e jugore. Beci sjell për Reç *brav*. Del në gegërishten veriore kryesisht si *brav*, në toskërishte si *bravare*. *çelunik* sillet prej Haxhihasanit për Lurë, prej Ulqinit për Mat dhe prej KLSH për Bushtricë të Kukësit. *pojatë* dhe *stërvaj* dalin në të gjitha zonat në veri të Peshkopisë.

⁸ Shkurtimi sipas titullit në gjermanisht KBSA, sipas atij në rusisht МДАБЯ.

⁹ Sobolev (2009)

¹⁰ Sobolev (2005, 2006, 2009, 2010).

¹¹ Ka edhe ndonjë huazim tjetër si psh. *i dobët*, i cili ashtu si *piçkë* apo *gjobë* mund t’i përkasin më shumë ndonjë fushe tjetër se sa blegtorisë.

Sigurisht, duke lënë mënjanë përpjestimin, që lidhet me karakterin tepër të hollësishëm të pyetësorit, gjë që shihet edhe në disa shembuj të këtushëm, kur për pyetje të ndryshme merret e njëjta përgjigje (*koritë, oqiç*), do të thoshim, se megjithatë ndikimi sllav në këtë fushë është i kufizuar në fare pak elementë, që do të mund të lidheshin me atë, që e quajmë bërthamë të fushës, apo të nëfushave përkatëse të blegtorisë, si psh. *stan, çeltnik, koritë*, që lidhen me verimin e bagëtisë në mal; *skopit, përçit* me mbarështrimin e bagëtisë. *Piçkë* do të ishte vështirë të shihej si term i blegtorisë, sa kohë që ndeshet vetëm në Le-shnjë dhe vetëm për delen, paralelisht me *vete e deles*. Kjo e fundit është përgjigjja e vetme për *dhinë* dhe në Muhurr edhe për *delen*, edhe për *dhinë*; *rudë*, një term i vetëm me orgjinë sllave i prodhimit blegtoral, etj.

Ndikimi i pakët sllav në fushën e blegtorisë gjen mbështetje edhe nga një e dhënë e ADGJSH-së (2008), botuar tani së fundi, ndonëse leksiku, që lidhet me këtë fushë është i kufizuar. Kështu në hartat me të dhëna për emërtimin e bagëtisë të imta, *dele* e *dhi* (Hartat nr. 189-200), të cilat janë objekt i veçantë edhe i pyetësorit të Atlasit Ballkanik (KBSA), nga dymbëdhjetë të tilla vetëm *rrogushë* „dele me brirë”, e përhapur në Shqipërinë Veriore, është e burimit sllav, të tjerat janë fjalë vendi a latine.

Duke përfunduar mund të themi, se një analizë e hollësishme, e cila dallon inventarët absolut dhe relativ, përcakton vendin dhe peshën specifike të këtyre huazimeve brenda fushave përkatëse dhe i ndjek këto në gjithë territorin e shqipes, në gjeografinë e tyre, do të përbënte parakushtin e domosdoshëm për t’ju afruar një interpretimi objektiv të tyre.

Nga ana tjetër është vendi të theksohet, se edhe këndvështrimi i KBSA-së, që shtrihet në të gjitha gjuhët e Ballkanit, pavarësisht nga vërejtjet, që mund të kemi për shtysat e projektit, pavarësisht nga vërejtjet, që mund të kemi për përzgjedhjen e pikave të anketimit, pavarësisht nga interpretimi i ndryshëm i materialit të tij, pavarësisht faktit, që në këtë interpretim disa elementë të shqipes apo elementë të tjerë të pasigurtë trajtohen si huazime sllave, është i domosdoshëm dhe i vlefshëm për të pasur një vështrim të përgjithshëm lidhur me gjurmët sllave, që janë të përhapura jo vetëm në trojet e shqipes, po në mbarë Ballkanin. Po ashtu ato përbëjnë një bazë të rëndësishme të dhënash, që të plotësuara më të dhënat

e pritshme të trojeve të shqipes jashtë Republikës së Shqipërisë, problem i shtruar edhe nga Sobolev (2010a), do të na lejonim të hidhnim një dritë më të qartë në marrëdhëniet shqiptaro-sllavojugore, veçanërisht për shtrirjen dhe intensitetin e tyre.

Huazimet leksikore sllave të Leshnjës dhe Muhurrit¹²



Harta 1 Inventari relativ i sllavizmave,
Ylli (1997: 298)



Harta 2 Inventari relativ i blegtorisë,
Ylli (1997: 302)

1. „dash i tredhun plotësisht / pjesërisht” / „tredh”, S. 44, 46, 376. Y 235.
M. *da^esh i skopeitun* (por edhe *da^esh i tretun*) / *da^esh llakatrec /skopeit*
L. *skopec, skopc / skopec /skopit*
2. „dash dyvjeçar”, S. 50
M. *zhelek, shelek*
L. *milor*
3. „dele dyvjeçare, ende pa qingj”, S. 54
M. *rrunxa, shelege*
L. *rrurëz, milore*
4. „organi seksual i deles”, S. 70. Y 192.
M. *vete e deles*, por edhe *vete e dhisë*
L. *vete e deles, piçkë*, por edhe *vete e dhisë*
5. „qengji Shëngjergjit”, S. 84. Y 176.
M. *kinxh i pashue, sugjar, kinxhi Zhgjergjit, kurban*
L. *pirës, oqiç, kurban*
6. „qengji nga momenti i ndarjes nga delja e deri sa mbush një vjeç” / „njëvjeçar”, S. 108, 110, 112, 114

¹² Huazimet e kartografuara në Sobolev 2009. Shkurtimi S. shënon Sobolev 2009 dhe Y. Ylli 1997.

- M./L. *shelek*
7. „qengji që mban çobani pas vetes”, S. 116. Y 176.
M. *kinxh beslem, manar*
L. **ogič**, *manar*
8. „qengja të një moshe”, S. 118. Y 278.
M. *ortak*
L. **vërsnik**
9. „leshi i shkurtër e i butë”, S. 122. Y 226.
M. / L. **rud /rudë**
10. „dash me pulla të bardha në këmbë”, S. 168. Y 254.
M. **shark**
L. *laramën*
11. „cjav i patredhur”, S. 172. Y 189.
M. *sqap / cep i paskopeitun*
L. **përçak**
12. „mbarsja e dhisë”, S. 178. Y 189.
M. *marset*
L. **përçitet**
13. „dhi, cjav i kuqrremtë”, S. 194. Y 45.
M. *i kuq, e kuqe*
L. *i kuqrrëm, e kuqrrëmë; carro, carr*
14. „objekti ku u jepet kripë bagëtisë”, S. 206. Y 130.
M. *lugj, rras*
L. **koritë**, *gur*
15. „dash/dhi prijëse e kopesë”, S. 228. Y 189.
M. *dash i stroms / cepi me kmon*
L. *dash përçor, dashi këmborës / cjav përçor, cjapi i ziles*
16. „bagëti, që kullot veçan tufës”, S. 230. Y 38.
M. *brec*
L. **bravare**
17. „drejtuesi i stanit”, S. 244. Y 52.
M. *krebari, kreçoban*
L. **çelniku i stanit**
18. „për dëmin paguaj...”, S. 260. Y 97.
M. *paguaj damin, gjob*
L. *paguaj dëmin*
19. „pajisja e drurit ku u jepet ujë bagëtive”, S. 304. Y 130.
M. **koret**
L. **koritë**
20. „vendstrehimi bagëtisë në mal”, S. 314, 320, 324. Y 243.
M. **stan**, *sta^on*
L. **stan**, *mëndër*
21. „vendi ku u jepet ushqimi bagëtisë”, S. 316. Y 92.
M./L. **grasht**

22. „ndërtimi lehtë për të rruajtur bagëtinë”, S. 318. Y 201.

M. *hajat*, *pojat*

L. *rrethake me lesa*, *vathë me lesa*

23. „vendi ku qëndrojnë barinjtë”, S. 332. Y 124.

M. *kolib*, *kotar*

L. *kasolle*, *kolibe*

24. „kockë”, S. 358. Y. 120.

M. *koc*


L. *kockë*

25. „kufomë e bagëtisë; mbeturina të saj”, S. 380. Y 246.

M. *stërvaj*

L. *kërmë*

Hartë e KBSA



Соблев (2009: 217). Harta nr. 102

Bibliografi

- AJETI I. (1997): *Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-sllave. / Zhvillime paralele fonetike dhe ndikime të ndërsjella të dialekteve shqiptare dhe serbe të Kosovës. / Studime të ndërsjella etimologjike albano-sllave. / Emërtime gjeografike në shqipen dhe serbokroatishen. / Kontribut për studimin e onomastikës mesjetare në territorin e Malit të Zi, Bosnjës dhe Hercegovinës dhe të Kosovës.* Në: I. Ajeti **Vepra 4**. Prishtinë.
- ATLASI DIALEKTOLOGJIK I GJUHËS SHQIPE. I, 2007; II, 2008. Napoli.
- BLAKU, M. (2010): **Ndikimi i shqipes mbi të folmet serbe të Kosovës.** Prishtinë.
- DESNIČKAJA, A. (1963): **Славянские заимствования в албанском языке.** Москва.
- DOMOSILEČKAJA & ZUGRA (1997): **Малый диалектологический атлас балканских языков. Лексическая програма.** Санкт-Петербург.
- GASHI, S. (1979): *Prania e etnosit shqiptar në Kosovë gjatë shekujve XIII-XIV në dritën e burimeve kishëtare serbe.* Në: **Onomastika e Kosovës.** Prishtinë. S. 59-102.
- GINARI, J. (1966): *Mbi disa elemente sllave në të folmet veriore të Shqipërisë jugore.* Në: **Studime filologjike.** Nr. 2. Tiranë.
- ISMAJLI, R. (1979): *Disa çështje të onomastikës mesjetare.* Në: **Onomastika e Kosovës.** Prishtinë. S. 47-56.
- ISMAJLI, R. (2005): *Note sur l'influence slave en Albanais.* Në: **Studia Albanica II. In memoriam Waclaw Cimochofski.** Toruń. S. 91-105.
- JOKL. N. (1935): *Slaven und Albanern.* Në: **Slavia. Časopis pro slovanskou filologii.** XIII, I, 1935, S. 281-325. II, 1936, S. 609-645. Praha.
- MEYER, G. (1891): **Etymologisches Wörterbuch der albanesischen Sprache.** Straßburg.
- MIKLOSICH, F. (1870): **Albanische Forschungen I.** Die slawischen Elemente im Albanischen. Në: *Denkschriften der AdW. Ph.-H. Classe*, 19. Wien.
- MLADENOV, S. (1927): *Принос към изучаване на българско-албанските отношения.* Në: **Годишник на софийския университет ист.-фил.** XXII, 8. София.
- MURATI, Q. (2004): **Fjalor i sllavizmave në të folmet shqiptare të Maqedonisë.** Tetovë.
- MURATI, Q. (2007): **Bashkëmarrëdhëniet gjuhësore shqiptare-maqedonase.** Shkup.
- OMARI, A. (1994): *Ndihmesë për inventarin e huazimeve sllave në gjuhën shqipe.* Në: **Studime Filologjike.** XLVIII (XXXI). 1-4. Tiranë.
- СЕЛИЩЕВ, А.М. (1931): **Славянское население в Албании.** София.
- СКОК, Р. (1925): *Slaven et albanais.* Në: **Архив за арбанаску старину, језик и етнологију.** II. S. 107-126. Београд.
- СОБОЛЕВ, А. (2005): **Малый диалектологический атлас балканских языков.** Серия лексическая. Том I. Лексика духовной культуры. München.
- СОБОЛЕВ, А. (2006): **Малый диалектологический атлас балканских языков.** Серия лексическая. Том II. Человек. Семья. München.
- СОБОЛЕВ, А. (2009): **Малый диалектологический атлас балканских языков.** Серия лексическая. Том III. Животноводство. Санкт-Петербург – München.
- СОБОЛЕВ, А. (2010): **Малый диалектологический атлас балканских языков.** Серия лексическая. Том IV. Ландшафт. Санкт-Петербург – München.
- СОБОЛЕВ, А. (2010a): *Древнейшие славянские, сербские и македонские лексические заимствования в албанских диалектах: проблемы диахронической и диатопической стратификации.* Në: **Makedonski jazik.** LXI. S. 37 – 52. Skopje.
- SVANE, G. (1992): **Slavische Lehnwörter im Albanischen.** Në: *Acta Jutlandica* LXVIII, Humanistische Reihe 67. Aarhus.

- VASMER, M. (1921): *Studien zur albanischen Wortbildung*. Në: **Eesti Vabariigi Tartu Ülikooli. Acta et commentationes Universitatis Dorpatensis**. Humaniora 1. Tartu.
- YLLI, XH. (1997): **Das slavische Lehngut im Albanischen. 1.Teil. Lehnwörter**. Në: Slavistische Beiträge 350. München 1997.
- YLLI, XH. (2000): **Das slavische Lehngut im Albanischen. 2.Teil. Ortsnamen**. Në: Slavistische Beiträge 395. München 2000.
- YLLI, XH. & СОБОЛЕВ, А. (2002): **Албанский тоскский говор села Лешня (краина Скрапар). Синтаксис. Лексика. Этнолингвистика. Тексты**. München 2002.
- YLLI, XH. & СОБОЛЕВ, А. (2003): **Албанский гегский говор села Мухурр (краина Дибьр). Синтаксис. Лексика. Этнолингвистика. Тексты**. München 2003.

Imri BADALLAJ, Prishtinë PASKAJORJA NË SHQIPEN DHE NË SERBISHTEN

Abstrakt

Disa gjuhëtarë janë të mendimit, se mosprania e paskajores është tipar qenësor i gjuhëve ballkanike. Mendim ky, që gjithsesi është i pranueshëm për greqishten e re, për bullgarishten e maqedonishten, për rumanishten, por jo edhe për shqipen e serbishten me kroatishten. Në shqipen e serbishten përdorimi i paskajores dendur na del me funksione të shumta sintaksore, si:

- a. me funksion qëllimor,
- b. me funksion përcaktor,
- c. me funksion kallëzuesor,
- ç. me funksion të kryefjalës dhe
- d. kjo formë foljore së bashku me foljen ndihmëse *kam* formon kohën e ardhme.

Edhe serbishtja me paskajore formon format foljore të kohës së ardhme: *Ja ću raditi*. Mirëpo, në serbishten paskajorja shpeshherë është e barsvlershme plotësisht me lidhoren, çfarë me shqipen kjo nuk ndodh, por paskajorja e serbishtes kur përkthehet në shqipen, gjithmonë kërkon një formë të lidhores. Gjithashtu në serbishten format infinitivale dalin me forma sintetike: morati, hteni, uraditi etj., ndërsa format e paskajores së shqipes janë të një karakteri analitik.

Nuk janë të pakët gjuhëtarët të cilët janë të një mendjes, se mosprania e paskajores është njëri ndër tiparet qenësorë të gjuhëve të Ballkanit.

Këtë pohim, si proces të zhdukjes të formave infinitivale mund ta pranojmë vetëm për disa gjuhë të arealit ballkanik, siç është bullgarishtja me maqedonishten, greqishtja e re dhe rumanishtja, por sa i përket shqipes dhe disa gjuhëve sllave jugore, është tezë e pambështetur, sepse në serbishten, kroatishten dhe sidomos në shqipen, prania e paskajores përfshin hapësirën më të madhe shqipfolëse.

Shikuar kronologjikisht, paskajorja si formë perifrastike është krijuar brendapërbrenda shqipes gjatë zhvillimit historik të saj, atëherë kur edhe u krijuan edhe format e tjera foljore. Prandaj, si e tillë kjo

formë foljore gjallon në të dy dialektet e shqipes, por me dallime në mënyrën e ndërtimit dhe në dendurinë e përdorimit.

Në shqipen standarde, sidomos pas Kongresit të Drejtshkrimit të vitit 1972, tipi i paskajores *me punue*, që është tipar i gegërishtes, dhunshëm u përjashtua nga përdorimi, duke u zëvendësuar nga forma foljore e pashtjelluar e përbërë nga pjesëza parafoljore dhe emri foljor asnjans i pashtuar *për të punuar*, formë kjo, që në shqipen standarde u bë zotëruese, nga se toskërishtja në sistemin e saj foljor e posedon një formim kësosoj. Përndryshe, në mbarë sferën dialektore paskajorja e mirëfilltë: *me ba, me la, me punue* etj., ka një shtrirje fort të hapur, jo vetëm në gegërishten e Shqipërisë Veriore dhe në atë të Shqipërisë së Mesme, por në gjithë Kosovën, në Mal të Zi, në Maqedoni dhe në trevat shqiptare në jug të Serbisë..

Megjithatë, tipi i paskajores *me punue* është dominues, duke kryer funksione të shumta gramatikore, si:

me funksion qëllimor: *I uli perdet për të mos u dukur njerëzit në dhomë;*

me funksion përcaktor: *Iu shtue dëshira për me u kthye në vendlindje;*

me funksion kallëzuesor: *Gjendja e tyre është për të ardhur keq;* dhe

me funksion të kryefjalës: *Na ka mbetur për të zgjidhur vetëm edhe detyrën e shtëpisë.*

Paskajorja shërben për të formuar edhe kohën e ardhme bashkë me foljen *kam*, e cila edhe zgjedhohet: *Nesër kam me punue ma mirë se sot. Ti ke për të punuar në kompaninë më të madhe të qytetit tonë.* etj.

Është për t'u përmendur edhe tipi i paskajores *për me punue*, që haset në gegërishten jugore dhe në italo-arbërishten *për+me +pjesore*¹, por s'duhet lënë pa përmendur, se në shkrimet e moçme italo-arbëreshe si dhe në të folmet e sotme arbëreshe, por jo edhe aq dendur, paskajorja edhe me formën *me+pjesore* gjallon si formë foljore e pashtjelluar.

¹ Françesko Altimari, *Gjurmë të paskajores të shqipes në arbërishten e Italisë: Përfaqje diakronike*, në **Çështje të studimeve diakronike të shqipes**, ASHAK, Prishtinë, 2010, f. 101-116.

Për zhvillimin historik të kësaj forme foljore kanë bërë fjalë një varg gjuhëtarësh, që gjithsesi mendimet e tyre janë jo të një segmenti dhe shpeshherë mjaft kontradiktore, çfarë çështjen e paskajores e bënë të një rëndësie gjuhësore të veçantë.

Ata të cilët mendojnë se paskajorja është kategori foljore, e cila në gjuhët e Ballkanit është vazhdimësi e gjuhëve të familjes indoevropiane nuk janë pak, por që brenda tyre ka pasur edhe gjykime me kahje jo të njëjta.

Në përgjithësi kontribut për shpjegimin dhe përcaktimin e tipareve të kësaj forme foljore kanë dhënë: Holger Pedersen, Dhimitër Kamarda, Kristian Sandfeld, Helmut Shaller, Selman Riza, Besim Bokshi, Shaban Demiraj, Gjergj Pekmezi, Joseph Brian, Mahir Domi, Eqrem Çabej, Idriz Ajeti, Petja Asenova, E. Hamp. M. A. Gabinskij, Stefan Schumacher, Gerhard Rohlfs, Henrik Bariq, Agnja Desnickaja, Petja Asenova, Wilfried Fiedler, Rexhep Ismajli, Kolec Topalli, Françesko Altimari, Ethem Likaj, Leonardo Mario Savoia, Seit Mansaku, Valter Beu, Bahri Beci, Remzi Nesimi, etj.

Holger Pedersen është i mendjes se ka ekzistuar një paskajore edhe në gjuhët e Ballkanit, që në një fazë të hershme të zhvillit të saj është bërë unifikimi i formës së pjesores me format e paskajores. Format *pa pasur* dhe *do me thanë* i trajton si paskajore të mbarë shqipës. Të këtij mendimi janë edhe Jokl dhe Sanfeld.

I përmenda këta dy të fundit, sepse mbronin tezën për origjinën e paskajores në shqipen, duke trajtuar të ardhur nga djepi indoevropianishtes, tezë kjo që disa prej gjuhëtarëve të zënë ngoje më sipër e mohonin, shpeshherë pa ndonjë argumentim bindës.

Mahir Domi pohon se shqipja sipas gjitha gjasave ka pasur, thjesht një formë foljore të paskajores si ato të gjuhëve motra të indoevropianishtes dhe ngul këmbë, duke thënë "... se paskajorja me *me* ka qenë e tërë shqipës, sepse mbetjet e këtij mjeti gramatikor nuk mungojnë as në toskërishten"².

Shaban Demiraj në tipin e formave *me ba* sheh ekzistimin e paskajores, që me kohë këto forma janë zhvilluar si zëvendësime të formave të një paskajoreje më të vjetër, e cila edhe mund të jetë zhdukur.

² Mahir Domi, **Morfologjia historike** (konspekt leksionesh), Tiranë, 1961, f.67

Mirëpo, Besim Bokshi në studimin e tij monografik: *Paskajorja e shqipes – vështrim diakronik* na duket se më shumë se gjithë të tjerët gjuhëtarë është thelluar edhe rreth çështjes së paskajores në shqipen, për të cilën shton: “Argument kryesor në të cilën bazohet mendimi, se shqipja e fazës së dokumentuar ka krijuar dëshmi të pranisë së dukshme të paskajores sintetike, e cila del me formën e pjesores së sotme me burim nga participi pasiv i perfektit, merret në radhë të parë bashkëvajtja e kësaj forme foljore modale *duhet* dhe *do: duhet thënë – do thënë, duhet- larë, do- larë*, duke pasur parasysh se në gjuhët neolatine perëndimore këto folje ndiqen nga infinitivi. Nga kjo, shton më tutje Bokshi, u konkludua pastaj edhe për format: *me la – pa la*, apo *pa larë*, si të përbëra burimisht nga paskajorja me parafjalë, e u nxor në vijim i njëjti përfundim për pëcjelloren: *tue la – duke larë*”³.

Sipas Gjergj Pekmezit trajta e shkurtër e pjesores brenda kohëve të përbëra është e besueshme të jetë formë e shkurtuar e infinitivit të lashtë⁴. Aleksandër Xhuvani është kategorik në bindjen e tij, se shqipja e lashtë ka pasur një paskajore sintetike të tipit indoevropian.

Mirëpo, Selman Riza i ka bërë paskajores një trajtim shumë më të shtrirë, jo vetëm në shqipen, por edhe në gjuhët e tjera, sidomos paskajores së serbishtes në veprën *Gramatikë e serbo-kroatishtes, Prishtinë, 1952*, që vë theks të veçantë, duke i vënë në përjasje format infinitivale me ato të serbishtes, apo siç quhej atëherë të serbo-kroatishtes.

Edhe në serbishten, si edhe në shqipen gjallon forma foljore e pashtjelluar, e cila figuron nëpër gramatikat e serbishtes si *neodredjeni glagolski oblik ose infinitiv*.

Funksionet e kësaj forme i gjejmë në formimin e strukturave foljore të futurit (*Ja ću čitati*), që do t’i pëgjigjej në shqipen, gjithashtu me futur i ndërtuar *kam+ infinitiv (me punue)*.

Infinitivi i serbishtes shpeshherë është i barazueshëm me lidhoren, p.sh. *Raditi dobro i brzo nije uvek lako = Nije uvek lako da čovek radi dobro i brzo. (Me punue mirë e shpejt nuk asht lehtë = Nuk është gjithmonë lehtë të punosh mirë e shpejt.*

³ Besim Bokshi, *Pjesorja e shqipes-vështrim diakronik*, Prishtinë, 1998, f.11

⁴ Gjergj Pekmezi, *Grammatik der albanesischen Sprache*, Wien, 1908, s.130

Shembujt e shënuar këtu më sipër lënë përshtypjen sikur në shqipen dhe në serbishten paskajorja na duket se ka të njëjtin funksion gjuhësor, dmth. jo vetëm të njëjtën domethënie, por edhe të njëjtat mundësi të përdorimit dhe zëvendësimit me format koniuktivale.

Sipas Rizës, ...ndërmjet këtyre dy gjuhëve lidhur me këtë mënyrë ekziston edhe një ndryshim tjetër i rëndësishëm, sepse shqipja këtë formë foljore e ndërton në disa mënyra me parafjalë, ndërsa serbishtja, këtë mënyrë ndërtimi e ka të përcaktueshme dhe gjithmonë format infinitivale të saj në përkthim e sipër kërkojnë medoemos lidhoren⁵.

Dihet mirëfilli se në shqipen e lashtë paskajorja ka qenë e karakterit sintetik, dmth. e përbërë prej një fjale të vetme: *punu*, përkundraziti në shqipen e vonë ajo vjen e bëhet shprehje foljore e përbërë prej paskajores së lashtë dhe një parafjale që në këtë formë (*me pune*) ka humbur çdo kuptim të mvetësishëm, por kur shoqërohet me parafjalën *pa* nuk merr parafjalën me (*pa punue*). Pikërisht në këtë serbishtja përdor mënyrën lidhore dhe elementet përbërëse të kësaj forme: *a da*, si psh.: *Kjo çështje nuk mund të kalojë pa shkaktuar kundërshtime. To ne može da prodje a da ne izazove otpor. Askund nuk mund të jetosh pa punue. Nigde ne možeš da živiš a da ne radiš. Ai është pranuar në fakultet pa i plotësuar kushtet. On je primljen na fakultetu a da nije ispunio uslove.*

Kur në shqipen paskajorja ndërtohet me parafjalën qëllimore *për*, ajo ruan edhe parafjalën *me*: *për me punue*, por edhe vetë paskajorja me formën *me punue* mund të ketë kuptim qëllimor. Në këtë rast serbishtja përdor lidhoren: *Došao sam da te posetim.*

Nëse shqipja përdor formën foljore *me pasë* (*imati*) e ndjekur me paskajoren e fojes përkatëse, serbishtja i përgjigjet me lidhoren: *Kam pasë me shkue edhe në qytet. Imao sam da idem i u gradu. Kam pasë me thanë edhe diçka. Imao sam još nešto da kažem.*

Një tjetër ndryshim ndërmjet shqipes dhe serbishtes është, siç shton Selman Riza: “Në lidhje me mënyrën pacaktore qëndron këtu që shqipja, përveç pacaktore së tashme: *me u la* (*umivati se*), *me ardhë* (*doći*) etj., ka dhe pacaktoren e kalueme: *me u pas la*, *me pasë ardhë* etj., që përdoren në fjalitë kushtore nëpër frazat e ndryshme, që në

⁵ Selman Riza, *Gramatikë e sërbo-kroatishes*, Prishtinë, 1952, f.132.

serbishten zavendësohen me lidhoren: *Erdha se mos me pasë ardhë unë, ju do të kishit qenë në kujdes për mue. Došao sam jer da nisam ja došao vi biste zbog mene bili zabrinuti*”⁶.

Në serbishten shumica e formave të paskajores mbarojnë me *-ti*: *čuti, pevati,, čekati, toniti* etj., ndërsa një numër me i vogël dalin e dhe me mbaresën *-ći*: *moći, reći, ići, dići* etj.

Duhet përmendur se në serbishten, kur bëhet klasifikimi i foljeve, për bazë gjithmonë nisen apo kanë parasysh formën e paskajores, çfarë me shqipen kjo nuk mund të ndodhë.

⁶ Selman Riza, Po aty, f. 133.

Anila OMARI, Tiranë

RRETH SHTRRESËZIMIT KRONOLOGJIK DHE SHTRIRJES DIALEKTORE TË HUAZIMEVE SLLAVE TË SHQIPES SË SHEK. XVII.

Abstrakt

Me punën e derisotme të albanologëve sllavistë është krijuar tashmë një pamje e qartë e shtrirjes së huazimeve sllave nëpër dialektet e shqipes në mbarë territorin e saj. Për një shtresim kronologjik të sllavizmave të shqipes, përkundrazi, mungojnë të dhëna të sakta, me gjithë përpjekjet e bëra, sidomos nga sllavistët, për dallimin e një shtrese më të vjetër në bazë të kriterëve fonetike. Për një shtresëzim relativ të kronologjisë së huazimeve sllave në shqipe na vijnë në ndihmë edhe tekstet e vjetra shqipe duke na dhënë dëshminë shkrimore për hyrjen e disa sllavizmave të caktuara në shqipe të paktën qysh para shek. XV.

Në gjuhën e Pjetër Bogdanit mund të vihen re më mirë se te autorët e tjerë të vjetër ndikimet sllave dhe pasojat e situatës së gjuhëve në kontakt. Vëllimi i konsiderueshëm i veprës së tij dhe tematika e gjerë dhe komplekse ofrojnë lëndë të bollshme për të studiuar huazimet sllave në tekstin e këtij autori, si përfaqësues i shqipes veriore të shek. XVII. Ndër autorët e vjetër të Veriut te Bogdani ndeshet numri më i madh i sllavizmave leksikore, rreth 77 njësi, 20 prej të cilave nuk gjenden në literaturën tjetër të vjetër. Kundrejt këtij, numri prej 42 sllavizmash të Budit shpjegohet jo vetëm me tematikën më të ngushtë, kryesisht fetare, të veprave të tij, por edhe me prejardhjen e këtij autori nga një krahinë e brendësisë, siç është Mati, të folmet e së cilës përmbajnë më pak sllavizma sesa ato të krahinave më veriore, në kontakt të drejtpërdrejtë me serbishten.

Në tekstin e Bogdanit mund të zbulohet një shtresë huazimesh që i takon periudhës së sundimit të mbretit Dushan e pasuesve të tij, pra mund të caktohen kronologjikisht që nga shek. XIV.

Një shtresë tjetër leksikore janë leksema me burim sllav të gjuhës popullore, të së folmes së tij të vendlindjes e më gjerë të geg. veriore. Këta janë sllavizma krahinorë, ndikime të kontaktit gjuhësor në një territor etnikisht të përzier. Në gjuhën e Bogdanit mund të gjurmohen edhe kuptimet më të vjetra të leksemave me burim sllav që gjëllijnë edhe sot në gjuhën shqipe, tashmë me ngjyrimë kuptimore të ndryshuara, të cilat rezultojnë të kenë përkim më të madh me kuptimin origjinal të shenjuesit në gjuhën burimore.

Puna e deritanishme e albanologëve sllavistë ka arritur rezultate të shënueshme në përvijimin sa më të plotë të përhapjes gjeografike të huazimeve sllave të shqipes. Që nga hulumtimet e para në terren të

Agnia Desnickajas, e cila hapi rrugë në këtë fushë duke zbatuar në praktikë metodologjinë e re të propozuar nga Jokli për studimet e huazimeve sllave të shqipes, e deri te monografitë e plota të Gunnar Svanes e Xhelal Yllit që e çuan më tej dhe e zbatuan në mënyrë sistematike përcaktimin e përhapjes gjeografike të sllavizmave të shqipes për çdo njësi leksikore, duke krijuar dhe një lloj atlas të sllavizmave të shqipes, është krijuar tashmë një tablo e qartë e shtrirjes së huazimeve sllave nëpër dialektet e shqipes në mbarë territorin e saj.

Për një shtresim kronologjik të sllavizmave të shqipes, përkundrazi, mungojnë të dhëna të sakta, me gjithë përpjekjet e bëra, sidomos nga Jokli, Treimeri, Selishevi, Vasmeri, Duridanovi, Svane etj., për dallimin e një shtrese më të vjetër të sllavizmave të shqipes, në bazë të kriterëve fonetike.¹ Për një shtresëzim relativ të kronologjisë së huazimeve sllave në shqipe na vijnë në ndihmë edhe tekstet e vjetra shqipe. Është e qartë se pjesa më e madhe e sllavizmave të shqipes janë huazuar shumë më herët se shek. XVI, kur shfaqen tekstet e para shqipe. Shumica e sllavizmave u përkasin, sipas studimeve më të reja, shekujve IX deri XV². Megjithatë tekstet e vjetra shqipe na ofrojnë dëshminë shkrimore për hyrjen e disa sllavizmave të caktuara në shqipe të paktën qysh para shek. XV. Numri i sllavizmave në tekstet e vjetra shqipe, nga shek. XV me Buzukun deri në fund të shek. XVII me Pjetër Bogdanin, arrin në rreth 115 njësi leksikore. Në një inventar të përgjithshëm prej rreth 1000 njësisish leksikore me burim sllav (Svane 1992), ky raport mund të duket befasues. Por duhet pasur parasysh në radhë të parë specifika e huazimeve sllave të shqipes, të cilat për shkak të rrethanave historike, sociale e kulturore të depërtimit të tyre në shqipe ndryshojnë nga shtresat e ndikimeve të gjuhëve e kulturave të tjera në shqipe në radhë të parë nga përhapja jo e njëtrajtshme në territorin e shqipes: ato janë më të përqendruara në skajet e truallit të shqipes dhe vijnë duke u pakësuar drejt brendësisë; së dyti,

¹ Megjithatë studimet nuk kanë arritur të provojnë kontakte të hershme, para shek. IX, të shqiptarëve me sllavët. Në shqipe nuk ka dëshmi të mjaftueshme gjuhësore për të vërtetuar gjurmë të periudhës para metatezës sllave të likuidave, si dukuri gjuhësore me cak kohor të përcaktuar qartë (shek. IX). Khs. A. Omari, "Përsëri rreth huazimeve më të vjetra sllave në shqipe", *SF*, nr. 1-2, 1999, f. 72-77.

² G. Svane, *Slavische Lehnwörter im Albanischen*, Aarhus University Press, 1992, S. 290-304.

në pjesën më të madhe të tyre ato kanë hyrë nëpërmjet kontakteve me gjuhët sllave fqinjë, pra ndryshojnë sipas zonave të kontaktit. Kështu, nga kërkimet tona në terren për huazimet sllave në Shqipërinë e Veriut rezultoi se numri më i madh i tyre është përqendruar në krahinën e Malësisë së Madhe në veriperëndim, me rreth 220 njësi dhe në krahinën e Tropojës (me përfaqësues të folmen e fshatit Valbonë) në verilindje, me rreth 280 njësi. Në të njëjtën mënyrë secili nga autorët e vjetër mund të konsiderohet përfaqësues i një të folmeje të caktuar, të asaj të origjinës. Në qoftë se konsiderojmë pastaj vëllimin e kufizuar të teksteve të vjetra shqipe e sidomos tematikën e ngushtë, kryesisht fetare e diturore të tyre, mund të përligjim numrin relativisht të vogël të sllavizmave që përmbajnë ato edhe me faktin e njohur se huazimet sllave nga një anë përfshijnë kryesisht fusha semantike që lidhen me jetën fshatare dhe administrimin feudal mesjetar dhe nga ana tjetër nuk kanë prekur terminologjinë fetare të shqipes.

Duke u nisur nga tekstet e vjetra mund të gjurmohet edhe përhapjen gjeografike të fjalëve me burim sllav, që në zanafillë i përkisnin gegërishtes veriore, dhe nëpërmjet bashkëveprimit ndër dialektor dhe më pas gjuhës letrare janë shtrirë edhe në të folme të tjera, madje në mbarë gjuhën.

Në gjuhën e Pjetër Bogdanit mund të vihen re më mirë se te autorët e tjerë të vjetër ndikimet sllave dhe pasojat e situatës së gjuhëve në kontakt. Vëllimi i konsiderueshëm i veprës së tij dhe tematika e gjerë dhe komplekse ofrojnë lëndë të bollshme për të studiuar huazimet sllave në tekstin e këtij autori, si përfaqësues i shqipes veriore të shek. XVII. Bogdani nga prejardhja i takon një zone të vjetër kontakti shumëshekullor, madje dhe dygjuhësie, mes shqipes e serbishtes, siç është krahina rreth Prizrenit. Veprimtarinë klerikale, politike, kulturore e shoqërore në një pjesë të madhe të jetës së tij ai gjithashtu e ushtroi në zonat me popullsi të përzier, serbe e shqiptare, siç ishte Kosova. Detyrën e tij si prift i ri, pas përfundimit të studimeve në Romë e Loreto, ai e filloi në Misionin e Gashit, “ne i confini di Servia, et Albania”³ dhe e përfundoi po në ato krahina, si arqipeshkëv i Shkupit dhe administrator kishtar i popullsisë katolike në mbretërinë e Ser-

³ L. Marlekaj, **Pietro Bogdani e l'Albania del suo tempo**, Liantonio Editrice, Palo del Colle, Bari, 1989, f. 24.

bisë. Në veprën e tij ai flet shpesh për “dheun e Arbënit e të Shërbisë” si dy vende me fate të përbashkëta nën sundimin turk. Megjithëse nuk ka dëshmi të sigurt për shkollim të tij në gjuhën serbe, përveç pohimeve të tërthorta për shkollimin fillor në Ciprovac të Bullgarisë, Bogdani do ta ketë njohur serbishten nëpërmjet mjedisit dygjuhësh të vendlindjes së tij. Dëshmi për njohjen perfekte të serbishtes nga ana e Bogdanit, madje për dygjuhësinë e tij, japin burimet dokumentare vatikanase që përmendin veprimtarinë e tij klerikale, sipas të cilave atë “e ndihmon gjuha turke, ilire [sllave -A.O.] e shqipe, të cilat Ipeshkvi i zotëron përsosur”⁴ e sidomos dëshmitë për predikimet e tij edhe në gjuhën sllave, përveç se në shqip: në zonat me popullsi kryesisht sllave, si në Shkup, Prokuplje, Trepçë, Bogdani mbante predkun në gjuhën sllave (“predica in illirico”)⁵. Edhe vetë vepra e tij dëshmon për njohjen e serbishtes, por edhe të kulturës popullore të fqinjëve serbë, me përfshirjen në tekst të një dyvargëshi serbisht që këndohet me rastin e një feste popullore që evokon kujtimin e profetit Jeremi (*Jeremia u polje, beži zmija u gore* I 124 2).

Ndër autorët e vjetër të Veriut të Bogdani ndeshet numri më i madh i sllavizmave leksikore, rreth 77 njësi, 20 prej të cilave nuk gjenden në literaturën tjetër të vjetër. Kundrejt kësaj shifre, numri prej 42 sllavizmash të Budit shpjegohet jo vetëm me tematikën më të ngushtë, kryesisht fetare, të veprave të tij, por edhe me prejardhjen e këtij autori nga një krahinë e brendësisë, siç është Mati, të folmet e së cilës përmbajnë më pak sllavizma sesa ato të krahinave më veriore, në kontakt të drejtpërdrejtë me serbishten.

Në tekstin e Bogdanit mund të zbulohet një shtresë huazimesh që i takon periudhës së sundimit të mbretit Dushan e pasuesve të tij, pra mund të caktohen kronologjikisht që nga shek. XIV. Këto janë kryesisht terma të administrimit feudal mesjetar, ndër të cilat mund të dallohen disa nënfusha kuptimore. Një pjesë prej tyre dëshmohen edhe në autorët e tjerë para tij. Në fushën e organizimit agrar mesjetar hyn leksema *bashtinë* “arë pranë shtëpisë; pronë toke”, me përhapje në të gjithë Ballkanin, e dëshmuar në të gjitha tekstet e vjetra shqipe, madje që vitin 1462 në tekstin latinisht të

⁴ Arkivi i Prop. Fide, vëll. 304, fl. 55r, shih L. Marlekaj, **Pietro Bogdani e l'Albania del suo tempo**, vep. cit., f. 71.

⁵ L. Marlekaj, vep. cit., f. 114.

Vendimeve të Kuvendit të Matit të Pal Engjëllit. Kuptimi historik “pronë tokësore” ose thjesht “pronë” (Budi) që del te autorët e vjetër dhe te arbëreshët e Italisë sot është i vjetruar dhe më fort fjala përdoret për “kopsht pranë shtëpisë” (FGJSSH). Një tjetër fjalë e organizimit feudal mesjetar, e nënfushës sociale, që dëshmohet në të gjitha tekstet e vjetra shqipe që nga shek. XVI është *bujar* “patric, përfaqësues i parisë, fisnik”, e përhapur gjerësisht territorin e shqipes si dhe në diasporën arbëreshe të Italisë e të Greqisë. Autorët e vjetër e përdorin me kuptimin historik, sot të vjetruar dhe të mbetur në përdorim në sens të figurshëm “zemërgjerë, dorëdhënë”. Në fushën e administratës mesjetare të sundimit serb hyjnë edhe emërtimet e taksave e detyrimeve. Bogdani përdor sllavizmin e mbarë shqipes *gjobë* (me shqiptim shkodran *gjobë*) dhe *vojshtinë* “taksë, haraç”, fjalë e vjetruar e Veriut, ndërsa Budi e Bardhi përdorin *carinë* “taksë; taksë dogane”, sot jashtë përdorimit. Që te Buzuku del termi ekonomik *kamatë*, një ballkanizëm me burim nga greq. bizantine⁶, i cili në shqipe pas Meyerit (edhe Çabejt) ka hyrë nga serbishtja. Burimin sllav e përforcon edhe *kamatnik* e Budit që duket si huazim i drejtpërdrejtë, kundrejt derivatit me mjetet e shqipes *kamatar* të Bogdanit. Në këtë fushë hyn dhe *penez* që përdor Bogdani për “monedhë”, fjalë e gegërishtes, sot me një kuptim të vjetruar “monedhë argjendi që përdorej si stoli”. Pjesë e terminologjisë feudale mesjetare është sllavizmi *vojvodë*, te Bogdani “prijës ushtarak, capitano”, fjalë e geg. veriore që me kohë ka marrë edhe kuptime të tjera në shqipe: “bajraktar; kryetar vëllazërie brenda fisit; kryeplak; guvernator” etj., me përhapje të gjerë edhe në Ballkan: përveç se në shqipe, ka kaluar edhe në rumanishte e hungarishte. Si një autor që në krahasim me paraardhësit e tij qëndron më pranë rrethanave serbe, Bogdani përdor edhe ndonjë serbizëm ekskluziv të tij, si *ban* për “princ serb; baron”, fjalë përndryshe e panjohur në shqipe. Nga fusha e administrimit juridik mesjetar serb është leksema *beleg*, sot në geg. veriore me kuptimin “dyluftim” ose te arbëreshët “shesh lufte” (Giordano); në shek. XVII del te Bardhi e Bogdani në shprehjen *me shtim beleg* “provocare, disidare”. Fjala sllave *biljeg* me prejardhje të vjetër turke, është e përhapur edhe te rumunët e te hungarezët, pra ka një shtrirje të gjerë në Ballkan. Kuptimet e shenjuesit në sllavisht janë “shenjë, vulë; nishan në trup”, por edhe një kuptim shumë i vjetër “shenjë, nishan për qitje; objektiv” në serb. e Kosovës (Skok ER I

⁶ P. Skok, ER I, 549.

150). Këtë kuptim të vjetër duket të ketë marrë shqipja. Shprehja e autorëve të vjetër *me shtim beleg* del që në Statutet e Shkodrës të mesit të shek. XIV, në formulimin e venecianishtes së vjetër *metter belego*, me kuptim kontekstual “provokoj”⁷, me sa duket një përkthim nga shqipja. Zhvillimi kuptimor në shqipe ka shkuar nga “sfidoj, thërras në dyluftim” në “dyluftim”. Kuptimi “shesh lufte” del dhe në epikën popullore të kroatëve: *biljeg* “mejdani”⁸. Në fushën administrative hyn dhe *leçit* “shpall, publikoj; shpall jashtë ligjit, ekskomunikoj”, te Budi, Bardhi e Bogdani. Në sferën e organizimit social bën pjesë termi *opqinë* “familje; fis, farefis” (Buzuku, Bogdani), fjalë e geg. veriore, e dëshmuar në KLSH për Shkodër e Prizren (Kosovë), e regjistruar te fjalori i Bashkimit, sot jashtë përdorimit të përgjithshëm. Në të njëjtën fushë kuptimore mund të vendoset edhe *starisfat* “krushku i parë”, nga serb. *stari svat*, te Buzuku e Bogdani “architriclino”, fjalë e vjetër e geg.veriore, sot jashtë përdorimit aktiv. Nga sfera e administrimit juridik është dhe sllavizmi *padit* “akuzoj” i dëshmuar në të gjithë autorët e vjetër të Veriut, me përhapje mjaft të gjerë në mbarë territorin e shqipes. Mund të hyjë në sferën administrative edhe leksema *rend* “radhë, rresht; rregull”, nga një trajtë më e vjetër sllave me hundore *ređb*, që dëshmohet që te Bardhi e Bogdani. Buzuku ka një trajtë pa hundorësi që del si folje në lidhore të pakryer: *të reditishnë* dhe si mbiemër prejpjesor *të reditunë*. Kjo trajtë vjen nga varianti me zanore gojore *red* “radhë, rend i një pune” i gegërishtes veriore që regjistrohet në FGS, si në shprehjen *nuk më del red(i)* (Jungg, Bashkimi) dhe dëshmohet në terren për Kastrat *ret,-di* (Shkurtaç), Kelmend *meredoj* “vë me radhë”. Në një këngë popullore nga Trjepshi: *Prā me rēt aj çikat naj ka lutun* (shënuar me hundore nga Camaj, Il ‘Messale’, 82). Fjala e ka prejardhjen nga serbishtja *red* “rend, radhë, rregull”, me *e* gojore për *ê* të sllavishtes së vjetër (Jokl Sbornik Miletić 143, Çabej SE VI 272). Prania e këtij varianti fonologjik te Buzuku konfirmon prejardhjen e Buzukut nga krahinat skajore të Shqipërisë veriore në kufi me zonat sllavishtfolëse. Në fushën e terminologjisë feudale mesjetare hyn dhe sllavizmi *rob* “skllav; njeri”, me përhapje në mbarë gjuhën dhe i dëshmuar që në tekstet e vjetra gege, përveç Buzukut ku del emri i mocionit *robinjë* dhe derivati *robī*. Te Bogdani dalin të dy kuptimet e leksemës. Të gjithë autorët e vjetër përdorin termin ushtarak me

⁷ Khs. **Statuti di Scutari**, përg. nga L. Nadin, Viella, Roma, 2002, f. 113. Botim i dytë: Onufri, Tiranë, 2010, f. 232.

⁸ F. Miklosich, **Die slavischen Elemente im Albanischen**, AF I, 16.

burim sllav *shtrazë* “roje; garnizon”: Buzuku e Budi “custos”, Bardhi “praesidium, vigilia”, Bogdani “strehë, mbrojtje, it. custodia, gjerm. Obhut”, me rrjedhjen *shtrazëtār* “custode”, te Bardhi edhe *shtraznik* “vigilante; procubitor”. Fjala gjëllin edhe sot në të folme të gegërishtes veriore, si në Malësi të Madhe e Prekal të Dukagjinit (nga kërkimet tona në terren), e në Kelmend (pas Shkurtajt DS III), por në të folme të tjera të Veriut edhe me kuptimin “një shtrat i ngritur mbi dërrasa ku vendosin kashtën që të mos e hanë bagëtia” ose “shtrat i ngritur ku flenë pulat”, pra me zhvendosje kuptimi nga “vendroje” përmes përbërësit kuptimor “postroje i ngritur mbi një shtrat dërrasash”. Nga marrëdhëniet administrative feudale buron edhe sllavizmi i mbarë gjuhës *zakon*, sot me kuptimin “normë, shprehi, doke; hist. kanun”, te autorët e vjetër edhe “ligj”, siç lexohet te Buzuku: *porsi ish zakoni i Mojszeit* (84v2 =94v2) “secundum legem Moysi”, e më fort “testament”: *ñnesh hjektë gjithë të pālignje n zakonit plak* (57r50 =67r50), te Budi: *e gjithë urdhëni e ligja e zakonit plak e e zakonit rii* (DC 30 9), *qi çprishi zakone-tanë e na nxuor zakon të rii* (DC 205 20), te Bardhi “institutum; mos, costume; ritus; usus”; te Bogdani “precetto; rito; esempio; costume; uso; usanza”. Kuptimi “ligj” që del te Buzuku e Budi është më afër burimit sllav të fjalës, serb. *zakon* “ligj”.

Një shtresë tjetër leksikore janë leksema me burim sllav të gjuhës popullore, të së folmes së vendlindjes së Pjetër Bogdanit e më gjerë të geg. veriore. Këta janë sllavizma krahinorë, ndikime të kontaktit gjuhësor në një territor etnikisht të përzier. Në gjuhën e Bogdanit mund të gjurmohen edhe kuptimet më të vjetra të leksemave me burim sllav që gjëllijnë edhe sot në gjuhën shqipe, tashmë me ngjyerime kuptimore të ndryshuara, të cilat rezultojnë të kenë përkim më të madh me kuptimin origjinal të shenjuesit në gjuhën burimore.

Sllavizma të Bogdanit me përhapje në geg. veriore janë p.sh. folja *gërditet* (më) “më vjen ndot”, te Bogdani si mbiemër: *gërđiçim* (I 143 2) dhe emër asnjës: *të gërđiçmitë* (I 132 9); *hit* “ngut” (II 14 11, II 113 19), fjalë e formuar në shqipe nga *hitas*, *hitat* fjalë e geg. veriore, prej serb. *Hitati* “nxitaj, ngutem; hedh”; *mamicë*, te Bogdani “mami”, sllavizëm krahinor i Veriut që gjëllin si “mbretëresha e bletëve” në Vrith të Shkodrës; *megje* “kufi”, me shtrirje të gjerë në geg. veriore; *mor* “vdekje masive nga epidemia, mortalitë”, fjalë e geg. veriore e dëshmuar në fjalorët e Veriut; burimin e diskutuar sllav të saj e përforcon folja *me u moritunë* e autorëve të vjetër dhe e Bogdanit në veçanti, si një sllavizëm krahinor i së folmes së

këtij autori. *naçëndunë* (*me*) “cënoj; pakësoj” që përdoret te Bogdani: II 17 17 *pa mos u naçendunë të pasosmitë t'kulluemit t'inaj* “senza diminuirsene l'infinito della chiarezza”, është një sllavizëm krahinor i së folmes së autorit nga skr. *naçeti* “nis, filloj”, që dëshkohet edhe për Drenicë të Kosovës *naçet* “ha pak nga një gjë”, *i naçeti* “i hëngri disa kokrra”, *e naçeti vegshin* “i muer pak të lyen” (*GJA* 1971/1, 190). *rok*, sllavizëm krahinor i geg. veriore me kuptimin “afat, kohë e caktuar; radhë”, te Bogdani përdoret me kuptimin “caktim, qëllim”: (I 53, 20) *Zotynë... kishte vum rok me çuem e me nalcuem Natyrën e Nierit mbī gjithë kreatyrët* “Dio... determinato havea di elevare la Natura Humana sopra tutte le creature”; II 1 1 *me mos kjanë roku i amëshueshim, qi kam bam me krijuem një virgjinë* “la determinazione eterna”. *Dobit* “fitoj; ngadhënjej, mposht”, sllavizëm i autorëve të vjetër, sot mbijeton në ndonjë të folme skajore të Veriut, por derivati i saj *dobi* është shtrirë në mbarë gjuhën. *Qutë* “kokëfortësi” e Bogdanit dhe *qud* e Bardhit është një sllavizëm krahinor i geg. veriore, që dëshkohet edhe në Sapë të Zadrimës (Gazulli), sot i vjetruar, nga serb. *ćud* “natyrë, karakter”. Te *pokrovë* e Bogdanit ruhet më mirë forma fillestare e fjalës, po edhe kuptimi “çarçaf i të vdekurit” që ka serbishtja. Përndryshe fjala në shqipe përdoret në trajta e kuptime më të diferencuara, në të folme të ndryshme të të dy dialekteve, si psh. te Budi *pokrave kualsh* “mbulesë apo shilte leshi”. Bogdani përdor dhe një folje *me u cmilunë* “vihem në lëvizje, nisem”, ndoshta një me *smiloj* që jep Gazulli për Pukë dhe me *smilas* të Bashkimit dhe FGS, shpjeguar si sllave nga Desnickaja. *Uzdatem* “mbaj shpresë; marr zemër, kam siguri” është fjalë e Budit dhe e Bogdanit, që në geg. Veriore të Shkodrës haset si emër *uzdajë* “shpresë” nga serb. *uzdanje* “shpresë”. Sllavizma të tjerë të Bogdanit janë *sablje* “jatagan”, *stenicë* “çimkë”, *treme* “hajat”, *xehë/cehë* “minierë”, nga serb. *ceh* e huazuar nga minatorët saksonë të Transilvanisë që emigruan në Serbi për të punuar në miniera. Trajta *temel* e Bogdanit mban karakteristikat e serbishtes, përkundrajt *themel* të mbarë shqipes me burim nga greqishtja. Po kështu *prutekë* është më afër burimit serb. *prutak* sesa *purtekë* e Budit e *portekë* e Buzukut. Ndonjë nga turqizmat që përmban teksti i Bogdanit mund të ketë hyrë nëpërmjet serbishtes, si *qurdie* “mantello”: *e mbi tâ bajtëke një qurdie mavi* (II 119 6), përkundrajt shqipes së Veriut *xhurdi* nga turq. Te ky autor ndeshet edhe ndonjë kalk apo huazim kuptimor nga serbishtja si *giū* “brez, fis: it. discendenza, progenie, stirpe” nga serb. *koleno* “1. gju; 2. brez, gjenëratë”: I 3 10 pari regji i Asirit, nipi i Nembrotit *giunit* së Kamit: (it. ne-

pote di Nembrot, descendente di Cam). Edhe disa trajta emrash të përveçëm te Bogdani kanë gjurmë sllave: *jevrej* (I 18 27), *jevreisht* (I 13 5), *jeremī* (II 8 14), *Beç* “Vjenë” (Të primitë), *Gërgur/ Gurgur* (Të primitë, II 42 16/ I 24 21).

Një grup sllavizmash që sot janë në përdorim ose njihen në mbarë territorin e shqipes, madje kanë hyrë edhe në gjuhën letrare, në zanafillë duket se kanë qenë të gegërishtes veriore, siç dëshmohet nga tekstet e vjetra dhe nga të dhënat e kërkimeve në terren. Është me interes fakti se në mjaft raste ka përkime me toskërishten lindore (Korçë, Pogradec). Kjo tregon se këto huazime janë pasoja të ndikimit të adstratit, pra të fqinjësisë me gjuhët sllave, serbishtes në veri e bullgarishtes ose maqedonishtes në juglindje. Për arsye të burimeve të ndryshme të huazimit, ndonjëherë largohen disi kuptimet e Veriut nga ato të Jugut. Një nga këto fjalë është *avitem* “afrohem” që dëshmohet në tekstet e vjetra te Bardhi e Bogdani, e përhapur në gegërishten veriore, por dëshmohet dhe në tosk. lindore *avitem/ javitem* “shfaqem, dukem”. *Bisedë* dëshmohet gjerësisht në gegërishten veriore dhe në tekstet e vjetra (përveç Bogdanit, i cili përdor leksemat më të vjetra *kuvend, kuvenduem*), po ashtu edhe në Shqipërinë juglindore, ndërsa në Shqipërinë e Mesme e të Jugut njihet më fort nëpërmjet gjuhës letrare. *Bashtinë* është po ashtu një fjalë e geg. veriore që shtrihet deri në Malësinë e Tiranës (*bështinë*), ku ka marrë kuptimin “tufë bagëtish që kullosin pa bari”. Dëshmohet edhe për tosk. e Korçës e të Pogradecit si “prona e babait të gruas”, në një shprehje me kuptim të bartur “dhëndër brenda, kollovar” (KLSH). Leksema *i begatë* sot është e përhapur në mbarë gjuhën, por nga të dhënat dialektore të terrenit, të fjalorëve (Kristoforidhi e jep si gege) dhe të teksteve të vjetra të Veriut duket të ketë qenë në zanafillë e gegërishtes, megjithëse e kanë edhe arbëreshët e Italisë (Giordano)⁹. *Çudit*, me rrjedhojën *çudi*, sipas Çabejt, është përhapur në mbarë gjuhën me pikënisje geg. veriore; nga autorët e vjetër dëshmohet te Buzuku. *Habitunë* del së pari te fjalori i Da Lecces (1702) “gaboje në llogari” dhe fjalorët e shënojnë si gege (Miklosichi, Kristoforidhi, Meyeri, Bashkimi). Sot përdoret në mbarë territorin e shqipes. Në Veri del më fort kuptimi “hutoj”, në Jug “çudit”. *Leçis* “shpall, publikoj; nxjerr jashtë

⁹ Burimet që citon Giordano, **Fjalor i arbëreshvet t’ Italisë**, Edizioni Paoline, Bari, 1963, gjithsesi duhen marrë me rezervë si dëshmi për të folmet e arbëreshëve të Italisë. Lemat që përmban fjalori i tij janë marrë nga tekstet e autorëve arbëreshë, të cilët shpesh herë janë ndikuar nga gjuha e letërsisë së dheut amë.

bashkësisë” është fjalë e autorëve të vjetër me përhapje në geg. veriperëndimore si Malësi e Madhe, Fushë-Zadrimë, Mirditë me kuptimin “shpall; nxjerr në tellall për të shitur”, që jepet edhe për tosk. lindore të Korçës “le-xoj; predikoj”. E gegërishtes veriore është fjala *gërç*, te Bogdani *të kërcitunë* “podagra, përdhes”, në normën e sotme *ngërç*, që përdoret edhe në disa vise të Toskërisë juglindore. *Oborr* është më fort e gegërishtes, del në tekstet e vjetra (përveç Bogdanit që përdor latinizmin *kurt*), por e ka dhe tosk. lindore. Siç e vuri re Çabej, *rend* “radhë, rresht; rregull” është në thelb fjalë e gegërishtes, me kohë e përgjithësuar në mbarë gjuhën, ku është bërë edhe mjaft prodhimtare. Është interesante të vendoset lidhja me foljen *rend*, *ngarend* “vrapij” që ka e folmja e Korçës, nëpërmjet togfjalëshit *me ngām rend* që e ka dhe Bogdani, si dhe me emrin *rend* në shprehjen *rendi i diellit = vrapi i d.* (I 35 12). *Sodit* “vështroj, kundroj”, është fjalë në thelb e Veriut, sot e përhapur në mbarë gjuhën. Te Bogdani përdoret rëndom me kuptimin “vështroj”, por edhe “përkujdes; vlerësoj; përfill”: I 93 26 *Zotynë i tha se kish me i soditunë me mish* “li provederebbe di carne”; I 111 5 *po ende me mbajitunë e me soditunë kurtetë vet* “ma anche di prevedere la sua corte”; II 3 7 *Tinëzot, qi për të madhet mëshërier të vet, të denjohej me i soditunë, tue falë një frujt të bekuem* “si degnasse à riguardarli”, kuptime më të afërta me serb. *suditi* “gjykoj, vlerësoj, jap mendim, konsideroj”, ndoshta nga një variant më i vjetër me *-o-* të çundurëzuar. Edhe *sundoj*, sot e mbarë gjuhës, duhet të jetë formuar brenda shqipes nga *sund* që dëshmohet në KLSH nga tekste të geg. veriore me kuptimet “vendim me fuqi ligjore; ligj, rend; mbikëqyrje, sundim, mbrojtje”, nga sll. e vj. *sođb* “gjyq”. *Sanë* (te Buzuku, Bardhi, Bogdani) është në thelb fjalë e gegërishtes që ka hyrë edhe në gjuhën letrare. Nga një anë mbahet si sllavizëm i vjetër për shkak të zanores *a* të rrënjës që reflekton shqiptimin e vjetër [eā] të sllavishtes juglindore (Svane 41), por më anë tjetër nuk ka pësuar ndërrimin *s > sh* dhe është e kufizuar gjeografikisht në Veri. Gjithsesi refleksi sllav. *ě > shq. a* është problematik. Shprehja shumë e përhapur në mbarë gjuhën *marr vesh*, te autorët e vjetër *marr vesh*, mund ta ketë burimin në geg. veriore *vesht* “i aftë, i zoti, me përvojë, mendjemprehtë”, në shprehjet: *a je vesht?* “a ke dijeni?” *jam vesht; marr vesht* “kuptoj, vihem në dijeni”, *i veshtë* “që dëgjon me vëmendje fjalët e të tjerëve, i zgjuar dhe i kuptueshëm, mendjemprehtë”, *veshtak* “i zgjuar, mendjemprehtë” etj. Te Budi gjendet kuptimi i parë: *mb atë herë, kūr gruoja ashtë mā vesht e di mā mirë materienë e formënë* (RR 19 4) “kur gruaja është më me përvojë...”. Është vështirë të ndahet *vesht* “i aftë, i mprehtë; ekspert” nga

vesht në *marr vesh(t)*. E para, siç mendon dhe Svane 269, është pa dyshim huazim nga sllavishtja: sll. e vj. **věštь*, serb./ bullg. (maq.) *vešt* “i shkathët, i zoti; ekspert, i rysur”, *biti vešt nečemu* “njoh, di, marr vesh”, rrjedhojat *veštak* “ekspert, njeri që merr vesh nga diçka”, *veština* “aftësi, shkathësi” etj. Në rast se e dyta buron prej së parës, lidhja me *vesh* do të jetë bërë me etimologji popullore, për shkak të shoqërizimit formal dhe ngjashmërisë kuptimore mes dy fjalëve. *Vozit* (Buzuku, Bardhi, Bogdani) është fjalë kryesisht e geg. veriore, por del edhe në tosk. lindore të Korçës e Pogradecit, sot e mbarë gjuhës dhe e gjuhës letrare; *xehë* (Bogdani) edhe kjo fjalë e Veriut që e ka marrë gjuha letrare dhe ka formuar edhe derivate.

Një numër sllavizmash që i janë të përbashkët për të gjithë autorët e vjetër dhe janë të përhapur në mbarë territorin e shqipes pas gjithë gjasash i përkasin asaj shtrese sllavizmash më të vjetër, të hyrë në shqipe në periudhën e kontakteve të hershme me gjuhët sllave jugore, një periudhë që gjithsesi është shumë e shtrirë në kohë. Ajo fillon ndoshta që nga shekujt VII-VIII, pas stabilizimit të sllavëve në Ballkan e fillimit të kontakteve me popullsitë vendase, përforcohet në shekujt IX-XI dhe XIII me sundimin e shteteve bullgare në Shqipërinë e Mesme e të Jugut e të shteteve serbe në Veri në shek. XI-XII e deri në shek. XIV. Kjo është periudha parashkrimore e shqipes, prandaj datimi i saktë i hyrjes së sllavizmave të veçantë është shumë i vështirë, po të lëmë mënjanë disa kritere fonetike, si sondërimet sllav. *s* > shq. *sh* apo sllav. *č* > shq. *s*, që na japin njëfarë kronologjie relative të hyrjes së atyre leksemave që i përmbajnë këto para shek. XI. Ndonjëherë këta sllavizma të vjetër pasqyrojnë trajta arkaike ose dialektore periferike të gjuhëve sllave të Ballkanit, të padokumentuara në shkrim dhe që mund të kenë mbetur jashtë zhvillimeve normale të shumicës së të folmeve të tjera sllave, çka e vështirëson edhe nga pikëpamja sllavistike çështjen e burimit të drejtpërdrejtë të huazimeve. Sllavizma të kësaj shtrese janë në shqipen e dokumentuar herët leksema si *breg*, *bujar*, *čas* (në tekstet e vjetra me formën parësore pa shtesën fonetike me burim prej lokativit *ndë çast*); *godit* (fjalë e përbashkët e autorëve të vjetër që del me kuptimet “qëlloj, rastis; ndërtoj; rregulloj” e me përhapje në të dy dialektet, por me kuptime të ndryshme: në Veri dalin më fort kuptimet “rregulloj, ndërtoj, ndreq”, në Jug më fort kuptimet “qëlloj, i bie”, po edhe “ndodh, rastis”); *gostit* (te Bogdani si folje, por emri *gosti*, *gostë* i formuar prej saj gjendet te të gjithë autorët e vjetër); *gozhdë* (në bullg. dial. *gozd*, *gozdej*); *grabit*; *grazhd*; *grusht* (përmban tipare fonetike të vjetra sllave dhe sondërimet fonetike të vjetra shqipe, para shek. XI), *gjobë*,

kosë, kosh, kurvë, lakmi, mërzi (te Bogdani edhe me kuptimin “urrej”, më pranë kuptimit burimor të serb. *mrziti*); *neverit* “braktis” (te Bogdani edhe neologjizmi *i neveritunë* “tradhtar i fesë, heretik”, më afër me kuptimet e foljes serb. *izneveriti* “tradhtoj; bëhem i pabesë”, *nevera* “pabesi”, *neveran* “i pabesë, i pafe”, bullg. *neverije* “pabesi, mungesë besimi fetar”; kuptimi “braktis” dëshmohet edhe për tosk. lindore -KLSH); *nevojë; padit* [nga një sll. **pōditi* = bullg. *pъdъ* “vë përpara, ndjek, përzë; shpif” (Selishev 181), me kuptim juridik të huazuar prej gr. διώκω “ndjek, vë përpara, përzë” e “kallëzoi, padit” (Jokl, Slavia XIII 303, 317 v.; Çabej SE VI 114), e cila në gjuhët e sotme sllave jeton në serb. *puditi* e maq. *padi* “përze, dëboj, ndjek” (Svane 238)]; *pleh*, te autorët e vjetër më fort si asnj. *plehëtë*, nga një sllav. e vjetër e rindërtuar); *pogaçë* (Bardhi, Bogdani) me kuptimin e vjetër “bukë e ndorme”, *porosit* (Budi, Bardhi, Bogdani) me kuptimin e vjetër “ia lë në dorë, raccomandare” më pranë kuptimit burimor sllav; *prag, pushkë* (Bardhi, Bogdani), *rend* (Bardhi, Bogdani), *rob, rrafsh* nga një sll. e vj. *равнь* (megjithëse i diskutuar si huazim); *stan* te Buzuku e Budi me kuptimin “banesë”, i afërt me kuptimin parësor të fjalës në sllav. e vjetër “vend qëndrimi, vendbanim”; *strehë* (Buzuku, Bogdani); *shëtit*, nga serb. *šetati se*, por me një shndërrim brenda shqipes (Buzuku ka formën *shetat*- drejtpërdrejt nga serb.); *vobeg*, që dëshmohet në të gjitha tekstet e vjetra shqipe, edhe te Matrënga (*vapëk*), huazim pas gjase shumë i vjetër, pasi ka pësuar zhvillimin fonetik sllav. *u-* > shq. *vo-/va-* ndoshta me mbështetje në ndarjen *i vorfën/i varfër*; *zakon* e mbarë shqipes, te autorët e vjetër edhe me kuptimin “ligj” (Buzuku, Budi) më pranë burimit serb. *zakon* “ligj”.

Duke u nisur nga disa prej shembujve të sjellë më lart, mund të themi se kriteri gjeografik për përcaktimin e burimit të drejtpërdrejtë të huazimit: serbishtja për sllavizmat e gegërishtes veriore e bullgarishtja për ato të geg. jugore e të toskërishtes, nuk duhet të vlejë për shtresën më të vjetër të sllavizmave të shqipes. Tekstet e vjetra shqipe na dëshmojnë fjalë të vjetra të gegërishtes veriore që përmbajnë karakteristika të sllavishtes ballkanike lindore, si *padit, grusht, gozhdë* etj., gjë që tregon se kontaktet më të lashta të shqiptarëve kanë qenë me sllavët që më vonë formuan grupin bullgar të gjuhëve sllavo-jugore. Që këtë mund të nxirren përfundime edhe për shtrirjen e kësaj popullsie sllave në Ballkanin jugerëndimor, çështje që prek më fort interesat e sllavistikës.

Shkurtime:

GJA = Gjurmime albanologjike, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë.

DS = Dialektologjia Shqiptare. Akademia e Shkencave të RPS të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Sektori i Dialektologjisë. Vëll. I-VII, Tiranë, 1971-2005.

SE = Eqrem Çabej, Studime etimologjike në fushë të shqipes, vëll. II, A-B (1980), III, C-D (1987); IV, DH-J (1996); V, (K-M) (në proces botimi); VI, N-RR (2002); VII, S-ZH (2008).

SF = Studime Filologjike. Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. Tiranë.

KLSH = Kartoteka e Leksikut të Shqipes. Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. Tiranë.

Bashkimi = Fjaluer i Ri i Shcypës perbâam prëie Shocniët t' Bashkimit (1908)

FGS = Fjalor i Gjuhës Shqipe, Tiranë, 1954.

Bibliografia

Buzuku Missale. On the basis of the facsimile editions by Namik Ressuli, **II "Messale" di Giovanni Buzuku**, Città del Vaticano: Biblioteca Apostolica Vaticana, 1958 and Eqrem Çabej, **Meshari i Gjon Buzukut (1555), I-II**, Prishtinë: Rilindja 1987, entered by Wolfgang Hock, Berlin 2000-2002; TITUS version by Jost Gippert, Frankfurt a/M, 9.3.2003

CAMAJ, M., **II "Messale" di Gjon Buzuku**, Roma, 1960.

ÇABEJ, E., **Meshari i Gjon Buzukut**, botim kritik, Tiranë, 1968.

ÇABEJ, E., **Studime etimologjike në fushë të shqipes, vëll. II, A-B** (Akademia e Shkencave e RP të Shqipërisë, IGJL, Tiranë, 1976), **III, C-D** (ASHSH, IGJL, Tiranë, 1987), **IV, DH-J** (ASHSH, IGJL, Tiranë, 1996), **V, K-M** (dorëshkrim i depozituar në Institutin e Gjuhësisë e të Letërsisë, në proces botimi), **VI, N-RR** (ASHSH, IGJL, Tiranë, 2002), **VII, S-ZH** (ASHSH, IGJL, Tiranë, 2008). (=SE)

DEMIRAJ, B. **Dictionarium Latino-Epiroticum** (Romae 1635) per R. D. Franciscum Blanchum, Botime Françeskane, Shkodër, 2008.

DESNIKAJA, A. V., Slavjano-albanske jazykovje otnošenija i albanskaja dialektologija, **Slavjanskoe jazykoznanije**, 1968, f. 120-147.

DESNIKAJA, A. V., **Slavjanskije zaimstovanija v albanskom jazyke**, Dokladi sovjetskoj delegacii, Sofija, 1963.

DURIDANOV, I., Zur Bestimmung der ältesten slavischen Entlehnungen im Albanischen, në: **Akten des internationalen albanologischen Kolloquiums**, Innsbrucker Beiträge zur Kulturwissenschaft, Sonderheft 41, Innsbruck, 1977.

Fjalor serbokroatisht-shqip. (A. Zajmi-M. Bardhi-S. Drini-L. Mulaku- G. Luboteni-S. Imami), Instituti Albanologjik i Prishtinës, Rilindja, Prishtinë, 1974.

Fjaluer i Ri i Shcypës perbâam prëie Shocniët t' Bashkimit (1908). Fjalori i "Bashkimit", ribotim anastatik, Prishtinë 1978.

GAZULLI, N., **Fjalorth i Ri**. Fjalë të rralla të përdoruna në Veri të Shqipnis, në: Visaret e Kombit, XI, Tiranë, 1941.

GIORDANO, E., **Fjalor i arbëreshvet t' Italisë**, Edizioni Paoline, Bari, 1963.

JOKL, N., Slaven und Albaner, **Slavia XIII**, 2-3, Pragë 1935, f. 281-325; 4, 1936, f. 609-645. (= Slavia)

JOKL, N., Südslavische Wortstratographie und albanische Lehnwortkunde, **Sbornik v čest na prof. L. Miletič**, Sofija, 1933, f. 118-146. (= Sbornik Miletič)

- KRISTOFORIDHI, K., **Fjalor shqip-greqisht**, transkriptuar në alfabetin shqip dhe përpunuar prej A. Xhuvanit, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Tiranë, 1961.
- MANDALÀ M. (ed.), **Luca Matranga. E mbsuame e krështerë**, Edizione critica dei testi manoscritti e a stampa (1592), S. Sciascia Editore, Caltanissetta, 2004.
- MARLEKAJ, L., **Pietro Bogdani e l'Albania del suo tempo**, Liantonio Editrice, Palo del Colle, Bari, 1989.
- MEYER, G., **Etymologisches Wörterbuch der albanesischen Sprache**, Strassburg, 1891.
- MIKLOSICH, F., Die slavischen Elemente im Albanischen, **Albanische Forschungen I**, Denkschriften der Akademie der Wissenschaften. Phil.-Hist. Classe, 19, Wien, 1870.
- NADIN, L., **Statuti di Scutari**, Viella, Roma, 2002
- OMARI, A. (ed.), **Pjetër Bogdani, Cuneus Prophetarum**, botim kritik, Tiranë, 2005.
- OMARI, A. **Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-serbe**, QSA, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2011 (në proces botimi).
- Rečnik srpskohrvatskoga književnog jezika**, uređivački odbor M. Stevanović i dr., Novi Sad-Zagreb 1967-76 [2. fototipsko izdanje], Matica Srpska, Novi Sad, 1990, 6 knj.
- SELIŠČEV, A. M., **Slavjanskoe naseleñie v Albanii**, Sofija, 1930.
- SHKURTAJ, Gj., *E folmja e Kastratit II*, **SF**, nr. 3, 1967, f. 47-66.
- SHKURTAJ, Gj., *E folmja e Kelmendit*, **DS, III**, 1975, f. 5-129.
- SKOK, P., **Etimologijski rječnik hrvatskoga ili srpskoga jezika**, Völl. 1-4, Jugoslavenska Akademija Znanosti i Umjetnosti, Zagreb 1971-1974.
- SVANE G. (ed.), **Peter Budi, Rituale Romanum (1621)**. With a transcription into modern orthography and a concordance prepared by Gunnar Svane. Institut for Lingvistik, Aarhus Universitet, Århus, 1986.
- SVANE, G. (ed.), **Peter Budi, Dottrina Christiana (1618)**. With a transcription into modern orthography and a concordance prepared by Gunnar Svane. Institut for Lingvistik, Aarhus Universitet, Århus, 1985.
- SVANE, G. (ed.), **Peter Budi, Speculum Confessionis (1621)**, With a transcription into modern orthography and a concordance prepared by Gunnar Svane. Institut for Lingvistik, Aarhus Universitet, Århus, 1986.
- SVANE, G., **Slavische Lehnwörter im Albanischen**, Acta Jutlandica, Aarhus University Press, 1992.
- VASMER, M., **Studien zur albanischen Wortforschung**, Dorpat, 1921.
- YLLI, Xh., **Das slavische Lehngut im Albanischen**, 1. Teil Lehnwörter, Slavistische Beiträge 350, München, 1997.

Shkumbin MUNISHI, Prishtinë

PROBLEME TË ZBATIMIT TË DYGJUHËSISË SHQIP-SERBISHT NË KOSOVË

Abstrakt

Gjuha shqipe dhe gjuha serbe kanë një histori të gjatë të bashkëjetesës dhe të ndërmdikimit në Kosovë. Kjo bashkëjetesë dhe ky ndërmdikim ka ndodhur në situata të ndryshme të statusit të këtyre dy gjuhëve. Për një periudhë të gjatë kohore serbishtja kishte status më të favorshëm dhe, rrjedhimisht, ndikim më të madh në raport me shqipen. Por, pas çlirimit të Kosovës (1999) dhe krijimit të shtetit të pavarur (2008), shqipja dhe serbishtja kanë fituar që të dyja status zyrtar të barabartë në Kosovë, pra në të gjitha dokumentet ligjor është përcaktuar dygjuhësia zyrtare në Kosovë. Megjithatë, zbatimi praktik i dygjuhësisë aktualisht është i pamundur. Qëllimi i këtij punimi është të hedh dritë mbi vështirësitë e zbatimit të dygjuhësisë shqip serbisht dhe të vë në dyshim adekuacitetin e përcaktimit të statusit për shqipen dhe serbishten.

Punimi bazohet në një hulumtim pilot, më konkretisht në një anketim me një numër të kufizuar personash, folës të shqipes, nga të cilët jemi përpjekur ta kuptojmë se sa e njohin gjuhën serbe, cili është qëndrimi i tyre ndaj saj, cili është intensiteti i kontakteve me folës të serbishtes dhe me çfarë gjuhe do të komunikonin në rastet e ndërkomunikimit me folës të serbishtes.

Në bazë të të dhënave nga ky hulumtim do të përpiqemi t'i nxjerrim përfundimet lidhur me vështirësitë në zbatimin e dygjuhësisë shqip serbisht në Kosovë.

1. Hyrje

Dygjuhësia si dukuri është e pranishme gjithandej nëpër botë dhe pothuajse nuk ka entitet shoqëror apo shtetëror që është krejtësisht njëgjuhësh. Pothuajse në çdo vend, dukuria e bilinguizmit i ka tiparet dhe karakteristikat e veta specifike. Kjo dukuri, e cila shfaqet si rezultat i kontakteve gjuhësore, është shumë komplekse dhe variable, e ndërlidhur ngushtë me zhvillimet e përgjithshme shoqërore, politike e kulturore. Ndryshimet e këtyre faktorëve ndikojnë drejtpërdrejt edhe në aspekte të bilinguizmit në kuadër të entiteteve shoqërore digjuhëshe. Duke qenë dukuri aq komplekse, dygjuhësia paraqet një sfidë komplekse për planifikimin e gjuhës, sidomos për planifikimin e statusit dhe të funksioneve të gjuhës, sepse ky planifikim reflekton edhe qasjen dhe nivelin e tolerancës së shoqërisë në raport me gjuhët. Planifikimi gjuhësor shpërfaq synimin e bashkësisë shoqë-

rore për të stimuluar dominimin gjuhësor, ose e kundërta, synimin për të promovuar barazinë gjuhësore.

Në kuadër të shembujve të ndryshëm të planifikimit gjuhësor të dygjuhësisë, të cilët mund të gjenden gjithandej nëpër botë, rasti i dygjuhësisë shqip-serbisht në Kosovë paraqet një shembull mjaft me interes për t'u studiuar. Dygjuhësia shqip-serbisht në Kosovë shfaqet si dukuri e bilinguizmit asimetrik dhe si rrjedhojë e kontaktit dhe konfliktit gjuhësor (Munishi, 2010). Në të kaluarën, sidomos nga viti 1945 e tëhu, ky bilinguizëm ka qenë subjekt i ndërhyrjes planifikuese, e cila ka pasur për qëllim, në radhë të parë, përcaktimin e statusit të shqipes dhe të serbishtes, por edhe planifikimin e funksioneve të tyre, sidomos në rrafshin zyrtar dhe administrativ. Problemet dhe tiparet e këtij planifikimi gjatë periudhës 1945-1990 janë trajtuar në mënyrë më të thelluar nga Gazmend Zajmi dhe, sidomos, Rexhep Ismajli. Sa i përket planifikimit të statusit të shqipes dhe serbishtes në Kosovë gjatë viteve 1945-1990, mund të thuhet se përkundër avancimit gradual të pozitës së shqipes pas vitit 1945, sidomos pas vitit 1974, kur u përcaktua statusi i barabartë për shqipen dhe serbishten në Kosovë, megjithatë serbishtja ishte në pozitë më të favorshme për faktin se në kontekstin e përgjithshëm të ish-Jugosllavisë, si gjuhë e shumicës (bashkë me kroatishten dhe bosanishten përbënin të ashtuquajturën serbo-kroatishte apo kroato-serbishte), shërbente edhe si lingua franca e federatës së atëhershme jugosllave. Për të përcaktuar statusin e shqipes në raport me serbishten Ismajli kishte përdorur tipologjinë e Heinz Kloss-it, me ç'rast kishte konstatuar me të drejtë se shqipja kishte statusin e gjuhës zyrtare bashkë me një gjuhë tjetër (Ismajli, 1991). Vlen të përmendet fakti se shqiptarët dhe serbët në Kosovë në atë kohë, ndonëse ishin bashkësi folëse të ndryshme, përbënin një bashkësi komunikuese, sepse kishin ndërveprim dhe ndërkomunikim të përditshëm me njëri tjetrin, me ç'rast komunikimi zhvillohej kryesisht në kodin dominant që ishte serbishtja. Pas vitit 1990 gjuha shqipe, praktikisht, u bë gjuhë e ndaluar dhe përdorimi i saj u kufizua vetëm në domenet e familjes, në rrethin shoqëror që përbëhej kryesisht prej shqiptarëve, në punët me të cilat merreshin shqiptarët nën okupimin serb e në ato pak media që kishin mbetur në gjuhën shqipe. Në një situatë të tillë, statusi i shqipes u degrada deri në pikën më të ulët (Munishi, 2006).

Pas përfundimit të luftës në Kosovë e largimit të pushtetit serb (1999) u krijuan rrethana të reja politike, ekonomike e kulturore, të cilat patën ndikim të drejtpërdrejtë në procesin e zhvillimit të bilinguizmit shqip-

serbisht. Evoluimi i statusit të shqipjes dhe të serbishtes në Kosovë pas vendosjes së Misionit të OKB-së është trajtuar nga Ismajli (Ismajli, 2002, 2003) e Munishi (2006, 2009, 2010). Kohë më parë, në dy raste jemi për-pjekur të trajtojmë statusin e shqipjes në kontekstin rajonal dhe europian (Munishi, 2009) dhe, konkretisht, statusin e shqipjes në Kosovë (2010). Sa i përket planifikimit të statusit të gjuhëve në Kosovë pas shpalljes së pavarësisë kemi theksuar se ky planifikim është bërë në përputhje me politikat gjuhësore të BE-së, të cilat e promovojnë diversitetin gjuhësor si vlerë, dhe në përputhje me normat aktuale ndërkombëtare të përshkruara në *Kartën Evropiane për Gjuhët Regjionale ose të Minoriteteve*¹, si dhe në dokumente të tjera ndërkombëtare, siç është *Deklarata Universale Mbi të Drejtat Gjuhësore e Barcelonës*, e miratuar në qershor 1996, nga institucionet dhe organizatat joqeveritare nën mbështetjen e UNESCO-s (Munishi, 2009 dhe 2010). Në Kushtetutën e Kosovës², e cila bazohet në rekomandimet e të Dërguarit Special të Kombeve të Bashkuara, Martti Ahtisaari dhe Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, si gjuhë zyrtare përcaktohen shqipja e serbishtja (neni 5, pika 1), ndërsa gjuha turke, boshnjake dhe ome kanë statusin e gjuhëve zyrtare në nivel komune ose do të jenë në përdorim zyrtar në cilindo nivel në pajtim me ligj (neni 5, pika 2). Megjithatë, përkundër përcaktimit të statusit zyrtar për shqipen dhe serbishten, ka probleme të shumta dhe vështirë të kalueshme për zbatimin e dygjuhësisë shqip-serbisht në Kosovë. Në një raport të hartuar nga Misioni i OSBE-së në Kosovë³ janë identifikuar disa probleme ligjore, buxhetore e teknike sa i përket zbatimit të dygjuhësisë në komunat e Kosovës (Munishi, 2009). Problemet e tjera janë të natyrës politike, demografike e kulturore.

Përfundimi i luftës në Kosovë pati ndikim edhe në fushën e gjuhëve. Duke qenë se shqiptarët përbëjnë më shumë se 90% të popullsisë së Kosovës, ata e kanë fjalën kryesore në institucionet e Kosovës dhe duke qenë shumicë kanë mundësi ta favorizojnë gjuhën e tyre (Munishi, 2009). Pra, **kriteri demografik**, luan rol kryesor në raportet

¹ Shih në Internet: <http://conventions.coe.int/treaty/en/Treaties/Html/148.htm>, qasja për herë të fundit më 8 nëntor 2011.

² Shih: http://www.assembly-kosova.org/common/docs/Kushtetuta_sh.pdf, qasja për herë të fundit më 8 nëntor 2011.

³ “Raportin për përdorimin e gjuhëve minoritare në komunat e Kosovës”, shih në Internet: http://www.osce.org/documents/mik/2006/12/22607_en.pdf, qasja për herë të fundit më 23 mars 2009.

midis shqipes dhe serbishtes në Kosovë. Në anën tjetër, si pasojë e luftës, marrëdhëniet midis shqiptarëve dhe serbëve janë ftohur në masë të madhe dhe kjo ka çuar pothuaj në ndarjen fizike të tyre. Sot, serbët jetojnë kryesisht në disa qytete e fshatra të Kosovës në bashkësi kompakte, të cilat kryesisht janë të ndara jo vetëm nga popullsia shqiptare, por edhe nga bashkësitë e tjera etnike që jetojnë në Kosovë. Me fjalë të tjera, **domenet e kontakteve** midis shqipes dhe serbishtes janë kufizuar ndjeshëm. Kontaktet e përditshme, sidomos ato joformale, midis shqiptarëve dhe serbëve janë reduktuar në masë të madhe dhe kjo është reflektuar edhe në komunikimin gjuhësor reciprok. Nëse dikur shqiptarët dhe serbët në Kosovë përbënin bashkësi komunikuese, sot shqiptarët dhe serbët janë bashkësi pothuajse të ndara gjuhësore. **Ndërkomunikimi** i reduktuar gjithashtu ka ndikim të drejtpërdrejtë zbatimin e bilinguizmit shqip-serbisht në Kosovë. Institucionet e Kosovës janë duke bërë përpjekje që t'i integrojnë pakicat në Kosovë dhe mund të ndodhë që kjo situatë të ndryshojë në një të ardhme të afërt. Megjithatë, ndarja fizike ka bërë që brezat e rinj të mos jenë në gjendje ta mësojnë gjuhën e njëri-tjetrit. **Njohja e gjuhës** paraqet problem fundamental për zbatimin e bilinguizmit shqip-serbisht. Derisa shqiptarët më nuk janë të detyruar ta mësojnë serbishten, pasi që prestigji që ajo kishte dikur është zhdukur, serbët ende kanë paragjykime negative ndaj gjuhës shqipe dhe ende nuk janë në gjendje ta pranojnë faktin se pas luftës në Kosovë rrethanat dhe raportet politike e shoqërore kanë ndryshuar. Edhe pse për shkak të epërsisë që kishte dikur serbishtja shqiptarët e Kosovës, brezat e mesëm dhe të vjetër, në masë të madhe ishin bilingë, sot ata hezitojnë të flasin serbisht në rastet kur duhet të komunikojnë me serbët. Në anën tjetër, edhe brezat e mesëm dhe të vjetër të serbëve, duke jetuar në fqinjësi me shqiptarët, e kuptojnë dhe e flasin shqipen, por hezitojnë ta flasin kur komunikojnë me shqiptarët, mbase për shkak të sedrës. **Qëndrimet reciproke ndaj gjuhës** serbe, respektivisht shqipe, janë gjithashtu një element i rëndësishëm që ndikon në bilinguizmin shqip - serbisht. Një tjetër zhvillim ka të bëjë me mësimin e gjuhëve dhe dy gjuhët zyrtare të Kosovës më nuk mësohen as në sistemin arsimor. Nxënësit shqiptarë në shkollat e tyre e mësojnë anglishten jo më serbishten, ndërsa nxënësit serbë nuk e mësojnë shqipen.

Të gjitha këto rrethana kanë ndikuar që ndonëse në Kosovë kemi dygjuhësi zyrtare të deklaruar dhe të vendosur në kushtetutë, megjithatë, në realitet, dygjuhësia është e reduktuar vetëm në funksione e domene formale, por edhe në këto funksione epërsia e shqipes për shkak të kriterit demografik

është domethënëse. Këto janë vetëm disa nga problemet më evidente të bilinguizmit zyrtar shqip-serbisht.

Në vazhdim do të përpiqemi t'i trajtojmë disa nga problemet e cekura më lart dhe ndikimin e tyre në zbatimin e dygjuhësisë në Kosovë.

2. Faktorët kryesorë që ndikojnë në vështirësitë në zbatimin e bilinguizmit shqip-serbisht në Kosovë

Siç u tha pak më parë, në dy punime të kaluara (2009, 2010) kemi folur për problemet e zbatimit të dygjuhësisë në Kosovë dhe kemi theksuar se përveç problemeve të natyrës ligjore, buxhetore e teknike, problemet kryesore kanë të bëjnë me aspektin demografik, nxënien e gjuhës, dendurinë e komunikimit, domenet e dygjuhësisë dhe qëndrimet ndaj gjuhëve respektive. Duke dashur të shtjellojmë më tej dhe të argumentojmë ndikimin e këtyre faktorëve në vështirësitë e zbatimit të bilinguizmit shqip-serbisht, kemi kryer një hulumtim të kufizuar të opinionit publik në Kosovë gjetjet dhe rezultatet e të cilit po i japim këtu.

2.1 Qëllimi dhe metodologjia e hulumtimit

Qëllimi i hulumtimit ka qenë të verifikojmë se sa e flasin aktualisht folësit e shqipes gjuhen serbe, sidomos duke pasur parasysh faktin që serbishtja më nuk është gjuhë që mësohet në sistemin arsimor në Kosovë. Pra, qëllimi ka qenë të merret një vlerësim i përafërt lidhur me nivelin e nxënies së gjuhës serbe nga qytetarët shqiptarë. Gjithashtu, kemi dashur të shohim se sa e shpeshte është denduria e komunikimit të folësve të shqipes me folës të serbishtes. Më tej, përmes kësaj ankete jemi përpjekur të kuptojmë se a kanë kontakte folësit e shqipes me folës të serbishtes në domene të tilla siç është lagja në të cilën banojnë dhe vendi ku studiojnë apo punojnë. Qëllimi tjetër ka qenë që të kuptojmë se në rastet kur ndodh, apo nëse do të kishte komunikim midis folësve të shqipes dhe serbishtes, cilin kod preferojnë ta përdorin folësit e shqipes. Në fund, jemi përpjekur të kuptojmë se cili është qëndrimi i folësve të shqipes ndaj serbishtes si gjuhë dhe sa kanë dëshirë ta flasin, apo ta mësojnë serbishten folësit burimorë të shqipes.

Hulumtimi është kryer nga data 15 tetor deri më 3 nëntor 2011, ndërkaq sa i përket metodologjisë së anketimit, kemi përdorur kryesisht mostra të rastit, por deri diku grupi i të anketuarve ka qenë grup i synuar. Kjo për faktin se të anketuarit kanë qenë kryesisht popullsi aktive, në kuptim të

angazhimit të tyre në studime dhe në vende pune. Pra, të anketuarit kanë qenë kryesisht studentë, të punësuar në institucione të Kosovës dhe të punësuar në organizata ndërkombëtare. Kështu, janë anketuar gjithsej 154 persona, prej të cilëve 79 të anketuar kanë qenë meshkuj dhe 75 femra. Mosha e të anketuarve ka qenë prej 18 deri në 55 vjeç. Grupet e synuara kanë qenë studentët e Fakultetit të Filologjisë të Universitetit të Prishtinës, studentë të Kolegjit Universitar AAB-Riinvest, nëpunës dhe menaxherë të Ministrisë së Financave dhe punonjës në organizata ndërkombëtare, siç janë EULEX-i dhe OSBE-ja. Grupi i të anketuarve në Kolegjin Universitar AAB-Riinvest ka paraqitur grup mjaft interesant, për faktin që në mesin e tyre kanë qenë kryesisht studentë pa shkëputje nga puna, të cilët studiojnë në Departamentin e Gjuhës Angleze, por që njëkohësisht janë të punësuar në organizata vendore e ndërkombëtare.

Hulumtimet janë bërë me qytetarë nga shumë vise të Kosovës. Ka pasur të anketuar nga qytetet si: Prishtina, Gjilani, Kamenica, Prizreni, Peja, Mitrovica, Vushtrria, Ferizaj, Kaçaniku, Shtimja, Gjakova, Rahoveci etj. Gjithashtu, në këtë hulumtim të opinionit publik, nga kampionët kemi marrë informata për gjininë, moshën, shkollimin, profesionin, prejardhjen regjionale dhe vendbanimin. Respondetëve ua kemi bërë të qartë që anketimi bëhet për qëllime studimore të karakterit sociolinguistik dhe që informatat e marra prej tyre do të përdoren vetëm në kuadër të këtij studimi dhe do të mbeten e drejtë e autorit të studimit. Natyrisht, respondentëve u është lënë mundësia që të mbeten anonimë, pa e dhënë emrin e tyre, por duke u mjaftuar me të dhënat për gjininë, moshën, arsimimin dhe prejardhjen regjionale. Me fjalë të tjera, jemi përpjekur që gjatë anketimit t'i respektojmë kriteret etike të punës në terren.

Gjatë punës sonë në hartimin e pyetjeve kemi përdorur kryesisht pyetjet me përgjigje të mbyllura, ndërkaq pyetësorët kanë qenë të përgatitur me shkrim dhe u janë dhënë respondentëve për t'u përgjigjur me shkrim. Por, gjatë kohës që respondentët e kanë plotësuar pyetësorin, në disa raste të caktuara, në kuadër të ndërkomunikimit me ta lidhur me pyetjet, u kemi dhënë edhe shpjegime të caktuara lidhur me ndonjë paqartësi. Gjithashtu, të anketuarve u është lënë mundësia që në fund të anketës të bëjnë komente me shkrim. Hulumtimi nuk ka pasur për qëllim të bëjë matje të caktuara, por qëllimi ka qenë orientues. Qëllimi ka qenë që të pasqyrohen pikëpamjet e një grupi të qytetarëve të Kosovës, të cilët kanë dhënë mendimet e tyre për disa aspekte të dygjuhësisë shqip-serbisht.

Krejt në fund, të shtojmë se ky hulumtim sigurisht që do të kishte qenë më komplet sikur të ishin anketuar dhe qytetarë serbë të Kosovës, folës burimorë të serbishtes. Në pamundësi për t'i anketuar ata, hulumtimi mund të ketë mangësi të caktuara, sidomos sa i përket krahasimit të pikëpamjeve. Megjithatë, duke u nisur nga faktori demografik në Kosovë, ku shqiptarët përbëjnë 90% të popullsisë, dhe nga fakti se shqiptarët e dominojnë jetën shoqërore e institucionale, mendojmë se pikëpamjet e tyre hedhin dritë të mjaftueshme mbi problemet e zbatimit të dygjuhësisë në Kosovë.

2.2 Rezultatet dhe gjetjet

Me qëllim që të merren informatat e kërkuara të anketuarve u janë bërë 6 pyetje. Pyetja e parë kishte të bënte me nivelin e nxënies së gjuhës serbe. Në pyetjen *A e flitni gjuhën serbe?, nga 154 të anketuar* 18 nga ta ose 11.68% janë përgjigjur se **e flasin shumë mirë**, 30 apo 19.48% janë përgjigjur se **e flasin mirë**, 37 apo 24.02% janë deklaruar se **nuk e flasin mirë** dhe 69 të anketuar apo 44.80% janë përgjigjur se **nuk e flasin fare**. Nga këto të dhëna vërehet qartë se numri më i madh i të anketuarve, gati 70 %, janë deklaruar se ose e flasin pak ose aspak gjuhën serbe. Sidomos, mosnjohja e gjuhës serbe ishte e pranishme te studentët e rinj, pra te brezat që kanë lindur pas vitit 1990, që kur serbishtja më nuk është mësuar në shkollat shqipe në Kosovë. Të anketuarit të cilët janë deklaruar se e njohin serbishte kanë qenë kryesisht qytetarë të moshave më të vjetra, pra mbi 30 vjet e tutje.




Tabela 1

Këto të dhëna dëshmojnë se problemin themelor për zbatimin e dygjuhësisë në Kosovë e paraqet mosnjohja e gjuhës serbe nga folësit e shqipes në Kosovë, sidomos te moshat e reja, të cilat janë aktive dhe të cilat janë duke hyrë në tregun e punës.

Pyetja e dytë që u ishte bërë të anketuarve kishte të bënte me dendurinë aktuale të komunikimit dhe të përdorimit eventual të gjuhës serbe. Në pyetjen *Sa shpesh ju bie të komunikoni në gjuhën serbe?*, nga numri i përgjithshëm i të anketuarve 9 të anketuar apo 5.84% janë përgjigjur se **komunikojnë pothuajse çdo ditë**, 7 apo 4.54% janë përgjigjur se **komunikojnë shpesh**, 37 apo 24.02% janë përgjigjur se **komunikojnë nganjëherë**, po ashtu 37 apo 24.02% janë përgjigjur se **komunikojnë rrallë** dhe 64 apo 41.55% janë përgjigjur se **nuk komunikojnë kurrë**. Nga këto të dhëna vërehet qartë se numri i atyre që kanë komunikim të përditshëm apo të shpeshtë në gjuhën serbe është shumë i vogël. Në mesin e tyre janë kryesisht personat që punojnë në organizata ndërkombëtare, si OSBE-ja dhe EULEX-i, ku kanë bashkëpunëtorë e kolegë pune të nacionalitetit serb, punonjës në Ministrinë e Financave në Departamentin e Buxhetit Komunal, që kanë kontakt me përfaqësues të komunave të Kosovës me shumicë serbe, si dhe qytetarë të Rahovecit, të cilët deklarojnë se serbishtja është gjuhë që përdoret ende në komunën e tyre. Ndërkaq, përsëri, shumica e të anketuarve janë deklaruar që ose u bie të komunikojnë rrallë në gjuhën serbe, ose kurrë. Kjo dëshmon që denduria e komunikimit të folësve të shqipes me folës të serbishtes është e rrallë dhe jodomethënëse, që paraqet edhe një vështirësi për dygjuhësinë shqip-serbisht në Kosovë.



Tabela 2

Një element i rëndësishëm për bilinguizmin është edhe stabiliteti i kontaktit në domene të ndryshme. Domenet e kontaktit, siç i përshkruan Joshua Fishman (1971), mund të jenë familja, rrethi ose fqinjësia, shkolla, vendi i punës, administrata, institucionet e kultit etj. Në të kaluarën, bilinguizmi shqip-serbisht ka qenë i pranishëm pothuajse në të gjitha domenet që i përshkruan Fishmani. Kontaktet midis folësve të shqipes dhe serbishtes kanë mundur të ndodhin në lagje, në shkollë a në fakultet, në vendin e punës e kudo tjetër. Kjo për faktin që, siç u tha më lart, folësit e shqipes dhe të serbishtes para vitit 1990 kanë përbërë një bashkësi komunikuese. Megjithatë, ndryshimet demografike dhe lëvizjet e popullsisë që kanë ndodhur, si dhe pasojat e luftës, kanë ndikuar që shumica e domeneve të kontaktit midis folësve të shqipes dhe të serbishtes të shuhen.

Për këtë arsye, pyetja tjetër që u kemi parashtruar të anketuarve ka pasur të bëjë me kontaktet eventuale midis folësve të shqipes dhe të serbishtes në lagje dhe në vendin e punës apo të studimeve. Kështu në pyetjen Në lagjen në të cilën jetoni a keni kontakt me folës të serbishtes?, vetëm 3 persona apo 1.94% janë përgjigjur që kanë kontakt të përditshëm, 18 apo 11.68% janë deklaruar se kanë kontakt nganjëherë, 34 apo 22.07% janë shprehur se shumë rrallë kanë kontakt me folës të serbishtes, 62 apo 40.25% kanë deklaruar se pothuajse asnjëherë nuk kanë kontakt, ndërkaq 37 apo 24.02% janë shprehur se në të kaluarën kanë pasur kontakte me folës të serbishtes, por që nuk kanë më kontakt në lagjet e tyre.



Tabela 3

Këto të dhëna dëshmojnë se kontakti midis folësve të shqipes dhe të serbishtes në një domen të tillë, siç është lagja apo fqinjësia,

është shumë i rrallë. Sigurisht, migrimet e popullsisë, fillimisht i popullsisë shqiptare gjatë viteve 1990-2000, dhe pastaj i popullsisë serbe pas vitit 2000, ka ndikuar drejtpërdrejt që struktura etnike e popullsisë në zonat urbane, por edhe ato rurale, të ndryshojë. Për këtë arsye, është e qartë që lagja apo fqinjësia mund të konsiderohet si domen i rrallë i kontaktit midis folësve të shqipes dhe të serbishtes.

Të njëjtat rezultate pak a shumë dalin edhe sa i përket kontaktit në domene të tilla si institucioni arsimor ose vendi i punës. Në pyetjen Në vendin e punës në të cilin punoni, apo në vendin ku studioni, a keni kontakt me folës të serbishtes?, 13 të anketuar apo 8.84% janë deklaruar se kanë kontakt të përditshëm. Këtu hyjnë kryesisht personat të cilët janë deklaruar se punojnë në EULEX dhe OSBE dhe në institucione qeveritare që kanë kontakt të përditshëm me përfaqësues të komunave me shumicë serbe të Kosovës. 20 të anketuar apo 12.98% janë deklaruar se kanë kontakt nganjëherë, 25 ose 16.23% janë deklaruar se shumë rrallë kanë kontakt, 82 ose 53.24% kanë theksuar se nuk kanë kontakt pothuajse asnjëherë dhe 14 persona ose 9.09% janë deklaruar se kanë pasur kontakte përpara, por jo më. Nga këto të dhëna del qartë se edhe domenet e tilla si institucionet arsimore e vendi i punës më nuk mund të konsiderohen si domene të zakonshme e të qëndrueshme të kontaktit midis folësve të shqipes dhe të serbishtes.

Duke pasur parasysh faktin që pikërisht domenet kryesore si lagja dhe fqinjësia dhe institucionet arsimore dhe vendi i punës nuk mund të konsiderohen më si vatra të dygjuhësisë, është e qartë se dygjuhësia shqip-serbisht në Kosovë është reduktuar ndjeshëm, për të mos thënë është shuar fare. Mungesa e kontakti në domenet më të zakonshme ndikon drejtpërdrejt në rrjedhat dhe në reduktimin e dygjuhësisë.




Tabela 4

Dy pyetjet e fundit të anketës sonë kishin të bënin me qëndrimet e folësve të shqipes lidhur me komunikimin me folës të serbishtes dhe qëndrimet ndaj gjuhës serbe në përgjithësi. Në pyetjen hipotetike *Nëse do të takoheshit me ndonjë person që e ka gjuhë amtare serbishten, me çfarë gjuhe do të komunikonit me të?*, kemi marrë këto përgjigje: 22 të anketuar ose 14.28% janë përgjigjur se **do të komunikonin në gjuhën serbe**, 67 ose 43.50% janë shprehur qartazi se **do të komunikonin në gjuhën shqipe dhe se presin që edhe bashkëbiseduesi të flasë shqip**, 53 ose 34.41% kanë thënë se **do të komunikonin në gjuhë angleze ose ndonjë gjuhë tjetër**, pra me një *lingua franca*, ndërkaq 12 ose 7.79% janë shprehur kundër komunikimit duke u deklaruar se **nuk do të komunikonin fare**. Nga përgjigjet e mësipërme vërehet qartë se shumica dërmuese janë shprehur se nuk do të komunikonin në gjuhën serbe, gjë që tregon se serbishtja e ka humbur dominimin e dikurshëm, të cilin e ka pasur në rastet e komunikimit midis folësve shqiptarë dhe serbe. Kjo humbje e dominimit është sigurisht rezultat i pasojave të luftës, i ndryshimit të rrethanave politike e kulturore dhe i rritjes së prestigjit të shqipes.

Nëse do të takoheshit me ndonjë person që e ka gjuhë amtare serbishten, me çfarë gjuhe do të komunikonit me të?




Tabela 5

Së fundi, në pyetjen konkrete *Çfarë mendimi keni për gjuhën serbe?*, vetëm 7 të anketuar ose 4.54% kanë deklaruar se **u pëlqen**

shumë dhe se kanë dëshirë ta flasin, 16 ose 10.38% janë shprehur se u pëlqen serbishtja, por që nuk dinë ta flasin dhe që do të donin ta mësonin, ndërkaq shumica më e madhe, 95 të anketuar ose 61.68%, janë deklaruar indiferent duke theksuar se **nuk kanë ndonjë mendim për serbishten**. Një pjesë e të anketuarve, 21 të anketuar ose 13.63%, janë shprehur se **nuk u pëlqen gjuha serbe**, ndërkaq 15 të anketuar ose 9.74% kanë pasur qëndrim krejt negativ ndaj serbishtes duke u shprehur se **nuk u pëlqen aspak dhe se nuk do të donin ta mësonin kurrë**. Edhe këto qëndrime të shprehura për gjuhën serbe, qoftë qëndrimet indiferente, qoftë negative, ndaj serbishtes, dëshmojnë se mendimet e shqipfolësve ndaj serbishtes kanë ndryshuar si pasojë e luftës, por edhe e ndryshimit të rrethanave politike.




Tabela 6

Duke përmbledhur rezultatet që u diskutuan këtu, mund të konstatohet se niveli i atyre që e flasin gjuhën serbe ka rënë ndjeshëm, sidomos te brezat e rinj. Brezat që po vijnë, sidomos ata të lindur pas vitit 1999, do ta njohin edhe më pak këtë gjuhë. Edhe denduria e kontaktit dhe komunikimit ka rënë ndjeshëm, pothuajse në të gjitha vatrat e kontaktit. Më tej, shqiptarët më nuk janë të detyruar që nën trysninë e pushtetit të huaj ta përdorin gjuhën serbe në komunikim me serbët. Të dhënat e anketimit tregojnë që ata nuk do t'i ikin komunikimit me serbë, por në rastet e tilla janë të prirë ta përdorin ose gjuhën e tyre, ose anglishten si *lingua franca*. Edhe motivi për ta mësuar gjuhën serbe ka rënë plotësisht. Ndonëse paragjykimet krejtësisht

negative për gjuhën serbe nuk janë aq të theksuara, nxitja për ta mësuar atë nuk ekziston më.

Një problem tjetër që është identifikuar gjatë anketimit është edhe mungesa e përkthyesve. Disa të anketuar që punojnë në institucionet qeveritare të Kosovës (Ministria e Financave) kanë deklaruar se mungesa e përkthyesve është shumë e theksuar. Kjo, sigurisht, shkakton probleme në zbatimin e dygjuhësisë edhe në rrafshin institucional zyrtar, që mbase mbetet domeni i vetëm i kontaktit më të shpeshtë midis folësve të shqipes dhe të serbishtes.

Në fund, të përmendim edhe një element tjetër që ka ndikim në rrjedhat e dygjuhësisë shqip-serbisht. Ky element ka të bëjë me ndryshimin e kahut të kontaktit dhe të komunikimit të folësve të shqipes në Kosovë. Nëse në të kaluarën shqiptarët e Kosovës duke qenë pjesë e ish-Jugosllavisë, jo me dëshirën e tyre, kishim më tepër komunikim me folës të gjuhëve sllavo-jugore, sot situata ka ndryshuar krejtësisht. Kahu i kontaktit dhe i komunikimit është kthyer drejt Shqipërisë. Integrimi shqiptar po ecën me hapa të përsheptuar. Raportet politike, infrastruktura e përmirësuar, teknologjia informative dhe mediat janë duke pasur ndikim të fuqishëm në afrimin dhe në komunikimin ndërrshqiptar. Kjo po ndikon që shqiptarët e Kosovës të mos kenë shumë nevojë për kontakt me Serbinë, gjë që ndikon në uljen e komunikimit.

Përfundime

Politika gjuhësore që ka ndjekur shoqëria dhe institucionet e Kosovës është sigurisht politikë progresive, që shkon përtej standardeve më të larta të Bashkimit Europian dhe standardeve të tjera të përshkruara në dokumentet e ndryshme ndërkombëtare, të cilat rregullojnë çështjet e politikave dhe të planifikim gjuhësor. Një politikë e tillë është sanksionuar edhe në planifikimin e statusit të gjuhëve në Kosovë, ku gjuhës serbe, e cila ka më pak se 10% folës burimorë në Kosovë, i është dhënë statusi i gjuhës zyrtare.

Megjithatë, zbatimi i kësaj politike gjuhësore është në shpërputhje me realitetin në terren dhe i ka vështirësitë e veta reale. Këto vështirësi kanë të bëjnë me rënin e nxënies së gjuhës serbe dhe me reduktimin e dendurisë së komunikimit dhe të domeneve të kontaktit.

Po ashtu, problem tjetër paraqet edhe mungesa e stimulimit të shqiptarët, që përbëjnë shumicën e banorëve të Kosovës, për ta nxënë dhe për ta përdorur gjuhën serbe.

Në anën tjetër, mund të supozojmë se probleme pak a shumë të ngjashme ka edhe te serbët. Humbja e privilegjeve të kaluara, sedra e prekur dhe paragjykimet negative ndikojnë që edhe ata të mos e mësojnë dhe të mos e përdorin shqipen. Megjithatë, duket që rrethanat e reja politike dhe ekzistenciale në Kosovë do të kenë ndikim të fuqishëm që tek ata që të fillojnë ta mësojnë dhe ta përdorin gjuhën shqipe. Si rrjedhojë e kësaj, zhvillimi më i pritshëm është që bilinguizmi asimetric që ka ekzistuar dikur në Kosovë, do të ndërrojë kahun. Serbët do të jenë të detyruar ta mësojnë shumë më tepër shqipen, ndërkaq shqiptarët do të jenë në situatë që sa më pak ta njohin dhe ta përdorin serbishten. Kriteri demografik do të jetë vendimtar në përcaktimin e drejtimit të zhvillimit të dygjuhësisë. Prandaj, mendojmë që do të ishte me interes që shoqëria dhe institucionet e Kosovës të gjejnë mënyra për ta nxitur dhe për ta stimuluar mësimin e gjuhës shqipes te serbët.

Në fund, të shtojmë se fqinjësia dhe komunikimi i paevitueshëm ekonomik me botën sllave do të jenë gjithnjë një motiv për shqiptarët për ta mësuar serbishten, por një gjë e tillë do të bëhet në bazë të vullnetit të mirë e jo në bazë të detyrimit. Edhe përparimi dhe risitë në fushën e teknologjisë së informacionit do të mund të kenë ndikim pozitiv në komunikim. Softuerët e përkthimit si Google Translation, dita-ditës po përmirësohen dhe po bëjnë të mundur përkthim sa më të saktë në të gjitha gjuhët e botës, rrjedhimisht edhe në shqipe dhe serbishte. Përkundër faktit që faktori njeri mbetet vendimtar, avancimi i teknologjisë megjithatë do ta lehtësojë në një masë komunikimin.

Në përmbyllje, të theksojmë se përmirësimi eventual i raporteve politike midis shqiptarëve dhe serbëve do të ketë ndikim në relaksim të kontakteve dhe të ndërkomunikimit, dhe mbase do të jetë nxitje për njohjen reciproke të gjuhëve. Heqja e paragjykimeve ndaj gjuhës është sigurisht pikënisja e parë në këtë drejtim.

Literatura:

- Fishman, Joshua (1971). Raporti në mes mikrosociolinguistikës dhe makrosociolinguistikës në studimin kush flet cilën gjuhë me kënd dhe kur, në: Sociolinguistics, Edited by J.B. Pride and J. Holmes, Penguin Books, First Published 1972; shih edhe te Vesel Nuhju, Ndikimet ndër-gjuhësore, Rilindja, Prishtinë, 1990, f. 181-209.
- Freudenstein, Reinhold (1999). Bilingualism, language policy, and the European Union, Content made available by Georgetown University Press, Digital Georgetown, and the Department of Languages and Linguistics, në Internet: http://digital.georgetown.edu/gurt/1999/gurt_1999_26.pdf, qasja për hetë të fundit më 19 mars 2009.
- Friedman, Victor A. (2007). Language Politics and Language Policies in the Contemporary Western Balkans: Infinitives, Turkisms and EUrolinguistics, EES Noon Discussion on April 18, 2007. The following is a summary of his presentation. Meeting Report 337, në Internet: www.wilsoncenter.org/topics/pubs/MR337Friedman.doc, qasja për herë të fundit 20 mars 2009.
- Gal, Susan (2006) Migration, Minorities and Multilingualism: Language Ideologies in Europe, Language Ideologies, Policies and Practices, Edited, by Clair Mar-Molinero and Patrick Stevenson, First Published by Palgrave Macmillian, Houndmills, Basingstoke,
- Ismajli, Rexhep (1989). Albanski jezik u Jugosllaviji, Zbornik - Kosovo - Srbija - Jugoslavija, Ljubljana, Maj.
- Ismajli, Rexhep (1991), Gjuhë dhe etni, Rilindja, Prishtinë.
- Ismajli, Rexhep (1998). "Në gjuhë" dhe "për gjuhë", Dukagjini, Pejë.
- Ismajli, Rexhep (2003). Standarde dhe identitete, Dukagjini, Pejë.
- Kostallari Androkli (1984). Gjuha letrare kombëtare shqipe dhe epoka jonë, Gjuha letrare kombëtare shqipe dhe epoka jonë (Materiale të Konferencës shkencore të mbajtur në Tiranë më 7-8 dhjetor 1984), Tiranë 1988
- Kushtetuta e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Rilindja, Prishtinë, 1974.
- Kushtetuta e Republikës së Kosovës (2005), Akte të Kuvendit të Republikës së Kosovës, ASHAK, Prishtinë.
- Mackey, William F. (1989). Determining the Status and Function of Languages in Multinational Societies, Status and Function of Languages and Language Varieties, Walter de Gruyter, Berlin – New York.
- Munishi, Shkumbin (2006). Gjuha standarde shqipe në Kosovë dhe drejtimet e zhvillimit të saj, disertacion i doktoratës, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë.
- Munishi, Shkumbin (2009). Barazia e gjuhëve në Kosovë dhe perspektiva evropiane, 1 Uluslararası Balkanlarda Tarih ve Kültür Kongresi, Bildirler Kitabı, (Kongresi I Ndërkombëtar Ballkanik), 10-16 Mayıs, 2009, Kosova, Prishtinë. (shih edhe në Internet: <http://www.linguasocio.blogspot.com/>)
- Munishi, Shkumbin (2010). Planifikimi i statusit të gjuhëve në Kosovë, Pozita e sotme e gjuhës shqipe në Mal të Zi në krahasim me atë në përgjithësi (sesion shkencor i organizuar më 19.12.2010 në Ulqin – Mali i Zi), Art Club, Ulqin, Mali i Zi, 2010. (shih edhe në Internet: <http://www.linguasocio.blogspot.com/>)
- Munishi, Shkumbin (2010). Konfliktet dhe kontaktet gjuhësore, Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare 29, Prishtinë, 2010: shih edhe në Internet: <http://www.linguasocio.blogspot.com/>)
- Thomason, Sara G. (2001). Language Contact – an introduction, Georgetown University Press.

Haxhi SHABANI, Ulqin

NDIKIMI I GJUHËS MALAZEZE NË EMRAT DHE MBIEMRAT E NJERËZVE

Abstrakt

Në këtë kumtesë trajtohet prirja e përdorimit të disa varianteve të emrave dhe mbiemrave të njerëzve, te shqiptarët në Malin e Zi. Sipas kësaj prirjeje shqipfolësit në Malin e Zi emrat dhe mbiemrat e tyre, një pjesë e konsiderueshme, i përdorin në dy variante, herë-herë edhe në tri. Variantet dalin sipas këtij modeli. Për emrin Gjergj: Gjoko e Gjorgje, për mbiemrin Resulbegu-Resulbegoviq. Kjo dukuri në bazë të vëzhgimeve, të intervistave dhe të anketave bërë në terren del se është më e përhapur në pjesët urbane të shqipfolësve (Ulqin e Tuz), por nuk përjashtohet as në pjesët rurale.

Në kumtesë vihen në dukje dhe arsyet e funksionimit të disa varianteve. Një nga këto është “nevoja” e folësve për fshehjen e identitetit kombëtar, gjuhësor e fetar, duke përdorur emra asnjans.

Subjektet shqiptare të fesë katolike në Malin e Zi, shumica e tyre, kanë në përdorim tre emra. Varësisht nga ata që i thërrasin kanë në shfrytëzim tre emra të ndryshëm. P. sh. subjektin me emrin Pjetër, rrethi familjar e thërret me këtë emër, ai i mjedist ku jeton Pero, kurse serbishtfolësit e quajnë Petar, siç është në të shumtën e rasteve edhe i regjistruar në dokumentet e identifikimit. Apo, sipas të njëjtit model, kemi emrin Gjergj- Gjoko, Gjorgje.

Subjektet shqiptare të fesë islame, zakonisht kanë dy emra në përdorim. I pari është ai që e përdor rrethi familjar i tij dhe ai për vete. P. sh. Ragipi për rrethin familjar dhe nga të afërmit e vet quhet Gipi ose Gipo. Varianti është më përkëdhelësi, kurse i dyti variant përdoret më shumë nga një rreth më i gjerë. Shembujt e tjerë: Emri Shyqyri, në certifikatën e ditëlindjes së këtij personi pothuajse rregullisht është i shkruar Shuqurija. Në mjedisin familjar dhe nga të afërmit, të njohurit, kolegët e miqtë, këtë person e quajnë Çulo. Apo Fuadin-Pati, apo Fulo, Xhaudetin-Xhudo. Ndryshimi i emrit në përdorim nganjëherë, nga ai zyrtar është aq i madh, saqë nuk ka ndonjë lidhje logjike me emrin bazë. Ky lloj transformim i emrit faktikisht në një emër tjetër ka

bazën në ndërdijen e subjekteve shqiptare për të fshehur identitetin kombëtar, gjuhësor e fetar përmes një emri “neutral”. Kush mund ta di me siguri se cilit identitet kombëtar, gjuhësor e fetar i përkasin emrat në përdorim të përditshëm si: Çulo, Pati e Xhudo!

Se ndikimi i gjuhës malazeze është i dukshëm në sistemin emëror të emrave të përveçëm vërehet edhe në faktin se është mjaft e zakonshme emëroro-thirrora e tipit: ku je profesore, ose: o Naile (për emrin e gjinisë mashkullore).

Ka edhe raste kur subjekte të caktuara shqiptare në jetën e përditshme, varësisht nga fakti se kujt u drejtohet përdorin dy mbiemra. P. sh. Resulbegoviq-Resulbegu, Bisha-Bisheviq. Përdorimi e ka bazën në kontekstin gjuhësor e etnik. Nëse personi identifikohet dhe merr pjesë në komunikim me serbishtfolësit, atëherë ai rregullisht përdor variantin me -iq, kurse në komunikim me shqipfolësit varinat pa -iq. Çështja e përdorimit të shumë emrave për të njëjtin njeri është bazuar në vëzhgimin individual, kurse anketa¹ e zhvilluar për këtë problem vërteton kryesisht pohimet e sjella, duke e relativizuar ndonjë nga ata.

Janë anketuar njëzet folës në bazë të ekzemplarit të rastësishëm.

Nga të gjithë të anketuarit të gjithë janë shprehur se emri i tyre ka së paku nga dy variante: varianti i parë është ashtu si e ka të shkruar në dokumentet personale dhe tjetrin në përkëdheli të cilin zakonisht e përdorin familja dhe të afërmit e tjerë. Dhe një nënvariant tjetër që është faktikisht emri i shkurtuar, por me mbaresë të natyrës së gjuhës serbe. Si p.sh. Zamira-Mina, apo Hasene-Sene-Sena. Ka raste edhe kur një person ka tri variante të emrit në përdorim varësisht se kush e thërret. Konkretisht personi që ka emrin Shyqyri, të afërmit e thërrasin Shyqo, joshqiptarët: Shuqo (Çulo), kurse në dokumentet zyrtare e ka të regjistruar Šučurija. Kështu, nga të anketuarit, që mbiemrin e kanë me viq, iq-8 sish në pyetjen se pse s'e kanë hequr mbaresën sllave nga mbiemri, përveç një të reje që ka thënë se është punë që duhet ta zgjidhin prindërit kanë dhënë përgjigjet: kështu më pëlqen, nuk më pengon, s'dua ta heq, më pëlqen, nuk e kanë ndërruar të parët e mi. Këto përgjigje të japin të kuptosh se ata që i mbajnë mbiemrat me viq apo iq jo vetëm që janë të kënaqur me mbiemrat e tyre, joshqiptarë, por në përgjigjet e tyre manifestojnë edhe një ashpërsi mohuese ndaj

¹ Shiko anketën, Të njëjtit njerëz me emra dhe mbiemra të ndryshëm, në sythin Shtojcë, f. 147.

pyetjes për arsyen se pse nuk e kanë ndryshuar mbiemrin. Të tjerët kanë mbiemra shqiptarë, si p.sh: Murati, Katana, Hidri, Lazoja, Shkreli. Por, duhet pohuar se me ndonjë përjashtim emrat nuk janë të shkruar me alfabetin shqip, por me atë latin, kurse ka raste të ralla edhe me cirilicë². Dhe pyetja tjetër e kësaj ankete ka qenë se a u prezentohen me mbiemrin e njëjtë si shqiptarëve e malazezëve, apo me variante mbiemrash, shqiptarëve pa viq, iq, kurse malazezëve me ta. Përgjigjet e anketës janë se u prezentohen njësoj. Por, realiteti dëshmon se ka edhe raste kur i njëjti person që ka prirje për t'u treguar me përkatësi dyshe, zakonisht me mbiemrin zyrtar me viq, ose iq, për opinionin shqiptar të prezentohet pa këtë mbarese, si p. sh. Resubegović-Resulbegu.

Si ilustrim i punës në terren po jap edhe modelin e anketës të cilën e kam përdorur.

² Ombdusmani në Malin e Zi, në këtë drejtim iu është drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme në Malin e Zi, që shqiptarëve t'i u mundësojë përdorimin e gjuhës shqipe në dokumentet e tyre personale.

Anketa: Të njëjtit njerëz me emra e mbiemra të ndryshëm**Gjinia** _____**Mosha** _____**Kombi** _____**Feja** _____**Profesioni** _____**1. Si e ke emrin ?** _____

a) Si të thërret nëna ? _____

b) Si të thërret babai? _____

c) Si të thërret bashkëshorti (ja)? _____

ç) Si të thërret shoqëria _____

d) Si të thërrasin shqiptarët ? _____

dh) Si të thërrasin malazetët? _____

e) Si e ke emrin e regjistruar në letërnjoftim (shkruaje në original)

2. Si e ke mbiemrin _____**3. Nëse e ke me viq apo me iq a u prezantohesh njësoj shqiptarëve dhe malazetëve ?**

a) Shqiptarëve dhe malazetëve njësoj

b) Malazetëve me viq, iq shqiptarëve pa të

c) Tjetër _____

4. Nëse e ke me viq, iq pse nuk e ndyshuar deri tash?

Shkruaj pse ? _____

Martin SUROVČÁK, *Masarykova univerzita, Brno*

MALLKIMI SI ÇËSHTJE E FRAZELOGJISË BALLKANIKE

Abstrakt

Mallkimi paraqet një çështje të veçantë etnolinguistike, e cila mund të trajtohet edhe nga aspekti i frazeologjisë ballkanike, pasi vihen në dukje disa tipare të përbashkëta të gjuhëve ballkanike. Në kumtesë krahasohen shembuj nga shqipja, greqishtja, bullgarishtja, maqedonishtja, serbishtja dhe rumanishtja. Trajtohen faktorët jashtëgjuhësorë si dhe mjetet gramatikore në frazat e mallkimit, ndërsa tema thelbësore është klasifikimi kuptimor i mallkimeve sipas dëmit që kanë për të shkaktuar. Mallkimet i kam ndarë në këto grupe: I. mallkime të përgjithshme, II. tanatoboli (mallkime që shkaktojnë vdekjen), III. mallkime që shkaktojnë pësim pas vdekjes, IV. Mallkime që shkaktojnë sëmundje, V. mallkime që shkaktojnë humbjen e pronës, VI. mallkime që shkaktojnë prapësi, VII. mallkimet që ndikojnë mbi anëtarët e familjes. Në secilin prej grupeve të sipërhënuara gjejmë raste që njëra frazë i përgjigjet tjetrës fjalë me fjalë ose të paktën kanë të njëjtin kuptim.

Antropologjia e përcakton mallkimin (serb., maq., bullg. *клетва*, gr. *κατάρα*, rum. *blestem*) si *thënie bazuar në magji, me shqiptimin e së cilës një objekt (person, shoqëri, kafshë, formim natyror etj.) bëhet i mallkuar – do të ketë fat të keq ose do të shkatërrohet etj.* Ndryshe nga mësyshi pra, thelbi i mallkimit është besim në ndikimin magjik të fjalës. Si motiv i shpeshtë haset nëpër gojëdhëna, përralla si dhe këngë popullore. Mallkimi në konceptim të shkencës letrare çeke i takon letërsisë gojore dhe vihet krahas të ashtuquajturave lloje të shkurtra folklorike si fjalë e urtë, gjëgjëzë e kështu me radhë. Hulumtuesit serbë e karakterizojnë me termin „lloj apelativ”, ndërsa kroatët e përcaktojnë si „formë retorike” si p.sh. përshëndetje. Duhet theksuar se në vendet e Ballkanit u krijua një numër i konsiderueshëm i antologjive të letërsisë popullore dhe disa monografi kushtuar mallkimeve, nga të cilat u mblodh pjesërisht materiali i kësaj kumtese.

Gjuhët ballkanike kanë një fond jashtëzakonisht të pasur mallkimesh, në të cilat pasqyrohet fantazia e popujve ballkanikë. Për shembull, gjuhëtarja bullgare Lilija Krumova-Cetkova ka hulumtuar mbledhje të letërsisë popullore bullgare që nga shek. XIX dhe ka numëruar

në bullgarishten gjithsej rreth 2 500 mallkime, trefish më shumë se numri i urimeve. Ky korpus i madh mund të klasifikohet sipas disa parimeve. Sipas marrësit dallohen mallkimet **individuale** dhe **kolektive**, që u përkasin grupeve të individëve, madje fshatrave të tëra. Sipas dërguesit dallohen mallkimet **profesionale** që përdoren mes përfaqësuesve të një profesioni të caktuar (bullg. Късмет да имаш толкова, колкото вода в рибарска мрежа! *Paç fat sa ka ujë në rrjetë peshkimi!*), **mallkimet e lypësve** (serb. Убило те парче хлеба! *Të vraftë copa e bukës!*) ose **mallkimet e të veve**.

Nga më të rëndat konsiderohen mallkimet e nënës, të babait ose të nunit, të cilat sipas besimit të popullit përbushen gjithmonë. Pasojat e këtyre mallkimeve kalojnë shumë vështirë, madje ato kanë forcë për të dënuar personin dhe pasardhësit e tij deri në brezin e nëntë, çka thotë edhe fjala e urtë bullgare Бащина и майчина клетва стига до девета рода. *Mallkimi i babait dhe i nënës shkon deri në brezin e nëntë*. Nuni konsiderohet te popujt e krishterë të Ballkanit si ndërmjetës mes famullit dhe Zotit, përkatësisht mes botës së gjallëve dhe asaj të vdekurve, prandaj i takon aftësia të ndikojë mbi fatin e famullit të vet. Sidoqoftë, në besimin e popullit ekzistojnë mjetet mbrojtëse që i neutralizojnë pasojat e rënda të mallkimit. Për mos ta mallkuar padashur fëmijën e saj, nëna mban unazën ose shqipton një thënie apotropaike: serb. Боже, опрости ми грешној. *Më fal mua mëkatares, o Zot*. Në qoftë se nëna dëshiron të „pranohet” mallkimi i saj, e heq unazën. Po edhe babai, kur mallkon qëllimisht, e heq kapelën e tij. Edhe i mallkuari mund të mbrohet me ndonjë thënie apotropaike (gr. απευχή): shq. Hurdhër!, gr. Φτού, φτού, φτού, σκόρδα!, po ashtu Μακριά από μας! *Larg nesh! Ai, χάσου! Zhduku, more!* etj.

Mallkimi mund të shoqërohet me shprehje të ndryshme joverbale – gjunjëzim, mimikë të veçantë ose gjest fyes si për shembull „munxa” te grekët (μούντζα, ndoshta nga persishtja) – gjest me gishtërinjtë e dorës së shtrirë. Supozohet se munxa del nga zakoni bizantin të prekin me dorë të pluhurosur fytyrën e një njeriu të dënuar ose nga zakoni turk t’i shënojnë shtëpitë publike me dorë të zhytur në katran. Kjo fjalë depërtoi edhe në gjuhën shqipe (mynxyrë) me një kuptim tjetër. Në disa vende të Ballkanit zbatohet në të kaluarën rituali i **anatemës**, i cili është i lidhur ngushtë me fenomenin e mallkimit. Në rast se u krye një krim dhe fshatarët nuk arritën gjatë ta kapnin shkelësin, pleqëria bën thirrje për t’u takuar në vendin e

krimit, në udhëkryq ose ndonjë vend të shenjtëruar, ku fshatarët luten për dënimin e krimit. Pastaj secili prej tyre merr një gur dhe e hedh në grumbull (bullg. dhe maq. *грамада*) që rritet gjithnjë e më shumë, sepse gurët i shtojnë edhe kalimtarët e rastit. Në kuptim më të ngushtë fjala anatema do të thotë përjashtim nga kisha ortodokse për shkak të një krimi të rëndë, gjatë të cilit thyheshin qirinjtë dhe shkriheshin në katran të ngrohtë.

Me kalimin e kohës mallkimi mori thjesht funksionin sharës (d.m.th. funksionin e çlirimit të menjëhershëm nga inati) ose ngacmues. Një transformim llojor më i thellë ka ndodhur në mjedisin serb, ku ekzistojnë mallkimet me kuptim anekdotik, p.sh. *Дао ти бог дукат од сто ока, па нити га могао носити ни трошити, већ седео крај њега и просио! Тë dhëntë Zoti një flori njëqind okësh që mos ta mbash as ta harxhosh, veç të rrish pranë tij e të lypësh!*

Duke qenë se thelbi i mallkimit është besimi në ndikimin magjik të fjalës, mallkimet ruajnë një strukturë stereotipe gramatikore që e pasqyron modalitetin e dëshirës. Kështu folja në mallkimin shqip del zakonisht në trajtën e optativit, përdorimi i të cilit në shqipen është kufizuar pothuajse vetëm në frazeologjizma. Greqishtja e re dhe pjesërisht rumanishtja e shprehin mallkimin nëpërmjet lidhore, e cila në këtë funksion zëvendëson imperativin, mirëpo në mallkimet në rumanisht haset më shumë kushtorja. Për bullgarishten dhe maqedonishten në këtë kontekst janë karakteristike ndërtimet me pjesëzën „da” që me strukturën dhe përdorimin e tyre i përgjigjen drejtpërdrejt lidhore në greqishten dhe rumanishten, kurse ndryshimi midis tyre është pak a shumë çështje terminologjike. Serbishtja, e cila gjithashtu i njeh da-ndërtimet, po edhe disa dialekte maqedone i japin përparësi optativit, d.m.th. participit vepror të së shkuarës të pashoqëruar me foljen ndihmëse *jam*. Përveç kësaj, mallkimi përforcohet shpesh me një shënues – në serbisht *da Bog da*, në maqedonisht *da dađe Госнод*, në greqisht *пов*, në bullgarisht *дано* – i cili i jep mallkimit ton stereotip. Një mundësi tjetër për ta përforcuar kuptimin e mallkimit është antifrazë – fillimisht jepet një urdhër, i cili në pjesën e dytë të mallkimit mohohet (p.sh. *Пођи, не пошао! Једи, не најео се!*) – ose „figura etymologica” (p.sh. *Треска да те тресе!*). Shikuar nga aspekti kuptimor, ka mallkime me kuptim konkret si dhe mallkime me kuptim metaforik (p.sh. serb. *Прстима говорио! Folsh me gishtërinjt!* nënkuptohet *U mbetsh pa gojë!*).

Çdo mallkimi ka për të shkaktuar një dëm apo thënë më ndryshe, ka për t'i hequr të mallkuarit një të mirë: pronë, sukses, shëndet, madje në rastin më të keq edhe jetë, prandaj klasifikimi kuptimor mund të bazohet në këtë parim. Kjo na mundëson t'i trajtojmë mallkimet edhe nga aspekti i frazeologjisë ballkanike, pasi vëmë në dukje disa tipare të përbashkëta të gjuhëve ballkanike. Siç duket nga pasqyra e mëposhtme, në secilin grup kuptimor gjejmë raste kur njëra frazë i përgjigjet tjetrës fjalë për fjalë ose të paktën kanë të njëjtin kuptim.

I. Mallkime të përgjithshme

Dëmi i mallkimit nuk specifikohet.

serb. Проклет био! serb. Проклет да си и овога и онога света! – maq. Проклет да си! – bullg. Проклет да бъдеш! – gr. Την κατάρα μου να 'χεις!

gr. Ανάθεμά σε! – maq. Анатема те!

Përfshihen edhe mallkimet, motivi i të cilave është dënimi nga Zoti:

serb. Бог нека ти плати! – maq. Господ да ми ти судит!

II. Tanatoboli

Ndonëse mallkimet të cilat shkaktojnë vdekjen janë nga më të rëndat, takohen jashtëzakonisht shpesh. Në terminologjinë shkencore shënohen me termin *tanatoboli* (< gr. thanatos *vdekje* + ballō *hedh*).

serb. Мртвог те нашли! У мукама умро! – maq. Мртов да си!

rum. Dormire-ai somnul morții! Dormire-ai somnul de veci! – gr. Να μην ξημερωθείς! – maq. Да заспијаш та да се не разубудиш!

serb. Не дочекао сутрашњи дан! – rum. Să n-apuci ziua de mâine!

shq. Të shtifsha në dhe për së gjalli! Të hapsha varrin me thonj! Të punofsha varrin! – maq. У земата да те посипам!

shq. Mos e prufsh kokën gjallë në shtëpi!

maq. Смрт те собрала!

serb. Душа ти испала!

a) Posaçërisht te sllavët ortodoksë të Jugut ekzistojnë mallkimet që thërrasin vdekje nga Zoti ose një shenjtor. Prejardhja e këtyre mallkimeve del nga sinkretizmi i paganizmit dhe të krishterimit, ndërsa hyjnitë pagane u zëvendësuan nga shenjtorët e krishterë. Vetë mallkimet janë në

kundërshtim me moralin e krishterë, pra është e kuptueshme se kisha ortodokse në të kaluarën përpiqej t'i shtypte, meqë mallkimet në të cilat përmenden Zoti ose shenjtorët i konsideron si blasfemi.

shq. Të vraftë Zoti! – serb. Бог те убио! Господ те убио! – maq. Бог да те убие!

serb. Убила те Света Богородица! Мајка те Божја убила!

serb. Убила те Света Недеља! – maq. Света Недеља да ти земе душата!

Убио те Свети Илија! – maq. Свети Илија да го земе!

b) Një grup mallkimesh thërret *forca të errëta dhe genie mbinjerëzore*:

shq. Dreqi të marrtë! Vofsh me dreqin! – serb. Враг те однео! Ђаво те однео! Ђаво те изео! – maq. Ѓаол те зел! – rum. Să te muncească dracii! Să fii al dracului! Dracul să te ia! Cânta-ți-ar dracul la ureche!

serb. Иди до ѓавола! Ђаво ти душу попио! Ђаво ти главу разбио! Ђаво ти чорбу запржио! Ђаво ти очи ископао! – maq. Ѓавол да те расчепе на триста парчиња!

serb. Виле те однеле! – rum. Juca-te-ar Rusaliile!

shq. T'hangshin shtrigat!

shq. Të shitoftë Zana!

serb. Але те однеле!

c) Në shumë mallkime figurojnë *kafshët*, të cilave u atribuohen karakteristika negative:

serb. Црви те изели! – rum. Mânca-te-ar viermii și veninul!

rum. Bea-te-ar șerpîi și tăunii!

bullg. Вџки да те изядат! – maq. Вошките да те јадат!

bullg. Гавран очи да ти извади!

serb. Мачке те појеле!

serb. Вуци те појели! – maq. Волци те изеле!

gr. Να σε φάν' τα σκυλιά και τα όρνια! – maq. Орли и врани да те изедат! – bullg. Кучета главата да ти изядат!

gr. Να σε φάει το μαύρο φίδι! Οχιά να σε φάει! – serb. Змија те за срце ујела!

shq. Të këndoftë kukumjacka! – gr. Που να λαλήσουν κουκουβάγιες στα κεραμίδια σου! – maq. Кукавица да ти кука! – rum. N-ai mai auzi cucul! N-ai mai ajunge să-ți cânte cucul la anul!

d) Një grup tjetër mallkimesh kërkon *vdekje të dhunshme, tortura a katastrofa natyrore*:

gr. Φοτιά να πέσει και να σε κάψει! Κάρβουνο να σε φάει!

serb. Ватра те изгорела! Глогов ти колац на огњиште!

rum. Arde-te-ar focul! Mânca-te-ar focul să te mănânce!

maq. Оган да те изгори!

bullg. На прах и пепел да станеш!

serb. Гром те згромио! Гром те спалио, да Бог да!

bullg. Гръм да те тресне!

shq. Të zëntë rrufeja! Të raftë rrufeja! Të shitoftë rrufeja!

serb. Вода те однела!

rum. Şede-a-ţi-ar stâlpul la cap!

bullg. На суха върба да те обесят!

serb. Коњи те растргли!

maq. Остра сабја да те пресече!

serb. Стрела те убила! Помрчина те појела!

e) Te serbët haset motivi i *vajtimit të nënës mbi të mallkuarin të vdekur*:

serb. Цркао мајци, да Бог да! Содомисао се мајци! Урнисао се мајци! Мајка те пожелела! Мајка те не видела! Мајка те сахранила! Мајка ти за душу пила!

III. Mallkimet që shkaktojnë pësim pas vdekjes

a) Shumë karakteristike janë mallkimet, në të cilat përmendet *varrosje*:

gr. Να μη λιώσουν τα κόκαλά σου!

maq. Дано да седиш сто години во гробо и да се не разгниеш!

shq. Të mbuloftë dheu i zi! Të kalbtë toka!

bullg. Черна земя да те погълне!

gr. Που να σε φάει το χώμα! Να σε ξεράσει η γη!

serb. Земља ти кости истурила!

gr. Που να σε πάνε τέσσερις και ο παπάς πέντε! Που να στο πεί ο παπάς στ' αυτί!

rum. Citi-ţi-ar ropa!

gr. Που να σε νεκροφιλήσω!

rum. Mânca-ți-aș coliva!

shq. Të sjellshin në çarçaf!

maq. Свињи гробот да му изријат!

b) Një motiv i fortë në mallkimet është harresë. Familja ndodhet shumë lart në shkallën e vlerave të ballkanasve, prandaj ata konsiderojnë një nga katastrofa më të mëdha që mund t'u ndodhin në jetë, të mos varrosen a të harrohen nga familja, çka dëshmohet edhe në këngët e kreshnikëve, të junakëve dhe të kleftëve.

shq. Shkofsh e mos u kthefsh!

serb. Отишао па се не вратио!

bullg. Където отидеш да не се върнеш!

maq. Ошол та не дошол!

gr. Που να πας και να μη γυρίσεις!

shq. T'u harroftë emri!

maq. Име ти се не спомнило!

bullg. Опустяло ти име и презиме!

serb. Траг ти се затро!

gr. Να χαθείς και να μη φανείς!

shq. Të lashin metë!

serb. Гроб ти се не знао!

shq. U dafsh shokësh!

IV. Mallkimet që shkaktjnë sëmundje

serb. Болест те спопала!

maq. Болест да те јаде!

rum. Lovi-te-ar boala!

shq. Të lëntë Zoti sakat!

bullg. Сакат да осакатееш!

serb. Тражили ти лека па ненашли!

gr. Να ξερομαραθείς!

rum. Să se topească carnea pe tine ca lumânarea!

shq. Të shplaftë panuklla! Të shplaftë mortja! Të marrtë mortja! Të raftë murtaja!

gr. Να σε φάει η πανούκλα!

bullg. Чума да те вземе!

gr. Να σε πιάσει σιγηνικό! Να σε πιάσει ζαλιακό!

shq. Mos folsh kurrë më! T'u marret ajo gojë! T'u thaftë goja!

bullg. Езика да ти изсъхне!

serb. Онемео, да Бог да! Прстима говорио!

maq. Онемел!

serb. Оћоравио! Ослепио, да Бог да! Слепог те водили по свету!

maq. Ќор да одиш!

shq. Kurrë dritë mos pafsh!

gr. Που να σου βγουν τα μάτια!

serb. Руке ти отпале! Руке ти се осушиле!

maq. Дано ти исахнаа рацете!

bullg. Ръцете да ти изсъхнат!

bullg. Три години треска да те тресе!

maq. Да би треснал треснатику!

serb. Језик прегризао!

gr. Δάμασε τη γλώσσα σου! Δάγκωσε τη γλώσσα σου!

serb. Пођи, не пошао! Пођи, не дошао! Не дигао се! Не помакао се!

serb. Црева ти се преврнула!

serb. Цигерица ти се распала!

serb. Полудео, да Бог да!

serb. Врат сломио! Врат скршио!

gr. Που να σταθεί το κάτουρό σου!

V. Mallkimet që shkaktojnë humbjen e pronës

serb. Ватра ти кућу изгорела! Кућу не видео!

shq. T'u shkretoftë shtëpia!

maq. Прав и пепел куката да ти се сторит!

serb. Просио, па се хранио!

maq. Просил та се ранил!

bullg. Да просиш и да се храниш!

rum. Călca-te-ar nevoia!

serb. Кад соли имао, хлеба немао!

serb. Не најео се!

VI. Mallkimet që shkaktojnë prapësi

shq. Mos pafsh hajer e prokopi!

gr. Χαίρι και προκοπή μην κάνεις!

bullg. Хаир да не видиш!

maq. Аир да не видиш!

shq. Mos pafsh ditën!

maq. Бел ден не видел!

gr. Που να μη δεις άσπρη μέρα!

bullg. Бял свят да не видиш!

shq. Mos pafsh të mirë në jetë! T'u preftë nafaka!

serb. Црн ти век био!

gr. Την κακή σου και την ψυχρή σου ημέρα! Τον κακό σου τον καιρό!

Τρομάρα και λαχτάρα να σου 'ρθει!

maq. Да не прокопсаш!

serb. Сунце ти не синуло! Сунце те не огрејало!

rum. N-ai mai vedea fața soarelui!

gr. Μούντζες και στάχτες πάνω σου!

rum. Să se-aleagă praful și pulberea de capu-ți!

shq. Kurrë Zoti mos të dhashtë!

rum. N-ai mai cālca iarbă verde!

shq. Të ngelçin armët varur në mur!

VI. Mallkimet që ndikojnë mbi anëtarët e familjes

Shembujt e mëposhtëm dëshmojnë, se mallkimi mund të ndikojë mbi të mallkuarin edhe tërthorazi duke dëmtuar të afërmit të tij.

serb. Проклет био и ко те родио!

gr. Ανάθεμα που σ' έκανε!

serb. Нит женио, нит удавао!

maq. Ни да омажиш ни да ожениш!

shq. Të vraftë gjiri i nënës!

shq. Të sjellshin mandatën!

shq. Të humbtë fara! [I mallkuari do të mbetet pa pasardhës.]

gr. Να το βρεις απ' τα παιδιά σου!

serb. Цркло ти најмилије!

shq. Dalsh fare! [pa burrë]

Mund të përfundojmë se mallkimi përbën pjesë të veçantë të trashëgimisë kulturore të popujve ballkanikë dhe paraqet një çështje të veçantë etnolinguistike, e cila mund të trajtohet edhe nga aspekti i frazeologjisë ballkanike. Bashkëpërkimet në disa fraza të mallkimit

janë të dukshme. Rezultatet e këtij hulumtimi mund të gjejnë zbatim praktik në një fjalor të ri frazeologjik ballkanik.

Literatura

- Ajdačić, Dejan. *O kletvi u usmenoj književnosti*. [online] [cit. 2011-03-21]. WWW: http://www.rastko.rs/književnost/nauka_knjiz/dajdacic-kletva.html.
- Malina, Jaroslav. *Antropologický slovník*. Elportál [online]. WWW: <http://is.muni.cz/do/1431/UAntrBiol/el/antropos/index.html>
- Nikolić, Davor. *Struktura i funkcija kletvi u usmenoj i pisanoj epici*. **Narodna umjetnost** 47/2, 2010.
- Глоула, Σαλφώ. **Ευχές, ξόρκια, κατάρες, εκφράσεις θυμού**, Θεσσαλονίκη 2001.
- Вуковић, Милан. **Народни обичаји, веровања и пословице код Срба**, Београд 2004.
- Китевски, Марко. **Македонски народни клетви**, Скопје 1997.
- Крумова–Цветкова, Лилия. **Българските благословии, пожелания и клетви – част от националната самобитност и културното наследство**, София 2010.
- Милисавац, Живан. **Антологија говорних народних умотворина**, Београд 1972.
- Славейков, Рачо. **Български народни обичаи и вярвания**, Велико Търново, 2006.

Monica GENESIN* & Donato MARTUCCI,** Universiteti i Salentos
 GJUHA DHE KULTURA SHQIPE NË VEPRIMTARINË E
 QENDRËS SË STUDIMEVE PËR SHQIPËRINË (*CENTRO STUDI
 PER L'ALBANIA*, 1939-1944)

Abstract

As a result of the occupation of Greece and Yugoslavia about 70 years ago by the Axis powers the borders of the Balkan states were reshaped. In this way in 1941 Italy enlarged the territories under its control gaining thus among others Epirus and Kosova. The new territories were united with Albania which was already under Italian control since 1939. To celebrate the new acquisitions the Presidenza del Centro Studi per l'Albania projected a two-volume publication dedicated to Kosova and Çamëria entitled *Le terre albanesi redente*. Each volume was designed to contain articles of distinguished scientists on Albanological research in history, literature, linguistics, folk culture, and natural sciences. The volume dedicated to Kosova was released in July 1942. The other volume indeed remained unpublished. However, thanks to the documents kept by the Accademia dei Lincei it is possible to reconstruct this volume today and to gain insight into the motives that gave rise to these publications during those times. In our lecture the articles of the two volumes will be presented with a special emphasis on the contributions of G. Petrotta "Resistenza e conservazione della lingua albanese nell'Epiro e propulsione letteraria della Ciamuria" and the one of C. Tagliavini "Le parlate albanesi di tipo ghego orientale". It is well known that Tagliavini's article played a decisive role in the development of Albanian dialectology and in the field of Balkan linguistic studies

1. Më 1939, pas aneksimit të Shqipërisë nga Italia, u ngrit pranë Akademisë Mbretërore të Italisë Qendra e Studimeve për Shqipërinë (Centro Studi per l'Albania), ku bënë pjesë të gjithë studiuesit më të njohur të çështjeve shqiptare, si edhe shumë personalitete kulturore dhe politike shqiptare, ndër të cilët E. Koliqi, Gj. Fishta, E. Çabej etj. Gjatë kohës së shkurtër të veprimtarisë së vet, nga 1939 deri më 1944, Qendra e Studimeve përkrahu dhe mbështeti nisma të ndryshme për

* Paragrafët 2. dhe 4.

** Paragrafët 1. dhe 3.

botime me karakter ndërdisiplinor, për të bërë të njohur anë të ndryshme të historisë, letërsisë, artit, pasuritë dhe gjuhën e vendit që kishte hyrë tashmë në Mbretërinë e Italisë. Falë revistës tremujore “Rivista d’Albania” në këtë periudhë shohin dritën e botimit studime të shumta të specialistëve të kohës që ndihmuan për të njohur mjaft aspekte të një vendi të afërt gjeografikisht, por ende pak të studiuar, ndërsa në rrafshin shkencor u dhanë një shtysë të rëndësishme studimeve albanologjike. Kjo Qendër pati një rëndësi të dorës së parë edhe për kërkimet në lëmin e gjuhësisë shqiptare, si përmes botimit të veprës *Le terre albanesi redente*, për të cilën do të flasim më poshtë, ashtu edhe përmes përpjekjes për të hartuar një atlas dialektologjik të shqipes. Ishte kjo një ide e hedhur nga Matteo Bartoli që në vitin 1927¹, i cili duke e përmendur më 1933 në *Essai de bibliographie de géographie linguistique générale* shpreh bindjen që *L’atlante linguistico [...] dovrà avere un’importanza particolare perché servirà non solo alla storia dei dialetti e della lingua degli albanesi, ma anche alla lingua e alla storia di alcuni linguaggi vicini (greco, romanico, romanzi, slavi e altri) dei quali l’albanese conserva parecchi e preziosi cimeli di fasi antiche, perdute in quasi tutte le aree di quei linguaggi [...]* (Atlasi gjuhësor [...] do të ketë një rëndësi të veçantë sepse do t’i shërbejë jo vetëm historisë së dialekteve dhe gjuhës së shqiptarëve por edhe gjuhës dhe historisë së disa fqinjëve (grekë, romanë, sllavë e të tjerë) prej të folmeve të të cilëve shqipja ruan mjaft relike të çmuara të kohëve të lashta, që kanë humbur thuajse në të gjitha trevat e atyre gjuhëve...) ²

Bartoli mendonte që mbledhjen e materialit në të gjitha trevat gjuhësore të shqipes t’ua besonte N. Resulit dhe G. Schirò-it. Të dy këta do të mblidhnin dhe renditnin më pas përgjigjet e “Pjesës së për-

¹ Në një letër për Federzonin, të ruajtur në arkivin e Accademia del Lincei të datës 9 maj 1940, Bartoli shkruan se që më 1927 ishte përpjekur të fillonte projektin për një atlas gjuhësor të shqipes: khs. *Promemoria per l’Atlante linguistico albanese*, në Archivio Storico dell’Accademia Nazionale dei Lincei (ASANL), Fondo Accademia d’Italia, Centro Studi per l’Albania, b. 5, fasc. 26.

² M. Bartoli, *L’Atlante linguistico albanese*, në J. Schrijnen, **Essai de bibliographie de géographie linguistique générale**, Nimègue 1933, f. 28-30. Që më 1929 Bartoli kishte botuar një artikull mbi atlasin gjuhësor të shqipes, por në një revistë më pak të njohur dhe që gjendej me vështirësi: po atje, *Për Atlantian e gjuhës shqipe*, në “Studenti shqiptar: rivistë mujore, kulturele e ilustruar”, Torino 1929 (kjo revistë drejtohej nga O. Paskali dhe botohej nga *Shoqëria Studenti Shqiptar*).

gjithshme” dhe “Pjesëve të veçanta” të një pyetësoni të hartuar sipas atij që ishte përdorur për atlasin gjuhësor të italishtes. Projekti u pranua dhe u gjeti vend në programin e veprimtarive të Qendrës³. Më 1940 u formua një komitet ekzekutiv që përbëhej nga C. Merlo (kryetar), M. Bartoli dhe C. Tagliavini, i cili në korrik të po atij viti gjatë mbledhjes së parë i kërkoi Ministrisë së Arsimit që mbledhjen e materialit ta kryente E. Çabej⁴. Zgjedhja e Çabejtë diktohej kryesisht nga dy arsye: e para kishte karakter politik. Sipas Francesco Merlos, drejtor i Qendrës së Studimeve, nuk do të ishte politikisht e përshtatshme që Atlasi Gjuhësor i shqipes të hartohej pa bashkëpunimin e ndonjë gjuhëtari shqiptar. Arsyeja e dytë ishte shkencore: Çabej ishte glotologu shqiptar më i përgatitur⁵. Me të mbërritur në Itali filloi menjëherë të diskutonte me anëtarët e Komitetit për problemet teorike dhe praktike që kishin të bënin me hartimin e një atlasit gjuhësor, hartimin e pyetësonit, identifikimin e vendeve ku do të kryheshin hulumtimet gjuhësore, kriteret e tejshkrimit fonetik etj. Për të gjitha këto çështje hartuesit e Atlasit gjuhësor të italishtes, Bartoli, Pellis dhe Vidossi, i vunë në dispozicion Çabejtë materialet e tyre.

Puna përgatitore e domosdoshme dhe më e rëndësishme ishte sigurisht përgatitja e pyetësonit. Në hartimin e tij, të ndarë në dy pjesë, njëra e përgjithshme dhe tjetra specifike, u morën parasysh edhe kërkesat e akademikëve Pettazzoni dhe Toschi që Atlasi të ishte jo vetëm një burim studimesh gjuhësore, por, sa të ishte e mundur, edhe etnografike⁶.

Çabej bëri prova për të dyja pjesët, duke shkuar dy herë në Shqipëri, herën e parë në fund të pranverës së vitit 1941, duke kryer hulumtime për të folmet e Tiranës, Kakozit (Gjirokastrë) dhe Durrësit; herën e dytë, në vjeshtë të po atij viti, kreu hulumtime mbi dialektet e Kakozit, Panaritit (Korçë) dhe Selçanit (Elbasan). Gjatë këtyre provave e ndryshoi në mënyrë thelbësore pyetësonin, i cili në krye të herës mbështetej në modelin e Atlasit Gjuhësor të italishtes, duke hequr

³ Khs. *Verbale dell'adunanza del Consiglio direttivo del Centro Studi per l'Albania del 19 aprile 1940*, po atje, b. 1, fasc. 4.

⁴ Khs. *Verbale dell'adunanza del Comitato per l'Atlante linguistico albanese del 1° luglio 1940*, po atje, b. 1, fasc. 5.

⁵ Khs. *Federzoni a Ercole, 5 settembre 1940*, po atje, b. 5, fasc. 25.

⁶ Khs. *Verbale dell'adunanza del Comitato per l'Atlante linguistico albanese del 5 dicembre 1940* po atje, b. 1, fasc. 6.

fjalë dhe shprehje që nuk kishin të bënin me kulturën shqiptare dhe duke shtuar të tjera që ishin karakteristike për jetën në Shqipëri (p.sh. një vend të gjerë zuri këtu e drejta zakonore shqiptare)⁷. Pyetësi u botua në shtypshkronjën S. Nilo në Grottaferrata në fund të korrikut 1943 dhe u përgatit edhe një artikull me titull *L'Atlante linguistico albanese: il questionario*, i cili fatkeqësisht mbeti i pabotuar⁸. Mbledhja e materialit gjuhësor duhet të fillonte nga bashkësitë shqipfolëse të Italisë së Jugut në gusht 1943, por rrjedhat e luftës bënë që Akademia të shtynte ekspeditat⁹. Kujtojmë këtu që më 25 korrik 1943 ra qeveria e Mussolinit dhe më 8 shtator të po atij viti u nënshkrua armëpushimi, i cili sollti shpërbërjen e ushtrisë italiane të vendosur jashtë kufijve, ndërsa Shqipëria hyri nën kontrollin gjerman. Në Janar 1944 sekretari i përgjithshëm i Ministrisë së Jashtme i kërkoi Akademisë që ta largonte Çabejnë nga Qendra e Studimeve për Shqipërinë, meqenëse ky i fundit kishte lidhje me qeverinë e re të Tiranës, me karakter të theksuar antiitalian (bëhet fjalë për qeverinë e Rexhep Mitrovicës)¹⁰. Madje Schirò i kërkoi kryetarit të Akademisë së Italisë që të marrë masa paraprake për të neutralizuar ndonjë hakmarrje të mundshme të Çabejtë, për shkak të largimit të tij. Ndër rreziqet e mundshme nga një veprim i tillë hynte edhe mundësia që Çabej t'ia kalonte Gjermanisë frytet e punës së kryer në gjirin e Qendrës së Studimeve për hartimin e Atlasit, duke qenë se kishte studiuar atje dhe ruante shumë lidhje me Gjermaninë¹¹.

Pak muaj më vonë, me çlirimin e Italisë së Veriut, Akademia e Italisë dhe Qendra e Studimeve për Shqipërinë pushuan së ekzistuari dhe si rrjedhojë të gjitha veprimtaritë e tyre u ndërpreën.

2. Edhe pse projekti i Atlasit Gjuhësor nuk u realizua dot në lëmin e veprimtarive të Qendrës së Studimeve, ai shënon një përpjekje të rëndë-

⁷ Khs. *L'Atlante linguistico albanese. Il questionario*, po atje, b. 5, fasc. 26.

⁸ Po atje.

⁹ Khs. D. Martucci, *Il primo tentativo di compilazione di un Atlante linguistico albanese (1940-1944)*, në "Res Albanicae, në shtyp.

¹⁰ Khs. *Mazzolini a Gentile, 25 gennaio 1944*, në ASANL, Fondo Accademia d'Italia, Archivio del Nord Italia, b. 3, posiz. 13, fasc. 10.

¹¹ Khs. *Pro memoria. L'Atlante linguistico albanese nell'attuale fase dei lavori e la scelta del nuovo raccoglitore*, po atje.

sishme për ta pajisur shqipen me këtë mjet të rëndësishëm kërkimor¹², ashtu siç ishte bërë ose po bëhej në atë kohë edhe për gjuhët e tjera europiane (gjermanisht, frëngjisht, italisht, rumanisht). Ky objektiv u arrit vetëm pas shumë vjetësh, me botimin në vitin 2007 të *Atlasit dialektologjik të gjuhës shqipe* (ADGjSh), i hartuar me një konceptim të ri, mbi bazën e zhvillimeve të fundit metodologjike në fushën e gjeografisë gjuhësore, dialektologjisë, sociolinguistikës dhe pas kërkimeve të imta që synonin fillimisht të përfitonin një pamje të përgjithshme të dialekteve të shqipes e më pas të thellonin njohuritë mbi sistemet fonetike, morfologjike, morfosintaksore dhe leksikore të të folmeve të ndryshme, për të vijuar më pas me mbledhjen, tejkshkrimin dhe ruajtjen e të dhënave të mbledhura në kërkimet përfundimtare. Por le të kthehemi në ngjarjet që kanë të bëjnë me projektin e një atlasit të parë gjuhësor të shqipes. Edhe në këtë rast puna përgatitore u krye në faza të ndryshme, të karakterizuara nga vështirësi praktike dhe nga paqartësi që rridhnin nga njohja ende e cekët e të folmeve të shqipes, duke qenë se ende mungonte një studim sistematik i këtij realiteti kompleks dialektor. Në fund të viteve '30 Matteo Bartoli dërgon një propozim të parë që përmbante tre opsione, të quajtura plani A, B dhe C. I pari ishte botuar në *Essai de bibliographie de géographie linguistique générale*, botuar nga J. Schrijnen (Nijmegen 1933) dhe, sipas Bartolit, ishte më i pëlqyeshëm se dy të tjerët “për intensitetin dhe pasurinë e materialit të mbledhur”. Plani A, i cili “kërkonte më shumë kohë dhe shpenzime se dy të tjerët” parashikonte që dy mbledhës për 4 vjet të mbledhnin të dhënat e 206 pikave të shpërndara në zonat shqipfolëse të Mbretërisë së Shqipërisë (158 vende) dhe Italisë së Jugut (48 vende). Në dy planet e tjerë alternative, mjetet financiare të parashikuara pakësohen në mënyrë drastike për arsye ekonomike, aq sa në planin C numri i vendeve ku do të kryhej mbledhja e materialeve ulet në 128, ndërsa kohëzgjatja e saj pakësohet në një vit e gjysmë dhe puna do të kryhej nga një mbledhës i vetëm. Pak kohë më pas, për arsyet e paraqitura në paragrafin 1, komiteti ekzekutiv vendos t’ia besojë hartimin e pyetësorit Çabejt, i cili e hartoi atë duke mbajtur pa-

¹² Siç vë në dukje me të drejtë Glauco Sanga në hyrjen e botimit italian të *Atlante linguistico ed etnografico dell'Italia e della Svizzera meridionale* (vëll. I, Unicopli 1987, Milano, p. 7), “atlasit përdoret për të pasur përgjigje, të volitshme dhe të gatshme për t’u përdorur. Atlasi nga ana e vet shërben për të shtruar pyetje, dhe asnjëherë nuk mund të përdoret si hambar formash, nga i cili këto të merren në mënyrë mekanike ç...] konsultimi i atlasit duhet të jetë pika e nisjes e kërkimeve gjuhësore”.

rasysh veçoritë e realitetit gjuhësor dhe etnografik shqiptar. Siç mund të shihet nga përmbledhja e pyetësorit në relacionin deri më sot të pabotuar, me titull *L'atlante linguistico albanese. Il questionario*¹³, struktura e tij teorike natyrisht ka ndikime të modeleve të përpunuara në atë kohë, të cilat u linin shumë vend kërkimeve leksikore, duke u kushtuar më pak vëmendje fakteve me karakter gramatikor:

Përmbledhje e pyetësorit	Pyetje e detyrueshme	Pyetje jo e detyrueshme
Të dhënat e informantit dhe vendi	1	-
1. Trupi i njeriut (cene, sëmundje)	254	5
2. Jeta e njeriut. Lindja dhe fëmijëria, lidhjet familjare dhe farefisnore, moshë, lojëra fëmijësh, shkolla, martesë, vdekje	209	14
3. Fshati. Shtëpia (ndërtimi; kuzhina dhe mjetet e punës, orenditë)	177	10
4. Jeta në shtëpi (veshja, higjiena, ushqime dhe pije, vakte dhe gosti; të pirët, muzika dhe vallet; të pirët e duhanit, të fjeturit)	270	10
5. Cilësi morale, jeta fetare dhe shoqërore, armët, qeverisja, përshtetjet	138	5
6. Forma të truallit. Dukuri atmosferike. Trupa qiellorë. Metale .	154	11
7. Zeje dhe mjeshtëri	143	33
8. Bujqësi (mjetet e punës, qerret)	103	11
9. Bimë të egra dhe bimë të kultivuara (pyll, drurë, gëmusha, lule, fruta, perime)	224	14
10. Kafshë shëpiake, bujqësi	251	43
11. Kafshë të egra, gjueti, peshkim	149	10
12. Ndarja e kohës (ditë, muaj, vit, festa). Ndajfolje kohe dhe vendi. Numra. Ngjyra	147	9
13. Gramatikë. Krahasime. Demologji	173	5
Gjithsej	2418	180

Ky theksim i dukurive të kulturës materiale dhe elementeve etnografike, krahas interesit të pakët për çështje me karakter gramatikor janë një element i thellë dallues nga ADGjSh i sotëm, i cili u kushton mjaft hapësirë dallimeve fonetike dhe variacioneve gramatikore. Hartuesi i artikullit mbi pyetësorin mjaftohet të përsërisë që: “Për sa i përket gramatikës, dallimet fonetike do të dalin nga pyetjet që do të bëhen, në formulimin e të cilave janë marrë parasysh, tek emri formimi i shumës, gjinia mashkullore dhe femërore dhe në veçanti asnjësi, përshtatja e mbiemrit me

¹³ *L'Atlante linguistico albanese. Il questionario*, në ASANL, Fondo Accademia d'Italia, Centro Studi per l'Albania, b. 5, fasc. 26.

emrin, tek përemri ndërkallja e tij në urdhëroren e foljes, kohët, mënyrat dhe vetat”. Edhe sintaksës i kushtohet pak vëmendje, duke u kufizuar në disa dukuri të caktuara, ndër të cilat prirja ndaj parataksës, e trajtuar disa dhjetëvjeçarë më parë nga Kristian Sandfeld në veprën *Linguistique balkanique, problèmes et résultats* (Paris, 1930) në kuadrin e një analize të gjuhëve ballkanike me karakter të përgjithshëm.

3. Një nismë tjetër me rëndësi për përparimin e studimeve albanologjike në shumë fusha, ndër të cilat edhe ajo gjuhësore, është botimi i një përmbledhjeje studimesh kushtuar Kosovës dhe Çamërisë. Në prill 1941 Italia i kishte zgjeruar zotërimet e saj në Ballkan, duke marrë Kosovën dhe Epirin, të cilat do t’i bashkonte më pas me Shqipërinë. Për të festuar siç duhet këtë ngjarje kryesia e Qendrës së Studimeve për Shqipërinë projektoi botimin e veprës me dy vëllime *Le terre albanesi redente*, në të cilën do të përmbledheshin artikuj të studiuesve më të njohur të kohës, duke paraqitur arritjet më të fundit në sektorë të ndryshëm mbi historinë, aspektet etnografike, gjuhësore, kulturore dhe natyrore të territoreve të aneksuara. Vëllimi mbi Kosovën u botua më 1942, ndërsa ai kushtuar Çamërisë, që duhej të dilte menjëherë pas të parit, nuk e pa kurrë dritën e botimit. Për të kuptuar arsyet e ndërprerjes së botimit duhet rindërtuar konteksti i veçantë historik i projektit të tij. Është koha kur Italia synon të krijojë për qëllimet e veta një “Shqipëri të Madhe”, ku do të përfshiheshin të gjitha trevat me popullsi në shumicë shqiptare, duke ndjekur në këtë mënyrë politikën që kishte filluar Zogu më 1925. Kjo “Shqipëri e Madhe” do të ishte shtylla e hegjemonisë së ardhshme italiane në Ballkan dhe rrjedhimisht do të shërbente si ledh ndaj përparimit të Gjermanisë drejt Mesdheut.

Mbështetja e irredentizmit shqiptar bëhet mjeti kryesor për krijimin e *rendit të ri (ordine nuovo)*, duke rishikuar, mbi bazën e parimit të kombësisë dhe duke filluar nga Shqipëria, rregullimin politik-territorial të Ballkanit sipas kërkesave dhe synimeve të Italisë. Pikërisht gjatë këtyre zhbi-llimeve, më 10 maj 1941 Qendra e Studimeve paraqet *Planin e botimeve mbi Çamërinë dhe Kosovën (Piano di pubblicazioni sulla Ciamuria e sul Cossovo)*¹⁴. Nga maji deri në korrik 1941 Qendra e Studimeve kërkon studiues kompetentë për hartimin e dy vëllimeve. Nga letrat e ruajtura në Arkivin Historik në Accademia dei Lincei mund të hartohet një listë

¹⁴ Khs. *Piano di pubblicazioni sulla Ciamuria e sul Cossovo, 10 maggio 1941*, po atje, b. 7, fasc. 40.

personalitetesh të cilët u ftuan për bashkëpunim: Antonio Baldacci, Matteo Bartoli, Carlo Tagliavini, Giuseppe Valentini, Ernest Koliqi, Fulvio Cordignano, Stavro Frashëri, Bernardin Palaj, Eqrem Çabej, Donat Kurti, Francesco Chinigò, Sergio Bettini, Gennaro Maria Monti, Domenico Mustilli, Gaetano Petrotta, Nilo Borgia, Namik Ressuli, Francesco Ribezzo. Natyrisht jo të gjithë pranuan, disa prej tyre morën pjesë vetëm në vëllimin mbi Kosovën, të tjerë tek të dyja vëllimet. Gjithsesi, vështirësitë më të mëdha u hasën në vëllimin mbi Çamërinë, për shkak të botimeve shumë të pakta mbi atë krahinë¹⁵.

Fillimisht për dorëzimin e artikujve ishte caktuar data 20 korrik dhe botimi ishte parashikuar në fund të tetorit (1941), por për arsye të rrethanave politike dhe vështirësive për gjetjen e materialeve afati u shty disa herë.

Në një relacion të përgatitur për mbledhjen e këshillit të Qendrës së Studimeve më 23 mars 1942 thuhet se: Hartimi i dy vëllimeve ka hasur në shumë vështirësi për shkak të njohjes së pakët të disa çyshtjeve dhe vështirësive për mbledhjen e materialit studimor. Por kompetenca e veçantë e studiuesve të ndryshëm dhe zelli i treguar nga secili prej tyre ka bërë që të kapërcehet çdo pengesë, pra sot mund të kemi besim se vëllimet do të priten mirë nga bota kulturore italiane dhe shqiptare. Për dy vëllimet kanë bashkëpunuar studiuesit e cituar më poshtë në rend alfabetik: Baldacci, Bettini, Ercole, Koliqi, Monti, Mustilli, Paluca, Petrotta, Ribezzo, Schirò, Tagliavini, Vlora.

Vëllimi kushtuar Kosovës është gati dhe Shkëlq. Ercole po shkruan parathënien; ai mbi Çamërinë do të dalë pak kohë pas të parit. Botimet do të mbajnë titullin: “Le Terre albanesi redente” vol. I° Kossovo, vol. II° Ciamuria¹⁶.

Pra më 23 mars 1942 ende ekzistonte bindja se do të botoheshin të dy vëllimet.

Më 4 korrik del vëllimi kushtuar Kosovës¹⁷.

Por ndërmjet marsit dhe gushtit diçka duhet të ketë ndryshuar në planet e Qendrës së Studimeve, sepse më 13 gusht e më pas më 24

¹⁵ Khs. po atje, bb. 8-14.

¹⁶ *Relazione sulle pubblicazioni in corso per l'adunanza del Consiglio direttivo del Centro Studi del 23 marzo 1942*, po atje, b. 1, fasc. 10.

¹⁷ Khs. *Schirò alla Libreria Zenel Tivari di Scutari, 4 luglio 1942*, po atje, b. 14, fasc. 244.

shtator nga letrat e Giuseppe Schiròit dërguar Carlo Tagliavinit kuptohet se botimi i vëllimit mbi Çamërinë është shtyrë. Tagliavini ende nuk e ka dorëzuar artikullin e vet dhe Schirò e siguron:

Puna për vëllimin mbi Çamërinë nuk është e ngutshme. Nëse ke kohë mund të hartosh pikat kryesore të studimit, në mënyrë që, kur të ta kërkoj, të kesh mundësi ta mbarosh brenda një kohe të shkurtër¹⁸.

Shkaqet e shtyrjes së botimit të këtij vëllimi i gjejmë në një letër të 12 janarit 1943 që Schirò ia dërgon Baldaccit, në përgjigje të kërkesës së këtij të fundit për të marrë bocat e artikullit të tij që do të botohej në vëllim: Botimi i vëllimit mbi Çamërinë i cili, me përjashtim të një artikulli është gati, është shtyrë për shkaqe që rrjedhin nga rrethanat politike. Për këtë arsye ju kam dërguar honorarin, por jo bocat¹⁹.

Fundi i historisë së botimit të vëllimit të dytë që u kushtohet tokave shqiptare të çliruara të Çamërisë mësohet nga letërkëmbimi ndërmjet Qendrës së Studimeve dhe shtypshkronjës së Senatit, ku ky vëllim do të shtyptej: në dy letra të datave 24 nëntor dhe 7 dhjetor 1943 kërkohet pezullimi i përgatitjes për shtyp të botimit mbi Çamërinë. Për fat të mirë bocat e daktilografuara mbetën në arkivin historik në Accademia Nazionale dei Lincei dhe në cepin e sipërm djathtas të çdo artikulli ende sot mund të shihen shënimet e bëra me laps, pasi u vendos që këta të mos botoheshin më: “*A dopo la guerra*” (Pas luftës) ose “*Nella rivista dopo la guerra*” (Në revistën pas luftës). “Arsyet e rrethanave politike” të anulimit të një botimi të gatshëm me sa duket kanë të bëjnë me marrëdhëniet ndërmjet Italisë dhe Greqisë, sepse pas kthimit të Mussolinit nga një vizitë në Athinë projekti i botimit të vëllimit mbi Çamërinë pezullohet. Natyrisht edhe në këtë rast, ashtu si edhe për Atlasin Gjuhësor të Shqipës, disfata e fashizmit solli braktisjen përfundimtare të veprimtarive të planifikuara. Më tepër informacion për këtë çështje gjendet në botimin (e pritshëm) të vëllimit *Le terre albanesi redente. Vol. II La Ciameria*, përgatitur nga Donato Martucci.

4. Në planin e botimeve mbi Çamërinë e Kosovën, të hartuar më 10 maj 1941 kryetari i Qendrës së Studimeve për Shqipërinë Frances-

¹⁸ Schirò a Tagliavini, 13 agosto e 24 settembre 1942, po atje, b. 14, fasc. 242.

¹⁹ Nuk është e sigurt që Baldacci ta ketë marrë këtë letër, sepse në një letër më mëvonshme, të datës 21 korrik 1943, dërguar Qendrës së Studimeve ai vijon të kërkojë bocat e vëllimit mbi Çamërinë. Khs. Schirò a Baldacci, 12 gennaio 1943; Baldacci a CSA, 21 luglio 1943, po atje, b. 11, fasc. 66.

co Ercole i paraqet kryetarit të Akademisë Mbretërore të Italisë (Reale Accademia d'Italia) një sërë nismash me qëllim që si celebri degnamente nell'ambito della cultura e della scienza la vittoria delle armi che ha deciso il ritorno degli albanesi irredenti alla madre patria (të festohet denjësisht në lëmin e kulturës dhe të shkencës fitorja e armëve që ia kthyen atdheut shqiptarët e paçliruar)²⁰.

Përveç organizimit të një konference u propozua edhe hartimi dhe botimi i dy vëllimeve ku, përveç historisë, arkeologjisë dhe letërsisë të gjejë vend edhe gjuhësia që potrà interessarsi alle caratteristiche dialettali, ghego per il Cossovo, toscano per la Ciamuria, e delle rispettive estensioni areali (mund të merret me tiparet dialektore, të gegërishtes për Kosovën, të toskërishtes për Çamërinë, dhe të shtrirjes së zonave gjuhësore përkatëse)²¹.

Kryetari Ercole shkruan se puna do t'u besohet studiuesve kompetentë dhe shton se në përzgjedhjen e bashkëpunëtorëve *si cercherà una cameratesca collaborazione tra studiosi italiani e albanesi* (do të synohet një bashkëpunim kameratesk ndërmjet studiuesve italianë dhe atyre shqiptarë)²².

Në letrat që ruhen në arkivin e Accademia dei Lincei gjendet lista e studiuesve që janë thirrur për të bashkëpunuar në këtë projekt, ndër të cilët bien në sy, për pjesën gjuhësore Matteo Bartoli, Carlo Tagliavini, Eqrem Çabej dhe Namik Resuli. Në korrik 1941 Francesco Ercole i dërgoi Kryetarit të Akademisë Mbretërore listën paraprake të studiuesve që kishin pranuar të bashkëpunonin për botimet: për pjesën gjuhësore të vëllimit për Kosovën shfaqen emrat e Mustafa Krujës dhe Carlo Tagliavinit; në të njëjtën pjesë të botimit për Çamërinë haset përsëri emri i Tagliavinit, krahas Namik Resulit²³. Fatkeqësisht, siç kemi përmendur më sipër, vëllimi i dytë nuk u botua kurrë, pas disa shtyrjeve, gjurmët e të cilave i gjejmë në letërkëmbimin ndërmjet Schiròit dhe Tagliavinit. Ky i fundit ende duhet të dorëzojë artikullin e vet për Çamërinë dhe Schirò e qetëson il lavoro per il volume sulla Ciamuria non urge. Se hai tempo puoi stendere i caposaldi dello studio in maniera che ove dovessi chiedertelo, puoi completarlo in

²⁰ *Piano di pubblicazioni sulla Ciamuria e sul Cossovo...*, vep. cit.

²¹ Po atje.

²² Po atje.

²³ Khs. *Ercole a Federzoni, luglio 1941*, po atje, b. 5, fasc. 25.

breve tempo (puna për vëllimin mbi Çamërinë nuk është e ngutshme. Po të kesh kohë mund të hartosh pikat kyçe në mënyrë që, nëse ta kërkoj, ta përfundosh brenda një kohe të shkurtër.

Tagliavini pra mjaftohet me disa shënime, pa e hartuar artikullin; siç na vërteton Elton Prifti, i cili punon prej vitesh në arkivin personal të Tagliavinit, ky i fundit ka lënë vetëm një hartë të dialekteve të vizatuar me laps dhe disa shënime që janë përdorur në punime të tjera për t'iu referuar shkurt këtyre të folmeve. Nga letra që Schirò i dërgon Baldaccit më 12 janar 1943 mësohet se në listën e artikujve të gatshëm për vëllimin e dytë mungon vetëm artikulli i një studiuesi të cilin Schirò nuk e përmend me emër, por që mund të identifikohet me lehtësi si Tagliavini.

Ndërsa për vëllimin e parë kushtuar Kosovës të botuar më 1942 Tagliavini ka shkruar artikullin “Le parlate albanesi di tipo ghego orientale (Dardania e Macedonia nord-occidentale)”, përkthyer në shqip në serinë *Studime gjuhësore* botuar në Prishtinë “Të folmet shqipe të tipit të gegërishtes lindore Dardania dhe Maqedonia veriperëndimore”²⁴, që edhe pas shtatëdhjetë vjetësh ruan ende interes shkencor.

Artikulli i Tagliavinit është një përpjekje e parë për të sistemuar, me aq sa ia mundësonte materiali që kishte mbledhur, veçoritë e të folmeve të mësipërme përmes një analize kryesisht fonetike dhe shumë më pak morfologjike dhe leksikore. Vetë autori vë në dukje se ndihmesa e tij është e paplotë, duke qenë se kërkimi bëhej mbi “materiali a stampa fin qui esistenti, scarsi e di vario valore” (materiale të shtypura deri më sot, të pakët dhe me vlerë të ndryshme) ndër të cilët tekstet me karakter etnografik, shpeshherë të „normalizuar” nga mbledhësit e tyre, si edhe nga pak të dhëna të dorës së parë të mbledhura gjatë kërkimeve të shpejta të kryera në zonën e Kumanovës dhe Prishtinës, Përparimet e shumta në njohjen e këtyre të folmeve, falë edhe kërkimeve në terren dhe botimit të studimeve dhe monografive, bënë të mundur përgjatë viteve që të përvijoheshin ndarje të reja dialektore brenda këtyre zonave, duke ripërkufizuar përmbajtjen e emërimit *dialekte të gegërishtes verilindore*, së cilës Tagliavini

²⁴ Kontributi i Tagliavinit është ribotuar në përmbledhjen **Scritti minori** dhe i përkthyer në shqip është botuar në serinë **Studime gjuhësore** botuar në Prishtinë: *Të folmet shqipe të tipit të gegërishtes lindore: Dardania dhe Maqedonia veriperëndimore*, në: **Studime gjuhësore I (Dialektologji)**. Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës, f. 103-152.

dhe Lambertz (1943) i kishin dhënë një shtrirje mjaft të gjerë. Të dhënat e mbledhura nga studiues të ndryshëm, ndër të cilët në veçanti Bahri Beci (1990, 2007), shpjen në përfundimin se të folmet shqipe të Maqedonisë veriperëndimore, ndryshe nga ato kosovare që hyjnë në grupin lindor të gegërishtes veriore, bëjnë pjesë në gegërishten e mesme, krahas dialekteve të Matit, Fushë-Krujës, Mirditës, Lumës dhe Dibrës. Në disa prej ndihmesa më të fundit të Lumnije Jusufit, që mbështeten në një punë kërkimore të thelluar në terren, shfaqet kompleksiteti dhe heterogjeniteti demografik, gjeografik dhe gjuhësor i shqipes së Maqedonisë, në të cilën përveç toskërishtes gjenet një tipologji e larmishme e të folmeve të gegërishtes, dhe pikërisht të folme të llojit të gegërishtes verilindore (në veriperëndim të Kumanovës dhe verilindje të Tetovës), të gegërishtes së mesme, e shtrirë në të gjithë brezin perëndimor, të gegërishtes jugore (Krushevë, Demir Hisar) dhe të një lloji gjuhësor të cilin autorja e përkufizon si *Mittelgeisch*, me tipare shumë heterogjene.

Duke lënë mënjanë vështirësitë që lidhen me pasaktësitë në klasifikim, të cilat rrjedhin nga sasia e pakët e materialit që kishte në dispozicion, Tagliavini shfaq intuitë të sigurt në identifikimin për herë të parë të dukurive që më pas do të vërtetoheshin në terren dhe do të studioheshin në dhjetëvjeçarët vijues, si p.sh. shndërrimi zanor /o/ ~ /ö/ në të folmet e Dibrës (*grösh, vörb, bölet*)²⁵, dhe duke dhënë shpjegime të arsyeshme për dukuri të tjera karakteristike të gegërishtes së mesme, si qiellzorizimi i bashkëtingëllores grykore /g/ (khs. *gjaz, gjardh* etj.), që sipas studiuesit italian duhet të ketë zënë fill përpara zanoreve qiellzore, për t'u shtrirë më pas në pozicione të tjera²⁶.

²⁵ B. Beci, **Të folmet qendrore të shqipes së veriut (gegërishtja qendrore dhe grupimi i të folmeve të saj)**, EDFA, Tiranë 2007, p. 341.

²⁶ Po atje, p. 349.

Bibliografia

- Ajeti I. 1998: *Rreth disa tipareve gjuhësore të ligjëtimeve shqiptare të Kosovës*, in: **Vepra 2**. Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës. Botime të veçanta XXXI. Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. Libri 15. Prishtinë, pp. 97-104.
- Ajeti I. 2002: *Contributi i Carlo Tagliavinit në studimet e historisë së gjuhës shqipe*, in: **Vepra 5**. Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës. Botime të veçanta XLIII. Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. Libri 18. Prishtinë, pp. 63-69.
- Bartoli M. 1933: *L'atlante linguistico albanese*, in: **Essai de bibliographie de géographie linguistique générale**. Par J. Schrijnen. N.V. Dekker & Van de Vegt en J. W. van Leuwen. Nimègue, pp. 28-30.
- Beci B. 1990: *Të folmet lindore të gegërishtes veriore*, in: **Dialektologjia shiptare VI**. Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë. Istituti i gjuhësisë dhe i letërsisë. Tiranë, pp. 31-56.
- Beci B. 2007: **Të folmet qendrore të shqipes së veriut (gegërishtja qendrore dhe grupimi i të folmeve të saj)**. EDFA. Tiranë.
- Centro Studi per l'Albania 1942: **Le terre albanese redente. I. Kossovo**. Reale Accademia d'Italia. Roma
- Desnickaja A.V. 1976: **Gjuha shqipe dhe dialektet e saj**. Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës. Prishtinë 1976.
- Gjinari J., Shkurtaj Gj. 2003: **Dialektologjia**. Shtëpia botuese e librit universitar. Tiranë.
- Jusufi 2010: *Die albanischen Mundarten in Mazedonien und ihre Stellung in der albanischen Dialektologie*, in: **Scritti in onore di Eric Pratt hamp per il suo 90. compleanno**. Università della Calabria, Centro editoriale e librario. Rende, pp. 172-196.
- Jusufi L. 2011: **Die zentralgegische Mundartengruppe in Mazedonien**. Harrassowitz. Wiesbaden.
- Lambertz M. 1943: *Die Mundarten der albanischen Sprachen und ihre Erforschung*. In: **Leipziger Vierteljahrsschrift für Südosteuropa**, 7. Leipzig: Harrassowitz, pp. 123-160.
- Tagliavini C. 1942: *Le parlate albanesi di tipo ghego orientale*, in: **Le terre albanesi redente, I. Kossovo**. Centro Studi per l'Albania. Reale Accademia d'Italia. Roma, pp. 1-82.

Dhori Q. QIRJAZI, Universiteti i Selanikut

“MJALTË” NGA HOJET DHE TROJET E SHQIPES: FJALORI DORËSHKRIM SHQIP-GREQISHT I TH. MITKOS DHE SUAZA BALLKANIKE E TIJ

Abstrakt

Fillimisht do të japim një informacion të përgjithshëm rreth dy Fjalorëve, shqip-greqisht dhe greqisht-shqip, hartimin e të cilëve Thimi Mitkoja e pat ndërmarrë krahas punës për “Bletën Shqiptare”. Për fat të keq, ndryshe nga Fjalori i Kristoforidhit, Fjalorët e Mitkos mbeten në dorëshkrim edhe sot e kësaj dite. Botimi i tyre, e sidomos i Fjalorit shqip-greqisht, do të ndihmojë për vlerësimin më të plotë e më objektiv të ndihmesës së tij si leksikograf e si lëvrues i shqipes. Pasuria e lëndës leksikore që sjell Mitkoja ka për ta vendosur atë denjësisht në krah të Kristoforidhit. Mbase nuk e teprojmë të themi se, shumë shpejt, do të fillojmë të flasim për dy autorë bashkëkohës të Rilindjes kombëtare shqiptare, veprat leksikografike të të cilëve zënë e plotësojnë shoshoben, edhe pse njëra po del në dritë me mbi një shekull vonesë. Habent sua fati manuscripta!

Suaza ballkanike e Fjalorit shqip-greqisht të Mitkos përvijohet jo thjesht me faktin se kemi të bëjmë, në shikim të parë, me një fjalor dygjuhësh, shqip-greqisht, dhe as ngaqë fjalë-huazime prej gjuhëve ballkanike kanë zënë vend në fjalësin e tij, së bashku me indikacionet përkatëse. Ajo shihet kryesisht nga mënyra si pasqyrohen a si konceptohen raportet mes shqipes e këtyre gjuhëve. Në këtë pikë, bindjet e Mitkos për afrinë e shqipes me greqishten, formuar nën ndikimin e Kamardës dhe formuluar shkoqur në parathënien e “Bletës” apo në shënimin hyrës të “Λεξιλόγιον Ἀλβανο-Ελληνικόν”, që shoqëron këtë veper, na japin dorë për të ndjekur hap pas hapi e fjalë pas fjale mënyrën se si kjo teori bëhet pjesë e programit dhe e praktikës leksikografike të autorit.

Deri më sot e kemi njohur Th. Mitkon (1820-1890) më tepër si folklorist, e madje si themeluesin e folkloristikës shqiptare, dhe më pak si leksikograf. Ndonëse “Bleta Shqiptare” (Aleksandri 1878) përmban edhe një sprovë leksikografike me titull “Λεξιλόγιον Ἀλβανο-Ελληνικόν” (Fjalorth shqip-greqisht) vëmendja e studiuesve ka qenë përqendruar kryesisht në lëndën folklorike të grumbulluar prej tij.

Prurjet e reja arkivore të viteve '80 të shekullit të kaluar e zgjeruan ndjeshëm fondin e dorëshkrimeve të Mitkos, duke e pasuruar me mijëra fletë deri atëherë të panjohura të opusit të tij. Botimi i plotë i

veprës së Mitkos është një ndërmarrje e vështirë, që kërkon kohë, mund, njohuri dhe bashkëpunim të specialistëve të fushave të ndryshme.

Mes dorëshkrimeve të Mitkos vend të veçantë zënë edhe dy fjalorë, shqip-greqisht dhe greqisht-shqip, hartimin e të cilëve autori e pat ndërmarrë krahas punës për përgatitjen e “Bletës Shqiptare”. Por, ndërsa “Bleta” e gjeti rrugën e vështirë e të lodhshme të botimit, fjalorët e Mitkos, ndryshe nga Fjalori i Kristoforidhit, botuar edhe ky pas shumë peripecish, mbeten në dorëshkrim edhe sot e kësaj dite.

S’ka dyshim se botimi i tyre do të ndihmojë për vlerësimin më të plotë e më objektiv të kontributit të Mitkos si leksikograf e si lërvues i shqipes. Pasuria e lëndës leksikore që sjell Mitkoja e vendos atë denjësisht në krah të Kristoforidhit. Duke e rizbuluar dhe rivlerësuar Mitkon leksikograf, do të fillojmë të flasim për dy autorë bashkëkohës të Rilindjes kombëtare shqiptare, veprat e të cilëve zënë e plotësojnë shoshoben, edhe pse njëra po del në dritë me mbi një shekull vonesë. *Habent sua fati manuscripta!*

• Njoftime për Fjalorin shqip-greqisht të Th.Mitkos

Në këtë kumtesë do të japim disa njoftime paraprake për Fjalorin shqip-greqisht të Mitkos, të cilin po e përgatisim për botim, dhe paskëtaj do të ndalemi në suazën ballkanike të veprës.

Koha e hartimit të Fjalorit shqip-greqisht

Lista e shkurtesave të emrave të vendeve dhe të veprave prej nga vjen apo është vjelë lënda leksikore (Shih Shtojcën I), e gjetur mes dorëshkrimeve, na ndihmon të arrijmë në përfundimin se Mitkoja ka grumbulluar material nga libra të botuar deri në vitin 1888, gjë që do të thotë se ai nuk e ka ndërprerë punën e leksikografit deri në vitet e fundit të jetës, edhe pse, siç shkruan J. Buló, i pati humbur shpresat për botimin e fjalorit/fjalorëve.

Nga ana tjetër, në një letër dërguar Dh. Kamardës më 1868, e cila ruhet në AQSHSH, ai shprehet qartë për nevojën e hartimit të një fjalori shqip – greqisht nga ana e arbëreshëve te Italisë: *Përandaj, dotë ishte një punë emirë edhe evëleshime për Shqipëtarët, ndë munt të jipeshe ka Italia një gazetë vetëm Shqip edhe një Leksiko Shqip e Gërqisht.*

Pak më lart shkruante: *Zemërën time të plagosurë për fatkeqërin' e madhe të Shqipëriës sotme, m'a ngroh meaft patriotismi, dituria edhe mësimi i Shqipëtarëve Italiës. Ndodhur Shqipëria në mes dy dritrave të mëdha, dotë ndritsonetë edhe dotë mësonetë, por sotpërsot ka Elladha gluha na prishetë edhe na humbetë ngadit.*

Puna për grumbullimin e lëndës folklorike mbase ka qenë shtysa e parë për t'i hyrë ai vetë hartimit të Leksiko-it Shqip e Gërqisht. Modest dhe i përmbajtur prej natyre, apo i ndodhur para një qerthulli problemesh të vështira për t'u zgjidhur, ai flet pak për planet e veta leksikografike dhe konsideron se të tjerë, si K. Kristoforidhi, janë në gjendje t'ia dalin mbanë më mirë kësaj pune.

Studimi i fondit të Mitkos na bën të mendojmë se puna e tij leksikografike ndahet në dy faza. *Faza e parë* ka të bëjë me grumbullimin e lëndës. Janë me qindra fletët ku regjistron në mënyrë të përzier fjalë të shqipes e të greqishtes, renditur përgjithësisht sipas alfabetit grek, meqenëse edhe fjalët shqip i shkruan me ndihmën e gër-mave të greqishtes. Krahasimi i lëndës së këtyre fletëve me lëndën e përfshirë në fjalësin e *fazës së dytë*, tregon se jo gjithçka e regjistruar gjatë fazës së parë ka zënë vend në faqet e asaj që Mitkoja e mendonte si variant përfundimtar të fjalorit.

Hapat e parë të Mitkos leksikograf mund të ndiqen edhe nga shqyrtimi krahasues i Λεξιλόγιον Ἀλβανο-Ἑλληνικόν të “Bletës” me lëndën e Fjalorëve. E vërteta është se deri më sot ai është parë si një Fjalorth shpjegues i “Bletës”, por duhet thënë se, krahas këtij funksioni utilitar, përmbahen në të elemente që e bëjnë një sprovë të mëvetësishme leksikografike. Po ndalemi vetëm në një shembull, të marrë prej f. 233 të origjinalit të “Bletës”,

Χηνδσίρ, χοῖρος, γουροῦνι. (άλβ.) δέερ –ι, καὶ δέρκ –ου, γ. θῖ –ου (πρβλ. σῦς, φήρ, θήρ, θηρίον, καὶ (Grim) δέρκω, δορκάς, καὶ τὸ Ἀγγλ. deer = δορκάς, καὶ ἀλβ. dre = ἔλαφος). ἀρβ. [αράβικον = arabisht]

që përkon me f. 495 të botimit të v. 1981:

hënxhír, χοῖρος, γουροῦνι. (shq.) derr-i, dhe δέρκ –ου, (geg. thi-u (Krs. σῦς, φήρ, θήρ, θηρίον, dhe (Grim) δέρκω, δορκάς, dhe anglisht deer = δορκάς, dhe shqip dre = ἔλαφος,

dhe që e hasim edhe në dorëshkrimin e Fjalorit shqip-greqisht të Mitkos:

dēp-i. τ. χοῖρος, γουροῦνι (αρβήρ) λέγεται δέρκ-ου. (γεγστ.) θῖ -ου = (ἀγριόχοιρος ?) ἢ ἀπλῶς χοῖρος. δέρκου (πλθ.) δίρκιε-τη. [dēr-i. tosk. χοῖρος, γουροῦνι (arbër) thuhet *derk-u*. (geg.) *thī-u* = (derr i egër ?) apo thjesht *derr*: dérku (πλθ.) δίρκε-τῆ.]

Leximi i plotë (dhe jo i cunguar, siç ndodh me botimin e v. 1981) i shënimit hyrës të Fjalorthit (Shih Shtojcën II) tregon se Mitkoja përpiket të krahasojë dhe të vlerësojë fjalësin e shqipes në raport me gjuhë të tjera (për hollësi shih më poshtë), ndërsa shqyrtimi i imtë i mikrostrukturës dëfton kujdesin e autorit për të renditur një varg sinonimesh të shqipes përballë fjalës së huaj, (të cilat më pas do të zënë vend në faqet e Fjalorit shqip-greqisht). Kësisoj, në të dy rastet, “leksikografia dhe ideologjia” ecin krah për krah, por edhe i ndriçojnë udhën njëra-tjetrës. Në një shënim të thukët të tij (Shih Shtojcën III), Mitkoja thekson se kuptimi i fjalëve rroket më mirë në ngërthim të fjalisë. Me të njëjtën logjikë, edhe vepra leksikografike e Mitkos duhet parë në kuadër të prirjeve, të interesave dhe të kundërshtive të epokës gjatë së cilës u shfaq. Pra, *fjala* e vështruar në ngërthim të fjalisë, por edhe *fjala për fjalët* e vështruar në ngërthim të shoqërisë.

Ka shumë indikacione që na bëjnë të besojmë se Mitkoja nuk arriti t’i japë dorën e fundit veprës së vet leksikografike. P.sh., në Fjalorin shqip-greqisht, rrjeti i referencave të brendshme mbetet në mjaft raste i mangët, ngaqë jo gjithnjë janë pasqyruar si zëra më vete fjalët që përdoren si pika referimi.

Burimet e Mitkos

Lista e shkurtesave (Shtojca I) na jep mundësinë e njohjes me burimet e shkruara që përdor Mitkoja si dhe me shpërndarjen gjeografike të lëndës që ai ka vjelë prej bashkatdhetarësh. Mund të thuhet se lista përmban pothuaj gjithë librat shqip, apo që lidhen me shqipen, të botuar deri në vitin 1888, ndër të cilët vend të veçantë zë letërsia arbëreshe. (Ai vjel lëndë deri edhe nga letrat që i dërgojnë savantët arbëreshë, siç shënon në një numër rastesh për Kamardën). Megjithatë, ka raste titujsh që hasen në faqet e Fjalorit e jo në listën e lartpërmendur, siç ndodh me *Kuvendin e Arbënit*, nga teksti i të cilit Mitkoja ka bërë citime të shumta, shoqëruar me shkurtesën *Conc.* ose *Concil.* E njëjta gjë ndodh edhe me disa nga pikat e ndryshme të mbarë hapësirës shqipfolëse, si Tirana, Malësia e Gjakovës, Opari, Sheperi etj. Në një listë tjetër të papërfunduar, të gjetur në shënimet e Mitkos, hasim në

shkurtesën Ἐπιπ. -Ἐπιτοπίως ἐν τῇ κυρίως Ἀλβανίᾳ, që do të thotë [mbledhur] në terren, në Shqipërinë e mirëfilltë e që tregon se Mitkoja ka grumbulluar lëndë edhe gjatë udhëtimeve në viset shqipfolëse.

Megjithatë, lëndën kryesore të shqipes së folur Mitkoja e vjel gjatë kontakteve me shqiptarë të kolonive të Egjiptit, të ardhur këtu nga anë të ndryshme të Shqipërisë. Siç shkruante S. Dineja, "...për fat të mirë atë kohë ndodheshin edhe shqiptarë shumë në Egjipt; ngado të shkonje do të piqnje shqiptarë. Karakollet e Kajros qenë plot gegë e toskë. Këngët e vallet nuk reshtnin; ...na dukej sikur gjendeshim në Shqipëri".

Natyra e Fjalorit dhe teknika leksikografike

Gjatë hartimit të Fjalorit shqip-greqisht, Mitkoja duket se ka në mend kryesisht shqipfolësin që njeh edhe greqishten (shih f.v. listën e abonentëve të "Bletës", në botimin origjinal të Aleksandrisë) e që nëpërmjet kësaj mund të ndihmohet për t'u bërë zot i pasurive të gjuhës së vet amtare. Pra, edhe në rastin e Mitkos, ashtu si edhe te Kristo-foridhi, *greqishtja nuk është gjuha e pikëmbërritjes e një fjalori tradicional dygjuhësh*. Ajo është hallka ndërmjetëse, *metagjuha*, që e ndihmon autorin për t'u nisur prej shqipes e për të mbërritur po tek ajo:

cipë-a. Ὑμῖν (Νερ.), ἡ λεπτή φλούδα τοῦ κρομμυδιοῦ, ἡ ἐπίδερμις τοῦ ἀνθρώπινου σώματος καὶ τοῦ ὄφεως, λεπτόν μεταξωτόν ἢ βαμπακερόν ὕφασμα, λεπτόν οἰονδήποτε ἐπικάλυμμα (ἐπί ζυλουργικῆς ἢ ραπτικῆς κλπ.). "Është" e hollë, si cipë qepe. -Cipë të mëndafshhtë. -Këjo dhogë ka cipë përsipër". Ἐτι (πελ.σγ.λ. 61) φύλλον π.χ. τῆς πῆττας κλπ. [cipë-a. Membranë (Ner.), lëvozhga e hollë e qepës, epiderma e trupit të njeriut dhe të gjarpërit, pëlhurë e hollë mëndafshi a pambuku, çdo lloj mbulese e imtë (në marangozi a në rrobaqepësi etj.). "Është" e hollë, si cipë qepe. -Cipë të mëndafshhtë. -Këjo dhogë ka cipë përsipër". Gjithashtu (πελ.σγ.λ. 61) fletë p.sh. e byrekut etj.]

fîér-i. φρύγανον, ἡ φτέρη κυρίως, ὅπερ ὁμοιάζει μὲ τὸ φρύγανον. Εἶναι χόρτον λίαν δροσερόν, φυόμενο εἰς τὰ ὄρη τῆς Τοσκαρίας μὲ τὸ ὅποιον περιτυλίσσουν τὸ χιόνι, πορτοκάλια κλπ. πρὸς διατήρησιν. [fîér-i. shkarpë, kryesisht fieri, që ngjan me shkarpat. Është bar që mban mjaft fresk, që mbin në malet e Toskërisë dhe me të cilin mbështjellin borën, portokajtë etj. për t'i ruajtur.]

káčkë-a. Κάρυον, καρύδι, ὅταν ἔχει ξεφλουδισμένην τὴν ὅλως ἐπάνωθι (φυτικὴν) πρώτην φλούδα. Ὅταν δὲ αὐτὸ εἶναι κεκαλυμμένον καὶ μὲ τὴν ρηθεῖσαν ἐξωτερικὴν φλούδα, τότε λέγεται árrë-a. [káčkë-a. Arrë, kokërr arre, kur është e zhveshur nga e gjithë lëvozhga e parë (bimore) e sipërme. Kur është e mbuluar dhe me lëvozhgën e jashtme të përmendur më lart, atëherë quhet árrë-a.]

E vështruar në këtë prizëm, kjo vepër inkadrohet plotësisht në mënyrën si i koncepton Mitkoja marrëdhëniet e shqipes me greqishten, përkatësisht të shqiptarëve me grekët në dhjetëvjeçarët e fundit të shek. XIX, e pikërisht në prag, gjatë e pas viteve 1878. Njohës dhe adhurues i kulturës greke, por edhe ndriçimtar e mbrojtës i kombit të vet, ai ka arritur të kristalizojë një qëndrim që mbetet i admirueshëm edhe sot e kësaj dite. Dritat e qytetërimit helen nuk ia lëbyrin sytë dhe as ia errësojnë mendtë. Në parathënien e “Bletës”, ai shprehet qartë se vlerat e këtij qytetërimi mund të bëhen pronë e kombit të shqiptarëve vetëm nëpërmjet të gjuhës së tyre amtare. Pra greqishtja mund të shërbejë si model a si faktor ndihmës për selitjen e shqipes, por kurrsesi si mjet për greqizimin e shqiptarëve. Ndaj edhe i bën thirrje fqinjës jugore të mos sillet si njerëz ziliqare ndaj tyre. Sikurse shënon prof. A. Buda, kemi të bëjmë me një realitet politik kontradiktor, që buron herë nga konvergimi e herë nga divergimi i interesave të të dy kombeve, prej të cilëve njëri ka krijuar shtetin e vet dhe tjetri ndodhet në udhë e sipër. Brenda këtij kuadri, dhe gjithnjë nën shenjën e iluminizmit evropian e ballkanik, duhet parë edhe qëndrimi i Mitkos, i cili, në moshë ende të njomë, përshëndet ringritjen më 1843 të një shkolle greke në Korçë, kurse më 1868 i shkruan Kamardës se “sotpërsot ka Elladha gluha na prishetë edhe na humbetë ngadit”, për të arritur dhjetë vjet më pas në artikullimin e qëndrimit të shprehur në parathënien e “Bletës”, ku, siç u shtjellua më lart, vendoset një kufi i qartë mes hapësirës kulturore të greqishtes dhe hapësirës etnike të grekëve.

Ndonëse nuk na ka lënë (a nuk kemi gjetur ende) ndonjë parashitesë të kriterëve që zbaton, duket qartë se Mitkoja e shoshit lëndën leksikore para se ta përfshijë në variantin përfundimtar. Kësisoj kufizohet numri i fjalëve të huaja (nuk ka përfshirë p.sh. fjalën *jetim*, të cilën e gjejmë në fletët e fazës së parë) dhe i neologjizmave – huazime përkthimore (mungon p.sh. fjala *mirëvetijë* e J. Vretos, lentuar sipas greqishtes *χρηστοθήθεια*), me të cilat tregohet më “dorëlëshuar” në rastin e Fjalorit greqisht-shqip. Nuk ka shumë rëndësi nëse Mitkoja ka arritur vetë të këto kritere apo është ndikuar nga diskutimet që bëheshin mes savantëve shqiptarë të kohës. E rëndësishme është se ai rreket të vendosë një drejtpeshim mes lëndës që gjuha e largon (a duhet ta largojë) si “mish të huaj” dhe asaj që ndoshta mund ta zëvendësojë me përdorimin e neologjizmave të përfutur me anë të kalkimit.

Për mendimin tonë, kontakti i vazhdueshëm i Mitkos folklorist me gjuhën e popullit i vjen në ndihmë sa e sa herë Mitkos leksikograf. I mëkuar me “ujët e bekuar” të gurrës/gjuhës popullore ai arrin t’i shmanget modës a manisë së neologjizmave.

Fjalori sjell lëndë leksikore nga mbarë viset ku flitet shqipja e madje janë jo të pakta rastet e lemave ku gjejmë vargje të tëra sino-nimike, siç duket në shembujt vijues:

ájkë-a. Τσούπα τοῦ βρασμένου γάλακτος· ἀνθόγαλα, τὸ (τουρκ.) καϊμάκι, ἀφρόγαλα, πῦαρ. Ἰδε máazë-a. (flj. shtálpë-a). [*ájkë-a*. Cìpë e qumështit të zier; ajkë, kajmaku (turq.), shkumë qumështi, kulloshtër. Shih máazë-a. (flj. shtálpë-a)].

búbas-i. (Σκόδρ.) Ἐλμινς, λεβίθι, ἤτοι σκολήκι τῆς κοιλίας καὶ τῶν ἐντέρων. Οἱ χωρικοὶ Σκόδρας τὸ λέγουσι rájëza. Ἐν Κορυτσῶ δὲ γλιστ-ι, πλθ. γλίστα. [*búbas-i*. (Shkodr.) Bubë, ose krimb barku a zorrësh. Katundarët e Shkodrës e quajnë rájëza, ndërsa në Korçë glist-i, shm. glísta.]

trobolicë-a (πρμτ) ἢ túndës-i (κρτζς). Τάλαρος ἢ κάδδη, ὅπου κτυποῦν το γάλα ἵνα βγάλουν τὸ βούτυρον. Ἰδ. pëti-ja καὶ túndës καὶ tī-u. (ἴσως trubulicë). [*trobolicë-a* (Prmt) a túndës-i (Krç.). Talër a kade, ku rrahin qumështin që të nxjerrin gjalpë. Shih pëti-ja dhe túndës dhe tī-u. (ndoshta trubulicë).]

Krahasuar me Kristoforidhin, numri i kalkeve në Fjalorin shqip-greqisht të Mitkos është shumë më i kufizuar. Këto fjalë i merr zakonisht prej të tretësh ose, në raste të veçanta prej gjuhës së popullit, ku, siç dihet, numri i tyre është i vogël.

anáke-a (πλθτ.) anáka-të. (ρψ.pd. 40 καὶ flj.). Περιδέραιον. Ἰδ. reth-gúshë καὶ stríngë. [*anáke-a* (shm.) anáka-të. (rps.rd. 40 dhe flj.). Gjerdan. Shih reth-gúshë dhe stríngë.]

bënjapiésëmë ἢ bënjapyésëmë-i (flj. 7, 248). Βουλευτής, ὑπάλληλος τῆς Κυβερνήσεως, ufficiale. [*bënjapiésëmë* a *bënjapyésëmë-i* (flj. 7, 248). Deputet, nëpunës i Qeverisë, ufficiale.]

hie-madhëri-ja (ditour. 8ⁿ 139). Μεγαλοπρέπεια. [*hie-madhëri-ja* (ditur. 8-të 139). Madhështi.]

hieróre-ja. (ευαγ. Ματθ. 31, 7) ἱερὸν, ναὸς, ἱερὸν βῆμα. (ἴσως hyierōre) καὶ (Kend. 18) hietōre. [*hieróre-ja*. (ευαγ. Ματθ. 31, 7) tempull, kishë, tempull i shenjtë (ndoshta hyierōre) dhe (Kend. 18) hietōre.]

Bótës-i. Κύριον ὄνομα (Κοσμάς). [*Bótës-i*. Emër i përveçëm (Kozma).]

farmírë-i (πελσγ. 10). Θεός. “Farmiri të të ruanjë”. [*farmírë-i* (πελσγ. 10). Zot. “Farmiri të të ruanjë”.]

Në vitet kur Mitkoja harton fjalorët e vet, nuk ka nisur ende vërshimi në shqipen i neologjizmave nga gjuhët neolatine, që do ndodhë ca më vonë. P.sh., fjala greke βουλευτής, që te Mitkoja (Fjalor greqisht-shqip) jepet me barasvlerësin *kryeplak*, më pas do t’ia lërë vendin fjalës *deputet*.

Megjithëse Mitkoja nuk shquhet për një përpunim leksikografik të veçantë të lëndës (shpesh herë trajtat gramatikore hyjnë si zëra më vete të Fjalorit), ai jep rregullisht dysorët fonetikë dhe sinonimet e fjalëve-lemma si dhe veçon kuptimin e mirëfilltë nga kuptimi i figurshëm i fjalës. Informacioni gramatikor pasqyrohet në mënyrë të rregullt, por një mangësi e Fjalorit është numri i kufizuar i shembujve të përdorimit të fjalëve. Hasen edhe raste fjalësh të lëna pa shpjegim, ose që shoqërohen vetëm me shembuj përdorimi.

bárrë-a. Βάρος, φορτίον. (μτφρ.) Εὐθύνη, καθήκον, ἠθική ὑποχρέωσις. [*bárrë-a*. Barrë, ngarkesë. (mtfr.) Përgjegjësi, detyrë, detyrim moral.]

bóshiti. Ἀτρακτος, ἀδράκτι ἄξων – τὸ ξύλον τῆς ἀμάξης, περὶ τὸ ὅποιον στρέφονται οἱ τροχοί. (πλθτ.) pshtínjë-të, àντὶ bështínjë. [*bóshiti*. Bosht; aks – druri i qerres, rreth të cilit vërtiten rrotat. (shm.) pshtínjë-të, në vend të bështínjë.]

bulmët-i. Γαλακτερά ἐδέσματα. Τὸ εἰς γάλατα προῖδν τῶν γαλακτοφόρων ζώων. “Simviet s’kanë bulmet bagëtia”. (μετφρ.) προῖδν ἐν γένει. “Ky stan këtë bulmet ka”. “Ἐτι bulmët = καρύκευμα τῶν φαγητῶν, καὶ ἐν γένει προσφάγι (σκδρ.). (”Id. bulmīnj καὶ përbulët). “Mos keni ndoonjë bulmet për me hangrun? (Εὐαγ. 321)”, ἄρτυμα. [*bulmët-i*. Gatesa qumështi. Produkti në qumësht i kafshëve qumështore. “Simviet s’kanë bulmet bagëtia”. (metfr.) produkti në përgjithësi. “Ky stan këtë bulmet ka”. Gjithashtu bulmët = mëlmesë e gjellëve, dhe përgjithësisht mëlmesë (shkdr.). (Shih. bulmīnj dhe përbulët). “Mos keni ndoonjë bulmet për me hangrun? (Εὐαγ. 321)”, mëlmesë.]

Pjesë më vete e mikrostrukturës së zërave të përfshirë në Fjalor janë edhe “përsiatjet” etimologjike të Mitkos, për të cilat do të flitet më hollësisht në pjesën e dytë të kumtesës. Etimologjitë popullore dhe ndonjëherë arbitrare hasen jo rrallë në veprën leksikografike të tij:

der-be-dér (ἀντὶ dérë-për-dërë). Ἐπαίτης, ζήτουλας, ζητιάνος. (φαίνεται μὲν ἡ λέξις τουρκικῆ, ἀλλ’ εἶναι καθαρῶς ἀλβανικῆ ὑπὸ τῶν Τούρκων παρεφθαρμένη). ”Id. përdëresi. [*der-be-dér* (në vend të dérë-për-dërë). Lypës, lypsar, kërkaç. (fjala duket si turke, por është kryekrejt shqipe e bastarduar prej turqve). Shih përdëresi.]

dórrë-ja (ἀρσ. καὶ θηλυκ.). (Χαον.) Εὐσωμος καὶ εὐρωστος, ρωμαλέος, μάχιμος, ὄρεινός, τραχύς, τολμηρός· ἀλλὰ κάπως περιφρονητικῆ ἢ λέξις, ὅθεν χωριάτης. (Ἄν ἔχη σχέσιν μὲ τὸ Δωριεῦς)· (λέξ. ἐν Χαονία προπάντων ἐπὶ γυναικῶν ὄρεινῶν φιλοπολέμων συνηθιζομένη). [*dórrë-ja* (mashk. dhe fem.). (Kaon.) Trupmadh dhe i fuqishëm, burrëror, luftarak, malësor, i sertë, guximtar; por fjala ka një nuancë disi përbuzëse, pra katunar. (Nëse ka lidhje me fj. Δωριεῦς)· (fjalë e përdorur sidomos në Kaoni, zakonisht për gra malësore të etura për luftë.)]

Janë interesante gjithashtu edhe sugjerimet e tij me karakter drejtshkrimor, të cilat i mbështet në kritere etimologjike, shpesh para-shkencore:

deftër-i. Κατάστιχον, κατάλογος, (Concil.) πίναξ, (dëftēnj = δεικνύω), δείκτης. Γραπτέον dëftër. [*dëftër-i*. Regjistër, katalog, (Concil.) tabelë, (dëftēnj = δεικνύω), tregues. Duhet shkruar dëftër.]

Vlera e Fjalorit dhe vendi i tij në leksikografinë shqiptare

Për të kuptuar vlerat e Fjalorit shqip-greqisht të Mitkos dhe vendin e tij në traditën leksikografike shqiptare është e nevojshme ta krahasojmë atë me Fjalorin e Kristoforidhit, vepër e cila konsiderohet më e mira dhe më e plota e periudhës së Rilindjes në lëmë të leksikografisë. Meqenëse krahasimi i hollësishëm i dy fjalorëve do të ndërmerret në kuadër të botimit të plotë të veprës leksikografike të Mitkos, këtu do të kufizohemi të themi se këto dy vepra qëndrojnë në krah të njëra-tjetrës dhe plotësojnë shoshoben. Ato mbajnë pashmangërisht edhe vulën e rrethanave dhe të personalitetit të njerëzve që i hartuan.

Nga pikëpamja sasiore, numri i njësive leksikore të Fjalorit të Kristoforidhit është dy herë më i madh sesa ai i Fjalorit të Mitkos: 11.675 fjalë tek i pari, rreth 5.900 tek i dyti. Por ky numër nuk përfshin vjeljen e brendshme të lëndës së Mitkos, e cila, në të kundërt, fallë punës së Xhuvanit, e rriti ndjeshëm numrin e fjalëve të Kristoforidhit. Nga ana tjetër, shfrytëzimi në tërësi i lëndës së mbledhur si dhe hartimi i një versioni invers të Fjalorit greqisht-shqip të Mitkos kanë për ta rritur ndjeshëm numrin e fjalëve të ky i fundit.

Krahasimi i mikrostrukturës së dy fjalorëve tregon se njëri ka fjalë a kuptime fjalësh që nuk hasen te tjetri dhe anasjelltas. Po japim disa syresh për të gjykuar mbi drejtësinë e këtij përfundimi. Mitkoja ka fjalën

mjeraúshë-a (Δεβολ και Γόρρα) μύρμηξ, (γ) thënëgëlë, και (Τοσκ.) mizë-përdhëseja. (Ίσως γραπτέον mieraúshë, και mieraúshkë). [*mjeraúshë-a* (Devoll dhe Gorrë) milingonë, (geg.) thënëgëlë, dhe (tosk.) mizë-përdhëse-ja. (Mbase duhet shkruar mieraúshë, dhe mieraúshkë).]

që nuk e gjejmë te Kristoforidhi, i cili ka për këtë emërtim fjalë të tjera (shih botimin e vitit 1904, f. 244, si dhe botimin e vitit 1961, f. 365). Po kështu, ndërta Mitkoja ka

biëshkë-a γ. Ὅρος ἢ δένδρον, χρήσιμον πρὸς βοσκήν ποιμνίων (Concil. 12), βουνὸν φαλακρὸν. [*biëshkë-a* g. Mal ose lis, i dobishëm për kullotjen e kopeve; (Concil. 12), mal i zhveshur] (nënvizimet tonat, Dh. Q.),

Kristoforidhi nuk i përmend fare kuptimet ‘kullotë’ dhe ‘mal i zhveshur’:

bieshkë-a (Shk.) sh. bieshka-të = ὄρος, krhs. mal-i = βουνόν, kodrë-a = λόφος (edhe bishka = ύψηλόν, ἔλλην. βόσκω).

Duke u zhvendosur në një fushë të afërt semantike, vërejmë se te Kristoforidhi fjala

bulmet-i (d. t.) sh. bulmete-të em. ὄα. (në Shk. sh. i papërd.) = τὰ ἐκ τοῦ γάλακτος ἔξαγόμενα, τυρός, βούτυρον κ.τ.λ. (Botimi 1961)

nuk pasqyrohet me gjerësinë kuptimore që e hasëm te Mitkoja (shih më lart). Po kështu, te Mitkoja fjalët *farkë* dhe *farkonj* kanë kuptime më të detajuara sesa te Kristoforidhi.

M.: farkë-a. Τὸ ὄνυχιον τῶν ζώων, οἰονεὶ χαράκωμα. 2/ ἡ στρώσις, ἡ οἰκοδομὴ τῆς λεκάνης τῆς βρύσεως, ἡ λιθοστρωσις τῆς αὐλῆς, τῆς οἰκίας, τοῦ ἐδάφους, κλπ. “Te kroj i farkuarë”. [*farkë-a*. Thoi i kafshëve, diçka si gërvishtje. 2/ shtresa, konstrukti i bazës së çezmës, pjesa e shtruar me plloça e oborrit, e shtëpisë, e truallit, etj. “Te kroj i farkuarë”.]

K.: farkë-a. = ἡ ἐστία τοῦ σιδηρουργοῦ [vatra e kovaçit] (Botimi 1961)

M.: farkōnj. Πεταλόνω τὸν ἵππον. 2/ οἰκοδομῶ τὴν λεκάνην τῆς βρύσεως, λιθοστρόνω τὸ δωμάτιον, ἢ τὴν αὐλὴν τῆς οἰκίας κλπ. Ἔτι (ἐπὶ ματίων, ὄπλων κλπ.) χρυσόνω εἰς τρόπον ὥστε νὰ εἶναι ὡς πλάκα. “Me silahun të farkuarë”. [*farkōnj*. Mbath kalin. 2/ ndërtoj bazën e çezmës, shtroj me plloça dhomën, apo oborrin e shtëpisë etj. Gjithashtu (për sy, armë etj.) praroj në mënyrë që të jetë si pllakë. “Me silahun të farkuarë”.]

K.: farkonj. = mbërthenj me gozhdë patkojt e kalit përsëri, kur janë ngrënë patkojt kalit = πεταλώνω. (Botimi 1961)

Probleme të botimit të veprës leksikografike të Mitkos

Botimi integral i veprës leksikografike të Mitkos, duke përfshirë në një vëllim të vetëm gjithë kontributet leksikografike të tij, nisat nga premisa se këto kontribute kanë mes tyre një lidhje organike e si të tilla duhen marrë e duhen parë së bashku. Fjalori shqip-greqisht gjen vazhdimin e vet te Fjalori greqisht-shqip, sikurse Fjalorthi shqip-greqisht i “Bletës” plotësohet e korrigjohet nga një sprovë leksikografike e panjohur deri më sot, për të cilën do të flitet më poshtë (Shih Shtojcën III).

Botimi has në probleme të natyrës teknike, që do të zgjidhen duke u mbështetur në përvojën e derisotme (shih sidomos botimet e Fjalorit të Kristoforidhit të v. 1904 dhe të v. 1961) si dhe në mundësitë dhe lehtësitë që na ofron teknologjia moderne. Botimi do të shoqërohet me një CD ku do të përfshihen të gjitha fotografitë e fletëve të

dorëshkrimit. Kjo do të thotë se, në një rënë anë, është e mundur të krahasohen në çdo rast dorëshkrimet me zgjidhjet e dhëna prej botuesit, dhe, në anën tjetër, fondi leksikografik i arkivit të Mitkos “çel” dyert për studim të mëtejshëm.

- **Përmasa ballkanike e Fjalorit**

Suaza ballkanike e Fjalorit shqip-greqisht të Mitkos përvijohet jo thjesht me faktin se kemi të bëjmë, në shikim të parë, me një fjalor dygjuhësh, dhe as ngaqë fjalë-huazime prej gjuhëve ballkanike kanë zënë vend në fjalësin e tij, së bashku me indikacionet përkatëse. Ajo shihet kryesisht nga mënyra si pasqyrohen a si konceptohen raportet mes shqipes e këtyre gjuhëve. Në këtë pikë, bindjet e Mitkos për afrinë e shqipes me greqishten, formuar nën ndikimin e Kamardës dhe formuluar shkoqur në parathënien e “Bletës” apo në shënimin hyrës të “Λεξιλόγιον Ἀλβανο - Ἑλληνικόν”, që shoqëron këtë vepër, na japin dorë për të ndjekur hap pas hapi e fjalë pas fjale mënyrën se si kjo teori bëhet pjesë e programit dhe e praktikës leksikografike të autorit (Shih Shtojcën II).

Prirja e tij e hershme për të hetuar kudo e ngado lidhjet e mundshme të shqipes me greqishten haset disi më e përmbajtur në faqet e Fjalorit shqip-greqisht. Megjithatë, duke i mëshuar idesë se këto dy gjuhë kanë lidhje të lashta Mitkoja përgatit terrenin për t’i dhënë greqishtes një status të veçantë: sipas tij, ndryshe nga gjuhët e tjera, ajo do të jetë burimi i njëmendtë i plotësimit të nevojave eventuale leksikore të shqipes (Shih Shtojcën II).

Është për t’u vënë re se Mitkoja i shoqëron me shënimin *turq.* edhe fjalët greke të pjesës shpjeguese të Fjalorit, çka do të thotë se ai ka një ndjeshmëri të veçantë ndaj huazimeve turke, e cila mund të shihet e të shpjegohet edhe në kuadër ballkanik. Qëndrime të ngjashme hasen edhe në procesin dhe përpjekjet për lëvrimin e gjuhëve kombëtare të kombeve fqinje të shqiptarëve, të cilat Mitkoja i njeh dhe i ndjek. Megjithëse është kundër përdorimit të fjalëve të huaja, ai e përsërit më se një herë se nuk mund t’i heqë ato nga tekstet folklorike të “Bletës”.

Sikurse u tha më lart, sprova me titull “Korrigjim fjalësh të gabuara të librit të parë [të “Bletës”] përbën një kontribut leksikografik

të panjohur Mitkos. Janë disa faqe me fjalë turko-perso-arabe, të përfshira dikur në Fjalorthin e “Bletës”, në të cilat Mitkoja bën ndreqje dhe plotësime të pjesshme, bazuar në një kuadër teorik që shtjellohet thukët në vetëm pak rreshta. Në Shtojcën III kemi riprodhuar tekstin greqisht dhe në vazhdim japim përkthimin tërësor (me pak plotësime) të tij. Në këtë tekst hasim një Mitko tjetër. Mitkon teorik, njohës të gjuhëve lindore dhe vëzhgues të mprehtë të ndryshimeve shumëplanëshe që pësojnë fjalët kur shtegtojnë nga njëra gjuhë në tjetrën. Një densitet i pazakontë informacioni, kuintesenca e përvojës së tij leksikografike e derdhur brenda një greqishteje elitare, sintaksën e ndërlikuar të së cilës Mitkoja duket se e zotëron mirë.

Idetë që shfaqen këtu (“Kuptimi i fjalës kapet më mirë në ngërthim të fjalisë”. “Fjalët kanë kuptim të mirëfilltë dhe prej këtij rrjedh kuptimi sinekdokik e metaforik”, etj.) kanë vlerë të përgjithshme dhe e pasurojnë mendimin gjuhësor të Rilindjes kombëtare shqiptare. Duke u nisur nga sa thotë e shkruan posaçërisht për turqizmat, arabizmat e persizmat (“...shumë fjalë, që turqishtja i mori prej arabishtes dhe persishtes, humbën kuptimin origjinal dhe morën një kuptim të ri, të panjohur në gjuhën burimore. Për rrjedhojë, kush mund të dijë nëse gjatë kalimit nga ajo [turqishtja] në shqipen nuk morën një tjetër kuptim të ri, të panjohur në gjuhën dhënëse”), si dhe nga fakti se jeto i për një kohë të gjatë në një vend arab, do të guxonim ta quanim, në mos të parin, një ndër të parët orientalistë shqiptarë, një Dizdar të fundshekullit XIX.

Fjalori shqip-greqisht i Mitkos, me lëndën e pasur që përmban, ka vlerë edhe për sa i përket zgjidhjes së problemeve gjuhësore në kuadër ballkanik. Po sjellim vetëm një shembull, duke marrë shkas nga tekstet e dokumenteve të Arkivit të Ali Pashës, botuar tani vonë në Greqi.

Në Dok. 57 (viti 1800), kapetan Spiroja nga Vunoi i Himarës i dërgon Ali Pashës një letër të shkruar në greqisht, ku ndër të tjera lexojmë: ...γράφει του Ταχίραγα για κάθε δουλιά να μας κυβερνίσι ης κάθε δουλιά όχι όχι ίμε για ευτού για να μου δόσις κανένα τζεβάπι γιατί του Χατζί αγά τα καμόματα δεν πορό να τα πομένο... (...shkruaji Tahiragës për çdo punë, të kujdeset e të na ndihmojë në çdo gjë; jo jo [= në të kundërt], jam për [të ardhur] aty që të më japësh ndonjë xhevap, sepse nuk mund t’i duroj më bëmat e Haxhiagës).

Në tekstin e mësipërm kemi përsëritjen e pjesëzës mohuese *όχι* ‘jo’ të greqishtes, në një përdorim që është krejt i huaj për këtë gjuhë. Në kërkim të zanafillës së këtij konstrukti, shfletuam fjalorë të ndryshëm të shqipes, por pa rezultat. Për fat të mirë, dorëshkrimi i Fjalorit shqip-greqisht të Th. Mitkos na jep informacionin e mëposhtëm: *jo – jó. Εἶδέ μῆ [përndryshe], Ἄν τουναντίον [në të kundërt], ἐς ἔναντίαν περίστασιν [në rast të kundërt]*. Është një nga lemat “jetime” të Fjalorit të Mitkos, në kuptimin që autori, ndryshe nga sa e ka zakon, nuk na thotë ku e lexoi apo e dëgjoi këtë konstrukt. Megjithatë, nëse e ka dëgjuar nga shqiptarët bashkëkohës të tij, rezulton që *jo-jo* dhe *όχι όχι* të jenë përdorur nga fundi i shek. XVIII deri në vitet ‘70-’80 të shek. XIX. Ekzistenca në turqisht e një përdorimi të ngjashëm të *yok yok* [jok jok] na ndihmon për të sqaruar bindshëm rrugëtimin e tij në shqipen e folur, e ndoshta edhe në greqishten. Fjalori i Redhouse-it jep për *yok yok* kuptimin “Everything can be found, you can get whatever you wish”, i cili i përshtatet plotësisht kontekstit të përdorimit të *όχι όχι* në shembullin e dhënë më sipër. Shtojmë se në glosarin e një monografie për gjuhën dhe toponiminë e Qeparoit, fshat i ndodhur ca kilometra më në jug të Vunoit, *jo-jo* regjistrohet me kuptimin ‘përndryshe’.

Në përfundim të kësaj trajtесе, po theksojmë edhe një herë se shfaqëm një varg idesh dhe cekëm një sërë çështjesh, të cilat do të paraqiten në mënyrë më të plotë e në një kuadër ballkanik në botimin e afërt të opusit leksikografik të Mitkos.

Shtojca -I-

Συγκεκομμένοι λέξεις [Fjalë të shkurtuara]

- αρβ. Αρβηρία = ἡ Χαονία ἐν Ἠπειρῷ.
 αρπ. Arpa d’ un Albanese 1881.
 брт. Βεράτι ἡ πρωτεύουσα τῆς κυρίως Τοσκαρίας.
 bd. Boudi “dottrina christiana”, in Roma, 1664.
 γ. Γεγιστί, ἡ διάλεκτος τῶν ἄνω Ἀλβανῶν ἐν γένει.
 dbr. Dibra ἡ πόλις καὶ ἐπαρχία.
 дрp. Εὐαγγέλιον τοῦ Δόρσα ἐν Ἰταλία, ἐν Λονδίῳ 1836.
 кμрд. Καμάρδας Ἀλβανός ἐν Σικελία “Grammatologia comparata della lingua albanese”, in Livorno, 1864.

κπτρ.	Π. Κουπιτόρης Ὑδραῖος.
κρνδ.	Διάλεκτος Κρανιδίου (Ἑλλάς).
κλρ.	Α. Κουλουριώτης, ἀλφαβητάρ. 1882.
κρτσ.	Διάλεκτος Κορυτσᾶς καὶ τῶν πέριξ ἐπαρχιῶν.
μτφρ.	Μεταφορικῶς.
αρβ.ρτ.	Arberi i rii. Περιοδικὸν, ἐν Σικελίᾳ 1887.
δνλ.	Ἐπαρχία, ἢ διάλεκτος τοῦ Devol.
πρμτ.	Διάλεκτος τῆς Πρεμετῆς καὶ τῶν πέριξ μερῶν.
σκδρ.	Διάλεκτος τῆς Σκόδρας.
τσκ.	Τοσκαρία ἦτοι κάτω Ἀλβανία.
τσμ.	Τσαμουρία ἢ Θεσπρωτία.
φλτ.	Φιλζέτια αρβηνόρε τοῦ Δ. Καμάρδα, ἐν Λιβόρνῳ, 186...
ύδρ.	Κατὰ τὴν διάλεκτον τῶν Ὑδραίων.
Χρστφ.	Κ. Χριστοφορίδης ἐξ Ἑλβασανίου.
εὐαγγ.	Εὐαγγέλιον ἀλβ. τοῦ 1866.
διάτ.	Διαθήκη νέα τοῦ 1858, ἐν Ἀθήναις.
ίστρ.	Ἱστορία τῆς ἀγίας γραφῆς, 1872.
Ἔξ.	“Τη βήρητη ἐδέ τη δάλητη” ὑπὸ Χριστοφορίδου τοῦ 1880.
βρσς.	Βόρσσι, κωμόπολις μεταξὺ Χαονίας καὶ Τσαμουρίας.
χαον.	Χαονία, διάλεκτος αὐτῆς.
ρδ.	De Rada συγγραφεὺς ἀλβ.ιταλός.
flj.	Flijamburi Arberit, περιοδικὸν ἀλβανο-ιταλικὸν τοῦ De Rada, 1884.
γρμ.	Γραμματικὴ τοῦ Χριστοφορίδου, 1882.
Βσ.	Βάσα Ἐφένδης, ἀλβ. ἀλφάβητον Κ/πόλεως τοῦ ἔτους ...
Βρτ.	Βρέτος, περιοδικὸν φύλλον ἀλβ. 1884, ἐν Κ/λῃ.
flj.	Flijamuri Arbërit, περιοδικὸν σύγγρ.
Ἱστορ.	Ἱστορία ε σκρόννηση σσεντ. Χριστοφ. 1872.
ρψ.	Rapsodia albanese, Schirò, Palermo 1887.
βγτ.	Bayetī e Bujqesī, 1886, τύποις ἐν Βουκουρ.
Αβτ.	Αβετᾶρ Σαμί Βέη 1886, Βουκουρεστίου.
κηνδ. I.	Ἀναγνωσματάρ. E kendimit NHF, τόμ. 1, τοῦ 1886. Βουκουρέστ.
ρψ.ρδ.	Rapsod. de Rada 1866. Φιρέντσε.
αρβ. ρτ.	Arberi rī, περιοδικὸν ἀλβανο-ιταλικὸν τοῦ Gius. Schirò, 1887 Sicilia.
vet.	Μιρηβετῆ ε Vretos. Βουκουρεστίου.
σαμ.	Γραμματ. τοῦ Σαμῆ-Βέη. Βουκουρεστίου.

αργκ. ή γρκ. Άργυροκάστρον.

Εὐαγ. Sep. Εὐαγγέλ. Matteo Londra 1868.

ρψ.σκι. Rapsodie Albanesi 1887.

γρμ. M. Γραμματ. άλβαν. τοῦ Meyer 1888.

Ματθ. Εὐαγγέλ. κατὰ Ματθαῖον, άλβ.γραικιστ. 1878 Κ/λη.

γεωγ. Γεωγραφία τοῦ Σαμῆ. 1888. Βουκουρέστι.

Diturite N.H.F. 1888. Βουκουρέστι.

Vjersa per mesonetoret 1886.

E Kendimit Çunavet 1886.

istor.pergj. ἡ istori e pergjithsime 1886, N.H.F.

ίστορ.

γρ.ρδ. Γραμματική De Rada.

Πελασγ. ή Πελσγ. Πελασγικά Reinhold. 1855, Αθήναις.

Lista e shkurtimeve të titujve të librave dhe të emrave të vendeve nga u mbledhën lënda për hartimin e Fjalorit shqip-greqisht.

-II-

Προεισαγωγή

...τοιαῦται λέξεις εἶναι ὅλως ξέναι καὶ ἄσχετοι μὲ τὴν ἀλβανικὴν, καὶ ὅτι ἡ ἀλβανικὴ, οὔσα στενοτάτη συγγενὴς τῆς ἀρχαίας ἑλληνικῆς, οὐδεμίαν σχέσιν ἔχει μὲ τὴν τουρκικὴν, ἢ τὴν περσικὴν, ἢ τὴν ἀραβικὴν, εἴτε τὴν σλαβικὴν, ἐκ τῶν ὁποίων γλωσσῶν παρεισέφρησαν αἱ λέξεις αὗται, ὅλως περιτταί, ἀνωφελεῖς καὶ κακόφωνοι δι' αὐτὴν. Ὅθεν τὰς τοιαύτας λέξεις ξένης ὅλως καταγωγῆς καὶ ρίζης δέον νὰ ἀπορρίψῃ ὁ Ἀλβανικὸς λαὸς, διότι ἐκτὸς ὅτι εἶναι ὅλως περιτταί καὶ κακὸήχοι, νοθεύουσι τὴ γλῶσσα, ὡς μὴ κοινολογοῦσαι πρὸς τὰς τῆς ἀλβανικῆς προκειμένου δὲ περὶ πραγματικῆς γλωσσικῆς ἀνάγκης, πρέπει νὰ ἐρανίζηται τοιαύτας ἐκ τῆς ἑλληνικῆς ὡς τῆς φυσικῆς πηγῆς.

Parathënie

...kësi fjalësh janë krejt të huaja për shqipen e nuk lidhen me të, dhe se shqipja, e ndodhur në farefisni të ngushtë me greqishten e vjetër, nuk ka asnjë farë lidhjeje me turqishten, persishten, arabishten, apo sllavishten, prej të cilave gjuhë kanë hyrë këto fjalë, [që janë] krejt të tepërta, të padobishme e keqtingulluese për të.

... këto fjalë ... duhen hedhur poshtë nga populli shqiptar, sepse, përveç që janë të panevojshme e të çjerrin vesh të, ato e bastardojnë gjuhën.... [Prandaj], në rast se gjuha ka vërtet nevojë [për fjalë], duhet t'i marrë ato prej greqishtes, burimit të njëmendtë.

Pjesë e parathënies së Λεξιλόγιον Αλβανο-Ελληνικόν, shoqëruar me përktimin përkatës.

-III-

Διόρθωσις τῶν ἐν τῷ α΄ βιβλίῳ ἐσφαλμένων λέξεων

Ἐπειδὴ καὶ ὅταν αἱ λέξεις ὡς μεμονωμένοι σποράδιον, δὲν εἶναι εὐχερῆς κυριολεκτικῆ ακρίβεια τῆς σημασίας τοσοῦτον, ὅσον ὅταν συλλαμβάνωνται ἐκ τῆς πλοκῆς τοῦ λόγου, τίθημι τὰς κυριότερας [σημασίας] ἐκάστη. Ἰστέον δ' ἔτι ὅτι πολλαὶ ἀραβικαὶ καὶ περσικαὶ λέξεις, εἰσαχθεῖσαι εἰς τὴν τουρκικὴν, ἀπώλεσαν τὴν παρὰ τῷ ἔθνει ἰδιάζουσαν προφορὰν καὶ μάλιστα τὴν ὀρθογραφίαν, ὅταν γράφονται καὶ προφέρονται ὑπ' ἀμαθῶν, πολλῶ δὲ πλέον ὑπ' Ἀλβανῶν καὶ Ἑλλήνων, ὧν πάντῃ ἀλλοία ἢ προφορὰ τῆς τῶν ἀνατολικῶν λαῶν. Διὸ καὶ ἐν πολλοῖς διστάζει τις περὶ τοῦ τίς ἄραγε ἢ πρώτη, ἐξ ἧς παράγεται ῥίζης ἢ λέξης, ὅπως ὀρίση τὴν πρώτην κυρίαν σημασίαν, ἐξ ἧς ἢ συνεκδοχικῆ καὶ ἢ μεταφορικῆ. Ὁμολογούμενον προσέτι ἐστὶν ὅτι πολλαὶ λέξεις εἰλημμένοι ἐκ τῆς ἀραβικῆς καὶ περσικῆς εἰς τὴν τουρκικὴν ἀπώλεσαν τὴν εἰς τὴν πρωτότυπον γλῶσσαν σημασίαν, καὶ ἔλαβον νέαν μὴ ὑπάρχουσαν εἰς ἐκείνην. Τίς οἶδεν ὅθεν ἂν εἰσπηδήσασαι καὶ ἐκ αὐτῆς εἰς τὴν ἀλβανικὴν δὲν προσέλαβον νέαν τινὰ καὶ εἰς αὐτήν, ἄγνωστον εἰς ἐκείνην. Προσέτι, ἐπειδὴ καὶ ἡ τουρκικὴ καὶ περσικὴ προφορὰ τονίζει τὰς λέξεις ἐπὶ τῆς καταλήξεως, πολλὰς προπαροξυτόνους ἐν τῇ ἀραβικῇ τονίζουσι κατὰ τὸ ἰδίωμα τῶν ἐπὶ τῆς ληγούσης, καὶ τοῦτο συγγέει πολλῶν ἀραβικῶν λέξεων τὴν σημασίαν, αἵτινες φέρουσι διάφορα σημαίνόμενα κατὰ τὸν διάφορον τύπον, καθ' ὃν μορφοῦνται, καθ' ὃν καὶ ὁ τονισμὸς, καὶ ἡ σημασία τῆς λέξεως.

Korrigjim i fjalëve me gabime të librit të parë

Meqenëse kuptimi i fjalëve, kur ato janë të veçuara andej këtej, nuk është e lehtë të përcaktohet me saktësi të mirëfilltë dhe as të rrokjet në po atë masë sa në rastin kur konceptohen në ngërthim të fjalisë, po shënoj kuptimet bazë të secilës [fjalë]. Duhet ditur gjithashtu se shumë fjalë arabe dhe perse, pasi hynë në turqishten, e borën shqiptimin specifik të origjinës e sidomos ortografinë, ngaqë shkruhen e shqiptohen prej të pamësuarish, e aq më tepër prej shqiptarësh e grekësh, shqiptimi i të cilëve ndryshon kryekrejet nga ai i popujve lindorë. Prandaj dhe ngurrojmë të vendosim cila vallë është rrënja e parme prej së cilës rrjedh fjala, e të caktojmë mandej kuptimin e parë themelor, nga i cili zënë fill kuptimi sinekdokik dhe metaforik. Po kështu, pranohet se shumë fjalë, që turqishtja i mori prej arabishtes dhe persishtes, humbën kuptimin origjinal dhe morën një kuptim të ri, të panjohur në gju-

hën burimore. Për rrjedhojë, kush mund të dijë nëse gjatë kalimit nga ajo [turqishtja] në shqipen nuk morën një tjetër kuptim të ri, të panjohur në gjuhën dhënëse. Gjithashtu, për shkak se turqishtja dhe persishtja i theksojnë fjalët në mbaresë, këto gjuhë, duke ndjekur zakonet e tyre, e zhvendosin theksin në rrokjen fundore të shumë fjalëve proparoksite të arabishtes, dhe kjo e bën lëmsht domethënien e mjaft fjalëve arabe, të cilat, në varësi të tipit të ndryshëm, sipas të cilit formësohen, dhe nga i cili varen si theksimi ashtu edhe kuptimi i fjalës, bartin kuptime të ndryshme.

Besim KABASHI, Universität Erlangen-Nürnberg

KORPUSE GJUHËSORE PËR SHQIPEN

Abstrakt

Korpuset gjuhësore janë përmbledhje tekstesh, në kuptimin përmbledhje e gjuhës së shkruar, asaj të folur apo e të dy formave së bashku, të cilat si të tilla ose veç e veç, të organizuara në një mënyrë të caktuar përbëjnë një njësi të quajtur korpus, me qëllim për të lehtësuar, përshpejtuar studimet gjuhësore e letrare, ngritjen e cilësisë së tyre, si dhe për të dokumentuar gjuhën në ato lëmi, kohë, shtrirje gjeografike e sipas veçorive të tjera, të cilat ai ka për qëllim që t'i mbulojë. Bërja e një korpusi varet shumë nga qëllimi i përdorimit të tij. Një korpus nuk mjafton të jetë vetëm përmbledhje e thjeshtë tekstesh apo/dhe e gjuhës së folur. Tekstet apo pjesët e korpusit duhen të jenë të kategorizuara, të përshkruara dhe të analizuara në mënyrë që të mund të përdoren më mirë si dije gjuhësore – aq më tepër kur sot për përdorim të një korpusi duhen vegla dhe metoda nga teknologjia e përpunimit të gjuhëve natyrore, të cilat bazohen, ndër të tjera, në të tilla përshkrime. Në kumtesë do të diskutohet rëndësia e bërjes së një korpusi gjuhësor të shqipes sa më parë që është e mundur, pastaj tipi i korpusit që do të duhej të bëhej së pari, struktura e tij dhe gjëra të tjera të cilat lidhen me bërjen e korpuseve.

Kryefjalë të këtij shkrimi janë njohuritë thelbësore për korpuset, roli i korpuseve në studime gjuhësore, llojet më të përhapura të korpuseve, rëndësia e ndërtimit të një korpusi gjuhësor gjithëpërfshirës të shqipes dhe gjëra të tjera, të cilat ndërlidhen me këto çështje – parë si punë promovuese.

Roli i korpuseve në studime gjuhësore

Para rreth 50 vitesh, në fillim të viteve '60 të shekullit të kaluar, u krijua *Korpusi Brown*, në origjinal *Brown Corpus* (emërtimi nga Brown University), ndërsa para rreth 40 vitesh, pra në fillim të viteve '70 të shekullit të kaluar, gjermanët, sapo kishin parë rëndësinë e një korpusi, pa u vonuar filluan punën dhe pak vite më vonë, ndërtuan korpusin gjuhësor të quajtur *Limas* (emër i përfituar nga fjalët “*Linguistik und maschinelle Sprachverarbeitung*”).¹

Nga ajo kohë, nga ajo ide, nga ato prodhime të para, sot është zhvilluar një degë shkencore që në anglishte quhet *Copus Linguistics*,

¹ Khs. [FRANCIS/KUČERA 1964] dhe [GLAS 1975].

në shqipe le të quhet *gjuhësi e korpuseve*, apo *gjuhësi e bazuar në korpuse dhe metoda statistikore*. Për një pjesë studiuesish kjo mbetet një metodë pune, pa arritur mëvetësinë si shkencë. Sidoqoftë, ajo ka nxitur studimet gjuhësore me metodat dhe rezultatet e saja, ka përsheptuar dhe njëkohësisht ka lehtësuar punën e gjuhëtarëve, ka ndihmuar që ata të kalojnë nga introspekcioni dhe nga mbledhja e shembujve dhe e argumenteve gjuhësore në mënyrën tradicionale, d. m. th. përmes leximit të shkrimeve përkatëse, në një mënyrë, e cila mbështetet në kërkime të shpejta në tekste elektronike. Mund të përmendet këtu si shembull kërkimi i një fjale, fjalëforme, një shenje apo një vargu shenjash në kuptimin e shprehjeve të rregullta (angl. *Regular Expressions*), si dhe nxjerrja e ndonjë statistike të fjalëve apo fjalive nga një tekst.²

Metodat e kësaj fushe kanë ndihmuar që të rritet cilësia e studimeve, duke u bazuar në të dhëna konkrete, d. m. th. empirike, dhe në rastin optimal edhe në të dhëna të shumta. Si rrjedhojë, në shumë raste janë nxjerrë dije të reja, sidomos nga puna me të dhëna të sasive të mëdha. Një standard madhësie që është arritur para më shumë se një dekade vitesh, është 100 milionë fjalë teksti, hap i bërë së pari nga *British National Corpus* (shkurt *BNC*).³

Kujt i shërben korpusi? Një përgjigje e thjeshtë do të ishte: leksikografisë. Jo më pak ai do t'i shërbente edhe fushave të tjera, si drejtshkrimi (ortografisë), fonetikës, morfologjisë, sintaksës, semantikës dhe fushave tjera, prej nga mund të nxirreshin shembuj të shumtë, kuptohet edhe dije tjetër, p. sh. në formë rregullash apo përjashtimesh.

Korpuset gjuhësore janë përmbledhje tekstesh, në kuptimin përmbledhje e gjuhës së shkruar, asaj të folur apo e të dy formave së bashku, të cilat janë të organizuara në një mënyrë të caktuar, me qëllim për t'u përdorur për hulumtime shkencore e didaktike, si të tilla për të lehtësuar e përsheptuar studimet gjuhësore e letrare, për të ngritur cilësinë e tyre, si dhe për të dokumentuar gjuhën sipas veçorive të

² Khs. [KENNEDY 1998] dhe [LEMNITZER/ZINSMEISTER 2010].

³ Khs. [BNC-XML 2007]. Sasia e fjalëve që përmbajnë korpuset sot shkon shumëfish përtej 100 milionë fjalësh teksti. Në këtë kuptim, një shembull është korpusi i projektit *DWDS* (*Das digitale Wörterbuch der deutschen Gegenwartssprache des 20 Jh*, Berlin-Brandenburgische Akademie der Wissenschaften), shih. <http://www.dwds.de/> (21.10.2011).

ndryshme – sipas fushës, kohës, shtrirjes gjeografike e sipas veçorive tjera, të cilat ai ka për qëllim që t'i mbulojë.

Llojet e korpuseve dhe veçoritë kryesore të tyre

Varësisht se nga cila pikëpamje trajtohen veçoritë e teksteve, përkatësisht korpuseve, aq lloje korpusesh mund të identifikohen. Nuk ka një kufi të paracaktuar. Ato më të përhapura janë *korpuset e baraspeshuara* dhe *korpuset paralele*.

– *Korpuset e baraspeshuara* apo ndryshe të quajtura edhe *korpuse reference* (angl. *Reference Corpus*). Këto korpuse mbulojnë në formë gjithëpërfshirëse gjuhën dhe përdoren në rend të parë për studime të ndryshme gjuhësore.

– *Korpuset paralele*, p. sh. një korpus paralel shqip–anglisht.⁴ Këto korpuse përdoren në rend të parë për studime gjuhësore krahasuese, për ndihmë gjatë përkthimeve apo edhe për leksikografi dy- apo shumë-gjuhëshe.

Nisur nga veçori të tjera, siç është koha e shkrimit të teksteve, korpuset mund të ndahen në *korpuse statike* dhe *korpuse dinamike*.

– *Korpuset statike (historike)*. Përmbajtja e teksteve të këtij tip i korpuseve caktohet gjatë fazës së ndërtimit të tij dhe pastaj mbetet e pandryshueshme.

– *Korpuset dinamike*. Përmbajtja e korpuseve të këtij tipi ndryshohet pandërprerë apo kohë pas kohe, por duke mbajtur strukturën dhe disa veçori tjera themelore në bazë të një formule të caktuar.

Veçori tjera kryesore, duke theksuar të parën, janë edhe këto në vijim :

– *Gjuha*. E folur apo e shkruar, ajo ka shumë ngjyime, të cilat janë të ndërthurura (ortogonale) me njëra-tjetrën dhe në shumë raste nuk mund të ndahen veç e veç. Ato mund të jenë *regionale, sociale, raporti në mes folësit përkatësisht shkruarit të tekstit dhe atij me të cilin flitet përkatësisht me atë, të cilit i është kushtuar teksti*, e shumë të tjera, të cilat mund të nënkuptohen. Pjesët e korpusit (angl. *Pieces*),

⁴ Në këtë kontekst, ndonëse qëllimi i shkrimit është tjetër, do të ishte me vlerë të theksohej këtu se një korpus paralel i llojit arvanitisht–shqip përkatësisht arbërisht–shqip do të ishte shumë i rëndësishëm për studime gjuhësore të shqipes.

përkatësisht *tekstet* mund të jenë *tekste “normale”*, d. m. th. *gjuhë e shkruar*, apo *tekste të përfituara nga gjuha e folur*.⁵

— *Madhësia*. Madhësia e korpusit është shumë e rëndësishme. Sa më i madh të jetë korpusi, aq më tepër ka gjasa, që kërkimet e bëra në korpus të përcillen me rezultate të kënaqshme, së pari për nga ana sasiore, dhe më pas edhe nga ana cilësore. Me rritjen e madhësisë së korpusit, rritet edhe gjasa që fjalët, strukturat, shprehjet apo diçka tjetër që kërkohet të gjenden në korpus. Qëllim i korpusit është dhënia e sa më shumë shembujve, të paktën disave ose tek e fundit edhe të vetëm një shembulli, për një kërkim të caktuar.

— *Fusha*. Varësisht se çfarë tekstesh e përbëjnë korpusin, ai mund të jetë *i përgjithshëm* apo *i veçantë* (special). Një *korpus i përgjithshëm* do të ishte ai, i cili ka tekste nga sa më shumë fusha të jetës materiale e shpirtërore, të dijeve shkencore dhe të artit e kulturës. Një *korpus i veçantë* do të përmbante tekste të një fushe të caktuar, b. fj. nga fusha e drejtësisë, e ekonomisë ose e mjekësisë. Në të dyja rastet me rëndësi thelbësore është hapësira që zë një tekst në krahasim me tekstet tjera.

— *Mediumi*. Sot nuk mund të diskutohet kjo çështje edhe pse korpuset kanë një histori, e cila fillon para “kohës së kompjuterëve” : korpuset e sotshme duhet të jenë në formë elektronike. Këtu bëhet fjalë për një zgjidhje të shkallës së dytë : *korpuset të rëndomta* apo *multimediale*. Këto të fundit bashkërendisin pamjen (video), zërin (audio), rrethanat ku flitet gjuha me përshkrimin e tyre në formë teksti. Kuptohet, bëhet fjalë për korpus të gjuhës së folur.

Këto janë disa nga veçoritë më kryesore, jo të gjitha, dhe se përzgjedhja mund ishte edhe ndryshe. Në bazë të veçorive të këtyra mund të fillohej me punë dhe mund të ndërtohej një korpus, i cili do të ishte në gjendje të ashtuquajtur *lëndë e parë e klasifikuar*. Megjithatë një korpus i tillë do të ishte i përdorshëm dhe do t’u hynte padyshim në punë shumë gjuhëtarëve – por me shumë kufizime.

Analiza e lëndës së parë

Tekstet apo pjesët e korpusit duhen të jenë të kategorizuara, të

⁵ 10 % e teksteve, të cilat i përmban BNC, janë të përfituara nga gjuha e folur, shih. <http://www.natcorp.ox.ac.uk/corpus/index.xml> (21.10.2011).

përshkruara dhe të analizuar në mënyrë që të mund të përdoren më mirë si dije gjuhësore – aq më tepër kur sot për përdorim të një korpusi duhen vegla dhe metoda nga teknologjia e përpunimit të gjuhëve natyrore, të cilat bazohen, ndër të tjera, në të tilla përshkrime. Për këtë arsye është i nevojshëm një hap tjetër, një punë e mëtejme me “lëndën e parë”. Ajo është shumë e rëndësishme dhe po ashtu e kushtueshme. Është fjala për *analizën dhe përshkrimin e informacionit gjuhësor dhe jogjuhësor* të teksteve të korpusit nga ana e ekspertëve gjuhësorë të fushave të ndryshme, duke filluar nga drejtshkrimi, për të kaluar me përshkrimin statistikor të shumanshëm, përshkrimin fonetik, leksikografik, morfologjik⁶, sintaksor, semantik e kështu me radhë me përshkrime tjera. Këtu mund të përmendet edhe një ndarje, ajo në *korpuset të papërshkruara* (të paanalizuara, të paannotuara [lat. *annotare* : shënim, vërejtje, sqarim]) dhe në *korpuset të përshkruara*.⁷ Varësisht nga mundësia e përdorimit, një korpus mund të jetë *jopublik*, p. sh. të jetë për qëllime të caktuar vetëm në rrethet e një institucioni, grupi njerëzish, *publik i kufizuar* (për njerëz të regjistruar për përdorim të korpusit apo ata të cilët do të blinin licencën/atë), apo dhe *publik*, d. m. th. për të gjithë.

Para fillimit të punës duhet të jetë një kusht që duhet pasur përndërprerë në mendje : *përfitim i të drejtës së autorit/autorëve për përdorim/përpunim pa kufizime të teksteve që do të ishin pjesë e korpusit*. Përjashtim bën këtu rasti, nëse tekstet “nuk kanë të drejta”, b. fj. tekstet e vjetra, siç mund të jetë “Meshari” i Gjon Buzukut.

Korpuset gjuhësore për shqipen

Një rol të një korpusi të shqipes për një kohë e ka pasur teksti i romanit “Koncert në fund të dimrit” nga I. Kadare, botuar nga ECI/MCI më 1994 si pjesë e një korpusi përmbledhës, të thjeshtë, të gjuhëve evropiane.⁸ Me gjithë hapin e parë, dhe vlerën e padiskutueshme, aq më tepër për atë kohë, si tekst përfaqësues i shqipes, ai tekst, nuk mund të quhet korpus gjuhësor në kuptimin e një korpusi gjithë-

⁶ Kjo bëhet në pjesë të madhe ose tërësisht në mënyrë automatike me ndihmen e programeve (veglave) përkatëse, khs. p. sh. [KABASHI 2004].

⁷ Khs. [BNC-XML 2007].

⁸ Khs. këtu [KONCERT 1994] dhe [ECI/MCI 1994].

përfshirës. Që nga ajo kohë, në këtë fushë nuk ka ndonjë përparim, i cili mund të përmendej këtu, kur është fjala për gjuhën shqipe.⁹

Duke u nisur nga fakti se një korpus reference do t'u shërbente të gjithëve, ai përbën një pikënisje të mirë për të qenë korpusi i parë i shqipes së sotshme. Detyra e parë do të ishte *përzgjedhja e teksteve*, punë e cila do të bëhej duke u bazuar në baraspeshën e teksteve në bazë të shumë veçorive. Ato mund të jenë shumë të ndryshme nga njëra-tjetra si *gjuhë e folur dhe e shkruar, cilësi të ndryshme sociolinguistike dhe psikolinguistike të gjuhës, vendi ku ajo flitet përkatësisht shtrirja gjeografike e saj, cilësi organizative formale të saj dhe së fundi statusi i saj*.

Puna teknike-shkencore me korpus

Pasi që korpuset e sotshme që nga fillimi i ndërtimit të tyre janë të parapara për t'u përdorur me ndihmen e veglave elektronike, puna teknike-shkencore me korpus përbën në shumë raste një pjesë të pandashme apo përcjellëse të punës tjetër për korpusin. Ajo përfshin, ndër të tjera, çështjet në vijim : *kodifikimin teknik të teksteve, gjuhën përshkruese, gjuhët pyetëse, kompatibilitetin me korpuset e tjera dhe përshtatshmërinë e përdorimit të veglave punuese me standarde të përhapura dhe aktuale*. Disa nga këto veçori teknike-shkencore duhet pasur në mendje qysh nga fillimi i punës.¹⁰

Përmbledhje

Sot për sot, një korpus gjuhësor do të duhej të kishte të paktën 100 milionë fjalë teksti. Gjuhësisë së sotshme shqipe pa mëdyshje i duhet një korpus gjithëpërfshirës, i cili do të duhej të ishte i baraspeshuar.

Për shkak të natyrës së mbledhjes së teksteve, në rrethanat e tashme në hapësirën shqipfolëse, një korpus të mirëfilltë mund ta ndërtonin vetëm institucionet shkencore përkatëse të specializuara – të cilat sot për sot, në hapësirën shqipfolëse, janë ende vetëm një dëshirë.

⁹ Khs. këtu për çështje të resurseve të gjuhës shqipe shkrimin [KABASHI 2009].

¹⁰ Khs. këtu [WYNNE 2005].

Ndërtimi i një korpusi të gjithëpërfshirës është një ndërmarrje jo e vogël dhe se puna për ndërtimin e tij nuk do të duhej të nënvlerësohej. Në këtë rast, ai që fillon punën “lehtë”, e përfundon me vështirësi dhe çmim të lartë, për më tepër, në dëm të cilësisë së korpusit, dhe sidomos, në dëm të atyre që do ta përdornin atë. Një korpus i ndërtuar jo mirë, duke mos mbuluar të dhënat e duhura gjuhësore apo p. sh. duke i tjetërsuar raportet e tyre statistikore, do të ngadalësonte zhvillimin e shkencave gjuhësore, krahasuar me një korpus të ndërtuar mirë.

Referencat / Literatura

- [BNC-XML 2007] British National Corpus. Version 3. BNC XML Edition. Distributed under license by Oxford University Computing Services on behalf of the BNC Consortium, 2007.
- [ECI/MCI 1994] European Network of Excellence in Human Language Technologies (ELSNET): *European Corpus Initiative Multilingual Corpus I*. (CD-ROM). Utrecht : ELSNET, 1994.
- [FRANCIS/KUČERA 1964] Nelson W. Francis / Henry Kučera : Manual of Information to Accompany 'A Standard Corpus of Present-Day Edited American English'. Brown university : Dept. of Linguistics. Providence 1964.
- [GLAS 1975] Glas, Reinhold : „Das LIMAS-Korpus, ein Textkorpus für die deutsche Gegenwartssprache”. [In :] *Linguistische Berichte 40* (1975), 63–66.
- [KABASHI 2004] Kabashi, Besim : “Analiza automatike e fjalëformave të gjuhës shqipe”. 129–135. [Në :] (Materialet nga) *Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, XXIII*. Libri 23/1. Prishtinë : Universiteti i Prishtinës, 2004.
- [KABASHI 2009] Besim Kabashi : “Resurset e gjuhës shqipe – një diskutim rreth gjendjes së tyre të tashme”. 97–102. [Në :] (Aktet nga) *Seminari III i Albanologjisë*. Tetovë, Universiteti Shtetëror i Tetovës, 2009.
- [KENNEDY 1998] Graeme Kennedy : *An Introduction to Corpus Linguistics*. Longman: London / New York, 1998.
- [KONCERT 1994] Romani *Koncert në fund të dimrit* nga I. Kadare, Tiranë, “Naim Frashëri“, 1988. *alb01*. [Në :] [ECI/MCI 1994].
- [LEMNITZER/ZINSMEISTER 2010] Lothar Lemnitzer/ Heike Zinsmeister : *Korpuslinguistik. Eine Einführung*. 2. Auflage. Tübingen: Narr Verlag, 2010.
- [WYNNE 2005] Wynne, Martin (Ed.) : *Developing Linguistic Corpora: a Guide to Good Practice*. Oxford : Oxbow Books, 2005.

Timofej ARKHANGELSKIJ, Moskva/ Mikhail DANIEL, Moskva/ Maria MOROZOVA S.-Peterburg/ Aleksandar RUSAKOV, S.-Peterburg

KORPUSI I GJUHËS SHQIPE: DREJTIMET KRYESORE TË PUNËS

Abstrakt

Në kohën tona puna e suksesshme gjuhësore varret shumë nga mundësia e shfrytëzimit të korpuseve elektronike, të përmbledhjeve reprezentative të teksteve elektronike të pajisura me informatën e caktuar linguistike dhe metatekstuale (bibliografike). Tani korpuset të tilla ekzistojnë për disa gjuhë evropiane. Për fat të keq, ne s'kemi korpusin të tillë për gjuhën shqipe – një gjuhë evropiane që flitet nga 8 miliona njerëzish dhe përfaqëson një grup me vete i gjuhëve indoevropiane. Ndërkaq korpus gjuhësor, i balancuar dhe i pajisur me shënime është një mjet i fuqishëm, i pazëvendësueshëm në studimet gjuhësore moderne. Nga njëra anë, korpusi na lejon ta mbledhim gjatë disa sekondash një material gjuhësor (që karakterizon përdorimin në tekstet të ndonjë fjale, fjalëforme, lokucioni ose forme gramatikore), që do të mblidhej në mënyrë "punëdore" ndoshta gjatë disa muajsh. Nga ana tjetër, mundësia të krahasimit të sasive të mëdha të teksteve që u përkasin llojeve të ndryshme të diskursit (të shkruar dhe gojor), shtresave të ndryshme kronologjike, varianteve dialektore na jep mundësi të formulojmë probleme të reja shkencore.

Siç duket, krijimi i korpusit elektronik të gjuhës shqipe është puna është një qëllim i domosdoshëm dhe aktual

Në këtë vit në bashkëpunimin e ngushtë midis albanologëve të Sankt Peterburgut dhe gjuhëtareve nga Moska që merren shumë vjet me përpunimin e korpuseve të gjuhëve të ndryshme (mund t'i përmendim korpuset e gjuhëve ruse dhe armene) filloi puna paraprake për krijimin e korpusit të gjuhës shqipe. Ne etapën e parë ne merremi me përpunimin e sistemit të shënimeve gramatikore, të hartimit të fjalorit gramatikor dhe me përpunimin e programit të analizës morfologjike

Në kumtesën do të jenë paraqitur disa nga rezultatet paraprake që janë arritur gjatë etapës së parë të punës në kuadrin e projektit.

I. Parafjalë. Korpusi gjuhësor është një sistem informacioni, që bazohet në një përmbledhje reprezentative të teksteve elektronike të pajisura me informatën gjuhësore dhe metatekstuale (bibliografike). Gjuha paraqitet në Korpusin në etape të ndryshme të historisë së saj

dhe në llojllojshmërinë e zhanreve, stileve, ligjërimeve, varieteteve sociale dhe rajonale. Në kohën e sotshme korpusë të tilla ekzistojnë për disa gjuhë evropiane dhe dallojnë sipas plotësisë së tyre dhe sipas nivelit të përpunimit shkencor të teksteve të përmbledhura. Midis korpusëve më të mëdha dhe më të plota vlen përmendur Korpusi Gjuhësor Britanik (me 100 milion përdorime fjalësh), Korpusi Gjuhësor Çek (500 milion përdorime fjalësh), Korpusi i Gjuhës Ruse (160 milion përdorime fjalësh), Korpusi i Armenishtes Lindore (90 milion përdorime fjalësh). Një Korpus të madh mund të përbëhet nga disa nënkorpuse. Kështu organizohet, për shembull, Korpusi i Gjuhës Ruse. Nënkorpusi i tij bazor e pasqyron gjuhën e epokave të kaluara, ashtu edhe gjuhën bashkëkohore në variante të saj të ndryshme sociallinguistike (gjuha standarde, gjuha e folur, variantet dialektore etj). Ai i përfshin veprat origjinale (d.m.th. jo të përkthyer) me rendësi të madhe kulturore, gjuhësore dhe stilistike, që u krijuan në mesin i shekullit XVIII – fillimin e shekullit XXI. Përveç letërsisë artistike, korpusi përfshin edhe tekste të tjera të shkruara dhe të folura, si memuarët, tekstet eseistike, publicistike dhe shkencore, fjalime publike, korrespondenca, ditoret, dokumentet etj. Ato janë përmbledhur në nënkorpuse të tilla, si korpusi sintaksor, korpusi gazetar (shtypi i viteve 1990–2000), korpuset paralele (anglisht-rusisht, rusisht-anglisht, gjermanisht-rusisht, ukrainisht-rusisht, rusisht-ukrainisht), korpusi i teksteve dialektore, korpusi i teksteve poetike, korpusi mësimor i gjuhës ruse, korpusi i gjuhës së folur dhe korpusi multimedial me fragmentet e filmave të viteve 1930–2000.

II. Arkitektura e korpusit. Korpusi gjuhësor karakterizohet nga dy veçori kryesore. Së pari, përmbledhje tekstesh, në të cilën bazohet korpusi, duhet të jetë e plotë, e balancuar dhe reprezentative. Kjo do të thotë që korpusi përmban, më sa është mundur, të gjithë tipat e teksteve të folura dhe të shkruara në gjuhën e dhënë (artistike, publicistike, mësimore, shkencore, bisedore, dialektore etj.). Sasia me përqindje e teksteve të ndryshme të çdo periudhe në korpusin duhet të përcaktohet sipas sasisë së këtyre në realitetin historik.

Së dyti, çdo korpus gjuhësor patjetër përmban informatën gjuhësore dhe metatekstuale, që shprehet me anë të sistemit të shënimeve, i cili quhet **anotimi**. Sa më i pasur është anotimi, aq më e lartë është vlera shkencore dhe mësimore të korpusit. Korpusi gjuhësor i mirë-

filltë dallohet nga koleksionet e teksteve, siç janë bibliotekat elektronike në Internet, me anë të anotimit. Anotimi i korpusit bazohet në parime të tilla kryesore:

1) “You-get-what-you-did”. Në qoftë se ju dëshironi të bëni kërkim nëpër korpusin me shumë parametra të ndryshme, së pari duhet të përpunoni një sistem të hollësishëm anotimi.

2) “Make-it-work”. Përkundrazi, sa më i hollësishëm është sistemi i shënimeve i krijuar nga gjuhëtarët, aq më të gjerë janë mundësitë e kërkimit nëpër korpus.

Arkitektura standarde e korpusit gjuhësor përfshin pjesën programore, fjalorin gramatikor dhe bazën tekstuale.

1. Pjesa programore përfshin programin indeksimi, programin kërkimi, ndërfaqen e përdoruesit dhe regjistrimin në server. Komponente të tilla mund të janë krijuar në etapa të tjera të përpunimit të arkitekturës. Pjesa më e rëndësishme është **Parser** – një program analize dhe përpunimi lingistik të teksteve. Parser-i analizon tekstin duke ndarë çdo fjalë në temën, ndajshitesat fjalëndryshuese dhe mbaresën me të gjithë mënyrat e mundshme. Te pjesët e ligjëratës së pandryshueshme tema përkon me vetë fjalën.

2. Mjeti i nevojshëm për funksionimin e suksesshëm të Parser-it është **fjalori gramatikor**, i cili përmban informatën për veçoritë gramatikore të fjalëve. Fjalori gramatikor i mirëfilltë përfshin standarden bashkëkohor, ashtu edhe variante gramatikore të vërtetuara në periudhe të ndryshme. Fjalori gramatikor përfshin bazën gramatikore me të gjithë tipat e paradigmave të pranueshme në gjuhën e dhënë, dhe fjalorin, ku shfaqen leksemat me të gjithë temat e pranueshme për çdo leksemë.

3. Anotimi morfologjik. Shfaqje e mëtejshme të informatës për format e fjalëve dhe kuptimet e tyre gramatikore bëhet me anë të anotimit morfologjik. Gjuha ndërmjetësuese e shënimeve gramatikore përbëhet nga shkurtimet (teg-ët) e bazuara në alfabetin latin, i kuptueshëm për shumicën e përdoruesve të korpuseve. Përpunimi i sistemit të shënimeve morfologjike është problemi i rëndësishëm në kuadrin e krijimit të korpusit. Për shembull, në Korpusin e Gjuhës Ruse përdoret modeli shfaqur në “Fjalorin Gramatikor e Gjuhës Ruse” nga Zaliznjaku (M., 1977; botimi i 4-të, M., 2003). Informata morfologjike për

çdo formë fjale përfshin formën bazore të fjalës, ose lemmë-n, pjesën e ligjëratës dhe kuptimet gramatikore që shpreh forma e dhënë. Për shembull, forma fjale *ndërtohet* do të dukej kështu:

lemma: *ndërtoj*

pjesa e ligjëratës: *V*

kuptimet gramatikore: *intr, ind, pass, pres, 3Sg*

4. Shënimet metatekstuale. Sistemi i shënimeve metatekstuale, ose meta-përshkrimi i teksteve të përmbledhura është pjesa e konsiderueshme e aparatit kërkimi të korpusit gjuhësor. Për shembull, në sistemin e shënimeve metatekstuale të Korpusit të Gjuhës Ruse, të gjithë tekstet janë pajisur me informatën si vijon: emri i tekstit, emri i autorit, koha e krijimit, madhësia e tekstit. Informata e rëndësishme për letërsinë artistike është zhanri, tipi (anekdotë, novelë, përrallë, etj.) dhe hronotopi i tekstit. Për tekste të tjera përdoruesi mund të gjejë të gjithë informatën për sferën e funksionimit, tipin e tekstit (biografi, ditore, ligj, publicitet, artikull, etj.) dhe temën e tekstit (biznes, ekonomi, mjekësi, art, etj.).

Duke përdorur informatën metatekstuale si parametër kërkimi, përdoruesi i korpusit mund të zgjedhë tekstet për të krijuar një nënkorpus të vetë për punën e mëtejshme. Për shembull, ai mund të gjejë në korpusin vetëm memuare, ose vetëm tekste të krijuara nga burrat, ose tekste të krijuara në periudhën që shkon nga viti 1940 deri në vitin 1960, ose vetëm tekste të predikimeve kishtarë, ose tekste të romaneve dhe novelave etj.

5. Baza tekstuale. Burimet për të grumbulluar tekstet për një korpus gjuhësor sot për sot janë të shumta. Proza artistike, publicistikë, artikuj shkencorë gjenden me mijëra në bibliotekat, libraritë dhe në Internet. Të gjithë tekstet elektronike për korpusin duhet të përpunohen në formatin e përshtatshëm elektronik; për tekstet e printuara dhe të shkruara bëhet skanimi dhe përpunimi i mëtejshëm.

Vlen pasur parasysh që, ndryshe nga bibliotekat elektronike, përdoruesit e korpusit *nuk mund t'i shikojnë tekstet e plotë* të grumbulluara në bazën tekstuale. D.m.th. pas kërkesës përdoruesi e fiton vetëm listën fjalish, që përmbajnë fjalën ose togfjalëshin e kërkuar, së bashku me informatën metatekstuale për të gjithë tekstin. Parimi i tillë i zakonshëm për korpuset gjuhësore lehtëson zgjidhjen e çështjes së rëndësishme lidhur me mbrojtjen e të drejtave të autorëve.

III. Korpusi i Gjuhës Shqipe. Dihet se gjuha shqipe akoma nuk ka korpusin e saj gjuhësor. Ndërkaq një korpus gjuhësor, i balancuar dhe i pajisur me shënime është një mjet i fuqishëm dhe i pazëvendësueshëm për studimet gjuhësore moderne. Nga njëra anë, korpusi na lejon ta mbledhim gjatë disa sekondash materialin gjuhësor për përdorimin e ndonjë fjale, forme fjale ose togfjalëshi, i cili do të mblidhej në mënyrë "punëdore" ndoshta gjatë disa muajsh. Nga ana tjetër, mundësia të krahasimit të sasive të mëdha të teksteve që u përkasin llojeve të ndryshme të diskursit (të shkruar dhe gojor), shtresave të ndryshme kronologjike, varianteve dialektore dhe sociale na jep mundësi të formulojmë dhe zgjidhim probleme të reja shkencore. Korpusi gjithashtu mund të përdoret në mësimdhënien e gjuhës shqipe për të huajt.

Më sa duket, Korpusi i gjuhës shqipe duhet të dalë si një përmbledhje e balancuar të teksteve elektronike të përbërë nga dy pjesa kryesore, e cilat janë korpusi i teksteve të shkruara dhe korpusi i teksteve gojore. Korpusi i teksteve të shkruara mund të ndahet në dy nënkorpuse: nënkorpusi i teksteve të shkruara në shqipen standarde, i cili do të përfshijë tekstet e periudhës që nga vitet 1944–1945 deri në kohën e sotshme, dhe nënkorpusi i teksteve të periudhës, që vazhdon nga vitet 1840-të deri në mes të viteve 1960-të. Ky i fundit mund të përfshijë edhe dokumente të shkruara në variantet e shqipes që ekzistojnë para krijimit të standardit të përbashkët dhe ndoshta edhe vazhdonin të përdreshin së bashku me atë standard. Ato janë tekste të Rilindjes Kombëtare, tekste të shkruara në variantet e shqipes të bazuara në gegërishten jugore, gegërishten veriore dhe toskërishten. Më sa duket, Korpusi duhet të përfshijë një përzgjedhje reprezentative të teksteve të traditës letrare të arbëresheve të Italisë.

Gjatë përpunimit të nënkorpuseve duhet përdorur metoda të ndryshme. Nënkorpusi i teksteve të vjetra, veçanërisht ato të viteve 1840–1920-të, duhet të jetë maksimalisht i plotë dhe të përfshijë të gjithë tekstet që ekzistojnë. Nënkorpusi i teksteve të shkruara në gjuhën e sotme standarde duhet të jetë të paktën e balancuar dhe të përfshijë mjaft shembuj të letërsisë artistike, memuare, publicistike, shkencore, teknike, politike, fetare, juridike, ashtu edhe shembuj të teksteve të ndryshme prej Internet-komunikimi. Kuptohet se përfshirje e plotë të teksteve në shqipen e sotme është pamundur, sepse sasia e këtyre teksteve bëhet pothuajse pakufizuar.

Korpusi i teksteve gojore gjithashtu mund të përbëhet nga dy nënkorpuse. I pari përfshin gjuhën e folur standarde (për shembull, incizime të fjalimeve publike të politikeve, incizime të leksioneve dhe emisioneve në radio dhe TV, ashtu edhe incizime të monologëve dhe dialogëve spontane). Nënkorpusi i dytë duhet të përmbajë incizimet e të folurit dialektor.

IV. Etapa e tanishme e punës në kuadrin e projektit. Në vitin 2011 në bashkëpunimin e ngushtë midis albanologëve të Sankt-Peterburgut dhe gjuhëtarëve nga Moskva, që merren shumë vjet me përpunimin e korpuseve të gjuhëve të ndryshme, filloi puna paraprake për krijimin e Korpusit të gjuhës shqipe. Në etapën e parë ne merremi me përpunimin e sistemit të shënimeve gramatikore, me hartimin e fjalorit gramatikor dhe me përpunimin e programit të analizës morfologjike. Këtu paraqiten disa nga rezultatet paraprake që janë arritur gjatë etapës së parë të punës në kuadrin e projektit.

1. Anotimi morfologjik për Korpusin është përpunuar në bazë të sistemeve të ngjashme të korpuseve të mëdha, si Korpusi i Gjuhës Ruse dhe Korpusi i Armenishtes Lindore. Sistemi i shënimeve përfshin informatën për pjesët e ligjëratës dhe kategoritë gramatikore që mund të shprehen format e fjalëve në tekstin.

2. Tekste të zgjedhura për bazën tekstuale të Korpusit janë skanuar dhe arkivuar në formatin txt.

3. Analiza morfologjike në kuadrin e Korpusit është bërë me anë të programit analizues UniParser 2.0, përpunuar nga specialistë nga Moskva.

4. Puna më e rëndësishme që bëhet sot për sot në kuadrin e projektit është përgatisje e fjalorit gramatikor. Fjalori bazohet në parime kryesore të *Gramatikës së gjuhës shqipe* nga Oda Buchholz dhe Wilfried Fiedler (Buchholz O., Fiedler W. *Albanische Gramatik*. Leipzig, 1987).

Në bazë të kësaj gramatike kemi krijuar një pjesë të fjalorit gramatikor, e cila përfshin foljet, emrat dhe e shqipes. Tipat kryesore të lakimit dhe të zgjedhimit, që gjejmë në Gramatikën e Buchholz-Fiedler-it, janë sistematizuar në një file e formatit .txt. Çdo paradigmë është emërtuar dhe pas çdo forme jepet informata për kuptimin e saj gramatikor. Parametra të tilla, si sasia dhe rendi i temave të fjalëve, janë të rëndësishme për funksionimin e duhur të programit. Për shem-

bull, për sistemin emëror është vendosur që tema e parë sipas radhës është tema e numrit shumës, e cila është njësoj në të gjithë rasat e shquarës dhe të pashquarës, kurse në numrin njëjës emrat mund të kanë më shumë se një temë.

File tjetër përmban leksemat se bashku me të gjithë temat e pranueshme për çdo leksemë. Për të plotësuar listën e leksemave, përdoren fjalorët ekzistues të shqipes. Çdo leksemë ka lemën, temën (ose disa tema) dhe numrin e paradigmës. Gjithashtu këtu jepet informata gramatikore, përkthimet në gjuhë të tjera, informata për veçoritë e fjalëformimit.

Duke përdorur informatën të dhënë në ata file, Parser-i formon paradigmat e plota të të gjithë fjalëve të fjalorit gramatikor. Në procesin e analizës së tekstit programi lemmatizon çdo formë fjale, d. m. th. e ndërlidh me leksemën e duhur nga fjalori gramatikor dhe i jep anotimin e duhur.

Në kuadrin e punës së mëtejshme mbi Korpusin duhet të zgjidhim një varg të konsiderueshëm problemesh.

1. Një nga detyrat kryesore është krijimi i Korpusit **reprezentativ** me një sasi të konsiderueshëm tekstesh. Kuptohet, se denduria e ndonjë dukuri gjuhësore mund të studiohet në mënyrë të hollësishme me ndihmën e korpusit të madh me 100 milion përdorime fjalësh.

A. Korpusi i plotë. Ka dukuri që mund të studiohen vetëm në tekstet e epokës së caktuar (për shembull, gjuhëtari do të sqarojë, a përdorej leksema A me kuptimin B në gjuhën e shekullit XIX). Për këtë arsye duhet të krijohet *korpusi maksimalisht i plotë*, i cili do të përfshijë pothuajse të gjithë tekstet (qoftë vetëm tekste të shkruara) në shqipen të krijuara në epokë të ndryshme.

B. Korpusi që pasqyron kulturën. Gjuha e shkruar është, në radhë të parë, gjuha e kulturës së popullit. Prandaj një grumbullim tekstesh që kanë vlerën e madhe kulturore gjithashtu përfaqëson një nga burimet më të rëndësishme për korpusin. Si shembull mund të përmendet Korpusi i Akademisë Austriake, që po krijohet sot për sot në Venë. Është korpusi paralel gjermanisht-rusisht, i cili përfshin tekstet në gjuhën gjermane që kanë ndikuar kulturën e Austrisë, dhe ndër të tjera tekste të përkthyer, si Bibël ose romanët e Dostoevskit.

2. Burime elektronike të teksteve. Ka probleme që lidhen me përpunimin e teksteve elektronike të skanuara dhe veçanërisht të nxjerra nga Interneti. Internet-burimet e mungojnë standardin e përbashkët të paraqitjes së tekstit (për shembull, vizë ose shenje të tjera të pikësimit mund të shkruhen me mënyra tepër të ndryshme në tekstet nga Interneti). Gjithashtu në tekstet e Internetit jo-oficial zakonisht ka shumë gabime shtypi, gabime ortografike dhe gabime pikësimi, të cilat duhet të eliminohen “me dorë”.

3. Homonimia në Korpusin e gjuhës shqipe. Dihet, se në zanafillë programi i analizës morfologjike nuk dallon:

- homografët – të gjithë njësitë, që shkruhen në të njëjtën mënyrë
- homonimet leksikore (*hap – hap*)
- homonimet gramatikore (homofomat) – për shembull, format e emërores dhe të kallëzores së trajtës së pashquar njëjës. Për çdo formë të tillë programi do të propozojë disa variante të analizës, të cilat i ka krijuar duke përdorur algoritmin e fjalorit të tij gramatikor.

Prandaj çdo tekst i analizuar me anë të parser-it zakonisht përpunohet me një program filtrues, i cili i veçon dhe i heq variantet e analizës që pothuajse nuk janë të mundshme. Megjithatë, format homonimike mbeten në tekstin me shumicë edhe pas filtrimit të tillë, dhe përpunimi i mëtejshëm bëhet vetëm *me dorë* me anë të programit special.

- **Përfundim.** Pra, detyrat e dorës së parë në kuadrin e projektit të Korpusit të gjuhës shqipe janë përkryerje e sistemeve të shënimeve morfologjike dhe metatekstuale, zgjerimi i fjalorit gramatikor dhe zgjerimi i bazës tekstuale të Korpusit. Është e qartë, që realizimi i projektit të tillë tepër të madh do të bëhet mundur vetëm në kusht të bashkëpunimit të albanologëve të vendeve të ndryshme. Për shembull, veç përpunimi i teksteve, zbatimi i sistemit të shënimeve në masive të mëdha tekstesh, përpunimi përfundimtar i teksteve është një punë jash-tëzakonisht e madhe, që mund të bëhet vetëm me forcat e tërë grupi specialistësh. Rezultati i bashkëpunimit, Korpusi i Gjuhës Shqipe, pa diskutim, do të ketë dominancë të madhe për përdorues të ndryshëm, të cilët për shkak të specializimit, ose një nevojë ose një interesi amator, do të kërkojnë në Korpusin përgjigjet për pyetje të lidhura me strukturën dhe funksionimin e gjuhë shqipe në kohë të ndryshme e historisë së saj.

Nebi ÇAKA, Ali ÇAKA, Prishtinë

KORPUSI I GJUHËS SHQIPE – REZULTATET E PARA, PROBLEMET DHE DETYRAT

Abstrakt

Në punim përshkruhet mënyra e përpilimit të korpusit të parë njëmilion-fjalësh të gjuhës shqipe nga N. Caka dhe A. Caka, në Universitetin e Prishtinës, më 2006, sipas korpusit përkatës të anglishtes, të njohur si ‘Korpusi i Braunit’, përpiluar nga H. Kucera dhe W. N. Francis më 1960 në Universitetin e Braunit në SHBA. Paraqiten rezultatet e para të nxjerra nga përdorimi i këtij korpusi – fjalorët e dendurisë. Po ashtu jepen dhe rrugët për përpilimin e një korpusi më të madh të gjuhës shqipe, të tipit BNC (British National Corpus), si dhe problemet dhe detyrat që dalin gjatë kësaj ndërmarrjeje.

Fjalët çelës: korpusi njëmilionfjalësh i gjuhës shqipe, korpusi i Braunit, BNC (British National Corpus), fjalorët e dendurisë.

1. Hyrje

Përdorimi gjithnjë më i madh i kompjuterit dhe i teknologjisë së informacionit në të gjitha fushat e kërkimit shkencor nuk ka lënë pa e përfshirë edhe fushën e linguistikës. Korpuset tekstore të përpiluara me kompjuter paraqesin një mjet me rëndësi jo vetëm për leksikografinë, por dhe për studime të ndryshme linguistike. Ato kanë gjetur zbatim edhe në lëmenj të ndryshëm që kanë të bëjnë me gjuhët njerëzore a natyrore, në radhë të parë në përpunimin e gjuhës natyrore (Natural Language Processing, NLP) dhe në përkthimin kompjuterik. Sot krahas korpuseve të shumta njëgjuhëshe janë ndërtuar dhe korpuse të ndryshme paralele në dy a më shumë gjuhë, të cilat ndihmojnë për një përkthim më të saktë kompjuterik nga një gjuhë në disa gjuhë të ndryshme dhe anasjelltas.

2. Korpusi tekstor dhe llojet e tij

Në linguistikë dhe në leksikografi, *korpusi* është një koleksion (tërësi) tekstesh, shprehjesh ose mostrash (shembujsh) që konsiderohen pak a shumë përfaqësues të një gjuhe dhe rëndom ruhen si një ba-

zë e të dhënave (databazë).

Sipas McEnery & Wilson (1996), në parim, secili koleksion/grumbull i dy e më shumë teksteve mund të quhet *korpus*. Sipas Ball-it, me *korpus* nënkuptojmë një tërësi tekstesh të një gjuhe natyrore të përpiluar sipas një kriteri të caktuar. [Ball 1996].

Në linguistikën e korpusit, korpusi dallohet nga tekstet e tjera sipas kriterëve linguistike sipas të cilave është përzgjedhur dhe është grumbulluar/ mbledhur. Sipas rekomandimeve të EAGLES (Expert Advisory Group on Language Engineering Standards, 1994) “korpusi është një grumbull (koleksion) i pjesëve të gjuhës që janë përzgjedhur dhe renditur sipas kriterëve të caktuar për t’u përdorur si një mostër e gjuhës”. Sipas po këtyre rekomandimeve, “korpusi kompjuterik është një korpus i cili është i koduar në mënyrë të standardizuar dhe të njëtrajtshme (homogjene) për qëllime të gjetjes/ përdorimit të lirë (open-ended retrieval tasks)”.

Sipas analogjisë me kompjuterët, e sipas kriterit të madhësisë së tyre, korpuset ndahen në tri gjenerata:

- Në **gjeneratën e parë** të korpuseve bëjnë pjesë korpuset me rreth një milion paraqitje, ku me *paraqitje* nënkuptojmë të gjitha trajtat e fjalëve që dalin në tekstet e përfshira në korpus. Përfaqësues tipikë të kësaj gjenerate janë *Korpusi i Braunit* (Brown), i përpiluar më 1963-64, për anglishten amerikane dhe korpusi *Lancaster-Oslo-Bergen*, LOB, i viteve ‘70, i anglishtes britanike. Një korpus të këtij tipi për gjuhën shqipe e kanë përpiluar, më 2006, N. Caka dhe A. Caka.

- **Gjeneratës së dytë** të korpuseve i përkasin korpuset e viteve ‘80 të shekullit të kaluar, të madhësisë deri në 30 milionë paraqitjesh, me përfaqësues tipikë *Birmingham Collection of English Texts* të Sinclair-it, 1985, me rreth 20 milionë paraqitjesh dhe *Longman/ Lancaster English Language Corpus*, me rreth 30 milionë paraqitjesh.

- Në **gjeneratën e tretë** të korpuseve përfshihen korpuset e përpiluara duke filluar nga mesi i viteve ‘90 të shekullit të kaluar e deri më ditët e sotme, të cilat përmbajnë 100 milionë e madje edhe disa qindra milionë fjalë. I pari i këtij lloji është *Korpusi BNC (British National Corpus)*, i përpiluar së pari më 1994 (botimi i fundit është ai i vitit 2007, *BNC XML Edition*), i cili përmban 100 milionë paraqitje fjalësh të gjuhës së sotme angleze, të shkruar dhe të folur.

2.1 Krijimi dhe ruajtja e korpusit tekstor

Për ruajtjen e korpusit tekstor në kompjuter, është e domosdosëme që tekstet që përbëjnë korpusin të jenë në formë elektronike. Tekstet mund të mbliidhen, sipas procedurës më parë të caktuar, në pesë mënyra:

1. duke i zhbartur (shkarkuar) nga Interneti tekstet elektronike ekzistuese,

2. duke kërkuar nga botuesit tekstet e caktuara në formë elektronike,

3. duke i skanuar dhe pastaj digjitalizuar tekstet e shtypura,

4. duke i konvertuar në formë digjitale materialet e mikrofilmuara,

5. duke i rishkruar me kompjuter tekstet e shkruara që vështirë skanohen (për shkak të dëmtimit të dokumentit, tipit të shkronjave etj.) dhe tekstet në dorëshkrim e në mikrofilm.

Për materialet e përdorura, duhet konsultuar ligji për të drejtat e autorit [Në Kosovë, Ligji Nr. 2004/45 *Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të përfaqëruara*] dhe, në rast nevojë, duhet kërkuar leja për shfrytëzimin e teksteve që dëshirojmë t'i përfshijmë në korpus. Nga ana tjetër edhe vetë korpusi duhet mbrojtur nga shfrytëzimi i paautorizuar (pa leje) dhe nga pirateria.

Korpusi i parë i përpiluar me anë të kompjuterit, është **Korpusi i Braunit i anglishtes amerikane standarde**, i realizuar nga W. N. Francis dhe H. Kuçera në Universitetin e Braunit (*Brown*) Providence, RI, SHBA, gjatë viteve 1963-1964.

Karakteristikat themelore të korpusit të Braunit janë [Francis-Kucera 1964]:

1. përbëhet prej rreth 1 milion paraqitjeve (saktësisht: 1.014.312),

2. është i ndarë përfaqësisht njëtrajtësisht sipas zhanreve (15 zhanre),

3. përmban 500 mostra tekstesh (374 prozë informative dhe 126 prozë imagjinative/artistike),

5. secila mostër e tekstit ka 2000 e ca paraqitje (secila mostër fillon në fillim të një fjalie, por jo patjetër në fillim të një paragrafi,

dhe mbaron në fund të fjalisë së parë pas 2000 fjalëve)

5. tekstet e përfshira në këtë korpus janë botuar brenda një vitit kalendarik (1961).

Sot korpusi i Braunit konsiderohet i vogël dhe paksa i vjetruar, por ai ende përdoret. Ai është marrë si model a standard për hartimin e korpuseve të mëvonshme, si ai gjerman, polak, bullgar etj., po edhe të korpusit të anglishte britanike (*Lancaster-Oslo-Bergen Corpus LOB*) dhe të atij të anglishtes hindiane (*Kolhapur Corpus*), ndaj e kemi marrë edhe ne si model. Ne gjatë hartimit të korpusit tonë (Korpusi Caka), për të cilin do të flasim më poshtë, nuk kemi respektuar vetëm karakteristikën e pestë të dhënë më sipër: Tekstet e përdorura si mostra për hartimin e korpusit tonë janë botuar në një hark kohor më të madh se një vit. Arsyet kanë qenë që të përfshihen tekste sa më reprezentative sipas zhanreve.

2.2 Shënimi/ etiketimi i korpusit tekstor

Për një analizë më të hollësishme të korpusit, tekstit origjinal të korpusit duhen shoqëruar informacione shtesë, të cilat do të ndihmonin në kërkime të mëtejme. Pra korpusi do të duhej të shënohej a etiketohet, ku me shënim (angl. *annotation*) a etiketim (angl. *tagging*) nënkuptojmë vënien e etiketave (angl. *tags*) secilës formë (trajtë) të fjalës së korpusit.

Si informacion, së paku, duhet përfshirë shënimet për burimin e tekstit. Kjo nënkupton pajisjen e tekstit me shënime (të dhëna) lidhur me autorin/autorët ose folësin/folësit, botuesin, të drejtat e autorit, si dhe informacionin kontekstual, d.m.th. prejardhjen rajonale dhe sociale të autorëve/folësve, moshën dhe gjininë e folësit/folësve, vendin dhe kohën e publikimit/regjistrimit (incizimit) etj.

Në shumë korpuse, përdoret ndonjë gjuhë markuese (shenuese) për të përfshirë informacionin lidhur me **strukturën e dokumentit** origjinal (p.sh. titujt, paragrafët), **formatimin** (tipi, stili dhe madhësia e fontit) dhe tipare të tjera të caktuara të tekstit (luhatjet në drejtshkrim, fjalët e shkruara gabimisht, ndryshimet në tekstin origjinal etj.). Për këtë qëllim shpesh përdoret e ashtuquajtura gjuha XML (*Extensible Markup Language* apo *eXtended Markup Language* – gjuhë e zgjeruar për shënim), si dhe gjuha SGML (*Standard Generalized Markup Language* –

gjuhë standarde e përgjithësuar për shënim), metagjuhë markuese këto të cilat ofrojnë formatin për përshkrimin e të dhënave të strukturuar.

Në fund, disa korpuse përmbajnë informacione metalinguistike:

– **Lematizimi** (angl. lematization): reduktimi i fjalëve në korpus në leksemat e tyre përkatëse apo në fjalën përfaqësuese që jepet në fjalorë; p.sh. fjalët jam, je, është, jemi, jeni, janë; isha, ishe, ishte, ishim, ishit, ishin; qeshë, qe, qemë, qetë, qenë; qenkam, qenke, qenka, qenkemi, qenkeni, qenkan; qenkështa, qenkështe, qenkësh, qenkëshim, qenkëshit, qenkëshin; qofsha, qofsh, qoftë, qofshim, qofshi, qofshin; ji, jini; (të) jem, (të) jesh, (të) jetë, (të) jemi, (të) jeni, (të) janë – që të gjitha janë trajta të foljes “me qenë”, që në fjalorë jepet me trajtën e saj të vetës së parë njëjës të dëftores së të tashmes: jam – dhe kjo është lema e të gjitha këtyre fjalëve.

- **Tokenizimi** (angl. tokenization): identifikimi i njëjësive leksikore (angl. *tokens*), p.sh. *ai, atij; djalë, djem, djemve; jam, janë, isha, qesh; kam, kemi* etj.

- **Etikitimi gramatikor** (angl. *POS tagging*): shënimi që tregon se cilës pjesë të ligjëratës (angl. *part of speech, POS*) i takon fjala; p. sh. *emër, mbiemër, folje, lidhëze* etj. Është tipi themelor i etiketimit të korpusit lingvistik, i cili shërben si pikënisje për llojet e tjera të analizave.

- **Analiza sintaktike** (angl. *syntactic parsing*) - informacioni lidhur me strukturën pemë apo të marrëdhënieve/relacioneve gramatikore të përbërësve, e madje edhe

- Shënimi semantik (angl. *semantik annotation*), ku fjalët, togjet e fjalëve (sintagmat) ose fjalitë kanë etiketa që shënon fushën semantike (kuptimore), metaforën etj., me të cilën zgjidhet problemi i homonimisë, si në rastin: dhe (korja e rruzullit tokësor; dhe i zi) – emër, dhe (jap; ti dhe) – folje, dhe (unë dhe ti) – lidhëse, dhe (dhe atje nuk u mësua) – pjesëz dhe i polisemisë (shumëkuptimisë), si në rastin: rrënjë (rrënjë e një bime; rrënjë e flokut; prejardhje; rrënjë katrore – në matematikë, rrënjë kimike – në kimi etj.).

Etiketimi a shënimi i korpusit të gjuhës shqipe nuk është punë e lehtë për shkak të trajtave të shumta që marrin fjalët në ligjërim. Bie fjala, sipas Buchholz-it (Buchholz et al., 1992) kemi 53 klasa të zgjedhimit të foljeve, e sipas Munishit (1998) madje 85. Edhe emrat e bëjnë në shumësin sipas një numri të madh gjedhesh. Etiketuesi (tageri) i gjuhës shqipe përdor 200 etiketa (tagje). [Caka, A. 2011]

3. Korpusi njëmilionëfjalësh i gjuhës shqipe

Që në fillim duhet të saktësojmë se kur flasim për korpusin njëmilionfjalësh kemi të bëjmë në fakt me një korpus prej një milionë paraqitjesh fjalësh të ndryshme.

Më poshtë do të paraqitet mënyra e përpilimit të korpusit njëmilionfjalësh të gjuhës shqipe nga N. Caka dhe A. Caka, Prishtinë, më 2006, të cilit në vazhdim do t'i referohem si "Korpusi Caka".

Ky korpus është përpiluar sipas metodologjisë së përpilimit të korpusit të Braunit [Francis-Kucera 1964], me disa modifikime të vogla.

Për hartimin e Korpusit Caka është grumbulluar një material i shkruar mjaft heterogjen i teksteve në gjuhën shqipe, të krijuara ose të botuara për herë të parë në periudhën (harkun kohor) 1976-2006, pjesa më e madhe pas vitit 2000, nga hapësira gjuhësore mbarëshqiptare, nga i cili janë marrë në konsideratë 500 mostra me nga 2000 fjalë (a pak më shumë) apo gjithsej 1.000.000 fjalë (në rastin konkret: 1.084.396 fjalë).

Në këtë korpus përfaqësohen zhanre apo gjini të ndryshme, të cilat mund të grupohen në pesë nënkorpuse:

- Mostra tekstesh nga letërsia artistike – proza letrare: 175 artikuj 2000-fjalësh = 353.000 fjalë [rreth 35% e korpusit] me 37.423 fjalëforma.
- Mostra tekstesh nga shtypi i shkruar – proza informative: 75 artikuj 2000-fjalësh = 155.195 fjalë (rreth 15% e korpusit) me 36.514 fjalëforma
- Mostra tekstesh nga dramat, pjesët teatrale dhe regjistrimet e mbledhjeve – zëvendësim për "gjuhën e folur": 75 artikuj 2000-fjalësh = 151.508 fjalë (rreth 15% e korpusit) me 17.360 fjalëforma
- Mostra tekstesh nga letërsia shkencore dhe edukative-arsimore – proza shkencore-edukative: 125 artikuj 2000-fjalësh = 250.000 fjalë ([rreth 25% e korpusit) me 29.113 fjalëforma
- Mostra tekstesh nga legjislacioni dhe administrata – gjuha zyrtare: 50 artikuj 2000-fjalësh = 103.390 fjalë (rreth 10% e korpusit) me 9.432 fjalëforma

Në vend të gjuhës së folur, në korpus është përfshirë gjuha e teksteve (kryesisht e dialogëve dhe monologëve) dhe transkriptet e seancave parlamentare. Tekstet e filmave, dramave e pjesëve teatrale i ka-

në marrë si “gjuhë e folur” edhe përpiluesit e disa korpuseve të gjuhëve të tjera, si p.sh. të frëngjishtes, polonishtes e rusishtes [Buk 2004].

Një pjesë e këtyre teksteve është siguruar në mënyrë elektronike:

- nga interneti, drejtpërsëdrejti nga autorët e teksteve apo në mënyrë tjetër; e pjesa tjetër është përfutur me shndërrimin (konvertimin) e tekstit të shkruar në tekst në formën elektronike:
- me anë të njohjes optike të tekstit, si dhe të njohjes inteligjente, të tekstit të skanuar.

Për kompletimin e korpusit CAKA i kemi skanuar 180 tekste (libra), 36% të teksteve përfaqësuese të korpusit (500 tekste). Tekstet janë ruajtur në formatin jpg. Skanimi është bërë me dy tipa skanerësh, skanerin shtratrafshët HP6100C të prodhuesit Halwet Packard dhe me skanerin e kombinuar shtratrafshët me furnizues automatik të dokumenteve me shpejtësi të lartë skanimi Fujitsu M3097DE/DG Image Scanner të prodhuesit Fujitsu. Për përpunimin optik të teksteve të skanuara, njohjen optike të shenjave, është përdorur softueri i licencuar ABBYY Fine Reader 7.0 Corporate Edition (versioni i fundit në vitin 2006).

Tekstet e skanuara i kemi ruajtur në formatin jpg. E kemi përzgjedhur këtë format të imazheve sepse fajlat me këtë format zënë më pak vend në diskun e kompjuterit. Për krahasim, në tabelën 1 kemi dhënë madhësitë e fajlit të imazhit të tekstit të skanuar, të një faqe të romanit “Oh” të Anton Pashkut (formati i librit A5), ku shihet se formati jpg ka më pak KB (kilo bajt) krahasuar me formatet e tjera. Madhësitë janë dhënë për formatet që mund të njihen nga softuerët për njohje të karaktereve.

Tabela 1 - Madhësia e fajlit për formate të ndryshme

Formati i imazhit	Madhësia e fajlit në KB
jpg	142
tif	1171
png	837
gif	148

Rezolucioni i imazhit të skanuar ka ndikim të madh në njohjen optike të tekstit. Se me çfarë rezolucioni duhet të skanohet teksti varet edhe nga përgatitja e tij. Tekstet e përgatitura/shtypura jo mirë japin

keqnjohje më të madha në rezolucion më të lartë, shih shembullin në figurën 1 ku nga gjithsej 70 fjalë, 23 fjalë o 32.8 % janë lexuar (interpretuar) gabimisht:

Figura 1 - Teksti i njohur nga imazhi i skanuar (Ilaz Prokshi, *Daullet e natës*).

Tefc e pasijë sesi u shkëput auga ikflo botë dhe sikur nuk më kuptoi dot, kjo ishte e qartë. Dhe fçësiisoj e indiente veten gjersa binte të flinte. Edie në ëmdërr siikur e torturonte veten, e me një ndjenjë rreptësie e melaaikotlie sikUT dëshironte të vazhdojë nrëfiimin për mua. S'ikam ç'të bëj, iftia me vete. E di se miuind të in'ë ptemgojoië ,ë? isilkiur ,më tOidsfhfoe inë ato çaste vetmie.

Ndërsa, tekstet e përgatitura/shtypura mirë japin keqnjohje tejet të vogël ose aspak. Për rezultatin e njohjes optike të tekstit të përgatitur mirë shih shembullin e mëposhtëm ku nga gjithsej 97 fjalë, 0 fjalë o 0 % janë lexuar (interpretuar) gabimisht:

Figura 2 - Teksti i njohur nga imazhi i skanuar (I. Kadare, *Përballë pasqyrës së një gruaje*).

Më 7 prill 1939, në orën 6 të mëngjesit, tabloja "Kalorësi me skifter" ishte varur në muzeun e një vendi skandinav. Rreth dy mijë kilometra më larg, në një qytet të Italisë Qendrore, arkitekti Ernesto Mohr, pas një nate plot dyshime, për shkak të dhimbjeve në shpretkë, po bënte një gjumë të rëndë plumb. Diku më në lindje, në anën tjetër të detit Adriatik, djaloshi 17 vjeçar shqiptar Bardh Beltoja, nxënës i liceut klasik, flinte gjithashtu në banesën 27, Rruga mbretërore, në qytetin e Durrësit. Një avion ushtarak fluturonte gjatë bregdetit shqiptar, midis Durrësit dhe Shëngjinit. Që

Raporti i teksteve të siguruar në mënyrë elektronike dhe atyre të përfutur me digjitalizimin apo kthimin në formë elektronike të teksteve të skanuara është: 320 (64%) me 180 (36%).

Në dallim nga korpusi i Braunit, i cili përbëhet prej 500 mostrash tekstesh 2000-fjalëshe të publikuara në anglishte në SHBA brenda vetëm një viti (1961) dhe si i tillë tregon një gjendje relativisht ho-

mogjene të anglishtes amerikane, Korpusi Caka, në pamundësi që të përbëhet prej teksteve të botuara brenda një viti e që do të mbulonin të gjitha kategoritë, ose pjesën më të madh të tyre, të marra në konsideratë në Korpusin e Braunit, përfshin një hark kohor prej 40-50 vjetësh dhe si i tillë nuk është pasqyrë e një gjendjeje homogjene të gjuhës, por e një periudhe dhe si i tillë është heterogjen edhe në pikëpamje kohore.

Larueshmëria e zhanreve, stileve e kategorive e mostrave të teksteve të zgjedhura në korpus mundëson që leksiku i përfshirë në të t'i afrohet sa më shumë gjendjes reale të gjuhës dhe të mos ketë anime si, bie fjala, në korpusin e rusishtes të njohur si "Zasorina 1977", ku p.sh. fjalët *Soviet* dhe *komrad* (= shok) rangohen ndër 100 fjalët e para, së bashku me fjalët funksionale, si rezultat i përzgjedhjes së mostrave nga tekstet e Leninit e Hrushqovit dhe nga shtypi sovjetik i kohës.

Problem në vete ka qenë ndërtimi i bazës së të dhënave për tekstet e grumbulluara dhe përzgjedhja e teksteve përfaqësuese nga fondi prej më se 60.000 fajlave (skedarëve).

Fragmentet e teksteve të njohura dhe të përpunuara i kemi bashkuar në një fajl të vetëm. Emërtimin e fajlave e kemi bërë sipas modelit:

G84-Azem_Shkreli_Karvani i bardhë-Roman_fj2079.doc

ku është:

G84 - Zhanri sipas modelit të korpusit të Brown-it

Azem – emri i autorit

Shkreli – mbiemri i autorit

Karvani i bardhë – Titulli i veprës

Roman – gjinia letrare

fj2079 – numri i fjalëve

doc – formati i fajlit

Secilin fajl në formatin doc e kemi përpunuar veç e veç me anë të një *macro*-je. Këtu me *macro* (term në shkencat kompjuterike) nënkuptojmë një numër të caktuar veprimesh (komandash) që përmbliidhen në një komandë të vetme sipas rregullave të caktuara të programimit.

4. Fjalori i dendurisë

Korpusi i ndërtuar, i tipit të paetiketuar, është përdorur për të krijuar fjalësin e duhur të fjalëve me denduri më të lartë të paraqitjes [Zasorina 1977]. Më poshtë, tabela 2, jepet lista e 100 fjalëve të para të radhitura sipas dendurisë së paraqitjes.

Tabela 2 - Lista e 100 fjalëve të para të radhitura sipas dendurisë së paraqitjes në korpus

1	të	
2	e	63956
3	në	34998
4	i	26649
5	dhe	25677
6	jam	19665
7	për	17936
8	me	17681
9	kam	17608
10	që	16895
11	një	13851
12	ky	12679
13	ai	11585
14	më	10630
15	nga	10100
16	se	8712
17	nuk	8431
18	si	6930
19	u	6322
20	edhe	6241
21	së	6202
22	bëj	5734
23	po	4925
24	unë	4845
25	cili	4245
26	them	4207
27	dua	3820
28	tjetër	3737
29	por	3728
30	ta	3502
31	tij	3355
32	mund	3077
33	shumë	2976
34	gjithë	2921
35	duke	2810
36	tyre	2670
37	kur	2552
38	vit	2547
39	marr	2442
40	ti	2248
41	vetëm	2196
42	te	2131
43	prej	2129
44	parë	2068
45	sa	2030
46	njeri	2018
47	pa	2007
48	ku	2003
49	madh	1991

50	punë	1974
51	kohë	1964
52	mirë	1935
53	pas	1929
54	shqiptar	1921
55	vend	1909
56	jetë	1844
57	jo	1718
58	di	1716
59	dy	1713
60	a	1705
61	ose	1670
62	ditë	1661
63	s'	1648
64	saj	1615
65	apo	1579
66	vetë	1559
67	mos	1547
68	disa	1538
69	mbi	1477
70	vij	1443
71	gjuhë	1439
72	na	1426
73	para	1413
74	gjatë	1404
75	fund	1377
76	jap	1358
77	im	1340
78	fjalë	1334
79	shkollë	1283
80	shoh	1258
81	as	1255
82	kërkoj	1237
83	ia	1230
84	pjesë	1224
85	dal	1179
86	çdo	1173
87	gjë	1169
88	herë	1153
89	deri	1143
90	shkoj	1127
91	mënyrë	1081
92	dukem	1081
93	sipas	1071
94	kështu	1039
95	ynë	1015
96	flas	1007
97	rast	1004
98	rrugë	987
99	re	975
100	gjej	975

5. Fjalorët themelorë të gjuhës shqipe

Problem më vete për përpilimin e një korpusi paraqet, siç u tha, zgjedhja e korpusit përfaqësues (reprezentativ) për analizë gjuhësore, ngase tematikat dhe funksionet komunikuese ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme nga një tekst te tjetri, përkatësisht nga një autor te tjetri. Prandaj një korpus i cili do të përdorej për nxjerrjen e një fjalori themelor të akëcilës gjuhë, pra dhe të gjuhës shqipe, do të duhej të merrte parasysh të gjitha këto aspekte.

Fjalët nuk kanë përndarje të njëjtë në tekst. Është e natyrshme që fjalët shërbyese të kenë denduri më të madhe të paraqitjeve se fjalët e tjera. Nga ana tjetër, denduria e fjalëve të caktuara ndryshon nga një zhanër te tjetri, si nga autori te autori. Ndodh që një fjalë, si p.sh. një emër i përveçëm (p.sh. Kosova, në një artikull për Kosovën), një titull nderi (p.sh. imzot, në një artikull për religjionin) apo një term teknik i caktuar (p.sh. diodë, në një artikull nga elektronika) të përsëritet shumë herë në tekst, duke e ngritur atë fjalë në një rang që nuk i takon nëse merret parasysh i tërë korpusi. Ekzistojnë mënyra të ndryshme për matjen e variacionit, përkatësisht të koeficientit të variacionit, i cili rëndom përkufizohet si raport ndërmjet shmangies standarde (dispersionit absolut të të dhënave) dhe mesatares [Për më shumë të shihet: Church, K. and Gale, W. (1995), "Poisson Mixtures", *Journal of Natural Language Engineering* 1:2]

Korpusi Caka është i etiketuar pjesërisht; është bërë lematizimi i tërë korpusit dhe përcaktimi i kategorisë gramatikore të 10000 fjalëve të para.

Etiketimi është bërë në mënyrë gjysmautomatike, elektronikisht dhe manualisht. Po ashtu ky etiketim është krahasuar me rezultatin e etiketimit me etiketuesin (tagerin) e gjuhës shqipe, modeli kompjuterik i të cilit është zhvilluar nga A. Caka dhe V. Neziri, Prishtinë 2011. [Caka, A. 2011]

Kriteret e përcaktimit të *fjalës* (*word*):

– Për fjalë zakonisht merret secili *varg* (*string*) i shkronjave të njëpasnjëshme që ndodhet ndërmjet dy zbrazëtirave.

– Sipas Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe, me *fjalë* nënkuptohet: "Njësia e mëvetësishme më e vogël e gjuhës, (një) tërësi e pandashme e tingëllimit dhe e kuptimit e formësuar nga ana gramatikore, që

pasqyron në mënyrë të përgjithësuar e shënon sende e dukuri të realitetit dhe riprodhohet e veçohet në rrjedhën e ligjërimit” [FGjSSH 1981].

Sipas këtij përkufizimi, nuk janë marrë si fjalë të veçanta: nyjat e përparme *i, e, të, së* dhe pjesëzat trajtëformuese *do, të, u*, por ato janë përfshirë me fjalët përkatëse që i shoqërojnë, si në shembujt: *i nxënësit, e bujkut, të shtëpive, së ëmës*, përkatësisht si në shembujt: *të shkojë, do të punojë, u la*.

Korpusi është lematizuar, fjalëformat janë sjellë në trajtën përfaqësuese.

Në korpusin e lematizuar, 1.160 fjalë lema (trajta përfaqësuese) kanë dendurinë e paraqitjes 100 e më shumë dhe përbëjnë 86.7% (867.627 fjalë) të korpusit.

Bazuar në Korpusin njëmilionfjalësh të gjuhës shqipe (“Korpusi Caka”), e në kuadër të temës së tij të magjistraturës shkencore me titull “Kontribut për fjalorin themelor të gjuhës së sotme shqipe”, A Caka, nën udhëheqjen e Akademik R. Ismajlit ka përpiluar më 2006 dy fjalorë themelore të gjuhës shqipe, njëri me 2500 fjalë, e tjetri me 5000 fjalë.

6. Projekti i Korpusit tekstori të gjuhës shqipe i ASHAK

Është inkurajues fakti që Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, në kuadër të Qendrës Leksikografike-Enciklopedike të saj në themelim ka planifikuar hartimin e Korpusit kombëtar të gjuhës shqipe, i cili do të përfshinte 10-20 milionë ose madje edhe 100 milionë paraqitje të fjalëve të gjuhës shqipe, të vjela nga tekstet e ndryshme të shkruara, por dhe nga gjuha e folur, sipas ecurisë tashmë të përpunuar të hartimit të veprave të tilla në vendet e tjera, që tashmë i kanë korpuset e tilla kombëtare. Përveç për qëllime të analizave e studimeve linguistike, ekzistimi i korpusit të tillë do të ishte edhe ndihmesë e madhe për hartimin e Fjalorit të gjuhës shqipe të tipit të madh, i cili do ta paraqiste në mënyrë më të plotë leksikon e gjithëmbarshtëm të gjuhës shqipe.

Në fazën e parë (dvyjeçare) do të skanoheshin dhe do të digjitalizoheshin 2.000 libra të përzgjedhur shqip, me rreth 600.000 faqe, të botuar në ish-Jugosllavi në periudhën 1945-1972 (që përfshin kohën

nga mbarimi i Luftës së Dytë Botërore deri te Kongresi i Drejtshkrimit, kur u zyrtarizua drejtshkrimi i gjuhës së sotme shqipe) dhe të gjithë numrat, rreth 15.000, të së përditshmes “Rilindja” (nga viti 1945, kur kjo doli për herë të parë deri në vitin 1990, kur kjo pushoi së dali) me rreth 300.000 faqe. Përzgjedhja e këtij materiali tekstor për përfshirjen e tij në korpusin kombëtar të gjuhës shqipe pikërisht në fazën e parë të këtij projekti do t’u linte hapësirë veprimi dhe bashkëveprimi projekteve të tjera të ngjashme në hapësirën mbarëshqiptare.

Për kërkimin e mëvonshëm të teksteve të ruajtura në kompjuter, ato duhet të markohen/shënohen a pajisen me një sërë të dhënash të veçanta shtesë, të njohura si *metadata*, të cilat na mundësojnë gjetjen më të lehtë të fjalëve, të togjeve të fjalëve a të fjalive të tëra sipas kri-tereve të caktuara (morfologjike, sintaktike, semantike etj.).

7. Përfundim

Korpusi njëmilonfjalësh i gjuhës shqipe, i përpiluar sipas modelit të Braunit, edhe pse i tipit të vogël dhe pjesërisht i etiketuar, ka shërbyer dhe mund të shërbejë për hulumtime në kuadër të gjuhësisë së aplikuar, siç e dëshmon fjalori i dendurisë dhe fjalorët themelorë 2500-fjalësh dhe 5000-fjalësh. Ky korpus mund të shërbejë si pikënisje për përpilimin e një korpusi më të madh, me 2.000.000-3.000.000 fjalë ose madje edhe me 100.000.000 fjalë. Korpusi i tillë do të mund të shërbente jo vetëm për hulumtime shkencore në fushë të leksikologgjisë e të linguistikës, por dhe si bazë e mirë e një fjalori të tipit të madh të gjuhës shqipe. Që të mund të shërbejë për hulumtime shkencore, korpusi i tillë do të duhej të shënohej/etiketohej, që përveç burimeve financiare kërkon edhe burime njerëzore dhe kohë. Në të kaluarën në koston e punimit të korpusit të tillë më së shumti ka ndikuar kostoja e përpunimit kompjuterik, sepse pajisja kompjuterike ka qenë e shtrenjtë, ndërsa koha e përpunimit shumë më e ngadalshme se sot. Sot në koston e përpilimit (krijimit) të korpusit më së shumti ndikon sasia e punës njerëzore të angazhuar.

Literatura

- [Ball 1996]. [Ball 1996], Ball, N. Catherine (1996), *Concordances and Corpora*, Corpus linguistic course, Department of Linguistics, Georgetown University, Washington DC, <http://www.georgetown.edu/ball/corpora/tutorial.html>].
- [Buchholz et al., 1992] Buchholz, O. and Fiedler, W. (1987). *Albanische Grammatik*. Leipzig: VEB Verlag Enzyklopaedie.
- [Buk 2004], Buk, Solomiya, *Lexical base as a compressed language model of the world* (on the material of the Ukrainian language), 2004.
- [Caka, A. 2006] Caka, *Kontribut për fjalorin themelor të gjuhës së sotme shqipe* (Punim i magjistraturës), Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 2006.
- [Caka, A. 2011] Caka, Ali; Vehbi Neziri, “Algoritmi i modelit kompjuterik të etiketuesit (tagerit) të gjuhës shqipes”, *Takimi i gjashtë vjetor ndërkombëtar i Institutit Alb-Shkenca*, Prishtinë, 01.-04.09.2011.
- [Caka, N. 2011] Caka, Nebi; Ali Caka, “Korpusi njëmilionfjalësh i gjuhës shqipe si bazë për nxjerrjen e fjalëve çelës të teksteve të ndryshme në gjuhën shqipe”, *Takimi i gjashtë vjetor ndërkombëtar i Institutit Alb-Shkenca*, Prishtinë, 01.-04.09.2011.
- [Church 1995], Church, K. and Gale, W. (1995), “Poisson Mixtures”, *Journal of Natural Language Engineering* 1:2
- [EAGLES 1994], *Expert Advisory Group on Language Engineering Standards* (EAGLES) 1994)
- [Francis-Kucera 1964], Francis, W. Nelson, Henry Kucera, *Brown corpus manual of information* (Manual to accompany A Standard Corpus of Present-Day, Edited American English, for use with Digital Computers), Brown University, 1964
- [McEnery & Wilson 1996], McEnery, Tony and Andrew Wilson, *Corpus Linguistics*, Edinburgh: Edinburgh University Press, 1996
- [Munishi 1998], Munishi, Zijadin, *Zgjedhimi i foljeve*, Libri Shkollor, Prishtinë, 1998.
- [Zasorina 1977], Zasorina, L. N. (Ed.). (1977). *Chastotnyi Slovari Russkogo Yazyka* (Frequency dictionary of Russian, Language). Moscow: Russkii Yazyk.

Kolec TOPALLI, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë

FJALA E MBYLLJES SË KONFERENCËS

Qëkurse dijetarët e shekullit të kaluar vunë re lidhjet dhe përkimet e shumta në fusha të ndryshme ndërmjet gjuhëve ballkanike, nisi udhën e saj edhe ballkanistika si shkencë më vete, e lidhur me degë të tjera të gjuhësisë historike, teorike dhe krahasimtare, me diakroninë dhe sinkroninë. Tubimi i këtyre ditëve, që u zhvillua nën kujdesin e veçantë të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, në bashkëpunim me Akademinë e Shqipërisë, është në vazhden e këtyre studimeve, duke përfaqësuar aktivitetin me përmasat më të mëdha të këtij fillim shekulli në këtë fushë të rëndësishme të dijes. Konferenca dyditore që po i mbyll punimet, është gjithashtu aktiviteti më i madh dhe më i rëndësishëm që u zhvillua në mesin e re të Akademisë, të cilën ua urojmë shkencëtarëve të Kosovës ta gëzojnë këtë dhuratë të bukur dhe të merituar, që ia solli liria dhe puna e tyre e lavdrueshme. Është merita e akademikëve dhe dijetarëve të Kosovës, sidomos kryesisë së saj, që mundën të mbledhin në një konferencë të përmasave të tilla jo të zakonshme albanologët, ballkanistët, sllavistët, helenistët, turkologët e romanistët e shumë shteteve nga tre kontinente. Takime të tilla jo vetëm çojnë përpara studimet e kësaj fushe, por hapin horizonte të reja për studime të mëtejme dhe vënë në kontakt dijetarët e shumë vendeve duke qenë premtues për takime të tjera po kaq të gjera dhe po kaq të frytshme.

Për dy ditë radhazi konferenca trajtoi probleme të shumta të fushës së ballkanistikës, sa e lëvruar në shekullin e kaluar, po aq me probleme ende të pazgjidhura në shekullin tonë, të cilat janë trajtuar në shumë studime të dy shekujve të fundit dhe përmbledhtas në vepërën “Linguistique balkanique. Problèmes et résultats” të Kristian Sandfeldit.

Në konferencë u mbajtën gjithsejt 43 kumtesa nga gjuhëtarë që lëvrojnë shqipen në shtetet e mëposhtme: Kosovë, Shqipëri, Maqedoni, Greqi, Mali Zi, Itali, Gjermani, Austri, Francë, Rusi, Poloni, Çeki, Sh. B. A., Moldavi. Punimet e paraqitura u përkasin degëve të ndrysh-

me të gjuhësisë, siç janë: leksikologjia e leksikografia duke përfshirë edhe frazeologjinë, gramatika bashkë me fjalëformimin dhe morfo-sintaksën, fonetika me fonologjinë, onomastika me antropologjinë e toponiminë etj.

Për fushën e gramatikës, ku elementet e përbashkëta të gjuhëve ballkanike kanë tërhequr prej kohësh vëmendjen e gjuhëtarëve, u mbajtën kumtesat: “Format e futurit të shqipes në raport me gjuhët e Ballkanit” nga Besim Bokshi; “Shqipja dhe rumanishtja në vështrim ballkanistik” nga Rexhep Ismajli; “Ç’ dëshmon mënjanimi i paskajores në gjuhët ballkanike?” e Shaban Demirajt; “Disa veçori të urdhërores në gjuhët ballkanike” nga Wilfried Fiedler; “Problemi i urdhërores treguese në gjuhën shqipe dhe në gjuhët e tjera të Ballkanit” nga Victor Friedman; “Tipologji romane dhe ballkanike në strukturën gramatikore të shqipes” nga Seit Mansaku; “Case as nominal property: the interaction of DOM and discourse-linking in Shkodër pronouns” nga Rita Manzini e Leonard Savoia; E ardhmja e tipit do + lidhore si dukuri dialektore dhe ballkanike në gjuhën shqipe” nga Bardhyl Demiraj; “Prania e infinitivit në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe” nga Imri Badallaj; “Sa ballkanike janë mënyrët e foljeve të shqipes, kushtorja dhe habitorja?” nga Blertë Ismajli; “Një strukturë alternative foljore në gjuhën shqipe: ndikimi prej një gjuhe të arealit ballkanik” nga Julie Kolgjini.

Problemeve të morfo-sintaksës, lidhur sidomos me trajtat e shkurtra dhe nyjat si dukuri të kësaj fushe, i kushtohen kumtesat: “Bashkësia e “traj-tave të shkurtra të përemrit vetor” dhe zgjedhimi subjektor-objektor sui generis në gjuhën shqipe dhe në gjuhët ballkanike” nga Remzi Përnaska; “Përsëritja e nyjës para elementeve të sintagmës në shqipe dhe greqishte dhe problemi i nyjës shquese në shqip” nga Aristotel Spiro; “Nyja e prapavendosur në gjuhët e Ballkanit - ngjashmëri dhe dallime morfo-sintaksore” nga Teuta Abrashi. Ndërsa fjalëformimit të gjuhëve ballkanike, si një fushë e lidhur ngushtë me gramatikën, iu kushtuan kumtesat: “Syntactic methods in word formation on the basis of contrastive word formation of the balkan languages” nga Artur Karasiński dhe “Disa ndikime të greqishtes në fjalëformimin foljor të arbërishtes së Italisë” nga Francesco Altimari.

Fushës më të lëvizshme dhe më të ndryshueshme, leksikut, me një vështrim historik të problemeve, i kushtohen kumtesat: “Shqipja dhe gjuhët fqinje” nga Idriz Ajeti; “Saktësime rreth fondit leksikor të

quajtur „rumuno-shqiptar” nga Marcu Gabinski; “Mbi turqizmat në të folmet arbëreshe” nga Matteo Mandala; “Shtresëzimit kronologjik dhe shtrirja dialektore e huazimeve sllave të shqipes së shek. XVII” nga Anila Omari; “Rreth vlerësimit të huazimeve sllave në gjuhën shqipe” nga Xhelal Ylli, “Elementet latine në shqipen dhe rumanishten, vështrim tipologjik dhe semantik” nga Evalda Paci. E lidhur me leksikologjinë, për fushën e frazeologjisë u mbajt kumtesa: “Mallkimi si çështje e frazeologjisë ballkanike” nga Martin Surovčák.

Për fushën e leksikografisë u mbajtën kumtesat: “Korpusi i gjuhës shqipe – rezultatet e para, problemet dhe detyrat” e Nebi Cakës dhe Ali Cakës; “Korpuse gjuhësore për shqipen” nga Besim Kabashi; “Për një fjalor ballkanik të turqizmave” nga Lindita Latifi; “Korpusi i gjuhës shqipe: drejtimet kryesore të punës” e Timofej Arkhangelskijt, Mikhail Danielit, Maria Morozovas dhe Aleksandër Rusakovit; “Shtresimi i huazimeve nga gjuhët ballkanike në një fjalor etimologjik” nga Kolec Topalli. Fushës së fonetikës dhe fonologjisë i kushtohet kumtesa: “Lidhjet fonetike shqipe-ballkanike” nga Irena Sawicka.

Marrëdhëniet ndërmjet gjuhëve ballkanike disa kumtesa i kanë vështruar për një periudhë më të hershme që i kapërcen dy mijëvjeçarët tanë, duke hulumtuar marrëdhëniet gjuhësore edhe ndërmjet gjuhëve që vijnë jetën e tyre nëpërmjet gjuhëve të reja, bijave të tyre. Të tilla janë kumtesat: “*Protoshqipja në mesin e gjuhëve të lashta të Ballkanit*” e Heiner Eichner dhe “*Gjurmë interferimesh emërtimi heleen(iko)-greke, ilir(iko)-albane dhe ital(ik)o-romane në fushë të etnonimisë*” nga Shefki Sejdiu.

Ka pasur kumtesa që marrëdhëniet ndërmjet gjuhëve ballkanike i kanë shikuar në kuadrin dialektor, si ndikime arealesh, siç është kumtesa “*Konsiderata të përgjithshme për rolin e shqipes në formimin e bashkësisë gjuhësore ballkanike*” e Bahri Becit. Nuk kanë munguar as trajtimet për problemet e onomastikës në plan historik. E tillë është kumtesa për fushën e toponimisë “*Gjurmë të latinitetit e të romanitetit ballkanik në mikrotoponiminë e Kosovës*” e Skënder Gashit dhe kumtesa për fushën e antroponimisë “*Ndikime të gjuhës malazeze në shqipen e Malit të Zi*” e Haxhi Shabanit.

Me rëndësi është fakti se marrëdhëniet ndërmjet gjuhëve ballkanike janë trajtuar jo vetëm në planin diakronik, në vështrimin klasik të këtyre studimeve, por ato janë parë edhe si studime aktuale në plan

sinkronik, si ndikime gjuhësh në epokën moderne. Këtë trajtim kanë kumtesat “*Pozita dhe statusi i shqipes kundruall gjuhëve të tjera të Ballkanit*” e Bardh Rugovës; “*Kontaktet ndërgjuhësore ballkanike në rastin e turqizimave*” e Giorgio Buflit, “*Probleme të zbatimit të dygjuhësisë shqip/serbisht në Kosovë*” e Shkumbin Munishit; “*Shqipja dhe maqedoarumanishtja nga aspekti i kontakteve midis tyre*” e Qemal Muratit; “*Shqipja dhe gjuhët e tjera ballkanike në mjetet mësimore të sotme të historisë*” nga Dieter Nehring. Në këtë kuadër janë vështruar edhe ndikimet e shqipes në gjuhët fqinje, që kanë gjetur trajtimin e tyre në kumtesën “*Interferenca të shqipes në gjuhët sllave të jugut*” e Murat Blakut.

Së fundi, në disa kumtesa hodhën një vështrim kritik për vepra shkencore që lidhen me ballkanistikën, sidomos në fushë të dialektologjisë e leksikografisë. Të tilla ishin kumtesat: “*Perceptimi i gjuhës dhe i kulturës shqipe nëpërmjet vëllimeve: “Le terre albanesi redente: Cossovo” (1942) e “Le terre albanesi redente: Ciamuria” (i pabotuar)*” nga Monica Genesin e Domenico Martucci dhe “*Mjaltë” nga hojet dhe trojet e shqipes: Fjalori dorëshkrim shqip-greqisht i Th. Mitkos dhe suaza ballkanike e tij*” e Dhori Qirjazit.

Kjo tematikë kaq e gjerë dhe kaq e larmishme e punimeve të paraqitura në këtë konferencë është dëshmi e interesit që ngjall kjo fushë studimesh, si edhe e punës serioze të gjuhëtarëve nga vende të ndryshme që u paraqitën denjësisht në këtë tubim shkencor. Duke ndjekur tematikën e konferencës, dukuritë dhe problemet e trajtuara mund të grupohen sipas gjuhëve që janë bërë objekt studimi. Disa dukuri që u trajtuan këtu, janë të përgjithshme duke përfshirë të gjitha ose shumicën e gjuhëve ballkanike. Disa dukuri përfshijnë një grup gjuhësh, që lidhen me njëra-tjetrën me arsye gjenetike, siç është rasti i gjuhëve sllave ndërmjet tyre. Më së fundi ka dukuri që shfaqen në vetëm në dy gjuhë të këtij areali, si marrëdhënie historike ose gjeografike (fqinjësie). Të tilla janë marrëdhëniet ndërmjet shqipes e rumanishtes, ndërmjet shqipes e greqishtes, ose ndërmjet turqishtes e gjuhëve të veçanta ballkanike. Kontributet e kumtuesve u pasuruan më tej me diskutimet që u zhvilluan për probleme të veçanta.

Punimet e kësaj konference na dhanë gjithashtu njoftime shpresëdhënëse për hartimin e disa veprave themelore të kësaj fushe ose të atyre që lidhen tërthorazi me të. Të tilla janë: hartimi i korpusit të

gjuhës shqipe, projekti për fjalëformimin ballkanik, fjalori etimologjik i gjuhës shqipe dhe fjalori ballkanik i turqizimave.

Një tjetër aspekt pozitiv i kësaj konference që edhe pjesëmarrja e brezit më të ri të studiuesve të kësaj fushe, gjë që jep shpresa dhe siguri për vijimin e këtyre studimeve në të ardhmen.

Gjatë zhvillimit të kësaj konference u shtruan për zgjidhje shumë probleme që kanë lidhje me bashkëjetesën dhe ndikimet reciproke të gjuhëve ballkanike, u thelluan zgjidhjet e mëparshme me argumente më të plota dhe me fakte të tjera gjuhësore, u parashtruan probleme të reja me mëtimin e zgjidhjes së tyre.

Në mbyllje të këtij aktiviteti sigurisht është shpejt të flasim për vlerësimet dhe rezultatet e tij konkrete shkencore, që më mirë se askush do ta bëjë koha. Por për një gjë jemi të sigurt: konferenca është një hap i madh përpara në studimet albanologjike dhe ballkanistike, që do të hapë perspektiva të tjera për arritje të mëtejshme.

Duke u mbështetur në përvojën tejet pozitive që ka krijuar Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës për publikimin e literaturës albanologjike, shpreh bindjen se punimet e kësaj konference do të gjejnë shumë shpejt rrugën e botimit, gjë që do të jetë një konfirmim i plotë i suksesit të vetë konferencës dhe do të ndihmojë përhapjen dhe përvetësimin e rezultateve të saj nga studiuesit e kësaj fushe.

Në seancën e mbylljes nga të gjithë pjesëmarrësit u shpreh mendimi që gjuhëtarët e Kosovës të kenë statusin e përfaqësuesve zyrtarë të shtetit të Kosovës në Shoqatën e Studimeve të Europës Juglindore, që radhën e ardhshme do të zhvillojë punimet e saj në Turqi. Për këtë u krijua një komision nismëtar prej tre vetësh, i përbërë nga akad. Besim Bokshi, akad. Rexhep Ismajli dhe prof. Bardh Rugova. Komisioni u miratua nga të gjithë pjesëmarrësit.

Urojmë që konferenca me përmasa dhe përgatitje të tilla të zhvillohen edhe në të ardhmen, si shenjë e udhës së mbarë që po merr ballkanistika dhe albanologjia.

TREGUESI I EMRAVE

A

Abrashi, 235, 6, 658, 674
 Acaroğlu, 309, 316
 Adamović, 307
 Adger, 418, 423, 424, 431
 Ahladi, 308
 Aikhenwald, 482
 Aissen, 412, 421, 431
 Ajdačić, 594
 Ajeti, 23, 474, 476, 482, 488, 489,
 543, 547, 607, 5, 8, 16, 38, 50, 68,
 69, 135, 658, 673, 535
 Akay, 315
 Alexiadou, 237, 263
 Altay, 309
 Altimari, 475, 476, 482, 493, 546,
 547, 5, 38, 52, 53, 69, 85, 182,
 658, 673, 91, 476
 Altin, 315
 Ambrosini, 286
 Anamali, 195, 344, 354
 Andersen, 125, 134, 135
 Andreičin, 149
 Andreose, 355
 Andriotis, 108, 116
 Androutsopoulou, 267, 272, 275
 Angelovski, 366, 367, 371, 386
 Anovska, 363, 364, 386
 Apiani, 156
 Arapi, 38, 46, 54, 55, 69,
 Argirovski, 366
 Arkhangelskij, 635, 675, 7, 659
 Aronoff, 496
 Aronson, 481, 482, 495
 Caka, Nebi 643, 675, 7, 659, 643,
 644, 648
 Asan, 149, 150
 Asenova, 102, 113, 116, 119, 122,
 124, 148, 160, 386, 547
 Ashta, 182, 351
 Atanasov, 105, 116, 359, 361, 362,
 364, 379, 381, 386

Auer, 493
 Avram, 182

B

Babel, 493
 Babiniotis, 275
 Bach, 431
 Badallaj, 545, 658, 675, 7, 38, 69
 Bahner, 309
 Bajraktari, 523
 Baker, 241
 Balan, 149
 Baldacci, 602, 603, 605
 Ball, 644, 656
 Balotă, 154
 Banfi, 20, 73, 211, 354
 Banguoğlu, 315
 Banniard, 354
 Barborică, 212
 Bardhi, 45, 54, 60, 61, 128, 133, 555,
 559, 562, 563, 45, 128, 282, 558
 Bariç, cf. Barić 154, 154, 205, 326,
 211, 547
 Barjaktarević, 104, 116, 528, 528
 Barleti, 27
 Barri, 399
 Bartl, 44, 68
 Bartoli, 50, 66, 69, 596, 599, 602,
 604, 607
 Baskakov, 108, 116
 Bečanović, 523
 Beci, 486, 493, 538, 547, 606, 607, 5,
 16, 19, 20, 153, 154, 163, 164,
 166, 167, 173, 199, 211, 419, 673,
 659
 Beerenwinkel, 520
 Bejar, 423, 431
 Belić, 377, 527, 528, 528, 527, 528
 Bello, 374, 386
 Belluscio, 433, 6, 674
 Belmonte, 100
 Belvin, 412, 413, 421, 431
 Benveniste, 31, 32, 400, 51
 Berkeley, 21, 212
 Berrino, 354
 Berwick, 416, 431
 Besch, 61, 69
 Bettini, 602
 Bevington, 246, 247

- Beyrer, 103, 116
 Biçoku, 159
 Bittner, 257
 Bizantini, 158, 159
 Blaku, 525, 525, 528, 530, 543, 6, 7,
 168, 173, 675, 535, 660
 Blass, 149
 Bloomfield, 250, 251
 Boçi, 523
 Boeckx, 431
 Bogdani, 46, 47, 48, 49, 54, 60, 61,
 68, 352, 354, 551, 553, 554, 555,
 557, 558, 559, 560, 561, 562, 564,
 45, 47, 48, 58, 76, 282, 352, 551,
 553, 554, 555, 557, 558, 559
 Bokshi, 29, 475, 476, 482, 493, 547,
 548, 5, 8, 16, 19, 20, 86, 135, 150,
 182, 183, 191, 194, 202, 211, 271,
 275, 403, 404, 405, 658, 661, 673,
 193, 202
 Bonnet, 20, 211
 Bontcheva, 258
 Boretzky, 257, 281, 289, 290, 301,
 307, 315
 Borgia, 602
 Börjars, 246, 236, 237, 238, 244, 251,
 256, 257
 Borries, 520
 Boškosi, 523
 Botezatu, 218
 Bourciez, 341, 354
 Brâncuș, cf. Brënkush, Brîncus, 20,
 155, 156, 185, 186, 187, 188, 189,
 190, 191, 197, 198, 199, 200, 208,
 211, 359, 187, 359
 Breu, cf. Broj 69, 473, 482, 493, 547
 Brixhe, 10, 20, 211
 Brown, 494, 627, 634, 644, 645, 651,
 656
 Bubalo, 523
 Bubenik, 83
 Buchholz, cf. Buholc 102, 110, 116,
 122, 124, 257, 399, 406, 473, 474,
 482, 640, 647, 656
 Budi, 45, 54, 60, 61, 68, 69, 555, 558,
 560, 562, 564, 45, 282, 551, 554,
 555, 558
 Bufli, 289, 6, 674, 660
 Bühler, 241
 Bulo, 610
 Buzuku, 25, 42, 43, 46, 47, 56, 57,
 58, 59, 60, 61, 69, 70, 81, 105,
 108, 116, 128, 406, 493, 555, 556,
 559, 562, 563, 23, 25, 42, 44, 45,
 47, 50, 53, 55, 70, 79, 81, 82, 105,
 128, 282, 287, 352, 476, 493, 556,
 558, 563, 631
 Byron, 493
 C
 Caka, Ali 7, 643, 644, 647, 648, 653,
 643, 656, 659, 675, 659,
 Caka, Nebi 7, 643, 644, 648, 659,
 675, 659
 Calabrese, 417, 418, 431
 Camaj, 44, 68, 70, 419, 474, 482,
 493, 496, 522, 523, 556, 563
 Camarda, cf. Kamarda 193, 211, 273,
 275, 488, 547, 612, 273, 609, 610,
 614, 619
 Candrea, 186
 Capidan, 107, 116, 186
 Carlier, 261
 Catalano, 285
 Călărășu, 212
 Cech, 123, 124
 Ceka, 344, 354
 Chiriacescu, 258
 Chomsky, cf. Çomski, 238, 411, 413,
 414, 415, 416, 417, 426, 431
 Chorikov, 109, 116
 Christidis, 275
 Christophoridou, 274, 275
 Church, 653, 656
 Cimochoowski, 158, 493, 543
 Cinque, 143
 Cioranescu, 291, 294, 297, 301, 330,
 334
 Cipo, 240, 241, 397, 493, 241
 Clairis, 268, 275
 Clairis-Babiniotis, 268
 Conev, 475
 Constantinescu, 321
 Cordignano, 295, 301, 332, 602
 Coteanu, 147, 148, 150
 Coupland, 493
 Cramer, 167
 Creangă, 218

- Culicover, 414, 431
 Cuvata, 361, 363, 365, 366, 367, 368,
 369, 370, 371, 372, 373, 374, 375,
 376, 377, 378, 382, 384, 386
 Сваснѣи, 212
 Стоянов, 117
- Ç
- Çabej, 10, 11, 16, 20, 23, 25, 26, 38,
 60, 69, 75, 76, 77, 86, 89, 108,
 116, 148, 150, 152, 155, 157, 158,
 160, 182, 183, 187, 188, 191, 192,
 193, 194, 200, 205, 211, 233, 268,
 271, 275, 277, 278, 279, 281, 282,
 283, 284, 285, 287, 292, 298, 299,
 301, 302, 307, 308, 309, 315, 316,
 325, 342, 343, 345, 346, 347, 350,
 351, 353, 354, 365, 367, 368, 370,
 373, 375, 376, 386, 387, 476, 488,
 490, 491, 493, 547, 555, 556, 559,
 560, 562, 563, 595, 597, 598, 602,
 604
 Çetta, 493
- D
- Da Lecce, 48, 54, 397, 48, 68, 282,
 315, 285, 559
 Daničić, 121
 Daniel, 496, 635, 675, 7, 659
 Dara, 285
 Darden, 495
 Dazat, 324
 De Rada, 275, 285, 476, 622, 623,
 129, 274
 De Vaan, 182
 Debraekeleer, 149
 Debrunner, 150, 355
 Deçev, 188
 Delavrancea, 123
 Demaj, 523
 Demina, 149
 Demiraj, Bardhyl 5, 37, 45, 66, 68,
 69, 70, 182, 191, 658, 563, 673
 Demiraj, Shaban 5, 16, 19, 20, 30,
 31, 34, 38, 41, 42, 43, 45, 50, 53,
 56, 59, 60, 61, 65, 66, 68, 69, 79,
 82, 86, 125, 129, 135, 247, 148,
 149, 150, 155, 211, 153, 155, 157,
 158, 159, 191, 194, 233, 252, 267,
 271, 275, 301, 315, 351, 354, 399,
 473, 475, 476, 477, 478, 482, 487,
 488, 489, 491, 494, 529, 547, 563,
 673
 Demiri, 523
 Deniaux, 344, 354
 Densusianu, 83, 155, 186, 211
 Desnickaja, 474, 476, 482, 535, 543,
 547, 552, 558, 563, 607
 Detschew, 20, 188, 211
 Devellioğlu, 301
 Di Giovine, 182
 Dikken, 412, 413, 421, 431
 Dimčev, 363, 366, 386
 Dimitrova, 237, 258, 259
 Dimitrova-Vulchanova, 237, 258,
 259
 Dinić, 337
 Dizdari, 183, 280, 289, 290, 292,
 296, 299, 300, 301, 307, 315, 279
 Dobruna, 325
 Dobrunner, 149
 Dokle, 328
 Domi, 16, 17, 20, 38, 64, 69, 187,
 191, 194, 195, 211, 489, 490, 494,
 547
 Domosileckaja, 538, 543
 Donald, 496
 Donhauser, 478
 Dostojevski, 641
 Draga, 501, 523
 Dragidella, 520, 523
 Drini, 25, 563
 Du Nay, 208
 Dubois, 400
 Dumitrescu, 212
 Dumitru, 123, 124
 Dunovski, 363, 380, 384, 386
 Duridanov, 10, 20, 188, 198, 563
 Dzardanos, 119
- Dh
- Dhima, 195
 Dhrimo, 107, 116, 275, 111
- E
- Eichner, 5, 659, 673
 Elezi, 295, 301, 494, 295
 Elsie, 49, 68, 360, 386

- Embick, 416, 431
 Engjëlli, 555
 Ercole, 597, 602, 604
 Erdelja, 522, 523
 Ernout, 352, 354
 Errington, 494
 Evans, 414, 415, 431
 Evciokov, cf. Evsiokov, 132
 135
 Everett, 415, 431
- F
- Fanfani, 98
 Ferguson, 494
 Feuillet, 73, 146, 148, 151
 Fidler, 5, 35, 38, 39, 40, 42, 43, 46,
 51, 53, 56, 57, 59, 60, 61, 62, 63,
 64, 69, 101, 102, 105, 106, 108,
 110, 116, 122, 124, 135, 149, 182,
 257, 406, 473, 474, 475, 476, 482,
 640, 656, 658, 673
 Filan, 308
 Filipaj, 43, 58, 68
 Filippin, 182
 Fishman, 494, 573, 579
 Fishta, 41, 68, 301, 494, 595
 Fitch, 415, 431
 Francis, 627, 634, 643, 645, 648, 656
 Franck, 323
 Frashëri, 275, 365, 371, 384, 513,
 514, 522, 602, 634, 274, 512
 Freges, 248
 Freidin, 431
 Freudenstein, 579
 Friedman, 5, 13, 106, 119, 135, 173,
 243, 244, 259, 381, 382, 386, 474,
 475, 477, 480, 482, 485, 486, 487,
 491, 494, 495, 579, 658, 673
 Fromkin, 238, 251
- G
- Gabinschi, 217, 6, 673
 Gabinski, 182, 659, 547
 Gal, 495, 579, 653, 656
 Ganieva, 109, 116
 Gashi, 317, 495, 543, 6, 7, 68, 674,
 535
 Gazulli, 296, 301, 558, 563
 Genesis, 595, 660, 675, 7, 70, 182
- Georgidas, 308
 Georgiev, 10, 21, 64, 65, 152, 187,
 188, 198, 212, 319, 320, 354
 Gërkoviç, cf. Grković 528
 Gerlach, 236, 237
 Giacomo, 400
 Giordano, 100, 472, 555, 559, 563,
 97, 98, 284, 286
 Giovine Di, 354
 Giusti, 237, 243
- Goga, 279
 Goļab, 308, 363, 365, 366, 383, 475,
 364, 365, 366, 386
 Gološ, 523
 Grandi, 354
 Grannes, 301, 309
 Graur, 123, 124, 148, 200
 Greenberg, 235, 236, 265
 Grijzenhout, 236, 237
 Groussier, 401
 Guagliata, 41, 68
 Guboğlu, 309
 Guboğuz, 315
 Gumperz, 495
 Gusmani, 290, 292, 301, 354
- Gj
- Gjata, 103, 106, 107, 109, 110
 Gjeçovi, 41, 68
 Gjinarri, 488, 489, 494, 543, 607, 68,
 535
- H
- Haarmann, 21, 212, 205
 Hacking, 120, 124
 Hadžibegić, 325
 Hahn, 157, 158
 Hajnal, cf. H12, 21, 206, 212
 Hale, 431
 Halle, 417, 431, 496
 Halpern, 237, 245
 Hammond, 159, 336
 Hamp, 10, 11, 12, 14, 17, 21, 29, 30,
 182, 198, 199, 212, 359, 495, 547
 Handžić, 325
 Hannig, 520
 Harbour, 418, 423, 424, 431
 Harries, 246

- Harrison, 236, 237, 244, 248
 Hasan, 315, 498, 515, 520
 Hasdeu, 186, 212
 Haspelmath, 236, 252, 253, 254, 259
 Haugen, 495
 Hauser, 415, 431
 Hawkins, 260
 Haxhihasani, 84, 97, 100, 286, 538
 Hazen, 495
 Heath, 495
 Heidolph, 250
 Heine, 249, 309
 Heinschink, 123, 124
 Helena, 132, 135
 Herman, 354
 Hetzer, 42, 69
 Himmelmann, 235, 236, 237, 259, 264
 Hinrichs, 69, 116
 Holm, 21, 206, 212
 Holmes, 579
 Hopper, 266
 Hoxha, 378, 495
 Hrushçov, 651
 Hubbard, 275, 482, 496
 Hubschmid, 354
 Huld, 21, 183, 197, 212
 Hymes, 495
- I
- Idrizi, Aljabak, 328
 Iliescu, 153, 354
 Ilievski, 150, 151, 383, 386
 Imami, 563
 Ionescu, 332
 Jordan, 152, 333, 342
 Irimia, 124
 Islami, 158, 173
 Ismajli, Blertë 473, 658
 Ismajli, Rexhep 5, 6, 8, 9, 21, 41, 55, 70, 155, 157, 159, 163, 164, 167, 172, 173, 182, 185, 190, 192, 199, 212, 213, 233, 315, 347, 349, 354, 535, 495, 543, 547, 654, 658, 661, 566, 567, 673, 674, 579
 Ivănescu, 127, 135
 Ivić, 138, 143, 308, 528, 530, 531, 168
- J
- Jackendoff, 414, 415, 425, 431, 432
 Jagić, 327
 Jakobson, 138, 143, 259
 Jankaj, 41, 68
 Janson, 183
 Jastrebov, 334
 Јашар-Настева, 301
 Jelavich, 157
 Jelinek, 415, 431
 Jespersen, 407
 Jireçek, 27, 198, 338
 Jochemas, 100, 91
 Jokl, 11, 21, 25, 30, 64, 150, 152, 183, 191, 213, 337, 359, 474, 488, 534, 535, 543, 547, 556, 562, 563
 Jordan, 354
 Jorga, 359, 387
 Joseph, cf. Jozef 21, 191, 199, 213, 236, 485, 486, 494, 495, 496, 547
 Jungg, 556, 68, 298
 Jusufi, 607
- K
- Kabashi, 7, 182, 627, 631, 632, 634, 659, 675
 Kadare, 474, 631, 634, 650
 Kahane, 496
 Kaiser, 237
 Kakuk, 315
 Kallulli, 241, 263, 494, 241
 Kamarda, cf. Camarda
 Kamsi, 44, 68
 Kappler, 289, 290, 301
 Karaagaç, 315
 Karadafov, 386
 Karapici, 497
 Karasiński, 389, 6, 658, 674
 Katičić, 10, 21, 157, 158, 213, 135, 157
 Kazazis, 315, 44
 Kennedy, 628, 634
 Kerim, 309, 315
 Keyser, 431
 Kieckers, 116
 King, 173, 239, 496
 Kitanoski, 143
 Klagenfurt, 21, 212
 Klemenčič, 213

- Klingenschmitt, 22, 213
 Kloss, 111, 566
 Ködderitsch, 195, 196
 Kolgjini, 485, 496, 6, 658, 674
 Koliqi, 496, 595, 602
 Komata, 195
 Koncert, 631
 Koneski, 104, 110, 112, 116, 120,
 121, 124, 147, 148, 149, 150, 151,
 152, 153, 330, 372, 475
 Kongoli, 474
 König, 236
 Kopitar, 13, 38, 66, 70, 148, 487
 Kostallari, 280, 281, 282, 307, 315,
 579, 279, 280
 Kostić, 334
 Kostov, 112
 Koukkidis, cf. Kukkidis 293, 298,
 308
 Kovačec, 331
 Kovačević, 323, 325
 Kovačić, 121
 Krajni, 278, 282, 307, 315
 Krammer, 163, 164, 173, 487
 Kramsky, 256, 257
 Kratzer, 431
 Kristoforidhi, 274, 512, 513, 559,
 564, 609, 610, 611, 613, 617, 618
 Kristophson, 203, 204, 213
 Kruja, 283, 604, 606
 Krumbacher, 308
 Kryeziu, 329
 Kučera, 627, 634
 Kurti, 602
- L
- La Piana, 148, 194, 213, 267, 275,
 489
 Labov, 496
 Lafe, 325
 Lambertz, 286, 496, 606, 607
 Landi, 196, 197, 213, 354
 Latifi, 303, 6, 315, 659, 674
 Lee, 354
 Lehmann, 266
 Leiss, 254, 257, 260
 Lemnitzer, 628, 634
 Leninit, 651
 Leotti, 94, 97, 295, 301
- Leskien, 109, 116
 Levinson, 414, 415, 431
 Lika, 5, 6, 38, 70, 273, 274, 275, 547
 Lindsted, 22, 213
 Lindstedt, 15, 478, 482
 Livio, 257
 Ljungvik, 150
 Lobel, 309
 Löbner, 262
 Lokotsch, 309
 Lombard, 86, 148
 Lopašov, 149
 Louis, 315
 Luboteni, 563
 Ludmila, 496
 Luisi, 354
 Luka, 50, 397, 526
 Lunt, 112, 116
 Lutovac, 328
 Lyons, 245, 246, 255, 264
- M
- Mackey, 579
 Маслово, 116
 Mahootian, 496
 Majer, 155, 362
 Malcolm, 173
 Malev, 109, 116
 Malina, 594
 Mandalà, 277, 315, 564, 6, 182, 659,
 674
 Mann, 220, 298, 302, 496
 Mansaku, 5, 6, 38, 42, 43, 53, 54, 56,
 64, 70, 71, 128, 135, 158, 344,
 354, 547, 658, 673
 Manzini, 411, 6, 411, 412, 413, 416,
 421, 422, 427, 431, 432, 658, 674
 Marantz, 417, 431
 Maretić, 121, 124
 Maria, 602, 635, 659, 675, 7, 48, 54,
 132, 135, 411
 Maria-Martins, 132
 Marko, 111
 Marković, 675, 7, 363, 365, 370, 371,
 372, 374, 375, 381, 386, 387
 Marlekaj, 553, 554, 564
 Marta, 212
 Martucci, 595, 598, 603, 660, 675, 7
 Maslov, 112, 116, 114
 Mateus, 46, 132, 135

- Matkovski, 364, 387
 Matranga, cf. Matrënga 51, 53, 59, 60, 84, 486, 488, 490, 564
 Matras, 123
 Matzinger, 10, 22, 38, 42, 43, 61, 70, 80, 213, 472
 Maynard, 38, 42, 61, 70, 496
 McEnery, 644, 656
 Meillet, 352
 Meksi, 195
 Memushaj, 107, 116
 Merlo, 597
 Metaj, 302
 Metodi, 127
 Meyer, 42, 70, 153, 155, 183, 203, 280, 294, 298, 299, 302, 307, 308, 315, 360, 367, 368, 377, 387, 533, 543, 564, 623, 555
 Meyer-Lübke, 22, 153, 155, 203, 205, 209, 213
 Mihăescu, 11, 22, 135, 186, 202, 205, 206, 209, 210, 214, 345, 354, 362, 387, 348, 350, 352, 371
 Mihăilă, 206, 214, 319, 320, 322, 330, 336
 Mihăileanu, 109, 116
 Miklošič, 13, 308, 38, 70, 135, 145, 146, 148, 158, 279, 289, 290, 302, 307, 309, 316, 323, 330, 332, 397, 398, 533, 543, 556, 564
 Miller, 496
 Milojević, 327
 Minissi, 139, 143
 Mira, 132, 135
 Mirčev, 104, 107, 116, 147, 148, 149, 150, 152, 153
 Mirdita, 338
 Mišeska-Tomić, 19, 22, 18
 Mitko 609, 610, 611, 612, 613, 614, 615, 616, 617, 618, 619, 620
 Mladenov, 534, 543
 Mladenova, 250, 261
 Mladenović cf. Mladenović, 168
 Montei, 29
 Morozova, 635, 675, 7, 659
 Moser-Philtsov, 103, 116
 Mulaku, 563
 Mulder, 261
 Muljačić, 205
 Munishi, 7, 163, 164, 166, 167, 168, 169, 173, 501, 523, 566, 567, 579, 565, 656, 675, 647, 660
 Murati, 6, 319, 357, 358, 371, 378, 383, 385, 387, 496, 525, 535, 543, 583, 660, 674
 Mustilli, 602
 Müth, 258
 Muzaka, 159
 Myderrizi, 397, 398, 403, 403
 Myers-Scotton, 496

 N
 Nadin, 556, 564
 Nash, 496
 Nastev, 361, 363, 370, 386, 387, 160, 308, 384, 387
 Ndreca, 302, 316
 Nehring, 499, 660, 674, 7
 Németh, 282
 Neroznak, 10, 22, 214
 Nesimi, 547
 Newmark, 240, 241, 272, 275, 302, 473, 482, 496
 Neziri, 496, 653, 656
 Nichols, 422, 432
 Nicolova, 120, 121, 124
 Nikolić, 594
 Nilson, 158
 Nocentini, 354
 Norberg, 355
 Nosić, 291, 292, 293, 296, 302
 Novak, 399
 Nurlu, 309

 Nj
 Njegoš, 121

 O
 Oesterreicher, 236
 Okuka, 168, 171, 173
 Ölberg, 346, 354
 Omari, 7, 45, 49, 68, 354, 525, 535, 538, 543, 552, 564, 551, 659, 675
 Ortmann, 236, 237, 243, 245, 249, 250
 Osmani, 322, 329, 331, 336, 497, 553
 Otero, 431

- P
Paci, 6, 341, 659, 674
Palaj, 602
Paliga, 22, 194, 195, 196, 197, 198, 214
Palmer, 355, 478, 482
Paluca, 602
Pamfil, 212
Papahaghi, 106, 107, 109, 117, 186, 293, 294, 298, 302, 334, 358, 361, 363, 369, 387
Papailia, 360, 384, 387
Papanastasiou, 269, 275
Papanastasiou-Petrounias, 269
Papazoglu, 322
Partee, 431
Paskali, 596
Pättruç, 206, 214
Pavlloviç, cf. Pavlović 160, 528
Pedersen, 148, 213, 274, 275, 497, 547, 76
Pekmezi, 547, 548
Pellegrini, cf. Pelegrini 22, 214, 278, 284, 355
Pengili, 111
Përnaska, 397, 6, 7, 658, 674
Perrot, 407
Pesetsky, 264, 411, 413, 417, 432
Pešikan, 331
Petrela, 122
Petrota, 595, 602
Petrounias, 275
Petrovici, 320, 333
Petruševski, 383, 387
Pettan, 166, 173
Philippide, 63, 70, 186, 214
Piccitto, 100
Pinker, 415, 432
Pipa, 496, 497
Pisani, 152
Pocetti, 355
Poçi, 361, 362, 364, 387
Poghirc, 10, 22, 188, 190, 198, 208, 213, 214
Polák, 154
Polenakoviç, cf. Polenaković, 359, 369, 387
Poli, 355
Pool, 497
Popescu, 236, 237, 243, 245, 249, 250
Popović, 70, 321
Popvasileva, 363, 369, 370, 374, 387
Porzig, 241
Pride, 579
Prifti, 182, 275, 482, 496, 605
Prokshi, 650
Pseud, 158
Pulaha, 336
Pullum, 235, 236, 239, 246, 248, 256
Purnell, 497
Puşcariu, 186, 205
- Q
Qemali, 513
Qirili, 127
Qirjazi, 609, 675, 7, 660
- R
Rå Hauge, 301
Radoja, 41, 54, 55, 68
Radovicka, 497
Rama, 523
Ramat, 71, 135, 355
Redhouse, 302, 621
Reichenkron, 63, 64, 70
Reinhold, 579, 623, 634
Reinkowski, 316
Reiter, 481, 482
Renzi, 355
Ressuli, 563, 602
Rexhepi, 523
Rezac, 423, 431
Ribezzo, 602
Riska, 387
Ristovski, 523
Rivière, 401
Rix, 130, 135
Riza, 22, 30, 75, 78, 79, 86, 148, 193, 201, 202, 214, 267, 271, 274, 275, 406, 474, 478, 482, 497, 547, 548, 549, 550, 478, 549
Rocchi, 302
Rohlf, 85, 152, 547
Romaine, 497
Roques, 129
Rosetti, 20, 152, 187, 188, 206, 211, 213, 214, 215, 219, 333, 337

- Rostaing, 324
 Roxândoiu, 212
 Rugova, 5, 7, 163, 172, 173, 660, 661, 673
 Rusakov, 635, 675, 7, 659
 Rusek, 149
 Rushi, 399
 Russu, 186, 188, 189, 195, 196, 198, 200, 215, 333
- Rr
- Rrota, 352, 355, 497
- S
- Șăineanu, 291, 302, 309
 Sala, 153, 154, 215, 355
 Samara, 307, 316
 Sandfeld, 13, 22, 30, 31, 36, 38, 39, 62, 64, 70, 78, 79, 82, 127, 129, 130, 131, 135, 146, 147, 148, 149, 150, 151, 152, 156, 215, 280, 488, 547, 601, 657
 Santini, 355
 Santori, 285
 Saramandu, 149, 150
 Sasse, 51, 68, 108, 117
 Savoia, 6, 411, 412, 413, 416, 421, 422, 427, 431, 432, 547, 658, 674
 Sawicka, 5, 17, 137, 139, 143, 182, 481, 483, 659, 673
 Scărlatoiu, 333
 Schaller, 62, 70, 146, 147, 148
 Schirò, 285, 286, 596, 598, 602, 603, 604, 605
 Schleicher, 13
 Schlösser, 355
 Schmaus, 26, 474
 Schmid, 355
 Schneider, 497
 Schramm, 215
 Schrijnen, 596, 599, 607
 Schrodt, 478
 Schumacher, 22, 199, 200, 201, 202, 215
 Schütz, 316
 Schwyzer, 130, 135
 Sciullo, 431
 Sejdiu, 221, 5, 6, 221, 659, 674
 Selišček, 149, 398, 534, 564
- Simeonov, 139, 143, 320, 324
 Sirotkin, 109, 117
 Skalička, 74
 Škaljić, 292, 293, 296, 299, 302, 307, 316
 Skiroit, 285
 Skok, 152, 154, 322, 326, 336, 384, 387, 529, 534, 543, 555, 564
 Sobolev, 537, 538, 540
 Sofia, 21
 Solovjev, 334
 Solta, 22, 38, 39, 60, 62, 63, 64, 70, 135, 146, 160, 215
 Sornicola, 100
 Spiro, 267, 6, 194, 272, 273, 276, 658, 674
 Spolsky, 497
 Stachowsski, 282
 Stanišić, 526, 531
 Starauschik, 520
 Stark, 254, 260
 Stevanović, 121, 124, 525, 526, 527, 528, 529, 530, 564
 Stevanović, 527, 528, 529, 527, 529, 526
 Stijović, 322
 Stojanov, 104, 117, 149
 Stojanović, 523
 Stolz, 355
 Straboni, 158, 159, 156
 Süleymanoğlu, 301
 Surovčák, 585, 659, 675, 7
 Surroi, 173, 170
 Svane, 11, 22, 45, 68, 69, 135, 206, 215
 Svane, 543, 552, 560, 562, 564, 535, 552
- Sh
- Shabani, 523, 581, 675, 7, 171, 173, 659
 Shaller, 547
 Shepard, 497
 Sheperi, 398, 399, 497, 612
 Shkurtaj, 490, 494, 497, 556, 564, 607
 Shumaker, 547
 Shuteriqi, 41, 497

- Š
Šafarik, 330, 331
- T
Tagliavini, 215, 595, 597, 602, 603, 604, 605, 606, 607, 595, 603, 604, 605, 607
Tahsini, 513
Tasmowski, 263, 494
Teodorov–Balan, 124, 120
Theodorescu, 212
Thieroff, 479, 482, 483
Thomason, 579
Thumb, 104, 117, 148, 183
Thunmann, 13, 156, 157, 219
Toma, 212, 497
Tomić, cf Tomiq 168, 173, 237, 258, 259, 251, 252, 256, 257, 259
Topalli, 5, 7, 8, 38, 41, 54, 70, 86, 107, 110, 155, 175, 183, 267, 271, 272, 276, 474, 476, 477, 483, 497, 547, 657, 659, 673, 675
Topolinska, 259, 260
Torrego, 264, 411, 413, 417, 432
Totoni, 84, 399, 490
Trajanovski, 366, 374, 375, 378, 382, 384, 387
Traugott, 266
Triantafillidis, cf Triandafillidhi, Triantaphyllidēs, Triantaphyllidēs, Triantaphyllidēs, 10, 107, 112, 117, 273, 276, 308, 529
Trudgill, 493, 496, 497
Tukididi, 158, 159, 158
Турецко, 116
Tzartzanos, 112, 117, 124
- U
Urciuoli, 498
- V
Väänänen, 355
Vaillant, 152, 529
Vajzovič, 316
Valentini, 602
Valter, 406
Variboba, 100, 94, 129
Varvaro, 100, 355
Vasmer, 375, 534, 544, 564
- Vătășescu, 197, 215
Veljanovski, 523
Veqilharxhi, 512
Vidi, 514
Vinogradov, 121, 124
Vlora, 158, 602
Vokshi, 397, 498
von Harff, 42, 70, 128, 79, 80
von Heusinger, 258
Vraciu, 10, 22, 188, 215
Vreto, 512, 513, 614
Vujović, 525, 526, 528, 529, 532, 526, 528, 531, 532, 526
Vuković, 153
Vuk, 121
Vulchanova, 243, 258
Vulić, 325
- W
Wackernagel, 126, 134, 135, 240, 241, 245, 256
Wassa, 398
Weigand, 14, 38, 64, 70, 146, 149, 189, 205, 332, 357
Welo, 258
Wendt, 309
Werner, 254, 260
Wilder, 237
Wilkins, 432
Wilson, 644, 656
Woolard, 498
Wynne, 632, 634
- X
Xoxi, 359, 387
- Xh
Xhanari, 303
Xhufi, 159, 160
Xhuvani, 16, 191, 308, 309, 316, 387, 498, 548
- Y
Yaeger-Dror, 498
Yaşar, 316
Ylli, 465, 466, 535, 537, 538, 540, 544, 564, 533, 659, 675, 7, 11, 22, 206, 215, 552

Z

Zajmi, 563, 566

Zalizinjaku, 637

Zasorina, 651, 656

Zentella, 498

Zinsmeister, 634

Zmajevikut, 55

Zolta, 146

Zubizarreta, 431

Žugra, 38, 538, 543

Zwicky, 235, 236, 239, 246, 248, 256

Zymberi, 498

Zh

Zhugra, 38, 51, 70

Βρέτος, 622

Ганиева, 116

Дуриданов, 215

Καμάρδα, 621, 622

Κουκκίδης, 301

Κουλουριώτης, 622

Κουπιτώρης, 622

Σαμί Βέη, 622

Τλουπα, 594

Χριστοφορίδης, 622

Баскаков, 116

Вуковић, 594

Десницкой, 143

Китевски, 594

Крумова–Цветкова, 594

Лопашов, 398

Милисавац, 594

Радовановић, 379, 387

Селищев, 543

Симеонов, 143

Славейков, 594

Соболев, 543, 544

Pamje nga punimet e Konferencës

















PËRMBAJTJA

Rexhep ISMAJLI , Prishtinë: <i>Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit – fjala e hapjes</i>	9
Idriz AJETI , Prishtinë: <i>Shqipja dhe gjuhët fqinje</i>	23
Besim BOKSHI , Prishtinë: <i>Format e futurit të shqipes në raport me gjuhët e Ballkanit</i>	29
Bardhyl DEMIRAJ , München: <i>Velle futurum si dukuri dialektore dhe ballkanike në gjuhën shqipe</i>	37
Seit MANSAKU , Tiranë: <i>Tipologji romane dhe ballkanike në strukturën gramatikore të shqipes</i>	71
Francesco ALTIMARI , Cosenza: <i>Disa ndikime të greqishtes në fjalëformimin foljor të arbërishtes</i>	91
Wilfried FIEDLER , Meissen: <i>Disa veçori të urdhërores në gjuhët ballkanike</i>	101
Victor FRIEDMAN , Chicago: <i>Problemi i urdhërores treguese në gjuhën shqipe dhe në gjuhët e tjera të Ballkanit</i>	119
Shaban DEMIRAJ , Tiranë: <i>Ç’ dëshmon mënjanimi i paskajores në gjuhët ballkanike?</i>	125
Irena SAWICKA , Warszawa: <i>Lidhjet fonetike të shqipes në kontekst ballkanik</i>	137
Bahri BEÇI , Paris: <i>Konsiderata të përgjithshme për rolin e shqipes në formimin e bashkësisë gjuhësore ballkanike</i>	145
Bardh RUGOVA , Prishtinë: <i>Pozita dhe statusi i shqipes kundruall gjuhëve të tjera të Ballkanit</i>	
Kolec TOPALLI , Tiranë: <i>Shtresimi i huazimeve nga gjuhët ballkanike në një fjalor etimologjik</i>	
Rexhep ISMAJLI , Prishtinë: <i>Shqipja dhe rumanishtja</i>	185
Marcus GABINSCHI , Chişinău: <i>Saktësime rreth fondit leksikor të quajtur “rumuno-shqiptar”</i>	217

- Shefki **SEJDIU**, Prishtinë: *Gjurmë interferimesh emërtimi helen(iko)-greke, ilir(iko)-albane dhe ital(iko)-romane në fushë të etnonimisë*..... 221
- Teuta **ABRASHI**, Prishtinë: *Nyja e prapavendosur në gjuhët e Ballkanit – ngjashmëri dhe dallime morfosintaksore* 235
- Aristotel **SPIRO**, Tiranë: *Përsëritja e nyjës para elementeve të sintagmës në shqipe dhe greqishte dhe problemi i nyjës shquese në shqipe*..... 267
- Matteo **MANDALÀ**, Palermo: *Mbi turqizmat në të folmet arbëreshe* 277
- Gjorgji **BUFLI**, Trieste: *Kontaktet ndërgjuhësore ballkanike në rastin e turqizmeve* 289
- Lindita **LATIFI (XHANARI)**, Tiranë: *Për një fjalor ballkanik të turqizmeve* 303
- Skender **GASHI**, Wien: *Gjurmë të latinitetit e të romanitetit ballkanik në mikrotoponiminë e Kosovës*..... 317
- Evalda **PACI**, Tiranë: *Elemente latine në shqipen dhe rumanishten, veshtrim semantik dhe tipologjik*..... 341
- Qemal **MURATI**, Prishtinë: *Shqipja dhe maqedoarumanishtja nga aspekti i kontakteve midis tyre*..... 357
- Artur **KARASIŃSKI**, Torunj: *Një projekt për fjalëformimin ballkanik* 389
- Remzi **PËRNASKA**, Paris: *Bashkësia e “trajtave të shkurtra të përemrit vetor” dhe zgjedhimi subjektor-objektor sui generis në gjuhën shqipe dhe në gjuhët ballkanike*..... 397
- Leonardo **SAVOIA** & Rita **MANZINI**, Firenze: *Case as Nominal Property: the Interaction of DOM and Discourse-linking in Shkodër Pronouns*..... 411
- Giovanni **BELLUSCIO**, Cosenza: *Si shqiptohet shqipja në Ballkan?* 433
- Blertë **ISMAJLI**, Prishtinë: *Sa ballkanike janë mënyrat e foljeve të shqipes? Kushtorja dhe habitorja*..... 473
- Julie **KOLGJINI**, Prishtinë: *Një strukturë alternative foljore në gjuhën shqipe: ndikimi prej një gjuhe të arealit ballkanik*..... 485
- Dieter **NEHRING**, Berlin: *Shqipja dhe gjuhët ballkanike në arsimin shkollor tek shqiptarët dhe fqinjët e tyre* 499

Murat BLAKU , Prishtinë: <i>Interferenca të shqipes në gjuhët sllave të jugut</i>	525
Xhelal YLLI , Heidelberg: <i>Rreth vlerësimit të huazimeve sllave në gjuhën shqipe</i>	533
Imri BADALLAJ , Prishtinë: <i>Infinitivi në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe</i>	545
Anila OMARI , Tiranë: <i>Shtresëzimit kronologjik dhe shtrirja dialektore e huazimeve sllave të shqipes së shek. XVII</i>	551
Shkumbin MUNISHI , Prishtinë: <i>Probleme të zbatimit të dygjuhësisë shqip/serbisht në Kosovë</i>	565
Haxhi SHABANI , Ulqin: <i>Ndikimi i gjuhës malazeze në emrat dhe mbiemrat e njerëzve</i>	581
Martin SUROVČÁK , Brno: <i>Mallkimi si çështje e frazeologjisë ballkanike</i>	585
Monica GENESIN & Domenico MARTUCCI , Bari: <i>Perceptimi i gjuhës dhe i kulturës shqipe nëpërmjet vëllimeve: “Le terre albanesi redenti: Cossovo” (1942) dhe “Le terre albanesi redenti: Ciamuria” (i pabotuar)</i>	595
Dhori QIRJAZI , Selanik: <i>“Mjaltë” nga hojet dhe trojet e shqipes: Fjalori dorëshkrim shqip-greqisht i Th. Mitkos dhe suaza e tij ballkanike</i>	609
Besim KABASHI , Erlangen: <i>Korpuse gjuhësore për shqipen</i>	627
Timofej ARKHANGELSKIJ , Moskva/ Mikhail DANIEL , Moskva/ Maria MOROZOVA , S.-Peterburg/ Aleksandër RUSAKOV , S.-Peterburg: <i>Korpusi i gjuhës shqipe: drejtimet kryesore të punës</i>	635
Nebi CAKA , Ali CAKA , Prishtinë: <i>Korpusi i gjuhës shqipe – rezultatet e para, problemet dhe detyrat</i>	643
Kolec TOPALLI , Tiranë: <i>Fjala e mbylljes e Konferencës</i>	657
Treguesi i emrave.....	662
Përmbajtja.....	681

**SHQIPJA DHE GJUHËT E BALLKANIT
ALBANIAN AND BALKAN LANGUAGES
2012**

Botues
AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

Lektor:
Shefqet Riza

Redaktor teknik:
Taulant Veseli

Realizimi kompjuterik:
ASHAK

Madhësia: 42 tabakë shtypi
Tirazhi: 300 copë
Formati: 16x24 cm

Shtypi:
Fokus Print
Shkup

Katalogimi në publikim - (CIP)
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

811.18-26(496.51)(063)
811.135-26(496.51)(063)

Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit : Konferencë shkencore e mbajtur më 10-11 nëntor 2011 në Prishtinë / redaktor Rexhep Ismajli. - Prishtinë : Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, 2012.- 684 f. ; 24 cm

Titulli paralel në gjuhën shqipe dhe angleze. Treguesi i emrave : f. 662-672

1. Ismajli, Rexhep

ISBN 978-9951-615-03-7